

**VENDIME
TË PËRZGJEDHURA
TË GJYKATËS SË LARTË
2021 – 2023**



**GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS SË LARTË 2021-2023



**GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

MAJ 2024

© Të drejtat e autorit në lidhje me përmbajtjen e këtij botimi, duke përfshirë
tekstin dhe fotot e përdorura, i takojnë Gjykatës së Lartë.
Tiranë, 2024

Përgatiti Aulona Hazbiu
Faqosja dhe kopertina Maluka print
Shtypur në Shqipëri nga "Maluka"

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

TABELA E SHKURTIMEVE

| | |
|-----------------------------|---|
| ATP | Agjencia e Trajtimit të Pronave |
| AKKP | Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës |
| EKB | Entit Kombëtar të Banesave |
| GJKKO | Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar |
| GJEDNJ | Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut |
| IEVP | Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale |
| KC | Kodi Civil |
| KDPM | Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur |
| KD | Kodi Doganor |
| KEDNJ | Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut |
| ish-KKKP | ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, |
| KAGJL | Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë |
| KCGJL | Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë |
| KPGJL | Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë |
| KPA | Kodi i Procedurës Administrative |
| KP | Kodi i Punës |
| K.Penal | Kodi Penal |
| KPP | Kodi i Procedurës Penale |
| KRR | Kodi Rrugor |
| OPGJ | Oficer e Policia Gjyqësore |
| Prokuroria e Posaçme | Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar |
| ZRKKP | Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave |
| ZVRPP | Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme |
| VKAGJL | Vendim Kolegj Administrativ Gjykatë e Lartë |
| VKCGJL | Vendim Kolegj Civil i Gjykatës së Lartë |
| VKPGJL | Vendim Kolegj Penal i Gjykatës së Lartë |

PËRMBAJTJA

| | |
|---|------------|
| TABELA E SHKURTIMEVE | 3 |
| PJESA E PARË: Kolegji Administrativ | 8 |
| I. Mosmarrëveshje mbi kompetencën lëndore | 8 |
| 1. Vendim Njësues Nr. 00-2023-3628 (302), datë 22.09.2023 (Dallimi Kontrata Administrative dhe Private) | |
| 2. Vendim Nr.31003-208-2021, datë 07.05.2021 (Dallimi: Korigjim Dhënash në Regjistra Publikë/Vërtetim Gjyqësisht Fakti Juridik) | |
| 3. Vendim Njësues Nr. 00-2023-3406(258), datë 07.07.2023 (Marrëdhënie pune: mesues sistem arsimor publik parauniversitar) | |
| 4. Vendim Nr.00-2023 -3080 (291), datë 14.09.2023 (Marrëdhënie pune: shërbim civil) | |
| 5. Vendim Njësues Nr. 00-2021-1215, datë 15.07.2021 (Marrëdhënie pune: policia e shtetit) | |
| 6. Vendim Nr.00-2023-2000 (311), datë 20.09.2023 (Marrëdhënie pune: policia e burgjeve) | |
| 7. Vendim Nr.00-2022-1598 (268), datë 07.07.2022 (Marrëdhënie pune: funksionar i veçantë politik) | |
| II. Juridiksioni Administrativ | 60 |
| 1. Vendim Njësues Nr. 00-2021-1317, datë 22.07.2021 (Kundërshtim vendimi, KMCAE Epror) | |
| 2. Vendim Nr. 00-2022-896 (150), datë 11.04.2022 (Ezaurim rruge administrative sipas Kodit Doganor) | |
| III. E drejta e Ankimit | 83 |
| 1. Vendim 00-2021-418, datë 25.03.2021 (Dënim plotësues: pezullim leje drejtim automjeti) | |
| 2. Vendim Njësues nr.00-2023-4279(259), datë 07.07.2023 (Rivendosje në afat) | |
| IV. Mosmarrëveshje mbi Aktin Normativ Nënligjor | 95 |
| 1. Vendim Nr. 00-2021-1938 (243), datë 22.11.2021 (Legjitimiteti) | |
| 2. Vendim Nr. 00-2022-3236 (415), datë 11.02.20233 (Pezullim Akt Normativ Nënligjor) | |
| V. Pavlefshmëri akti administrativ | 103 |
| 1. Vendim Nr.00 – 2022 – 590 (81), datë 25.02.2022 (AMPT) | |
| 2. Vendim Nr.00-2023-2494 (175), datë 11.05.2023 (Mosmarrëveshje fushën tatimore) | |
| 3. Vendim Nr.00-2023-2210(195), datë 01.06.2023 (Arkëtim shuma monetare: gjetje audit) | |
| VI. Kontrata Publike | 114 |
| 1. Vendim Nr.00-2021-2049(260), datë 02.12.2021 (Dallimi: Kusht penal vlerësues-kusht penal gjabor) | |
| VII. Dëm Jashtëkontraktor | 117 |
| 1. Vendim nr.00-2023-3348(275), datë 26.07.2023 (Parashkim padie) | |

VIII. Mosmarrëveshje e Drejta e Pronës 122

1. Vendim Nr. 00-2022-928 (225), datë 02.06.2022 (Shpronësimi publik)
2. Vendim Nr. 00-2022-1200 (245), datë 16.06.2022 (Privatizim prone)
3. Vendim Nr. 00-2022-326 (71), datë 24.02.2022 (Vlerësim financiar prone -ATP)
4. Vendim Nr. 00-2023-1509 (116), datë 04.04.2023 (Refuzim regjistrim prone- ASHK)
5. Vendim Nr. 00-2023-145 (27), datë 20.01.2023 (Kufizim pasurie- ASHK)
6. Vendim Nr.00-2023-3142(128), datë 07.04.2023 (AMTP: Bashkëndërgjyqësi pasive e detyrueshme)

IX. Prokurimi Publik 138

1. Vendim Nr.00-2023-376(42), datë 07.02.2023 (Rishikim kushte kontrate)
2. Vendim Nr.00-2022-1851 (284), datë 18.07.2022 (Mospërbushje detyrime kontraktore)

PJESA E DYTË: Kolegji Civil 150

I. Mosmarrëveshje mbi kompetencën lëndore..... 150

1. Vendim me nr.00-2023-932, datë 22.02.2023 (Dallimi Kontrata Publike dhe Private)
2. Vendim nr.00-2022-3710(484), datë 16.11.2022 (Kompensim për burgim të padrejtë)
3. Vendimin nr.00-2023-3114, datë 26.07.2023 (Lëshim urdhër ekzekutimi)

II. Juridiksioni Civil 162

1. Vendim Nr.00-2022-964(169), datë 04.05.2022 (Vërtetimi gjyqësor fakti juridik vjetërsi në punë)
2. Vendim Nr.00-2023-2782, datë 31.05.2023 (Çështje familjare: Lënie e fëmijës edukim/rritje)
3. Vendim Nr.00-2021-181, datë 10.02.2021 (Sigurim i Padisë)

III. E Drejta Ankimit/Rekursit/Rishikimit të vendimit..... 178

1. Vendim Nr.00-2023-227(49), datë 01.02.2023 (Afat ankimi pavlefshmëri titulli ekzekutiv)
2. Vendim Njësues Nr. 00-2022-4586(392), datë 26.10.2022 (Afat ankimi veprimet përmbartore)
3. Vendim Kolegjet e Bashkuara Gjykatë e Lartë Nr.1, datë 16.12.2022 (Rishikim vendimi)

IV. Dëm Jashtëkontraktor 201

1. Vendim Nr.00-2022-917(44), datë 01.02.2023 (Afat parashkrimit)
2. Vendim Nr.00-2023-3102(472), datë 19.07.2023 (Llogaritje dëmi në aksidente automobilistike)

V. Marrëdhënie Kontraktore 211

1. Vendimi Nr.00-2023-1888(302), datë 11.05.2023 (Pavlefshmëria e kontratës)
2. Vendim Nr.00-2023-2583(312), datë 16.05.2023 (Dallimi: kusht penal vlerësues-kusht penal gjabor)
3. Vendim Njësues nr.00-2023-4411(106), datë 02.03.2023 (Kontrata e dorëzarisë)

VI. Mosmarrëveshje në Marrëdhënie Pune 238

1. Vendim Nr.00-2023-233(43), datë 01.02.2023 (Kontratë Kolektive: zgjidhje kontrate)
2. Vendim Nr.00-2023-465(59), datë 15.02.2023 (Dëshmipërblim zgjidhje kontrate afat të caktuar/pacaktuar)
3. Vendim Nr.00-2023-1832(287), datë 11.05.2023 (Afat njoftimi)

VII. Mosmarrëveshje e Drejta e Pronës 251

1. Vendim Nr.00-2021-1857, datë 15.11.2021 (Vlerësim financiar/ATP)
2. Vendim Nr.00-2022-4480(578), datë 21.12.2022 (Vendim KKKP: e drejta parablerjes)
3. Vendim Nr.00-2023-469(58), datë 15.02.2023 (Padi mohuese-karakteristikat)
4. Vendimin Njësues Nr.00-2022-4596(393), datë 26.10.2022 (Parashkim fitues me titull)

VIII. Bashkëpronësia 285

1. Vendim Nr.00-2022-63(9), datë 12.1.2022 (Pjesëtimi në bashkëpronësi-fazat)
2. Vendim Nr.00-2022-1381(165), datë 29.04.2022 (Lirim dorëzim sendi-bashkëpronar)
3. Vendim Nr.00-2021-139, datë 03.03.2021 (Gjyqvarësia)

IX. Mosmarrëveshje trashëgimie 300

1. Vendim Nr.00-2023-1002(161), datë 27.03.2023 (Përrjashtim trashëgimtar ligjor)
2. Vendimin Nr.00-2023-3267(399), datë 20.06.2023 (Rrethi trashëgimtarëve me zëvendësim)

PJESA E TRETË: Kolegj Penal 311

I. Mosmarrëveshje mbi kompetencën lëndore 311

1. Vendim Njësues Nr.00-2021-712 (23), datë 27.07.2021 (Viktima akuzuese në rastet e shpifjes)
2. Vendim Njësues Nr.00-2021-1120(55), datë 13.10.2021 (Masa sigurimi gjykata jo kompetente-Moskompetencë prokuror gjatë hetimeve paraprake)
3. Vendimi Njësues Nr.00-2022-1036(114), datë 07.04.2022 (Rehabilitimi i të dënuarit)
4. Vendim Njësues Nr.00-2023-470(4), datë 12.01.2023 (Gjykimi i çështjeve në fazën e ekzekutimit të vendimit)
5. Vendim Nr.00-2023-1020, datë 20.6.2023 (Shuarje masë sigurimi)

II. Gjyqtari i seancës paraprake 353

1. Vendim Njësues Nr. 00-2021-1134(62), datë 01.01.2021 (Afatet e paraburgimit)
2. Vendim Nr.00-2022-115(53), datë 18.02.2022 (Dallimi kompetencë gjyqtar seancë paraprake-gjyqtar themeli)
3. Vendim Nr.00-2023-40, datë 17.01.2023 (Plotësim hetimi/zgjatje afateve të paraburgimit)
4. Vendim Nr.00-2023-94(23), datë 19.01.2023 (Pushim akuze: ndalim vlerësim provave)

III. Gjykimi i shkurtuar 373

1. Vendim Nr.00-2022-657(175), datë 21.06.2022 (Shqyrtimi në apel i vendimit të pafajsisë së shkallës së parë)
2. Vendim Nr.00-2023-1078(191), datë 30.06.2023 (Mosrëndimipozitëssë të pandehurit ngaj gjykatari shikuese)

IV. Gjykimi në mungesë 394

1. Vendim Kolegjet e Bashkuara Nr.2, datë 18.01.2022 (Rivendosje në afat)

V. Masat e sigurimit 406

1. Vendim Njësues Nr.00-2021-1135(147), datë 23.12.2021 (Sekuestrimi i të dhënave kompiuterike)
2. Vendim Njësues Nr.00-2022-1823(332), datë 15.12.2022 (Detyrueshmëria e mendimit të prokurorit/ ndryshimit të qëndrimit kur s'është bërë ankim)
3. Vendim Nr.00-2022-1235 (261), datë 13.10.2022 (Llogaritje afat paraburgimi)
4. Vendim Nr.00-2023-1313(224), datë 25.07.2023 (Arrest burg: përkatësi minoriteti)

VI. Ekzekutimi i dënimit 436

1. Vendim Kolegjet e Bashkuara Nr.1, datë 28.10.2022 (Parashkrimi i ekzekutimit të vendimit)

VII. Ekstradimi 443

1. Vendim Nr.00-2023-980(139), datë 25.04.2023 (Moslejim ekstradimi: mosdhënie garancie shteti kërkues)
2. Vendim Nr.00-2023-1099(195), datë 30.06.2023 (Mosidentifikimi i personit të kërkuar në gjykim)

VIII. Analizë e elementëve të veprave të ndryshme penale..... 453

1. Vendim Nr.00-2021-483, datë 06.07.2021 (Dhuna në familje: klasifikimi i veprës penale)
2. Vendim Nr.00-2022-68(47), datë 17.02.2022 (Shërdorimi i detyrës: ndarja përgjegjësi penale/ administrative)
3. Vendim Nr.00-2023-35(10), datë 17.01.2023 (Shpërdorimi i detyrës: Dashja/vetëdija)
4. Vendim Nr.00-2023-1169(202), datë 06.07.2023 (Mashtrimi: elementët të kualifikimit)
5. Vendim Nr.00-2023-406(76), datë 21.03.2023 (Falsifikim dokumentesh: aplikim gjyqtar KPA)
6. Vendim Nr.00-2023-1569(215), datë 24.07.2023 (Deklarim i rremë: formular vetëdeklarimi dekriminalizim)
7. Vendim Njësues Nr.00-2022-1679(217), datë 27.07.2022 (Trafikimi qënieve njerëzore)

I. Mosmarrëveshje mbi kompetencën lëndore

KAGJL Vendim Nr. 00-2023-3628 (302), datë 22.09.2023 (Dallimi Kontrata Administrative dhe Private)

Së pari: Një kontratë do të konsiderohet administrative, kur krahas pranisë si palë të një organi publik (kriteri organik) verifikohet domosdoshmërisht edhe krijimi, ndryshimi apo shuarja e një marrëdhënie juridike konkrete, për shkak të zbatimit të normave të së drejtës publike (kriteri material), në funksion të një shërbimi publik dhe të realizimit të një interesi publik, të cilit i shërben. Për rrjedhojë, është edhe natyra juridike (shkaku ligjor i mosmarrëveshjes në gjykim), që do të përcaktojë gjykatën kompetente.

Së dyti: Elemente kryesorë përcaktues për identifikimin e një kontrate administrative janë: shërbimi në interesin publik, që përbën shkakun e kontratës; kufizimi i lirisë kontraktore; epërsia e organit publik, në kuptim të kufizimit të vullnetit kontraktor të palës tjetër për kushte të caktuara të panegociueshme të kontratës, të rregulluara nga e drejta publike; karakteri specifik i kontratës, lidhur me të drejtën e organit publik për tërheqje të njëanshme nga kontrata, kur nuk arrihet marrëveshja për ndryshim ose prishje të saj, kundrejt detyrimit për t'i paguar palës private dëmin e shkaktuar.

Së treti: Në një kontratë administrative palët qëndrojnë në raport me njëra-tjetrën në një marrëdhënie që imponohet nga parimi i ushtrimit të fuqisë/pushtetit sovran, ku mbajtësi i këtij sovraniteti bazohet te kuadri normativ i së drejtës publike. Kontrata është administrative, kur pavarësisht pjesëve të saj që normohen nga e drejta private, evidentohet qartë se rregullimi në tërësi i saj nga normat e së drejtës publike peshon më shumë.

Së katërti: Dallimi mes kontratës publike dhe private, në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore, bëhet jo nëpërmjet leximit literalisht të kontratës, por nëpërmjet analizës në thelb të përmbajtjes së saj dhe natyrës së mosmarrëveshjes. Objekti, qëllimi dhe normat, që rregullojnë marrëdhënien juridike, duhet të evidentohen qartë si nga palët në proces, ashtu edhe në analizën dhe konkluzionin, që nxjerr gjykata lidhur me këtë çështje. Kontrata e privatizimit të banesave shtetërore, në kuptim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa” ka elementet e një kontrate administrative. Megjithatë, për të përcaktuar gjykatën kompetente për shqyrtimin e një mosmarrëveshje, në të cilën vihet në diskutim një kontratë privatizimi banese, përcaktuese do të jetë natyra juridike e mosmarrëveshjes dhe kërkimet konkrete të palëve. Nëse pala kundërshton kontratën administrative, për shkak se bie ndesh me normat e të drejtës publike dhe ka për pasojë kthimin e pronës tek organi publik, kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes është gjykata administrative. Nëse një person i tretë, që nuk është palë në kontratë, kërkon njohjen pronar apo bashkëpronar mbi banesën e privatizuar nga pala tjetër, sipas ligjeve të mësipërme, pavarësisht se në mënyrë të tërthortë ngre pretendime edhe për vlefshmërinë e kontratës së privatizimit, mosmarrëveshja në këtë rast është e natyrës civile dhe shqyrtimi i saj është në kompetencën e gjykatës civile.

Fjalë kyçe: Ent Kombëtar Banese, organ publik, kontrata e shitjes së banesave sociale, kontratë privatizimi, kontratë administrative, kontratë private.

Rrethanat e çështjes:

Paditësi K.T. ka pasur në posedim një apartament banimi, me sipërfaqe 228 m², ndodhur në katin përdhe të godinës 4 katëshe të ish Shkollës së Partisë Tiranë. Në bazë të VKM nr. 678, datë 18.06.2009 “Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të [...] dhe ish Shkollës së Partisë, Tiranë”, (në vijim VKM nr. 678/2009), objekti në përdorim të paditësit, sikurse edhe objektet e tjera, ka kaluar në fond banesash të EKB, me qëllim privatizimin në favor të personave, që i kishin në përdorim sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të VKM nr. 678/2009 dhe udhëzimit nr. 17, datë 17.10.2012 “Për procedurat e shitjes së banesave, pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë[...], për EKB për qëllime privatizimi” të ndryshuar, EKB ka filluar procedurën e privatizimit të objektit në posedim të paditësit. Rezultoni që, midis EKB, me cilësinë e shitësit dhe shtetasve K.T. e M.T. (bashkëshortja e paditësit), me cilësinë e blerësve është lidhur “Kontrata e shitjes me rezervë e pronës” me nr. 2306/1 rep., nr. 858/1 kol., datë 11.07.2011, me vlerë të plotë e detyrimit financiar ...në shumën 1.374.722 lekë. Shlyerja e vlerës së plotë të çmimit nga paditësi është parashikuar të kryhet brenda një periudhe 25 vjeçare, me këste mujore të barabarta, ndërsa interesi është përcaktuar 2% në vit...

Ndërkohë, me anë të VKM nr. 367, datë 18.04.2013 “Për një ndryshim në VKM nr. 678, datë 18.06.2009 “Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të [...] dhe ish Shkollës së Partisë, Tiranë”, (në vijim VKM nr. 367/2013) është ndryshuar pika 2 e VKM nr. 678, datë 18.06.2009, në këtë mënyrë: “EKB të bëjë kalimin në pronësi pa kundërshtim të këtyre objekteve për personat, të cilët i kanë aktualisht në përdorim”. Sakaq, paditësi në vitin 2015 ka bërë pagesën e plotë të çmimit të blerjes së apartamentit, fakt i provuar nga mandati bankar, datë 27.08.2015 i Credins Bank dhe është pajisur me certifikatë pronësie, duke i kaluar pronësinë mbi pronën objekt gjykimi.

Duke pretenduar se pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 367/2013, paditësi nuk duhej të vijonte me pagesën e çmimit sipas kontratës dhe se pala e paditur duhet të bënte privatizimin e objektit pa kundërshtim, i është drejtuar disa herë me shkresë palës së paditur, duke i kërkuar kthimin e shumës së paguar. Në kushtet kur këto kërkesa kanë mbetur të pa adresuara, paditësi i është drejtuar gjykatës duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe prandaj duhet të kthejë vlerën e çmimit të kontratës që ka paguar, pas hyrjes në fuqi të aktit nënligjor normativ.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. [...] Gjykata Administrative e Apelit, e cila e shqyrtoi çështjen mbi bazën e ankimit të paditësit, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vlerësuar se mosmarrëveshja objekt gjykimi është në kompetencë të gjykatës civile. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji ka vlerësuar se është i nevojshëm njësimi e praktikës gjyqësore, me qëllim dhënien e një koncepti më të qartë mbi kontratat administrative, evidentimin e dallimeve që ekzistojnë ndërmjet kontratave administrative dhe atyre të së drejtës private, veçanërisht në rastet kur njëra nga palët është organ publik dhe merr pjesë në procedurat e shitblerjes së banesave, qoftë në kuadrin e programit social të strehimit, ashtu edhe në procedurat që i përkasin privatizimit të banesave shtetërore, si dhe për të konkluduar edhe për gjykatën kompetente që shqyrton çështje të kësaj natyre.

Kolegji... vendosi të ngrejë për njësim këto çështje:

1. Cilët janë elementet ligjorë që duhen mbajtur parasysh për identifikimin dhe dallimin e kontratave administrative nga ato civile?

2. Në kuptim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ose në rastin kur organi publik ndërhyr me akt nënligjor për zbatimin e një objekti social në favor të përfituesve, kontratat që lidhen me këtë rast do të cilësohen si kontrata administrative apo si kontrata civile?

3. Kontrata e privatizimit, në kuptim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa”, është kontratë administrative apo civile?”

a) *Parashikimet ligjore për kontratat administrative*

[...] Pavarësisht parashikimeve ligjore në KPA, identifikimi i kontratës si administrative dhe dallimi i saj nga kontrata të lidhura ekskluzivisht sipas regjimit të së drejtës private nuk paraqitet aq i lehtë, si për doktrinën juridike, ashtu dhe për praktikën gjyqësore. Përcaktimi i natyrës juridike të kontratës, në të cilën një nga palët është organ publik evidenton njëkohësisht edhe kompetencën e gjykatës, që do të zgjidhë mosmarrëveshjen që mund të lindë. Për këtë, Kolegji vlerëson të nevojshme të specifikohen kriteret që shërbejnë për të dalluar natyrën administrative të një kontrate nga ajo civile, sepse në këtë mënyrë arrihet të qartësohet edhe kompetenca lëndore e gjykatës.

b) *Dy mënyrat klasike që përdoren për identifikimin e kontratave administrative*

Kolegji konfirmon qëndrimin e tij për dy mënyrat që përdoren për identifikimin e kontratave administrative. Sipas një mënyre, natyrën e kontratës dhe, për rrjedhojë, kompetencën e gjykatës që do të zgjidhë mosmarrëveshjet mes palëve, mund ta përcaktojë drejtpërdrejtë vetë ligji, ndërsa mënyra tjetër është kur gjykata, në një mosmarrëveshje mes palëve, nëpërmjet zbatimit të kriterëve të përgjithshme dhe kryerjes së analizës dhe metodave të interpretimit, bën cilësimin e kontratës, si administrative ose si civile [...]

Nga pikëpamja e teknikës legjislative, mund të parashikohet shprehimisht në ligjin material natyra e një kontrate si administrative, ndërsa në ligjin procedural se gjykimi i mosmarrëveshjeve për një kontratë specifike i përket kompetencës lëndore të gjykatës administrative. Me një parashikim të tillë ligjor, kontrata është administrative pa qenë nevoja të përmbushen kriteret e përgjithshme të kontratës administrative, sipas neneve 3, pika 4 të KPA. Vetë KPA ka bërë cilësime për disa kontrata administrative. Kështu, në

nenin 90 parashikohet natyra administrative e një kontrate që lidhet në përfundim të një procedure administrative, ndërsa në nenin 120 përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë karakteri administrativ i kontratës që zëvendëson aktin administrativ (*kontrata administrative zëvendësuese*). [...] Në nenin 121 parashikohet një tjetër kontratë administrative me objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët ndërmjet organeve publike (*coordinate*), e quajtur ndryshe *kontratë administrative bashkërendimi* apo *koordinimi*. Parashikime për kontrata administrative gjenden edhe në ligje të tjera. Kështu, në nenin 4, pikat 14 deri 20 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të gjitha kontratat në këtë fushë cilësohen si “*kontrata publike*”. Në nenin 3/1 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, parashikohet shprehimisht se “*Koncesion*” është *koncesioni i punëve publike ose koncesioni i shërbimeve publike [...]*, ndërsa në nenin 3/23 parashikohet se “*Kontratë e partneritetit publik privat*” ka *kuptimin e një kontrate pune publike apo kontrate të shërbimit publik*. Edhe në ligjin nr. 10416/2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” (në nenet 49 deri 52), parashikohet lidhja e kontratave publike të shërbimeve në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, midis Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe palëve të treta, subjekte publike apo private, etj.

Nga ana tjetër, ligjvënësi mund të përcaktojë gjithashtu se, gjykimi i mosmarrëveshjeve për një kontratë të caktuar, i përket kompetencës lëndore të gjykatave administrative. Kështu, p.sh., ligji nr. 93/2015, “Për turizmin” dhe VKM nr. 369, datë 18.05.2016 miratimi i rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, kanë parashikuar se zgjidhja e mosmarrëveshjeve mbi kontratën për përdorimin e hapësirës së plazhit “*do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse*.” Në të gjithë rastet e sipërcituara, kontrata identifikohet si administrative për shkak të përcaktimit të kompetencës nga vetë ligji, pa qenë nevoja të përmbushen kriteret e përgjithshme të kontratës administrative sipas nenit 3, pika 4 të KPA.

Problematika më e madhe për të identifikuar natyrën e kontratës administrative, si dhe për të përcaktuar kompetencën lëndore krijohet kur një gjë e tillë nuk është e parashikuar nga ligji, por duhet ta zgjidhë gjykata, nëpërmjet interpretimit dhe arsytimit gjyqësor...

c) *Identifikimi i kriterëve të përgjithshme të kontratës administrative*

Së pari, Kolegji sjell në vëmendje se, për të arritur në përfundimin nëse një kontratë është apo jo administrative, analiza duhet të nisët nga përkufizimi dhe rregullimi ligjor që bëhet në nenin 3, pika 4 të KPA. [...] Referuar doktrinës juridike, mënyrës së rregullimit që bën ligji, por edhe praktikës së Kolegjit Administrativ, rezulton se dy janë kriteret bazë, që ndihmojnë për identifikimin e kontratës administrative dhe dallimin e saj nga kontrata private. Njëri është *kriteri organik*, që kërkon praninë e një organi publik në kontratë dhe tjetri është *kriteri material*, që lidhet me lëndën e kontratës dhe, më konkretisht, me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike. Nga mënyra si është hartuar neni 3, pika 4 i KPA (ashtu si edhe neni 6 i KPA të vitit 1999), dy kriteret rezultojnë të jenë kumulative dhe jo alternative.

Pavarësisht se në pamje të parë, përmbushja e kriterit organik duket si një kriter formal dhe lehtësisht i identifikueshëm, me zgjidhjen që ka bërë ligjvënësi në vite, duke evoluuar nga koncepti i ngushtë ligjor “*organ i administratës shtetërore*”, në atë të “*organit të administratës publike*”, duke ardhur gradualisht në një koncept shumë më të zgjeruar të “*organit publik*”, por edhe për arsye se koncepti i shërbimit publik dhe i interesit publik përfshihet jo vetëm te organet e mirëfillta të administratës shtetërore, por, në raste të veçanta, edhe te personat privatë që u njihet “*e drejta e ushtrimit të funksioneve publike*”, Kolegji vlerëson të nevojshme të bëjë një analizë më të thelluar, si për “*kriterin organik*”, ashtu edhe për “*kriterin material*”. Lidhur me plotësimin e “*kriterit organik*”, shtrohet pyetja nëse i përmbush elementet e një kontrate administrative vetëm plotësimi i kushtit të ekzistencës si palë i një organi administrativ, ndërkohë që sipas ligjit ai kryen qoftë funksione publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative, ashtu edhe veprime të administratës publike që rregullohen nga e drejta private?

Nga një lexim i shpejtë dhe sipërfaqësor i nenit 3, pika 4 të KPA, ..në jo pak raste, pyetjes së shtruar më lart i është dhënë përgjigje se kontrata është administrative. Në fakt, dispozita duhet analizuar në tërësinë e saj, sipas së cilës “kontrata administrative” është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike[...].” Që një kontratë të cilësohet si administrative dhe të përputhet me kuptimin e nenit 3, pika 4 të KPA, nuk mjafton vetëm prania si palë kontraktore e një subjekti të së drejtës publike, por nevojitet që në ushtrimin e veprimtarisë, ai “*të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre*” (neni 1 i KPA). Sipas këtij vlerësimi, përfshirja në një kontratë e organit publik duhet të kuptohet si masë e ushtruar “me qëllim realizimin e interesit publik të cilit i shërben”, duke përmbushur parakushtin ligjor “sipas të drejtës publike”, nëse kontrata ka për qëllim të ketë ndikim të drejtpërdrejt në një çështje që rregullohet nga e drejta publike, edhe pse objekti i kontratës nuk rregullohet nga e drejta administrative. Kjo mbetet një çështje thelbësore për identifikimin e natyrës së kontratës, përderisa pranohet se organet publike nuk janë të kufizuara vetëm në kryerjen e veprimtarisë, që lidhen me funksionet publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative, por janë të detyruara të kryejnë veprime edhe në kuadrin e të drejtës private.

Kushti për praninë si palë në një kontratë të organit publik nuk përjashton faktin se kontrata administrative mund të lidhet edhe ndërmjet dy ose më shumë organeve publike, ashtu si edhe midis dy subjekteve të së drejtës private. Pra, nevojitet të analizohet gjithashtu nëse do të konsiderohet kontratë administrative, kur palë në këtë kontratë nuk është organi shtetëror, por janë subjekte të së drejtës private, që sipas ligjit u njihet e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike? Në këtë aspekt është e domosdoshme të bëhet paraprakisht një analizë e konceptit “*organ publik*”.

c) Mbi organin publik

Referuar, nenit 2, pika 6 i ligjit nr. 49/2012 [...] dallohet menjëherë se përkufizimi

që i bëhet nocionit “*organ publik*” është më i zgjeruar se përkufizimi i nocionit “*organ i administratës publike*” që bën neni 3 i KPA të vitit 1999. Në fakt, neni 2, pika 6 i ligjit nr. 49/2012, përveç se ka marrë, në mënyrë identike, të gjithë përcaktimet e nenit 3 të KPA të vitit 1999, ka shtuar formulimin se organ publik është edhe “[...] *çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislati në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.*” Pikërisht, kjo shtesë e bërë në përkufizimin “*organ publik*” merr një rëndësi të veçantë për mundësinë e cilësimit si administrative edhe të kontratave të lidhura edhe mes personave të së drejtës private.

Nga zgjidhja që ka bërë ligjvënësi rezulton se *çdo person fizik ose juridik* mund të cilësohet organ publik, vetëm nëse nëpërmjet kontratës së lidhur i është njohur “*e drejta e ushtrimit të funksioneve publike*”. Pra, një kontratë mund të cilësohet si administrative, edhe pse është nënshkruar midis dy subjekteve të së drejtës private, me kusht që njërit nga personavetë së drejtës private, i cili është palë kontraktuese, t’i jetë dhënë e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative/publike (*shih vendimin nr. 577, datë 14.01.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Kështu, shoqëritë aksionere, sipas rastit, mund të përfshihen në kategorinë e subjekteve, që u është dhënë e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative/publike dhe, për rrjedhojë, të konsiderohen “organ publik”, ashtu si edhe palë të një kontrate administrative (*shih vendimin e Kolegjit Administrativ nr. 00-2014-3136, datë 11.09.2014*). Nga ana tjetër, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, kur një person juridik privat, të cilit i është njohur e drejta e ushtrimit të funksioneve publike, lidh kontrata në funksion të objektit të veprimtarisë së vet, këto nuk konsiderohen kontrata administrative por private, përjashtimisht rasteve kur përmbajnë kushte kontraktore që shmangen nga e drejta private, ose bien nën një regjim juridik që shmanget nga e drejta private, apo kur ushtrojnë veprimtari të cilat për nga natyra e tyre hyjnë në kompetencat e organeve publike.

Kushti i ushtrimit të funksioneve publike nevojitet të përmbushet, gjithashtu, edhe nga çdo subjekt i së drejtës publike. Kështu, nuk do të konsiderohet i plotësuar kriteri organik në ato raste, kur me nënshkrimin e kontratës, një person juridik i së drejtës publike nuk vepron në ushtrimin e funksioneve të tij administrative/publike, por vepron si një subjekt i së drejtës private. Këtë qëndrim jo shumë të konsoliduar e gjen edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, sipas të cilës “[...] *pavarësisht se palë e kontratës është një organ i administratës publike, në këtë marrëdhënie ai merr pjesë jo si subjekt i së drejtës publike, që ushtron pushtet dhe sovranitet shtetëror, por si subjekt i së drejtës private, në pozita të barabarta me subjektet e tjera të së drejtës private [...]*” (*shih vendimin nr. 00-2017-159, datë 28.02.2017 dhe vendimin nr. 00-2017-1167, datë 22.06.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

Në përmbyllje të këtij arsyetimi, Kolegji thekson se **prania e një subjekti që identifikohet si organ publik nuk e bën automatikisht kontratën të cilësohet administrative. Përkundrazi, përmbushja domosdoshmërisht edhe e kriterit material është thelbësore për kontrata të tilla. Pra, ushtrimi i funksioneve administrative/publike në një kontratë është kusht që pala**

të cilësohet si organ publik, në kuptim të nenit 3, pika 6 të KPA dhe, për rrjedhojë, edhe kriteri organik të konsiderohet i plotësuar.

d) *Mbi kriterin material*

Siç edhe u përmend më lart....përveç kriterit organik duhet që të krijohen, ndryshohen apo shuhen marrëdhënie juridike konkrete, sipas të drejtës publike. Ky është **kriteri material**, pasi ka të bëjë drejtpërdrejt me lëndën e kontratës administrative. ..Sipas nenit 119, pika 1 të KPA, kontrata administrative duhet të ketë për qëllim dhe objekt “[...] realizimin e një interesi publik, të cilit i shërben[...].” Ky element i kriterit material shërben për të përkufizuar kontratën administrative, por edhe si një kusht vlefshmërie për lidhjen e saj.

Për të qartësuar konceptin mbi kriterin material, që duhet të përmbushet në një kontratë administrative, nevojitet të evidentohen të përbashkëtat apo dallimet mes konceptit ligjor “marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike” (neni 3, pika 4 i KPA) dhe konceptit të “marrëdhënies juridike” (neni 659 i KC), që është i pranishëm në një kontratë të së drejtës private. Kolegji vlerëson se një analizë e tillë shërben për të evidentuar njëkohësisht edhe dallimin mes të drejtës publike dhe të drejtës private.

i. *Dallimi mes të drejtës publike dhe të drejtës private.*

[...] E rëndësishme për të bërë dallimin ndërmjet një kontrate të së drejtës publike dhe private është mënyra e pjesëmarrjes së kontraktorit (e njohur si (pa)barazia e palëve), gjë e cila përcakton edhe natyrën e kontratës. Pranohet gjerësisht se e drejta kontraktore private është një e drejtë ku dominojnë marrëdhënie juridike midis subjektsh juridikisht të barabartë, ndërsa e drejta publike dominohet nga marrëdhënie juridike, që i vendos palët në një marrëdhënie jo të njëjlojtë. Të drejtat që gëzojnë palët në një kontratë, sipas së drejtës private (*neni 660 i KC*), ku përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të ligjit, nuk parashikohen njëjlojtë për palët edhe në kontratat administrative. Kontratat publike ose administrative janë çështje të së drejtës administrative dhe autoriteti administrativ në këto kontrata nuk qëndron në të njëjtin pozicion me palën tjetër kontraktuese. Kështu, administratës publike nuk i njihet autonomi negociuese dhe liri kontraktore, ashtu si në kontratat e së drejtës private. Në rast se palëve në një kontratë administrative do t’u jepej e njëjta liri që kanë palët në një kontratë private, kjo do të ngushtonte diferencën që ekziston mes tyre dhe nuk do të diktonte nevojën e ekzistencës së një kontrate të tillë. Kështu, e drejta e autoritetit administrativ për të ndërhyrë në çdo moment, si dhe për tu tërhequr, qoftë edhe në mënyrë të njëanshme, përbën një veçori të këtyre kontratave. Sidoqoftë, e drejta e administratës për të kryer veprime të tilla, me efekt të njëanshëm, nuk rrjedh drejtpërdrejt nga kontrata, por nga vetë natyra e pushtetit administrativ që krijon mundësi për të vepruar si një fuqi sovraane, që ka në themel interesin publik të cilit i shërben.

Element dallues që shërben për të bërë ndarjen mes të drejtës publike dhe të drejtës private është *shërbimi publik*. Vetë administrata publike, nëpërmjet veprimtarisë së saj ka gjithmonë për qëllim të përmbushë një mision shërbimi publik, gjë që e bën

marrëdhënien të cilësohet si një marrëdhënie juridike e së drejtës publike. Kështu, vetëm një kontratë që ka në objektin e saj “një veprimtari të shërbimeve publike” ose “realizimin e një interesi publik” (neni 119 i KPA) do të cilësohet si kontratë administrative.

Një tjetër element që ndihmon në bërjen e dallimit midis të drejtës publike dhe të drejtës private është i njohur në doktrinë me termin *prerogativat e fuqisë publike*, të cilat zotërohen nga administrata publike dhe që lidhen me nxjerrjen eaktit *administrativ të njëanshëm*, me *ushtrimin epushtetit diskrecial* dhe me *privilegjin e ekzekutimit paraprak*. Në KPA gjendet i gjithë kuadri ligjor që rregullon këto prerogativa të fuqisë publike. Nenet 98 deri 118 të KPA rregullojnë konceptin për aktin administrativ të njëanshëm, neni 3, pika 3 i KPA *përkufizon pushtetin diskrecial si të drejtën e organit publik...*, ndërsa privilegji i ekzekutimit paraprak në favor të administratës publike shfaqet në disa raste (neni 133/3 i KPA), [...] ose edhe në ligje të tjera që përcaktojnë ekzekutimin e menjëhershëm të dënimit me gjobë nga organet administrative pa pritur vendimin gjyqësor të formës së prerë (si p.sh., ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”). Pikërisht, këto tre përbërës të së drejtës publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit më thelbësor të administratës publike, që është misioni i interesit publik.

Dallimi midis të drejtës publike dhe të drejtës private bazohet në teorinë e interesave, që mbrojnë normat juridike. E drejta publike është e drejtë e posaçme e shtetit dhe përmban norma juridike të cilat mbrojnë interesat e shtetit si organizim në funksion të interesit publik, ndërsa e drejta private përmban norma juridike të cilat mbrojnë interesat e subjekteve private. Në këtë aspekt, një element kryesor i së drejtës publike, që është qëllim i administratës publike dhe që e dallon të drejtën publike nga e drejta private, është *interesi publik*. Mbrojtjen e interesit publik, KPA e parashikon në shumë dispozita, si p.sh., nenet 1, 4, 12, 119/1 dhe 123, ashtu si ligji nr. 49/2012 parashikon në nenin 3/2 [...] si një nga parimet e gjykimit administrativ.

Bazuar në sa më sipër, Kolegji thekson sekoncepti i “***marrëdhënieve konkrete, sipas së drejtës publike***”, nënkupton marrëdhënie juridike të cilat mund të përmbledhin, në të njëjtën kohë ose veç e veç, shumë elemente, si kryerja e një shërbimi publik, ushtrimi i prerogativave të fuqisë publike, raporti jo i njëjtë mes palëve sa i përket mënyrës së formimit dhe shfaqjes së vullnetit kontraktor, përmbushja e interesit publik, etj. Në këtë mënyrë, sa herë gjendemi përpara një kontrate të nënshkruar nga një organ publik, që krijon të drejta dhe detyrime të normuara nga e drejta publike të cilat mund të jenë edhe të shpërpjestuara midis palëve në favor të organit publik, që nuk bazohen në parimet e autonomisë së vullnetit dhe të barazisë midis privatëve, atëherë kriteri material (marrëdhënie juridike në fushën e së drejtës publike) konsiderohet i plotësuar.

ii. *Elementet e kriterit material*

Kolegji ka analizuar, në jo pak raste, nevojën mbi ekzistencën e disa elementeve të tjerë, të cilët veprojnë si tregues kryesorë për përmbushjen e kriterit material (praninë e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike). Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson të domosdoshme të ritheksojë se, kur plotësohet

kriteri organik (një nga palët në kontratë është organ publik), atëherë kontrata do të konsiderohet si administrative, me kushtin që të përmbushet edhe kriteri material (ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike), i cili është i lidhur me rastet kur kontrata administrative:

- *ka për objekt kryerjen ose ekzekutimin e një veprimtarie shërbimi publik;*
- *ka për objekt kryerjen e punëve publike;*
- *ka për objekt ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative/publike;*
- *financohet nga paratë publike;*
- *rregullohet dhe i nënshtrohet një regjimi juridik të së drejtës publike;*
- *ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike.*

Të gjithë këto elemente apo nënkritere nuk janë vlerësuar si kumulative, por si alternative dhe, si të tilla, mjafton ekzistenca e njërit prej tyre në një kontratë që kriteri material të konsiderohet i përmbushur, ndonëse jo pak herë kontratat përmbajnë dy apo më tepër nga elementet e mësipërm. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka zhvilluar praktikën gjyqësore, duke i dhënë një kuptim më të zgjeruar kriterit material, përmes analizës së këtyre elementeve, me synim përcaktimin e drejtë të natyrës së kontratës administrative dhe për ta dalluar atë nga kontrata civile. Konkretisht:

Kontrata ka për objekt kryerjen e një veprimtarie shërbimi publik. ...Pikërisht, karakteri administrativ i kontratës do të rezultojë nëse objekti i saj është i lidhur me një veprimtari shërbimi publik. Nënkriteri i kryerjes së një veprimtarie shërbimi publik nuk është gjithmonë i lehtë për tu evidentuar në një kontratë. Prandaj, para se të arrihet në përfundimin se një kontratë është administrative duhet të identifikohet ekzistenca e një veprimtarie shërbimi publik dhe më pas të verifikohet natyra juridike e kontratës. ...Përgjithësisht është pranuar se kontrata është administrative kur i beson një personi fizik ose juridik të së drejtës private ekzekutimin e një shërbimi publik. Shembulli tipik i kontratave që kanë për objekt kryerjen e një veprimtarie shërbimi publik janë koncesionet dhe partneritetet publike private. Duke ia besuar kontraktuesit privat ekzekutimin e një shërbimi publik, organi publik pranon ta bëjë këtë subjekt privat zbatues të vërtetë të këtij shërbimi. Pikërisht, kryerja e një veprimtarie të tillë përcakton natyrën administrative të kontratës dhe, për rrjedhojë, nënshttrimin e saj normave të së drejtës publike, por edhe kompetencën e gjykatave administrative për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin për shkak të tyre. Qartësimi që i ka bërë ligji natyrës së këtyre kontratave nuk ka krijuar ndonjë problematikë as për praktikën gjyqësore.

Kontrata ka për objekt kryerjen e punëve publike. Pranohet se kontrata e nënshkruar nga një organ publik do të krijojë efekte dhe pasoja juridike në fushën e së drejtës publike dhe kriteri material do të konsiderohet i përmbushur, nëse kontrata ka për objekt kryerjen e punëve publike. ...Referuar doktrinës juridike mund të thuhet se punët publike janë punët, që kryhen apo ekzekutohen në emër dhe për llogari të një organi publik dhe kanë për qëllim përmbushjen e interesit publik. P.sh: konsiderohet se puna kryhet apo ekzekutohet në emër dhe për llogari të një organi publik, kur kryhet

apo ekzekutohet mbi një objekt apo send që është në pronësi të organit publik, ose kur puna që po kryhet apo ekzekutohet, në përfundim, do të kalojë në pronësi të organit publik. Kryerja apo ekzekutimi i punëve publike është një veprimtari publike, për shkak se përgjatë kryerjes së këtyre punëve publike manifestohen prerogativa të fuqisë publike, siç mund të jenë shpronësimet për interes publik nëpërmjet nxjerrjes së një akti administrativ të njëanshëm, etj. Për rrjedhojë, si nocioni i shërbimit publik dhe ai i punëve publike nënkupton prezencën e një organi publik dhe përmbushjen e një qëllimi të interesit publik. Edhe për këto kontrata nuk është vërejtur ndonjë paqartësi në praktikën gjyqësore.

Kontrata ka për objekt ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative/publike. Kriteri material i marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike, do të konsiderohet i plotësuar dhe, për rrjedhojë, kontrata është administrative, nëse organi publik e nënshkruan kontratën përgjatë dhe në funksion të ushtrimit dhe përmbushjes së detyrave administrative/publike. Kështu, në jurisprudencën e Kolegjit ka jo pak qëndrime që kanë orientuar praktikën gjyqësore në drejtim të plotësimit të kriterit material, për arsye seme anë të kontratës administrative palët synojnë të rregullojnë të drejta dhe detyrime në lidhje me:

- “[...] ndërtimin e një godine për përdorim nga organet e policisë për ushtrimin e funksionit publik” (vendimi nr. 1235, datë 01.04.2014);

- “[...] ndërtimin e një godine për përdorim nga organet e arkivave shtetërore për ushtrimin e funksionit publik” (vendimi nr. 1111, datë 01.04.2014);

- “[...] realizimin e pavionit etnografik pranë Muzeut Historik Kombëtar, që administrohet nga kjo e fundit, në kuadër të ushtrimit të funksionit publik” (vendimi nr. 1554, datë 06.05.2014);

“[...] dhënie në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar për qëllim ushtrimin e veprimtarisë agro-pylltari sipas qëllimit të përcaktuar në kontratë, si dhe në lejen e mjedisit për përdorim nga organet shtetërore për ushtrimin e funksionit publik pjesë e fondit pyjor publik, *Ekonomia Pyjore Dumre*” (vendimi nr. 1637, datë 10.06.2014);

Pavarësisht se me këto kontrata organet publike synojnë ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre administrative/publike, ato lehtësisht identifikohen edhe si kontrata prokurimi publik.

Kontrata financohet nga paratë publike. Gjithashtu kriteri material do të konsiderohet i përmbushur dhe kontrata do të jetë administrative në rastet e financimit të saj nga paratë publike. Nocioni i fondeve publike është përkufizuar në nenin 4, pika 9 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ... Një kontratë e lidhur nga një organ publik dhe që financohet pjesërisht ose tërësisht nga paratë publike duhet t’i nënshtrohet regjimit juridik të së drejtës publike dhe kompetencës lëndore të gjykatës administrative, nëse marrëdhënia që krijohet dhe normohet nga e drejta publike ka të bëjë me një shërbim publik dhe është në interes të publikut.

Financimi i kontratës nëpërmjet fondeve publike bën që kontrata të rregullohet nga marrëdhëniet juridike të së drejtës publike dhe kriteri material të përmbushet, por kjo nuk do të thotë se një kontratë e financuar nga kontraktuesi privat me fondet e tij, ose me kredi

të marrë në institucionet financiare, nuk mund të përmbushë kriterin material dhe, për rrjedhojë, të mos ketë natyrë administrative. [...] **Përdorimi i parave publike është i rëndësishëm dhe mund të plotësojë karakterin administrativ të kontratës, por kontrata është administrative jo vetëm për faktin se financohet nga paratë publike, por për arsyen se ka për objekt kryesor të saj kryerjen e punëve e shërbimeve publike.** Kjo do të thotë se jo çdo financim nga paratë publike e bën domosdoshërisht kontratën administrative. Është e ditur se organi publik edhe kur vepron si subjekt i së drejtës private përdor paratë publike, sepse kjo nënkuptohet **çdo herë që shteti vepron**, por nevojitet të vlerësohet domosdoshmërisht natyra juridike e marrëdhënies konkrete. Kështu, është i njohur rasti kur organi publik përdor para publike që nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimi. Në këtë aspekt ndikon edhe vlera e ulët e financimit. Ka blerje me para publike, në vlera të vogla, të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik. Kontrata të tilla, ku organi publik vepron si çdo subjekt i së drejtës (pa kufizime të lirisë kontraktore), pa qenë nevoja të përdorë fuqinë e tij sovrane konsiderohen si civile. Këtë e ka konfirmuar, në jo pak raste, edhe jurisprudenca e Gjykatës së Lartë.

Kontrata rregullohet nga një regjim juridik i së drejtës publike. Kontrata do të cilësohet si administrative edhe kur elemente të së drejtës publike, që shfaqen nëpërmjet normave ligjore ose nënligjore, rregullojnë kontratën që u imponohet palëve. Në këtë rast, bëhet fjalë për një regjim juridik të së drejtës publike. Nëse rregullat që i zbatohen kontratës i përkasin të drejtës publike, atëherë kriteri material do të gjendet i plotësuar. Përdorimi nga ligjvënësi i termit “*sipas të drejtës publike*” për përkufizimin e kontratës administrative do të thotë se zbatohet vetëm për sferën që rregullohet nga e drejta administrative, siç parashikohet edhe në pikën 1 të nenit 2 të KPA. Kjo do të thotë se një kontratë është administrative kur objekt i saj rregullohet nga e drejta administrative. Pra, është e drejta administrative që përcakton shprehimisht lidhjen e një kontrate administrative si e vetmja mënyrë e mundshme për zgjidhjen e një çështje të caktuar dhe se është kontrata administrative që ndryshon një marrëdhënie juridike ekzistuese që rrjedh nga e drejta administrative, si dhe vendos një detyrim ndaj organit publik që mund të plotësohet vetëm përmes nxjerrjes së një akti administrativ.

Në parim, regjimi juridik që i zbatohet kontratës është pasojë e përcaktimit të natyrës juridike të saj. Në këtë rast, ndodh e kundërta: nga regjimi juridik që i zbatohet kontratës evidentohet natyra juridike e saj. Pra, nëse për një kontratë të caktuar, ekziston një regjim juridik i parashikuar për këtë kontratë dhe ky regjim paraqet norma tepër origjinale, të cilat janë norma të së drejtës publike dhe që normalisht nuk zbatohen në një kontratë midis dy personave të së drejtës private, atëherë kjo kontratë do të cilësohet detyrimisht si një kontratë administrative, për shkak të normave të së drejtës publike që e rregullojnë atë.

Kontrata ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes tëpërbashkët të organeve publike. Kriteri material do të konsiderohet i përmbushur, sa herë që kontrata e lidhur midis dy ose më shumë organeve publike, do të ketë për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të

përbashkët të organeve publike kontraktuese. Ky nën kriterrezulton drejtpërdrejt nga ligji dhe zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ndërmjet organeve publike... neni 121 i KPA.... Këto kontrata i gjejmë të parashikuara kryesisht në ...ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenet 9/1, pikat 1.5 dhe 1.6, shkronja a), 14, 21/3 dhe 30/5, është parashikuar e drejta e njërive të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe qarqet) të lidhin kontrata me anë të të cilave: organet e pushtetit qendror i delegojnë funksionet dhe/ose kompetencat e tyre organeve të pushtetit vendor; organet e pushtetit vendor vendosin të ushtrojnë së bashku funksione të dhëna me ligj; organet e pushtetit vendor vendosin t’i delegojnë një pale të tretë organ publik ushtrimin e një apo disa funksioneve; si dhe kontratat midis organeve të pushtetit qendror dhe organeve të pushtetit vendor apo midis vetë organeve të pushtetit vendor për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët kontraktore, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara, të quajtur subjekt i kompetencave të përbashkëta. Këto kontrata kanë për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët midis organeve të qeverisjes qendrore me organet e qeverisjes vendore apo midis vetë organeve të qeverisjes vendore. Kontrata me objekt delegimin e kompetencave midis organeve administrative, kur nuk janë në marrëdhënie varësie me njëri-tjetrin, parashikohet edhe nga neni 29/1 i KPA.... Gjithashtu, neni 14/1 i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, parashikon lidhjen e kontratave ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore me objekt planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, ose për kryerjen e shërbimeve për planifikimin dhe zhvillimin e territorit...Për rrjedhojë, kontrata me objekt delegimin e kompetencave nga një organ publik delegues tek një organ publik i deleguar, jo në varësi të organit delegues, përbën kontratë ndërmjet organeve publike me objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët.

Një rast tjetër i kontratës mes dy organeve publike, me objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët, është kontrata e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave me institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, në mënyrë që institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore të ofrojnë shërbimet e tyre nëpërmjet sporteve të shërbimit dhe pikave të shërbimit me një ndalesë, që administrohen nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) [...]

dh) Disa konkluzione paraprake

Mbi këtë analizë të hollësishme, rezulton se kontrata do të konsiderohet administrative nëse plotësohen të dy kriteret e kërkuar nga neni 3, pika 4 i KPA, kriteri organik (prania e të paktën një organi publik në kontratë në cilësinë e palës kontraktuese), si dhe kriteri material (ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike). ...Në parim, të dy kriteret duhet të gjenden të plotësuar, në përmbajtje dhe jo në formë, në mënyrë që kontrata të paraqesë karakter administrativ. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ***një kontratë do të konsiderohet administrative kur krahas pranisë si palë të një organi publik (kriteri organik) kërkohet domosdoshmërisht ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike (kriteri***

material), që do të thotë se kontrata duhet të ketë për objekt kryerjen apo ekzekutimin e një veprimtarie shërbimi publik; kryerjen e punëve publike; ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative/publike; rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike kontraktuese; financimin nga paratë publike; rregullimin dhe nënshtrimin një regjimi juridik të së drejtës publike.

Kolegji vlerëson se një përfundim i tillë nuk është shterues, sepse nga analiza e mësipërme nevojitet të identifikohen edhe elemente të tjerë që ndihmojnë për të dalluar kontratën administrative nga ajo civile. Për këtë arsye është e domosdoshme që në funksion të nxjerrjes së përfundimeve mbi pyetjen e parë, të specifikohen dhe mbahen parasysh edhe disa elemente thelbësore, që shërbejnë për identifikimin e një kontrate administrative, si:

- shërbimi në interesin publik, që përcjell një qëllim të veçantë të kontratës;
- kufizimi me ligj i lirisë kontraktore;
- epërsia e organit publik ndaj palës tjetër kontraktore, që diktohet nga nevoja për të mbrojtur interesin e përgjithshëm;
- karakteri specifik (*intuitu personae*) i kontratës, ku në raste të caktuara ndërprerja e saj nuk lejohet pa miratim të autoritetit publik;
- tërheqja e njëanshme nga kontrata e organit publik, kur nuk arrihet marrëveshja për ndryshim ose prishje të saj, kundrejt detyrimit për t'i paguar palës private dëmin e shkaktuar.

Kolegji vlerëson se një trajtim i tillë doktrinar dhe jurisprudencial, padyshim që orienton dhe ndihmon për qartësuar problematikën që ndeshet në praktikë, por për të kuptuar dhe zbatuar ligjin me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore nevojitet një analizë edhe më e thelluar.

Sëpari, për të bërë dallimin mes kontratës publike dhe private fokusimi është tek objekti, qëllimi, si dhe normat juridike që rregullojnë natyrën e marrëdhënies juridike, të cilat duhet të dalin të qarta si gjatë pretendimeve që parashtrijnë palët, ashtu edhe nëpërmjet interpretimit dhe konkluzionit që nxjerr gjykata për zgjidhjen e çështjes. Për palët në gjykim, por edhe për vetë gjykatën mbetet e rëndësishme bërja e këtij dallimi, jo nëpërmjet leximit literalisht të kontratës, por nëpërmjet analizës në thelb të përmbajtjes së kontratës dhe natyrës së mosmarrëveshjes. Nuk e përcakton natyrën e kontratës apo kompetencën për shqyrtimin e saj vetëm emërtimi i kontratës, apo formaliteti i palëve pjesëmarrëse në lidhjen e saj. Vlen në këtë rast referimi edhe në vendimin njësim të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 29.03.2012 [...]

Çështja nëse një mosmarrëveshje është e së drejtës publike apo civile, kur mungon një parashikim i shprehur i ligjvënësit që përcakton juridiksionin specifik gjyqësor, varet ngushtësisht nga natyra e marrëdhënies juridike, prej së cilës rrjedh edhe pretendimi i palëve për të ngritur padi. Gjykata duhet të niset nga mënyra se si palët i paraqesin pretendimet e tyre mbi një kontratë konkrete dhe objekti i saj për të përcaktuar natyrën e marrëdhënies juridike, llojin e mosmarrëveshjes, e për rrjedhojë edhe kompetencën e gjykatës. Kolegji vlerëson se **me rëndësi përcaktuese është se si palët i**

ngrënë pretendimet dhe si i parashtrojnë kërkesat, “nëse ato fokusohen te marrëdhëniet juridiko-civile apo ato juridiko-publike”, si dhe pasojat respektive para gjykatës kompetente (shih vendimin e Gjykatës së Lartë Federale gjermane 10, 164, 165 dhe vendimin e Gjykatës Administrative Federale gjermane BVerëGE 7, 257, 258).

[...] Tashmë mbizotëron qëndrimi se një marrëdhënie juridike, e cila rrjedh nga një objekt konkret, i bazuar në ndërveprimin e të paktën dy subjekteve juridike ose e një subjekti kundrejt një çështje juridike të caktuar, do të konsiderohet tërësisht, ose si publike, ose si private. Kontrata në tërësi, përfshirë edhe pjesën ku ajo kategorizohet si private, do të konsiderohet publike, nëse pjesa e cila rregullohet sipas së drejtës publike peshon më shumë (që në jurisprudencën gjyqësore ndërkombëtare cilësohet si “teoria e pikës së rëndësës”), sa i përket evidentimit të natyrës së marrëdhënies kontraktore. Pra, në një kontratë të lidhur mes një organi publik dhe subjekteve private fokusi duhet të jetë tek *objekti i kontratës*. Në rast se objekti kryesor i kontratës është shitja e një trualli, apo dhënia me qira e një objekti, kur organi publik nuk përdor fuqinë sovranë, nuk kryen një shërbim publik dhe nuk vepron në mbrojtje apo avancim të interesit publik, por ushtron liri kontraktore, ashtu si edhe pala tjetër, atëherë bazuar në *teorinë e pikës së rëndësës*, do të kemi të bëjmë me kontratë private, pavarësisht se ndonjë nga detajet e tjera mund të rregullohen nga normat e së drejtës publike, si p.sh metodologjia e përcaktimit të çmimit apo tarifat e tjera që vendosen me ligj, ose akt nënligjor. Në këtë rast, gjykata civile është kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nga ana tjetër, një veprimtari publike mund të ketë efekte relevante të një veprimtari ekonomike të ushtruar nga vetë organi. Kështu, *nëse në një kontratë për shitjen e një trualli apo dhënien me qira të një objekti, organi publik mban/ushtron sovranitet shtetëror dhe ku dukshëm prevalon interesi publik (si p.sh., kontrata e qirasë me 1 euro, apo me një çmim simbolik, me kushtin e përmbushjes së një objektivi social, etj), atëherë kontrata do konsiderohet publike, pavarësisht se ka edhe detaje të së drejtës civile*. Në këtë rast, gjykata administrative është kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Përmbajtja thelbësore e kontratës duhet të ketë disa cilësi objektive, midis të cilave kryesore është ardhja e pasojave juridike në fushën e së drejtës publike (si p.sh zbatimi i normave të së drejtës publike ose detyrimi i organit publik për të kryer ose moskryer një veprim administrativ). Në këtë drejtim orienton edhe jurisprudenca ndërkombëtare.... **Përcaktuese në këto raste mbetet “çështja nëse palët qëndrojnë përballë njëra-tjetrës në marrëdhënie që imponohet nga parimi i ushtrimit të sovranitetit shtetëror, pra - me mbi dhe nënvendosje të palëve në kontratë -, si dhe nëse mbajtësi i sovranitetit shtetëror bazohet tek kuadri normativ i së drejtës publike apo tek e drejta civile e vlefshme për këdo.”**(shih vendimin e Gjykatës së Lartë Federale, 41, 264, 267, si dhe vendimin e Gjykatës Federale Administrative gjermane 7, 180, 182).

Kolegji rithekson, ashtu siç arsyetohet edhe në jurisprudencën e njohur ndërkombëtare se nuk ka një kategorizim absolut nëse një veprimtari është apo jo publike, por kjo përcaktohet nga marrëdhënia juridike konkrete në raport me

personalitetin juridik, me të cilin vishet organi publik, kur vepron si i tillë. Është e pranuar se kjo çështje mbetet për t'u përcaktuar në varësi të këndvështrimit që i bëhet marrëdhënies juridike (nëse ajo është mikse apo e paqartë), bazës ligjore të padisë dhe pasojave juridike të marrëdhënies/konfliktit. Nisur nga ky vlerësim dallues që i referohet këtyre elementeve, të cilat mund të jenë në favor ose disfavor të organit publik, vlerësohet se kompetencat e karakterit sovran nuk mund të ushtrohen ndaj çdokujt, por vetëm ndaj një rrethi të caktuar personash dhe në raste konkrete. Nëse marrëdhënia është e tillë që i vendos palët në pozita të barabarta dhe organi publik nuk bazohet në normat e posaçme të së drejtës publike, atëherë konflikti nuk është i natyrës së të drejtës publike dhe, për rrjedhojë, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është gjykata civile. **Pra, është natyra juridike e mosmarrëveshjes që përcakton edhe kompetencën e gjykatës civile apo administrative dhe jo domosdoshmërisht prania formalisht e një organi publik në kontratë, prania ose jo e interesi publik, apo fakti nëse janë përdorur fonde publike, “sepse të gjitha këto nënkuptohen çdo herë që shteti vepron.”** (shih vendimin e dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë Federale, datë 20 maj 2009).

Të gjitha këto karakteristika të përgjithshme shërbejnë për identifikimin e një kontrate administrative dhe dallimin nga një kontratë e zakonshme e së të drejtës private. Megjithatë, pavarësisht nga mënyra sesi analizohen në doktrinën juridike apo në legjislacion elementët që shërbejnë për të dalluar një kontratë administrative nga kontrata civile, nuk mund të konkludohet se këto përfundime për kontratën administrative janë shteruese [...]

Nisur nga kjo analizë e thelluar doktrinare dhe jurisprudenciale, Kolegji vlerëson të nevojshme të nxjerrë disa përfundime. *Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së parë:*

- **Së pari: Një kontratë do të konsiderohet administrative, kur krahas pranisë si palë të një organi publik (kriteri organik) verifikohet domosdoshmërisht edhe krijimi, ndryshimi apo shuarja e një marrëdhënie juridike konkrete, për shkak të zbatimit të normave të së drejtës publike (kriteri material), në funksion të një shërbimi publik dhe të realizimit të një interesi publik, të cilit i shërben. Për rrjedhojë, është edhe natyra juridike (shkaku ligjor i mosmarrëveshjes në gjykim), që do të përcaktojë gjykatën kompetente.**
- **Së dyti: Elemente kryesorë përcaktues për identifikimin e një kontrate administrative janë: shërbimi në interesin publik, që përbën shkaku të kontratës; kufizimi i lirisë kontraktore; epërsia e organit publik, në kuptim të kufizimit të vullnetit kontraktor të palës tjetër për kushte të caktuara të panegociueshme të kontratës, të rregulluara nga e drejta publike; karakteri specifik i kontratës, lidhur me të drejtën e organit publik për tërheqje të njëanshme nga kontrata, kur nuk arrihet marrëveshja për ndryshim ose prishje të saj, kundrejt detyrimit për t'i paguar palës private dëmin e shkaktuar.**
- **Së treti: Në një kontratë administrative palët qëndrojnë në raport**

me njëra-tjetrën në një marrëdhënie që imponohet nga parimi i ushtrimit të fuqisë/pushtetit sovran, ku mbajtësi i këtij sovraniteti bazohet te kuadri normativ i së drejtës publike. Kontrata është administrative, kur pavarësisht pjesëve të saj që normohen nga e drejta private, evidentohet qartë se rregullimi në tërësi i saj nga normat e së drejtës publike peshon më shumë.

- **Së katërti: Dallimi mes kontratës publike dhe private, në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore, bëhet jo nëpërmjet leximit literalisht të kontratës, por nëpërmjet analizës në thelb të përmbajtjes së saj dhe natyrës së mosmarrëveshjes. Objekti, qëllimi dhe normat, që rregullojnë marrëdhënien juridike, duhet të evidentohen qartë si nga palët në proces, ashtu edhe në analizën dhe konkluzionin, që nxjerr gjykata lidhur me këtë çështje.**

Lidhur me dy pyetjet e tjera të shtruara për njësim, të cilat janë të ndërlidhura me njëra tjetrën, Kolegji vlerëson t'i përgjigjet duke iu referuar analizës së mësipërme, por edhe legjislacionit të posaçëm që rregullon këto marrëdhënie.

Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar në vite legjislacioni në fushën e strehimit social, në thelb, mënyra e rregullimit të marrëdhënieve dhe e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura, nuk paraqet ndonjë ndryshim thelbësor që të krijojë paqartësi për efektet juridike të vendimit njësuës ndaj çështjeve që janë në gjykim prej vitesh (siç është edhe rasti në shqyrtim) dhe çështjeve të reja që regjistrohen. [...] Nga kjo pikëpamje, analiza dhe interpretimi në parim i dispozitave të mëparshme ligjore, krahasuar me dispozitat aktuale, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore ndihmon në marrjen e një përgjigje përfundimtare për pyetjen e shtruar nëse “kontratat që lidhen me këtë rast do të cilësohen si kontrata administrative apo si kontrata civile”? Pra, si për mosmarrëveshjet e krijuara nga ligji nr. 9232/2004, ashtu edhe për ato që kanë lindur nga ligji nr. 22/2018, ky vendim njësuës i jep zgjidhje natyrës së kontratave, që përfshihen në programin social të strehimit, por edhe kompetencës së gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkrete.

Ligji nr. 22/2018, si edhe ligji nr. 9232/2004 parashikojnë programet sociale për strehimin që rregullohen me kontrata të posaçme (kontrata sociale me qira, kontrata shitblerje me kosto të ulët, kontrata zhvillimi etj), pa përcaktuar drejtpërdrejt natyrën administrative apo civile të tyre. Për identifikimin e këtyre kontratave nevojitet t'i referohemi kriterëve, të analizuara më sipër në këtë vendim njësuës. Kështu, bazuar në nenin 1 të VKM nr. 198/1993 rezulton se organi publik që vepron, me qëllim mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe sigurimin e banesave me kosto të ulët, duke lidhur edhe kontratat përkatëse, është EKB. Këtij organi publik i është dhënë me akt nënligjor, [...] e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike. Bazuar në këtë akt nënligjor, ndërmjet objektivave të tjera të interesit publik, EKB ka si veprimtari, administrimin e banesave të ndërtuara me fonde publike, të cilat përdoren për plotësimin e kërkesave të familjeve që janë të pastreha. Gjatë kryerjes së veprimtarisë, EKB ka të drejtë tu shesë banesa sociale shtetasve shqiptarë, të cilët plotësojnë kriteret

e ligjit për personat e pastrehë, kundrejt një çmimi të përcaktuar në aktet nënligjore, duke i ndihmuar këto persona edhe me anë të kredive të buta, si dhe tu japë me qira banesa sociale. EKB ka gjithashtu të drejtë të financojë, ndërtojë dhe shesë banesat sociale, si dhe të zgjidhë problemet e huave për blerësit. Këto detyra dhe funksione që i përkasin qartësisht një misioni interesi publik, përfshihen tek ushtrimi i funksioneve administrative publike. Në këto kushte, në lidhjen e kontratave të posaçme... EKB ka cilësinë e organit publik. [...]

Edhe në lidhje me kriterin material rezultojnë se kontratat për programet sociale të strehimit kanë për objekt pikërisht ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative/publike të një organi publik. Nga referimi në dispozitat e ligjit nr. 22/2018, si edhe të ligjit nr. 9232/2004, rezultojnë se programi i banesave sociale me qira, apo i shitblerjes kontrollohet nga shteti. ..Kontrata e qirasë së banesave sociale, pavarësisht se lidhet, bazuar në dispozitat e KC (neni 29/1 i ligjit nr. 22/2018), rregullohet dhe i nënshtrohet një regjimi juridik të së drejtës publike, që është element i rëndësishëm i kriterit material. Kështu, vetë kontrata e qirasë sociale përkufizohet si një kontratë, ku niveli i qirasë kontrollohet dhe/ose mund të subvencionohet nga institucionet shtetërore (neni 2/22). Gjithashtu, dispozitat ligjore rreth administrimit dhe mirëmbajtjes së banesave sociale me qira (neni 26), kushtet e menaxhimit të banesave sociale me qira (neni 28), përcaktimi i çmimit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, i kufizuar sipas metodikës për llogaritjen që miratohet me VKM (neni 30), zgjidhja e kontratës së qirasë në rastet kur qiramarrësi bën deklaram të rremë për të ardhurat, përfiton një banesë tjetër apo të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në ligj (neni 31), si dhe subvencioni i qirasë (nenet 33 deri 39) etj, janë tregues që ndihmojnë për të konkluduar se kontrata e qirasë së banesave sociale është një kontratë që rregullohet dhe i nënshtrohet një regjimi juridik të së drejtës publike, pasi këto rregulla nuk gjejnë zbatim për kontratat e lidhura midis privatëve të cilat nuk lidhen për një interes publik. Interesi publik i strehimit të personave të pastrehë dhe me mundësi të ulët ekonomike, bën që në rastin konkret të ekzistojnë këto rregulla për kontratën e qirasë së banesave sociale. [...]

Gjithashtu, kontratat e sipërmarrjes që mund të lidhen midis EKB dhe përfituesve, referuar programit për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese (neni 11/1, shkronja b), nenet 40 deri 43 të ligjit nr. 22/2018), do të rregullohen dhe nënshtrohen një regjimi juridik të së drejtës publike. Kështu, grantet që jepen (neni 40), objektet që trajtohen (neni 41), instrumentet e programit (neni 42) dhe përfituesit nga programi (neni 43), tregojnë për nënshttrimin e këtyre kontratave një regjimi juridik të së drejtës publike. Edhe në lidhje me programin e banesave me kosto të ulët (nenet 11/1, shkronja c), 44 deri 49), parashikohet se ato shiten me çmim nën vlerën e tregut, por jo nën vlerën e koston së ndërtimit (neni 44), ashtu siç përcaktohet se normat dhe standardet e banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët, miratohen me VKM (neni 45). Ligji parashikon gjithashtu përfitimin e grantit të menjëhershëm për blerjen e banesave me kosto të ulët (neni 46), si dhe

subvencionimin e interesave të kredisë (neni 47). Në të njëjtën mënyrë, edhe programi për zhvillimin e zonës për qëllim strehimi (nenet 11/1, shkronja ç), 50 deri 53), programi i strehëve të përkohshme (nenet 11/1, shkronja d), 54 deri 57), si dhe programi i banesave të specializuara (nenet 11/1, shkronja dh), 58 deri 64), janë programe për zbatimin e të cilave kontratat që do të lidhen do të rregullohen nga një regjim juridik i së drejtës publike.

Të gjitha këto norma ligjore, si dhe analiza që bën Kolegji konfirmojnë qëndrimin se: **interesi publik i strehimit të personave të pastrehë dhe me mundësi të ulët ekonomike bën që të ekzistojnë rregulla specifike për kontratën e shitjes së banesave sociale, që plotëson kriterin material të kontratës administrative - praninë e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike. Kontrata e shitjes së banesave sociale është në funksion të një shërbimi publik, që ofron shteti, nisur nga interesi publik për zbatimin e objektivave sociale të parashikuar në nenin 59 (1)(b) të Kushtetutës dhe rregullohet e i nënshtrohet regjimit juridik të së drejtës publike. Për rrjedhojë, shqyrtimi i mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë lloj kontrate, do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative.**

Lidhur me përgjigjen e pyetjes së tretë, Kolegji i qëndron analizës dhe interpretimit të zhvilluar më sipër për cilësimin, pikësëpari, të EKB si organi publik, që kryen shitjet tek personat e së drejtës private. Për këto kontrata shitje/privatizimi të banesave shtetërore, konsiderohet i plotësuar kushti i kriterit organik të kontratës administrative (organi publik si palë kontraktuese), ndërkohë që Kolegji e vlerëson të domosdoshme edhe përmbushjen e kriterit material, pasi nuk mund të konkludohet në mënyrë kategorike se të gjitha mosmarrëveshjet, që shfaqen në fushën e privatizimit të banesave shtetërore, janë domosdoshërisht administrative.

Në këtë aspekt, vlen të analizohen shumë faktorë që lidhen, në këtë rast, me objektin, qëllimin, si dhe me normat juridike që rregullojnë natyrën e marrëdhënies juridike, të cilat duhet të dalin të qarta nga objekti i kërkimit, nga pretendimet që parashatrojnë palët, por edhe nga interpretimi dhe konkluzioni që nxjerr gjykata për zgjidhjen e çështjes. Kolegji vlerëson se çështje e privatizimit të banesave shtetërore kanë të përbashkëta, ashtu siç kanë edhe veçori, krahasuar me kontratat që lidhen në kuadrin e programit sociale të strehimit. Ato nuk janë tërësisht të njëjta në përmbajtjen e tyre dhe, për këtë arsye, duhen analizuar hollësisht. Është e vërtetë që EKB, kur shet këto banesa, vepron përgjatë ushtrimit dhe përmbushjes së funksioneve administrative publike dhe se qëllimi dhe objektivi i ligjit 7652/1992 dhe i ligjit nr. 9321/2004 është brenda perimetrit të misionit të shërbimit publik të strehimit, sepse i mundëson qiramarrësve të banesave shtetërore të bëhen pronarë të tyre (neni 1), si dhe krijon tregun e banesave. Gjithashtu, regjimi juridik që zbatohet për këto kontrata është ai i së drejtës publike, sepse përcaktimi i çmimit të kontratës së shitjes bëhet jo sipas tregut të lirë, por me VKM dhe se për disa banesa e kategori subjektsh që përmbushin kushte të caktuara (ata që kanë statusin e ish të burgosurit, të internuarit, të dëbuarit politik dhe të invalidit të luftës), kalimi i pronësisë është falas. Megjithatë, Kolegji thekson se është e nevojshme se për të analizuar mosmarrëveshjet që krijohen në fushën e privatizimit të banesave

shtetërore (proces i cili është pothuajse i përfunduar) duhet të orientohemi edhe nga përfundimi i arritur nga analiza e bërë në këtë vendim njëses se *përcaktuese është edhe mënyra se si palët i ngrënë pretendimet dhe i parashatrojnë kërkesat e tyre, duke u orientuar te marrëdhëniet juridiko-civile apo ato juridiko-publike, si dhe te zgjidhja e pasojave para gjykatës kompetente.*

Në këtë aspekt vlen të theksohet se pavarësisht nga natyra në dukje administrative që përmban një kontratë e privatizimit të banesave shtetërore, ndryshe paraqitet çështja kur kundërshtimi vjen nga palët në kontratë dhe ndryshe kur të tretët pretendojnë fitimin e pronësisë mbi këtë banesë (ku këto të fundit përbëjnë edhe numrin më të madh të çështjeve që kanë mbetur për zgjidhje para gjykatave). Nuk përjashtohen rastet kur çështje me objekt pavlefshmërinë absolute të kontratave të privatizimit me pasojë kalimin e tyre në favor të shtetit të identifikohen si administrative. Ndërkohë që në çështje, ku paditësi i cili nuk është palë në kontratë i kundërtrohet EKB dhe blerësit të banesës shtetërore, duke kërkuar detyrimin për njohjen e tij si pronar/bashkëpronar, atëherë mosmarrëveshja në një rast të tillë trajtohet si me natyrë të mirëfilltëcivile dhe kompetente për shqyrtimin e tyre do të jetë gjykata e juridiksionit të përgjithshëm dhe jo gjykata administrative. Kjo është përgjithësisht edhe praktika që është ndjekur së fundmi në disa vendime të Gjykatës së Lartë. Mbi këtë analizë të detajuar ligjore, doktrinare dhe jurisprudenciale, Kolegji arrin në përfundimin:

Kontrata e privatizimit të banesave shtetërore, në kuptim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa” ka elementet e një kontrate administrative.

- **Megjithatë, për të përcaktuar gjykatën kompetente për shqyrtimin e një mosmarrëveshje, në të cilën vihet në diskutim një kontratë privatizimi banese, përcaktuese do të jetë natyra juridike e mosmarrëveshjes dhe kërkimet konkrete të palëve.**
- **Nëse pala kundërshton kontratën administrative, për shkak se bie ndesh me normat e të drejtës publike dhe ka për pasojë kthimin e pronës tek organi publik, kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes është gjykata administrative.**
- **Nëse një person i tretë, që nuk është palë në kontratë, kërkon njohjen pronar apo bashkëpronar mbi banesën e privatizuar nga pala tjetër, sipas ligjeve të mësipërme, pavarësisht se në mënyrë të tërthortë ngre pretendime edhe për vlefshmërinë e kontratës së privatizimit, mosmarrëveshja në këtë rast është e natyrës civile dhe shqyrtimi i saj është në kompetencën e gjykatës civile.**

Në rastin konkret [...] referuar kontratës për shitje të banesës shtetërore, të lidhur nga palët, mbi bazën e një programi social të strehimit, por edhe arsyetimit të sipërpërmendur, Kolegji vlerëson se kur organi publik ndërhyr me akt nënligjor për zbatimin e një objekti social në favor të përfituesve, mosmarrëveshja që krijohet në këtë rast për zbatimin e kontratës, duhet të cilësohet si administrative. [...] Nga ana tjetër, Kolegji evidenton edhe

faktin se, në rastin në shqyrtim padia mbështetet në pretendimin se kontrata e lidhur mes palëve i ka ndërprerë efektet e mëtejshme për shkak të një VKM, që vendos të kalojë në pronësi pa shpërblim banesën përkatëse. Mbi këtë pretendim, paditësi kërkon kthimin nga një organ publik të vlerës së çmimit të kontratës që ka paguar, pas hyrjes në fuqi të aktit nënligjor normativ VKM nr. 367, datë 18.04.2013. Një padi me këtë objekt dhe shkak ligjor, që lidhet me pretendimin për pagim të padetyruar organit publik, e cilëson marrëdhënien juridike të pretenduar, e për rrjedhojë edhe mosmarrëveshjen, si juridiko administrative, ndaj edhe kompetencën për gjykimin e çështjes e ka vetëm gjykata administrative. Referuar analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin u vlerësua se mosmarrëveshja objekt gjykimi është në kompetencë të gjykatës civile, është i pabazuar në ligj. Gjykata Administrative e Apelit ka kompetencën të shqyrtojë mosmarrëveshjen, duke qenë detyrë e saj të vlerësojë pretendimet e ngritura në ankim për një pagim të padetyruar dhe lindjen e përgjegjësisë së EKB, kundrejt konkluzionit të gjykatës së shkallës së parë për vijimin e zbatimit të kontratës dhe efekteve të saj, edhe pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 367, datë 18.04.2013.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL 00-2020-836, datë 16.11.2020, KAGJL 00-2021-1634, datë 4.11.2021

KAGJL Vendim Nr.31003-208-2021, datë 07.05.2021 (Dallimi: Korigjim Dhënash në Regjistra Publikë/Vërtetim Gjyqësisht Fakti Juridik)

Paditë e ngritura për vërtetimin e qenies ose jo të një marrëdhënieje juridike ose një të drejte si dhe për njohjen e vërtetësisë ose jo të një dokumenti me pasoja juridike për paditësin duhet të gjykohen nga e njëjta gjykatë pasi mosmarrëveshja është e njëjtë si në lëndë dhe në lloj. Kategorizimi procedural i padive nuk përcakton apriori kompetencën lëndore të gjykatës, kompetencë e cila përcaktohet nga natyra juridike e kërkimeve të përfshira në të. Në fushën e pensioneve, dy janë kriteret thelbësore që përcaktojnë natyrën e gjykimit: Së pari, kriteri formal, nëse kërkuesi i është drejtuar gjykatës përmes një gjykimi gracioz ose kontencioz dhe së dyti, kriteri substancial, nëse e drejta e pretenduar gjyqësish përmes padisë vepron si një çështje e ndërmjetme e të drejtës kryesore, që është njohja e të drejtës së pensionit.

Në rastet kur kundërshtohet akti administrativ apo veprimet ose mosveprimet e organit publik që kanë ndikuar në njohjen e të drejtës së pensionit, kemi kompetencë administrative. Ndërsa në rastin e kërkimit për vërtetimin gjyqësish të faktit juridik, që ndikon në lindjen e të drejtës së pensionit, për shkak se dokumentacioni që provon faktet e pretenduara nga kërkuesi ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri në rrugë tjetër, përveç rrugës gjyqësore, gjendemi përpara një lloji të posaçëm gjykimi gracioz i cili përbën lëndë civile për gjykim ku prevalon kriteri formal ndaj atij substancial në identifikimin e gjykatës kompetente.

Fjalë kyçe: vërtetimin gjyqësish të faktit juridik, njohjen të drejtës së pensionit, natyra e gjykimit, kriteri formal, kriteri substancial

Rrethanat e çështjes:

Paditësja M.Ç., pasi ka plotësuar moshën për pension pleqërie, i është drejtuar DRSSH, Dega Rajonale Fier për t'i lidhur pension të plotë pleqërie, bazuar në vitet e vjetërisë në punë. Sipas vendimit nr. 339, datë 20.07.2020 rezulton se DRSSH Fier ka refuzuar të njoh vitet e punës për periudhën 06.04.1987 - 30.09.1993, si dhe 01.12.1993 - 31.12.1993, me arsyetimin se librezat e punës e paraqitur është dublikatë, e hapur në vitin 1996 dhe në të janë pasqyruar vula të palexueshme. Gjithashtu për vitet e punës për periudhën 25.01.1995 - 15.04.1996, subjekti nuk rezulton të ketë paguar sigurimet shoqërore.

Në këto kushte, paditësja i është drejtuar gjykatës me objekti kërkimi **vërtetimin** si i rregullt i dokumentit, librezë pune. Këto pretendime kërkuesja i ka ngritur në kuadër të përfitimit e plotë të pensionit të pleqërisë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur të shpall moskompetencën lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për gjykimin e çështjes civile [...] për kompetencë gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Më tej, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin ka vendosur ti drejtohet Gjykatës së Lartë me qëllim për tu shprehur për kompetencën lëndore [...].

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji...pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi objektin dhe shkaku ligjor të padisë, çmon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është i bazuar në ligj dhe duhet të lihet në fuqi. Shkaku i mosmarrëveshjes lidhet me paqartësinë që krijon objekti i padisë, në të cilin përfshihet kërkimi për vërtetësinë e dokumentit "librezë pune", me synim përfitimin e të drejtës për pension pleqërie për paditësen.

Nisur nga natyra juridike e kërimit që, në rastin konkret ka investuar gjykatën, Kolegji çmon të rëndësishme të evidentojë se, praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, në çështje të ngjashme, nuk ka qenë koherente. [...]

Kolegji Administrativ vlerëson të domosdoshme të individualizojë kriteret bazë, që do i shërbejnë gjykatave më të ulëta për të zgjidhur *pro futuro* dhe, rast pas rasti, çështjen e kompetencës lëndore.

Kolegji vlerëson të marrë në analizë fillimisht natyrën juridike dhe llojet e padive, sipas nenit 32 të KPC, dallimin midis tyre dhe raportin juridik që krijojnë me njëra-tjetrën, gjykimet e iniciuara nga padi të tilla, pozicionin ligjor përcaktues që ka organi publik (drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore) në shqyrtimin e kërkesave të të interesuarve, gjatë procedurës hetimore administrative, por edhe roli i gjyqtarit të çështjes që në fazën e kryerjes së veprimeve paraprake.

Natyra juridike dhe llojet e padive, sipas nenit 32 të KPC, si dhe dallimi mes tyre.

Në radhë të parë, Kolegji vlerëson se neni 32 i KPC është një dispozitë kuadër dhe e përgjithshme që, ashtu si doktrina juridike dhe jurisprudenca gjyqësore, i kategorizon proceduralisht paditë në dy lloje: në padi detyrimi (*formulae praeiudiciales*), si dhe padi njohjeje apo deklarative. Paditë e detyrimit, të ngritura sipas nenit 32/a të KPC, janë mjete me të cilat paditësi investon gjykatën për të kërkuar rivendosjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm të cenuar. Padi të tilla kanë për qëllim të provokojnë nxjerrjen e një vendimi

gjqësor detyruet në përfundim të gjykimit (*kondemnator*), në kuptim të nenit 511/a të KPC. Nga ana tjetër, paditë e njohjes apo me natyrë deklarative, sipas shkronjës b) dhe c) të nenit 32 të KPC, të njohura ndryshe si padi provokatore, nuk shoqërohen në kërkim edhe me detyrimin e të paditurit për kryerjen e një veprimi të caktuar. Padi të tilla sigurojnë bazën për një padi detyrimi në të ardhmen (*formulae praeiudiciales*) dhe kanë natyrën e çështjeve paragjykimore në raport me paditë e detyrimit.

Në veçanti, padia e ngritur sipas nenit 32/c të KPC përfaqëson instrumentin e kontrollit të vërtetësisë së një dokumenti. Ashtu sikundër edhe verifikimi i origjinalitetit të dokumentit apo goditja e shkresës për falsitet, një pretendim i tillë mund të realizohet nëpërmjet një gjykimi principal (themeli), sipas kësaj dispozite, ose nëpërmjet gjykimit incidental (paragjykimor), të investuar nga një padi detyrimi, sipas nenit 32/a të KPC apo edhe padi njohjeje sipas nenit 32/b të KPC, ku çështja e origjinalitetit, falsitetit apo vërtetësisë së dokumentit shtrohet për zgjidhje, jo më si qëllim në vetvete, por si mjet për të arritur zgjidhjen e çështjes kryesore.

Sipas parimit të disponibilitetit maksimal të padisë dhe të të drejtave subjektive, pala e interesuar mund të përzgjedhë të ngrejë padinë, sipas nenit 32, shkronja b) ose c), e cila është provokatore dhe mund të jetë bazë për ngritjen e padisë së themelit në të ardhmen ose mund të ngrejë menjëherë padinë e themelit, ku pretendimi për njohjen e së drejtës, për vërtetësinë ose pavërtetësinë e dokumentit është pjesë e shkaktit të padisë dhe do të gjykohet në formë paragjykimore nga gjykata që gjykon themelin e mosmarrëveshjes. Në çdo rast, të dyja llojet e padive, do të duhet të gjykojnë nga e njëjta gjykatë, pasi është e njëjta mosmarrëveshje, në lëndë dhe në lloj.

[...]

Nenit 7 ligjit nr. 49/2012 parashikon një listë të hapur dhe përcakton kriteret orientuese që duhet të ketë parasysh gjykata për të identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, sipas shkaktit dhe objektit të padisë. [...] Kolegji vlerëson se neni 32 i KPC është një dispozitë kuadër dhe e përgjithshme, e cila kategorizon proceduralisht llojet e padive. Ky kategorizim juridik është i vlefshëm për të gjitha llojet e padive dhe nuk lidhet me natyrën e kompetencës lëndore të gjykatave, të cilat ato aktivizojnë. Kjo do të thotë se si gjykatat administrative, ashtu edhe gjykatat civile mundet të gjykojnë padi detyrimi, padi njohjeje apo padi me objekt vërtetësinë apo jo të një dokumenti. Ajo ç'ka ndan dhe përcakton ligjërisht kompetencën lëndore të padive civile dhe administrative nuk është kategorizimi procedural i nenit 32 të KPC, por natyra juridike e kërtimeve të përfshira në të. Kjo dispozitë përbën burimin primar të së drejtës procedurale që rregullon në mënyrë të përgjithshme të drejtën e padisë dhe llojet e saj dhe gjen zbatim në mënyrë komplementare me çdo ligj që rregullon në mënyrë të posaçme të drejtën e padisë, sipas marrëdhënies juridike konkrete.

Për paditë e njohjes, sikurse parashikohen në nenin 32/b dhe 32/c të KPC, nuk mund të konkludohet se janë *a priori* lëndë gjykimi civil, vetëm se rregullohen nga KPC... prandaj gjykata, rast pas rasti, vlerëson nëse një padi e ngritur sipas nenit 32/b apo 32/c të KPC është në kompetencën lëndore të gjykatës civile apo administrative duhet të shqyrtojnë dhe të konkludojnë drejtë mbi kriterin objektiv dhe material, që

do të thotë mbi natyrën e marrëdhënies juridike të palëve, e cila ka ardhur në gjykatë si kontest gjyqësor. Gjykatat do të duhet të individualizojnë se cili është qëllimi dhe interesi i paditësit në ngritjen e padisë, shkaku që ka provokuar ngritjen e saj, kujt i kundrejtohet ajo, me çfarë lloj gjykimi apo procedimi krijon raportin paragjykimor apo të ndërmjetëm gjykimi i investuar nga një padi e tillë.

Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin *prima facie* të padisë. Ato duhet të shqyrtojnë, më tej, faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërtimeve të padisë, të të drejtës subjektive, të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet t'i kundërvihet kësaj të drejte subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes.

[...] *..në rastet kur paditë e pavërtetësisë së një dokumenti i kundrejtohen një organi publik, sikurse janë, në veçanti, paditë për njohjen e së drejtës së pensionit, kanë si qëllim detyrimin e organit publik të njohë ose jo vlerën provuese të një dokumenti, në mënyrë që ky i fundit të përdoret ose jo si provë në procedurën administrative.* Padi të tilla kanë si shkak dhe janë të provokuara, përgjithësisht në praktikë, nga një sjellje neglizhente apo mosveprim i organeve të administratës publike, të cilat nuk përmbushin detyrimet ligjore që kërkon hetimi administrativ. Kjo mund të ndodhë, herë për shkak të mungesës së kujdesit të duhur dhe, herë për shkak të keqkuptimit mbi funksionin, të drejtat dhe detyrimet që këto organe kanë në procedurën administrative.

[...] *Raporti ndërmjet padive sipas nenit 32 të KPC dhe kërkesës për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik.* Në praktikën gjyqësore konstatohen paqartësi, nga palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit profesionist të palëve, sa i përket shkaqeve për të cilat ngrihet padia në mbështetje të nenit 32 b) dhe c) të KPC dhe shkaqeve për të cilat ngrihet kërkesa për vërtetim fakti, në mbështetje të nenit 388 të tij. Kjo paqartësi reflektohet edhe nga gjykatat e faktit në funksion të përcaktimit të gjykatës kompetente për nga pikëpamja lëndore për gjykimin e padisë/kërimit.

Dallimi i parë dhe kryesor mes tyre është qëllimi për të cilin investohet mjeti procedural. Neni 388 i KPC ka për qëllim të garantojë ekzistencën e një fakti juridik, i cili nuk mund të provohet drejtpërdrejtë nga përmbajtja e një akti. Sipas kësaj dispozite procedurale çdo palë e interesuar ka mundësi të krijojë gjyqësish një dokument shkresor, i cili nëse ka ekzistuar, paraqet një fakt, nga i cili varet lindja, ndryshimi dhe shuarja e të drejtave personale apo pasurore për këtë palë. Vërtetimi gjyqësor i fakteve juridike konfirmon ekzistencën e këtij fakti dhe i shërben palës si mjet prove për këtë fakt. Nga ana tjetër, padia nuk ka për qëllim konfirmimin e ekzistencës së faktit juridik, por vërtetimin e (mos)qenies së një marrëdhënie juridike/të drejte (neni 32/b i KPC), ose njohjen e (pa)vërtetësisë së një dokumenti (neni 32/c i KPC).

Në gjykimet për vërtetimin gjyqësor të fakteve, kushtet e domosdoshme që duhet të provojë kërkuesi janë: *Së pari: i)* personi që e kërkon vërtetimin gjyqësish të faktit juridik duhet të ketë interes të ligjshëm në inicimin e këtij procesi; *ii)* akti të jetë

zhdukur; *iii*) akti që ka humbur nuk mund të bëhet përsëri; *iv*) akti nuk mund të merret me rrugë tjetër; *Së dyti*, vërtetimi i fakteve juridike është një gjykim gracioz, jo kontencion. Vërtetimi gjyqësor i faktit proceduralisht paraqet në formën e një gjykim pa palë kundërshtare. Sipas nenit 390 të KPC, në gjykim mund të thirren me cilësinë e personit të tretë edhe persona të tjerë, ose prokurori. Padia është mjete procedural, ku pretendimet e paditësit i kundrejtohen palës kundërshtare në një gjykim kontencioz, kontradiktor; *Së treti*, vërtetimi gjyqësor i fakteve karakterizohet nga mungesa e konfliktit, për arsye se gjykimi për vërtetimin gjyqësor të një fakti ka për qëllim të konstatojë ekzistencën, ose mos ekzistencën e një fakti të caktuar, i cili nuk mund të provohet me dokumentin e nevojshëm. Ai nuk ka për qëllim të zgjidhë një konflikt të caktuar të së drejtës. Për këtë arsye, ky gjykim nuk është kontencioz, pra pa palë kundërshtare, ndërsa gjykimi për vërtetimin e ekzistencës, ose mos ekzistencës së një marrëdhënie juridike/të drejte ose njohjen e (pa)vërtetësisë së një dokumenti, ka për qëllim të zgjidhë një konflikt mes palëve. Në padinë sipas nenit 32/b të KPC, konflikti lind nga kundërshtimi rreth ekzistencës, ose mos ekzistencës së marrëdhënies juridike, ose të një të drejte midis palëve ndërgjyqëse, ndërsa në padinë sipas nenit 32/c, konflikti lind për shkak të kundërshtimit të (pa)vërtetësisë së dokumentit; *Së fundmi*, vendimi për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik ka natyrë deklarative. Vendimi gjyqësor për vërtetim fakti ka fuqi provuese për kërkuesin dhe personat e tjerë të thirrur në gjykim dhe prej këtyre të fundit nuk kërkohet asgjë, sepse nuk ju është kundërtuar asnjë kërkim i kundërshtuar prej tyre.

[..]Mbi pozicionin ligjor të organit publik gjatë procedurës hetimore administrative. ..Kolegji vlerëson se hetimi, marrja e provave, mbledhja e fakteve dhe vlerësimi i tyre në tërësi, si çështje e ndërmjetme e procedurës hetimore administrative, nga e cila varet zgjidhja e çështjes, nuk është kompetencë dhe tagër vetëm i pushtetit gjyqësor, por është detyrim primar dhe funksional i organit publik që do të vendosë mbi kërkesën e palës së interesuar në procedurën administrative. Detyrimi për të shqyrtuar kërkesën dhe për tu shprehur me vendim përfundimtar, nuk mund të kuptohet si një proces i shkëputur dhe i ndarë nga procesi i verifikimit të fakteve dhe provave, në themel të së drejtës subjektive të pretenduar nga pala e interesuar. Ky verifikim nuk mund të jetë i përciptë dhe mekanik, por duhet të jetë tërësor dhe i thelluar.

*[..]Në përfundim të hetimit, organi publik duhet të bëjë një analizë tërësore të fakteve dhe provave, bazuar në arsytetime dhe deduksione, sipas rregullave të logjikës formale, cilësi që nuk mund të kuptohen se janë ekskluzivitet vetëm i magjistratit, por edhe i nëpunësit publik. Kolegji vlerëson se *ligjvënësi e ka pajisur organin administrativ me të njëjtin kapacitet ligjor për të hetuar, sikurse organet gjyqësore*. Ai ka të drejtën dhe detyrimin të pranojë dhe të marrë prova nga pala në procedurën administrative, sipas të gjitha burimeve të provës, të lejuara edhe në gjykimin administrativ apo civil: dokumente, prova me dëshmitar, deklarata të palëve, ekspertime etj. ...*Vetëm nëse organi publik (organet kompetente në fushën e sigurimeve shoqërore) nuk do kenë përmbushur këto detyrime ligjore, apo subjekti i interesuar nuk do të bindet për vendimmarrjen e tyre, atëherë kjo veprimtari administrative do të jetë objekt i kontrollit gjyqësor.**

[..] Lidhur me rolin e gjyqtarit të çështjes që në fazën e kryerjes së veprimeve paraprake. I gjithë procesi i gjykimit administrohet nga gjyqtari. Ky administrim i procesit, në kuptimin formal e procedural, do të thotë se gjyqtari, ndërsa mbetet arbitër i paanshëm, njëkohësisht kontrollon edhe veprimtarinë e pjesëmarrësve në proces, përmbushjen prej tyre të detyrimeve procedurale, me qëllim shqyrtimin dhe përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. ..Në këtë kuptim, para së gjithash, padia që i paraqitet gjykatës kërkohet të plotësojë të gjitha kushtet formale të saj. Verifikimi me saktësi nga gjyqtari i kushteve formale të padisë, duke filluar, në veçanti, me legjitimitetin aktiv e pasiv, përcaktimin e qartë të objektit të padisë, sikurse edhe të shkakut të saj ligjor janë thelbësore për të kuptuar natyrën e mosmarrëveshjes e, për rrjedhojë, edhe kompetencën lëndore të gjykatës, ku është paraqitur padia.

Kolegji thekson se kryerja e këtij verifikimi paraprak është i domosdoshëm dhe thelbësor për drejtësinë e vendimmarrjes, por edhe sepse i shërben ekonomisë gjyqësore, ashtu siç shmang investimin e gjykatës në një çështje, qartësisht, pa një të ardhme. Moskryerja me seriozitet e këtij verifikimi nga gjyqtari, që në fazën e paraqitjes së padisë dhe rregullimit të të metave të saj, është një ndër arsytet që ndikon në shtimin artificialisht të mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet gjykatave administrative e civile, në veçanti, në çështjet që lidhen me përfitimin e të drejtës për pension. Një kërkesëpadi që përmban të meta të dukshme në kërkimet e ndërthurura e të shumta të objektit të padisë, apo në mos përcaktimin e saktë të shkakut ligjor prej paditësit, është e nevojshme që të rikthehet për tu plotësuar apo saktësuar në tërësinë e saj.

[..] Është i konsoliduar tashmë qëndrimi i mbajtur nga ky Kolegj, se gjyqtari, në momentin e paraqitjes së padisë, duhet të bëjë mirë dallimin ndërmjet kërkimeve të palëve për njohjen e një të drejte në fushën e marrëdhënieve të sigurimeve shoqërore (vendim nr. 00-2020-567, datë 12.10.2020, nr. 31003-1094-00-2020 akti, datë 14.12.2020 si dhe vendimin nr. 00-2020-797, datë 16.11.2020 i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë)... [..] Kolegji çmon të domosdoshme të nënvizojë rregullin se elementi përcaktues që evidenton kompetencën lëndore të gjykatës është natyra juridike e shkakut të padisë. Është pikërisht shkakut ligjor i padisë, elementi thelbësor që do të ndihmojë gjykatën në përcaktimin e kompetencës lëndore. Shkakut ligjor i padisë, pra, thelbi material për të cilin investohet gjykimi, ndikon dhe është pazgjidhshmërisht i lidhur me elementët formal procedural të gjykimit (vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 3, datë 29.03.2012).

Në praktikën gjyqësore dallohen forma të larmishme në paraqitjen e kërkimeve/padive, me qëllim njohjen e të drejtës subjektive të pensionit. *Kolegji vlerëson se dy janë kriteret thelbësore që përcaktojnë natyrën e gjykimit, për efekt të përcaktimit kompetencës lëndore në këto lloj mosmarrëveshje: Së pari, kriteri formal, nëse kërkuesi i është drejtuar gjykatës përmes një gjykimi gracioz ose kontencioz dhe së dyti, kriteri substancial, nëse e drejta e pretenduar gjyqësish përmes padisë vepron si një çështje e ndërmjetme e të drejtës kryesore, që është njohja e të drejtës së pensionit.*

[...] në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore, pranë gjykatave të faktit paraqiten situata të ngjashme me rastet e mëposhtme, kur: i. *Kundërshtohet akti*

administrativ i organit publik, me padi për njohjen e pensionit. Në këtë rast, paditësi kundërshton aktin administrative, sipas nenit 7, shkronja a) të ligjit nr. 49/2012. Në përmbushje të parashikimeve të ligjit nr. 7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, paditësi, pasi ka ezauruar rrugën administrative të ankimit, i drejtohet gjykatës, duke kundërshtuar vendimet e organeve të sigurimeve shoqërore, lidhur me vlefshmërinë dhe saktësinë e dokumentacionit të marrë në shqyrtim prej tyre për caktimin e masës së pensionit. Kolegji vlerëson pa asnjë dyshim se ky lloj gjykimi përbën lëndë administrative dhe kompetente për nga pikëpamja lëndore do të jenë gjykatat administrative. ii. *Kundërshtohen përmes padisë veprimet ose mosveprimet e organit publik që kanë ndikuar në njohjen e të drejtës së pensionit.*⁵⁸ Në këto raste, nuk kundërshtohet akti administrativ përfundimtar i organeve të sigurimeve shoqërore për njohjen/refuzimin e të drejtës së pensionit, por sjellja apo veprimet administrative e organit publik. Nisur nga problematika specifike që mund të ketë pasur kërkuesi në realizimin e të drejtës subjektive të përfitimit të pensionit (pasaktësi dokumentacioni që reflektohet në forma nga me të ndryshmet, si në pasqyrimin e gabuar të gjeneraliteteve, të viteve të punës, vjetërsisë në punë, llojit, kategorisë të punës etj.), kërkohet të konstatohet gjyqësish se (mos)veprimet e organit publik, në funksion të hetimit administrativ të kryer prej tij, ndërhyjnë në mënyrë të paligjshme në të drejtën e pretenduar të kërkuesit. Në këtë kategori të mosmarrëveshjeve kundërshtohet në mënyrë direkte veprimtaria administrative e organit publik, në funksion të lidhjes së pensionit. Në të gjitha këto raste, mes kërkuesit dhe organeve të sigurimeve shoqërore ekziston konflikti për plotësimin ose jo të kushteve për përfitimin e të drejtës së pensionit për shkak të mënyrës së vlerësimit të organit publik. Kolegji thekson se në këto raste, kompetente për nga pikëpamja lëndore për gjykimin e mosmarrëveshjes do jenë gjykatat administrative. Kolegji vlerëson gjithashtu se kur kërkohet njohja e vjetërsisë në punë, e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti, ose saktësia/pasaktësia e tyre, kërkim ky i kundërshtuar organit, për shkak se pas hetimit administrativ organi publik ka refuzuar të njoh të drejtën e pensionit, të pretenduar nga paditësi, kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjes është gjykata administrative. Në këtë rast, pavarësisht se objekti i padisë në dukje mund të paraqes elementët e një kërkimi civil, në thelb kundërshtohet gjyqësish veprimtaria administrative e ndërmjetme e organit publik, në funksion të çështjes kryesore, që është lidhja e pensionit. Për këto arsye, kompetente nga pikëpamja lëndore, sipas nenit 7, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012 vlerësohet se është gjykata administrative. iii. *Kërkohet gjyqësish vërtetimi i faktit juridik, që ndikon në lindjen e të drejtës së pensionit, për shkak se dokumentacioni që provon faktet e pretenduara nga kërkuesi ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri në rrugë tjetër, përveç rrugës gjyqësore.* Në këtë rast, gjendemi para kushteve të nenit 388 të KPC, ku përmes një gjykimi të posaçëm të natyrës civile kërkohet të provohet gjyqësish ekzistenca e një fakti krijues që në të ardhmen mund të aktivizojë njohjen e të drejtës subjektive të paditësit për përfitimin e pensionit. *Ky lloj i posaçëm gjykimi gracioz përbën lëndë civile për gjykim.* Në këto raste, Kolegji vlerëson se do të prevalojë kriteri formal ndaj atij substancial në identifikimin e gjykatës kompetente, pasi ligji procedural civil ka

përcaktuar si gjykatë kompetente gjykatën e vendbanimit të kërkuesit ose gjykatën e vendndodhjes së sendit të paluajtshëm për gjykimin e vërtetimit gjyqësor të faktit. [...]...Pra, në rastin kur ndodhemi përpara vërtetimit gjyqësor të fakteve që ndikojnë në përfitimin e të drejtës subjektive për pension, ligji ka kanalizuar rrugën e kërkimit të së drejtës subjektive, përmes inicimit të një gjykimi gracioz, të parashikuar në nenin 388 të KPC dhe, për rrjedhojë, edhe kompetencën lëndore të gjykatave të rretheve gjyqësore për shqyrtimin e këtij kërkimi.

Duke i'u rikthyer rastit në shqyrtim, Kolegji pasi ka analizuar objektin e kërkesës, formën e paraqitjes së saj dhe aktet provuese, bashkëlidhur dosjes gjyqësore, vlerëson se në mosmarrëveshjen objekt gjykimi rezulton qartësisht se kërkimi është ngritur në mënyrë të gabuar nga kërkuesi dhe kjo e metë formale nuk është konstatuar nga gjykatat e faktit. ... [...]

Kolegji çmon sethelbi i kërkimeve lidhet me mënyrën sesi organi publik ka konkluduar mbi vërtetësinë e dokumentacionit, me anë të të cilit kërkuesja pretendon ekzistencën e viteve të punës, për efekt të lidhjes së pensionit të pleqërisë. Rezulton se kërkuesja i është drejtuar gjykatës, duke pretenduar njohjen e vërtetësisë së dokumentit, librezë pune, pasi organi e ka refuzuar të njoh përmbajtjen e këtij dokumenti. Konstatohet qartazi se për kërkimet e kësaj natyre gjen zbatim neni 32 c) dhe jo neni 388 i KPC. Kolegji vlerëson të nevojshme të ritheksojë se gjykimi mbi vërtetësinë e një dokumenti është i ndryshëm, si në aspektin përmbajtësor, ashtu dhe atë formal, nga gjykimi mbi vërtetimin e një fakti juridik.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL 00-2022-224, datë 21.02.2022, KAGJL 00-2020-172, datë 06.07.2020

KAGJL Vendim Njësues Nr. 00-2023-3406(258), datë 07.07.2023 (Marrëdhënie pune: mesues sistem arsimor publik parauniversitar)

Gjykatat kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë janë gjykatat administrative.

Fjalë kyçe: marrëdhënie punesim mësues arsim parauniversitar publik, ligj i posaçëm, kompetencë gjykata administrative

Rrethanat e çështjes:

Siç rezulton nga konstatimi i faktit prej gjykatave më të ulëta, paditësja ka ushtruar funksionin e mësueses pranë shkollës 9-vjeçare “Mihal Grameno”; [...] marrëdhënia juridike e punës është formalizuar me vendimin nr.12, datë 28.10.2016, nëpërmjet të cilit paditësja Brunilda Gjeçi është emëruar “Mësuese provizore” deri në përfundim të paaftësisë së përkohshme në punë të mësueses E.K. Në kushtet kur paaftësia e përkohshme në punë e mësueses së profilit ka vijuar, paditësja është riemëruar më datë 11.09.2017 si mësuese provizore me kushtin që marrëdhënia punës do të përfundonte

kur të përfundonte paaftësia e përkohshme në punë e mësueses E.K.

Rezulton se mësuesja e emëruar në profilin anglisht E.K. ka dalë në pension 25.05.2021. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, me vendimin nr.197, datë 08.07.2021, ka vendosur të ndërpresë marrëdhënien e punës me paditësen B.GJ. si mësuese zëvendësuese/provizore në shkollën 9-vjeçare “Mihal Grameno” Tiranë, për arsye të mbarimit të afatit provizor të kontratës. Në kontratën e punës së paditëses është bërë shënimi për përfundimin e marrëdhënies së punës më datë 21.07.2021, për shkak të përfundimit të afatit.

Pala paditëse ka pretenduar se largimi nga puna si mësuese pranë shkollës 9-vjeçare “Mihal Grameno” përbën zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës në referim të nenit 155 të KP [...] dhe i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi[...].

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes [...] dërgimin e çështjes [...] gjykatës kompetente që është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë [...] ka vendosur të parashtrijë çështjen e konfliktit të kompetencave për çështjen [...].

Arsyetimi i Kolegjit:

A. Mbi nisjen e procedurës së gjykimit njëses

[...] Kolegji konstatoi se për sa i përket gjykatës kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve të punësimit për mësuesit, vihen re praktika të ndryshme gjyqësore, në lidhje me faktin nëse gjykimi i tyre i përket gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm apo gjykatave administrative. Kolegji ka identifikuar se në vendimet nr. 31003-01255-00-2018, datë 05.06.2018 dhe nr. 00-2021-718 datë 27.05.2021, ka mbajtur qëndrimin se mosmarrëveshjet mbi zgjidhjen e marrëdhënies së punës të mësuesit përbëjnë mosmarrëveshje civile, të cilat rregullohen nga dispozitat e KP, pasi sipas ligjit nr. 39/2017 [...] marrëdhëniet e punës në administratën publike, në gjykatë ose në prokurori, të cilat bazohen në KP, janë përjashtuar nga kompetenca lëndore e gjykatave administrative nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ligji i posaçëm nr. 69, datë 21.6.2012 [...] nuk rregullon marrëdhënien në kuptim të nenit 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Fakti që parashikohet një pikë e dispozitës e cila përcakton se si emërohet një mësues nuk përbën dhe nuk ka kuptimin e ligjit të posaçëm sipas dispozitës së sipërcituar. Në kuptim të nenit 7, shkronja “ç” të ligjit 49/2012 i ndryshuar, do të kuptohet si ligj i posaçëm vetëm ai ligj i cili bënë një rregullim të qartë të marrëdhënies së punës, duke filluar nga mënyra e përcaktimit të kriterëve të punësimit, rekrutimit, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, të drejtat dhe detyrimet e punonjësit, përfitimet përkatëse, masat disiplinore, të drejtën e ankimit dhe organin përkatës i cili ushtron këtë funksion, afatet dhe mënyrën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si dhe çdo masë apo kriter tjetër që shërben për rregullimin e kësaj marrëdhënie pune. Pra, ky ligj do të quhet i posaçëm në kuptim të nenit 7/ç të ligjit 49/2012 dhe që nuk referon në KP për rregullime të tjera apo për mënyrën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës. [...] Pra,

po vetë ligji i posaçëm nr. 69/2012 [...] referon si ligj të zbatueshëm dispozitat e KP.

Ndërsa në vendimet nr. 00-2022-1806, datë 21.07.2022 dhe nr. 00-2023-324, datë 07.02.2023, Kolegji [...] ka mbajtur qëndrimin se në kuptim të nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 69/2012, si dhe aktit nënligjor të dalë në zbatim të tij, në rastin konkret, udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 i ministrit të Arsimit parashikon një procedurë të hollësishme mbi emërimin dhe, në veçanti, për largimin nga puna të mësuesve, rregulla të cilat duhet të respektohen, si nga punëdhënësi, ashtu edhe nga punëmarrësi. Marrëdhënia e punës me mësuesit gjen rregullim nga ligji i posaçëm nr. 69/2012 [...]dhe jo nga KP, pasi në ligjin e posaçëm parashikohet, procedura e rekrutimit të mësuesve, e cila kalon në disa faza, ku, midis të tjerave, parashikohet edhe rruga e ankimit për çdo fazë konkurrimi.

Gjithashtu, Kolegji konstaton se në Gjykatën e Lartë, në lidhje me objektin e mësipërm, janë paraqitur një numër çështjesh mbi mosmarrëveshjen për kompetencë ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave administrative. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata që ka kompetencën lëndore për gjykimin e çështjeve që lidhen me mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me sa më sipër, në referim të nenit 62(a)(2) të ligjit nr. 49/2012, Kolegji [...] në dhomë këshillimi, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për njësim pyetjen:

Cila është gjykata kompetente që gjykon mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë?

B. Analiza e çështjes së shtruar për njësim

Kolegji, referuar jurisprudence së Gjykatës së Lartë, vlerëson se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. [...] (*shih vendimin nr. 917, datë 11.05.2017, nr. 00-2022- 3905, datë 15.12.2022; nr. 00-2023- 2318, datë 22.05.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili përcakton konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. [...]Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kriterë themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete (*shih vendimin nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet.

Kolegji vlerëson thelbësore të evidentojë [...] Gjithashtu edhe jurisprudenca e

Gjykatës Kushtetuese mbi termin “Ligj” të përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka mbajtur qëndrimin se një parashikim i tillë nënkupton një interpretim të gjerë, duke mos përjashtuar, në varësi të formulimit të përdorur, aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit “Ligj”, në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës, dhe jo të aktit të organit ligjvënës (Kuvendit). Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës. Nisur nga konteksti, termi “Ligj”, në nenin 17 të Kushtetutës, nuk ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në nenin 18, *barazia para ligjit*. Kjo e fundit identifikohet me të drejtën në përgjithësi, ndërsa e para të referon në kompetencën e një organi të vetëm. Konteksti, në të cilën është përdorur togfjalëshi “vetëm me ligj” nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta, si në rastin në shqyrtim. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe GJEDNJ në praktikën e saj (*shih vendimi Delcourt kundër Belgjikës, datë 17.01.1970*). Koncepti i zgjeruar i termit “Ligj” që përdoret në doktrinë, nuk vlen për nenin 17 të Kushtetutës. Togfjalëshi përjashtues “vetëm me ligj”, i përdorur në nenet 11(3) dhe 17 të Kushtetutës, ka të bëjë me kufizime të të drejtave dhe ka kuptim të njëjtë, atë të interpretimit të ngushtë, në dallim nga dispozitat e tjera ku termi “Ligj” mund të kuptohet më gjerë. Në këtë përfundim, veç sa u përmend, arrihet edhe duke iu referuar fjalës *vetëm* që përmendin nenet 11(3) e 17 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është i rastit, por ai është bërë për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. [...] (*shih vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, vendim nr. 7 datë 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Duke marrë në konsideratë standardet e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi interpretimin e normës, si dhe bazuar në interpretimin teleologjik dhe logjik të saj, Kolegji çmon se terminologjia e përdorur në nenin 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar ia ka njohur ligjit, në kuptimin e gjerë të tij, të drejtën e parashikimit të dispozitave të posaçme për rregullimin e marrëdhënies juridike. Pra, formulimi i nenit 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012 ka lidhur kompetencën e gjykatave administrative me kushtin e rregullimit të marrëdhënies së punës me ligj organik. [...] Vlen të theksohet se pas ndryshimit të vitit 2017, edhe neni 17(1)(g) do të shihet i lidhur me nenin 7(ç) të ligjit nr.49/2012 dhe do të interpretohet sipas kuptimit të këtij neni. Në vijim, pas trajtimit të bërë për kuptimin e termit “Ligj” [...] Kolegji vlerëson të nevojshme të analizojë natyrën e ligjit nr. 69, datë 21.6.2012 “[...]”, të udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “[...]”, si edhe të udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “[...]”, i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019, (hyrë në fuqi pas datës 16.06.2021), për sa i përket klasifikimit të marrëdhënies së punësimit të mësuesve si “nëpunës shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm”.

Neni 7(ç) i ligjit nr. 49/2012 përbëhet nga dy fjali, ku e para vendos rregullin e zbatueshëm dhe e dyta përjashtimin nga ky rregull. Sipas fjalisë së parë të këtij neni, rregulli është se në kompetencën lëndore të gjykatave administrative janë

mosmarrëveshjet që lindin në fushën e marrëdhënieve të punës [...] Fjalja e dytë përjashton nga rregulli i mësipërm kategorinë e mëposhtme [...]

Kolegji vëren se në rastin e dispozitave, si ajo e nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012, për identifikimin e rregullit të së drejtës që ato përmbajnë, zbatohet teknika e interpretimit e quajtur “Ejusdem Generis” (të të njëjtit lloj dhe natyrë). Sipas kësaj teknike interpretimi, kur fjalë apo fraza të përgjithshme pasojnë një renditje të dy apo më shumë personave, sendeve apo rrethanave specifike, ato (fjalët e përgjithshme) gjejnë zbatim vetëm për personat, sendet apo rrethanat që përfshihen në të njëjtin lloj të përgjithshëm apo klasë me ato që përmenden specifikisht. Pra, për të kuptuar se nga se përbëhet bashkësia e “nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë rregullim të posaçëm”, nevojitet të gjendet e përbashkëta e tre kategorive specifike të përmendura nga dispozita që janë “nëpunësit civilë”, “nëpunësit civilë gjyqësorë” dhe “nëpunësit civilë të prokurorisë”.

Një nga të përbashkëtat e marrëdhënies së punës të kategorive “nëpunës civil”, “nëpunës civil gjyqësor” dhe “nëpunës civil të prokurorisë” është se në të tre rastet ka një ligj organik të veçantë që rregullon marrëdhënien e tyre të punës, në mënyrë më shumë apo më pak të detajuar, si dhe parashikimin nga këto ligje të rregullimit me akte nënligjore të aspekteve të veçanta të këtyre marrëdhënieve. Pra, e përbashkëta që i vendos të tri këto kategori në një bashkësi, është rregullimi i aspekteve kryesore të marrëdhënies së tyre të punës ekskluzivisht me ligj të veçantë dhe në vijim rregullimi i detajuar i saj me akte nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatimin e këtyre ligjeve. Për këtë mjafton të shihet formulimi i neneve 19(9), 22(6), 23(5), 24(5), 25(5), 26(9), 28(6), 48(7), 50(9), 56(5), 59(10), etj, të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar); neneve 34(9), 41(2), 42(10), 43(3), 44(3), 54(7), 57(13), 58(6), etj, të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; apo neneve 59(2), 73(9), 74(7), 77(14), 78(6), 83(4), 85(11), 86(7), 88(4), 102, etj, të ligjit nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. [...] Pra, rregullimi i marrëdhënies së tyre të punës nuk bëhet vetëm nga ligji, por edhe nga aktet nënligjore, të cilat së bashku përbëjnë kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënies së punës.

Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se do të konsiderohen marrëdhënie juridike të rregulluara me ligj organik të posaçëm edhe rastet kur përveç rregullimit pjesor të lëndës me ligj, ky i fundit në zbatim të nenit 118 të Kushtetutës autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë në mënyrë më të detajuar marrëdhënien e punës, duke përcaktuar organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte nënligjore. Ky arsyetim gjen zbatim për sa kohë ligjvënësi (ligji nr. 49/2012) nuk e ka kushtëzuar rregullimin e posaçëm të marrëdhënies së punës “vetëm me ligj”.

[...] Kolegji vlerëson se neni 118 i Kushtetutës vendos disa kritere, të cilat, nga njëra anë, e detyrojnë ligjvënësin t’u përmbahet atyre në mënyrë rigorozë dhe, nga ana tjetër, orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore. Kuvendi, nëse nëpërmjet ligjit autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore, duhet të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në

bazë të të cilave nxirren këto akte.

Konkretisht, neni 60 i ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ia ka deleguar përcaktimin e procedurave të detajuara për konkurrimin, vlerësimin, si dhe largimin nga detyra të mësuesit, ministrit, duke i njohur këtij të fundit të drejtën për të nxjerrë akte nënligjore (udhëzime). Kolegji çmon se ajo është një dispozitë deleguese, e cila respekton rezervën ligjore relative, si dhe kriteret për nxjerrjen e akteve nënligjore, të sanksionuara në nenin 118 të Kushtetutës. [...] Pra, neni 60 i ligjit nr. 69/2012 ka autorizuar nxjerrjen e akteve nënligjore, ka përcaktuar organin kompetent, si dhe çështjet specifike që duhen rregulluar mbi bazën e parimeve kryesore për emërimin dhe largimin nga detyra të mësuesve.

Për sa më sipër del në pah qëllimi i ligjvënësit për ta deleguar me akte nënligjore rregullimin e procedurës së pranimit, emërimit, largimit apo lëvizjes paralele të mësuesve, por edhe të procedurës që subjektet duhet të ndjekin pranë këtij organi në sistemin arsimor parauniversitar. Në respektim të këtij delegimi, ministri i Arsimit dhe Sportit ka nxjerrë udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 [...] dhe në vijim, udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019 [...] si dhe udhëzimin nr. 12, datë 10.06.2021 [...].

Kolegji, duke e analizuar dhe në këndvështrimin e interpretimin evolutiv, vlerëson se udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 të ministrit të Arsimit, “[...] përcaktonte rregulla të hollësishme si për emërimin ashtu edhe për largimin nga puna të mësuesve. [...]

[...] Megjithatë, vihet re se sërish udhëzimi i ri përmban detajime dhe procedura të hollësishme lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës së mësuesit. Në këtë udhëzim parashikohen procedurat e pranimit, të emërimit në një vend të lirë pune dhe të lëvizjes paralele të mësuesit. [...] Në vijim, udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019 përmban në kreun 2 një detajim të hollësishëm të procedurës së konkurrimit, e cila zhvillohet me dy faza, vlerësimi me dosje dhe testimi i informatizuar. Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar krijojnë komisione të posaçme për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas parashikimeve në kreun 6. Udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019 përmban një procedurë të hollësishme edhe për lëvizjen paralele të mësuesve, ku dhe për këtë proces parashikon ngritjen e komisioneve të posaçme, konkretisht komisionin e vlerësimit të dosjeve të lëvizjes paralele, sipas përcaktimeve të kreut 7. Gjithashtu, udhëzimi parashikon një shkallë ankimi administrativ në kreun 8, [...] Ndërsa në kreun 9 parashikohet “Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit”, [...]

Kolegji vlerëson se marrëdhënia e punësimit të mësuesve ka qenë objekt i ndryshimeve të shpeshta të bëra me akte nënligjore, ku nëpërmjet udhëzimeve të reja janë shfuqizuar apo ndryshuar udhëzimet e mëparshme. Në këto kushte, udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021 [...] ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13 datë 22.05.2019, sipërcituar. Në tërësinë e tij ky udhëzim përmban të njëjtat etapa, faza dhe procedura, si udhëzimet e mëparshme, por ajo që vihet re është një detajim dhe shtimi i procedurave mbi konkurrimin, komisionet e vlerësimit, administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, procedurën e emërimit në detyrë të mësuesit, lëvizjen paralele etj. Vlen për tu theksuar rregullimi që i bëhet procedurës së pezullimit dhe largimit nga detyra dhe të drejtës së ankimit në kreun 10 dhe 11 të udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021[...]

Kolegji vlerëson se në kuptim të nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 69/2012, si dhe aktit nënligjor të dalë në zbatim të tij, në rastin konkret, udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019, por edhe atij pasardhës me nr. 12, datë 10.06.2021 të ministrit të Arsimit, janë bërë parashikime të hollësishme të procedurës mbi pranimin, emërimin, lëvizjen paralele dhe largimin nga puna të mësuesve, rregulla të cilat duhet të respektohen, si nga punëdhënësi, ashtu edhe nga punëmarrësi në sektorin publik. Përpara se të ushtrojnë profesionin e mësuesit, personat e interesuar duhet që paraprakisht të kenë kryer me sukses praktikën profesionale, të kenë kaluar në provimin e shtetit dhe në vijim të futen në konkurrimin e hapur, i cili kalon në tri faza, ku është parashikuar edhe procedura e ankimit për çdo fazë të konkurrimit. Ndërsa në dispozitat vijuese të ligjit përcaktohet mënyra e përfundimit të marrëdhënieve të punës së mësuesit.

Kolegji thekson se për sa kohë, për çdo procedurë e fazë konkurrimi parashikohet e drejta e ankimit administrativ, rrjedhimisht edhe padia në procesin gjyqësor do të duhet të merret në shqyrtim nga gjykata administrative, e cila do të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve/mosveprimeve të organit publik. Ky qëndrim është mbajtur, si nga Kolegji Civil, ashtu dhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të cilët në mënyrë konsistente kanë arsyetuar se në rastet e kundërshtimit të akteve të nxjerra nga institucionet arsimore, kompetente është gjykata administrative të shkallës së parë. Kundërshtimi i vendimarrjes së një organi publik lidhur me një veprim administrativ individual dhe bazueshmëria e tij në ligj, nuk mund të shqyrtohet nga gjykata civile, sepse mosmarrëveshja është e natyrës administrative dhe ajo çka kërkohet të shqyrtohet është pikërisht nëse ky organ ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 69/2012 [...] dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. *(shih vendimin nr. 00-2023-322 datë 07.02.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 00-2022-399 (43) datë 09.02.2022; vendimin nr. 00-2020-297 datë 24.06.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).*

Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se do të ishte e pakuptimtë që për kundërshtimin e procedurës së ndjekur nga institucioni arsimor për konkurrimin, emërimin apo lëvizjen paralele, një mësues t'i drejtohej gjykatës administrative dhe për largimin nga detyra të investonte gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë që rregullohet nga ligji nr. 69/2012 dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij, mbrojnë një marrëdhënie juridike. Nga kjo marrëdhënie juridike (marrëdhënia e punës) duhet të burojnë të drejta dhe detyrime, të cilat kontrollohen nga i njëjti juridiksion, si në etapat e para të nisjes së saj, ashtu edhe në përfundim. Në të kundërt, copëzimi i kompetencës lëndore sipas fazës së konkurrimit apo largimit nga detyra, do të prodhonte procese gjyqësore jo efektive, do të rriste ngarkesën e gjykatave dhe mundësinë për dhënien e vendimeve kontradiktore nga juridiksione të ndryshme.

Në lidhje me sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se marrëdhënia e punës e mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik, rregullohet nga ligji organik nr. 69/2012, [...], si dhe udhëzimet e ministrit përkatës (nr. 13, datë 22.05.2019, apo udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021), me të cilat janë detajuar rregullat e zbatueshme për marrëdhënien e punës së kësaj kategorie nëpunësish shtetërorë. Për shkak të

bazës së mësipërme ligjore, marrëdhënia e punës së mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik, është pjesë e bashkësisë së nëpunësve shtetërorë, që sipas ligjit organik, marrëdhënia e tyre e punës ka rregullim të posaçëm. Fakti që ligji nr. 69/2012 nuk ka bërë të njëjtin rregullim të marrëdhënies së punës të mësuesve në sektorin publik, në raport me rregullimin që kanë bërë ligjet nr. 153/2013, 98/2016 apo 97/2016 për nëpunësit civilë, nëpunësit civilë gjyqësorë apo nëpunësit civilë të prokurorisë, nuk e përjashton këtë marrëdhënie nga të klasifikuarit si e rregulluar në mënyrë të posaçme me ligj të veçantë (përfshirë edhe aktet nënligjore të zbatueshme). Përderisa ligji nr. 69/2012, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurën për konkurrimin, pranimin, emërimin, vlerësimin, lëvizjen paralele, si dhe largimin nga detyra të mësuesit, por edhe procedurën që subjektet duhet të ndjekin pranë organit në sistemin arsimor parauniversitar, Kolegji vlerëson se të gjithë këto elemente e identifikojnë këtë mënyrë të rregullimit ligjor si të posaçëm. Mënyrat e ndryshme të përdorimit të teknikës legislative, diku me procedura më të detajuara e diku më pak, por që nxjerrin në pah qartësisht të gjithë fazat në të cilat kalon procesi i rekrutimit e deri në largimin nga puna të nëpunësve, apo të procedurave të ankimit, janë një zgjedhje e ligjvënësit që nuk zbeh cilësinë e qenies së marrëdhënies së punës si të rregulluar me ligj të posaçëm, konform nenit 7(ç) të ligjit nr.49/2012.

Ndaj, në kuptim të kësaj dispozite, Kolegji vëren se është në kompetencën e gjykatave administrative zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës së nëpunësve shtetëror, mjafton që nëpunësi shtetëror të ushtrojë një funksion publik për të cilin ka një rregullim të posaçëm me një ligj të së drejtës publike dhe marrëdhënia e tij e punës të jetë normuar po nga ky ligj, i cili të ketë autorizuar njëkohësisht rregullimin e mëtejshëm të kësaj marrëdhënie edhe me akte nënligjore. Parashikimi i nenit 60 të ligjit organik nr. 69/2012 (i ndryshuar), si dhe udhëzimet e sipërcituara të ministrit të Arsimit, përmbushin mjaftueshëm kriterin e një rregullimi ligjor të posaçëm të marrëdhënies së punës së mësuesve në sektorin publik të arsimit parauniversitar, pasi nëpërmjet kësaj baze ligjore rregullohen dhe detajohen rregullat e së drejtës që do të duhet të mbahen parasysh në të gjitha hallkat e marrëdhënies së punës së mësuesve, duke filluar nga emërimi, transferimi dhe deri tek largimi i tyre nga puna.

Fakti se për aspekte të veçanta të marrëdhënies së punës të kategorive të ndryshme të nëpunësve shtetëror (për të cilat nuk ka rregullim të posaçëm, ligjor ose nënligjor), gjen zbatim edhe KP, nuk do të thotë se këto pushojnë së qeni të rregulluara me ligj të posaçëm, në kuptim të nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012. KP është *lex generalis*, i cili gjen zbatim për çdo aspekt të marrëdhënies së punës, për të cilën nuk ka rregullim të posaçëm *lex specialis*. P.sh: nëse në ligjin e posaçëm mungojnë dispozita për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, atëherë do të gjejnë zbatim rregullat e KP, apo ligjeve të tjera të zbatueshme (sipas rastit[...])

Nga ana tjetër, në interpretim të përjashtimit që parashikon fjalja e dytë e nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012, i cili përforcon rregullin e trajtuar më sipër, arrihet në përfundimin se nuk është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës së punonjësve në administratën publike, në

gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në KP. Për të kuptuar se cilën kategori punonjësish përfshin fjalia e dytë e nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012 na ndihmon interpretimi që iu bë më sipër fjalisë së parë, në lidhje me të përbashkëtat e katër kategorive të nëpunësve, për të cilët ligji i posaçëm ka rregullim të veçantë. E përbashkëta e këtyre katër kategorive është se ato veçohen nga ligjet e posaçme nga kategoria e punonjësve të tjerë që punojnë në të njëjtët institucione, por që nuk ushtrojnë funksione publike të mirëfillta. P.sh: në nenin 4(1)(d) të ligjit nr. 153/2012 [...] është dhënë përkufizimi si vijon: “d) *“Punonjës administrativ”* [...] Ndërkohë sipas nenit 2(g) të ligjit nr. 153/2012, punonjësit administrativë përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij ligji, duke u rregulluar marrëdhënia e tyre e punës nga KP. Kësisoj, marrëdhënia e punës e punonjësit administrativ, të punësuar në administratën publike, në ndihmë apo mbështetje të nëpunësve civile, kur marrëdhënia e tyre e punës nuk rregullohet me ligj të veçantë, nuk është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative. Ngjashëm në nenin 70 të ligjit nr. 97/2016, [...] .Kjo do të thotë se të gjithë punonjësit e tjerë të prokurorisë, që nuk përfshihen në kategoritë sipas nenit 70, por që marrëdhënia e tyre e punës normohet kryesisht nga KP dhe jo me ligj organik të veçantë, nëse do të kenë mosmarrëveshje nga marrëdhënia e punës, nuk i përkasin kompetencës lëndore të gjykatave administrative. Edhe ligji nr. 98/2016 ka një rregullim të ngjashëm, në nenin 50 të [...] Edhe mosmarrëveshjet e këtyre punonjësve në administratën publike, për të cilët ligji organik nuk bën rregullim të posaçëm të marrëdhënies së punës, por referon tek KP, nuk do të jenë në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

Bazuar në çka u tha më sipër, edhe punonjësit e tjerë në administratën publike të sistemit arsimor parauniversitar publik, për të cilët ligji organik nr. 69, datë 21.6.2012 [...] si dhe aktet përkatëse, nuk kanë parashikuar rregullim të posaçëm të marrëdhënies së tyre të punës, nuk do të jenë në kompetencën e gjykatave administrative. Ndërsa mësuesit në sektorin arsimor parauniversitar publik, për të cilët ligji i posaçëm dhe aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të këtij ligji, kanë rregulluar posaçërisht procedurën e konkurrimit, pranimit, emërimit, vlerësimit, lëvizjes paralele, si dhe largimit nga detyra të mësuesit, duke parashikuar madje edhe të drejtën e ankimit dhe kompetencën për shqyrtimin e saj. Për fazat paraprake të punësimit, hyjnë në kategorinë e nëpunësve shtetërorë që ushtrojnë një funksion publik, të rregulluar sipas ligjit organik në mënyrë të posaçme, që trajtohen nga gjykatat administrative.

Kolegji vlerëson gjithashtu se ligji nr. 69/2012 përcakton parimet bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në [...] duke përfshirë këtu institucionet e arsimit publik dhe ato privat, duke përjashtuar në mënyrë të shprehur aspekte të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, të cilat rregullohen me ligj të veçantë. Për aspekte të përgjithshme ky ligj është baza dhe shërben si ligj i posaçëm si për institucionet arsimore publike edhe për ato private. Megjithatë, përse i përket aspekteve që normojnë marrëdhënien e punësimit të mësuesit në interpretim sistematik të neneve 42, 55 të ligjit nr. 69/2012, si dhe bazuar në parashikimet eksplicite të nenit 60, Kolegji vlerëson se parashikimet mbi procedurën që duhet të ndjekin mësuesit për pranimin, emërimin, largimin apo lëvizjen paralele janë të

detyrueshme vetëm për mësuesit në institucionet arsimore publike. Për rrjedhojë, për sa kohë udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 [...] apo ai i vitit 2021 që shfuqizoi këtë të fundit, janë nxjerrë në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës [...] dhe nenit 60 të ligjit 69/2012, ato kanë si fushë zbatimi vetëm rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të emërimit, largimit apo lëvizjes paralele të mësuesve të institucioneve arsimore publike.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se ky ligj, pavarësisht se përcakton kriteret bazë të arsimimit apo kualifikimit që duhet të plotësojë një mësues për të ushtruar profesionin e tij [...] (*si një nga profesionet e rregulluara sipas ligjit të posaçëm*), nuk rregullon aspektet që lidhen me marrëdhënien e punës për mësuesit në institucionet arsimore private, duke e lënë në lirinë kontraktore të privatëve rregullimin e marrëdhënies së punës. Për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se përmban dispozita që të përbëjnë rregullim të posaçëm sipas kërkesave të nenit 7, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, për këtë kategori të punësuarish. Referuar jurisprudencës së deritanishme, Kolegji thekson se për të identifikuar një mosmarrëveshje, si administrative ose jo, duhet që kumulativisht të plotësohen tre kushte. [...] (*shih vendimin nr. 2, datë 10.03.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23*).

Koncepti i marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike nënkupton ato marrëdhënie juridike që përfshijnë në mënyrë kumulative ose alternative shumë elemente, siç janë raportet e pabarazisë mes palëve, kryerjen e një misioni shërbimi publik, ushtrimin e prerogativave të fuqisë (pushtetit) publike, si dhe përmbushjen e interesit publik. Kolegji thekson se, të gjithë këto elemente që karakterizojnë të drejtën publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit thelbësor të administratës publike, që është misioni i përmbushjes së interesit publik.

Kolegji për identifikimin e kuptimit të nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012 (sipas ndryshimeve me ligjin nr. 39/2017) vlerëson të nevojshme referimin edhe në relacionin shpjegues të Komisionit mbi Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend. [...] Siç rezultojnë dhe nga diskutimet mbi projektligjin në Komision, qëllimi i ndryshimeve ligjore ka qenë përfshirja në kompetencë të gjykatave administrative edhe e punonjësve të tjerë përveç nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe nëpunësve civilë të prokurorisë, duke e lënë të hapur mundësinë e interpretimit në varësi të rregullimeve të posaçme që gëzon një marrëdhënie juridike punësimi. Kolegji vlerëson se një parashikim i tillë nuk kushtëzoi përfshirjen në kompetencë të gjykatave administrative vetëm të kategorisë së subjekteve që kanë të njëjtën garanci, si nëpunësit civil, të cilët përfitojnë rikthimin në detyrë. Nëse ligjvënësi do kishte pasur këtë qëllim, do kishte lidhur përcaktimin e kompetencës jo me rregullimin e posaçëm në ligjin organik, por me pasojat që do të vinin nga zgjidhja e paligjshme e marrëdhënies së punës (që një nga rastet mund të jetë rikthimin në detyrë). Ligjvënësi e ka lënë të hapur kategorinë e subjekteve që synon të mbrojë apo t'i japë një garanci më të madhe nëpërmjet parashikimit të nenit 7, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, pa dashur të përcaktojë një listë shteruese të tyre, duke e lidhur domosdoshmërisht vetëm me kriterin e ekzistencës së një ligji organik që ka një rregullim të posaçëm. Pikërisht, përcaktimi si i posaçëm i rregullimit ligjor që i bëhet kategorisë së nëpunësve shtetërorë

përcakton edhe kompetencën e gjykatës.

Kolegji çmon se në rastin objekt gjykimi marrëdhënia e punës së paditëses me palën e paditur [...] që ka filluar prej vitit 2016, rregullohet nga ligji nr. 69/2012 “[...] si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kolegji vlerëson se vendimi [...]i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi dhe çështja duhet t’i dërgohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vijimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes. Gjykata [...] ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, duke individualizuar drejt nga pikëpamja lëndore edhe gjykatën kompetente. [...] Përcaktimi i kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative.

[...]Vlen të përmendet se në vendimin nr. 00-202-718, datë 27.05.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i është referuar nenit 60, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 69/2012, [...] por ky përfundim nuk duhet të merret i shkëputur nga rasti konkret që është shqyrtuar. Pavarësisht nga referimi që përdoret për atë rast, formulimi në dispozitën e mësipërme ku përdoret si shkak për largimin e mësuesit “shkelje e dispozitave të Kodit të Punës”, nuk do të thotë se aplikohet procedura e këtij Kodi për mësuesit. Përderisa ka një rregullim me ligj të posaçëm, ku parashikohen shprehimisht kriteret e emërimit apo shkaqet e largimit të mësuesve nga puna me detyrimin për zbatimin e një procedure të hollësishme, atëherë kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të tyre është gjykata administrative. *(shih vendimin nr. 00-2022-1806, datë 21.07.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në mbështetje të këtij arsyetimi dhe rregullave të interpretimit të sipërcituara, sipas kuptimit të ndryshimeve ligjore të vitit 2017 në nenin 7(ç) të ligjit nr. 49/2012, dhe parashikimit të posaçëm ligjor dhe nënligjor të procedurave të hollësishme mbi marrëdhënien e punës së mësuesit, mënyrën e konkurrimit, pranimit, emërimit, lëvizjes paralele, pezullimit të mësuesit nga detyra, largimin, të drejtën e ankimit tek organi publik del në pah qartë qëllimi për rregullimin e posaçëm ligjor të kësaj marrëdhënieje punësimi. I gjithë kuadri ligjor që rregullon marrëdhënien e punës së mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë përmbush standardin e kërkuar nga neni 7 shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012, pra përbën ligji organik që ka një rregullim të posaçëm, duke hyrë mosmarrëveshjet e punës në këto raste, në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

C. Rregulli i së drejtës për çështjen e shtruar për njësim

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin e mësipërm, referuar çështjes së shtruar për njësim, arrin në këtë përfundim njësues:

- **Gjykatat kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë janë gjykatat administrative.[...]**

KAGJL Vendim Nr.00-2023 -3080 (291), datë 14.09.2023 (Marrëdhënie pune: shërbim civil)

Në rastet e largimit të nëpunësve civil për shkelje të rënda disiplinore bazuar në gjetjet e auditit të brendshëm, gjykatat duhet të hetojnë dhe evidentojë nëse shkeljet janë në fushën e përgjegjësisë së nëpunësit, si dhe nëse shkaqet dhe rëndësia e shkeljes disiplinore, shkalla e fajësisë, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, pasojat e shkeljes sjellja e përgjithshme në kryerjen e detyrave përligjin masën e largimit nga detyra.

Fjalë kyçe: largim nëpunësi civil, shkelje e rëndë disiplinore, gjetje audit i brendshëm, përgjegjësia e nëpunësit civil**Rrethanat e çështjes:**

Paditësja J.Z. ka qenë në marrëdhënie pune pranë palës së paditur, ku ka ushtruar së fundi detyrën si Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit për Tatimpaguesit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë. Ndaj paditëses ka filluar procedimi disiplinor për shqyrtimin e shkeljes disiplinore “Mos përmbushja e rëndë e detyrave”. Komisioni i Disiplinës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, [...] pasi referuar raportit të auditimit dhe memos [...] të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm mbi rekomandimet për procedim disiplinor, [...] rezulton se nga ana e paditëses nuk janë zbatuar pikët e programit të kontrollit për TVSH-në, kryerjen e inventarit fizik të mallra, të lëndëve të para, produkteve të gatshme dhe të arkës, si dhe mbajtja e procesverbalit përkatës ku të përfshihen numrat e fundit në blerje dhe shitje të faturave. Gjithashtu nuk është evidentuar numri i llogarive bankare që operon shoqëria, e po ashtu për periudhën objekt kontrolli ka punuar dhe me fonde të tjera publike si tendera të fituar si konstruksion rrugësh etj, objekte për të cilat nuk është regjistruar vlera totale dhe % e realizimit të punimeve, por jepen vetëm me faturat punimeve. Më tej, në raport kontrollin e përgatitur nga paditësja nuk pasqyrohen leja e ndërtimit e subjektit, leja sheshit të ndërtimit, sipërfaqja në ndërtim dhe në objektin e ndërtuar nuk është bërë llogaritja TVSH-së, fitimet, sigurimet shoqërore për objektin, bazuar në VKM-në nr. 173 datë 29.03.2006 “Për miratimin e koston minimale në ndërtim”. [...]

Veprimet e palës paditëse janë vlerësuar shkelje shumë e rëndë në mos përmbushjen e detyrës dhe moszbatimin e dispozitave ligjore në subjektin e kontrolluar, shkelje që kanë të bëjnë me mosrespektim të procedurave të kontrollit duke vepruar në kundërshtim me nenet 83 dhe 84 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe udhëzimet në zbatim të tij dhe manualin e kontrollit. Në këto kushte, paditësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me kërkesë padinë duke kërkuar anulimin e vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe rikthim në vendin e punës si dhe pagesë për të gjithë periudhën deri në rikthim në punë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka vendosur rrëzimin e padisë. [...] Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, duke pranuar tërësisht padinë sipas

kërkimeve. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] duke marrë në vlerësim të natyrës juridike të mosmarrëveshjes, shkakut të lindjes së saj, akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore e të administruara gjatë gjykimit, objektit dhe shkakut ligjor të padisë, pretendimeve e prapësimeve të palëve, të vendimeve të gjykatave të faktit, shkaqeve të rekursit, vlerëson se, arsyetimi dhe përfundimi që ka arritur Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e mosrespektimit dhe e moszbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural.

Mbështetur mbi të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga gjykata e faktit, Kolegji vlerëson se në rastin objekt gjykimi është bërë një interpretim i gabuar i ligjit, nuk është bërë një cilësim dhe vlerësim i saktë i rrethanave të faktit dhe për rrjedhojë çështja nuk është zgjidhur në përputhje me dispozitat procedurale (*veçanërisht rregullat e barrës së provës*) dhe materiale në zbatim. Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se, shkeljet e palës paditëse nuk janë të provuara dhe nuk përlligjin marrjen e masës së largimit nga shërbimi civil. Megjithatë, gjykatat arsyetojnë provueshmërinë e pretendimeve të organit publik me arsyetim se auditimi i brendshëm i realizuar prej saj është provë e njëanshme.

Kolegji vlerëson se lidhur me vlerën provuese të gjetjeve të identifikuar nga auditimi i brendshëm në Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik“, (neni 5) [...] dhe në nenin 22 po të këtij ligji [...] ligjvënësi ka përcaktuar qartë se mbi çfarë parimesh ligjore duhet të udhëhiqet veprimtaria e auditimit të brendshëm, i cili realizohet nëpërmjet audituesit të emëruar në këtë detyrë sipas ligjit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2017-212, datë 01.03.2017 ka theksuar faktin se, referuar rëndësisë së veçantë që ka procesi i auditimit të brendshëm të sektorit publik, në themel të kësaj veprimtarie ligjvënësi ka vënë parimin e ligjshmërisë, pavarësisë dhe atë të paanshmërisë. Pra, veprimtaria e audituesit është një veprimtari që bazohet në parimin e ligjshmërisë, ku audituesi duhet ti nënshtrohet në detyrën e kryer prej tij vetëm në parashikimet ligjore, duke nisur nga ligji më themeltar që është Kushtetuta, e më pas duke ndjekur hierarkinë e ligjeve të zbatueshme. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij audituesi gëzon pavarësi të plotë, pra veprimtaria e tij udhëhiqet vetëm nga ligji i zbatueshëm dhe jo nga ndikimet që mund të kenë strukturat e tij eprore apo ato të auditurara. Gjithashtu, audituesit për shkak të veprimtarisë që ata kryejnë, duhet të garantojnë që janë të paanshëm, pasi në thelb veprimtaria e tyre lidhet me faktin nëse strukturat ligjzbatuese kanë respektuar kuadrin ligjor të zbatueshëm, duke mos treguar njëanshmëri, pasi në të gjitha rastet do të kishim të bënim me shkelje të rëndë të parimeve bazë mbi të cilat kryhet veprimtaria e auditimit të brendshëm.

Duke marrë në konsideratë vlerësimet e mësipërme, Kolegji konkludon se në gjykimin e kësaj çështje, gjykata Administrative e Apelit nuk ka realizuar “*një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin*” (neni 14 i Kodit të Procedurës Civile), nuk ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe rrethanave në këtë mosmarrëveshje; nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të palës paditur (*rekursuese*

në këtë vendim) dhe nuk kanë realizuar një analizë tërësore dhe objektive të provave sipas barrës së provës që parashikon ligji (*neni 126 i KPC dhe neni 35 i ligjit nr.49/2012*), për ta zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj (*neni 16 i KPC*).

Gjithashtu, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në mënyrë që gjykata të realizojë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, të analizojë të gjitha shkeljet e gjetura nga auditi i brendshëm dhe të evidentojë provat me të cilat provohen ose jo këto shkelje, në mënyrë që të arrijë në përfundimin nëse gjetjet janë të bazuara ose jo, në harmoni këto me pozicionin që ka mbajtur paditësja në kohën e dhënies së masës disiplinore . Gjykata ka barrën të analizojë pretendimet themelore të të paditurit, të cilat janë vlerësuar prej këtij të fundit si shkelje shumë të rënda të paditëses, e pasi t'i analizojë ato, të vendosë nëse përbëjnë apo jo shkelje të rënda disiplinore. Nuk mundet të arrihet në përfundimin se nuk janë shkelje të rënda disiplinore, sjelljet e konstatuara nga auditi i brendshëm (*që pretendohet se bëjnë me faj paditësen*) pa i analizuar ato një për një, ashtu siç janë konstatuar nga punëdhënësi, në kohën e marrjes së masës disiplinore. Gjithashtu, gjykata duhet të çmojë faktet në harmoni me provat e tjera. Gjykata Administrative e Apelit ka arsytuar në mënyrë të përgjithshme dhe pa analizuar se përse gjetjet e auditit të brendshëm nuk janë përgjegjësi e palës paditëse. Në vlerësimin e proporcionalitetit të masës disiplinore objekt gjykimi gjykata ka detyrimin të hetonte nëse shkaqet dhe rëndësia e shkeljes disiplinore, shkalla e fajësisë, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, pasojat e shkeljes sjellja e përgjithshme në kryerjen e detyrave përligjin masën objekt gjykimi.

[...] Mbi bazën e kësaj analize, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në këtë gjykatë, por me tjetër trupë gjyquese.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL 00-2017-212 datë 01.03.2017

KAGJL Vendim Njësues Nr. 00-2021-1215, datë 15.07.2021 (Marrëdhënie pune: policia e shtetit)

Procesi i fitimit të gradave policore nga niveli “Nënkomisar” deri në nivelin “Drejtues i Parë”, duhet t’i nënshtrohet domosdoshmërisht procedurës së vlerësimit konkurrues, sipas parashikimeve të neneve 50-60 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Plotësimi i kriterëve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtuar më parë punonjësit e Policisë së Shtetit një procesi vlerësimi konkurrues nga komisioni i gradimit.

Fjalë kyçe: struktura polici shteti, procedure vlerësimi konkurrues, fitim grade, komision gradimi

Rrethanat e çështjes:

Paditësi L.N. me urdhrin nr. 900/1, datë 31.12.2001 është bërë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, duke ushtruar detyra të ndryshme përgjate periudhes 2001-2010 [...]. Me urdhrin nr. 3052/1, datë 02.11.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësit rezultoi t'i jetë njohur grada "Komisar". Me urdhrin nr. 2304 prot., datë 15.10.2015 të Drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi është transferuar përkohësisht në detyrën e shefit të komisariatit, në Komisaratin e Policisë [...]. Me urdhrin nr. 452, datë 08.02.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit, është ndërprerë transferimi i përkohshëm i paditësit, duke e transferuar dhe emëruar paditësin në detyrën e shefit të komisariatit, në Komisaratin e Policisë Malësi e Madhe, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. [...].

Në muajin janar të vitit 2017, paditësi i është drejtuar palës së paditur me kërkesën për njohjen e gradës policore "Kryekomisar" [...] duke pretenduar se ka kaluar afati tre vjeçar i qëndrimit në gradën policore "Komisar" dhe se aktualisht ushtron një funksion të cilit i takon grada "Kryekomisar". Pala e paditur përmes shkresës nr. 159/1-2 prot., datë 09.02.2017 [...] ka komunikuar paditësit se në mbështetje të ligjit nr.108/2014 nuk parashikohet marrja e gradës sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës së radhës bëhet përmes vlerësimit konkurrues nga Komisioni i Gradimit. Në këtë shkresë pala e paditur fton paditësin të marrë pjesë në konkurrimin e radhës në rast se plotëson kriteret ligjore. Për shkak të mosnjohjes nga pala e paditur të gradës korresponduese "Kryekomisar", paditësi është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër [...] duke pretenduar nëpërmjet kërkespadiisë objekt gjykimi, detyrimin e palës së paditur t'i njohë gradën "Kryekomisar".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër ka vendosur pranimin e kërkesëpadiisë; dhe detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit gradën policore "Kryekomisar". [...] Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...]

I. Për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me sistemin e fitimit të gradave policore të punonjësve të Policisë në Republikën e Shqipërisë.

[...] Kolegji sjell në vëmendje se nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore që lidhet me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me objekt njohjen e gradës policore, është konstatuar se praktika gjyqësore e gjykatave administrative për çështje të ngjashme është e ndryshme.

[...] Për shkak të paqartësisë që është hasur në praktikën gjyqësore lidhur me kufinj të shqyrtimit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organit publik në procesin e dhënies së gradave policore, duke marrë në konsideratë faktin se në Vendimin Unifikues nr. 1, datë 29.02.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk u arrit të njësohej praktika gjyqësore, në lidhje me pyetjen e shtruar për unifikim, mbi kriteret ligjore që duhet të merren parasysh për caktimin e gradës së re, në rastin e ekuivalentimit të gradave policore, por edhe duke konstatuar se praktika e mbajtur në ndonjë rast nga

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nuk ka gjetur pasqyrim në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative të të gjitha niveleve, Kolegji vlerëson të domosdoshme që të shtrohet për diskutim interpretimi përfundimtar i dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, konkretisht nenet 50-60 të tij, lidhur me plotësimin e kushteve dhe kriterëve që nevojiten për fitimin e gradave policore për punonjësit e Policisë së Shtetit, me synim për të konkluduar me një qëndrim njësoj, për këtë çështje. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson të shtrojë për njësim këtë çështje:

- **A mund të fitohet gjyqësisht grada policore për shkak të plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë dhe/ose ushtrimit të funksionit përkatës për gradën e pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së vlerësimit konkurrues nga një komision gradimi?**

A. *Analizë mbi kuadrin ligjor*

Në përputhje me statusin institucional që i është njohur punonjësve të Policisë së Shtetit me ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” (në vijim ligji nr. 8553/1999), u miratua ligji nr. 8643, datë 20.7.2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit” (në vijim ligji 8643/2000), në të cilin u konfiguruan rishtrazat gradat policore, si shprehje e hierarkisë së punonjësve të policisë. Ligji 8643/2000 parashikonte se gradat policore fitohen sipas arsimit dhe kualifikimit profesional, vjetërsisë në shërbim, duke përfshirë edhe periudhën e mëparëshme të shërbimit ushtarak të kohës (sipas parashikimeve të ligjit 8553/1999) dhe karrierës në strukturat policore. [...] Në pasqyrim të ndryshimeve ligjore, si më sipër, ka evoluar edhe qasja e legjislatorit lidhur me njohjen dhe fitimin e gradës policore. Ligji nr. 9749/2007 shënoi kalimin në një sistem të ri gradash policore, duke detajuar ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë në raport me ushtrimin e gradës. Neni 36 i ligjit nr. 9749/2007 gruponte gradat në nivel zbatues, drejtues të ulët, të mesëm dhe të lartë, duke njohur si grada funksionale, të cilat merren *ex lege*, për shkak të emërimit në funksion, atë të Drejtorit/Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Sipas nenit 39 të ligjit nr. 9749/2007, përcaktimi i funksionit korrespondues për secilën prej gradave realizohet me akte normative nënligjore. Në mbështetje të nenit 39 dhe 126 të ligjit nr. 9749/2007, kalimi nga sistemi i vjetër i gradave, parashikuar në ligjin 8643/2000, në gradat sipas ligjit nr. 9749/2007, u realizua përmes VKM nr. 803, datë 21.11.2007 [...].

Ligji nr. 9749/2007 përcaktonte rregullat dhe parimet përmes të cilave fitohen gradat policore. [...]

Neni 41/5, shkronja a) i ligjit nr. 9749/2007 [...] neni 42 i këtij ligji [...] dhe Gjithashtu neni 3.1 i VKM nr. 803, datë 21.11.2007 [...] në analizë të dispozitave ligjore dhe nënligjore të mësipërme Kolegji vlerëson se procedura e fitimit të gradës policore sipas ligjit nr. 9749/2007, pas kalimit në sistemin e ri të gradave, realizohet ekskluzivisht përmes procesit të fitimit të gradës me konkurim. Sipas kërkesave të ligjit, punonjësi i policisë do të duhet t'i nënshtrohet më parë procesit kualifikues dhe testimit në mënyrë që të realizohet efektivisht e drejta e ngritjes në gradë dhe vetëm në përfundim të kësaj procedure, organi kompetent do mund të merrte vendim për fitimin ose jo të gradës.

Sipas ligjit nr. 9747/2007, ngritja në gradë nënkuptonte ngritjen në detyrë dhe jo të anasjelltën. Ngritja në detyrë nuk prezumon vetiu përfitimin e gradës vetëm për shkak të ushtrimit të funksionit. Në vështrim të dispozitave të mësipërme çmohet se ligjvënësi qartësisht ka sanksionuar se fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative, e cila, *së pari*, kërkon kalimin me sukses të procedurës konkurruese dhe, *së dyti*, ndjekjen e trajnimit korrespondues për secilën gradë policore. Në këtë kuptim, ngritja në gradë sipas ligjit nr. 4979/2007, pas sistemit të ri të gradave, kërkon plotësimin kumulativ të kushteve vijuese:

1. Punonjësi i policisë duhet të plotësojë kushtin e vjetërsisë në gradë, sipas nenit 41/5 të ligjit nr. 4979/2007,
2. Ngritja në gradë realizohet vetëm për të plotësuar vendet e lira që ka sistemi i policisë për çdo gradë dhe, për këtë arsye, ngritja në gradë sjell ngritjen në detyrë,
3. Ngritja në gradë kërkon kalimin me sukses të procesit të vlerësimit konkurrues,
4. Në vijim, punonjësit duhet të ndjekin kursin e trajnimit përkatës për gradë.

Një ndër rrisitë e ligjit nr. 9747/2007 ishte përcaktimi i një sistemi të ri gradash policore. Në këtë kontekst lindi nevoja për ekuivalentimin e gradave, të fituara sipas ligjit të mëparshëm nr. 8643/2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit”. [...]. Punonjësit e policisë përmes ekuivalentimit të gradës përfitonin gradën në përputhje me funksionin vetëm nëse plotësohej kushti i vjetërsisë në gradën që i korrespondonte funksionit, në të kundërt punonjësi përfitonte gradën më të lartë sipas vjetërsisë përkatëse në gradë.

Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të mësipërme, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në nenet 41 dhe 42 të ligjit nr. 9749/2007 për fitimin e gradës policore, në procesin e ekuivalentimit të gradave të vjetra me ato të reja, u ndoq parimi “funksioni përcakton gradën”. Kolegji vlerëson se kjo qasje e ligjvënësit në vështrim të situatës ligjore dhe faktike të kohës ka qenë e drejtë dhe ka ardhur natyrshëm në kushtet ku ekuivalentimi i gradës nuk përbënte fitim të një gradë të re dhe as përparim në karrierë, por vetëm barazvlerësim të sistemit të gradave për shkak të ndryshimeve ligjore.

Për sa më sipër, Kolegji çmon të sjell në vëmendje se ngritja ose ulja në gradë për shkak të ekuivalentimit të gradave, ndjek një regjim juridik të ndryshëm nga fitimi i gradës policore për shkak të përparimit në karrierën policore.

I njëjti regjim juridik gradimi është ruajtur edhe për punonjësit e policisë, të cilët u ripranuan në Policinë e Shtetit, pasi kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9749/2007, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 917, datë 04.10.2013 [...] Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se në kuptim të ligjit nr. 9479/2007, pas sistemit të ri të gradave, për fitimin e gradës policore nga niveli “Inspektor” deri në nivelin “Drejtues i Parë”, punonjësit e policisë duhet t’i nënshtroheshin procedurës konkurruese, në përputhje me parashikimet e nenit 41 dhe 42 të ligjit.

Kolegji vlerëson se të njëjtën qasje për mënyrën e fitimit të gradave policore, ka edhe edhe ligji i ri, aktualisht në fuqi, nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. [...] Ligji nr. 108/2014 përcakton se ecuria në karrierë e punonjësve të Policisë së Shtetit, bazohet në avancimin gradual dhe meritokratik në gradë policore, sipas konfigurimit të përgjithshëm të sistemit të gradave të parashikuara në të. Përmes ligjit nr.108/2014,

legjislatori synon rishikimin e rolit të gradave në Policinë e Shtetit, duke ribashkuar gradën me funksionin, e më pas funksionin me trajtimin financiar.

Legjislatori e ka konceptuar gradën policore si një e drejtë që fitohet nëpërmjet procesit vlerësues e konkurrues, duke i njohur kompetencën ekskluzive autoritetit përkatës, komisionit të gradimit, për zhvillimin e karrierës policore të punonjësve të policisë, përmes ecurisë në gradë. [...] Në nenet 53 dhe 54 të ligjit nr. 108/2014 parashikohet procedura për fitimin e gradës, autoriteti përgjegjës për dhënien e gradës përkatëse dhe parimet e përgjithshme për fitimin e gradave policore. [...] Ligjvënësi, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, në frymë të ligjit dhe *ad litteram* ka përcaktuar se procedura e fitimit të gradës policore për punonjësit e Policisë së Shtetit kalon nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësues dhe konkurrues, i cili administrohet nga komisioni i gradimit. Ligji nr. 108/2014 njeht kompetencën ekskluzive dhe diskrecionare të komisionit të gradimit për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në procesin konkurrues për fitimin e gradës, duke përcaktuar parimet, kriteret, fazat e testimit të kandidatëve dhe ankimin për procesin administrativ të fitimit të gradës policore. Gjithashtu ligji i njeht autoritetin përgjegjës, Drejtorit të Policisë së Shtetit, kompetencën diskrecionare për të vlerësuar nevojat e sistemit dhe në varësi të prioriteteve të çel procedurat për fitimin e gradës. Ligji nr. 108/2014 synon që çdo pozicion brenda strukturave të Policisë së Shtetit të ushtrohet nga mbajtësi i gradës takuese dhe, për këtë qëllim, dispozitat ligjore i kushtojnë një vëmendje të veçantë procedurës së fitimit të gradës, avancimit meritokratik dhe gradual në gradë të punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këtë mënyrë, ligjvënësi garanton plotësimin e nevojave të sistemit policor me punonjës të kualifikuar, duke synuar shkrirjen e gradës me funksionin e ushtruar efektivisht.

Përcaktimi i funksionit korrespondues për secilën prej gradave policore ka gjetur rregullim të detajuar në VKM nr. 892, datë 21.12.2016. [...] Neni 55 i ligjit nr. 108/2014 rendit kriteret që duhet të përmbushin punonjësit e policisë për fitimin e gradës nga niveli “Nënkomisar” në nivelin “Drejtuesi i Parë”, [...] Plotësimi i kriterëve formale për fitimin e grades, të parashikuara në nenin 55 të ligjit, nuk përbën kushtin e vetëm për përfitimin e gradës policore. Ligji nr. 108/2014, në nenet 55-59 ka parashikuar të gjitha hallkat e procedurës administrative për fitimin e gradave policore. Kriteret e parashikuara në nenin 55 të ligjit kanë natyrë objektive formale, plotësimi i të cilave verifikohet nga strukturat qendrore të burimeve njerëzore gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit, deri në momentin e fitimit të gradës. Këto kriterë përbëjnë vetëm kushtet formale që shoqërojnë aplikimin e punonësve të Policisë së Shtetit gjatë procedurave vlerësuese dhe konkurruese.

Për fitimin e gradës policore punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të kalojnë me sukses fazën e testimit me shkrim, intervistës me gojë dhe specifikisht për përfitimin e gradës “Kryekomisar” deri në “Drejtuesi i Parë” parashikohet edhe kryerja e ushtrimeve vlerësuese. Kufiri minimal për kalimin e testimit përkatës përcaktohet nga Drejtori i Policisë së Shtetit dhe nuk mund të jetë më i ulët se 70%. Numri i personave të shpallur fitues për përfitimin e gradës nuk mund të jenë më shumë se 30 % mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.

Konkurentët e shpallur fitues për gradat “Nënkomisar” dhe “Drejtues” përfundojnë programin e arsimit përkatës, ndërsa për gradat e tjera duhet të kenë përfunduar programin e trajnimit përkatës sipas gradës. Në vijim të procedurës administrative hartohet lista emërore e të drejtës për gradë policore, duke filluar nga punonjësi me vlerësimin më të lartë në rend zbritës, duke u mundësuar të drejtën e përzgjedhjes së pozicionit të lirë për emërim. Në përfundim të procedurës sa më sipër, dhënia e gradës policore realizohet përmes urdhrit të Drejtorit të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës. [...]

Nisur nga analiza e mësipërme e kuadrit ligjor mbi fitimin e gradave policore, Kolegji vlerëson se në mbështetje të ligjit nr.108/2014, fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative që kalon nëpër disa faza dhe kuadrohet nga detyrimi i kandidatëve për plotësimin e një sërë kriteresh formale. Kolegji konkludon se procesi i dhënies së gradave policore, në mbështetje të ligjit nr. 108/2014 kushtëzohet, *së pari*, me plotësimin e kriterëve objektive për konkurim, të cilat listohen në nenin 55 të ligjit dhe, *së dyti*, me kalimin me sukses të procedurës konkurruese të testimit dhe kryerjes së trajnimeve përkatëse. Gjithashtu vlerësohet se këto faza duhet të paraprihen nga ekzistenca e vendeve vakante për funksionet takuese, të cilat i korrespondojnë gradës, për të cilën zhvillohet konkurrimi. Ky proces formësohet nëpërmjet ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, në drejtim të çeljes dhe administrimit tërësor të procedurave konkurruese.

B. Parimet kushtetuese dhe procesi i fitimit të gradave policore

Kolegji, nisur nga autoriteti kushtetues që gëzon në drejtim të interpretimit dhe zbatimit përfundimtar dhe të drejtë të ligjit, në përputhje me parimet koventore dhe kushtetuese, në vështrim të problematikave që parashtron interpretimi i hasur gjerësisht nga ana e gjykatave të faktit për procesin e fitimit të gradave policore dhe në mbështetje të analizës ligjore të parashtruar sa më sipër, vlerëson se në rastin konkret implikohet zbatueshmëria e parimeve kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit dhe parimit të shanseve të barabarta. [...].

Kolegji vlerëson se asnjë institucion pushteti nuk mund të marrë përsipër kompetenca nga një institucion tjetër e as mund të transferojë ose të heq dorë prej tyre. Kolegji çmon se çdo vendimarrje gjyqësore që detyron organin publik të njoh gradën policore punonjësve të policisë, pa lejuar zhvillimin sipas ligjit të një procedure administrative vlerësimi nga komisioni përkatës i gradimit, duke ushtruar në mënyrë të paligjshme kompetenca ekskluzive dhe ekzekutive të organit publik, në cenim të pushtetit të tij diskrecionar për të vlerësuar përmbushjen e të gjitha kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj për fitimin e gradës, në thelb ka zëvendësuar funksionin që ka organi publik në këtë proces ligjor të rëndësishëm. Një qëndrim i tillë cenon rëndë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe parimin e ligjshmërisë.

Shtrirja e kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative përfshin kontrollin e ligjshmërisë së veprimit administrativ dhe veprimtarisë administrative në tërësi, në drejtim të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, i cili garantohet përmes parimit

kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Funkzioni thelbësor i kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative, kryesisht synon të garantojë mungesën e arbitraritetit në ushtrimin e kompetencave administrative të organit publik. Në këtë drejtim, gjykata duhet të jetë e kujdesshme për të mos vepruar vetë si një organ administrativ, përveç rasteve kur një gjë e tillë parashikohet shprehimisht nga ligji.

Autoriteti publik i organeve administrative ushtrohet përmes kompetencave urdhëruese ligjzbatuese, si edhe nëpërmjet kompetencave diskrecionare. [...] Kolegji vlerëson se kompetencat diskrecionare gëzojnë legjitimitim kushtetues dhe janë të pajtueshme me shtetin e së drejtës, nëse ato i janë dhënë administratës publike me ligj. Pushteti diskrecional është pushteti që i jep një autoriteti administrativ një shkallë të caktuar lirie për të marrë vendime, duke i mundësuar që të zgjedhë mes disa vendimeve të pranueshme ligjore atë që është më i përshtatshëm. [...] Në këtë kuptim, diskrecioni është ushtrimi i pushtetit të autorizuar nga ligji, por i kufizuar nga e drejta.

Ligji nr. 108/2014 ka parashikuar një sërë kompetencash diskrecionare të organit publik në procesin administrativ për fitimin e gradës si: evidentimi i nevojave për çdo gradë sipas prioriteteve dhe miratimi i urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës (neni 54 pika 1), verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kriterëve për konkurim gjatë fazës së aplikimit, testimin, trajnimin deri në momentin e fitimit të gradës (neni 56, pika 1 dhe 2), përcaktimi i nivelit minimal për kalimin me sukses të testimin me shkrim dhe intervistës me gojë (neni 57 pika 3), si dhe dhënien e gradës përmes vlerësimit në tërësi nga ana e komisionit të gradimit (neni 59) [...]përkatësisht Drejtorit të Policisë së Shtetit lidhur me vlerësimin e nevojave dhe prioritetëve për çeljen e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës, sikurse ka autorizuar komisionin e gradimit për vlerësimin dhe përparimin e punonjësve të Policisë së Shtetit në karrierë, në të cilin përfshihet edhe pjesëmarrja në procesin konkurrues për fitimin e gradës. Kolegji çmon se ka rëndësi të veçantë të sjell në vëmendje, se këto kompetenca diskrecionare nuk janë të pakufizuara, sepse përndryshe do cenohej thelbi i shtetit të së drejtës. [...] Qëllimi i një koncepti kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve siguron të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollin dhe ekuilibrat që njih Kushtetuta i japin secilës degë pushtet që të kompensojnë apo zbus ato të degëve të tjera. [...] (*Shih vendimin nr. 11, datë 06.03.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kolegji vlerëson se misioni i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore që i është ngarkuar pushtetit gjyqësor mund të realizohet vetëm atëherë kur zbatimi i normës nga pushteti ekzekutiv, i cili ka ndërhyrë në sferën e të drejtave të qytetarëve, bëhet i kontrollueshëm nga gjykatat administrative. [...]Ushtrimi i gabuar i vlerësimit diskrecionar nga ana e autoriteteve publike i nënshtrohet kontrollit të gjykatave administrative. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes mund të garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe ekuilibrave.

Në këtë kuptim, shtrirja e juridiksionit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organeve publike ka për qëllim të garantojë parimin e ligjshmërisë dhe kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë diskrecionare të organit publik, por pa dubluar ose zëvendësuar kompetenca të cilat ekskluzivisht janë njohur organit publik, sipas ligjit.

Kolegji vlerëson se ky është një qëndrim i konsoliduar që pasqyrohet gjerësisht edhe në praktikën e gjykatave supreme europiane. [...] (*Shih vendimi nr. 207, datë 21.12.2004 i Gjykatës Kushtetuese belge*). Kolegji çmon të sjell në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ, në këtë drejtim rastin *Meltex Sh.p.k. dhe Mesrop Mousesyan kundër Armenisë* (*shih prg 81, 2008*) [...] (*Navalnyy kundër Rusisë 2018, prg.113*), [...] (*Maestri kundër Italisë 2004, prg. 30*).

[...] Duke ju rikthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor në kontrollin e veprimtarisë administrative të organit publik në procesin e dhënies së gradave mund të shtrihet në drejtim të vlerësimit të gabuar ligjit, konstatimit të rrethanave të pasakta ose kryerjes së gabimeve procedurale të tilla që kanë ndikuar në vlerësimin e gabuar të përmbushjes së kriterëve formale për aplikimin në fazën e konkurrimit, duke përfshirë kundërshtimin e secilës prej fazave administrative për fitimin e gradës, të cilat sipas nenit 60 të ligjit nr. 108/2014 i nënshtrohen paraparakishtë edhe procesit të ankimit administrativ dhe veçanërisht kontrollit mbi rastet e ushtrimit ultra vires të pushtetit diskrecionar të organit publik lidhur me administrimin tërësor të procesit të konkurimit për fitimin e gradës. Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor që gëzojnë gjykatat administrative në këtë proces duhet të ketë për qëllim mbrojtjen e meritokracisë për avancimin në gradë në kuadër të lirisë së ushtrimit të profesionit dhe nuk mund të zëvendësojë organin publik, konkretisht komisionin e gradimit, duke dhënë gjyqësisht gradën policore, në kushtet ku aplikanti nuk i është nënshtruar konkurimit për fitimin e gradës.

Kolegji vlerëson se nënshtrimi i punonjësve të policisë në procedurën konkurruese për fitimin e gradës është në përputhje me parimet kushtetuese të sigurisë juridike, stabilitetit ligjor dhe pritshmërive legjitime, në kushtet ku legjislacioni mbi fitimin e gradave policore, që në vitin 2007, ka ofruar qartësi dhe qëndrueshmëri, në drejtim të përcaktimit të mënyrës së fitimit të gradës përmes procedurave konkurruese. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se fitimi i gradave policore gjyqësisht pa ju nënshtruar më parë punonjësit e policisë procedurës konkurruese cenon rëndë edhe parimin e shanseve të barabarta.

Jurisprudenca kushtetuese ka elaboruar në vijimësi parimin e barazisë, [...] (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017, nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 71, datë 27.11.201, nr. 20 datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Kolegji çmon të sjell në vëmendje jurisprudencën autoritative të Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane, në të cilën është trajtuar e drejta e shanseve të barabarta në fushën e vlerësimeve konkurruese. Sipas parimit të shanseve të barabarta, e cila mbizotëron në të drejtën mbi provimet për ata që merren në provime të ngjashme, duhet të vlejnjë me sa të jetë e mundur kushte të ngjashme të marrjes në provim, dhe kriteret e ngjashme vlerësimi. Do të ishte e papajtueshme nëse kandidatëve të veçantë, të cilët fillojnë një proces gjyqësor administrativ, do t'u jepej shansi i një vlerësimi të pavarur e pa kuadrin e krahasimeve. Do të çenohej rëndë gjykimi i barabartë i të gjithë kandidatëve të ngjashëm. Ai është i mundur vetëm kur komisioneve të provimeve u lihet një hapësirë veprimi në vlerësimet për provime specifike dhe nëse kufizohet kontrolli gjyqësor. [...]

(Shih vendimin e Gjykatës Federale Gjermane 1 BvR 419/81 dhe 21 3/83 i Senatit të Parë datë 17.04.1991).

Së fundmi, Kolegji çmon të theksojë se procesi konkurreues synon të rrisë profesionalizmin në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të garantojë meritokracinë, në kuadër të zhvillimit të tyre profesional, në përputhje me parashikimet e nenit 49 të Kushtetutës [...]

Nisur nga kjo analizë e hollësishme që i bëhet çështjes në shqyrtim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon në sentencën unifikuese:

Procesi i fitimit të gradave policore nga niveli “Nënkomisar” deri në nivelin “Drejtues i Parë”, duhet t’i nënshtrohet domosdoshmërisht procedurës së vlerësimit konkurrues, sipas parashikimeve të neneve 50-60 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Plotësimi i kriterëve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtroar më parë punonjësit e Policisë së Shtetit një procesi vlerësimi konkurrues nga komisioni i gradimit.

II. Në lidhje me shqyrtimin e rekursit të palës së paditur

[...]Vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përmes së cilës është lënë në fuqi vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjjirokastër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit. [...] Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjjirokastër [...]ka pranuar padinë, duke vlerësuar se paditësit i takon përfitimi i gradës, për shkak se plotëson kushtin e vjetërsisë në detyrë dhe efektivisht ushtron funksionin në përputhje me gradën e pretenduar “Kryekomisar”. Gjykata ka vlerësuar se në kuadër të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara padia është e mbështetur në ligj. [...]

Në vijim të përfundimit njësuës Kolegji vlerëson se plotësimi i kriterit të ushtrimit të funksionit të kërkuar për gradën e pretenduar dhe vjetërsisë në gradë, nuk mund të sjell përfitimin gjyqësisht të gradës policore të pretenduar, pa iu nënshtroar procedurës së konkurrimit vlerësues nga komisioni i gradimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 108/2014.

Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se pretendimet e paditësit se plotëson kushtet për fitimin e gradës dhe duhet ta fitoj atë gjyqësisht, pasi organi nuk ka hapur procedurën e konkurimit vlerësohet i pabazuar në ligj. Në këtë aspekt, Kolegji çmon të theksojë se paditësi do mund të kishte orientuar gjykimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi në një tjetër drejtim, duke vlerësuar gjyqësisht ushtrimin e diskrecionit nga ana e palës së paditur në administrimin dhe çeljen e procesit të konkurrimit dhe jo duke pretenduar dhënien e menjëhershme të gradës nga gjykatat, në kushtet ku nuk është ndjekur procedura ligjore konkurruese për fitimin e gradës policore.

[...] Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji konkludon se vendimet e gjykatave të faktit janë dhënë në zbatim të gabuar të ligjit dhe se çështja që shtrohet për zgjidhje në mosmarrëveshjen objekt gjykimin është ekskluzivisht çështje ligji, për të cilën

nuk është e nevojshme të kryhet rivlerësimi i provave apo i fakteve të vëna në themel të mosmarrëveshjes. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 63, shkronja dh) të ligjit nr. 49/2012, pas ndryshimeve me ligjin nr. 49/2021, Kolegji nuk pengohet të zgjidhë në themel mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

KAGJL Vendim Nr.00-2023-2000(311), datë 20.09.20233 (Marrëdhënie pune: policia e burgjeve)

Zgjidhja e marrëdhënieve të punës sipas ligjit të posaçëm për Policinë e Burgjeve plotësohet me dispozitat e Kodit të Punës për institutet e parregulluara prej tij. Në kushtet e mungesës së parashikimeve në ligjin e posaçëm për të drejtën dhe afatin për kundërshtimin gjyqësisht të aktit administrativ për zgjidhjen e marrëdhënies, zbatohet afati 1 ujeçar parashikuar në nenin 18/2 të ligjit nr.40/2012, ndryshuar

Fjalë kyçe: marrëdhënie pune policia e burgjeve, ligji i posaçëm për Policinë e Burgjeve, afati i ngritjes së padisë kur mungon parashikimi në ligjin posaçëm.

Rrethanat e çështjes:

Paditësi P.D. është emëruar pranë palës së paditur në detyrën e punonjësit të policisë të rolit bazë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, në datën 24.02.2009. [...] Marrëdhënia e punës [...] ka zgjatur deri në datën 15.01.2015, kohë në të cilën pala e paditur, me urdhrin nr. 11760/3, datë 09.01.2015 i ka ndërprerë paditësit marrëdhënien e punës [...] me motivacionin “Moszbatim i neneve 5/7 dhe 7/4 të rregullores “Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve miratuar me Urdhrin nr. 52/51, datë 30.07.2010. [...] që lidhet me mospagimin e detyrimeve të KESH. Sipas të dhënave të librezës së KESH Zona Durrës, rezulton se paditësi ka kryer likuidimin e detyrimeve të energjisë elektrike deri në muajin Mars 2015. Paditësi rezulton të ketë nënshkruar një akt marrëveshje me KESH, në lidhje me arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqinë datën 23.12.2014. Nga përmbajtja e të cilës rezulton se detyrimi i paditësit në momentin e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshje ka qenë në vlerën totale të detyrimit dhe kamatëvonesave 462.066,92 lekë. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesëpadinë duke kërkuar shfuqizimin e urdhërit dhe detyrimin për pagimin e dëmshpërblimeve për zgjidhje të marrëdhënies së punës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë duke detyruar palën e paditur të paguaj në mënyrë solidare, 14 (katërmbëdhjetë) paga neto mujore, si dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna; Rrëzimin e padisë në kërkimet e tjera, si të pabazuara në ligj dhe prova. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi i palës paditëse përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, shkronja a) të ligjit nr. 49/2012, pas ndryshimeve me ligjin nr. 39/2017. Kolegji çmon se vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit, përmes së cilës është vendosur pushimi i gjykimit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural me rëndësi themelore për zhvillimin e praktikës.

Paraprakisht, vlerësohet se duhet të qartësohet natyra e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Konstatohet se kërkimet e paditësit lidhen me pretendime që burojnë nga marrëdhënia e punës, të cilat rregullohen sipas ligjit të posaçëm nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”. Duke iu referuar shkakut ligjor të kërkimeve të paditësit, çmohet se objekt i këtij gjykimi, lidhet me shfuqizimin e urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nëpërmjet të cilit paditësi është larguar nga puna, si dhe zgjidhjen e pasojave që vijnë nga përfundimi i menjëhershëm i marrëdhënies së punës, që ka ekzistuar midis paditësit dhe palës së paditur.

Ligji i zbatueshëm në çështjen objekt gjykimi është ligji nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar (me ligjin nr 36/2014). Referuar nenit 13 i këtij ligji [...], rezulton se marrëdhënia e punës e punonjësit të policisë së burgjeve rregullohet me ligj të posaçëm dhe vetëm për çështje që nuk gjejnë rregullim tek ligji i posaçëm, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

Në rastin në gjykim, konstatohet se paditësi është larguar me urdhrin nr. 11760/3, datë 09.01.2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i cili si bazë ligjore ka nenin 36, pika 1, shkronja d) dhe nenin 38, shkronja d), të ligjit nr. 10032/2008 “Për Policinë e Burgjeve” i ndryshuar. Mbi këtë bazë, largimi nga detyra i palës paditëse është trajtuar nga pala e paditur, si masë disiplinore për largim nga detyra.

Kolegji vlerëson se urdhri i kundërshtuar në këtë gjykim ndjek regjimin juridik të ankimit në përputhje me parashikimet e ligjit të posaçëm nr. 10032/2008 dhe ligjit nr. 49/2012. Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit ndonëse ka zbatuar nenin 18 të ligjit nr. 49/2012 për afatin e kundërshtimit të aktit, nuk ka patur në vëmendje se akti i largimit nga detyra të palës paditëse nuk parashikon as të drejtën për t’ju drejtuar gjykatës dhe as afatin për ngritjen e padisë. Bazuar në nenin 18, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, gjykata do duhet të kishte arritur në përfundimin se pala paditëse ka qenë brenda afatit një vjeçar për kundërshtimin e aktit, pasi konstatohet se padia është depozituar në datë 06.05.2015, ndërsa akti i largimit nga detyra mban datën 09.01.2015.

Për sa më sipër Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në zbatim jo të drejtë të ligjit procedural. Në kushtet ku në shkallën e dytë të gjykimit të çështjes, palët nuk kanë patur akses në një vendim përfundimtar mbi themelin e pretendimeve të tyre, Kolegji vlerëson se çështja duhet të dërgohet për rishqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

KAGJL Vendim Nr.00-2022-1598 (268), datë 07.07.2022 (Marrëdhënie pune: funksionar i veçantë politik)

Nënprefekti është funksionar publik që ushtron funksione me natyrë politike dhe nuk legjitimohet në kërkimet për shpërblim dëmi për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Fjalë kyçe: nënprefekt, status juridik të posaçëm, shpërblim dëmi për ndërprerje të marrëdhënies së punës

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezulton se paditësi H.D. me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 731, datë 23.11.2009, "Për lirim dhe emërim nënprefekti" është emëruar në pozicionin e nënprefektit të rrethit Bulqizë, Qarku Dibër. Me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 80, datë 14.05.2012 paditësi Hamit Dervishi është liruar nga detyra e nënprefektit të rrethit Bulqizë, Qarku Dibër. Ky urdhër është bazuar në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikën 2 të nenit 20 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin", si dhe në urdhrin e Kryeministrit nr. 54, datë 10.04.2006 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Dibër".[...]

Në kushtet kur nuk ka qenë dakord me sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar dëmshpërblime për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës sipas dispozitave të KP.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë duke detyruar palën e paditur të paguajë dëmshpërblim për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke pranuar pjesërisht padinë, shfuqizimin e urdhrin nr. 80, datë 14.05.2012 të Ministrit të Brendshëm si dhe detyrimin e të paditurës të dëmshpërblejë paditësin me 10 (dhjetë) paga mujore për lirim nga detyra në kundërshtim me ligjin. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] Zëvendesprefekti, sikurse edhe prefekti gëzojnë një status juridik të posaçëm, të ndryshën nga punonjësit e tjerë të administratës publike [...] Referuar përcaktimeve të nenit 13 të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" [...] si dhe të nenit 20 të ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për prefektin" [...] Prefekti si përfaqësues i Këshillit të Ministrave ushtron funksione me natyrë politike. Emërimi dhe shkarkimi i tij kryhet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit përkatës dhe në ushtrim të detyrave të tij, ligji parashikon se mbështetet nga nënprefekti, i cili nuk është pjesë e administratës së prefektit, strukturës administrative me varësi hierarkike prej tij. Kjo rezulton nga ligji nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për prefektin" ku stafi administrativ pranë prefektin në ushtrimin e detyrave të tij (neni 19 i ligjit) ka një status juridik të ndryshëm nga nënprefekti (neni 20), i cili gjenë rregullime të posaçme. Ky dallim është bërë edhe më i qartë nga parashikimet e neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8927/2002 që rregullon konfliktin objekt gjykimi). Për rrjedhojë, Kolegji nuk pajtohet me qëndrimin e gjykatës së shkallës

së parë se marrëdhënia juridike në rastin konkret rregullohet nga dispozitat e KP.

Lidhur me statusin juridik në funksioneve të ushtruara nga nënprefektit, jurisprudenca e Gjykata e Lartë ka vlerësuar: “Ndërkohë ligji nr. 107/2016 nuk përmban rregulla të posaçme, të shprehura lidhur me natyrën e funksionit publik të prefektit të qarkut, si edhe të nënprefektëve. Megjithatë, ky ligj qartazi, në nenin 1 të tij përcakton se prefekti i qarkut është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku, pra qartazi e përcakton këtë funksion publik, si një funksion me natyrë politike... Për sa i përket nënprefektit, sipas nenit 21 të ligjit nr. 107/2016, ky funksionar publik nuk përfshihet as në kategorinë e nëpunësve civilë dhe as në atë të punonjësve administrativë. Natyra e këtij funksioni publik tregohet qartë nga neni 22 i këtij ligji ku qartazi parashikohet roli i tij si “mbështetje e veprimtarisë së prefektit të qarkut”, pra si mbështetje e drejtpërdrejtë e funksionit politik të prefektit, i cili ndihmon dhe mbështet ushtrimin e kompetencave të prefektit të qarkut duke ndjekur me nga afër në një apo disa njësi administrativo-territoriale të të njëjtit qark. Në këtë kuptim nënprefekti është funksionar publik që ushtron funksione me natyrë politike. Prandaj, në logjikën juridike të qenies me natyrë politike të këtij funksioni, në pikën 2 të nenit 22 parashikohet në mënyrë të posaçme, ndryshe nga nëpunësit dhe punonjësit e tjerë administrative të prefekturës që, nënprefekti emërohet dhe lirohet në detyrë nga ministri.”.(Shiko vendimin nr. 00-2020 – 368, datë 16.09.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.)

VKM nr. 173, datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”, i cili merret në analizë nga Gjykata Administrative e Apelit vlerësohet se nuk gjen zbatim në rastin konkret. Kjo VKM ashtu siç kuptohet nga titulli i saj i referohet institucioneve të varësisë të organeve të përcaktuara në të dhe nga përmbajtja e ligjit nr. 8927/2002, rezulton se prefekti është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në çdo qark dhe jo organ varësie, ashtu sikurse nënprefekti nuk është organ vartës në raport me ministrin. Pikërisht për shkak të ushtrimit të funksioneve me natyrë politike legjislativë i posaçëm i ka rezervuar një status ligjor të ndryshëm nënprefektit ku shkarkimi i tij mjafton të plotësojë kushtet e parashikuara në nenin 20, pika 2 ligjit nr. 8927/2002 për të qenë e ligjshme. Përmes urdhrit nr. 731, datë 23.11.2009 të palës së paditur Ministria e Brendshme, me propozim të Prefektit të Qarkut të Dibrës është urdhëruar lirimi nga detyra i paditësit, duke u plotësuar kështu kërkesat e ligjit për largimin nga detyra të kësaj kategorie funksionarësh.

Në këto kushte Kolegji vlerëson se kërkesëpadia është e pabazuar në ligj dhe e tillë duhet rrëzuar. Kolegji sjell në vëmendje se ky përfundim vjen në përputhje edhe praktikën e Kolegjit Administrativ për raste të ngjashme, ku funksionar të cilët janë konstatuar se ushtrojnë funksione politike nuk janë legjitimuar në kërkimet e tyre për shpërblim dëmi për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës si nënkryerët e bashkive ose komunave.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KCGJL nr. 00-2020 – 368, datë 16.09.2020

II. Juridiksioni Administrativ

KAGJL Vendim Njësues Nr. 00-2021-1317, datë 22.07.2021 (Kundërshtim vendimi, KMCAP Epror)

Ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar në vitin 2011, nuk plotëson të gjitha standardet e vendosura nga GJEDNJ, në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë” dhe standardet kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj, mbi pavarësinë dhe patundshmërinë e anëtarëve të KMCAP Epror, sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, konkludohet se KMCAP Epror, sipas rregullimit që i ka bërë ky ligj, nuk është formësuar si një organ quazi gjyqësor. Përderisa nuk plotëson këtë kusht thelbësor, nuk mundet që paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror të mos i nënshtrohen kontrollit gjyqësor dhe këto vendime nuk mund të përcaktohen nga ligji si akte administrative të pakundërshtueshme.

Neni 39/1, pika 3 i ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon se “...Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë”, vjen në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë”. Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi quazi gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejtë ky vendim i GJEDNJ-së, dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ.

Fjalë kyçe: kontroll incidental, KMCAP Epror, quazi gjykatë, zbatim drejtëpërdrejtë vendim GJEDNJ, pavarësi dhe paanshmëri, formë e prerë vendimi.

Rrethanat e çështjes:

[...] Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala paditëse, prej vitesh është trajtuar për një lloj sëmundje dhe duke qenë e paaftë për punë, i është drejtuar palës së paditur për të njohur shkallën e invaliditetit dhe për t'i caktuar shumën e mbrojtjes shoqërore respektive. Me Vendimin nr. 173, datë 01.11.2010, Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë e ka përcaktuar paditësen si të paaftë për punët e lehta. Pala paditëse nuk ka qenë dakord me këtë vendim, duke pretenduar se konkluzioni i organit administrativ është i gabuar dhe se ajo duhet të përcaktohet se është e paaftë për punë sipas ligjit. Pala paditëse është trajtuar me pension invaliditeti nga viti 2004 deri në vitin 2010. Ankimi administrativ i paditëses nuk është pranuar me Vendimin nr. 44, datë 21.12.2010 të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë Epror, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim KMCAP). Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar anulimin e vendimit të komisionit rajonal dhe KMCAP dhe përcaktimin e saj si invalide e grupit të dytë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...] ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe

anulimin e të dy vendimeve dhe [...] detyrimin e të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë për t'i paguar paditëses pensionin e invaliditetit si person i paaftë për punë, [...], në masën që e ka pasur kur e ka ndërprerë. Gjykata e Apelit Tiranë [...] ka vendosur të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes civile [...] dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.”. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me [...] ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrolli incidental, sipas nenit 145 të Kushtetutës.

Kolegji [...] vëren se në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative të shkallës së parë, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë janë vënë re qëndrime të kundërta mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 39/1, pika 3 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 (në vijim ligji nr. 7703/1993), në lidhje me kuptimin e formës së prerë të vendimeve të KMCAP. Në çështje gjyqësore të ndryshme, nga gjykatat është marrë në analizë, nëse KMCAP, sipas ligjit nr. 7703/1990, plotëson kushtet e gjykatës, në kuptim të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim KEDNJ) dhe sipas standarteve të vendosura nga GJEDNJ, në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*”, për të konkluduar mbi juridiksionin gjyqësor mbi këto çështje.

Sipas njërit qëndrim të mbajtur në praktikën gjyqësore, neni 39/1, pika 3 i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 nuk lejon kontrollin gjyqësor mbi vendimet e KMCAP epror dhe se ky organ, me ndryshimet që pësoi ligji nr. 7703/1993, në vitin 2011, plotëson elementët e gjykatës, në kuptimin material. Në të tilla raste, gjykatat kanë konkluduar mungesën e juridiksionit gjyqësor mbi kontrollin e këtyre vendimeve (*shih vendim nr. 00 - 2017-1934, datë 26.09.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendim nr. 1651, datë 02.05.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

Në raste të tjera të ngjashme Gjykata e Lartë, duke referuar në standardet e vendosura nga GJEDNJ, në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*”, ka vlerësuar se duhet të njihet e drejta e ankimit gjyqësor mbi vendimet e KMCAP epror (*shih vendim nr. 00-2017-116, datë 01.02.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendim datë 06.06.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; Vendim nr. 5325 (06125), datë 26.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; vendim nr. s'ka, datë 21.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë etj*).

[...] Kolegji vlerësoi se KMCAP epror, edhe me ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 7703/1993, në vitin 2011, nuk plotëson elementet e *quazi (pothuajse)* gjykatës, sipas nenit 6 të KEDNJ, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe praktikës së GJEDNJ, në çështjen e referuar më sipër.

Nga ana tjetër, Kolegji vlerësoi se rekursi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë nuk mund të shqyrtohej dhe të vendosej për ligjshmërinë apo jo të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, në kushtet kur këto dy dispozita ligjore, nga viti 1995 e deri më sot, ndalojnë ushtrimin e kontrollit gjyqësor mbi vendimet e KMCAP Epror.

Kolegji vlerësoi se të dy këto parashikime ligjore, i pari i zbatueshëm sa kohë

është realizuar kontrolli administrativ (deri në vitin 2011) dhe i dyti i zbatueshëm gjatë kontrollit gjyqësor, pas ushtrimit të padisë dhe nga momenti i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 7703/1993 të vitit 2011 e deri më sot, vijnë në kundërshtim me nenin 42 dhe 83 të Kushtetutës, por edhe me nenin 6 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, të artikulluar mbi këtë dispozitë ndër vite. Për rrjedhojë, Kolegji konkludoi se asnjë vlerësim ligjor mbi rekursat objekt gjykimi nuk mund të ishte i mundur, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet mbi kushtetutshmërinë e dispozitës së zbatueshme për zgjidhjen e çështjes, konkretisht pika 3 e nenit 39/1 të ligjit nr. 7703/1993.

Mbi këtë analizë, në bazë të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “[...] me vendimin e ndërmjetëm datë 12.10.2020, Kolegji pezulloi gjykimin dhe i'u drejtua Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 3 të nenit 39/1 të ligjit nr. 7703/1993. [...] Gjykata e Lartë shtroi para Gjykatës Kushtetuese disa çështje të natyrës kushtetuese, zgjidhja e të cilave varej nga analiza, interpretimi dhe qëndrimi që do të mbante ky autoritet i lartë kushtetues se:

i) A mundet gjykata në zgjidhjen e çështjes të refuzojë të zbatojë ligjin, duke zbatuar drejtpërdrejtë Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare, duke shmangur zbatimin e nenit 145/2 të Kushtetutës, apo thënë ndryshe, duke shmangur nisjen e kontrollit incidental kushtetues të ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese?

ii) Çfarë fuqie juridike kanë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që konstatojnë përmbushjen e masave të përgjithshme që GJEDNJ ka lënë si detyrë ndaj shtetit në një nga vendimet e saj që ka marrë formë të prerë, nëse pas rezolutës konstatohet se në të vërtetë masat ligjore të marra nga shteti nuk e kanë zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ dhe sërish ka shkelje të dispozitave të KEDNJ?

iii) A e kanë respektuar jurisprudencën “Dauti kundër Shqipërisë” të GJEDNJ-së ndryshimet e ligjit nr. 7703/1993 në vitin 2011 dhe, a e kanë shndërruar ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAE Epror materialisht në një gjykatë me të gjitha elementet e nenit 6 të KEDNJ-së?

iv) A mundet të krijohen organet quasi gjyqësore me ligj me shumicë të zakonshme, duke pasur parasysh rregullimin e nenit 81 të Kushtetutës?

v) A mundet të rregullohet organizimi, funksionimi dhe procedurat e shqyrtimit të organeve quasi gjyqësore me ligje me shumicë të zakonshme apo me akte nënligjore normative?

Me vendimin nr. 55, datë 31.03.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se zgjidhja e këtyre çështjeve lidhej më së shumti me interpretimin e ligjit, ç’ka përbën funksion natyral për Gjykatën e Lartë. Ndër të tjera, Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese ka konkluduar se, çështjet e interpretimit të ligjit i përkasin kompetencës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos Gjykatës së Lartë, si organi më i lartë i sistemit gjyqësor që ka për funksion të përgjithshëm njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. [...] Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar se, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar në kohë, neni 86 i ligjit nr. 7703/1993 parashikonte dhe vazhdon të parashikojë të drejtën

e ankimit gjyqësor të individëve kundër vendimeve administrative që përcaktojnë përfitime të pafavorshme. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se ky ligj garanton aksesin në gjykatë të procesit kryesor që përcakton të drejtat e ligjshme të individit dhe për efekte të cilin zhvillohet procesi administrativ i caktimit të shkallës së aftësisë për punë nga Komisioni Epror. Sipas Gjykatës Kushtetuese, në këtë çështje, Gjykata e Lartë duhet të ushtrojë funksionin e saj, duke vlerësuar brenda kufijve kushtetues, nëse është vendi për njësimin, zhvillimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Përderisa Gjykata Kushtetuese, për pesë çështjet e sipërcituara, të shtruara nga gjykata referuese nuk ka vlerësuar se duhet të ushtrojë përmes rrugës së kontrollit incidental, kontrollin e papajtushmëria e ligjit me Kushtetutën, atëherë Kolegji [...] ka konkluduar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se çështjet që duhet të shtrohen për njësim janë:

1) A e kanë respektuar jurisprudencën “Dauti kundër Shqipërisë” të GJEDNJ-së ndryshimet e ligjit nr. 7703/1993 në vitin 2011 dhe, a e kanë shndërruar ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAE Epror materialisht në një gjykatë me të gjitha elementet e nenit 6 të KEDNJ?;

2) Si duhet interpretuar dhe zbatuar neni 39/1 i ligjit nr. 7703/1993, konkretisht pika 3, në pjesën ku parashikon se “...Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”, dhe si qëndron kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera procedurale, ligjore dhe kushtetuese që parashikojnë të drejtën e përgjithshme të ankimit, si e drejtë themelore?

[...]

Kolegji vlerëson se çështjet e shtruara për njësim kanë një lidhje organike me njëra-tjetrën, ku zgjidhja e çështjes së parë, kushtëzon të dytën. Si rrjedhojë, edhe trajtimi analitik i tyre do të ndjekë të njëjtën renditje. Konkretisht, për të konkluduar mbi mënyrën e interpretimit dhe zbatimin të nenit 39/1, pika 3 të ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon se “...vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”, nëse vendimet e KMCAE epror janë përfundimtare apo duhet të ushtrohet kontrolli dhe juridiksioni gjyqësor mbi to, fillimisht do të duhet të merret në analizë nëse KMCAE Epror, sipas ligjit nr. 7703/1993, pas ndryshimeve të vitit 2011, plotëson kushtet materiale të një organi *quazi* gjyqësor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së.

A) Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim:

[...] Për të konkluduar mbi këtë çështje, Kolegji çmon të marrë në analizë ndryshimet që ka pësuar, ndër vite, ligji nr. 7703/1993, nën një vështrim historik dhe krahasimor me dispozitat ligjore në fuqi, të para këto nën dritën e jurisprudencës relevante të GJEDNJ.

Neni 35 i ligjit nr. 7703/1993 është ndryshuar fillimisht me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995. [...] Pra, sipas kësaj dispozite, [...]parashikohej, ndër të tjera, se KMCAP Epror është organi administrativ më i lartë që përcakton paaftësinë për punë, masën e invaliditetit dhe, për rrjedhojë, edhe masën e pensionit për shkak të paaftësisë në punë. [...]Në çdo rast, vendimi i KMCAP Epror nuk mund të ankimohej gjyqësisht, pasi ligji e parashikonte si një akt të formës së prerë dhe të pakundërshtueshëm gjyqësisht.

Në atë kohë, ligji nr. 7703/1993 nuk kishte rregulla organike që të përcaktonin organizimin dhe funksionimin e KMCAP Epror. [...]

35. Rregullorja e përbashkët e datës 13 korrik 1995 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe e Ministrisë së Shëndetësisë mbi organizimin, të drejtat dhe detyrat, si dhe funksionimin e KMCAP-ve rajonale dhe KMCAP Epror [...] Ndërkohë KMCAP Epror[...] përbëhej nga mjekë të specializuar në fushën e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë dhe patologjisë dhe anëtarësia në këtë komision duhet të merrte miratimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Rregullorja parashikonte se KMCAP kryesohej nga titullari i njësisë së shëndetit. As në ligj dhe as në aktet nënligjore nuk kishte dispozita që të parashikonin rregullime për shkaqet e largimit nga detyra apo të mbarimit të mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror. Gjithashtu, nuk kishte dispozita që të rregullonin garancitë e qëndrimit në detyrë për anëtarët e këtij komisioni apo mekanizma *restitutio in integrum*, në rast të largimit të padrejtë nga detyra.

Në jurisprudencën “*Dauti kundër Shqipërisë*”, GJEDNJ ka marrë në analizë dhe interpretuar nëse KMCAP Epror, me karakteristikat e rregullimit ligjor dhe nënligjor si më lart, është apo jo gjykatë ose tribunal, në kuptimin autonom që jurisprudenca e saj i ka njohur nenit 6 të KEDNJ-së. [...] Ky vendim i GJEDNJ-së ka marrë formë të prerë, me datë 03.05.2009. Thelbi i vendimmarrjes së GJEDNJ-së në çështjen e sjellë në vëmendje më sipër, ishte se sipas nenit 6 të KEDNJ-së, shtetet kontraktuese, duke përfshirë këtu edhe Republikën e Shqipërisë, kanë hapësirë për të krijuar edhe organe alternative “*për shqyrtimin e të drejtave dhe detyrimeve civile*”, që nuk janë gjykata në kuptimin formal, por që materialisht dhe në mënyrë ekuivalente, plotësojnë të gjitha elementët e organit të caktuar me ligj, paanësisë dhe pavarësisë. Në të kundërt, duhet domosdoshmërisht të njihet ankimi dhe aksesimi në gjykatë, ndaj vendimmarrjes së tyre.

Nga kjo jurisprudencë e detyrueshme ndërkombëtare rezultoi të jenë vendosur detyra dyplanëshe për Republikën e Shqipërisë. [...]Në planin e përgjithshëm, Shqipëria detyrohej të ndryshonte paragrafin e katërt të nenit 35 të ligjit nr. 7703/1993, që do të thotë të lejonte kundërshtimin në gjykatë të vendimeve të KMCAP Epror. Nëse kjo nuk do të ndodhte, do të duhej që Shqipëria të shndërronte me ligj, KMCAP Epror në një gjykatë apo tribunal me të gjitha karakteristikat jurisprudenciale dhe autonome të nenit 6 të KEDNJ-së, që GJEDNJ i ka elaboruar ndër vite. Në vitin 2011, Kuvendi miratoi ndryshime ligjore në ligjin nr. 7703/1993. Ndryshimet u destinuan dhe synuan të zbatonin detyrat e përgjithshme të vendimit “*Dauti kundër Shqipërisë*” [...]

Në Raportin e Veprimit datë 03.05.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, [...] në lidhje me çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*”, në pikën 10 të tij konkludohet se shqetësimi i ngritur nga GJEDNJ, se KMCAP Epror nuk përbënte

një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, ka gjetur zgjidhje nëpërmjet amendamenteve ligjore të miratuar në ligjin nr. 7703/1993 të vitit 2011. Më tej, në pikën 11 të raportit, konkludohet se zgjidhja finale e vendimit të GJEDNJ-së, në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*” është arritur edhe në planin e përgjithshëm, edhe në planin individual (*Shih Raportin datë 03.05.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, DH-DD(2013)506, nga mbledhja e datës 4 – 6 Qershor 2013 (“Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Dauti v. Albania (19206/05), judgment of 03/02/2009, final on 03/05/2009”).*

Në këtë pikë të analizës, për Kolegjin u shtrua për zgjidhje çështja se çfarë fuqie juridike kanë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që konstatojnë përmbushjen e masave të përgjithshme që GJEDNJ ka lënë si detyrë ndaj shtetit në një nga vendimet e saj që ka marrë formë të prerë, në rast se pas rezolutës konstatohet se, në të vërtetë, masat ligjore të marra nga shteti nuk e kanë zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke lejuar vijimin e shkeljeve të dispozitave të KEDNJ-së.

Kolegji vlerëson se, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës[...] është një ndër organet vendimmarrëse dhe ekzekutive kryesore të Këshillit të Europës. [...] Neni 46 i KEDNJ-së ka parashikuar se vendimet e formës së prerë të GJEDNJ-së i kalojnë Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr përmbushjen e tyre. Nga rregullimi i pikës 5 të kësaj dispozite del se, nëse Komiteti i Ministrave vlerëson se vendimi i GJEDNJ-së është zbatuar në masat individuale dhe të përgjithshme, atëherë vendoset mbyllja e shqyrtimit të çështjes. [...]

Kolegji thekson se duhet të mbahet parasysh rregullimi i nenit 17 të Kushtetutës, [...] Për rrjedhojë, nga neni 17 i Kushtetutës del konkluzioni se gjykatat shqiptare, sikurse edhe Gjykata Kushtetuese, janë të lira të pranojnë standarde më të larta të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut se sa ato që rrjedhin prej Këshillit të Europës.

Pavarësisht rolit të rëndësishëm që i jepet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave të përgjithshme [...] nuk mundet që këtij institucioni t’i njihet edhe autoriteti gjyqësor i vetë GJEDNJ-së, i gjykatave kushtetuese apo edhe i gjykatave vendase të pushtetit gjyqësor. Kjo do të thotë se, pavarësisht konkluzioneve të arritura, rast pas rasti, nga ana e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, mbi ekzekutimin e masave të përgjithshme të vendimeve të formës së prerë të GJEDNJ-së prej shteteve anëtare, konkluzioni nëse këto masa përmbushin cilësisht standardet kushtetuese dhe konventore mbeten në pushtetin e natyrshëm dhe sovran të pushtetit gjyqësor, gjykatave kushtetuese dhe vetë GJEDNJ-së. Në këtë këndvështrim, konkludohet se nuk mund t’i njihet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një pushtet i tillë juridik që të zëvendësojë dhe njëkohësisht t’i imponohet gjykatave të zakonshme, gjykatave kushtetuese dhe vetë GJEDNJ-së.

Duke mbajtur parasysh sa më lart u analizua Kolegji arrin në përfundimin se, edhe në rastin konkret, nuk mundet të imunizohet kontrolli i kushtetutshmërisë apo konvencionalitetit të ndryshimeve të ligjit nr. 7703/1993, vetëm nga fakti se Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka konkluduar se masat e përgjithshme të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë, në vitin 2011, e kanë përmbushur jurisprudencën “*Dauti*

kundër Shqipërisë”. Për shkak të statusit kushtetues që ka KEDNJ, nuk mund të pengohen gjykatat e zakonshme të shmangin zbatimin e një ligji të brendshëm, kur vlerësojnë se është në kundërshtim me të.

i) *Jurisprudenca e GJEDNJ-së, e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Lartë mbi quazi gjykatat*

[...]Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë për organet *quazi gjyqësore*.

49. Terminologjinë e *quazi gjykatës* e ka përdorur Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, fillimisht, për të shquar kompetenca *quazi gjyqësore* të organeve kushtetuese, të cilat nuk janë pjesë e pushtetit gjyqësor, konkretisht të komisioneve hetimore parlamentare, të ngritura sipas nenit 77 të Kushtetutës, (*shih Vendimin nr. 18, datë 14.05.2003 dhe Vendimin nr. 21, datë 01.08.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). [...] (*shih Vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*), [...] *shih ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve*”). [...] (*shih Vendimin nr. 43, datë 06.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*) [...] (*shih Vendimin nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), [...]

Konceptin e organeve *quazi gjyqësore* e ka elaboruar edhe Gjykata e Lartë. Kolegjet e Bashkuara të [...] nëpërmjet një vendimi unifikues, kanë arritur në konkluzionin se Komisioni i Shërbimit Civil është një organ *quazi gjyqësor* (*shih Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.01.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). [...] (*shih Vendimin Unifikues nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk e kanë vënë në diskutim çështjen nëse aktet nënligjore me karakter normativ mund të rregullojnë çështje themelore të së drejtës procedurale mbi shqyrtimin e ankimeve apo kërkesave të individëve nga organet *quazi gjyqësore*. [...] Gjykata e Lartë, në disa çështje të shqyrtuara përmes ankimeve të veçanta të subjekteve paditës kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë administrative që kanë nxjerrë nga juridiksioni gjyqësor paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror, ka mbajtur qëndrimin se karakteristikat e sjella nga ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 7703/1993 në vitin 2011, e kanë bërë KMCAP Epror një organ *quazi gjyqësor*, duke konkluduar se ndaj këtyre vendimeve nuk mund të ushtrohet padi në gjykatë, sipas pikës 3 të nenit 39/1 të ligjit. [...] (*Shih Vendimin nr. 00-2017-1934, datë 29.06.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

Ndërkohë, GJEDNJ, sipas jurisprudencës konstante të saj, [...] (*shih çështjen “Ramos Nunes de Carvalho e Sá c. Portugal”, Req. nos 55391/13 et 2 autres, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ datë 06.11.2018, paragrafi 132. Gjithashtu shih çështjen “Vera Fernández-Huidobro c. Espagne”, Req. no 74181/01, Vendim i GJEDNJ datë 06.01.2010, paragrafi 131*). [...] GJEDNJ ka vlerësuar se edhe një organ administrativ dhe jo gjyqësor klasik apo jo i integruar në pushtetin gjyqësor mund të kualifikohet si gjykatë apo tribunal në konceptin autonom të nenit 6 të KEDNJ (*shih çështjen “Ali Rıza and others v. Turkey”*), edhe pse ai e ka juridiksionin e kufizuar për shkak të lëndës së gjykimit (*shih çështjen “Rolf Gustafson c. Sueden”*). [...] Gjithashtu

jurisprudenca e GJEDNJ-së ka konfirmuar se mungesa e presionit të jashtëm dhe të brendshëm e një tribunali apo organi *quasi* gjyqësor duhet të konkludohet në mënyrë të tillë që të përjashtojë mundësinë e cenimit të pavarësisë dhe paanësisë së trupës gjyqësore, në mënyrë që të mos cenohet besimi që në një shoqëri demokratike gjykata duhet të transmetojë tek publiku (*shih* çështjen “*Morice v. France*”, Ap. no. 29369/10, Vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 23.04.2015, paragrafi 78, ECHR 2015 dhe çështjen “*Oleksander Volkov v. Ukraine*”, Ap. no. 21722/11, Vendim i GJEDNJ-së, datë 09.01.2013, paragrafi 106). [...]

Gjithashtu në vlerësimin e kësaj çështje duhet të mbahet parasysh edhe jurisprudenca relevante e Gjykatës Kushtetuese mbi nenin 42 të Kushtetutës. [...] (*shih Vendimin nr. 10, datë 04.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*) [...] (*shih Vendimin nr. 10, datë 11.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për të konkretizuar këto vlerësime të përgjithshme jurisprudenciale, të parashtruara më lart, Kolegji e vlerëson të nevojshme të analizojë nëse KMCAP Epror, si një organ i administratës publike, përmbush kushtet dhe kriteret material për t’u konsideruar *quazi* gjykatë, për efekt të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42 të Kushtetutës. Për këtë arsye, duhet të analizohen dhe interpretohen dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë juridiksionin, kompetencën, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

ii) *Përmbushja e elementit të paanësisë dhe pavarësisë*

Kolegji sjell në vëmendje sërish, disa nga konkluzionet e GJEDNJ-së, në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*”, [...] Këto shkelje të evidentuara nga GJEDNJ të çojnë paraprakisht në përfundimin se të gjitha vendimet e KMCAP Epror, që referojnë në paragrafin e katërt të nenit 35 të ligjit nr. 7703/1993 (para hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të vitit 2011), janë marrë nga një organ administrativ që nuk ka garancitë kushtetuese dhe konventore të një organi *quazi* gjyqësor. [...] Në rrethana të tilla, në bazë dhe për zbatim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, do të duhet që ligji të lejojë dhe të krijojë një mjet ankimi efektiv në një gjykatë kundër vendimeve të KMCAP Epror (*shih për analogji konkluzionet dhe arsyetimin e çështjes “Ortenberg v. Austria”, Vendim i GJEDNJ datë 25.11.1994, paragrafi 31, seria A nr 295-B. Shih gjithashtu dhe çështjen “Crisan v. Rumania”, Kërkesa nr. 42930/98, Vendim i GJEDNJ datë 27.05.2003, paragrafi 24*).

Mbi bazën e kësaj analize, mbetet të vlerësohet nga Kolegji, *nëse ndryshimet ligjore të vitit 2011 e kanë formatuar KMCAP Epror si një organ quasi gjyqësor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së e të Gjykatës Kushtetuese mbi konceptin autonom të gjykatës apo tribunalit, sipas standardeve të së drejtës për proces të rregullt ligjor?*

Neni 35 i ligjit nr. 7703/1993, i ndryshuar, që është në fuqi aktualisht, [...] ka përcaktuar organin, juridiksionin dhe kompetencën e tij.

Ligji parashikon [...] se rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP të nivelit të parë caktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

[...] Neni 39/2 i Ligjit nr. 7793/1993 parashikon përbërjen e KMCAP Epror [...] Në ndryshim nga parashikimi i mëparshëm, KMCAP Epror, në përbërjen dhe konstituimin e tij nuk rregullohet nga aktet nënligjore normative, por nga ligji dhe për sa kohë ligji shteron në parashikime, atëherë rregullimi i organizimit dhe funksionimit të këtij organi realizohet me një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili është një akt nënligjor normativ. Kështu, pika 4 e nenit 39 të ligjit parashikon se rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e KMCAP Epror, si dhe masa e shpërblimit mujor të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Më tej, në nenin 39/3 dhe 39/4 rregullohet me ligj vijueshmëria e mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror dhe lëvizshmëria e tyre nga detyra. [...] Me qëllim përmbushjen e një prej detyrimeve që rrjedh nga vendimi “*Dauti kundër Shqipërisë*”, neni 39 i ligjit ka rregulluar edhe procedurën e betimit të anëtarëve të KMCAP Epror. [...] Neni 39/4 i këtij ligji ka rregulluar mbarimin e mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror para kohe [...] Për të përcaktuar mënyrën se si organizohen, si funksionojnë Komisionet Eprore dhe mënyrën e shpërblimit të tyre është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 10.06.2015 “*Për organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë*” (në vijim VKM nr. 505). [...]

[...] Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se, nga problematika e evidentuar nga jurisprudenca “*Dauti kundër Shqipërisë*”, ndryshimet ligjore të vitit 2011 kanë plotësuar këto masa të përgjithshme: i) parashikimin e procedurës së betimit të anëtarëve të KMCAP Epror; ii) përcaktimin e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror; iii) përcaktimin taksativ të shkaqeve për mbarimin e mandatit të anëtarit të KMCAP Epror; iv) përcaktimin taksativ të shkaqeve të shkarkimit nga detyra të anëtarit të KMCAP Epror; v) proklamimin në ligj të ushtrimit të detyrës së anëtarëve të KMCAP Epror në pavarësi dhe sipas bindjes profesionale; vi) garantimin e anëtarësisë së një anëtari me profesion jurist dhe me përvojë gjyqësore në KMCAP Epror, i cili emërohet nga Ministri i Drejtësisë.

Nga ana tjetër, Kolegji vëren se ka edhe çështje të tjera, të cilat, megjithëse janë lënë si detyrë në kuadër të masave të përgjithshme të vendimit “*Dauti kundër Shqipërisë*” të GJEDNJ-së, nuk kanë gjetur zbatim në ndryshimet që i janë bërë ligjit në vitin 2011. Analiza e këtyre çështjeve që në fakt përbën edhe një ndër drejtimet kryesore të këtij vendimi njësues që ndihmon në nxjerrjen e konkluzionit nëse KMCAP Epror plotëson kushtet e një organi *quazi* gjyqësor është e lidhur me:

- i) garantimin e pavarësisë materiale dhe funksionale nga presionet e organeve të emërtesës;
- ii) garantimin e patundshmërisë nga detyra;
- iii) garantimin e kthimit në detyrë në rast shkarkimi në kundërshtim me shkaqet e parashikuara në nenin 39/4 të ligjit nr. 7703/1993;
- iv) parashikimin e garancive procedurale të procesit të rregullt ligjor gjatë shkarkimit nga detyra për anëtarët e KMCAP Epror.

Kolegji vlerëson të sjell në vëmendje se pika 2 e nenit 39/3 të ligjit nr. 7703/1993 [...] Ligji, në pikën 2 të nenit 39/3, është përprjekur të kryejë një rregullim të dyfishtë të statusit

të anëtarit të KMCAP Epror, duke parashikuar rregullime të posaçme dhe të pavarura statutore për këtë funksionar shtetëror, që e ushtron veprimtarinë me kohë të pjesshme, në raport me pozicionin si nëpunës që ai ka jashtë kësaj detyre, detyrë kjo me kohë të plotë dhe e rregulluar nga normat ligjore respektive që përcaktojnë nëpunësinë e institucionit të emërtesës. Çështja që shtrohet në këto raste ka të bëjë me faktin nëse ky rregullim ligjor i dyfishtë, i posaçëm dhe i pavarur, a garanton anëtarin e KMCAP Epror të jetë i pavarur nga presionet që mund t'i vijnë atij nga institucioni ku është i emëruar si nëpunës? Kolegji vlerëson se për t'iu përgjigjur në mënyrë pohuese kësaj pyetje duhet, në radhë të parë, të sanksionohen përmes parashikimeve ligjore disa garanci që arrijnë të krijojnë besimin se nëpunësit shtetërorë të zakonshëm, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet sipas KP ose nëpunësit shtetëror që kanë statusin e nëpunësit civil gëzojnë një status pavarësie dhe patundshmërie me natyrë të ngjashme me gjyqtarët.

Është e vërtetë që ndryshimet e ligjit në vitin 2011 përcaktuan kohëzgjatjen, shkaqet e mbarimit të mandatit dhe shkaqet e shkarkimit nga detyra, por në të njëjtën kohë duhet të mbahet parasysh se as ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar dhe as aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, nuk kanë parashikuar garancitë procedurale të shkarkimit nga detyra të anëtarit të KMCAP Epror. Në ligj janë parashikuar vetëm shkaqet e shkarkimit në mënyrë taksative nga kjo detyrë, jo me kohë të plotë dhe se anëtarët e KMCAP Epror shkarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Duke mos parashikuar asnjë garanci procedurale për shkarkimin e anëtarit të KMCAP Epror, është e pamundur të plotësohet teorikisht dhe praktikisht standardi i procesit të rregullt ligjor dhe se për rrjedhojë diskrecioni i lënë në shkaqet e parashikuara në nenin 39/4 të ligjit në kompetencën e Këshillit të Ministrave nuk është shoqëruar me garanci procedurale për kontrollin e ushtrimit të tij. Mungesa e këtyre garancive ligjore bën që anëtarët e KMCAP Epror të jenë fillimisht njëlloj të pambrojtur nga ushtrimi i presionit të organit punëdhënës në cilësinë e tyre të parë si nëpunës dhe, më tej, të jenë njëlloj të pambrojtur nga ushtrimi i presionit të organit që i shkarkon nga detyra si anëtar të KMCAP Epror.

Gjithashtu duhet të mbahet parasysh se KMCAP Epror nuk plotëson standardet e detyrueshme për t'u quajtur organ *quazi* gjyqësor, pasi ometimi i ligjit nr. 7703/1993, shoqëruar me mënyrën e emërimit dhe të shkarkimit të tyre nga detyra nuk garanton parimin e pavarësisë dhe patundshmërisë, që duhet të ketë një organ shtetëror administrativ për t'u kualifikuar juridikisht si *quazi* gjykatë apo si tribunal, në kuptim të konceptit autonom që ka elaboruar jurisprudenca e GJEDNJ-së, ndër vite, mbi nenin 6 të KEDNJ-së.

[...] Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje interpretimet e kryera në Vendimin Unifikues nr. 31/2003, në Vendimin Unifikues nr. 19/2007, si dhe në Vendimin Unifikues nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilat është konkluduar se e drejta e punëmarrësve të shkarkuar pa të drejtë nga detyra, kur ligji i posaçëm nuk e parashikon të drejtën e rikthimit në punë, në mënyrë të qartë dhe eksplicite, nuk gëzon mbrojtje ligjore dhe se këto padi janë të destinuara të rrëzohen gjyqësisht.

Kjo do të thotë se nuk mund të bëhet fjalë për pavarësi dhe patundshmëri në

ushtrimin e detyrës së anëtarëve të KMCAP Epror, kur në ligj nuk parashikohet e drejta e rikthimit në detyrë, për shkak të vendimmarrjes së paligjshme të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra. Në këtë pikë të analizës ligjore vlen të sillet në vëmendje dhe merr një rëndësi të madhe edhe natyra juridike e organit të emërtesës dhe të shkarkimit nga detyra, për të cilët janë ministritë e linjës si organe emërtese dhe si organ shkarkimi nga detyra është Këshilli i Ministrave. Duke pasur parasysh statusin në punësimin e përhershëm të tyre dhe se organi i emërtesës dhe i shkarkimit nga detyra janë institucionet kushtetuese më të larta ekzekutive në vend, së bashku me mungesën e garancive procedurale të shkarkimit dhe të garancive statutore të rikthimit në detyrë, Kolegji arrin në përfundimin se ndryshimet ligjore të vitit 2011 nuk kanë arritur ta konturojnë KMCAP Epror si një organ *quazi* gjyqësor.

iii) *Përmbushja e elementit formal të krijimit me ligj të quazi gjykatës.*

Në vijim të analizës së mësipërme, Kolegji risjell në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi aktin normativ që krijon gjykatën. [...] Në çështjen konkrete, të shtruar për njësim, Kolegji konstaton se VKM nr. 505 ka krijuar rishtazi edhe një figurë tjetër anëtarë në KMCAP Epror, konkretisht atë të anëtarit zëvendësues. Në fakt, ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar nuk parashikon mundësinë e zgjedhjes së anëtarëve të tjerë, qoftë edhe zëvendësues. Në këtë aspekt, akti nënligjor normativ kapërcen përmbajtjen e ligjit, duke rregullar kryesisht dhe duke krijuar një tjetër pozicion të anëtarit vendimmarrës në KMCAP Epror, të cilin ligji nuk e individualizon dhe as nuk e njeh.

VKM nr. 505 ka parashikuar gjithashtu se KMCAP Epror mund të shqyrtojë ankimet administrative të subjekteve ndaj komisioneve rajonale edhe me 4 anëtarë, ndërkohë që neni 39/2, pika 1 i ligjit nr. 7703/1993 ka parashikuar pa ekuivok se KMCAP Epror përbëhen nga 5 anëtarë. [...] Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se në mënyrën se si krijohet dhe konstituohet trupa gjyqësore e KMCAP Epror ka parashikime të tilla, të cilat në rastin më të mirë nuk janë rregullime ligjore dhe nuk janë vullneti i ligjvënësit dhe, në rastin më të keq, janë rregullime nënligjore normative, të cilat ndryshojnë vullnetin e ligjvënësit dhe parashikimet për formësimin e trupës gjyqësore të KMCAP Epror.

Duke sjellë në vëmendje se, në rastin në shqyrtim, trupa gjyqësore e KMCAP Epror nuk rregullohet vetëm nga vullneti i ligjvënësit, por edhe me akte nënligjore që tejkalojnë vullnetin e ligjvënësit, Kolegji konkludon natyrshëm se KMCAP Epror nuk përbën një *quazi* gjykatë, të caktuar me ligj, sipas konceptit autonom të nenit 6 të KEDNJ. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh se eventualisht trupës gjyqësore mund t'i mungojë, sipas rregullimit nënligjor normativ, edhe anëtar i jurist dhe sërish ankimi i individit do të shqyrtohet dhe vendimi i KMCAP Epror do të rezultojë si i pakundërshtueshëm sipas ligjit. Evidentimi i një rasti të tillë do të konsiderohej haptazi në kundërshtim me jurisprudencën e detyrueshme "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ-së. Pikërisht, rregullime të tilla normative që janë bërë me këtë akt normativ nënligjor, ndërkohë që vlerësohen se e kanë tejkaluar haptazi përmbajtjen e ligjit, tek i cili duhet të bazohen, konsiderohen nga Kolegji, sipas nenit 38 të ligjit 49/2012, si të paligjshme dhe, për rrjedhojë, të pazbatueshme.

Një çështje tjetër që shtrohet për diskutim, përsa i përket standardit të *quazi* gjykatës së caktuar me ligj, është edhe çështja e procedurës së miratimit të ligjit, me të cilin krijohet dhe rregullohet organizimi dhe funksionimi i organeve *quazi* gjyqësore. [...] Kjo çështje lidhet ekskluzivisht me zbatimin e drejtë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në këtë pjesë të posaçme të veprimtarisë së pushtetit legjislativ.

Në vijim të kësaj analize, për Kolegjin u shtrua për zgjidhje *nëse, në referim të rregullit të nenit 81 të Kushtetutës, mund të krijohen organet quazi gjyqësore me një ligj me shumicë të zakonshme?* Kjo pyetje u shtrua gjithashtu për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese, e cila vlerësoi se edhe kjo çështje i përkiste funksionit nomofilatik të Gjykatës së Lartë. [...]

[...] Kështu Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk është mjaftuar vetëm me rregullimin e nenit 42 dhe 135, sikurse ka bërë KEDNJ, në nenin 6 të saj. [...] Nga mënyra se si është formuluar neni 81 i Kushtetutës rrjedh se ligjet për organizimin dhe funksionimin e gjykatave apo edhe për krijimin e tyre (neni 135 i Kushtetutës) duhet të miratohen me shumicë prej tre të pestave të anëtarëve të Kuvendit. Kjo do të thotë se Kushtetuta nuk lejon krijimin, organizimin dhe funksionimin e gjykatave, me ligje me shumicë të zakonshme. Më tej, mbetet përmes analizës dhe interpretimit, për t'i dhënë përgjigje pyetjes se, *në rast se gjykatat nuk mund të krijohen, të funksionojnë dhe të organizohen me ligje me shumicë të thjeshtë, a është e mundur që në zbatim të Kushtetutës, Kuvendi të krijojë, të organizojë apo të bëjë të mundur, me ligje të tilla, funksionimin e organeve quazi gjyqësore?*

Duhet të mbahet parasysh se, nëse kjo pyetje do të merrte një përgjigje pozitive atëherë garancitë që jep shumica e cilësuar parlamentare në krijimin e institucioneve që ushtrojnë drejtpërdrejt funksione kushtetuese dhe që i përkasin pushtetit gjyqësor apo pushtetit të dhënies së drejtësisë, nuk do të shërbenin për organet ekuivalente të tyre dhe që materialisht ushtrojnë të njëjtin juridiksion në zgjidhjen e çështjeve të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nëse kjo do të lejohej, atëherë do të pranohej se Kuvendi mund të miratojë edhe me procedurë të përsheptuar ligje për krijimin, organizimin dhe funksionimin e organeve *quazi* gjyqësore, në kuptim të pikës 2 dhe 3 të nenit 83 të Kushtetutës. Gjithashtu, Kolegji çmon se, nëse pyetja e shtuar më lart do të merrte përgjigje pozitive, atëherë do të konkludohej se organet *quazi* gjyqësore do të lejoheshin të krijoheshin, të organizoheshin dhe të funksiononin edhe me akt normativ të Këshillit të Ministrave, në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës.

Nga një analizë historike që i bëhet ligjit nr. 7703/1993, i cili është miratuar dhe ndryshuar me shumicë të zakonshme parlamentare rezulton të mos i ketë shpëtuar ndërhyrjeve, qoftë nëpërmjet procedurave të përsheptuara parlamentare [...] Kolegji vlerëson se nëse organet *quazi* gjyqësore nuk do të gëzojnë garancinë e nenit 81 të Kushtetutës, atëherë garancitë kushtetuese të dhënies së drejtësisë nga gjykatat dhe nga ana e ligjeve organike do të ishin me ndikim jo pozitiv për funksionimin e shtetit të së drejtës. Mos vendosja e pengesave ligjore për krijimin e organeve *quazi* gjyqësore do të krijonte premisat e shtimit të tyre, gjë e cila sjell shpërpjestimisht edhe zvogëlimin e efekteve të organeve të mirëfillta gjyqësore. Shfaqja e një fenomeni të tillë bën që të mos

ekzistojë asnjë kufizim ndaj çdo shumice të zakonshme parlamentare, në legjislatura të ndryshme për të zbehur juridiksionin e përgjithshëm të gjykatave klasike, nëpërmjet partikularizimit të juridiksionalizimit të organeve administrative me funksione gjyqësore. Një zgjidhje e tillë nuk duket se ndalohet shprehimisht nga Kushtetuta, por Kolegji vlerëson se ajo që Kushtetuta ka synuar të ndalojë kategorikisht është rregullimi ligjor i dhënies së drejtësisë dhe mbrojtjes juridiksionale të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me ligje me shumicë të zakonshme.

Vlerësohet e domosdoshme të sillet në vëmendje, në këtë rast, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese mbi elaborimin që i ka bërë respektimit të nenit 81 të Kushtetutës. [...] (shih *Vendimin nr. 25, datë 5.12.2008 dhe Vendimin nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). [...] (shih *Vendimin nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). [...] (shih *Vendimin nr. 19, datë 03.05.2007, Vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 dhe Vendimin nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). [...] (shih *Vendimin nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Mbi këtë jurisprudencë të elaboruar prej saj, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenin 81, pika 2, shkronja a) të Kushtetutës (shih *Vendimin nr. 19, datë 03.05.2007, Vendimin nr. 9, datë 23.03.2010, si dhe Vendimin nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e një akti normativ, sipas kuptimit të nenit 101 të Kushtetutës, i cili ndryshonte një nga ligjet, që sipas nenit 81 të Kushtetutës, miratohen me shumicë parlamentare prej 3/5 të deputetëve (shih *Vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). [...] Kjo jurisprudencë e zhvilluar kushtetuese ka konkluduar se ligji që miraton Kuvendi, duke vlerësuar, formalisht dhe substancialisht aktin normativ me fuqinë e ligjit sipas nenit 101 të Kushtetutës është instrumenti konvertues i të parit si ligj material në një ligj formal dhe, ky i fundit, nuk mund të jetë veçse ligj i thjeshtë. [...]

Në vijim të kësaj analize, bazuar në nenet 6, 42, 135 dhe në veçanti, në nenin 81 të Kushtetutës, Kolegji konkludon se, me qëllim ruajtjen e standardit kushtetues të mbrojtjes juridiksionale të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i gjithë procesi i dhënies së drejtësisë në Republikën e Shqipërisë krijohet, organizohet dhe funksionon, sipas ligjit që miratohet me shumicën e cilësuar të Kuvendit. Shkronja a) e nenit 81 të Kushtetutës nuk lidhet ngushtësisht me institucionin në kuptimin formal, por me përmbajtjen dhe substancën e funksioneve kushtetuese dhe ligjore që një institucion ushtron. Kjo detyron Kuvendin që sa herë miraton gjykata të posaçme të vlerësojë se ligji i përmendur në dispozitat e sipërcituara do të duhet të miratohet me 3/5 e të gjithë deputetëve, pasi dhënia e drejtësisë është një nga pushtetet kryesore të sistemit të qeverisjes (shih *nenin 7 të Kushtetutës*).

Në respektim të këtij standardi kushtetues që i shërben mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, Kolegji vlerëson se edhe në rastin kur pushteti i dhënies së drejtësisë i besohet, jo një gjykatë në kuptim të nenit 135, pika 1 të Kushtetutës, por një organi publik, i cili jo aq

për emërtimin që mban apo klasifikimin institucional që ka në organikën shtetërore, por për funksionin e rëndësishëm *quazi* gjyqësor që kryen, do të duhet që procesi i ligjberjes të respektojë garancitë kushtetuese të nenit 81 të Kushtetutës. Është e domosdoshme se për t'i dhënë pushtet një organi administrativ, që cilësohet apo njihet si *quazi* gjyqësor, duhet t'i jepen të paktën të njëjtat garanci pavarësie dhe paanësie, sikurse gjykatat klasike. Të dy këto kategori organesh shtetërore e kanë njëlloj të nevojshme garancinë e nenit 81 të Kushtetutës, jo për emrin që mbajnë, por për funksionet që kryejnë.

Kolegji vlerëson se edhe aktet nënljigjore normative nuk mund të rregullojnë, në bazë dhe për zbatim të nenit 118 të Kushtetutës, organizimin dhe funksionimin e organeve *quazi* gjyqësore në kundërshtim me ligjin apo në rastet kur nuk ka një autorizim ligjor nga një ligj i miratuar, sipas nenit 81 të Kushtetutës.

Në vijim të kësaj analize vlen të interpretohet, gjithashtu, nga Kolegji, nëse është e mundur me një ligj me shumicë të zakonshme parlamentare apo me akte nënljigjore normative të rregullohet procedura apo riti i shqyrtimit të organeve *quazi* gjyqësore? Në praktikën kushtetuese dhe parlamentare të Shqipërisë tradita ka formësuar konkluzionin se koncepti i organizimit dhe funksionimit të një institucioni shtrihet edhe në procedurën e shqyrtimit të çështjeve. [...] Duke i'u rikthyer rastit në shqyrtim rezulton se procedura e shqyrtimit të KMCAP Epror, fillimisht parashikohet në disa dispozita të ligjit nr. 7793/1993 dhe, më tej, detajohet, sipas pikës 4 të nenit 39/2 të këtij ligji me VKM nr. 505.

Në leximin e parashikimeve procedurale të VKM nr. 505 konstatohet se, për herë të parë, në historinë e së drejtës procedurale civile, penale dhe administrative prezantohet një procedurë e posaçme e gjykimit në mungesë të ankuesit, në të cilën akti nënljigjor normativ i jep vlerë provuese dhe vendimmarrëse vetë mungesës si fakt procedural. Ndër të tjera, ky akt nënljigjor normativ parashikon se mungesa e pajustificuar e ankuesit në proces passjell rrëzimin e ankimit apo humbjen e statusit të invaliditetit, që do të thotë edhe shuarjen e së drejtës për të përfituar nga mbrojtja shoqërore.

Kolegji vlerëson se çështje të tilla me rëndësi themelore të së drejtës procedurale nuk mund të prezantohen në rendin juridik, për herë të parë, nga një akt nënljigjor normativ. Këtë gjë në historinë e shtetit shqiptar nuk e ka bërë as Shtojca e Dytë e Procedurës Civile, as Kodi i Procedurës Civile i vitit 1958, as Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953, as Kodi i Procedurës Civile i vitit 1981, as Kodi i Procedurës Penale i vitit 1977, as Kodi i Procedurës Civile në fuqi, pavarësisht ndryshimeve ligjore ndër vite, as Kodi i Procedurës Penale në fuqi, pavarësisht ndryshimeve ligjore ndër vite, as Kodi i Procedurave Administrative i vitit 1999 dhe i vitit 2014 dhe as ligji nr. 49/2012.

Për rrjedhojë, përmes këtij shembulli të marrë nga rregullimet procedurale me karakter nënljigjor, në rastin e KMCAP Epror, Kolegji vlerëson se procedura e shqyrtimit të çështjeve ka një rëndësi themelore për vetë të drejtën kushtetuese dhe konventore të procesit të rregullt ligjor dhe, si e tillë, ajo do të duhet të jetë objekt i rregullimeve parësore ligjore. Bazuar në shkronjën a) dhe d) të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës mund të konkludohet se riti i gjykimit penal, civil apo administrativ do të duhet të jetë objekt rregullimi, kryesisht i ligjeve organike apo i kodeve dhe, në çdo rast, i ligjeve me

shumicë të cilësuar. Për rastin në shqyrtim, zgjidhja ligjore mund të ishte gjetur edhe në parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, apo me një ligj tjetër, por jo të krijohej një rit i posaçëm gjykimi me akt nënligjor normativ. Sigurisht nuk mund të përjashtohet mundësia që një ligj i tillë të zbatohet parashikimet e delegimit të rregullimit normativ, sipas nenit 118 të Kushtetutës, por në çdo rast delegime të tilla të pushtetit normativ nuk mund të bëhen për çështje kaq themelore të së drejtës procedurale. Ato do të duhet gjithnjë të jenë domen ekskluzivisht i ligjit me shumicë të cilësuar.

Në rastin konkret konstatohet se e gjithë procedura e shqyrtimit të rekurseve administrative e KMCAP Epror është rregulluar me ligj me shumicë të thjeshtë dhe, për më tepër, me akt nënligjor normativ, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 39/2 të ligjit. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se edhe parashikimet procedurale të procesit të shqyrtimit të rekursit administrativ të individit kundër një vendimi të komisioneve rajonale nga ana e KMCAP Epror nuk plotësojnë proceduralisht dhe materialisht garancitë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ.

Nga analiza e mësipërme, Kolegji konkludon në sentencën e parë të këtij vendimi njësoj, duke vendosur se:

Ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar në vitin 2011, nuk plotëson të gjitha standardet e vendosura nga GJEDNJ, në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë” dhe standardet kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj, mbi pavarësinë dhe patundshmërinë e anëtarëve të KMCAP Epror, sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, konkludohet se KMCAP Epror, sipas rregullimit që i ka bërë ky ligj, nuk është formësuar si një organ *quazi* gjyqësor. Përderisa nuk plotëson këtë kusht thelbësor, nuk mundet që paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror të mos i nënshtrohen kontrollit gjyqësor dhe këto vendime nuk mund të përcaktohen nga ligji si akte administrative të pakundërshtueshme.

B) Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njësim:

Si duhet interpretuar dhe zbatuar neni 39/1 i ligjit nr. 7703/1993, konkretisht pika 3, në pjesën ku parashikon se “...Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë” dhe si qëndron kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera procedurale, ligjore dhe kushtetuese që parashikojnë të drejtën e përgjithshme të ankimit, si e drejtë themelore?

[...] Megjithatë, sa e thjeshtë paraqitet zgjidhja në parim e kësaj çështje, po aq ndërlikohet për shkak të parashikimeve të ligjit nr.7703/1993, sepse duhet respektuar sa detyrimi kushtetues nga çdo gjykatë, sipas nenit 145 të Kushtetutës, për zgjidhjen e një çështjeje konkrete, po ashtu edhe dhënia e arsyeve në rast të shmangies së zbatimit të ligjit, në respektim të parimit të epërsisë dhe të zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjes ndërkombëtare, sipas nenit 122 të Kushtetutës.

[...] Kolegji risjell në vëmendje se Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 55, datë 31.03.2021 ka orientuar Gjykatën e Lartë për të bërë interpretim pajtues të kësaj dispozite, duke theksuar se koncepti “*formë e prerë*” mund të marrë kuptime të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi dhe jo në çdo rast është i barazvlefshëm me konceptin e vendimit final. Gjykata Kushtetuese ka sjellë si shembull, për analogji, Vendimin unifikues nr. 2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku është diferencuar fuqia ekzekutive e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nga cilësia gjë e gjykuar. Kolegji ndan një qëndrim të ndryshëm nga ky orientim i Gjykatës Kushtetuese, mbi interpretimin e këtij ligji, për arsyt që do të parashtrihen në vijim.

Së pari, Ligji nuk ka dhënë përkufizime për të sqaruar kuptimin e frazës “vendim gjyqësor i formës së prerë”. Megjithatë konceptin “*formë e prerë*”, si cilësi dhe status ligjor të një vendimi, ligji e përmend edhe në dy dispozita të tjera. Njërin formulim e gjen në nenin 39/4, ku parashikohet se anëtari i KMCAP Epror shkarkohet nga detyra, nëse dënohet me një vendim gjyqësor penal të formës së prerë. Për të përcaktuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, sipas këtij rregullimi, do t’i referohemi parashikimit që jepet në nenin 462 të KPP. Formulimin tjetër e gjen në shkronjën d) të së njëjtës dispozite ligjore, ku parashikohet se mandati i anëtarit të KMCAP Epror përfundon kur vërtetohet paaftësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Edhe për këtë formulim do të duhet t’i referohemi parashikimit që bën neni 451 i KPC.

E përbashkëta e këtyre dy parashikimeve normative mbi konceptin “*formë e prerë e një vendimi*”, për llogari të zbatimit të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, qëndron te situata juridike e prekluzivitetit të ankimeve dhe njëherazi te finaliteti i një zgjidhje ligjore administrative apo gjyqësore.

Ligji nr. 7703/1993 përmban edhe një tjetër formulim mbi formën e prerë të vendimit, në nenin 86, pika 3, [...] Pra, cilësisë së vendimit të formës së prerë, sipas këtij ligji, i shtohet edhe cilësia e vendimit përfundimtar, duke konkluduar se kjo zgjidhje administrative është finale dhe e pamundur të kontestohet gjyqësisht.

Krahas interpretimit literal dhe sistematik, Kolegji çmon të ndalet edhe tek interpretimi teleologjik dhe se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit në përdorimin e togfjalëshit “*formë e prerë*”, kur përcakton efektet e vendimeve të KMCAP Epror. Në këtë kuadër, Kolegji risjell në vëmendje Raportin e Veprimit, datë 03.05.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ku [...] pasqyrohet se në Kuvend u hodh poshtë propozimi për të lejuar ankim gjyqësor kundër vendimeve të KMCAP Epror, të pafavorshme për llogari të subjekteve kërkues, duke u miratuar norma ligjore në variantin se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë, të paankimueshme dhe të detyrueshme. Nisur nga këto tre forma të interpretimit të ligjit, Kolegji vlerëson se koncepti “*formë e prerë*”, i përdorur nga ligjvënësi në nenin 39/1, pika 3 të ligjit nr. 7703/1993, pa ekuivok dhe pa dyshim është i njëjtë me konceptin e vendimit përfundimtar dhe të paankimueshëm gjyqësisht. Me këtë zgjidhje ligjvënësi ka konkluduar se çështja konsiderohet e përfunduar në procedurën administrative, pa asnjë mundësi ankimi në gjykatë.

Së dyti, nëse ligjvënësi do të kishte pasur të konsoliduar si qëllim të këtij ligji se

cilësia “formë e prerë” e vendimeve të KMCAP Epror, nuk është e njëjtë me cilësinë e “vendimit përfundimtar, të paankimueshëm gjyqësisht”, nuk do të ishte e nevojshme angazhimi i Kuvendit, në vitin 2011, që nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr. 7703/1993, të kërkonte përbushjen e standardeve të GJEDNJ-së, për ta konturuar KMCAP Epror si *quazi* gjykatë. Kolegji vlerëson se synimi i ligjvënësit, pavarësisht se nuk e ka përbushur tërësisht këtë detyrim të GJEDNJ-së, për ta formatuar KMCAP Epror si një organ *quazi* gjyqësor, përputhet me konceptin për të mos lejuar kundërshtimin në gjykatë të këtyre vendimeve.

Në kushtet ku neni 39/1, pika 3, ka ndaluar shprehimisht kontrollin gjyqësor të vendimeve të KMCAP Epror, përpara Kolegjit shtrohet për zgjidhje çështja *nëse i lejohet gjykatës, në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të refuzojë apo të shmang zbatimin e ligjit, kur vlerëson se ky i fundit vjen në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, në veçanti me KEDNJ, duke kërkuar zbatimin e drejtpërdrejtë të kësaj të fundit*. Kjo është një nga çështjet që Gjykata e Lartë i'a shtroi për zgjidhje Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet kontrollit incidental, me qëllim shfuqizimin e nenit 39/1, pika 3 të Ligjit nr. 7703/1993.

Në mënyrë të përgjithshme, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se edhe kjo çështje i përket funksionit njësuës të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, në respekt të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që nuk vlerësoi se zgjidhja e çështjes i përket atij autoriteti të lartë kushtetues, por Gjykatës së Lartë, mbetet detyrë e këtij Kolegji për të mbajtur një qëndrim përfundimtar, nëpërmjet njësimi të praktikës gjyqësore, mbi raportin juridik midis të drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare.

Një nga parimet bazë në marrëdhëniet ndërshtetërore, të sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është ai i zbatueshmërisë së detyrueshme të marrëveshjeve ndërkombëtare (*pacta sunt servanta*), i cili përbën një nga instrumentet bazë të globalizimit dhe unifikimit të së drejtës. Parimi *pacta sunt servanta* është sanksionuar në Kushtetutë, në nenet 5, 116, 122, ku marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara i është dhënë një status i veçantë. [...] Neni 116 i Kushtetutës, i cili përcakton hierarkinë e akteve normative në Republikën e Shqipërisë i rendit marrëveshjet ndërkombëtare pas Kushtetutës dhe u jep atyre fuqi mbilgjore në sistemin e burimeve normative. Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar dhe interpretuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, [...]

Në veçanti, KEDNJ, si një nga dokumentet më të rëndësishme ligjore europiane, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gëzon një status të privilegjuar në rendin kushtetues shqiptar kundrejt të gjitha marrëveshjeve të tjera. Kolegji sjell në vëmendje nenin 17/2 të Kushtetutës, [...] Nisur nga fakti se të drejtat dhe liritë individuale që renditen në Kushtetutën e Republikës së Shqiptare dhe në KEDNJ janë analoge dhe se kufizimet e të drejtave e lirive kanë status kushtetues, konkludohet se çdo shkelje e KEDNJ-së është njëkohësisht edhe shkelje e Kushtetutës. Për rrjedhojë, korrigjimi i shkeljeve konventore do të thotë njëkohësisht edhe korrigjim i shkeljeve të Kushtetutës.

Neni 46 i KEDNJ-së ka parashikuar fuqinë detyruese të vendimeve të GJEDNJ-së dhe jurisprudencës së saj, e cila është cilësuar si “konventa në veprim”. [...] Kërkesat e

këtij neni kanë gjetur zbatim gjerësisht në jurisprudencën e GJEDNJ-së. [...] (*Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [DHM], nr. 39221/98 dhe 41963/98, GJEDNJ 2000-VIII, para. 249; Assanidze kundër Gjeorgjisë [DHM], nr. 71503/01, GJEDNJ 2004-II, parag. 198.*)[...] (*shih çështjen Piersack k. Belgjikës*) [...] (*shih, Karanović k. Bosnjës dhe Herzegovinës, nr. 39462/03, § 28, 20 nëntor 2007*), [...]

Në këtë kuadër Kolegji çmon të nevojshme të sjellë në vëmendje çështjen *Xheraj kundër Shqipërisë*, [...] Çështja e zbatimit të vendimit të GJEDNJ-së, në këtë rast, u adresua para Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 20, datë 01.6.2011 vendosi si standard zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimit të GJEDNJ-së. [...] Qasja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në vendimin e sipërcituar, erdhi si rrjedhojë e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave R (2000), të miratuar me datë 19.01.2000, për shtetet anëtare mbi rishqyrtimin apo rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel vendi pas vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Të njëjtën problematikë mbi ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së kishte edhe çështja *Lika dhe Laska kundër Shqipërisë*. [...]

Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ dhe Këshilli i Ministrave në Rekomandimin e tij 6/2004, për përmirësimin e mjeteve të brendshme të ankimit, përcaktuan se shtetet ishin të detyruara të modifikonin të drejtën e tyre të brendshme për t'u dhënë fund shkeljeve të Konventës dhe për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ-së. [...]

Në vijim të kësaj analize, duke u bazuar te dispozitat kushtetuese mbi statusin e posaçëm të KEDNJ në rendin e brendshëm, si dhe në nenet 1 dhe 46 të KEDNJ-së, Kolegji konkludon se vendimet dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, adreson detyrime për të gjitha pushtetet shtetërore të brendshme për të bërë të mundur zbatimin e menjëhershëm dhe të përshtatshëm të KEDNJ-së. Krahas pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, një rol të rëndësishëm e luajnë gjykatat, të cilat në veprimtarinë e përditshme ligjzbatuese, duhet të garantojnë zbatimin e KEDNJ-së dhe vendimeve të GJEDNJ-së, nëpërmjet teknikave të interpretimit pajtues të ligjit, interpretimeve me analogji dhe kur është rasti, në kushtet e ometimit legjislativ apo të ligjit në kundërshtim me KEDNJ-në, të zbatojnë drejtpërdrejtë këtë të fundit.

Në veçanti, refuzimi nga gjykatat për të zbatuar drejtpërdrejtë KEDNJ-në dhe praktikën e GJEDNJ-së, me argumentimin formal të mungesës së ligjit apo ekzistencës së ligjit që pengon zbatimin e saj, në prirje për reforma apo ndërhyrje nga pushteti ligjvënës apo edhe nga Gjykata Kushtetuese, nuk pajtohet me nenin 46 të KEDNJ-së dhe standardin e vendosur nga GJEDNJ, mbi marrjen e çdo lloj mase të shpejtë, efikase dhe të përshtatshme për rikthimin në gjendjen e mëparshme. [...] Nën këtë vështrim krahasues, Kolegji konstaton se zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimeve të GJEDNJ-së, edhe në kushtet e ometimit legjislativ apo të kundërshtive me sistemin e brendshëm ligjor, jurisprudenca e gjykatave të larta të vendeve europiane e ka përdorur si një ndër mekanizmat e respektimit të nenit 46 të KEDNJ-së, duke zbatuar standardin e vendosur nga GJEDNJ për "*heqjen e pengesave ligjore për kthimin në gjendjen e mëparshme*". Kështu, në çështjen *Barbera etj kundër Spanjës*, [...] në çështjen *Brusco kundër Francës*, [...]

Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje Konventën e Vjenës “Për të drejtën e traktateve”, e cila ka përcaktuar rregulla për zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (siç është dhe KEDNJ). [...] Në veçanti, Kolegji vlerëson se detyrimi për zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës rëndon mbi Gjykatën e Lartë, e cila nëpërmjet funksionit të saj kushtetues për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, (sipas nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), arrin të garantojë zbatimin e KEDNJ-së dhe të vendimeve të GJEDNJ-së me efekt *erga omnes*, në rastet kur ka ometim legjislativ apo kur ligji vjen në kundërshtim me këtë marrëveshje ndërkombëtare. Vendimet njësuere janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta në raste të ngjashme dhe në këtë mënyrë garantohet edhe një kontroll i centralizuar i konvencionalitetit të ligjit. Në këtë mënyrë arrihet uniformiteti në zbatimin e KEDNJ-së, garantohet neni 5 i Kushtetutës, sipas të cilit Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, si edhe neni 122 i Kushtetutës mbi zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Duke i'u rikthyer çështjes konkrete, për të gjitha argumentat e dhëna në pjesën e parë të këtij vendimi njësuere, në kushtet ku KMCAP Epror nuk plotëson të gjitha elementët e tribunalit në kuptimin material, sipas standarteve të nenit 6 të KEDNJ-së, të trajtuara në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*”, parashikimi i nenit 39/1, pika 3 se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë, përbëjnë mohim të pajustificuar të aksesit në gjykatë dhe, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se në raste të tilla gjen zbatim drejtpërdrejtë vendimi i GJEDNJ-së, në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*”, se në rast se KMCAP Epror nuk plotëson kushtet për tu konsideruar *quazi* gjykatë, atëherë duhet të njihet kontrolli dhe juridiksioni gjyqësor mbi vendimmarrjen e këtij organi. Si rrjedhojë Kolegji vlerëson se neni 39/1, pika 3 i ligjit nr. 7703/1993 do të mbetet i pazbatueshëm, në raport me vendimin e GJEDNJ-së, si më sipër, dhe në raport me dispozitat e tjera me natyrë procedurale, ligjore dhe kushtetuese, që njohin të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj aktit administrativ.

Kolegji sjell në vëmendje, parashikimin e nenit 86/3 të ligjit nr. 7703/1993, [...] Përderisa nuk ka rregullim ndryshe, mbi procedurën, afatet, kushtet e ushtrimit të padisë ndaj aktit administrativ, do të gjejnë zbatim dispozitat e përgjithshme të ligjit nr. 49/2012.

Kolegji vlerëson se e drejta e ankimit gjyqësor ndaj aktit administrativ është një prezumim kushtetues që buron nga e drejta e përgjithshme e kujtdo për akses në gjykatë (neni 42), dhe e drejta kushtetuese themelore për tu zhdëmtuar/dhe ose rehabilituar nga aktet e paligjshme të organeve publike (neni 44), përveç rasteve kur ligji në mënyrë të shprehur mund ta kufizojë, sipas kriteve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

Kolegji vlerëson se, parimi i shtetit të së drejtës kërkon jo vetëm që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet me ligj, por edhe që kjo veprimtaria, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. [...] (*Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 27, dt. 27.07.2009*). Aksesi në gjykatë përbën një të drejtë themelore kushtetuese dhe konventore për individin, e cila duhet të garantojë në çdo

rast juridiksion fillestar apo rishikues të plotë, ligji apo fakti, me të gjitha karakteristikat e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

Në përfundim Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se nevoja për fleksibilitet dhe efikasitet, që janë plotësisht në pajtim me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund ta justifikojnë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në lidhje me të “*drejtat dhe detyrimet civile*” nga organe administrative, profesionale dhe të specializuara, në kushtet ku organet gjyqësore nuk përmbushin këto kërkesa në çdo aspekt. Në këtë kuptim, konkluzionet e Gjykatës së Lartë, nuk pengojnë ligjëvënësin që në të ardhmen, nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr. 7703/1993, të marrë masat për të konturuar KMCAP Epror si një *quazi* gjykatë, me të gjitha elementet që e karakterizojnë atë, sipas jurispruedencës së GJEDNJ-së, të analizuara në këtë vendim njësesues. Vetëm në një eventualitet të tillë, kufizimi i aksesit në gjykatë kundër vendimmarrjes së këtyre organeve do të vlerësohet i pajtueshëm me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me vendimin “Dauti kundër Shqipërisë” të GJEDNJ-së.

Në vijim, Kolegji konkludon në sentencën e dytë të këtij vendimi njësesues se:

Neni 39/1, pika 3 i ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon se “... Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë”, vjen në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë”. Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi *quazi* gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejtë ky vendim i GJEDNJ-së, dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ.

C. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

Kolegji vlerëson se pretendimi themelor i palës së paditur, [...] ka qenë mbi mungesën e juridiksionit gjyqësor për kontrollin e vendimit të KMCAP Epror, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për shkak të parashikimit të nenit 39/1, pika 3 të ligjit nr. 7703/1993. Sipas analizës dhe interpretimit të kryer nga Kolegji në këtë vendim njësesues, rezulton se ky pretendim i palës së paditur është i pabazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Vendimin e GjEDNJ-së, në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë” dhe në dispozitat e tjera ligjore që njohin të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj këtij akti administrativ, sikurse janë cituar më sipër. Kolegji vlerëson se me të drejtë gjykatat më të ulëta kanë pranuar se mosmarrëveshja i përket juridiksionit gjyqësor.

Nga ana tjetër, pretendimet e palës së paditur në rekurs, mbi mënyrën e vlerësimit të provave, nga gjykatat më të ulëta, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë dhe si të tilla janë të papranueshme.

KAGJL Vendim Nr. 00-2022-896 (150), datë 11.04.2022 (Ezaurim rruge administrative sipas Kodit Doganor)

Marrëdhënia midis autoriteteve doganore dhe subjekteve të së drejtës civile është e natyrës administrative e jo civile dhe për rrjedhojë pretendimet për rimbursim të

detyrimeve të importit i nënshtrohen parashikimeve të KD mbi shterimin e rrugës administrative dhe kundërshtimit brenda afateve ligjore në gjykatë.

Përrjashtimi nga taksat bëhet vetëm nëpërmjet një parashikimi të shprehur me ligj dhe jo VKM.

Fjalë kyçe: rimbursim detyrime importi, shterim rruge administrative, përjashtim pagim taksa/tatime me ligj

Rrethanat e çështjes:

Nga fashikulli i gjykimit rezulton se [...] në datën 19.06.2004, Shoqëria “Saxon Interna Tonal Energy” Ltd-Albania Branch, palë kontraktore (aktualisht shoqëria Bankers Petroleum Albania LTD [...]), ka nënshkruar Marrëveshjen Hidrokarbure, me shoqërinë “Albpetrol” sh.a., për kryerjen e operacioneve hidrokarbureve sipas përcaktimit të ligjit mbi hidrokarburet në zonën e kontratës - Patos, Marinëz.

Midis Ministrisë Industrisë dhe Energjetikës [...] dhe “Albpetrolit” sha., [...] është bërë një Licencë Marrëveshje në të cilën shoqëria “Albpetrol” sha. është palë në Licencë Marrëveshje për të kryer të gjitha operacionet e hidrokarbureve (zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve - vend burimi Patos Marinëz Albpetroli) duke përfshirë dhe marrëveshjet e të licensuarit, Albpetrol sha, dhe një kompanie të huaj, (në rastin konkret “Bankers Petroleum Albania” LTD[...]), të zgjedhur në përputhje me ligjin e hidrokarbureve. Në nenin 3 të Licencë Marrëveshjes është përcaktuar se kjo licencë marrëveshje do të ketë fuqi të plotë ligjore në përputhje me nenin 27 sipas të cilës Licencë Marrëveshje për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve miratohet nga Këshilli i Ministrave; shoqëria “Bankers Petroleum Albania” LTD mban statusin e “Depozituesit të miratuar prodhim” dhe shoqëria Bankers Petroleum Albania është subjekt i përjashtuar nga taksat doganore, akciza, TVSH për produktet energjetike që përdoren në operacione hidrokarbure.

AKBN bazuar në Marrëveshjen Hidrokarbure, dhe në ligjin e zbatuar për hidrokarburet ka konfirmuar se shoqëria “Bankers Petroleum Albania” LTD është subjekt i përjashtuar nga akciza, taksat doganore dhe TVSH për artikujt Gasoil 0.1 dhe Diesel D1 100 ppm, për përdorim në operacionet hidrokarbure. Rezulton se shoqëria “Bankers Petroleum Albania” LTD, bazuar në marrëveshjet e lartpërmendur, që prej vitit 2008 nuk ka paguar taksën e karbonit dhe taksën e qarkullimit. Deklaratat doganore janë pranuar nga pala e paditur pa asnjë rezervë ligjore apo kundërshtim lidhur me përjashtimin nga pagesa e taksës së qarkullimit dhe taksës së karbonit.

Në vitin 2012, Dega e Doganës Durrës e ka detyruar palën paditëse që si kusht për çlirimin e mallit, për çdo deklaram malli pas vitit 2012 duhej të paguhej taksa doganore përfshirë taksën e qarkullimit dhe taksën e karbonit. [...]

Palë paditëse bazuar në nenin 249 të KD dhe të pikës 585 e në vijim të VKM nr. 205 datë 13.04.1999 [...], ka kërkuar nga Dega Doganës për të rimbursuar detyrimin e importit për taksën e karbonit dhe taksën e qarkullimit për periudhën 16.05.2012 deri më 24.01.2014 në shumën taksë karboni 730.249.679,16 lekë, taksë qarkullimi 1.767.203.726,35 lekë si

detyrime importi të përjashtuara nga Ligji.

Dega e Doganës Durrës [...] ka refuzuar rimbursimin e shumave të paguara për llogari të taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit nga pala paditëse. Drejtoria e Përgjithshme të Doganave nëpërmjet shkresës 5831/1prot., datë 25.03.2014 ka vendosur mospranim e kërkesës duke lënë në fuqi vendimin e Degës së Doganës Durrës. Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë për detyrimin e Degës së Doganës Durrës të përmbushë kushtëzimin e nenit 249 të KD, duke rimbursuar detyrimin e importit për taksën e karbonit dhe taksën e qarkullimit për periudhën 16.5.2012 deri më 26.1.2014 në vlerat përkatëse.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe pranimin e kërkesë padisë duke detyruar palën e paditur të përmbushë kushtëzimin e nenit 249 të KD duke rimbursuar paditësin për detyrimin e importit për Taksën e karbonit dhe Taksën e Qarkullimit në shumën 1.767.176. 360 lekë dhe Taksën e Karbonit në vlerën 729. 997.660.20 lekë si detyrim importi të përjashtuar nga ligji. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi i palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit ka ngritur disa shkaqe të bazuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] të cilat do të mjaftonin për ta bërë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. [...]

Në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i fakteve të pranuar nga gjykatat më të ulta, duke analizuar objektin dhe shkakun ligjor të padisë, pretendimet dhe prapësimet e palëve, arsyetimin e vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe në veçanti shkaqet e rekursit, vlerësohet se përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit jo të drejtë të kërkesave të ligjit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se duhet të prishet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe të lihet në fuqi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, por me një arsyetim të plotësuar. [...]

Neni 249, pika 2 i ligjit nr. 8449 datë 27.1.1999 KD, që është ligji i zbatueshëm për çështjen në shqyrtim [...] përcakton procedurën që duhet të ndjekin subjektet të cilët kanë pretendime për rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit dhe eksportit, përpara se t'i drejtohen gjykatës. Mosmarrëveshja juridike që lind ndërmjet subjektit dhe organeve doganore duhet të zgjidhet nëpërmjet kërkesës që i paraqitet zyrës doganore kompetente, e cila zbaton rregullat që përcakton legjislacioni doganor, si dhe KPA. Në rast se subjekti ka pretendime për mënyrën e zgjidhjes administrativisht të çështjes nga zyra doganore kompetente, atëherë, pas shterimit të rrugës së ankimit administrativ në organin administrativ epror (në këtë rast Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) i lind e drejta për të kërkuar me padi në gjykatën administrative kundërshtimin e veprimtarisë administrative si të paligjshme. Afati 3 (tre) vjeçar i parashikuar në nenin 249 lidhet me të drejtën e subjektit për t'iu drejtuar administrativisht organit publik dhe nuk lidhet me afatin e ngritjes së padisë në gjykatë. Pra, kjo dispozitë ka parashikuar shprehimisht një

rrugë administrative të detyrueshme për t'u shteruar nga pala paditëse, në mënyrë që të mundësohet shqyrtimi i pretendimit të tij për rimbursim të detyrimeve të pretenduara si të paguara më tepër nga sa ishte detyrimi ligjor.

Referuar çështjes në shqyrtim, [...] rezulton se paditësi i është drejtuar Degës së Doganës Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në vitin 2012, duke kërkuar rimbursimin e shumave të taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit, por me shkresat nr. 10177/3 prot., datë 19.07.2012 dhe nr. 12550/2. prot, datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i është refuzuar kjo kërkesë. Paditësi rezulton t'i ketë bërë objekt gjykimi edhe më parë aktet e sipërcituara, por ka hequr dorë nga gjykimi [...].

Ndonëse paditësi e dinte tashmë qëndrimin e autoriteteve doganore në lidhje me kërkesat e tij për rimbursim, ai i është drejtuar sërish me kërkesë palës së paditur, për të rimbursuar detyrimin e importit [...], të pretenduara si të përjashtuara nga ligji. Dega e Doganës Durrës [...] ka refuzuar rimbursimin e shumave të paguara [...] duke i përmendur edhe qëndrimet e mëparshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të cilat paditësi ishte në dijeni. Mbi ankimin administrativ të palës paditëse Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, [...] ka vendosur mospranim e kërkesës, duke lënë në fuqi vendimin e Degës së Doganës Durrës. Në këtë shkresë paditësit i kujtohet se tashmë kjo problematikë ishte shqyrtuar edhe më parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave [...] duke mbajtur qëndrim se kërkesa për rimbursim është e pabazuar në ligj. Pas refuzimit që i është bërë kërkesës së paraqitur, pala paditëse, e cila e kishte nisur vetë ndjekjen e kësaj procedure administrative, nuk ka përdorur, brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 289(5) të KD mjetin juridik të padisë për kundërshtimin e kësaj veprimtarie administrative nga pala e paditur, por në datën 06.05.2014, i është drejtuar me kërkesëpadinë objekt gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, pa kundërshtuar veprimtarinë e mësipërme të organeve doganore, por duke kërkuar drejtpërdrejtë rimbursimin në gjykatë.

Neni 18(1) i KD të vitit 1999, [...] e lidhur me parashikimin e nenit 249(2) të këtij Kodi (*e cila parashikon rrugën administrative për trajtimin e kërkesës për rimbursim*), nxjerr në pah faktin se që të mund të bëhet rimbursimi, pala duhet domosdoshmërisht të shterojë rrugën administrative. Këtë rrugë ai e ka shteruar pa sukses në vitin 2012 dhe kërkesat e vitit 2014 janë vetëm një përsëritje formale e atyre të vitit 2012, për të cilat autoritetet kompetente doganore ishin shprehur njëherë me vendim.

Duke iu referuar shkakut të rekursit se padia është ngritur jashtë afatit ligjor dhe të rregullimeve që bën KD mbi verifikimin nga autoritetet doganore kompetente të pagimit ose jo të detyrimeve doganore, si dhe të afatit që parashikohet për tu ankuar në gjykatë në rast të mospranimit të ankesës së apeluesit, Kolegji vlerëson se pala paditëse nuk mund të investonte gjykatën me padinë objekt gjykimi, por kishte detyrimin që brenda afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 289 pika 5 të KD, të kundërshtonte vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për refuzimin e kërkesës për rimbursimin e detyrimit doganor. Kjo pasi, marrëdhënia midis autoriteteve doganore dhe paditësit është e natyrës administrative e jo civile. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për padi për kthimin e pagimit të padetyruar, siç parashikon neni 653 i KC, pasi midis shtetit dhe paditësit

nuk ka një marrëdhënie civile, por administrative. Për rrjedhojë, detyrimi i shterimit të rrugës administrative dhe kundërshtimi brenda afateve në gjykatë i vullnetit të organeve administrative, është i domosdoshëm për të mundësuar gjykimin e pretendimeve të paditësit. Mjafton ky element që padia e paditësit të rrëzohej nga gjykatat më të ulta.

Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se edhe në themel pretendimet e paditësit janë të pambështetura në ligj. Kjo pasi, siç me të drejtë kanë mbajtur qëndrim në vitin 2012 autoritetet doganore, nuk rezulton që paditësi të jetë përjashtuar me ligj nga pagimi i taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit (neni 155 i Kushtetutës) [...] Pretendimi i paditësit se ai është përjashtuar nga pagimi i taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit, si rrjedhojë e parashikimeve të posaçme të marrëveshjes së vitit 2004, nuk është i bazuar pasi: 1) vetë marrëveshja të cilës i referohet paditësi nuk e përjashton drejtpërdrejtë atë nga pagimi i taksës së karbonit dhe taksës së qarkullimit, por ka një dispozitë referuese të tipit “*në masën siç jepet në Ligjin Shqiptar*”, çka do të thotë se çdo përjashtim nga taksat sipas marrëveshjes, do të jetë për aq sa parashikohet në ligj dhe duhet të inkorporohet domosdoshmërisht në një ligj, në mënyrë që të jetë detyrues për autoritetet doganore; 2) marrëveshja është miratuar me VKM e jo me ligj, ndaj çdo pretendim i paditësit për përjashtim nga ndonjë taksë e caktuar, bazuar në këtë marrëveshje, nuk gjen zbatim; 3) ligji “Për sistemin e taksave [...]”, nuk ka të parashikuar shprehimisht përjashtimin e paditësit nga pagimi i taksave për të cilat ai kërkon rimbursimin; 4) edhe neni 199(3) i KD parashikon se përjashtimi nga taksat duhet patjetër të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që të jetë detyrues. Ndaj, referuar termave të marrëveshjes datë 19.06.2004 dhe faktit se përjashtimi nga taksat bëhet vetëm nëpërmjet një parashikimi të shprehur me ligj, pretendimet e palës paditëse nuk janë të bazuara, e për këtë shkak nuk duhen pranuar, pasi ai nuk ka një kredi të bazuar në ligj kundrejt autoriteteve doganore.

Kolegji, bazuar mbi të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës dhe Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson se në rastin objekt gjykimi është bërë një interpretim i gabuar i ligjit nga kjo e fundit duke mos e zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale të zbatueshme. Për rrjedhojë padia duhej rrëzuar me arsyetim të plotësuar. [...] vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës duhet lënë në fuqi me arsyetimin e mësipërm.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGJL nr.00-2018-540, datë 03.04.2018

III. E drejta e Ankimit

KAGJL Vendim Nr. 00-2021-418, datë 25.03.2021 (Dënim plotësues: pezullim leje drejtimit automjeti)

Dënimi plotësues i pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit ka karakter sa

parandalues, ashtu siç përmban në vetvete edhe karakterin ndëshkues dhe shkurajues. Fakti se ky lloj dënimi nuk përfshihet si dënim kryesor, nuk do të thotë se zbutet natyra e tij dhe as se përfshihet te çështjet administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, për të cilën mund të kufizohet e drejta për ankim.

Fjalë kyçe: dënim plotësues, pezullimi i lejës së drejtim automjeti, kufizim ligjor e drejtë ankimi, Kodi Rrugor

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit [...] ka rezultuar se nga ana e efektivëve të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë është mbajtur procesverbali i konstatimit të shkeljes nr. 0933728, datë 01.02.2014, në të cilën është përshkruar: *“Drejtuesi i mjetit tip Renault me targa [...] rezultoi të kishte përdorur alkool në masën 03-04 %.”*. Me vendimin nr. 1040, datë 07.02.2014 të organit administrativ pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të shkeljes, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë është vendosur gjobitja e paditësit në shumën 6.000 (gjashtë mijë) lekë, si dhe pezullimi i lejes së drejtimit për një afat prej 6 (gjashtë) muaj, me argumentin se veprimet e paditësit bien ndesh me nenin 184/3 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, paditësi ka paraqitur padinë objekt gjykimi në gjykatë me argumentin se sasia e alkoolit të konstatuar është jo e mjaftueshme për të marrë ndaj tij masën e pezullimit të lejes së drejtimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë duke shfuqizimin pjesërisht të vendimit e palës së paditur, për pjesën ku është pezulluar leja e drejtimit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër.[...] Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji vlerëson se në rekursin e palës së paditur janë ngritur shkaqe ligjore që bazohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin [...] e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. [...]

Kolegji vlerëson të evidentojë kuadrin ligjor të zbatueshëm për çështjen objekt gjykimi. [...] nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 [...]..nenin 184 të KRR, ndryshuar [...] E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor përbën një të drejtë procedurale, përmes së cilës mbrohet një e drejtë substanciale dhe bazohet në rregullin se *“... nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit ...”* ose *“... nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë.”* Si e tillë, e drejta e ankimit përbën një nga të drejtat themelore të njeriut dhe parashikohet edhe në KEDNJ dhe në Protokollat e saj shtesë. [...] Kjo garanci është konsideruar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese si një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim KEDNJ.[...] Mbi këtë rregullim konventor, neni 43 i Kushtetutës ka pranuar kufizimin e kësaj të drejte, si për kundërvajtjet e lehta penale, ashtu edhe për çështjet civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël,

në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të saj.

Duke ju rikthyer mosmarrëveshjes objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se, në këtë rast, merr rëndësi analiza mbi natyrën që ka dënimit administrativ, pezullimi i lejes së drejtimit të automjetit, që parashikon neni 184 i KRR. Pra, është e domosdoshme të përcaktohet nëse sanksioni i pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit, si një dënim plotësues ka të njëjtin natyrë dhe efekt si edhe gjoba dhe nëse konsiderohet apo jo dënim i rëndë, në kuptim edhe të standardit që ka pranuar jurisprudenca e GJEDNJ-së, sipas nenit 6, pika 1 e KEDNJ.

Kolegji thekson se në praktikën e GJEDNJ-së është argumentuar se “edhe nëse çështja nuk është për nga natyra e vet penale, mund të duket e tillë, në kuptimin e Konventës, pas marrjes në konsideratë të shkallës së saj të ashpërsisë” (*Shih Eggs kundër Zvicrës, si dhe Engel dhe të tjerë kundër Holandës*). Sipas gjykatës “dënimi nuk ka për qëllim të kompensojë dëmin, por në thelb ai synon të shkurajojë rikryerjen e veprës. Dënimi, si rregull i përgjithshëm, ka qëllim të dyfishtë, shkurajues dhe ndëshkues” (*Shih Bendenoun kundër Francës, par 47*). Sanksioni ka karakter penal, “në qoftë se e drejta që përbën bazën e tij, gjen zbatim ndaj të gjithëve dhe jo vetëm ndaj një grupi të caktuar, me status special.” (*shih Eeber kundër Zvicrës, A, 177, par.33*). Edhe për sa i takon masës së dënimit dhe rëndesës së saj, Kolegji mban në vëmendje këtë jurisprudencë, e cila ka konkluduar se “është e padiskutueshme që e drejta për të drejtuar një mjet motorik është shumë e dobishme në jetën e përditshme për të ushtruar një detyrë apo profesion” (*Shih vendimin e GJEDNJ, Malige kundër Francës, datë 23 shtator 1998*). Në këtë çështje, Gjykata tërhoqi vëmendjen se ulja e pikëve për shkelje të normave të trafikut rrugor megjithëse “ka karakter parandalues, ajo gjithashtu përmban në vetvete edhe karakterin ndëshkues dhe shkurajues dhe, për këtë arsye, barazohet me një dënim plotësues. Fakti që ligjvënësi ka pasur si qëllim të shkëpusë sanksionin e uljes së pikëve nga sanksionet e tjera të karakterit penal nuk do të thotë se natyra e masës është e ndryshme. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se neni 6, pika 1 gjen zbatim në këtë rast” dhe se kjo masë përbënte dënim, në kuptim të kësaj dispozite.

Mbi këtë analizë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, Kolegji vlerëson se edhe dënimi plotësues i pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit ka karakter sa parandalues, ashtu siç përmban në vetvete edhe karakterin ndëshkues dhe shkurajues. Fakti se ky lloj dënimi nuk përfshihet si dënim kryesor, nuk do të thotë se zbutet natyra e tij dhe as se përfshihet te çështjet administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, për të cilën mund të kufizohet e drejta për ankim.

Në një interpretim literal, Kolegji çmon se neni 184 i KRR i referohet ndëshkimit administrativ të subjektit përmes dy lloje dënimesh, në lidhje me të njëjtin fakt. [...] Nga ana tjetër, ligji nr. 49/2012 kufizon të drejtën e ankimit për kundërshtimin e dënimit mbi kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Kolegji vlerëson se në zbatimin e drejtë të këtij kufizimi ligjor, në funksion të garantimit të të drejtave themelore kushtetuese, gjykata duhet të vlerësojë në çdo rast rëndësinë dhe pasojën konkrete të çdo dënimi administrativ. Fakti që masa e dënimit administrativ me gjobë nuk e tejkalon kufizimin minimal të përcaktuar në nenin

45 të ligjit të sipërcituar, nuk prezumon apriori shtrirjen e këtij kufizimi edhe për të drejtën e ankimit ndaj dënimit të pezullimit të lejes së drejtimit. Të dyja këto dënime duhet të vlerësohen dhe të konsiderohen se qëndrojnë të pavarur nga njeri tjetri, pikërisht për shkak të natyrës së ndryshme që kanë, por edhe të pasojave që sjellin, të cilat nuk janë të njëjtoja. Për subjektin e ndëshkuar, masa administrative e pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit mund të vlerësohet më e rëndë sesa ajo e dënimit me gjobë. Në këtë aspekt, nisur nga shkalla e ashpërsisë që mund të paraqes ky lloj dënimi, për çdo rast konkret, nuk mund t'i ndalohej subjektit e drejta themelore e ankimit gjyqësor. Gjithashtu, Kolegji çmon se, për të përcaktuar natyrën e vërtetë të masës së pezullimit të lejes së drejtimit është e nevojshme të vlerësohet pika 3 e nenit 184 të KRR, me nenin 30, paragrafi i parë, shkronja 3të Kodit Penal, ku sanksionohet si dënim plotësues, i titulluar “... 3. *Ndalimi për të drejtuar automjete. ...*”. Edhe nga ky këndvështrim, masa administrative ka elementë të plotë dhe ekuivalentë me dënimin penal plotësues, për të cilin ligji penal ofron garancitë procedurale të ankimit gjyqësor, arsye për të cilën të njëjtat garanci duhet të sigurohen edhe në raport me ndëshkimin administrativ.

Për sa u përshtrua më sipër, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit, për zgjidhjen e drejt të çështjes, duhet të pranojë për shqyrtim ankimin e paraqitur nga pala e paditur, si dhe të drejtojë hetimin gjyqësor në funksion të shterimit dhe arsytimit të të gjitha pretendimeve të ngritura nga palët. Për rrjedhojë, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim në këtë gjykatë, por me tjetër trup gjyqësor.

KAGJL Vendim Njësues nr.00-2023-4279(259), datë 07.07.2023 (Rivendosje në afat)

Në kuptim të neneve 152 dhe 458 të KPC, në të gjitha gjykimet administrative ku paraqitet një kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit, kërkuasi ka detyrimin që t'i bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat.

Fjalë kyçe: afate procedurale, pavlefshmëri e njoftimit, mungon procedura e njoftimit, shkaqet e arsyeshme, rivendoje në afat, akt procedural ankimi

Rrethanat e çështjes:

Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Borsh, Sarandë, nëpërmjet Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) datë 01.10.1995, duke përcaktuar se bazohej në ligjin nr. 7501/1991 “Për Tokën”, ka trajtuar familjen Lala (T.L., T.L., D.L. dhe E.L.), me 10.500 m² tokë bujqësore dhe me 600 m² truall. Prefekti i Qarkut Vlorë, duke vlerësuar se AMTP në fjalë është lëshuar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kërkuar anulimin e AMTP-së të dhënë në favor të familjes Lala.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur të shpallë mos kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për gjykimin e çështjes civile[...]. Dërgimin

e akteve për gjykim gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër[...].Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë pjesërisht. Deklarimin e pavlefshmërisë së pjeshme të AMTP[...]. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit. [...] Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, sipas shënimeve të sekretarisë gjyqësore, rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 23.08.2014, pa u ankimuar nga palët.

Duke mos qenë dakord me këtë fakt, kërkesit i janë drejtuar më datë 10.11.2014 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me kërkesën për rivendosjen në afat për paraqitjen e ankimit kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, duke pretenduar ndër të tjera se:

- Me vendimin e gjykatës janë njohur më datë 04.11.2014. [...]dhe pretendojnë për pavlefshmëri të njoftimeve për shkak se njoftimet janë bërë në adresë të gabuar dhe jo në vendbanimin e tyre.

- Njoftimet dhe komunikimi i vendimit është bërë në Komunën Lukovë, Sarandë, ndërkohë që adresa e saktë ku dhe duheshin bërë njoftimet është: Borsh, Sarandë, Lagja Shkallë. [...]

Rezulton se kërkesa objekt gjykimi, nuk përmban bashkëlidhur ankimin drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit për të cilin kërkohet rivendosja në afat.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër ka vendosur pranimin e kërkesës. Dhe rivendosjen në afat të kërkesve [...]. Gjykata Administrative Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]konstatoi ekzistencën e praktikave të ndryshme, që lidheshin me kuptimin e institutit procedural të rivendosjes në afat të ankimit, lidhur me faktin nëse duhet apo jo që kërkesës për rivendosje në afat t'i bashkëlidhet edhe akti procedural i ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat (*shih ndër të tjerë, vendimin nr. 00-2013-570 (73), datë 29.01.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 00-2015-3386, datë 09.07.2015 të Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 00-2022-2780 (456), datë 09.11.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, etj*).

Dy qëndrimet kryesore kontradiktore të konstatuara nga Kolegji dhe që janë vënë re në praktikë janë:

(1) Gjatë shqyrtimit të kërkesës për rivendosje në afat, nuk është e nevojshme të bashkëlidhet edhe akti procedural i ankimit, por ky i fundit depozitohet brenda një afati të ri 15 ditor, që fillon të ecë pasi vendimi gjyqësor për rivendosje në afat të apelit merr formë të prerë;

(2) Kërkesës për rivendosje në afat duhet t'i bashkëlidhet edhe akti procedural për të cilin kërkohet rivendosja në afat, që është pikërisht ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit. Nëse kjo kërkesë pranohet me vendim të formës së prerë, atëherë akti procedural i paraqitur bashkëlidhur kërkesës për rivendosje në afat quhet se është paraqitur në afat dhe bëhet i aftë të nisë procedurën e apelit, sa i përket shqyrtimit të themelit të çështjes

nga Gjykata Administrative e Apelit.

Mbi këto qëndrime kontradiktore, Kolegji, mbështetur në nenet 62(1)(b) dhe 62/a të ligjit nr. 49/2012, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke shtruar për njësim çështjen kryesore si vijon:

- **Referuar nenit 152 të Kodit të Procedurës Civile, në gjykimet administrative, kur paraqitet një kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, a duhet që kërkuesi ti bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkon rivendosjen në afat?**

[...]

Kolegji vlerëson se instituti procedural i rivendosjes në afat, është i lidhur ngushtësisht dhe është pjesë përbërëse e konceptit juridik të afateve procedurale. Ndaj, para trajtimit të këtij instituti si dhe parashtrimin të rregullit të së drejtës për çështjen e shtruar për njësim nga Kolegji, vlerësohet e nevojshme që të jepen disa konsiderata të përgjithshme në lidhje me kuptimin, llojet dhe zbatimin e afateve që parashikon ligji procedural. Kolegji vëren se afatet procedurale janë ato hapësira kohore para, brenda apo pas kalimit të cilave, ligji procedural lejon apo kërkon nga subjektet procedurale kryerjen e sjelljeve të caktuara, të cilat kanë pasoja juridike për të drejtat dhe detyrimet e tyre në atë proces. Afatet janë përshpejtuese kur ligji përcakton momentin deri kur mund të kryhet një akt procedural dhe vonuese, kur ligji përcakton momentin para të cilit nuk mund të kryhet një akt procedural i caktuar. Afatet janë veçanërisht të rëndësishme në procedurat gjyqësore, pasi janë shfaqje e formalizmit të së drejtës procedurale, të cilat kanë si funksion kryesor rregullimin, disiplinimin, orientimin dhe qartësimin e procesit gjyqësor, duke buruar nga nevoja për gjykim brenda afateve të arsyeshme, sipas kuptimit të nenit 42(2) të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, si dhe mbi të gjitha për garantimin e parimit të sigurisë juridike. [...].

Afatet procedurale gjejnë zbatim dhe rregullojnë si veprimtarinë procedurale të palëve ashtu edhe atë të gjykatës. [...] në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për *afatet* dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme. [...]

Në vija të përgjithshme mund të thuhet se afatet që parashikon ligji procedural janë ose detyruese ose orientuese. Afate detyruese janë ato, mosrespektimi i të cilave passjell pasoja penalizuese juridike për subjektet procedurale, duke iu pamundësuar atyre kryerjen e mëtejshme të veprimeve të caktuara procedurale apo ushtrimin e të drejtave në proces. Ndërsa afatet orientuese nuk passjellin pasoja të drejtpërdrejta penalizuese për subjektet procedurale, por parashikohen nga ligji me qëllim për të orientuar subjektet për kohën e arsyeshme që duhet të kenë parasysh për kryerjen e veprimtarive të caktuara procedurale. Nenet 145, 146, 147, 151 e 445 të KPC rregullojnë aspektet kryesore të afateve procedurale, duke i ndarë ato në dy kategori kryesore: 1) afatet ligjore (*ato që parashikohen shprehimisht në ligj*), 2) afatet gjyqësore (*ato, përcaktimi konkret i të cilave lihet në zgjedhjen e kujdesshme të gjykatës, pavarësisht se ligji mund të kenë parashikuar marzhe të caktuara në ushtrimin e kësaj zgjedhje*). Afatet ligjore janë a) të zakonshme, b) të prera, c) me karakter prekluziv. Afatet gjyqësore janë gjithnjë vetëm të zakonshme, përveç kur ligji shprehimisht i jep të drejtë gjykatës

për vendosjen e një afati të prerë apo prekluziv. Afatet e prera dhe ato prekluzive duhet të përcaktohen shprehimisht nga ligji si të tillë, pasi mosrespektimi i tyre passjell pamundësi apo humbje të së drejtës për të kryer një veprimtari konkrete procedurale. Gjykata mund që kryesisht apo me pëlqimin e palëve të shkurtojë apo të zgjasë afatet e zakonshme, kur një gjë e tillë është e lejueshme nga ligji, ndërsa afatet e prera dhe ato prekluzive nuk mund të shkurtohen apo të zgjaten. Nga ana tjetër të gjitha afatet mund të rivendosen, me përjashtim të atyre me natyrë prekluzive, por edhe këto të fundit mund të mos merren parasysh nga gjykata, në rrethana të caktuara shprehimisht në ligj (*si p.sh: në rastin e palës që nuk ka dijeni për procesin gjyqësor ku është palë për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve*).

Midis llojeve të ndryshme të afateve, ato që normojnë ushtrimin e të drejtës së ankimit, janë ndër afatet më të rëndësishme të parashikuara në KPC dhe ligjin nr.49/2012, pasi kalimi i tyre, i shoqëruar me mosveprimin e palës së interesuar për të paraqitur ankim ndaj një vendimi gjyqësor, passjell humbjen e të drejtës për këtë palë. Nisur nga karakteristikat e nxjerra në pah më sipër, afatet e ankimit të parashikuara nga neni 443 i KPC janë përsheptuese, detyruese, ligjore dhe të prera. Ndaj në nenin 444 të KPC parashikohet se afatet e ankimit janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Kalimi i afateve të ankimit passjell marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor përkatës, në kuptim të nenit 451(b) të KPC. Vendimi përfundimtar i formës së prerë dhe që nuk mund t'i nënshtrohet më asnjë mjeti të zakonshëm ankimi ka fuqinë e gjësë së gjykuar, në kuptim të nenit 451/a të KPC dhe e njëjta çështje nuk mund të gjykohet sërish.

Në lidhje me sa më sipër, dallohen disa situata që mund të verifikohen në praktikë, ndër të cilat veçohen tre, si vijon: 1) rasti kur pala është në dijeni të procesit gjyqësor, por vendimi përfundimtar i arsyetuar i gjykatës nuk i njoftohet fare (mungon procedura e njoftimit) nga sekretaria gjyqësore sipas nenit 316 të KPC; 2) rastin kur pala është në dijeni të procesit gjyqësor dhe i është njoftuar edhe përmbajtja e vendimit përfundimtar të arsyetuar të gjykatës, por gjatë kohëvazhdimin të afatit të ankimit, ndodhet në rrethana të tilla që pa fajin e saj, e bëjnë absolutisht të pamundur ushtrimin e të drejtës së ankimit në afat (shkaqet e arsyeshme); dhe 3) rasti kur pala në mungesë nuk ka dijeni fare për procesin dhe as vendimin përfundimtar të gjykatës, për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, por merr dijeni efektive më pas për vendimin e gjykatës.

Referuar rastit të parë, kur palës e cila ka dijeni për procesin (*pavarësisht se mund të ketë qenë në mungesë të vullnetshme në shpalljen e vendimit apo në ndonjë seancë tjetër gjyqësore, ose ka qenë prezent në shpalljen e vendimit nga gjykata pa arsyetim por vetëm me dispozitiv*), nuk i njoftohet vendimi përfundimtar i arsyetuar i gjykatës sipas nenit 316 të KPC, atëherë në këtë rast, gjykata nuk mund të konsiderojë të formës së prerë një vendim që nuk i është njoftuar palëve dhe nëse gabimisht e ka bërë një gjë të tillë, shënimi i “formës së prerë” në atë vendim nuk ka vlerë juridike. Forma e prerë është gjendje fakti dhe juridike njëkohësisht, e cila kushtëzohet nga dijenia e vërtetuar e palëve. Në këtë rast, pala e interesuar konform nenit 444 të KPC, ka të drejtë të paraqesë ankim në gjykatën që ka dhënë vendimin (sipas nenit 446 të KPC) brenda afateve të

parashikuara në nenin 443 të këtij Kodi, duke filluar nga dita e nesërme e ditës kur njoftohet apo merr dijëni efektivisht për vendimin e arsyetuar. Në këtë rast është gjyqtari i ankimit ai që sipas nenit 450 të KPC, do të vlerësojë respektimin e kushteve formale të ankimit. Ndaj nuk shtrohet për diskutim rivendosja në afat e ankimit, pasi afati as formalisht nuk ka filluar të ecë për palët, për shkak të mos realizimit të ndonjë njoftimi nga gjykata. [...]

Ndryshe qëndron rasti i dytë, kur gjykatat ia njoftojnë vendimet ndaj të cilave lejohet ankim, palëve apo përfaqësuesve të tyre, por këto për shkaqe të arsyeshme, që kanë të bëjnë me rrethana objektive me natyrë absolute dhe të pavarura nga vullneti i tyre, nuk kanë mundësi të ushtrojnë të drejtën e ankimit. Në këtë rast pala ka dijëni për vendimin e arsyetuar ndaj të cilit kërkon të ushtrojë ankim, por ndodhet në kushtet e pengesave objektive absolute që nuk mund të ishin parashikuar prej saj, e që për këtë shkak nuk mundet të ushtrojë të drejtën e ankimit. Këtu gjen zbatim instituti i rivendosjes në afat të ankimit, sipas neneve 151, 152 e 458 të KPC.

Në vijim referuar rastit të tretë të parashtuar më sipër, nëse gjykata i ka zbatuar formalisht rregullat e njoftimeve sipas KPC (*p.sh: nenet 128-133/b dhe 141-144/a*) për palët në mungesë apo përfaqësuesit e tyre, duke u dërguar atyre njoftimet gjatë gjykimit dhe më pas edhe për vendimin e gjykatës, si dhe ka administruar aktet përkatëse të njoftimit, por këto njoftime preken nga pavlefshmëri sipas nenit 122 të KPC (*të tilla që krijojnë pasiguri të plotë për personin apo datën e njoftimit*), atëherë “forma e prerë” që i ka shënuar gjykata vendimit të saj (*për mosankimim nga palët në mungesë*), mund të cenohet vetëm nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, në të cilën pala e interesuar shënon si shkak për humbjen formale të afatit të ankimit, pavlefshmërinë e njoftimeve të kryera nga gjykata. Po kështu vepron edhe pala që ndonëse ka dijëni për procesin, ka qenë në mungesë në shpalljen e vendimit, ose vendimi është shpallur i paarsyetuar dhe akti i njoftimit të vendimit të arsyetuar të gjykatës për të është i pavlefshëm sipas nenit 122 të KPC. Edhe kjo palë duhet të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, nëse dëshiron të ankimojë vendimin e gjykatës. Pavlefshmëria e njoftimit në këtë rast, përbën një rrethanë që nuk duhet të ketë të bëjë me vullnetin e palës, siç janë për shembull rastet e parashikuara nga nenet 129(5), 158(5) të KPC (*detyrimi i palëve dhe personave të tretë për të njoftuar gjykatën për ndryshimin e të dhënave të tyre elektronike të kontaktit*), përndryshe pretendimi për pavlefshmëri është i papranueshëm.

Nisur nga sa më sipër, Kolegji vëren se instituti procedural i rivendosjes në afat të ankimit është aspekti ekuilibrues i ngurtësisë që shoqëron në vetvete ekzistencën e afateve procedurale dhe përbën përjashtimin nga rregulli, i cili ndikon në përforcimin e vetë rregullit. Ky institut i jep elasticitetin e nevojshëm procedurave gjyqësore dhe shërben për mbrojtjen dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor. Rivendosja në afat e cila parashikohet nga nenet 151, 152 e 458 të KPC, është mjete i mbrojtjes për palën që, pa fajin e saj, humb formalisht një afat ankimi. Kjo, si në rastin kur ajo vetë apo përfaqësuesi i saj për shkaqe të arsyeshme ndodhen në kushtet e pamundësisë absolute për paraqitjen e ankimit, që nuk varet nga rrethana që mund të parashikoheshin prej tyre, ashtu edhe

në rastin kur afati humbet për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, të cilat formalisht janë kryer nga gjykata, por që në thelb janë të vesuara në atë masë, sa ligji i quan të pavlefshme. Në këtë rast, pala e interesuar, e cila dëshiron të paraqesë ankim, do që të zhbëjë cilësinë e formës së prerë të vendimit gjyqësor, dhe kjo realizohet vetëm nëpërmjet procedurës së posaçme të rivendosjes në afat, e cila sipas neneve 152 e 458 të KPC, është një procedurë që zhvillohet në prani edhe të palës tjetër kundërshtare, pasi është zgjatim natyral i institutit procedural të ankimit dhe vlerësimi gjyqësor të respektimit apo jo të afatit të ankimit nga palët e interesuara. [...] Kjo pasi, siç u tha më lart, nëse nuk ushtrohet e drejta e ankimit (në rastet kur lejohet ankimi), vendimi merr formë të prerë dhe nuk mund të cenohet më ajo që është vendosur nga gjykata, pasi cenohet siguria juridike dhe gjëja e gjykuar (*kur nuk ka mjete të tjera ankimi në dispozicion*), përveç kur vendimi ka natyrë të tillë që ligji parashikon se mund të ndryshohet sa herë ndryshojnë rrethanat (si p.sh: vendimi që ka vendosur një detyrim për ushqim).

Në rastin e humbjes së afatit të ankimit për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, ky fakt përbën argument për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit të munguar, e jo paraqitjen e një padie për pavlefshmërinë e njoftimeve. Në këtë rast, pretendimi që shërben për të mbështetur kërkesën për rivendosje në afat, ngrihet gjatë kësaj procedure të posaçme ku gjykata heton dhe vlerëson faktin nëse pretendimi i parashtruar është apo jo i vërtetë. Por, nuk ka interes juridik pala e interesuar që të iniciojë një proces gjyqësor de novo me palë kundërshtare vetëm për këtë pretendim, duke paraqitur padi me objekt pavlefshmërinë e njoftimeve, kundrejt palës tjetër kundërshtare të gjykimit të themelit. Aktet e njoftimit, janë akte të gjykatës dhe çdo pretendim për pavlefshmeri të tyre i adresohet gjykatës nëpërmjet kërkesës për rivendosje në afat, ku gjatë kësaj procedure, për shkak se potencialisht mund të preken të drejtat e palës tjetër, dëgjohet edhe kjo e fundit, në lidhje me qenien apo jo të pavlefshme të njoftimeve. Nëpërmjet këtij procesi, i cili ka si objekt të tij vetëm rrethanat që kanë penguar ushtrimin e të drejtës së ankimit nga pala e interesuar, mundësohet zgjidhja e pretendimit dhe eventualisht rivendosja në vend e të drejtës.

Nisur nga sa më sipër natyrshëm shtrohet pyetja, çfarë kuptohet me rivendosje në afat? A është ky një rifillim i afatit procedural të ankimit, i cili ndodh pasi vendimi për rivendosje në afat merr formë të prerë, apo afati i kaluar nuk rifillon më, por e drejta që do të ushtrohet brenda atij afati të kaluar, lejohet të ushtrohet më pas dhe konsiderohet njësoj si të ishte paraqitur brenda afatit?

Kolegji vlerëson se[...] formulim i nenit 152 të KPC rregullon disa çështje: 1) Përcakton se është gjykata që ka dhënë vendimin ajo që shqyrton dhe vendos për kërkesën për rivendosjen e afatit të humbur të ankimit (*shih dhe nenin 458 të KPC*), 2) Pala e interesuar duhet të paraqesë edhe dokumentet (provat) që justifikojnë ekzistencën e rrethanave të tilla që vlerësohen të arsyeshme dhe që i pamundësonin palës ushtrimin e të drejtës së ankimit brenda afatit të përcaktuar nga ligji, 3) Pala e interesuar ka detyrimin që bashkë me kërkesën për rivendosjen në afat, të paraqesë edhe ato dokumente për të cilat kërkohet rivendosja e afatit, d.m.th në rastin e ankimit atë akt procedural që do të duhej të ishte paraqitur brenda afatit të humbur pa fajin e

palës, por që për shkak të rrethanave të justifikuara, nuk qe e mundur të paraqitej. Në këtë rast, shprehja “dokumentet” ka disa kuptime njëherësh, si në kuptim të provave që provojnë rrethanat e arsyeshme që penguan ushtrimin e të drejtës së ankimit, ashtu edhe vetë aktin e ankimit që kërkohet të rivendoset në afat.

Pala ka interes juridik për paraqitjen e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, vetëm nëse e shoqëron kërkesën e saj me aktin procedural të ankimit, ashtu siç kërkon neni 152 i KPC [...]. Nëse pala nuk e bashkëlidh ankimin, atëherë gjykata duhet ta konstatojë me të meta kërkesën dhe t'i lërë asaj një afat për plotësimin e saj me aktin procedural për të cilin kërkohet rivendosja në afat (*sipas nenit 455 të KPC*). Pala nuk ka interes nëse kërkon thjesht rifillimin e afatit nga e para, në mënyrë që të ketë në dispozicion një afat të ri, gjatë të cilit të vlerësojë nëse do e bëjë apo jo ankimin. Afati i kaluar nuk mund të rifillojë edhe njëherë, por e drejta e “cenuar” mund të “shërohet”. Ndaj flitet për rivendosje në afat (rivendosje në situatën *quo ante*) dhe jo rifillim të afatit. Kjo pasi, pala kur merr dijeni efektive për vendimin gjyqësor të arsyetuar, të cilin kërkon ta ankimojë, ndonëse e humbi më parë afatin ligjor të ankimit për shkaqe të pavarura nga vullneti i saj (qoftë edhe për shkak të njoftimit të pavlefshëm), duhet të paraqesë kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit dhe bashkë me këtë kërkesë të paraqesë edhe kopjen e ankimit që kërkon të rivendosë në afat, me qëllim që edhe ai bashkë me kërkesën t'i njoftohet palëve të tjera. Në këtë mënyrë, palët e tjera kanë mundësi që të paraqesin kundërshtimet e tyre (nëse kanë) për kërkesën për rivendosje në afat dhe njëkohësisht, nëse dëshirojnë, të paraqesin edhe kundërankimet (apo kundërrekurset) përkatëse, me qëllim që nëse kërkesa për rivendosje në afat pranohet, gjykata që do të shqyrtojë ankimin, të ketë mundësi të vlerësojë edhe qëndrimin e palës kundërshtare në lidhje me përmbajtjen e tij. Kjo do të thotë se në procedurën që pason paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat, gjykata mban parasysh dhe zbaton *mutatis mutandis* edhe rregullat e tjera procedurale që shoqërojnë paraqitjen e mjetit përkatës të ankimit, që lidhen me pranueshmërinë e tij, si dhe plotësinë e aktit procedural të ankimit, konform neneve 442 e vijues të KPC (*për aq sa i lejohet të vlerësojë gjykatës që ka dhënë vendimin*).

Kolegji thekson se nëse do të pranohej se nëpërmjet institutit procedural të rivendosjes në afat, rifillon edhe njëherë një afat i caktuar, atëherë rrezikohet që ky mjet procedural të kthehet në jo efektiv, pasi mund të prodhojë situata absurde kur pas rivendosjes së afatit, lindin rrethana të tjera që i pamundësojnë palës sërish paraqitjen e ankimit, e kështu mund të kalohet në një proces ciklik kërkesash për rivënien e afateve njëri pas tjetrit, duke dëmtuar sigurinë juridike dhe afatet e arsyeshme të gjykimit. Kolegji vëren se nuk është, e nuk mund të jetë ky kuptimi i institutit të rivendosjes në afat, e për këtë qëllim ligji ka përcaktuar në nenin 152 të KPC se kërkesës për rivendosje në afat i duhet bashkëlidhur edhe dokumenti (në këtë rast akti procedural) për të cilin kërkohet rivendosja në afat. Në këtë mënyrë, shmanget mundësia e rifillimit disa herë të të njëjtit afat, për shkaqe të ndryshme, ekonomizohet procesi dhe garantohet gjykimi i çështjes në afate të arsyeshme, duke u respektuar njëkohësisht edhe parimi i sigurisë juridike. E njëjta qasje legislative gjendet edhe në nenin 147 e 420/1 të KPP, apo nenin 54 të KPA.

Referuar sa më sipër dhe në lidhje organike dhe aksesore me faktin se kërkesës për

rivendosje në afat të ankimit i duhet bashkëlidhur edhe akti procedural i ankimit për të cilin paraqitet kjo kërkesë, shtrohet pyetja: a ka një afat pala e interesuar për të paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të ankimit? Në lidhje me këtë ligji procedural civil nuk ka parashikuar drejtpërdrejtë një rregull të tillë, porse në nenin 445 të KPC është parashikuar vetëm afati i gjatë prekluziv një vjeçar [...]. Kjo dispozitë rregullon vetëm afatin prekluziv një vjeçar i cili fillon nga dita e shpalljes së vendimit dhe pasi mbaron, shuan të drejtën e ankimit të palëve. Ky rregull nuk zbatohet vetëm në rast se njoftimet janë të pavlefshme dhe për këtë shkak pala në mungesë nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor. Pra, në rastin e njoftimeve të pavlefshme, pala në mungesë si më sipër nuk ndalohet të ushtrojë të drejtën e ankimit, e cila siç u tha më sipër, do të lejohet në kuadër të procedurës së rivendosjes në afat. Ndaj, meqë kërkesës për rivendosje në afat i duhet bashkëlidhur detyrimisht edhe akti procedural i ankimit, ky fakt bën që për ushtrimin e kësaj të drejte aksesore, në mungesë të një parashikimi të ndryshëm ligjor, e në funksion të garantimit të barabartë të të drejtave të palëve, të merret për referencë afati i ankimit për të cilin paraqitet kërkesa për rivendosjen në afat. Në këtë rast, mbahet një standard si për rastin kur humbja e afatit ndodh për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, ashtu edhe kur gjatë kohëvazhdimin të afatit, pala që ka dijeni për vendimin e arsyetuar të gjykatës, e humb afatin e ankimit për shkaqe të arsyeshme që nuk varen prej saj.

Pra, kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit duhet të paraqitet brenda të një afati të njëjtë me atë që parashikon neni 443 i KPC për bërjen e ankimit përkatës i cili kërkohet të rivendoset. Ky afat do të fillojë të llogaritet sipas nenit 148 të KPC, nga dita e nesërme e ditës së marrjes dijeni efektivisht për vendimin e arsyetuar për të cilin kërkohet rivendosja në afat e ankimit (*në rastin e pavlefshmërisë së njoftimeve*), ose nga dita e nesërme e ditës kur ka pushuar së ekzistuari shkak i arsyeshëm (*forcë madhore apo shkak tjetër i arsyeshëm që nuk mund të parashikohej nga pala*) që e ka penguar palën të ushtrojë të drejtën e ankimit. Ky arsyetim, sidomos sa i përket pavlefshmërisë së njoftimit, si shkak për rivendosjen në afat të ankimit, mbështetet edhe në kuptimin e paragrafit të tretë të nenin 120 të KPC [...].

Nëse pala e interesuar është penguar në ushtrimin e të drejtës së ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, vetëm për shkak të njoftimeve të pavlefshme të këtij vendimi dhe më pas ndonëse merr dijeni efektivisht për këtë vendim, nuk vepron brenda të njëjtës kohë sa afati i ankimit që kërkon të rivendosë, duke mos paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të këtij ankimi, atëherë kjo palë vlerësohet se ka hequr dorë heshtazi nga pretendimi për pavlefshmëri të njoftimit e për rrjedhojë nuk mund të gëzojë më mbrojtje e drejta e saj e ankimit dhe nuk mund të pranohet rivendosja në afat, për mungesë interesi juridik. Heqja dorë heshtazi nga pretendimi për pavlefshmërinë e njoftimit, nëse ai është i vetmi argument në të cilin pala e mbështet kërkesën për rivendosje në afat, dëmton drejtpërdrejtë mundësinë e saj për mbrojtjen e të drejtës së ankimit, pasi edhe kjo e drejtë humbet bashkë me pretendimin e pa ngritur në kohë. Kjo mënyrë të kuptuari e dispozitave ligjore të mësipërme është nga njëra anë garantuese për palën që gabimisht dhe pa fajin e saj është penguar që të ushtrojë të drejtën e ankimit, e cila mund ta rivendosë të drejtën e saj nëpërmjet paraqitjes brenda afatit të kërkesës për

rivendosje në afat të ankimit, e nga ana tjetër është shkruajuese për palën që neglizhon apo qëllimisht nuk vepron në kohë dhe zvarrit pa shkak mbrojtjen e të drejtave të saj. Në rastin e fundit, balanca midis interesit për mbrojtjen e të drejtave të atij që me vetëdije nuk vepron për t'i mbrojtur ato brenda afatit dhe interesit për garantimin e sigurisë juridike që prodhojnë vendimet e formës së prerë, anon nga ana e kësaj të fundit.

Lidhur me sa është trajtuar më sipër në këtë vendim njësoje, shtrohet për zgjidhje qëndrimi që duhet të mbajnë gjykatat për çështjet e gjykuara para njësimi të praktikës gjyqësore. Në lidhje me këtë, Kolegji thekson se gjykatat në shqyrtimin e kërkesave të paraqitura e të shqyrtuara para botimit në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi njësoje, duhet të bëjnë kujdes që sa është theksuar më sipër, të mos lëndojnë në mënyrë joproporcionale të drejtat procedurale të palëve. [...]. Rrjedhimisht gjykatat duhet të kenë parasysh si vijë orientuese, që të rregullojnë sa të jetë e mundur procedurën, në atë mënyrë që të garantojë ushtrimin efektiv të të drejtave nga palët. P.sh: nëse një palë ka iniciuar një proces për pavlefshmëri njoftimesh, por nga kjo del qartë se kërkohet rivendosja në afat e të drejtës së ankimit të humbur për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, atëherë gjykatat duhet të vlerësojnë thelbin e kërimit dhe të kërkojnë nga pala edhe paraqitjen e ankimit përkatës, e më pas të disponojnë për rivendosjen në afat, nëse ky kërkim rezulton i mbështetur në ligj e në prova. Në zgjidhjen e drejtë të çështjeve të parashtruara dhe të shqyrtuara para njësimi, sa i përket elementëve formalë të procesit, gjykatat duhet të mbajnë parasysh parimin e së drejtës së shënuar në paragrafin e fundit të nenit 119 të KPC [...]. Kësisoj, nuk mund të cenohet një vendim i marrë për një çështje të shqyrtuar para njësimi të praktikës, në të cilën p.sh: gjykata ka vendosur rifillimin e afatit procedural dhe pala e interesuar ka ushtruar më pas të drejtën e ankimit brenda afatit të rifilluar, dhe aktet janë përcjellë në gjykatën kompetente për shqyrtimin e ankimit. Në këtë rast pavarësisht të metave, akti e ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar. Në të njëjtën frymë gjykatat duhet të vlerësojnë edhe raste të tjera që mund të lindin në praktikë.

Kolegji, bazuar në arsyetimin e mësipërm, referuar çështjes së shtruar për njësim, arrin në këtë përfundim njësoje:

- **Në kuptim të neneve 152 dhe 458 të KPC, në të gjitha gjykimet administrative ku paraqitet një kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit, kërkuuesi ka detyrimin që t'i bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat.**

Në lidhje me zgjidhjen çështjes objekt gjykimi, Kolegji vëren, se[...] referuar akteve procedurale në dosjen gjyqësore, rezulton se shkalla e parë nuk e ka administruar dosjen e themelit për të parë dhe vlerësuar pretendimet mbi mosnjoftimin e rregullt të kërkuësve. Kjo e metë e hetimit gjyqësor nuk është rregulluar as nga gjykata administrative e apelit. Sa herë kërkohet rivendosja në afat e ankimit, gjykata duhet të administrojë dosjen origjinale, ose në pamundësi një kopje të vërtetuar të saj, pasi nëpërmjet kësaj mund të vlerësojë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuësit për pavlefshmëri të njoftimeve. Disa nga aktet e njoftimit të gjykimit të themelit, rezultojnë se janë depozituar nga kërkuësit, të cilët bashkëlidhur rekursit[...].

[...]Gjykatat duhet ti kërkonin shpjegime kërkuësve në lidhje me rrethanat se nga kush dhe në ç'mënyrë janë njoftuar në këtë datë. Gjithashtu, rezulton se kërkesa për rivendosje në afat objekt gjykimi, nuk përmban bashkëlidhur ankimin kundër vendimit të themelit, çka përbën një të metë të vetë kërkesës. Për këtë fakt, asnjë nga dy gjykatat më të ulta nuk është shprehur. Kolegji vlerëson se gjykatat më të ulta kanë zbatuar gabim nenin 152 të KPC [...]. i cili plotëson nenin 458 të këtij Kodi, kur nuk kanë konstatuar të metë kërkesën për rivendosje në afat dhe të kërkonin nga kërkuësit që asaj ti bashkëlidhej edhe akti procedural i ankimit për të cilin kërkohej rivendosja në afat. Kjo e metë formale i pamundëson Gjykatës së Lartë vlerësimin e mëtejshëm të argumenteve në lidhje me shkakun e mosmarrjes dëjani nga pala, që është pavlefshmëria e njoftimeve, pasi pavarësisht nëse ky pretendim është apo jo i bazuar, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të disponohet me vendim për rivendosjen në afat të një ankimi që mungon në dosje.

Kolegji vlerëson, se referuar analizës së mësipërme lidhur me aktet e ndodhura në dosje, ndodhemi në kushtet kur duhet të prishet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në rigjykim, kjo gjykatë ti lërë afat palës kërkuëse që të plotësojë kërkesën për rivendosje në afat me ankimin përkatës, të administrojë dosjen gjyqësore të themelit, për të cilën kërkohet të ushtrohet ankim, e më pas të vijojë me shqyrtimin e çështjes, duke u shprehur për shkaqet e parashtruara nga palët, në lidhje me themelësinë e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit.

IV. Mosmarrëveshje mbi Aktin Normativ Nënligjor

KAGJL Vendim Nr. 00-2021-1938 (243), datë 22.11.2021 (Legjitimiteti)

Shoqatat dhe grupet e interesit nuk kanë legjitimitet të pakushtëzuar në mbrojtjen e interesave të tyre kur kundërshtojnë gjyqësisht një akti normativ. Ato duhet të duhet të provojnë edhe se interesi ligjor se është aktual, i sigurt dhe i drejtpërdrejtë, edhe për shkak se është i lidhur me faktin se pa ndërhyrjen e gjykatës, mosmarrëveshja do të vazhdojë të ekzistojë dhe pala do të ndjehet nën kërcënimin e një dëmi të mundshëm.

Fjalë kyçe: akt normativ, legjitimitet individ, gjykim incidental

Rrethanat e çështjes:

Nga dosja gjyqësore rezulton se pala paditëse shoqëria “FERLUT” sha, është një shoqëri tregtare dhe që ushtron aktivitetin e saj kryesisht në “fushën e transportit të udhëtarëve...etj”. Rezulton se me vendimin nr. 39, datë 23.05.2016 “Për përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rreth-qytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja”, Këshilli Bashkiak Tiranë (në vijim VKB) ka miratuar 15 linja qytetase të transportit publik në Tiranë, ndër të cilat edhe linjën “Unaza”, që është linja nr. 14 “Unaza”, bashkë me stacionet e qëndrimit përkatëse, që

janë 19 stacione qëndrimi në sensin orar dhe 20 stacione qëndrimi në sensin antiorar.

Shoqëria është pajisur me licencë[...] nga Bashkia Tiranë si operator ekonomik për ofrimin e shërbimit të transportit publik qytetas për linjën e Unazës në qytetin e Tiranës sipas VKB nr. 39, datë 23.06.2016 dhe midis palëve është lidhur kontrata e shërbimit[...] “Për transportin e udhëtarëve në linjën qytetase “Unaza”, për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.

[...] Kryetari i Bashkisë Tiranë ka dërguar para Këshillit Bashkiak Tiranë për shqyrtim dhe miratim relacionin dhe projekt vendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 39, datë 23.05.2016 të Këshillit Bashkiak”. Sipas relacionit bashkëngjitur, të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike pranë Bashkisë Tiranë, arsyetohet se: [...] me mbarimin e projekteve të mëdha si “Unaza e Madhe”, Sheshi “Skënderbej” dhe “Unaza e Vogël” dhe kërkesave të ardhura nga Njësitë Administrative dhe qytetarë të zonave të ndryshme, lind nevoja e ndryshimeve në disa stacione për linjat qytetëse dhe shtrirje më e gjerë e rrjetit të linjave qytetëse, për mbulim më të mirë me transport publik qytetës. Për këtë, Bashkia Tiranë propozon shtimin e rrjetit të linjave qytetëse me linjën nr. 16, e cila do të emërtohet “Linja e gjelbër”.

Rezultoni se me vendimin e Këshillit Bashkiak [...] është bërë shtimi në transportin publik qytetas të Tiranës të linjës nr. 16, e quajtur “Linja e gjelbër”, bashkë me stacionet e qëndrimit përkatëse, që janë 33 stacione qëndrimi në sensin orar dhe 34 stacione qëndrimi në sensin antiorar. Pala paditëse duke mos qenë dakord me aktin normativ të mësipërm [...] depoziton padinë me objekt shfuqizimin pjesërisht të tij.

Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur shfuqizimin pjesërisht të aktit nënligjor normativ Vendimit të Këshillit Bashkiak [...] konkretisht në Linjën Nr. 16 “Linja e Gjelbert” (Unazore), vetëm për stacionet si vijojnë: Sensi Orar stacionet [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se nuk do të marrë në shqyrtim shkaqet e ngritura në rekurs nga pala e paditur Këshilli Bashkiak Tiranë, lidhur me zbatimin e gabuar të ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit, për sa i përket themelit të çështjes, pasi nga ana e gjykatës janë lejuar shkelje procedurale të asaj natyre që nuk lejojnë vijimin e mëtejshëm të gjykimit. Prandaj, vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është i cenushtëm ligjërisht dhe, për rrjedhojë, duhet të priset dhe gjykimi duhet të pushohet, për shkak të moslegjitimitit procedural formal të paditësit për të kundërshtuar, në rastin konkret, paligjshmërinë e aktit normativ.

[...] Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit për vendimin [...] e Këshillit Bashkiak Tiranë, si një akt me natyrë normative është në përputhje me përcaktimet që jep ligji mbi llojin e aktit administrativ dhe mbi kompetencën funksionale të kësaj gjykate. Akti, objekt shqyrtimi, me anë të të cilit shprehet vullneti i Këshillit Bashkiak, në ushtrim të funksionit të tij publik që synon të rregullojë një marrëdhënie të përcaktuar me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjellje për të gjithë subjektet që operojnë në këtë fushë dhe që nuk shteron me zbatimin e tij, përputhet me kuptimin që jepet për “aktin nënligjor normativ”, në nenin 2, pika 3 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 [...]

Mbi kuptimin e “aktit nënligjor” është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese, e cila ka interpretuar tri kritere që përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ [...] (*Shih vendimin nr. 14 datë 21.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi këto referenca ligjor, por edhe jurisprudenciale, Kolegji vlerëson, për rastin në shqyrtim, se kontrolli i ligjshmërisë së aktit normativ është në kompetencën e Gjykatës Administrative të Apelit si gjykata kompetente për të shqyrtuar mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, siç paraqitet edhe rasti në gjykim [...]

Nisur nga faktet e pranuar nga vetë Gjykata Administrative e Apelit për çështjen në gjykim, Kolegji vlerëson të domosdoshme të theksojë se, ajo ka interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural, kur ka konkluduar se paditësi, shoqëria “FERLUT” sha legjitimohet për paraqitjen e padisë ndaj këtij akti normativ. [...]

Kolegji vlerëson se mbi çdo subjekt që i drejtohet gjykatës qëndron detyrimi për të provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës ose interesit të pretenduar si të cenuar dhe akti normativ, të cilin e kundërshton si të paligjshëm. E rëndësishme është se, për çfarëdo lloj akti administrativ që shqyrtohet, për më tepër një akt normativ, paditësi duhet të provojë përtej çdo dyshimi se të drejtat e tij janë cenuar. Për të qenë bindës në një rast të shkëlqes së të drejtave të paditësit, me qëllimin për të konfirmuar legjitimitimin e tij, duhet që akti normativ të rezultojë si objektivisht i paligjshëm dhe se, interesi ligjor duhet të provohet se është aktual, i sigurt dhe i drejtpërdrejtë për paditësin, edhe për shkak se është i lidhur me faktin se pa ndërhyrjen e gjykatës, mosmarrëveshja do të vazhdojë të ekzistojë dhe pala do të ndjehet nën kërcënimin e një dëmi të mundshëm. Kur gjykata arrin në përfundimin se pala kërkuese ka interes për çështjen, ajo ka konkluduar, në këtë mënyrë, edhe për legjitimitimin e saj. Pra, koncepti për interesin ndihmon për të verifikuar dhe legjitimitimin. Këto dy koncepte janë në funksion të njëri-tjetrit.

Duke ju referuar nenit 15, shkronja a) dhe d) të ligjit nr. 49/2012 rezulton se [...] në parim, ky parashikim ligjor lejon paraqitjen para gjykatës administrative të çdo subjekti për të kundërshtuar një veprim administrativ, siç mund të jetë edhe kundërshtimi i një akti normativ. Megjithatë, që në nisje të një procesi gjyqësor është e domosdoshme të verifikohet paraprakisht legjitimiteti i paditësit, për çdo rast konkret, me qëllim që gjykata të kontrollojë në vijim edhe ligjshmërinë e aktit normativ.

Kolegji e çmon të nevojshme të theksojë se shoqatat dhe grupet e interesit, si subjekte të legjitimuar për ngritjen e padisë kundër një akti normativ janë parashikuar, jo pa qëllim nga ana e ligjvënësit, në nenin 15, shkronja d) të ligjit nr. 49/2012. Një përcaktim i tillë që legjitimon shoqatat dhe grupet e interesit lidhet me natyrën e vetë aktit normativ, i cili vendos rregulla të përgjithshme, parashikon hipoteza abstrakte, si dhe nuk shteron me një akt të vetëm zbatim. Pra, normat e sjelljes që parashikon akti normativ nuk iu drejtohen drejtpërdrejtë subjekteve të identifikueshëm, por një grupimi subjektësh, interesat e të cilëve, kur kanë pretendime se një akt normativ shkel të drejtat të ligjshme, mund të mbrohen me efektivitet dhe në mënyrën më eficiente, nëpërmjet shoqatave dhe grupeve të interesit, të cilat kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, duke mbrojtur të drejtat kolektive në tërësi. Kjo nuk do të thotë se këto subjekte kanë legjitimitet të pakushtëzuar në mbrojtjen e interesave të tyre për t'iu drejtuar gjykatës. Edhe në raste të kësaj natyre,

verifikimi i legjitimitetit të shoqatave e grupeve të interesit mbetet detyrë kryesore e gjykatës që shqyrtton padinë për kundërshtimin e aktit normativ.

Pavarësisht nga parashikimi në nenin 15, shkronja d) të ligjit 49/2012, Kolegji vlerëson se si rregull, aksesi i individëve për t'i drejtuar gjykatës nuk pengohet në rastet kur ata dëshirojnë të kundërshtojnë drejtpërdrejtë një akt normativ dhe për të cilin vlerësojnë se cenon interesat e tyre të ligjshme. Pra, çdo subjekt, i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij, mund t'i drejtohet gjykatës, duke marrë zgjidhje për këto pretendime me një vendim përfundimtar. Megjithatë është e domosdoshme për çdo individ se për të vërtetuar legjitimitetin e tij para gjykatës, duhet të provojë interesin e ligjshëm dhe dëmin konkret që i është shkaktuar nga cenimi i këtyre të drejtave. Legjitimiteti që paraqitet, si në aspektin procedural (formal) dhe në atë substancial (real), nënkupton faktin se mungesa e legjitimitetit procedural (formal) është kusht për vazhdimin e gjykimit dhe pengon inicimin e procesit (duke qenë pengesë për shqyrtimin e themelit të çështjes), ndërsa mungesa e legjitimitetit substancial (real) i takon shqyrtimit gjyqësor të themelit të çështjes, për të cilin gjykata shprehet me vendim përfundimtar, duke sjell rrëzimin ose jo të padisë.

Kolegji e çmon të nevojshme të ritheksojë se është konsoliduar praktika gjyqësore dhe ajo kushtetuese, sipas të cilës individët apo subjektet, për mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme, duhet të provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë, në veçanti, për kundërshtimin e një akti normativ, duke bindur gjykatën se nuk kanë rrugë tjetër për të mbrojtur të drejtat e tyre. Është e kuptueshme se pasojën e drejtpërdrejtë juridike mbi subjektin nuk e krijon akti normativ. Për vetë natyrën e përgjithshme të aktit normativ që përmban norma hipotetike dhe në abstrakt, si rregull, ai nuk mund të zbatohet, nëse organi administrativ nuk nxjerrë aktin individual ndaj subjektit konkret. Kjo do të thotë se përpara se të kundërshtohet në gjykatë një akt normativ, mbrojtja e interesave të ligjshme nga çdo subjekt fillon me paraqitjen në gjykatën e shkallës së parë të padisë ndaj aktit individual konkret. Pra, çdokush që cenohet në të drejtën e tij dhe ky cenim rezulton të jetë konkret, aktual, i sigurt dhe i formësuar në një akt individual, duhet t'i drejtohet gjykatës administrative të shkallës së parë që ligji ka ngarkuar për shqyrtimin e saj, si nga pikëpamja lëndore, tokësore dhe funksionale, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit, për kundërshtimin e aktit normativ.

Nga ana tjetër, Kolegji e vlerëson të nevojshme të theksojë se ligji nr. 49/2012 ka parashikuar, për herë të parë, një tjetër mjet të rëndësishëm që në fakt synon shmangien apo moszbatimin e aktit normativ, që vlerësohet si i paligjshëm, konkretisht në nenin 38 të tij [...] Në interpretim të dispozitës së sipërcituar, Kolegji vlerëson se ligjvënësi ka përcaktuar shprehimisht se edhe gjykatat administrative të shkallës së parë kanë të drejtë të verifikojnë ligjshmërinë e një akti normativ, edhe pse nuk është në kompetencë funksionale të saj. Pra, nëpërmjet gjykimit incidental, pala paditëse mund të pretendojë se akti administrativ që ka dalë në zbatim të një akti normativ të paligjshëm cenon të drejtat e tij dhe, në këtë rast, gjykata ka detyrimin të marrë në shqyrtim këtë pretendim, në zbatim me parashikimet e nenit 37 të ligjit nr. 49/2012, i cili ka përcaktuar kufijtë e shqyrtimi të çështjes. Gjatë shqyrtimit të çështjes gjykata administrative e shkallës

së parë vlerëson nëse akti normativ është nxjerrë ose jo në zbatim të ligjit dhe, në varësi të kësaj analize, disponon me vendim vetëm në lidhje me aktin administrativ individual. Nëse gjykata çmon se akti normativ nuk ka dalë në zbatim të ligjit ose ka dalë tej parashikimeve të tij, ç'ka e bënë të paligjshëm në të dy rastet, e konstaton këtë fakt dhe gjatë gjykimit në themel mënjanon zbatimin e aktit normativ, duke zbatuar drejtpërdrejtë ligjin dhe duke disponuar me pranimin e padisë e shfuqizimin e aktit administrativ individual, që ka cenuar të drejtat e palës kërkuese. Në rastin konkret, gjykata administrative e shkallës së parë nuk disponon me shfuqizimin e aktit normativ, pasi kjo është kompetencë funksionale e drejtpërdrejtë e Gjykatës Administrative të Apelit, por nëpërmjet qëndrimit që mban me shmangien e zbatimit të aktit normativ të paligjshëm, zgjidh përfundimisht kërkesën e paditësit, duke shfuqizuar aktin administrativ individual që është bazuar mbi një akt normativ të paligjshëm.

Pikërisht, nëpërmjet gjykimit incidental, subjektit që pretendon se i janë cenuar interesat e ligjshme, i njihet e drejta absolute t'i mbrojtë ato në gjykatën e shkallës së parë, duke kundërshtuar drejtpërdrejt aktin administrativ, i cili ka dalë në bazë dhe në zbatim të një akti normativ, pa kundërshtuar gjyqësisht këtë të fundit, sipas nenit 10, pika 2, shkronja b) të ligjit nr. 49/2012. Vetëm në rastin kur individi pretendon se akti normativ që cenon të drejtat e tij është drejtpërdrejtë i zbatueshëm për të, duke i shkaktuar një dëm konkret, që është i sigurt, aktual dhe i vërtetë, si dhe kur subjekti arrin të provojë përpara gjykatës se nuk ka asnjë mjet tjetër ligjor për të mbrojtur të drejtat e tij, atëherë i lind e drejta t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit për të kundërshtuar aktin normativ.

Referuar rrethanave dhe fakteve të pranuar nga vetë Gjykata Administrative të Apelit nuk rezulton që paditësi, shoqëria "FERLUT" sha, të jetë ndodhur në rrethana të tilla që vërtetojnë legjitimitetin për të kundërshtuar para kësaj gjykate paligjshmërinë e aktit normativ. Kolegji vlerëson se ligji është zbatuar dhe interpretuar gabim nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi pala paditëse nuk ka provuar legjitimitetin për të drejtën që i është cenuar dhe nëse akti normativ, objekt gjykimi është drejtpërdrejtë i zbatueshëm ndaj tij, pa qenë nevoja e nxjerrjes së ndonjë akti individual konkret. Ashtu sikurse është pranuar nga palët ndërgjyqëse me vendimin [...] e *Këshillit Bashkiak*, [...] janë përcaktuar rregulla të përgjithshme sjellje që veprojnë ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë që operojnë në këtë fushë në Republikës së Shqipërisë. Në rastin në shqyrtim, pala paditëse nuk ishte në gjendje të provonte para Gjykatës Administrative të Apelit se cili është interesi i saj konkret që preket nga ky akt normativ dhe cili është dëmi real që i është shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra, vetëm afirmimi formal i normave apo dispozitave të caktuara në një akt normativ, nëpërmjet paraqitjes së një padie, nuk është argument për vërtetimin e legjitimitetit të paditësit, pasi siç u theksua edhe më sipër, dëmi duhet të jetë real dhe jo hipotetik, të jetë aktual ose i formësuar në një akt administrativ individual konkret, që të sjellë efektet të drejtpërdrejta që vlerësohet se cenojnë interesat e palës paditëse.

[...] Kolegji vlerëson se duhet të priset vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe gjykimi duhet të pushohet, për arsye të mungesës të legjitimitetit procedural formal të paditësit, në rastin në konkret, për kundërshtimin e këtij akti normativ.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL Nr. 00-2022-533(125), datë 25.03.2022

KAGJL Vendim Nr. 00-2022-3236 (415), datë 11.02.2023 (Pezullim Akt Normativ Nënligjor)

Pezullimi i akteve nënligjore normative në fushën e taksave, tatimeve apo tarifave të ndryshme nëpërmjet mund të bëhet vetëm nëse nga zbatimi i tij cenohet rëndë interesi publik. Vetë vendimi për sigurimin e padisë duhet të plotësojë kushtin bazë që është mos cenimi rëndë i interesit publik nga marrja e masës së sigurimit të padisë në formën e pezullimit të zbatimit të aktit nënligjor normativ.

Fjalë kyçe: akt nënligjor normativ, ulja e tarifave përmbarrimore, cënim i rëndë i interesit publik, sigurim padie

Rrethanat e çështjes:

Rezulton [...] se ndërmyjet titullarëve (Ministrave) të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Drejtësisë është miratuar udhëzimi nr.30, datë 30.8.2018 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor privat”. Udhëzimi nr. 30, datë 30.8.2018, përmes ndryshimeve në udhëzimin e mëparshëm (udhëzimi bazë) me nr. 385/7, datë 28.6.2017, solli një ri konfigurim të sistemit tarifor të miratuar duke ndërhyrë në vlerat e tarifave për ofrimin e shërbimit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

[...] Relacioni që shoqëron udhëzimin shpjegon motivimin e ministrive për të miratuar këtë akt që ndryshon elementet e sipërcituar, duke adresuar në përmbajtje të tij: Përkeqësimin e zhvillimit të procedurave të ekzekutimit; Devijimin nga qëllimi i reformës për reduktimin e kredive të këqija; Diferencimin e shërbimeve përmbarrimore gjyqësore shtetërore dhe private duke sjellë deformim të tregut. [...] Më tej, relacioni sqaron se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka kryer rishikim të tarifave aktuale të aplikuara, duke mos kryer ndryshime thelbësore procedurale, por vetëm ri fokusim tek vlerat tarifore, duke ngarkuar në fund shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat dhe shtetëror me zbatimin e këtij udhëzimi. [...]

Pala paditëse Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë [...] ka kërkuar shfuqizimin e këtij akti nënligjor normativ dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë për shkak të antikushtetutshmërisë, paligjshmërisë dhe veprimit regresiv ndaj parimeve të shtetit të së drejtës [...], e shoqëruar edhe me pasoja dhe dëme serioze për ushtrimin e profesionit të përmbarruesit gjyqësor privat.

Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të aktit normativ nënligjor Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë [...] për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Privat” deri në përfundim në themel të gjykimit të kësaj çështjeje. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji Administrativ vlerëson se [...] vendimi objekt rekursi i Gjykatës Administrative të Apelit është një vendim i marrë në shkellje të rëndë të kritereve ligjore për caktimin e masave të sigurimit të padisë në një gjykim administrativ. Gjykata nëpërmjet pezullimit të aktit nënligjor normativ objekt gjykimi, ka cenuar rëndë interesin publik, për pasjen e një akti nënligjor normativ në fuqi, të nxjerrë sipas vullnetit të organeve kompetente shtetërore, që përcakton në mënyrë transparente dhe të qartë, llojet dhe masat e tarifave përmbartimore. Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave [...] mbetën pa fuqi disa dispozita të aktit pararendës bazë të vitit 2017 (*për pjesët e ndryshuara*), të cilat nuk mund të ripërtëriheshin automatikisht nëpërmjet pezullimit që urdhëroi Gjykata Administrative e Apelit.

Një nga kushtet bazë për sigurimin e padisë, është mos cenimi rëndë i interesit publik, pikërisht nga marrja e masës së sigurimit të padisë në formën e pezullimit të zbatimit të aktit administrativ. Si rregull, aktet nënligjore normative në fushën e taksave, tatimeve apo tarifave të ndryshme, nuk mund të pezullohen nga gjykata në gjykimin abstrakt të ligjshmërisë së këtij akti, përveç nëse provohet bindshëm se ekzistojnë kushtet e kriteret e përcaktuara në nenet 28(1) e 29 të ligjit nr. 49/2012. Aktet nënligjore normative i drejtohen një grupi të papërcaktuara subjektsh të së drejtës dhe padia sipas nenit 15(d) të ligjit nr. 49/2012, mund të ngrihej nga paditësi Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, vetëm në rast se ata do të argumentonin se është cenuar një interes i ligjshëm publik. Pra, akti objekt padie ka dalë për të realizuar një interes publik që lidhet me përcaktimin sipas ligjit të masës së tarifave përmbartimore të përmbartuesve gjyqësorë privatë dhe pezullimi i këtij akti mund të bëhej vetëm nëse nuk cenohet rëndë interesi publik, sipas nenit 29(b) të ligjit nr. 49/2012, i cili me shumë gjasë cenohet nëse vendimmarrja e gjykatës së paku krijon konfuzion në lidhje me masën e tarifës që do të zbatohet përmbartuesit gjyqësor privatë. Gjykata në gjykimin administrativ, konform nenit 3(2) të ligjit nr. 49/2012 zbaton parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshme të personave privatë. Asnjë argument konkret nuk është dhënë nga gjykata më e ulët për ndërhyrjen aq të fortë në zbatimin e aktit nënligjor normativ objekt gjykimi, nëpërmjet pezullimit të zbatimit të tij. Nuk është e qartë se si ulja e tarifave përmbartimore cenon interesin publik dhe për më tepër se si pezullimi i zbatimit të këtij akti të vitit 2018, nuk cenon rëndë interesin publik, siç u tha më sipër. Po ashtu, gjykata nuk ka arsyetuar se pse është i pakthyeshëm dëmi që mund t'i shkaktohet përmbartuesve gjyqësor privatë nga tarifimi më i ulët ndaj kreditorëve dhe debitorëve dhe pse këta nuk kanë mundësi ti marrin mbarsht këto tarifa nëse dalin gjyqftues në themel. Ndaj ky vendim i gjykatës administrative të apelit është i paargumentuar, i pabazuar në kriteret e përcaktuara në nenet 28(1) dhe 29 të ligjit nr. 49/2012, e për rrjedhojë nëse do të ishte gjykuar në kohë, do të duhej të ishte ndryshuar.

Mirëpo analiza e mësipërme nuk ka vend të shtjellohet më tej, pasi rezulton se nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit është disponuar me vendim përfundimtar në lidhje me themelin e çështjes (*vendimi nr. 211, datë: 17.12.2018*) dhe për rrjedhojë është hequr edhe masa e sigurimi, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë që

në momentin e shpalljes së tij. Pra nga data 17.12.2018 e deri sot më datë 01.12.2022 nuk ka pasur më masë sigurimi në fuqi, pasi vendimi nr. 363 akti, datë 26.09.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit (*objekt rekursi*) e ka humbur fuqinë më datë 17.12.2018.

Kolegji [...] thekson se referuar ligjit në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit (*nr. 363 akti, datë 26.09.2018*) objekt rekursi, apo edhe të vendimit nr. 211, datë: 17.12.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, vendimi i themelit i kësaj të fundit, konsiderohej i formës së prerë dhe madje dërgohej për botim njësoj si akti që shfuqizonte (kur bëhej shfuqizimi). Sipas ligjit në fuqi në kohën e zhvillimit të gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, kjo e fundit në rastin e shqyrtimit të padive për shfuqizimin e akteve normative nënligjore, vepron si shkallë e parë dhe e vetme e gjykimit në fakt. [...]. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ishte i formës së prerë, pasi vendimet përfundimtare të gjykatës së apelit janë të formës së prerë menjëherë sapo jepen. Pikërisht për këtë arsye në nenet 449 e 479 të KPC është parashikuar instituti i pezullimit të ekzekutimit të vendimit të rekursuar, ç'ka do të thotë se vendimi që rekursohet, është i formës së prerë dhe vetëm Gjykata e Lartë mund ta pezullojë atë. Vendimi i gjykatës së Apelit Administrativ është menjëherë i ekzekutueshëm sapo jepet nga kjo gjykatë dhe sipas ligjit të kohës ekzekutueshmëria e tij nuk varej nga gjykimi në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit është vetëm gjykatë ligji dhe konform nenit 479 të KPC ka vetëm tagër për pezullimin e vendimit të ekzekutueshëm të gjykatave të faktit (në këtë rast Gjykatës Administrative të Apelit). Në këtë linjë duhet kuptuar edhe parashikimi i nenit 451(ç) të KPC, i cili do parë gjithnjë i lidhur ngushtë me nenet 449 e 479 të këtij Kodi, për të nxjerrë në pah natyrën e vendimeve të gjykatës së apelit, kur kjo e fundit vepron si shkallë e parë gjyqësore (*përveç kur ka parashikim të kundërt ligji*). Në këtë rast, vendimi i gjykatës së apelit, është menjëherë i ekzekutueshëm, d.m.th është i formës së prerë sapo jepet dhe rekursi që paraqesin palët ndaj tij, nuk e heq ipso lege fuqinë ekzekutive. Kjo pasi, Gjykata e Lartë nuk është shkallë e dytë gjykimi, pasi nuk bën gjykim në fakt, por kufizohet vetëm në shkeljet e rëndësishme ligjore. Në këtë linjë kuptohet edhe parashikimi i nenit 28(4) të ligjit nr. 49/2012 [...] Është e kuptueshme që në Gjykatën e Lartë nuk mund të kërkohet sigurim padie, por vetëm pezullim ekzekutimi të vendimit të gjykatave më të ulta (kryesisht gjykatës së apelit), pasi në rastin e sigurimit të padisë gjykata do të duhej të vlerësonte faktin e çështjes, ç'ka del jashtë kompetencës funksionale të Gjykatës së Lartë si gjykatë ekskluzivisht ligji.

Siç u theksua edhe më lart, në momentin e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe mbi bazën e rekursit të paraqitur nga palët e paditura dhe Avokatura e Shtetit, rezulton se nga gjykata e faktit ka përfunduar shqyrtimin e themelit të çështjes për padinë e ngritur nga pala paditëse Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privat. Konkretisht, me vendimin nr. 211 datë 17.12.2018 të Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur "*Rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligj e prova. Heqjen e masës së sigurimit të padisë të caktuar me vendimin e ndërmjetëm të datës 26.09.2018*".

Kolegji [...] konstaton se vendimi objekt rekursi nr. 363 akti, datë 26.09.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit ka rënë nga fuqia, pasi kjo gjykatë e ka hequr këtë masë që më datë 17.12.2018 nëpërmjet vendimit nr. 211, datë 17.12.2018 dhe duke qenë

se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë, shqyrtimi në Gjykatën e Lartë i rekurseve ndaj vendimit për caktimin e masës së sigurimit, nuk mund të vazhdojë më. Për rrjedhojë, duhet të priset vendimi nr.363 akti, datë: 26.09.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit dhe të pushohet gjykimi i çështjes.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL Nr.00-2022-635, datë 01.04.2022

V. Pavlefshmëri akti administrativ

KAGJL Vendim Nr.00 – 2022 – 590 (81), datë 25.02.2022 (AMPT)

AMTP dhënë në emër të një personi i cili nuk është anëtar i familjeve të ish-kooperativës bujqësore dhe nuk figuronte banor i fshatit në 01.08.1991, është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, që nuk ka sjellë dhe as mund të sjellë ndonjë pasojë juridike.

Fjalë kyçe: Anëtar familjeve të ish-kooperativës bujqësore, Aktin të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), Agjencia Shtetërore Kadastrës (ASHK), akt administrativ absolutisht i pavlefshëm

Rrethanat e çështjes:

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se pala e paditur L.L me Aktin të Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim AMTP) nr. 74, datë 20.01.1994 ka marrë në pronësi sipërfaqe toke prej 10.400 m² të ndodhura në fshatin Suç (Mat).

Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, kryesisht, ka bërë verifikimin e titullit të pronësisë të lartpërmendur, në emër të familjes bujqësore të të paditurit L.L. dhe ka vlerësuar se atij i ishte dhënë tokë në pronësi në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 [...]. Sipas Komisionit ka rezultuar se i padituri i nuk kishte qenë banor i fshatit Suç, në datën 01.08.1991. Këtë konkluzion Komisioni e ka mbështetur në shkresën [...] të lëshuar nga Komuna Suç. [...]dhe ka marrë vendimin nr. 46, datë 08.11.2010, ku në përfundim të tij ka vendosur: “Për pavlefshmërinë ligjore dhe shfuqizimin e plotë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMPT) [...] në emër të familjes bujqësore të përfaqësuar nga L.L”.

Në këto kushte, Prefektit të Qarkut Dibër, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së plotë të AMTP nr. 74 Regj, datë 20.01.1994.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur rrëzimin e padisë së si të pabazuar në ligj e në prova, vendim që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Mbi rekursin e palës paditëse Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.143, datë 21.03.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit e dy vendimeve të gjykatave më të ulta dhe pranimin e padisë, duke konstatuar

pavlefshmërinë absolute të AMTP.

Në këtë vendim, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatave janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, pasi nga aktet e administruara në dosje rezulton se paditësi nuk plotëson një prej kriterëve të përcaktuara në ligj, pasi në momentin e ndarjes së tokave nga Komisioni i Ndarjes së Tokës nuk ka qenë me banim në fshatin ku ka përfituar tokën bujqësore dhe as anëtar i kooperativës bujqësore përkatëse. Sipas ligjit [...] të drejtën për të marrë në pronësi tokë bujqësore e kishin vetëm anëtarët e familjeve të ish-kooperativës bujqësore, të cilët ishin banor të fshatit përkatës me datën 01.08.1991, prandaj AMTP-ja e dalë në emër të të paditurit, është një akt administrativ në kundërshtim flagrant me ligjin [...] (nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike).

Mbi kërkesën e L.L, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.10, datë 03.04.2018 ka vendosur pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2017-143, datë 21.03.2017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se Kolegji ka tejkaluar kompetencat ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese çmon se [...] Kolegji Administrativ nuk mund të bëjë vlerësim të ndryshëm për të njëjtat fakte nga ato që kanë bërë dy gjykatat më të ulëta, pasi kjo gjë nuk është në përputhje me juridiksionin e asaj gjykate. Gjykata është shprehur se nxjerrja e një konkluzioni të kundërt nga ana e Gjykatës së Lartë lidhur me provat e marra gjatë gjykimit në dy gjykatat e shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit të saj. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse ajo vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo nëse çmon se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. [...] Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta.

Arsyetimi i Gjykatës (Kolegjit):

Kolegji pa i hyrë analizës së provave, nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore dhe pretendimeve të parashtruara në rekurs duhet të evidentojë nëse nga gjykatat e faktit janë lejuar ose jo shkelje të normave procedurale dhe nëse ligji material është respektuar drejtë ose jo. Në varësi të zgjidhjes së këtyre çështjeve nga gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë, në realizim të funksionit të saj rishikues, shprehet për bazueshmërinë ose jo në ligj të vendimeve të gjykatave të faktit. [...] Gjykata e Lartë ka kompetencë të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin mund të jetë bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj

duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimiara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta.

Kolegji në vlerësim të natyrës juridike të mosmarrëveshjes, shkakut të lindjes së saj, akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore e të administruara gjatë gjykimit, objektit dhe shkakut ligjor të padisë, pretendimeve e prapësimeve të palëve, të vendimeve të gjykatave të faktit, shkaqeve të rekursit, vlerëson se, arsyetimi dhe përfundimi që ka arritur Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka qenë kompetente në kohën e shqyrtimit të kësaj çështje, është rrjedhojë e mosrespektimit dhe e moszbatimit të drejtë të ligjit material.

Mbështetur mbi të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Apelit Tiranë, Kolegji vlerëson se në rastin objekt gjykimi është bërë një interpretim i gabuar i ligji. Mbi të njëjtat rrethana të faktit vlerësohet se çështja nuk është zgjidhur në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale në zbatim. Gjykatat e kanë pranuar dhe evidentuar faktin se në momentin e ndarjes së tokave nga komisioni i ndarjes së tokës, pala e paditur nuk ka qenë me banim në fshatin ku ka përfutur tokën bujqësore dhe as anëtar i kooperativës bujqësore përkatëse.

Kolegji thekson të nevojshme të evidentojë edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese ...dhe duke marrë në vlerësim të njëjtin fakt dhe rrethanë që provohet dhe pranohet nga gjykatat e faktit, dhe pa bërë asnjë rivlerësim të ndryshëm të të njëjtit fakt, Kolegji çmon se sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, të drejtën për të marrë në pronësi tokë bujqësore e kishin vetëm anëtarët e familjeve të ish-kooperativës bujqësore, të cilët ishin banor të fshatit përkatës, me datën 01.08.1991. Në këto kushte AMTP-ja e dalë në emër të të paditurit L.L, i cili nuk figuronte banor i fshatit në atë periudhë, është një akt administrativ në kundërshtim flagrant me ligjin. Për rrjedhojë, ai konsiderohet si një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm që nuk ka sjellë dhe as mund të sjellë ndonjë pasojë juridike.

Mbi bazën e kësaj analize, Kolegji vlerëson se arsyetimi i përdorur nga gjykatat për zgjidhjen e çështjes është i gabuar. Përdërisa zbatimi i ligjit procedural apo material, për rastin në shqyrtim, nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo provave, por nga domosdoshmëria për interpretim të ndryshëm të ligjit mbi të njëjtin fakt, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet ndryshuar dhe çështja duhet të zgjidhet përfundimisht në themelin e saj, nga ky Kolegji.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL Nr.31003-00468-2015, datë 27.10.2020

KAGJL Vendim Nr.00-2023-2494 (175), datë 11.05.2023 (Mosmarrëveshje fushën tatimore)

Miratimi verbal në kuadër të procedurës së sekuestrimit të pajisjeve për shmangie të detyrimeve nga evazioni fiskal për sipas legjislacionit tatimor, nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ. Në rastet e sigurimit të padisë, gjykata nuk mund të ndalojë paraprakisht organi tatimor që të ushtrojë kompetencat e veta për vlerësimin nëse ka apo jo shkelje tatimore, duke i “ngrirë” burimin e provës, nëse

nuk ndodhemi para rasteve të dukshme të pavlefshmërisë absolute.

Fjalë kyçe: akt administrativ, pavlefshmëri absolute, sekuestro pajisesh, lëshim fature jo tatimore, evazion fiskal, miratim verbal, sigurim padie

Rrethanat e çështjes:

Paditësi, shoqëria “Birra Korça” Shpk [...] ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit të pijeve alkoolike dhe të ujit të pijshëm. Pranë fabrikës së prodhimit [...] në qytetin e Korçës, shoqëria ushtron aktivitet edhe në njësi shërbimi, birrari, ambient ku rezultoi të jetë ushtruar kontroll me datë 17.09.2014 nga inspektorët e Sektorit të Zbatimit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, strukturë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (këtu e në vijim DPT).

Në vijim të kontrollit, është paraqitur edhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë ku është bërë me dije nga inspektorët për vlerësimin e tyre se shoqëria përveç printerit fiskal përdorte edhe dy printera jo fiskale, dhe se kanë konstatuar lidhjen e tyre me dy njësi qendrore. Nga ana e inspektorëve janë përpiluar aktet e konstatimit me nr. serial 0383704, 0383705 dhe 0383706 ku [...] është konstatuar se dy kompjuterët ishin të lidhur në rrjet me zyrën qendrore në të cilën ishte instaluar serveri. [...] sipas vlerësimit të inspektorëve dy printerët e gjetura në ambientet e njësisë së shërbimit nxirrnin fatura jo tatimore dhe se lidhja e tyre në rrjet të brendshëm me serverin në zyrën qendrore të shoqërisë krijon dyshime se shoqëria kryen fshehje të të ardhurave. Mbi këtë bazë, inspektorët kanë proceduar me sekuestrimin e pajisjeve.

[...] rezultoi dërgimi pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (këtu e në vijim DTM) për veprime të mëtejshme i informacionit sipas dokumentimit të tij nga punonjësit e Drejtorisë së Hetimit të DPT, përkatësisht aktet e konstatimit të mbajtura si dhe faturat cilësuar jo tatimore duke përfunduar së është në pritje nga ana e kësaj drejtorie rajonale të ngritjes së grupit të verifikimit dhe dorëzimit të pajisjeve të sekuestruara. Sipas urdhrit [...] urdhërohet ngritja e grupit të verifikimit me punonjës të DTM, procedurë e cila rezultoi e kryer më datë 22.09.2014 sipas procesverbalit nr.1, datë 22.09.2014.

[...] shoqëria ka kërkuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar çdo veprim dhe akt tjetër administrativ në vijim të veprimit administrativ, sekuestrim i 2 (dy) njësi qendrore, i 1 (një) serveri dhe 2 (dy) printer, fiksuar në akt konstatimet nr.0383704, nr.0383705 dhe nr.0383706 datë 17.09.2014 të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, pranë DPT. Kërkesa është paraqitur nga shoqëria para ngritjes së padisë objekt gjykimi për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ të sekuestrimit nga ana e Drejtorisë së Hetimit [...] Kërkesa është pranuar me vendimin e datës 03.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendim i lënë në fuqi me vendimin nr. 9, datë 12.02.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Po në datën e dhënies së vendimit për sigurimin e padisë datë 03.10.2014, rezultoi të jetë nxjerrë shkresa nr.25170/1 prot., për njoftimin e shoqërisë paditëse për raport

verifikimin e përmbajtjes së pajisjeve kompjuterike të sekuestruara të datës 29.09.2014, marrë njoftimi nga shoqëria më datë 06.10.2014. Sa më sipër, në datë 12.10.2014, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ sekuestrim pajisjesh.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesë padisë. [...] Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58(a)(c), të ligjit nr. 49/2012 [...] të cilat bëjnë të cenueshëm vendimin nr. 1064, datë 09.05.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit. [...]

Kolegji thekson paraprakisht se kompetenca funksionale e Gjykatës së Lartë shtrihet vetëm në vlerësimin e zgjidhjes së drejtë ligjore të çështjes nga gjykatat më të ulta (çështje ligji), pa u shtrirë në vlerësimin dhe vërtetimin e fakteve prej tyre (çështje fakti). Pra, çështjet e ligjit hyjnë në kompetencën rishikuese të Gjykatës së Lartë, ndërsa çështjet e faktit jo. Mirëpo, natyrshëm shtrohet pyetja, çfarë janë çështjet e ligjit, e çfarë janë ato të faktit dhe si bëhet dallimi midis tyre? Në lidhje me këtë, Kolegji vlerëson se çështje fakti janë ato që lidhen me ekzistencën apo jo të një sjellje të njeriut, ngjarje shoqërore apo fenomeni natyror, ndërsa çështje ligji janë vlerësimet apo përfundimet në të cilat arrin gjykata në lidhje me pasojat juridike që rrjedhin nga vërtetimi apo jo i fakteve të caktuara. Ka ndodhur apo jo një fakt i caktuar është çështje fakti që i përket gjykatave të faktit për ta përcaktuar, ndërsa pasojat ligjore të ndodhjes apo jo të një fakti të caktuar janë çështje ligji, për të cilën Gjykata e Lartë ka kompetencë të plotë ligjore dhe kushtetuese, të thotë fjalën e fundit.

Në çështjen objekt gjykimi, gjykatat e faktit kanë shqyrtuar një padi që lidhet me konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve të caktuara administrative dhe ato kanë arsyetuar vetëm në drejtim të pavlefshmërisë absolute të këtyre veprimeve, duke arritur në përfundimin se ndodheshin para rastit të pavlefshmërisë absolute. Kolegji e çmon të nevojshme të theksojë se në rastet kur kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ gjykatat duhet të hetojnë e gjykojnë vetëm ekzistencën e shkaqeve ligjore që i përkasin këtij lloji kërkimi, të cilat janë të parashikuara në nenet 115(a), 116 dhe 117 të KPA (ligji i kohës nr. 8485, datë: 12.05.1999 [...])

Nenet 116 e 117 të KPA nuk mund të kuptohen drejtë, nëse nuk lexohen në dritën e nenit 115(a) të këtij Kodi [...]. Kjo dispozitë nxjerr në pah dallimin thelbësor midis pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative të akteve administrative, ku në të parën akti është nxjerrë në kundërshtim flagrant ose të hapur me ligjin, ndërsa në të dytin akti nxirret në kundërshtim jo të hapur me ligjin. Pra dallimi lidhet, me qenien e shkeljes ligjore flagrante apo jo. Kjo pasi, jo çdo shkelje materiale apo procedurale e ligjit në veprimtarinë administrative, passjell pavlefshmërinë absolute të akteve administrative. Nëse neni 116(c) i KPA shihet i shkëputur nga neni 115(a) i këtij Kodi, atëherë mund të arrihet në përfundimin e gabuar se çdo shkelje e formës apo procedurës që kërkon ligji

për nxjerrjen e një akti administrativ, do të pas sillte pavlefshmëri absolute të tij. Po çfarë kuptohet me shkelje flagrante të ligjit? Përgjigja për këtë jepet nga natyra e shkeljeve të përcaktuara nga neni 116 i KPA, ku rastet e përfshira në të, duhen parë së bashku, duke nxjerrë në pah cilësinë e përbashkët që i karakterizon. Kur një akt administrativ nxirret nga një organ administrativ i paidentifikuar, ky fakt mund të konstatohet dukshëm dhe lehtësisht nga kushdo që bie në kontakt me këtë lloj akti. Pikërisht, cilësia dhe natyra e veprimtarisë konstatuese nga kushdo në mënyrë të dukshme (*apo të hapur*) dhe të lehtë të një të mete thelbësore të aktit administrativ (*siç është identifikueshmëria e organit administrativ, kompetenca ligjore e organit administrativ për nxjerrjen e aktit administrativ, apo respektimi i formës dhe procedurës së kërkuar nga ligji për nxjerrjen e një akti administrativ*), futet në sferën e pavlefshmërisë absolute të këtij akti. Ndërsa çdo e metë tjetër e aktit që nuk mund të konstatohet që me shikim të parë, por për të cilën nevojitet hetim më i thelluar dhe vlerësim i fakteve që kanë çuar në nxjerrjen e aktit administrativ, përfshihet potencialisht në sferën e pavlefshmërisë relative të aktit administrativ. Për këtë të fundit veprojnë kufizimet ligjore të shterimit të rrugës së ankimit administrativ dhe afateve për paraqitjen e pretendimeve për pavlefshmëri, të cilat mund të kufizojnë proporcionalisht qasjen e palës në gjykatë, nëse nuk përmbush kushtet formale të sipërcituara.

Në lidhje me sa më sipër, në kuptim të ligjit, Kolegji vlerëson se jo çdo shkelje e procedurës administrative mund të sjellë edhe nulitetin e aktit të prodhuar. Doktrina ka pranuar se si kriter kryesor për të dalluar pavlefshmërinë absolute nga paligjshmëria është shkalla e shkeljes së ligjit, rrezikshmëria e aktit të shkelur, shkalla e mundësisë së eliminimit të shkeljes nga vet organi që ka nxjerrë aktin, etj. Pavlefshmëria absolute e një akti administrativ është forma më e rëndë e pavlefshmërisë së aktit. Në kuptimin e së drejtës, akte administrative absolutisht të pavlefshme janë ato akte, të cilat për shkak të shkeljes thelbësore të ligjeve mbi bazën e të cilave janë nxjerrë, nuk kanë fuqinë e një akti administrativ të vlefshëm dhe objektivisht nuk konsiderohen që të kenë ekzistuar në asnjë çast. Një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, që nga momenti i nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike për të cilat ai është nxjerrë. Një akt absolutisht i pavlefshëm nuk është akt, ai është një nulitet i plotë, i cili konsiderohet se nuk ka hyrë në fuqi asnjëherë. Për shkak të shkeljes së rëndë thelbësore të ligjit, pavlefshmëria absolute e një akti nuk mund të rregullohet në të ardhmen, as nga palët dhe as nga organi që ka lëshuar aktin, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tillë, ai nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve, të cilëve iu kundërdrejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore. (*Shih çështjen me Nr. 00-2022- 1803 i Vendimi (286), datë 18.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

Kolegji çmon se shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, por jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën mund të shpjen detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit (absolute apo relative). Gjykatat kanë detyrimin të arsyetojnë në këtë drejtim. Mosrespektimi i këtyre elementëve duhet të jetë i atij karakteri dhe asaj rëndësie që të ketë ndikuar drejtpërdrejt në nxjerrjen e aktit

administrativ. Një shkelje e parëndësishme e procedurës apo formës së aktit nuk mund të shkaktojë pavlefshmëri të aktit. Natyra e shkeljes vlerësohet nga vetë organi/gjykata që shqyrton pavlefshmërinë e aktit. Si rregull i përgjithshëm, një akt administrativ nuk është i papranueshëm për mosrespektim të një kërkesë formale ose procedurale, në rast se një shkelje e tillë nuk do të jepte ndonjë ndryshim substancial në vendim (*shih nenin 40(4) të ligjit nr.49/2012*). Por, një mosrespektim i tillë është i papranueshëm, nëse shkelja e kryer çon drejt nulitetit të aktit ose paligjshmërisë së saj. Të gjitha këto elementë do duhet të shqyrtohen nga organi procedues rast pas rasti për të vlerësuar nëse shkelje të kësaj natyre janë të tilla sa të ndikojnë në ligjshmërinë/vlefshmërinë e aktit administrativ duke marrë në vlerësim së pari sa ka ndikuar shkelja në dhënien e vendimit nga ana e organit dhe së dyti nëse pavarësisht shkeljes, akti do mund të përbënte një titull të ekzekutueshëm.

Referuar rastit objekt gjykimi, në nenin 127(3) të ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 10209, datë 23.12.2009[...] ky parashikim ligjor që i njeh të drejtën të paditurve që të sekuestrojnë pajisjet ku ndodhen gjurmë të veprimtarisë së paligjshme, detajohet në aktin nënligjor Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” (*pika 127.3*). Pala e paditur ka vepruar me sekuestrimin e pajisjeve, pasi punonjësit e saj kanë konstatuar në flagrancë lëshimin e faturave jo tatimore nga paditësi. Më tej, akti tjetër nënligjor, Udhëzuesi nr. 19723 prot., datë 17.07.2014, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve [...]

Kolegji konstaton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë një vendim për sigurim padie, duke penguar administratën tatimore që të ushtrojë kompetencat e veta ligjore, për dokumentimin e mëtejshëm të shkeljes tatimore të dyshuar. Kjo qasje dhe vendimmarrje e gjykatës së shkallës së parë është në shkelje të rëndë të ligjit, pasi nuk ka mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret sipas nenit 28 të ligjit nr.49/2012 dhe ka paragjykuar çështjen. Po ashtu, duke penguar administratën tatimore që të hetojë sendet e sekuestruara pranë paditësit, gjykata ka cenuar rëndë interesin publik (*neni 29(b) i ligjit nr.49/2012*) që lidhet me nevojën që organet tatimore të gjurmojnë, hetojnë dhe ndëshkojnë shkeljet në fushën tatimore, sidomos kur i konstatojnë ato në kryerje e sipër të veprimtarisë së tyre zyrtare. Praktikisht duke pezulluar çdo veprim dhe akt tjetër administrativ në vijim të veprimit administrativ të sekuestrimit të 2 njësisve qendrore, 1 server dhe 2 printera, gjykata ka pamundësuar shqyrtimin në themel nga administrata tatimore të shkeljes tatimore, çka përbën vendimmarrje në shkelje të rëndë të normave procedurale. Nuk mund të ndalohej paraprakisht organi tatimor që të ushtrojë kompetencat e veta për vlerësimin nëse ka apo jo shkelje tatimore, duke i “ngrirë” burimin e provës, nëse nuk ndodhemi para rasteve të dukshme të pavlefshmërisë absolute. Kjo vendimmarrje ka ndikuar edhe në zgjidhjen e mëpasme në themel të çështjes nga gjykata, e cila edhe ajo është marrë në shkelje të normave procedurale që lidhen me vlerësimin ligjor të provave (siç do arsyetohet më poshtë).

Sa i përket zgjidhjes së çështjes në themel gjykata e shkallës së parë ka argumentuar mbi bazë pavlefshmërie absolute veprimtarinë paraprake administrative hetimore në lidhje me sekuestrimin e pajisjeve sipas akt konstatimeve [...]. Kolegji konstaton se

shkaqeve që i janë referuar gjykatat më të ulta për të konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të të paditurve, nuk janë të tilla që të justifikojnë këtë përfundim, bazuar në kriteret e sipërcituara të ligjit. Të paditurit kanë vepruar konform kompetencës që i jep ligji, e konkretisht neni 127(3) i ligjit nr. 9920/2008 [...]. Shkeljet procedurale, nëse kanë qenë të tilla, i referohen procedurave të brendshme të palës së paditur, të detajuara me aktin nënligjor udhëzuesin e dalë në zbatim të ligjit, e nuk janë të tilla që të kenë shkelur ndonjë normë urdhëruese ligjore. Gjykatat nuk kanë mbajtur parasysht në zgjidhjen e çështjes dhe nuk kanë arsyetuar në lidhje me parashikimet e nenit 40(4) të ligjit nr.49/2012, pasi asnjë nga shkeljet e argumentuara prej tyre nuk shpiten në pavlefshmëri absolute të akteve përkatëse, për sa kohë që punonjësit tatimorë kanë konstatuar veprimtari të paligjshme tatimore në kushtet e flagrancës dhe kanë vepruar në zbatim të nenit 127(3) të ligjit nr.9920/2008.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, sikurse edhe Gjykata Administrative e Apelit kanë përkrahur argumentin dhe e kanë bërë atë pjesë thelbësore të vendimmarrjes së tyre, se nuk u provua që Drejtori kompetent të ketë dhënë miratim (*procedurë e brendshme e palës së paditur kjo*), jo vetëm me shkrim, por as verbal, ndonëse organi tatimor ka provuar komunikimin me telefon me Drejtorin përkatës. Në akt-konstatimin [...] inspektorët nuk kanë bërë shënimin e dhënies së një miratimi të tillë, qoftë ky edhe verbal nga Drejtori kompetent. Kolegji vlerëson se përfundimi ligjor i nxjerrë nga gjykatat më të ulta, mbi faktet e mësipërme është i gabuar dhe nuk mund të passjellë kurrësi pavlefshmërinë absolute të akteve dhe veprimeve administrative objekt gjykimi. Kolegji çmon se standardi i provueshmërisë i kërkuar nga gjykatat e faktit mbi miratimin verbal të Drejtorit kompetent në DPT në lidhje me veprimtarinë sekuestruese të inspektorëve të kësaj drejtorie, ka cenuar veprimtarinë administrative të organit publik në kuadër të misionit të tij publik për hetimin dhe ndjekjen e shkeljeve tatimore në fushën fiskale. Parashikimi nënligjor në udhëzuesin nr. 19723 prot., datë 17.07.2014 të DPT, në pikën 2.2 të tij, ka për qëllim garantimin e parimit të deburokratizimit dhe efijensës, parim themelor i procedurave administrative trupëzuar edhe në KPA. Në kushtet ku organit publik i është dhënë mundësia e miratimit verbal për vijimin e një procedure paraprake në funksion të hetimit administrativ për shmangie nga detyrimet tatimore dhe siç kanë konstatuar gjykatat më të ulta sekuestrimi është kryer, punonjësit sekuestrues kanë kontaktuar me DPT dhe procedura ka vijuar rregullisht deri në momentin e sigurimit të padisë nga gjykata administrative e shkallës së parë, atëherë gjykatat më të ulta duhej të arsyetonin në lidhje me prezumimin e faktit se miratimi ishte dhënë. Mungesa e miratimit nuk rezulton nga organi administrativ në këtë gjykim, e për më tepër konfirmohet veprimtaria administrative e sekuestrimit prej organit më të lartë epror (DPT). Gjykatat nuk mund të vendosin një standard të tillë provueshmërie të veprimtarisë së organit, pasi kjo çmohet si një “barrë e tepruar” në funksion të veprimtarisë së ligjshme të organit publik. Komunikimi verbal është i tillë që për sa kohë është provuar (siç kanë pranuar gjykatat më të ulta) me tabulate se ka ndodhur, prezumohet se ka qenë në përputhje dhe miratues për veprimtarinë administrative sekuestruese, e nuk ka nevojë të provohet edhe përmbajtja e komunikimit

verbal. Të kërkosh të kundërtën, do të thotë ta vësh organin administrativ në të vetmen pozitë procedurale, që ai e ka të pamundur ta provojë. Ky veprim është i panevojshëm për zgjidhjen e çështjes. Nëse gjykatat e faktit kishin dyshime për “miratimin verbal”, duhej të thërrisnin për të dëshmuar zyrtarin përkatës, por jo të konsideronin këtë fakt si shkak për pavlefshmëri absolute. Kjo veprimtari e gjykatave më të ulta, ka cenuar rëndë procesin e rregullt ligjor.

Gjykatat më të ulta kanë administruar si provë shkresën nr. 25120/1 prot., datë 03.10.2014 të DPT, e cila duhej të ishte mbajtur parasysh prej tyre, e të cilat duhej të arsyetonin në lidhje me pasojat ligjore që rrjedhin prej saj, [...] Me shkresën nr. 3798/2 prot., datë 18.09.2014 Drejtoria e Hetimit Tatimor ka njoftuar qëndrimin në pritje të DTM për ngritjen e grupit të verifikimit. Me shkresën nr. 14214/1 prot., datë 18.09.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj është urdhëruar ngritja e grupit të verifikimit të pajisjeve kompjuterike të sekuestruara në ambientet e shoqërisë së palës paditëse. Me shkresën nr. 14214/4 prot., datë 29.09.2014, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka dërguar raportin e verifikimit të përmbajtjes së pajisjeve kompjuterike të sekuestruara të palës paditëse, ku në përfundim grupi i verifikimit ka arritur në konkluzionin për shmangie të detyrimeve nga evazioni fiskal (*të gjitha këto veprime konfirmuese të sekuestrimit*). Nëse nuk do të kishte pasur miratim për sekuestrimin, aktet e mësipërme administrative nuk do të kishin përmbajtjen që kanë dhe veprimtaria administrative nuk do të kishte vijuar normalisht. Gjykatat më të ulta nuk i kanë mbajtur parasysh këto elementë dhe kanë gjetur pavlefshmëri absolute aty ku nuk ka, duke arritur në përfundime ligjore të paqena. Po ashtu edhe argumenti i gjykatave më të ulta se mungonte procesverbali i sekuestrimit, nuk është bindës në lidhje me argumentimin e shkëljes së tillë që të passjellë pavlefshmëri absolute të procedurës, për sa kohë që të dhënat e nevojshme gjenden në aktet e konstatimit objekt gjykimi. Gjykatat nuk kanë argumentuar se në çfarë forme kjo “mangësi” ka vesuar rëndë veprimtarinë administrative objekt gjykimi, sidomos në kushtet e parashikimeve të nenit 37(1) i ligjit nr.49/2012 [...]

Ndaj, nisur nga aktet shkresore si më sipër të cilat datojnë pas akt konstatimeve objekt gjykimi, si dhe qëndrimin të organit publik në gjykim dhe në aktin e rekursit, Kolegji konstaton se vlerësimi ligjor i çështjes nga ana e gjykatave më të ulta ka qenë i gabuar. Ato kanë konstatuar pavlefshmëri absolute, kur në fakt nuk ka një të tillë. Po ashtu të metat procedurale të konstatuara prej gjykatave më të ulta, duhej të ishin analizuar në përputhje me nenin 40(4) të ligjit nr.49/2012, pasi nëse gjykatat kishin dyshim për dhënie miratimi nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor për sekuestrim, mund të kërkonin dëgjimin e dëshmitarëve përkatës. Për rrjedhojë konstatohet interpretim i gabuar i ligjit material dhe procedural i cili dukshëm ka ndikuar në dhënien e vendimit përfundimtar pasi nuk mund të shtrohet për diskutim pavlefshmëria absolute e veprimtarisë administrative bazuar në po ato fakte që janë konstatuar prej gjykatave më të ulta. Kolegji sjell në vëmendje se organet publike kanë detyrimin të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe përgjegjësisë. Megjithatë, në rastin konkret nuk jemi para rastit kur për shkak të

shkeljeve në mënyrë flagrante të procedurës apo formës së nxjerrjes së aktit ky i fundit do të quhej nul ose absolutisht të pavlefshëm.

Kolegji vlerëson se për shkak se gjykatat më të ulta e kanë bazuar zgjidhjen e çështjes vetëm në argumentet e pavlefshmërisë absolute, çka nuk rezultoi të jetë e mbështetur në ligj, çështja duhet të kthehet për rigjykim dhe rivlerësim pranë Gjykatës Administrative të Apelit e cila duke interpretuar në harmoni të gjitha faktet dhe provat e administruara në dosje, konform edhe parashikimeve të nenit 40 të ligjit nr. 49/2012, ka detyrimin që pas kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm (ku mund të marrë edhe dëshmi, nëse e vlerëson të nevojshme), të respektojë ligjin material të zbatueshëm dhe të zgjidhë drejtë çështjen, bazuar edhe në konstatimet e mësipërme ligjore të Kolegjit [...].

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL Nr.00-2023-53(7), datë 19.01.2023

KAGJL Vendim Nr.00-2023-2210(195), datë 01.06.2023 (Arkëtim shuma monetare: gjetje audit)

Punëdhënësi ka detyrimin që ndaj punonjësve apo ish punonjësve, kur konstaton se ekzistojnë detyrime financiar ndaj saj, duhet ti drejtohet gjykatës për të provuar këtë detyrim dhe jo të veprojë në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare.

Fjalë kyçe: akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, akt shkresor, pasojë juridike, interes i ligjshëm

Rrethanat e çështjes:

[...] rezultoi se pala paditëse A.F. [...] konform dhe në zbatim të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ka përfutur pagesë papunësie për bashkëshorten e tij, e cila ka humbur punën e saj si rezultat i zhvendosjes me banim familjarisht për shkak të transferimit të paditësit. Nga një kontroll i ushtruar pranë D.P. Policisë nga auditi i brendshëm i D.P. Policisë janë gjetur me shkelje disa përfitime mes të cilave dhe ai i bashkëshortes së paditësit. Mbi bazën e raportit të auditit nga ana e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit i është njoftuar paditësit akti nr. 630/13 datë 27.05.2014 “Njoftim mbi arkëtim të detyrimit”. Në këto kushte paditësi në datë 02.06.2014 i është drejtuar gjykatës, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar, se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe kërkon pranimin e padisë sipas objektit të saj.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë [...] Gjykata Administrative e Apelit [...] ka vendosur ndryshimin e vendimit [...] të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ urdhër zhdëmtimi [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] konstaton se nga vlerësimi në tërësi i shkaqeve të rekursit arrihet në

përfundimin se rekursi i palës së paditur [...] përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] Prandaj, vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të prishet dhe të lihet në fuqi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që ka rrëzuar padinë.

Kolegji, vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me të drejtë ka arsyetuar se akti shkresor objekti gjykimi “Njoftim mbi arkëtimin e një detyrimi” me nr. 630/13 prot., datë 27.05.2014 nuk është një akt absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 116 të KPA në fuqi në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes, pasi ka dal nga një organ publik i identifikuar (ish punëdhënësi), siç është pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me kompetencat e dhëna nga ligji, si dhe respektim të formës dhe procedurës. Pra, nuk plotësohen asnjë nga kriteret e kërkuar nga KPA për rastet e pavlefshmërisë absolute. Kjo shkresë madje nuk është as akt i mirëfilltë administrativ, pasi është thjesht një njoftim për punëmarrësin nga punëdhënësi, në lidhje me pagesa të pretenduara të marra më tepër nga punëmarrësi.

Pra Kolegji, ndryshe nga sa arsyeton Gjykata Administrative e Apelit, vlerëson se akti shkresor “Njoftim mbi arkëtimin e një detyrimi” me nr. 630/13 prot., datë 27.05.2014, nuk është një akt administrativ në kuptim të nenit 105 të KPA [...] Në interpretim të kësaj dispozite akti shkresor objekt gjykimi nuk krijon asnjë pasojë juridike për palën paditëse, pasi ai është një akt me karakter njoftimi/vënie në dijeni dhe nuk e kërcënon paditësin në cenimin e të drejtave apo mbajtjen e pagës, pasi nga njëra anë paditësi nuk është më punonjës pranë palës së paditur, por pranë SHKB dhe nuk ekziston asnjë rrezik potencial që ti mbahet paga në mënyrë të njëanshme, si dhe nga ana tjetër pala e paditur ka detyrimin që ndaj punonjësve apo ish punonjësve, kur konstaton se ekzistojnë detyrime financiar ndaj saj, duhet ti drejtohet gjykatës për të provuar këtë detyrime dhe jo të veprojë në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare. Konform nenit 117 të KP punëdhënësi nuk mund të bëjë asnjë zbritje nga paga që nuk parashikohet shprehimisht në këtë dispozitë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të punëmarrësit.

Kolegji thekson se palës paditëse, nuk i cenohet asnjë e drejtë nga akti shkresor objekti gjykimi dhe nuk gëzon interes të ligjshëm për të ngritur padinë. Kjo e drejtë është parashikuar qartë edhe në nenin 31 dhe 32 të KPC, nga ku rezulton se çdo subjekt ka të drejtën ti drejtohet gjykatës, e cila me pushtetin që ligji i ka dhënë, ka të drejtë të zgjidhë një konflikt apo situatë juridike të krijuar, për të cilën pala e interesuar ka një interes direkt të saj të cenuar dhe nëpërmjet këtij procesi synon përmbushjen e së drejtës së saj, e cila rezulton e pa përmbushur ose e cenuar. Pra, interesi i ligjshëm, si një nga elementet kryesore të padisë/kundërpadisë, nënkupton që ai të ekzistojë për paditësin në momentin e ngritjes së padisë. Interesi për të ngritur padi është një element shumë i rëndësishëm dhe konsiston në interesin për të marrë nga gjykata vendimin e kërkuar. Ky është një interes procedural i cili lind nga domosdoshmëria për të arritur nga procesi mbrojtjen e një interesi material dhe për këtë arsye pala i drejtohet gjykatës duke kërkuar njohjen e cenimit të një interesi dhe rivendosjen e së drejtës së shkelur. Interesi për të ngritur një padi është një element i së drejtës së padisë. Ai dallon nga interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme

dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Interesi për të ngritur padi është një interes procedural, dytësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt vendimin që i kërkohet gjykatës të japë si mjet për arritjen e përmbushjes së interesit material i cili është cenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër, ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në esencë, presupozon njohjen e cenimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. Nuk mund të merret në shqyrtim një padi kur në situatën faktike, aktuale, nuk njihet apo nuk evidentohet cenimi i një të drejte ose i një interesi që mund të pretendohet kundrejt palës tjetër.

Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin, se vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të prishet dhe të lihet në fuqi vendimi i Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë që ka rrëzuar padinë.

VI. Kontrata Publike

KAGJL Vendim Nr.00-2021-2049(260), datë 02.12.2021 (Dallimi: Kusht penal vlerësues-kusht penal gjodor)

Gjykata në interpretimin e natyrës juridike të kushti penal duhet të analizojë se cili ka qenë qëllimi që kanë pasur palët në çastin e hartimit të kontratës. Në rastin e parashikimit të një klauzole kontraktore (kushti penal gjodor), synimi është nxitja dhe disiplinimi i palëve për të përmbushur detyrimet e tyre kontraktore.

Fjalë kyçe: kusht penal vlerësues, kusht penal gjodor, parashkrimi

Rrethanat e çështjes:

[...] rezulton se pala paditëse e kundërpaditur Shoqëria Firma “VILA” sh.p.k është person juridik më [...] me objekt të veprimtarisë së saj: “Ndërtime civile e industriale turizmi dhe ndërtime rrugësh e urash projektive të ndryshme, prodhim transport e shitje të materialeve të ndërtimit., etj” [...]. Midis palëve ndërgjyqëse është lidhur një kontratë me Nr.. ref 463-13 sh-k/01.3 kab Kukës, datë 07.09.2007 me një vlerë totale 4.526.565 lekë. Kjo kontratë është lidhur si rrjedhojë e fitimit të një tenderi publik nga ana e palës paditëse të kundërpaditur, Firmës “Vila” sh.p.k. Objekti i kësaj kontrate ka qenë “Rikonstruksioni i rrjetit të tre kabinave në qytetin e Kukësit”. Afati i zbatimit të punimeve ka qenë 40 ditë kalendarike pas fillimit të punimeve, ndërsa si datë për fillimet e punimeve do të jetë 2 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës nga palët.

Pas përfundimit të punimeve nga pala paditëse e kundërpaditur sipas procedurave është kryer edhe marrja në dorëzim e objektit nga ana e investitorit, pra palës së paditur kundërpaditëse. Pas kësaj nga pala e paditur kundërpaditëse është lëshuar një vërtetim, ku vërtetohet se pala paditëse e kundërpaditur Firma “Vila” sh.p.k ka kryer punimet në afat dhe me cilësi. Sa sipër pala paditëse e kundërpaditur ka pretenduar se nga ana e

palës së paditur kundërpaditëse nuk është zbatuar detyrimi i saj për të kryer financimin e plotë të projektit të kontratës, dukë bërë vetëm një pagesë të pjesshme në datën 24.01.2008 në vlerën 3.270.000 lekë, duke lënë pa financuar vlerën 1.256.568 lekë. Në këto kushte pala paditëse e kundërpaditur i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar përmbushjen e detyrimit sipas kontratës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...] ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e palës së paditur kundërpaditëse CEZ Shpërndarje sha të përmbushë nenin 18 të kontratës [...] duke i paguar palës paditëse të kundërpadiditur Shoqërisë Firma "Vila" sh.p.k, vlerën e kushtit penal, në masën 3.214.478 lekë. Gjykata e Apelit Tiranë [...] ka vendosur moskompetencën e shqyrtimit të çështjes, dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës së Apelit Administrativ. Gjykata Administrative e Apelit, [...] ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...] në pjesën që ka të bëjë me padinë e paditësit [...] dhe pushimin e gjykimit të çështjes për padinë. Rrëzimin e kundërpadisë së palës së paditur CEZ Shpërndarje sha.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është prishur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për padinë dhe rrëzimin e kundërpadisë, është marrë pjesërisht në zbatim të gabuar të ligjit dhe për këtë shkak duhet të priset. Kolegji çmon se Gjykata Administrative e Apelit, ndonëse rrethanat e faktit i ka pranuar të provuara, sikurse edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e konsideron kushtin penal të parashikuar në kontratë, si kusht penal vlerësues dhe sipas saj, në aplikim të nenit 115/a të KC, padia është paraqitur tej afatit të parashkrimit. Qëndrimet e mbajtura nga Gjykata Administrative e Apelit janë rezultat i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit në çështjen objekt gjykimi, përse i përket instituteve të kushtit penal, parashkrimit dhe parimeve themelore të së drejtës civile në lidhje me këto institute; atyre që lidhen me vetë thelbin e kuptimitin e kushtit penal, dallimeve të tij në atë gjëbor e vlerësues, afateve të parashkrimit e ndërprerjes së tij.

Kolegji konstaton se Gjykata në themel të zgjidhjes së çështjes, ka arritur në një konkluzioni të gabuar që, kushti penal i parashikuar në kontratë është vlerësues dhe si i tillë i nënshtrohet afatit të parashkrimit. Parimet themelore të kushtit penal, parashikohen në nenet 541-545 të KC (Titulli III, Kreu II), si një nga mjetet e sigurimit për të garantuar ekzekutimin/përmbushjen e detyrimeve. Në vështrim të përmbajtjes së këtyre dispozitave, si dhe të neneve 115/a, 131 e 134 të KC, ky Kolegji, në argumentim të vendimit të tij, parashtron se: Pavarësisht se dallimi i llojeve të kushtit penal nuk jepet shprehimisht në ligj, por nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, parë në harmoni dhe me shkronjën a) të nenit 115 të KC, ai dallohet në kushtin penal gjëbor dhe atë vlerësues/çmues.

(a) Për rastet që kushti penal parashikohet për të riparuar pozitën pasurore të kreditorit dhe/ose nxitjen e debitorit për të përmbushur në rregull detyrimin, ai ka funksionin e një marrëveshje ndëshkimore-gjorbë (*stipulatio poenae*) dhe në këtë rast, debitori, krahas

ekzekutimit të detyrimit, duhet të paguajë kushtin penal, si dhe dëmet e shkaktuara kreditorit, duke u kërkuar këto në mënyrë kumulative (Neni 453/II Kodit Civil).

(b) Ndërsa kushti penal që fiksohet në kontratë, i përcaktuar sipas llogaritjeve paraprake të dëmit të mundshëm që mund të vijë nga mospërmbushja e detyrimit, apo mospërmbushja në mënyrën e duhur dhe i paracaktuar aproksimativisht në një masë të vlerësueshme, për aq sa mund të parashikohet (që me lidhjen e kontratës) masa e dëmit të mundshëm, quhet kusht penal vlerësues. Në thelb, kushti penal vlerësues përfaqësohet si një instrument teknik për llogaritjen që më parë të humbjeve që mund t'i vijnë kreditorit nga mos ekzekutimi i detyrimit dhe ka për qëllim, t'a shkarkojë palën nga barra e provës për masën e dëmit të pësuar. Kreditori, në këtë rast, ka të drejtë të kërkojë, në mënyrë alternative, ose shpërblimin e dëmit ose kushtin penal (përfshirë pjesën e dëmit që kalon kushtin penal) dhe jo të dyja së bashku (Neni 543/I KC).

I pari, kushti penal gjobor, nuk i nënshtrohet afatit të parashkrimit 6 mujor, ndërsa i dyti po. Kushti penal, i parashikuar në kontratën e lidhur midis palëve ndërgjyqëse, nuk është kusht penal vlerësues, por gjobor dhe me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë ka arritur në konkluzionin se, pala e paditur detyrohet të paguajë në favor të paditësit vlerën që përbëhet nga *“4/1000 të vlerës së papaguar për çdo ditë vonesë, sipas nenit 18 të kontratës”*. Në nenin 18 të kontratës së lidhur mes palëve ndërgjyqëse është parashikuar se *“Për çdo ditë vonesë përtej periudhës së kërkuar të përfundimit të punimeve, kundrejt kontraktuesit do të zbatohet një penalitet prej 4/1000 në ditë të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë, ky penalitet vlen për të dy palët”*.

Në vijim të arsyesimit të mësipërm Kolegji vlerëson se, në lidhje me interpretimin e natyrës juridike të kushti penal, duke qenë se kemi të bëjmë me një kusht kontraktor, të vendosur paraprakisht nga palët me vullnetin e tyre të lire, është e nevojshme që të analizohet se, cili ka qenë qëllimi që kanë pasur palët në çastin e hartimit të kontratës.

Nga mënyra e formulimit të nenit 18 të kontratës rezulton se: Synimi i palëve në momentin e lidhjes së kontratës ka qenë pikërisht, parashikimi i një klauzole kontraktore (kushti penal gjobor), i cili do të disiplinonte palët për të përmbushur detyrimet e tyre kontraktore. Qëllimi ka qenë pikërisht nxitja e palëve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Në konkluzion Kolegji vlerëson se vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në kushtet kur nuk e ka gjykuar çështjen në themel, por e ka pushuar padinë si të parashkruar, duhet të priset dhe të kthehet për rigjykim, duke mbajtur në konsideratë këtë përfundim të arritur.

Duke marrë në konsideratë vlerësimet e mësipërme, Kolegji konkludon se Gjykata Administrative të Apelit, si gjykata kompetente që do të merret me shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete mes palëve, me qëllim zgjidhjen e drejtë të këtij konflikti gjyqësor, në rigjykim duhet të kryejë *“një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin” (neni 14 i KPC)*; të kryejë një cilësim të saktë të fakteve dhe rrethanave në këtë mosmarrëveshje; tu jap përgjigje pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe të kryejë një analizë tërësore dhe objektive të provave *(neni 126 i KPC)*, për ta zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj *(neni 16 i KPC)*. Kolegji konstaton se përsa i përket

kundërpadisë me objekt “Konstatimin e pavlefshëm të nenit 18 (për pjesën ky penalitet vlen për të dy palët) i kontrates nr. ref 463-13 sh-k/01.3 kab Kukës datë 7.9.2007 lidhur midis palëve”, dhe përderisa nuk ka rekurs për mënyrën e disponimit nga gjykata për këtë pjesë të vendimit, e konsideron të pacenushëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në lidhje me disponimin e saj për rrëzimin e kundërpadisë.

Për sa u parashtrua më sipër, Kolegji Administrativ vlerëson se Gjykata e Apelit Administrativ duhet të konkludonte mbi zgjidhjen në themel të çështjes. Për rrjedhojë vendimi i kësaj gjykate duhet të priset dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim sërish në këtë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, vetëm përsa i përket mënyrës së disponimit mbi padinë.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës:

VII. Dëm Jashtëkontraktor

KAGJL Vendim nr.00-2023-3348(275), datë 26.07.2023 (Parashkrim padie)

Për shkak se përcaktimi i kohës së marrjes dijeni për faktin dhe personin/organin që ka shkaktuar dëmin, është një çështje e cila lidhet me dinamika të ndryshme, nuk mund të arrihet në një përfundim të unifikuar nëse në çdo rast duhet pritur përfundimi i hetimit/gjykimit penal, për të ngritur padi për shpërblim dëmi jashtëkontraktor ndaj organeve publike, në rastet kur për ngjarjen që ka shkaktuar dëmin civil janë çelur edhe hetime penale. Rast pas rasti, është detyrë e gjykatave të faktit të evidentojnë kohën e lindjes së të drejtës së padisë dhe përllogaritjes së afatit të parashkrimit.

Fjalë kyçe: dëm jashtëkontraktor, afat parashkrimi, organe të administratës publike, mosveprim titullar i të drejtës

Rrethanat e çështjes:

[...] Nga fashikulli i gjykimit rezulton se në datën 17.07.2010, rreth orës 16.00 është ngritur një postbllok nga Komisariati i Policisë Lezhë, pranë Urës së Cenit, me qëllim ndalimin dhe kontrollin e automjetit me targë TR-7870-R. Arsyeya e ngritjes së postbllokut ka qenë ndalimi i shtetasve, A.S. dhe F.N., të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja me armë në bashkëpunim”.

Në operacionin e datës 17.07.2010 kanë marrë pjesë oficerët e policisë gjyqësore, mes të cilëve edhe shtetasi S.S., me detyrë shëf i sektorit kundër akteve terroriste, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Lezhë, etj. Fillimisht automjeti me personat e dyshuar, me targë TR-7870-R, është identifikuar tek bar-kafe-Antika në superstradën Lezhë-Tiranë, [...] Në vijimësi automjeti [...], i drejtuar prej shtetasit A.S., brenda të cilit kanë qenë shtetasit F.N. në ndenjësën e parë dhe A.S. në ndenjësën e pasme, është nisur në drejtim të qytetit të Lezhës, ndërkohë, në momentin që shtetasi A.S., ka hyrë në Urën e Cenit me automjetin e tij, është përballur me postbllokun e ngritur nga policia. Në këtë moment ai

ka ndaluar automjetin dhe ka tentuar të ecë mbrapsht, por prapa automjetit të tij është ndaluar automjeti me të cilin ishin oficerët e policisë, të cilët kanë zbritur menjëherë nga automjeti dhe kanë dalë në të dy krahët e automjetit duke thirrur ‘*policia*’ dhe kanë tentuar të hapin derën e mjetit, por automjeti i ka pasur dyert në siguresë dhe nuk i janë hapur. Shtetasi A.S. nuk ju është bindur forcave të policisë dhe ka lëvizur me mjetin e tij sa para mbrapa duke goditur automjetin që ishte prapa dhe motoçikletën që ishin vendosur para. Nga intensiteti dhe dinamika e lëvizjes së mjetit të tij janë përplasur dhe punonjësit e policisë që kanë marrë pjesë në operacion dhe kanë pësuar dëmtime të lehta. Në momentin që shtetasi A.S. ka goditur automjetin me targë POLICIA 0271 dhe motoçikletën e policisë me targë POLICIA 101 dhe ka nisur largimin për në drejtim të rrugës kryesore që shkon në drejtim të qytetit të Shkodrës, në moment oficerët e policisë janë kthyer mbrapsht dhe janë futur në mjetin e tyre me qëllim vazhdimin e ndjekjes. Pikërisht në këtë moment këta kanë deklaruar se kanë dëgjuar të shtëna automatike dhe kur janë kthyer me drejtim nga mjeti i shtetasit A.S. kanë parë se xhami i pasëm ishte i thyer plotësisht dhe mjeti po lëvizte. Ata më pas kanë vazhduar ndjekjen bashkë me mjete të tjera të policisë dhe në fshatin Balldre në aksin rrugor në drejtim të Shkodrës është gjetur mjeti me targë TR-7870-R i braktisur, ku nga këqyrja e mjetit ka rezultuar se në ndenjësën e pasme është gjetur një person i vdekur, i cili pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se ishte i ndjeri A.S. i moshës 16 vjeç, njëkohësisht vëllai i shtetasit A.S.

Nga veprimet e kryera në vijimësi dhe administrimi i akteve përkatëse rezultoi se vdekja e tij ishte shkaktuar me armë zjarri, e ardhur si rezultat i goditjeve nga jashtëbrenda, dhe lidhur me autorin e vrasjes së shtetasit A.S., nga veprimet e kryera rezultoi se ajo është shkaktuar nga pakujdesia gjatë operacionit të datës 17.07.2010, dhe konkretisht nga oficeri i policisë që ka marrë pjesë në këtë operacion, shtetasi S.S., i cili në momentin që automjeti me targë TR-7870-R, i drejtuar prej shtetasit A.S. ka arritur të çajë postbllokun e policisë ai ka gjuajtur me breshëri automatike në drejtim të mjetit duke i shkaktuar vdekjen shtetasit A.S.

Lidhur me këtë ngjarje, me vendimin [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka deklaruar fajtor shtetasin S.S. për veprën penale të “vrasjes nga pakujdesia” dhe e ka dënuar atë me pesë vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër [...].

Pala paditëse, [...] i është drejtuar gjykatës (fillimisht asaj të Lezhës) duke pretenduar se vdekja e të ndjerit A.S. ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme dhe me faj të së paditurve, duke kërkuar prej palëve të paditura solidarisht, shpërblimin e dëmit nga vdekja e shkaktuar. Paditësit F.S dhe T.S. janë trashëgimtarë ligjorë të së ndjerit, djalit të tyre A.S. [...] dhe me padi drejtuar gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë kanë kërkuar shpërblimin për dëmin në shumën prej 30.000.000 lekësh për humbjen e jetës së viktimës në ngjarjen e datës 17.07.2010 në vendin e quajtur “Ura e Cenit” në Lezhë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë [...] ka vendosur pezullimin e gjykimit tëçështjes. [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, [...] ka vendosur: “Rifillimin e gjykimit të **çështjes së pezulluar civile me paditës** [...], të paditur Ministria e Punëve të

Brendshme, Drejtoria Vendore Policisë Lezhë dhe Skënder Seferi, me objekt shpërblim dëmi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin datë 08.02.2017 “Për veçimin e kërtimeve dhe shpalljen e moskompetencës lëndore” ka vendosur: Veçimin e kërkesës së paditësve [...] për pjesën që drejtohet ndaj Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, duke shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e këtyre kërtimeve dhe dërgimin akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Vazhdimin e gjykimit për pjesën e kërtimeve të drejtuar ndaj të paditurit S.S. [...] Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, [...] ka vendosur pranimin e kërkesë padisë. Detyrimin e të paditurve Ministria e Brendshme dhe Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, që solidarisht, të dëmshpërblejë paditësin [...], në shumën 15.000.000(pesëmbëdhjetë milion) lekë. Detyrimin e të paditurve [...] që solidarisht, të dëmshpërblejë paditësen [...] në shumën 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë. [...] Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit** [...] të Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] Për shkak të natyrës komplekse e çështjes në raport me shkaqet e parashtruara në rekurs nga pala e paditur, Kolegji ka çmuar se gjendemi në kushtet ku thirrja dhe dëgjimi i palëve ndërgjyqëse është i domosdoshëm për gjykimin e çështjes dhe në mbështetje të nenit 62 (c), të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, Kolegji vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Kolegji vlerëson se vendimarrja e gjykatave të faktit është e mbështetur në ligjin material dhe procedural, për rrjedhojë në mbështetje të nenit 63 (e), të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, vendimi nr. [...] i Gjykatës Administrative të Apelit, duhet të mbetet në fuqi.

Kolegji sjell në vëmendje se, për sa i përket aplikimit të kuadrit ligjor që rregullon aspektin material të të drejtës subjektive në gjykim, në rekursin e palëve të paditura nuk parashtrohen shkaqe në mbështetje të kërkesave të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se një ndër shkaqet e parashtruara në rekurs dhe gjatë gjykimit faktik të çështjes në të dyja shkallët e gjykimit është afati i parashkrimit për ngritjen e padisë së shpërblimit të dëmit. Nisur nga qëndrimet e gjykatave të faktit, qëndrimi i parashtruar nga palët në rekurs dhe gjatë gjykimit faktit të çështjes, Kolegji çmon se shtrohet për diskutim çështja se *nga cili moment nis afati i parashkrimit për padinë e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor drejtuar organeve të administratës publike.*

Neni 18, pika 4 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor paraqiten në gjykatë, sipas afateve të parashikuara në ligjin e posaçëm. Në nenin 17, të ligjit nr. 8510/1999, i ndryshuar parashikohet: “*Kërkimi i shpërblimit për demet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore parashkruhet brenda 3 vjetësh nga çasti kur i dëmtuari merr dijëni për demin dhe organin që e ka shkaktuar atë. Ne rastin kur dëmi shkaktohet nga ndryshimi i situatës, në vend të marrjes dijëni për demin, futet koncepti i marrjes dijëni për rrethanat, të cilat e kanë bërë situatën të kundërligjshme.*”

Në gjykimet me natyrë civile afati i parashkrimit të padisë gjenë rregullim të

posaçëm në nenin 115/dh të KC [...] Afati i parashkrimit në lidhje me këtë padi rregullohet nga neni 120 i këtij Kodi, i cili përcakton se për kërkimin e shpërblimit të dëmit jsthtëkontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar. Në nenin 112 të KC [...] Nga përkufizimi i dhënë në këtë dispozitë del në pah natyra juridike e institutit të parashkrimit, funksionet e tij, duke u dhënë në mënyrë sintetike karakteristikat e përgjithshme dhe kushtet thelbësore të parashkrimit shues.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite tregohet se parashkrimi i padisë përmban kurdoherë dy kushte ose elemente thelbësore: a) kalimin e një periudhe kohe të caktuar dhe b) mosveprimin e titullarit për të ushtruar këtë të drejtë gjatë kësaj kohe. Kushti i parë përbën atë që quhet afat i parashkrimit të padisë dhe kushti tjetër konsiston në mosveprimin e titullarit të së drejtës në rastet kur ai mund dhe duhej të vepronte.

Elementi thelbësor i parashkrimit nuk është kalimi i kohës në vetvete, por është mosveprimi/pasiviteti i titullarit të së drejtës për të mbrojtur, brenda kohës së caktuar nga ligji, të drejtën e tij të cenuar ose të mohuar. Për nga karakteri, parashkrimi i shtrin efektet e veta kryesisht në një marrëdhënie juridike dypalëshe relative, ku në fakt një subjekt mund të favorizohet duke mos u detyruar forcërisht të përmbushë atë. Instituti i parashkrimit është vendosur në favor të debitorit, për ta mbrojtur atë nga paditë e vjetra dhe vështirësitë e të provuarit.

Sipas nenit 117 të po këtij Kodi, afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë. Nga momenti i lindjes të së drejtës fillon të ecë afati i parashkrimit. Pra, ky është momenti nga i cili fillon të llogaritet ky afat, llogaritje që bëhet sipas nenit 136 të KC. Momenti i lindjes të së drejtës së padisë përcaktohet si momenti i fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit, pasi vetëm me lindjen e kësaj të drejte mund të flitet për mosveprim të titullarit dhe vetëm kur cenohet e drejta subjektive lind e drejta e padisë për mbrojtjen e saj. (*shih vendimin nr. 273 datë 28.05.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Ligji nr. 49/2012 parashikon se afatet e parashkrimit të padisë janë të prera dhe shkelja e tyre shkaktonte humbjen e së drejtës së padisë, njësoj sikurse në gjykimin civil, por në dallim nga ky i fundit, gjykimi administrativ, e vesh gjyqtarin me detyrimin për të vepruar kryesisht në drejtim të hetimit të afatit të parashkrimit, pasi ligji ka parashikuar se këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht.

Në paditë me objekt shpërblimin e dëmit, kur nga veprimi i paligjshëm i organit publik është çelur hetimi penal lidhur me ngjarjen që ka shkaktuar dëmin, rezultonte se ka praktika gjyqësore jouniforme sa i përket momentit të fillimit të përlllogaritjes së afatit të parashkrimit të padisë. Konstatohet se në këto raste disa qëndrime gjykatash përkrahin teorinë e nisjes së afatit të parashkrimit në momentin kur gjykimi i çështjes penale ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Nga ana tjetër një pjesë e praktikës gjyqësore argumenton se përgjegjësia civile është e pavarur në raport me përgjegjësine penale dhe afati i parashkrimit nis në kohën e marrjes dijeni efektive për dëmin. Edhe në mosmarrëveshjen objekt gjykimi shtrohet për diskutim pikërisht kjo çështje, pasi konstatohet se ngjarja prej të cilës kanë rrjedhur veprimet e pretenduara si të paligjshme nga pala paditëse kanë ndodhur gjatë operacionit policor të datës

17.07.2010, padia për kërkimin e shpërblimit të dëmit është ngritur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në datë 23.09.2015, ndërsa me vendimin nr. 453, datë 11.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur: “*Deklarimi fajtor të pandehurit S.S për kryerjen e veprës penale të “vrasjes nga pakujdesia”, e në bazë të nenit 85 të KP e dënon me 5 (pesë) vite burgim..*” Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është lënë në fuqi me vendimin nr. 364, datë 14.09.2016 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Nocioni i përgjegjësisë civile të organeve shtetërore në një gjykim administrativ është më i gjerë se ai i përgjegjësisë civile të subjekteve private në gjykimin civil. Në këtë të fundit, në mbështetje të nenit 608/3 të KC dëmi civil është i kërkueshëm vetëm në rastin kur provohet ekzistenca e një dëmi të paligjshëm dhe dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhojë e shkeljes ose e cenimit të interesave dhe të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira. Nga ana tjetër në një gjykim administrativ, organet publike nuk përgjigjen vetëm kur cenohen interesat e ligjshme të palëve të treta, por edhe në rastet kur megjithëse organet kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktohet një dëm i pabarabartë subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim ose kur veprimtaria e organit shkakton një rrezik të vazhdueshëm personave të tretë.

Kolegji vlerëson se që të mund të shtrojmë për diskutim nëse një padi është apo jo e parashkruar, duhet përcaktuar *së pari* momenti i lindjes së të drejtës së padisë. Sipas nenit 120 të KC, parashkrimi i padisë për kërkimin e shpërblimit jashtëkontraktor, fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkakuar, kushte këto që legjislatori i ka parashikuar që duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative. Në mënyrë analoge në nenin 17, të ligjit nr. 8510/1999, i ndryshuar, parashikohet se afati i parashkrimit të padisë fillon nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për dëmin dhe organin që e ka shkakuar atë. Kolegji vlerëson se marrja dijeni për dëmin dhe organin që e ka shkakuar dëmin janë kushte kumulative, të cilat duhet të jenë plotësuar bashkërisht dhe pa dyshime, në mënyrë që procesi gjyqësor administrativ të jetë i suksesshëm në drejtim të legjitimitit substancial/procedural pasiv të palëve ndërgjyqëse në gjykim. Për shkak se përcaktimi i kohës së marrjes dijeni për faktin dhe personin/organin që ka shkakuar dëmin, është një çështje e cila lidhet me dinamika të ndryshme, Kolegji vlerëson se nuk mund të arrihet në një përfundim të unifikuar nëse në çdo rast duhet pritur përfundimi i hetimit/gjykimit penal, për të ngritur padi për shpërblim dëmi jashtëkontraktor ndaj organeve publike, në rastet kur për ngjarjen që ka shkakuar dëmin civil janë çelur edhe hetime penale. Kolegji vlerëson se rast pas rasti, është detyrë e gjykatave të faktit të evidentojnë kohën e lindjes së të drejtës së padisë dhe përlllogaritjes së afatit të parashkrimit.

Kolegji vlerëson se kushti i parë, marrja dijeni për ngjarjen, në rastin objekt gjykimi nuk shtron diskutime mes palëve, por marrja dijeni për organin/personin që ka sjell dëmin, është faktor determinant në drejtim të lindjes së të drejtës së padisë. [...] Nisur nga mekanizmi i ngjarjes, në mbështetje të akteve bashkëlidhur dosjes, Kolegji konstaton se pala paditëse nuk e ka patur të mundur identifikimin dhe dokumentimin e personit/organit përgjegjës që ka shkakuar vdekjen e të ndjerit, në kohën e ndodhjes së

ngjarjes (2010), sikurse pretendohet nga pala paditëse. Nga kërkesa e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq edhe nga pohimet gjyqësore të palëve në seancë gjyqësore, konstatohet se në kohën kur ka ndodhur ngjarja ka patur dyshime mbi autorin e vrasjes së të ndjerit, pasi nuk është arritur të identifikohet që në kohën kur ka ndodhur ngjarja vdekja ka ardhur si pasojë e goditjeve nga jashtë brenda automjetit apo anasjelltas. Rrjedhisht Kolegji vlerëson, se së paku, nga koha ku mekanizmi i ngjarjes lidhur me këtë fakt është sqaruar dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq (datë 18.12.2013), ka nisur koha nga e cila pala paditëse dinte apo duhet të dinte se dëmi i shkaktuar nuk ka ardhur nga brenda automjetit por nga veprimet e policisë.

Mbi këtë argument, Kolegji konkludon se padia për shpërblimin e dëmit nuk është parashkruar sikurse pretendon pala e paditur. Për më tepër, Kolegji sjell në vëmendje se ka qenë pala e paditur, kërkuese për pezullimin e gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (vendimi i datës 16.05.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë), nën argumentin se nuk mund të vijojë gjykimi civil, pa përfunduar më pare çështja penale në ngarkim të S.S [...]

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGJL Nr.00-2022-562, datë 10.03.2022

VIII. Mosmarrëveshje e Drejta e Pronës

KAGJL Vendim Nr. 00-2022-928 (225), datë 02.06.2022 (Shpronësimi publik)

Vlera e shpronësimit duhet të jetë në proporcion të plotë me qëllimin për të cilin realizohet shpronësimi, si dhe të përfitimit që ka komuniteti nga ky shpronësim. I takon gjykatave të faktit që, pasi të vlerësojnë e të shprehen për të gjitha faktet me rëndësi çështjen, të gjejnë balancën në përcaktimin e masës konkrete të shpërblimit të drejtë, referuar rrethanave specifike të saj dhe t'i njohin palës atë masë shpërblimi që kënaq më së miri interesat e saj të ligjshme.

Fjalë kyçe: ligjshmëria e shpronësimit, vlera e shpronësimit

Rrethanat e çështjes:

Nga dosja gjyqësore rezulton se pala paditëse K.B. ka qenë pronar i një objekti tre katësh, [...] në Lagjen “28 Nëntori”, Berat, objekti ka një sipërfaqe ndërtimi kati përdhe 173 m², sipërfaqe ndërtimi kati i dytë 400 m² dhe truall me sipërfaqe 200 m². [...] pasqyruar në vërtetimin hipotekor të lëshuar në datë 16.10.2014 nga ZVRPP Berat. Pasuria [...] e përshkruar [...] si më sipër, së bashku me një kat tjetër të objektit të ndërtuar sipas ligjit të kohës, por të pa regjistruar, ka rezultuar se përbente vendin

e regjistruar të ushtrimit të veprimtarisë si subjekt tregtar nga pala paditëse, ku ajo ofronte shërbime të plota të Bar-Restorant-Hotelerisë.

Me shkresën nr. 1147 prot, datë 19.05.2014 të Bashkisë Berat paditësi është njoftuar për fillimin e procedurës së shpronësimit publik të objektit [...], pronës së tij. Sipas përmbajtjes së këtij njoftimi shpronësimi i objektit [...] është vendosur për shkak të zbatimit të projektit “*Ndërtimin e ishullit në Lumin Osum*”. [...] paditësi është informuar lidhur me raportin përfundimtar të vlerësimit dhe vlerën e nxjerrë nga Komisioni i Vlerësimit prej 37.821.663 lekësh.

Kryerja e shpronësimit është miratuar me anë të VKM-së nr. 519, datë 12.06.2015 [...] dhe si vlerë e shpronësimit dhe dëmshpërblimit, është miratuar shuma prej 37.821.663 lekësh. Sendi është prishur krejtësisht disa ditë pas miratimit të VKM-së së shpronësimit. Në këto kushte paditësi, [...] i është drejtuar gjykatës, me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar, se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, [...] ka vendosur pranimin e kërkesë padisë[...]. ndryshimin e VKM nr. 519, datë 12.06.2015, për sa i përket masës së shpërblimit të shpronësimit të paditësve; detyrimin e të paditurve të shpërblejnë paditësit në masën 205.780.314 lekë [...]për shpronësimin e objektit dhe 912.400 [...] lekë për shpronësimin e truallit, shpërblim nga i cili do të zbritet shuma 37.821. [...] lekë e përcaktuar në VKM nr. 519, datë 12.06.2015. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit [...] të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke pranuar pjesërisht padinë; Ndryshimin e vlerës së shpërblimit të shpronësimit për pasurinë e palës paditëse të përcaktuar me VKM nr. 519 datë 12.06.2015, nga 37.821.663 lekë, në 43.658.493 lekë. Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditësit shumën prej 5.836.830 lekë. Rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursitet e paraqitura nga pala e paditur [...] dhe Avokatura e Shtetit, nuk ngrënë shkaqe nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 [...] Duke qenë se shkaqet e ngritura në rekursin e palës paditëse, lidhen me nevojën e vlerësimit të fakteve të çështjes, të pakryer nga Gjykata Administrative e Apelit, ky vendim [...] duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, për hetimin e plotë të çështjes dhe interpretimin e drejtë të ligjit material dhe procedural të zbatueshëm.

Kolegji vlerëson se në gjykimin e zhvilluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, nuk janë zbatuar drejtë parashikimet e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “[...] (*indryshuar*). Gjykata Administrative e Apelit nuk ka argumentuar dhe analizuar drejtë në lidhje me zbatimin e nenit 17(2) të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 [...]].

Pra, kriteret mbi të cilat bëhet vlerësimi i pronës janë:

- a) Vlëra fillestare e pronës në momentin e krijimit e pronësisë private mbi të.
- b) Amortizimi eventual.
- c) Destinacioni.
- ç) Vendndodhja e objektit,

d) Indekset e ndryshimit të çmimeve të tregut dhe të monedhës.

Në zbatim të nenit 17(3) të ligjit nr.8561, datë: 22.12.1999, ka dalë edhe VKM nr.138, datë 23.03.2000 [...]cila në pikën 2 të saj parashikonte [...] Nga ana tjetër neni 21(2)(ç) i ligjit nr.8561/1999 parashikonte se vendimi i shpronësimit duhet të përmbajë edhe “afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit, si dhe organin ose subjektin që merr në përdorim pasuritë pronë private të shpronësuara.” Në vijim sipas nenit 26(1) të këtij ligji “[në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm [...]”. Në lidhje me këtë, VKM-ja objekt gjykimi nuk ka të përcaktuar në të afatin e fillimit të punimeve për interesin publik, për të cilin është vendosur shpronësimi dhe prishja e pasurisë së paditësit. Kjo bie ndesh me nenin 21(2)(ç) të ligjit nr.8561/1999 dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk ka arsyetuar aspak në lidhje me këtë element të rëndësishëm që prek ligjshmërinë e shpronësimit dhe prishjes së objektit të ndërtuar, gëzuar dhe poseduar në mënyrë të ligjshme prej palës paditëse. Paditësi ka paraqitur prova gjatë gjykimit në apel (shkresa të Bashkisë Berat), sipas të cilave provohet se edhe në vitin 2018, nuk ishte bërë asgjë në lidhje me projektin për të cilin iu prish prona disa vite më parë. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka arsyetuar në lidhje me këtë fakt. Në këto rrethana, gjykatat duhet të mbanin parasysh se procedura e shpronësimit dhe prishja e mëpasme e pronës së paditësit, nuk ka ndodhur brenda kushteve të përcaktuara shprehimisht në ligj. Shpronësimi për interes publik në kuptim të ligjit nr.8561/1999 ka kuptim të ndodhë në ato raste kur interesi publik është i prekshëm dhe i referohet një nevoje të afërt të shtetit (apo subjekteve të tjerë që ligji i lejon), për shpronësimin e një prone private. Po ashtu, paditësve ju është prishur jo vetëm ndërtesa, por u është shkatërruar njëkohësisht edhe biznesi që ata kryenin (që në kohën e daljes së VKM-së shpronësuese), ndonëse më pas nuk është vijuar me realizimin e punës publike përkatëse (brenda afateve të arsyeshme).

Paditësi ka pretenduar se kishte ndërtuar në mënyrë të ligjshme edhe katin e tretë të ndërtesës, për të cilën kishte marrë miratim në heshtje prej Bashkisë Berat dhe e shfrytëzonte si pjesë e hotelit, porse Gjykata Administrative e Apelit nuk ka arsyetuar fare në lidhje me bazueshmërinë apo jo të këtij pretendimi. Për rrjedhojë, ajo në rigjykim duhet të vlerësojë edhe këtë element, për të nxjerrë në pah vlerën e drejtë të shpronësimit që kanë pësuar paditësit. Në rrethanat e kësaj çështje, balanca midis interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesës për mbrojtjen e të drejtave individuale themelore, arrihet nëpërmjet pagimit të një kompensimi që i referohet në mënyrë të arsyeshme “vlerës së tregut”, siç rezulton në kohën e shpronësimit (shih vendimet e GjEDNj *Pincova dhe Pinc k. Republikës Çeke*, §53; *Gashi k. Kroacisë*, §41; *Vistins dhe Perepjolkins k. Lituanisë (DHM)*, §111; *Guiso-Gallsay k. Italisë (shpërblimi i drejtë) [DHM]*, §103; *Moreno Diaz Pena dhe Të Tjerët k. Portugalisë*, §70). Po ashtu, përshtatshmëria e masës së kompensimit do të ulej ndjeshëm nëse do të paguhej pa marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në rritjen e vlerës, siç është rasti kur

prona e shpronësuar nuk ishte vetëm send por gjithashtu vend i ushtrimit të aktivitetit të biznesit (shih praktikën e GjEDNj *Vlerra Naturstein GmbH & Co Kg k. Gjermanisë, §46; Azas k. Greqisë, §§ 52-53; Athanasiou dhe Të Tjerë k. Greqisë, §24*).

Kolegji vlerëson se është i njohur parimi që pronari duhet të përfitojë një shpërblim të drejtë për pronën që shpronësohet (neni 41, pika 4 i Kushtetutës) dhe se kjo vlerë nuk barazohet gjithnjë me vlerën e tregut dhe nuk mund të jetë e nuk mund të dalë jashtë konceptit të qëllimit të shpronësimit. Kjo vlerë duhet të jetë në proporcion të plotë me qëllimin për të cilin realizohet shpronësimi, si dhe të përfitimit që ka komuniteti nga ky shpronësim. Në këto kushte, Kolegji e gjen të drejtë pretendimin e ngritur në rekurs se mungon hetimi gjyqësor në këtë pikë dhe vlera e shpronësimit e dhënë nga gjykata Administrative e Apelit nuk i përgjigjet vlerës reale që pala e paditur duhet të paguajë, bazuar në kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8561, datë: 22.12.1999. Sipas vlerësimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë vlera e tregut e pronës së palës paditëse varion midis 174,913,267 lekë dhe 205,780,314 lekë. I takon gjykatave të faktit që, pasi të vlerësojnë e të shprehen për të gjitha faktet me rëndësi për këtë çështje, të gjejnë balancën në përcaktimin e masës konkrete të shpërblimit të drejtë, referuar rrethanave specifike të kësaj çështje dhe t'i njohin palës paditëse atë masë shpërblimi që kënaq më së miri interesat e ligjshme të kësaj pale. Kjo në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, nëpërmjet të cilit vlerësohen të gjitha pretendimet themelore të palëve, të cilat paraqiten me rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

[...] Kolegji konkludon se Gjykata Administrative të Apelit duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen në themel dhe me qëllim zgjidhjen e drejtë të këtij konflikti gjyqësor, në rigjykim duhet të zbatohen udhëzimet e mësipërme të Gjykatës së Lartë; të garantohet zhvillimi i një *“hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin”* (neni 14 i KPC); të kryhet një cilësim i saktë i fakteve dhe rrethanave në këtë mosmarrëveshje; të zbatohen drejtë rregullat ligjore të barrës së provës (neni 35 i ligjit nr. 49/2012); tu jepet përgjigje pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe të kryhet një analizë tërësore dhe objektive e provave (neni 126 i KPC), për ta zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj (neni 16 i KPC). Në rigjykim, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit duhet të rivlerësojë faktet, bazuar në kriteret e sipërcituara ligjore dhe në fund të japë vendim për zgjidhjen në themel të pretendimeve të paditësit.

Mbështetur sa më sipër, Kolegji vlerëson se duhet të priset vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykuese.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL Nr.00-2022-435, datë 10.03.2022

KAGJL Vendim Nr. 00-2022-1200 (245), datë 16.06.2022 (Privatizim prone)

Përfundimi i procedurës së privatizimit mbetet në vlerësimin e organit publik, i cili deri sa nuk është lidhur kontrata, mund të rivlerësojë nevojat për privatizim dhe në

zbatim të interesit publik mund të vendosë të mos e privatizojë një aset shtetëror, por ta përdorë në përmbushje të funksioneve të veta publike. Në procedurën e privatizimit një nga kushtet për përfundimin e suksesshëm të saj është marrja e pëlqimit të organit publik që ka në administrim sendin që do të privatizohet.

Fjalë kyçe: procedurë privatizimi, lidhje kontratë privatizimi, pëlqim organ publik administron pronën, e drejtë parablerje

Rrethanat e çështjes:

Rezultun se, pala paditëse Bashkësia Fetare Provinca Françeskane “Zonja Nunciatë”, është pronare e disa objekteve të ndodhur në Kepin e Rodonit, Komuna Ishëm, Durrës, të Postës Kufitare Rodon dhe dy ish reparteve ushtarake [...], për të cilat procedurat e privatizimit kanë kaluar pranë Drejtorisë së Shitjes. Pronësia [...] i është kthyer paditësit [...] me vendimin nr. 416, datë 31.01.2008, për njohjen e së drejtës së pronësisë, kthimin e pronës së Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, Zyra Rajonale Durrës.

Pala e paditur, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave, ka shpallur me afat publikimi prej datës 27.08.2013, deri në datë 16.09.2013, për shitje objektet: *Posta e Policisë Kufitare Rodon, me vendndodhje Kepi i Rodonit, Shetaj, Ishëm, Durrës; Prona nr. 252 me emertësë “Ish Bateri ABD”, me adresë Kepi i Rodonit, Ishëm, Durrës dhe prona nr. 253, me emërtesë “Objektet DID”, Kepi i Rodonit, Ishëm, Durrës për subjektin pronar, Provinca Françeskane “Zoja Nunciatë”.*

Në datë 27.08.2013, me Faturat për Arkëtim [...], është bërë pagesa e 20% të vlerës së objekteve të mësipërme. Pala paditëse i është drejtuar palës së paditur për pagesën e vlerës së mbetur prej 80% të objekteve me letra me vlerë apo bono privatizimi. Me shkresën me nr.740/1 prot., datës 23.05.2014, të palës së paditur është kthyer përgjigje se: *“Të gjitha procedurat e privatizimit të pronës shtetërore janë pezulluar, deri në miratimin e bazës së re ligjore për privatizim.”* Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi si më sipër pasqyruar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë [...] ka vendosur pranimin e padisë të paditësit [...]

Detyrimin e organit publik, [...] për nxjerrjen e aktit administrativ, të vazhdimit të procedurës së shitjes së pronave për të cilat është likujduar 20%, sipas ligjit dhe pagimin e pjesës tjetër të detyrimit të mbetur prej 80%, të objekteve me letra me vlerë dhe bono privatizimi, per pronat [...] Gjykata Administrative e Apelit [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e çështjes [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekurset e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme dhe Avokaturës së Shtetit ngrenë shkaqe të bazuara në nenin 58(a) të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar [...], të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin [...] e Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pjesën e lënë

në fuqi. [...] Në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i fakteve të pranuar nga gjykatat më të ulta, objektit dhe shkakut të padisë, pretendimeve e prapësimeve të palëve, të vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe shkaqeve të rekursit, Kolegji vlerëson se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e apelit është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të jo të drejtë të kërkesave të ligjit material, e një rëndësie themelore për zhvillimin e praktikës gjyqësore.

[...] Rezulton se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me shkresën me nr. 696 prot, datë 27.01.2014 (cituar në shkresën me nr. 123/1 prot., datë 20.01.2016) dhe Ministri i Punëve të Brendshme me shkresën me nr. 3449, datë 22.04.2014, i ka kërkuar Ministrisë së Financave pezullimin e të gjitha procedurave të privatizimit, me qëllim që kjo e fundit të rivlerësojë inventarizimin e pronave në administrim të saj dhe të institucioneve të varësisë dhe se në fund të rivlerësimit do të bëjë me dijeni Ministrinë. Pala e paditur edhe pas marrjes së këtij informacioni ka vijuar procedurat e privatizimit, ndonëse e ka patur të detyrueshme pëlqimin dhe i ka kërkuar Ministrisë së Brendshme për të caktuar përfaqësuesin ligjor për të përfunduar procedurën e privatizimit. Nga provat e administruara në dosje nga përmbajta e shkresës me nr. 123/1 prot, datë 20.01.2016 ndër të tjera rezulton [...] Ndërkohë personi i tretë në mënyrë të përsëritur me shkresën e fundit me nr. 3393/1, datë 08.05.2017 ka rikonfirmuar qëndrimin e tij për mosdhënien e pëlqimit për privatizimin e postës së policisë, duke e motivuar vendimmarrjen e saj se ky objekt do të shërbejë për nevoja të strukturës së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji vlerëson se gjykatat e faktin nuk kanë kuptuar drejtë natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Përfundimi i procedurës së privatizimit mbetet në vlerësimin e organit publik, i cili deri sa nuk është lidhur kontrata, mund të rivlerësojë nevojat për privatizim dhe në zbatim të interesit publik mund të vendosë të mos e privatizojë një aset shtetëror, por ta përdorë në përmbushje të funksioneve të veta publike. Kolegji vlerëson se në procedurën e privatizimit një nga kushtet për përfundimin e suksesshëm të saj është marrja e pëlqimit të organit publik që ka në administrim sendin që do të privatizohet. Kjo përbën kusht pa të cilën kjo procedurë nuk mund të përfundojë. Vullneti për të pasur marrëveshje është parakushti i çdo marrëdhënie kontraktore të vlefshme. Neni 151(1) i KPA [...] [...] VKM nr.428, datë 9.6.2010 [...] nenin 2 [...] dhe i njëjti formulim gjendet edhe në pikën 2 të pjesës (I) të VKM-në pasardhëse nr.926, datë 29.12.2014, e cila shfuqizoi VKM-në nr.428, datë 9.6.2010. Në interpretim të rregullave të mësipërme del qartë se pëlqimi i organeve që administrojnë pronën shtetërore përbën kusht pa të cilin nuk mund të përfundojë procedura e privatizimit. Në rastin konkret mosprivatizimi i një poste policie është e qartë se i shërben interesit publik, për sa kohë që Ministria e Brendshme ka shfaqur vullnetin për ta përdorur atë aset shtetëror, në funksion të misionit që ka policia e shtetit.

Ndaj në kushtet kur rezulton se procedura e privatizimit nuk është bërë në përputhje me VKM nr.428, datë 9.6.2010, pasi Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka dhënë pëlqimin për përfundimin e kësaj procedure, nuk ka vend për pretendimin e ndonjë të drejte të cenuar nga pala paditëse. Ministria ka argumentuar në lidhje me objektin

e privatizimit i cili do të vijojë të shërbejë për nevojat e strukturës së Ministrisë së Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht, nuk mund të ngrihet padi për të kërkuar lidhjen e kontratës së privatizimit, për sa kohë që organi administrativ që ka të drejtën të thotë fjalën vendimtare nuk dëshiron ta privatizojë asetin shtetëror. Në kushtet e mungesës së vullnetit për privatizimin e ambienteve të postës policore, procedura e privatizimit ka ngelur pa objekt dhe pala paditëse nuk mund të realizojë të drejtën e saj të parablerjes, pasi pala privatizuese ka hequr dorë nga procedura e privatizimit. Në këto kushte gjykimi i padisë së paditësit (*për pjesën e lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit*) nuk mund të vazhdojë dhe në bazë të nenit 299(c) i KPC duhet të priset vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë përsa i përket disponimit për postën policore, që është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit dhe të pushohet ky gjykim, pasi padia për detyrimin e të paditurve të privatizojnë pronën shtetërore kundër vullnetit të tyre dhe kundër interesit publik, është një padi që nuk mund të ngrihet.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KAGJL 00-2020-903, datë 16.11.2020

KAGJL Vendim Nr. 00-2022-326 (71), datë 24.02.2022 (Vlerësim financiar prone -ATP)

Nëse pala paditëse provon bindshëm në gjykim se ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar aktin administrativ që kundërshton dhe për arsye të pavarura nga vullneti i saj nuk ka mundur ta marrë këtë akt, gjykata nuk duhet apriori të disponoj kthimin e akteve, pa bërë paraprakisht përpjekjet për të siguruar aktin objekt gjykimi. Në gjykimin administrativ, gjykata pasi është bindur se pala paditëse ka treguar kujdesin e duhur në funksion të përmbushjes së detyrimeve procedurale që i ngarkohen me ligj, do duhet të ketë rol aktiv në kuadër të garantimit të procesit të rregullt.

Fjalë kyçe: Vlerësim financiar prone, ATP, përpjekje gjykatës siguruar aktin, arsye pavarura vullnet i palës, kthim padie

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se, paditësi është një nga trashëgimtarët ligjore të trashëgimlënësës Q.L. Me vendimin nr. 434, datë 06.02.1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë, në emër të ish-pronarit Q.L., në lidhje me pronën e ndodhur në lagjen Laprakë Tiranë ka vendosur: *“Të njohë ish pronaren Q.L. (trashëgimtarëve) [...] mbi pronën e saj të përbëre nga një truall me sipërfaqe 102 247 m² [...] të ndodhur në Laprakë Tiranë, duke e kthyer e kompensuar si më poshtë: l.a. Një truall¹ i lirë me sipërfaqe 5000 m² siç tregohet në genplan, [...] i njihet dhe i kthet pronares Q.L. (Trashëgimtarëve) pronësia mbi këtë Truall. l.b. Një truall i lirë me sipërfaqe 3552 m² (2530+1022) m² siç tregohet në genplan, [...], kompensohet në natyrë Q.L. (Trashëgimtarëve) me një truall ekuivalent që gjendet brenda pronës së saj dhe i njihet dhe i kthet pronësia mbi këtë truall. l.c. Një truall pjesërisht i lirë me*

sipërfaqe 72 253 m² dhe një truall i zënë me ndërtime shtetërore me sipërfaqe 21 442 m², [...] me letra me vlerë. l.ç. Një sipërfaqe e zënë me ndërtime shtetërore e private me sip. 01=354 m² Ferlut, 02=313,5 m² ish godina e institutit të tokave, 03=589 m² ish drejtoria e fermës 17 nëntori., 04=1883 m² ish magazine e fermës, 05= 545 dhe 06=803m² ish godina e ofiçinës së fermës [...] u lind e drejta e parablerjes së këtyre objekteve sipas dispozitave në fuqi.

Paditësi duke pretenduar se me ndryshimet e ligjit në vitin 2004 u njoh mundësia për kthim fizik në natyrë të pronës u drejtua përsëri Z.R.K.K Qarku Tiranë i cili me vendim nr. 353, datë 29.12.2008 përfundimisht vendosi: “1. Të kthejë trashëgimtarëve ligjorë të subjekteve të shpronësuar [...] edhe sipërfaqen e lirë totale 9353 m² [...]m². 2. Sipërfaqja e mbetur për t’u kompensuar është 82 894 m² [...] 3. Njohjen e së drejtës së parablerjes për objektet shtetërore kur ato të privatizohen të cilat ndodhen brenda sipërfaqes 102 247 m² [...]”

Paditësi në kushtet kur ishte dakord me vendimin [...] i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadinë objekt gjykimi. Gjykata Administrative e Apelit [...] ka vendosur t’i kthejë palës paditëse padinë [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Administrative të Apelit. [...]

Në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë përfshihen vetëm rastet rigorozisht të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit, si dhe me shkeljet e rënda të normave procedurale apo shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore vlerësohet se përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e mosrespektimit dhe zbatimit jo të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

Në nenin 21 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 [...] Në gjykimin administrativ, ligjvënësi ka sanksionuar se pala paditëse ka detyrimin që përveç akteve të parashikuara në nenin 154 dhe 156 të KPC, të paraqesë specifikisht edhe aktin administrativ të kundërshtuar. Ky parashikim ligjor ka natyrën e një detyrimi procedural që rëndon mbi palën paditëse me qëllim garantimin e efikasitetit të procedurave gjyqësore administrative dhe synon të balancojë detyrimet procedurale të palëve në gjykim, në kushtet ku mbi organet publike rëndojnë sanksione procedurale për mosparaqitje të provave në gjykim. Megjithatë, Kolegji vlerëson se në drejtim të detyrimeve që mbart gjykata në funksion të garantimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, ky detyrim nuk ka natyrën e një kushti absolut.

[...]Me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor dhe ekuilibrimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve në proces nga njëra anë dhe gjykatës si aktor procedural në gjykim nga ana tjetër, neni 21 pika 2 e ligjit nr. 49/2012, nuk duhet të interpretohet si një dispozitë urdhëruese me natyrë absolute në ngarkim të palës që inicion procesin gjyqësor. Në këtë linjë arsyetimi Kolegji çmon se nëse pala paditëse provon bindshëm në

gjykim se ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar aktin administrativ që kundërshton dhe për arsye të pavarura nga vullneti i saj nuk ka mundur ta marrë këtë akt, gjykata nuk duhet *a priori* të disponoj kthimin e akteve, pa bërë paraprakisht përpjekjet për të siguruar aktin objekt gjykimi. Kolegji vlerëson se ky detyrim rëndon mbi gjykatën, në përputhje me kërkesat procedurale të nenit 14 të KPC dhe ka për qëllim të garantojë aksesin në gjykatë në funksion të procesit të rregullt ligjor. Interpretim i kundërt do kufizonte në mënyrë të paarsyeshme qytetarët nga aksesin në gjykatë, në rastet kur provohet pamundësia objektive e tyre për të siguruar aktin e kundërshtuar, që lidhet me mosveprimin në kohë dhe sipas ligjit të organit administrativ që e disponon aktin, duke favorizuar në mënyrë të paarsyeshme pasivitetin e organeve publike gjatë gjykimit, çka bie ndesh edhe me filozofinë e ndërtimit të dispozitave procedurale të ligjit nr. 49/2012.

Kolegji vlerëson se gjykata, përpara se të dispononte kthimin e akteve, ka pasur detyrimin që në përputhje me nenet 223 dhe 224 të KPC, pasi të bindej se pala i kishte bërë të gjitha përpjekjet e mundshme, ti drejtohej organit publik me qëllim sigurimin e aktit administrativ të kundërshtuar, për më tepër në kushtet kur ky ka qenë edhe kërkimi i palës paditëse. Vetëm nëse pala nuk do të kishte ezauruar mundësitë procedurale që i ofron ligji, atëherë gjykata do të mund të dispononte me vendim jopërfundimtar. Në gjykimin administrativ, gjykata pasi është bindur se pala paditëse ka treguar kujdesin e duhur në funksion të përmbushjes së detyrimeve procedurale që i ngarkohen me ligj, do duhet të ketë rol aktiv në kuadër të garantimit të procesit të rregullt.

Në rastin në gjykim, Kolegji konstaton se pala paditëse ka treguar kujdesin e duhur me qëllim sigurimin e aktit administrativ objekt gjykimi. Bashkëlidhur akteve të dosjes rezulton se paditësi i është drejtuar palës së paditur me kërkesë për vendosjen në dispozicion të vendimit objekt gjykimi pasi është njohur nëpërmjet sistemit elektronik për ekzistencën e këtij vendimi, por nuk e disponon fizikisht atë. Në mbështetje të këtyre argumenteve paditësi ka kërkuar nga gjykata marrjen e provës nga pala e paditur.

Për sa më sipër, Kolegji çmon se në kushtet ku provohet se paditësi ka bërë përpjekjet e arsyeshme për të siguruar aktin në gjykim, gjykata, duhet të kishte bërë të gjitha përpjekjet sipas ligjit për të garantuar aktin pa disponuar *a priori* me kthimin e akteve. Për rrjedhojë vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet prishur dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në atë gjykatë.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGL nr.00-2022-616, datë 07.04.2022

KAGJL Vendim Nr. 00-2023-1509 (116), datë 04.04.2023 (Refuzim regjistrim prone- ASHK)

Organ publik, duhet që jo vetëm të shprehet që regjistrimi i pasurisë së kërkuesit, krijon mbivendosje, por duhet që të përcaktojë qartësisht pasurinë me të cilin krijohet mbivendosja, me të gjithë elementët përbërës identifikues të saj. Në rastin e mbivendosjes eventuale të pronave, do të duhet që nëpërmjet një procesi gjyqësor për

verifikimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, të zgjidhë përfundimisht çështjen e regjistrimit të pronës, por që të mund të realizohet kjo, duhet që të jenë qartësisht të identifikuar pronari/bashkëpronarët, prona që krijohet mbivendosja si dhe aktin e pronësisë mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi.

Fjalë kyçe: ASHK, mbivendosje, vlefshmëria e titullit të pronësisë

Rrethanat e çështjes:

Nëpërmjet Kontratës së Shitjes nr. 607 rep, nr. 445 kol, datë 02.12.1994, paditësi F.K. ka blerë nga Ndërmarrja e Materialeve të Ndërtimit Vriion, objektin ish-Depo Dinamiti dhe truallin me sipërfaqe 260 m², me vendndodhje në fshatin Metoq [...], Sarandë. Kjo pronë është regjistruar në regjistrat hipotekor [...] datë 13.02.2005. Paditësi i është drejtuar ZVRPP Sarandë, nëpërmjet kërkesës nr. 5098, datë 05.06.2013, duke kërkuar kalimin e kësaj pasurie nga hipoteka në sistem dhe pajisjen me certifikatë pronësie. Me shkresën nr. 419, datë 03.02.2014, ZVRPP Sarandë, i kthen përgjigje paditësit duke e sqaruar për pamundësinë e kalimit të pasurisë në sistem regjistrimi, për shkak të mbivendosjes që krijohet me pasurinë [...] e llojit “ullishte”, në bashkëpronësi.

Njëherësh, paditësi është njoftuar se në lidhje me kërkesën e tij, ZVRPP Sarandë ka nxjerrë urdhrin nr. 121 datë 03.02.2014, për vendosjen e masës së kufizimit, mbi dy pasuritë që krijojnë mbivendosje, përkatësisht pasuri e regjistruar në regjistrin hipotekor [...] datë 13.02.2005 në pronësi të paditësit dhe mbi pasurinë [...] e llojit “ullishte”, në bashkëpronësi. Duke mos qenë dakord me sa më sipër, paditësi [...] i është drejtuar gjykatës me padinë duke kërkuar anulimin e regjistrimit në bashkëpronësi si dhe shfuqizimin e urdhërit të ZVRPP Sarandë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë [...] ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë anulimin e regjistrimit në bashkëpronësi, [...] **të pronës së paditësit, të pasurisë së paluajtshme «ish Depo Dinamiti» dhe të sipërfaqes së përgjithshme të tokës truall prej 260 m²**, [...] si dhe shfuqizimin e urdhërit [...] të anës së paditur, [...] detyrimin e palës së paditur të kryejë regjistrimin e pronës së paditësit pasurinë “Depo Dinamiti” me sipërfaqe 260 m² truall sipas kontratës së shitjes nr. 607 Rep, nr. 445 Kol, datë 02.12.1994 dhe regjistrin hipotekor [...].

Gjykata Administrative e Apelit, [...] ka vendosur ndryshimin e vendimit [...] të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe rrëzimin e kërkesë-padisë.

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji, konstaton se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2018, datë 7.2.2019 “Për kadastrën” është vendosur krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) [...] Në referim të nenit 67 të këtij ligji, ASHK krijohet si bashkim i AITPP, ALUIZNI dhe ZRPP. Pas krijimit të ASHK, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre institucioneve i ngarkohen ASHK. Ndodhur në këto kushte, [...]me vendim të ndërmjetëm bëri kalimin procedural për palën e paditur nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë, tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë,

së cilës i kanë kaluar të drejtat.

Kolegji konstaton se [...]rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin [...] të Gjykatës Administrative të Apelit. [...] Kolegji konstaton se Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe ka vendosur rrëzimin e padisë, duke argumentuar në thelb, se nuk mund të regjistrohesh pasuria e paditësit, pasi krijohet mbivendosje me pasurinë nr. 628/29 e llojit “ullishte”, në bashkëpronësi. Kjo gjykatë ka argumentuar, se një proces gjyqësor në funksion të verifikimit të vlefshmërisë së titujve të pronësisë, përbën mënyrën e vetme për tu ndjekur, në funksion të realizimit të regjistrimit përfundimisht të sipërfaqeve të mbivendosura, në emër të njërit prej pronarëve të dy pasurive, mbi të cilat është vendosur kufizimi.

Kolegji vlerëson, se ky përfundim i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në interpretim të gabuar të ligjit material.

[...]Ligji nr. 33/2012, (ligji në fuqi në kohën e ngritjes së padisë), në nenin 36, neni 37, neni 41, pika 1, [...] Referuar dispozitave ligjore të mësipërme, Kolegji çmon, se në parim, nuk mund të regjistrohesh një pasuri e cila krijon mbivendosje me një pasuri tjetër të regjistruar më parë. Në një rast të tillë, personat pretendentë të pasurisë që krijon mbivendosje, duhet të zgjidhin çështjen e vlefshmërisë së titujve të pronësisë. [...]

Kolegji vlerëson se nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes. Vetëm fakti se pala e paditur refuzon regjistrimin e pronës së palës paditëse, pasi krijohet mbivendosje, nuk përligj rrëzimin e padisë. Një zgjidhje e tillë e çështjes nuk është në interpretim dhe zbatim të drejtë ligjit material e procedural. Kolegji çmon, se që të mund të inicohet një proces gjyqësor, me qëllim zgjidhjen e mbivendosjes që krijohet, duke verifikuar vlefshmërinë e titujve të pronësisë, duhet që të saktësohen në mënyrë të qartë pronat që krijojnë mbivendosje si dhe aktet përkatëse të pronësisë. E thënë ndryshe, pala e paditur si organ publik, duhet që jo vetëm të shprehet që regjistrimi i pasurisë së paditësit, krijon mbivendosje, por duhet që të përcaktojë qartësisht pasurinë me të cilin krijohet mbivendosja, me të gjithë elementët përbërës identifikues të saj. Gjithashtu, duhet që të saktësohet emri i pronarit/bashkëpronarëve, si dhe akti i fitimit të pronësisë, mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi.

Marrja e këtyre të dhënave mbi pronësinë që krijohet mbivendosja, kërkohet jo vetëm për të provuar se refuzimi i organit publik për të regjistruar pasurinë e palës paditëse, nuk është abuziv, por edhe për qartësimin e palës paditëse për të ndjekur rrugën e duhur për zgjidhjen e çështjes. Pra, paditësi, sikundër shprehet dhe Gjykata Administrative e Apelit, në rastin e mbivendosjes eventuale të pronave, do të duhet që nëpërmjet një procesi gjyqësor për verifikimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, të zgjidhë përfundimisht çështjen e regjistrimit të pronës. Që të mund të realizohet kjo, duhet që të jenë qartësisht të identifikuar pronari/bashkëpronarët, prona që krijohet mbivendosja si dhe aktin e pronësisë mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi.

Kolegji konstaton, se organi publik, ASHK Vendore Sarandë, nuk rezulton të ketë paraqitur të dhëna mbi pronën objekt gjykimi, me çfarë akti është bërë regjistrimi i saj në bashkëpronësi, sa është mbivendosja si dhe emrat e bashkëpronarëve. Kjo është dhe

një kërkesë e ligjit nr. 33/2012, neni 41, pika 1 e tij. Për sa më sipër, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, është rrjedhojë e një hetimi jo të plotë dhe si i tillë, vendimi duhet të priset e çështja të kthehet për rigjykim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGJL Nr.00-2023-122(23), datë 21.01.2023

KAGJL Vendim Nr. 00-2023-145 (27), datë 20.01.2023 (Kufizim pasurie-ASHK)

Organi vepron brenda kompetencave të dhëna nga ligji dhe është në diskrecionine tij të vendos kufizime sipas situatave dhe kriterëve të përcaktuara në ligj, kur kufizimet kërkojnë saktësi të plan-vendosjes pasi krijohet mbivendosje midis pronave kufitare. Afati i heqjes së kufizimit duhet të lidhet me realizimin e një ngjarje të caktuar, saktësimin e plan-vendosjes.

Fjalë kyçe: shfuqizim akt administrativ, regjistrim kufizimi, mbivendosje prona kufitare

Rrethanat e çështjes:

Pala paditëse K.B është një nga trashëgimtarët ligjore të subjektit të shpronësuar Th.B, i cili me vendimin nr.290, datë 29.03.1996 të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të Bashkisë së qytetit Sarandë është vendosur të njihet si ish pronar në masën 1/129 të 2.400.000 m², si sipërfaqe ish kullotë e tjetërsuar sot në truall; Në bazë të nenit 19 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 ti kthejë trashëgimtareve ligjore [...] një sipërfaqe truall prej 5000 (pesë mijë) m² në zonën e studiuar Kodra e Marinës me këto kufizime: [...] Në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 dhe kriterëve të përcaktuara në pikën 10 të Udhëzimit të KM nr. 3, datë 21.6.1993, të kompensojë në natyrë trashëgimtarët ligjore të [...]me një sipërfaqe truall prej 5000 (pesë mijë) m² në zonën e studiuar Kodra e Marinës me këto kufizime [...]

Nga certifikatat për vërtetim pronësie datë 24.07.2014 lëshuar nga ZVRPP Sarandë rezulton së pala paditëse është bashkëpronare në pasuritë e ndodhura në zonën kadastrale nr. 8642, nr. pasurisë 1/225, vol. 13, faqe 158, adresa e pasurisë Sarandë, Rr. “Janaq Kumi” me sipërfaqe totale 5000 m² (pesë mijë) truall; nr. Pasurisë 1/226 vol. 13, faqe 159, adresa e pasurisë Sarandë. Rr. “Janaq Kumi”, me sipërfaqe totale 5000 m² (pesë mijë) truall.

Pala e paditur me shkresën datë 13.11.2014 e ka njoftuar paditësin së mbi pronën vepron masa e kufizimit e vendosur në bazë të urdhrit të regjistruarit nr. 17/1, datë 06.09.2007 të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë pika 7. Sipas këtij urdhri rezulton së i është kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën nr. 671 prot., datë 05.09.2007 të bëjë saktësimin e plan-vendosjes për arsye së prona e miratuar me VKM është një sipërfaqe prej 128.070 m², ndërkohë që plan-vendosja është bërë për

një sipërfaqe prej 395.959 m² dhe brenda kësaj sipërfaqe ka regjistrime me VKKP dhe një ndër to është dhe regjistrimi i poshtë shënuar në librin 4, faqe 78, nr. 688 ind, datë 01.07.1993 në emër të M.B, P.B., K.B. Dh.B dhe Q.B.

Në këto kushte paditësi i është drejtuar gjykatës, [...] duke pretenduar, se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjirokastrë [...] ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe shfuqizimi e aktit administrativ [...] të ZRPP Sarandë për kufizimin e regjistrimit të pasurive të ndodhura në [...] Gjykata Administrative e Apelit Tiranë [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit** të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] konstaton se me ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, është shfuqizuar ligji nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme”, në të tilla rrethana, me vendim të ndërmjetëm, datë 26.01.2023 u bë kalimi procedural nga “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës” në “Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Durrës”. [...]

Kolegji vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] dhe në shqyrtim të tyre, Kolegji arrin në vlerësimin se, duhet të ndryshohet vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe padia duhet të rrëzohet. [...]

Kolegji, nisur nga rrethanat e faktit të pranuar nga gjykatat administrative të faktit, arrin në përfundimin se, nuk e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen objekt gjykimi konform ligjit dhe brenda kufijve të shqyrtimit të përcaktuar në ligj. (neni 37 i ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar dhe neni 16 i KPC.) [...] Kolegji thekson fillimisht se pala paditëse, referuar objektit të padisë, ka kërkuar njëkohësisht edhe pavlefshmërinë absolute dhe paligjshmërinë (pavlefshmërinë relative), por ashtu sikurse me të drejtë kanë pranuar edhe gjykatat e faktit, nga tërësia e pretendimeve dhe kërtimeve në padi, pala paditëse pretendon paligjshmërinë e aktit administrativ, pasi pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 [...] dhe ligjit nr. 33/2012 [...]. Në këtë kuptim gjykata ka detyrimin të marrë në analizë dhe të gjykojë nëse veprimtaria e organit publik është apo jo në zbatim të ligjit dhe në këtë rast kur kërkohet shfuqizimi i aktit administrativ, gjykatat i referohet ekzistencës së shkaqeve ligjore që i përkasin këtij lloji kërkimi, të cilat janë të parashikuara në nenet 115(b), 118 dhe 119 të KPA (ligji i kohës nr. 8485, datë 12.05.1999) [...].

[...] Nenet 118 e 119 të KPA nuk mund të kuptohen drejtë, nëse nuk lexohen në dritën e nenit 115(a) të këtij Kodi, [...] Kjo dispozitë nxjerr në pah dallimin thelbësor midis pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative të akteve administrative, ku në të parën akti është nxjerrë në kundërshtim flagrant ose të hapur me ligjin, ndërsa në të dytin akti nxirret në kundërshtim jo të hapur me ligjin. Pra, gjykata në zbatim të këtyre kritereve merr në analizë faktin se çfarë parashikon apo çfarë nuk lejon ligji i posaçëm, mbi të cilin ka vepruar pala e paditur. E thënë ndryshe, gjykata do të marrë në analizë se çfarë

kufizimesh ka parashikuar ligji i posaçëm, të cilat kufizojnë veprimtarinë e organit publik për të kryer një veprim konkret dhe në këtë kuptim të arrihet në konkluzionin se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

Kolegji në zbatim të nenit 37 të ligjit nr. 49/2012 identifikon se në rastin konkret, ligji i zbatueshëm është ligji nr.7843, datë 13.07.1994 [...] që ka qenë i zbatueshëm në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ, objekt kundërshtimi gjyqësor dhe konkretisht, mosmarrëveshja administrative e lindur rregullohet mbi bazën e nenit neni 44, që është norma juridike që i ka dhënë kompetencën dhe përgjegjësinë administrative Regjistruesit për urdhërimin e kufizimeve. [...]

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar, Kolegji vlerëson se pala paditur ka vepruar në përputhje të plotë me kompetencat e dhëna nga ligji dhe se është diskrecion i organit publik të vendos kufizime sipas situatave dhe kritereve të përcaktuara në ligj. Në këtë kuptim me urdhrin nr. 17/1, datë 06.09.2007 të ZRPP Sarandë, është kufizuar pasuria e palës paditëse, pasi kufitarëve të tij, konkretisht Ministrisë së Mbrojtjes i është kërkuar me shkresën nr. 671 prot., datë 05.09.2007 të bëjë saktësimin e plan-vendosjes, për arsye se prona e miratuar me VKM ka një sipërfaqe prej 128.070 m², ndërkohë që plan-vendosja e saj është bërë për një sipërfaqe prej 395.959 m², si dhe brenda kësaj sipërfaqe ka regjistrime me VKKP dhe një ndër to është dhe pasuria e palës paditëse. Pra, me të drejtë organi publik ka vendosur kufizim mbi pasuritë objekt shqyrtimi, pasi krijohen mbivendosje midis pronave kufitare, si dhe qëllimi është pikërisht ai i përcaktuar në normën ligjore, paragrafi i parë i nenit 44 të ligjit organik. Mbi bazën e të cilit vepron pala e paditur. Në këtë kuptim pala e paditur, ka vendosur si afat të heqjes së kufizimit, realizimin e një ngjarje të caktuar, konkretisht saktësimi që duhet të bëjë Ministria e Mbrojtjes në lidhje me plan-vendosjen e pasurisë së saj, e cila ka krijuar edhe mbivendosjen me pasuritë e palës paditëse. (neni 44 pg 2 germa “b” e ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 [...])

Mbështetur sa më sipër, përderisa në procedurën e kryer nga pala e paditur që është konkretizuar me nxjerrjen e aktit administrativ objekt shqyrtimi, nuk evidentohen shkelje të ligjit nga organit publik, përkundrazi është vepruar brenda sferës së kompetencave dhe përgjegjësisë administrative, duke qenë se zbatimi i ligjit material, në rastin në shqyrtim, nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes, Kolegji konkludon se duhet të ndryshohet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe padia duhet të rrëzohet.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGJL Nr.00-2023-1509(116), datë 04.04.2023

KAGJL Vendim Nr.00-2023-3142(128), datë 07.04.2023 (AMTP: Bashkëndërgjyqësi pasive e detyrueshme)

Padiakundërgjyqësi të marrjes së tokës në pronësi, sikurse çdo padi tjetër kundërgjyqësi titullit të përbashkët të bashkëpronarëve, krijon detyrimisht bashkëndërgjyqësi

pasive të detyrueshme, sipas paragrafit të dytë të nenit 162 të KPC. Kryetari i familjes bujqësore nuk mundet të ketë veçse tagra të zakonshme administrimi dhe përfaqësimi në lidhje me bashkëpronarët e tjerë, anëtarë të familjes bujqësore.

Fjalë kyçe: kryetar familje bujqësore, bashkëndërgjyqësi pasive e detyrueshme, AMTP

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala e paditur, Y.Z. është pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, nr. 402, datë 30.04.1996 (në vijim AMTP), nga Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Hamallaj, Bashkia Sukth, për një sipërfaqe prej 15.000 m2, tokë të cilën e posedon edhe aktualisht. Rezulton se me vendimin nr.157, datë 25.02.2010, Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, i ngritur pranë Prefektit të Qarkut Durrës, ka marrë në shqyrtim kërkesën e ankuesit, familjes Qorralliu, e cila pretendon se prona që e trashëgon në mënyrë të ligjshme, i është ndarë në kundërshtim me ligjin të paditurit Y.Z.

Sipas të dhënave të konstatuar nga Komisioni i Verifikimit të Vlefshmërisë ligjore të Titujve të Pronësisë për këtë zonë [...], rezulton se i padituri, është pajisur me AMTP, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 [...] Po ashtu, Komisioni ka konkluduar se AMTP vjen në kundërshtim edhe me VKM nr.452, datë 17.10.1992 [...] pika 2 dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 8053, datë 21.12. [...]

Në kohën e ndarjes së tokës bujqësore, sipas Ligjit nr.7501, referuar gjendjes familjare me datë 01.08.1991, kohë në të cilën ka hyrë në fuqi ky ligj, i padituri nuk ka qënë anëtar i famljes bujqësore, pasi nuk ka qënë banor i fshatit Hamallaj. Po ashtu, rezulton se pala e paditur nuk ka qënë punonjës i Ndërmarrjes Bujqësore Sukth dhe për rrjedhojë nuk ka qënë subjekt përfitues sipas VKM nr. 452 dhe sipas Ligjit nr. 8053. Nga provat e administruara në gjykim, nuk rezulton që procesi i ndarjes së tokës në ish-Ndërmarrjen Bujqësore Sukth, të jetë bërë në përputhje me kriteret e VKM nr. 452 dhe Ligjit nr. 8053. Së fundi, rezulton se parcela që i përket pronës së palës së paditur, shtrihet brenda vijës kufizuese të zonës me përparësi zhvillimin e turizimit, sipas kriteve të përcaktuara në VKM nr. 321, datë 20.07.1992 dhe VKM nr. 88, datë 01.03.1993.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 583 (1707), datë 28.02.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë [...] Deklarimin e pavlefshmërisë ligjore të AMTP [...] në emër të të paditurit [...] si dhe shfuqizimin e këtij akti dhe kthimin e pronës në emër të pronarit “shtet”.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin [...] ka vendosur prishjen e vedimit [...]të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës[...]

Kolegji [...] në seancën gjyqësore, datë 13.06.2017, nisur nga fakti se ka patur praktika të ndryshme gjyqësore në lidhje me formimin e rregullt të ndërgjyqësisë në paditë me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga Komisionet e Verifikimit të Titujve të pranë Prefektit të Qarkut, ka

vlerësuar kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke shtruar këto çështje për zgjidhje:

a) *Në paditë me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga Komisionet e Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut, duhet të thirren me cilësinë e të paditurit të gjithë anëtarët e familjes bujqësore apo mjafton të thirret vetëm kryetari si përfaqësues i saj?*

b) *Për efekt të ndërtimit të rregullt të ndërgjyqësisë, nëse në gjykim do të thirren me cilësinë e të paditurit të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, do të konsiderohen si të tillë vetëm personat që figurojnë në çertifikatën familjare, përkatësisht të datës 01.08.1991, për ish-kooperativat bujqësore dhe 01.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore, apo edhe persona të tjerë sipas kritereve të nenit 223 të Kodit Civil (personat që lidhen ndërmjet tyre, për shkak gjinie, martesë, birësimi, ose pranimi si anëtar i familjes bujqësore)?*

c) *Deri në çfarë raportesh juridike shtrihet e drejta e kryetarit të Familjes bujqësore për të përfaqësuar këtë të fundit në marrëdhënie pasurore me të tretët? [...]*

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji në përbushje të funksionit të tij kushtetues nomofilatik, pas vendimit të Kolegjeve të Bashkuara, ka vijuar shqyrtimin gjyqësor për njësimin e praktikës gjyqësore në përputhje me parashikimet e nenit 62/a, të ligjit nr. 49/2012, duke caktuar seancën gjyqësore për shqyrtimin e çështjes në prani të palëve në përputhje me rregullat e reja procedurale. Në seancën gjyqësore të datës 03.03.2023, Avokatura e Shtetit në cilësinë e përfaqësuesit të palës paditëse, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, rekursuese në çështjen në gjykim, ka parashtruar gjatë mbrojtjes, por edhe në qëndrimin përfundimtar se bashkohet me vendimarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit, objekt rekursi. Përfaqësuesi i palës rekursuese, ka argumentuar se për shkak të ndryshimeve ligjore dhe evoluimit të jurisprudencës, i qëndron mendimit se në paditë me objekt anulimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga ish Prefekti, do duhet të thirren në gjykim të gjithë anëtarët e familjes bujqësore dhe jo vetëm Kryefamiljari. Ky qëndrim është në themel të vendimit nr. 966, datë 21.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit. Përfaqësuesi i rekursuesit ka shprehur në seancë gjyqësore se nuk i qëndron rekursit, duke drejtuar si kërkim përfundimtar lënien në fuqi të vendimit nr. 966, datë 21.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit, i njëjtë sikurse edhe qëndrimi i përfaqësuesit të palës së paditur në gjykim. Rrjedhimisht, Kolegji vlerëson se pala rekursuese, duke i'u bashkuar vendimarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit, ka humbur substancialisht interesin mbi shkaqet e parashtruara në rekursin kundër vendimit të kësaj gjykate[...]

Sa i përket çështjeve të ngritura për njësim, Kolegji sjell në vëmendje se me njësim të praktikës gjyqësore kuptohet unifikimi i qëndrimeve të ndryshme të praktikës gjyqësore të gjykatave më të ulëta apo unifikimi i qëndrimit të kolegjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë të mbajtura në vendimet e zakonshme të tyre mbi zbatimin e një apo disa normave ligjore dhe se kjo kompetencë nomofilatike i është njohur nga Kushtetuta dhe

ligjet procedurale secilit kolegji të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar se krijimi i precedentit të parë apo krijimi i precedentit fillestar mbi një çështje civile, penale apo administrative nga ana e Gjykatës së Lartë do të bëhet nga secili kolegji respektiv, duke vendosur njësimin e praktikës gjyqësore të ndryshme të mbajtur më parë nga gjykatat. Kolegji sjell në vëmendje se nga koha kur janë shtruar për njesim pyetjet e parashtruara nga Kolegji (2017) e deri në shqyrtimin e çështjes (2023), ka evoluar precedenti jurisprudencial i Kolegjit Administrativ mbi formimin e rregullt të ndërgjyqësisë pasive në çështjet administrative me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi. Në harkun kohor 2020-2023, që përkon me periudhën e rifunksionalizimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka mbajtur një qëndrim jurisprudencial sipas së cilit padia kundrejt aktit të marrjes së tokës në pronësi, sikurse çdo padi tjetër kundrejtuar titullit të përbashkët të bashkëpronarëve, krijon detyrimisht bashkëndërgjyqësi pasive të detyrueshme, sipas paragrafit të dytë të nenit 162 të KPC. Sipas këtij qëndrimi argumentohet se kryetari i familjes bujqësore nuk mundet të ketë veçse tagra të zakonshme administrimi dhe përfaqësimi në lidhje me bashkëpronarët e tjerë, anëtarë të familjes bujqësore. (shih vendimet nr. 00-2020-739, datë 27.10.2020, nr. 00-2021-1592, datë 21.10.2021, nr. 00-2022-1667, datë 18.07.2022, nr. 00-2021-1789, datë 15.11.2021, nr. 00-2022-2252, datë 06.10.2022, nr. 00-2021-1788, datë 15.11.2021, nr. 00-2022-2252, datë 06.10.2022, nr. 00-2023-1439, datë 13.04.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë). Nga ana tjetër ka një qëndrim të vetëm jurisprudencial (shih vendimi nr. 00-2021-904, datë 27.05.2021 të Kolegjit Administrativ), ku mbahet qëndrimi se kryetari i familjes bujqësore mbart të drejta të jashtëzakonshme për përfaqësimin e të gjithë bashkëpronarëve në rastet kur paditet nga të tretët, përfshirë padinë për anulimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, sikurse mendime pakice ku mbahet qëndrimi se bashkëndërgjyqësia në familjen bujqësore nuk është e detyrueshme (shih vendimi nr. 00-2022-2701, datë 17.10.2022 të Kolegjit Administrativ).

Nisur nga sa më sipër, vlerësohet se jurisprudenca e Kolegjit ka një zhvillim të praktikës gjyqësore mbi qëndrimin mbi llojin e bashkëndërgjyqësisë që krijojnë paditë kundrejtuar aktit të marrjes së tokës në pronësi dhe që evokojnë pavlefshmërinë e tij. Kolegji vlerëson se ndodhur në kushtet ku pala rekursuese ka shfaqur hapur vullnetin për t'iu bashkuar qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit Administrativ dhe vendimarrjes së Gjykatës Administrative të Apelit, duhet konkluduar me mospranimin e rekursit, duke vlerësuar njëkohësisht se nuk ka vend për vijimin e gjykimit njësuës mbi çështjen konkrete.

IX. Prokurimi Publik

KAGJL Vendim Nr.00-2023-376(42), datë 07.02.2023 (Rishikim kushte kontrate)

Në mënyrë që një palë kontraktore, në një kontratë publike, të kërkojë rishikimin e çmimit të kontratës, si pasojë e ndryshimit të rrethanave që vijnë si pasojë e miratimit të ndonjë akti normativ, duhet që pala kontraktore ta ketë zbatuar efektivisht aktin

normativ dhe zbatimi konkret i tij të ketë ndikuar efektivisht në realizimin e kontratës dhe ky ndikim të jetë përballuar efektivisht nga pala kontraktore. Pala kontraktore nuk mund të kërkojë rishikim të çmimit të kontratës, të shkaktuar nga hyrja në fuqi e një akti normativ, sa kohë nuk e ka zbatuar këtë akt normativ.

Fjalë kyçe: rregullat e prokurimit publik, rishikim çmimi kontrate, ndryshim rrethanash, shkak akti normativ nënligjor

Rrethanat e çështjes:

[...] Rezulton se, pala paditëse shoqëria “Anakonda” SHPK është një shoqëri tregtare e regjistruar që ushtron aktivitet tregtar me objekt, “*Sigurim i objekteve publike dhe private në pronësi ose në përdorim të personave juridikë dhe fizikë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, etj*”. Pala e paditur, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër, ka organizuar procedurën e prokurimit me objekt, “*Shërbimi i ruajtjes me roje civile i ambienteve në administrim të Universitetit* [...] Në përfundim të procedurave të prokurimit ndërmjet palës paditëse e cila ka dalë fituese dhe Universitetit [...] **është nënshkruar kontrata e shërbimit nr.233prot, datë 31.03.2014, me objekt: Ruajtja e objekteve të tri godinave të Universitetit** [...] me roje civile, si dhe të ish-shtëpisë së ushtarakëve, me vlerë 295.052 [...] lekë, për dy vende “roje” dhe me vlerë totale në shumën 2.655.468 [...] lekë. Kjo kontratë është nënshkruar për periudhën 01.04.2014-31.12.2014.

Rezulton se midis palëve ndërgjyqëse është lidhur kontrata shtesë “Shërbimi me roje civile” me nr.791prot, datë 31.12.2014, me vlerë mujore me atë të përcaktuar në kontratën me nr.233prot, datë 31.03.2014, me vlefshmëri nga data 01.01.2015 dhe deri në lidhjen e kontratës pas zhvillimit të prokurimit të ardhshëm.

Në datën 08.08.2014 në Fletoren Zyrtare [...]nr. 124/2014 është botuar ligji nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 23.08.2014. Në nenin 18, shkronja “g” të këtij ligji përcaktohet se “*Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave*”.

Me shkresën nr.96 prot, datë 12.12.2014, pala paditëse bazuar në këtë ndryshim ligjor dhe në pikën 21 të kushteve të përgjithshme të kontratës, i ka kërkuar palës së paditur rishikimin e çmimit të kontratës në masën e diferencës së vlerës së re të shërbimit dhe çmimit të kontratës aktuale. Sipas palës së paditur paga minimale e një punonjësi shërbimi shkon në 33.000 lekë nga 22.000 lekë që ishte referuar VKM nr.573, datë 03.07.2013 [...]

Me shkresën nr.771prot, datë 19.12.2014, pala e paditur [...] i ka kthyer përgjigje palës paditëse duke e informuar se, “*referuar në nenin 21 të kushteve të përgjithshme të kontratës negociimi nuk duhet të sjellë ndryshime thelbësore nga pikëpamja e vlerës dhe e kushteve mbi të cilat është lidhur kontrata. Si dhe ndryshimi i vlerës së kontratës nisur nga paga e re e punonjësit të rolit bazë të shërbimit sipas ligjit nr.75/2014 përbën një ndryshim të konsiderueshëm në atë masë që nuk mund të flitet për negociim,*

por për të lidhur një kontratë të re sipas procedurës negocim pa shpallje referuar përcaktimeve të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006” [...]. Kontratat e lidhura sipas kësaj procedure dihet se nuk mund të kalojnë 20 % të vlerës së kontratës fillestare. Në këtë rast, [...] vlera e re e kontratës tejkalon haptazi këtë kufi, duke e bërë të papranueshme edhe sipas kësaj procedure. Për këto arsye kërkesa juaj është e papranueshme”.

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër me aktin administrativ njoftim- vlerësimi për detyrimet nr.21291prot. (datë nuk ka), ka njoftuar palën paditëse [...] se ka të paguara deri në datën 31.07.2015, ndër detyrime të tjera tatimore dhe sigurime shoqërore dhe TAP për periudhën gusht 2014 e deri në janar 2015.

Në datë 21.09.2015, pala paditëse [...] i është drejtuar palës së paditur [...] me kërkesë për pagesën e rritjes së çmimit të kontratës duke e bazuar dhe argumentuar këtë kërkesë në nenin 18, shkronja “g”, të ligjit nr.75/2014, rritjen e pagës minimale të punonjësve të shërbimit si pasojë e kësaj pike në shumën 33.000 lekë, nenin 21 të kushteve të përgjithshme të kontratës, si dhe njoftim- vlerësimin për detyrimet të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër. Pala paditëse ka llogaritur në shkresën e saj se diferenca në pagesë për periudhën 23.08.2014 e deri më 22.02.2015 është 751.580 lekë me TVSH.

Me shkresën nr.534/1 prot. datë 12.10.2015, pala e paditur [...] i ka kthyer përgjigje palës paditëse se, “1. Në bazë të nenit 62, pika 1 të ligjit nr.9643/2006 detyrimet fiskale, detyrime për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punëtorëve, kushtet e punës që janë në fuqi në momentin e fillimit të zbatimit të kontratës janë të pandryshueshme gjatë zbatimit të kontratës. Gjithashtu është detyrim imperativ i nenit 53, pika 1 të këtij ligji që të mos lejohet ndryshim në çmim. 2. Ndryshimi i vlerës së kontratës nisur nga paga e re e punonjësit të rolit bazë të shërbimit sipas ligjit nr. 75/2014 përbën një ndryshim të konsiderueshëm në atë masë që çon në ndryshim të fondit limit të parashikuar për këtë prokurim. 3. Nuk rezulton në asnjë nen të ligjit nr.75/2014 detyrimi që kontratat e lidhura në bazë të ligjit nr.8770/2001 i shfuqizuar, të ndryshohen dhe të rregullohen sipas ligjit të ri. Nuk mund të cenohet parimi i sigurisë juridike duke i vendosur kontratat e lidhura nën presionin e mundësisë së ndryshimit të ligjeve gjatë zbatimit të tyre”. Në këto kushte, pala paditëse iu drejtua me kërkesëpadi [...] duke pretenduar kompensimin për burgim të padrejtë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me [...] ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur [...] ti paguajë paditësit shoqëria private e sigurisë fizike [...] shumën prej 751.580 [...]. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër [...]”.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në një linjë të gabuar arsyetimi që nuk përputhet me parashikimet e ligjit material dhe procedural. Për këtë arsye, në kushtet kur zbatimi i ligjit procedural apo material, për rastin në shqyrtim, nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo provave, të cilat janë të ditura që

nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës së Lartë, vlerësohet se duhet ndryshuar vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe çështja, në referim të nenit 63, shkronja “dh” të ligjit nr.49/2012, duhet zgjidhur përfundimisht nga ky Kolegj në themelin e saj, duke vendosur rrezimin e padisë.

Neni 33(5) i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, [...] Ndërsa neni 60 i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 [...] Kolegji thekson se, gjykata e shkallës së parë, në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje i është referuar nenit 17, pika 1, të kontratës së shërbimit nr.233 prot, datë 31.04.2014, e cila përcakton se, *“Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon në kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës”*.

Në rastin objekt gjykimi, Kolegji e konsideron të gabuar përfundimin e arritur nga gjykata e faktit dhe për rrjedhojë vendimet e tyre duhet të ndryshohen. Referuar objektit e shkakut të kërkesëpadisë, gjykatat nuk kanë përcaktuar saktë të gjithë elementet që duhen marrë në konsideratë në rastet kur kërkohet rishikim i çmimit dhe kanë gabuar në zgjidhjen e drejtë të konfliktit. Mosmarrëveshja objekt shqyrtimi, duhet të trajtohet si një marrëdhënie kontraktore me natyrë administrative, zgjidhja e së cilës, duhet të referohet në ligjin specifik, nr.9643, datë 20.11.2006 [...] ky ligji [...] ka për qëllim përcaktimin e rregullave për prokurimin e mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve me synim nxitjen e përdorimit efektiv të fondeve publike nga entet prokuruese; nxitjen e pjesëmarrjes së kandidatëve, të konkurrencës duke siguruar një trajtim të barabartë, jodiskriminues të pjesëmarrësve në prokurim, ndershmëri, besim publik dhe transparencë në prokurimin publik. Në kontrata të kësaj natyre autonomia e vullnetit të palëve nuk është e pakufizuar në kuptimin e së drejtës private, por ka parashikime specifike nga legjislacioni, të cilat rregullojnë marrëdhëniet juridike që krijohen dhe funksionojnë në bazë të fondeve publike.

Pala e paditur, [...] me shkresën nr.771prot, datë 19.12.2014, e ka refuzuar ndryshimin e çmimit të kontratës së nënshkruar me palë paditëse për shkak të miratimit të ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 [...] pasi ky ndryshim do të binte ndesh me dispozitat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 [...] pasi ndryshimet e kontratës nuk mund të kalojnë 20% të vlerës së kontratës fillestare.

Kolegji vlerëson se, legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, jo vetëm që e ndalon një organ që administron fonde publike të kryejë pagesa pa zbatuar rregullat e prokurimit publik dhe pa nënshkruar kontratat përkatëse, por parashikon edhe kufizime për organin publik, i cili nuk mund të tejkalojë në mënyrë të njëanshme kufirin e vlerës së kontratës të përcaktuar në mënyrë të detajuar në termat e prokurimit publik. Në këto raste, liria kontraktuale e palës publike është e kufizuar nga respektimi dhe zbatimi i një sërë rregullash të vendosura në ligj, të cilat kanë për qëllim transparencën dhe efektivitetin maksimal të shpenzimeve publike. Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 [...] parashikon rregulla të detajuara të detyrueshme për t’u respektuar, nga të gjithë entet

dhe organet shtetërore që prokurojnë shërbime dhe mallra me fonde publike, për të zbatuar procedura specifike që lidhen me planifikimin e fondeve për prokurim mallrash apo shërbimesh, publikimin e kërkesave të enteve publike për prokurime mallrash apo shërbimesh, vlerësimin e ofertave të paraqitura, shpalljen e fituesit të procedurës prokuruese, lidhjen e kontratës përkatëse, termat dhe kushtet e pagesës.

Kolegji vlerëson se në mënyrë që një palë kontraktore, në një kontratë publike, të kërkojë rishikimin e çmimit të kontratës, si pasojë e ndryshimit të rrethanave që vijnë si pasojë e miratimit të ndonjë akti normativ, duhet që pala kontraktore ta ketë zbatuar efektivisht aktin normativ dhe zbatimin konkret i tij të ketë ndikuar efektivisht në realizimin e kontratës dhe ky ndikim të jetë përballuar efektivisht nga pala kontraktore. Kolegji vlerëson se pala kontraktore nuk mund të kërkojë rishikim të çmimit të kontratës, të shkaktuar nga hyrja në fuqi e një akti normativ, sa kohë nuk e ka zbatuar këtë akt normativ. Duke iu rikthyer rastit objekt gjykimi, nuk rezulton që pala paditëse, gjatë zbatimit të kontratës më palën e paditur, të ketë zbatuar detyrimet që burojnë nga ligji nr.75/2014, neni 18 shkronja “g”, për të paguar punonjësit të rolit bazë të shërbimit, minimalisht 50 për qind më shumë se paga minimale e përcaktuar me KM. Pala paditëse, pavarësisht ndryshimeve ligjore, ka vazhduar me pagat sipas parashikimeve kontraktore dhe për më tepër, më datë 31.12.2014, ka lidhur një shtesë kontratë me të njëjtin çmim, pavarësisht se tashmë ishte në fuqi ligji nr.75/2014. Ka qenë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër, e cila ka konstatuar mos pagesë të detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore duke iu referuar nivelit të pagës të parashikuar nga ligji nr.75/2014. Mbështetur sa më sipër, Kolegji [...] arrin në përfundimin, se në çështjen objekt gjykimi, meqenëse zbatimin e ligjit material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes, vendimet e gjykatave të faktit do të duhen të ndryshohen dhe padia të rrëzohet.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGJL Nr.00-2022-1866(297), datë 08.09.2022

KAGJL Vendim Nr.00-2022-1851 (284), datë 18.07.2022 (Mospërbushje detyrime kontraktore)

Në kontratat administrative rëndësia “e pakët” e mospërbushjes së detyrimit, me rrjedhje të drejtën e organit publik për të zgjidhur kontratën, duke qenë se nuk lidhet vetëm me interesa të ngushta pasurore të palëve, duhet të gjejë interpretim gjyqësor të ngushtuar. Kjo vlen në të gjitha rastet kur provohet mirëbesimi i organit publik në raportin kontraktor. Në një kontratë administrative, mospërbushjet kontraktore afektojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë interesat ekonomike, sociale, kulturore, kombëtare të publikut të gjerë; për rrjedhje mospërbushjet kontraktore të reklamuar nga organi publik, duhen analizuar në mënyrë të kujdesshme nga ana e gjykatave, me qëllim garantimin e interesit publik.

Fjalë kyçe: kontrate me detyrime të ndërsjellta, mospërbushje e

parëndësishme detyrimi kontraktor, zgjidhje kontrate administrative

Rrethanat e çështjes:

Nga fashikulli i gjykimit rezulton se shoqëria “Marsi & Al” sh.p.k. është një shoqëri [...] që ushtron aktivitetin e saj në fushën e import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë i artikujve të ndryshëm industrialë, ushqimor, konfeksione, veshje, këpucë, materiale sportive, pjesë këmbimi për autojete [...].

Shoqëria “Yakupglu Tekstil Ve Deri” San Tic.A.S është person juridik i së drejtës tregtare turke [...] e përfaqësuar në Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë nga shoqëria shqiptare “Marsi&Al”shpk. Sa më lartë, rezulton nga përmbajtja e aktit noterial nr.11083 datë 07.04.2014, të noterit publik të Republikës së Turqisë.

[...] Më datë 12.01.2016 midis palës së paditur Drejtoria e Policisë dhe palës paditëse Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë [...] është lidhur kontrata e furnizimit nr. 49/1, me objekt: Loti 1 “Blerje uniformash për DPSH”. Kjo kontratë është nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 [...] dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 [...] dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “[...]. Kontrata është lidhur në përfundim të një procedure konkurimi të hapur dhe publik, e shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike të datës 06.11.2015. Oferta e bërë nga pala paditëse ka qënë në vlerën 91.917.500 lekë pa TVSH, dhe 110.301.000 lekë me TVSH, vlerë e cila me nënshkrimin e kontratës, përfaqësonte edhe vlerën e përgjithshme të saj. Sipas kontratës, afati i lëvrimit të mallit objekt i saj, pra i të gjithë sasisë prej 27.900 artikuj, do të ishte brenda 25 ditëve nga lidhja e kontratës.

Bazuar në përcaktime kontraktore, transporti i mallit do të përballohej nga kontraktuesi (pala paditëse), me mjetet e tij, deri në magazinat e Autoriteti Kontraktor, të ndodhura në Qendrën e Furnizimit të Materialo-Teknik, Mullet, Tiranë.

Ndër kushtet e lëvrimit, është përcaktuar se malli do të merret në dorëzim në këto magazina të Autoriteti Kontraktor brenda orarit zyrtar, [...] përjashtuar ditët e fundjavës dhe të pushimeve/festave zyrtare, duke njoftuar Kontraktori një ditë përpara, për dorëzimin e mallit. Transporti i mallit mund të kryhej nga Kontraktori me çfarëdolloj mjeti, duke mbajtur parasysh kushtet klimaterike dhe temperaturat, si dhe duke u kërkuar një mjet i mbuluar dhe i pastër. Përsa i përket cilësisë së artikujve, ajo duhet të ishte sipas Shtojcës nr. 10, Specifikimet Teknike të Dokumenteve Standard të Tenderit’ dhe marrja në dorëzim do të realizohej sipas përcaktimeve të nenit 6 të Kontratës, - dispozitë në të cilën është rënë dakord se Autoriteti Kontraktor do të kryente kontroll paraprak të mallit që në momentin e dorëzimit të mallit nga ana e shitësit për ambalazhimin, etiketimin, paraqitjen e dokumenteve shoqëruese të mallit dhe sasinë e tij [...] fatura tatimore e shitjes dhe çertifikata e origjinës. Ky kontroll paraprak duhet të përfundonte brenda 1 (një) dite nga data e dorëzimit të mallit dhe të shoqërohej detyrimisht me një procesverbal paraprak dhe me marrjen hyrje provizore të mallit në sasi.

[...] Bazuar në kontratën e furnizimit [...] Ekipi i Menaxhimit të kontratës, ngritur me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.2 datë 21.1.2016 [...] ka ndjekur procedurat e zbatimit të kontratës. Ekipi i Menaxhimit të Kontratës, gjatë

kontrollit të zbatimit, ka evidentuar problematika që bien ndesh me kushtet e kontratës.

Me lëvrimin e mallit në QFMT-Mullet, në datat 11, 15 dhe 16 Shkurt 2016, në prezencë të përfaqësuesit të shoqërive kontraktore dhe të Ekipit të Menaxhimit të Kontratës, janë marrë mostrat për kryerjen e analizave laboratorike [...] në dy drejtime dhe konkretisht: a) Fiziko mekanike dhe kimike, të lëndëve të para të përdorura për çdo objekt të uniformës; b) analizat organoleptike. Më datë 2.3.2016, kanë mbërritur analizat laboratorike nga Universiteti Politeknik i Tiranës, [...] e konkretisht kanë mbërritur vetëm analizat fiziko mekanike dhe kimike (Raportet e testimit). Me datë 10.3.2016, Ekipi i menaxhimit të kontratës ka bërë matjet dhe ka identifikuar problematikën për 3 (tre) objekte të lëvuara në magazinat e QFMT-Mullet, [...]

Më datë 11.3.2016, është realizuar takimi ballafaques për të vënë në dijeni problematikën e konstatuar gjatë kolaudimit të objekteve të uniformës të lëvuara, [...] nga ku është konkluduar se duhet të rriten disa objekte dhe të riparohen defektet apo deviacionet e objekteve. Me shkresën nr. 016 prot., datë 15.3.2016, Laboratori i tekstilit ka dërguar raportet e konfeksionimit të objekteve të uniformës (11 raporte). [...] Me shkresën nr. 1223/1 prot., datë 16.3.2016, bazuar në rezultatet e takimit të zhvilluar më datë 15.3.2016, DPPSH ka kërkuar rivlerësim dhe rianalizim të produktit për disa objekte të lëvuara. Me shkresën nr. 41/1 prot., datë 17.3.2016, shoqëria kontraktore është përgjigjur se: *“Objektet e prodhuara dhe të konfeksionuara, janë konform specifikimeve teknike dhe kampioneve zyrtare”*. Për devijimet në tabelat e përmasave trupore, shoqëria pretendon se janë përdorur përmasat evropiane me tolerancat e përcaktuara 3-5%.”

Me shkresën nr. 1457 prot., datë 17.3.2016, DPPSH i ka kërkuar Ministrisë së Punëve të Brendshme [...] mostrat zyrtare prezantuar nga shoqëria fituese, analizat laboratorike të prezantuar, nga subjekti fitues. [...] E cila ka dërguar kopje të analizave laboratorike për disa objekte të shoqërisë kontraktore, nga krahasimi rezulton se janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike të tenderit. [...] Pas rritimit nga Laboratori i Universitetit Politeknik Tiranë, vlerat e paraqitura janë më afër specifikimeve teknike të krahasuara me ato të kontratës së furnizimit, duke përjashtuar objektin, bluzë pambuku me dy kopsa për policinë rrugore. Me certifikatën nr. 001, datë 30.03.2016 Grupi i Mbikëqyrjes ka certifikuar produktet e gatshme të përcaktuara në specifikime teknike për artikujt objekt i kontratës së shitjes nr. 49/1, datë 12.01.2016 në përputhje me kërkesat teknike të vlefshme për përdorim nga efektivat e policisë.

Më datë 31.3.2016, ekipi i menaxhimit të kontratës ka verifikuar në QFMT-Mullet të gjitha objektet e mbetura pa u inspektuar, nga i cili ka rezultuar problematika në lidhje me kërkesat sipas specifikimeve të kontratës. Me shkresën nr. 1444/1 prot., datë 15.05.2016 Drejtoria Ekonomike pranë [...] të Drejtorisë së Policisë së Shtetit ka njoftuar shoqërinë ‘Marsi&Al’ sh.p.k. për problematikën e dala nga kontrolli i objekteve të lëvuara në QFMT-Mullet nga ku është njoftuar se është kryer kolaudimi teknik i mallit të lëvuara. Në këtë kërkesë paditësja njoftohet se nga procesi i kolaudimit dhe testimet e analizave laboratorike dhe verifikimi fizik i konfeksioneve rezulton të ketë devijime cilësore dhe mungesë elementësh të cilat janë bërë pengesë për marrjen në dorëzim të mallit duke evidentuar [...] mangësi[...]

Me shkresën nr. 1444/1 prot., datë 15.4.2016, është njoftuar shoqëria “Marsi & Al” sh.p.k., mbi problematikat e dala nga kontrolli i objekteve të levruara në QFMT-Mullet, nga ku është njoftuar se objektet nuk pranohen nga ana e palës së paditur.

Me shkresën nr.45/1 prot., datë 18.4.2016, shoqëria kontraktore në përgjigje të shkresës së sipërcituar, ka kërkuar ribërje të testimit të objektit: [...] [...] Me shkresën nr. 6/3 prot., datë 27.4.2016, nga QFMT-Mullet është njoftuar shoqëria [...] mbi çertifikimin përfundimtar të objektit “Pantallona uniforme dimri për meshkuj” si dhe problematikat e hasura për 9 objekte të tjera të uniformës së policisë. [...] Me Memon nr. 2317 prot., datë 5.5.2016, është informuar Drejtoria e Përgjithshme për Shërbimet Mbështetëse, mbi përfundimin e kontrollit dhe problematikat e dala nga kontrolli i kryer nga të dy palët e pranishme në QFMT-Mullet.

Me shkresën nr.2289 prot., datë 6.5.2016, është kërkuar pranë QFMT-Mullet, koordinimi me shoqërinë [...] për riparimin e defekteve të konstatuara. Me shkresën nr. 1444/15 prot., datë 31.5.2016 të palës së paditur, është njoftuar shoqëria [...] për tërheqjen e objektit “Bluzë pambuku me 2 kopsa për policinë rrugore”, pasi është testuar në përdorim (provë), nga ku ka rezultuar me humbje të ngjyrës (pjesa e verdhë) deri në 70% të saj. Kjo procedurë nuk është kryer nga shoqëria kontraktore. Me shkresën nr.6/12 prot., datë 2.6.2016, shoqëria është informuar nga QFMT-Mullet kryerjen e procedurave të identifikimit të objekteve të uniformës me probleme dhe tërheqjes për riparim të tyre, ku sipas informacionit të ardhur tek pala e paditur, ka rezultuar se shoqëria [...] ka tërhequr objektet me defekte apo deviacione. Në përfundim është informuar pala e paditur se, shoqëria ka riparuar objektet e lëvruara me defekte.

Me shkresën nr.1444/15/1 prot., datë 9.6.2016, është njoftuar shoqëria [...] për kryerjen e kolaudimit përfundimtar të përbashkët të objekteve të uniformës së policisë së lëvruar më datë 13.6.2016, [...] Shoqëria nuk është paraqitur në këtë datë me arsyetimin se personi që e përfaqëson është me raport.

Me Memon nr. 2504 prot., datë 8.6.2016, është informuar Ministria e Punëve të Brendshme, mbi problematikat e dala nga lëvrimi i uniformave të Policisë së Shtetit.

Me shkresën nr. 3199 prot., datë 17.6.2016 të palës së paditur, është rinjoftuar dhe kërkuar prezenca e përfaqësuesve të shoqërisë “[...] për kryerjen e kolaudimit përfundimtar të përbashkët të objekteve të uniformës së policisë së lëvruar më datë 20.6.2016, [...] i bëhet me dije shoqërisë se në rast mosparaqitje, kolaudimi do të realizohet pa prezencën e tyre.

Më datë 20.6.2016, Ekipi i Menaxhimit të Kontratës është paraqitur në QFMT-Mullet, ku ka kryer kontrollin e objekteve të lëvruara, në mungesë të përfaqësuesit të shoqërisë “[...] ku kanë rezultuar të njëjtat problematika dhe ekipi ka arritur në përfundimin se ndërhyrjet apo riparimet e kryera nga shoqëria, janë të pjesshme dhe nuk kanë sjellë ndikime pozitive në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike të kontratës (Shtojca 10).

[...] Me shkresën nr.3485 prot., datë 30.6.2016, DPSH ka dërguar pranë Drejtorisë Juridike të gjithë dokumentacionin (korrespondencën e ndjekur nga dita e parë e fillimit të punës deri më datë 29.7.2016), nga ku është kërkuar fillimi i procedurave

të zgjidhjes së kontratës. [...] Më datë 28.7.2016, Ekipi i Menaxhimit të Kontratës dhe 2 (dy) përfaqësues të subjektit kontraktor me autorizim përfaqësimi, kanë asistuar në kolaudim, nga ku kanë rezultuar të gjitha devijimet apo mospërputhjet me specifikimet teknike të kontratës. Me shkresën nr.1444/31-2 prot., datë 15.8.2016, është njoftuar shoqëria kontraktore mbi ndërprerjen për mosplotësim të kontratës, duke i lënë një afat prej 15 ditësh në zbatim të nenit 13 të kontratës, me synim ndreqjen e mosplotësimeve sipas procesverbalit të kolaudimit. [...] edhe pas kalimit të afatit 15 ditor të vënë në dispozicion, nuk ka reaguar për të rregulluar të metat e mallrave.

Me shkresën nr.1444/31-7 prot., datë 2.9.2016 të palës së paditur, është bërë njoftimi i shoqërisë kontraktore për ndërprerjen përfundimtare të kontratës, duke i lënë një afat 4 ditor për tërheqjen e mallrave nga QFMT Mullet. Në vijim, me shkresën nr.1444/31-8 prot., date 20.9.2016, Drejtoria e Përgjithshme për Shërbimet Mbështetëse pranë DPSH-së, ka dërguar dokumentet për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës të furnizimit me uniforma për Policinë e Shtetit, për veprime të mëtejshme nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar, [...]

Rezulton se për përfaqësuesit e shoqërive që përbejnë bashkimin e operatorëve ekonomikë, DPSH ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së rrethit Tiranë (regjistruar për këtë procedim penal në vitin 2016), dhe me vendimin e datës 8.5.2017 të prokurorit të çështjes, është vendosur pushimi i procedimit penal nr.3209 i vitit 2016 për veprat penale të “Mashttrimit” dhe “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga nenet 143 dhe 186 të KP. Kundër vendimit të prokurorisë është ushtruar ankim nga pala e paditur, ankim i cili nuk është gjetur i bazuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, duke lënë në fuqi vendimin e pushimit të organit të prokurorisë. Vendimi i pushimit ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 1815 datë 21.12.2017 të gjykatës së apelit Tiranë, [...]

Ndodhur në këto kushte, pala paditëse [...] i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë [...] ka vendosur rrëzimin e padisë[...]. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur ndryshimin e vendimit [...] të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë. Detyrimin e palës së paditur [...] për të përmbushur detyrimin kontraktor ndaj palës paditëse [...] në zbatim të kontratës nr. 49/1, datë 12.1.2016, duke i paguar palës paditëse vlerën e detyrimit kontraktor prej 87.937.550 [...] lekë si dhe kamatëvonesat mbi këtë detyrim deri në ekzekutimin e tij, të cilat deri më datë 18.03.2020 janë në masën 3 195 354 [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 [...] shkronja a), të cilat bëjnë të cenueshëm vendimin [...] të Gjykatës Administrative të Apelit.

Kolegji vlerëson se në rekurs [...] ngrihen shkaqe të një rëndësie themelore për zhvillimin e praktikës gjyqësore lidhur me të drejtën e organit publik për të zgjidhur kontratën administrative në rast mospërmbushje të detyrimit kontraktor. Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në

zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural, në përputhje të plotë me parashikimet kontraktore, Kodit Civil dhe vjen si rezultat i një analize të hollësishme të akteve objekt gjykimi. Për rrjedhojë, vlerësohet se, vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të priset dhe duhet të lihet në fuqi vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pa u ndalur në analizën e provave dhe fakteve konkrete të mosmarrëveshjes të cilat rezultojnë se janë debatuar dhe analizuar në mënyrë të hollësishme gjatë gjykimit faktik të çështjes, Kolegji konstaton se është fakt i pakundërshtueshëm, i pranuar edhe në vendimin e gjykatës së apelit në aspektin e provueshmërisë së tij, se përmbushja e detyrimeve kontraktore nga ana e palës paditëse nuk ka qenë brenda të gjitha parashikimeve specifike të kushteve kontraktore. Gjykata e faktit kanë reflektuar qasje të ndryshme lidhur me natyrën e mospërmbushjes, nëse ajo ka qenë e rëndësishme apo e parëndësishme, në kuptim të nenit 698, 724 dhe 725 të KC. Gjithashtu konstatohet se Gjykata Administrative e Apelit ka analizuar edhe afatin e zgjidhjes së kontratës, duke konkluduar se të metat e sendeve objekt i kontratës së shitjes nr. 49/1, datë 12.01.2016 janë depozituar pranë palës së paditur në datë 11.02.2016-16.02.2016, provohet të jenë zbuluar në datat 10.03.2016-28.07.2016 dhe se zgjidhja e kontratës është kryer në datë 02.09.2016, pra tej afatit 15 ditor parashikuar në nenin 725 të KC, duke përfshirë edhe afatin 10 ditor të denoncimit të të metave, sipas nenit 717 të KC

Kontrata nr. 49/1, datë 12.01.2016 në nenin 9 “Reklamimet” [...] Bashkëlidhur kontratës është aneksi nr. 1, ku në kushtet e përgjithshme është parashikuar “Përshtatshmëria e mallrave me standardet teknike”(neni 9) [...] Në nenin 17 “Garancitë” të aneks kontratës, [...] Bashkëlidhur kontratës nr. 49/1, datë 12.01.2016 janë specifikimet teknike për mallrat objekt kontrate në të cilat parashikohet në mënyrë të detajuar standardet teknike, përshkrimet e detajuara, skicat përkatëse, përmasat, kolaudimi, paketimi, etiketimi për uniformat punonjësve të Policisë së Shtetit [...] Për të gjitha mallrat objekt kontrate që janë reklamuar në mospërmbushje të specifikimeve teknike nga organi publik, në referim të aktit të ekspertimit të kryer në gjykim dhe vendimeve të gjykatave të faktit, është konstatuar se ka patur të meta dhe mospërputhje mes mallrave efektivisht të dorëzuara dhe kushteve specifike të parashikuara në kontratë, pasi mallrat nuk janë saktësisht brenda parametrave të specifikimeve teknike. Të metat e konstatuar, pa u kufizuar në to përfshijnë mosrespektim të përmasave, montim të gabuar të etiketave, vendosjen e zinxhirit në vend të kopsave, vendosjen e ylyqeve në mënyrë jo të barazlartuar, mungesë e kopsave plastike rezervë, numrin e perçinave të montuara, mënyrën e montimit të zinxhirit në gavaturë etj. Pra konstatohet se pala paditëse është në kushtet e mospërmbushjes së pjesshme të detyrimit.

Neni 690 i KC parashikon se kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Në kontrata me detyrime të ndërsjella, sikurse kontrata në gjykim, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës (neni 698). Në nenin 699 të KC odit [...] Konstatohet se nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, rëndësia e pakët e mospërmbushjes është analizuar kryesisht duke u bazuar në faktin se artikujt pavarësisht të metave janë funksionale. Kjo rezulton edhe nga akti i

ekspertimit, i cili pasi detajon të gjitha mospërputhjet në raportin përfundimtar arrin në përfundimet se mospërputhjet nuk prishin anën funksionale të mallrave.

Kolegji vlerëson se ashtu si me të drejtë është konkluduar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, përshtatshmëria e mallrave duhet analizuar në drejtim të përdorimit specifik të tyre, pasi ato janë veshje zyrtare protokollare të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe për shkak të rëndësisë së këtij funksioni publik, veshja e një punonjësi policie identifikon drejtëpërdrejtë imazhin që përcjell dhe autoritetin që ushtron shteti. Kushtet e veçanta teknike të veshjes së punonjësve të policisë nuk mund të barazohen me kushtet e zakonshme të funksionalitetit të veshjeve në përdorim të publikut të gjerë. Nuk mund të thuhet se tërësia e kushteve specifike të kërkuara përmes një procedure administrative tenderimi ku detajohen në mënyrë eksplicite kriteret teknike që duhet të përmbushin veshjet, janë “jo të rëndësishme” ose “të një rëndësie të pakët” dhe mund të tejkalohen për shkak të funksionalitetit të mallit. Për më tepër ky arsyetim nuk qëndron në kushtet ku autoriteti kontraktor jo vetëm nuk ka dhënë pëlqimin për ndryshimin e kushteve teknike të mallrave pjesë e kontratës dhe procedurës së tenderimit por ka kontestuar në mënyrë të përsëritur veshjet si jo të rregullta dhe në mospërputhje me specifikimet teknike kontraktore. Nga tërësia e veprimeve të palës së paditur, ashtu si me të drejtë konkludohet edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, provohet mirëbesimi në raportin kontraktor, ndërsa e kundërta nuk është e vërtetë, pasi pala paditëse jo vetëm ka dorëzuar mallrat jo në përputhje të plotë me kushtet teknike, por edhe pas ndreqjes së tyre, gjatë gjykimit faktik ka rezultuar se, ato përsëri kishin të meta.

Kolegji vlerëson se funksioni publik dhe i posaçëm i punonjësve të Policisë së Shtetit duhet të pasqyrojë, edhe në veshjen zyrtare të punonjësve, autoritetin dhe dinjitetin e shtetit shqiptar. Për këtë qëllim, në kontrata të ngjashme me atë objekt gjykimi, i kushtohet një vëmendje e posaçme mbrojtjes së interesit publik. Në këtë drejtim, vlen të sille në vëmendje se edhe në aneksin e kontratës objekt gjykimi, palët kanë parashikuar se organi publik, me qëllim që t'i shërbejë interesit publik sa më mirë, mund të ndërpres kontratën (neni 29). Nisur nga ky këndvështrim, vlerësohet se në kontratat administrative rëndësia “e pakët” e mospërmbushjes së detyrimit, me rrjedhojë të drejtën e organit publik për të zgjidhur kontratën, duke qenë se nuk lidhet vetëm me interesa të ngushta pasurore të palëve, duhet të gjejë interpretim gjyqësor të ngushtuar. Kjo vlen në të gjitha rastet kur provohet mirëbesimi i organit publik në raportin kontraktor siç rezulton në mosmarrëveshjen konkrete. Në një kontratë administrative, mospërmbushjet kontraktore afektojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë interesat ekonomike, sociale, kulturore, kombëtare të publikut të gjerë; për rrjedhojë mospërmbushjet kontraktore të reklamuar nga organi publik, duhen analizuar në mënyrë të kujdesshme nga ana e gjykatave, me qëllim garantimin e interesit publik.

Në rastin në gjykim, sikurse është analizuar gjerësisht nga të dyja gjykatat e faktit, mospërputhjet e evidentuara në uniformat e Policisë së Shtetit, pavarësisht se nuk cenojnë funksionalitetin e tyre (pra, ato mund të gjejnë përdorim të përditshëm si veshje), evidentimi i një numri të lartë mospërputhjes dhe në mënyrë të përsëritur

në një pjesë të konsiderueshme të veshjeve, në vetëvete nuk mund të kualifikohet si një mospërmbushje e parëndësishme e detyrimit kontraktor. Duke pasur në konsideratë se organi publik ka vepruar në mirëbesim, pasi ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen, Kolegji nuk pajtohet me qëndrimin e Gjykatës Administrative të Apelit pasi zgjidhja e kontratës ka qenë *in extremis*. Kolegji vlerëson se malli i dorëzuar nga pala kontraktore për efekt të kushteve specifike që ka kontrata publike në gjykim, i bënë ato të papërshtatshme për qëllimin e posaçëm të përdorimit të tyre, pasi dështimi i kontraktorit në garantimin e të gjitha kushteve teknike të nevojshme për uniformën e punonjësve të Policisë së Shtetit nuk është në përputhje me imazhin që duhet të përcjellin këta punonjës në publik.

I. Mosmarrëveshje mbi kompetencën lëndore

KCGJL Vendim me nr.00-2023-932, datë 22.02.2023 (Dallimi Kontrata Publike dhe Private)

Dy janë kriteret bazë që ndihmojnë në identifikimin e kontratës administrative dhe në dallimin e saj nga kontrata civile. Njëri është kriteri organik, që kërkon praninë e një organi publik në kontratë dhe, tjetri është kriteri material, që ka të bëjë me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike. Kriteri material ka të bëjë me natyrën juridike të kontratës dhe përmbajtjen e saj që duhet të jetë e tillë, që të krijojë, ndryshojë apo shuajë një marrëdhënie juridike sipas të drejtës publike.

Në rast se sipas natyrës, shkakut dhe objektit të padisë, objekt kontrolli nga gjykata është mospërmbushja e detyrimeve kontraktore për pagimin e çmimit të shitjes, jemi përpara një mosmarrëveshje civile që gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pavarësisht se palë në kontratën e shitjes dhe në gjykim është një organ publik, sikurse është Enti Kombëtar i Banesave. Në këtë rast, objekt kontrolli nga gjykata nuk është veprimtaria e këtij organi dhe pajtueshmëria me ligjin nr.9232, datë 13.05.2004, për programet sociale.

Fjalë kyçe: EKB, kontratë shitblerje, mospërmbushje detyrime kontraktore blerës, kompetencë lëndore

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet bashkëlidhur, rezulton se paditësi Enti Kombëtar i Banesave, [...] në datën 08.09.2008 ka lidhur kontratë shitblerje me palët e paditura, të cilët kanë përmbushur kriteret ligjore si të pastrehë. Rezulton se të paditurit S.S., V.S pas lidhjes së kontratës nuk i kanë zbatuar kushtet e kontratës duke mos kryer pagesat e kësteve mujore, këste të cilat nuk i kanë paguar edhe pas njoftimeve të kryera nga paditësi.

Rezulton se paditësi, Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Vlorë, fillimisht e ka paraqitur këtë kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me [...] ka vendosur moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për gjykimin e çështjes civile [...] Dërgimin e çështjes [...] për kompetencë gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë [...] Rezulton se ky vendim është i formës së prerë [...] [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë e ka konsideruar në kompetencën lëndore të saj këtë çështje, e ka regjistruar në datën 12.11.2019 dhe [...] ka vazhduar me gjykimin e saj deri në datën 22.02.2022.

Pas dy vjet e shtatë muaj nga shpallja e moskompetencës lëndore nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin [...] (dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 27.07.2022), ka vendosur deklarimin e mungesës së kompetencës lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës

së Parë Vlorë për e çështjes gjyqësore me [...] pasi kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e kësaj çështje është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. [...] Gjykata ka arsyetuar se, referuar objektit dhe shkakut të padisë, mosmarrëveshja objekt gjykimi i përket lëndës së gjykimit civil dhe jo administrativ, duke u referuar tek parashikimet e nenit 7 të Ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar.

Me vendimin e ndërmjetëm [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur t'i parashtrijë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se vendimi [...] Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, vjen në kundërshtim me nenin 64 të KPC [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se vendimi nr. [...] Gjykatës Administrative tës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është i bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë çështjen e kompetencës lëndore të gjykatave dhe në praktikën e Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme. Si i tillë ky vendim duhet të lihet në fuqi.

Padia e ngritur para gjykatës ka për objekt zgjidhjen e kontratës së shitjes të lidhur midis Entit Kombëtar të Banesave dhe palëve të paditura, në cilësinë e të pastrehut. Kolegji vlerëson se është i pabazuar në ligj arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë [...] se kontrata e lidhur midis palëve në rastin konkret është një kontratë administrative.

Paraprakisht është e nevojshme të qartësohet koncepti mbi kontratën administrative, me synimin për të bërë dallimin e saj nga një kontratë civile. Pikësëpari, për të arritur në konkluzionin nëse një kontratë është apo jo administrative duhet të nis analiza nga përkufizimi dhe rregullimi ligjor që bëhet në KPA. [...] neni 3, pika 4 të këtij Kodi [...] Referuar doktrinës juridike, mënyrës së rregullimit nga ligji, por edhe konfirmimit që i ka bërë jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, është konkluduar se dy janë kriteret bazë që ndihmojnë në identifikimin e kontratës administrative dhe në dallimin e saj nga kontrata civile. Njëri është kriteri organik, që kërkon praninë e një organi publik në kontratë dhe, tjetri është kriteri material, që ka të bëjë me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike. Për t'u plotësuar kriteri organik në një kontratë administrative kërkohet në radhë të parë, që personi i së drejtës publike të veprojë në përmbushjen e funksioneve të tij administrative/publike. Është gjithashtu i pranueshëm për të konsideruar të plotësuar këtë kriter edhe rasti, kur një personi fizik apo juridik të së drejtës private, i njihet me ligj, me akt nënligjor apo me çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga ligji, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Plotësimi vetëm i kriterit organik nuk mjafton për t'a kualifikuar kontratën si kontratë administrative. Ai duhet të lidhet detyrimisht me kriterin material. (*Vendim nr. 00-2020-903, datë 16.11.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

Kriteri material ka të bëjë me natyrën juridike të kontratës dhe përmbajtjen e saj. Pra ajo duhet të jetë e tillë, që të krijojë, ndryshojë apo shuajë një marrëdhënie juridike sipas të drejtës publike. Duke pasur parasysh elementët e marrëdhënies juridike, për të dalluar rast pas rasti nëse jemi para kontratës administrative apo jo, do të shohim objektin si dhe të drejtat apo detyrimet që ajo krijon. Ky kriter mund të paracaktohet nga ligji, i cili mund të përcaktojë nominalisht se cilat janë kontrata administrative në

qarkullimin civil. Por, nëse nuk paracaktohet nga ligji, i përket gjykatës, rast pas rasti të vlerësojë dhe kualifikojë natyrën e kontratës në fjalë (*Shih vendim nr. 00-2018-336, datë 07.02.2018 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

Kolegji vlerëson se, kriteri material, sikurse u parashtrua më sipër, ose lidhet me objektin e kontratës, i cili mund të jetë ofrimi i një shërbimi publik, ose lidhet me të drejtat dhe detyrimet e palëve, ku vihet re epërsia apo pozita e privilegjuar e palës shtet në raport me palën tjetër. Ofrimi i një shërbimi publik do të thotë përfshirja e një subjekti privat në ekzekutimin e një shërbimi publik. Ky ekzekutim duhet të jetë real, i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm. Nëpërmjet kësaj kontrate personi publik duhet të delegojë plotësisht ose një pjesë të ekzekutimit të shërbimit publik, në mënyrë të tillë që subjekti privat duhet të ketë kontribut në shërbimin publik. Në këto raste, funksioni publik do të duhet të identifikohet edhe si pasojë e marrëdhënies juridike/publike, të rregulluar në këtë kontratë dhe të shërbimit publik, që ofrohet nëpërmjet pasojave juridike që rrjedhin nga zbatimi i saj.

Nga ana tjetër, nëse objekti i kontratës nuk është ofrimi i një shërbimi publik, gjykata për të vlerësuar natyrën juridike të kontratës rast pas rasti, do të marrë në analizë ato klauzola apo dispozita të kontratës që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në doktrinën juridike dhe në jurisprudencën gjyqësore¹, klauzolat e kontratës që i japin epërsi palës shtet në të drejta, ndryshe quhen klauzola të nënshtimit të palëve ndaj të drejtës publike apo që i atribuojnë personit publik një pozicion superioriteti në raport me palën tjetër, duke i vendosur sakaq në pozita të pabarabarta. Këto klauzola janë jo të zakonshme në një kontratë klasike tipike midis dy subjekteve private dhe që rregullohet nga e drejta private (p.sh e drejta e palës shtet për t'u tërhequr në mënyrë të njëanshme nga kontrata, kufizimi i lirisë kontraktore apo autonomisë së vullnetit etj.). Kjo do të thotë se nëse të tilla klauzola do të ishin pjesë e një kontrate tipike midis dy subjekteve private dhe që rregullohet nga e drejta private, kjo e fundit do të ishte e paligjshme, sepse palët në një kontratë të tillë gëzojnë të drejta të barabarta. Kështu, nëse nga përmbajtja e kontratës del se palët janë në pozita të barabarta, apo nuk rezultojnë klauzola jotipike që e vendosin palën publike në raport epërsie, atëherë kjo kontratë do të jetë një kontratë e zakonshme, që rregullohet nga e drejta private dhe jo një kontratë administrative.

Një tjetër element dallues midis të drejtës publike e private është i lidhur me konceptin e shërbimit publik. Në të drejtën private, palët nuk kanë për objekt sigurimin e misioni të shërbimit publik, ndërsa në të drejtën publike synohet, pikërisht, përmbushja e këtij misioni. Karakteristika e tretë dalluese qëndron te prerogativat e fuqisë (pushtetit) publik, të cilat janë atribut i administratës publike dhe që shfaqen në formën e aktit administrativ, pushtetit diskrecial dhe të privilegjit të ekzekutimit paraprak.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, koncepti i marrëdhënies juridike në fushën e së drejtës publike nënkupton ato marrëdhënie juridike që përfshijnë në mënyrë kumulative ose

¹ Shiko Vendimin nr. 30701, datë 31.07.1912 të Këshillit të Shtetit të Republikës së Francës. Në këtë Vendim precedent, Këshilli i Shtetit për herë të parë elaboroi kriteret jurisprudenciale për kualifikimin rast pas rasti të kontratës administrative sa herë që gjyqtarit të juridiksionit administrativ do t'i lindte çështja e kompetencës lëndore.

alternative shumë elementë, siç janë raportet e pabarazisë mes palëve, kryerjen e një misioni shërbimi publik, ushtrimin e prerogativave të fuqisë (pushtetit) publik, si dhe përmbushjen e interesit publik. Kolegji thekson se, të këto element që karakterizojnë të drejtën publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit thelbësor të administratës publike, që është misioni i interesit publik (*shih Vendim nr. 00-2020-903, datë 16.11.2020; vendim nr. 00-2020-505, datë 12.10.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendim nr. 00-2018-336, datë 07.02.2018; Vendim nr. 00-2021-76, datë 20.01.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj*).

Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se mosmarrëveshja objekt gjykimi, sipas shkakut dhe objektit të padisë, është me natyrë civile. Pavarësisht se palë në kontratën e shitjes dhe në gjykim është një organ publik, sikurse është Enti Kombëtar i Banesave, objekt kontrolli nga gjykata nuk është veprimtaria e këtij organi dhe pajtueshmëria me ligjin nr.9232, datë 13.05.2004, për programet sociale. Objekt shqyrtimi gjyqësor janë pretendimet e organit publik, i cili ka pozitën e paditësit në këtë gjykim, për mospërmbushjen e detyrimeve të palës blerëse, për pagimin e çmimit. Padia ka si objekt zgjidhjen e kontratës së shitjes dhe lirimim dhe dorëzimin e sendit dhe është bazuar në dispozitat e KC që rregullojnë kontratën e shitjes, zgjidhjen e kontratës, dhe pasojat e saj, konkretisht nenet 698 e vijues të KC. Kjo mosmarrëveshje sipas natyrës, shkakut dhe objektit të padisë, nuk përfshihet në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 7 të Ligjit nr. 49/2012.

Gjithashtu, Kolegji vlerëson se kontrata e shitjes e lidhur midis palëve ndërgjyqëse në rastin konkret nuk është një kontratë administrative dhe nuk jemi para rastit të parashikuar në shkronjën “a” të nenit 7 të Ligjit nr. 49/2012 [..]

Pavarësisht se palë në këtë kontratë është një organ publik (kriteri organik), ky është i pamjaftueshëm për të konkluduar mbi natyrën e kontratës, pasi nuk plotësohet kriteri material. Kontrata ka për objekt shitjen e një sendi të paluajtshëm në pronësi të shtetit kundrejt palëve të paditura, që përfshihen në një kategori të caktuar sipas ligjit për programet sociale. Ajo nuk ka për bazë kryerjen e një veprimtarie publike apo ekzekutimin e një shërbimi publik, i cili duhet të jetë i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm. Nuk duhet ngatërruar fakti se ligji për programet sociale në bazë të të cilit është lidhur kontrata objekt gjykimi, në vetvete mbron një interes publik, pasi është shprehje e politikës sociale të shtetit dhe për këtë arsye shteti ka një autonomi vullneti të kufizuar në lidhjen e kësaj kontrate sipas këtij ligji. Ndërkohë, kontrata individuale që lidhet me një subjekt konkret, në bazë të këtij ligji, ka efekt vetëm ngushtësisht *inter partes* dhe nuk sjell impakt të menjëhershëm dhe të drejtëpërdrejtë mbi publikun e gjerë. Efekti i menjëhershëm dhe i drejtëpërdrejtë mbi interesin publik është elementi që ndan natyrën e kontratës. Kontratat administrative përbëjnë lëndë gjykimi për gjykatat administrative pikërisht për faktin se gjykata në marrjen e vendimit do të duhet të peshojë edhe interesin publik dhe vendimi përfundimtar që ajo lëshon ka një impakt të drejtëpërdrejtë edhe në publikun e gjerë. Këtu Kolegji sjell në vëmendje kriteret që vlerëson gjykata administrative kur shqyrton një kërkesë për sigurimin e një padie administrative. Konkretisht në referim të nenit 29 të Ligjit nr. 49/2012, gjykata duhet

të çmuj nëse a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm për paditësin; b) (nuk) cenohet rëndë interesi publik; c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Gjykimi administrativ për marrjen e masës së sigurimit të padisë ka një veçanti që nuk paraqitet në gjykimin civil. Nevoja për të argumentuar natyrën e (mos) cenimit të rëndë të interesit publik, në aspektin e një balance që duhet të vendoset mes mirëqenies individuale dhe asaj komunitare, përshkron gjykimin administrativ, në tërësinë e tij. Për këtë arsye, lind nevoja që gjykatat të argumentojnë bindshëm në drejtim të cenimit ose moscenimit të rëndë të interesit publik, gjatë vendimmarrjes (*shih vendim nr. 00 – 2021 – 903, datë 02.06.2021; Vendim nr. 00- 2021 – 762, datë 02.06.2021; Vendim nr. 00-2021-969, datë 24.06.2021 i Kolegjit Administrativ etj*).

Organet e administratës publike veprojnë jo vetëm si mbajtëse të pushtetit publik, por ato mund të shfaqen edhe si subjekte të qarkullimit civil. Pra, organet administrative mund të jenë titullare të autoritetit shtetëror dhe njëkohësisht edhe mbajtëse të të drejtave dhe detyrimeve juridike civile, në marrëdhëniet private në të cilat hyjnë me të tretët. Megjithatë, shteti edhe kur operon si subjekt i së drejtës private, nuk gëzon asnjëherë autonomi të plotë vullneti sikurse një subjekt privat, sepse negociimin në fazën parakontraktore dhe vendimmarrjen për të hyrë në marrëdhënie juridike me privatin në qarkullimin civil, e ka të kushtëzuar në çdo rast nga zbatimi i ndonjë norme të së drejtës publike që rregullon veprimtarinë e tij. Kjo pasi, shteti në çdo rast, në mënyrë direkte ose indirekte, mbron një interes publik sepse është një entitet abstrakt që vepron gjithmonë në emër dhe për llogari të publikut të gjerë dhe me këtë logjikë, çdo kontratë ku ai do të ishte palë do të kualifikohej *apriori* si kontratë administrative.

Si shembull, Kolegji sjell disa situata, ku edhe pse marrëdhënia juridike me palën shtet dhe me subjektin privat, mund të rregullohet në disa aspekte nga norma të së drejtës publike, sepse financohet nga fonde publike, ky nuk përbën kriter të mjaftueshëm për ta cilësuar kontratën mes tyre si kontratë administrative. Përshembull, në praktikën e Gjykatës së Lartë është mbajtur qëndrimi se realizimi i procedurës së prokurimit publik që kushtëzon lidhjen e kontratës midis shtetit dhe privatit, nuk është kriter i mjaftueshëm për të konkluduar mbi natyrën civile ose administrative të kontratës. Një veprim juridik, që përbën kontratë administrative, mund të realizohet faktikisht edhe pa këtë procedurë ligjore të lidhjes së kontratës, qoftë sepse ligji e lejon por në rastet kur ligji nuk e lejon dhe duke e shkelur atë. Por në të dy këto raste nuk mund të konkludohet se veprimi juridik i realizuar në fakt nuk është kontratë administrative kur del e qartë për nga përmbajtja e të drejtave dhe e detyrimeve se veprimi juridik ka krijuar, ndryshuar dhe shuar një marrëdhënie juridike të së drejtës publike apo edhe e anasjellta (*shih vendim nr. 00–2020–528, datë 12.10.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 00-2021-76, datë 20.01.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 00-2021-1032, datë 17.05.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Në raste të tjera analoge, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se kontrata e privatizimit e lidhur me Entin Kombëtar të Banesave (*shih Vendim nr. 00-2020-903,*

datë 16.11.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë) dhe kontratat e qirasë (00-2020-505, datë 12.10.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë), nuk kanë natyrë administrative. Përsa i përket arsyetimit të gjykatës parashtruese, se vendimi [...] i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet të priset meqenëse nuk është respektuar neni 64 i KPC, Kolegji vlerëson se ai është i pabazuar në ligj.

[...] Neni 64 synon të parandalojë dhe të shmangë zvarritjet e gjykimeve për shkakun e vetëm pse gjykatat janë të paqarta në lidhje me çështjen e kompetencës qoftë kjo lëndore, funksionale apo tokësore. Kjo garanton gjykimin brenda një afati të arsyeshëm në kuptim të nenit 6 të KEDNJ dhe shmang vonesat në proceset gjyqësore për shkaqe që nuk lidhen me sjelljen e palës, por kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit, për të drejtën e gjykatave për të shqyrtuar një kategori të caktuar mosmarrëveshjesh sipas lëndës apo natyrës së tyre. Konfliktet për kompetencë nuk lejohen dhe gjykata e dytë e individualizuar si kompetente (gjykata pritëse) me vendimin e gjykatës së parë që shpallet jokompetente (gjykata dërguese), nëse ndan pikëpamje të ndryshme në lidhje me kompetencën (pavarësisht llojit të kompetencës që ajo vlerëson, lëndore, tokësore apo funksionale) ka vetëm një mundësi, atë të parashtrimit të mosmarrëveshjes në Gjykatën e Lartë, si autoriteti më i lartë gjyqësor i interpretimit të ligjit, që vendos përfundimisht në lidhje me gjykatën kompetente. [...] Gjykata pritëse, ka të drejtën dhe detyrimin, qoftë edhe kryesisht t'a shqyrtojë, çështjen e kompetencës së paderogueshme. Por ndryshe nga gjykata dërguese, e cila në çdo rast për vlerësimin e kompetencës merr vendim të ndërmjetëm, për dërgimin e çështjes në një gjykatë tjetër, gjykata pritëse të vetmin mjet ligjor që ka për të kontestuar kompetencën, është vendimi i ndërmjetëm që thërret për vlerësim përfundimtar Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se, gjykata pritëse mundet vetëm të kërkojë të shpallet jokompetente, qoftë duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së parë që e ka shpallur veten jokompetente dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë apo qoftë duke kërkuar dërgimin e çështjes në një gjykatë tjetër, që ajo e vlerëson si kompetente, por kurrsesi nuk mund të vendosë vetë deklarimin e mungesës së kompetencës për të njëjtin shkak ose për një shkak tjetër, tej kufijve të vendimmarrjes së parë.

Duke u nisur nga ratio e nenit 64 të KPC, moskompetenca për shqyrtimin e një çështjeje mund të shpallet vetëm një herë. Ky është interpretimi pajtues i kësaj dispozite me KEDNJ [...] për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendim 00-2018-331, datë 14.02.2018 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj*).

Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, nuk është respektuar neni 64 i KPC. Kjo gjykatë, me vendimin për të dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për kompetencë aktet e gjykimit, ka krijuar situatën procedurale të konfliktit të kompetencës, e cila është e ndaluar nga ligji. Megjithatë mosrespektimi i kësaj dispozite nga gjykatat më të ulëta nuk përbën shkak për prishjen e vendimit, nëse prej tyre është kualifikuar drejtë gjykata kompetente. Kjo shkelje nga gjykatat përbën zvarritje të pajustificuar të gjykimit dhe mjafton të konstatohet dhe ti sillet në vëmendje nga Gjykata e Lartë.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se duhet të vendosë lënien në fuqi të vendimit [...] të

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke i sjellë në vëmendje shkeljen e nenit 64 të KPC.

KCGJL Vendim nr.00-2022-3710(484), datë 16.11.2022 (Kompensim për burgim të padrejtë)

Në rastet e kompensimit për burgim të padrejtë sipas ligjit, pavarësisht se kërkimi ka natyrë civile, marrëdhënia krijohet midis personit që pretendon se gëzon të drejtën e kompesimit për burgimin e vuajtur dhe shtetit, organeve ose institucioneve shtetërore të ngarkuara nga ligji me të drejtën dhe detyrimin për të ndjekur dhe zbatuar procedurat për realizimin e kompesimit për burgim të padrejtë. Kjo marrëdhënie është e karakterit administrativ dhe për rrjedhojë, nga pikëpamja lëndore, mosmarrëveshjet që lindin për shkak të saj janë në kompetencën e gjykatave administrative.

Fjalë kyçe: kompensim burgim i padrejtë, kompetencë gjykata administrative

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datën 13.09.1998 ka nisur procedimin penal në ngarkim të paditësit E.K. akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 221 i KP. Me vendimin nr. 1564 akti, datë 15.10.2008, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit (datë 13.10.1998) të E.K. dhe ka caktuar masën shtrënguese “arrest në burg” me afat 20 ditor. Më pas me vendimin nr. 1676 akti, datë 03.11.2008, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur caktimin e masës shtrënguese “arrest në burg”. Me vendimin nr. 367 akti, datë 13.10.1999, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur; ndryshimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i KPC, masë kjo, e cila rezulton të jetë shuar më datë 14.04.2000.

Më datë 24.03.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e hetimeve për Procedimin penal nr.2086/1, të vitit 1998, në bazë të nenit 328/1 gërma “d” të KPP. Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë për kompensim për burgim të padrejtë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...] ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e të paditurve të paguajnë në favor të paditësit E.K. shumën prej 1.276.000 [...] e cila përfaqëson masën e kompensimit për burgim të padrejtë. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. [...] Gjykata e Apelit Tiranë [...]ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë[...]

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 11243-03098-2015 akti, datës 09.06.2022 ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe kalimin e çështjes me [...] **për gjykim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë**”

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe

të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC, që i bëjnë të cenueshëm vendimet e gjykatave më të ulta.

[..] Duke ju rikthyer mosmarrëveshjes objekt gjykimit, bazuar në objektin dhe shkakun ligjor të padisë, vendimet e gjykatave të faktit dhe parashtrimet e ngritura në rekurs, në interpretim të dispozitave ligjore të zbatueshme, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në shkelje të ligjit procedural, pasi janë shkelur dispozitat ligjore mbi kompetencën lëndore.

Kompetenca lëndore nuk duhet të shikohet vetëm me kërkesë të palëve të ngritura në ankim ose rekurs, por edhe vetë kryesisht nga gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë, pasi kjo kompetencë nuk mund të “kurohet” qoftë edhe me zgjidhjen e drejtë të çështjes në themel nga gjykata më e ulët. Çështja e kompetencës lëndore konsiderohet e një rëndësie të veçantë në respektim të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Gjykata në çdo shkallë gjykimi është e detyruar që të marrë në shqyrtim dhe të vendosë në lidhje me kompetencën e saj lëndore përpara se të gjykojë çështjen që i paraqitet për shqyrtim. Ky detyrim i gjykatës për të vepruar edhe kryesisht është e lidhur drejtpërdrejt me zbatimin dhe respektimin e parimit të një procesi të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës [...] dhe nenin 6 të KEDNJ. Nëse një gjykatë nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim tjetër procedural në lidhje me këtë çështje.

Kolegji vlerëson se, mosmarrëveshja objekt gjykimi ka të bëjë me të drejta të lindura nga legjislacioni i fushës publike, ligji nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”. Ky ligj, duke synuar përmirësimin e arsyeshem të nivelit të gjendjes ekonomike të një kategorie personash, e cila është dëmtuar gjatë kohës që ata kanë qëndruar padrejtësisht në burg, për shkak të një akti të paligjshëm të organeve shtetërore, rregullon “...rastet e përfitimit dhe të kompensimit për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi dhe masën e mënyrën e llogaritjes së tij, si dhe procedurat për kërkimin, pagesën dhe kompensimin për burgim të padrejtë” (neni 1), që përballohet nga Buxheti i Shtetit (neni 9.1). Pra, në thelb ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personit i cili është “...deklaruar i pafajshëm ose për të cilin është pushuar çështja me vendim gjyqësor të formës së prerë apo të prokurorit, ose është mbajtur në burg tej kohës së caktuar në vendimin e dënimit,...” dhe që kanë të bëjnë me “...të drejtën e kompensimit për burgimin e vuajtur” (neni 2).

Në këtë kuadër ligjor, pavarësisht se kërkimi ka natyrë civile, marrëdhënia krijohet midis personit që pretendon se gëzon të drejtën e kompesimit për burgimin e vuajtur dhe shtetit, organeve ose institucioneve shtetërore të ngarkuara nga ligji me të drejtën dhe detyrimin për të ndjekur dhe zbatuar procedurat për realizimin e kompesimit për burgim të padrejtë. Kjo marrëdhënie është e karakterit administrativ dhe për rrjedhojë, nga pikëpamja lëndore, mosmarrëveshjet që lindin për shkak të saj janë në kompetencën e gjykatave administrative. Sipas nenit 7 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 [...] [...] Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin nr. 3, datë 06.12.2013, ku kanë unifikuar se: “Gjykatat Administrative të

Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me Ligjin nr. 49, datë 03.05.2012 [...] janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma.”. Kolegji vlerëson se kushtet kur mosmarrëveshja objekt gjykimi kishte natyrë administrative dhe gjykimi i saj nuk kishte përfunduar akoma, në zbatim të nenit 7/b të ligjit nr. 49/2013 [...] dhe vendimit unifikues nr. 03/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit, kanë qenë të detyruara që të vendosnin moskompetencën e saj lëndore dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në gjykatën kompetente.

Përsa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se moskompetenca lëndore për zgjidhjen e çështjes përbën shkelje të rëndë të rregullave procedurale, e cila ndikon drejtpërdrejtë në dhënien e vendimit në kuptimin që, mosrespektimi i saj e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm. Gabimet në procedim, të cilat parashikohen në nenin 467/a të KPC dhe nenin 54 të ligjit nr. 49/2012 “[...] shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht, pikërisht për shkak të efektit të drejtpërdrejtë që ato kanë në vendimin e dhënë. Në kushtet kur vendimi i ndërmjetëm i gjykatave të faktit që kanë pranuar për kompetencë, gjykimin e kësaj çështje është marrë në kundërshtim me ligjin procedural e si pasojë vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykata kompetente.

KCGJL Vendimin nr.00-2023-3114, datë 26.07.2023 (Lëshim urdhër ekzekutimi)

Neni 61 i KPC e ka kushtëzuar dhe kufizuar ofcialitetin e gjykatës për të vlerësuar kryesisht kompetencën tokësore vetëm për paditë e ngritura sipas neneve 45 dhe 46 të KPC dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të zgjeruar qoftë për kërkesat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, apo qoftë në mënyrë të përgjithshme edhe për paditë e ngritura gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutive, regjimi juridik i të cilave përcaktohet në dispozita të tjera të KPC.

Fjalë kyçe: kompetencë tokësore, parakusht procedural, kërkesë palëve moskompetencë

Rrethanat e çështjes:

Pala kërkuese, A.K. ka paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për deklaratën noteriale me nr.2481 rep., nr.1056 kol., të nënshkruar më datë 09.06.2020, para noterit [...]. Detyrimin e palës debitore të paguajë kamat vonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Detyrimin e palës

debitore të paguaj shpenzimet gjyqësore për avokat në shumën 40.000 lekë.

Nga shqyrtimi i kërkesës dhe provave bashkëlidhur, rezultoi e provuar se në datën 02.06.2020, është lëshuar deklarata noteriale me nr.2481 rep., nr.1056 kol., ku në cilësin e deklaruesit debitorit është K.A. [...] dhe në cilësin e kreditorit është z. A.K. [...] Në këtë deklaratë është parashikuar se:... *“Unë deklaruesi i mësipërm K.A. deklaroj me vullnetin tim të lirë e të plotë dhe nën përgjegjësinë time personale dhe përpara të gjitha efekteve që parashikon ligji për deklartë të rreme se shumën në vlerën 70.000 (shtatedhjetëmijë) euro do ja kthej zotit A.K brenda datës 08.07.2020. Unë deklaruesi i mësipërm deklaroj me vullnetin tim të lirë e të plotë dhe nën përgjegjësinë time personale dhe përpara të gjitha efekteve që parashikon ligji për deklaratë të rreme se pasi lexova, kuptova dhe mu shpjegua neni 510 pika d KPC njoh dhe kuptoj pasojat që vijnë prej saj. Bazuar në nenin 510 pika d KPC kjo deklaratë përbën titull ekzekutiv. Në rast të moskthimit të shumës brenda datës 08.07.2020, në zbatim të dispozitave që parashikon ligji, kjo deklaratë përbën titull ekzekutiv dhe palët mund ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit”.*

Në këto rrethana dhe me pretendimin se shuma e marrë nuk i është kthyer nga shtetasi K.A., kërkuesi A.K. ka kërkuar nga gjykata lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, duke ju drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë [...] ka vendosur të shpallë moskompetencën tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për gjykimin e çështjes civile [...] Dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykate kompetente. [...]

Nga ana e saj, duke mos qënë dakort me vendimin e mësipërm, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, [...] **ka kërkuar para Gjykatës së Lartë** rregullimin e kompetences tokësore të çështjes [...] **Dërgimin e çështjes** [...] për vazhdimin e gjykimit Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si gjykatë kompetente e krijuar me ligj[...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] pasi shqyrtoi aktet e dosjes gjyqësore, vlerëson se vendimi [...]mi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për shpalljen e moskompetencës tokësore dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i pabazuar në ligj. Si i tillë ky vendim duhet të priset dhe çështja të dërgohet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për vazhdimin e gjykimit.

Kolegji [...] vlerëson se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Kompetenca tokësore është e drejta e gjykatës për shqyrtimin e një kategorie të caktuar mosmarrëveshjesh, sipas lidhjes që ekziston midis konfliktit gjyqësor dhe gjykatës me një territor të caktuar. Ajo ka për qëllim të zbatojë shpërndarjen e çështjeve mes gjyqtarëve të të njëjtit lloj për të lehtësuar dhe për t'a bërë më komode mbrojtjen e palëve dhe aksesin në gjykatë si dhe për zgjidhjen më lehtë dhe më shpejtë të çështjes. Veç kësaj, për kategori të caktuara mosmarrëveshjesh, procesi duhet të zhvillohet përpara një gjykate, vendndodhja e së cilës të ndihmojë që procesi të zhvillohet në mënyrë sa

më efektive dhe brenda një afati të arsyeshëm, në respektim edhe të nenit 6 të KEDNJ, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4 të KPC.

Si parakusht procedural në interes të palëve kompetenca tokësore mund të përcaktohet edhe me marrëveshje, duke deroguar nga rregullat e KPC që përcaktojnë kriteret e përgjithshme se si individualizohet ajo nga gjykata rast pas rasti. Nuk mund të derogohet vetëm nga rregullat ligjore që individualizojnë kriteret për kompetencën tokësore, e cila sipas ligjit ka karakter ekskluziv.

Po ashtu, si parakusht procedural në disponibilitetin e palës, sipas vlerësimit që ato i bëjnë interesave të tyre ngushtësisht personale, për gjykatën që do të zgjidhë më shpejtë dhe më lehtë çështjen e tyre, KPC, (*pas ndryshimeve me Ligjin nr. 38/2017*), në nenin 61, ka parashikuar se çështja e kompetencës tokësore është një prapsim procedural në kuptimin e ngushtë, që mund të ngrihet vetëm nga pala dhe brenda afatit dekadent, konkretisht derisa të jetë nxjerrë urdhri për seancën gjyqësore.

[..] Pra, ndryshe nga parashikimi i mëparshëm, çështjen se cila gjykatë do ta zgjidhë më lehtë dhe më shpejtë çështjen mund t'a vlerësojnë ekskluzivisht palët dhe nuk mundet gjykata, sipas parimit të disponibilitetit, të bëjë një vlerësim ndryshe, të këtyre interesave. Përrjashtimisht kjo dispozitë ka parashikuar se në disponibilitetin e gjykatës, mbetet vetëm çështja e kompetencës tokësore ekskluzive sipas neneve 45 dhe 46 të KPC dhe gjykata mund të investohet kryesisht për të konstatuar kompetencën tokësore vetëm për paditë reale në lidhje me sende të paluajshme apo për paditë trashëgimore sipas këtyre dispozitave.

Qëllimi i ligjvënësit (*ratio legis*) në lidhje me këtë ndryshim të nenit 61 të KPC lidhet me faktin se çështjen e kompetencës tokësore ligji procedural e ka konceptuar që në vitin 2001 si prezumim ligjor relativ dhe si të tillë të konvalidueshëm. Kështu, neni 467/b i KPC, i pandryshuar, [...] Kjo dispozitë në fakt frymëzohet nga parimi i disponibilitetit dhe parimi i konvalidimit të akteve procedurale në gjykimin civil, (shiko nenin 120 të KPC) sipas të cilit nuk mund të shpallet pavlefshmëria e një akti procedural, pa kërkesën e palës në interes të të cilës kryhet ai akt. Kjo do të thotë se gjykata që sipas ligjit nuk është fillimisht kompetente nga pikëpamja tokësore, bëhet e tillë dhe prodhon akte të vlefshme në momentin kur pala e pranon apo heshtazi ka hequr dorë nga kundërshtimi i kompetencës tokësore. Parashikimi i nenit 61 të KPC të ndryshuar është marrë si model nga i njëjti regjim juridik që zbatohet në procesin penal apo atë administrativ. Ndërkohë paragrafi i parë i nenit 61 të KPC duhet të rregullojë vetëm mënyrën se si gjykata verifikon kompetencën tokësore.

Administrimi i procesit në kuptimin formal e procedural, do të thotë se gjyqtari, ndërsa mbetet arbitër i paanshëm, njëkohësisht kontrollon edhe veprimtarinë e pjesëmarrësve në proces, përmbushjen prej tyre të detyrimeve procedurale, me qëllim shqyrtimin dhe përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. [...].

Duke ju rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se, Gjukata se Rrethit Gjyqësor Kavaje, nuk ka zbatuar drejt dispozitat ligjore. Referuar të dhënave që pasqyrojnë aktet shkresore të ndodhura në dosjen gjyqësore, mosmarrëveshja objekt gjykimi ka të bëjë me kërkesën e kreditorit A.K. për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Deklaraten Noteriale nr.2481 rep.nr..1056 kol. datë 09.06.2020[...] me kredimarrës shtetasin K.A.

Duke qenë se kompetenca e gjykatës për shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit si ajo objekt gjykimi, nuk është e natyrës ekskluzive, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ku është paraqitur çështja për shqyrtim bëhet kompetente nga pikëpamja territoriale, duke qenë se pala kërkuese ka zgjedhur atë si gjykatë kompetente. Për rrjedhojë në të tilla raste, Gjykata nuk mund, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve të marr në shqyrtim moskompetencën tokësore kryesisht, pasi një situatë të tillë e ndalon neni 61 i KPC. Është konsoliduar praktika sipas të cilës, kompetenca tokësore, përveç padive sipas neneve 45 dhe 46 të KPC, vlerësohet vetëm me kërkesë të palëve, dhe për sa kohë nuk është nxjerrë urdhëri për caktimin e seancës gjyqësore. Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit ka natyrën e një gjykimi gracioz, pa palë kundërshtare dhe sipas dispozitave të ndryshuara të KPC ai zhvillohet në dhomë këshillimi (gjykim de plano) pa praninë e palës, kjo do të thotë se në të tilla gjykime, për shkak të natyrës së posaçme, praktikisht asnjëherë nuk do të mund të vihet në diskutim nga gjykata çështja e kompetencës tokësore për sa kohë nuk ka një palë kundërshtare që të ngrejë prapësimin e mungesës së kompetencës tokësore të gjykatës para të cilës është paraqitur kërkesa për lëshimin e urdhërit dhe nga ana tjetër pala kërkuese prezumohet se e ka shprehur vullnetin se cila gjykatë do e gjykojë kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në momentin që ka paraqitur kërkesën para gjykatës respektive. Kjo do të thotë se neni 61 i KPC e ka kushtëzuar dhe kufizuar oficialitetin e gjykatës për të vlerësuar kryesisht kompetencën tokësore vetëm për paditë e ngritura sipas neneve 45 dhe 46 të KPC dhe nuk mund të zbatohet në mënyrë të zgjeruar qoftë për kërkesat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, apo qoftë në mënyrë të përgjithshme edhe për paditë e ngritura gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutive, regjimi juridik i të cilave përcaktohet në dispozita të tjera të KPC.

Kolegji vëren se në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 98/2016 “[..].VKM nr. 495, datë 21.7.2022 *“Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”*, si dhe Vendimit të KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022 *“Për fillimin e funksionimit të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”*, që prej datës 1 maj 2023 ka nisur funksionimi i hartës së re gjyqësore përmes riorganizimit të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Duke nisur nga kjo datë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, [..].Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ndërpret veprimtarinë më datë 30.04.2023, për këto arsye shqyrtimi i çështjes konkrete do të duhet të vijojë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi [..]i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duhet prishur dhe çështja duhet të dërgohet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për vijimin e gjykimit.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr. 00-2022-95(11), datë 17.01.2022

II. Juridiksioni Civil

KCGJL Vendim Nr.00-2022-964(169), datë 04.05.2022 (Vërtetimi gjyqësisht fakti juridik vjetërsi në punë)

Ligjit nr. 169/2020 përbën shkarkimi nga barra e provës të kërkuetit, në mënyrë të tillë që fakti juridik i viteve të punës në ish-kooperativat bujqësore, nga i cili varet e drejta e pensionit, në raste kur dokumentacioni është djegur, të ngrihej në nivelin e një prezumimi, para kujtdo juridiksioni që do të merrej në shqyrtim (administrativ apo gjyqësor), i cili njihet ex lege, mjafton të provohet baza e prezumimit se: a) kërkueti nuk ka vuajtur dënimin me heqje lirie në atë kohë; b) nuk ka përfituar nga sigurimet shoqërore, pension për invaliditet të plotë; c) ka qenë pjesëtar i kooperativës përkatëse. Prezumimi, si çlirim nga barra e provës, konsiston në atë që disa fakte mund të deduktohen nga ekzistenca e fakteve të tjera me të cilat të parat kanë një lidhje shkakësore të domosdoshme dhe të drejtpërdrejtë.

Fjalë kyçe: e drejtë pensioni, pjesëtar ish kooperative bujqësore, shterrim rruge administrative

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, kërkueti, K.Q. me datë 17.11.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesë për vërtetimin e faktit juridik të viteve të punës, pranë ish-Ndërmarrjes Bujqësore (NB) Thumanë, Krujë. Ai ka pretenduar se dokumentacioni përkatës që provon këtë fakt juridik është djegur dhe nuk mund të ribëhet më. Për këtë fakt, kërkueti ka paraqitur vërtetimin nr. s'ka, datë 22.10.2021 të lëshuar nga Njësia Administrative Thumanë.

Rezulton se kërkueti i është drejtuar fillimisht DRSSH Durrës, prej të cilës i është bërë me dije se nuk figuron në regjistrat themeltarë të vjetërsisë në punë të subjektit NB Thumanë Krujë. Nga DRSSH Durrës, i është bërë me dije gjithashtu se nuk disponhet dokumentacion për këtë ndërmarrje. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë [...] ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të kërkesës civile [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë nuk ka kualifikuar drejtë çështjen e juridiksionit në shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 388 të KPC në rastin konkret. Si rrjedhojë, vendimi i gjykatës duhet të priset dhe çështja të dërgohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për vazhdimin e gjykimit.

Juridiksioni gjyqësor civil është parashikuar në nenin 36 të KPC, sipas të cilit janë në juridiksionin gjyqësor të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor është i përgjithshëm dhe i detyrueshëm (neni 1/2 i KPC). Një çështje mund të nxirret jashtë juridiksionit

gjyqësor vetëm kur ligji në mënyrë eksplicite ka përcaktuar se subjekti pretendues, përpara se t'i drejtohet gjykatës duhet të shterojë juridiksionin administrativ. Në këto raste mos ndjekja e juridiksionit administrativ pengon marrjen në shqyrtim të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ku është pranuar se juridiksioni gjyqësor prezumohet, për sa kohë ligji i posaçëm në mënyrë eksplicite nuk e ka kushtëzuar me ndjekjen e rrugës administrative. Në Vendimin Unifikues nr. 1, datë 26.11.2010, është konkluduar se: *“Ndjekja e rrugës administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative para se subjekti ti drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, pranon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët, eventualisht dhe sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ...”*

Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Ligji nr. 169/2020 *“Për Njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”*, është miratuar me datë 23.12.2020. [...] dhe ka hyrë në fuqi me datë 23.01.2021. Në nenin 1 të Ligjit ku përcaktohet qëllimi i tij, [...] Ligji ka gjithsej 6 dispozita dhe në asnjërën prej tyre, nuk parashikon në mënyrë të shprehur se për njohjen e faktit të vjetërsisë në punë, në kushtet e përcaktuara në të, duhet të shterohet rruga administrative, si kusht për të aktivizuar juridiksionin gjyqësor sipas nenit 388 të KPC.

Kolegji vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësit, ka patur si qëllim thjeshtëzimin e hetimit administrativ dhe shmangien e procedurave të panevojshme dhe të zgjatura gjyqësore për të vërtetuar fakte që nuk kanë nevojë të provohen dhe që mund të verifikohen lehtësisht nga organi administrativ. Miratimi i këtij ligji u imponua për shkak të praktikave abuzive të administratës publike në fushën e sigurimeve shoqërore, që në çdo rast të mungesës së dokumentacionit i adresonin subjektet që pretendonin të drejtën e pensionit të vërtetonin gjyqësisht faktin e vjetërsisë në punë në ish-kooperativat bujqësore.

Nga ana tjetër, proceset e gjata gjyqësore, në të gjithë shkallët e gjykimit dhe të pajustificuara, për provueshmërinë e fakteve botërisht të njohura, rrezikonte humbjen në thelb të së drejtës së pensionit, si e drejtë themelore kushtetuese me rëndësi jetike për shtresa vulnerabël të shoqërisë.

Zvarritja e procedurave hetimore, administrative apo gjyqësore, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së këtij ligji, por të moskuptimit si duhet të të drejtave dhe detyrimeve të organeve publike në hetimin administrativ (shih *Vendim nr. 00 – 2021 – 597, datë 14.04.2021; Vendim nr. 00-2021-565, datë 14.04.2021; Vendim nr. 00 – 2021 – 562, datë 14.04.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë* etj.).

Me qëllim verifikimin e pretendimit të palës kërkuese gjatë një procedure administrative, organi publik ka detyrimin ligjor të realizojë hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Përveç rasteve përjashtimore të parashikuar në ligj, organi publik është i detyruar të shprehet me vendim përfundimtar (shih nenin 90 të KPA), duke nxjerrë aktin administrativ që refuzon ose pranon kërkesën e palës për njohjen e së drejtës subjektive të pretenduar prej saj, pasi ka analizuar dhe vlerësuar në tërësi të gjitha faktet

dhe provat e administruara me iniciativë të palës ose edhe kryesisht prej tij.

Hetimi, marrja e provave, mbledhja e fakteve dhe vlerësimi i tyre në tërësi, si çështje e ndërmjetme e procedimit administrativ, nga e cila varet zgjidhja e çështjes, nuk është kompetencë dhe tagër vetëm i pushtetit gjyqësor, por është detyrim primar dhe funksional i organit publik që do të vendosë mbi kërkesën e palës së interesuar në procedimin administrativ.

Duke iu referuar neneve 77, 78, 79, 80 dhe 81 të KPA, ligjvënësi e ka pajisur organin administrativ me të njëjtin kapacitet ligjor për të hetuar, sikurse organet gjyqësore. Ai ka të drejtën dhe detyrimin të pranojë dhe të marrë prova nga pala në procedurën administrative, sipas të gjitha burimeve të provës të lejuara edhe në gjykimin administrativ apo civil: dokumente, prova me dëshmitar, deklarata të palëve, ekspertime etj. Neni 80/2 i KPA referon tek Ligji nr. 49/2012 për provat dhe mjetet e provës të lejuara në procedurën administrative dhe si rrjedhojë, në mënyrë komplementare edhe në dispozitat e KPC mbi burimet e provës për aq sa është e mundur. Në mënyrë simetrike me hetimin gjyqësor, hetimi administrativ thjeshtëzohet edhe nga prezumimet ligjore apo faktet botërisht të njohura, të cilat nuk kanë nevojë të provohen.

Nga ana tjetër, aksesit në gjykatë sipas neneve 32, pika "b" dhe "c" apo sipas nenit 388 të KPC, është mjet alternativ, e drejtë dhe garanci e palës së interesuar, por jo rrugë e detyrueshme për tu ndjekur, kusht pa të cilin nuk mund të vijojë procedura administrative. Po ashtu, për ngritjen e një padie me karakter deklarativ sipas nenit 32 të KPC apo për të investuar gjykatën sipas nenit 388 të KPC, nuk është e detyrueshme ezaurimi paraprakisht i juridiksionit administrativ. Mbetet në disponibilitetin e palës për të përzgjedhur mjetin se si do të rivendosë më shpejt dhe në mënyrë më eficiente të drejtat subjektive. Në këtë kuptim, Ligji nr. 169/2020 nuk solli risi në atribuimin për herë të parë të juridiksionit administrativ mbi hetimin e fakteve juridike me pasoja për palën në procedurën administrative, por e thjeshtëzoi atë dhe kufizoi diskrecionin e organeve vendimmarrëse (administrative apo gjyqësore), mbi vlerësimin e faktit juridik të vjetërsisë në punë, duke i hequr palës që pretendon të drejtën e pensionit, një barrë të paarsyeshme për të paraqitur prova në procedimin administrativ dhe gjyqësor (Vendim nr. 00–2021-706, datë 10.05.2021 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

[..]Duke qenë se prezumimet formalisht parashikohen nga ligji, arsyeja e daljes së Ligjit nr. 169/2020 ishte shkarkimi nga barra e provës të kërkuarit, në mënyrë të tillë që fakti juridik i viteve të punës në ish-kooperativat bujqësore, nga i cili varet e drejta e pensionit, në raste kur dokumentacioni është djegur, të ngrihej në nivelin e një prezumimi, para kujt do juridiksioni që do të merrej në shqyrtim (administrativ apo gjyqësor), i cili njihet *ex lege*, mjafton të provohet baza e prezumimit se: a) kërkuari nuk ka vuajtur dënimin me heqje lirie në atë kohë; b) nuk ka përfutuar nga sigurimet shoqërore, pension për invaliditet të plotë; c) ka qenë pjesëtar i kooperativës përkatëse.

Prezumimi, si çlirim nga barra e provës, konsiston në atë që disa fakte mund të deduktohen nga ekzistenca e fakteve të tjera me të cilat të parat kanë një lidhje shkakësore të domosdoshme dhe të drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë, duke operuar me instrumentin e prezumimeve ligjore, Ligjvënësi synon të përshpejtojë procesin e të

provuarit dhe të ekonomizojë procedurën e hetimit administrativ apo gjyqësor.

Përcaktimi me ligj, i këtij prezumimi, ka si bazë detyrimin që ka patur çdo pjesëtar i ish-kooperativës bujqësore për të punuar sipas legjislacionit të kohës dhe puna si detyrim ligjor në atë periudhë përbën fakt botërisht të njohur. Për shkak të këtij detyrimi, ekziston një lidhje shkakësore e drejtëpërdrejtë dhe e domosdoshme midis mungesës së rrethanave penguese për të punuar, sikurse përcaktohen në nenin 2/2 të Ligjit nr. 169/2020 dhe ekzistencës së marrëdhënies së punës së kujtdo, në këto organizime kolektive publike. E thënë ndryshe, mungesa e tre rrethanave përjashtuese të parashikuara në ligj, në mënyrë të domosdoshme passjell faktin se kushdo ka punuar sipas normës dhe ligjit të kohës në ish-kooperativat bujqësore. Kjo është rrjedhojë logjike për shkak të experiencës dhe marrëdhënieve shoqërore të asaj kohe.

Kolegji çmon të theksojë se, kjo analizë vlen në veçanti për rastin konkret, ku kërkuesi i është drejtuar më parë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës. Kjo e fundit, ka konkluduar se kërkuesi nuk ka dokumenta për të vërtetuar vitet e punës së pretenduara prej tij. Si rrjedhojë, e vetmja rrugë e mbetur e kërkuesit, ka qenë ajo gjyqësore dhe vërtetimi gjyqësor i faktit juridik për vjetërsinë në punë, me qëllim njohjen e së drejtës së pensionit. Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka patur detyrimin të shqyrtojë dhe ti japë zgjidhje me vendim përfundimtar, kërkesës së kërkuesit, [...] sipas nenit 388 të KPC, duke u bazuar, për aq sa është e mundur, në kriteret e vendosura në Ligjin nr. 169/2020, në vërtetimin e faktit juridik të viteve të punës të pretenduar prej tij.

KCGJL Vendim Nr.00-2023-2782, datë 31.05.2023 (Çështje familjare: Lënie e fëmijës edukim/rritje)

Në referim të nenit 38 të KPC gjykata nuk mund të disponojë për nxjerrjen jashtë juridiksionit në rastin e gjykimeve të njëkohëshme, kur të dyja gjykatat kanë juridiksion, gjykata shqiptare ka të drejtë vetëm të pezullojë shqyrtimin e çështjes. Vendimi i pezullimit të gjykimit të çështjes sipas nenit 38 të KPC është paraparë nga ligjvënësi si një garanci për palët në mënyrë që ata të kontrollojnë ecurinë e procesit në gjykatën e huaj dhe në rast të vështirësive të tij ose të pushimit të gjykimit në gjykatën e huaj, të kenë të drejtë të vazhdojnë gjykimin në Shqipëri të çështjes së pezulluar. Togfjalëshi “për administrimin më të mirë të drejtësisë” ka si qëllim që çështja të zgjidhet sa më lehtë e shpejtë në interesin më të lartë të fëmijës duke u vendosur në një balancë të pranueshme interesat e të gjithë subjekteve të përfshira në proces.

Juridiksioni i kërkimit kryesor për zgjidhjen e martesës është përcaktues për juridiksonin e pasojave të zgjidhjes së martesës, sikurse janë ato objekt gjykimi.

Fjalë kyçe: shqyrtimit kryesisht juridiksion, administrimin më të mirë të drejtësisë, juridiksion zgjidhje martese pazgjidhmërisht lidhur juridiksion zgjidhje pasojash

Rrethanat e çështjes:

Paditësi dhe e paditura kanë lidhur martesë në datë 25.03.2016. Nga kjo martesë ka lindur djali M.M në datë 15.10.2016. Paditësi ka jetuar në Amerikë dhe prej vitit 2021 është kthyer në Shqipëri, ndërsa e paditura vazhdon të jetoj në Amerikë me djalin.

Sipas certifikatës së gjendjes civile, Bashkia Tiranë, datë 22.09.2021 rezulton se paditësi, e paditura dhe djali i tyre kanë vendlindjen në Shqipëri dhe shtetësi shqiptare. Gjithashtu sipas certifikatave personale dhe vendbanimi i tyre është në Shqipëri.

Në seancë përgatitore, pasi është kryer seanca e pajtimit, pala e paditur ka paraqitur kërkesën për nxjerje jashtë juridiksioni të gjykatës shqiptare, duke parashtruar se paditësi përveçse është shtetas shqiptar ka dhe shtetësinë amerikane dhe e paditura së bashku me fëmijën e mitur edhe pse kanë vetëm shtetësi shqiptare jetojnë prej datës 18.04.2020 në SHBA. Aktualisht në këtë shtet është duke u zhvilluar një proces gjyqësor me palë paditëse Xh.M. dhe palë të paditur E.M me objekt “Caktimin e kujdestarisë mbi fëmijën e mitur M.M dhe caktimin e pensionit ushqimor për të”. Meqënëse çështja ka “element të huaj” caktimi i juridiksionit të gjykatës që duhet ta shqyrtojë atë përcaktohet nga ligji Nr. 10428 datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombetare private” .

[..]Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë [..]ka vendosur të pranojë juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e martesës midis E.M dhe Xh.M. Nxjerrjen jashtë juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kërkimet [..] Lënien e fëmijës për rritje dhe edukim të paditurës; Pagim pensioni ushqimor për fëmijën në masën 15.000 lekë në muaj duke u caktuar dhe e drejta relative personale me fëmijën. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] sjell në vëmendje se është qëndrim i konsoliduar se çështja e juridiksionit është një nga çështjet më të rëndësishme procedurale, mosrespektimi dhe moszgjidhja drejt e së cilës sjell automatikisht prishjen e vendimit. Përcaktimi i saktë i juridiksionit, ka rëndësi të madhe për vetë fatet e çështjes dhe për zgjidhjen përfundimtare të saj. Kjo është dhe arsyeja se përse KPC mungesën e juridiksionit gjyqësor e ka konsideruar si një nga shkeljet më të rënda të normave procedurale, gjë që sjell si pasojë prishjen e vendimit nga gjykatat më të larta (neni 472, pika (b) në referencë të nenit 467).

Në nenin 59 të KPC [..] Në analizë të dispozitës së mësipërme konstatohet se çështja e juridiksionit mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor nga çdo gjykatë e pushtetit gjyqësor dhe në çdo fazë gjykimi. Çdo lloj gjykate dhe në çdo shkallë gjykimi ka të drejtë të marrë në shqyrtim, të analizojë dhe të vendosë nëse çështja është në juridiksionin gjyqësor, nëse është në juridiksionin administrativ, nëse është në juridiksionin kushtetues, nëse duhet të gjykohet nga gjykata e arbitrazhit, nëse subjekti kërkues është një subjekt i huaj i cili gëzon imunitet diplomatik, etj.

Këtë gjë gjykata mund ta bëjë edhe kryesisht, pasi çështja e juridiksionit është e lidhur ngushtë me elementet që përbëjnë administrimin e procesit gjyqësor, si dhe me të drejtën për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të KEDNJ. [..]

Kolegji vlerëson se pavarësisht se këto dispozita flasin për konfliktin midis

juridiksionit administrativ dhe atë gjyqësor, i njëjti parim respektohet dhe në rastin e konfliktit që mund të ekzistojë midis juridiksionit gjyqësor shqiptar dhe juridiksionit gjyqësor të huaj. Duke iu kthyer çështjes objekt gjykim pavarësisht debatit dhe parashtrimet e palëve, gjykata nxjerrjen jashtë juridiksionit lidhur me kërkimin për lënien e rritje fëmije të paditurës dhe caktimin e pensionit ushqimor e ka argumentuar vetëm duke iu referuar Konventës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e Fëmijëve” e ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr.9443 datë 16.11.2005.

Gjykata ka arsyetuar se nuk mund ta bënte këtë në fazën e veprimeve paraprake siç përcakton neni 158/a i KPC, por e ka bërë pasi është njohur me faktet dhe rrethanat konkrete të rastit. Në fakt në kërkesëpadi paditësi ka parashtruar se e paditura dhe fëmija i mitur jeton në SHBA dhe kjo ishte një rrethanë e njohur për gjykatën që në veprimet paraprake. Për rrjedhojë, ajo kishte mundësi kryesisht të merrte në shqyrtim çështjen e juridiksionit të saj lidhur me të gjitha kërkimet objekt padie. E vetmja rrethanë për të cilën gjykata nuk ka qënë në dijeni ishte fakti se e paditura kishte paraqitur në gjykatën e SHBA një kërkesë për kujdestarinë e fëmijës, kërkesë që është ngritur pas asaj objekt shqyrtimi të paraqitur nga paditësi në gjykatën shqiptare.

Të gjitha pretendimet e paraqitura nga e paditura lidhur me nxjerrjen jashtë juridiksioni të **çështjes sipas ligjit nr.10428/2011** “Për të drejtën Ndërkombëtare Private” apo për zhvillimin e një procesi tjetër gjyqësor në SHBA, i cili pengonte zhvillimin e këtij procesi në gjykatën shqiptare, gjykata i ka rrëzuar si të pabazuara dhe ka vendosur nxjerrjen jashtë juridiksionit të kërkimeve të kujdestarisë dhe detyrimit për ushqim sipas Konventës [...] me arsyetimin se fëmija jeton në SHBA dhe në funksion të interesit më të lartë të fëmijës për dy kërkimet e tjera të padisë çështja mund të gjykohej më mirë dhe më lehtë nga gjykata e SHBA, pasi eksperti mund të vlerësonte më mirë gjendjen e fëmijës, kushtet e të paditurës, të ardhurat e palëve ndërgjyqëse etj. Kolegji vlerëson se ky arsyetim i gjykatës së shkallës së parë nuk justifikon mungesën e shqyrtimit kryesisht të çështjes së juridiksionit nga gjykata që në veprimet paraprake, pasi ajo ishte në dijeni të faktit që fëmija dhe e paditura jetonin në SHBA dhe nuk kishte as rrethanë të re dhe as të panjohur për gjykatën në këtë drejtim, që doli gjatë gjykimit.

Gjithsesi, pavarësisht parregullsisë procedurale të fazës, kur është marrë vendimi, duke mbajtur në konsideratë se vendimi për nxjerrjen jashtë juridiksionit mund të merret në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, Kolegji vlerëson se duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë të tij. Në tërësi të natyrës së çështjes dhe të kuadrit ligjor që rregullon atë, kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës ë parë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit për kërkimin e lënies së fëmijës për rritje dhe edukim dhe atë të detyrimit për ushqim nuk është në përputhje me ligjin.

Në aspektin procedural vendimi i gjykatës [...] është marrë në kundërshtim me nenet 37 e 38 të KPC, ku përcaktohet mënyra e disponimit të gjykatës shqiptare në rastet kur e njëjta çështje, për të njëjtin objekt e shkak ligjor është duke u gjykuar nga një gjykatë e huaj. Kjo situatë zbatohet kur si gjykata e huaj dhe ajo shqiptare kanë juridiksion për çështjen. Gjykata e shkallës së parë nuk ka mohuar ekzistencën e juridiksionit të gjykatës

shqiptare për çështjen, por ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit me arsyetimin se çështja për shkak të specifikës së vendqëndrimit të fëmijës në shtetin e huaj mund të zgjidhet më mirë në shtetin e huaj. Ky lloj disponimi bie ndesh me nenin 38 të KPC [..]

Në përputhje me dispozitën e sipërcituar arsyetimi i gjykatës për nxjerrjen jashtë juridiksionit ka të bëjë me pikën ‘c’ për administrimin më të mirë të drejtësisë. Megjithatë disponimi për nxjerrjen jashtë juridiksionit nuk gjen mbështetje në këtë dispozitë, pasi në rastin e gjykimeve të njëkohëshme, kur të dyja gjykatat kanë juridiksion, gjykata shqiptare ka të drejtë vetëm të pezullojë shqyrtimin e çështjes. Ky lloj vendimi i shërben mbrojtjes së interesave të të dyja palëve në respektim të parimit të aksesit në drejtësi. Vendimi i pezullimit të gjykimit të çështjes sipas nenit 38 të KPC është paraparë nga ligjvënësi si një garanci për palët në mënyrë që ata të kontrollojnë ecurinë e procesit në gjykatën e huaj dhe në rast të vështirësive të tij ose të pushimit të gjykimit në gjykatën e huaj, të kenë të drejtë të vazhdojnë gjykimin në Shqipëri të çështjes së pezulluar. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit vë në pamundësi paditësin për të kërkuar të drejtat e tij për mënyrën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore të fëmijës, të drejtën e takimit me të në gjykatën shqiptare edhe në një kohë të mëvonëshme pavarësisht nga fakti se gjykimi i çështjes në gjykatën e huaj mund të pushohet për mosparaqitje të paditëses (të paditurës në procesin në Shqipëri) ose heqje dorë të saj nga gjykimi i çështjes. Togfjalëshi “për administrimin më të mirë të drejtësisë” ka si qëllim që çështja të zgjidhet sa më lehtë e shpejtë në interesin më të lartë të fëmijës duke u vendosur në një balancë të pranueshme interesat e të gjithë subjekteve të përfshira në proces, gjë që nuk është analizuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë.

Transferimi i juridiksionit të gjykatave shqiptare një gjykatë të huaj është parashikuar në nenin 37 të KPC [..]. Komponenti “i huaj” si shkak për transferimin e juridiksionit ka të bëjë kryesisht me dy element; a- shtetësia ose b-vendqëndrimi dhe c-në raste përjashtimore me parashikimet e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në rastin konkret është fakt, që palët nuk kanë marrëveshje për zgjedhjen e juridiksionit pasi secila prej tyre ka ngritur padi të vecanta në Shqipëri dhe në Amerikë lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore. E paditura e ka ngritur padinë në Amerikë, pas paraqitjes së padisë në Shqipëri nga paditësi.

Sipas nenit 1 parag 2 i ligjit nr.10428/2011 [..] Nga kjo dispozitë konstatohet se elementi i huaj për çështjen konkrete i referohet vendqëndrimin të fëmijës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Megjithatë, ky element nuk ka relevancë për të përjashtuar juridiksionin e gjykatës shqiptare në gjykimin e kërkimeve për mënyrën e ushtrimit e përgjegjesisë prindërore dhe detyrimin për ushqim si pasojë e zgjidhjes së martesës. Palët ndërgjyqëse janë me shtetësi shqiptare, martesa është lidhur në Shqipëri dhe fëmija ka lindur në Shqipëri. Vendbanimet zyrtare sipas akteve të dosjes janë në Shqipëri, Tiranë, pavarësisht vendqëndrimit të palës së paditur në SHBA, i cili në këtë rast nuk ka relevancë për të ndryshuar juridiksionin, pasi ligji është shumë i qartë se në cilin rast konsiderohet ‘element i huaj’ që çon në nxjerrjen jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare. Sipas nenit 8 të ligjit 10428/ [..].Pra dhe pse vetëm paditësi ka dhe shtetësinë amerikane për efekt të këtij ligji shtetësia shqiptare ka epërsi.

Gjithashtu juridiksioni i gjykatave shqiptare për marrëdhëniet prind fëmijë dhe detyrimin për ushqim bazohet në nenin 76 të ligjit nr.10428/2011, [...] ndërkohë në rastin konkret të dy bashkëshortët dhe fëmija kanë shtetësi shqiptare. Pra, në unitet të të gjitha dispozitave ligjore kuptohet se gjykata shqiptare ka juridiksion si për zgjidhjen e martesës ashtu edhe për rregullimin e pasojave të saj si mënyra e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore dhe detyrimi për ushqim.

Në përputhje me nenin 37 të KPC dhe nenin 116 të Kushtetutës, gjykatat shqiptare kanë të drejtë të zbatojnë drejtëpërdrejtë marrëveshjet ndërkombëtare, pasi ato konsiderohet pjesë e legjislacionit të brendshëm. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka kuptuar e zbatuar drejtë rregullat për përcaktimin e juridiksionin të parashikuara nga Konventa [...] Kështu në zbatim të nenit 5 dhe 6 të Konventës juridiksioni për të vendosur marrjen e masave të mbrojtjes së fëmijës dhe pasurisë së tij i përket vendqëndrimit të fëmijës dhe nëse është emigrat ose zhvendosur për shkak të problemeve të vendit të tij, në një vend tjetër, atëherë juridiksioni i përket vendit ku ndodhet fëmija. Neni 8 i Konventës, ku gjykata e shkallës së parë bazon vendimin e saj, rregullon situatën juridike kur një shtet kontraktues i Konventës, që ka juridiksion sipas nenit 5 e 6 , pra që është vendi i banesës së përhershme të fëmijës ose ai i zhvendosjes së fëmijës, autorizon një shtet tjetër kontraktues të marrë masa, që ai i konsideron të nevojshme ose pezullon gjykimin duke i orientuar palët që t'i drejtohen shtetit tjetër të adresuar, nga ato të përcaktuara në nenin 8/2, ku përfshihet edhe shteti autoriteti i të cilit është duke shqyrtuar një kërkesë për divorc midis prindërve të fëmijës. Sipas nenit 8/3 të Konventës parashikohet se shteti i adresuar mund të marrë juridiksion në vend të atij që e ka juridiksionin, kur kjo është në të mirë të fëmijëve. Pra, kjo dispozitë zgjidh situatën, kur shteti që gjykon një kërkesë ndarje nuk e ka juridiksionin për të vendosur për fëmijën por juridiksioni i përcillet atij nga shteti kontraktues, që e ka juridiksionin sipas nenit 5 dhe 6 të Konvetës, si shteti ku ka banesën e përhershme fëmija. Po sipas nenit 9 të Konventës shtetet e përcaktuara në paragrafin 8/2 të konventës (ku përfshihet dhe ai i gjykimit të divorcit) kërkojnë autorizim nga shteti i vendbanimit të përhershëm të fëmijës për të pasur juridiksion në marrjen e masave të nevojshme për fëmijën. Pra, kuptohet se nenet 8 e 9 të Konventës rregullojnë rastet kur shteti i divorcit nuk ka juridiksion për të vendosur për fëmijët, por i përcillet ky juridiksion nga autoriteti i shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës. Në rastin konkret, mungon kjo situatë pasi gjykata e shkallës së parë Tiranë është gjykata, që shqyrton kërkesën për divorc dhe ka juridiksion për të vendosur edhe për çështjen e marrëdhënieve prind-fëmijë si pasojë e zgjidhjes së martesës. Si rrjedhim kjo gjykatë nuk ka të drejtë t'i transferojë juridiksionin e saj gjykatës tjetër të vendqëndrimit të fëmijës.

Konventa [...] përcakton qartë se shteti që shqyrton kërkesën për divorc ka juridiksion për masat mbrojtje për fëmijën [...] në nenin 10 të saj; [...] Në përputhje me këtë dispozitë del se shteti kontraktues, që ka juridiksion për të vendosur për divorcin e prindërve ka juridiksion për të marr masa për mbrojtjen e fëmijës nëse e parashikon ligji i tij dhe kur prindi ka banesën e përhershme në këtë shtet dhe ka përgjegjësi ligjore në lidhje me fëmijën. Ligji ynë nr.10428/2011 parashikon shprehimisht se gjykatat shqiptare kanë

juridiksion për të vendosur jo vetëm për zgjidhjen e martesës, por edhe për pasojat në drejtim të mënyrës së ushtrimit të përgjegjesisë prindërore për fëmijët e detyrimin për ushqim përderisa si prindërit edhe fëmija janë shtetas shqiptar dhe paditësi ka banesë të përhershme në Shqipëri. Sipas nenit 10 të Konventës së sipërcituar pranohet se juridiksioni i zgjidhjes së martesës i jep gjykatës juridiksion edhe për të vendosur për masat mbrojtëse ndaj fëmijës. Për sa më sipër është e qartë se edhe sipas Konventës gjykata shqiptare kanë juridiksion për të shqyrtuar kërkimet e paditësit lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore dhe detyrimin për ushqim.

Gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksion pasi jo vetëm që ky vendim nuk gjen mbështetje në nenin 8 të Konventës që ajo referon por bie ndesh me nenin 13 të Konventës. [...] Në përputhje me këtë dispozitë rezulton se kërkesa për rregullimin e përgjegjesisë prindërore dhe detyrimin për ushqim është paraqitur në gjykatën e shkallës së parë Tiranë, e cila ka juridiksion për çështjen sipas nenit 10 i Konventës. Kjo kërkesë ka qënë në proces shqyrtimi në këtë gjykatë, para se të paraqitej kërkesa për kujdestarinë mbi fëmijën nga e paditura në gjykatën amerikane. Për rrjedhojë gjykata e Sh.B.A. nuk mund të shqyrtonte kërkesën për kujdestari ndaj fëmijës, që ishte objekt procedimi para gjykatës shqiptare. Pikërisht, për këtë shkak gjykata amerikane ka shtyrë seancën dhe nuk i ka shqyrtuar kërkesat, duke pranuar kështu se gjykatat shqiptare kishin juridiksion në shqyrtimin e çështjes. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë Tiranë për të nxjerë çështjen jashtë juridiksionin për kërkimet e përgjegjesisë prindërore e detyrimin për ushqim, nuk gjen mbështetje në asnjë prej neneve të Konventës.

Në rezume sa më sipër Kolegji, konstaton se Konventa nuk parashikon transferimin e juridiksionit midis shteteve, që kanë njëkohësisht juridiksion për shqyrtimin e çështjes. Sikurse rregullohet nga neni 8 i Konventës instituti i transferimit të juridiksionit zbatohet në ato raste kur autoriteti juridiksional (gjykata ose autoriteti qëndror) ia kalon shqyrtimin e çështjes autoritetit të një shteti tjetër jojuridiksional. Ky i fundit e fiton juridiksionin e çështjes nga vendimi autorizues i dhënë nga autoriteti juridiksional i shtetit tjetër kontraktues, situatë që mungon në rastin konkret. Konventa ka vendosur rregulla në rast të konkurimit të juridiksioneve të disa shteteve për shqyrtimin e çështjes (neni 5 deri në 10). Kështu juridiksioni për masat mbrojtëse ndaj fëmijëve i përket atij shtetit kontraktues, të cilit i është paraqitur më parë kërkesa (neni 13), ndërsa shtetet e tjera mund të marrin vetëm masa të përkohëshme mbrojtëse, fuqia e të cilave përfundon kur merren e njihen masat e vendosura nga shteti që kishte juridiksion. Administrimi më i mirë i drejtësisë sic arsyeton gjykata e shkallës së parë nuk përbën shkak për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit nga gjykata shqiptare, si në bazë të konventës dhe as në bazë të KPC. Sipas nenit 37 të KPC transferimi i juridiksionit të gjykatës shqiptare në çështje i kalon autoriteti të një shteti të huaj, kur parashikohen shprehimisht në marrëveshje ndërkombëtare, gjë që në rastin konkret mungon.

Argumentat e gjykatës së shkallës së parë se gjykimi në SHBA është në interes të fëmijës për efekt të administrimit më të mirë të drejtësisë është i pabazuar. Nisur nga objekti i kërtimeve në padi pala paditëse nuk ka ngritur pretendime për të mbajtur

kujdestarinë ndaj fëmijës, por ka pretenduar të drejtën e takimit të tij dhe mbajtjen e përkohshme, duke pranuar kështu që fëmija të vijojë të qëndrojnë pranë nënës së tij. Ky objekt kërkimi nuk çënon të drejtën e fëmijës për të vijuar qëndrimin në shtetin amerikan. Gjithashtu, detyrimi për ushqim si një pasojë e zgjidhjes së martesës do të rëndojë mbi paditësin, përderisa ai ka kërkuar që fëmija të vazhdojë të mbahet nga e paditura. Për rrjedhojë lidhur me këtë detyrim vendimi do të ekzekutohet në Shqipëri, pasi këtu banon paditësi. Për këtë pjesë vendimi i gjykatës shqiptare është direkt i ekzekutueshëm në Shqipëri pa qënë e nevojëshme të kalojë në një procedurë njohje në ndryshim nga vendimi i huaj, që do i nënshtrohej kushteve të parashikuara nga nenet 394 e vijues të K.Pr.Civile. Në këtë mënyrë e paditura i përmbush më mirë interesat e fëmijës në procesin në Shqipëri se sa nga gjykimi për këto pjesë të kërkimeve në SHBA, pasi vendimi i kësaj të fundit nuk ka fuqi ekzekutive në Shqipëri pa kaluar procesin e njohjes. Ndërkohë është paditësi ai i cili për të realizuar takimet me fëmijët duhet të drejtohet për njohje gjykatës amerikane. Për sa i përket arsytimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me marrjen e provave si për pyetjen e fëmijës, intervistimin e tij etj, Kolegji vlerëson se gjykata shqiptare ka mundësi të sigurojë ardhjen e fëmijës në Shqipëri përderisa ai ka shtetësinë shqiptare ose palët mund të sigurojnë provat në shtetet respektive me letërporosi. Për sa më sipër Kolegji vlerëson çështja objekt shqyrtimi nuk ka asnjë specifikë ligjore dhe fakti, për nxjerrjen jashtë juridiksionit

Në analizë si më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...] nuk është në përputhje me ligjin pasi nga njëra anë pranon juridiksionin për zgjidhjen e martesës, por jo rregullimin e pasojave, gjë që bie ndesh me nenin 76 të Konventës. Dy kërkimet e tjera janë të lidhura ngushtësisht dhe të ndërvarura nga kërkimi kryesor për zgjidhjen e martesës. Juridiksioni i kërkimit kryesor për zgjidhjen e martesës është përcaktues për juridiksonin e pasojave të zgjidhjes së martesës, sikurse janë ato objekt gjykimi.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2020-606, datë 18.11.2020

KCGJ Vendim Nr.00-2021-181, datë 10.02.2021 (Sigurim i Padisë)

Në vendosjen e masës së sigurimit të padisë, gjykatat më të ulëta duhet marrin në analizë të gjitha kushteve themelore të parashikuara nga ligjvënësi për identifikimin e qartë të rrezikut konkret që i shkakton palës paditëse një dëm të pariparueshëm, deri në momentin e shqyrtimit të çështjes me vendim përfundimtar (periculum in mora).

Fjalë kyçe: sigurim padie, dhomë këshillimi, shqyrtim seancë përgatitore, rreziku konkret i momentit, dëm të pariparueshëm

Rrethanat e çështjes:

Paditësit në këtë gjykim janë trashëgimtarë ligjorë të subjektit të shpronësuar S.P.. Ka rezultuar se i ndjeri S.P., ka ndërruar jetë në datën 04.04.1967 dhe me me vendimin

nr. 980, datë 22.02.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të, duke u caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, fëmijët Zh.Xh., L.P. dhe T.P..

Nëpërmjet vendimit gjyqësor [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar dëshmia testamentare për të ndjerën T.P., e cila rezulton të ketë ndërruar jetë në datën 01.02.2007, duke përcaktuar si trashëgimtarë testamentarë paditësit G.Xh. dhe I.Xh.. Ndërsa, me vendimin [...] të noterit publik, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerën L.P., e cila ka ndërruar jetë në datën 06.11.1991, duke përcaktuar si trashëgimtarë të vetme paditësen Zh.Xh.. Paditësit në këtë gjykim, kanë pretenduar se janë bashkëpronarë të një pasurie të paluajtshme "Truall", [...] Këtë fakt, pala paditëse e vërteton me certifikatën për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP Tiranë me datë 23.01.2018. Origjinën e pronësisë mbi pronën objekt gjykimi, pala paditëse ka pretenduar se rrjedh nga vendimi nr. 7, datë 03.04.1997 të ish-K.K.K. Pronave pranë Bashkisë së Tiranë, me të cilin, është vendosur: *"Të njohë Z. S.P., ish-pronar të pronës së tij, të përbërë nga një tokë me sipërfaqe 1299 m2, e ndodhur në Tiranë[...]"*

Ka rezultuar se për pasurinë e paluajtshme prej 1299 m2 të trajtuar në vendimin e dhënë nga KKKP Bashkia Tiranë në favor të trashëgimtarëve ligjorë të subjektit ish-pronar S.P., në vitin 2001 është lidhur kontrata e qirasë [...] midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (në cilësinë e qiradhënësit) dhe shoqërisë "SC" sh.p.k [...] Trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar S.P., i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë me objekt: *"Kundërshtimin e vendimit nr. 7, datë 03.04.1997 të ish-K.K.K.Pronave pranë Bashkisë së Tiranë. Sigurimin e padisë dhe pezullimin e qfarëdolloj veprimi të shoqërisë "M." sh.p.k dhe Ministrisë së Ekonomisë mbi sipërfaqen prej 1650 m2 të përcaktuar më poshtë"*. Në këtë gjykim, pala paditëse ka thirrur si palë të paditur Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe si persona të tretë në gjykim, Shoqërinë [...] Ministrinë e Ekonomisë dhe Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes së mësipërme, me vendimin [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: *"Pranimin e kërkesë padisë. Anulimin e vendimit nr. 7, datë 03.04.1997 të K.K.K.Pronave. Detyrimin e të paditurit K.K.K.Pronave të njohë pronësinë mbi sipërfaqen prej 1650 m2, të trashëgimtarëve të S.P. si dhe tu kthejë atyre sipërfaqen prej 1299 m2. Sip prej 365 m2 ti kompensohet"*. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin [...] të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Pas marrjes formë të prerë të vendimit të gjykatës, ndërmjet palëve është nënshkruar aneks kontrata me [...] nëpërmjet së cilës për sipërfaqen prej 1299 m2 truall, e drejta e qiradhënësit i ka kaluar pronarëve të ligjshëm. Në këtë akt palët kanë parashikuar se: *"Marrëdhëniet ndërmjet qiradhënësit të ri (Zh.Xh.) dhe qiramarrësit për sipërfaqen prej 1299 m2 rregullohen me marrëveshje të veçantë ndërmjet tyre"*.

Ka rezultuar se për pronën objekt të këtij gjykimi, ndërmjet paditëses Zh.Xh. dhe të paditurit A.A. janë nënshkruar disa kontrata qiraje me afate të përcaktuara, e konkretisht, kontrata e datës 18.02.2006 me afat deri në 30.09.2006, kontrata e datës 11.11.2006 me afat deri në datën 05.03.2007.

Pas mbarimit të afatit të qirasë, paditësit kanë kërkuar që i padituri ti lirojë dhe dorëzojë sendin, pasi nuk ka më asnjë titull të ligjshëm për gëzimin e saj, si dhe po i shkakton një dëm të rëndë pasuror. Referuar palës paditëse, pala e paditur ka treguar shenja të shmangies nga detyrimi dhe në mënyrë të paligjshme, vazhdon edhe sot të përdorë pasurinë duke nxjerrë të ardhura dhe duke mohuar të drejtën ligjore të pronarëve të ligjshëm të saj për të nxjerrë të ardhura nga ky send. [..]

Në kushtet kur mes palëve nuk është zgjidhur mosmarrëveshja në rrugë jashtë-gjyqësore, [..] pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë [..] duke kërkuar lirim dhe dorëzimin e pasurisë së tyre të paluajtshme, tokë truall, si dhe shpërblimin për përdorimin e këtij sendi pa asnjë lloj tagri deri në momentin e lirim të tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [..] ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Marrjen e masës provizore për sigurimin e padisë, duke urdhëruar lirim dhe menjëhershëm të truallit objekt gjykimi [...] Gjykata e Apelit Tiranë, [..] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor [..] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur A.A. përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC të cilat i bëjnë të cënueshme vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta. Kolegji çmon të theksojë se nga ana e dy gjykatave më të ulëta nuk janë interpretuar drejtë dispozitat e ligjit procedural që kanë lidhje me vendosjen e masës së sigurimit të padisë, si dhe nuk është respektuar qëndrimi i mbajtur në praktikën e unifikuar gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

[..] Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji, konstaton se të dyja gjykatat më të ulëta nuk e kanë kuptuar drejtë natyrën e kërkesës objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë e kanë zgjidhur atë në kundërshtim me dispozitat ligjore të zbatueshme. Këto gjykata nuk rezultojn të kenë bërë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, nuk kanë bërë një interpretim të drejtë të fakteve dhe rrethanave, nuk rezultojn tu kenë dhënë të dyja palëve pjesëmarrëse në këtë gjykim, përgjigje në lidhje me kërkesat e tyre, si dhe nuk kanë bërë një interpretim të drejtë të ligjit të zbatueshëm dhe praktikës gjyqësore tashmë të unifikuar.

Pavarësisht se shkeljet procedurale që kanë kryer gjykatat më të ulëta, nuk janë të asaj shkalle sa ta bëjnë nul procesin e zhvilluar pranë tyre, Kolegji vlerëson se duhet të marrë në shqyrtim ato dhe tu japë përgjigje të arsyetuara, me qëllim që ti ndreqë këto të meta në shkallën më të lartë të gjykimit. Kështu, Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar parashikimet ligjore për ti garantuar palës së paditur një proces të rregullt ligjor, pasi nuk rezultojn që kjo gjykatë ti ketë dhënë përgjigje të paditurit A.A., i cili ka pretenduar shkelje të rregullave procedurale të gjykimit që kanë të bëjnë me formimin e trupit gjykues, sipas përcaktimeve të nenit 35 të KPC, [..]

Pala e paditur A.A., ka pretenduar para Gjykatës së Apelit Tiranë faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur rëndë parashikimet e nenit 35, pika 1, shkronja “a” të KPC, pasi nuk rezultojn që të ketë formuar trupin gjykues me tre gjyqtarë në shqyrtimin

e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, duke kryer kështu një shkelje të rëndë procedurale. Këtë pretendim, pala e paditur e ka ngritur në kuadër të faktit që padia e paraqitur për shqyrtim ka një vlerë mbi 50 milion lekë dhe si e tillë, duhet të ishte gjykuar nga një trupë gjykuese e përbërë prej tre gjyqtarësh dhe jo nga një gjyqtar i vetëm sikundër ka ndodhur në fakt.

Kolegji, vlerëson se ky pretendim i palës së paditur nuk përbën shkelje procedurale të asaj shkalle, sa ta bëjë gjykimin në shkallë të parë të pavlefshëm në këtë fazë në të cilën ndodhet gjykimi, duke ju referuar si shkak mosformimit të trupit gjykues me tre gjyqtarë. Është tashmë një praktikë e gjithpranuar se formimi i drejtë i trupit gjykues është garanci për të pasur një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye, ligjvënësi formimin e drejtë të trupit gjykues e ka kategorizuar në ato lloj çështjes, të cilat, çmohen kryesisht nga gjykata, pavarësisht fazës apo shkallës ku ndodhet gjykimi.

Në këtë drejtim, formimi i drejtë i trupit gjykues është një çështje që nuk kërkon domosdoshmëri që të ketë kërkesë nga palët, pasi ajo duhet të vlerësohet kryesisht nga gjykata, për shkak të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Ky ka qenë edhe thelbi i ndryshimit të kësaj dispozite në vitin 2017, kur ligjvënësi e ndryshoi nenin 35 të KPC, duke e bërë shkronjën “a” të këtij neni me karakter urdhërues, në ndryshim nga parashikimi i mëparshëm, për të cilin, ligjvënësi kishte parashikuar që për padi me vlerë më të madhe se 20 milion lekë, gjykata mund ta shqyrtonte çështjen me trupë gjykuese të përbërë me tre gjyqtarë, vetëm nëse një nga palët në gjykim, e kërkonte këtë gjë në seancë përgatitore, sipas nenit 158/a të këtij Kodi.

Në momentin e shqyrtimit të kësaj çështje (padia është depozituar në datën 02.11.2018), formimi i trupit gjykues me tre gjyqtarë për shqyrtimin e padive me vlerë mbi 50 milion lekë është detyrim ligjor, i cili garanton kryerjen e një procesi të rregullt ligjor. Rezulton se në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga një gjyqtar i vetëm, ka marrë në shqyrtim në datën 09.11.2018, në seancë përgatitore, kërkesën e palës paditëse për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, në përputhje me parashikimet e nenit 158/a të KPC, [..]

Kolegji, çmon të evidentojë faktin se, shqyrtimi i kërkesës për vendosjen e sigurimit të padisë, përbën një kërkesë që ka karakter emergjent dhe duhet të shqyrtohet nga gjykata brenda afatit 5 ditor, referuar këtu parashikimeve të nenit 202 të KPC, [..] Në kushtet kur pala paditëse, ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë së bashku me paraqitjen e padisë së themelit, gjykata ka pasur si detyrim që të marrë në shqyrtim këtë kërkesë në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të nenit 185/a të KPC, të cilat përbëjnë veprime procedurale që kryhen nga gjyqtari i vetëm (relator).

Fakti që gjykata ka vlerësuar që të mos e shqyrtojë kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë në dhomë këshillimi, por ka vlerësuar që ta shqyrtojë në seancë përgatitore me prani të palëve, nuk përbën shkelje procedurale, pasi është gjyqtari ai që vlerëson nëse shqyrtimi i kërkesave të tilla mund të bëhet vetëm mbi bazë aktesh, apo edhe duke u dëgjuar pretendimet e palëve në proces. Ky veprim vjen tërësisht në përputhje me parashikimet e nenit 158/b [..]

Për sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se në shqyrtimin e kërkesës së palës

paditëse për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka pasur detyrimin që të formojë trupin gjykues me tre gjyqtarë për shqyrtimin e kësaj kërkesë (edhe pse padia objekt shqyrtimi dukshëm rezultoi të ketë një vlerë mbi prej 50 milion lekë, duke ju referuar vetëm objektit të padisë për detyrimin e të paditurve që ti paguajnë paditësve shumës prej 568.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD), pasi shqyrtimi i këtyre lloj kërkesave për shkak të karakterit emergjent që ato kanë, janë kërkesa që shqyrtohen nga gjykata brenda afateve shumë të shkurtra (5 ditë) dhe përbëjnë veprime të ngutshme që kryhen nga gjyqtari i vetëm, në kuptim të nenit 158/a të KPC. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se pretendimi që ka ngritur pala e paditur se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer një shkelje të rëndë procedurale e cila e bën nul procesin e gjykimit në këtë shkallë nuk qëndron, dhe si e tillë duhet rrëzuar.

Gjithashtu, Kolegji çmon se të theksojë se edhe pretendimi tjetër me karakter procedural që ka ngritur pala e paditur në këtë gjykim, A.A., i cili lidhet me mosnjofitim e tij për zhvillimin e seancës përgatitore të 09.11.2018 (seancë në të cilën, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur masën e sigurimit të padisë), nuk qëndron dhe si i tillë duhet të rrëzohet. Kolegji, çmon të theksojë se, mos marrja dijani e palës së paditur A.A. për zhvillimin e seancës përgatitore në të cilën gjykata ka marrë vendimin për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, nuk përbën shkelje të rëndë të procedurës së gjykimit, e cila ta bëjë të pavlefshëm gjykimin apo të ketë ndikuar në dhënien e vendimit objekt gjykimi për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

Në kushtet kur ligjvënësi ka parashikuar se kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi (pa praninë e palëve) nga gjyqtari i vetëm për shkak të karakterit emergjent të saj, Kolegji vlerëson se, mosnjoftimi i palës së paditur për shqyrtimin e kësaj kërkesë nuk e çënon procesin e rregullt ligjor, përse kohë vendimi për caktimin e masës së sigurimit të padisë është i ankimeshëm sipas parashikimeve të nenit 209 të KPC dhe si i tillë, ai është i detyrueshëm për t'ju komunikuar palëve ndërgjyqëse, në mënyrë që ato të kenë mundësi mbrojtjeje, nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit të veçantë ndaj tij.

Kolegji, çmon të evidentojë faktin se, edhe sikur në rastin objekt shqyrtimi do të konstatohej se dy gjykatat më të ulëta kanë kryer shkelje të rënda procedurale gjatë shqyrtimit të kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, këto shkelje nuk do të përbënin shkak për të prishur dy vendimet dhe për ta kthyer çështjen sërish për rigjykim. Kjo për faktin se, këto lloj çështjesh kanë karakter emergjent dhe janë vendime të ndërmjetme, të cilat mund të ndryshohen deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes me vendim përfundimtar. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë ka detyrimin që ti shqyrtojë këto çështje në themel të tyre, kur ato i paraqiten me ankim (rekurs) të veçantë duke i dhënë zgjidhje në themel të çështjes, si dhe duke rregulluar të gjitha gabimet në procedim që mund të kenë kryer gjykatat më të ulëta, kur ato kanë mundësi të rregullohen në një shkallë më të lartë gjykimi.

Ky qëndrim, përbën tashmë një qëndrim konstant të Gjykatës së Lartë (referojuni vendimit nr. 00-2006-363 (849), datë 29.06.2006 të Gjykatës së Lartë), me të cilin është konkluduar se për vendimet e ndërmjetme objekt rekursi, nuk zbatohen rregullat

e përgjithshme në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, për shkak se ato kanë karakter urgjent dhe do të duhet të gjykohej me shpejtësi. Këto vendime nuk mund të prishen dhe të kthehen për rigjykim sipas nenit 467 të KPC, por për këto lloj vendimesh duhet të konkludohet përfundimisht nga Gjykata e Lartë. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson të marrë në shqyrtim të dyja vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta, për të vlerësuar në themel nëse vendosja si masë e sigurimit të padisë objekt shqyrtimi, për lirim dhe dorëzimin e menjëhershme të pasurisë së paluajtshme, tokë truall me sip. 1299 m², nga ana e palës së paditur në favor të palës paditëse deri në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, është një bërë ose jo në përputhje me dispozitat ligjore materiale e procedurale të zbatueshme.

Në lidhje me shqyrtimin e kësaj çështjeje, Kolegji çmon të evidentojë faktin se, në caktimin e masës së sigurimit të padisë, gjykata i referohet kërkesave që parashikon dhe kërkon ligji procedural, konkretisht neni 202 i KPC, [...] Në analizë të dispozitës ligjore të mësipërme, rezultojnë se ligjvënësi ka parashikuar dy kushte themelore për të vendosur masën e sigurimit të padisë: (i) ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues çënohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës; (ii) të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata. Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve përkatëse në çdo shkallë gjykimi, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës [...] dhe nenit 13 të KEDNJ.

[...] Gjithashtu, KPC ka garantuar edhe standardin e proporcionalitetit të këtij kufizimi, duke parashikuar se sigurimi i padisë mund të vendoset përkundërt një garancie pasurore nga pala paditëse, për dëmin që mund të shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë (neni 202/b e KPC). Po ashtu, për të garantuar proporcionalitetin, në nenin 206/2 të KPC është parashikuar se sigurimi i padisë nuk mund të bëhet për një shumë më të madhe se ajo e padisë.

Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se asnjë nga gjykatat më të ulëta që është përfshirë në shqyrtimin e kësaj çështjeje, nuk rezultojnë të ketë kryer një analizë ligjore të mirëfilltë në vendimet e dhëna prej tyre, në të cilin të identifikohet qartësisht se cili është rreziku konkret i momentit që i shkakton palës paditëse një dëm të pariparueshëm, deri në momentin e shqyrtimit të çështjes me vendim përfundimtar (*periculum in mora*). Në asnjë nga vendimet objekt të këtij gjykimi nuk rezultojnë që gjykata të ketë marrë në analizë dhe shqyrtim të gjitha kushtet themelore që ka parashikuar ligjvënësi për të vendosur masën e sigurimit të padisë, apo të ketë arsyetuar ligjërisht nëse përdorimi i pasurisë së paluajtshme tokë truall të përbëjë një rrezik konkret, e cila mund të pamundësojë ose të vështirësojë përmbushjen e një detyrimi monetar.

Të dyja gjykatat më të ulëta janë mjaftuar me faktin se pala paditëse është pronare legjitime e pronës, ndërsa të paditurit në këtë gjykim e përdorin këtë pasuri pa asnjë titull të ligjshëm, duke i shkaktuar palës paditëse një dëm të konsiderueshëm, i cili, do të bëhet edhe më i madh, nëse pala e paditur vijon të mbajë në posedim truallin prej

1299 m2 dhe të sigurojë të ardhura prej tij. Asnjë prej gjykatave më të ulëta, nuk ka analizuar se cili është dyshimi i arsyeshëm që e ka detyruar gjykatën për të vendosur si masë sigurimi padie lirimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të truallit prej 1299 m2. Gjithashtu, në asnjë prej vendimeve objekt shqyrtimi në këtë gjykim, nuk është analizuar se sa proporcionale dhe e justifikuar ligjërisht është vendosja e kësaj mase për sigurimin e padisë, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të palës paditëse ose të një interesi publik. Referuar përmbajtjes së dy vendimeve objekt shqyrtimi, nuk rezulton që gjykatat më të ulëta të kenë marrë në shqyrtim situatën financiare dhe ekonomike e palës së paditur në lidhje me mundësinë e saj për të përmbushur detyrimin monetar të kërkuar në padi.

Pala paditëse në këtë gjykim, ka pretenduar se trualli prej 1299 m2 është përdorur nga pala e paditur për gati 10 vjet pa përmbushur detyrimet monetare, pra, pa paguar qiranë për të cilin kishin lidhur edhe aneks kontratën [...]. Në këtë drejtim, përdorimi i sendit nga ana e palës së paditur pa përmbushur detyrimet ligjore, nuk përbën një të dhënë të re, e cila të identifikohet si një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm, me qëllim që gjykatat të vendosnin si masë të sigurimit të padisë lirimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të truallit me sipërfaqe 1299 m2, pa u zgjidhur çështja me vendim përfundimtar. Në këtë kuptim, pretendimi i palës paditëse për tu vendosur si masë e sigurimit të padisë lirimi dhe dorëzimi i truallit objekt shqyrtimi, me arsyetimin se, vijimi i mbajtjes së tij nga pala e paditur do të rriste vlerën e dëmit të shkaktuar dhe të kërkuar në padi, duke sjellë si pasojë pamundësinë e ekzekutimit të tij, nuk rezulton të jetë i provuar dhe i mbështetur në ligj.

Pamundësia financiare e palës së paditur për të paguar detyrimin në masën prej 568.000 [...] USD, nuk mund të gëzojë mbrojtje ligjore në kuptim të nenit 202 të KPC, duke u vendosur si masë sigurimi padie lirimi dhe dorëzimi i menjëhershëm i sipërfaqes së truallit objekt gjykimi. Për këtë arsye, pala paditëse por edhe gjykatat më të ulëta, duhet të kishin mbajtur në vëmendje faktin se, për të siguruar shlyerjen e detyrimit monetar objekt të këtij gjykimi, duhet të ishte hetuar dhe provuar në gjykim se cilat ishin pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që dispononin palët e paditura në këtë gjykim si: (i) llogari bankare; (ii) asete të ndryshme të regjistruara në regjistrat publikë (aksione në shoqëri të ndryshme, pasuri të paluajtshme në emër të tij etj), të cilat, mund të kishin një vlerë të tillë që mund të siguronin përmbushjen e detyrimit në masën e kërkuar nga pala paditëse në këtë gjykim.

Të dyja gjykatat më të ulëta duhet të kishin analizuar faktin nëse, dyshimi i arsyeshëm i palës paditëse në këtë gjykim, se pala e paditur nuk do të mund ta përmbushte detyrimin monetar në vlerën prej 568.000 [...]USD për shkak të vlerës së lartë që ajo përfaqëson, por edhe të dhënave që ofronte ekstraktit historik i shoqërisë [...], mund të gjente mbrojtjen e nevojshme ligjore nëpërmjet liritimit dhe dorëzimit të sendit si masë sigurimi padie. Për sa kohë në këtë gjykim, nuk është pretenduar se veprimet e kryera nga pala e paditur çënojnë pronën objekt shqyrtimi, duke rrezikuar që ajo të dëmtohet, të priset, të shkatërrohet apo të humbasë vlerën e saj nga përdorimi, kërkesa për lirimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të saj në formën e masës së sigurimit të padisë, nuk plotëson kushtet dhe kriteret ligjore që kërkon neni 202 i KPC për tu pranuar nga

ana e gjykatës. Përveç sa është analizuar më sipër, Kolegji, çmon të evidentojë edhe faktin se, në padinë objekt gjykimi, një nga kërkimet themelore të palës paditëse në padi është kërkimi që lidhet me *“Detyrimin e të paditurve që t’i lirojnë dhe t’i dorëzojnë paditësve pasurinë e paluajtshme “Truall”, [..]masë e cila rezulton të jetë pranuar nga të dyja gjykatat më të ulëta.*

Bazuar sa më sipër, rezulton e provuar se të dyja gjykatat, në momentin që kanë pranuar kërkesën e palës paditëse për sigurimin e padisë dhe kanë urdhëruar lirimin e menjëhershëm të pronës objekt i këtij gjykimi, kanë dhënë konsiderata për zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi, përsa i takon kërkimit të padisë që ka lidhje me lirimin dhe dorëzimin e sendit të paluajtshëm *“truall”* me sipërfaqe 1299 m2, duke vepruar në këtë mënyrë në kundërshtim me sa parashikon ligji procedural, si dhe praktika gjyqësore e konsoliduar në trajtimin e çështjeve të ngjashme. Kolegji, vlerëson se me këtë lloj vendimmarrje, të dy gjykatat më të ulëta kanë paragjykuar zgjidhjen në themel të çështjes për atë pjesë të kërkimit në padi që ka të bëjë me lirimin dhe dorëzimin e truallit prej 1299 m2, duke e bërë të panevojshëm vijimin e gjykimit të themelit për këtë kërkim.

Vendimet e dhëna nga të dyja gjykatat më të ulëta, vijnë në kundërshtim të hapur me qëndrimin që kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 10/2004, [..]

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e ngritura në rekurs nga pala e paditur, përsa i takon themelit të gjykimit të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë janë të drejta dhe si të tilla duhet të pranohen. Vendimi i ndërmjetëm i [..] Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të cilin është marrë masa e sigurimit të padisë, si dhe vendimi [..] i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor, janë vendime të marra në kundërshtim me ligjin procedural dhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, të dyja këto vendime duhet të ndryshohen dhe duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2020-728, datë 26.11.2020

III. E Drejta Ankimit/Rekursit/Rishikimit të vendimit

KCGJL Vendim Nr.00-2023-227(49), datë 01.02.2023 (Afat ankimi pavlefshëmri titulli ekzekutiv)

Goditja e titullit ekzekutiv për pavlefshëmri bëhet me padi para gjykatës së vendit të ekzekutimit dhe jo me ankim kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor. Kjo është një padi që lidhet me themelin e çështjes dhe i përket një gjykimi të zakonshëm e për pasojë edhe ankimi është i zakonshëm. Në këtë kontekst si afate ankimi në çështjen objekt gjykimi duhet të ndiqen afatet e parashikuara nga neni 443 i K.Pr.Civile.

Fjalë kyçe: afat ankimi i veçantë, afat ankimi të përgjithshëm, goditja e titullit ekzekutiv për pavlefshmëri

Rrethanat e çështjes:

Referuar fakteve të pranuar nga të dyja shkallët e gjykimit rezulton se, dërmjet palëve në proces ka një kontratë furnizimi me energji elektrike, [..], me të cilën palët mbartin të drejta dhe detyrime reciproke. Kjo kontratë është e miratuar me vendim të ERE dhe është e një karakteri të veçantë për shkak të pozitës monopol ku ushtron aktiviteti pala e paditur. [..] Rezulton që paditësi ka qenë një pages i rregullt i pagesës së faturave të energjisë elektrike, mepërjashtim të faturave të kontestuara nga ana e tij.

Paditësi është faturuar nga ana e CEZ Shpërndarje sh.a., për periudhën 11.03.2012-11.04.2012 me 1848 këh në rubrikën “energji e matur”, për periudhën 11.04.2012-11.05.2012 është faturuar 5297 këh me rubrikën energji e matur.

Pala paditëse pretendon se faturat e muajve 11.03.2012 deri 11.04.2012 dhe 11.04.2012 deri 11.05.2012 përmbajnë vlera më të larta se sa është konsumi i energjisë, pasi leximi i matësit është bërë formalisht, ndërkohë që matësi i energjisë ka qenë i pakoaliduar dhe jashtë kushteve teknike. Ndodhur në këto kushte, paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë [..] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, [..]ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë; Deklarimin e pavlefshmërisë së pjeshme të faturave të energjisë elektrike për periudhat 11.03.2012 deri 11.04.2012 [..] dhe 11.04.2012 deri 11.05.2012 për masën [..]. Detyrimin e palës së paditur që të faturojë paditësin për dy muajt objekt gjykimi një sasi të barabartë me mesataren e konsumit të muajve paraardhës[.] Gjykata e Apelit Shkodër [..]ka vendosur pospranimin e ankimit [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se në rekursin e paraqitur nga pala paditëse ekzistojnë shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC të cilat e bëjnë të cënueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

[..] Duke ju rikthyer mosmarrëveshjes objekt gjykimi evidentohet se përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është paraqitur padia e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv. Sipas dispozitave në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit, konkretisht sipas nenit 609/3 të KPC [..] Në referim të dispozitë së sipërcituar, në lidhje me parashkimin për të drejtën ankimit të veçantë, si dhe nenit 450/1/a të KPC, ku përcaktohet se ankimi nuk pranohet kur është paraqitur jashtë afatit, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur mospranimin e ankimit . Ndërkohë që, në rekurs pala e paditur pretendon se, afati i ankimit është ai i përgjithshëm 15 ditor, nisur edhe nga fakti që vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka përcaktuar në dispozitiv afatin 15 ditor të ankimit.

Në lidhje me thelbin (*legjitimimi ratione materiae*), Kolegji [..] shtron për zgjidhje çështjen nëse, afati i ankimit është ai i përgjithshëm 15 ditor, që gjykata e shkallës së

parë ka përcaktuar në dispozitivin e vendimit e të respektuar nga pala e paditur, apo kjo palë duhej të kishte ushtruar ankimin e veçantë brenda afatit 5 ditor.

Nga analiza në tërësi e dispozitave procedurale (nenet 145-152, 442-448), të cilat përcaktojnë mjetet e ankimit, rregullojnë afatet procedurale dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, vlerësohet se, ankimi i veçantë ushtrohet kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë vetëm në ato raste kur ai është parashikuar shprehimisht. Ndërsa për rastet e tjera, si mjet ankimi për goditjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankimi, afati i të cilit është 15 ditor, pra zbatohet rregullimi i përgjithshëm.

Nga aktet në dosje rezulton se, pala paditëse ka ngritur një padi me objekt pavlefshmëri të titullit ekzekutiv, me shkak ligjor nenin 609 të KPC. Në këtë dispozitë nuk është parashikuar shprehimisht e drejta e pjesëmarrësve në gjykim të kundërshtojnë vendimin përfundimtar të gjykatës, por kjo nuk do të thotë se vendimi i dhënë nga gjykata është i paankimueshëm. Sipas nenit 452 të KPC mund “*të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj*”. Në vështrim të dispozitave të Pjesës së Katërt të KPC, në të cilat janë përcaktuar rregullimet ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm dhe mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve, ankimi i veçantë kundër vendimeve të gjykatës është parashikuar shprehimisht në nenet 512, 516/3, 517/2, 539, 601 dhe 611 të këtij Kodi.

Neni 609 i KPC është një dispozitë e përgjithshme, e cila duhet parë e harmonizuar dhe me dispozita të tjera të po këtij Kodi. Në interpretim të kësaj dispozite, goditja e titullit ekzekutiv për pavlefshmëri bëhet me padi para gjykatës së vendit të ekzekutimit dhe jo me ankim kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor. Kjo është një padi që lidhet me themelin e çështjes dhe i përket një gjykimi të zakonshëm e për pasojë edhe ankimi është i zakonshëm. Në këtë kontekst si afate ankimi në çështjen objekt gjykimi duhet të ndiqen afatet e parashikuara nga neni 443 i KPC.

Kjo mënyrë interpretimi në lidhje me konsiderimin si ankim të përgjithshëm, me afat 15 ditor, të ankimit ndaj vendimit të dhënë në përfundim të shqyrtimit të padisë me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, ka qenë e vazhdueshme në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, kur janë interpretuar nenet 609 dhe 610 dhe 611 të KPC (para shfuqizimit me Ligjin nr. 122/2013). Ndërkohë që afati 5 ditor apo ankimi i veçantë sipas nenit 609 paragrafi i fundit apo sipas nenit 610, është vlerësuar si mjet për goditjen e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës me të cilat vendoset pezullimi i ekzekutimit të veprimeve përmbaimore. (shiko *Vendim nr. 00-2012-1839 (257), datë 17.05.2012; Vendim nr. 00-2015-3441 i Vendimit (417), datë 07.10.2015; Vendim nr. 00-2015-2903 i Vendimit (347), datë 02.07.2015; Vendim nr. 00-2015-2445 i Vendimit (256), datë 14.05.2015; Vendim Nr. 00-2016-2015 i Vendim (221), datë 22.06.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*).

Po ashtu, në vijueshmëri, kjo praktikë e Kolegjit Civil gjeti pasqyrim edhe në ndryshimet e KPC, me ligjin nr. 114/2016, [..]. Me këto ndryshime, neni 609 i KPC, në mënyrë eksplicite ka bërë dallimin midis ankimit të zakonshëm për vendimet përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë dhe ankimit të veçantë mbi vendimet e

ndërmjetme për masat e pezullimit. Kështu, me këtë ligj, paragrafi i fundit i nenit 609, u riformulua [...]Kolegji vlerëson se, për shkak se ankimi i palës së paditur është paraqitur brenda afatit 15 ditor të ankimit të përgjithshëm, që parashikohet nga ligji procedural civil për kundërshtimin e vendimeve përfundimtare, Gjykata e Apelit Shkodër ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 450/1 shkronja “a”, kur ka disponuar për mospranimin e ankimit. Në kushtet kur ka një vendim jopërfundimtar nga gjykata e apelit në lidhje me padinë e paraqitur nga paditësi, me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, Kolegji vlerëson se çështja nuk mund të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Lartë, sipas parimit të respektimit të shkallëve të pushtetit gjyqësor, të parashikuar nga neni 135 i Kushtetutës [...]. Si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se duhet të vendosë prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e çështjes për rigjykim, me tjetër trup gjykues. Gjykata e apelit në rigjykim duhet të mbajë parasysh zhvillimin e gjykimit në përputhje me nenin 14 të KPC, sipas parimit të gjykimit kontradiktor dhe të barazisë së armëve. Po ashtu, në rigjykim, gjykata e apelit do të duhet të marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në ankimin e palës së paditur dhe të disponojë me vendim përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes.

Kolegji vëren se në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 98/2016 [...]VKM nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, si dhe Vendimit të KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, që prej datës 1 shkurt 2023 ka nisur funksionimi i hartës së re gjyqësore përmes riorganizimit të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Duke nisur nga kjo datë [...] shqyrtimi i çështjes konkrete do të duhet të vijojë nga Gjykata e Apelit Tiranë Juridiksioni i Përgjigjshëm.

Sa më sipër, referuar jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, Kolegji konkludon se nga Gjykata e Apelit Shkodër nuk është interpretuar drejtë neni 609 i KPC, në lidhje me afatin e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë. Si rrjedhojë, vendimi duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim për vazhdimin e gjykimit.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2023-1261(177), datë 29.03.2023

KCGJL Vendim Njësues Nr. 00-2022-4586(392), datë 26.10.2022 (Afat ankimi veprimet përmbartimore)

Neni 610 i KPC, lejon ankim të veçantë, brenda një afati 5 ditor, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi ankimin kundër veprimeve të përmbartuesit gjyqësor.

Ankimi i veçantë i parashikuar në nenin 610 të KPC, është mjete me të cilin goditet si vendimi për “pezullimin e veprimeve përmbartimore” ashtu edhe vendimi që disponon përfundimisht mbi “kundërshtimin e veprimit përmbartimor.”

Rrethanat e çështjes:

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur një padi me objekt

kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore, [..]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë [..] ka vendosur rrëzimin e padisë [..]

Lidhur me ankimin e paditësit, Gjykata e Apelit Tiranë, [..] ka vendosur mospranimin e ankimit [..]

I. Procedura para Gjykatës së Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore.

Kolegji [..] Pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të gjykimit; llojin e vendimmarrjes së gjykatës së apelit sipas nenit 450/a të KPC, objekt rekursi dhe kontrolli nga Gjykata e Lartë, pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur nga paditësi, [..] Kolegji vlerësoi se në rastin konkret, shtrohej për zgjidhje një çështje ligjore, se sa është afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka shqyrtuar ankimin e palëve ndaj veprimeve të përmbarruesit gjyqësor, sipas nenit 610 të KPC. Pas një hulumtimi mbi praktikën gjyqësore ndër vite, Kolegji konstatoi se çështja e llojit dhe afatit të ankimit, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, që ka disponuar mbi padinë/ankimin me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore, ka qenë shumë e diskutueshme në jurisprudencën e gjykatave më të ulëta dhe po ashtu të Gjykatës së Lartë.

KPC ka pësuar vazhdimisht disa ndryshime, duke përfshirë edhe kapitullin e dispozitave që rregullojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm dhe paditë e ngritura në fazën përmbarrimore [..] Në praktikën mbizotëruese të Kolegjit [..], ku është interpretuar si neni 611 i KPC, ashtu dhe neni 610, pas ndryshimeve me ligjin nr.122/22013, [..] është mbajtur qëndrimi i vazhdueshëm se afati i ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës që ka disponuar në lidhje me një padi të ngritur sipas nenit 609 apo 610 të KPC është 15 ditë, sipas rregullave të zakonshme të ankimit. Ndërkohë afati 5 ditor dhe ankimi i veçantë sipas nenit 610 apo sipas nenit 611 të mëparshëm është mjet për goditjen e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës me të cilat vendoset pezullimi i ekzekutimit të veprimeve përmbarrimore (*shih vendim nr.00-2009-1185 i vendimit (289), dt.01.10.2009; vendim nr.00-2012-1839 i vendimit (257), datë 17.05.2012; vendim nr.00-2015-3441 i vendimit (417), datë 07.10.2015; vendim nr.00-2015-2903 i vendimit (347), datë 02.07.2015; vendim nr.00-2015 -2445 i vendimit (256), datë 14.05.2015 vendim nr.(221), datë 22.06.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj).*

Nga ana tjetër, janë konstatuar edhe disa raste, më të pakta në numër, ku Kolegji [..], në interpretim të nenit 610 të KPC, ka mbajtur qëndrimin jurisprudencial që lejon ankim të veçantë ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës, që ka disponuar mbi ankimin kundër veprimeve të përmbarruesit gjyqësor (*shih vendim nr.11243-1613-2018, datë 23.02.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj).*

Edhe në rastet ku Gjykata e Lartë ka konkluduar mbi të drejtën e ankimit sipas rregullave të zakonshme, sipas jurisprudencës mbizotëruese, jo pak vendime të Kolegjit janë marrë me shumicë votash. Gjyqtarët e mbetur në pakicë kanë arsyetuar se neni 610 i KPC ofron një mjet ankimi të veçantë për goditjen e vendimeve gjyqësore që kanë disponuar mbi kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore. I njëjti interpretim është konstatuar edhe në jurisprudencën e gjykatave të apelit në përgjithësi. Duke vlerësuar

se ankimi i lejuar në të tilla raste është i veçantë, këto gjykata në zbatim të nenit 450/a të KPC kanë disponuar me mospranim ankimi, për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit 5 ditor.

Kolegji sjell në vëmendje se para Gjykatës së Lartë gjenden për gjykim, një numër i konsiderueshëm i rekurseve të regjistruara ndaj vendimeve të gjykatave të apelit, të marra sipas nenit 450/a të KPC në harmoni me nenin 610 të KPC, prej vitit 2015 e në vijim, që shtrajnë të njëjtin diskutim mbi interpretimin e ligjit procedural. Për shkak të paqartësisë së krijuar nga praktika gjyqësore e gjykatave me juridiksion rishikues, në jo pak raste, edhe gjykatat e shkallës së parë, kur kanë përcaktuar të drejtën e ankimit në pjesën urdhëruese të vendimit të dhënë prej tyre, sipas nenit 310/III/3 të KPC, nuk kanë qenë koherente mbi individualizimin e llojit të ankimit apo në rastin më të keq kanë orientuar gabimisht palën mbi të drejtën e ankimit dhe afatin e paraqitjes së tij. Edhe pse e drejta e ankimit, lloji dhe afati i paraqitjes së tij, përcaktohet nga ligji dhe nuk mund të ndryshohet me vendim gjyqësor, Kolegji konstaton se si rrjedhojë e një praktike gjyqësore jo të njësuar ndër vite, palët në një proces gjyqësor përmbarimor kanë qenë të paorientuara mbi mënyrën e interpretimit të nenit 610 të KPC, çka ka çuar në jo pak raste në humbjen e të drejtës së ankimit, si një e drejtë themelore kushtetuese.

Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore, është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. GJEDNJ në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se njëtrajtshmëria e zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (shih çështjen “Chapman v United Kingdom” vendim i GJEDNJ, datë 18.01.2001), duke patur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të KEDNJ

[..] Në vijim të kësaj analize, në çështjen ligjore të shtruar për diskutim, Kolegji,

- në ushtrim të të drejtës dhe detyrimit kushtetues dhe ligjor, që lidhet me funksionin nomofilatik;
- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që vijnë për shkak se mund të ketë disa interpretime të nenit 610 të KPC, mbi të drejtën e ankimit;
- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njëjtë dhe e njësuar në interpretimin e ligjit procedural;
- në zbatim të nenit 35/3, 472/a, 481 dhe 482/a të KPC, të ndryshuar me ligjin nr.44/2021, ka konkluduar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Mbi këtë bazë, Kolegji vlerësoi se çështja që duhet të shtrohet për njësim është:

Sa është afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi ankimin kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor

sipas nenit 610 të KPC?

Ankimi i veçantë i parashikuar në këtë dispozitë, nënkupton se me këtë mjet goditen vendimet e gjykatës mbi pezullimin e veprimeve përmbarimore apo vendimet e gjykatës që kanë disponuar përfundimisht mbi ankimin kundër veprimit të përmbaruesit gjyqësor? [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë në përgjithësi, e sidomos ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës në veçanti, konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar sipas ligjit. Karakteri unitar i procesit civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt si në fazën e gjykimit, ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë mënyrë ligji procedural ka ndërftuar si moderator të këtij procesi gjykatën e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit. [..]

I. Jurisprudenca relevante e GJEDNJ dhe e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me karakterin unitar të procesit dhe zbatimin e nenit 6 të KEDNJ, në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në jurisprudencën e vazhdueshme të GJEDNJ, [..] çështja “*Qufaj v. Shqipërisë*” [..] u shpreh se “*e drejta për t’iu drejtuar gjykatës nuk do të ishte reale, nëse sistemi ligjor i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor i detyrueshëm dhe përfundimtar të mos zbatohet në dëm të njëres palë*”. Duke u nisur nga ky konceptim, në praktikën e konsoliduar të GJEDNJ është vendosur si standard se, në veçanti, ekzekutimi i detyrueshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duhet të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm. Vonesat në ekzekutim, cenojnë të drejtën e palës për akses në gjykatë dhe kjo qasje përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ. Në çështjen “*Gjyli kundër Shqipërisë*”, GJEDNJ ka theksuar se një vonesë e tejzgatur e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi përfundimtar dhe detyrues mund të shkelë Konventën.

Kjo praktikë e GJEDNJ, mbi afatet e arsyeshme të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, gjeti pasqyrim edhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese [..] Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e të drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. [..] Në fazën e dytë, kur lipset dhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese për zbatimin e tij, realizohet ajo që quajmë qëllimi i drejtësisë. Duke qenë kështu, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë (*shih vendim nr.6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Kushtetuese, ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës [..] dhe të KEDNJ. [..]. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në

vend të drejtën e tij të fituar. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimin nr.1, datë 21.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

II. Konteksti historik dhe krahasimor mbi natyrën e padive/ankimeve përmbartimore, ndryshimet që ka pësuar ndër vite legjislativoni procedural civil shqiptar.

Kundërshtimi i veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, i normuar në nenin 610 të KPC, është konceptuar nga ligji si mjet juridik mbrojtës, me natyrë thelbësisht procedurale, në dispozicion të palëve të një procesi gjyqësor civil, në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Ky mjet në duart e palëve, ka për qëllim të kundërshtojë veprimet (*aktet procedurale*) që kryhen nga përmbartuesi gjatë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ose kundër refuzimit të përmbartuesit për të ekzekutuar një titull ekzekutiv.

Me këtë mjet, nuk kundërshtohet e drejta e kreditorit, por mënyra dhe ligjshmëria e zhvillimit të vetë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për shkak të mosrespektimit të ligjit procedural civil në vendimmarrjen dhe veprimet e përmbartuesit.

Në KPC të miratuar me ligjin nr.6341, datë 27.06.1981, kundërshtimi i veprimeve të përmbartuesit gjyqësor ishte rregulluar në nenin 214, [...] Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, në të tilla raste, duke u nisur nga nevoja e përfundimit të shpejtë të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, ishte i paankimueshëm dhe i formës së prerë. Një parashikim i tillë gjendej në nenin 216 të këtij Kodi.

Njëllor me parashikimin e KPC të Republikës së Shqipërisë të vitit 1981, ka edhe modele ligjore aktuale evropiane të cilat nuk lejojnë fare ankim, qoftë apel apo qoftë rekurs ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë që ka si kompetencë lëndore gjykimet përmbartimore. [...]

Më tej, me hyrjen në fuqi të KPC pas viteve 90, me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, kundërshtimi i veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, si mjet procedural ankimi, u rregullua në nenin 610. Në përpjekje për ta përqasur vazhdimisht me standartet ndërkombëtare, kjo dispozitë ka pësuar disa ndryshime thelbësore që prej vitit 2001 deri në vitin 2021, në lidhje me natyrën juridike të këtij mjeti, pozitën procedurale të pjesëmarrësve në proces, afatet dhe procedurën e gjykimit, në gjykatat e shkallës së parë dhe në ato me juridiskion rishikues.

Në formulimin e tij fillestar, neni 610 i KPC, [...], e konceptonte kundërshtimin e veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, si ankim të subjekteve të përfshirë në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, ndaj akteve procedurale të realizuara nga përmbartuesi gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, kundër veprimeve të përmbartuesit gjyqësor, [...]palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin. Aty, përcaktohej kompetenca e gjyqtarit të vendit të ekzekutimit për shqyrtimin e ankimit, por nuk parashikohej e drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo e drejtë rregullohej në nenin 611 të KPC[...]

[...]Ndërsa me ndryshimet që pësoi KPC, me ligjin nr.10052, datë 29.12.2008, për herë të parë dhe të vetme, ky mjet është konceptuar si padi, ku përmbartuesi duhet të

thirrej në cilësinë e palës së paditur. [..]

Më tej, me ligjin nr.122/2013, [..] është shfuqizuar neni 611. E drejta e ankimit, në mënyrë të njëjtë sikurse parashikohej në këtë dispozitë, u integrua dhe u rregullua në nenin 610 të KPC, [..]

Nga nevoja për përfundimin e ekzekutimit të detyrueshëm brenda një afati të arsyeshëm, dhe nga nevoja për një gjykim të shpejtë, si në juridiksionin fillestar, ashtu edhe në juridiksionin rishikues, me ligjin nr.114/2016, ligjvënësi e rikonceptoi ritin e gjykimit të kundërshtimit të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, në gjykimin në shkallë të parë dhe në apel. Ankimi kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, do të shqyrtohej tashmë nga gjykata e shkallës së parë në dhomë këshillimi pa praninë e palëve brenda 20 ditëve. Përrjashtimisht, gjykata e shkallës së parë mund të thërrasë palët dhe përmbaruesin gjyqësor kur e sheh të nevojshme, pa u cilësuar që përmbaruesi gjyqësor në këtë lloj gjykimi ka pozitën e palës së paditur.

Duke ndjekur një regjim të njëjtë të posaçëm edhe në juridiksionin rishikues, në këtë dispozitë u parashikua se shqyrtimi i ankimit nga gjykata e apelit, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, duhet të bëhet brenda 30 ditëve në dhomë këshillimi. Gjukata e apelit, përjashtimisht mund ta shqyrtojë ankimin në seancë gjyqësore, brenda 45 ditëve, kur debati gjyqësor çmohet si i domosdoshëm, në rastet dhe rrethanat e parashikuara nga ligji.

Së fundi, me ligjin nr.44/2021, gjykimi përmbarimor pësoi një ndryshim thelbësor. Në nenin 610 të KPC, u shtua paragrafi i tretë [..] Me këtë parashikim të fundit ligjor, u centralizua kompetenca e një gjyqtari të vetëm në shqyrtimin e të gjitha ankimeve ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor të lidhura me të njëjtin titull ekzekutiv. [..] Rikonceptimi i gjykimit përmbarimor, erdhi në përputhje me qasjen e GJEDNJ dhe të Gjykatës Kushtetuese, mbi karakterin unitar të gjykimit në fazën njohëse dhe ekzekutive. Copëzimi i gjykimit përmbarimor, në gjykime të veçanta, cenonte parimin e ekonomizimit procesual² si derivat i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. [..] Kjo mënyrë operimi krijonte premisat për cenimin e figurës së gjyqtarit natyral të çështjes, si një ndër elementet përbërës dhe thelbësor të gjykatës së caktuar me ligj.³

[..] Me ndryshimet që pësoi KPC në vitin 2021, për ti dhënë fleksibilitet dhe shpejtësi, procedurave gjyqësore përmbarimore, në nenin 35, figura e gjyqtarit monokratik u parashikua edhe në juridiksionin rishikues të gjykatës së apelit. Në gjykatën e apelit si rregull çështjet gjyqësore shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Përrjashtimisht në këtë dispozitë u parashikua se ankimet ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë që kanë disponuar mbi kundërshtimin e veprimeve përmbarimore do të

² Shih qëndrimin e mbajtur në vendimin njësuës nr.20315, dt.20.09.2006 të Seksioneve të Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë.

³ Shih vendimin nr.40, dt.11.03.2002; vendimin nr.35, dt.20.12.2005; vendimin nr.26, dt.02.11.2005; vendimin nr.25, dt.10.11.2006; vendimin nr.25, dt.10.11.2006; vendimin nr.9, dt.26.02.2007; vendimin nr.11, dt.04.04.2007; vendimin nr.23, dt.08.06.2007; vendimin nr.36, dt.15.10.2007; vendimin nr.7, dt.09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

gjykohen nga gjykata e apelit me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

Në Evropë ka modele legjislacionesh që e kanë krijuar gjyqtarin e ekzekutimit edhe në procesin civil. [..]

III. Lloji i ankimit të lejuar ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë sipas nenit 610 të KPC.

Në vijim të këtij vështrimi historik dhe krahasimor, Kolegji vlerëson se në ndryshimet që ka pësuar KPC, në dispozitat procedurale që normojnë kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit gjyqësor, ligjvënësi shqiptar ka synuar në vazhdimësi përsosjen, eficienën dhe përsheptimin e fazës ekzekutive, duke e disiplinuar atë në tërësi, me afate shumë të shkurtra dhe me procedura të thjeshtëzuara gjyqësore. Këto ndryshime kanë qenë një përpjekje e vazhdueshme për ta përqasur legjislacionin relevant të brendshëm me jurisprudencën e GJEDNJ dhe me modelet europiane që kanë si qëllim përfundimin e shpejtë të fazës ekzekutive. Ajo që vlen të theksohet është se për këtë arsye, faza e ekzekutimit të detyrueshëm dhe veprimtaria gjyqësore përmbaimore, ndjek një regjim juridik tërësisht të ndryshëm dhe të posaçëm në raport me normat juridike procedurale që rregullojnë veprimtarinë e gjykatës në fazën njohëse të së drejtës.

[..] Duke qenë një proces me karakter unitar, aktet e prodhuara nga përmbauesi gjyqësor në fazën ekzekutive, janë vijimësi e akteve procedurale, të prodhuara nga gjykata në fazën njohëse, por me një destinim të ndryshëm procedural, materializimin fizik të së drejtës së kreditorit, kundrejt debitorit, të njohur tashmë me vendim gjyqësor të formës së prerë ose të përfshirë në titullin ekzekutiv, objekt i ekzekutimit.

Përmbauesi gjyqësor [..], është një figurë e posaçme procedurale, që drejton fazën ekzekutive dhe që vihet në lëvizje me kërkesë të kreditorit. Për këtë qëllim, ligji procedural civil, e ka pajisur me kompetencën për të marrë vendime dhe për të nxjerrë urdhra, të cilat janë të detyrueshme për zbatim, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit të debitorit. Megjithatë veprimtaria e përmbauesit gjyqësor është e normuar nga ligji, ai nuk plotëson kualitetet e gjykatës apo kuazigjykatës (sikurse janë pavarësia, paanësia etj.), prandaj aktet procedurale të realizuara prej tij, nga të cilat mund të cenohen të drejtat pasurore të debitorit ose të personave të tretë, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.

Gjykimi përmbaimor ka për objekt pikërisht vlefshmërinë e këtyre akteve dhe me këtë logjikë juridike, edhe vendimet e gjykatës, në përfundim të gjykimit përmbaimor, kanë për qëllim kontrollin dhe drejtimin e fazës ekzekutive.

Çështja më e diskutueshme në praktikën gjyqësore, e cila është shtruar për zgjidhje në këtë vendim njëses, lidhet me të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë sipas nenit 610 të KPC.

E drejta e ankimit ndaj një vendimi të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, përbën një prezumim kushtetues, që e ka legjitimitetin nga neni 43 i Kushtetutës [..]. Kufizimi i kësaj të drejte, duhet të bëhet shprehimisht me ligj dhe vetëm për rastet dhe kushtet e parashikuara në nenet 17 dhe 43 të Kushtetutës. [..]

KPC ka parashikuar edhe llojet e ankimeve, duke i ndarë në dy kategori: ankimet sipas rregullave të zakonshme dhe ankimet e veçanta. Kategorizimi i tyre jepet në nenin

443 të KPC dhe ka si kriter ndarës primar afatin e paraqitjes së tyre.

[..]Regjimi juridik i posaçëm i ankimeve dhe/ose rekurseve të veçanta lidhet jo vetëm me afatin 5 ditor të paraqitjes së tyre në gjykatën me juridiksion rishikues, por edhe llojin e vendimmarrjes gjyqësore që ato kundërshtojnë, ritin e gjykimit të tyre nga gjykata rishikuese dhe afatet e posaçme për shqyrtimin e tyre.

Kolegji sjell në vëmendje llojet e vendimeve gjyqësore të prodhuara gjatë një procesi gjyqësor, të cilat ndahen në vendime përfundimtare, të ndërmjetme dhe jopërfundimtare. Kuptimi për secilin prej tyre jepet në nenet 125-127 të KPC. [...] Në KPC, është përzgjedhur një teknikë e tillë legjislative, ku në parim, vendimet gjyqësore ankimohen sipas rregullave të zakonshme të ankimit, me përjashtim të rasteve ku ligji në mënyrë të shprehur parashikon ankimin e veçantë. Nëse merren në analizë dispozitat e KPC që parashikojnë në mënyrë eksplicite të drejtën e ankimit të veçantë, mund të dallohet se me këtë mjet ankimi goditen në përgjithësi vendimet e ndërmjetme dhe jopërfundimtare të gjykatave (shih p.sh. nenet 154/a/5; 194/2; 209; 301; 315; 318; 370 etj). Përjashtim bën vetëm rasti i parashikuar në nenin 158/ç të KPC, ku vendimi gjyqësor me të cilin është miratuar marrëveshja e palëve për zgjidhjen e çështjes me pajtim mund të goditet me ankim të veçantë.

Kjo bëhet më e dukshme/e qartë në nenet 470 [...] dhe 471/a të KPC [...] ku është parashikuar se ankimet dhe rekursat e veçanta ndaj vendimit të ndërmjetëm ose jopërfundimtar të gjykatës, shqyrtohen nga gjykata më e lartë, në dhomë këshillimi dhe brenda 30 ditëve. Ndërkohë vendimet përfundimtare, me të cilat është zgjidhur mosmarrëveshja në themel, ankimohen sipas rregullave të zakonshme të ankimit.

Logjika e ligjvënësit në parashikimin e ankimit të veçantë për vendimmarrje të tilla gjyqësore, lidhet me nevojën urgjente të shqyrtimit të tyre nga gjykata rishikuese si dhe me mjetin efektiv të ankimit. Duke patur një karakter instrumental, në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel, ligjshmëria e vendimeve të ndërmjetme të goditura me ankim të veçantë, duhet të shqyrtohet nga gjykata rishikuese, para mbylljes së gjykimit në shkallë të parë, me vendim përfundimtar. Po ashtu, edhe vendimet jopërfundimtare, duke qenë se nuk i japin zgjidhje themelit të pretendimeve të palëve, si një kufizim i aksesit në gjykatë, duhet të gjykohen me shpejtësi nga gjykata rishikuese.

Në të tilla raste jo vetëm afati i ankimit është i shkurtër (5 ditë), por edhe shqyrtimi i tyre nga gjykata rishikuese duhet të përfundojë brenda një afati të shkurtër 30 ditor, sipas ritit të gjykimit në dhomë këshillimi.

Kolegji risjell në vëmendje edhe një herë parashikimin e nenit 610 të KPC, në [...] Në një paragraf më vete të kësaj dispozite, është parashikuar e drejta e ankimit të veçantë ndaj vendimit të gjykatës. Sikurse u evidentua në pjesën e evolucionit historik, në dispozitat e KPC, para ndryshimeve me ligjin nr.122/2013, neni 610 nuk parashikonte të drejtë ankimi, ndërkohë e drejta e ankimit të veçantë parashikohej në nenin 611 që rregullonte në mënyrë të posaçme masat e përkohshme gjyqësore për pezullimin e veprimeve të përmbauesit gjyqësor.

Edhe pas riformulimit të nenit 610 të KPC, me ligjin nr.122/2013, me të cilin u shfuqizua neni 611 e drejta e ankimit të veçantë është parashikuar në paragrafin që vjen

fill pas atij që rregullon masat gjyqësore të përkohshme të pezullimit të ekzekutimit. Për shkak të kësaj teknike legjislative të përzgjedhur, në praktikën gjyqësore është krijuar një paqartësi, nëse ankimi i veçantë është mjet për goditjen e vendimeve të gjykatës për pezullimin e veprimeve përmbarimore apo me këtë mjet goditet edhe vendimi i gjykatës që ka zgjidhur përfundimisht ankimin ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

Në interpretimin e nenit 610 të KPC, në praktikën mbizotëruese të Gjykatës së Lartë, është ndjekur një logjikë argumentuese tejet formaliste, duke u nisur thjesht nga teknika legjislative dhe nga fakti se ku është vendosur e drejta e ankimit të veçantë në këto dispozita. Në vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë para ndryshimeve të KPC me ligjin nr.122/2013, është theksuar se, duke vështruar në tërësi mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve, ankimi i veçantë kundër vendimeve të gjykatës është parashikuar shprehimisht në nenet 512, 516/3, 517/2, 539, 601 dhe 611 të këtij Kodi. Në këto vendime, Gjykata ka argumentuar se, ligjëbërësi, për rastet kur ka çmuar se duhet të ushtrohet ankimi i veçantë, e ka parashikuar këtë mjet ankimi në mënyrë të posaçme. Kjo haset në të gjitha dispozitat kur lejohet ushtrimi i këtij mjeti. Në kushtet kur në nenin 610 të KPC nuk është parashikuar afati i ankimit, sikurse është parashikuar për të gjitha rastet e tjera kur si mjet ankimi lejohet të ushtrohet ankimi i veçantë, atëherë ankimi i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm, afatit 15 ditor dhe se ankimi i veçantë i lejuar lidhet vetëm me masat e pezullimit të ekzekutimit të detyrueshëm.

I njëjti qëndrim jurisprudencial vijoi edhe pas ndryshimeve të KPC me ligjin nr.122/2013, edhe pse tashmë neni 611 ishte shfuqizuar dhe e drejta e ankimit të veçantë u integrua në një paragraf më vete në nenin 610 të KPC.

Kolegji vlerëson se një interpretim i tillë, ngushtësisht literal dhe i cunguar, duke u nisur thjesht nga vendi i vendosjes së parashikimeve ligjore që rregullojnë të drejtën e ankimit, nuk është në pajtim me parimet e përfundimit të ekzekutimit të detyrueshëm brenda një afati të arsyeshëm dhe me një interpretim teleologjik dhe sistematik të të gjitha dispozitave që dispijlojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm në tërësi, sipas natyrës juridike të ankimeve të tilla dhe qëllimit të cilin ato synojnë të realizojnë.

Kolegji vlerëson se ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, që disponon mbi ankimet ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, në çdo rast duhet të jetë i veçantë. Pra rregullimi i mëparshëm i nenit 611/2 të KPC, i integruar sot në nenin 610, si dispozitë e vetme që rregullon ankimin për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor (me ligjin nr.122/2013), duhet të interpretohet se rregullonte dhe rregullon të gjitha llojet e vendimmarrjes gjyqësore në lidhje me konfliktet e palëve me përmbaruesit gjyqësor në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Mjeti i parashikuar në nenin 610 të KPC, nuk ka natyrën e padisë, por të ankimit ndaj akteve procedurale të lëshuara nga subjekti i ngarkuar nga ligji për ekzekutimin e titullit ekzekutiv [...] Ndërsa kuptimi i ankimit, ku përfshihet edhe ankimi sipas nenit 610 të KPC, jepet në nenin 442/, [...] Në këtë kuptim, ankimi i palëve ndaj akteve procedurale të realizuara nga përmbaruesi gjyqësor është analog me ankimin e palëve në gjykatën rishikuese, ndaj akteve procedurale të realizuara nga gjykata më e ulët, gjatë procesit kontencioz, në fazën njohëse të së drejtës.

Një dallim i tillë midis ankimeve për kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore dhe padive të themelit është bërë vazhdimisht edhe në praktikën e Kolegjit Civil [...]. Ky dallim evidentohet më shumë, sidomos duke patur parasysh që në dispozitat e pjesës së katërt të KPC, ka edhe mjete të tjera mbrojtjeje në disponibilitetin e debitorit dhe të personave të tretë, gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, të cilat janë ndarë në dy kategori kryesore:

(i) paditë që ngrihen gjatë procesit përmbarrimor e që lidhen me mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga e drejta materiale (nenet 609, 612-614) dhe (ii) ankimi (kundërshtimi) ndaj veprimeve ose mosveprimeve të përmbarruesit (neni 610).

Të dyja mjetet e parashikuara në nenet 609 dhe 610 të KPC, edhe pse hyjnë në rrethin e mjeteve mbrojtjeje të debitorit ndaj ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kanë:

(i) shkak ligjor të ndryshëm; (ii) afate të ndryshme ankimi; (iii) mënyra mbrojtjeje të ndryshme; dhe (iv) pasoja dhe efekte të ndryshme ndaj palëve të përfshira në një procedurë ekzekutimi të detyrueshëm të titullit ekzekutiv.

Në nenin 609 të KPC, është parashikuar si mjet mbrojtjeje padia për goditjen e titullit ekzekutiv, që ngrihet nga debitori kundër kreditorit.

Titulli ekzekutiv si koncept juridik, tregon ekzistencën e një të drejte subjektive materiale, të cenuar ose të papërmbyshur. Për këtë arsye, titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimitetit të kreditorit për të iniciuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, legjitimiteti i cili buron nga fakti se subjekti që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të.

Padia për goditjen e titullit ekzekutiv konstituon një gjykim themeli që përqendrohet mbi shqyrtimin e masës dhe sasisë së të drejtës materiale që gjendet në titullin ekzekutiv dhe si e tillë i nënshtrohet një gjykimi të zakonshëm kontradiktor. Me anë të kësaj padie, nëpërmjet vërtetimit të së kundërtës, debitori synon të kundërshtojë të drejtën e kreditorit, i cili nga ana e tij, synon të procedojë me ekzekutimin e detyrimit.

Kjo padia, përmban elementet e një padie njohje negative. Shkaku ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv qëndron në të drejtën e debitorit, për t'u çliruar nga një detyrim i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht, kur e drejta e kreditorit nuk ka ekzistuar si e tillë që në origjinë ose për fakte shuese të ngjara pas formimit të titullit (*Shih vendim i Kolegjit Civil, nr.214, datë 06.05.2010.*)

Ndërkohë mjeti tjetër juridik gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm është padia e personit të tretë për kërkimin e sendit apo për përjashtimin e tij nga ekzekutimi i detyrueshëm e rregulluar në nenin 612 të KPC. Megjithëse ky mjet juridik është vendosur formalisht në rregullimet e pjesës së katërt të KPC, në thelb ka natyrën e një padie rivendikimi (*rei vindicatio*), e një lloji të veçantë, meqë ngrihet vetëm gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, pra para se të ketë përfunduar ekzekutimi i detyrueshëm dhe sendi të jetë shitur në ankand. Gjithashtu ajo ka një karakter njohës dhe detyrues në të njëjtën kohë.

Gjykata në shqyrtimin e kësaj padie investohet në verifikimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, që kanë palët ndërgjyqëse, me pretendime pronësie mbi sendin. Ajo konkludon për përjashtimin e sendit nga ekzekutimi, duke i njohur dhe konfirmuar titullin e pronësisë palës paditëse që i kundërvihet titullit të pronësisë së palës të paditur. Në përfundim të gjykimit, gjykata e detyron palën e paditur që të njohë pronësinë e paditësit mbi sendin (*vendim nr.222, datë 23.06.2016 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.*)

Vendimet e dhëna nga gjykata në përfundim të gjykimit të investuar nga padia sipas neneve 609 dhe 612 të KPC, janë vendime përfundimtare, të cilat goditen sipas rregullave të zakonshme të ankimimit. Ndërkohë, kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor është mjet që ka për qëllim të godasë vlefshmërinë e akteve të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, që realizohen nëpërmjet kryerjes ose moskryerjes së veprimeve të përmbauesit gjyqësor. Në këto lloj gjykimesh, gjykata nuk shqyrton më themelësinë e të drejtës së kreditorit të cilësuar në titullin ekzekutiv, por vlerëson, nga pikëpamja procedurale, nëse ankimi është ngritur brenda afatit ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin 610 të KPC dhe nëse veprimet e përmbauesit gjyqësor janë kryer apo jo në përputhje me ligjin. Shkaku për të cilin mund të kundërshtohen gjyqësisht veprimet e përmbauesit lidhen kryesisht me parregullsitë procedurale që mund të vërehen gjatë kryerjes së tyre nga ana e përmbauesit, ose me mungesën e kushteve që duhen për të proceduar lidhur me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. (*vendim nr. 658, datë 17.12.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.*)

Karakteristikat e gjykimit përmbauesor dhe çështjet që shqyrton gjykata e investuar nga një ankim sipas nenit 610 të KPC, diktuan edhe përqendrimin e gjithë fazës ekzekutive në kompetencën e një gjyqtari të vetëm sipas nenit 610/3 të KPC, të ndryshuar me ligjin nr.44/2021, për të garantuar parimin e gjyqtarit natyral të çështjes, gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parimin e sigurisë juridike etj. Në aspektin e ngushtë teknik-procedural, centralizimi i shqyrtimit të ankimeve kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor, në kompetencën e një gjyqtari të vetëm, lidhet pikërisht me faktin se në këtë fazë, gjykata nuk shqyrton themelësinë e të drejtës subjektive të kreditorit dhe ekzistencën e detyrimit të debitorit, si elemente përmbajtësorë të marrëdhënies juridike materiale, të përfshirë në një titull ekzekutiv. Si rrjedhojë, gjyqtari i ekzekutimit nuk bëhet i papajtuës në ankimet e ndryshme që mund të vijnë nga palët në fazën ekzekutive, ku ai kontrollon ekskluzivisht ligjshmërinë e veprimeve të ndryshme procedurale të ndërmarra nga përmbauesi, për ekzekutimin e të njëjtit titull ekzekutiv.

Vendimet që jep gjykata në fazën ekzekutive janë të karakterit të mirëfilltë procedural. Ato kanë natyrë të posaçme për nga kërkimet që zgjidhin dhe pasojat juridike që sjellin. Këto vendime sjellin efekte vetëm në marrëdhënien juridike procedurale ekzekutive, sa i takon vlefshmërisë së akteve të përmbauesit gjyqësor. Në përfundim të gjykimit përmbauesor, gjykata sipas rastit mundet të anulojë veprimin përmbauesor dhe/ose të urdhërojë ripërsëritjen e tij, çka përcakton vijimësinë e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm. Si të tilla ato përafrohen më shumë nga natyra me urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme që merr gjykata për të drejtuar dhe kontrolluar procesin gjatë fazës njohëse.

Sipas parimit të gjyqtarit natyral dhe të pandërmjeshmërisë, njëlloj si në procesin gjyqësor njohës, ku gjyqtari (apo trupa gjyqësore), si rregull duhet të jetë një dhe i vetëm gjatë gjithë gjykimit, edhe në fazën ekzekutive do të duhet të ruhet kjo garanci.

Natyra e tillë e këtyre vendimeve, bëhet më e dukshme/e qartë sidomos në gjykimin administrativ, ku gjykata apo gjyqtari që ka dhënë vendimin, me qëllim ekzekutimin e tij, në dhomë këshillimi, me kërkesë të palëve, merr masa për kryerjen e veprimeve të posaçme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e tyre (neni 66 i ligjit nr.49/2012, të ndryshuar). Këto masa gjyqësore nuk kanë për qëllim të zgjidhin thelbin e së drejtës së individit kundrejt organit shtetëror, por kanë për qëllim të konkretizojnë mënyrën se si do të realizohet kjo e drejtë. Sikurse u analizua më sipër, si rregull, KPC parashikon ankim të veçantë për vendimmarrje të tilla gjyqësore.

Këtu vlen të sillel në vëmendje se me ndryshimet që pësoi KPC, me ligjin nr.114/2016, në nenin 609 të KPC, u bë një diferencim i shprehur midis vendimit përfundimtar dhe vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, për sa i përket të drejtës së ankimit. [...] Një diferencim i tillë, qëllimisht, nuk u bë me këtë ligj, në nenin 610 të KPC, në të cilën u la i pandryshuar paragrafi i 5 [..]

Nëse vështrohet e gjithë pjesa e katërt e KPC apo edhe dispozita të tjera në Kod, që rregullojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm dhe gjykimet përmbartimore, mund të thuhet se këto dispozita, përbëjnë një regjim juridik të posaçëm, në raport me rregullat që dispijlojnë gjykimin kontencioz të zakonshëm, të iniciuar nga padia sipas neneve 31 dhe 32 të KPC. Nga një vështrim sistematik, lehtësisht vërehet vullneti i qartë dhe i padiskutueshëm i ligjvënësit që, kjo fazë është e dispijnuar me afate shumë të shkurtra dhe gjykimet zhvillohen në afate të përcaktuara nga ligji, sipas ritit të gjykimit të posaçëm në dhomë këshillimi, si në gjykimin me juridiksion fillestar, ashtu edhe në gjykimin rishikues. Rregullimi i posaçëm mbi afatet që dispijlojnë këtë fazë, fillimisht rezulton nga parashikimi i nenit 399/2 të KPC, ku janë parashikuar afatet orientuese, me qëllim shqyrtimin e kërkesave të palëve për shkelje të afateve të arsyeshme si standard i parashikuar në nenin 6 të KEDNJ dhe 42 të Kushtetutës [..]. Sikurse mund të konstatohet, ligjvënësi, ka parashikuar afate dukshëm më të shkurtra për fazën ekzekutive. Duke qenë se në këtë fazë, materializohet fizikisht e drejta e çertifikuar në procesin njohës apo në titullin ekzekutiv të parashikuar si të tillë nga ligji dhe që përbën qëllimin e drejtësisë, nuk mundet që ajo të zgjasë po njëlloj apo edhe më shumë në kohë, sesa vetë procesi gjyqësor njohës.

Duhet të mbahet parasysh në këtë drejtim që potencialisht dhe teorikisht çdo veprim përmbartimor mundet të bëhet objekt gjykimi brenda pesë ditëve në gjykatë. Nëse sjellim në vëmendje se sa veprime përmbartimore ndërmerren për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, atëherë kuptohet se sa kohë do të mund të zgjaste faza ekzekutive nëse do të ndiqeshin rregullat e zakonshme të gjykimit.

Këtu, Kolegji risjell në vëmendje, se ka modele ligjore (të marra në analizë në pjesën e dytë të këtij vendimi njësuës), të cilat nuk lejojnë fare ankim, qoftë apel apo qoftë rekurs ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë që ka si kompetencë lëndore gjykimet përmbartimore. Ligjvënësi jonë nuk e ka vendosur një kufizim të tillë, por ka parashikuar afate shumë të shkurtra ankimi dhe gjykimi në gjykatat rishikuese.

Kështu, lëshimi i urdhrat të ekzekutimi të titullit ekzekutiv, pa të cilin nuk mund të fillojë procedura e ekzekutimit të detyrueshëm, realizohet nga gjykata në dhomë këshillimi (neni 511 i KPC). Ndaj vendimit të gjykatës me të cilin refuzohet lëshimi i urdhrat lejohet ankimi i veçantë, brenda afatit 5 ditor (neni 512 i KPC).

Më tej, afatet të cilat dispiplinojnë veprimtarinë e përmbauesit gjyqësor dhe të subjekteve të përfshira gjatë fazës ekzekutive, (shih nenet 515, 517, 553, 557, 560, 564, 567, 569, 575, 601 etj); afatet e ankimeve në gjykatë ndaj veprimeve të veçanta të përmbauesit (shih nenet 512, 516, 517, 539, 583, 588, 599, 601, 606, 617 etj), janë më të shpejtat dhe më të shkurtrat ndërmjet mjeteve procedurale që mundëson e parashikon ligji procedural civil. Po ashtu, procedurat gjyqësore përmbaimore janë dispiplinuara nga afate të shkurtra (shih nenet 517/3, 522 etj).

Sipas nenit 610 të KPC, ankimi ndaj veprimeve të përmbauesit gjyqësor duhet të paraqitet në gjykatë brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit ose nga data e njoftimit. Po ashtu, ky ankimi shqyrtohet nga gjykata, në dhomë këshillimi, si rregull, brenda një afati të shpejtë prej 20 ditësh. Edhe ankimi ndaj vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, në apel, shqyrtohet, me një gjyqtar, sipas rritit të posaçëm në dhomë këshillimi, brenda një afati 30 ditor nga data e regjistrimit të ankimit (rregull analog me atë të parashikuar në nenin 470/3 të KPC), me përjashtim kur debati zhvillohet në seancë gjyqësore, gjykimi duhet të përfundojë brenda një afati prej 45 ditësh.

Nëse e gjithë veprimtaria e palëve dhe e gjykatës në fazën ekzekutive, dispiplinohet nga afate shumë të shkurtra dhe nga procedura gjykimi të posaçme, të thjeshtëzuara dhe të shpejta, nuk ka asnjë arsye logjike e juridike që të justifikojë interpretimin se, përbën përjashtim, pra nuk ka ankim të veçantë, vetëm rasti i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që disponon lidhur me kundërshtimin e veprimeve përmbaimore sipas nenit 610 të KPC, që përbën një dispozitë të përgjithshme dhe pilot për të gjitha ankimet e paraqitura kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor.

Kjo dispozitë nuk mundet të interpretohet si një rregull i izoluar, në raport me dispozitat e tjera dhe me frymën që përshkon në tërësi rregullat e posaçme që dispiplinojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Në të kundërt do të krijohet një anomali, ku gjykimi në këtë fazë do të zgjaste në kohë njëloj apo edhe më shumë, në raport me procesin gjyqësor në fazën njohëse.

Kolegji sjell në vëmendje faktin se, ankimi ndaj veprimeve të përmbauesit gjyqësor në gjykatë dhe, më pas, ankimi ndaj vendimit gjyqësor për pranimin ose jo të ankimit për kundërshtimin e veprimeve përmbaimore, nuk kanë efekt pezullues kundrejt veprimeve të kryera ose jo nga përmbauesi gjyqësor. Në dallim edhe nga parimi i përgjithshëm i sanksionuar posaçërisht në nenin 449 të KPC, sipas të cilit ankimi ndaj vendimit përfundimtar gjyqësor pezullon ekzekutimin e tij, synimi është që këto ankime të lidhur me veprimet përmbaimore të fazës së ekzekutimit të mos shërbejnë si një lojë e mjet abuzues i palës debitore pikërisht për të penguar ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. Ligjvënësi në këtë dispozitë synon e parashikon vetëm një përjashtim, atë që vetëm gjykata, në rrethana të posaçme e përjashtimore, të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ankimit për kundërshtimin e veprimeve përmbaimore.

Së fundi, vlen të silltet në vëmendje se me ndryshimet që pësoi neni 35 i KPC, me ligjin nr. 44/2021, ligjvënësi në mënyrë të shprehur përcaktoi se ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, është ankimi i veçantë. [..]

Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se neni 610 i KPC, ku parashikohet edhe mjeti i “ankimit të veçantë”, nuk lidhet vetëm me vendimin e gjykatës së shkallës së parë që urdhëron pezullimin e ekzekutimit apo vetëm me pjesën eventuale të dispozitivit të vendimit që ka disponuar përfundimisht mbi ankimin kundër veprimeve përmbarimore, për pezullimin ose jo të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Pavarësisht nga teknika legislative jo e përsosur në formulimin e paragrafëve, për sa i përket vendndodhjes të së drejtës së ankimit të veçantë, paragrafi i gjashtë i nenit 610 përfshin natyrshëm edhe ankimin kundër vendimit gjyqësor që ka disponuar përfundimisht për çështjet me shkak ligjor dhe objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.

Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se ankimi i veçantë i parashikuar në nenin 610, me ndryshimet që ka pësuar KPC në vitin 2021, do të duhet të ndjekë të njëjtin regjim juridik të posaçëm, si në gjykimin në apel, ashtu edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Në nenin 443 të ndryshuar me ligjin nr.44/2021, është parashikuar instituti i rekurseve të veçanta, si mjet për goditjen e vendimeve të gjykatës së apelit, të vënë në lëvizje nga një ankimi i veçantë, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ligjvënësi ka patur si qëllim që të ofrojë ankime të veçanta ndaj çështjeve për të cilat duhet adresuar gjyqësisht nga juridiksioni rishikues një zgjidhje e shpejtë, qoftë nga gjykata e apelit, qoftë nga Gjykata e Lartë.

Ndaj njëjtësimi i rregullave të gjykimit rishikues në Gjykatën e Lartë, si ndaj ankimeve të zakonshme ashtu edhe ndaj ankimeve të veçanta nuk do të ishte as në frymën e ligjit dhe as zbatim kushtetues i tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ndaj vendimeve të gjykatës së apelit që disponojnë mbi ankimet e veçanta kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, sipas nenit 610 të KPC, ligji lejon rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë, që do të thotë rekurs brenda 5 ditëve.

II. *Sentenca Njësuese.*

Sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, arrin në konkluzionin njësuës si më poshtë vijon:

Neni 610 i KPC, lejon ankim të veçantë, brenda një afati 5 ditor, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi ankimin kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

Ankimi i veçantë i parashikuar në nenin 610 të KPC, është mjeti me të cilin goditet si vendimi për “pezullimin e veprimeve përmbarimore” ashtu edhe vendimi që disponon përfundimisht mbi “kundërshtimin e veprimit përmbarimor.”

III. *Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete.*

Në çështjen konkrete, pala paditëse ka kundërshtuar veprimet e përmbaruesit gjyqësor, sipas nenit 610 të KPC. Vendimi i gjykatës është shpallur me datë 23.10.2015

dhe ai ka qenë prezent në momentin e shpalljes. Rezulton se ankimi i paditësit në gjykatën e apelit është depozituar me datë 02.11.2015 dhe më tej është plotësuar me datë 07.12.2015, pas marrjes dijani mbi arsyetimin e vendimit.

Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar se sipas nenit 610 të KPC, (të zbatueshëm në atë kohë), ankimi i lejuar është ankim i veçantë, brenda një afati 5 ditor. Ky afat ka filluar të ecë nga e nesërmja e shpalljes, sipas neneve 443 dhe 444 të KPC dhe ka përfunduar me datë 28.10.2015. Nuk rezulton që kjo datë dhe ditët në vijim të kenë qenë ditë pushimi ose festë zyrtare, çka do të shkaktonte shtyrjen e afatit, sipas nenit 148 të KPC. Si rrjedhojë, në bazë të nenit 450/a të KPC, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit.

Duke u bazuar në konkluzionet e këtij vendimi njësuës, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural dhe duhet të lihet në fuqi.

Vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.1, datë 16.12.2022 (Rishikim vendimi)

Sipas nenit 494/a të KPC duhet të plotësohen katër kushte kumulative për t'i dhënë udhë rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë: 1) dalja e rrethanave apo provave të reja; 2) këto rrethana apo prova të reja duhet të kenë ekzistuar gjatë gjykimit, por nuk dihehin dhe as nuk mund të dihehin nga pala apo gjykata në kohën e gjykimit të çështjes, jo vetëm për shkak të veprimit të palës kundërshtare, por edhe, për çdo shkak tjetër që nuk rrjedh nga faji i palës që kërkon të mbështesë të drejtat e tij mbi provën ose rrethanën e zbuluar; 3) këto prova të mos jenë administruar gjatë gjykimit; 4) të kenë rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes. Parashikimi ligjor në nenin 495 të KPC, është i qartë për kushtin që duhet të plotësojë kërkesa për rishikim sipas nenit 494/ç, kur pretendohet dhënia e vendimit bazuar në dokumenta të falsifikuara dhe nuk le mundësi për ekuivoke. Kërkesa për rishikim, në rastet e parashikuara në pikat “b”, “c” dhe “ç” të KPC, duhet të shoqërohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë, lidhet me garancinë që çështja gjyqësore të rihapet, bazuar jo mbi dyshime se dokumentat ku është bazuar vendimi kanë qenë të falsifikuara, por mbi bazën e një shkalle të lartë të vërtetësisë mbi këtë fakt, në mënyrë të padiskutueshme.

Fjalë kyçe: Rishikim vendimi, dokumente të falsifikuara

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se, ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë, me vendimin nr. 609, datë 11.06.1996 i ka kthyer palës së paditur-kundër paditëse, Kishës Katolike “Zemra e Krishtit”, ndër të tjera, një ndërtesë të ndodhur në [...] Tiranë, [...]. Këtë banesë e përdorin paditësat në bazë të një kontrate qiramarrjeje me shtetin.

Paditësit e kundër paditur, duke pretenduar se banesa duhet të ruajë regjimin juridik të pronës shtetërore dhe se ata kanë të drejtën e privatizimit të saj sipas dispozitave mbi

privatizimin e banesave shtetërore, kanë kërkuar anulimin për këtë pjesë të vendimit të Komisionit të Pronave. Ata kanë pretenduar se banesa në kohën e shtetëzimit nuk ka qenë në pronësi të Kishës [...] por në pronësi të shoqërisë së huaj tregtare “SAVIEI”, prandaj padrejtësisht i është kthyer Kishës Katolike.

Nga ana tjetër, Kisha Katolike [...] me cilësinë e pronares, nëpërmjet kundërpadisë ka kërkuar detyrimin e paditësave t`i lirojnë e dorëzojnë banesën përkatëse.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1793, datë 24.04.1997, ka vendosur pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë; Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1740, datë 15.08.1997 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.. [...] **Gjykata e Kasacionit**, me vendimin nr. 446, datë 14.01.1998 ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.”

Në këtë vendim, Gjykata e Kasacionit ka orientuar gjykatën e apelit për të hetuar se çfarë është shoqëria “Saviei”, për çfarë qëllimi i blinte ajo këto prona, nga kush administrohej në atë periudhë kjo shoqëri dhe nga kush përfaqësohej shoqëria e Jezuitëve. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 115, datë 8.7.1998 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. [...] dhe pranimin e kundërpadisë [...] **Gjykata e Lartë**, me vendimin nr. 406, datë 30.4.1999 ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë. Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Apelit nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë...; pranimin e pjesshëm të kundërpadisë. Ruajtjen e pozitës juridike si qiramarrës të paditësve të kundër paditur, mbi banesën objekt gjykimi dhe detyrimin e tyre për lirimin e banesës në zgjidhjen e problemit të tyre të strehimit.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 470, datë 25.04.2002 ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.” Ndër të tjera, Gjykata e Lartë ka arsytuar se gjykata e apelit nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë. Në rigjykimin e çështjes, gjykata e apelit ka administruar vetëm një deklaratë të Kurisë së Përgjithshme të Jezuiteve të Romës, e cila ka qenë një dokument i administruar edhe në gjykimet e mëparshme dhe që i është nënshtruar vlerësimit si provë nga gjykatat. [...] Nga pala paditëse është pretenduar se prona nuk është blerë nga Kisha por nga shoqëria “SAVIEI” (shoqëria anonime Venete Industriale dhe Imobilare) dhe ky pretendim i saj është provuar gjatë gjyqimeve. Në këto rrethana, pala e paditur ka patur barrën për të vërtetuar pretendimin e ngritur në të gjithë gjykimet se edhe pse pronat janë blerë nga kjo shoqëri në fakt ato janë blerë për llogari të Kishës. [...] Nga hetimi i këtyre rrethanave varet zgjidhja përfundimtare e çështjes. Kjo për faktin se neni 23 i ligjit nr 7698 datë 15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronareve” përjashton nga trajtimi pronat e ish-mbretit dhe të shoqërive të huaja ose të përbashkëta.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1, datë 20.01.2003 ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë duke anuluar piken 1/a te vendimit nr.609, datë 11.06.1996 të K.K.K.Pronave Bashkia Tiranë, për godinën dy-katëshe në rruga e Kavajes; Rrëzimin e

kërkesë-padisë. [..]

Çështja ka kaluar për gjykim në **Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë**, ku është shtruar për unifikim kjo pyetje:

“(. . .) Në rrethanat e reja të shfuqizimit të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 dhe të mos përfshirjes në ligjin e ri të ndalimit të parashikuar në nenin 23 të këtij ligji për pronat e shoqërive të huaja, a vazhdojnë të konsiderohen të legjitimuar paditësat në kërkimin e tyre për anulimin e vendimit përkatës të Komisionit të Pronave [..]

Në përfundim, **Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë** me vendimin nr. 5, datë 30.03.2005 kanë arritur në konkluzionin unifikues se:

“...në rastet kur regjimi komunist ka shtetëzuar prona kundër Kishës Katolike, pavarësisht se ato kanë qenë të regjistruara në emër të personave fizikë apo personave juridikë (shoqëri tregtare) të krijuara para hyrjes në fuqi të marrëveshjes midis Shtetit Italian dhe Selisë së Shenjtë, këto prona i kthehen apo kompensohen Kishës Katolike.

Këto disponime në favor të Kishës Katolike mund të kundërshtohen vetëm nga trashëgimtarët e personave fizikë apo suksesorët e personave juridikë (shoqëri tregtare), në emrin e të cilëve kanë qenë të regjistruara pronat. Nga ana tjetër, çdo person që pretendon se ka një interes të ligjshëm, përfshirë këtu edhe qiramarrësit e ndërtesave të përshtatura për banim pas shtetëzimit të tyre, nuk mund të privohet nga drejta për të kundërshtuar vendimet e Komisioneve të Pronave, d.m.th. legjitimohet në një kërkim të tillë, veçse kundërshtimi mund të bëhet vetëm për shkaqe të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me marrëdhëniet faktike e juridike të rregulluara nga konkordati midis shtetit italian dhe Selisë së Shenjtë...”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arsyetuar se vendimi nr. 609, datë 11.06.1996 i Komisionit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të drejtë të dispozitave të Ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 [..] [..] Kolegjet e Bashkuara [..] arrijnë në përfundimin se në rastet kur regjimi komunist ka shtetëzuar prona kundër Kishës Katolike, pavarësisht se ato kanë qenë të regjistruara në emër të personave fizikë apo personave juridike (shoqëri tregtare) të krijuara para hyrjes në fuqi të marrëveshjes midis Shtetit Italian dhe Selisë së Shenjtë, këto prona i kthehen apo kompensohen Kishës Katolike.

Kolegjet kanë arritur në konkluzionin se padia e paditësave nuk rrëzohet thjeshtë për mungesë legjitimitimi procedural. Paditësat legjitimohen për ngritjen e padisë, si në regjimin juridik të Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993, ashtu edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”. Ligji i ri nuk e parashikon ndalimin për kthimin apo kompensimin e pronave të shoqërive të huaja, por, gjithsesi, çështja është zgjidhur sipas ligjit të mëparshëm dhe prona i është kthyer një subjekti për të cilin nuk ka pasur e nuk ka ndalim ligjor. [..]

Përsa i përket kundërpadisë vendimi i apelit duhet të lihet në fuqi. Posedimi i paditëseve nuk është i kundërligjshëm, sepse ai bazohet në një kontratë qiraje. Lirimi dhe dorëzimi i ndërtesës do të behet i mundur nëpërmjet ekzekutimit të vendimit të Komisionit të Pronave sipas modaliteteve të përcaktuara nga shteti për këtë qëllim.

Në përfundim, në lidhje me rastin konkret, **Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës**

së Lartë, kanë vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr.1 datë 20.01.2003 të Gjykatës së Apelit lidhur me padinë, rrëzimin e padisë se paditësave të kundërpaditur [...], kundër të paditurës kundër paditëse Kisha [...] me objekt anulimin e vendimit nr.609 datë 11.06.1996 të K.K.K Pronave Tiranë; Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit lidhur me kundërpadinë”

Më datë 30.01.2009, kërkuesi Gj.S. i është drejtuar Gjykatës së Lartë me një kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 5, datë 30.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [...].

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë gjyqësore. Meqenëse objekt i kërkesës për rishikim, është një vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore datë 25.02.2015 është vendosur që kërkesa për rishikim të gjykohej nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Është zhvilluar një seancë gjyqësore nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vitin 2017 e të cila është shtyrë për shkak të papajtueshmërisë së anëtarëve të trupës gjyqësore.

Në vijim, çështja është ri shortuar dhe është planifikuar gjykimi i çështjes [...] në seancë publike më datë 18.11.2022.

Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë:

Përsa i përket mënyrës se procedimit në lidhje me gjykimin e çështjes në fjalë, Kolegjet e Bashkuara [...] evidentojnë faktin se çështja në fjalë ka kaluar për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara si dhe është zhvilluar edhe seancë publike me prezencë të palëve.

Po kështu vlen të evidentohet fakti që objekt rishikimi është një vendim unifikues i praktikës gjyqësore, i cili në kohën e paraqitjes së kërkesës për rishikim (përpara ndryshimeve të KPC me Ligjin nr. 38/2017 datë 30.03.2017) ishte në kompetencë funksionale të Kolegjeve të Bashkuara.

Përsa më lartë, Kolegjet e Bashkuara vlerësuan se shqyrtimi i kërkesës për rishikim duhet të vijojë të shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në seancë gjyqësore. Duke iu kthyer çështja në gjykim, objekt i kërkesës për rishikim është vendimi unifikues nr.5, datë 30.03.2005. Nëpërmjet provave të paraqitura nga pala kërkuese bashkëlidhur kërkesës, kjo e fundit ka mohuar lidhjen midis pronave të shoqërisë “SAVIEI” dhe atyre të Kishës Katolike. Në këtë kuptim, nëpërmjet kërkesës për rishikim, pala kërkuese në thelb ka kundërshtuar konkluzionin unifikues [...]

Kolegjet e Bashkuara, vlerësojnë se pretendimet e palës kërkuese mbi statutin dhe aktin themeltar të shoqërisë “SAVEI” janë bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor dhe po ashtu këto prova janë administruar dhe janë bërë pjesë e debatit gjyqësor. Si rrjedhojë nuk mund të paraqiten rishtazi në mbështetje të kërkesës për rishikim.

Gjithashtu, pala kërkuese e ka mbështetur kërkesën në disa dokumenta arkivorë dhe hipotekorë të marra nga ish-ZVRPP Tiranë dhe nga institucione të tjera publike, një pjesë e të cilave janë lëshuar me kërkesën e tij gjatë gjykimimit. Në vijim pala kërkuese dhe më tej trashëgimtarët e tij, kanë paraqitur në vijimësi dokumenta të kësaj natyre,

me të cilat synojnë të vërtetojnë faktin se prona objekt gjykimi nuk i është shtetëzuar Kishës Katolike; se mbi truallin prej 713 m² nuk është ndërtuar godina e Kishës; se nuk ka patur një lidhje midis pronave të shoqërisë “SAVEI” dhe atyre të Kishës Katolike etj.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se këto pretendime janë haptazi të pambështetura në nenet 494 e vijues të KPC dhe në praktikën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme, kur ka interpretuar se çfarë kushtesh duhet të plotësojë kërkesa për rishikim sipas nenit 494/a të KPC.

Gjykata e Lartë, në praktikën e saj ka vlerësuar se, sipas nenit 494/a të KPC duhet të plotësohen katër kushte kumulative për t'i dhënë udhë rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë: 1) dalja e rrethanave apo provave të reja; 2) këto rrethana apo prova të reja duhet të kenë ekzistuar gjatë gjykimit, por nuk dihetin dhe as nuk mund të dihetin nga pala apo gjykata në kohën e gjykimit të çështjes, jo vetëm për shkak të veprimit të palës kundërshtare, por edhe, për çdo shkak tjetër që nuk rrjedh nga faji i palës që kërkon të mbështesë të drejtat e tij mbi provën ose rrethanën e zbuluar; 3) këto prova të mos jenë administruar gjatë gjykimit; 4) të kenë rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes. Përsa i përket kushtit të dytë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se mungesa e dijenisë mbi rrethanën apo provën e re, lidhet me pamundësinë objektive dhe jo subjektive të palës për të gjetur provat me të cilat do të provojnë pretendimet e tyre gjatë gjykimit. (vendim nr. 00-220-966, datë 17.12.2020; vendim 00-2018-194 i Vendimit (6) dt.15.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj).

Neni 494 i KPC duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë dhe kufizuese dhe në zbatimin e tij është e rëndësishme të mbahet parasysh karakteri përjashtimor dhe i jashtëzakonshëm i kërkesës për rishikim, si mjet për goditjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në praktikën e konsoliduar të GJEDNJ parimi i sigurisë juridike dikton rregullin, që kur mosmarrëveshja civile është shqyrtuar në themel nga gjykatat ajo duhet të vendoset njëherë e përgjithmonë dhe nuk duhet të diskutohet apo të vihet në pikëpyetje (*Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, app no 477 97/99 dhe 68698/01, dt. 12.01.2006*). Gjithashtu, GJEDNJ ka theksuar se, parimi i gjësë së gjykuar nënkupton, që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë vetëm për të përfituar një ridëgjim në seancë gjyqësore, një rishqyrtim dhe një rigjykim të çështjes. [...] Anashkalimi i këtij parimi, justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe detyruese (*Brumarescu kundër Rumanisë, app no 28342/95, dt. 28.10.1999*).

Gjykata e Lartë në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrimin se vendimi gjyqësor i formës së prerë që e ka zgjidhur çështjen në themel, përbën një zgjidhje të natyrës përfundimtare dhe të qëndrueshme të mosmarrëveshjes si në kuptimin konstituiv, ashtu dhe në atë prekluziv. Në kuptimin konstituiv ai jep zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pozitive të palëve të kundërta në atë gjykim, ndërsa në kuptimin prekluziv ndalohet mundësia e kërkimit në gjykatë të ndryshimeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

Derogimi nga parimi i përgjithshëm, mund të justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose detyrues nëpërmjet

rihapjes së çështjes. Meqenëse, rishikimi i vendimit civil të formës së prerë është një mjet i jashtëzakonshëm, ai nuk cenon parimin e përgjithshëm që ndalon goditjen e vendimit të formës së prerë, dhe nuk i heq vendimit që kërkohet të rishikohet cilësinë dalluese të pakundërshtueshmërisë, sepse rishikimi, mbetet gjithmonë një mjet shumë i kufizuar, që mund të ushtrohet vetëm në ato raste përjashtimore, kur ka të dhëna se vendimi gjyqësor i formës së prerë, i cili ka zgjidhur konfliktin gjyqësor në mënyrë përfundimtare, nuk i përgjigjet të vërtetës objektive (vendim 00-2014-3434 (360), datë 06.06.2014 i Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë).

Gjatë gjykimit civil pala që bën pretendimin është e ngarkuar me barrën e provës, qoftë për të paraqitur provat që ndodhen pranë saj, qoftë duke ju drejtuar të tretëve (insitucione shtetërore apo subjekteve privatë) dhe në pamundësi të shfrytëzojë mjetet e parashikuara në nenet 223 dhe 224 të KPC që këto prova t'i sigurojë nëpërmjet gjykatës.

Kërkesa për rishikim nuk mund të shërbejë si mjet për rihapjen e procesit gjyqësor, sa herë që pala ndërgjyqëse, e cila ka ometuar për faj të saj, në përmbushjen e barrës së provës gjatë gjykimit, gjen prova që objektivisht mund dhe duhet t'i kishte paraqitur gjatë procesit gjyqësor (Vendim nr. 00-220-966, datë 17.12.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë). Në rastin konkret Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, në thelb, kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi, është një apel i fshehur nga pala e pakënaqur me vendimin gjyqësor dhe ka për qëllim një rishqyrtim të çështjes nga e para, për rrethana, fakte apo prova që mund të ishin paraqitur prej saj gjatë gjykimit. Dokumentat arkivore dhe hipotekorë të paraqitura nga pala kërkuese, duke pretenduar se paditësit nuk gëzojnë cilësinë e ish-pronarit, janë prova të cilat kjo e fundit, i kishte të gjitha lehtësitë dhe mundësitë për t'i gjetur, mjafton të tregonte kujdesin e duhur gjatë gjykimit dhe mjafton t'i drejtohej me kërkesë institucioneve përkatëse, sikurse e ka bërë menjëherë sapo ka përfunduar gjykimi.

Dokumentacioni i paraqitur nga pala kërkuese, pavarësisht datës se kur është nxjerrë, ka ekzistuar gjatë gjykimit dhe pala paditëse nuk ka patur asnjë pengesë objektive për të paraqitur këto dokumenta. Për më tepër, mbrojtja e palës së paditëse duhet të kishte qenë e orientuar në hetimin dhe marrjen e këtyre dokumentave, kur çështja e shtruar për diskutim dhe debati gjyqësor ka qenë përqendruar pikërisht tek lidhja që ekziston midis pronave të shoqërisë "SAVIEI" dhe Kishës Katolike dhe nëse mbi pronën objekt gjykimi, i padituri gëzon cilësinë e ish-pronarit. Kjo ka qenë arsyeja pse çështja është kthyer disa herë për rigjykim në apel nga Gjykata e Lartë.

Kërkuesi nuk ka argumentuar dhe provuar në kërkesën për rishikim se pse me gjithë kërkimet e tij, objektivisht e ka patur të pamundur të gjejë këto prova gjatë gjykimit dhe njëkohësisht nuk rezulton që kjo pamundësi të ketë ardhur për shkak të veprimeve me keqbesim të palës kundërshtare.

Akti i ekspertimit teknik-grafik, i realizuar gjatë hetimit paraprak nga prokurori, nuk mund të shërbejë si bazë dhe shkak për rishikimin e vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 494/ç dhe 495 të KPC. Sipas këtyre dispozitave, nëse pala pretendon se vendimi gjyqësor i formës së prerë është bazuuar në dokumenta të falsifikuar, rishikimi lejohet vetëm nëse një rrethanë e tillë është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë

civil ose penal (shiko vendim nr. Nr. 00-2009-303 (95), dt. 19.03.2009; Vendim Nr.00-2009-814 i Vendimit (218), dt. 18.06.2009; Vendim i (277), dt. 25.04.2013; Vendim nr. 00-2014-2010 (247), datë 20.05.2014; Vendim Nr. 00-2018-194 i Vendimit (6) dt.15.02.2018 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.)

Parashikimi ligjor në nenin 495 të KPC, është i qartë për kushtin që duhet të plotësojë kërkesa për rishikim sipas nenit 494/ç, kur pretendohet dhënia e vendimit bazuar në dokumenta të falsifikuara dhe nuk le mundësi për ekuivoqe. Qëllimi i Ligjvënësit ku ka parashikuar detyrimin që kërkesa për rishikim, në rastet e parashikuara në pikat “b”, “c” dhe “ç” të KPC, duhet të shoqërohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë, lidhet me garancinë që çështja gjyqësore të rihapet, bazuar jo mbi dyshime se dokumentat ku është bazuar vendimi kanë qenë të falsifikuara, por mbi bazën e një shkalle të lartë të vërtetësisë mbi këtë fakt, në mënyrë të padiskutueshme.

IV. Dëm Jashtëkontraktor

KCGJL Vendim Nr.00-2022-917(44), datë 01.02.2023 (Afati para-shkrimit)

Momenti i lindjes të së drejtës së padisë përcaktohet si momenti i fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit, pasi vetëm me lindjen e kësaj të drejte mund të flitet për mosveprim të titullarit dhe vetëm kur cenohet e drejta subjektive lind e drejta e padisë për mbrojtjen e saj. Sipas nenit 120 të KC, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar. Këto dy kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative. Në këtë vështrim, parashkrimi i padisë dëmin jashtëkontraktor ka filluar të ecë nga momenti kur ata janë dëmtuar dhe janë vënë në dijeni për personin që i'u ka shkaktuar dëmin.

Fjalë kyçe: shpërblim dëmi jo kontraktor, afati i parashkrimit, momenti i lindjes të së drejtës së padisë, marrja dijani shkak dëmi

Rrethanat e çështjes:

Nga administrimi i dosjes gjyqësore ka rezultuar se, paditësi E.D. është i biri i paditësit J.D. [...] Shoqëria “ART-Ndërtim” sh.p.k, është shoqëri tregtare, [...] që ushtron veprimtari në fushën e ndërtimit.

Më datë 09.11.2008, rreth orës 12.00, në Lagjen “11 Janari” të qytetit Gjirokastrë, nga kryerja e punimeve të gërmimit për hapjen e sheshit për ndërtimin e një objekti masiv banimi dhe shërbimesh, është shkaktuar shembja e pjesshme e një pallati banimi 5-katësh, të ndodhur në afërsi të objektit në ndërtim. Pallati i shembur ndodhej në pjesën e sipërme të një kodre, [...] ndërsa punimet kryheshin nga shoqëria “ART-Ndërtim” sh.p.k, në pjesën e poshtme, [...] Ka rezultuar e provuar se si pasojë e aksidentit, shkatërrimit dhe rrënimit të plotë të pallatit kanë gjetur vdekjen shtetaset V.D. [...] dhe E.D. [...] bashkëshortja dhe e bija e paditësit J.D. (nëna dhe motra e paditësit E.D.).

Për këtë ngjarje ka filluar çështja penale ndaj administratorit të shoqërisë S.J. dhe personave të tjerë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr.300 datë 10.11.2009 ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit S.J. [...] për veprën penale të “vrasjes nga pakujdesia” parashikuar nga neni 85 i K.P. dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit S.J. për veprën penale të “shpërdorimit të pronës nga pakujdesia” parashikuar nga neni 161 i K.P dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. [...] Gjykata e Apelit Gjyqësor me vendimin [...], ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë [...] Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. [...]ka vendosur [...] Pushimin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë për të gjykuarin S.J.

Nëpërmjet padisë objekt shqyrtimi gjyqësor, paditëset kanë pretenduar se si rezultat i shembjes së pallatit është shkaktuar një dëm jashtëkontraktor pasuror dhe jopasuror, ku sipas llogaritjeve të paditësve, dëmi pasuror dhe jopasuror arrin vlerën 100.200.000 lekë, të ndarë si dëm material jo pasuror 82.200.000 lekë dhe dëm pasuror 18.000.000 lekë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, [...] ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësve [...] Gjykata e Apelit Gjyqësor, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se në rekursin e paraqitur ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

[...]Në rastin konkret Kolegji vlerëson se parashkrimi është një fakt juridik i kategorisë së ngjarjeve me vërtetimin e të cilit vijnë pasoja me natyrë shuese, pasoja këto të lidhura me të drejtën subjektive të përdorimit të njerit prej mjeteve bazë dhe më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave civile-padisë. Ligji duke u njohur personave të drejtën subjektive për t’iu drejtuar gjykatës me anën e padisë, njëkohësisht, e kufizon ushtrimin e kësaj të drejte me afate të caktuara kohore, të gjykuara të arsyeshme dhe të mjaftueshme nga ligjvënësi për ushtrimin e kësaj të drejte. Mosushtrimi i të drejtës brenda këtyre afateve bën që subjekti të humbasë të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, pra të humbasë të drejtën për të detyruar palën tjetër të përmbushë detyrimin e saj. Në nenin 112 KC [...]. Në kuptimin material padia është e drejta subjektive që i takon subjektit të së drejtës civile dhe që duhet të ushtrohet brenda një afati kohor të caktuar; së dyti, në kuptimin procedural është mjetei përmes të cilit vihet në lëvizje Gjykatë dhe në këtë kuptim kjo e drejtë mund të ushtrohet në çdo moment pa qenë e kufizuar në kohë (pra nuk parashkruhet). Në një gjykim civil palët pjesëmarrëse janë paditësi dhe i padituri. Paditësi është personi i cili investon Gjykatën pasi pretendon se i është cënuar, mohuar apo shkelur një e drejtë nga pala tjetër ndërgjyqëse (i padituri) të cilën e thërret në gjykim (*legjitimimi real ose legitimatio ad causam*).

Kolegji vëren se elementet përbërëse të parashkrimit janë dy: mosveprimi i titullarit (*mbajtësit*) të së drejtës subjektive dhe kalimi i kohës brenda të cilës ai duhet ta kishte

ushtruar këtë të drejtë. Pra, parashkrimi është humbja e të drejtës së padisë për shkak të kalimit të afateve të përcaktuara në ligj. Parashkrimi shues sjell shuarjen e të drejtës subjektive. Arsyeja për të cilin rregullimi juridik e lidh me shkaqet jo të arsyeshme të titullarit shuarjen e së drejtës subjektive qëndron në nevojën e sigurisë së marrëdhënieve juridike. Kur një e drejtë subjektive nuk ushtrohet, tek njerëzit formohet bindja që ajo nuk ekziston ose sepse është braktisur.

Parashkrimi zbatohet në pjesën më të madhe të marrëdhënieve pasurore që përbëjnë objektin e rregullimit juridik të së drejtës civile. Nëse i referohemi fushës së marrëdhënieve personle jopasurore si rregull ato nuk parashkruhen, përveç kur në ligj është parashikuar shprehimisht e kundërta.

[..] Për lloje të ndryshme marrëdhëniesh e drejta e padisë lind në kohë të ndryshme. Në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat dhe kur detyrimi është i përbërë nga pagesa periodike, për secilën prej tyre afati i parashkrimit fillon të ecë në mënyrë të veçantë. Për detyrimet kontraktore të lidhura pa afat dhe për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, afati i parashkrimit fillon nga dita kur ka lindur detyrimi. Për kërkimin e sendit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur pronari ka marrë ose duhej të merrte dijëni për cenimin dhe cenuesin e së drejtës së tij. Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar. Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur, ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës; Padi të e kthimit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur paditësi ka paguar vullnetarisht, në bazë të një detyrimi ligjor ose kontraktor, personit të tretë, për fajin e të paditurit, shumën e parave apo sendin që kërkohet me anë të kësaj padie, ose nga dita kur është dhënë vendimi i gjykatës ose arbitrazhit përkatës nga i cili ka lindur padia e regresit. Plotësimi i afatit për kërkimin kryesor bën që të parashkruhen dhe padi të për kërkimet e rrjedhura prej saj, pavarësisht nëse për to nuk është plotësuar afati i parashkrimit si kërkime më vete (*neni 124 KC*).

Mund të ndodhë që para se të fillojë të ecë afati i parashkrimit ose pasi afati ka filluar të ecë, të vërtetohen rrethana të cilat pengojnë titullarin e së drejtës për të realizuar të drejtën e tij subjektive nëpërmjet ngritjes së padisë. Në rastet kur vërtetohen rrethana të tilla penguese bëhet fjalë për pezullim të parashkrimit. Pezullimi i parashkrimit konsiston në mosfillimin ose mosecjen e afatit të parashkrimit për sa kohë ekziston rrethana (*ose rrethanat*) që nuk e lejojnë titullarin e të drejtës të paraqesë padinë. Ecja e afatit të parashkrimit ndalohet nga vërtetimi i shkakut të pezullimit, pas rënies së të cilit afati vazhdon të ecë. Shkaqet e pezullimit të parashkrimit parashikohen në mënyrë të shprehur dhe shteruese nga ligji. Pengesat e tjera të çfarëdolloji qofshin nuk merren parasysh. Ndërprerja e parashkrimit është rrethana e cila pengon ecjen e afatit të parashkrimit. Koha e kaluar përpara vërtetimit të rrethanës/rrethanave që sjell ndërprerjen nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së shkakut ndërprerës fillon të ecë një afat i ri parashkrimi. Duke ju rikthyer mosmarrëveshjes objekt gjykimi Kolegji vëren se afati

i parashkrimit për paditë që kanë për objekt kërkimi shpërblimin e dëmit jo kontraktor është tre vjeçar (neni 115/dh KC). Sipas nenit 117 të po këtij Kodi afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë. Nga momenti i lindjes të së drejtës fillon të ecë afati i parashkrimit. Pra, ky është momenti nga i cili fillon të llogaritet ky afat, llogaritje që bëhet sipas nenit 136 të KC. Momenti i lindjes të së drejtës së padisë përcaktohet si momenti i fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit, pasi vetëm me lindjen e kësaj të drejte mund të flitet për mosveprim të titullarit dhe vetëm kur cenohet e drejta subjektive lind e drejta e padisë për mbrojtjen e saj.

Sipas nenit 120 të KC, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar. Këto dy kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative. Në këtë vështrim, parashkrimi i padisë për paditësat ka filluar të ecë nga momenti kur ata janë dëmtuar dhe janë vënë në dijeni për personin që i'u ka shkaktuar dëmin. Duke i'u referuar këtij rregulli ligjor dhe fakteve të vërtetuara gjatë gjyqimit për rastin arrihet në përfundimin se gjykatat nuk kanë hetuar në drejtim të përcaktimit të momentit konkret kur pala paditëse ka marrë dijeni për subjektin që ka shkaktuar dëmin.

Gjykata e Apelit duhet të kishte analizuar në tërësi të gjitha provat që i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor në shkallë të parë duke i dhënë përgjigje secilit prej shkaqeve të ankimit si dhe duke konkluduar në një përfundim harmonik të tyre, referuar në nenin 14 të KPC [...] Për sa më lart, në rigjykim, Gjykata e Apelit duhet të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt gjykimi duke administruar provat e kërkua nga palët si dhe t'u japë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura në ankim.

Kolegji vëren se në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 98/2016 [...] VKM nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, si dhe Vendimit të KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, që prej datës 1 shkurt 2023 ka nisur funksionimi i hartës së re gjyqësore përmes riorganizimit të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm. [...] për këto arsye shqyrtimi i çështjes konkrete do të duhet të vijojë nga Gjykata e Apelit Tiranë Juridiksioni i Përgjigjshëm.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2023-2726(414), datë 21.06.2023

KCGJL Vendim Nr.00-2023-3102(472), datë 19.07.2023 (Llogaritje dëmi në aksidente automobilistike)

Mospërcaktimi i saktë i ligjit të zbatueshëm nga ana e gjykatave më të ulëta passjell që edhe përcaktimi i masës së dëmshpërblimit nga ana ato të mos nuk bëhen në pëpruthje me ligjin. Ligji i zbatueshëm për të përcaktuar masën e dëmshpërblimit në aksidentet automobilistike është ligji që gjen zbatim gjatë kohës kur ndodh ngjarja e paligjshme. Në lidhje me përlllogaritjen e masës së dëmit nuk ka rëndësi momenti se kur ka hyrë në fuqi Rregullorja nr. 53/2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga

kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” e AMF, pasi referuar parashikimeve të saj mbi shtrirjen e efekteve në kohë të saj dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, edhe pse ka hyrë në fuqi në momentin e publikimit në Fletoren Zyrtare, gjen zbatim me efekt prapaveprues në çdo rast që është në shqyrtim nga shoqëritë e sigurimit apo edhe për çdo çështje që është në gjykim, në kohën e hyrjes në fuqi të saj.

Fjalë kyçe: aksidente automobilistike, ngjarje e paligjshme, masë dëmshpërblimi

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e administruara në dosje, ka rezultuar i provuar fakti se, paditësja me datën 15.03.2011, ka pësuar një aksident nga mjeti motorik [...], i drejtuar nga F.D, në Sheshin “Rilindja“, Tiranë, [...].

Si pasojë e këtij aksidenti, pala paditëse ka pësuar dëmtime të shëndetit të saj dhe është dërguar me urgjencë në Spitalin Qendror Ushtarak, ku i është përcaktuar diagnoza klinike *fractura coli humeni et colles dexter*. Për këtë arsye, paditësja i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale me reponim të hapur të frakturave.

Referuar Aktit të Ekspertizës Mjeko – Ligjore me nr. 556, dëmtimet e paditëses futën në kategorinë e atyre dëmtimeve që për pasojë kanë dhënë humbje të aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 (nëntë) ditë, por për të gjykuar në lidhje me kriterin e humbjes së aftësisë për punë në masën mbi një të tretën, kërkohet riezaminimi i të dëmtuarës 6 muaj pas ditës së ngjarjes.

Sipas ekzaminimeve të bëra në Klinikën Mjekësore [...] rezulton se tek paditësja konstatohet *hernie diskale mediolateral sinistra në C5-6*. Gjithashtu referuar epikrizës nr.02 regj., datë 21.01.2012 të lëshuar nga “[...] tek paditësja janë konstatuar dhimbje e kufizim të lëvizjeve në artikulationin radio – [...] ishin të fiksuar në 5 gradë flexion. Për shkak të këtyre dëmtimeve, paditësja nuk arrin të bëjë abduktion të krahut mbi 90 gradë, si dhe gishtat e saj kryejnë lëvizje deri në masën 15 gradë në artikulationet interfalangeale. Për këto shkaqe, ajo është shtruar në klinikën e më sipërme për trajtim të mëtejshëm dhe rehabilitim.

Nga ana tjetër ka rezultuar se në lidhje me ngjarjen aksidentale, Policia e Qarkullimit Rrugor Tiranë ka kryer të gjitha veprimet paraprake hetimore për të evidentuar rrethanat e mekanizmit të ngjarjes si dhe të autorit të veprës penale. [...] Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, nga ana e saj ka nisur procedimin penal në ngarkim të shtetasit F.D. për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”.

Referuar Aktit të Ekspertimit Autoteknik nr. 14, datë 22.03.2011, ka rezultuar së shkak i aksidentit ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit të mjetit motorik [...] konkretisht e nenit 152, pika 1, germa “a” e KRR [...]. Sipas Vendimit “Për mos fillimin e procedimit penal nr. 1904/11 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera është pasqyruar se: “Në rastin konkret, kemi shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit [...] F.D.” dhe “... nga ana e këmbësorës S.Sh.

nuk është konstatuar shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor“.

Pala paditëse ka pretenduar se mjeti shkaktar i aksidentit, nuk ka qenë i siguruar në asnjë nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në treg, me asnjë policë sigurimi të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj palëve të treta. Në kushtet kur, ngajrja aksidentale e datës 15.03.2011 është shkaktuar nga një mjet motorrik i pasiguruar, atëherë dëmi i ardhur nga ky aksident mbulohet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit, referuar nenit 29 të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Bazuar sa më sipër, pala paditëse në datën 02.02.2013, i është drejtuar me kërkesë për kompensimin e dëmit palës së paditur në këtë gjykim, Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Gjithashtu, pala paditëse ka pretenduar se i është drejtuar po në datën 02.02.2013, edhe shoqërisë së sigurimeve “Albsig” sh.a, me kërkesën për kompensimin e demit që i është shkaktuar nga ngajrja aksidentale e datës 15.03.2011.

Në kushtet kur pala e paditur nuk i ka kthyer asnjë përgjigje palës paditëse në lidhje me kërkesën e saj për kompensimin e dëmit, pala paditëse [...] i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë [...] duke kërkuar [...] shtëm e plotë pasuror e jopasuror (biologjik, moral dhe ekzistencial) në vlerën 1 500 000 lekë (një milion e pesëqind mijë) lekë dhe shpenzimet e kryera për shkak të dëmit që i është shkaktuar asaj [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë; Detyrimin e palës së paditur [...] të dëmshpërblejë paditësen [...] për dëmin pasuror dhe jopasuror (biologjik, moral dhe ekzistencial) që i është shkaktuar asaj në aksidentin e datës 15.03.2011 në shumën 1 500 000 [...] lekë. [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit [...]**

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]vlerëson se rekursi i paraqitur nga nga pala e paditur në këtë gjykim, Byroja Shqiptare e Sigurimit, kundër vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC, të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

[...] Kolegji, për shkak të rëndësisë që paraqet kjo çështje në lidhje me përcaktimin e saktë të ligjit të zbatueshëm mbi bazën e të cilit duhet të bëhet përlllogaritja e dëmit pasuror dhe jopasuror, vlerëson të ndalet në analizimin dhe shqyrtimin e atyre shkaqeve që lidhen me mënyrën e përlllogaritjes së dëmit, duke mos u marrë parasysh përcaktimet e Rregullores nr. 53/2009.

Të dyja gjykatat më të ulëta kanë vendosur pranimin e padisë së paraqitur nga pala paditëse në këtë gjykim, duke e përlllogaritur dëmin pasuror dhe atë jopasuror sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 [...]në shumën prej 1,500,000 [...] lekë. Të dyja gjykatat kanë pranuar faktin se, Rregullorja e miratuar me vendimin nr. 53, datë 25.06.2009 AMF, nuk gjen zbatim në këtë rast, pasi nuk është publikuar në Fletore Zyrtare, qëndrim i cili vjen ndesh me praktikën e këtij Kolegji.

Në praktikën e vazhdueshme të Gjykatës së Lartë, në çështje të ngjashme, është mbajtur qëndrimi se Rregullorja e AMF-së ka hyrë në fuqi në momentin e botimit të saj në Fletoren Zyrtare. Megjithatë, ajo zbatohet me efekt prapaveprues edhe për çështjet

që janë në shqyrtim nga shoqëritë e sigurimit apo edhe për çështjet që janë në gjykim, në momentin e hyrjes në fuqi të saj. Në bazë të parimit “*lex specialis derogat generali*”, pra kur në një gjykim zbatohen njëkohësisht dy ligje (materiale apo procedurale), atëherë do të zbatohet ligji i posaçëm pasi ai ka prioritet mbi ligjin e përgjithshëm, baza e rregullimit të marrëdhënies së detyrimit të krijuar midis palëve do të jetë (*lex specialis*), si dhe aktet nënligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mbajtësit e automjeteve.

Ligji nr. 10076[...], duke bërë një rregullim specifik të formulës së llogaritjes, ka vendosur rregulla të përgjithshme për çdo subjekt sigurimi dhe standarde të njëjta në trajtimin dhe vlerësimin e pagesave të dëmeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 7641, datë 01.12.1992 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij të fundit (Neni 59 i ligjit nr.10076/2009).

Kolegji, çmon se çështja që shtrohet për analizë dhe diskutim ka të bëjë identifikimin e ligjit të zbatueshëm në çështjen konkrete, momentin e lindjes së mosmarrëveshjes objekt gjykimi në raport me momentin e hyrjes në fuqi të Rregullores nr.53, datë 25.06.2009, si dhe efektet juridike të këtij akti nënligjor normativ. Në këtë kuadër, Kolegji vlerëson se AMF ka miratuar Rregulloren me vendimin nr.53, datë 25.06.2009, e cila sipas nenit 51, pika 3 “*Dispozitat kalimtare dhe të fundit*”, parashikon se: “*Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e botimit të saj në faqen elektronike zyrtare të Autoritetit*”.

Duke qenë se ligji nr.10076, datë 12.02. [...] dhe ligji nr.9572, datë 03.07.2006 “[...] nuk përmbajnë dispozita konkrete të cilat dispijlojnë procesin e shpalljes dhe botimit të akteve normative nënligjore të nxjerra nga AMF (neni 117, pika 2 e Kushtetutës), atëherë për shpalljen dhe botimin e këtyre akteve normative me qëllim hyrjen në fuqi të tyre, do të zbatohen dispozitat e Kushtetutës [...] (neni 117, pika 1) dhe ato të ligjit të kohës, konkretisht ligjit nr.8502, datë 30.6.1999 [...] (*shih vendim nr. 00-2014-2914 (473), datë 18.09.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë*).

Me ligjin e posaçëm nr. 10076/2009, ligjvënësi ka plotësuar boshllëqet ligjore që ekzistonin në këtë fushë dhe që nxitën dhe sollën nevojën për interpretimin e disa dispozitave të përgjithshme të Kodit Civil nga ana e Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 12, datë 14.09.2007, i cili, pati si qëllim interpretimin e dispozitave të përgjithshme të shpërblimit të dëmit, në mungesë të rregullimit në mënyrë të detajuar nga legjislacioni i kësaj fushe. Me Vendimin unifikues nr.12, datë 14.09.2007, u interpretuan gjerësisht parimet mbi shpërblimin e dëmit, por për llogaritja u referua që të kryhej në bazë të akteve nënligjore të posaçme të dala pikërisht për këtë qëllim. Ky legjislacion i posaçëm në këtë fushë, gjithashtu nëpërmjet aktit normativ nënligjor (i dalë në bazë dhe në zbatim ligjit nr.10076/2009), Rregullores nr. 53, datë 25.6.2009, “*Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit*”, ka përcaktuar tashmë edhe kriteret tabelore ligjore ku duhet të mbështeten gjykatat për përcaktimin e vlerës së dëmshpërblimit. Këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e ushtrimit nga ana e institucioneve shtetërore ligjvënëse të së drejtës për të rregulluar ndryshe një situatë ekzistuese në varësi të kërkesave që imponon evoluimi i vazhdueshëm i shoqërisë. Kjo e drejtë reflektohet në krijimin e një

kuadri normativ dinamik që i përshtatet zhvillimit të shoqërisë. (*shih vendimin nr.37, datë 13.06.2012; vendimin nr.6, datë 17.02.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

Në rastin në shqyrtim, rezulton se përmbajta e Rregullores nr.53, datë 25.6.2009, [...] është në përputhje të plotë me frymën dhe përmbajtjen e dispozitave e ligjit nr. 10076/2009.

Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. [...]

Në analizë të përmbajtjes së këtij akti nënligjor normativ rezulton se, ligji nr. 10076/2009, në nenin 13 të tij ka autorizuar AMF, si organin kompetent për të nxjerrë një akt nënligjor, si dhe çështjet që do të rregullojë akti dhe parimet në bazë të të cilit ai do të nxirret. Në këtë kuadër, Kolegji Civil çmon se, Rregullorja nr. 53, datë 25.6.2009[...] për sa kohë ka dalë në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 10076/2009 është i detyrueshëm për zbatim. Një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është ai i “sigurisë juridike”, i cili, ndër të tjera ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qartë, të përcaktuar dhe të kuptueshëm, si dhe shmangia e vakumeve legislative është në mbrojtje të këtij parimi të rëndësishëm, (*shih vendimin nr.31, datë 19.11.2003; vendimin nr.34, datë 20.12.2005; vendimin nr.9, datë 26.02.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 [...] është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 04.03.2009 dhe ka hyrë në fuqi në datën 19.03.2009. Ndërkohë, me vendimin e AMF nr. 53, datë 25.06.2009, në mbështetje të nenit 13, të Ligjit nr.10076/2009, është miratuar Rregullorja “Për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”. Ky akt normativ nënligjor është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 25.01.2012 (datë në të cilën Fletorja Zyrtare ka dalë nga shtypi) dhe ka hyrë në fuqi, në datën 26.01.2012.

Kolegji çmon se, në mbështetje të nenit 117 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare. Nga ana tjetër shpallja dhe botimi i akteve të tjera normative, bëhet sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Kolegji kërkon të sqarojë dy koncepte të rëndësishme të cilat lidhen me procesin e publikimit/shpalljes apo botimit të akteve normative si “shpallja e aktit normativ” dhe “botimi i aktit normativ në Fletoren Zyrtare”. Shpallja e aktit normativ përbën në vetvete një proces publikimi (njoftimi), i cili jo domosdoshmërisht konsiston në botimin në Fletoren Zyrtare. Organi përkatës i cili ka nxjerrë aktin normativ në funksion të llojit të aktit, specifkave të marrëdhënies që rregullon, si dhe në funksion të kohës që ka në dispozicion, krahas botimit në Fletoren Zyrtare, mund të aplikojë forma të tjera të përshtatshme të komunikimit zyrtar të aktit normativ.

Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se botimi i një akti në Fletoren Zyrtare, krahas shpalljes dhe publikimit (njoftimi) të përmbajtjes së aktit normativ, ka gjithashtu dhe karakter “konstitutiv” duke synuar hyrjen në fuqi të tij. Botimi i një ligji apo akti nënligjor normativ në Fletoren Zyrtare, kërkohet si kusht i domosdoshëm për hyrjen në fuqi (*krijimin e pasojave juridike*), për aktet normative me efekt ndaj personave

fizikë ose juridikë, për ato që krijojnë të drejta dhe detyrime, që detyrojnë ose ndalojnë kryerjen e një veprimi, sepse ndryshe nuk mund të zbatohet prezumimi “*nemo censetur ignorare legem*” (askush nuk mund të quhet se nuk e njeh ligjin) (shih vendimin nr.03, datë 23.02.1995; vendimin nr.47, datë 07.07.1999; vendimin nr.53, datë 28.09.1999; vendimin nr.206, datë 24.12.2001, të Gjykatës Kushtetuese).

Në këtë kuadër, duke mbajtur në konsideratë faktin se AMF ka miratuar Rregulloren me Vendimin nr. 53, datë 25.6.2009, e cila sipas nenit 51, pika 3 “Dispozitat kalimtare dhe të fundit[...].si dhe duke qenë se Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “[...]dhe Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “[...]nuk përmbajnë dispozita konkrete të cilat dispijlojnë procesin e shpalljes dhe botimit të akteve normative nënligjore të nxjerra nga AMF (neni 117, pika 2 i Kushtetutës), atëherë për shpalljen dhe botimin e këtyre akteve normative me qëllim hyrjen në fuqi të tyre, do të zbatohen dispozitat e Kushtetutës (neni 117, pika 1) dhe ato të ligjit të kohës, konkretisht Ligjit nr. 8502, datë 30.06.1999 [...].

Një çështje tjetër e rëndësishme e cila vlen për t`u analizuar është edhe çështja e momentit të fillimit të efekteve juridike të aktit nënligjor normativ. Kolegji Civil çmon se me kohë apo moment i “*hyrjes në fuqi të aktit normativ*”, do të kuptohet ai moment kur ka lindur detyrimi për njohjen dhe respektimin e përmbajtjes së aktit normativ (normës abstrakte) nga ana personave fizikë ose juridikë të cilëve i drejtohet, ndërsa me “*shtrirjen e efekteve juridike të aktit normativ*”, do të kuptohet momenti i prodhimit të pasojave juridike nga përmbajtja e këtij akti normativ. Hyrja në fuqi e aktit normativ, jo domosdoshmërisht mund të përkojë në kohë me shtrirjen e efekteve juridike të aktit normativ. Në varësi të shtrirjes së efekteve juridike të aktit normativ, organet të cilat të cilat nxjerrin këto akte mund të parashikojnë momente të ndryshme të shtrirjes së efekteve juridike të këtyre akteve normative (*prapavepruese, apo të vonuar*) në varësi të qëllimit, objektit dhe specifikave të marrëdhënies juridike e cila rregullohet nëpërmjet tyre.

Rregullorja nr. 53, datë 25.6.2009, në nenin 51, pika 1, [...] Kolegji vlerëson se është parim i njohur i së drejtës se ligji nuk ka fuqi prapavepruese. Ligji ka fuqi vetëm për marrëdhëniet juridiko civile që lindin pas hyrjes në fuqi të tij dhe se *zbatimi i tij për marrëdhënie juridike që kanë lindur më parë, lejohet vetëm kur parashikohet shprehimisht në ligj*. Në rastin konkret, rezulton se është vetë akti normativ ka parashikuar shprehimisht fuqinë prapavepruese të shtrirjes së efekteve të tij, pavarësisht botimit në datën 25.01.2012 dhe hyrjes në fuqi në datën 26.01.2012.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se nga ana e të dy gjykatave më të ulëta, gjatë procesit të analizimit të çështjeve të cilat kishin të bënim me shpërblimit të dëmit jokontraktor, figurat përkatëse të secilës kategori dëmi, rrethin e subjekteve të cenuara, kriteret e pranimit dhe caktimit të masës së dëmshpërblimit, krahas dispozitave të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 [...] duhet të ishin mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009[...].

Në çështjen konkrete, ngjarja e aksidentit apo fakti i paligjshëm ndaj paditëses që përcakton edhe momentin e veprimit në kohë të ligjit të zbatueshëm, ka ndodhur me datë 15.03.2011. Në këtë kohë kishte hyrë në fuqi ligji nr.10076/2009. Rezulton se ky

ligj është botuar në Fletoren Zyrtare në datë 04.03.2009 dhe ka hyrë në fuqi në datë 19.03.2009 (15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, referuar nenit 60 që përcakton hyrjen në fuqi të tij). Ndërkohë Rregullorja nr. 53, e vitit 2009, ka hyrë në fuqi me datë 25.01.2012, pra, pas ngritjes së padisë në datën 04.03.2013, gjatë kohës që çështja ka qenë në gjykim.

Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se nuk ka rëndësi momenti se kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e AMF. Referuar parashikimeve të Rregullores mbi shtrirjen e efekteve në kohë të saj dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, Rregullorja nr. 53, e vitit 2009, edhe pse ka hyrë në fuqi në momentin e publikimit në Fletoren Zyrtare, gjen zbatim me efekt prapaveprues në çdo rast që është në shqyrtim nga shoqëritë e sigurimit apo edhe për çdo çështje që është në gjykim, në kohën e hyrjes në fuqi të saj.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se, vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë është rrjedhojë e mospërcaktimit të saktë të ligjit të zbatueshëm në këtë rast në lidhje me përlllogaritjen e masës së dëmit dhe për këtë arsye, arrin në konkluzionin se ky vendim duhet të priset dhe çështja të kthehet për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë, me një trupë tjetër gjykuese. Në përcaktimin e Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në rigjykimin, Kolegji, mban në vëmendje faktin se, me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022 të KLGJ “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, është vendosur se, nga data 01.02.2023, Gjykata e Apelit Tiranë emërtohet Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila, operon si gjykata e vetme në nivel apeli për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Mospërcaktimi i saktë i ligjit të zbatueshëm nga ana e gjykatave më të ulëta ka sjellë që edhe përcaktimi i masës së dëmshpërblimit nga ana e dy gjykatave më të ulëta nuk është bërë në përputhje me ligjin dhe për këtë arsye, Gjykata e Lartë si një gjykatë ligji, është në pamundësi për ta zgjidhur këtë çështje në themel të saj, brenda kufijve të saj të gjykimin, duke u fokusuar në një interpretim përfundimtar të mënyrës sesi duhet të aplikohet dhe të zbatohet ligji në këtë rast, si dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e nenit 485, shkronja “a” “b” dhe “ç” të KPC.

Kolegji, vlerëson të bëjë evident faktin se, gjatë fazës së rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e nenit 461, pika 6 dhe nenit 465 pika 3 dhe 4 të KPC, duhet të marrë një vendim të ndërmjetëm për riceljen tërësisht ose pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor, duke identifikuar saktësisht çështjet që ajo do të hetojë në këtë fazë të gjykimin. Marrja e një vendimi të ndërmjetëm, bazuar në nenin 465 të KPC, për Kolegjin, nuk është thjesht një formalitet, por detyrim ligjor për gjykatën, referuar përcaktimeve të nenit 125 të po këtij Kodi, i cili duhet të pasqyrohet në proces verbalin gjyqësor.

Gjithashtu, gjatë fazës së rigjykimin, Gjykata e Apelit [...] duhet të mbajhtë në konsideratë dhe të ruajë kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykatë, të cilat varen nga kufijtë dhe shkaqet e ankimit që kanë investuar gjykatën. Gjykata në këtë fazë të gjykimin, duhet tu bëjë të qartë palëve se është detyrë e secilës prej tyre, që në përputhje me ligjin të provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet për të drejtat që kërkojnë.

Palët ashtu siç kanë të drejta kanë dhe detyrime që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara me ligj. Gjykata duhet të lejojë palët që të paraqesin prova shpresore me anën e të cilave, ato të provojnë pretendimet e tyre bazuar në nenin 12 dhe 19 të KPC dhe t'i lejojë palët që t'ia nënshtrojnë këto prova hetimit e debatit gjyqësor.

Gjithashtu, gjykata duhet të mbajë në vëmendje dhe të zgjidhë çështjen në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 5, 6, 95, 120 të KPC dhe brenda kufijve ligjore që përcaktohen në nenin 467 të KPC, si dhe ti japë zgjidhje përfundimtare asaj në përputhje edhe me praktikën gjyqësore të konsoliduar në shqyrtimin e kësaj natyre mosmarrëveshjeje. Kryerja e veprimeve të përmendura më sipër, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të lindin gjatë rigjyqimit, do të lejojnë gjykatën të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Për sa më sipër, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk i hyn analizës së provave, gjë që duhet ta bëjnë gjykatat e niveleve me të ulëta, por ajo vetëm evidenton shkeljet ligjore që kanë lejuar gjykatat e ulëta, qoftë të normave procedurale apo atyre materiale, duke kërkuar respektimin e tyre. Në rrethanat kur gjykata e apelit i ka të gjitha mundësitë ligjore të marrë në shqyrtim dhe të zgjidhë mosmarrëveshjen objekt gjykimi, Kolegji, vlerëson të prishë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të dërgojë çështjen për rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me një tjetër trup gjykues.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2023-1970 (246), datë 20.04.2023

V. Marrëdhënie Kontraktore

KCGJL Vendimi Nr.00-2023-1888(302), datë 11.05.2023 (Pavlefshmëria e kontratës)

Për shkak të mosrespektimi të të formës së kërkuar nga ligji i prokurimit publik, kontrata e sipërmarrjes lidhur midis palëve me veprime konkludente konstatohet si e pavlefshme. Për përcaktimin e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit që buron nga një kontratë e pavlefshme por që ka krijuar besueshmëri për vlefshmërinë e saj tek pala e dëmtuar, duhet të vërtetohen njëkohësisht këto kushte: i) Dijenia apo mundësia objektive për marrjen dijeni për pavlefshmërinë e kontratës nga pala ndaj të cilës kërkohet shpërblimi i dëmit; ii) Ekzistenca e mirëbesimit të palës së dëmtuar në kryerjen e veprimeve, bazuar në bindjen se burojnë nga një kontratë e vlefshme; iii) Mungesa e fajit të palës së dëmtuar për kryerjen veprimeve në ekzekutim të një kontrate të pavlefshme.

Fjalë kyçe: kontratë sipërmarrje, prokurim publik, formë shpresore, kontratë e pavlefshme, shpërblim dëmi

Rrethanat e çështjes:

Ka rezultuar e provuar se pala paditëse, shoqëria “Taulanti” SHPK, është person juridik privat [...] që ushtron aktivitetin e saj tregtar në fushën e “*Ruajtjes dhe sigurimit të objekteve publike dhe private, sigurimit fizik dhe mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të shtetasve vendas dhe të huaj. Survejimit me kamera sigurie dhe sisteme alarmi*”.

Në zbatim të veprimtarisë së saj tregtare pala paditëse, [...] ka kryer shërbim ruajtje objekti me roje private pranë Drejtorisë së Rajonit Jugor Gjirokastër, sipas ligjit nr. 9643 [...] me kontratën nr. 371 prot. e datës 20.06.2013 me afat deri më 31.12.2013. Pas përfundimit të kontratës midis palëve ndërgjyqëse është lidhur kontrata shtesë [...] datë 30.12.2013 me afat deri më datë 07.02.2014. Çmimi i shërbimit mujor është përcaktuar në vlerën 142 655 lekë [...] lekë.

Sipas palës paditëse drejtori i këtij institucioni [...] i ka kërkuar përfaqësuesit të shoqërisë vazhdimin e shërbimit deri në mbarimin e procedurave të prokurimit sipas ligjit nr. 9643 [...] me arsyetimin se nuk mund të lihej institucioni pa shërbim roje sepse kishte pajisje, makineri me vlera të mëdha monetare.

Shoqëria “Taulanti” SHPK e ka pranuar marrëveshjen duke kryer shërbimin, ruajtjen e objekteve [...] prej datës 07.02.2014 deri më datë 22.05.2014, sipas kushteve të vendosura në kontratën bazë nr. 371 prot., datë 20.06.2013.

Propozimin, marrëveshjen për vazhdimin e kontratës për ruajtjen e objekteve të Drejtorisë së Rajonit Jugor, shoqëria “Taulanti” e ka pranuar pa pasur dijeni më parë se për shërbimin e kryer nuk do të paguheshin. Pala paditëse pretendoi se kjo gjë është lejuar për faktin se pala e paditur është ndodhur në kushte emergjence sepse nuk ka patur mundësi të ndiqte procedurat standarde sipas VKM nr.1 datë 10.01.2007 “[...] Procedurat e prokurimit kanë përfunduar më datë 22.05.2014, datë e cila përkon me lidhjen e kontratës me fituesin e prokurimit shoqërinë “Anakonda” SHPK e cila ka filluar punë më datë 23.05.2014.

Pala e paditur nuk e ka mohuar asnjëherë kryerjen e shërbimit prej tyre, provuar ky fakt edhe me vërtetimin e lëshuar nga pala e paditur dhe deklarimin në seancë gjyqësore. Për shërbimin e kryer pala e paditur duhet të paguante muajin shkurt 2014, prej datës 08.02.2014 deri më 28.02.2014 = 21 ditë shërbim ose 99858.41 lekë me TVSH; muajin mars detyrimi mujor 142654.88 lekë me TVSH; muajin prill detyrimi mujor 142654.88 lekë me TVSH; muaji maj 2014, prej datës 01.05.2014 deri më datë 22.05.2014 = 22 ditë shërbim ose 104613.52 lekë me TVSH. Totali i detyrimit për shërbimin e kryer është në shumën 489781.69 lekë me TVSH.

Për sa më lart pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me kërkesë padinë [...]

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër [...] ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër për gjykimin e çështjes civile [...] dhe dërgimin për kompetencë gjykimi gjykatës kompetente, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, [...] ka vendosur: “Pranimin e padisë. Detyrimin e palës së paditur [...] të paguajë palës paditëse shumën prej 489.781.69

([..] lekë, për shërbimin e kryer për periudhën kohore 07.02.2014-22.05.2014. [..]

Gjykata e Apelit Gjyrokastër [..] ka vendosur ndryshimin e vendimit civil [..] dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se vendimi nr. [..]i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër duhet të priset si i marrë në zbatim jo të drejtë të ligjit material dhe të lihet në fuqi vendimi [..] i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër. [..]

Duke iu rikthyer çështjes objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit nuk ka kuptuar drejt natyrën e konfliktit midis palëve ndërgjyqëse dhe si rrjedhojë nuk ka zbatuar drejt ligjin material.

[..] Në referim të fakteve të sipërcituar rezulton se pavarësisht mënyrës së formulimit të kërimit në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë, nga leximi në tërësi i kërkesëpadisë në funksion të zbulimit të shkakut të padisë, sipas vendimit unifikues nr.3, datë 29.03.20112 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rezulton se paditësi në thelb pretendon pagesën e shërbimit të ruajtjes dhe sigurimit të objekteve, të kryer prej tij në favor të palës së paditur, për periudhën 07.02.2014-23.05.2014, për shkak se ka vepruar me mirëbesim duke patur bindjen, në referim të sjelljes në tërësi të paditurit, para dhe gjatë kësaj periudhe, se ishte duke marrë pjesë në një marrëdhënie të vlefshme detyrimi, në vijimësi të të njëjtës marrëdhënie të mëparshme të formalizuara.

Pikërisht duke vlerësuar se shkak i padisë në rastin konkret lidhet me shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar paditësit nga mosveprimi me faj i palës së paditur, Gjykata e Administrative Shkallës së Parë Gjyrokastër, me vendimin nr.595, datë 07.10.2014, ka shpallur moskompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje duke e dërguar për kompetencë gjykimi gjykatës civile, që në referim të kompetencës tokësore ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër.

Asnjë prej palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të ketë paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm për shpalljen e moskompetencës lëndore. Nga ana tjetër, një identifikim i tillë i natyrës së mosmarrëveshjes, prej të cilit varej dhe përcaktimi i kompetencës lëndore është pranuar nga gjykata pritëse (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër), e cila ka pranuar çështjen dhe ka shqyrtuar padinë, bazuar në të njëjtin shkak padie, duke mos paraqitur parashtuar ndonjë qëndrim për kundërshtimin e kompetencës lëndore në Gjykatën e Lartë.

Duke u nisur nga ratio e nenit 64 të KPC, moskompetenca për shqyrtimin e një çështjeje mund të shpallet vetëm një herë. Ky është interpretimi pajtues i kësaj dispozite me KEDNJ dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendim 00-2018-331, datë 14.02.2018 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj*).Rrjedhimisht, në të tilla kushte, kur është shpallur moskompetenca dhe asnjë nga palët ndërgjyqëse dhe as vetë gjykata pritëse nuk e ka kundërshtuar kompetencën e gjykatës civile, një çështje e tillë nuk mund të vihet më në diskutim.

Kontrata që ka ekzistuar ndërmjet palëve ndërgjyqëse, prej të cilës varet edhe përcaktimi i natyrës së dëmit të pretenduar nga pala paditëse, për periudhën kur kontrata nuk ka qenë e formalizuar me shkrim, është një kontratë sipërmarrje, kuptimi i të cilës jepet nga neni 850 i KC [..]

Në përputhje me veçoritë dalluese të kontratës së sipërmarrjes të evidentuar nga përkufizimi i sipërcituar rezulton se marrëdhënia juridike që ka ekzistuar mes palëve ndërgjyqëse në rastin konkret ka të gjitha elementët e kontratës së sipërmarrjes për kryerjen e shërbimit të ruajtjes fizike, objekteve dhe vlerave monetare. Kontrata e sipërmarrjes është një kontratë e dyanshme dhe me kundërshtëpërblim. Ajo përfshihet në rrethin e kontratave konsensuale, pasi lidhet mbi bazën e vullnetit të palëve kontraktuese dhe karakterizohet si një kontratë risku, e cila është pjesë përbërëse e përgjegjësisë së sipërmarrësit gjatë ekzekutimit të kontratës. Kontrata e sipërmarrjes në fushën e shërbimeve ka një përcaktim jo shterues në varësi të fushës apo sferës së veprimtarisë ekonomike dhe tregtare në të cilën ofrohet, dhe për këtë fakt, zakonisht lidhet duke u bazuar në vetitë apo cilësitë e veçanta të palës sipërmarrëse.

Ashtu si me të drejtë arsyetohet gjykata e shkallës së parë marrëdhënia juridike e sipërmarrjes së shërbimit të ruajtjes, mes palëve ndërgjyqëse ka funksionuar pa ndërprerje, pavarësisht nga fakti se për periudhën e posaçme kontrata kishte kufizime sa i përket mbulimit nga ana financiare. Për këtë periudhë kohore, marrëdhënia juridike që ka ekzistuar mes palëve plotëson të gjitha kushtet e nevojshme të parashikuara nga neni 663 i KC mbi qenien apo ekzistencën e kontratës, përveç formës së kërkuar nga ligji, pasi: i) ekziston vullneti i palës paditëse, i shprehur nëpërmjet kryerjes së veprimeve faktike të ruajtjes dhe sigurimit të objekteve; ii) ekziston pëlqimi i palës së detyruar, i shprehur nëpërmjet veprimeve konkludente të pranimit të këtij shërbimi; iii) ekziston lënda e kontratës që përfaqësohet nga veprimtaria e kryerjes së shërbimit të ruajtjes fizike dhe objekteve; iv) ekziston shkak i ligjshëm, i cili rezulton nga fakti që për shkak të natyrës së veçantë të objektit të kontratës, nuk mund të lihen pa ruajtje objektet e kësaj kategorie. Pavarësisht plotësimit të këtyre kushteve, mungon forma shkresore, e kërkuar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” për lidhjen e kontratave të kësaj natyre. Kjo formë e veprimit juridik në rastin konkret, në ndryshim nga kontrata e sipërmarrjes private e rregulluar posaçërisht nga KC, që nuk kërkon respektimin e ndonjë forme të caktuar, kërkohet për efekt të vlefshmërisë së kontratës.

Për shkak të mosrespektimit të të formës së kërkuar nga ligji, kontrata e lidhur midis palëve me veprime konkludente për periudhën në vijimësi, duhet të konstatohet si e pavlefshme dhe të vetmit elementët që paraqesin rëndësi dhe që duhen trajtuar në funksion të kërkimit të paditësit për t’u shpërblyer për shërbimin faktik të ruajtjes së objekteve në administrim të palës së paditur, janë faji dhe mirëbesimi apo keqbesimi i palëve kontraktore. Në mënyrë specifike, në lidhje me kuptimin e këtyre elementëve në funksion të sjelljes dhe përgjegjësisë që buron nga një sjellje e tillë në një marrëdhnie kontraktore që ka krijuar besueshmëri për vlefshmërinë e saj, në neni 674 të KC [..]

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se për përcaktimin e përgjegjësisë për shpërblyerjen e dëmit që buron nga një kontratë e pavlefshme por që ka krijuar besueshmëri

për vlefshmërinë e saj tek pala e dëmtuar, duhet të vërtetohen njëkohësisht këto kushte: i) Dijenia apo mundësia objektive për marrjen dijeni për pavlefshmërinë e kontratës nga pala ndaj të cilës kërkohet shpërblimi i dëmit; ii) Ekzistenca e mirëbesimit të palës së dëmtuar në kryerjen e veprimeve, bazuar në bindjen se burojnë nga një kontratë e vlefshme; iii) Mungesa e fajit të palës së dëmtuar për kryerjen veprimeve në ekzekutim të një kontrate të pavlefshme.

Në rastin konkret janë plotësuar të gjitha këto kushtet për lindjen përgjegjësisë së palës së paditur, pasi: i) Vërtetohet nga shkresat e hartuara nga vetë pala e paditur dijenia e kësaj pale për ndalimin ligjor të vazhdimësisë, pa një kontratë të lidhur në formë shkresore, të kontratës së sipërmarrjes që ka ekzistuar ndërmjet palëve; ii) Në kushtet e një marrëdhënieje kontraktore të pandërprerë si dhe në përputhje me natyrën specifike të shërbimit të ofruar në drejtim të ruajtjes së objekteve të palës së paditur, pala paditëse rezulton të ketë vepruar në mirëbesim në kryerjen e këtij shërbimi; iii) Nuk ekziston faji i palës paditëse, për sa kohë që kjo e fundit ka qenë duke kryer veprime në vijim të një marrëdhënieje të mëparshme kontraktuale dhe duke u bazuar në garancinë e dhënë nga pala e paditur për vazhdimësinë e kryerjes dhe pranimit të të njëjtit shërbim, përkundrejt pagesës të njëjtit çmim.

Për shkak të veprimeve me faj dhe me keqbesim të plaës së paditur në rastin konkret, kjo e fundit, në interpretim të drejtë të neneve 674 dhe 850 të KC, është e detyruar të shpërblejë palën paditëse që është dëmtuar nga këto veprime, dhe ky shpërblim, në kushtet e pëmbushjes së detyrimit nga pala paditëse që ka vepruar në mirëbesim, ka të bëjë pikërisht me vlerën e detyrimeve të papërbushuara të palës së paditur, sipas të njëjtës marrëdhënie detyrimi që ka funksionuar në vijimësi me të njëjtat kushte.

Për rrjedhojë vlerësohet prej këtij Kolegji se përfundimi i arritur nga gjykatat e apelit se paditësit nuk i takon shpërblimi për shërbimin e kryer sepse nuk ka kontratë është i gabuar, pasi shërbimi i ruajtjes dhe sigurimit të objekteve dhe makinerive, është një punë e kryer me miratimin e anës së paditur dhe në mirëbesim dhe që për më tepër lidhet me objekte të rëndësisë së veçantë, arsye për të cilën palës paditëse nuk mund t'i mohohet pagesa e çmimit të një shërbimi të tillë, që në rastin konkret përfaqëson edhe dëmin faktik që kjo palë ka pësuar.

Në analizë si më sipër Kolegji vlerëson se vendimi [...] i Gjykatës së Apelit Gjirokastër duhet të priset dhe të lihet në fuqi vendimi [...] i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: KCGJL Nr.00-2022-677(117), datë 06.04.2022

KCGJL Vendim Nr.00-2023-2583(312), datë 16.05.2023 (Dallimi: kusht penal vlerësues-kusht penal gjabor)

Në rastin e kushtit penal gjabor, ky kusht përbën një të detyrim që i ngarkohet debitorit jo me qëllim për të zëvendësuar pagimin e detyrimit kryesor të tij, por i shtohet detyrimit kryesor duke i dhënë mundësi kreditorit që të kërkojë ndaj debitorit si pagimin e detyrimit kryesor dhe atë të kushtit penal. Këtë karakteristik e ka vetëm

kushti penal gjabor dhe jo ai vlerësues në rast te të cilit kreditori mund të kërkojë nga debitori në alternativë ose vetëm detyrimin ose vetëm kushtin penal vlerësues. Në rast se kreditori është në vonesë për të përmbushur detyrimin e tij për lëshimin e faturës tatimore ndaj palës debitore, atëherë në zbatim të nenit 491 e 492 të KC debitori nuk mund të paguajë kushtin penal gjabor ndaj palës kreditore

Fjalë kyçe: kontratë qiraje, kusht penal vlerësues, kusht penal gjabor, parashkrim

Rrethanat e çështjes:

Ndërmjet Bashkisë Korçë, si qiradhënëse dhe palës së paditur Shoqërisë “Plus Communication” ShA është lidhur kontrata e qirasë nr. [...] datë 01.07.2010. Objekt i kontratës së qirasë është një sipërfaqe prej 400 m2 truall, ndërsa qëllimi është ndërtimi i një stacioni, pra instalimi i një bazë transmetimi, nisur nga objekti i veprimtarisë së palës qiramarrëse.

Vlera e qirasë është përcaktuar në nenin 4 të saj 484.800 lekë në vit. Ndërsa mënyra e pagesës së vlerës së qirasë është përcaktuar në nenin 6, dhe ne piken 6.1, citohet se : *“Pagesa do të bëhet në dy pjesë, në çdo 6 muaj në vit në shumën 242.400 lekë secila. Pagesa e parë do të bëhet brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës nga palët.62. Pagesa në vijim do të bëhet brenda 30 ditëve që nga dita e fundit e përfundimit të 6 mujorit të fundit.6.3)Në rast se pagesa kryhet në tejkallim të afatit të përmendur në këtë nen qiramarrësi detyrohet të paguajë një kamatëvonesë prej 1% të vlerës së papaguar për çdo ditë vonesë.6.4.....6.5. Për çdo pagesë qiramarrësi do të lëshojë në adresë të qiradhënësit paraprkisht faturën për arkëtim sipas modelit të miratuar në udhëzimin nr. 19 datë 20.05.2010 nga Ministria e Financave.6.6.....6.7. Qiraja do të paguhet pas lëshimit të faturës së lartpërmendur në llogarinë bankare të qiradhënësit.*

Pala paditëse qiradhënëse, [...]ka lëshuar faturën për arkëtim nr.17 datë 22.02.2012, duke u kërkuar bankave të nivelit të dytë të pranojnë arkëtime nga subjekti [...].Në kolonën “përshkrimi i të ardhurave” është përshkruar: *Qira trualli për periudhat 01.07.2010-31.12.2010; 01.01.2011-30.06.2011; 01.07.2011- 31.12.2011; 01.01.2012 - 30.06.2012; 01.07.2012 - 31.12.2012.* Me lëshimin e kësaj fature, pala e paditur qiradhënëse ka kryer pagesat e qirasë, për periudhën 01.07.2010 - 30.06.2012 në llogarinë bankare të Bashkisë [...] Veprimtaria e punës së Bashkisë [...] i është nënshkruar auditimit nga KLSH dhe me shkresën nr. 4371/51 prot, datë 31.07.2013, i kërkohej Bashkisë të zbatojë rekomandimet e lëna [...]. [...]Referuar faktit që pagesa e vlerës së qirasë nuk rezultoi të jetë bërë brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit 6 mujor, në referim të nenit 6 të kontratës është llogaritur 1% të vlerës së papaguar për çdo ditë vonesë, referuar kushtit të kontratës, neni 6.3, duke rezultuar shifra prej 3.030.000 lekë, për të cilat sipas auditimit duhet të aplikoheshin penaltitetet për qiramarrësin.

Bazuar në këtë konkluzion të KLSH pala paditëse [...] ka paraqitur për gjykim padinë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë [...] Gjykata e Apelit Korçë [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Korçë, [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë, është i bazuar në ligj dhe duhet të lihet në fuqi, por me tjetër arsyetim. Kolegji vlerëson se konkluzioni i gjykatave të faktit dhe disponimi i tyre mbi kërkimet e palës paditëse janë të drejta, por argumentet e dhëna prej tyre, të cilat mbështesin dispozitivin e vendimit, janë rrjedhojë pjesërisht e zbatimit të gabuar të ligjit material lidhur me kuptimin e kushtit penal.

[..]

Kolegji çmon se Gjykata e Apelit, ndonëse rrethanat e faktit i ka pranuar të provuara, sikurse edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e konsideron kushtin penal të parashikuar në kontratë, si kusht penal vlerësues dhe sipas saj, në aplikim të nenit 115/a të KC, padia është paraqitur tej afatit 6 mujor të parashkrimit. Qëndrimet e mbajtura nga Gjykatat [..] janë rezultat i interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit në çështjen objekt gjykimi, përse i përket instituteve të kushtit penal, parashkrimit dhe parimeve themelore të së drejtës civile në lidhje me këto institute; atyre që lidhen me vetë thelbin e kuptimin e kushtit penal, dallimeve të tij në atë gjoror e vlerësues, afateve të parashkrimit e ndërprerjes për secilin prej tyre.

Parimet themelore të kushtit penal, parashikohen në nenet 541-545 të KC (Titulli III, Kreu II), si një nga mjetet e sigurimit për të garantuar ekzekutimin/përmbushjen e detyrimeve. Në vështrim të përmbajtjes së këtyre dispozitave, si dhe të neneve 115/a, 131 e 134 të KC, ky Kolegj thekson se lidhur me kushtin penal nga përmbajtja e neneve 542 e vijues të KC parë në harmoni dhe me shkronjën a) të nenit 115 të KC, rezultojnë se ai dallohet në kushtin penal gjoror dhe atë vlerësues/çmues. Në rastet kur kushti penal gjoror parashikohet për të riparuar pozitën pasurore të kreditorit dhe/ose nxitjen e debitorit për të përmbushur në rregull detyrimin, ai ka funksionin e një marrëveshje ndëshkimore-gjorbë (*stipulatio poenae*) dhe në këtë rast, debitori, krahas ekzekutimit të detyrimit, duhet të paguajë kushtin penal, si dhe dëmet e shkaktuara kreditorit, duke u kërkuar këto në mënyrë kumulative (Neni 543/II KC). (b) Ndërsa kushti penal, që fiksohet në kontratë, i përcaktuar sipas llogaritjeve paraprake të dëmit të mundshëm, që mund të vijë nga mospërmbushja e detyrimit, për aq sa mund të parashikohet (që me lidhjen e kontratës) masa e dëmit të mundshëm, quhet kusht penal vlerësues. Kreditori, në këtë rast, ka të drejtë të kërkojë, në mënyrë alternative, ose përmbushjen e detyrimit ose kushtin penal (përfshirë pjesën e dëmit që kalon kushtin penal) dhe jo të dyja së bashku (Neni 543/I dhe neni 542 i KC). I pari, kushti penal gjoror, nuk i nënshtrohet afatit të parashkrimit 6 mujor, ndërsa i dyti po.

Duke iu kthyer rastit objekt shqyrtimi, konstatohet se gjykatat e faktit nuk kanë identifikuar drejtë llojin e kushtit penal, të parashikuar në kontratën e lidhur midis palëve e cila ka focën e ligjit për to. Kështu në nenin 6.3 të kontratës së lidhur mes palëve ndërgjyqëse është parashikuar se "Në rast se pagesa kryhet në tejkalim të afatit të përmendur në këtë nen qiramarrësi detyrohet të paguajë një kamatëvonesë prej 1% të vlerës së papaguar për çdo ditë vonesë". Mjafton të analizohet përmbajtja e kësaj

klauzole kontraktore për të kuptuar se palët kanë parashikuar në kontratë një kusht penal gjorbër për të nxitur përmbushjen e detyrimit pasi pagesa e tij bëhet në rast se përmbushja e detyrimit për pagesën e qirasë bëhet në tejkalim të afatit. Pra, ky kusht përmbën një të detyrim që i ngarkohet debitorit jo me qëllim për të zëvendësuar pagimin e detyrimit kryesor të tij pra të qirasë, por i shtohet detyrimit kryesor duke i dhënë mundësi kreditorit që të kërkojë ndaj debitorit si pagimin e detyrimit kryesor dhe atë të kushtit penal. Këtë karakteristik e ka vetëm kushti penal gjorbër dhe jo ai vlerësues në rast të të cilit kreditori mund të kërkojë nga debitorit në alternativë ose vetëm detyrimin ose vetëm kushtin penal vlerësues.

Për sa mësipër del se synimi i palëve në momentin e lidhjes së kontratës ka qenë pikërisht, parashikimi i një klauzole kontraktore (kushti penal gjorbër), i cili do të disiplinonte palët për të përmbushur detyrimet e tyre kontraktore. Qëllimi ka qenë pikërisht nxitja e palëve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Për rrjedhojë ky kusht penal i parashikuar në kontratë nuk i nënshtrohet afatit të parashkrimit të nenit 115/a të KC, institut që vepron për kushin penal vlerësues. Afati i parashkrimit për kushtin penal gjorbër përderisa nuk është i përcaktuar rregullisht në ligj është ai 10 vjeçar sipas nenit 114 të KPC.

Nga ana tjetër Kolegjivlerson të drejtë konkluzionin e Gjykatave [...] në lidhje me faktin se mospërmbushja e detyrimit nga pala e paditur Shoqëria [...], në mënyrën e duhur, në formën e përmbushjes me vonesë, ka ardhur jo për fajin e palës së paditur, debitore në këtë rast, por për fajin e vetë palës paditëse, kreditore. Sipas kontratës së nënshkruar midis palëve është parashikuar se për çdo pagesë qiramarrësi duhet të lëshojë në adresë të qiradhënësit paraparakisht faturën për arkëtim, sipas modelit të miratuar në Udhëzimin nr. 19 datë 20.05.2010 nga Ministria e Financave. Ky parashikim për palën qiradhënëse, që rezulton të jetë një person juridik, sikurse dhe pala qiramarrëse është në përputhje dhe me legjislacionin fiskal.

Në referim të nenit 36 të ligjit nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” dhe të nenit 11.1 të Udhëzimit nr. 17 datë 13.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, [...] Në zbatim të këtij legjislacioni dhe subjekti tatimpagues, pra pala e paditur [...], që do të shlyejë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e qirasë, nuk mund të shlyejë një detyrim, nëse për shërbimin e marrë nuk është lëshuar një faturë tatimore nga subjekti që e përfiton pagesën, në rastin konkret, pala kreditore Bashkia.

Sikurse pranojnë të dyja gjykatat e faktit paditësi nuk ka lëshuar në kohë faturën për arkëtim të qirasë, e cila përmbën kusht të caktuar në kontratë për kryerjen e pagesës nga pala e paditur. Duke qënë se kreditori ka qënë në vonesë për të përmbushur detyrimin e tij për lëshimin e faturës tatimore ndaj palës debitore, atëherë në zbatim të nenit 491 e 492 të KC debitorit nuk mund të paguajë kushtin penal gjorbër ndaj palës kreditore. Prandaj me të drejtë nga gjykatat e faktit është rrëzuar padia si e pabazuar.

Sa më lart u arsyetua, vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë duhet të lihet në fuqi, sipas arsyetimit të ndryshuar nga ky Kolegj.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGJL Nr.00-

2021-2049 (260), datë 02.12.2021

KCGJL Vendim Njësues nr.00-2023-4411(106), datë 02.03.2023 (Kontrata e dorëzarisë)

Njësimi për çështjen e parë. Për aktet që përmbajnë detyrime në të holla dhe që sipas nenit 510 të KPC janë tituj ekzekutivë, kërkesa e kreditorit për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit është e barazvlefshme, përsa i përket efekteve juridike që sjell, me padinë e ngritur sipas nenit 600 të KC. Ndërkohë për efekt të vënies në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit, kërkesa drejtuar përmbaruesit gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në nenin 113 të KC, pra kjo kërkesë i nënshtrohet një tjetër afati të përcaktuar në nenin 600 të KC.

Njësimi për çështjen e dytë. Referuar përcaktimeve të neneve 597, 598, 599 dhe 600 të KC dorëzani legjitimohet të kërkojë shuarjen e dorëzarisë me padi të tij, apo ta prapësojë atë në një proces gjyqësor ku është thirrur si i paditur me kërkimin e paditësit për përmbushjen e këtij detyrimi. Për aktet që janë tituj ekzekutivë mjeti procedural me të cilin dorëzani mund të kërkojë shuarjen e dorëzarisë është padia për “Pavlefshmërinë e këtij titulli”, përsa i takon detyrimit të dorëzansit, sipas nenit 609 të KPC.

Njësimi për çështjen e tretë. Afati 6 (gjashhtë) mujor i përcaktuar në nenin 600 të KC është një afat që lidhet me shuarjen e të drejtës për të përdorur mjetin procedural, padinë, për realizimin e të drejtës, dhe jo me humbjen e vetë të drejtës subjektive. Si i tillë ky është afat parashkrimi dhe jo prekluziv.

Njësimi për çështjen e katërt. Kontrata e dorëzarisë fillon të japi efektet e parashikuara në ligj që në momentin e lidhjes së saj dhe cilësia e debitorit dhe dorëzansit barazohet në momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm. Në këtë moment, si rregull, kreditori mund t'i drejtohet si debitorit ashtu edhe dorëzansit. Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të KC, cilësia e dorëzansit me atë të debitorit barazohen vetëm për pjesën e detyrimit, radhën e ekzekutimit dhe ndarjen e detyrimit mes disa dorëzansave, si palët mund të kenë përcaktuar në kontratën e dorëzarisë.

Fjalë kyçe: kontratë dorëzanie, shuarje dorëzanie, detyrim solidar

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit [...] rezulton se pala e paditur, shoqëria Banka Credins sh.a. është [...] person juridik, [...] me objekt të saj, veprimtarinë bankare.

Personi i tretë në këtë gjykim, Shoqëria “Italdruri Elbasan” sh.p.k. është [...] person juridik, [...] me objekt të veprimtarisë, ndër të tjera, prodhim dhe tregtim të lëndës drusore, mobilim etj, ndërkohë që paditësi N.H., është njëri prej ortakëve të shoqërisë “Italdruri” sh.p.k. Midis palës së paditur [...], në cilësinë e kredidhënësit dhe të personit të tretë shoqëria [...] në cilësinë e kredimarrësit është lidhur kontrata “Marrëveshje linjë kredie nr. 256, datë 03.07.2009”, e noterizuar me [...] datë 17.07.2009. Me këtë kontratë personi i tretë ka marrë kredi shumë prej 25.000.000 lekë me qëllimin e financimit të aktivitetit të tij. Kontrata është lidhur për një afat 6 mujor, i cili nis të llogaritet nga dita e

autorizimit në llogari (neni 3.2 i kontratës). Paditësi N.H., në cilësinë edhe të njërit prej ortakëve të [...] në kohën e nënshkrimit të kontratës së kredisë, është përfshirë në këtë kontratë kredie në cilësinë e dorëzansit për të garantuar përmbushjen e detyrimit nga huamarrësi. Duke qënë se detyrimi sipas kontratës nuk është përmbushur nga debitori, person i tretë në këtë gjykim [...] pala e paditur [...] si kreditore ka kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për kontratën e kredisë si titull ekzekutiv.

Me vendimin nr.1016, datë 11.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar urdhëri i ekzekutimit për këtë titull ekzekutiv dhe me kërkesë të kreditorit, [...] ka filluar procedurat për ekzekutimin e këtij titulli. Si debitori dhe dorëzansi kanë marrë dijeni për fillimin e këtyre procedurave dhe lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, por nga asnjëri prej tyre nuk është përmbushur detyrimi vullnetarisht. Në këto rrethana nga ana e Zyrës së Përmarrimit ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm duke vendosur sekuestron mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe të dorëzansit. Paditësi në vijim i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi, [...] duke pretenduar se, dorëzania e tij është shuar, në mbështetje të nenit 600 të KC. [...] duke qënë që afati i ekzekutimit të detyrimit ka qënë data 17.01.2010, me kalimin e afatit 6 mujor nga kjo datë [...]

Rezulton se kreditori, [...] është drejtuar gjykatës në muajin mars 2011 me kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit. Lidhur me këtë pretendim të paditësit, pala e paditur në prapsimet e saj ka pretenduar se jemi përpara ndërprerjes së parashkrimit për faktin se si debitori edhe dorëzansi, pas kalimit të afatit për ekzekutimin e detyrimit, e kanë pranuar këtë detyrim, duke kryer edhe pagesa pjesore të detyrimit. Kjo në mbështetje të nenit 131 të KC gërma "a", sipas të cilit parashkrimi i dorëzansit është ndërprerë. Pas përfundimit të afatit të shlyerjes së detyrimit, kreditori, pala e paditur në këtë proces, ka njoftuar si debitorin dhe dorëzansin për shlyerjen e detyrimit. Nga ana e këtyre të fundit ka filluar likuidimi i detyrimit në këste, shlyerje të cilat kanë vazhduar deri në dhjetor 2010. Sipas nenit 134 të KC, koha e kaluar para se të vërtetohej shkaku ndërprerës nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së këtij shkaku fillon një afat i ri parashkrimi. Meqenëse pagesat nuk kanë vazhduar gjatë vitit 2011, pala kreditore në Mars 2011 i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe ka vazhduar ekzekutimi i detyrueshëm nga përmbartuesi gjyqësor.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit [...] Mbi ankimin e paditësit, Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë". [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me datë 01.06.2016, ka vendosur kalimin për shqyrtimin e çështjes konkrete në Kolegje të Bashkuara, për unifikimin e praktikës gjyqësore mbi interpretimin e dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë institutin e dorëzansit, të cilat do të parashtrihen në mënyrë më të detajuar në vijim.

Pavarësisht se u mblodhën për të vendosur mbi çështjet e shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, ato nuk arritën të marrin një vendim, për shkak të mosplotësimin

të kuorumit ligjor të gjyqtarëve.

Në këto kushte, çështja u rimor në shqyrtim nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegjet), pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016. [...] Në bazë të këtij konteksti të ri juridik, Kolegjet kanë vlerësuar se kjo çështje duhet të shqyrtohet nga Kolegji Civil në seancë gjyqësore me trup të përbërë nga 5 gjyqtarë.

Në vijim, Kolegji, [...] konstatoi se në vazhdimësi gjykatat shqiptare në të gjitha shkallët e gjykimit, kanë interpretuar dhe zbatuar në mënyra të ndryshme normat materiale mbi dorëzaninë. Kjo ka sjellë edhe disponime të kundërta përsa i përket formës së veprimit procedural me të cilin kreditori investon gjykatën për kërkimin e ekzekutimit të detyrimit, legjitimitimit të dorëzanësit për të kërkuar shuarjen e dorëzanisë, natyrës dhe llojit të afatit që parashikon ligji, neni 600 i KC për ngritjen e padisë, si qëndrojnë në raporte mes tyre dhe me kreditorin, dorëzanësi dhe debitori etj.

Kolegji vlerëson se paqartësia e parë ka ardhur mbi çështjen e regjimit juridik të përgjegjësisë civile të dorëzanësit, nëse mundet apo jo kreditori, që pa provuar se ka gjuarmuar dhe ka kryer të gjitha veprimet e mundshme ligjore për përmbushjen e kredisë me pasurinë e debitorit kryesor, t'i drejtohet dorëzanësit sakaq për të aktivizuar mjetin e tij të garancisë mbi kredinë. Në disa praktika gjyqësore praktikën gjyqësore është mbajtur qëndrimi se kreditori mundet t'i drejtohet palës dorëzënëse vetëm atëherë kur ka kryer të gjitha veprimet e mundshme për përmbushjen e kredisë nga pasuria e debitorit kryesor, por ka qenë e pamundur një gjë e tillë.

Në disa praktika të tjera gjyqësore, në interpretim të nenit 590 të KC, është mbajtur qëndrimi se në momentin që vërtetohet rënia në morë e debitorit kryesor, atëherë kreditori mundet të zgjedhë cilindo nga të detyruarit e tij për t'i kërkuar përmbushjen e detyrimit, qoftë debitorit kryesor dhe qoftë dorëzanësit. Në këto raste është konkluduar se nga momenti i rënies në morë të debitorit kryesor, ai dhe dorëzanësi janë debitor solidar të kreditorit.

Po ashtu, në praktikën gjyqësore ka pasur çështje në të cilat është pretenduar dhe është pranuar nga gjykatat se aktivizimi i përgjegjësisë pasurore të dorëzanësit kundrejt kreditorit mundet të bëhet vetëm pas ngritjes së padisë nga ky i fundit, si në rastet kur detyrimi kryesor nuk është titull ekzekutiv dhe në rastet kur detyrimi kryesor është titull ekzekutiv. Kjo praktikë gjyqësore është mbështetur në interpretimin literal të nenit 600 të KC. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke interpretuar se marrëdhënia e dorëzanisë është një marrëdhënie e mëvetësishme nga kontrata e kredisë bankare dhe se nuk ndjek regjimin juridik të saj si titull ekzekutiv, por se për vënien në ekzekutim të dorëzanisë kreditori duhet të ngrejë padi në gjykatë kundër dorëzanësit.

Nga ana tjetër ka pasur edhe qëndrime apo pretendime të palëve në gjykime se neni 600 i KC duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar, që do të thotë se kur detyrimi kryesor është titull ekzekutiv, atëherë kreditori për t'iu drejtuar dorëzanësit do të duhet ta bëjë njëlloj sikurse për aktivizimin e përgjegjësisë pasurore të debitorit kryesor, që do të thotë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në gjykatë dhe më tej me kërkesë për ekzekutimin e detyrueshëm në shërbimin përmbarimor. Ky qëndrim vijon

se, kur përgjegjësia e debitorit kryesor është e aktivizueshme civilisht vetëm pas një gjykimi kontencioz dhe sakaq vetëm me ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, atëherë i njëjti regjim juridik do të vlejë edhe për aktivizimin e përgjegjësive pasurore të dorëzanësit kundrejt kreditorit.

Gjithashtu, në praktikën gjyqësore ka pasur mosmarrëveshje në të cilat është vënë në diskutim fakti nëse afati gjashtë mujor apo një vjeçar, që parashikon neni 600 i KC, është afat parashkrimi apo është afat prekluziv.

Kështu, rezulton se në një rast Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i ka konsideruar afatet që përmend neni 600 i KC si afate parashkrimi (*shih vendimin nr. 00-2013-980 (223), datë 28.03.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Në një vendim tjetër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, e ka konsideruar marrëdhënien e dorëzansisë si të mëvetshme, dhe afatin 6 mujor të parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 600 të KC si një afati prekluziv, mosrespektimi i të cilit ka si pasojë shuarjen e së drejtës së kreditorit për të realizuar të drejtën e tij nëpërmjet pasurisë së dorëzanësit (*shih vendimin nr. 00-2015-3661 (455), datë 28.10.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Ndërkohë, qasja e ndryshme e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është më e theksuar në praktikën e gjykatave më të ulta, të cilat kanë mbajtur qendrime të ndryshme nëse afatet e përcaktuara në nenin 600 të KC, janë afate parashkrimi apo afate prekluzive.

Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtuësme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike.

[..] Në vijim të kësaj analize, në çështjet ligjore të shtruar për diskutim, Kolegji, në ushtrim të të drejtës dhe detyrimit kushtetues dhe ligjor, që lidhet me funksionin nomofilatik;

- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit [...], që vijnë për shkak se mund të ketë disa interpretime lidhur me dorëzaninë e konkretisht me parashkrimet e nenit 600 të KC;
- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njëjtë dhe e unifikuar në interpretimin e ligjit material;
- në zbatim të nenit 35/3, 472/a, 481 dhe 482/a të KPC, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021,

ka konkluduar se duhet të vijojë me gjykimin njësoj duke vlerësuar të drejta edhe çështjet e ngritura nga Kolegji i mëparshëm, në funksion të njësimi të praktikës gjyqësore, ka vlerësuar të ngrerë për njësim të praktikës gjyqësore, çështjet si më poshtë vijon:

- 1. A barazohet kërkesa për lëshim urdhëri ekzekutimi me padinë referuar nenit 600 të KC?**
- 2. Referuar neneve 597, 598, 599 dhe 600 të KC, a legjitimohet dorëzanësi të kërkojë shuarje dorëzanie?**
- 3. Afati 6 mujor është afat prekluziv apo afat parashkrimi (neni 600 KC)?**
- 4. Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të KC, a barazohet cilësia e dorëzanësit me atë të debitorit? Nëso po, gjatë cilës fazë mund të**

barazohen këto dy cilësi?

Mbi institutin e dorëzarisë, aspekti ligjor dhe kushtetues.

Dorëzania në ligj (shih nenin 585 të KC), përkufizohet si një veprim juridik i dyanshëm, me të cilën një person (dorëzanësi), detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë (debitori kryesor). Pra, përmes dorëzarisë, një subjekt i tretë në marrëdhënien kreditor-debitor, dorëzanësi, garanton përmbushjen e detyrimit nga ky i fundit, (debitori), si dhe merr përsipër ta përmbushë atë, (detyrimin) vetë në eventualitetin e “dështimit” nga debitori. Si një marrëdhënie juridike detyrimi, mundet të ketë si burim krijimi ligjin, marrëveshjen ndërmjet palëve apo një vendim gjyqësor.

Në një kuptim të përgjithshëm, dorëzania përbën një marrëdhënie juridike detyrimi. Regjimi juridik i detyrimeve përcaktohet në mënyrë të detajuar në KC dhe në ligje të tjera, por parësisht ato janë shprehje e lirisë së veprimtarisë ekonomike, si një nga liritë themelore kushtetuese.

Në nenin 11 § 1 të saj, Kushtetuta [...] Më tej, neni 41 i Kushtetutës, [...] Referuar këtyre parashikimeve kushtetuese dhe jurisprudencës përkatëse, Kolegji çmon se mundësia e subjekteve të njohur nga e drejta, për të hyrë në marrëdhënie juridike të ndryshme që kanë si qëllim lidhjen e kontratave për qarkullimin e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit gëzon mbrojtje kushtetuese. Në këtë kuptim, interpretimi i dispozitave të legjisllacionit civil që rregullojnë marrëdhëniet juridike të detyrimit, dhe në veçanti marrëdhënien juridike të dorëzarisë, duhet të qaset drejt asaj mënyre që i garanton këto liri. [...]

Nga një vështrim të dispozitave të KC, edhe në planin historik dhe krahasimor, mund të deduktohet se, dorëzania, si një veprim juridik dhe shfaqje vullneti, është një kontratë e dyanshme e lidhur ndërmjet dorëzanësit dhe kreditorit, ndërsa debitori, si rregull, mbetet i palidhur me këtë marrëdhënie. Nuk kërkohet për perfeksionimin dhe konstituimin e marrëdhënies juridike të dorëzarisë vullneti i palës debitore kryesore. Qëllimi i dorëzarisë nuk është garantimi i debitorit, por garantimi i kreditorit.

Ajo kategorizohet në mjetet e garancisë personale dhe subjektive, pasi dorëzanësi garanton përmbushjen e detyrimit të debitorit kryesor me të gjithë pasurinë e tij të tashme dhe të ardhshme, nëse në kontratën e dorëzarisë nuk parashikohet ndryshe. Subjekti dorëzanës garanton kreditorin për cilësitë personale të debitorit, për besueshmërinë dhe mundësinë e tij në përmbushjen e detyrimit. Gjithashtu dorëzanësi merr përsipër riskun duke garantuar ekzekutimin e detyrimit me pasurinë e tij, pa dhënë si garanci një pasuri të caktuar. Kjo karakteristikë e dallon dorëzaninë nga mjetet reale të garancisë, si për shembull pengu apo hipoteka, të cilat krijohen janë të lidhura pazgjidhshmërisht me sendin dhe pasurinë respektive që individualizojnë palët në kontratë. Si mjet garancie personale, dorëzania nuk lidhet me një pasuri konkrete, por lidhet me pasurinë në tërësi të dorëzanësit. Dorëzania ka gjithmonë karakterin e një marrëdhënie juridike aksesore në raport me marrëdhënien juridike parësore që ekziston ndërmjet kreditorit dhe debitorit. Ajo qëndron vetëm për një detyrim efektiv dhe mund të jepet për një detyrim të ardhshëm dhe/ose një detyrim me kusht. Si e tillë ajo është e lidhur funksionalisht dhe integralisht me veprimin juridik kryesor (*aksesorum sequitur principales*).

Kjo lidhje do të ndikojë gjithmonë në mënyrën se si lind, si zhvillohet dhe se si shuhet ajo. Një karakteristikë e tillë, e dallon marrëdhënien juridike të dorëzarisë me detyrimin solidar në përgjithësi.

Dorëzania ka në vetvete një qëllim ekonomik, por njëherazi edhe njerëzor sepse dorëzanësi, bëhet mbështetës i debitorit dhe rrit besueshmërinë e tij në sytë e kreditorit. Në këtë marrëdhënie, interesat e palëve qëndrojnë në këto raporte: kreditori ka interes të ketë një mundësi shtesë/plus nga një subjekt i tretë që debitori do ta përmbushë detyrimin në formën, mënyrën dhe kohën e caktuar në kontratë; debitori ka interes të ketë përkrahje të shtuar dhe një person të besuar, me qëllim që kreditorit ti mundësojë vlerën e kërkuar; dorëzanësi nisat nga një interes me natyrë sociale dhe njerëzore duke përkrahur dhe mbështetur edhe juridikisht debitorin.

Dorëzania është një marrëdhënie juridike subsidiare dhe e kushtëzuar, që do të thotë se aktivizohet atëherë kur debitori kryesor nuk përmbush detyrimin. Kjo do të thotë se momenti i vërtetimit të kushtit, vonesa apo mora e debitorit në përmbushjen e detyrimit, aktivizon përgjegjësinë civile të dorëzansit garant ndaj kreditorit. Kjo karakteristikë e dorëzarisë është shenjë tjetër dalluese e saj me detyrimin solidar.

Kontrata e dorëzarisë mund të gjendet në praktikë në formën e një kontrate bankare, ose kontratë nga një institucion financiar jobankar.

Në paragrafin e parë, shkronja d) të nenit 510 të KPC [...] Parimisht të gjitha aktet e kësaj kategorie janë tituj ekzekutivë dhe për to lëshohet urdhëri i ekzekutimit sipas përcaktimeve të nenit 511 të po këtij kodi. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji çmon se dorëzania do të konsiderohet titull ekzekutiv vetëm në ato raste kur përmbushen kërkesat ligjore që parashikon neni 510 i KPC, në mënyrë të veçantë paragrafi i parë, shkronja d) e kësaj dispozite, e lidhur me aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare. Për pasojë, në këto raste kemi një ndërthurje midis dy llojeve të gjykimeve, gjykimit për kontestimin e kontratës së dorëzarisë si titull ekzekutiv dhe gjykimit për kontestimin e saj si veprim juridik i dyanshëm.

Çështjet e shtruara për njëhsim

1. A barazohet kërkesa për lëshim urdhëri ekzekutimi me padinë referuar nenit 600 të Kodit Civil ?

Nisur nga fakti se si në çështjen objekt shqyrtimi dhe gjerësisht në praktikën gjyqësore, kontratat e dorëzarisë gjendet edhe në formën e një kontrate bankare, ose kontratë nga një institucion financiar jobankar, akte të cilat referuar parashikimit të nenit 510 i KPC janë tituj ekzekutiv, Kolegji ka shtruar si pyetje nëse kërkesa që bën kreditori në këto raste për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, mund të konsiderohet e barazvlefshme me padinë që kreditori duhet të ushtrojë në respektim të nenit 600 të KC. Në nenin 600 të KC [...] Kjo dispozitë, sipas njërit variant interpretimi, nuk ndjek të njëjtën logjikë juridike për përmbushjen e detyrimeve për të cilat ligji heq fazën njohëse të së drejtës, apo fazën gjyqësore të formësimit të titullit ekzekutiv. Kjo do të thotë se edhe për detyrimet kryesore, të cilat sipas ligjit janë tituj ekzekutiv, dorëzania

do të duhet të ekzekutohet vetëm nëpërmjet ngritjes së padisë, marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor dhe më tej ekzekutimit të detyrueshëm të këtij vendimi.

Në variantin më të mirë të interpretimit, dispozita ometon në lidhje me ekzekutimin e dorëzansë që është lidhur për të garantuar përmbushjen e një detyrimi kryesor, i cili sipas ligjit është titull ekzekutiv. Para këtij ometimit legjislativ, gjykata, në bazë dhe për zbatim të nenit 1 paragrafi i dytë i KPC, do të duhet të krijojë me analogji një dispozitë ligjore dhe rregull normativ të zbatueshëm për këto raste. Nga një vlerësim *apriori* nuk mund të thuhet se kreditori nuk ka afat ligjor brenda të cilit duhet të përmbushë detyrimin kundrejt dorëzansës, pasi kjo do të çonte në konkluzionin e papranueshëm se debitori kryesor do të gëzonte më shumë të drejta se dorëzansë. Si rrjedhojë do të duhet të arrijmë në konkluzionin se edhe dorëzania që është pjesë e titullit ekzekutiv anulohet, nëse kreditori brenda një periudhe të caktuar kohe nuk tregon interes për kredinë e tij kundrejt dorëzansës. Kolegji vlerëson se nëse ka disa mënyra interpretimi të normës ligjore, atëherë ndërmjet tyre duhet të zgjidhet ajo e cila vjen në pajtim me Kushtetutën. (*Shiko Vendimin Nr.12/2010, Vendimin Nr.30/2010, Vendimin Nr. 7/2013, Vendimin Nr. 39/2014 si dhe Vendimin Nr. 7/2015 të Gjykatës Kushtetuese etj*). Sa më lart, fillimisht, Kolegji vlerëson të përqëndrohet tek origjina e kësaj norme ligjore dhe tek modelet apo filozofia e normave analoge në shtetet evropiane.

[..] konstatohet se me përjashtim të Kodit Civil të vitit 1929, në vazhdimësi ligjvënësi ka përdorur termin “*padi*” për të identifikuar mjetin që duhet të përdoret nga kreditori, në përmbushje të interesave të tij, brenda afatit gjashtë mujor apo një vjeçar, me kërkimin që ky detyrim të ekzekutohet nga dorëzansë.

Çështja që shtrohet konkretisht për diskutim nga Kolegji është nëse me termin “*padi*”, për qëllime të nenit 600 të KC, do të duhet të kuptohet ngushtësisht kërkesëpapia si akt që konstituon një proces gjyqësor civil kontencioz, apo me të, do të kuptohet gjerësisht pretendimi i kreditorit kundrejt dorëzansës për mospërmbushje të detyrimit, pavarësisht formës se si artikullohet ky pretendim, që mund të jetë edhe kërkesa për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Kolegji vlerëson se në aspektin parimor, interpretimi i ngushtë dhe literal, do të shkaktonte cenimin e nenit 11 pika 3 të Kushtetutës, qarkullimin civil të lirë dhe iniciativën e lirë ekonomike, duke e vështirësuar atë. Pra, një interpretim i tillë, se me termin “*padi*”, sipas nenit 600 të KC, do të kuptohen vetëm aktet që iniciojnë gjykime kontencioze, do të mohonte qëllimin e legjislatorit në parashikimin e shkronjave “*d*” të nenit 510 të KPC ku janë cilësuar si tituj ekzekutiv kontratat e kredive bankare dhe kontratat e kredive të dhëna nga institucionet financiare jo bankë.

Qëllimi i këtij parashikimi ligjor ka qenë që në qarkullimin civil të mundësohej dhënia e kredive për vitalizmin e ekonomisë dhe paralelisht me të edhe mjetet paguese, me qëllim që subjektet të ishin solvabël dhe të kishin mundësi investimi. Por nga ana tjetër kjo politikë ligjore është shoqëruar me mundësinë dhe garancinë e ofruar nga ligji për bankat apo institucionet financiare për të mbledhur kreditë e tyre. Interpretimi i ngushtë dhe literal [..], dëmton ekskluzivisht bankat dhe institucionet financiare jobankë, pasi atyre iu vështirëson realizimin e kredisë, duke dërguar në gjykatë për

proces kontencioz këdo kreditor që kërkon të aktivizojë mjetin e garancisë së kredisë të individualizuar në dorëzani. Nuk mundet të pranohet me një logjikë mesatare juridike se ekzekutimi i detyrimit aksesor dhe i mjetit të garancisë të jetë i ndryshëm dhe shumë më i vështirë në kohë se sa ekzekutimi i detyrimit principal. Kështu edhe dorëzania nuk mundet të jetë *apriori* më e vështirë për t'u ekzekutuar se sa vetë detyrimi principal përmbushjen e së cilit ajo është destinuar juridikisht për ta garantuar. Në këtë linjë arsytimi, Kolegji vlerëson se neni 600 i KC, në pjesën ku përmendet termi “padi”, do të duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe teleologjike. Sakaq, është e rëndësishme të merret në analizë kuptimi juridik i padisë, qëllimi i dorëzanisë, si dhe rëndësia e kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, për të vlerësuar nëse ligji na e lejon një mënyrë interpretimi të tillë.

Fillimisht, Kolegji sjell në vëmendje se, në praktikën e Gjykatës së Lartë, është bërë në mënyrë të vazhdueshme dallimi midis padisë në kuptimin material dhe atij procedural. [...] (*shih vendimin nr. 00 - 2019 - 245 (7), datë 10.04.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*)

Ka një interpretim të qëndrueshëm në lidhje me faktin se termi “padi” që përdoret në KC, si një ligj material, ka të bëjë me “*padinë*”, në kuptimin e saj material. Për rrjedhojë “*padia*” që përmendet në KC, nuk është mjeti procedural me të cilën palët i drejtohen gjykatës. Mjeti me të cilën palët i drejtohen gjykatës, nuk rregullohet nga e drejta materiale, por nga e drejta procedurale, konkretisht KPC, i cili parasheh mjetet të ndryshme procedurale për vënien në lëvizje të gjykatës, sic janë “*kërkesëpadia*” dhe “*kërkesa*”. Përdorimi i këtyre mjeteve bëhet sipas rastit dhe llojit të gjykimit.

Kolegji vlerëson se neni 600 i KC, me padi nuk nënkupton kërkesëpadinë, si mjet procedural për vënien në lëvizje të gjykatës, por padinë në kuptimin material, pra si mundësi që njihet nga ligji për t'iu adresuar gjykatës, për të arritur respektimin e të drejtave dhe të një interesi legjitim. E drejta për të vënë në lëvizje gjykatën nëpërmjet një kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm, futet brenda konceptit të padisë në kuptimin material, pasi edhe qëllimi i këtij mjeti juridik është realizimi i një të drejte dhe interesi legjitim, siç është e drejta e kreditorit, për të kërkuar përmbushjen e detyrimit nga dorëzanesi. Vetëm kur dorëzania përbën titull ekzekutiv, kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi barazohet me padinë sipas nenit 600. Në rastet kur dorëzania nuk përbën titull ekzekutiv kreditori mund të shfrytëzojë nenin 600 për të *paraqitur një padi themeli, kundër dorëzanesit, duke respektuar afatet e parashikuara nga ky nen.*”

Në mënyrë komplementare me interpretimin teleologjik, Kolegji vlerëson të bëjë edhe interpretimin gjuhësor të dispozitës.

Fjalët e përdorura në një normë ligjore u duhet dhënë kuptimi i tyre i zakonshëm, me përjashtim kur vetë ligji u jep një kuptim tjetër. [...] Bazuar në këto dy formulime shkencore, gjuha shqipe, i ka dhënë dy kuptime termit “*padi*”. Kuptimi i parë lidhet me padinë me palë kundërshtare, ndërsa kuptimi i dytë i termit “*padi*”, rezulton që të jetë edhe një kërkesë nëpërmjet të cilës kërkohen të drejtat përpara gjykatës, ose për zgjidhjen një çështjeje, akt nëpërmjet të cilit vihet në lëvizje një proces pa palë kundërshtare. Edhe në aspektin krahasimor, duhet theksuar se një interpretim i zgjeruar i nenit 600

të Kodit tonë, është në përputhje me qasjen e modeleve europiane ligjore, në mënyrën sesi ato e kanë konceptuar institutinin e dorëzanisë.

[..] Kolegji vlerëson se kjo mënyrë interpretimi, garanton edhe regjimin juridik të solidaritetit në detyrime ndërmjet debitorit kryesor dhe dorëzanësit, që sanksionohet në nenin 590 të KC. Kjo dispozitë, në momentin kur detyrimi kryesor bëhet i kërkueshëm dhe nuk ka marrëveshje të ndryshme ndërmjet palëve për dorëzani subsidiare, e bën të kërkueshme njëloj edhe detyrimin kryesor nga debitori kryesor dhe nga dorëzanësi, që pas këtij momenti është debitor solidar apo bashkëdebitor.

Kjo do të thotë se i pajtueshëm me nenin 590 të KC, do të jetë vetëm interpretimi që do të mundet të bëjë njëkohësisht të kërkueshëm detyrimin kryesor nga debitori kryesor dhe nga dorëzanësi dhe do t'i japë sakaq të drejtën e zgjedhjes kreditorit ndërmjet dy të detyruarve solidar.

Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se në rastin kur dorëzania është dhënë nga subjekte të së drejtës që nuk janë insitucione bankare apo financiare jobankare, atëherë për mbrojtjen e të drejtave të tyre, këto subjekte i drejtohen gjykatës me aktin procedural, të emërtuar si *“kërkesëpadi”*. Në rastin e insitucioneve bankare dhe insitucioneve financiare jobankare, ligjvënësi ka përcaktuar që kontratat e tyre përbëjnë titull ekzekutiv. Për rrjedhojë në këtë rast, këto subjekte, kur i drejtohen gjykatës, i drejtohen me aktin procedural të *“kërkesës”*.

Kontrata e dorëzanisë, duke qenë një kontratë aksesore që garanton një detyrim kryesor, duhet t'i shërbejë pikërisht kësaj të fundit. Në praktikën e tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për çështje në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, duke analizuar se: [..]. (*shih vendimin nr. 00-2011-758 (181), datë 19.04.2011 të Kolqjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Sikurse u përmend edhe më sipër, kontrata e dorëzanisë haset më së shumti në praktikë si një kontratë bankare, ose kontratë nga një insitucion financiar jobankar, në të cilën subjekti bankar ose financiar jobankar, përkundrejt kredisë që lëvron ndaj debitorit, preferon edhe një garanci nga një subjekt tjetër, dorëzanësi. Në kuptim të shkronjës d) të nenit 510 të KPC, parimisht të gjitha aktet e kësaj kategorie janë tituj ekzekutivë dhe për to lëshohet urdhëri i ekzekutimit sipas përcaktimeve të nenit 511 të po këtij kodi. Në rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm, në interpretim të frymës dhe qëllimit të dorëzanisë, si dhe karakterit subjektiv të saj, duke e parë padinë në kuptimin material si një e drejtë subjektive, nevojitet që kreditori të ndërmarrë veprime procedurale ligjore konkrete ndaj dorëzanësit. Kreditori nevojitet që të tregojë interes të përshtatshëm dhe vigjilencë në këtë drejtim. Fakti që kreditori ndërmerr veprime procedurale konkrete duke ju drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për kontratën e dorëzanisë, në ato raste kur ajo është një akt për dhënien e kredisë bankare apo akt për dhënien e kredive nga insitucionet financiare jobankare, prezumon se ai, (kreditori), synon të realizojë një të drejtë subjektive, konkretisht të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e detyrimit nga dorëzanësi. Pra, në këtë rast kërkesa e kreditorit për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit barazohet me padinë në kuptim procedural. Në këtë konkluzion arrihet edhe po të kemi parasysh se në dispozitat e KPC përdoren termat *“padi”* dhe *“kërkesë”* për të treguar veprimin procedural me të cilin

pala e interesuar, paditës apo kërkues investon gjykatën në mbrojtje të së drejtës së tij subjektive, në këtë drejtim të dyja këto akte kanë të njëjtin qëllim.

Mbetet të konkludohet se brenda kujt afati kreditori duhet t'i drejtohet dorëzanësit me kërkesën për ekzekutim të detyrueshëm të dorëzanisë dhe se me kalimin e kujt afati dorëzania shuhet. Për këtë pjesë të rregullimit të posaçëm të dorëzanisë, kur ajo përbën titull ekzekutiv, ligji ometon. Në këto kushte norma duhet të krijohet rishtazi nga gjykata nëpërmjet interpretimit me analogji, në bazë dhe për zbatim të nenit 1 paragrafi i dytë i KPC. Kolegji çmon të marrë në analizë momentin juridik nga nis afati 6 mujor apo një vjeçar i shuarjes së dorëzanisë, momentin që shenjon fillimin e fazës së ekzekutimit të detyrueshëm dhe afatet e parashkrimit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Momenti i nisjes së afatit të shuarjes së dorëzanisë deduktohet qartë nga neni 600 i KC, i cili përkon me momentin nga ku detyrimi i kreditorit bëhet i kërkueshëm (në mënyrë më të zgjeruar, kjo çështje do të trajtohet në vijim).

Ky parashikim është i pajtueshëm me rregullin e përgjithshëm të sanksionuar në nenet 117 dhe 118 KC. Në këto dispozita është parashikuar se afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë dhe në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat. Ndërsa në rastin kur detyrimet janë pa afat, Ligjvënësi ka bërë një parashikim të posaçëm, sipas të cilit afati i shuarjes së dorëzanisë është 1 vit dhe fillon nga data e lidhjes së kontratës së dorëzanisë.

KC nuk ka një rregullim të plotë mbi parashkrimin e kërkesave për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, por për këtë, na vjen në ndihmë neni 113 i KC, si e vetmja dispozitë që thotë diçka mbi këtë institut. [...]

Kolegji vlerëson se me një interpretim të kundërt (*per a contrario*), kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, që lidhen me paditë që nuk përfshihen në listën e nenit 113, do të parashkruhen brenda afateve të parashkrimit të padive respektive dhe në rastet kur kemi të bëjmë me tituj ekzekutivë, të ndryshme nga vendimet gjyqësore, rregullat mbi parashkrimin e padive do të zbatohen me analogji.

Në këtë kuptim, duke patur në konsideratë edhe nenet 11 dhe 18 të Kushtetutës, do të duhet të konkludohet se, dorëzania që është titull ekzekutiv duhet të shuhet brenda të njëjtave afate ligjore sikurse dorëzania që nuk është titull ekzekutiv. Për rrjedhojë arrihet në konkluzionin se neni 600 i KC do të interpretohet dhe zbatohet me analogji edhe për afatin ligjor të shuarjes së dorëzanisë që është titull ekzekutiv.

Nga ana tjetër, mënyra dhe mjeti se si vihet në ekzekutim kjo lloj dorëzanie nuk rregullohet nga neni 600 i Kodit Civil, por rregullohet sipas nenit 515 i KPC.[...]. Lëshimi i urdhrin të ekzekutimit nuk është momenti i fillimit të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv. Lëshimi i urdhrin të ekzekutimit është një gjykim gracioz i cili ka për qëllim verifikimin e ekzistencës kushteve të vlefshmërisë së një titulli ekzekutiv.

Fillimi i ekzekutimit është momenti i paraqitjes së kërkesës përmbarusit për nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm. Mund të ndodhë që kreditori të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për një titull ekzekutiv dhe më tej të mos kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të tij. Kjo parashikohet edhe në nenin 131/ç të KC[...]

Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se çdo veprim që kreditori ndërmerret ndaj debitorit apo ndaj dorëzanësit, (padi, kërkesë për lëshim urdhri ekzekutimi, kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm), duhet të konsiderohet se *ipso legge* ndërpresin afatin e parashkrimit. Pra aktivizimi i ekzekutimit të dorëzanisë nga kreditori, për qëllimet e parandalimit të shuarjes së dorëzanisë, për shkak të kalimit të afatit ligjor, duhet të bëhet prej secilës formë juridiksionale të mbrojtjes së pasurisë, qoftë duke konstituuar një proces gjyqësor për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit apo edhe nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, me kërkesë drejtuar përmbauesit gjyqësor, mjete ligjore të cilat sipas rastit mundet të vënë në ekzekutim detyrimin kryesor ndaj debitorit kryesor apo ndaj dorëzanësit. Nga analiza e mësipërme konkludohet se për efekt të nenit 600 të KC, do të barazohen kuptimi i kërkesëpadisë dhe kërkesës për lëshim urdhri ekzekutimi, në rastin kur dorëzania përbën titull ekzekutiv.

Kjo do të thotë se kreditori për të parandaluar ecjen e afatit 6 mujor ose një vjeçar duhet ti drejtohet gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit brenda 6 muajve ose një viti, sipas nenit 600 të KC. Nga ky moment fillon një afat i ri 6 mujor ose njëvjeçar, brenda të cilit kreditori duhet të paraqesë kërkesën për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm drejtuar përmbauesit gjyqësor.

Nisur nga sa më lart, Kolegji konkludon se, për aktet që përmbajnë detyrime në të holla dhe që sipas nenit 510 të KPC janë tituj ekzekutivë, kërkesa e kreditorit për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit është e barazvlefshme, përsa i përket efekteve juridike që sjell, me padinë e ngritur sipas nenit 600 të KC.

Ndërkohë për efekt të vënies në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit, kërkesa drejtuar përmbauesit gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në nenin 113 të KC, pra kjo kërkesë i nënshtrohet një tjetër afati të përcaktuar në nenin 600 të KC.

2. Referuar neneve 597, 598, 599 dhe 600 të KC, a legjitimohet dorëzanësi të kërkojë shuarje dorëzanie?

Dispozitat e mësipërme të KC, përcaktojnë rastet e shuarjes së dorëzanisë. Kështu rezulton se sipas Kodit shuarja e dorëzanisë ndodh për shkak të shuarjes së detyrimit kryesor (neni 597); se kreditori heq dorë nga privilegjet, pengu dhe hipoteka, për pasojë dorëzanësi shkarkohet nga detyrimi (neni 598); kreditori pranon një pasuri ose çdo gjë tjetër për pagimin e detyrimit kryesor (neni 599); plotësimi i afateve të parashkrimit prej gjashtë muajsh apo një viti (neni 600). [...]

Ndër qëllimet e kontratës së dorëzanisë është dhënia e garancisë se debitori do të përmbushë detyrimin në kohën, mënyrën dhe kushtet e caktuara. Në këtë marrëdhënie me kreditorin, dorëzanësi nuk ka një të drejtë të tij subjektive dhe konkrete, por ai gjendet në çdo moment i riskuar në të drejtat pasurore sepse eventualisht debitori mund të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të përmbushur detyrimin kryesor. Në këto kushte, për të mbrojtur dorëzanësin nga ky risk i “pafund”, ligji ka parashikuar edhe rastet e shuarjes së detyrimit të tij.

Kështu, megjithëse nenet 597 deri 599 të KC nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur të drejtën e dorëzanësit për të kërkuar gjyqësisht shuarjen e dorëzanisë, kjo e drejtë del nga përmbajtja e nenit 592 të KC, [...] E thënë ndryshe, për të parashtruar një kërkim është e nevojshme që subjekti të ketë interes. Ky interes prezumon kërkesën e subjektit drejtuar gjykatës me qëllim njohjen ose rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar, mohuar apo shkelur nga një subjekt tjetër, të cilin ai e thërret në gjykim. Kërkimi për njohjen ose rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar, shkelur apo mohuar është legjitim vetëm nëse parashtrohet nga ai të cilit i përket e drejta subjektive e cenuar, shkelur apo mohuar (legjitimiteti aktiv), dhe vetëm kundër atij që me sjelljen apo veprimet e tij ka cenuar, shkelur apo mohuar të drejtën subjektive të palës tjetër (legjitimiteti pasiv). Ndaj edhe dorëzani gëzon legjitimitet aktiv për të investuar gjykatën me padi me objekt “shuarjen e dorëzanisë”. Tek e fundit dorëzani është palë në këtë veprim juridik sipas nenit 585 të KC dhe për rrjedhojë gëzon të drejtën e mbrojtjes ligjore duke qenë në pozitën e palës paditëse, pra ka legjitimitet aktiv.

Sipas teorisë bazë të së drejtës kushtetuese, të të drejtave të njeriut, të së drejtës civile dhe e së drejtës procedurale civile, kushdo që pretendon se cenohet në të drejtat e tij kushtetuese apo ligjore mundet t'i drejtohet gjykatës. Ky parim absolut i aksesit në drejtësi është në gjendje që të zgjidhë pikëpyetjen e shtruar për njësim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Sigurisht që askush më shumë se dorëzani nuk është i interesuar dhe mundet të legjitimohet aktivisht në gjykatë për të kërkuar shuarjen e dorëzanisë. Debitori kryesor nuk mundet të ketë interes për t'iu drejtuar gjykatës, pasi me një dorëzani efektive ai ka siguri që detyrimi i marrë përsipër do të përmbushet kundrejt kreditorit. Nga ana tjetër kreditori nuk mundet të kërkojë diçka të tillë në gjykatë, pasi ai nuk mundet të ketë interes që të pakësojë mjetet ligjore që garantojnë realizimin e kredisë së tij. Të tretët janë krejt indiferent në këtë çështje. E për rrjedhojë përgjigja e pyetjes së Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mbetet e padyshimtë se vetëm dhe ekskluzivisht dorëzani mundet të kërkojë në gjykatë me padi njohje shuarjen e dorëzanisë.

Në një rast ku paditës është dorëzani nuk jemi përpara ndërgjyqësisë së detyrueshme, pra dorëzani nuk është i detyruar të thërrasë si të paditur njëherazi kreditorin dhe debitorin. Sikurse u analizua në pjesën hyrëse, kontrata e dorëzanisë lidhet midis dorëzanësit dhe kreditorit, marrëdhënia juridike lind midis tyre dhe si rregull debitori mbetet i palidhur me këtë marrëdhënie juridike.

Nga ana tjetër, dorëzani legjitimohet të kërkojë shuarjen e dorëzanisë, edhe përmes prapësimi gjyqësor, në ato gjykime ku është thirrur në cilësinë e palës së paditur. Kjo deduktohet nga rregulli i përgjithshëm procedural civil, se barrën e paraqitjes së fakteve shuese, penguese apo ndryshuese të së drejtës së paditësit dhe barrën e provës për këto fakte, në një proces civil, e ka pala e paditur.

Dorëzania është një veprim juridik, pra konsiston në një manifestim të drejtpërdrejtë të vullnetit me synimin për të arritur pasoja juridike të caktuara, më konkretisht për: krijimin e një situatë të re (e një marrëdhënie juridike të re); disiplinimin e një situatë tashmë ekzistuese, (një marrëdhënie juridike që ekziston); mbarimin/shuarjen e një situatë tashmë ekzistuese, atëherë janë të zbatueshme dispozitat materiale që

parashikon Kodi Civil, nenet 79 e vijues të tij, sikundër edhe jurisprudenca e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e manifestuar në vendimet unifikuese.

Në rastet kur kontrata e dorëzansisë gjendet e integruar apo në formën e një kontrate bankare, ose kontratë nga një institucion finaciari jobankar, akte të cilat janë tituj ekzekutiv, mjetet e mbrojtjes të së drejtave të dorëzansisë përputhen me mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të detyrimeve të përcaktuara në nenet 609 e vijues të KPC. Këtu përmendim: padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv sipas nenit 609; ankimin për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore sipas nenit 610 dhe padinë për kërkimin e sendit nga personi i tretë neni 612.

Në nenin 609 të KPC parashikohet se: [...] Pra, kërkimi i pavlefshmërisë së pjeshme apo të plotë të titullit ekzekutiv është një nga mjetet e mbrojtjes së debitorit kundër ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile.

Titulli ekzekutiv është akti përmes të cilit legjitimohet kërkesa për nisjen e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm. Kushtet e titullit ekzekutiv konsistojnë në ekzistencën e së drejtës materiale, e drejtë e cila duhet të jetë e sigurt, e përcaktuar dhe e kërkueshme. Nga ana tjetër nëse kundërshtohet titulli ekzekutiv për pavlefshmëri, bazuar në nenin 609 të KPC, kërkohet të kundërshtohet tërësisht ose pjesërisht vetë e drejta e përfshirë në të. Në këtë kuadër, Kolegji vlerëson se, mjete proceduriale me të cilin dorëzansia mund të kërkojë shuarjen e dorëzansisë, në ato raste kur kjo e fundit përbën titull ekzekutiv është kërkespacia me objekt “*pavlefshmëri titulli ekzekutiv, kontratë dorëzanie*”.

Mbi këtë analizë, Kolegji konkludon se, referuar përcaktimeve të neneve 597, 598, 599 dhe 600 të KC, dorëzansia legjitimohet të kërkojë shuarjen e dorëzansisë me padi të tij, apo ta prapësojë atë në një proces gjyqësor ku është thirrur si i paditur me kërkimin e paditësit për përmbushjen e këtij detyrimi.

Për aktet që janë tituj ekzekutivë, mjete proceduriale me të cilin dorëzansia mund të kërkojë shuarjen e dorëzansisë është padia për “*Pavlefshmërinë e këtij titulli*”, përsa i takon detyrimit të dorëzansisë, sipas nenit 609 të KPC.

3. Afati 6 mujor, (neni 600 KC), është afat prekluziv apo afat parashkrimi ?

Neni 600 i KC, përmban në vetvete dy afate për shuarjen e dorëzansisë, afatin gjashtë mujor që nis të llogaritet “*nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit*” dhe afatin një vjeçar që nis të llogaritet “*nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzansisë*”. Për të sqaruar natyrën juridike të këtij afati, Kolegji çmon të trajtojë dy institute të së drejtës civile materiale, parashkrimin dhe dekadencën, kuptimin dhe dallimet midis tyre. [...]

Parashkrimi është një fakt juridik i kategorisë së ngjarjeve me vërtetimin e të cilit vijnë pasoja me natyrë shuese, pasoja këto të lidhura me të drejtën e përdorimit të njërit prej mjeteve bazë dhe më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave civile-padisë. Ligji duke u njohur personave të drejtën subjektive për t’iu drejtuar gjykatës me anën e padisë, njëkohësisht, e kufizon ushtrimin e kësaj të drejte me afate të caktuara kohore, të gjykuara të arsyeshme dhe të mjaftueshme nga ligjvënësi për ushtrimin e kësaj të drejte. Mosushtrimi i të drejtës brenda këtyre afateve bën që subjekti të humbasë të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, pra të humbasë të drejtën për të detyruar palën tjetër

të përmbushë detyrimin e saj nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

Elementet përbërëse të parashkrimit janë dy: mosveprimi i titullarit (*mbajtësit*) të së drejtës subjektive dhe kalimi i kohës brenda të cilës ai duhet ta kishte ushtruar këtë të drejtë. Pra, parashkrimi është humbja e të drejtës së padisë për shkak të kalimit të afateve të përcaktuara në ligj. Parashkrimi shues sjell shuarjen e të drejtës subjektive. Arsyeja për të cilin rregullimi juridik e lidh me shkaqet jo të arsyeshme të titullarit shuarjen e së drejtës subjektive qëndron në nevojën e sigurisë së marrëdhënieve juridike. Kur një e drejtë subjektive nuk ushtrohet, tek njerëzit formohet bindja që ajo nuk ekziston ose se është braktisur. Sipas nenit 117 të KC, [...]Për lloje të ndryshme marrëdhëniesh e drejta e padisë lind në kohë të ndryshme. Në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat dhe kur detyrimi është i përbërë nga pagesa periodike, për secilën prej tyre afati i parashkrimit fillon të ecë në mënyrë të veçantë. Për detyrimet kontraktore të lidhura pa afat dhe për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, afati i parashkrimit fillon nga dita kur ka lindur detyrimi. Mund të ndodhë që para se të fillojë të ecë afati i parashkrimit ose pasi afati ka filluar të ecë, të vërtetohen rrethana të cilat pengojnë titullarin e së drejtës për të realizuar të drejtën e tij subjektive nëpërmjet ngritjes së padisë dhe të cilat pezullojnë ecjen e afatit.

Pezullimi i parashkrimit konsiston në mosfillimin ose mosecjen e afatit të parashkrimit për sa kohë ekziston rrethana (*ose rrethanat*) që nuk e lejojnë titullarin e të drejtës të paraqesë padinë dhe vetëm pas rënies së tij, afati vazhdon të ecë. Nëse koha e mbetur nga afati i parashkrimit, pas zhdukjes së shkakut pezullues, është më e shkurtër se gjashtë muaj, ajo zgjatet deri në gjashtë muaj. Shkaqet e pezullimit të parashkrimit parashikohen në mënyrë të shprehur dhe shteruese nga neni 129 i KC.

Gjithashtu në ligj njihet edhe instituti i ndërprerjes së afatit të parashkrimit. Ndërprerja e parashkrimit është rrethana e cila pengon ecjen e afatit dhe koha e kaluar përpara vërtetimit të rrethanës/rrethanave që sjell ndërprerjen nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së shkakut ndërprerës fillon të ecë një afat i ri parashkrimi. Rastet e ndërprerjes së afatit të parashkrimit parashikohen në nenin 131 të KC.

Nga ana tjetër, KC në nenin 137 e vijues, ka parashikuar edhe institutin e afatit prekluziv dhe dekadent të të drejtave subjektive. Ndryshe nga kalimi i afatit të parashkrimit shues, me kalimin e afatit prekluziv apo dekadent, në rastet e parashikuara nga ligji, shuhet e drejta subjektive në vetvete. Në këtë rast, pasiviteti i titullarit të së drejtës, nuk ka si pasojë vetëm humbjen e së drejtës për të ngritur padi në gjykatë, por sjell një pasojë edhe më të rëndë, që është ajo e humbjes në tërësi të së drejtës subjektive. Pra, për efekt të ligjit, titullari i së drejtës nuk konsiderohet më se i përket ajo e drejtë

Duke u bazuar në këtë dallim midis dy instituteve, rrjedhin disa pasoja juridike. Nga e drejta për të prapsuar parashkrimin e padisë, pra shuarjen e të drejtës së subjektivit titullar për mbrojtje shtetërore, debitori, ndaj të cilit ushtrohet forca shtrenguese e shtetit, mund të heqë dorë pasi të jetë plotësuar afati i tij (neni 126 i KC). Kjo pasi e drejta subjektive e kreditorit edhe në këtë rast gjithësesi ekziston dhe debitori mund ta realizojë në çdo kohë qoftë edhe vullnetarisht.

Po ashtu, debitori nuk mund të pretendojë kthimin e shumës së parave apo të sendit të dhënë vullnetarisht, pas kalimit të këtij afati, sepse detyrimi i tij karshi kreditorit në vetvete nuk është shuar (neni 128 i KC). Afati i parashkrimit nuk mund të merret parasysh nga gjykata, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar (neni 125 i KC). Nga ana tjetër, nga afati prekluziv palët nuk mund të heqin dorë pas plotësimit të tij. Shuarja e së drejtës subjektive ndodh *ipso factum*, me kalimin e afatit, pavarësisht vullnetit të palëve (neni 139 i KC). Afati prekluziv, duke qenë se lidhet me vetë ekzistencën e së drejtës subjektive, merret parasysh nga gjykata kryesisht (neni 140 i KC).

Kolegji vijon se, ndryshimi midis parashkrimit dhe prekluzivitetit qëndron edhe te fakti nëse afatet mund të pezullohen, ndërpriten apo rifillojnë. Parashkrimi kërkon pasivitetin e pajustificuar të titullarit të së drejtës, që do të thotë se ky institut nuk vepron në rast se ai ka një arsye objektive që justifikon pasivitetin e tij. Në rast se ndodhemi përpara një situatë të tillë, do të zbatohen rregullat e pezullimit dhe ndërprerjes së parashkrimit. Prekluziviteti nga ana tjetër, përkon në afate të prera, strikte, të cilat as nuk mund të ndërpriten apo të pezullohen, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon shprehimisht një gjë të tillë. Duke iu kthyer çështjes konkrete, në nenin 600 të KC, Ligjvënësi ka përdorur termin "shuhet", në lidhje me të drejtën e kreditorit që nuk ushtrohet për të ekzekutuar detyrimin ndaj dorëzanësit brenda afatit të parashkuar në të dhe Kolegji vlerëson se kjo ka sjellë më së shumti paqartësinë lidhur me këtë afat.

Pavarësisht terminologjisë së përdorur në ligj, në konsideratë të kuptimit dhe dallimeve midis dy instituteve të trajtuara më sipër, Kolegji vlerëson se afati i parashkuar në nenin 600 të Kodit Civil, është një afat parashkrimi.

Së pari, Kolegji bazohet tek fakti se ky afat lidhet me ushtrimin e të drejtës së padisë së kreditorit ndaj dorëzanësit dhe referuar parashikimit të nenit 112 të KC, shuarja e të drejtës së padisë ndodh kur ajo nuk ushtrohet brenda afatit të caktuar të parashkrimit.

Gjithashtu, Kolegji vlerëson të bëjë edhe një interpretim historik të dispozitave që kanë normuar institutin e parashkrimit, duke i parë ato në mënyrë sistematike, me regjimin juridik të shuarjes së dorëzansisë ndër vite. Në planin historik, legjislacioni shqiptar e ka njohur dhe rregulluar, institutin e parashkrimit në mënyrë të vazhdueshme.

[..] Në vijim të kësaj analize, Kolegji evidenton faktin se prekluziviteti, si institut i së drejtës civile, në legjislacionin shqipëtar është parashkuar për herë të parë nga Kodi Civil i vitit 1994, nenet 137 – 140, duke munguar në legjislacionet e mëparshme. Kolegji, ka analizuar më lart dhe risjell në vëmendje se neni 600 i KC odit Civil i sotëm është pothuaj i njëjtë edhe në terminologji me nenin 133 të ligjit nr. 2359, datë 15.11.1956 "Mbi veprimet juridike dhe detyrimet" [..] Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, referoi se është në diskrecionin e ligjvënësit që të zgjedhë nëse norma që kanë qenë parashkuar në legjislacionin e mëparshëm, do të rikthehen në fuqi apo jo. Po sipas arsytimit të mësipërm, nëse ligjvënësi vendos t'i riktheje këto norma në fuqi, duke i parashkuar në mënyrë identike në ligjin e ri që miraton, konsiderohet se norma e re ruan të njëjtin kuptim, sic i ishte dhënë nga jurisprudenca dhe doktrina juridike e kohës.

Kolegji vlerëson se do të përbënte *non sens* juridik që e njëjta normë me përmbajtje identike të kishte kuptime të ndryshme në kohë të ndryshme. Për këtë arsye, Kolegji

Civil i Gjykatës së Lartë, duke respektuar zgjedhjen e ligjvënësit, si edhe duke e lidhur me parimet kushtetuese të sigurisë juridike dhe të barazisë para ligjit, çmon se neni 600 duhet të ketë të njëjtin kuptim që ka pasur neni 133 i LVJD. Përveç mungesës së parashikimeve ligjore, mbi prekluzivitetin e të drejtave, [...] Për rrjedhojë terminologjia e nenit 133 të LVJD, si për termin “shuhet”, ashtu edhe për afatin 6 mujor ka pasur në konsideratë afate parashkrimi dhe jo prekluziviteti.

Në vijim të analizës së tij, Kolegji Civil, analizon se përdorimi i termit “shuhet”, nga ligjvënësi në përmbajtjen e KC, si rregull, prezumohet se përdororet në një kuptim të caktuar dhe të njëjtë, me përjashtim të rasteve kur nga konteksti del se është përdorur në një tjetër kuptim. Në KC, termi “shuhet”, përdoret në disa dispozita, nenet 112, 526, 527, 583, 597, 600, 634, 763, 955, 1033 etj.

Nga përmbajtja dhe konteksti i këtyre dispozitave, rezulton se parashikimet e disa neneve, konkretisht 526 e 527, (pamundësia e ekzekutimit), 583, (shuarja e hipotekës) 597, 763, (shuarja e dhurimit), dhe 1033 nuk kanë të bëjnë me afate dhe për rrjedhojë nuk kanë vlerë të merren në konsideratë për analizë nga ky Kolegj.

Nga dispozita të tjera, konkretisht nga neni 112 i KC, rezulton se duke na dhënë pikërisht kuptimin e parashkrimit të padisë, ligji përdor termin “shuhet”, [...] Si konstatohet, vetë neni 112 përdor termin “shuhet”, i njëjti term i cili përdoret nga ligjvënësi edhe në nenin 600 të KC. Për rrjedhojë, duke qenë se në këto dy dispozita kemi të bëjme me afate, llogjika interpretuese kërkon që ky term të ketë kuptim të njëjtë, në të dyja këto norma. Pra, e thënë ndryshe, ligjvënësi, duke përdor termin “shuhet” në nenin 600 të KC, ka pasur në konsideratë afatin e parashkrimit për të cilin përdoret i njëjti term. Konkluzioni si më sipër përforcohet edhe nga fakti se në nenet 137-140 të KC, që trajtojnë prekluzivitetin, nuk përdoret për asnjë moment termin “shuhet”.

[...] Krahas interpretimit historik, Kolegji Civil, çmon të analizojë përmbajtjen e nenit 600 të KC, në mënyrë sistematike edhe në raport me dispozita të tjera të KC. Kështu, nga përmbajtja e neneve 115, shkronja “a” dhe “c”, nenit 129/d, 130, 312 dhe 313, 866 etj., rezulton se afatet 6 mujore dhe një vjeçare janë si rregull afate parashkrimi. Kolegji çmon të theksojë se gjatësia e afateve nuk mund të jetë gjithmonë një kriter kategorik ndarës, por shërben si tregues, në rastet kur ligji ndjek të njëjtën logjikë në përcaktimin e afateve. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje nenin 133 të KC në fuqi i cili [...] Kjo dispozitë që parashikon efektet e ndërprerjes së parashkrimit, sipas rasteve të nenit 131 të KC, i shtrin efektet e saj si për debitorin kryesor, ashtu edhe për dorëzanësin. Nëse Kolegji Civil, bazuar vetëm në termin “shuhet” do të konsideronte afatin 6 mujor në nenin 600, si një afat prekluziv, atëherë kjo do të sillte që neni 133 i KC, të mbetej pa fuqi juridike, pasi sikurse u analizua më sipër, instituti i ndërprerjes gjen zbatim vetëm për afatet e parashkrimit. Për rrjedhojë, Kolegji Civil, duhet që të bëjë një interpretim të harmonizuar të këtyre normave dhe e vetmja mënyrë që këto dy dispozita të KC të interpretohen në mënyrë pajtuese së bashku është që afatet e nenit 600 të konsiderohen si afate parashkrimi.

Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji arrin në konkluzionin se termi “shuhet” në nenin 600 të Kodit është përdorur për t’ju referuar parashkrimit dhe jo prekluzivitetit apo dekadencës.

E njëjta logjikë vlen edhe për afatin 1 vjeçar të parashikuar në fjalinë e dytë të kësaj dispozite. Ndryshimi midis tyre qëndron vetëm nga natyra e detyrimit, nëse jemi para detyrimeve me afat ekzekutimi ose jo.

Për sa më lart, Kolegji konkludon se, afati 6 (gjashtë) mujor i përcaktuar në nenin 600 të KC është një afat që lidhet me shuarjen e të drejtës për të përdorur mjetin procedural, padinë, për realizimin e të drejtës, dhe jo me humbjen e vetë të drejtës subjektive. Si i tillë ky është afat parashkrimi dhe jo prekluziv.

4. Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të KC, a barazohet cilësia e dorëzanësit me atë të debitorit? Nëso po, gjatë cilës fazë mund të barazohen këto dy cilësi?

Nga analiza e ligjeve shqiptare dhe europiane, të hulumtuara për qëllimet e këtij vendimi, Kolegji vlerëson se ka dy lloje të dorëzanisë, duke marrë si kriter kategorizimi, aktivizimin e përgjegjësisë së dorëzanësit kundrejt kreditorit. Në fakt të gjitha modelet ligjore të studiuara i njohin të dy kategoritë dhe llojet e ndryshme të dorëzanisë, por mënyra se si janë normat e formuluar ndryshojnë.

[..] Sa më lart, Kolegji vlerëson se përgjigja e kësaj pyetje të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, duke nënkuptuar këtu pjesën e parë të pyetjes, zgjidhet duke kuptuar se kë model ligjor dorëzanie ka zgjedhur legjislatori shqiptar. Pjesa tjetër e pyetjes do të zgjidhet duke pasur parasysh konkluzionin mbi pjesën e parë të çështjes së zgjidhur tashmë. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson të marrë në analizë në planin historik dhe krahasimor, se si është rregulluar kjo çështje, në legjislacionin shqiptar dhe atë europian. [...] Ndryshe nga Kodi Civil i vitit 1929, ligji civil i parë, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 1946, parashikoi se si rregull kontrata e dorëzanisë do të krijojë marrëdhënien e dorëzanisë solidare.[..]I njëjti regjim juridik i dorëzanisë solidare u parashikua edhe në Kodin Civil të vitit 1981.

[..]

Dispozita në fuqi e KC [..] që rregullon aktivizimin dhe llojin e përgjegjësisë së dorëzanësit kundrejt kreditorit është neni 590 i[..]Pas kësaj analize historike dhe krahasimore e llojit të përgjegjësisë së dorëzanësit kundrejt kreditorit, është e thjeshtë për të konkluduar se KC në fuqi, sikurse ligji civil shqiptar i vitit 1956 e 1981 dhe ligji civil italian, prezumojnë se dorëzania, në mungesë të një marrëveshje që do ta regjojë atë sipas modelit subsidiar, është solidare.

Në veçanti, Kolegji çmon të verë theksin tek fjalia e dytë e nenit 590 të Kodit Civil, [...] Kjo do të thotë se si rregull, përveç rastit kur palët parashikojnë ndryshe, nga momenti i rënies në morë të debitorit kryesor, ky i fundit dhe dorëzanësi i kreditorit përgjigjen solidarisht para tij për përmbushjen e detyrimit. Kreditori mundet të zgjedhë ndjekjen e secilës prej rrugëve apo mjeteve ligjore për ekzekutimin e detyrimit ndaj debitorit dhe dorëzanësit, i cili nga ai moment përgjigjet sikur të jetë bashkëdebitor solidar. I vetmi kufi për përgjegjësinë solidare të dorëzanësit është paragrafi i dytë i nenit 589 të KC, i cili parashikon se dorëzania që kalon detyrimin ose që jepet në kushte më të rënda se

detyrimi kryesor, është e vlefshme vetëm deri në kufijtë e këtij të fundit.

Në kuptim të neneve 589, 590 dhe 591, debitori kryesor dhe dorëzanësi janë në pozita të barasvlefshme përsa i përket detyrimit kryesor edhe në drejtim të pagimit të kamatës, shpërblimit të dëmit nga vonesa, apo edhe të shpenzimeve të tjera. Njëherazi debitori dhe dorëzanësi kanë një marrëdhënie solidariteti për ekzekutimin e detyrimit, duke i lejuar kreditorit të paraqesë padi kundër të dyve njëkohësisht.

Aktivizimi i përgjegjësishë solidarë të dorëzanësit, krahas asaj të debitorit kryesor, do të lindë në momentin kur detyrimi është maturuar, apo kur afati për të përmbushur detyrimin ka mbaruar dhe debitori kryesor ka rënë në morë. Kjo nuk duhet të çojë në konkluzionin se kontrata e dorëzanisë i jep efektet apo hyn në fuqi në momentin kur debitori kryesor bie në morë apo detyrimi bëhet i kërkueshëm.

Në të vërtetë kontrata e dorëzanisë është kontratë konsensuale, që do të thotë se ajo hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe perfeksionimit të saj sipas ligjit, por përgjegjësia solidarë e dorëzanësit kundrejt kreditorit dhe krahas debitorit kryesor do të varet nga vërtetimi i kushtit pezullues, që do të thotë maturimi i detyrimit apo rënia në morë e debitorit kryesor. Pikërisht ky është edhe momenti që nis të ecin afatet e parashkrimit të parashikuara në dy paragrafët e nenit 600 të KC.

Kolegji vlerëson se cilësia e dorëzanësit barazohet me cilësinë e debitorit kryesor për shkak të modelit të dorëzanisë solidarë që ligji civil shqiptar ka parashikuar. Por barazimi i cilësisë së dorëzanësit dhe debitorit kryesor nuk ndodh *a priori* dhe ndodh ndryshe sipas llojit të dorëzanisë së zgjedhur nga palët në kontratën e dorëzanisë.

Në dorëzaninë solidarë, kur palët nuk kanë parashikuar ndryshe në kontratë, cilësia e dorëzanësit do të barazohet me cilësinë e debitorit kryesor për llogari të përmbushjes së detyrimit kundrejt kreditorit, në momentin kur detyrimi maturohet dhe debitori kryesor bie në morë. Nga ana tjetër, nëse dorëzania është përcaktuar në kontratë nga palët si dorëzani subsidiare, atëherë cilësia e dorëzanësit do të barazohet me cilësinë e debitorit kryesor për llogari të përmbushjes së detyrimit kundrejt kreditorit, vetëm në momentin kur kreditori ka shteruar të gjitha mjetet e gjurmimit të pasurisë së debitorit kryesor dhe ka qenë e pamundur për të ekzekutimi i kredisë.

Në nenin 595 të KC [...] *Ratio legis* e kësaj dispozite është se dorëzanësi e përmbush detyrimin, në rastet kur kreditori i drejtohet atij duke e vënë në dijeni se nuk është përmbushur detyrimi nga debitori sipas kontratës. Në këtë rast kreditori nuk paraqet padi kundër tij, por e njofton në një mënyrë tjetër, me një veprim apo mjet tjetër juridik. Ndërkohë, dorëzanësi që përmbush detyrimin në vend të debitorit kryesor ka të drejtë që t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapsmet që mund t'i kundrejtonte vetë debitori, si dhe të kërkojë kompensimet që kreditori i detyrohet debitorit edhe sikur debitori të ketë hequr dorë nga e drejta ose të ketë pranuar detyrimin.

Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se kontrata e dorëzanisë fillon të sjellë efektet e parashikuara në ligj që në momentin e lidhjes së saj dhe cilësia e debitorit dhe e dorëzanësit barazohet në momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm. Në këtë moment, si rregull, kreditori mund t'i drejtohet si debitorit, ashtu edhe dorëzanësit, përveç kur palët kanë disponuar ndryshe në kontratën e dorëzanisë.

Nga sa më sipër, Kolegji konkludon se, kontrata e dorëzarisë fillon të japi efektet e parashikuara në ligj që në momentin e lidhjes së saj dhe cilësia e debitorit dhe dorëzansit barazohet në momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm. Në këtë moment, si rregull, kreditori mund t'i drejtohet si debitorit ashtu edhe dorëzansit.

Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të KC, cilësia e dorëzansit me atë të debitorit barazohen vetëm për pjesën e detyrimit, radhën e ekzekutimit dhe ndarjen e detyrimit mes disa dorëzansave, si palët mund të kenë përcaktuar në kontratën e dorëzarisë.

Në referim të nenit 485, paragrafi i dytë i KPC, disponimin njësuës, për secilën prej çështjeve të shqyrtuara nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është si në vijim.

- Njësimi për çështjen e parë. *Për aktet që përmbajnë detyrime në të holla dhe që sipas nenit 510 të KPC janë tituj ekzekutivë, kërkesa e kreditorit për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit është e barazvlefshme, përsa i përket efekteve juridike që sjell, me padinë e ngritur sipas nenit 600 të KC. Ndërkohë për efekt të vënies në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit, kërkesa drejtuar përmbaruesit gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në nenin 113 të KC, pra kjo kërkesë i nënshtrohet një tjetër afati të përcaktuar në nenin 600 të KC.*
- Njësimi për çështjen e dytë. *Referuar përcaktimeve të neneve 597, 598, 599 dhe 600 të KC dorëzansi legjitimohet të kërkojë shuarjen e dorëzarisë me padi të tij, apo ta prapësojë atë në një proces gjyqësor ku është thirrur si i paditur me kërkimin e paditësit për përmbushjen e këtij detyrimi. Për aktet që janë tituj ekzekutivë mjeti procedural me të cilin dorëzansi mund të kërkojë shuarjen e dorëzarisë është padia për “Pavlefshmërinë e këtij titulli”, përsa i takon detyrimit të dorëzansit, sipas nenit 609 të KPC.*
- Njësimi për çështjen e tretë. *Afati 6 (gjashtë) mujor i përcaktuar në nenin 600 të KC është një afat që lidhet me shuarjen e të drejtës për të përdorur mjetin procedural, padinë, për realizimin e të drejtës, dhe jo me humbjen e vetë të drejtës subjektive. Si i tillë ky është afat parashkrimi dhe jo prekluziv.*
- Njësimi për çështjen e katërt. *Kontrata e dorëzarisë fillon të japi efektet e parashikuara në ligj që në momentin e lidhjes së saj dhe cilësia e debitorit dhe dorëzansit barazohet në momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm. Në këtë moment, si rregull, kreditori mund t'i drejtohet si debitorit ashtu edhe dorëzansit. Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të KC, cilësia e dorëzansit me atë të debitorit barazohen vetëm për pjesën e detyrimit, radhën e ekzekutimit dhe ndarjen e detyrimit mes disa dorëzansave, si palët mund të kenë përcaktuar në kontratën e dorëzarisë.*

Zgjidhja e çështjes objekt shqyrtimi.

[..] Në analizë të këtyre fakteve Kolegji çmon se marrëdhënia e krijuar mes ndërgjyqësive është një marrëdhënie dorëzanie, në të cilën dorëzuesi dhe debitori përgjigjen solidarisht dhe në të njëjtën kohë ndaj kreditorit. Afati për ekzekutimin e detyrimit ka qenë data 17.01.2010.

Pasi është vënë në dijeni nga banka për qënien në vonesë në shlyerjen e detyrimit, pas datës 02.06.2010, debitori ka shlyer një pjesë të këtij detyrimi, duke kryer gjithësej dhjetë pagesa deri në datën 27.12.2010. Pra, nga dita e maturimit të kredisë deri në momentin e dorëzimit të dosjes pranë përmbauesit gjyqësor, personi i tretë, [..], në cilësinë e debitorit, ka kryer disa pagesa duke nisur nga data 08.03.2010 në vazhdim deri në datën 27.12.2010.

Për këtë arsye, në këtë periudhë kohore kur debitori ka vijuar të kryejë pagesa, afati i parashkrimit është ndërprerë, në kuptim të nenit 131, shkronja a) dhe nenit 133 të KC. Kolegji vlerëson se debitori dhe dorëzuesi si debitor solidar, me veprimet e mësipërme kanë njohur detyrimin, fakt i cili referuar nenit 131, shkronja a) të Kl ka sjellë ndërprerjen e parashkrimit. Në vijim ka nisur një afat i ri parashkrimi konform nenit 134 të KC.

Në këto kushte, pala e paditur, [..] në momentin që ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, në muajin mars të vitit 2011 ndodhje brenda afatit të parashkrimit prej gjashtë muajsh sipas përcaktimit të nenit 600 të KC.

Për sa më sipër, ky Kolegj, vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material, si i tillë duhet të lihet në fuqi. Në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 485 të KPC ky vendim që njëson praktikën gjyqësore botohet në Fletoren Zyrtare.

VI. Mosmarrëveshje në Marrëdhënie Pune

KCGJL Vendim Nr.00-2023-233(43), datë 01.02.2023 (Kontratë Kolektive: zgjidhje kontrate)

Ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë shteruese tërësinë e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësve në rastet kur punëdhënësi bën pushime kolektive nga puna. Këto kushte dhe kritere që ligjvënësi ka parashikuar në nenin 148 të KP, përbëjnë një garanci plotësuese për punëmarrësit për t'u mbrojtur nga pushimet kolektive nga puna. Zgjidhja e kontratës kolektive të punës nuk i njoftohet dhe nuk bisedohet në mënyrë individuale secilit punëmarrës, sikurse ndodh tek zgjidhja e kontratës individuale të punës, por diskutohet dhe bisedohet me sindikatën e punonjësve, e cila mbron në mënyrë të përgjithshme interesat e të gjithë punonjësve të prekur, si dhe garantohet me pjesëmarrjen në këto bisedime edhe të Ministrinë përkatëse.

Fjalë kyçe: Kontratë kolektive pune, pushimet kolektive nga puna, sindikata e punonjësve, shpërblim për vjetërsi

Rrethanat e çështjes:

Rezulton se pala paditëse S.K. ka qenë e punësuar pranë sektorit të naftës për një periudhë prej 33 vjetësh e 3 muajsh e 15 ditësh, fakt i cili provohet nga librezja e saj e punës si dhe nga vërtetimi [...]lëshuar nga Qendra e Përpunimit të Naftës Gorishtë.

Pala paditëse ka qenë e punësuar deri në datën 31.12.2010, pranë shoqërisë “Albpetrol” sh.a dhe nga data 01.01.2011 ka kaluar (transferuar) nga kjo shoqëri tek shoqëria “Stream Oil&Gas Ltd”, Dega Shqipëri [...]

Ka rezultuar i provuar fakti se, midis palëve të paditura në këtë gjykim, shoqëria “Albpetrol” sh.a dhe shoqërisë “Stream Oil&Gas” Ltd, [...] është lidhur marrëveshja hidrokarbure e datës 08.07.2007 «*Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Gorishtë-Kocul*», ku pala e paditur “Stream Oil & Gas” Ltd, [...] ushtron aktivitetin e saj. Kjo marrëveshje është miratuar me vendimin nr.509, datë 08.08.2007 të Këshillit të Ministrave, [...]

Në respektim të nenit 10 të Marrëveshjes Hidrokarbure, i padituri ka punësuar 331 punonjës të shoqërisë “Albpetrol” sh.a në vendburimin Gorishtë-Kocul, ndër të cilët, edhe paditësen [...]Me paditësen, marrëdhënia e punës ka filluar më datë 01.01.2011, dhe ka përfunduar në datën 22.01.2012 [...]

Në datën 4 Korrik 2011, pala e paditur, [...] ka filluar procedurat për pushimin kolektiv të 220 punonjësve në vendburimin Gorishtë-Kocul. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 148, pika 2 e KP [...] ajo ka njoftuar me shkresën nr. 302/11 prot., datë 04.07.2011, Sindikatën e [...], Ministrin e Punës, [...], si dhe disa autoritete të tjera të në fushën e hidrokarbureve si të interesuara për këtë proces. [...] pala e paditur [...], ka treguar arsyet e ndërmarrjes së pushimit kolektiv, ka përcaktuar saktë numrin e punëmarrësve që parashikoheshin të pushoheshin, ka përcaktuar saktë numrin e punëmarrësve të punësuar normalisht, kohën dhe periudhën gjatë së cilës do të shkarkohen këta punëmarrës, si dhe fazat e largimit të tyre. Po në këtë shkresë, pala e paditur ka ftuar organizatën sindikale të punëmarrësve për bisedime në funksion të arritjes së një marrëveshjeje. Ka rezultuar i provuar fakti se midis palës së paditur [...]nga njëra anë dhe Sindikatës [...] nga ana tjetër, është zhvilluar në datën 07.07.2011, takimi këshillimor për të diskutuar në lidhje me pushimin kolektiv të punonjësve në sektorin e naftës, [...] është mbajtur edhe procesverbali i datës 07.07.2011 [...] Në përfundim të këtij takimi është arritur marrëveshja, e cila është materializuar në shkresën e sjellë si provë “Akt-Marrëveshje” datë 07.07.2011, në të cilën, ndër të tjera, është rënë dakord që “*numri i përgjithshëm i punonjësve të kompanisë në vendburimin e Gorishtë-Kocul që do të reduktohet të jetë 200 punonjës*”. Në lidhje me shtrirjen në kohë të kësaj reforme, palët kanë rënë dakord që “*Reduktimi i numrit të punonjësve do të bëhet në dy faza. Në fazën e parë do të reduktohen 95-100 punonjës, ndërsa në fazën e dytë 100-105. Faza e parë do të fillojë me njoftimet paraprake më datë 15 korrik 2011, ndërsa faza e dytë do të fillojë 1 muaj më pas*”.

Sa më sipër, pala e paditur [...] nëpërmjet shkresës me nr.313/11, datë 11.07.2011 me “Njoftim mbi aktmarrëveshjen për pushimin kolektiv të punonjësve [...] ka njoftuar Ministrin [...] për arritjen e marrëveshjes rreth pushimit kolektiv nga puna. Kjo shkresë

rezulton të jetë dërguar për dijeni edhe Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorit të Albpetrol, Sindikatës së Lirë të Naftës Gorisht dhe Organizatës së Sindikatës së Pavarur të Naftës Patos.

Me shkresën nr.868/11 prot., datë 19.12.2011, pala e paditur [...] ka njoftuar palën paditëse se: *“...Kompania [...] në kuadër të ristrukturimit të dhe riorganizimit të personalitetit në vendburimin e saj Gorisht-Kocul, ka marrë vendimin që të reduktojë numrin e punonjësve të saj në këtë vendburim. Ju bëjmë të ditur se, në kuadrin e këtij procesi, kompania [...] ka vendosur të ndërpresë marrëdhëniet e punës me ju. Për sa më sipër, dhe bazuar në nenin 148 paragrafi 5 dhe 143 i KP, ju komunikojmë se marrëdhëniet e punës [...] do të ndërpriten në datën 22.01.2012, datë në të cilën do të bëhet edhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare. Bazuar në nenin 94 të KP, ju do të përfitoni vetëm pagën që ju takon për pushimet e pamarra gjatë kohës që keni punuar [...]*

Në rrethanat si më lart, paditësja [...], i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me padinë [...], duke pretenduar se zgjidhja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuar, pa respektuar afatin e njoftimit dhe procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës. Gjithashtu, pala paditëse ka pretenduar pagimin e dëmshpërblimeve që rrjedhin nga KP për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe shpërblimin për vjetërsi në punë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, [...] ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë. Detyrimin e të paditurit [...] të dëmshpërblejë paditësen [...] me 3 muaj pagë për mosrespektin të afatit të njoftimit; [...] me 16 muaj e 15 ditë pagë për shkak të vjetërsisë në punë; Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë. [...]

Gjykata e Apelit Vlorë, [...] ka vendosur ndryshimin e vendimit [...] dhe rrëzimin e padisë. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala paditëse në këtë gjykim, Servete Kobure përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC, të cilat, e bëjnë pjesërisht të cenusshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë. Kolegji çmon të theksojë se Gjykata e Apelit Vlorë e ka interpretuar drejtë mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, përse i takon ndryshimit të vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, edhe pse e ka trajtuar mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi si zgjidhje të kontratës kolektive të punës sipas përcaktimeve të nenit 148 të KP, i ka njohur palës paditëse dëmshpërblim për mosrespektim të afatit të njoftimit duke i njohur një dëmshpërblim në masën prej 3 muaj pagë.

Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit Vlorë ka ndryshuar vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, jo vetëm në pjesën ku ajo ka vendosur njohjen e dëmshpërblimit për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit në masën e 3 muajve pagë, por edhe për pjesën që kjo gjykatë i kishte njohur paditëses shpërblimin për vjetërsi në punë, duke zgjidhur çështjen në themel dhe duke vendosur përfundimisht rrëzimin e padisë.

Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Vlorë ka gabuar kur ka vendosur ndryshimin

e vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në pjesën që ajo ka njohur shpërblimin për vjetërsi në punë dhe e ka rrëzuar këtë kërkim, pasi në këtë mënyrë kjo gjykatë ka disponuar në kundërshtim me nenin 145 të KP. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë duhet të ndryshohet dhe çështja të zgjidhet në mënyrë përfundimtare nga Gjykata e Lartë, duke u pranuar padia vetëm në lidhje me kërkimin e përfitimit të shpërblimit për vjetërsi në punë, si dhe të rrëzohen të gjitha kërkimet e tjera të ngritura në padi. [..]

Bazuar në faktet e mësipërme, të dyja gjykatat më të ulëta kanë arritur në konkluzionin se jemi para rastit të zgjidhjes së kontratës kolektive të punës, referuar nenit 148 të KP. Më gjithatë, të dyja gjykatat kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm në lidhje me zgjidhjen e pasojave që rrjedh nga zgjidhja e kësaj marrëdhënie pune. [..]

Në rastin objekt shqyrtimi ndodhemi para pushimit kolektiv nga puna dhe për rrjedhojë, zgjidhja e efekteve të marrëdhënies së punës do të rregullohet nga parashikimet e e nenit 148 të KP i cili ka qenë në fuqi në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes, [..] Në analizë të dispozitës së mësipërme, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë shteruese tërësinë e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënies të punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësve në rastet kur punëdhënësi bën pushime kolektive nga puna. Këto kushte dhe kritere që ligjvënësi ka parashikuar në nenin 148 të KP, përbëjnë një garanci plotësuese për punëmarrësit për t'u mbrojtur nga pushimet kolektive nga puna. Për këtë arsye, procedura e caktuar në këtë dispozitë të KP është e detyrueshme për t'u zbatuar nga punëdhënësi, që parashikon të bëjë pushime kolektive nga puna.

Në të kundërt, nëse punëdhënësi nuk respekton procedurën e pushimit kolektiv nga puna sipas parashikimeve të pikave 1, 2, 3 dhe 4 të kësaj dispozite, ai ngarkohet me përgjegjësi civile, duke u detyruar të dëmshpërblejë punëmarrësit sipas parashikimeve të pikës 6. Pra, dëmshpërblimet e parashikuara në pikën 6 të nenit 148 të KP janë sanksione civile ndaj punëdhënësit që nuk ka respektuar procedurën e pushimit kolektiv nga puna. Kolegji e gjen me vend të parashitrojë faktin se, fryma e legjislacionit të punës e vë theksin tek parandalimet e largimeve nga puna, në kriteret ligjore që duhet të plotësohen nga ana e punëdhënëseve për të mos tejkaluar të drejtën e tyre për të ndërprerë marrëdhënien e punës dhe, për rastet e këtyre largimeve, sanksionon mbrojtjen ekonomike të punëmarrësve. Në këtë kuptim, pushimi kolektiv nga puna është një formë e përfundimit të marrëdhënies së punës, që kryhet nga ana e punëdhënësit në mënyrë të njëanshme dhe jo për shkaqe që kanë të bëjnë me punëmarrësin. Ai përfaqëson një rast të veçantë të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Duke ju rikthyer rastit konkret, Kolegji vlerëson se ndodhemi para rastit të pushimit kolektiv nga puna të palës paditëse dhe se ana e paditur i ka plotësuar të gjitha kërkesat që përcakton neni 148 i KP, duke mos lënë asnjë hapsirë për të konkluduar se kjo procedurë nuk është respektuar. Në ndryshim nga zgjidhja e kontratës individuale të punës, zgjidhja e kontratës kolektive nuk negociohet me vetë punëmarrësin në mënyrë të drejtpërdrejtë sikundër e ka pretenduar pala paditëse, por negociohet nëpërmjet Sindikatës së Naftës Patos si dhe me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, fakt i cili rezulton të provohet se është kryer. [..]

Në analizën që i bëhet kësaj akt-marrëveshje, rezulton se palët kanë përcaktuar të gjitha kushtet me të cilat do të bëhet shkurtimi i vendeve të punës pranë shoqërisë Stream Oil Gas Ltd. Albania Branch, e cila do të jetë deri në 200 punonjës, si dhe reduktimi i kësaj fuqie punëtore do të kryhet për periudhën kohore prej 6 muajsh. Gjithashtu, në këtë akt-marrëveshje palët kanë negociuar mes tyre edhe për shpërblimet që do të përfitojnë punonjësit që janë subjekte të ristrukturimit, të cilat do të jenë në përputhje me përcaktimet e nenit 143 dhe 148 të KP, si dhe rregullat që do të ndiqen për reduktimin e vendeve të punës, të cilat do të bëheshin në përputhje me këto kritere: (i) do të preferohet mbajtja në punë e punonjësve që kanë më shumë eksperiencë në punë; (ii) kanë treguar nivel të lartë profesional; si dhe (iii) performanca dhe serioziteti në punë që ka treguar punonjësi. Bazuar sa më sipër, Kolegji vlerëson se nga ana e palës së paditur janë respektuar kërkesat e nenit 148 të KP dhe se në këtë rast nuk qëndrojnë pretendimet e ngritura nga paditësit, të cilët kanë pretenduar se janë para zgjidhjes së menjëhershme dhe për shkaqe të paarsyeshme të marrëdhënies së punës.

Gjithashtu, Kolegji vlerëson të evidentojë faktin se pretendimet e ngritura nga paditësja, se në rastin konkret nuk janë respektuar afatet e njoftimit si dhe procedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës nuk qëndrojnë dhe nuk janë të mbështetura në ligj. Kjo për faktin se, zgjidhja e kontratës kolektive të punës nuk i njoftohet dhe nuk bisedohet në mënyrë individuale secilit punëmarrës, sikurse ndodh tek zgjidhja e kontratës individuale të punës, por diskutohet dhe bisedohet me sindikatën e punonjësve, e cila mbron në mënyrë të përgjithshme interesat e të gjithë punonjësve të prekur, si dhe garantohet me pjesëmarrjen në këto bisedime edhe të Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Për sa më sipër, [...] Kolegji arrin në konkluzionin se, kërkimet në padi që kanë lidhje me njohjen e dëmshpërblimeve që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të paarsyeshme, pa respektuar afatin dhe procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, janë të pabazuara në ligj dhe si të tilla duhet të rrëzohen. Në lidhje me kërkimin e pretenduar në padi nga na e palës paditëse, që ka lidhje me përfitimin e shpërblimit për vjetërsi në punë, Kolegji, në ndryshim nga Gjykata e Apelit Vlorë, vlerëson se ky është një kërkim i cili ka bazueshmëri në ligj dhe si i tillë, duhet pranuar.

Në nenin 145 të KP parashikohet [...] Në analizë të dispozitës ligjore të mësipërme, që një punëmarrës të përfitojë të drejtën e shpërblimit për vjetërsi në punë, duhet të plotësojë në mënyrë kumulative këto kushte: (i) të ketë një vjetërsi në punë pranë punëdhënësit prej jo me pak se 3 vitesh; (ii) punëmarrësi të mos largohet nga puna për shkaqe të arsyeshme ose të justifikuar.

Nga aktet e administruara në dosje, por edhe faktit të pranuar nga të dy gjykatat më të ulëta, rezulton se pala paditëse në këtë gjykim, ka një vjetërsi në punë pranë palëve të paditura prej 33 vite 3 muaj e 15 ditë. Pra, dukshëm paditësja rezulton të ketë një vjetërsi mbi 3 vjet pranë palëve të paditura, duke plotësuar kushtin e parë të vendosur nga ligjvënësi për përfitimin e shpërblimit për vjetërsi në punë. Gjithashtu, ka rezultuar i provuar fakti se paditësja në këtë gjykim nuk është larguar nga puna për shkaqe të

arsyeshme apo për shkaqe të justifikuara, por është larguar për shkak të zgjidhjes së kontratës kolektive të punës, si rezultat i ristrukturimit dhe organizimit të palës së paditur, shoqërisë Stream Oil Gas Ltd. [...] Në kushtet kur palët e paditura, nuk i kanë larguar punëmarrësit për faj të këtyre të fundit, duke mos u ndodhur para rasteve të përcaktuara nga neni 146 dhe 153 të KP paditësja në cilësinë e punëmarrëses ruan të drejtën që të përfitojë shpërblimin për vjetërsinë në punë, e cila, përfaqëson kontributin dhe vlerën e shtuar që punëmarrësi ka kontribuar për punëdhënësin gjatë kohës që ka punuar pranë tij. Për këtë arsye, Kolegji, vlerëson se ky kërkim duhet të pranohet si bazuar në ligj, duke detyruar palën e paditur në këtë gjykim shoqërinë [...], që ti paguajë palës paditëse shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 16 muajve e 15 ditë pagë, e cila përbën pagën e një 15 ditësi për 33 vite vjetërsi në punë.

[...] Kolegji arrin në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë duhet të ndryshohet dhe çështja të zgjidhet në themel të saj, duke vendosur pranimin e padisë në lidhje me kërkimin për pagimin e shpërblimit për vjetërsi në punë, duke detyruar palën e paditur [...] ti paguajë paditëses shpërblimin në masën e 16 muajve dhe 15 ditë pagë, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2022-946 (215), datë 06.06.2022

Në rastin e marrëdhënieve të punës që kanë zgjatur më shumë se 3 vjet, për të njëjtën natyrë pune, jo të përkohshme, të kryer nga punëmarrësi, përcaktimi i afatit gjatë vazhdimësisë së të mëtejshme të kontratës së punës punës do të përbënte një cenim të një prej elementëve thelbësor të kontratës së punës. Rrjedhimisht, për shkak të pavlefshmërisë të përcaktimit të afatit në një kontratë të tillë, kontrata e punës do të konsiderohej si kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

KCGJL Vendim Nr.00-2023-465(59), datë 15.02.2023 (Dëmshpërblim zgjidhje kontrate afat të caktuar/pacaktuar)

Fjalë kyçe: kontratë pune me afat, kontratë pune pa afat, zgjidhje kontrate, dëmshpërblim për zgjidhje kontrate, shpërblim për vjetërsi

Rrethanat e çështjes:

Paditësi M.L ka filluar punë pranë palës së paditur në datën 26 dhjetor 1997, fillimisht si revizor në Q.T.N.G. Patos dhe më tej në detyra të tjera. Në qershor 2009, paditësi ka fituar titullin “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, [...]

Në datën 01.08.2013, ndërmjet paditësit dhe palës së paditur është lidhur një kontratë individuale pune me afat dy vjeçar. Në këtë kontratë punëmarrësi (paditësi) caktohej të punonte si specialist në Drejtorinë e Auditimit, [...].

Me urdhrin [...] të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, u krye një auditim pranë Albpetrol SH.A., Patos, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2013, mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ligjshmërinë e veprimeve ekonomiko-financiare dhe ruajtjen e aseteve. [...]

Pas përfundimit të auditimit, me shkresën nr. 731/7 prot. datë 10.12.2013 [...] administratorit të shoqërisë Albpetrol SH.A. i është dërguar raporti final i auditimit dhe plani i veprimit, me detyrat e rekomandimet, ndërsa me shkresën nr. 731/9 prot. datë 10.12.2013, i janë njoftuar konstatimet dhe detyrat që i ngarkoheshin për zbatim.

Mbështetur në këtë shkresë të dytë [...] grupi i auditimit ka konstatuar [...] Mbështetur në këto rekomandime dhe konstatime, Administratori i shoqërisë Albpetrol SH.A, Patos, me shkresën nr. 198 prot. datë 09.01.2014, i ka drejtuar një relacion Këshillit Mbikëqyrës. [...] ku i kërkon ristrukturimin e plotë të Drejtorisë së Auditit të Albpetrol SH.A, duke konsideruar përgjegjës audituesit e brendshëm të shoqërisë për mosevidentimin apo trajtimin më parë të këtyre problematikave.

Me vendimin nr.10 datë 09.01.2014, Këshilli Mbikëqyrës [...] ka vendosur lirimin nga detyra të paditësit M.L. së bashku me audituesit e tjerë të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, [...]për shkak të mangësive serioze në komponentët e kontrollit të brendshëm, mosrealizimit të asnjë funksioni monitorues apo kontrollues dhe të një niveli të dobët profesional e analizues.

Me shkresën nr. 555 prot. datë 20.01.2014, paditësi është njoftuar për tu paraqitur pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore [...] më datë 24.01.2014, për të biseduar mbi shkëputjen e kontratës së punës. Në datën 24.01.2014, në ambientet e Drejtorisë [...] është mbajtur takimi në fjalë ku kanë marrë pjesë nga njëra anë, paditësi dhe nga ana tjetër, Drejtori i Burimeve Njerëzore [...]

Së fundi, me shkresën nr. 1124 prot., datë 30.01.2014, Administratori i Shoqërisë i ka komunikuar paditësit vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe ato financiare në datën 30.01.2014.

Mbështetur në rrethanat e faktit, [...] paditësi duke pretenduar se ndërmjet palëve ka ekzistuar fillimisht një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe duke filluar nga data 01.08.2013, me afat dy vjeçar, deri në datën 01.08.2015, e [...] i është drejtuar gjykatës me anën e një padie duke kërkuar dëmshpërblimet dhe shpërblimet përkatëse, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, [...] ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë; detyrimin e të paditurit t'i paguajë paditësit 18 paga mujore, të cilat do t'i kishte marrë deri në përfundim të kontratës së punës. [...] një dëmshpërblim në masën e 7 pagave mujore, si rrjedhojë e zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës. [...] një dëmshpërblim prej 2 muajsh pagë për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. [...] shpërblimin për vjetërsinë në punë në masën e 8 pagave mujore. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. [...]

Gjykata e Apelit Vlorë, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, çmon se në rekursin e paraqitur nga pala e paditur ekzistojnë shkaqet ligjore të

parashikuara në nenin 472 të KPC, të cilat e bëjnë të cenueshëm pjesërisht vendimin e gjykatës së apelit.

[..] Kolegji vlerëson se disponimi gjykatave të faktit në lidhje me detyrimin e të paditurit për t'i paguar paditësit 18 paga mujore, që i korrespondojnë masës së pagave që paditësi duhet të përfitonte deri në përfundim të afatit të kontratës së punës, sipas nenit 155/1 të KP, është rrejdhojë e cilësimit të gabuar të llojit të marrëdhënies së punës që ka ekzistuar midis palëve ndërgjyqëse në rastin konkret, bazuar në interpretimin jo të drejtë të dispozitave të KP që rregullojnë kontratën e punës me kohëzgjatje të pacaktuar. Në kuptim të nenit 16 të KPC, gjykata është e detyruar të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pavarësisht cilësimit të tyre nga palët ndërgjyqëse.

Në zbatim të këtij detyrimi procedural, gjykatat e faktit nuk mund të bazoheshin për cilësimin e llojit të marrëdhënies së punës në rastin konkret në vlerësimin e bërë nga pala paditëse me cilësinë e punëmarrësit në këtë marrëdhënie pune, në referim të kontratës së fundit me shkrim, me afat dy vjeçar, [..], por duhet të kishin mbajtur parasysh parashikimet ligjore në lidhje me kuptimin, kriteret dhe veçoritë dalluese që përcaktojnë një kontratë pune, si me kohëzgjatje të caktuar apo të pacaktuar.

Neni 140 i KP në lidhje me kuptimin dhe kriteret ligjore që dallojnë një kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar nga ajo me kohëzgjatje të përcaktuar, parashikon [..] Kjo dispozitë përcakton rregullin e përgjithshëm se kontrata e punës lidhet me kohëzgjatje të pacaktuar dhe si përjashtim nga ky rregull, lidhja e kontratës me kohëzgjatje të caktuar është e lejueshme vetëm kur justifikohet nga ekzistenca e arsyeve objektive që lidhen me natyrën e përkohshme të punës konkrete që do të kryhet nga punëmarrësi.

Kohëzgjatja e kontratës të punës në rastin e kontratave me afat të caktuar përbën një element thelbësor të kontratës në kuptim të nenit 21/3 të KP, që si i tillë duhet të përcaktohet që në fillim të marrëdhënies së punës duke e justifikuar një kufizim të tillë me natyrën e përkohshme të punës të marrë përsipër për tu kryer nga punëmarrësi. Rrjedhimisht në rastin e një marrëdhënie pune që ka qenë e përcaktuar që në fillim me kohëzgjatje të pacaktuar, punëdhënësi nuk mund të ndryshojë këtë element thelbësor të kontratës për të njëjtën natyrë pune.

Për të garantuar në një shkallë më të lartë mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësit, si pala më e dobët në këtë marrëdhënie kontraktore, nga veprimet e punëdhënësit që synojnë shmangien nga zbatimi të rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 140/2 i KP apo të çënojnë këtë element thelbësor në kontratat e punës që kanë zgjatur për më shumë se 3 vjet, ligjvënësi në nenin 151/1 të KP ka parashikuar se, kur midis palëve kanë qenë të lidhura disa kontrata të njëpasnjëshme por jo më pak se tre vjet, moripërtëritja e kontratës së fundit nga punëdhënësi vlerësohet si zgjidhje e kontratës me afat të pacaktuar.

Mbi bazën e interpretimit teleologjik dhe sistematik të neneve 140/2 dhe 151/1 të KP, Kolegji arrin në përfundimin se në rastin e marrëdhënieve të punës që kanë zgjatur më shumë se 3 vjet, për të njëjtën natyrë pune, jo të përkohshme, të kryer nga punëmarrësi, përcaktimi i afatit gjatë vazhdimësisë së të mëtejshme të kontratës së punës punës do të

përbënte një cenim të një prej elementëve thelbësor të kontratës së punës. Rrjedhimisht, për shkak të pavlefshmërisë të përcaktimit të afatit në një kontratë të tillë, kontrata e punës do të konsiderohej si kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

Kolegji për efekt të diferencimit në trajtim të pasojave që burojnë nga zgjidhja e kontratës së punës pa afat dhe asaj me afat, çmon të nevojshme të theksojë se kontrata e punës me afat të caktuar ka një regjim juridik të posaçëm (neni 149-152 i KP), të ndryshëm nga kontrata e punës me afat të pacaktuar dhe, për këtë arsye, nuk mund të rregullohet zgjidhja e menjëhershme e kontratës me afat, në të njëjtën mënyrë, ashtu si zgjidhja e kontratës pa afat. Në kontratën me afat të pacaktuar, kuptimin e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës e jep ligji, konkretisht neni 143/3 i KP. Në këtë dispozitë parashikohet se, kur njëra nga palët zgjidh kontratën e punës me afat të pacaktuar, pa respektuar afatin e njoftimit, ndërprerja e marrëdhënies së punës trajtohet si zgjidhje me efekt të menjëhershëm. Ndryshe nga kontrata e punës me afat të pacaktuar, ku afati i njoftimit për zgjidhje të kontratës përcaktohet nga ligji, në rastin e kontratës së punës me afat të caktuar është vullneti kontraktor, ai që përcakton kohëzgjatjen e marrëdhënies juridike të punës.

Në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat, para përfundimit të afatit kontraktor, punëmarrësit i lind e drejta të kërkojë pagën deri në përfundim të afatit kontraktor sipas paragrafit të parë të nenit 155 të KP, ndërsa në rastin e zgjidhjes së kontratës pa afat, pa respektuar afatin e njoftimit të parashikuar nga neni 143/3 i KP, punëmarrësit i lind e drejta në bazë të të njëjtit paragraf të kërkojë pagën korresponduese të afatit të njoftimit, në qoftë se shkak i zgjidhjes së kontratës është i pajustificuar.

Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim rezulton se marrëdhënia e punës e paditësit pranë të paditurit ka filluar që më datë 26.12.1997, dhe se në datë 01.08.2013 kur është lidhur kontrata individuale me shkrim, me afat 2 vjeçar, marrëdhënia e punës kishte zgjatur për 16 vjet pa ndërprerje duke u kryer nga paditësi detyra nga më të ndryshmet, të cilat kurrsesi nuk mund të konsiderohen si me natyrë të përkohshme duke u mjaftuar vetëm në rrethanën e kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënie pune. Në kontratën e datës 01.08.2013, nuk rezulton të jenë përcaktuar kriteret përjashtimore që kanë çuar punëdhënësin në përcaktimin e afatit 2 vjeçar për zgjatjen e saj. Rrjedhimisht, caktimi i afatit të kësaj kontrate, në datë 01.08.2013, në kushtet kur nuk nuk justifikohet nga arsye objektive, dhe për më tepër në kushtet e një vazhdimësie të mëparshme 16 vjeçare, në zbatim të drejtë të neneve 140/2 dhe 151/1 të KP, do të konsiderohet i pavlefshëm, dhe në të tilla kushte kontrata e punës do të cilësohet me kohëzgjatje të pacaktuar.

Në kushtet kur kontrata e punës ka qenë me kohëzgjatje të pacaktuar, paditësi nuk mund të përfitojë një dëmshpërblim të barabartë me pagën që do të kishte fituar në përfundim të kontratës me afat të caktuar sipas nenit 155/1 të KP. Për këto arsye, vendimi i gjykatave të faktit në lidhje me këtë kërkim në objektin e padisë është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material, dhe në të tilla kushte Kolegji arrin në përfundimin se, për sa kohë që zbatimi i ligjit material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrimin apo rivlerësimin e fakteve apo provave të çështjes, atëherë në referim të nenit 485, shkronja “dh” të KPC, është vendi për të disponuar për ndryshimin e vendimeve dhe për rrëzimin

e padisë në raport me këtë kërkim.

Zgjidhja e kontrates së punës është shprehje e vullnetit të njëjës palë në mënyrë të njëanshme dhe e detyrueshme për njoftim palës tjetër, duke respektuar formen dhe afate të caktuara për njoftim. Mbi bazën e interpretimit sistematik dhe teleologjik të neneve 141, 143 dhe 144 të KP konstatohet se ligjvënësi ka parashikuar dy mënyra për zgjidhjen e kontratës së punës: i) mënyra normale apo e zakonshme, në respektim të afatit dhe procedurës së përcaktuar shprehimisht në ligj, ii) mënyra e jashtëzakonshme, që ndryshe quhet zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm që konstatohet atëherë kur nuk respektohen afatet e njoftimit, të parashikuara nga ligji ose mbi bazën e vullnetit të përbashkët të palëve të shfaqur në kontratën individuale ose kolektive të punës.

Sipas nenit 143, pika 4 të KP, zgjidhja e kontratës pa respektuar afatin e njoftimit trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm. Në parim palët duhet të respektojnë afatet e njoftimit dhe zgjidhja e menjëhershme e kontratës është e ndaluar, me përjashtim të rastit kur ajo ndodh për shkaqe të justifikuar sipas kuptimit që përcaktohet për këto shkaqe nga neni 153 i KP. Në rastin e zgjidhjes së menjëhershme për shkaqe të justifikuar, pala që ka zgjidhur kontratën nuk ndëshkohet, pavarësisht mosrespektimit të afatit. Në rastin konkret, në referim të kohëzgjatjes të marrëdhënies së punës, afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës ishte 3 muaj dhe ky afat nuk është respektuar nga punëdhënësi pasi marrëdhëniet e punës dhe ato financiare janë ndërprerë në mënyrë të menjëhershme më datë 30.01.2014 kur është vendosur zgjidhur zgjidhja e kontratës së punës. Në lidhje me shkakun e zgjidhjes së kontratës së punës, Kolegji vlerëson e gjykatat e faktit i kanë kthyer përgjigje shtruese pretendimeve të palës së paditur të ngritura në rekurs duke i konsideruar si të pajustificuara, në interpretim të drejtë të nenit 153 të KP, shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës me paditësin në rastin konkret. Për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, punëmarrësit i lind e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin për mosrespektimin e afatit të njoftimit sipas nenit 155/1 të KP, që në këtë rast ka qenë 3 muaj, si dhe një dëmshpërblim, me karakter ndëshkues dhe ndreqës për dëmin moral, për punëdhënësin deri në 1 vit pagë, sipas nenit 155/3 të KP.

Për kërkimin e paditësit për dëmshpërblimin me 3 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës, sipas nenit 155/1 të KP, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur për rrëzimin e padisë dhe paditësi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit. Rjedhimisht pretendimet në lidhje me këtë dëmshpërblim, në kuptim të nenit 459 të KPC, duhet të konsiderohen si të rëna në dekadencë.

Nga ana tjetër, disponimi për pranimin e padisë në lidhje me kërkimin për dëmshpërblimin për zgjidhje të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuar të kontratës së punës, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të nenit 155/3 të KP dhe si i tillë vlerësohet nga ky Kolegj se duhet të lihet në fuqi.

Në zbatim të drejtë të dispozitave materiale, neneve 144/5 dhe 145 të KP vlerësohen prej këtij Kolegji dhe disponimet e gjykatave të faktit për pranimin e kërtimeve, për sa i përket detyrimit të të paditurit për të dëmshpërblyer paditësin me 2 muaj pagë për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe për ta shpërblyer

me 8 paga mujore për vjetërsinë në punë. [..]

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2022-4342(496), datë 23.11.2022

KCGJL Vendim Nr.00-2023-1832(287), datë 11.05.2023 (Afat njoftimi)

Për respektimin e afateve të njoftimit, gjykata duhet të marrë në analizë shkaqet e zgjidhjes së kontratës, të sqarojë natyrën e mosmarrëveshjes, e më pas të shprehet për masën e dëmshpërblimit. Mosrespektimi i afatit të njoftimit, sipas nenit 143 të K.Punës, përcakton nëse kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur menjëherë apo jo. Gjatë afatit të njoftimit marrëdhënia e punës vijon. Pagesa gjatë afateve të njoftimit nuk mund të interpretohet si mosrespektim i afateve të njoftimit, pasi shërben si një standard i shtuar në ndihmë të të drejtave të punëmarrësit

Fjalë kyçe: kontratë pune pa afat, zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës, afat njoftimi

Rrethanat e çështjes:

Ka rezultuar e provuar gjatë gjykimit se më datë 01.04.2013, ndërmjet paditësit B.B. dhe palës së paditur Shoqëria “CEZ Shpërndarje” sha [..] është lidhur kontrata e punës [..] Detyra e përcaktuar në kontratë për paditësin në cilësinë e punëmarrësit është “Shef grupi pranë Drejtorisë Rajonale Durrës/Njësia Durrës/Spektori i Faturimit dhe Arkëtimeve/Arkëtimi”.

Kontrata është lidhur për një afat të pakufizuar kohe, ku tre muajt e parë të punësimit konsiderohen kohë prove. [..]

Me shkresën nr.14292 prot., datë 27.08.2013 të palës së paditur, është bërë ndryshimi i pozicionit të paditësit, duke kaluar në “Shef grupi (task forcë)”, kategoria B 1/1 [..]. Rezulton e provuar se, me shkresën 21874/2 prot., datë 07.11.2013 të palës së paditur njoftohet fillimi i procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës. Në këtë shkresë në vendin ku shënohet firma e punëmarrësit në shkresë rezulton se është vendosur shënimi “Refuzoi firmën”.

Po kështu, me vendimin nr. 259, datë 15.11.2013 “Për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënieve të punës”, paditësi njoftohet për përfundimin e marrëdhënies së punës me palën e paditur dhe se në bazë të përcaktimeve të nenit 143 dhe 154/4 të KP ai do të përfitojë një muaj pagë që i korrespondon afatit të njoftimit si dhe pagën për pushimet vjetore të pamarra. Në këtë vendim është vënë shënimi “refuzoj firmën”. [..] është urdhëruar përfundimi i kontratës së punës për paditësin pa përmendur asnjë shkak.

Ndodhur para kësaj situatë juridike, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me padi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, [..] ka vendosur konstatimin e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes. Dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. [..]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, [...] ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë të [...] Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit shumën prej 2 paga mujore si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurës së largimit nga puna. [...] shumën prej 3 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të kërkkimeve si [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, objektit dhe shkakut të padisë, pretendimeve e prapësimeve të palëve, vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe shkaqeve të rekursit, Kolegji çmon se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është rrjedhojë e respektimit të gabuar të kërkesave të ligjit material, konkretisht nenit 155 dhe 143 të KP.

[...] Gjykatat e faktit, pasi kanë shqyrtuar mosmarrëveshjen objekt gjykimi, kanë vlerësuar se **“zgjidhja e kontratës së punës pa afat”, në kushtet kur nuk përlligjet nga ekzistenca e një shkakut të justifikuar, ngarkon punëdhënësin me detyrimin e dëmshpërblimit me pagën 3 muaj, sipas nenit 155/1/3 të KP, si dhe me dëmshpërblim, për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.**

[...] Marrëdhënia e punës krijohet bazuar në vullnetin e plotë e të pavesuar të palëve kontraktuese. Ndërsa zgjidhja e saj është shprehje e vullnetit të njëres palë në mënyrë të njëanshme, e detyrueshme për njoftim palës tjetër, duke respektuar procedurën dhe afatet që implikon KP, në këtë rast kemi të bëjmë me zgjidhje normale të marrëdhënies së punës. Në raste të jashtëzakonshme dhe për shkaqe të justifikuara në kuptim të nenit 153 të po këtij kodi, zgjidhja e kontratës së punës konsiderohet me efekt të menjëhershëm, në mungesë të respektimit të afatit të njoftimit dhe procedurës.

Kolegji vëren se procedura që parashikon KP konsiston në njoftimin me shkrim të punëmarrësit të paktën 72 orë para takimit të parë, me të cilin ky i fundit merr dijeni për datën dhe orën e tij. Ky parashikim ligjor është në favor të punëmarrësit për të pasur ky mundësi të njihet me arsyet se përse punëdhënësi kërkon të zgjidhë kontratën e punës dhe mbi të gjitha për të paraqitur pretendimet e tij. Më pas njoftimi për zgjidhjen e kontratës duhet të bëhet me shkrim brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit të parë. Në njoftimin me shkrim punëdhënësi duhet të përcaktojë arsyet e zgjidhjes së kontratës të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose me kërkesat operacionela të ndërmarrjes. Barra e provës për të vërtetuar se kjo procedurë është respektuar i takon punëdhënësit.

Ndërsa afati i njoftimit që duhet të respektojë punëdhënësi përpara se t'i komunikojë punëmarrësit zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës përcaktohet referuar viteve të punës sipas parashikimeve të nenit 143 të KP. Duke ju rikthyer mosmarrëveshjes objekt gjykimi Kolegji duke ju referuar provave të marra e analizuara nga gjykatat e faktit, çmon se pala e paditur, në cilësinë e punëdhënësit nuk ka respektuar procedurën në zgjidhjen e marrëdhënies së punës, ndaj me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe ajo e apelit i ka akorduar palës paditëse të drejtën e dëmshpërblimit me dy muaj pagë.

Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se në padinë në gjykim, çështja që shtrohet për zgjidhje lidhet me respektimin ose jo nga punëdhënësi, i padituri [...], të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës më paditësen, referuar kjo nenit 143 të KP. Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i paarsyetuar qartë dhe ajo gjykatë nuk ka arritur të sqarojë drejtë natyrën ligjore të mosmarrëveshjes në gjykim. Kështu, qartësisht, gjykata e apelit del në përfundimin se zgjidhja e kontratës së punës është e menjëhershme, duke ju referuar mosvërtetimit të shkaqeve të parashikuara në nenin 153 të KP, (*shkelja e detyrimeve me faj të rëndë; me faj të lehtë por në mënyrë të përsëritur...*).

Ndërkohë, të menjëherëshme ose jo, zgjidhjen e kontratës së punës e bën respektimi ose jo i nenit 143 të KP, afatit të njoftimit për zgjidhjen e kësaj kontrate. Neni 141 i KP, përcakton [...], ndërkohë që këto afate, në varësi të kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënie, përcaktohen në nenin 143 të KP.

Vetëm pasi në analizë të sa më sipër, gjykata do të kishte arritur në përfundimin se zgjidhja e kontratës ishte e menjëherëshme, do të mund të analizonte shkaqet e zgjidhjes sipas nenit 153 të KP, e më pas të vlerësonte masën e dëmshpërblimit, referuar nenit 155 të këtij kodi. Në rrethanat si më lart, gjykata pas vërtetimit të faktit se paditësi i kishte përfituar pagat mujore pikërisht si afat njoftimi, në respektim të nenit 143, ka gjetur një zgjidhje të gabuar që ndërsa këto paga, këtë kërkim të ja rrëzojë paditësit, vazhdon ta konsiderojë njëkohësisht “zgjidhjen e kontratës së punës të menjëhershme”, në fakt pa ndonjë arsyetim. Kolegji vlerëson se në konfliktin objekt gjykimi, çështje që shtrohet për zgjidhje, është nese pagesa e pagave punëmarrësit për afatin e njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës sipas nenit 143 të KP, por njëkohësisht vullneti i punëdhënësit për ta ndërprerë marrëdhënien e punës përpara përfundimit kohor të këtij afati, duke mos i kërkuar punëmarrësit të kryejë punën gjatë këtij afati për të cilin paguhet, do të konsiderohet ose jo si respektim i nenit 143 të KP. Duke vlerësuar se edhe në këtë rast afati i njoftimit duhet të konsiderohet i respektuar, vlerësohet se për këtë analizë është e nevojshme shqyrtimi i një marrëdhënie pune në tërësinë e saj.

Neni 12 i KP, duke dhene perkufizimin e “Kontratës së Punës”, parashikon se [...] Referuar kesaj dispozite, te konsiderosh qe pagimi i pagës gjatë afatit te njoftimit, pa i kerkuar punemarresit te kryejë punen për pagën që po përfiton është shkelje e të drejtave të tij, do të thotë të pranosh se punëmarrësit i është shkelur e drejta “*të marrë urdhëra nga punëdhënësi dhe detyrimi ti zbatojë ato*”, dhe kjo për faktin se vetë punëdhënësi gjatë kësaj periudhe, nuk ka vlerësuar ti japë atij asnjë urdher.

Kolegji vlerëson se është e vërtetë se gjatë afatit të njoftimit marrëdhënia e punës, duhet të konsiderohet se vijon, por nga ana tjetër, rezulton që për punëmarrësin, tej të drejtave për të marrë pagën, pushimet, për të mos qënë i diskriminuar, për të qënë i lirë të organizohet në sindikata etj, të drejta që nuk lidhen me afatin e njoftimit, të drejtat dhe detyrimet e tjera në kontratës së punës përcaktohen në nenet 23, 25, 26, 27 e 28, të KP, dispozita që rregullojnë “*detyrimi i punemarresit për bindje, për kujdes në punë, për dhënie llogari, për besnikëri, si dhe përgjegjësia e tij për shkeljen e këtyre detyrimeve*”, detyrime këto, që vlerësohen se nuk mund të konsiderohen si çënim i së drejtës së tij,

duke e paguar gjatë periudhës së afatit të njoftimit, pa i kërkuar respektimin e tyre.

Referuar sa më sipër, dhe duke mbajtur në konsideratë se respektimi nga punëdhënësi i një afati njoftimi për zgjidhjen e kontratës së punës, ka për qëllim thelbësor mbrojtjen e palës së dobët në këtë kontratë, punëmarrësit, duke i krijuar atij kushte kryesisht të përshtatet me këtë situatë dhe veçanërisht të interesohet për një stabilizim në një tjetër marrëdhënie pune, punëdhënësi duke i krijuar kushte të punojë me orar të reduktuar, apo të mos e ofrojë fare shërbimin e tij, ndërkohë që përfiton pagën për këtë afat, jo vetëm nuk cenon ndonjë të drejtë të punëmarrësit, por ka vendosur vullnetarisht një standard të shtuar në ndihmë të tij dhe në këto kushte nuk mund të interpretohet si mos respektim i këtij afati njoftimi.

Për sa më lart, vlerësohet se zgjidhja e kontratës së punës mes paditësit [...]dhe të paditurit [...]nuk është një zgjidhje e menjëherëshme e kontratës së punës, përfundim ky që ndryshon dhe zgjidhjen në themel të konfliktit objekt gjykimi.

Kështu, referuar nenit 141 të KP, unifikimi i praktikës gjyqësore lidhur me zgjidhjen e kontrates se punes pa afat ne zbatim te nenit 141 te KP eshte bërë me vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.19, dt.15.11.2007. [...] referuar këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara te Gjykatës se Lartë, [...] kanë dalë në përfundimin se : *“në kontratat me afat të pacaktuar, respektimi i neneve 141, 143,144 e 145 të KP, nga punëdhënësi, si rregull passjell përfundimin në mënyrë të natyreshme të kontratës së punës dhe respektimin e të gjitha të drejtave të punëmarrësit”.*

Nisur nga analiza dhe interpretimi i mësipërm i dispozitave ligjore, referuar rastit në shqyrtim, Kolegji konkludon se vendimmarrja e gjykatave të faktit, të cilat kanë vlerësuar dhënien e dëmshpërblimeve kumulative (sipas nenit 155/1, 143/1 dhe 144/5 të KP), është e papajtueshme me neni 155 dhe 141 të KP.

Për sa u parashtrua më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, ashtu edhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material, sa i përket dëmshpërblimeve të dhëna ndaj paditësit dhe për rrjedhojë, duhet të ndryshohen, duke vendosur: Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin me 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2022-1793(301), datë 20.07.2022

VII. Mosmarrëveshje e Drejta e Pronës

KCGJL Vendim Nr.00-2021-1857, datë 15.11.2021 (Vlerësim financiar/ATP)

Në rastet kur referuar shkakut i padisë dhe qëllimi final i paditësit, është që nëpërmjet gjykatës të ndryshojë vlerësimin financiar të realizuar fillimisht nga ATP në lidhje me vendimet e të ish-KKKP, atëhere kompetente nga pikëpamja lëndore/funksionale për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje është Gjykata Administrative e Apelit

Fjalë kyçe: korigjim gabimesh materiale, KKKP, vlerësim financiar, ATP

Rrethanat e çështjes:

Paditësi pretendon se është trashëgimtar ligjor i subjektit të shpronësuar M.N. Ai ka pretenduar se me vendimin nr.234, datë 14.12.1995, të ish-KKKP, Berat, është vendosur ti njihet pronësia trashëgimtarëve të ish-pronarit, M.N. për një pasuri të llojit truall dhe tokë bujqësore. Në këtë vendim, meqenëse trualli ka rezultuar i zënë, është vendosur kompensimi me letra me vlerë për sipërfaqen 13.700 m²x320lek/m², në vlerën totale 4.304.000 lekë, ndërsa pjesa e mbetur sipas këtij vendimi do të trajtohet si tokë bujqësore. Në vijim, paditësi ka pretenduar se me vendimin nr.86, datë 30.8.1996, të ish-KKKP, Berat, është vendosur se toka bujqësore me sipërfaqe 501 dynym do të kompensohet me letra me vlerë, për trashëgimtarët e ish-pronarit M.N.

Konkretisht për sipërfaqen 150.000 m², tokë bujqësore është vendosur kompensimi në letra me vlerë në vlerën 4.200.000 lekë, për sipërfaqen 33.700 m² është vendosur kompensimi në vlerën 1.044.700 lekë, në total në vlerën 5.244.700 lekë. Për pjesën tjetër është vendosur të kompensohet me tokë në bregdet.

[..]paditësi i është drejtuar ATP-së me kërkesë për rivlerësimin financiar të këtyre vendimeve, dhe ATP, ka realizuar atë duke e publikuar edhe në faqen e saj zyrtare dhe në Buletinin përkatës të njoftimeve zyrtare.

Duke mos qenë dakord me vlerën, paditësi i është drejtuar sërish ATP-së, me pretendimin se ka një gabim në përlllogaritje, pasi ka mbetur edhe një sipërfaqe prone pa u kompensuar. Konkretisht paditësi ka pretenduar se nga 501.000 m², është kompensuar sipërfaqja 150.000 m² + 13.700 m²= 163.700 m². Nga sipërfaqja totale ka mbetur dhe 337.300 m² pa u kompensuar, ndërkohë llogaritjet janë bërë për një sipërfaqe 33.700 m².

Me shkresën nr.2201/1 Prot, datë 05.11.2020, ATP, i ka kthyer përgjigje paditësit, se nga verifikimet e kryera nuk rezulton të ketë patur gabime në përlllogaritje dhe e ka orientuar paditësin ti drejtohet Gjykatës Administrative të Apelit. [..]ATP, [..]**është shprehur se përlllogaritja është bazuar vetëm tek sipërfaqet e kompensuar financiarisht sipas vendimeve të sipërcituara, ku vlera e kompensimit e përcaktuar në to është indeksuar.** [..] prona e njohur, por e pa trajtuar me të drejtë kompensimi nuk përfshihet në përlllogaritjen e vlerësimit financiar.

Në vijim, paditësi ka pretenduar se në fakt ky gabim në përlllogaritje e ka burimin nga vendimin nr. 86, datë 30.8.1996, të ish-KKKP, Berat, ku është përlllogaritur gabim sipërfaqja që do të duhet të ishte kompensuar. Si rrjedhojë e kësaj mosmarrëveshjeje, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me padi [..] duke referuar tek neni 16/3 i Ligjit nr. 133/2015, sipas të cilit, me kërkesë të subjektit ATP mund të bëjë edhe korigjimin e të metave teknike dhe hartografike apo gabimet materiale të dukshme në vendimet administrative, pa prekur përmbajtjen. Paditësi ka pretenduar se ka qënë detyrim i palës së paditur të rregullonte këto të meta në kuadër të procesit të rivlerësimit financiar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë [..] ka vendosur deklarinimin e mos-

kompetencës lëndore për shqyrtimin gjyqësor; dërgimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, si gjykata kompetente; [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur të parashtrijë qëndrimin e saj para Gjykatës së Lartë për rregullimin e kompetencës lëndore. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje, pasi analizoi objektin dhe shkakun ligjor të padisë dhe vendimet e gjykatave në mosmarrëveshje për kompetencën lëndore, në zbatim të KPC dhe dispozitave të Ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” çmon se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë nuk ka kualifikuar drejtë natyrën e mosmarrëveshjes.

Kolegji vlerëson se Ligji nr. 133/2015, pati si qëllim përfundimin efektivisht të procesit të trajtimit të pronës nëpërmjet njohjes dhe kompensimit të saj brenda një afati të arsyeshëm (Shiko Vendimin nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

Për këto arsye me këtë ligj u krijua një organ i vetëm, person juridik publik, vendimmarrës, konkretisht ATP, të cilës i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e AKKP dhe e cila do të trajtojë përfundimisht kërkesat e ish-pronarëve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës. Me qëllim përfundimin brenda një afati të arsyeshëm të procesit kthimit të pronave, Ligjvënësi në nenet 19 dhe 29, ka parashikuar vetëm një shkallë ankimi gjyqësor nga pikëpamja e faktit dhe e ligjit, konkretisht gjykatën e apelit.

Pra, sipas këtij Ligji gjykata e apelit ushtron juridiksion fillestar, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve midis subjekteve që pretendojnë se janë ish-pronarë dhe ATP, ku objekt i mosmarrëveshjes është vendimmarrja e këtij organi në lidhje me të drejtat e tyre për kthimin apo kompensimin e pronës.

Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se padia e paraqitur para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ka tre kërtime:

- kundërshtim i shkresës nr. 2201/1 Prot, datë 05.11.2020 të ATP me të cilën i është kthyer përgjigje paditësit se në vlerësimin financiar të realizuar prej saj nuk ka patur gabime materiale në përlllogaritje; • korrigjim gabimi material të vendimit nr. 86, datë 30.08.1996 të KKKP Berat, sa i takon sipërfaqes së përlllogaritur nga Komisioni; për rrjedhojë • korrigjimin e shumës së përcaktuar nga pala e paditur.

Shkaku i padisë është se nga gabimi material në përlllogaritjet e sipërfaqeve të kompensuara, në raport me sipërfaqen totale të njohur për kompensim, sipas vendimit të sipërcituar, nga pala e paditur është përcaktuar një vlerë financiare më e ulët e pronës.

Sipas paditësit, kjo ka ardhur edhe për shkak të veprimtarisë së paligjshme të ATP-së, e cila sipas nenit 16/3 të Ligjit nr. 133/2015, në rrugë administrative mund të korrigjojë gabimet materiale të vendimeve të ish-KKKP-ve, pa ndërhyrë në përmbajtjen e tyre, në kuadër të procesit të vlerësimit financiar të këtyre vendimeve.

Kolegji vlerëson se, bazuar në nenin 5 të KPC, pavarësisht mënyrës së formulimit të kërimit përfundimtar të paditësit, objekti i padisë përcaktohet duke e lexuar në tërësi tekstin e padisë dhe duke e vlerësuar në përputhje me pretendimet e palëve

dhe qëllimit që synon të arrijë paditësi duke investuar gjykatën. Referuar shkakut dhe objektit të padisë, në rastin konkret, qëllimi final i paditësit, është që nëpërmjet gjykatës të ndryshojë vlerësimin financiar të realizuar fillimisht nga ATP në lidhje me vendimet e sipërcituara të ish-KKKP, Berat.

Në këtë rast, nuk ka një konflikt midis ish-pronarit dhe ATP, përse i përket njohjes të së drejtës. Me vendimin nr. 86/1996 të ish-KKKP, Berat, paditësit i është njohur për kompensim një sipërfaqe 501 dynym, por në konflikt është kompensimi financiar në lekë, që sipas paditësit është bërë vetëm për një pjesë të sipërfaqes.

E drejta e pronësisë njohur në këtë vendim, nuk është kundërshtuar nga paditësi dhe as nuk mund të rishikohet apo kundërshtohet nga pala e paditur. Objekt hetimi dhe shqyrtimi nga gjykata do të jetë vetëm veprimtaria e ATP, në vlerësimin financiar të vendimit nr. 86/1996 të ish-KKKP, Berat; fakti nëse ka patur një përlllogaritje të gabuar matematikore nga ish-KKKP, Berat, në sipërfaqen e kompensuar, nga sipërfaqja tërësore e njohur për kompensim 501 dynym; nëse ka patur detyrim nga ATP për të korrigjuar këtë gabim të pretenduar prej tij, në rrugë administrative në funksion të vlerësimit financiar; nëse ka ndikuar ky gabim në vendimin e marrë nga ATP, për vlerësimin financiar të pronës etj. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se për individualizmin e gjykatës kompetente në rastin konkret, gjen zbatim neni 19 i Ligjit nr. 133/2015, [...] Sipas kësaj dispozite, Kolegji konkludon se kompetente nga pikëpamja lëndore/funksionale për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje është Gjykata Administrative e Apelit.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKAGJL Nr.00-2022-326(71), datë 24.02.2022

KCGJL Vendim Nr.00-2022-4480(578), datë 21.12.2022 (Vendim KKKP: e drejta parablerjes)

Gjatë gjyqimit të një vendimi të KKKP, duhet të hetohet, ndër të tjera, edhe e drejta e parablerjes, që përfitohet nga subjekti nëse plotësohen këto aspekte: së pari, ish-pronarit t'i ishte njohur e drejta e pronësisë në përputhje me ligjin; së dyti, pasuritë e paluajtshme të ish-in të zëna me objekte shtetërore që nuk ushtrojnë funksionet e tyre publike; së treti, shteti ka vendosur t'i privatizojë ato.

Fjalë kyçe: e drejta e parablerjes, vendim KKKP

Rrethanat e çështjes:

Rezultoni se, ish KKKP Korçë, me vendimin nr. 505, datë 19.09.1994 ndër të tjera ka vendosur: *“Të miratojë (konfirmojë) të drejtën e pronësisë së ish pronarit S.B., me trashëgimtarë [...] që trashëgojnë nga ¼ pjesë secili për njohjen e pronës së ndodhur në Sallahana të Korçës, [...]me kushtet e mëposhtme: A-Ju njihet pronësia për një sipërfaqe 11 000 m2. B-Ju lind e drejta e parablerjes për objektet e ndërtuara nga shteti në sipërfaqen 5 000 m2. C-Ju kompensohet me letër me vlerë sipërfaqja 6 000 m2.”.*

Vendimi i sipërcituar është ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila me vendimin nr. 2202, datë 24.11.2003 ka vendosur: “Pranimin e padisë dhe shtesës së objektit të saj, të paditësit P.B., i paditur KKKP pranë Bashkia Korçë, UMB-Korçë, duke e ndryshuar vendimin e Komisionit nr. 505, datë 19.9.1994, pika 1/b dhe c, si më poshtë: 1.Trashëgimtarëve të ish pronarit S.B u kthehet një sipërfaqe trualli e lirë prej 409 m2[...] dhe një sipërfaqe tjetër e lirë prej 502 m2, [...], duke mbetur e drejta e parablerjes për diferencën e sipërfaqes prej 2915.2 m2, të ndodhura brenda territorit të UMB-së. Trashëgimtarët e ish pronarit kompensohen me një nga mënyrat që parashikon ligji për sipërfaqen 6000 m2. ...”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 37, datë 26.2.2004. [...]

Rezulton se AKKP pasi ka shqyrtuar kërkesën e ish pronarëve për rishikimin e vendimit të KKKP nr. 505, datë 19.09.1994, i ka orientuar kërkuesit për t’ju drejtuar gjykatës pasi mungonte kuadri ligjor në kushtet e shfuqizimit të dispozitave të ligjit “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave” që i jepnin Agjencisë të drejtën e rishikimit të vendimeve të Komisioneve të Zyrave Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Të paditurit [...] janë trashëgimtarë ligjorë të H.D dhe M.D [...] Për sa më lart, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkespadinë objekt gjykimi, [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, [...] ka vendosur: “1.Pranimin e pjesëshëm të padisë dhe shtesës së objektit të saj, të paditësave [...], e paditur Bashkia Korçë, AKKP [...] Ndryshimin e vendimit të KKKP Korçë, nr. 505, datë 19.09.1994, ndryshuar pjesërisht me vendim gjyqësor nr. 2202, datë 24.11.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke ju kthyer trashëgimtarëve të ish pronarit S.B edhe një sipërfaqe trualli prej 859 m2, e ndodhur në Korçë, identifikuar si pasuri “shtet”, [...]. Rrëzimin e padisë lidhur me kthimin e sipërfaqes prej 4654 m2 [...]

Gjykata e Apelit Korçë, [...] ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se në rekursin e paraqitur nga pala paditëse ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Në çështjen objekt gjykimi Kolegji vlerëson se gjykata nuk kanë interpretuar drejtë dispozitat e ligjit material specifik në lidhje me të drejtat që përfiton subjekti kërkues në cilësinë e ish pronarit rreth të drejtave të pronësisë para datës 29.11.1944. Ky interpretim i gabuar i ligjit nga gjykatat më të ulëta ka ndikuar edhe në marrjen e një vendimi të papabazuar në ligj.

Disa konsiderata dhe qëndrime të konsoliduara tashmë prej vitesh për sa lidhet me çështjet e trajtimit të pronës për subjektet ish pronar, garantuar nga neni 1, protokollin 1 i KEDNJ dhe neni 41 i Kushtetutës

Ligji nr.7698 datë 15.04.1993 është i pari i miratuar nga ana e Kuvendit me synimin rivendosjen e të drejtave të cënuara dhe shkelura përgjatë regjimit të mëparshëm

në çështjen e të drejtës së pronës. Në mënyrë të përmbledhur ky ligj u njihte ish pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronës për pasuritë e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, po ashtu përcaktonte mënyrat dhe masat për kthimin apo kompensimin e tyre. Ligji garantonte të drejtën e kthimit në natyrë të pronës tërësisht ose pjesërisht si dhe të drejtën e kompensimit në natyrë deri në një masë të caktuar ose kompensimin në vlerë. Konditat që duhet të plotësoheshin ishin: -prona të ishte në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore, apo tokës bujqësore dhe jobujqësore; -prona të mos ishte e trajtuar nga ligji nr.7501 viti 1991; -prona të ishte në pronësi të shtetit; -prona të mos ishte e tjetërsuar për nevoja publike; etj. Pronat që nuk mund të ktheheshin në natyrë kompensoheshin: me obligacione shtetërore sipas vlerës ekuivalente të pronës, obligacione të cilat do të përdoreshin në versionin e parë për të siguruar aksione në ndërmarrjet shtetërore që po privatizoheshin ose në sipërmarrje të tilla si kredithënie; me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme; me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme. Aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave përcaktonte në mënyrë të detajuar mënyrën dhe afatet e kompensimit. Institucioni që shqyrtonte dhe vendoste për kërkesat lidhur me kthimin dhe kompensimin e pronës ishte KKKP - organi administrative.

Për shkak të problematikave të hasura në praktikë dhe pamundësinë e riparimit të të drejtës së cënuar përmes ligjit të vitit 1993, në vitin 2004 u miratua ligji nr.9235, me të cilin u shfuqizua ligji i mëparshëm dhe në të cilin u parashikuan dy forma të rivendosjes së të drejtës së cënuar të ishpronarëve: atë të kthimit të pronës në natyrë pa përcaktuar kufizime në sipërfaqen që mund të kthehej (*pikërisht kjo përbënte edhe një nga risitë e ligjit*) dhe atë të kompensimit të saj nëse kishte pamundësi objektive të kthimit në natyrë. Ligji parashikonte pesë forma kompensimi: 1-me një pronë të të njëjtit lloj, 2-me një pronë të një lloji tjetër; 3-me aksione në kompanitë shtetërore; 4-me vlerën e një prone shtetërore në proces privatizimi; 5-me një shumë parash, të cilat i korrespondonin vlerës së pronës në kohën e dhënies së vendimit. Organi administrativ të cilit i ngarkoheshin këto detyra ishte Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave si dhe komisionet lokale. Ligji parashikonte ankimin administrativ dhe atë gjyqësor brenda afateve të caktuara. Kuadri ligjor dhe ai nënligjor i dalë në zbatim të ligjit nr. 9235 parashikonin mënyra të vlerësimit të pronës, krijimin e hartës për vlerësimin e tyre si dhe krijimin e fondit për kompensimin e pronës. Me ndryshimin e ligjit në vitin 2006 u parashikua krijimi i AKKP një organ i ri kompetent për të vendosur në lidhje me pretendimet për kthimin dhe kompensimin e pronave. Në vitin 2015, u miratua një ligj që shfuqizonte ligjin e mëparshëm (9235/2004, i ndryshuar).

Së fundmi, miratimi i ligjit nr. 133/2015 në datën 05.12.2015, [...] Në referim të nenit 3, [...] Në këtë analizë Kolegji vlerëson se në zbatim edhe të parimit sipas të cilit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me karakter civil gjykata në çdo rast i referohet ligjit material që ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së konfliktit, pra praktikisht ligjit në fuqi në

kohën e regjistrimit të kërkespadiës.

Në çështjen Beshiri etj kundër Shqipërisë datë 22.08.2006 GJEDNJ [...] Në Vendimin Unifikues nr.24, datë 13.3.2002 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur [...] Në vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehen [...]

Nga dispozitat e mësipërme rezulton se natyra dhe qëllimi i këtyre ligjeve ishte rivendosja e të drejtave për pronat e marra në mënyrë të padrejtë nga shteti nëpërmjet shtetëzimit, shpronësimit apo konfiskimit sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29.11.1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër dhe në vazhdimësi, kërkesat ligjore formale dhe substanciale rreth llojit të dokumentacionit shoqërues që subjekti duhet të dispononte ka qenë dhe vazhdon të jetë i njëjtë.

Në vazhdimësi ligji ka parashikuar edhe të drejtën e parablerjes, në përfitimin e së cilës nga subjekti duhet të plotësoheshin këto aspekte: së pari, ish-pronarit t'i ishte njohur e drejta e pronësisë në përputhje me ligjin; së dyti, pasuritë e paluajtshme të jenë të zëna me objekte shtetërore që nuk ushtrojnë funksionet e tyre publike; së treti, shteti vendos t'i privatizojë ato. Në rastin kontret Gjykata e Apelit Korçë nuk e ka analizuar këtë të drejtë të përfituar nga pala paditëse, as edhe faktin nëse realisht shteti i ka dhënë ndonjëherë mundësinë palës paditëse të ushtronte të drejtën e parablerjes, apo faktin nëse shteti është kujdesur për objektet të cilat ishin pengese për paditësat që t'ju kthehej trualli pronë e tyre. Për sa më lart, në rigjykim, Gjykata e Apelit Korçë duhet të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt gjykimi duke administruar provat e kërkuara nga palët; t'u japë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura në ankim si dhe veprimet konkrete të kryera nga secila prej palëve.

Në konkluzion, Kolegji konkludon se rekursi i palës paditëse ngre shkaqe nga ato të parashikuara nga nenit 472 i KPC, të tilla që e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Apelit. Si rrjedhojë vendimi duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim pranë kësaj gjykatë.

KCGJL Vendim Nr.00-2023-469(58), datë 15.02.2023 (Padi mohuese-karakteristikat)

Njësoj si në padinë e rivendikimit, edhe në padinë mohuese, nëse prapësohet nga ana e të paditurit, paditësi ka detyrimin të provojë pronësinë e tij mbi sendin objekt gjykimi. Për sa më sipër, Gjykata e ka detyrimin e saj për t'ia nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor titullin e pronësisë të pronarit/paditës.

Vështirësia e marrjes së një prove, sipas qëllimit të ligjvënësit në parashikimin e një rregulli të tillë lidhet me ekzistencën e një tërësie rrethanash objektive që e bëjnë gati të pamundur marrjen e një prove në shkallën e dytë. Këto rrethana objektive nuk ekzistojnë në rastin e largësia gjeografike e sendit objekt ekspertimi nga vendndodhja e godinës së gjykatës, pasi ato nuk mund të përbëjë një rrethanë vështirësisht të pakapërcyeshme në kryerjen e detyrave përkatëse nga eksperti topograf, pasi verifikimi i gjendjes faktike të pronave në konflikt që përbën detyrën relevante në raport me një rrethanë të tillë është lehtësisht e mundur të kryhet nga eksperti

topograf, kudo të ndodhet vendbanimi i tij.

Fjalë kyçe: padia mohuese, hetim i paplotë, vështirësi kryerje ekspertimi

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e ndodhura në dosje ka rezultuar se paditësi M.K. [...] me AMTP nr 541 datë 15.08.1995 ai është bërë pronar i një sipërfaqe tokë arë prej 2200 m2, [...] Këtë pasuri paditësi e ka regjistruar në ZVRPP Krujë, e cila ka lëshuar çertifikatën e pronësisë nr.308641. [...]

Nga ana tjetër, në emër të Z.S. (që është nëna e të paditurës) ka dalë AMTP nr.163 /1995, me të cilin i është dhënë në pronësi një sipërfaqe 7000 m2 tokë arë. Ndër to figuron pasuria nr. 13/2/1 me sipërfaqe 5400 m2 dhe [...] Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP me numër pasurie 19/2. Paditësi M.K. ka pretenduar se në hyrje të pronës së tij, tashmë të regjistruar në ZRPP me numër pasurie 19/1, janë hedhur nga e paditura M.S. disa makina me inerte, të cilat i kanë bllokuar hyrjen në të. Për sa më sipër me padinë objekt gjykimi ai ka kërkuar detyrimin e palës paditur të pushojë cenimin e pronësisë dhe heqjen e inerteve në rrugën hyrëse të pronës . [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë [...] ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes civile [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, [...] ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes civile nr. [...] Pas paraqitjes të së njëtes kërkesëpadi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesë- padisë së paditësit [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, çmon se në rekursin e paraqitur nga palët ndërgjyqëse ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC, të cilat, ta bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. [...] Kolegji vlerëson se rekursi i secilës prej palëve ndërgjyqëse ngre shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC, të tilla që e bëjnë të cënueshëm vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi nuk ekziston asnjë shkak i ligjshëm në refuzimin e kësaj gjykate për zgjidhjen e çështjes në themel. Në këto kushte, për shkak të konstatimit të shkeljes së ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, Gjykata e Lartë duhet të vendosë prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit pranë kësaj gjykate.

[...] Në çështjen objekt gjykimi, mosmarrëveshja ndërmjet palëve ka të bëjë me të drejtën e pronësisë dhe gëzimin e saj. Neni 302 i KC [...] Në kuptim të nenit 302 të KC padia mohuese është padia e pronarit që pengohet në ushtrimin e pjesshëm të tagrave të

tij të pronësisë, posaçërisht të gëzimit dhe posedimit të sendit, por pa ia hequr atij këtë posedim. Me anë të kësaj padie reale pronari kërkon nga cenuesi që të pushojë cenimin dhe të mos e përsërisë këtë në të ardhmen. Si padi reale, padia mohuese synon mbrojtjen e pronësisë mbi sendin, pra ka për objekt sendin që është në pronësi të paditësit.

Kështu, me anë të padisë mohuese synohet, nga njëra anë njohja e së drejtës së pronësisë së paditësit dhe nga ana tjetër, njohja se i padituri nuk ka të drejtë të ndërhyjë, pra mohimi i qenies së të drejtës së pretenduar nga i padituri.

Në kuptim të nenit 302, si paditës në padinë mohuese mund të jenë ato subjekte të cilat, njësoj sikurse në padinë e rivendikimit (neni 296), kanë cilësinë e pronarit të sendit, si dhe kanë (*pra nuk e kanë humbur*) posedimin e sendit në kohën e kryerjes së cenimit të pretenduar nga ana e të paditurit.

Kolegji vlerëson se, njësoj si në padinë e rivendikimit, edhe në padinë mohuese, nëse prapësohet nga ana e të paditurit, paditësi ka detyrimin të provojë pronësinë e tij mbi sendin objekt gjykimi. Për sa më sipër, Gjykata e ka detyrimin e saj për t'ia nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor titullin e pronësisë të pronarit/paditës. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se barra e provës së të paditurit është të provojë prapësimet e tij se ka një të drejtë në bazë të së cilës bën ndërhyrjen në pronësinë e paditësit, nëse nuk ka ngritur pretendim mbi vetë pronësinë e paditësit mbi atë send, apo ky prapësim nuk vërtetohet në gjykim. Nga ky interpretim i drejtë i dispozitës së nenit 302 të KC, rezulton që, në thelb, paditësi duhet të jetë pronari i sendit, me titull të ligjshëm pronësie mbi sendin objekt gjykimi dhe se i padituri me veprime të paligjshme dhe të padrejta ka shqetësuar pronarin në lidhje me gëzimin e sendin. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i kuptimit të nenit [...] nëse gjatë shqyrtimit të një padie mohuese, nga ana e palës së paditur ngrihet prapësim mbi cilësinë e pronarit të sendit, atëherë paditësi duhet të provojë se është pronar i rregullt i sendit.

[...] Arsyetimi i bërë nga gjykata e apelit, për këtë shkak pavlefshmërie të vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nuk është i bazuar në nenin 467 të KPC, sipas formulimit që ka patur para ndryshimeve me ligjin nr.38/2017 dhe ligjin nr.44/2021, si dispozita në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit. Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite Kolegji vlerëson se nuk ka asnjë shkak që passjell pavlefshmërinë e gjykimit në shkallë të parë.

Gjykata e apelit, në pjesën arsyetuese përcakton dy shkaqe të prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë: i) formimi i gabuar i ndërgjyqësisë duke konsideruar si të detyrueshme pjesëmarrjen në këtë gjykim, në një pozitë procedurale të papërcaktuar të ZVRPP Krujë (aktualisht me emërtimin ASHK, Drejtoria Krujë); ii) hetimi i paplotë dhe mosmarrja e provave që janë të vështira për tu marrë në shkallë të dytë, sipas nenit 467/ë. Për sa i përket shkakut të parë, Kolegji vlerëson se thirrja në gjykim e ZVRP Krujë, qoftë dhe me cilësinë e personit të tretë, në këtë mosmarrëveshje me natyrë të pastër civile, që në themel të saj ka pretendimin për gëzimin e qetë të pronës nga pala paditëse për shkak të veprimeve cënuese nga pala e paditur, do të ishte tërësisht e panevojshme. Për më tepër, rezulton kontradiktor arsyetimi i gjykatës së apelit në këtë drejtim, kur nga njëra anë pranon se në referim të vendimit unifikues nr.1, datë 06.01.2009 të Kolegjeve

të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, se veprimet e regjistrimit mbi sendet e paluajtshme nuk kanë efekte krijuese mbi të drejtën e pronësisë, por vetëm efekte deklarative, njohëse apo publikuese të saj dhe nga ana tjetër, dhe pse bazuar në një konkluzion të tillë zgjidhja e mosmarrëveshjes së pronësisë do të kërkonte sqarimin e titullit të të pronësisë dhe verifikimet përkatëse mbi vlefshmërinë apo relevancën e këtij titulli, e kushtëzon zgjidhjen e saj nga mënyra e regjistrimit të titullit të pronësisë, duke devijuar thelbin e konfliktit të pronësisë dhe duke synuar zgjidhjen e tij nëpërmjet përfshirjes në mënyrë të panevojshme së një pale të tretë me funksione të natyrës administrative, që as nuk ka lëshuar titujt e pronësisë së palëve ndërgjyqëse dhe as nuk mund të pretendohet se ka kryer veprime të cënimit faktik të së drejtës së pronësisë.

Në lidhje me shkakun e dytë, Kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë argumentat e gjykatës së apelit për vështirësinë e kryerjes së ekspertimit topografik në shkallën e dytë për shkak se sendi objekt i kësaj mosmarrëveshje pronësie ndodhet në Fushë Krujë, në një vend të ndryshëm nga qyteti i Tiranës, ku ndodhet godina e Gjykatës së Apelit Tiranë. Vështirësia e marrjes së një prove, sipas qëllimit të ligjvënësit në parashikimin e një rregulli të tillë lidhet me ekzistencën e një tërësie rrethanash objektive që e bëjnë gati të pamundur marrjen e një prove në shkallën e dytë. Këto rrethana objektive në vlerësimin e këtij Kolegji nuk ekzistojnë në rastin konkret, pasi largësia gjeografike e sendit objekt ekspertimi nga vendndodhja e godinës së gjykatës, nuk mund të përbëjë një rrethanë vështirësisht të pakapërcyeshme në kryerjen e detyrave përkatëse nga eksperti topograf, pasi verifikimi i gjendjes faktike të pronave në konflikt që përbën detyrën relevante në raport me një rrethanë të tillë është lehtësisht e mundur të kryhet nga eksperti topograf, si në rastin e vendbanimit të këtij të fundit në rrethin e Krujës ashtu edhe në rastin vendbanimit të tij në qytetin e Tiranës. Për më tepër, në këtë drejtim rezulton se Gjykata e Apelit ka lejuar me vendim të ndërmjetëm përsëritjen e pjesësme të hetimit gjyqësor në bazë të nenit 465 të KPC duke thirrur ekspertin topograf për të dhënë sqarime plotësuese rreth aktit të ekspertimit të kryer prej tij gjatë gjykimit në shkallë të parë. Rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet se ka ndonjë bazë ligjore apo faktike pamundësia e vazhdimësisë së mëtejshme të hetimit gjyqësor në këtë drejtim, qoftë edhe nëpërmjet urdhërimit të kryerjes së një ekspertimi të ri topografik me grup ekspertësh, kur e njëjta trup gjykuese ka vlerësuar fillimisht se marrja e kësaj prove ishte tërësisht e mundshme dhe kur nga shpjegimet e ekspertit topograf nuk rezultuan vështirësi të pakapërcyeshme për marrjen e kësaj prove në shkallën e dytë të gjykimit.

Gjykata e apelit, ka juridiksion rishikues të plotë ligji dhe fakti. Ajo mund të vlerësojë provat ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, ashtu sikurse mund të plotësojë hetimin e paplotë të realizuar nga gjykata e shkallës së parë, duke riçelur pjesërisht apo tërësisht hetimin gjyqësor sipas nenit 465 të K.Pr. Civile.

Kjo mënyrë e interpretimit të ligjit ka qenë konsekuente në praktikën gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ndër vite dhe nuk konstatohet ndonjë rrethanë e ndryshme në çështjen objekt shqyrtimi, që të justifikonte shmangien nga një qëndrim i tillë i konsoliduar. Sa më sipër Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk gjen mbështetje në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 467 të KPC, i cili në

mënyrë shteruese ka parashikuar se kur mund të priset vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja të kthehet për rigjykim. Në të tilla kushte, kur nuk ka ekzistuar asnjë pengesë procedurale për gjykimin në themel të çështjes, gjykata e apelit duhet të kishte disponuar me vendim përfundimtar.

Në kushtet kur ka një vendim jopërfundimtar nga gjykata e apelit në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes, Kolegji vlerëson se çështja nuk mund të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Lartë, sipas parimit të respektimit të shkallëve të pushtetit gjyqësor, të parashikuar nga neni 135 i Kushtetutës. Si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se duhet të vendosë prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Kolegji vëren se në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 98/2016, VKM nr. 495, datë 21.7.2022 *“Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”*, si dhe Vendimit të KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022 *“Për fillimin e funksionimit të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”*, që prej datës 1 shkurt 2023 [...] Për këto arsye shqyrtimi i çështjes konkrete do të duhet të vijojë nga Gjykata e Apelit Tiranë Juridiksioni i Përgjithshëm.

Sa më sipër Kolegji vlerëson se gjykata e apelit nuk mund të kthejë çështjen për rigjykim për hetim të paplotë apo për vlerësim të gabuar të rrethanave të faktit dhe provave, por duhet ta gjykojë vetë çështjen në themel dhe nëse vlerëson ndryshe provat e administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, mund të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë (*shih Vendim nr. 00-2015-1350 i Vendimit (183) datë 08.04.2015; Vendim nr. 160, datë 06.04.2010; Vendim nr. 00-2015-1589 i Vendimit (225), datë 29.04.2015; Vendim nr. 00-2015-1350 i Vendimit (183) datë 08.04.2015; Vendim nr. 00-2013-1388 i Vendimit (329), datë 28.05.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*)

Gjykata e apelit në rigjykim duhet të mbajë parasysh zhvillimin e gjykimit në përputhje me nenin 14 të KPC, sipas parimit të gjykimit kontradiktor dhe të barazisë së armëve. Po ashtu, në rigjykim, gjykata e apelit do të duhet të marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në ankimin e palës paditëse dhe të disponojë me vendim përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes.

Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë nëse e çmon mund të riçelë hetimin dhe të kryejë të gjitha veprimet procedurale që i konsideron të domosdoshme në zbatim të dispozitave të KPC. Të gjitha veprimet e mundshme që do konsiderohen si të nevojshme për tu kryer gjatë riçeljes së hetimit gjyqësor, duhet të jenë vetëm në funksion të arritjes në përfundime të drejta dhe objektive në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes.

KCGJL Vendimin Njësues Nr.00-2022-4596(393), datë 26.10.2022 (Parashkim fitues me titull)

Me termin “veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë” të përdorur në nenin 168 të KC, do të kuptohen vetëm veprimet juridike sipas përkufizimit të dhënë në nenin 79 të KC, duke përfshirë nga zbatimi i kësaj dispozite, çdo titull tjetër të ndryshëm që përmban fitimin e një të drejte pronësie;

Nga fusha e zbatimit të nenit 168 të KC janë të përfshirë si rregull shkeljet që

sipas këtij Kodi shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik;

Jo çdo shkelje e ligjit që shkaktonte pavlefshmëri absolute të veprimit juridik, përfshihet në konceptin e veprimit "të ndaluar nga ligji" sipas nenit 168 të KC. Në këtë koncept do të përfshihen ato veprime juridike absolutisht të pavlefshme, në kundërshtim me një normë urdhëruese/ndaluese të ligjit e cila mbron një interes publik, në përputhje me kriteret e parashikuara në nenet 92 dhe 677 të KC.

Fjalë kyçe: veprim juridik për kalimin e pronësisë, pavlefshmëri absolute, pavlefshmeri relative, veprim i ndaluar nga ligji

Rrethanat e çështjes:

[..]ka rezultuar e provuar se, me AMTP nr.684, datë 01.08.1994, familja bujqësore me kryefamiljar të paditurin M.P, ka marrë në fshatin Sukth, Durrës, mes të tjerash edhe tokë arë prej 5 000 m², në parcelën me nr. 63/11. Kjo familje bujqësore, referuar gjendjes familjare në datën 01.08.1991 ka qenë e përbërë nga 4 anëtarë.

Midis palëve ndërgjyqëse, paditësit D.B. dhe të paditurit M.P. është përfunduar kontrata e qirasë nr. 1106/781, datë 09.03.1998, me akt noterial. [...] i padituri i jep paditësit me qira një sipërfaqe prej 4 790 m², në parcelën nr. 63/11, [...]

Palët kanë deklaruar në kontratë se, kjo tokë jepet me qira për afat 30 vjeçar, kundrejt një vlere qiraje të përgjithshme prej 500 mijë lekë për të gjithë periudhën e qirasë, shumë kjo e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Po kështu në kontratën e qirasë, palët kanë parashikuar edhe një klauzolë me këtë përmbajtje: *“Palët deklarojnë se këtë kontratë 30 vjeçare e konsiderojnë edhe si kontratë shitjeje me detyrimin që, sapo të fillojë zbatimi i ligjit të shitblerjes së tokës bujqësore për këtë zonë, të përpilojnë aktin noterial të shitjes pa asnjë pagesë tjetër nga qiramarrësi, sepse vlera e sipërme e paguar prej tij si qira 30 vjeçare, është në fakt vlefë e plotë e shitjes së kësaj sipërfaqe toke”.*

[...] Me prokurën e posaçme [...], të paditurit [...] kanë autorizuar të afërmin e tyre Z.P. që të kryejë procedurat për regjistrimin e pronës prej 4 790 m² në ZVRPP Durrës.

Palët e paditura gjithashtu kanë autorizuar po këtë këtë përfaqësues, që të marrë vendimin nga Këshilli i Kujdestarisë për të miturën E.P. dhe më pas të nënshkruajë aktin noterial të shitjes së tokës në favor të z. D.B., duke qenë plotësisht i lirë që të vendosë vetë për kushtet e kontratës.

Në datën 10.11.2009, paditësi i është drejtuar me shkrim përfaqësuesit të të paditurve, duke i kujtuar që të zbatojë detyrimet që i janë lënë me prokurën e posaçme të datës 15.08.2003. Ky i fundit i është përgjigjur me shkrim se nuk merr përsipër që të nënshkruajë për të paditurit në asnjë dokument, pasi ato kanë vite që ndodhen jashtë shtetit dhe se përfaqësuesi për një kohë të gjatë nuk ka patur komunikim me ta.

Paditësi, duke qenë në posedim të sendit objekt gjykimi, i është drejtuar gjykatës me padinë me objekt njohje pronar kundrejt palëve të paditura, duke pretenduar se e ka fituar pronësinë mbi sendin objekt gjykimi me parashkrim fitues me titull, me mirëbesim sipas nenit 168 të KC.

[..] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, [..] ka vendosur rrezimin e kërkesëpadisë [..] Gjykata e Apelit Durrës, [..] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [..]

Procedura para Gjykatës së Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore

[..]

Pas një studimi paraprak, Kolegji konstatoi se në praktikën e gjykatave më të ulëta janë hasur probleme të interpretimit të nenit 168 të KC, çka ka shkaktuar jo rrallë herë edhe praktika të ndryshme gjyqësore. Nga Gjykata e Lartë, deri më sot, nuk janë përcaktuar kriteret e qarta dhe të njëjta, për të orientuar praktikën gjyqësore mbi kuptimin e kësaj dispozite, mbi kuptimin e veprimeve juridike që kanë për qëllim kalimin e pronësisë; mbi kuptimin e veprimeve që nuk janë të ndaluara nga ligji, si kushte-premisa për fitimin e pronës, me këtë mënyrë origjinale të fitimit të pronësisë, mbi fushën e zbatimit të nenit 168 etj. [..] nuk është dhënë një kuptim i unifikuar dhe i qartë mbi nocionin e “veprimit juridik që nuk është i ndaluar nga ligji”, sipas nenit 168 të KC.

Me këtë nocion, shpesh herë janë identifikuar veprimet juridike absolutisht të pavlefshme, për shkak të shkëljes së një dispozite urdhëruese të ligjit, sipas nenit 92/a të KC. Ndërsa në disa raste është konkluduar se neni 168 i KC (në të njëjtën mënyrë edhe neni 91 i KC të vitit 1981), mbulon vetëm pavlefshmërinë e veprimit juridik për mungesë të formës (*shih vendim nr. 00-2009-1329 (456), datë 24.12.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 307, datë 29.06.2010 etj*).

Në raste të tjera, nga Gjykata e Lartë është konkluduar se neni 168 i KC nuk mbulon vetëm pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, në veçanti ato veprime juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, sipas nenit 92/a të KC (*shih vendim nr. (417), dt. 05.04.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

Në disa vendime, është konkluduar se neni 168 i KC, mbulon çdo lloj pavlefshmërie, si atë absolute, ashtu edhe atë relative, sepse kjo dispozitë parashikon një mënyrë origjinale të fitimit të pronës që ka për bazë posedimin dhe jo një mënyrë të prejardhur. Mjafton që veprimi juridik të mos jetë i ndaluar nga ligji. Në këto vendime është theksuar se duhet bërë dallimi midis veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme, nga veprimet juridike të ndaluara nga ligji (*shih vendim nr. 00-2010-379, datë 12.10.2010; vendim nr. 00-2014-844 (37), datë 06.02.2014; vendim nr. 290, datë 04.06.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj*). Kolegji Civil ka mbajtur qëndrimin se jo çdo veprim juridik absolutisht i pavlefshëm për shkak se vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, do të konsiderohet gjithashtu edhe një veprim juridik i ndaluar nga ligji, pasi ky i fundit i referohet rastit kur norma urdhëruese ndalon shprehimisht kryerjen e vetë llojit apo kategorisë së veprimit juridik, pavarësisht nga forma dhe përmbajtja e tij (*Vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr.1111-00655-00-2007 i Regj. Themeltar, nr.00-2009-1329 i vendimit (456), dt. 24.12.2009; vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr.1111-00639-00-2006 i Regj. Themeltar, nr.00-2008-544 i vendimit (214),*

dt.18.03.2008; vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr.11115-01734-00-2007 i Regj. Themeltar, nr.00-2010-973 i vendimit (307), dt. 29.06.2010. Vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil nr.11211-00165-00-2005 i Rregj. Themeltar, nr.00-2007-584 i vendimit (417), dt.05.04.2007 etj.).

[..] Po ashtu, nga Gjykata e Lartë, nuk ka patur një praktikë të njësuar mbi kuptimin e “veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë”, për efekt të nenit 168 të KC.

Sipas një qëndrimi jurisprudencial, për efekt të kësaj dispozite, do të kuptohen ngushtësisht vetëm veprimet juridike sipas përkufizimit të nenit 79 të KC. Si rrjedhojë, neni 168 i KC, fushën e zbatimit e ka vetëm për veprimet juridike midis privatëve dhe nuk mbulon marrëdhëniet juridike shtet-individ. Në një rast konkret, para Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është shtruar për diskutim çështja ligjore, nëse mund të fitohet pronësia sipas nenit 168 të KC, ku titulli i pretenduar nga personi që e ka zotëruar është një akt i marrjes së tokës në pronësi. Gjykatat më të ulëta e kishin rrëzuar padinë me argumentin se ky akt nuk përbën një veprim juridik për kalimin e pronësisë, por një akt administrativ i nxjerrë sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për Tokën”. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 553, datë 27.04.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, me argumentin që nuk konstatohen shkelje të ligjit material nga gjykatat më të ulëta.

Në një rast tjetër të ngjashëm, Kolegji Civil, me vendimin nr. 518, datë 17.12.2015, [..] Në të njëjtën mënyrë, në vendimin nr. 205, datë 16.04.2015, Kolegji Civil është shprehur se [..] Në të kundërt, në disa raste të tjera, është mbajtur qëndrimi se me konceptin “veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë”, sipas nenit 168 të KC do të kuptohet gjerësisht çdo lloj titulli i aftë për të kaluar pronësinë, qoftë ky veprim juridik apo akt administrativ. Kështu, në vendimin nr. 26, datë 05.04.2018, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, [..] (shih vendim nr. 463, datë 11.09.2014; vendim nr. 251, datë 13.05.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë);

Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. GJEDNJ në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se njëtrajtshmëria e zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike, që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (shih çështjen “Chapman v United Kingdom” vendim i GJEDNJ, datë 18.01.2001), duke patur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të KEDNJ.

[..] Në vijim të kësaj analize, në çështjet ligjore të shtruar për diskutim, Kolegji:

- në ushtrim të së drejtës dhe detyrimit kushtetues dhe ligjor, që lidhet me funksionin nomofilatik;
- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që vijnë për shkak se mund të ketë disa interpretime të nenit 168 të KC;
- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njësuar në interpretimin e ligjit material;
- në zbatim të nenit 35/3, 472/a, 481 dhe 482/a të KPC, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021;

[..] Mbi këtë bazë, Kolegji vlerësoi se çështjet që duhet të shtrohen për njësim janë:

(1) Me termin “veprim juridik për kalimin e pronësisë”, sipas nenit 168 të KC do të kuptohen ngushtësisht vetëm veprimet juridike sipas përkufizimit të nenit 79 të KC apo do të kuptohet gjerësisht çdo lloj veprimi tjetër i ligjshëm, titull i aftë për të kaluar pronësinë ?

(2) Cili është kuptimi i veprimit juridik “...që nuk është i ndaluar nga ligji”? Cilat shkelje të normave juridike përfshihen në këtë kategori? Si vepron neni 168 i KC, në raport me veprimet juridike në shkelje të dispozitave që shkaktojnë pavlefshmëri relative dhe absolute të veprimit juridik? [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

i) Konsiderata të përgjithshme mbi të drejtën e pronës dhe institutin e parashkrimit fitues me titull.

E drejta mbi pasurinë në përgjithësi dhe e drejta e pronës në veçanti përbëjnë bazën e sistemit ekonomik në Republikën tonë. Ajo është e drejtë themelore kushtetuese e kujtdo. [..] Në përputhje edhe me konsideratat e mbajtura nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ndër vite, garancia kushtetuese e pronës nuk mund të pranojë kufizime jo proporcionale, d.m.th. kufizime që nuk justifikohen me konsiderata sociale.

[..] Në bazë dhe për zbatim të këtyre parashikimeve kushtetuese, KC ka parashikuar edhe mjetet ligjore të fitimit të pronës, të mbrojtjes dhe realizimit të saj. Një prej tyre është ai që në doktrinë njihet si parashkrimi fitues, i cili rregullohet në nenet 168 dhe 169 të KC. Parashkrimi fitues ndahet në dy lloje, me titull dhe pa titull. Parashkrimi fitues me titull, ndahet sërish në dy lloje, kur bëhet fjalë për anën subjektive të poseduesit, d.m.th. mirëbesimin apo keqbesimin. Kur posedimi i pandërprerë ka qenë në mirëbesim, atëhere afatet e kohëkalimit do të mjaftohen së qeni 10 vite për sendet e paluajtshme dhe 5 vite për sendet e luajtshme. Ndërsa, kur posedimi i pandërprerë ka qenë në keqbesim atëhere afatet e kohëkalimit dyfishohen. Ndërkohë parashkrimi fitues pa titull, i prezantuar rishtazi me KC në fuqi, parashikohet në nenin 169 të tij. Ndryshe nga parashkrimi fitues me titull, kjo mënyrë fitimi pronësie vepron ekskluzivisht mbi sendet e paluajtshme. Nën të njëjtat kushte të posedimit të qetë dhe të pandërprerë dhe nën të njëjtat kërkesa për sjellje me sendin sikur të ishte pronari i vërtetë i tij, parashkrimi fitues pa titull nuk kërkon asnjë titull për të vepruar si mënyrë fitimi pronësie; nuk kërkon anën subjektive të subjektit që përfiton nga ajo; dhe afati i kohëkalimit është gjithmonë 20 vjet.

Duke qenë se ky interpretim bëhet në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, Kolegji do të trajtojë vetëm mjetin ligjor konkret [..] konkretisht padinë e njohjes pronar dhe parashkrimin fitues me titull sipas nenit 168 të KC, [..]

47. Parashkrimi fitues me titull, në klasifikimin doktrinar, është përfshirë në kategorinë e mënyrave origjinale të fitimit të pronës, ku kalimi i pronësisë mbi një send bëhet në kundërshtim me vullnetin e pronarit të tij ose kur e drejta dhe/ose sendi krijohen rishtaz, pa kaluar nga një subjekt i së drejtës tek tjetri. [..] Në vështrim të përcaktimit ligjor të cituar më sipër, që një person të fitojë pronësinë me anë të

parashkrimit fitues me titull duhet të konstatohen këto kushte-premisa: **(i)** *ekzistenca e një sendi të aftë për t'u tjetërsuar*; **(ii)** *ekzistenca e një veprimi juridik që të ketë për qëllim kalimin e të drejtës së pronësisë dhe që të mos jetë i ndaluar nga ligji*; **(iii)** *ekzistenca e faktit juridik të posedimit të këtij sendi në mënyrë të pandërprerë*; **(iv)** *ekzistenca e mirëbesimit të poseduesit dhe sjellja e tij me sendin sikur të jetë ai pronari*; **(v)** *kalimi i afatit të parashikuar nga ligji prej 5 ose 10 vjetësh (vendimi (307), dt. 29.06.2010, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë)*. Pra, në përgjithësi kjo mënyrë fitimi pronësie kërkon posedimin e sendit nga jopronari, si të ishte i tillë, dhe vazhdimi i posedimit për një kohë të paraparë nga ligji. [...] Posedimi i sendit në kuptimin cilësor, duhet të konsistojë në një sjellje të vazhdueshme, paqësore, të qetë dhe të pandërprerë të poseduesit me sendin, sikur të ishte ai pronari i saj. Në këtë mënyrë nga elementet cilësorë të posedimit të listuara më lart në mënyrë telegrafike dhe shteruese dalin dy kategori të mëdha elementesh, kategoria materiale e elementeve cilësorë të posedimit (*corpus*) dhe kategoria subjektive e elementeve cilësorë të posedimit (*animus*). Elementi material "*corpus*" lidhet me sjelljen dhe pushtetin faktik të ushtruar nga poseduesi mbi sendin. Ky pushtet duhet të përbëjë një sjellje faktike prej pronari, jo episodike, por të qëndrueshme në kohë dhe të pasëgmentuar nëpërmjet ndërprerjesh. [...] që sjellja prej pronari e përfituesit të mos jetë e dhunshme dhe e fshehtë. [...]

Elementi subjektiv cilësor i posedimit (*animus rem sibi habendi*), është gjithçka që tregon në mënyrë të padyshimtë qëndrimin psikik të përfituesit përkundrejt pasurisë që ai ushtron pushtetin e pronarit, por që nuk është i tillë. Kjo do të thotë që përfituesit duhet të silllet me sendin si të ishte pronari ekskluziv i tij. [...]

Neni 168 i KC nuk jep një përkufizim të mirëbesimit, për efekt të zbatimit të kësaj dispozite. [...]

Kolegji i referohet dispozitave të tjera që rregullojnë posedimin, të cilat duhen zbatuar dhe interpretuar në mënyrë sistematike me nenin 168 të KC. Në nenin 305 të KC, [...] Kjo dispozitë parashikon rastet se kur posedimi është i ligjshëm dhe me një interpretim të kundërt (*per a contrario*), posedimi është i paligjshëm, kur nuk buron prej vullnetit të pronarit, në bazë të një veprimi juridik apo akti administrativ. Më tej, sipas nenit 306 të KC, poseduesi është në mirëbesim kur nuk e ka ditur dhe nga rrethanat nuk kishte se si ta dinte se posedimi i tij është i paligjshëm, pra se buron jo prej vullnetit të pronarit apo në bazë të një veprimi juridik të paligjshëm.

Mirëbesimi, si gjendje e brendshme psikike, duhet të ekzistojë vetëm për kohën e realizimit të veprimit juridik për fitimin e pronësisë. [...] Kjo do të thotë se posedues në mirëbesim është ai person që në kryerjen e veprimit juridik, tregon kujdesin mesatar, të një njeriu mesatar, për të verifikuar nëse e drejta i ka kaluar nga pronari në bazë të një veprimi juridik të ligjshëm.

[...] Titulli është shkaku i cili ka aftësinë të transferojë pronësinë, që provon dhe justifikon posedimin si pronar apo edhe mirëbesimin e përfituesit në këtë mënyrë fitimi pronësie. Titulli mund të konsiderohet i aftë për të kaluar pronësinë e sendit vetëm kur objekti që individualizohet në të korrespondon në mënyrë të mjaftueshme me pasurinë, me pasurinë mbi të cilën efektivisht është ushtruar posedimi në sasi dhe cilësinë e

kërkuar nga ligji⁴.

Kështu, duhet të ekzistojë një përputhshmëri e mjaftueshme midis identitetit faktik dhe juridik të sendit të poseduar dhe atij të pretenduar për t'u fituar me parashkrim fitues me titull. Titulli është një element autonom dhe esencial që individualizon sendin dhe kufjtë e veprimit të institutit të parashkrimit fitues sipas nenit 168 të Kodit, në kuptimin që ai duhet të jetë i aftë të përcaktojë pasurinë e transferuar, në mënyrë që të ruhet njëjtësia e identitetit të objektit të kësaj mënyre fitimi pronësie dhe proporcionaliteti midis pritshmërive të ligjshme të personave mbi asetet e tyre dhe mbrojtjes juridike që gëzojnë këto pritshmëri nga rendi juridik.

Fituesi i sendit bëhet pronar që nga çasti që parashkrimi është plotësuar⁵, ç'ka do të thotë se pavarësisht se sa e vonë është padia e fituesit të ri të pronësisë, vendimi i gjykatës sipas nenit 170 të KC ka karakter konstatues e jo konstitutiv, që do të thotë se konfirmon një marrëdhënieje juridike ekzistuese dhe nuk e krijon atë. Data e perfeksionimit të kohëkalimit të parashikuar nga ligji shënon momentin final juridik të ndërrimit të titullaritetit të pronësisë nga ish pronari tek pronari i ri. Ndaj neni 170 i KC, interpretuar sistematikisht me nenin 32/b të KPC, për të përmbyllur konstatimin e këtij fakti juridik, ka lënë në disponibilitetin e pronarit të bërë rishtazi, një padi njohje e cila i kundrejtohet ish-pronarit, për ta detyruar këtë të fundit të njohë të drejtën e pronësisë dhe për të mundësuar sakaq regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik.

Instituti i parashkrimit fitues është edhe një politikë diskrecionare e pushtetit ligjvënës të çdo shteti, kryesisht në disiplinimin dhe ekonomizimin e tokës apo pasurive të paluajtshme në përgjithësi, që përbëjnë një burim të kufizuar natyror dhe si të tillë të shterueshëm. [...]

[..]

GJEDNJ, ka theksuar se parashkrimi fitues që titullon një subjekt tjetër pronar, duke shuar të drejtën e pronarit të mëparshëm, i shërben dy interesave publikë të rëndësishëm:

1) parandalimin e pasigurisë juridike dhe padrejtësisë në trajtimin e kërkesave të vonuara;

2) garantimin që posedimi faktik dhe e drejta e pronësisë, *de iure* të përputhen. [...]

ii) Mbi kuptimin e “veprimit juridik juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë”

[..] Kuptimi i i përgjithshëm i veprimit juridik, si një nënkategori e veprimeve të ligjshme, jepet në nenin 79 të KC, [...] Veprimi juridik sipas kësaj dispozite nënkupton shprehjen e vullnetit të një ose më shumë subjekteve të së drejtës private, të cilit/ve i jepet pushteti të disponojë/në mbi të drejtat e tij/tyre ose të marrë/in përsipër detyrime karshi një subjekti tjetër privat. Veprimet juridike që kanë për qëllim kalimin e të drejtës

⁴ Një qëndrim i tillë është mbajtur nga Gjykata e Kasacionit të Italisë në vendimin dt. 26.01.2000, nr. 866.

⁵ (Shiko vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.11111-00639-00-2006 i Regj. Themeltar, Nr.00-2008-544 i vendimit (214), dt. 18.03.2008)

së pronësisë rregullohen në dispozita të tjera të KC. Ato mund të jenë të njëanshme (rasti tipik është testamenti) ose të dyanshme, sikurse mund të jetë kontrata. [..]

Ndërkohë me ligje të veçanta, ligjvënësi mund të parashikojë si mënyra të fitimit të pronësisë edhe fakte të tjera juridike, të përfshira në kategorinë e veprimeve të tjera të ligjshme. Të tilla mund të jenë aktet administrative, si shfaqje e ligjshme e vullnetit të shtetit, nëpërmjet të cilave kalon e drejta e pronësisë nga një subjekt i së drejtës publike tek një subjekt privat. [..] Kuptimin e përgjithshëm të aktit administrativ, e më tej, të atij që ka për qëllim tjetërsimin e pronës shtetërore nga shteti tek individi, nuk e gjejmë në KC, por në ligjin nr. 49/2012 [..] dhe në ligje të veçanta [..]

Në nenin 2 të ligjit nr. 49/2012 parashikohet [..] Nisur nga ky përkufizim, akti administrativ që ka për qëllim kalimin e pronësisë, do të konsiderohet shprehja e vullnetit të ligjshëm të organit publik, ndaj një subjekti të përcaktuar të së drejtës, që krijon apo lind të drejtën e pronësisë.

[..] Aktet administrative që kalojnë pronësinë nga shteti tek individi, dallojnë nga veprimet juridike që kanë për qëllim kalimin e pronësisë, pasi ndryshe nga subjektet e së drejtës private, shteti, në disponimin e pronës shtetërore, nuk gëzon autonomi të plotë vullneti. Veprimtaria e tij është e kufizuar nga norma të së drejtës publike që përcaktojnë kushtet dhe kriteret se si apo kujt subjekti privat do t'i kalojë pronësia mbi një send të luajtshëm apo të paluajtshëm. [..] dhe prona shtetërore duhet të administrohet në përputhje me këtë interes.

Këtu Kolegji sjell si shembull, aktet e marrjes së tokës në pronësi, të cilat janë akte administrative të një natyre individuale, nëpërmjet të cilave ka kaluar pronësia e tokës bujqësore nga shteti tek subjektet privatë. [..]. Ligjvënësi u ka dhënë të drejtë organeve të krijuara me ligj të posaçëm që me anë të këtyre akteve të disponohet mbi të drejtën e pronësisë së tokës bujqësore nga pronë shtetërore në pronë private (*shih vendimin unifikues nr. 2, datë 10.03.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, paragrafi 20*).

Nga përmbajtja e nenit 168 të KC, qartazi vërehet se kjo dispozitë, si titull mbi të cilin mund të pretendohet fitimi i pronësisë, përmend vetëm veprimet juridike, duke përjashtuar sakaq të gjithë titujt e tjerë të pronësisë, si pjesë e kategorisë së fakteve juridike, si bazë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull.

Për të kuptuar këtë zgjedhje të legjislatorit, në lidhje me aktet që janë të afta të konstituojnë mënyrën origjinale të fitimit të pronësisë të parashkrimit fitues me titull, Kolegji çmon të bëjë një vështrim të nenit 168 të KC, së pari historik, me legjislacionin civil të mëparshëm që ka vepruar në vendin tonë dhe, së dyti krahasues, me legjislacionet e vendeve të Evropës Perëndimore, nën modelin e të cilëve është frymëzuar edhe legjislacioni ynë. [..]

Nga kjo analizë rezulton se neni 168 i KC është një përjasje *mutatis mutandis* i dy ligjeve civile të sipërcituara që kanë vepruar në vendin tonë në periudhën e diktaturës komuniste, përkatësisht i nenit 44 të Dekretit nr. 2083, datë 06.07.1955 "*Mbi Pronësinë*" dhe nenit 91 të KC të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Kodi Civil i vitit 1981). [..] Pra, çdo veprim juridik disponimi mbi tokën ishte i ndaluar nga ligji dhe,

njëkohësisht, askush nuk mund të sillej si pronar me tokën.

Ndërkohë ky parashikim, nuk i përgjigjet zhvillimeve të reja ekonomike që pasuan vitet '90 në Republikën e Shqipërisë.

Në fillim të proceseve demokratike, [...] Me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, [...]. Më pas, me ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Ish Pronarëve”, [...] shteti bënte shpronësimin e vetvetes, duke ia kaluar të drejtën e pronësisë individëve. Të gjitha këto mënyra kalimi pronësie përbëjnë titull për subjektin i cili fiton ose rifiton tagrat e pronarit mbi një send të paluajtshëm, pasi ato janë fakte juridike të kategorisë së veprimeve të ligjshme të njerëzve, të cilat sjellin lindjen e marrëdhënies juridike të pronësisë. Pra ato janë akte që titullojnë një subjekt të së drejtës pronar mbi një send.

Sikurse mund të konkludohet, edhe pse reminishencë e kodeve të mëparshme, neni 168 i KC, përmban një ometim të qartë legjislativ, për shkak se legjislatori nuk ka parashikuar të gjithë rrethin e fakteve juridike të cilët mund të qëndrojnë në themel të parashkrimit fitues me titull. Kjo dispozitë ka përjashtuar *apriori* të gjitha format e tjera të kalimit të pronësisë me ligj të veçantë. **Mëtimi është i tillë që nuk mund të shërohet me interpretim të zgjeruar nga ana e gjyqtarit të juridiksionit të zakonshëm**, në të kundërt ai do të bënte një normë të re juridike, duke e zgjeruar tej parashikimit të ligjit kategorinë e titujve të pronësisë, të cilat ky i fundit shprehimisht i ka përjashtuar. Kjo do të vinte në kundërshtim me nenin 145/1 të Kushtetutës [...]

Në vijim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionin se neni 168 i KC, i cili i është nënshtruar kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese, si autoriteti ekskluziv kompetent për të verifikuar pajtueshmërinë e ligjit me rendin kushtetues, në mënyrë të qartë, si tituj pronësie, ka parashikuar vetëm veprimet juridike që kanë për qëllim kalimin e pronësisë, sipas nenit 79 të KC dhe sipas dispozitave të tjera të po këtij Kodi, që rregullojnë dhe titullojnë në mënyrë të posaçme se cilat janë veprimet juridike të kësaj natyre, kontratat apo veprimet juridike të njëanshme. Kolegji vlerëson se nga formulimi i dispozitës dhe nga interpretimi sistematik i KC, nuk ekzistojnë mënyra të tjera interpretimi. Kolegji vlerëson se për arsyet e parashtruara më sipër, është e nevojshme një ndërhyrje legjislative nga ana e ligjvënësit, për riformulimin e nenit 168 të KC, në pajtim me Kushtetutën e dhe regjimit aktual ekonomik dhe pronësor të Republikës së Shqipërisë, por deri në atë moment eventual, ligji do të duhet të interpretohet dhe zbatohet sipas konkluzioneve të Kolegjit në këtë vendim njësesues, nga gjykatat më të ulëta, në raste të ngjashme.

iii) Mbi kuptimin e veprimit juridik “që nuk është i ndaluar nga ligji”

[...] Në këtë mënyrë, duhet kuptuar se fitimi i pronësisë, sipas nenit 168 të KC, nuk rrjedh për shkak të veprimit juridik në vetvete, por për shkak të vërtetimit të njëkohshëm të atyre fakteve juridike të parashikuara në këtë dispozitë, ku posedimi i gjatë dhe mirëbesimi përbëjnë bazën e lindjes së të drejtës së pronësisë. Megjithatë, legjislatori, ka vendosur një kufizim, se pronësia nuk mund të fitohet, nëse ka për bazë një veprim juridik të ndaluar nga ligji. [...]

KC nuk jep një përkufizim të “veprimit juridik të ndaluar nga ligji” dhe në pamje të parë, ky koncept është shumë i përgjithshëm. Në dhënien e një kuptimi të drejtë të këtij koncepti, duhet patur kujdes pasi nga një interpretim i zgjeruar, mund të kufizohet në mënyrë joproporcionale e drejta e poseduesit në mirëbesim për të fituar pronën dhe për lirinë e veprimtarisë ekonomike, aq sa neni 168 i KC të mbetet i pazbatueshëm ose të gjejë zbatim në raste shumë të kufizuara. [..]

iii/a) Natyra dhe rëndësia e shkeljeve të legjislacionit civil

Duhet thënë se jo çdo shkelje e dispozitave të KC apo të ligjeve të tjera që zbatohen në mënyrë komplementare në marrëdhëniet juridike midis privatëve dhe në veprimet juridike të realizuara midis tyre, mbart të njëjtën rëndësi juridike. [..] Në analizë të nenit 79 të KC, veprimi juridik që të jetë i vlefshëm duhet që të plotësojë këto kushte: 1) palët që kryejnë veprimin juridik duhet të kenë zotësinë për të vepruar; 2) vullneti i brendshëm i palëve në një veprim juridik duhet të përputhet me shfaqjen e tij të jashtme, i cili duhet të jetë e lirë dhe i pavesuar; 3) në përmbajtje, veprimi juridik të mos vijë ndesh me dispozita që kanë natyrë urdhëruese dhe që kufizojnë lirinë e vullnetit të palëve; 4) veprimi juridik duhet të realizohet në formën e kërkuar nga ligji. Fryma e legjislacionit tonë në fuqi është se vetëm në rast të mungesës së njërit prej këtyre elementeve do të ndodhemi përpara rastit të pavlefshmërisë së veprimit juridik (*shih vendim unifikues nr. 1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

Në varësi të rëndësisë së shkeljes ligjore dhe përmbajtjes së dispozitës së cenuar, KC, ka parashikuar dy lloje të pavlefshmërisë së veprimeve juridike, relative dhe absolute. Me qëllim zgjidhjen e çështjes së shtruar për njësim dhe për të qartësuar konceptin e veprimeve juridike që janë të ndaluara nga ligji, fillimisht, Kolegji çmon të marrë në analizë, kuptimin, shkaqet dhe dallimin midis dy llojeve të pavlefshmërisë së veprimit juridik.

Neni 92 i KC, rregullon institutin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, [..] Në vështrim të tërësisë së dispozitave që rregullojnë institutin e pavlefshmërisë, veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm mund të përcaktohet si veprim juridik i cili, për shkak të shkeljes së ligjit ose për shkak tjetër të parashikuar në ligj, nuk ka fuqi juridike ose është i paaftë të sjellë pasojat juridike të synuara nga palët. [..] Veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm, nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët. Pavlefshmëria absolute mund të pretendohet nga kushdo që ka interes, ajo mund t'i kundrejtohet si palës tjetër të veprimit juridik, ashtu edhe çdo personi të tretë. [..] (*shih vendim unifikues nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

Nga ana tjetër, instituti i pavlefshmërisë relative të veprimit juridik është parashikuar në nenin 94 të KC, [..] Rastet e listuara në këtë dispozitë janë rrethana që shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik, i anulueshëm me vendim gjyqësor dhe vetëm me kërkesë të palës së interesuar. Këto rrethana prekin interesa të ngushta të palëve të veprimit juridik dhe lidhen me shfaqjen e vullnetit të tyre në botën e jashtme ose me zotësinë e tyre për të vepruar. Si rrjedhojë pala e dëmtuar ka të drejtën ta konvalidojë apo ta miratojë veprimin e kryer, për shkak se kjo palë ka të drejtën të disponojë lirisht të drejtat e saj. Kolegji vlerëson të theksojë se rastet e pavlefshmërisë relative, të

parashikuara në nenin 94 të KC, nuk përbëjnë një listë shteruese. Këtu, Kolegji sjell në vëmendje parashikimin e nenit 57 dhe 94 të KF, që përbën një rast të pavlefshmërisë relative të veprimit juridik të parashikuar me ligj të posaçëm. [...]

Nga analiza e mësipërme, Kolegji vlerëson se, për nga pasojat që sjellin dhe për nga rrethi i subjekteve të dëmtuara, shkeljet e ligjit civil, që shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik, kanë një rëndësi dytësore në raport me shkeljet që shkaktojnë pavlefshmëri absolute sipas nenit 92 të KC. Këto të fundit janë të tilla që krahas interesave të palëve palëve të veprimit juridik mund të prekin edhe interesa të të tretëve apo edhe një interes publik (sikurse do të analizohet në mënyrë më të detajuar në vijim). Për këtë arsye mbi veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm, palët nuk mund të disponojnë lirisht duke e konvaliduar atë, ashtu sikurse palët nuk mund të disponojnë mbi interesin publik. Si rrjedhojë pasojat e shkeljes rrjedhin *ex lege*, pavarësisht vullnetit të tyre.

iii/b) Raporti midis veprimeve juridike të pavlefshme dhe veprimit të ndaluar nga ligji sipas nenit 168 të Kodit Civil.

- *Në lidhje me veprimet juridike relativisht të pavlefshme.*

[...] Në parim, vlen të theksohet se, nuk mund të cilësohen të ndaluara veprimet juridike, të cilat ligji i cilëson të vlefshme dhe për rrjedhojë të ligjshme deri në momentin kur pala e interesuar nuk kërkon anulimin e tyre. Veprimet e ndaluara për nga rëndësia e interesit që mbrojnë dhe për nga graviteti i shkeljes së ligjit, nuk mund të shndërrohen në veprime të lejuara me vullnetin e palës së prekur nga shkak i pavlefshmërisë, nëpërmjet konvalidimit. Kjo do të thotë se një veprim juridik që është i ndaluar nga ligji për shkak të natyrës dhe përmbajtjes së tij, është i tillë që prej fillimit dhe mbetet i tillë deri në momentin që vetë ligjvënësi, nisur nga konsiderata sociale, ekonomike apo politike, e liberalizon me një ndryshim të mëvonshëm legjislativ. Për rrjedhojë një veprim i tillë, nuk mund të ligjërohet me vullnetin e palës, por vetëm me vullnetin e ligjvënësit në një moment të caktuar kohor.

Nga ana tjetër, duke qenë se veprimet juridike të anulueshme janë të vlefshme derisa të anulohen me vendim gjyqate, pronësia mbi sendet, do të fitohet ose sipas veprimit juridik, si një mënyrë e prejardhur e fitimit të pronës, ose sipas një mënyre tjetër origjinale, pasi mënyrat e fitimit të pronës nuk janë konkurruese, por përjashtojnë njëra-tjetrën. Në doktrinën juridike dhe në jurisprudencën ndërkombëtare, në interpretim të Kodit Civil të Republikës së Italisë dhe të Republikës së Francës, që kanë shërbyer pjesërisht si model edhe për hartimin e Kodit tonë Civil, është pranuar se mënyrat origjinale të fitimit të pronës, që kanë për bazë një veprim juridik për kalimin e pronësisë dhe posedimin, sikurse janë parashkrimi fitues me titull (shih për analogji nenin 168 të KC) apo fitimi i sendeve të paluajtshme me mirëbesim (shih për analogji nenin 166 të KC), shërojnë kryesisht situatën ku pronësia ka kaluar nga jopronari dhe jo kur jemi para një veprimi juridik të anulueshëm. Ky është edhe thelbi i këtyre dy mënyrave origjinale të fitimit të pronës, ku pronësia fitohet rishtazi, pa vullnetin e pronarit të mëparshëm dhe për këtë shkak nuk vlen parimi se askush nuk mund të transferojë më shumë të drejta nga sa ai ka (*nemo plus juris ad alium transferre potest quam ipse habet*).

Logjika e kësaj doktrine është se titulli i pronësisë mbi një send të luajtshëm apo të paluajtshëm, i prekur nga një prej të metave që e bëjnë të anulueshëm një veprim juridik, nënkupton situatën ku e drejta ka kaluar prej pronarit, por vullneti i palës së veprimit juridik është i vesuar. Një veprim i tillë është i vlefshëm dhe sjell pasojat e dëshiruara nga palët, që në momentin e kryerjes së tij, derisa nuk i janë anuluar efektet, në mënyrë prapavepruese, me vendim gjyqësor të formës së prerë, me kërkesën e palës së prekur nga shkak i pavlefshmërisë. Në një situatë të tillë, poseduesi me mirëbesim i një sendi të luajtshëm apo të paluajtshëm, është pronar që prej fillimit, për shkak të titullit, si një mënyrë e prejardhur të fitimit të pronës. Këtë të drejtë të tij me karakter absolut dhe këtë titull pronësie, ai mund t'ia kundrejtojë çdo të treti, pasi asnjë tjetër, përveç palës, nuk legjitimohet të pretendojë pavlefshmërinë relative të veprimit juridik. Ndërkohë, me anulimin me efekt retroaktiv të veprimit juridik relativisht të pavlefshëm, poseduesit me mirëbesim që prej fillimit do i mungonte titulli i përshtatshëm për kalimin e pronësisë, si një nga kushtet thelbësore për fitimin e pronës sipas kësaj mënyre.

Përsa i përket palës së dëmtuar nga shkak i pavlefshmërisë, mund të thuhet se veprimet juridike relativisht të pavlefshme, mund të konvalidohen prej saj me veprime të mëpasshme. Në doktrinën juridike është pranuar se konvalidimi mund të bëhet në 3 forma: 1) konvalidim i shprehur, i heshtur ose i prezumuar⁶. Konvalidimi i prezumuar është rasti kur pala e interesuar, e konvalidon veprimin juridik, duke mos ushtruar të drejtën e padisë për anulimin e veprimit juridik, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Sipas nenit 103 të KC, padia për të kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë së veprimit juridik, parashkruhet brenda 5 viteve. Për të kuptuar natyrën juridike të këtij afati, Kolegji çmon të marrë në analizë disa institute të së drejtës civile, të lidhura me të.

E drejta e padisë në kuptimin material, jepet në nenin 112 të KC. [...] Rastet e humbjes të së drejtës subjektive janë të përcaktuara shprehimisht në ligj (*shih vendim unifikues nr. 5, datë 31.05.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). [...]

Në vijim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se afati 5 vjeçar, i parashikuar në nenin 103 të KC mbart në vetvete elemente miks të një afati prekluziv dhe një afati parashkrimi. Kjo pasi, me kalimin e këtij afati, subjektit të interesuar nuk i humb thjeshtë dhe vetëm e drejta e padisë, nëse nuk e ushtron atë, por njëkohësisht konvalidohet veprimi juridik, i cili mbetet përjetësisht i vlefshëm, pasi nuk ka asnjë autoritet tjetër përveç gjykatës që ti anullopë efektet. Parashkrimi sipas kësaj dispozite, është një parashkrim i veçantë që ka për bazë konfirmimin. Kjo do të thotë se me kalimin e këtij afati, shuhen përjetësisht edhe të drejtat subjektive civile të tjetërsuara nëpërmjet veprimit juridik relativisht të pavlefshëm. Kodi Civil, krahas parashkrimit shues, ka njohur edhe parashkrimin fitues me titull të sanksionuar konkretisht në nenin 168, objekt i kësaj analize. Afati i parashkrimit fitues për poseduesin e sendit, përbën njëkohësisht edhe një afat prekluziv dekadent për të drejtën subjektive të pronësisë së pronarit të mëparshëm. Ky i fundit e humbet të drejtën e pronësisë për shkak të neglizhencës së tij për ta ushtruar atë brenda

⁶ Shiko Baltasar Benusi, "Obligimet dhe kontratat përgjithësisht", Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1931, faqe 178.

afatit të parashikuar nga ligji. Dispozitat që rregullojnë afatin e parashkrimit shues të padisë së anulimit të veprimit juridik dhe afatin e parashkrimit fitues me titull sipas nenit 168 të KC, duhen analizuar sipas një lidhjeje logjike dhe juridike. [..]

Një nga kushtet për të fituar pronësinë sipas nenit 168 të KC është posedimi i pandërprerë me mirëbesim për një afat prej 5 vitesh për sendet e luajtshme dhe 10 vitesh për sendet e paluajtshme. Nëse posedimi është me keqbesim këto afate dyfishohen. Për të vlerësuar raportin midis këtyre afateve dhe afateve të parashkrimit shues të padisë së anulimit të veprimit juridik, Kolegji sjell në vëmendje rregullin e përgjithshëm të parashikuar në nenin 117 të KC, që parashikon momentin *a quo* se kur fillon të ecë afati i parashkrimit të padisë. Në këtë dispozitë sanksionohet si parim se afati i parashkrimit nis nga data e lindjes së të drejtës së padisë, pra nga data kur titullari i të drejtës subjektive është cenuar dhe ka marrë dijeni për cenimin dhe subjektin cenes.

Në nenin 104 të KC, parashikohet në mënyrë të posaçme momenti se kur palës së dëmtuar nga pavlefshmëria e veprimit juridik, për çdo rrethanë pavlefshmërie sipas nenit 94 të KC, i lind e drejta e padisë së anulimit. [..]

Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të nenit 104 të KC, pra kur veprimi juridik është kryer në kushtet e mashtrimit, kanosjes apo lajthimit, maksimalisht e drejta për të ngritur padinë e anulimit, parashkruhet brenda 8 vitesh nga data e kryerjes së veprimit juridik. Pra afatit 3 vjetor maksimal brenda të cilit lind e drejta e padisë, i shtohet edhe afati 5 vjeçar i parashkrimit të padisë. Sikurse mund të konstatohet, ky afat është më i shkurtër se afati 10 vjeçar i parashikuar në nenin 168 të KC, për posedimin e pandërprerë të sendeve të paluajtshme. Sipas shkronjës “c”, në të gjitha rastet e tjera, afati maksimal i ngritjes së padisë është 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit juridik.

Ndërkohë, rrethanat e parashikuara në shkronjën “a” të kësaj dispozite, lidhen me rastet e pavlefshmërisë të veprimit juridik të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 94 të KC, kur veprimi juridik është kryer nga i mituri mbi 14 vjeç pa pëlqimin e prindit ose nga personi madhor te cilit i është hequr ose kufizuar për të vepruar, pa pëlqimin e kujdestarit.

Një nga kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik është zotësia e plotë për të vepruar e palëve që marrin pjesë në të. Ligjvënësi kërkon zotësinë për të vepruar të palëve për shkak të prezumimit se vullneti i një të pazoti nuk mund të jetë i saktë. [..]

[..]

Rasti i parashikuar në shkronjën “a” të nenit 104 të KC, lidhet në fakt me rrethana që pezullojnë ecjen e afatit të parashkrimit të padisë së anulimit. Ato nuk përcaktojnë momentin se kur pala e dëmtuar merr dijeni për shkakun e pavlefshmërisë, si datë e lindjes së të drejtës së padisë, por lidhen me pamundësinë juridike dhe objektive të tyre për të ngritur padi. Instituti i pezullimit të afatit të parashkrimit është parashikuar në nenin 129 e vijues të KC dhe nënkupton ngrirjen e afateve të parashkrimit me vërtetimin e rrethanave të parashikuara nga ligji, që pamundësojnë objektivisht ngritjen e padisë nga palët e interesuara.

Kolegji vlerëson se, neni 104/a i KC duhet interpretuar në harmoni me nenin 129/d të KC, i cili, si rregull i përgjithshëm, parashikon se pezullohen afatet e parashkrimit të

padisë nga të miturit ose personat të cilëve iu është kufizuar ose iu është hequr zotësia për të vepruar, deri sa e fitojnë këtë zotësi, kur nuk kanë përfaqësues ligjor. Këtu Kolegji sjell në vëmendje nenin 171 të KC, i cili ka parashikuar se dispozitat mbi pezullimin dhe ndërprerjen e afatit të parashkrimit shues, zbatohen edhe për afatin e parashkrimit fitues. Kjo do të thotë se në rastin e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 104, bashkë me afatin 5 vjeçar për ngritjen e padisë së anulimit, pezullohet njëkohësisht edhe afati 10 vjeçar i parashkrimit fitues, për poseduesin e sendit, i cili e ka fituar posedimin në bazë të një veprimi juridik që është i prekur nga një prej rrethanave të pavlefshmërisë të parashikuar në nenin 94 “a” dhe “b”. Kjo do të thotë se në të tilla raste, afati i parashkrimit shues të padisë të anulimit, fillon të ecë njëkohësisht me afatin e parashkrimit fitues, si moment *a quo*. Pra edhe në këtë rast, afati i parashkrimit 5 vjeçar të padisë së anulimit ecën paralelisht me afatin e parashkrimit fitues 10 vjeçar sipas nenit 168 të KC.

Në rastet kur bëhet fjalë për veprimet juridike që kanë për objekt pasurinë e të miturve, duhet të mbahen në vëmendje edhe parashikimet e KF në lidhje me përgjegjësinë prindërore për administrimin e kësaj pasurie. Në mënyrë të veçantë në nenin 234 të KF, [...] Kolegji vlerëson se veprimi juridik i realizuar në kundërshtim me nenin 234 të KF, nuk shkakton pavlefshmëri absolute, por relative. [...]

Kur veprimi juridik i realizuar nga përfaqësuesi ligjor i të miturit plotëson kushtet e vlefshmërisë, verifikimi i përmbushjes së interesit më të lartë të fëmijës do të bëhet rast pas rasti dhe mosdhënia e autorizimit paraprak të gjykatës nuk nënkupton *apriori* se ky interes nuk është përmbushur. Madje edhe në gjykimin e iniciuar me padinë e anulimit sipas nenit 234 të KC, gjykata do të vlerësojë në varësi të rrethanave konkrete nëse veprimi juridik i tjetërsimit pa autorizimin paraprak të gjykatës ka përmbushur realisht interesin më të lartë të fëmijës dhe nuk do e shpallë në çdo rast të pavlefshëm, sipas një vlerësimi *apriori*, vetëm pse nuk është marrë paraprakisht miratimi nga gjykata.

[...] Duke iu rikthyer nenit 168 të KC, kur veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, është kryer me të mitur ose në emër dhe për llogari të të miturit, rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë relative sipas KC, duhen lexuar dhe interpretuar në harmoni me nenin 234 të Kodit të Familjes. Në këtë rast padia mund të ngrihet nga palët e legjitime në këtë dispozitë brenda një afati 5 vjeçar nga data e kryerjes së veprimit juridik, sipas parashikimit të përgjithshëm të neneve 103 dhe 104/c të KC.

[...] Në vijim të kësaj analize, mund të thuhet se, nëse pala e interesuar, e dëmtuar nga shkak i pavlefshmërisë relative, brenda afatit 5 vjeçar apo maksimalisht 8 vjeçar të parashikuar në nenin 104, nuk ngre padinë e anulimit të veprimit juridik, ai veprim është konvaliduar. Tashmë nuk do të ishte e nevojshme që poseduesi në mirëbesim të priste edhe disa vite të tjerë që të fitonte pronësinë mbi sendin sipas një mënyre primare të fitimit të pronësisë, pasi konsiderohet se e ka fituar pronësinë me një mënyrë tjetër, të prejdur, nëpërmjet veprimit juridik të konvaliduar për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të padisë, i cili si rrjedhojë mbetet përjetësisht i vlefshëm.

Mbetet për t'u analizuar veprimi i nenit 168 mbi sendet e luajtshme, pasi për këtë kategori afati i parashkrimit fitues me mirëbesim është më i shkurtër, 5 vjet, përveç rastit kur posedimi është me keqbesim, ku afati dyfishohet deri në 10 vjet.

Fillimisht, Kolegji çmon të theksojë se veprimi i nenit 168 të KC në lidhje me sendet e luajtshme, është i kufizuar dhe diskutimi është më shumë teorik. Në praktikën gjyqësore shqiptare, të konsultuar nga Kolegji, nuk është hasur ndonjë rast ku të jetë pretenduar fitimi i pronësisë së një sendi të luajtshëm sipas nenit 168 të KC. Megjithatë, Kolegji do të marrë në analizë, qoftë edhe në mënyrë hipotetike, të gjitha rastet e diskutueshme për të mbështetur konkluzionin njësoj në rastin konkret. Për këtë qëllim, do të trajtohen dy mënyra origjinale të fitimit të pronës që kanë për bazë dhe si shkak të fitimit të së drejtës së pronësisë, posedimin dhe ekzistencën e një veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, të parashikuara përkatësisht në nenet 166 dhe 168 të KC, si dhe dallimet thelbësore midis tyre. Analiza mbi nenin 166 të KC dhe raporti i tij me nenin 168, do të bëhet në funksion të çështjes së shtruar për njësim, me qëllim identifikimin e fushës së zbatimit të nenit 168.

[..] Ajo që e dallon thelbësisht nenin 166 nga neni 168 të KC është natyra e sendeve mbi të cilat këto dispozita veprojnë. Si rregull, neni 166 i KC vepron vetëm për sendet e luajtshme, ndërsa neni 168 i KC vepron kryesisht mbi sendet e paluajtshme. Shkaku i fitimit të pronës sipas të dyja mënyrave origjinale është i njëjtë dhe lidhet me efektet e posedimit me mirëbesim. Poseduesi i sendit, për shkak të një titulli me qëllim kalimin e pronësisë, sillet si pronar dhe beson realisht se e drejta i ka kaluar nga pronari. Ndryshimi është se sipas nenit 166 të KC, e drejta e pronësisë kalon menjëherë me vënien në posedim të sendit të luajtshëm, kurse sipas nenit 168, posedimi kërkon një afat më të gjatë kohor, për të sjellë si pasojë fitimin e pronësisë. Fitimi i pronësisë me vënien në posedim rezulton nga neni 167 i KC, [..] Parashikimi i nenit 166 të KC, ku e drejta e pronësisë fitohet menjëherë me posedimin, lidhet me natyrën juridike të sendeve të luajtshme, të cilat duhet të kenë një lëvizje më të shpejtë në qarkullimin civil. [..]

Në Kodet Civile analoge të shteteve europiane, që kanë shërbyer si bazë për hartimin e Kodit tonë, si dhe në doktrinën dhe jurisprudencën ndërkombëtare përkatëse, gjen zbatim prezumimi se posedimi i sendeve të luajtshme vlen si titull pronësie.

[..] Nga kjo analizë mund të deduktohet se ndryshimi thelbësor midis neneve 166 dhe 168 të KC lidhet me natyrën e sendeve. Nga ana tjetër ato kanë një logjikë të përbashkët mbi shkaku pse fitohet pronësia mbi to. Si rrjedhojë kufizimet që vendosin këto dy dispozita, që nuk kushtëzohen nga natyra e sendit, duhet të jenë simetrike, në pajtim me nenet 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ dhe nenit 11, 17 dhe 41 të Kushtetutës.

Kështu, së pari, neni 166 i KC nuk gjen zbatim, për sendet e luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë. Përjashtimisht për këtë kategori sendesh gjen zbatim neni 168 i KC, pasi për nga regjimi juridik ato përafrojnë me sendet e paluajtshme.

Së dyti, neni 166 i KC, nuk vepron mbi sendet e luajtshme të vjedhura ose që i kanë humbur pronarit të mëparshëm. Logjika e këtij kufizimi, lidhet me faktin se nga vepra penale nuk mund të burojnë pasoja të ligjshme. [..] (*shih vendim unifikues nr. 5/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

Së treti, neni 166 i KC nuk duhet të gjejë zbatim për sendet e luajtshme pronë publike. Këtu Kolegji sjell në vëmendje, për qëllime të interpretimit krahasues, një vendim të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Francës, (shih vendim, Dhoma Civile nr. 1, dt.

13 shkurt 2019). Në këtë vendim Gjykata ka vlerësuar se neni 2276 (analog me nenin 166 të Kodit tonë), nuk gjen zbatim për sendet e luajtshme në pronësi publike dhe kjo përbën një kufizim të justifikuar dhe legjitim të së drejtës së poseduesit në mirëbesim, në kuptim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ. Neni 166 i Kodit tonë, nuk e vendos në mënyrë të shprehur një kufizim të tillë, por në të njëjtën mënyrë sikurse nuk mund të veprojë neni 168 mbi pronën e paluajtshme publike të patjetërsueshme, e njëjta logjikë duhet të vlejë edhe për sendet e luajtshme pronë publike. Kjo sipas parimit se të mirat që i përkasin domenit publik, qofshin këto sende të luajtshme apo të paluajtshme, janë të patjetërsueshme dhe nuk mund të kalojnë në pronësinë e subjekteve privatë.

Së fundi neni 166 i KC nuk gjen zbatim për sendet e luajtshme të fituara në bazë të një veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, pa kundërshtim.

Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se neni 168 i KC, në lidhje me sendet e luajtshme, përjashton fushën e veprimit të nenit 166 të KC dhe gjen zbatim vetëm në dy situata: 1) në lidhje me sendet e luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë; 2) në lidhje me sendet e luajtshme të tjetërsuara pa kundërshtim.

Për veprimet juridike relativisht të pavlefshme, për tjetërsimin e sendeve të luajtshme, për të cilat vepron neni 168, si rregull, e drejta e padisë së anulimit fillon nga data e kryerjes së veprimit juridik, sipas nenit 103/c të KC. Në këtë rast, afati 5 vjeçar i parashkrimit shues përputhet me atë të parashkrimit fitues dhe pronësia mbi sendin ka kaluar për shkak të veprimit juridik të konvaliduar. Po ashtu, sipas analizës së realizuar në paragrafët 117 e vijues të këtij vendimi vlen i njëjti argument për veprimet juridike me objekt sende të luajtshme, të anulueshme për shkak të rrethanave të parashikuara në nenin 94, shkronjat “a” dhe “b”, për të cilat e drejta e padisë lind sipas nenit 104/a të KC, ku afatet e parashkrimit shues dhe fitues ecin njëkohësisht dhe përputhen midis tyre.

[..]Neni 94/c i KC ka parashikuar tre rrethana të veseve të vullnetit që shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik: a) kur veprimi juridik është kryer në kushtet e mashtrimit; b) të kanosjes; c) të lajthimit. [...] Në rastin e mashtrimit, që veprimi juridik të jetë i anulueshëm, duhet që mashtrimi i palës që ka kaluar pronësinë mbi sendin të ketë ardhur nga pala tjetër ose nga një person i tretë, por gjithmonë me dijeninë e palës tjetër. [...] Si rrjedhojë në këtë situatë, poseduesi është me keqbesim dhe gjen zbatim paragrafi i dytë i nenit 168 të KC, mbi afatin 10 vjeçar të posedimit. Në rastin e kanosjes, kur kanosja është shkaktuar nga pala tjetër e veprimit juridik sërish do të ishim para situatës së poseduesit me keqbesim, ku posedimi do të ishte fituar në mënyrë të dhunshme dhe në këtë rast afati i parashkrimit fitues është 10 vjet, më i gjatë se afati maksimal 8 vjeçar për ngritjen e padisë së anulimit. Në rastin e lajthimit, sërish diskutimi shtrohet teorikisht. Lajthimi sipas nenit 97 të KC, shkakton pavlefshmëri relative të veprimit juridik nëse lidhet me cilësitë e sendit apo të palës me të cilën kryhet veprimi juridik. Ato duhet të lidhen me rrethana të tilla thelbësore, të cilat pala tjetër po do ti dinte nuk do të kishte kryer veprimin juridik. Nëse e zbatojmë këtë parashikim të ligjit në një veprim që ka për qëllim kalimin e pronësisë, kur lajthimi ka lidhje me sendin, zbatimi i nenit 168 i KC mbetet pa kuptim, pasi poseduesi i sendit nëse do të kishte një pretendim të tillë nuk do të pretendonte fitimin e pronës mbi sendin as sipas

nenit 168 të KC, as me kontratë, por në çdo rast do të kërkonte kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Mbetet situata kur pronari i sendit të luajtshtëm, i ka tjetërsuar pa kundërshtëpërblim një send të luajtshtëm apo një send të regjistruar në regjistrat publikë, poseduesit të sendit, duke patur lajthitje mbi personin e tij. Vetëm në këtë rast, i cili gjithësesi mbetet shumë hipotetik, me kalimin e afatit 5 vjeçar, pronësia mbi sendin e luajtshtëm do të fitohej jo sipas mënyrës së prejardhur, por sipas nenit 168 të KC dhe mbetet irrelevant fakti nëse pas kalimit të këtij afati, pala e prekur nga veprimi juridik ngre apo jo pretendimin për pavlefshmëri relative të veprimit juridik, i cili edhe pse me të meta, nuk është i tillë që të jetë i ndaluar nga ligji.

- *Në lidhje me veprimet juridike absolutisht të pavlefshme*

Në vijim të kësaj analize, me karakter mbetës, shtrohet për diskutim se cilat janë ato veprime juridike absolutisht të pavlefshme, të cilat konsiderohen njëkohësisht të ndaluara nga ligji sipas nenit 168 të KC dhe cilat janë ato veprime absolutisht të pavlefshme, të cilat gjithësesi plotësojnë formalisht kushtin e titullit të aftë për të sjellë si pasojë fitimin e pronësisë sipas kësaj mënyre origjinale.

[..]

Fillimisht, Kolegji çmon të marrë në analizë, shkronjën “a” të nenit 92 të KC, i cili ka sanksionuar me pavlefshmëri absolute të gjitha veprimet juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit.

Një çështje e diskutueshme në doktrinën juridike ka qenë fakti nëse për të konkluduar mbi natyrën urdhëruese të dispozitës, mjafton formulimi i saj, apo duhet të merret në analizë edhe aspekti cilësor dhe përmbajtësor, pra marrëdhënia juridike që ajo rregullon dhe cila është natyra e interesit që norma juridike mbron.

[..] Duke pasur parasysh rregullimet e së drejtës, pranohet gjerësisht se normat juridike në doktrinë klasifikohen në dy grupe: me karakter imperativ (urdhërues) dhe norma me karakter lejues (dispozitive). [..] Përgjithësisht, e drejta private, është një korpus normash juridike me natyrë dispozitive (lejuese), por në të mund të gjenden edhe norma me karakter imperativ ose ndalues, që janë pjesë e së drejtës publike. Karakteri imperativ/ndalues i normave juridike në të drejtën private, përbën kufizim të autonomisë së vullnetit dhe mundet të përlligjet vetëm nga një interes publik apo për mbrojtjen e interesave të të tretëve, sipas neneve 11/3 dhe nenit 17 të Kushtetutës [..]

Kufizimi nga një interes publik i lirisë së vullnetit, gjen shprehje edhe në KC aktual konkretisht në nenin 677 [..] Këtu vlen të theksohet se, parimi i autonomisë së vullnetit dhe kufizimet e tij, gjejnë shprehje si në pjesën e përgjithshme të KC, ku rregullohen veprimet juridike në përgjithësi, kushtet për vlefshmërinë e tyre, ashtu edhe në pjesën e posaçme që përcakton regjimin juridik të kontratave. [..] Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji risjell në vëmendje nenet 92 dhe 94 të KC, ku janë parashikuar rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë e veprimeve juridike, e cila mund të jetë *absolute* ose *relative*. Rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë relative të veprimit juridik kanë si emërues të përbashkët se mbrojnë ngushtësisht të drejta subjektive dhe private të palëve të veprimit juridik dhe nuk i interesojnë gjerësisht publikut apo të tretëve. Si rrjedhojë vetëm pala e

dëmtuar ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e veprimit juridik nëse vërtetohet një nga faktet juridike të parashikuara në këtë dispozitë dhe sipas parimit të disponibilitetit kjo palë, mund ta konvalidojë në mënyrë të shprehur apo me heshtje, ashtu sikurse pala mund të disponojë lirisht të drejtat e saj. Në këtë kuptim mund të thuhet se instituti i pavlefshmërisë relative të veprimit juridik është shprehje e parimit të autonomisë së vullnetit. Në të kundërt, neni 92 i KC, i cili rregullon institutin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik shpreh në vetvete një kufizim të autonomisë së vullnetit, pasi palët nuk mund ta konvalidojnë një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm dhe pasojat e pavlefshmërisë rrjedhin *ex lege*, pavarësisht vullnetit të palëve apo edhe kundër vullnetit të tyre. [..]

Duke i përmbledhur rastet e listuara në nenin 92 të KC, mund t'i ndajmë në dy kategori: 1) shkeljet që vijnë ndesh me respektimin e rendit publik, normave juridike me natyrë urdhëruese dhe ndaluese, të cilat nuk mund të derogohen me marrëveshje të palëve (shkronja “a” dhe “b”); 2) shkeljet e dispozitave të KC që garantojnë kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik në vetvete dhe që përcaktojnë elementet strukturorë tij (shih shkronjat “c” dhe “ç”).

Kolejji vlerëson se ka një dallim midis këtyre dy kategorive. Të parat plotësojnë formalisht dhe në dukje kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik (zotësia e palëve, vullneti i lirë dhe i pavesuar, forma e kryerjes së veprimit juridik), por në përmbajtje dhe në pasojat juridike që ato sjellin, godasin një normë imperative të ligjit. Sakaq, marrëdhënia juridike që ato krijojnë është e kundërligjshme. Ndërsa kategoria e dytë lidhet me mungesën e kushteve dhe të elementeve strukturorë për qenësinë e veprimit juridik në vetvete, ku më thelbësori është vullneti i palës për ta realizuar atë dhe për të dëshiruar pikërisht dhe drejtpërdrejt pasojat e ardhura prej tij. Në lidhje me këtë kategori, ligji ka sanksionuar me pavlefshmëri absolute rastet ku ka një mungesë absolute të vullnetit të palëve për kryerjen e veprimit juridik. Për këtë arsye, sipas ligjit, veprime të tilla janë inekzistente dhe ato mjafton të konstatohen nga gjykatat si të pavlefshme. Ndryshe nga rastet e pavlefshmërisë absolute, në rrethanat që shkaktojnë pavlefshmëri relative sipas nenit 94 të KC, nuk flitet për inekzistencë absolute të vullnetit, por për ekzistencën e një vullneti të vesuar.

Këtu, Kolejji çmon të marrë në analizë rastet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 92 të KC. Veprimet juridike që kryhen për mashtrim të ligjit, përfshihen në kategorinë e përgjithshme të veprimeve të kundërligjshme. Këto veprime në formë dhe në dukje paraqiten si veprime të ligjshme, por në përmbajtje të tyre kanë elemente paligjshmërie. [..] Në rastet e simulimit dhe fiktivitetit (simulimit absolut) ka një mospërputhje midis vullnetit të brendshëm, pra të asaj që duan në të vërtetë palët e veprimit juridik dhe shfaqjes së tij. Veprimet juridike fiktive janë ato veprime që kryhen nga palët vetëm formalisht “për sy e faqe”, pa patur si qëllim që të sjellin pasojat juridike. [..] (*shih vendim unifikues nr. 932, datë 22.06.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

Në këto situata, nuk flasim për shkelje të dispozitave urdhëruese të ligjit, por për një mungesë absolute të vullnetit dhe qëllimit real të palëve për të kaluar pronësinë mbi

një send të caktuar. Këto situata janë të barazvlefshme me inekzistencën e titullit, pra të veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë. Në të tilla raste, ose posedimi i sendit nuk ka kaluar asnjëherë nga pronari tek pala tjetër e veprimit juridik, i cili është bërë për sy e faqe ose poseduesi ka qenë në keqbesim, pasi që prej fillimit e ka ditur se nuk i ka kaluar pronësia prej pronarit. Në rastin e parë nuk shtrohet fare si diskutim zbatimi i nenit 168 të KC, pasi mungon elementi thelbësor i tij që është posedimi. Në rastin e dytë, inekzistenca e veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, rrëzon kushtin tjetër thelbësor të zbatimit të nenit 168 të KC. Në një situatë të tillë, poseduesi me keqbesim do të mund të fitonte pronësinë mbi sendin sipas parashkrimit fitues pa titull, nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 169 të KC.

I njëjti argument vlen edhe për rastin kur veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, është kryer me një të mitur që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç. Sikurse u analizua më sipër, sipas ligjit, të miturit në këtë moshë, i mungon tërësisht vullneti për të vepruar. Si rrjedhojë çdo veprim juridik i kryer me të është i paqenë. Në këtë situatë nuk mund të flitet as për mirëbesim të poseduesit të sendit të paluajtshëm, të cilit i ka kaluar pronësia me një veprim të kryer me të mitur, pasi nuk mund të pretendojë se i ka kaluar pronësia me vullnetin e pronarit.

Sikurse mund të konkludohet, në rastet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 92 të KC, ligji sanksionon me pavlefshmëri absolute ato veprime juridike, jo sepse vijnë ndesh në përmbajtje me një dispozitë imperative të ligjit, por sepse mungon një nga kushtet thelbësore për qenësinë e veprimit juridik në vetvete, sikurse është ekzistenca e një vullneti për ta realizuar dhe për të synuar pasojat e ardhura prej tij. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se lista e parashikuar në nenin 92 të KC nuk është shteruese. Në Kod mund të gjenden parashikime të posaçme që shprehimisht përcaktojnë kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik, mungesa e të cilave e bën veprimin e paqenë, por që nuk mund të kualifikohen sipas parashikimit të përgjithshëm të nenit 92/a të KC, të cilat do të merren në analizë në vijim. Për këtë kategori shkaqesh të pavlefshmërisë absolute, nuk shtrohet për diskutim nëse jemi para një veprimi të ndaluar nga ligji, por nëse plotësohet kushti i parë që kërkon neni 168 i KC, mbi ekzistencën e një veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë.

Nga analiza e mësipërme, Kolegji vlerëson se, një dispozitë ndaluese, për nga formulimi duhet të ndalojë shprehimisht kryerjen e veprimit si të tillë. Ekzistenca e një veprimi të tillë, përveç se kufizon lirinë kontraktore për shkak se sanksionon me pavlefshmëri absolute veprimin juridik, përbën edhe një kufizim të së drejtës për pronë të poseduesit në mirëbesim sipas nenit 168 të KC dhe që të jetë i justifikuar në aspektin kushtetues apo konventor, duhet të përliqet nga një interes publik. Norma juridike e shkelur nga veprimi juridik, duhet të jetë e tillë, sa në psikikën e poseduesit të sendit, objektivisht dhe subjektivisht, nuk mund të krijohet përgjatë gjithë kohës së posedimit mbi sendin, një pritshmëri legjitime se me kalimin e kohës, për aq sa kjo normë është në fuqi, të mund të fitohet pronësia me një mënyrë origjinale, pasi ligji ka ndaluar tjetërsimin në çfarëdo lloj rrethane, me çdo mjet dhe në çdo kohë. Dispozitat imperative/ndaluese të ligjit, mund të kenë lidhje me sendin, i cili mund të jetë jashtë qarkullimit civil, por

edhe me përbajtjen e veprimit apo me palët, të cilave me ligj u është ndaluar kryerja e një veprimi të tillë. Një të dhënë se e drejta e garantuar në nenin 168 të KC, [...]Koncepti i pronës publike jepet në ligjin nr. 8743, datë 22.02.2002 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ku bëhet edhe dallimi me pronën e paluajtshme shtetërore jopublike.

Kolegji vlerëson se koncepte të tilla si interesi publik, rendi publik, zakonet e mira, morali, përmenden në disa dispozita të KC (psh neni 677), megjithatë Kodi nuk jep një përkufizim konkret se çfarë do të kuptohet me to. Koncepti i interesit publik fillimisht gjendet në KEDNJ, më tej në Kushtetutën dhe po ashtu në KC. [...] (shih vendim nr. 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese). [...] (vendim nr. 18, datë 14.05.2003 i Gjykatës Kushtetuese). Ligji nuk mundet të parashikojë në mënyrë konkrete dhe përfundimtare një koncept të tillë. Nëse do i jepnim një përkufizim do të thonim se interes publik është tërësia e interesave të përbashkët të një shoqërie, komuniteti apo grupi njerëzish. Ky koncept është relativ dhe i ndryshueshëm në kohë. Kjo do të thotë se ligjvënësi, në perioda të ndryshme, në përputhje me zhvillimin dhe ndryshimin e kushteve sociale, zhvillimin ekonomik, ndryshimin e mentalitetit dhe moralit të shoqërisë, mund të ndalojë kryerjen e një veprimi të caktuar në një moment të caktuar dhe në një moment tjetër ta liberalizojë atë. Po ashtu, Kolegji, çmon të rëndësishme të theksojë se një dispozitë ndaluese e ligjit është një nënkategori e dispozitave urdhëruese, shkelja e të cilave, për nga pasojat që sjell, përbën shkallën më të rëndë të cenimit të rendit publik. Jo çdo dispozitë urdhëruese e ligjit përbën njëkohësisht edhe një veprim të ndaluar nga ligji. [...] Në vijim, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje disa shembuj konkretë, për të kuptuar se kur shkelja e një dispozite të ligjit përbën një veprim të ndaluar nga ligji dhe kur shkakton thjeshtë pavlefshmëri absolute të veprimit juridik, por gjithsesi të aftë për të plotësuar kushtin sipas nenit 168 të KC, në mënyrë që të lindë e drejta e pronësisë për poseduesin me mirëbesim. [...] Fillimisht, Kolegji sjell si shembull, ligjin nr. 7501 “Për Tokën”, i cili para ndryshimeve që ka pësuar në vitin 1995 dhe 1998, ndalonte kategorikisht shitblerjen e tokës bujqësore. Në nenin 2 të këtij ligji, si një dispozitë me karakter imperativ, ndalohej shprehimisht tjetërsimi i tokës bujqësore. Ky parashikim ligjor ishte një disponim që mbronte interesin publik, [...]Duke qenë se ndalohej kategorikisht shitblerja e tokës bujqësore, kjo e fundit për të njëjtën arsye, nuk mund të fitohej nga subjekte të ndryshëm, me mënyra të tjera të fitimit të pronës.

[...] Po ashtu, ligji nr. 7980/1995 “Për Shitblerjen e Trojeve” përmban dispozita me karakter imperativë që ndalojnë të drejtën e personave fizikë ose juridikë, publikë apo privatë të shesin trojet në mënyrë të pakufizuar, të huajve. [...]

Në shkelje të dispozitave ndaluese janë ato akte apo fakte juridike që rrjedhin nga vepra penale të cilat janë shkalla më e rëndë e shkeljes së ligjit, për sa i përket detyrimit të vullnetit të tjetërsuesve deri në atë masë sa ta shndërrojë atë në fiktiv dhe të paqenë. Një rast i tillë mund të jetë falsiteti i dokumentit që kalon pronësinë dhe që përbën veprim juridik; tjetërsimi i sendit të vjedhur mbi të cilin kurrësesi rendi jonë juridik nuk lejon të fitohet pronësia në asnjë nga mënyrat e fitimit të saj të prejardhura apo origjinale; kategoria e shkeljeve me karakter administrativ apo edhe e dispozitave të cilat urdhërojnë ndalimin e kryerjes së veprimeve të caktuara juridike si pasojë e mbrojtjes së

një interes publik. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson të marrë si shembull, disa dispozita në KC dhe në ligje të tjera, ku formulimi i normës juridike duket i natyrës urdhëruese, por për nga elementi cilësor dhe përmbajtësor nuk mund të kategorizohet si e tillë dhe/ose nuk është e një rëndësie të tillë sa të përbëjë veprim juridik të ndaluar nga ligji. Në nenin 83/1 i KC [...] Kolegji vlerëson se veprimi juridik për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme, përfshihet në kategorinë e veprimeve juridike formale, ku forma e shprehjes së vullnetit të palëve është kusht për vlefshmërinë e tij (*ad validitatem*). Forma solemne, është pjesë përbërëse e strukturës dhe element konstitutiv i veprimit juridik, që i ndërgjegjëson palët për rëndësinë e tij. Mungesa e formës së veprimit juridik, në të tilla rastem e bën atë nul, por jo një veprim të ndaluar nga ligji. [...] Në këtë kuptim, titulli, për qëllim të nenit 168 të KC, nuk duhet të ngatërrohet apo të njësohet me dokumentin në të cilin ai materializohet, por duhet të kuptohet më shumë si një marrëdhënie juridike vullnetare e krijuar midis transferuesit dhe marrësit të së drejtës së pronësisë. Kolegji sjell në vëmendje gjithashtu, nenin 208 të KC, [...] Vullneti i të gjithë bashkëpronarëve për tjetërsimin e një sendi në bashkëpronësi, është pjesë e përsosurisë të veprimit juridik dhe element i vlefshmërisë së tij, ku kërkohet vullneti i plotë i secilit bashkëpronar për të ushtruar lirisht tagrin e disponimit të pronës së tij. Kjo dispozitë nuk mbron një interes publik, por garanton të drejtat e pronësisë dhe interesat privatë të secilit prej bashkëpronarëve mbi sendin. [...] E njëjta logjikë juridike vlen edhe për interpretimin e nenit 204 të KC, në lidhje me veprimin juridik të kryer për shitjen e pjesës mbi sendin e paluajtshëm nga njëri prej bashkëpronarët, pa garantuar të drejtën e parablerjes tek bashkëpronarët e tjerë. [...] Po ashtu, me të njëjtën logjikë mund të konkludohet mbi veprimet juridike në shkelje të neneve 57, 94, 234 të KF, të cilat janë të konvalidueshme me vullnetin e palës së dëmtuar nga rrethana e pavlefshmërisë dhe në kushtet e parashikuara nga ligji.

Një çështje e diskutueshme mbetet në lidhje me shitjen e sendit të paluajtshëm në kundërshtim me nenin 195 të KC, [...] Për Kolegjin shtrohet për zgjidhje nëse kryerja e veprimit juridik të shitjes në shkelje të kësaj dispozite, krahas pasojës së pavlefshmërisë, e bën atë një veprim juridik të ndaluar sipas nenit 168 KC? Legjislacioni ynë civil, sipas interpretimit të bërë nga Kolegjet e Bashkuara (shih vendim unifikues nr. 5/2011), përfshihet në ato sisteme ligjore, ku transkriptimi i titullit të pronësisë, nuk është kusht për vlefshmërinë e veprimit juridik, por ka efekte deklarative dhe i shërben publicitetit ndaj të tretëve. Transkriptimi/regjistrimi në regjistrat përkatës publikë kërkohet, për veprimet juridike (kontratat) që tjetërsojnë pasuritë e paluajtshme, si dhe për sende të luajtshme të një kategorie të veçantë siç janë anije, aeroplanë, automjete, etj. [...]

Sa më sipër, mund të thuhet se neni 195 i KC, që e ka kufizuar tagrin e disponimit të pronarit me regjistrimin paraprak të titullit të pronësisë, është me natyrë urdhëruese sepse në një kuptim të përgjithshëm garanton një interes publik, sigurinë juridike, mbron të tretët dhe parandalon konfliktet gjyqësore të pronësisë. Kjo pasi shitësi me keqbesim si pronari origjinal i regjistruar, mund ta tjetërsojë disa herë sendin e paluajtshëm tek të tretët. Shkelja e nenit 195 dhe tjetërsimi i pasurisë në kundërshtim me këtë dispozitë, sipas nenit 92/a të KC, shkakton pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, por ajo

ka natyrë parandaluese dhe nuk është e një rëndësie të tillë për nga pasojat që sjell, për tu kualifikuar si veprim i ndaluar nga ligji në kuptim të nenit 168 të KC. Rreziku i mosrespektimit të kësaj dispozite është që poseduesit të sendit të mos i ketë kaluar e drejta nga pronari i vërtetë dhe ky është një nga rastet tipike që shëron parashkrimi fitues me titull sipas nenit 168 të KC. Nëse pronari i vërtetë, që mund të dëmtohet nga kjo shkelje, brenda afatit të posedimit 10 vjeçar nuk ushtron padinë e rivendikimit dhe është neglizhent në ushtrimin e të drejtave të tij, atëherë është tërësisht e justifikuar dhe e përligjur që pronësinë ta fitojë ai që e ka poseduar dhe zhvilluar pronën qetësisht dhe pa ndërprerje brenda afatit ligjor të parashkrimit fitues. Pra veprimi juridik në shkelje të nenit 195 të KC, nuk është i një rëndësie të tillë sa të mos krijohet asnjë pritshmëri të ligjshme të poseduesit se mund ta fitojë pronën sipas nenit 168 të KC, për sa kohë nuk ka një ndalim kategorik për tjetërsimin e pasurisë në vetvete dhe nuk jemi para rastit kur sendi për nga natyra është i patransferueshëm.

I vetmi element që mund të shtrohet për diskutim lidhet me mirëbesimin e poseduesit, kur sendin që ka fituar dhe titulli i pronësisë së personit prej të cilit i rrjedh e drejta, nuk kanë qenë më parë të regjistruar. Sikurse u analizua në pjesën e parë të këtij vendimi njësesues, mirëbesimi lidhet me anën psikike të poseduesit, i cili për shkak të një titulli të aftë për të kaluar pronësinë, nuk e ka ditur dhe nga rrethanat nuk kishte se si ta dinte se pronësia i ka kaluar nga jopronari. [...]Kështu, poseduesi do të konsiderohet në mirëbesim, nëse personi me të cilin ka kryer veprimin juridik, nga ana e tij, ka një titull pronësie që i buron prej pronarit origjinal të regjistruar më parë në regjistrin publik. Sipas ligjit tonë dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, e drejta e pronësisë mbi sendin e transkriptueshëm nuk kalon me regjistrimin, por për shkak të titullit. Pra në një situatë të tillë, poseduesi beson dhe nga rrethanat nuk ka pse të mos besojë, se personi nga i cili i rrjedh e drejta është bërë pronar mbi sendin, edhe pse titullin e ka të paregjistruar. Për marrjen dijeni dhe verifikimin mbi pronësinë, poseduesi duhet të tregojë kujdesin mesatar të një njeriu mesatar dhe në kushtet kur nuk ka një regjistrim tjetër në regjistrat publikë në emër të personave të tretë, nuk mund ti vendoset si barrë detyrimi për të vënë në dyshim dhe për të hamendësuar nëse pronari origjinal ka vepruar me keqbesim, duke e shitur sendin tek disa subjekte njëkohësisht. [...]

Në një vështrim krahasues, të këtyre modeleve ligjore, Kolegji vlerëson se, arsyeja e parashikimeve të ndryshme përsa i përket regjistrimit të sendit, lidhet me vlerën që ka ky element për vlefshmërinë e veprimit juridik në secilin sistem. Nëse regjistrimi ka efekte konstitutive për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi sendin e paluajtshëm, mungesa e tij, nuk mund të prezumojë mirëbesimin e të tretëve, të cilëve sendi ju kalon nga jopronari, për shkak të mungesës së regjistrimit në regjistrat publikë. Në të kundërt, nëse regjistrimi ka efekte deklarative, i treti i cili e blen sendin është në mirëbesim, mjafton që personi nga i cili i kalon e drejta e pronësisë ka një titull të vlefshëm pronësie edhe pse ende të paregjistruar në regjistrat publikë.

Sentencat Njësesue

Sa më sipër u arsyetua, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në lidhje me çështjet e

shtruara për njësim, arrin në këto konkluzione njësuere:

1) Me termin “veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë” të përdorur në nenin 168 të KC, do të kuptohen vetëm veprimet juridike sipas përkufizimit të dhënë në nenin 79 të KC, duke përjashtuar nga zbatimi i kësaj dispozite, çdo titull tjetër të ndryshëm që përmban fitimin e një të drejte pronësie;

2) Nga fusha e zbatimit të nenit 168 të KC janë të përjashtuara si rregull shkeljet që sipas këtij Kodi shkaktajnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik;

3) Jo çdo shkelje e ligjit që shkakton pavlefshmëri absolute të veprimit juridik, përfshihet në konceptin e veprimit “të ndaluar nga ligji” sipas nenit 168 të KC. Në këtë koncept do të përfshihen ato veprime juridike absolutisht të pavlefshme, në kundërshtim me një normë urdhëruese/ ndaluese të ligjit e cila mbron një interes publik, në përputhje me kriteret e parashikuara në nenet 92 dhe 677 të KC.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

[..] Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi, por me tjetër arsyetim. [..]

Ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e apelit, Kolegji vlerëson se kontrata e lidhur midis palëve ndërgjyqëse duhet interpretuar si një veprim juridik (kontratë) që ka për qëllim kalimin e pronësisë, e simuluar në formën e një kontrate qiraje. Sipas nenit 681 të KC, kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të palëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës. Nga ana tjetër, sipas nenit 683 të KC, kushtet e kontratës interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë efekt dhe jo në atë sipas të cilit nuk do të kishin ndonjë efekt.

Pavarësisht titullimit që kanë vendosur palët në rastin konkret, duke e kualifikuar si kontratë qiraje fillimisht, qëllimi i vërtetë i tyre, ka qenë që të lidhin një kontratë shitjeje dhe që pala e paditur t'i kalonte pronësinë paditësit mbi sendin objekt gjykimi. Kjo rezulton nga sjellja e tyre para dhe pas lidhjes së kontratës, nga fakti i provuar në të dyja shkallët e gjykimit, se paditësi i ka parapaguar të paditurve, që në fillim të gjithë vlerën e qirasë për 30 vjet, i njëjtë me çmimin e shitjes dhe që përfaqësonte vlerën e tregut të pasurisë së paluajtshme. Nga ana tjetër, pala e paditur i ka kaluar posedimin mbi këtë send. Përpilimi i aktit noterial të shitjes mbetet vetëm një formalitet që do të përsoste kontratën e shitjes dhe do të formalizonte vullnetin tashmë të shprehur palëve për shitblerjen e sendit, pasi ky send të regjistrohej nga bashkëpronarët.

Sakaq, Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, ekziston një veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë dhe plotësohet kushti i parë që kërkon neni 168 i KC. Në vijim të këtij arsyetimi, shtrohet për zgjidhje nëse kontrata e lidhur midis palëve ndërgjyqëse përbën një veprim juridik të ndaluar nga ligji.

Gjykatat e apelit e ka kualifikuar këtë veprim juridik, si veprim të ndaluar nga ligji, për shkak se është kryer në mungesë të vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve

në tjetërsimin e sendit, Sipas gjykatës, ky veprim vjen në kundërshtim me nenet 200 dhe 222 të KC dhe sipas nenit 92/a të KC janë shkelur dispozita urdhëruese të ligjit. Këtu gjykata ka arsyetuar se, ndonëse parashkrimi fitues është rasti klasik që e mbulon pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik për shkak të mungesës së formës, në rastin konkret pavlefshmëria absolute nuk lidhet me formën, por lidhet me përmbajtjen, lidhet me mungesën e shfaqjes së vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve. Mund të ishim para rastit të parashkrimit fitues vetëm për pjesën e kryefamiljarit të familjes bujqësore dhe vetëm në rastin se pjesa e tij në këtë tokë do të ishte e veçuar. Po ashtu, gjykatat kanë vlerësuar se toka bujqësore në kohën e përfundimit të kontratës, si send i paluajtshtëm, nuk ishte e aftë për t'u tjetërsuar dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve do të lindin vetëm kur të lejohej shitja e saj. Vetëm në këtë moment, toka bujqësore do të konsiderohej si send i aftë për t'u tjetërsuar. Kolegji e vlerëson të pambështetur në ligj këtë arsyetim të Gjykatës së Apelit Durrës. Duke u bazuar në konkluzionet e këtij vendimi njësuës, mosdhënia e pëlqimit nga të gjithë bashkëpronarët për tjetërsimin e sendit nuk e bën veprimin juridik të ndaluar nga ligji në kuptim të nenit 168 të KC. Vullneti i të gjithë bashkëpronarëve për tjetërsimin e një sendi në bashkëpronësi, është pjesë e përsosurisë të veprimit juridik dhe element i vlefshmërisë së tij, ku kërkohet vullneti i plotë i secilit bashkëpronar për të ushtruar lirisht tagrin e disponimit të pronës së tij. Kjo dispozitë nuk mbron një interes publik, por garanton të drejtat e pronësisë dhe interesat privatë të secilit prej bashkëpronarëve mbi sendin. Si rrjedhojë veprimi juridik i kryer në shkelje të nenit 208 të KC është i pavlefshëm pjesërisht për pjesën e bashkëpronarit që nuk ka dhënë pëlqimin, por nuk është një veprim i ndaluar nga ligji dhe nuk kufizon të drejtën e poseduesit me mirëbesim, që i është tjetërsuar sendi sipas një veprimi të tillë, për të fituar pronësinë sipas nenit 168 të KC. Padiësi në rastin konkret, në cilësinë e poseduesit, ka qenë në mirëbesim në kohën e kryerjes së veprimit juridik. Ai ka besuar se sendi i kaluar me vullnetin e të gjithë bashkëpronarëve dhe nga rrethanat nuk kishte se si të besonte ndryshe, kur të gjithë e kishin shprehur vullnetin për kalimin e pronësisë në favor të padiësit. Kjo rezulton nga fakti se bashkëpronarët e tjerë, e kanë ditur dhe nuk kanë patur kundërshtime për tjetërsimin e pasurisë. Edhe pse nuk e kanë shprehur këtë vullnet në formën e aktit noterial, me kontratën e datës 09.03.1998, dijenia e tyre rezulton nga akte të tjera të mëtejshme, konkretisht me prokurën e posaçme me akt noterial, nr[...] Po ashtu, palët e paditura kanë autorizuar këtë përfaqësues, të marrë vendimin nga Këshilli i Kujdestarisë për të miturën [...] Po ashtu, ndryshe nga sa ka konkluduar Gjykata e Apelit Durrës, Kolegji sjell në vëmendje se ndalesa me karakter publik e mostjetërsimit të tokave bujqësore është suprimuar nga rendi juridik në vitin 1998. [...] Për rrjedhojë Kolegji konkludon se përfundimisht veprimi juridik, titulli dhe marrëdhënia juridike e tjetërsimit të tokës arë ndërmjet palëve ndërgjyqëse, plotëson kushtet ligjore të ekzistencës së një veprimi juridik të aftë për kalimin e pronësisë dhe njëkohësisht edhe të pandaluar nga ligji.

Një çështje që shtrohet për diskutim nga Kolegji, lidhet me faktin që toka e tjetërsuar nuk ishte e regjistruar në emër të anëtarëve të familjes bujqësore dhe kjo ishte arsyeja pse ato e kishin simuluar kontratën e shitjes, në formën e një kontrate qeraje. Për këtë

shkak veprimi juridik i realizuar ndërmjet tyre është absolutisht i pavlefshëm, sipas neneve 92/a dhe 195 të KC si dhe nenit 7 të ligjit nr. 8337/1998 “Për Kalimin Në Pronësi Të Tokës Bujqësore, Pyjore, Livadheve dhe Kullotave” sepse sendi është tjetërsuar pa qenë i regjistruar. Sërish, duke u bazuar në arsyetimin, në paragrafët 189 e vijues të këtij vendimi njësuës, Kolegji vlerëson se ky fakt nuk e bën veprimin e ndaluar nga ligji. Nga ana tjetër, paditësi ka qenë në mirëbesim, sepse ka besuar se sendi i ka kaluar nga pronari/bashkëpronarët e vërtetë, të cilët kanë patur një titull pronësie të vlefshëm, ku prona i ka kaluar nga shteti, me AMTP [...] Ai është sjellë si pronar që prej vitit 1998 dhe nuk ka qenë shqetësuar nga të tretët dhe nga palët prej të cilëve ju ka kaluar e drejta.

Së fundi, Kolegji vlerëson të marrë në analizë, faktin se familja bujqësore, në rastin konkret përbëhej nga 4 anëtarë. Njëri prej tyre, [...]ka qenë e mitur, nën 14 vjeç. Veprimi juridik i tjetërsimit të pasurisë në bashkëpronësi, në lidhje me pjesën e saj, është realizuar nga kryefamiljari, z[...]pa autorizimin e Këshillit të Kujdestarisë. Si rrjedhojë veprimi juridik vjen ndesh edhe me nenin 72 të KF, i vitit 1982, në fuqi në kohën e kryerjes së veprimit juridik të shitjes. [...] Sikurse u trajtua në pjesën teorike të këtij vendimi njësuës, shkelja e kësaj dispozite e bën veprimin juridik të anulueshëm, por nuk përfshihet në kategorinë e veprimeve juridike të ndaluara nga ligji.

Nga ana tjetër, shtrohet për diskutim nëse në këtë rast, për shkak të kësaj rrethane është plotësuar afati i posedimit 10 vjeçar, si kusht për fitimin e të drejtës së pronësisë sipas nenit 168 të KC. E drejta e padisë së të miturit, sipas nenit 104/a të KC, fillon nga data kur i mituri ka mbushur moshën 18 vjeç. Edhe pse neni 73 i Kodit të Familjes i vitit 1982, parashikonte se këtë padi mund ta ngrejë i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, KC i miratuar në vitin 1994, prevalon si ligj i mëvonshëm në kohë, sipas parimit *lex posterior derogat priori*. Kjo rrethanë ka pezulluar njëkohësisht edhe ecjen e afatit të parashkrimit fitues sipas nenit 171 të KC. E mitura, [...] ka qenë përafërsisht 10 vjeç, në kohën e kryerjes së veprimit juridik, në vitin 1998, moment nga i cili prezumohet të ketë filluar edhe posedimi mbi sendin prej paditësit (sipas nenit 308 të KC). Kjo rrethanë ka pezulluar ecjen e afatit të parashkrimit fitues deri në vitin 2006, kur e mitura [...] ka fituar zotësinë e plotë për të vepruar dhe për të kundërshtuar veprimin juridik të tjetërsimit të pjesës së saj mbi sendin në bashkëpronësinë e familjes bujqësore, pa u marrë më parë pëlqimi i Këshillit të Kujdestarisë. Afati ka rifilluar të ecë pas vitit 2006 dhe do të përfundonte në vitin 2016. Padia e paditësit Demir Bakanaci, është ngritur më datë 07.06.2010 dhe në këtë kohë ende nuk ishte plotësuar afati 10 vjeçar i parashkrimit fitues me titull sipas nenit 168 të KC.

VIII. Bashkëpronësia

KCGJL Vendim Nr.00-2022-63(9), datë 12.1.2022 (Pjesëtimi në bashkëpronësi-fazat)

Në kuptim të neneve 369 e vijues të KPC si dhe nenit 207 të KC, gjykimi për pjesëtimin e sendit në bashkëpronësi ka një natyrë të veçantë dhe kalon në dy faza:

në fazën e parë gjykata për detyrë të përcaktojë sendin apo sendet (pasuritë) që do të nënshtrohen pjesëtimit, rrethin e bashkëpronarëve dhe pjesët takuese ideale të secilit bashkëpronar. Vendimi i fazës së parë të pjesëtimit përbën një vendim gjyqësor sui generis sepse nuk ka thjesht karakter procedural, por përmes tij zgjidhen në themel dhe në mënyrë përfundimtare çështjet e përmendura më lart. Në vijim, pasi vendimi merr formë të prerë, në mënyrat që parashikon kodi, gjykata zhvillon fazën e dytë të pjesëtimit, gjatë së cilës merren në shqyrtim kërkesat që mund të kenë bashkëpronarët si dhe llogaritë që eventualisht duhet të japin midis tyre dhe që rrjedhin nga marrëdhëniet e bashkëpronësisë. Në këtë fazë Gjykata lejon kryerjen e aktit të ekspertimit për vlerësimin e sendeve që do të pjesëtohen, si dhe mundësinë/mundësitë që sendet të ndahen në natyrë duke u formuar aq pjesë sa janë edhe bashkëpjesëtarët.

Fjalë kyçe: rrethi i bashkëpronarëve, pjesa takuese ideale, fakt i ri

Rrethanat e çështjes:

Rezulton se palët ndërgjyqëse, paditësja J.D. dhe nëna e të paditurit P.M. e ndjera V.M. janë motra midis tyre dhe njëherazi trashëgimtare ligjore të trashëgimlënësve L. dhe A. P. (prindërit e tyre). Me vendimin nr.453, datë 18.03.2013 paditësja dhe motra e saj e ndjera V.M janë cilësuar trashëgimtare ligjore të radhës së parë të prindërve të tyre, trashëgimlënësve [...] në pjesë të barabarta nga 1/2 pjesë. Me aktin noterial nr. 777 rep., nr. 431 kol., datë 3.5.2018 është vendosur: “Pranimin e kërkesës. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare për trashëgimlënësen [...]”

Me vendimin gjyqësor nr.263 datë 04.03.2015 të Gjykatës se Apelit Vlorë janë njohur bashkëpronarë palët ndërgjyqëse J.D. dhe P.M në pasurinë truall me sipërfaqe 1.000 m² dhe ndërtesë me sip.80 m², midis bashkëpronarëve J.D. dhe P.M, në pjesët takuese nga 1/2 pjesë secili. Kjo pasuri është certifikuar nga ZVRPP, Fier me certifikatën e pronësisë nr.7434, datë 12.05.2015. Paditësja J.D. i është drejtuar Gjykatës me padinë objekt gjykimi kundër të paditurit duke kërkuar pjesëtimin e pasurisë nr.148/76, volumi 13, faqe 248, zona kadastrale 2599, fshati Marinëz, truall me sip. 1.000 m² dhe ndërtesë me sip.80 m², e cila është regjistruar në datën 14.04.2017.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, [...] ka vendosur lejimin e pjesëtimit të [...] midis bashkëpronarëve [...], në pjesët takuese nga 1/2 (një të dytën) pjesë secili. [...]

Gjykata e Apelit Vlorë, [...] ka vendosur prishjen e vendimit të ndërmjetëm [...] dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

[...]

Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, [...] ka vendosur lejimin e pjesëtimit të pasurisë [...] duke u përcaktuar si bashkëpjesëtarë në këtë pasuri të paluajtshme paditësja me 1/2 pjesë takuese P.M dhe M.M. me 1/4 pjesë takuese ...”.

Gjykata e Apelit Vlorë, [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit** [...] të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.”. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimin të tyre, vlerëson se në rekursin e paraqitur nga pala e paditur ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC, të cilat, e bëjnë të cënueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

[...] Në kuptim të neneve 369 e vijues të KPC si dhe nenit 207 të KC, gjykimi për pjesëtimin e sendit në bashkëpronësi ka një natyrë të veçantë dhe kalon në dy faza: në fazën e parë gjykata për detyrë të përcaktojë sendin apo sendet (pasuritë) që do të i nënshtrohen pjesëtimin, rrethin e bashkëpronarëve dhe pjesët takuese ideale të secilit bashkëpronar. Vendimi i fazës së parë të pjesëtimin përbën një vendim gjyqësor sui generis sepse nuk ka thjesht karakter procedural, por përmes tij zgjidhen në themel dhe në mënyrë përfundimtare çështjet e përmendura më lart. Në vijim, pasi vendimi merr formë të prerë, në mënyrat që parashikon kodi, gjykata zhvillon fazën e dytë të pjesëtimin, gjatë së cilës merren në shqyrtim kërkesat që mund të kenë bashkëpronarët si dhe llogaritë që eventualisht duhet të japin midis tyre dhe që rrjedhin nga marrëdhëniet e bashkëpronësisë. Në këtë fazë Gjykata lejon kryerjen e aktit të ekspertimit për vlerësimin e sendeve që do të pjesëtohen, si dhe mundësinë/mundësitë që sendet të ndahen në natyrë duke u formuar aq pjesë sa janë edhe bashkëpjesëtarët. Nëse ka një pabarazi në natyrë midis pjesëve bëhet kompensimi në para. Në vendimin përfundimtar gjykata cakton pjesën e secilit bashkëpjesëtar. Megjithëse nuk ka një parashikim të qartë ligjor, në raste specifike dhe me qëllimin e vetëm për të individualizuar sendin apo sendet Gjykata mundet edhe të lejojë marrjen e provës me ekspert.

Kolegji vëren se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka vlerësuar dhe nuk ka hetuar për të gjitha kërkimet dhe pretendimet e palës së paditur të ngritura gjatë gjykimit të çështjes, në respektim të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga procesi gjyqësor civil. Gjykata e Apelit nuk ka përcaktuar drejt rrethin e bashkëpronarëve dhe pjesët takuese ideale të secilit prej tyre. Referuar fakteve të pranuar nga të dyja gjykatat rezultoi se me vendimin gjyqësor nr. 263, datë 04.03.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë janë njohur bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme truall me sipërfaqe 1.000 m² palët ndërgjyqëse në pjesët takuese nga 1/2 pjesë secili. Në këtë vendim arsyetohet se J.D. ka të fituar të drejta pronësie mbi pasurinë si trashëgimtare ligjore e prindërve të saj, së bashku me të motrën VM.. Nga ana tjetër pas dhënies së këtij vendimi gjyqësor ka lindur një fakt i ri, më konkretisht, me aktin noterial nr. 777 rep., nr. 431 kol., datë 3.5.2018 është vendosur çelja e dëshmisë së trashëgimisë testamentare për testatoren V.M. duke u përcaktuar si trashëgimtar i vetëm testamentar M.M. Në këtë këndvështrim, ky fakt i ri padyshim që ndikon në përcaktimin e rrethit të bashkëpronarëve të pasurisë së paluajtshme dhe nuk është mbajtur parasysh nga Gjykata. Në rigjykim Gjykata e Apelit Vlorë ka për detyrë të respektojë nenin 14 të KPC dhe të hetojë të gjitha pretendimet e ngritura nga ana e palës së paditur në rekurs, në respektim të dispozitave procedurale civile dhe parimit të procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu, Gjykata e Apelit Vlorë në rigjykim duhet të vlerësojë drejt edhe kërkimin mbi pezullimin e gjykimit nisur nga faktet e reja të dala

pas dhënies së vendimit nr. 263, datë 04.03.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Për sa më sipër, ky Kolegj, vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC dhe për këtë arsye, duhet të pranohet.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2022-2892(345), datë 05.10.2022

KCGJL Vendim Nr.00-2022-1381(165), datë 29.04.2022 (Lirim dorëzim sendi-bashkëpronar)

Në padinë e rivendikimit e njohur në doktrinën juridike si padia e pronarit jo posedues kundër poseduesit jo pronar, pala paditëse ka barrën e provës për të provuar të drejtën e pronësisë, veçanërisht mënyrën e fitimit të saj. Në rastet kur pronësia mbi sendin individualisht të përcaktuar u përket në të njëjtën kohë disa personave, pra jemi përpara bashkëpronësisë, padia për kërkimin e sendit mund të ngrihet nga të gjithë bashkëpronarët ose nga secili prej tyre, kundër çdo poseduesi/ mbajtësi. Në këtë rast të fundit, bashkëpronari nuk rivendikon vetëm pjesën e tij në sendin e përbashkët, por të gjithë sendin. Pra, vendimi në favor të tij do të ketë efekte apo pasoja pozitive edhe për bashkëpronarët e tjerë. Mbi bashkëpronarin paditës bie barra e provës për të provuar pronësinë e bashkëpronarëve të tjerë. Në të njëjtën kohë pronari apo bashkëpronari mbart barrën e provës për të provuar posedimin e paligjshëm të palës së paditur të cilën e ka thirrur në gjykim. Është posedues i paligjshëm, personi që e mban sendin në posedimin e tij, qoftë edhe të përkohshëm, pa patur një shkak juridik ose shkaku juridik ka rënë.

Fjalë kyçe: padi rivendikimi, legjitimitet aktiv, legjitimitet pasiv,

Rrethanat e çështjes:

Rezulton se paditësi A.Q. është një nga trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar A.K, së bashku me 16 trashëgimtarë ligjorë të tij [...] Me vendimin nr. 17, datë 23.02.2009 të ZRKKP Qarku Berat është vendosur t'u kthehet trashëgimtarëve të tij prona me sipërfaqe prej 3250 m², [...] si dhe e drejta e parablerjes së tunelit me sip. prej 250 m², ndërsa për sipërfaqet e zëna me ndërtime nga reparti i ngjyrosjes, tezgjahu, ngjyrosja e fillit, ambulance, sektori i ndërtimit, mensa e tezgjahut, çerdhe e kombinatit, e drejta e parablerjes do të jepej me vendime të mëvonshme. Ky vendim është regjistruar në ZVRPP, Berat [...] Në vërtetimin hipotekor datë 22.10.2010 është shënuar: “Mbi këtë truall është ngritur ndërtesa me 19/45-nd. në favor të Ministrisë Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”. Me Vendimin e Përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 217, datë 16.04.2004 është vendosur: “...1. Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të objekteve të ish repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (Kombinat) Berat dhe të ish repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë 755, Elbasan nga Ministria e Rendit Publik Ministrisë së Drejtësisë. [...] Aktualisht i gjithë trualli që pretendon pala paditëse posedohet nga Njësia e Qarkullimit Rrugor në Berat në varësi të Ministrisë së

Brendshme Tiranë, si pikë e bllokimit të automjeteve të sekuestruara.

Paditësi A.Q. dhe bashkëpronarët e tjerë janë përpjekur të zgjidhin çështjen me marrëveshje, por një gjë e tillë nuk është bërë e mundur, ndaj [...] është drejtuar Gjykatës [...] me padi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, [...] ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesëpadiës. Detyrimin e palëve të paditura [...] t'i lirojnë dhe dorëzojnë paditësit dhe bashkëpronarëve të tjerë të cilët janë: [...] sipërfaqen e truallit prej 3140 m², [...] e cila është e regjistruar në ZVRPPalujtshme Berat, Vol 9 faqe 162, datë 30.09.2010 konform Vërtetim Dokumenti Hipotekor lëshuar më datë 22.10.2010 nga ZVRPP Berat. Detyrimin e palëve të paditura: [...] që të shpërblejnë palën paditëse [...] dhe të gjithë bashkëpronarët e tjerë të shprehur sa më sipër, si shpërblim për përdorimin e sendit prej 3140 m² x 40 lekë/m²=125.600 lekë që është dhe shuma e detyrimit solidar mujor për dy palët e paditura të sipërpërmendura, shpërblimi ditor i palëve të paditura [...] nga përdorimi i sendit, rezulton të jetë: 125.600 lekë (detyrim mujor); 31 ditë muaji = 4051.6 lekë. Detyrimin e palëve të paditura: [...] që të shpërblejnë palën paditëse Avdyl Qalliu dhe të gjithë bashkëpronarët e tjerë të shprehur sa më sipër shpërblimin për përdorimin e sendit për 530 ditët x 4051.6 lekë në ditë =2.147.348 lekë që është dhe shuma e detyrimit të përgjithshëm. [...]

Gjykata e Apelit Vlorë, [...] ka vendosur ndryshimin e vendimit [...] duke e gjykuar çështjen në fakt: Detyrimin e anës së paditur [...] të lirojë e dorëzojë truallin, [...]. Detyrimin e anës së paditur [...], të shpërblejnë paditësat [...] bashkëpronarët e tjerë: [...] për përdorimin e sipërfaqes 3250 m² nga data 15.06.2011 deri në datën 30.10.2014 në shumën 13.000.000 lekë. Detyrimin e anës së paditur [...] të shpërblejnë paditësin dhe b/p/ronarët e tjerë për përdorimin e truallit me sip. 3250 m² nga 10.834 lekë në ditë, deri në ditën që do të ekzekutohet ky vendim. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se në rekursin e paraqitur nga pala e paditur ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

[...] Kolegji vlerëson se në rastin konkret të dyja gjykatat nuk kanë respektuar nenin 14 të KPC [...] Konform nenit 6 të KPC, gjykata kur gjykon mosmarrëveshjet duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor (neni 8) dhe nuk vepron me iniciativë (*ex officio*) për hetimin e fakteve që nuk paraqiten nga palët në themel të pretendimeve të tyre. Nga ana tjetër, konform nenit 9 të KPC, gjykata ka të drejtë të ftojë palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Pala paditëse ka paraqitur një kërkesëpadi për rivendikimin e sendit sipas nenit 296 të KC, [...]

Në këtë dispozitë dhe në ato në vijim, ligjvënësi ka rregulluar njërin prej mjeteve më

kryesore e më të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, pikërisht padinë e rivendikimit e njohur në doktrinën juridike si padia e pronarit jo posedues kundër poseduesit jo pronar. Në një gjykim të tillë pala paditëse ka barrën e provës për të provuar të drejtën e pronësisë, veçanërisht mënyrën e fitimit të saj. Në rastet kur pronësia mbi sendin individualisht të përcaktuar u përket në të njëjtën kohë disa personave, pra jemi përpara bashkëpronësisë, padia për kërkimin e sendit mund të ngrihet nga të gjithë bashkëpronarët ose nga secili prej tyre, kundër çdo poseduesi/ mbajtësi. Në këtë rast të fundit, bashkëpronari nuk rivendikon vetëm pjesën e tij në sendin e përbashkët, por të gjithë sendin. Pra, vendimi në favor të tij do të ketë efekte apo pasoja pozitive edhe për bashkëpronarët e tjerë. Mbi bashkëpronarin paditës bie barra e provës për të provuar pronësinë e bashkëpronarëve të tjerë. Në të njëjtën kohë pronari apo bashkëpronari mbart barrën e provës për të provuar posedimin e paligjshëm të palës së paditur të cilën e ka thirrur në gjykim. Është posedues i paligjshëm, personi që e mban sendin në posedimin e tij, qoftë edhe të përkohshëm, pa patur një shkak juridik ose shkak juridik ka rënë. Nuk ka rëndësi fakti nëse poseduesi i paligjshëm në kohën që ka fituar posedimin ka qenë me mirëbesim ose me keqbesim, çka nënkupton se ai në çdo rast detyrohet ti kthejë pronarit sendin e rivendikuar. Në vijim të këtij interpretimi juridik me rëndësi është të theksohet se përmes padisë së rivendikimit realizohen në të njëjtën kohë dy kërkime ai për njohjen e të drejtës së pronësisë së palës paditëse dhe ai për të detyruar këtë palë t'i kthejë në natyrë paditësit sendin e rivendikuar.

Pala paditëse eventualisht mund të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit bazuar në nenet 297 e vijues të KC. Poseduesi mund të jetë me mirëbesim apo në keqbesim bazuar në faktin nëse ka patur dijeni se posedimi i tij ka qenë i paligjshëm ose nga tërësia e rrethanave vlerësohet se duhet të kishte dijeni. Në varësi të llojit të posedimit vjen edhe pasoja për shpërblimin e dëmit apo kërkimin e frutave apo shpenzimeve të tjera. Kësisoj poseduesit me mirëbesim i takojnë frutat natyrore të veçuara dhe frutat civile të vjela që janë bërë të kërkueshme deri në ditën që ka marrë dijeni se është posedues i paligjshëm, ose që i është njoftuar padia e pronarit për kërkimin e sendit. Ky posedues nuk detyrohet të shpërblejë pronarin për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit për çdo shkak tjetër, por pas kësaj dite ai përgjigjet për frutat e vjela ose që duhet të kish vjelur, duke vepruar me përkujdesje deri në kohën e kthimit të sendit, për shpërblimin për përdorimin e sendit, si dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit për faj të tij. Ndërsa poseduesi me keqbesim për gjithë kohën e posedimit të tij, detyrohet t'i kthejë pronarit bashkë me sendin edhe frutat natyrore të veçuara e frutat civile të vjela ose që janë bërë të kërkueshme, dhe të ardhurat e tjera që duhej të vilte, si dhe të shpërblejë pronarin për përdorimin e sendit dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit qoftë dhe pa fajin e tij. Ai shkarkohet nga përgjegjësia kur provon se dëmi do të shkaktohej edhe sikur të kishte dorëzuar sendin në kohën e duhur, përveç kur ai është marrë me anë vepre penale. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 5/2011 [...] Kolegji vëren se gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë si dhe nuk janë kujdesur të përcaktojnë drejt të drejtën e pronësisë mbi pasurinë ndërtesë, në referim edhe të të drejtave që paditësi dhe ish pronarët e tjerë kanë fituar

bazuar në vendimin nr. 17, datë 23.02.2009 të ZRKKP Qarku Berat. Gjithashtu gjykata nuk kanë administruar të gjitha aktet nënligjore të cilat sqarojnë të drejtën që pala e paditur ka mbi pasurinë objekt gjykimi. Për pasojë Kolegji vlerëson se në rastin konkret vihet në diskutim legjitimiteti aktiv i palës paditëse, nëse kjo palë gëzon të drejta pronësie mbi pasurinë objekt gjykimi, ndërtesë dhe si legjitimiteti pasiv i palës së paditur nëse ajo gëzon të drejta posedimi apo pronësie mbi këtë pasuri, njëherazi duhet të ishte vlerësuar nga gjykata nëse është rregulluar drejt ndërgjyqësia në raport me palën e paditur.

Sa më sipër, Kolegji konkludon se në rigjykim Gjykata e Apelit Vlorë detyrohet të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes duke sqaruar objektin dhe shkakun ligjor të padisë së paraqitur nga pala paditëse, t'i përgjigjet shkaqeve të ankimit të të paditurit për këtë pjesë, veçanërisht në drejtim sqarimit të të drejtës që gëzon pala e paditur mbi pasurinë objekt gjykimi, pra nëse pasuria vijon të jetë nën administrimin ose pronësinë e saj apo nëse këto të drejta i kanë kaluar personit të tretë. Si rrjedhojë vendimi duhet të priset dhe çështja të kthehet pranë kësaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2022-2058(315), datë 15.09.2022

KCGJL Vendim Nr.00-2021-139, datë 03.03.2021 (Gjyqvarësia)

Litispendenca apo gjyqvarësia lind në momentin që paraqitet padia në gjykatë në mënyrë të vlefshme, padi e cila është e pranueshme për gjykim dhe që prodhon proces gjyqësor në kushtet e vlefshme të procedueshmërisë, sipas nenit 153 të KPC. Si e tillë ajo zgjat për sa kohë zgjat vetë procesi gjyqësor. Ky i fundit nuk përfundon me vendimmarrjen përfundimtare apo jopërfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, pasi për sa kohë ekzistojnë në ligj mjetet e zakonshme të ankimit dhe ato mund të ushtrohen apo janë ushtruar, gjendja juridike e litispendencës e krijuar me paraqitjen e padisë në gjykatë do të ekzistojë aktive.

Fjalë kyçe: pengesa procedurale, parakushte vlefshmërisë së gjykimit, litispendentia, gjë e gjykuar, identitet juridik i njëjtë, bashkëpronësia

Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se shtetasit, I.B., i janë konfiskuar pronat, si i dënuar politik, sipas vendimit datë 14.04.1945 të Gjykatës Speciale të Tiranës[...] trualli me sipërfaqe 1428 m2, ndodhur në vendin e quajtur "B.K.", Elbasan.

Ka rezultuar se trashëgimlënësi, I.B. ka ndërruar jetë në vitin 1977 dhe nuk rezulton të ketë pasur fëmijë apo të ketë lënë testament. Ai ka qenë i martuar me znj. D.B., bashkëshortja pasjetuese. Rezulton se paditësi, S.M. është trashëgimtar ligjor i të ndjerës, Sh.M., e cila ishte vajza e S.B., motrës së paravdekur të trashëgimlënësit, I.B.. Nga ana tjetër, ka rezultuar se pala e paditur, E.R. është vëllai i bashkëshortes pasjetuese të trashëgimlënësit, D.B., e cila ka ndërruar jetë me datë 03.01.1988. Sipas kërkesës së palëve të interesuara, nga noteri, M.L., janë lëshuar dy dëshmi trashëgimie të ndryshme,

për të ndjerin I.B., duke u përcaktuar trashëgimtarë ligjorë të ndryshëm. [...]

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 9225/2004 [...] E.R. i është drejtuar me kërkesë, ZRKKP Elbasan, për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarit, I.B.. Kjo e fundit me vendimin nr. 76/2007, ka rrëzuar kërkesën, vendim i cili është lënë në fuqi nga Agjencia Qendrore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës. Në vijim, mbi padinë e kërkesës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur anulimin e këtyre vendimeve, duke i njohur të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen truall prej 1428 m², të ndodhur në vendin e quajtur “B.K.”. Me vendimin nr. 1173, datë 30.04.2008 të Gjykatës së Apelit Durrës është ndryshuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë, duke ju njohur pronësi paditësit E.R., me sipërfaqe 1391 m², është vendosur kthimi fizik për sipërfaqen 1333 m² dhe kompensimi për sipërfaqen 58 m².

Sa më sipër, z. E.R. ka regjistruar në emër të tij, pasurinë me sipërfaqe 1333 m² sipas vendimeve të mësipërme gjyqësore pranë ZVRPP Elbasan, e cila është regjistruar si pasuri e ndarë në dy pjesë, pasuria me nr. 11/91, me sipërfaqe 132 m² dhe pasuria me nr. 11/92, me sipërfaqe 1201 m². Në vijim, ka rezultuar se E.Sh., bashkë me Z.B. (trashëgimtar i të ndjerës A.B.), duke pretenduar qenien trashëgimtar ligjor të të ndjerit I.B., i janë drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kundër të paditurve E.R. dhe M.L., [...] Rezulton se znj. E.Sh., së bashku me paditësin në këtë gjykim, z.S.M., janë motër dhe vëlla, trashëgimtarë ligjorë të znj. Sh.M..

Me vendimin nr. 269, datë 08.03.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur rrëzimin e padisë dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 10-2018-2069 (808), datë 12.11.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga paditësja, E.Sh.. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me datë 08.02.2018 dhe ende nuk është shqyrtuar.

Në vijim, paditësi, S.M., duke pretenduar se është trashëgimtar ligjor i të ndjerit I.B., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Paditësi ka pretenduar se pasuritë objekt gjykimi janë regjistruar në emër të palës së paditur, E.R., si trashëgimtar e të ndjerit I.B., pa e pasur një cilësi të tillë. Sa më sipër paditësi, i është drejtuar gjykatës me padinë e kërimit të trashëgimit, [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e ndërmjetëm [...] ka vendosur: 1. Pranimin e kërkesës; Marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë, duke vendosur sekuestron konservative mbi: [...] duke ndaluar tjetërsimin e kësaj pasurie derisa vendimi gjyqësor në lidhje me këtë çështje të marrë formë të prerë. [...] Gjykata e Apelit Durrës, [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit** [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Duke u bazuar tek shkaqet e rekursit dhe tek parashtrimet e paditësit në kundërrekurs, para Kolegjit u shtrua për diskutim çështja, nëse gjykatat më të ulëta kanë pasur pengesë procedurale për shqyrtimin në themel të çështjes, çka kushtëzton edhe vlerësimin e kërkesës së paditësit mbi sigurimin e padisë.

Në kushtet ku prapësimi i palës së paditur mbi gjënë e gjykuar nuk është marrë në shqyrtim nga gjykatat më të ulëta, Kolegji ka vlerësuar të rëndësishëm dëgjimin e palëve dhe me vendim të ndërmjetëm ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë

gjyqësore. Një gjë e tillë është e lidhur me garantimin e standardit të vendosur nga GJEDNJ se respektimi i parimit të kontradiktoritetit dhe i të drejtës për tu dëgjuar merr rëndësi, sidomos në çështjet ku gjykata investohet kryesisht, me qëllim parandalimin e dhënies së vendimeve gjyqësore me efekt “surprizë” (*shih çështjen “Duralijski v. Bulgaria”, Nr. 45519/06, paragrafi 33-35, Vendim i GJEDNJ, datë 04.03.2014*).

Në rastin konkret, prapësimi mbi gjënë e gjykuar është ngritur nga pala dhe jo me iniciativë të gjykatës. Megjithatë standardi i GJEDNJ, i sjellë në vëmendje më sipër, i cili përbën një standard minimum, në kuadër të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse për proces të rregullt, është i aplikueshëm në rastin konkret, përsa kohë, mbi arsyetimin e gjykatave më të ulëta, tek palët ndërgjyqëse janë krijuar pritshmëritë se në lidhje me këtë pretendim të palës së paditur, gjykatat (qoftë me juridiksion fillestar apo edhe me juridiksion rishikues) do të duhet të shprehen në përfundim të gjykimit me vendim përfundimtar dhe jo gjatë shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë. [...]

Në lidhje me prapësimin e palës së paditur mbi gjënë e gjykuar dhe ligjshmërinë e vendimeve të ndërmjetme të gjykatave më të ulëta mbi sigurimin e padisë.

Kolegji vlerëson se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC, konkretisht, shkronja “b” dhe “c”, të cilat bëjnë të cënueshme vendimmarrjen e ndërmjetme të gjykatave më të ulëta.

Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, nuk janë interpretuar drejtë dispozitat e ligjit procedural në lidhje me pengesat procedurale dhe parakushtet për vlefshmërinë e gjykimit, sipas interpretimit të bërë në praktikën e mëparshme gjyqësore të Gjykatës së Lartë (*shih Vendim nr. 00-2020- 670, datë 02.10.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Ky interpretim i gabuar i ligjit nga gjykatat më të ulëta ka ndikuar edhe në marrjen e një vendimi të pabazuar në ligj, në lidhje me kërkesën e paditësit mbi sigurimin e padisë. Kolegji sjell në vëmendje se procesi gjyqësor civil apo administrativ kërkon ekzistencën e disa prezumimeve procedurale pozitive apo negative, në mënyrë që të mos shfaqen pengesa ligjore paprocedueshmërie (*shih nenin 299 të KPC*). Prezumimet procedurale pozitive janë ato kushte ligjore, pa të cilat procesi gjyqësor civil apo administrativ shuhet, si p.sh., vullneti i palëve për të proceduar. Nga ana tjetër, prezumimet procedurale negative janë ato kushte ligjore, të cilat nëse vërtetohen se ekzistojnë e shuajnë procesin. Ndryshe nga sa kanë konkluduar gjykatat më të ulëta, Kolegji vlerëson se, elementë të tillë të vlefshmërisë së procesit gjyqësor, sikurse janë gjëja e gjykuar, juridiksioni, kompetenca lëndore/funksionale, litispendenca etj., janë çështjet që duhet të verifikohen paraprakisht dhe të zgjidhen nga gjykatat, në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, si parakushte për gjykimin në themel të çështjes. Kolegji sjell në vëmendje nenin 451/a/2 të KPC, [...] Nga një interpretim literal i kësaj dispozite mund të konkludohet se, nëse do të verifikohet situata e gjësë së gjykuar, rigjykimi i çështjes është i ndaluar. Si rrjedhojë, padia e ngritur rishtazi mund të kualifikohet si një padi që nuk mund të ngrihet, pasi e drejta e padisë në kuptimin procedural dhe material është shuar për efekt gjykimi. Në bazë dhe për zbatim të nenit 299/c të KPC, gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen, në këtë rast, është e detyruar të pushojë menjëherë gjykimin, sapo vërtetohet një rrethanë e tillë.

Nën një parashikim ligjor eksplisit, të njëjtën pasojë juridike ka vërtetimi i situatës

së gjyqvarësisë (*litispendentia*). Në nenin 58 të KPC është parashikuar [...]Kolegji vlerëson se gjyqvarësia (*litispendentia*) është një ndër kushtet ligjore dhe prezumimet negative të procesit gjyqësor civil. Ajo nuk duhet të ekzistojë përgjatë procesit, pasi nëse vërtetohet se ekziston gjykimi i nisur, i dyti në kohë (*primus tempore potior est iure*) duhet të pushohet menjëherë. Ligji procedural nuk mundet të lejojë gjykimin e së njëjtës mosmarrëveshje, në të njëjtën kohë, nga dy trupa gjykues të ndryshëm.

Kolegji vlerëson se, gjëja e gjykuar dhe gjyqvarësia janë dy institute të së drejtës procedurale, të cilat në aspektin substancial ndjekin të njëjtin qëllim, që është ndalimi i gjykimit më shumë se një herë të së njëjtës çështjeje (*ne bis in idem*). Në themel të tyre qëndron marrëdhënia midis dy mosmarrëveshjeve gjyqësore me identitet të njëjtë juridik, sipas objektit, shkakut dhe palëve ndërgjyqëse.

Të dyja këto institute kanë si bazë sigurinë juridike dhe ndalimin e dhënies së vendimeve të ndryshme, për të njëjtën çështje. Qëllimi i tyre është qartësia juridike e titujve që formësohen në qarkullimin civil nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe gjë e gjykuar. Njëkohësisht përmes këtyre instituteve synohet të ruhet koherenca jurisprudenciale dhe e zgjidhjes gjyqësore të çështjeve. Ligjvënësi ka synuar të garantojë në qarkullimin civil parimin e sigurisë juridike të të drejtave dhe detyrimeve, duke synuar gjithashtu edhe eliminimin e krijimit fiktivisht të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimeve gjyqësore, gjë të gjykuar, sipas nenit 494 të KPC.

Kolegji vlerëson se ndryshimi midis këtyre instituteve është vetëm formal dhe qëndron tek faza procedurale, në të cilën ndodhen dy çështjet gjyqësore. Në rastin kur çështja përbën gjë të gjykuar, gjykimi i parë ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me të cilin janë përcaktuar me efekt prekluziv, të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqëse në marrëdhënien juridike materiale, objekt gjykimi. Ndërkohë, në situatën e gjyqvarësisë, mosmarrëveshja gjyqësore është ende në proces dhe, si rrjedhojë, ndalohet nisja e një gjykimi të dytë të çështjes me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt dhe shkak ligjor, në të njëjtën gjykatë ose në gjykata të ndryshme.

Neni 451/a/2 i KPC, si dispozitë e posaçme që rregullon institutin e gjësë së gjykuar, në ndryshim nga neni 58 i KPC, nuk e parashikon në mënyrë të shprehur se cila është pasoja që passjell për gjykimin, vërtetimi i kësaj rrethane penguese. Megjithatë, nëse ligjvënësi e ka parashikuar në mënyrë eksplicite në nenin 58 të KPC, se litispendenca është shkak për pushimin e gjykimit, akoma më tepër, të njëjtën pasojë juridike do të duhet të sjellë për gjykimin, rrethana e gjësë së gjykuar, si një fazë më e avancuar procedurale e gjykimit të parë, i cili tashmë ka përfunduar. Mbi bazën e kësaj analize, Kolegji vlerëson se nga pikëpamja e teknikës legjislative, KPC ka rregulluar në mënyrë të posaçme disa nga prezumimet procedurale absolute, si parakushte për vlefshmërinë e gjykimit, duke parashikuar shprehimisht edhe pasojën që sjell vërtetimi i tyre për procesin gjyqësor, sikurse është litispendenca, sipas nenit 58 të KPC, mungesa e juridiksionit gjyqësor, sipas nenit 59 e vijues të KPC etj.

Ndërkohë nën një rregullim më të përgjithshëm, neni 299 i KPC ka parashikuar të gjitha pengesat e tjera procedurale për shqyrtimin merititor të çështjes, të cilat kategorizohen, përgjithësisht, si rrethana që pengojnë ngritjen e padisë (padi që nuk

mund të ngrihen) apo si rrethana që pengojnë vazhdimin e gjykimit. Në një kuptim të përgjithshëm, gjyqvarësia apo mungesa e juridiksionit etj., janë rrethana që pengojnë ngritjen e padisë. Pra, paditë në të tilla rrethana mund të kualifikohen, përgjithësisht, si padi që nuk mund të ngrihen (*lato sensu*), por për to, ligjvënësi ka bërë një rregullim të posaçëm. Për të gjitha rastet e tjera, kur nuk ka një rregullim të posaçëm (*lex specialis*), do të gjejë zbatim neni 299 i KPC, (*lex generalis*). Pasoja që passjell për gjykimin, vërtetimi i rrethanave të tilla është vetëm pushimi i gjykimit me vendim jo përfundimtar, sipas nenit 127 të KPC. Përsa i përket fazës në të cilën gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen, duhet të konstatojë rrethana të tilla penguese, Kolegji vlerëson se ky operacion vlerësues i gjyqtarit që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të jetë i menjëhershëm dhe, nëse është e mundur, që në veprimet paraprake. Kështu, sipas nenit 158/a/2/e të KPC, gjyqtari me vendim, pa caktuar seancën përgatitore, vendos pushimin e gjykimit, nëse vërtetohet një nga rrethanat e parashikuara në nenin 299 të KPC. Në të njëjtën mënyrë, edhe gjykata me juridiksion rishikues që shqyrton mosmarrëveshjen, nëse nuk ka vepruar gjykata e shkallës së parë, menjëherë duhet të konstatojë pengesën dhe të disponojë me vendim jo përfundimtar mbi çështjen. Kolegji vlerëson se për të verifikuar rrethana të tilla penguese për gjykimin e mosmarrëveshjes, sikurse janë, gjëja e gjykuar apo gjyqvarësia, sipas rastit, nuk është e domosdoshme të shqyrtohet çështja në themel, por mjafton të verifikohet identiteti juridik i dy çështjeve, bazuar në elementët e dy padive që kanë konstituuar dy proceset gjyqësore (sipas shkakut, objektit dhe palëve). Kjo arrihet nëpërmjet një vlerësimi *prima facie*, pa qenë e nevojshme të gjykohet në themel padia e dytë.

Kolegji vlerëson se, nëse gjykata që gjykon mosmarrëveshjen gjendet para një pengese procedurale për shqyrtimin meritor të çështjes, *apriori* nuk mund të marrë në shqyrtim asnjë kërkesë të palëve gjatë gjykimit dhe nuk mund të marrë asnjë vendim të ndërmjetëm të vlefshëm, që i shërben zgjidhjes përfundimtare të çështjes. Sipas nenit 300 të KPC, nëse do të vërtetohej një nga prezumimet procedurale absolute që do t'i jepte shkak pushimit të gjykimit, çdo vendim i ndërmjetëm i gjykatës do të bëhej nul me vendimin e pushimit të gjykimit.

Akoma më tepër merr rëndësi një vlerësim i tillë nga gjykatat, kur bëhet fjalë për kërkesat e palës paditëse për sigurim padie, sipas neneve 202 e vijues të KPC. Vendimi i gjykatës që pranon kërkesa të tilla përbën kufizim të drejtave substanciale, kushtetuese dhe ligjore të palës së paditur, gjatë gjykimit, sikurse mund të jetë e drejta e pronës etj., në varësi të llojit të masave kufizuese. [...]

Në këtë kuptim, mund të sigurohen me masë sigurimi, në kushtet e neneve 202 e vijues të KPC, vetëm paditë që janë të afta ligjërisht të provokojnë nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar, që mund të shndërrohet në titull ekzekutiv. Nëse një padi nuk mund të ngrihet *ab initio* dhe të jetë e aftë të shndërrohet në një vendim gjyqësor përfundimtar, e më tej në titull ekzekutiv, nëpërmjet gjykimit, nuk plotësohen parakushtet themelore për vendosjen e masës së sigurimit. Në këtë kuptim, nuk mund të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm mbi bazueshmërinë e kësaj padie në kuptimin material, nëse ajo nuk mund të shqyrtohet në kuptimin procedural. Si rrjedhojë *apriori* nuk ekziston rreziku eminent se ekzekutimi i vendimit përfundimtar të gjykatës do të bëhet

i pamundur ose i vështirë. Çdo lloj mase sigurimi e marrë nga gjykatat, në lidhje me padi që nuk mund të ngrihen, përbën kufizim pa ligj dhe të pajustificuar të të drejtave kushtetuese apo ligjore të palës së paditur, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

Duke iu kthyer rastit konkret, para Kolegjit, u shtruan për diskutim disa çështje:

Së pari, nëse ka identitet juridik të njëjtë, midis çështjes konkrete dhe çështjes së mëparshme gjyqësore, me paditës znj. E.Sh. etj, kundër palës së paditur, z. E.R., shqyrtimi i të cilës ka përfunduar me vendimin nr. 808, datë 12.11.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës; Nëse është ky vendim i detyrueshëm për paditësin, z. S.M., në kushtet kur ai nuk është legjitimuar formalisht si palë në këtë gjykim;

Së dyti, nëse çështjet janë identike, a ka marrë vendimi nr. 808, datë 12.11.2018 i Gjykatës së Apelit Durrës statusin “*gjë e gjykuar*”, në kushtet kur ndaj tij është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, apo jemi në situatën e gjyqvarësisë (litispendencës), sipas nenit 58 të KPC. Për të konkluduar mbi këto çështje të shtruara për diskutim, Kolegji vlerësoi të marrë në analizë identitetin juridik të dy padive, sipas elementëve karakterizues të tyre, shkakut, objektit dhe palëve ndërgjyqëse.

Në çështjen e mëparshme, paditësit, E.Sh. dhe Z.B. kanë kërkuar nëpërmjet padisë njohjen bashkëpronar (bashkëtrashëgimtar) dhe kthimin fizik të sendit të paluajshëm, pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit I.B. (i njëjtë me objektin material të këtij gjykimi), duke vepruar në emër dhe për llogari të paditësit .M. (objekti i padisë). Paditësit në këtë gjykim kanë pretenduar qenien bashkëpronar (bashkëtrashëgimtar ligjor) të trashëgimlënësit I.B. dhe përjashtimin si trashëgimtar ligjor të palës së paditur E.R., i cili sipas tyre, ka fituar pasurinë trashëgimore me cilësinë e trashëgimtarit ligjor, pa qenë i tillë (shkaku i padisë). Si rrjedhojë ato kanë kërkuar deklarinimin e pavlefshmërisë së dëshmisë së trashëgimisë përkatëse ligjore të noteres dhe rregullimin e çdo pasoje që ka ardhur nga kjo dëshmi. Kolegji vlerëson se në thelb padia e mëparshme ka patur për objekt kërkimin e trashëgimit, sipas nenit 349 të KC. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se me të njëjtën padi, sipas shkakut dhe objektit, në lidhje me të njëjtën pasuri trashëgimore që i përkiste trashëgimlënësit I.B., i është drejtuar gjykatës paditësi, S.M., në çështjen konkrete, kundrejt të njëjtës palë të paditur, E.R.. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson të marrë në analizë edhe identitetin juridik të paditësve në dy çështjet gjyqësore, në kushtet kur padia e parë nuk është ngritur nga paditësi S.M., në çështjen konkrete. Kolegji vlerëson se, edhe pse paditësi, S.M. nuk ka qenë fizikisht palë në gjykimin e mëparshëm, ai ka qenë juridikisht i i tillë, për shkak të ligjit (*ipso legge*). Sikurse ka rezultuar nga aktet e fashikullit të gjykimit, në procesin e mëparshëm, padia është ngritur nga dy prej bashkëpronarëve (bashkëtrashëgimtarëve) pretendent, me qëllim që sendet objekt gjykimi t’u ktheheshin të gjithëve. Pra, në padinë e parë, paditësit E.Sh. etj., kanë vepruar edhe në emër dhe për llogari të bashkëpronarit tjetër pretendent, S.M..

Fillimisht Kolegji sjell në vëmendje, konceptin e bashkëpronësisë sipas nenit 199 të KC, i cili e përkufizon si një gjendje juridike kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave. Në këtë marrëdhënie juridike, midis bashkëpronarëve vepron rregulli i unitetit. Kjo do të thotë se në raport me të tretët, bashkëtitullarët e së drejtës reale, juridikisht veprojnë si një palë e vetme,

pasi e drejta mbi sendin ose sendet është e përbashkët dhe e pandarë.

Në të njëjtën logjikë, edhe në marrëdhënien juridike procedurale apo në konfliktet gjyqësore me të tretët, ato veprojnë juridikisht dhe unanimisht si një palë e vetme. Kjo është *ratio* e parashikuar në nenin 162 të KPC, ku thuhet se në bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme, ku të gjitha palët për shkak të ligjit konsiderohen si një e vetme e pandarë, veprimet e njërit bashkëndërgjyqës sjellin efekte për të gjithë.

Në vijim të kësaj analize, Kolegji sjell në vëmendje nenet 200/d dhe 296 të KC, ku parashikohet se, një nga të drejtat e secilit bashkëpronar është të ngrejë padinë e kërimit të sendit të përbashkët, kundrejt çdo poseduesi të paligjshëm, me kushtin që tua kthejë të gjithëve. Një e drejtë e tillë i përket edhe çdo bashkëtrashëgimtari për të ngritur padinë e kërimit të trashëgimit sipas nenit 349 të KC. Kolegji vlerëson se këto dy dispozita kanë pasur si qëllim të garantojnë të drejtën për pronë dhe mbrojtjen e saj gjyqësore, nga secili prej bashkëpronarëve, kundrejt çdo poseduesi të paligjshëm, edhe në kushtet ku bashkëpronarët e tjerë janë neglizhentë apo nuk tregojnë diligjencën e duhur në mbrojtjen e saj. Nga ana tjetër, secili bashkëpronar në këtë padi, nuk vepron në emër dhe për llogari të interesave vetjake; në të kundërt nuk do të kishte legjitimitet të kërkonte pjesën e bashkëpronarëve të tjerë, sipas neneve 31 dhe 95 të KPC. Kjo parashikohet në mënyrë literale në nenin 200/d të KC, në togfjalëshin: [...] Ky togfjalësh, në të dyja dispozitat, nënkupton se ligji nuk i jep legjitimitet të pavarur gjithsecilit prej bashkëpronarëve për të ngritur padi për kthimin e sendit sa herë që janë të pakënaqur nga vendimi gjyqësor (në eventualitetin e rrëzimit të padisë). Kolegji sjell në vëmendje, në mënyrë hipotetike situatën ku ka shumë bashkëpronarë dhe teorikisht do të kishte padi, aq sa bashkëpronarët janë në numër. Në këtë situatë, pala e paditur do të ishte e destinuar përjetësisht të qëndronte në procese gjyqësore, duke patur pasiguri absolute mbi të drejtën e pronës.

Në të njëjtën mënyrë, në situatën e kundërt, vendimi gjyqësor që është i favorshëm (në eventualitetin e pranimit të padisë), përbën titull ekzekutiv për të gjithë dhe secili mund të vejë në lëvizje ekzekutimin e detyrueshëm të tij edhe pse nuk është legjitimuar formalisht si palë në gjykim, pa qenë e nevojshme të iniciojë një proces tjetër gjyqësor, kundrejt poseduesit të sendit. Në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet se vendimi gjyqësor është gjë e gjykuar dhe detyruar për bashkëpronarët, vetëm nëse është i favorshëm për ta.

Kolegji vlerëson se këto dy dispozita të KC do të duhet të interpretohen në mënyrë sistematike me nenin 162/2 të KPC dhe, po ashtu, në mënyrë pajtuese me të drejtat kushtetuese dhe konventore të palës kundërshtarë për siguri juridike mbi të drejtën e pronës. Nëse mosmarrëveshja është konkluduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ajo nuk mund të rivihet në diskutim. Sipas nenit 162/2 të KPC, në bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme, sikurse është rasti i bashkëpronësisë, veprimet procedurale të kryera nga njëri bashkëndërgjyqës sjellin efekte për të gjithë, qoftë kur favorizojnë apo qoftë kur rëndojnë pozitën e atyre që nuk kanë vepruar. Si rrjedhojë, nëse padia e kthimit të sendit (padia e rivendikimit sipas nenit 296 të KC, ashtu edhe padia e kërimit të trashëgimit sipas nenit 349 të KC) është ngritur nga njëri bashkëpronarët, ajo sjell efekte për të gjithë, marrëdhënia juridike procedurale me gjykatën dhe palën kundërshtarë ka lindur për të gjithë dhe vendimi gjyqësor do të jetë i detyrueshëm për të gjithë, për shkak të ligjit.

Në këtë kuptim, Kolegji konkludon se, rasti i parashikuar në nenin 200/d të KC është një nga rastet e përfaqësimit ligjor, ku njëri nga bashkëpronarët mund të ngrejë padinë e kthimit të sendit edhe për llogari të bashkëpronarëve të tjerë dhe tagri për të ngritur padi i buron nga ligji.

Sa më sipër, duke interpretuar nenet 200/d dhe 296 të KC, në pajtim edhe me të drejtën për proces të rregullt të secilit bashkëpronar, sipas nenit 6 të KEDNJ dhe 42 të Kushtetutës [...] për tu dëgjuar para se të gjykohet, Kolegji vlerëson se çdo bashkëpronar në këtë lloj procesi, edhe në kushtet ku padia nuk është ngritur prej tij, por në emër dhe për llogari të tij, ka të gjitha të drejtat procedurale që i njihen palës ndërgjyqëse në këtë pozicion, për tu paraqitur në atë gjykim, për të parashtruar mbrojtjen, për të bërë kërkesa, për të ankimuar vendimin gjyqësor, për ta ekzekutuar atë, në kushtet e parashikuara në nenet 161 dhe 162 të KPC.

Në rastin konkret, Kolegji konstaton se, çështja e parë, me paditës E.Sh. etj., gjendet për shqyrtim para Gjykatës së Lartë. Duke patur parasysh konkluzionet e Vendimit Unifikues nr. 2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara, se çështja merr statusin gjë e gjykuar, pasi të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë, Kolegji vlerëson se, gjykata që po shqyrton mosmarrëveshjen e dytë me paditës S.M., nuk gjendet para pengesës procedurale të gjësë së gjykuar, por para situatës së gjyqvarësisë (litispencencës), sipas nenit 58 të KPC. Në këtë linjë arsyetimi para Kolegjit u shtrua për diskutim çështja nëse neni 58 i KPC gjen zbatim për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në gjykatat e të njëjtit nivel apo edhe në shkallë të ndryshme të gjykimit. Kolegji risjell edhe një herë në vëmendje *ration* e nenit 58 të KPC dhe të institutit të gjyqvarësisë, si një ndalesë ligjore e zhvillimit të proceseve gjyqësore paralele dhe të njëjta njëkohësisht, përmes së cilës ligjëvënësi synon të garantojë në qarkullimin civil parimin e sigurisë juridike të të drejtave dhe detyrimeve. Litispencenca apo gjyqvarësia lind në momentin që paraqitet padia në gjykatë në mënyrë të vlefshme, padi e cila është e pranueshme për gjykim dhe që prodhon proces gjyqësor në kushtet e vlefshme të procedueshmërisë, sipas nenit 153 të KPC. Si e tillë ajo zgjat për sa kohë zgjat vetë procesi gjyqësor. Ky i fundit nuk përfundon me vendimmarrjen përfundimtare apo jopërfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, pasi neni 43 i Kushtetutës dhe neni 442/a dhe 443 i KPC kanë ofruar në disponibilitetin e palëve ndërgjyqëse mjete të zakonshme ankimi. Mjetet e zakonshme të ankimit, konkretisht apeli dhe rekursi, synojnë dhe kanë aftësinë që të parandalojnë marrjen e cilësisë të gjësë së gjykuar (*res judicata*) të vendimit gjyqësor mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt konflikti gjyqësor. Për rrjedhojë konkludohet natyrshëm se, për sa kohë ekzistojnë në ligj mjetet e zakonshme të ankimit dhe ato mund të ushtrohen apo janë ushtruar, gjendja juridike e litispencencës e krijuar me paraqitjen e padisë në gjykatë do të ekzistojë aktive. Ky institut procedural, nëpërmjet garantimit të pavarësisë së brendshme gjyqësore, mbron edhe parimin e gjyqtarit natyral të çështjes dhe e ruan këtë figurë në çdo fazë dhe shkallë gjykimi. Si e tillë, nuk mund të pretendohet se kjo gjendje apo këto parime mbrohen vetëm në shkallën e parë të gjykimit. Përkundrazi, këto parime dhe ky rregull zbatohen në mënyrë identike në çdo fazë dhe shkallë gjykimi.

Sa më sipër, në rastin konkret, Kolegji konkludon se gjykata e shkallës së parë,

para se të merrte në shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë, duhet të verifikonte pretendimin e palës së paditur mbi gjënë e gjykuar, nëse mosmarrëveshja e parë kishte përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjë e gjykuar apo nëse ishte në situatën e gjyqvarësisë. Me verifikimin e këtij parakushti për vlefshmërinë e procesit gjyqësor, duhet të vendoste pushimin e gjykimit. Në të njëjtën mënyrë, edhe gjykata e apelit, gabimisht ka vlerësuar se ky element verifikohet në përfundim të gjykimit, duke lënë në fuqi vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë, mbi sigurimin e padisë. Sikurse rezultoi nga verifikimi i Kolegjit, nëpërmjet sekretarisë gjyqësore, tashmë gjykimi në shkallë të parë i mosmarrëveshjes ka vijuar dhe ka konkluduar me vendim përfundimtar të gjykatës, ku është vendosur rrëzimi i padisë, për shkakun se çështja përbën gjë të gjykuar. Gjykata e shkallës së parë, ka disponuar edhe për heqjen e masës së sigurimit të padisë, ndërkohë që ky vendim, sipas nenit 211 të KPC, sjell efektet pasi të marrë formë të prerë. Mbi ankimin e ushtruar ndaj tij, tashmë shqyrtimi i mosmarrëveshjes gjendet në Gjykatën e Apelit Durrës.

Kolegji vlerëson se në kushtet kur objekt rekursi është vetëm vendimi i ndërmjetëm i gjykatës së shkallës së parë mbi sigurimin e padisë, nuk mund të disponohet me vendim jo përfundimtar mbi çështjen e themelit, duke prishur edhe vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, sepse kjo detyrë, sipas parimit të respektimit të shkallëve të pushtetit gjyqësor, i mbetet Gjykatës së Apelit Durrës, si gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen, në bazë të nenit 466/c të KPC.

Në lidhje me mënyrën se si duhet të disponojë Kolegji

Në këtë rast, objekt rekursi është një ankim i veçantë mbi një vendim të ndërmjetëm të gjykatave më të ulëta, me të cilin është vendosur në lidhje me kërkesën e paditësit për sigurimin e padisë. Tashmë në praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë (Kolegjit Civil dhe Kolegjit Administrativ) është mbajtur qëndrimi se ankimet e veçanta që shqyrtohen sipas nenit 470 të KPC, ndjekin një regjim të posaçëm mbi ritin e gjykimit, kohën e shqyrtimit të tyre dhe për mënyrën e disponimit nga Gjykata e Lartë (*shih Vendimin nr. 00-2021-16, datë 08.01.2021 dhe Vendimin nr. 00-2021-15 (4), datë 18.01.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe Vendimin nr. 00-2020- 728, datë 26.11.2020, Vendimin nr. 00-2020-704, datë 26.11.2020, Vendimin nr. 00-2020- 696, datë 25.11.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*) [..]

Mbi këtë analizë juridike, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se rregullat e disponimit të gjykatës rishikuese mbi vendimet e ndërmjetme, të cilat ankimohen me ankime të veçanta, sipas nenit 470 të KPC, janë të ndryshme nga rregullat që regjojnë disponimet e gjykatës rishikuese ndaj vendimeve përfundimtare, objekt ankimi, respektivisht sipas nenit 466, 480 dhe 485 të KPC. Këto dispozita do të zbatohen për aq kohë sa pajtohen me gjykimin e posaçëm të ankimeve të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetme. Ligjvënësi ka parashikuar se brenda 30 ditëve nga momenti i regjistrimit të çështjes në gjykatën rishikuese do të duhet që ankimi i veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të marrë një zgjidhje, me qëllim që të garantohet mbarëvajtja e procesit gjyqësor kryesor dhe se kjo mbarëvajtje mund të garantohet vetëm duke kuptuar se vendimi i ndërmjetëm, objekt ankimi, në çdo rast do të duhet të marrë një përgjigje përfundimtare, në mënyrë që kjo çështje të jetë e zgjidhur

juridikisht. Në këtë kuadër Kolegji sjell në vëmendje një praktikë edhe më të hershme të Gjykatës së Lartë, kur është konkluduar se për vendimet e ndërmjetme objekt rekursi, nuk zbatohen rregullat e përgjithshme në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, për shkak se ato kanë karakter urgjent dhe do të duhet të gjykohen me shpejtësi. Këto vendime nuk mund të prishen dhe të kthehen për rigjykim, sipas nenit 467 të KPC, por për to duhet të konkludohet përfundimisht nga Gjykata e Lartë. Konkretisht, me vendimin nr. 00-2006-363 (849), datë 29.06.2006, [...] Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, me vendimin e ndërmjetëm të marrë nga gjykata e shkallës së parë, lënë në fuqi nga gjykata e apelit, është vendosur sigurimi i padisë në kundërshtim me ligjin, pasi është siguruar një padi që nuk mund të ngrihet, për shkak të pengesës procedurale të gjyqvarësisë. Si rrjedhojë, zgjidhja e çështjes përfundimisht nga Gjykata e Lartë, që përputhet edhe me interesin e palës së paditur për të bërë rekurs, do të ishte ndryshimi i vendimeve dhe anulimi i masës së sigurimit të padisë.

IX. Mosmarrëveshje trashëgimie

KCGJL Vendim Nr.00-2023-1002(161), datë 27.03.2023 (Përjashtim trashëgimtar ligjor)

Përjashtimi nga trashëgimi, mund të bëhet si në mënyrë të shprehur duke përcaktuar nominalisht personat që do të përjashtohen ashtu edhe në mënyrë të heshtur nëpërmjet përcaktimit të rrethit të trashëgimtarëve testamentarë, duke mos përfshirë personat që do të përfitonin nëse do të zbatohet trashëgimia ligjore. Një mënyrë e tillë interpretimi është në përputhje me qëllimin e ligjvënësit në parashkimet për rezervën ligjore sipas nenit 379 të KC, pasi synimi i rezervës ligjore në dobi të fëmijëve është mbrojtja e të miturve, qoftë kur ata janë fëmijët e mitur të trashëgimlënësit, qoftë kur ata janë fëmijë të mitur të fëmijëve të tij.

Fjalë kyçe: pavlefshmëri testamenti, instituti i rezervës ligjore

Rrethanat e çështjes:

Paditësja M.L. është në marrëdhënie të posaçme, me të paditurit (motër vëllezër). Me datë 17.04.2012 ka vdekur nëna e palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datë 21.02.2013 ka vdekur babai i tyre.

Nga provat në dosje rezultoi se i ati i paditëses S.B. në të gjallë të tij ka vendosur të disponojë me testament pasurinë e tij në favor të vajzës së tij, paditëses M.B. me testamentin nr. 54, datë 17.08.2012. Me kërkesën e paditëses është bërë nga noteri procesverbali Nr.1117 Rep., Nr.354/3 Kol., datë 09.09.2013 për çelje testamenti. Mbi bazën e këtij procesverbali nga ana e noterit, [...] është bërë lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare për trashëgimlënësin [...] paditësja ka paraqitur dokumentat pranë ZVRRPP Durrës për të reregjistruar pasurinë e fituar me testament.

Nga ana e ZVRRPP Durrës nuk është bërë regjistrimi i kësaj dëshmie testamentare

pasi në regjistrat e kësaj zyre figuron i reregjistruar vendimi nr.1260, datë 09.05.2013, me të cilin është vendosur “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerën F.B. vdekur me datë 17.04.2012, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të saj: Bashkëshortin e saj S.B. dhe fëmijët B.B., R.B., M.B., M.L, të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga 1/5 pjesë të pasurisë trashëgimore të të ndjerës, me të drejtat e detyrimit brenda vlerës së pasurisë që trashëgojnë. Të lëshojë dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerin S.B., [...] duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjore të rradhës së parë, fëmijët e tij të quajtur: B.B., R.B., M.B, M.L të cilët trashëgojnë të gjithë në mënyrë të barabartë nga 1/4 pjesë secili, me të drejtat e detyrimit brenda vlerës së pasurisë që trashëgojnë.” Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar gjykatës me padinë [...], duke kërkuar nga të paditurit që të njihet si trashëgimtare e vetme e pasurisë së lënë nga trashëgimlënësit sipas dëshmisë së trashëgimisë testamentare Nr.565 Rep., Nr.177/2 Kol., datë 28.05.2015. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës [...] ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së [...]Detyrimin e të paditurve [...]të njohin paditësen si trashëgimtare të vetme të pasurisë së trashëgimlënësit [...]Rrëzimin për pjesën tjetër të objektit të padisë.[...]

Gjykata e Apelit Durrës, [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi. [...]

Nga shqyrtimi i provave të marra gjatë gjykimit, si dhe mbi bazën e vlerësimit të pretendimeve dhe prapësimeve të palëve dhe vendimeve të gjykatave të faktit Kolegji vlerëson se, gjykata e apelit e ka kthyer çështjen për rigjykim në shkallë të parë me arsyetimin se nuk është pranuar për shqyrtim kundërpadia e paraqitur nga pala e paditur, nuk është hetuar nga gjykata lidhur me cenimin e rezervës ligjore dhe nëse në kohën e çeljes së trashëgimisë testatori ka patur fëmijë të mitur që hyjnë në trashëgim me zëvendësim të thirren në cilësinë e personit të tretë. Kolegji vlerëson se nga gjykata e shkallës së parë, mospranimi për shqyrtim i kundërpadisë, është marrë në interpretim të gabuar të dispozitave procedurale civile. Sipas nenit 160 të KPC[...]

Gjykata në interpretim dhe zbatim të drejtë të nenit 160 të KPC-së, ka detyrimin që ta trajtojë pranimin për shqyrtim të kundërpadisë njësoj sikurse edhe ajo vepron në rastin e padisë. Në këtë drejtim edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur me vendimet unifikuese nr.901, datë 14.07.2000, dhe nr.4, datë 01.02.2006 se e vetmja veçanti e kundërpadisë, njëkohësisht kusht shtesë për efekt të pranueshmërisë për shqyrtim të saj në një çështje që është duke u gjykuar, është se kërkimi i kundërpadisë duhet të ketë lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi. Kushdo ka të drejtën kushtetuese të ngrejë padi në gjykatë për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij. Nëse ato kërkime të ngritura në padi qëndrojnë, nëse kanë mbështetje në ligj dhe në prova, kjo është një aspekt që gjen zgjidhje dhe gjykata vendos

me vendim përfundimtar pasi e ka shqyrtuar çështjen.

Rezulton se pala e paditur ka paraqitur kundërpadi në gjykimin e shkallës së parë duke kërkuar pavlefshmërinë absolute të testamentit në $\frac{3}{4}$ pjesë për shkak të cenimit të rezervës ligjore të trashëgimtarit të mitur dhe njohjen si bashkëpronarë të palës së paditur për pasuritë testamentare që kanë cenuar rezervën ligjore [...] e cila nuk është pranuar për gjykim nga gjykata me arsyetimin se nuk mund të aplikohet neni 160 i KPC dhe mund të qëndroj si padi më vete [...] Pavarësisht se Kolegji e vlerëson të gabuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë lidhur me mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë, pretendimet e palës së paditur për pavlefshmërinë absolute të testamentit për cenim të rezervës ligjore dhe njohjen bashkëpronar në pasurinë objekt trashëgimi testamentare mund të shtrohen dhe në formën e prapësimeve dhe gjykata ishte e detyruar të hetonte dhe t'iu jepet përgjigje pretendimeve nëse në kohën e çeljes së trashëgimisë testatori ka patur fëmijë të mitur që hyjnë në trashëgim me zëvendësim. Nëse gjykata konkludon se është cenuar rezerva ligjore, gjykata e konstaton kryesisht ose dhe me anë të prapësimeve të palëve, pavlefshmërinë e testamentit që cenon këtë pjesë, të cilat mund të shqyrtoheshin nga gjykata dhe të disponohet për njohjen trashëgimtare të paditëses pjesërisht, duke përjashtuar pjesën që cenonte rezervën ligjore e parashikuar nga neni 379 i KC [...]

Neni 361, paragrafi i dytë, ku referon kjo dispozitë, [...] Në kuptim të dispozitave të sipërcituara që rregullojnë institutin e rezervës ligjore, rezulton se ai paraqitet në dy forma: i) Rezerva ligjore që pengon testatorin “*të përjashtojë nga trashëgimia fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim, si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim*”. Në këtë rast, bëhet fjalë për përjashtim të shprehur nga ana e testatorit. ii) Forma e dytë e këtij instituti paraqitet në rastet kur trashëgimlënësi disponon me testament pasurinë e tij, duke cenuar “*me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore*”. Në këtë rast testatori nuk shprehet posaçërisht për përjashtimin, por përjashtimi rezulton nga përmbajtja e testamentit. Të dy këto forma të shfaqjes së rezervës ligjore, si ajo në formën e përjashtimit të trashëgimtarëve ligjore nga trashëgimia, ashtu dhe ajo e shfaqur nëpërmjet disponimit të pasurisë me testament nga trashëgimlënësi (cënimi i rezervës ligjore me anë testamenti), pasjellin të njëjtën pasojë juridike, pavlefshmërinë e testamentit, për pjesën që ka cenuar rezervën ligjore.

Nga ana tjetër, që rezerva ligjore të ekzistojë juridikisht, pavarësisht nga forma e shfaqjes, duhet të plotësohen disa kushte. Trashëgimlënësi, në kohën e çeljes së trashëgimisë, duhet: Së pari: i) Të ketë fëmijë të mitur të cilët nuk mund t'i përjashtojë nga trashëgimia ligjore për asnjë arsye, “përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar”; ii) Të ketë trashëgimtarë të tjerë të mitur të cilët trashëgojnë me zëvendësim (neni 361/2); iii) Të ketë trashëgimtarë të paaftë për punë (neni 371); iv) Të ketë persona të tjerë të paaftë për punë, “të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij” (nenet 360, 363, 364). Së dyti, që personat e përcaktuar në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të cilët testatori nuk mund t'i përjashtojë nga trashëgimia, si dhe personat e tjerë të paaftë për punë të jenë përfitues të rezervës ligjore, duhet të

plotësojnë dhe dy kushte ligjore: i) **Të mos jenë bërë apo shpallur të padenjë për të trashëguar: ii) Të thirren në trashëgim.**

Trashëgimi me zëvendësim ndodh kur në trashëgim nuk thirret ai person që duhet thirrur drejtpërdrejt, por thirren të paslindurit e tij. Këta quhen trashëgimtarë me zëvendësim. Trashëgimi me zëvendësim në të drejtën tonë është i kufizuar. Ai gjen zbatim vetëm për fëmijët e fëmijëve dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të paravdekur. Zëvendësimi lejon vënien e zëvendësuesit në vendin, shkallën dhe në të drejtat e atij që zëvendëson. Në çështjen objekt shqyrtimi paraqet rëndësi rasti i rezervës ligjore duke hetuar gjykata nëse në kohën e vdekjes së testatorit ka pasur fëmijë të mitur të cilët përfitojnë për shkak të përjashtimit nga trashëgimia ligjore, nëpërmjet testamentit, të prindërve të tyre. Përjashtimi nga trashëgimi, mund të bëhet si në mënyrë të shprehur duke përcaktuar nominalisht personat që do të përjashtohen ashtu edhe në mënyrë të heshtur nëpërmjet përcaktimit të rrethit të trashëgimtarëve testamentarë, duke mos përfshirë personat që do të përfitonin nëse do të zbatoheshin trashëgimia ligjore. Një mënyrë e tillë interpretimi është në përputhje me qëllimin e ligjvënësist në parashkimet për rezervën ligjore sipas nenit 379 të KC, pasi synimi i rezervës ligjore në dobi të fëmijëve është mbrojtja e të miturve, qoftë kur ata janë fëmijët e mitur të trashëgimlënësist, qoftë kur ata janë fëmijë të mitur të fëmijëve të tij.

Në analizë si më sipër, rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar dhe hetuar të gjitha kërkimet dhe prapësimet që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes, duke mos hetuar dhe vlerësuar nëse është cenuar rezerva ligjore, gjë që përbën shkak sipas nenit 467/e, të KPC që çështja të dërgohet për rigjykim në shkallë të parë dhe vendimi nr.111, datë 14.02.2017 i Gjykatës së Apelit Durrës të lihet në fuqi.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2023-3267(399), datë 20.06.2023

KGJL Vendimin Nr. 00-2023-3267(399), datë 20.06.2023 (Rrethi trashëgimtarëve me zëvendësim)

Instituti i rezervës ligjore i parashikuar në KC siguron mbrojtje të detyrueshme të trashëgimisë ligjore për ta vetëm kur këta trashëgimtarë me zëvendësim janë të mitur ose të paafte për punë duke i ndaluar trashëgimlënësist përjashtimin e tyre nga trashëgimia. Në kushtet kur ata nuk kanë asnjë cilësi të tillë, përjashtimi i tyre nga trashëgimia nuk bie ndesh me nenin 379 të KC dhe as mund të përbëjë shkak për lindjen e trashëgimisë ligjore të detyrueshme, pra të rezervës ligjore në favor të pasardhësve të tyre. Këta të fundit përderisa nuk janë trashëgimtarë me zëvendësim nuk gëzojnë cilësinë e trashëgimtarëve rezervatarë.

Fjalë kyçe: testament, instituti i rezervës ligjore, trashëgimtarëve rezervatarë, përjashtim nga trashëgimia

Rrethanat e çështjes:

Rezultoi se paditësit në këtë gjykim janë nipërit e trashëgimlënësist H.P., i cili ka

qenë vëllai i palës së paditur në këtë gjykim, L.M..

Paditësit kanë pretenduar se gjyshi i tyre H.P. dhe motra e tij L.M janë trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të të ndjerit K.P. i cili ka ndërruar jetë në datën 20.06.2006.

[..] ka rezultuar i provuar fakti se, i ndjeri K.P. nga martesë me shtetasen E.P. ka pasur 2 fëmijë, vajzën L.M. dhe djalin H.P.. I ndjeri H.P. ka vdekur në vitin 1998, pra përpara trashëgimlënësit K.P. Gjithashtu, ka rezultuar se nga martesë e të ndjerit H.P. me L.P. kanë lindur tre fëmijë dhe konkretisht A.P., L.P. si dhe D.P.

Nga martesë e A.P. me P.J kanë lindur paditësit: (i) A.J. i datëlindjes 15.12.1994 dhe A.J. i datëlindjes 02.08.2004; nga martesë e L.P. me O.C. ka lindur fëmija A.C. i datëlindjes 12.06.2003, dhe nga martesë e D.P. me L.D. kanë lindur fëmijët Dh.D. e datëlindjes 08.09.2005 dhe K.D. i datëlindjes 02.09.2010.

Përpara se i ndjeri K.P. të ndërronte jetë, rezultoi të ketë disponuar për pasuritë e tij me anë të testamentit, konkretisht aktit noterial me nr. 592, datë 28.06.2005.

Me procesverbalin noterial nr. 953/2, datë 24.09.2007 [..] është çelur testamenti dhe ka rezultuar pa ndryshime a revokime të mëpasme. Në tërësi nga përmbajtja e testamentit rezultoi se testatori ka shprehur me gjallje vullnetin e tij që e gjithë pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme t'i kalojë pas vdekjes së tij, të bijës së tij L.M. Gjykata e Rrethit Elbasan me vendimin nr.1747, datë 04.10.2007 ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë testamentare të K.P. duke përcaktuar të bijën e tij L.M. si të vetmen trashëgimtare testamentare për të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të testatorit. Bazuar në aktin e dëshmisë testamentare, pala e paditur në këtë gjykim L.M. ka tërhequr pranë të paditurit Ministria e Financave në datat 18.05.2009 dhe 25.06.2013 shumat respektive në masën prej 674,300 lekë dhe 674,376 lekë, shumata të cilat kanë përfaqësuar dëmshpërblimin për shkak të përfitimit nga Ligji nr. 9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", meqenëse e kishte këtë status.

Nga ana tjetër ka rezultuar se shtetasja L.C. i është drejtuar me kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerit K.P. Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila, me vendimin civil nr. 2127, datë 17.03.2010 ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit K.P. duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore të radhës së parë vajzën e tij (të paditurën L.M) trashëgimtare ligjore të 3/6 pjesë dhe nga 1/6 pjesë mbesat e tij (vajzat e djalit të para vdekur H.P.) [..]

Shtetaset A.J. L.C., D.P. rezultojnë të kenë aplikuar pranë Ministrisë së Financave për të tërhequr dëmshpërblimin që gjyshi i tyre K.P. duhet të përfitonte si i përndjekur politik në bazë të ligjit [..] Nga ana e palës së paditur [..] ju është bërë me dije se ky dëmshpërblim është përfituar nga halla e tyre L.M.

Bazuar sa më sipër, paditësit në këtë gjykim, pra që janë stërnipërit e të ndjerit K.P. [..] i janë drejtuar Gjykatës [..] me padinë objekt shqyrtimi, duke pretenduar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit nr. 592, datë 28.06.2005 të trashëgimlënësit në masën 1/2 të tij, si dhe detyrimin e Ministrisë së Financave të njohë të drejtën për dëmshpërblimin që përfiton trashëgimlënësi [..] si ish i përndjekur politik duke i paguar pjesën tonë takuese. [..]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur deklarinimin jo kompetente nga pikëpamja tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes [...] Kalimin e kësaj çështje për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, [...] ka vendosur pranimin e padisë pjesërisht. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesëshme të veprimit juridik testamenti i testatorit [...] vetëm sa i përket cenimit të të drejtës së rezervës ligjore të paditësve [...] -Detyrimin e të paditurës L.M. tu kthejë paditësve shumat... [...]

Gjykata e Apelit Durrës [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] referuar akteve dhe provave që janë administruar në dosjen gjyqësore dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor, por pa i hyrë analizës dhe vlerësimit të tyre, vlerëson se rekursi i paraqitur nga pala e paditur përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC. [...]

Kolegji Civil pasi dëgjoi pretendimet e prapësimet e palëve vlerëson se gjykatat e faktit kanë bërë një interpretim të gabuar të ligjit material lidhur me rrethin e personave trashgimtarë ligjorë rezervatarë sipas nenit 379 dhe 361 të KC.

Trashëgimia është një formë e përfitimit të pasurisë, e cila realizohet me testament ose me ligj. Trashëgimia ligjore vepron vetëm kur trashgimlënësi nuk ka lënë testament. Kjo klauzolë ligjore vë theksin në prioritetin që duhet të ketë respektimi i vullnetit të trashgimlënësit duke e konsideruar trashëgiminë ligjore një përjashtim dhe jo një rregull. Sipas nenit 372 të KC [...] Duke qënë një formë disponimi e pasurisë së testatorit interpretimi i dispozitave, që rregullojnë vlefshmërinë e pavlefshmërinë e testamentit në KC duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës [...]

Trashëgimia njihet si një nga format klasike të fitimit të pronësisë për trashgimtarët dhe testamenti është akti, që identifikon vullnetin e trashgimlënësit për të disponuar pasurinë e tij pas vdekjes. Në interpretim të nenit 41 të Kushtetutës garantimi i të drejtës së pronësisë private qëndron jo vetëm në fitimin e gëzimin e saj por edhe në respektimin e të drejtës së disponimit të kësaj pasurie te personat e tjerë, pasi e drejta e disponimit është tagra kryesore e të drejtës së pronësisë, që e dallon atë nga e drejta reale e posedimit ose uzufuktit ose ajo e qirasë mbi pasurinë. Respektimi i kësaj të drejte nënkupton jo vetëm mundësinë formale të pronarit për të shfaqur vullnetin e kalimit të pasurisë në favor të personave të tjerë qoftë me shitje, dhurim, testament, por edhe ekzistencën e garancive ligjore që ky vullnet i tij do të respektohet dhe do të krijojë pasojat e dëshiruara prej tij, sidomos për kohën pas vdekjes sic ndodh në rastin e testamentit. Në rastin e këtij të fundit testatori shfaq vullnetin jo vetëm për ta tjetërsuar pasurinë e tij pas vdekjes, por për të përcaktuar personin i cili do të përjetësojë vullnetin e tij për gëzimin e pasurisë, kur ai të mos jetë gjallë. Pra, testamenti përveçse një akt disponimi vullneti përbën një vepër vazhdimësie të ekzistencës juridike të testatorit, pasi personi përfitues e gëzon pasurinë mbi bazën e vullnetit të testatorit shpesh duke e ngarkuar edhe me barrë në realizim të qëllimeve të tij pas vdekjes. Mbi këto karakteristika fizike e juridike të testamentit, si një akt disponimi pa shpërblim, analizimi dhe interpretimi i

vlefshmërisë ligjore të tij duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të sigurohet sa më shumë zbatimi i vullneti të testatorit dhe jo deformimi i tij. Cënimi i vlefshmërisë së testamentit duhet të bëhet në raste të kufizuara e përjashtimore, pasi në të kundërt trashgimia ligjore nga institut përjashtues i trashgimisë do të shndërrohej në rregull, gjë që bie ndesh me vetë qëllimin nga udhëhiqen dispozitat e KC “Mbi trashgiminë”.

Në nenin 41 të Kushtetutës nuk është parashikuar asnjë kufizim i të drejtës së trashgimlënësit për disponimin me testament të pasurisë së tij pas vdekjes. Për rrjedhojë interpretimi i dispozitave ligjore të trashgimisë duhet të bëhet në formë sa më pak cënuese për testamentin dhe jo për të rrëzuar fuqinë e tij në cdo kohë në të njëjtën mënyrë sikur testamenti të mos ishte realizuar. Në një situatë të tillë vullneti i testatorit do të mbetet i parespektuar dhe testamenti do të shndërrohej në një akt formal, që nuk do të ofronte asnjë siguri e pritshmëri të ligjshme se e drejta e testatorit për disponim të pasurisë së tij pas vdekjes do të respektohej. Vetëm një interpretim harmonik i ligjit sipas parimit të sipërcituar do të garantonte respektimin e nenit 17 të Kushtetutës [...] Kolegji vlerëson se ky parim gjen vend jo vetëm për verifikimin e kushtetueshmërisë së ligjit, por edhe për interpretimin e tij për aq kohë sa në ligj nuk ka dispozita që qartazi janë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Interpretimi i ligjit duhet të bëhet me qëllim për të garantuar zbatimin e të drejtës subjektive të parashikuar në të dhe jo për ta lënë atë pa efekt.

Në KC janë parashikuar disa kufizime të testatorit për të disponuar pasurinë me testament të cilat konsistojnë në këto drejtime: a-në përcaktimin e rrethit të personave përfitues me testament, që janë personat e përfshirë në 3 rradhët e para të trashgimisë dhe vetëm në mungesë të tyre trashgimlënësi mund tia lërë pasurinë kujdo dhe b-respektimin e rezervës ligjore (neni 379 i KC). Interpretimi i këtyre kufizimeve ligjore duhet të bëhet në mënyrë të tillë që cënimi i testamentit për shkak të tyre të jetë rast përjashtimor dhe jo i zakonëshme. Interpretimi i zgjeruar i kufizimeve do të cënonte vetë thelbin e të drejtës së testatorit për të bërë testament, duke i dhënë prioritet kështu zbatimit në cdo rast të trashgimisë ligjore.

Në çështjen në gjykim paditësit kanë pretenduar se testamenti është i pavlefshëm pasi ata janë trashgimtarë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim testatorit për shkak se ai ka përjashtuar nga trashgimia prindërit e tyre sipas nenit 361 e 379 të KC. Nga hetimi gjyqësor rezulton se paditësit janë stërnipërit e stërmbesat e testatorit dhe ata pretendojnë se thirren në trashgimi për shkak se testatori ka përjashtuar prindërit e tyre, fëmijë të djalit të paravdekur, duke ia lënë gjithë pasurinë vajzës së tij L.M. Pra rezulton se personi përfitues i pasurisë me testament është një nga fëmijët e trashgimlënësit dhe pasuria është disponuar në favor të një trashgimtari, që përfshihet brenda tre rradhëve të para të trashgimisë. Ndërkohë diskutohet nëse paditësit si stërnipër e stërmbesa të trashgimlënësit janë trashgimtarë ligjorë rezervatarë sipas nenit 379 të KC apo jo.

Për të kuptuar nëse paditësit e gëzojnë apo jo një cilësi të tillë duhet të analizojnë kuadrin ligjor për trashëgimtarët rezervatarë e ata me zëvendësim. Kështu instituti i zëvendësimit gjen zbatim në trashëgiminë ligjore sipas parashikimit të nenit 361 të KC. [...]. Ndërsa neni 379 i KC parashikon se; [...] Në bazë të kësaj dispozite kuptohet se cilësinë për të qënë trashgimtarë rezervatarë e kanë : a-fëmijët e mitur të trashgimlënësit dhe

b-trashgimtarët e tjerë të mitur, që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361 paragrafi i dytë), c-trashgimtarë të paaftë për punë nëse thirren në trashëgim. Instituti i rezervës ligjore sipas Kodit tonë Civil është i lidhur në rradhë të parë me cilësi personale të trashgimtarit të tilla si mituria e paaftësia për punë si edhe me pjesën e tij takuese, duke ndaluar trashgimlënësin të përjashtë nga trashgimia këtë kategori trashgimtarësh e të mos çenojë pjesën e tyre takuese në pasurinë trashgimore, që i takon sipas trashëgimisë ligjore.

Në kuptimin gramatikor fjala “rezervë” nënkupton një pjesë pasurie, e cila destinohet të qëndrojë e paprekur dhe në ruajtje deri në plotësimin e kushteve të caktuara, që diktojnë prekjën e saj. Kodi ynë Civil nuk ka paracaktuar ndonjë pjesë ideale të pasurisë trashgimore si rezervë të paprekshme paraprakisht nga disponimi testamentar, por e barazon rezervën ligjore me pjesën takuese në trashgiminë ligjore, që do të përfitonte trashgimtari rezervatarë, në rast se trashgimlënësi nuk do e kishte përjashtuar atë nga trashgimia me testament. Për rrjedhojë madhësia e pjesës së pasurisë trashgimore, që konsiderohet rezervë ligjore është e pakufizuar dhe mund të ndodhë që ajo të jetë e barabartë me gjithë pasurinë trashgimore duke lënë kështu tërësisht pa asnjë efekt testamentin. Psh kur trashgimlënësi ka trashgimtar në rradhë të parë vetëm një fëmijë e ky i fundit po ashtu ka vetëm një fëmijë. Në të tillë rrethana, del se trashgimlënësi ligjërisht nuk ka asnjë siguri juridike që disponimi i tij universal i pasurisë me testament në favor të një trashgimtari do të mbetet i pacënuar, pasi kufizohet në këtë disponim nga ekzistenca e trashgimtarëve ligjore rezervatarë, të cilët kanë të drejtë të përfitojnë qoftë të gjithë pasurinë trashgimore ose një pjesë të saj, duke e bërë të pavlefshëm testamentin.

Duke u ndodhur përballë këtij risku gjithmonë të pranishëm, atëherë gjithë fokusi i interpretimit të dispozitave të KC përqëndrohet te identifikimi i rrethit të personave, që e gëzojnë cilësinë e trashgimtarëve rezervatarë për të garantuar sa më shumë që të jetë e mundur respektimin e parimit kushtetues të lirisë të disponimit të pronës nga trashgimlënësi me testament. [...] Kuptohet se trashgimtari rezervatarë përveçse lidhjes së afërt gjinore me trashgimlënësin që i jep atij cilësinë e trashgimtarit të thirrur në trashëgimi duhet të jetë një trashgimtar nevojtar. Pra, rezerva ligjore e pranuar në KC udhëhiqet nga funksioni humanitar i asistencës për trashgimtarët e paaftë për punë, nga mosha ose nga gjëndja shëndetsore, pavarësisht nga gjëndja ekonomike, që ata mund të gëzojnë personalisht. Nga të gjitha dispozitat e pjesës së trashgimisë të KC kuptohet se pasuria, që mund të ketë personalisht trashgimtari rezervatarë nuk e përjashton atë nga fitimi i të drejtave nëpërmjet trashgimisë së detyrueshme (trashgimia me rezervë ligjore). Përfitimi i trashgimisë për trashgimtarët rezervatarë pa asnjë kufizim në pjesë në të njëjtën mënyrë sikurse trashgimlënësi të mos kishte lënë testament dhe pavarësisht gjëndjen ekonomike të trashgimtarit në fakt rrit mundësinë e goditjes për pavlefshmëri të testamentit duke e shndërruar atë në një formë jo të sigurt të fitimit të pronësisë për trashgimtarin testamentar. Në gjëndjen aktuale të rregullimit ligjor të trashgimisë në KC interpretimi harmonik i dispozitave mbetet e vetmja mënyrë për të ruajtur ekuilibrin midis interesave të trashgimlënësit e trashgimtarit testamentar nga njëra anë dhe ato të trashgimtarëve rezervatarë nga ana tjetër pa çënuar thelbin e të drejtës së testatorit për të disponuar

pasurinë e tij me testament. Nga ana tjetër e drejta e trashgimlënësit për të përjashtuar nga trashgimia trashgimtarët ligjor duhet të ketë të njëjtat kufizime si edhe përjashtimi ligjor i trashgimtarëve për shkak të padenjësisë dhe nuk mund të jetë më e gjerë se kjo e fundit. Padenjësia e prindit sipas nenit 323 të KC nuk përbën shkak për përjashtimin e fëmijës së tij që trashëgon me zëvendësim trashgimlënësin. Nën të njëjtën llogjik neni 361/2 i KC parashikon si shkak zëvendësimi si rastin e vdekjes, padenjësisë, heqjes dorë dhe atë të përjashtimit të fëmijës së trashgimlënësit duke i hapur rrugë trashgimisë me zëvendësim në favor të fëmijëve të fëmijëve.

Në rastin konkret trashgimlënësi ka disponuar pasurinë e tij me testament në favor të fëmijës së tij L.M. Nëpërmjet këtij disponimi universal ai ka përjashtuar të gjithë trashgimtarët e tij të tjerë ligjore nga trashgimia. [...] Kolegji vlerëson se KC e përcakton rrethin e trashgimtarëve ligjor në nenin 360 [...] Pra Kodi e kufizon cilësinë e trashgimtarëve të fëmijët e fëmijët e fëmijëve pa cituar të paslindur të tjerë të fëmijëve të fëmijëve. Ndërkohë neni 361/2 të KC parashikon se [...]Pra sipas kësaj dispozite rezultojnë se fëmijët e fëmijëve janë trashgimtarë me zëvendësim të fëmijëve të trashgimlënësit kur fëmija e trashgimlënësit ka vdekur para tij, është shpallur i padenjë, ka hequr dorë nga trashëgimia, apo është përjashtuar. Vetëm për fëmijët e fëmijëve dispozita përdor togfjalëshin përcaktues “hyjnë me zëvendësim”, ndërkohë që për të paslindurit e tjerë të këtyre (të fëmijëve të fëmijëve) cilëson se vijnë në trashëgimi. Pra, për të paslindurit e fëmijëve të fëmijëve megjithëse vijnë në trashgimi për shkaqet e përcaktuara në nenin 361 të KC ata nuk konsiderohen nga dispozita si trashgimtarë me zëvendësim. Ky trajtim i diferencuar i fëmijëve të fëmijëve nga pasardhësit e këtyre të fundit është në përputhje me nenin 360 të KC sipas të cilit vetëm fëmijët e fëmijëve e kanë ligjërisht cilësinë e trashëgimtarëve. Duke iu rikthyer përcaktimeve të trashgimtarëve rezervatarë sipas nenit 379 të KC rezultojnë se një cilësi të tillë e kanë në mënyrë të shprehur fëmijët e mitur të trashgimlënësit (ose të paaftë për punë) dhe trashgimtarët e tjerë të mitur (ose të paaftë për punë) që trashëgojnë me zëvendësim sipas nenit 361/2 të KC. Pra cilësinë e trashgimtarit rezervatarë sipas nenit 361/2 të Kodit e kanë vetëm ata që trashëgojnë me zëvendësim, që janë pikërisht fëmijët e fëmijëve dhe jo pasardhësit e tjerë të këtyre të fundit, sikurse janë paditësit. Në rast se legjislatori do të kishte si qëllim të përfshinte në rrethin e trashëgimtarëve rezervatarë edhe pasardhësit e tjerë të fëmijëve të fëmijëve atëherë së pari do i cilësonte ata shprehimisht si trashëgimtar sipas nenit 360 të KC, gjë që nuk e ka bërë dhe së dyti nuk do të përdorte në nenin 379 të KC togfjalëshin përcaktues “që trashëgojnë me zëvendësim” por që vijnë në trashëgim. Përdorimi i epitetit cilësues “zëvendësim” vetëm në rastet e thirrjes në trashëgim të fëmijëve të fëmijëve në nenin 361/2 të KC është bërë me qëllim për të diferencuar këta të fundit si trashgimtarë rezervatarë nga pasardhësit e tjerë, që megjithëse vijnë në trashëgim sipas nenit 361/2 të Kodit nuk konsiderohen trashgimtarë rezervatarë.

Në çështjen në shqyrtim paditësit nuk janë fëmijët e fëmijëve të trashgimlënësit, por janë pasardhës të fëmijëve të fëmijës së trashëgimlënësit të paravdekur. Si të tillë, ata nuk konsiderohen trashëgimtar me zëvendësim dhe për pasojë nuk janë trashgimtarë rezervatarë sipas nenit 379 të KC. Në kohën e celjes së trashgimisë, trashgimtarë me

zëvendësim të trashgimlënësit janë shtetasit A.J. L.C dhe D.P., fëmijët e djalit të tij të paravdekur H.P. dhe njëkohësisht prindër të paditësave. Të gjithë këta trashgimtarë zëvendësues rezultojnë të jenë të rritur në kohën e celjes së trashgimisë. Për rrjedhojë përjashtimi i tyre nga trashëgimia nga trashëgimlënësi nuk vjen në kundërshtim me nenin 379 të KC, pasi ata nuk kanë qënë të mitur në kohën e celjes së trashgimisë.

I njëjti qëndrim është mbajtur për rrethin e trashgimtarëve rezervatarë edhe në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara nr.1/2014 duke e shtrirë këtë të cilësi vetëm te fëmijët e fëmijëve. [...] Pavarësisht se ky vendim nuk ka fuqi unifikuese, ai konsiderohet pjesë e praktikës gjyqore interpretative të Kolegjit Civil [...] për këtë institut, për më tepër që është dhënë nga Kolegjet e Bashkuara të cilët konsideroheshin gjykata e caktuar me ligj për unifikimin e praktikës gjyqore para ndryshimit të KPC nga ligji nr.38/2017. Në vijim Kolegji konstaton se pasardhësit e fëmijëve të fëmijëve megjithëse mund të vijnë në trashgiminë ligjore ata nuk kanë cilësinë e trashgimtarëve rezervatarë për të cënuar vlefshmërinë e testamentit në rast se prindërit tyre që janë fëmijët e fëmijëve janë përjashtuar nga trashëgimia, pasi ata nuk quhen trashgimtarë me zëvendësim. Përjashtimi nga trashgimia mund të bëhet ose në mënyrë të shprehur ose në mënyrë të nënkuptuar kur trashgimlënësi ia lë të gjithë pasurinë trashgimore një ose disa prej trashgimtarëve të tij ose personave të tretë. Në rastin konkret trashgimlënës ka përjashtuar në mënyrë indirekte trashgimtarët ligjore me zëvendësim, pra fëmijët e djalit të tij H.P. të paravdekur, pasi ia ka lënë gjithë pasurinë vajzës së tij [...] Duke qënë se asnjë prej trashgimtarëve me zëvendësim nuk ka qënë I mitur në kohën e celjes së trashgimisë, disponimi me testament është i vlefshëm. Shtetasit [...] konsiderohen trashgimtarëve ligjore të rradhës së parë sipas nenit 361/2 të KC për shkak se i ati i tyre H.P. fëmija e trashgimlënësit, kishte vdekur para tij. Pra ata vetë janë trashgimtarë me zëvendësim dhe jo trashëgimtarë të drejtëpërdrejtë të trashëgimlënësit sipas nenit 361/1 të KC. Instituti i rezervës ligjore i parashikuar në KC siguron mbrojtje të detyrueshme të trashgimisë ligjore për ta vetëm kur këta trashgimtarë me zëvendësim janë të mitur ose të paaftë për punë duke i ndaluar trashëgimlënësit përjashtimin e tyre nga trashgimia. Në kushtet kur ata nuk kanë asnjë cilësi të tillë, përjashtimi i tyre nga trashgimia nuk bie ndesh me nenin 379 të KC dhe as mund të përbëjë shkak për lindjen e trashgimisë ligjore të detyrueshme, pra të rezervës ligjore në favor të pasardhësve të tyre paditës. Këta të fundit përderisa nuk janë trashgimtarë me zëvendësim nuk gëzojnë cilësinë e trashgimtarëve rezervatarë.

Për sa mësipër rezulton se mungojnë kushtet e pavlefshmërisë së testamentit sipas nenit 379, 407 e 412 të KC, pasi përmbajtja e tij nuk vjen në kundërshtim me ndonjë dispozitë urdhëruese të ligjit. Si rrjedhim padia për konstatimin e pavlefshmërisë së testamentit për pjesën e cënimit të rezervës ligjore të paditësave [...] është e pabazuar në ligj. Për pasojë vendimet e gjykatës së rrethit gjyqor dhe ajo e apelit për këtë pjesë duhet të ndryshohet duke u vendosur rrëzimi i padisë. [...]

Ndërkohë për pjesën tjetër të rrëzimit të padisë për të miturin [...] dhe për pjesën e padisë së ngritur ndaj Ministrisë së Financave Kolegji vlerëson se duhet të vendos lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit pasi me të drejtë është vendosur rrëzimi i padisë nga të dy gjykatat e faktit. Të dy këto palë nuk legjitimohen aktivisht dhe pasivisht në

padinë e ngritur në kuptim të nenit 32 të KPC pasi paditësit [...] nuk rezulton t'i jetë cënuar asnjë e drejtë e mbrojtur nga ligji dhe po ashtu i padituri Ministria e Financave nuk ka kryer asnjë veprim në cënim të të drejtës së trashgimisë së pretenduar nga paditësit. Ajo ka lëvruar shumën në favor të palës së paditur bazuar në dëshminë e trashgimisë testamentare të lëshuar në favor të saj nga vetë trashgimlënësi dhe të depozituar pranë saj kohë më parë se pretendimet e paditësive për trashgiminë ligjore.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKCGJL Nr.00-2023-3267(399), datë 20.06.2023

PJESA E TRETË: KOLEGJ PENAL

I. Mosmarrëveshje mbi kompetencën lëndore

KPGJL Vendim Njësues Nr.00-2021-712 (23), datë 27.07.2021 (Viktima akuzuese në rastet e shpifjes)

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuzat në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të KPP.

Fjalë kyçe: juridiksioni fillestar i ushtrimit të ndjekjes penale, funksionar lartë shtetërorë, akuzë publike, akuzë private, viktima akuzuese, shpifja

Rrethanat e çështjes:

Shtetasi L.B. me cilësinë procedurale penale të viktimës akuzuese, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dy kërkesa penale, duke kërkuar gjykimin e të akuzuarit E.V., për veprën penale “Shpifja” kryer botërisht, neni 120, paragrafi i dytë i K.Penal, [...]Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...]ka vendosur bashkimin e këtyre dy kërkesave penale, në bazë të neneve 79 dhe 92 të KPP dhe gjykimin e tyre në një të vetme. Nga aktet rezulton se, viktima akuzuese L.B. është kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndërsa i akuzuari E.V. është Kryetar i Bashkisë Tiranë. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari, në datën 24.09.2020, ka qenë i ftuar në emisionin “Opinion” në televizionin kombëtar “Klan”, dhe aty ka shpifur për viktimën akuzuese duke pretenduar edhe se ka prova për to. Gjithashtu, në datën 02.10.2020, ka qenë duke drejtuar fushatën elektorale në Tiranë dhe ka vijuar të thellojë shpifjen në drejtim të viktimës akuzuese. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari ka konsumuar veprën penale “Shpifja”, duke deklaruar një sërë thëniesh të pavërteta, prandaj i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosurshpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes penale [...] Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj çështje penale. [...]

Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, [...] ka vendosur ngritjen para Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të çështjes së mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore në shqyrtimin e çështjes penale nr. 77 Rregj. Themeltar, datë 26.02.2021 me viktimë akuzuese L.B., të akuzuar E.V. për veprën penale “Shpifja” të parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal midis GJKKO dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.” [...]

Kolegji Penal [...], në dhomë këshillimi, meqenëse ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO) si dhe Gjykatës së Lartë kishte qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP, me vendimin e datës 04.05.2021, vendosi kalimin e çështjes penale me nr. 52810-227-2021, datë regjistrimi 30.03.2021, për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen:

Cila është gjykata kompetente për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP? [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji Penal [...] vlerëson se në çështjen në shqyrtim ekziston konflikti për kompetencë, pasi dy gjykata të ndryshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe GJKKO, nuk pranojnë të gjykojnë çështjen e paraqitur, konkretisht kërkesën e paraqitur nga viktimja akuzuese kundër të akuzuarit, sipas nenit 59 të KPP.

[...] nenet 89, 90 dhe 91 KPP, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë[...]

Kolegji vlerëson se parashtrimi i GJKKO nuk është i drejtë, prandaj aktet duhet t'i kthehen kësaj gjykate, me qëllim vazhdimin e gjykimit të çështjes, referuar argumentimit që do të trajtohet në vijim. [...]. Fillimisht, Kolegji çmon me vend të sqarojë se përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe përse është e nevojshme të përcaktohet çështja/çështjet që do të shtrohen për njësim nga Kolegji. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e tij në lidhje me çështjen e mësipërme duhet të shërbejë si vendimmarrje njësuere, pasi është konstatuar se ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm, (GJKKO) si dhe Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-254, datë 19.03.2021, ka vendosur: “Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.” Nga ana tjetër, konstatohet se në Gjykatën e Lartë janë paraqitur një sërë çështjesh për mosmarrëveshje kompetence ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO) në lidhje me çështjen e mësipërme. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP. [...] Pasi trajtoi, arsyen e njësimin të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen e mësipërme dhe çështjen e shtruar për njësim, Kolegji vendos të ndalet në trajtimin e pyetjes njësuere dhe në vijim në zgjidhjen e çështjes konkrete. [...]

Neni 75/a i KPP (i ndryshuar me ligjin nr. 41/2021) përcakton kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar [...]

Në çështjen objekt gjykimi, para Kolegjit shtrohet detyra e interpretimit të termit “akuzë penale” parashikuar nga pika c) dhe ç) e nenit 75/a të KPP. Në kuadër të zgjidhjes drejtë të çështjes objekt gjykimi nga ky Kolegj, lind nevoja për përcaktimin, nëse tek akuza penale e përcaktuar nga neni 75/a i Kodit përfshihen edhe kërkesat e paraqitura nga viktimat akuzuese kundër subjekteve të posaçëm, sipas nenit 59 të KPP. Kolegji vlerëson të nevojshëm rikonfirmimin e qëndrimit se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. [...] (shih vendimin nr. 917, datë 11.05.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili determinon konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. “Gjykata e krijuar me ligj” është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1 i KEDNJ. GJEDNJ në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka trajtuar kuptimin e “gjykatës së krijuar me ligj” duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. [...] Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete⁷ dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet. [...] Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij Republika ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjyqësore, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjyqësore të spostohet, ndryshohet (*translatio iudicii*) apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion ose jokompetent. [...] (shih vendimin njësesues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2018-148, datë 04.04.2018).

Duke iu rikthyer çështjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se për të përcaktuar në mënyrë që qartë kuptimin e akuzës penale të përcaktuar nga neni 75/a i KPP, është e nevojshme të ndalet në interpretimin historik, logjik, sistematik e së fundi në interpretimin literal të dispozitës.

[...] Referuar këtyre ndryshimeve, rezulton se, aktualisht neni 135 i Kushtetutës [...] Me ndryshimet e miratuara [...] në dallim nga sa parashikohej më parë në nenin 135 të Kushtetutës së pandryshuar, ndryshimet e kësaj dispozite në pikën 2 parashikuan krijimin e një gjykate të posaçme penale, kompetenca lëndore e së cilës parashikohej

⁷ Shiko Vendimin nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

drejtpërdrejtë në Kushtetutë, njëlloj sikurse parashikohej juridiksioni fillestar penal i Gjykatës së Lartë në nenin 141 pika 1 të Kushtetutës së pandryshuar. Më tej ndryshimet kushtetuese prekën edhe nenin 148 të Kushtetutës, ku ndër të tjera u përcaktua edhe kompetenca lëndore e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq për prokurorinë. [...] Ndryshimet kushtetuese prekën edhe juridiksionin fillestar penal të Gjykatës së Lartë, duke e hequr këtë atribut të ushtrimit të pushtetit gjyqësor nga kjo gjykatë dhe duke e bërë pjesë integrale të juridiksionit të specializuar penal të gjykatës së posaçme, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Gjithashtu, juridiksioni fillestar i ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq i Prokurorisë së Përgjithshme, sipas nenit 141 pika 1 të pandryshuar të Kushtetutës, i kaloi Prokurorisë së Posaçme. Ky ndryshim i Kushtetutës është pasqyruar edhe në nenin 75/a të KPP [...] Nga tërësia e dispozitave të mësipërme, arrihet në përfundimin se juridiksioni fillestar që Kushtetuta parashikonte për Gjykatën e Lartë u suprimua, duke i dhënë asaj të drejtën vetëm të gjykimit të çështjeve lidhur me zbatimin dhe interpretimin e ligjit, referuar nenit 141/1 të Kushtetutës [...] Kolegji vë në dukje se pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, [...] Gjykata e Lartë nuk ka më juridiksion fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë. Kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçëm e ka GJKKO kompetencë lëndore që përcaktohet në nenin 75/a të KPP. [...] e cila ndër të tjera gjykon ...”akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave”.

Nga interpretimi i mësipërm historik, Kolegji arrin në përfundimin se juridiksioni fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë i ka kaluar në bllok Gjykatës së Posaçme e cila, sipas të njëjtit parashikim ligjor, ka të drejtë të gjykojë po akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve apo akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës. Në këtë linjë arsyetimi, në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte çdo akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pavarësisht nëse ajo përfaqësohej nga Prokuroria e Përgjithshme apo ngrihej nga i dëmtuari akuzues edhe Gjykata e Posaçme aktualisht ka kompetencë lëndore të gjykojë të gjitha akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë një diferencim në lidhje me akuzat e ngritura nga viktima akuzuese sipas nenit 59 të KPP. Përfundimi i mësipërm arrihet nga Kolegji edhe po të bëhet interpretimi logjik i dispozitave të mësipërme, duke identifikuar qëllimin e ligjvënësit në bërjen e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. GJKKO rregullohet me ligjin nr. 98/2016 [...] Qëllimi i krijimit të kësaj gjykate ishte krijimi i një gjykate të juridiksionit të posaçëm e cila do të gjykonte një kategori të caktuar veprash penale që kanë një rrezikshmëri të theksuar shoqërore, për të cilat lindi nevoja për t'u gjykuar nga një gjykatë e posaçme, në kuadër të nevojës për të luftuar korrupsionin dhe veprat penale në fushën e krimit të organizuar, prioriteti i shtetit shqiptar në kuadër të paketës ligjore për reformimin e drejtësisë.

GJKKO u krijua në radhë të parë si një gjykatë veprash, pra me qëllimin për të gjykuar një kategori të caktuar veprash penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe që cenojnë dukshëm rendin publik; krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b,

230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të K.Penal si dhe çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të K.Penal.

Së dyti, Gjykata e Posaçme u krijua si një gjykatë subjektsh, pasi kjo gjykatë ka kompetencë të gjykojë të gjitha akuzat penale të kryera nga funksionarët e lartë shtetërorë ose ish-funksionarët e lartë, në rast se veprat penale për të cilat akuzohen janë kryer gjatë kohës që ata kanë qenë në ushtrim të detyrës. Ligjvënësi ka përcaktuar gjykimin e akuzave penale ndaj këtyre subjekteve të posaçëm dhe nuk rezulton të ketë bërë dallim në varësi të faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjyq, Prokuroria e Posaçme apo viktimia akuzuese, pasi qëllimi i ligjvënësit ka qenë që Gjykata e Posaçme të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë. Kolegji çmon që në kushtet kur ligjvënësi nuk ka bërë dallim në këtë drejtim, atëherë një dallim i tillë nuk mund të bëhet as nga gjykatat, pasi një interpretim i tillë do të ishte tejkalim i parashikimit ligjor dhe gjithashtu i qëllimit që ka pasur ligjvënësi në ndryshimet thelbësore që miratoi me paketën e Reformës në Drejtësi.

Së fundmi, Kolegji çmon të nevojshme të kalohet tek interpretimi sistematik dhe literal i dispozitave procedurale penale, për të arritur në një konkluzion të qartë se çfarë do të konsiderohet akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a të KPP. Neni 148/1 i Kushtetutës [...] Neni 24/1 i KPP parashikon: [...] Neni 4 i ligjit nr. 95/2016 [...] Neni 8 i ligjit të mësipërm parashikon [...] Referuar parashikimeve të mësipërme, Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson në gjyq akuzën penale për veprat penale që janë në kompetencë të GJKKO sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a të KPP. Nga ana tjetër, ligjvënësi për një kategori të caktuar veprash penale parashikon të drejtën e viktimës akuzuese për të paraqitur kërkesë në gjykatë me qëllim për të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 59 të KKP [...].

Ligjvënësi parashikon se, për një kategori të caktuar veprash penale, viktimia akuzuese ka të drejtë të paraqitet vet në gjykim duke pasur si barrë prove vërtetimin e akuzës së ngritur prej tij. Veprat penale për të cilat parashikohet paraqitja e kërkesës nga viktimia akuzuese janë vepra penale me një rrezikshmëri më të ulët shoqërore, prandaj ligji parashikon se për këto kategori veprash penale është vet viktimia akuzuese që paraqitet në gjyq dhe provon akuzën e ngritur prej saj. Nga ana tjetër, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të KPP, rezulton se procesi gjyqësor penal fillon në bazë të depozitimit në Gjykatë:

- Të kërkesës së prokurorit, i cili në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës, ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit (neni 24/1 i KPP); për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimin nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme (neni 25 i këtij Kodi);
- Me kërkesë të viktimës akuzuese (në referim të nenit 60 të KPP) për kategorinë e

veprave penale të parashikuara shprehimisht në nenin 59 të këtij Kodi.

Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga viktimata akuzuese, sipas nenit 59 të KPP, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 3, datë 6.2.2008, me objekt: “Shfuqizimi si i pajtueshëm me Kushtetutën i nenit 59/1 të KPP”, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës*”.

[..]

Kolegji çmon të nevojshëm edhe trajtimin e mjetit procedural, kërkesën e viktimës akuzuese, parashikuar nga neni 59 i KPP. Së pari, Kolegji vë në dukje se termi akuzë private nuk është një term i parashikuar nga Kushtetuta dhe as nga ligji. Ky term është zhvilluar dhe përpunuar në doktrinën dhe teorinë e të drejtës procedurale penale dhe i referohet kërkesës që paraqitet në gjykim nga viktimata/i dëmtuari akuzues, i cili ka detyrimin të përfaqësojë akuzën e ngritur prej tij si dhe barrën e provës për ta provuar atë. Referuar nenit 59 të KPP, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Nga ana tjetër, prokurori në këtë gjykim nuk përfaqëson akuzën dhe as ka barrën e provës për ta provuar atë. Arsyeja e një parashikimi të tillë ligjor lidhet me kategorinë e veprave penale që parashikohen nga neni 59 i KPP, të cilat më shumë se interesin publik cenojnë interesin privat të viktimës akuzuese, në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Me anë të këtij mjeti procedural, ligjvënësi ka pasur për qëllim t’i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre (*shih vendimin më sipër të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 59 i KPP ka për qëllim t’i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Ligjvënësi me parashikimin e institutit të akuzës private është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuara dhe të mbrojtura nga prokuroria dhe interesave privatë nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij.

Neni 59 i KPP zbatohet vetëm për veprat penale që parashikohen nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të K.Penal, të cilat përmenden në mënyrë taksative në paragrafin e parë të nenit 59. Këto vepra penale karakterizohen nga mungesa e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe interesi i vogël publik në çështjen konkrete. Sa më serioze të jetë vepra penale ose sa më i madh të jetë rreziku për vepra penale të përshkallëzuara, aq më tepër duhet që ndjekja penale të vazhdojë kryesisht, në interes publik, edhe sikur viktimat t’i kenë tërhequr kallëzimet e tyre. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se dispozitat e KPP që normojnë ushtrimin e funksioneve të GJKKO pranë kësaj gjykate në gjykimin e akuzës penale ndaj funksionarëve publike, nuk e kufizojnë gjykimin e tyre vetëm me shqyrtimin “akuzës publike” dhe as përjashtojnë “akuzën private”, siç parashtrohet nga GJKKO në mosmarrëveshjen për kompetencë, por kanë përcaktuar në kompetencë lëndore të asaj gjykate të gjithë “akuzat penale” pa përjashtim në ngarkim të funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të nenit 75/a të Kodit, natyrisht kur vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

Kolegji çmon se pavarësisht rrezikshmërisë më të ulët shoqërore që kanë veprat

penale të parashikuara nga neni 59 i KPP, këto vepra penale do të gjykohej nga Gjykata e Posaçme, pikërisht për shkak të faktit se janë akuza penale që ngrihen ndaj subjekteve të posaçëm, me funksione të larta shtetërore, të lidhura drejtpërdrejt me interesin publik. Kompetencën Gjykata e Posaçme në rastin e pikës c) dhe ç) të nenit 75/a të Kodit e merr pikërisht për shkak se i akuzuar është subjekti i posaçëm dhe nuk kushtëzohet nga lloji i veprës penale apo ndaj faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjykim. Në rast se ligjvënësi do të kishte pasur një qëllim të tillë, ai do e kishte parashikuar, siç ka bërë ndarjen në varësi të llojit të veprës penale në pikën a) të nenit 75/a të K.Pr.Penale.

Kolegji çmon se është e vërtetë se GJEDNJ në çështjen Deëer kundër Belgjikës, është shprehur se “akuza”, në kuptimin e nenit 6 § 1, mund të përkufizohet si “*njoftimi zyrtar i një individi, nga ana e autoritetit kompetent, se mendohet që ka kryer një veprë penale*”, megjithatë ky vendim duhet të interpretohet sipas kontekstit të dhënë nga kjo Gjykatë. GJEDNJ në këtë vendim, por edhe në vendime të tjera, ka mbajtur qëndrimin se një person i ndaluar dhe i detyruar për t’u betuar përpara se të merrej në pyetje në cilësi dëshmitari ishte tashmë objekt i një “akuze penale” dhe përfitonte nga e drejta për të heshtur (Brusco kundër Francës, §§ 46-50). Sipas GJEDNJ, nuk është përfaqësimi i akuzës nga prokuroria që kushtëzoi faktin nëse ka një akuzë të ngritur ndaj të akuzuarit apo jo. Akuza është e tillë, pavarësisht se përfaqësohet nga organi publik apo një subjekt privat. Akuza i referohet atribuimit ndaj të akuzuarit të kryerjes së një vepre penale, e cila sjell pasojë ndaj të akuzuarit në lidhje me të drejtat apo liritë e tij personale.

Për sa i përket kuptimit autonom të termit “penal”, sipas GJEDNJ, Konventa nuk u kundërvihet prirjeve për “depenalizim” që hasen brenda shteteve kontraktuese. Megjithatë, veprat që pas depenalizimit klasifikohen si “shkelje administrative” mund t’i përkasin kuptimit autonom të veprës “penale”. Lënia në dorë të shteteve e kompetencës për t’i përgjatur këto vepra mund të sillte rezultate të papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës (Öztürk k. Gjermanisë, § 49).

Gjithashtu, GJEDNJ ka arsyetuar se pikënisja e shqyrtimit të zbatueshmërisë së pjesës penale të nenit 6 të Konventës mbështetet tek kriteret e parashtruara në vendimin *Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulëta*, §§ 82-83, kriteret që janë:

1. cilësimi në të drejtën e brendshme;
2. natyra e veprës;
3. ashpërsia e dënimit që rrezikon t’i jepet personit të interesuar.

[..] Sa më sipër, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ si të rëndësishme në përcaktimin nëse kemi një akuzë penale, në kuptim të nenit 6 të Konventës, arrihet në përfundimin se edhe kërkesa me të dëmtuar akuzues përfshihet në konceptin e akuzës penale. Prandaj, edhe në vështrim të praktikës së GJEDNJ, Kolegji vlerëson se akuza penale përfshin si koncept si akuzën e përfaqësuar në gjykim nga prokuroria, ashtu edhe kërkesën e paraqitur nga viktimat akuzuese, sipas nenit 59 të KPP. Duke iu rikthyer kuadrin ligjor shqiptar, referuar interpretimit historik të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale penale para ndryshimeve të vitit 2016-2017, rezultoi se juridiksioni fillestar për akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë iu suprimua Gjykatës së Lartë dhe i kaloi një gjykate të posaçme, Gjykatës

së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kjo gjykatë u krijua si një gjykatë e posaçme për gjykimin e veprave penale të parashikuar nga neni 75/a, paragrafi 1 dhe 2 i KPP, si dhe gjykatë që do të gjykonte subjekte të posaçëm, konkretisht ata të parashikuar në paragrafin 3 të nenit 75/a të Kodit. Pra, rezultoi se pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, [...] të pasuara me ndryshimet ligjore, juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë i kaloi Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte të gjitha akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë dallimi nëse akuza përfaqësohej nga prokuroria apo nga viktima akuzuese, Kolegji çmon se nuk ka arsye pse një dallim i tillë të bëhet tani që kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçëm e ka Gjykata e Posaçme. Për më tepër, ky dallim nuk mund të bëhet për aq kohë sa nuk e bën vet ligji.

Pranimi i interpretimit të bërë nga Gjykata e Posaçme do të cenonte garancitë e vendosura nga vet Kushtetuta dhe ligji që një kategori e subjekteve të posaçëm të gjykoheshin jo nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por nga një gjykatë e juridiksionit të posaçëm, e krijuar enkas për të ofruar garanci shtesë në drejtim të garantimit të procesit të rregullt ligjor dhe një vendimmarrje të drejtë. Në kushtet kur vet ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, interpretimi tej parashikimit kushtetues dhe ligjor do të cenonte jo vetëm parimin e ligjshmërisë, por edhe atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Në mbështetje të këtij arsytimi të Kolegjit vjen edhe interpretimi logjik, sipas qëllimit që ka pasur ligjvënësi kur ka bërë ndryshimet kushtetuese dhe ato ligjore. Krijimi i Gjykatës së Posaçme, si një gjykatë subjekti, që do të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë kishte si qëllim ofrimin e garancive shtesë që një kategori e veçantë subjektësh, për shkak të funksionit që mbajnë, e lidhur kjo drejtpërdrejtë me interesin publik, të gjykohej nga një gjykatë e posaçme, që ofron garanci shtesë si përsa i përket përbërjes së saj, mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve dhe në funksion të rritjes së standardit të procesit të rregullt ligjor. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë që juridiksioni fillestar që ushtronte Gjykata e Lartë t'i kalonte një gjykatë të posaçme dhe nuk rezultoi që ligjvënësi të ketë bërë diferencim tek kompetenca lëndore e Gjykatës së Posaçme, në varësi të faktit se kush e përfaqësonte akuzën në gjykim. Në kushtet kur vet ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, Kolegji vlerëson se arsytimi i Gjykatës së Posaçme në ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës është një tejkalim i parashikimit ligjor.

Kolegji çmon se Gjykata e Posaçme ka interpretuar në mënyrë të ngushtuar duke i dhënë nenit 75/a paragrafi 3 dhe 4 një kuptim të ndryshëm nga ai që i ka dhënë ligjvënësi. Ligjvënësi ka përcaktuar se gjykata e posaçme gjykon akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë dhe nuk përcaktoi se kompetenca i referohet vetëm akuzës që përfaqëson në gjykim prokuroria e posaçme. Në kushtet kur KPP parashikon se akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, por mund të ketë edhe kërkesë nga viktima akuzuese, Kolegji vlerëson se kur i akuzuar është një nga subjektet e posaçme të parashikuar nga neni 75/a i KPP, kompetenca lëndore për gjykimin e këtyre akuzave i përket GJKKO. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këtë përfundim njësisues:

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të KPP.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, referuar përfundimit të mësipërm njësues, Kolegji Penal vendos zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe GJKKO për shqyrtimin e çështjes penale [...] me viktimë akuzuese L.B., kundër të akuzuarit E.V. për veprën penale “Shpifja”, parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal, duke përcaktuar GJKKO si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

KPGJL Vendim Njësues Nr.00-2021-1120(55), datë 13.10.2021 (Masa sigurimi gjykata jo kompetente-Moskompetencë prokuroror gjatë hetimeve paraprake)

Neni 88 i KPP zbatohet si për masat e sigurimit personal, ashtu dhe për masat e sigurimit pasuror.

Gjykata që cakton masën e sigurimit, jo domosdoshmërisht është e njëjtë me gjykatën që shpall moskompetencën.

Parashikimet e nenit 88 të KPP në lidhje me masën e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente, nuk zbatohen në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente, sipas nenit 84/1 të KPP.

Fjalë kyçe: masat e sigurimit karakter pasuror, sekuestro preventive, humbjes së fuqisë së masës së sigurimit, moskompetencë prokurorori, fazë seancë paraprake

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, më datë 22.06.2016, ka regjistruar procedimin [...] për veprat penale “Mashtrimi”, i kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të kryera në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 143/1, 333/a, 319 - 25, 319/ç - 25, të KP, si dhe, në të njëjtën kohë, emrat e personave që ju atribuohen veprat penale të sipërcituara, të identifikuar në shtetasit A.D., D.H., A.D., E.S., me cilësinë (formale) e personave të hetuar.

Në kuadër të këtij procedimi penal, [...] gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj Gjykate, me [...], ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë [...] duke urdhëruar vendosjen e masës së sigurimit pasuror, të sekuestros preventive mbi pasuritë sipas objektit të kërkesës. Gjithashtu, me vendimin [...] gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj Gjykate ka vendosur heqjen e sekuestros të vendosur me vendimin nr. 16, datë

10.01.2018, të Gjykatës së [...] dhe vendosjen e sekuestros preventive, mbi 35 % të sipërfaqes së ndërtimit që do të realizohej mbi pasurinë [...] që do të regjistrohej, në ZVRPP Tiranë, pas nënshkrimit të aneks kontratës dhe kontratës së shkëmbimit midis palëve, për pjesën takuese të të hetuarës D.H.

[...] Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për çështjen penale [...] Kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë si prokuroria kompetente në lëndë dhe territor.”

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të hetimeve paraprake, [...] i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën me objekt gjykimin e çështjes [...] ndër të tjera, në ngarkim të të pandehurës D.H., duke e akuzuar, për kryerjen e veprave penale; “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i KP, “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i KP, dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/c i KP. Gjykata [...] ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. 7011, të vitit 2018.

Kërkesja D.H. në datën 01.02.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën me objekt heqjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të vendosur, [...]

[...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesës.”

[...] Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur pranimin e kërkesës. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit pasuror të sekuestros, të vendosur me vendimin nr [...]Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të vendosur me vendimin [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji Penal [...] në shqyrtim të kushteve të pranueshmërisë së rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në dhomë këshillimi, [...] në respektim të detyrimit të tij për të “shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs”, sikurse përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 434 të KPP, por pa paragjykuar të drejtën e kësaj Gjykate/këtij Kolegji “për të vendosur, kryesisht, edhe për çështje të ligjit” (pavarësisht shkaqeve të paraqitura në rekurs), sikurse përcaktohet në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, vlerësoi se duhet gjykuar mbi bazueshmërinë në ligj të shkaqeve të parashtruara nëpërmjet rekursit, në kushtet e aplikimit të gabuar, prej Gjykatës së Apelit Tiranë, të ligjit procedural, konkretisht, të nenit 88 të KPP që parashikon “humbjen e fuqisë (efekteve) të masës së sigurimit të caktuar prej gjykatës, e cila, në të njëjtën kohë apo më vonë, shpallet jokompetente (për çdo lloj shkak), në qoftë se, brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit”.

Nga ana tjetër, Kolegji, [...]vlerësoi se në rastin konkret verifikohet ekzistenca e kushtit të parashikuar në pjesën e parë të nenit 432/1-a të KPP, të “mosrespektimit apo të zbatimit të gabuar të ligjit procedural”, duke vlerësuar, në të njëjtën kohë, edhe konkurrimin e kushteve për nisjen e procedurës të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 438 të KPP, pikërisht të gjykimit, për të njësuar praktikën gjyqësore.

Kolegji konstaton se ka qëndrime të ndryshme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të

KPP, kryesisht të kolegjeve të veçantë të Gjykatës së Lartë që, lidhur me aplikimin e përcaktimeve të kësaj dispozite, kanë operuar në mënyrë kontradiktore, duke pranuar, herë – herë, aplikimin e kësaj dispozite, pra nenit 88 të KPP dhe deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit të caktuar nga gjykata (gjyqtari për hetimet paraprake) edhe në rastin e deklarimit të moskompetencës nga ana e prokurorit gjatë hetimeve paraprake, për vazhdimin e këtyre hetimeve dhe të dërgimit, për pasojë, të çështjes tek prokurori kompetent (vendimet nr. 25 dhe 64 datë 29.04.2015, nr. 14, datë 30.03.2015 të këtyre kolegjeve); si dhe herë – herë, kanë disponuar edhe të kundërtën. Por, Kolegji konstaton se edhe gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të KPP, situatë procedurale e verifikuar edhe në rastin konkret në shqyrtim.

Kolegji ka identifikuar si çështje me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, sa më poshtë vijon:

- ***A është i zbatueshëm neni 88 i KPP për masat e sigurimit pasuror apo është një dispozitë që i referohet vetëm masave të sigurimit personal?***
- ***Sipas përcaktimit të nenit 88 të KPP, gjykata që cakton masën e sigurimit a është e njëjtë me gjykatën që, në të njëjtën kohë ose më vonë, shpall moskompetencën?***
- ***A zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokurori dhe të dërgimit të akteve prokurorisë kompetente sipas përcaktimit të nenit 84/1- të KPP.***

Në funksion të zgjidhjes së problematikës kryesore, të vendosur në bazë të këtij gjykimi, Kolegji, në cilësinë e “aktorit” iniciues të procedurës së gjykimit njëses, ka detyrimin për tu prononcuar edhe lidhur me kuptimin, interpretimin e normës referuese, nenit 88 të KPP, aspekteve të veçanta të saj, të identifikuara në dy çështjet e para të renditura në objektin e këtij gjykimi njëses. Konkretisht, Kolegji, së pari, vlerëson të sqarojë nëse neni 88 i KPP zbatohet edhe për masat e sigurimit të karakterit pasuror, të sekuestros preventive, në rastin konkret, si dhe në mundësinë e interpretimit të zgjeruar të përcaktimit preciz dhe univok të kësaj dispozite, për pjesën që bën fjalë për “identitetin” e gjykatës që cakton masën e sigurimit me gjykatën që, kontekstualisht apo më vonë, shpallet/deklarohet në kushtet e moskompetencës.

Në këtë kuadër, neni 88 i KPP, përmbajtja e tij, konsiderohet si një disiplinë e përgjithshme dhe organike për të gjithë lëndën e masave të sigurimit, të caktuara nga gjyqtari jokompetent dhe që, bashkë me nenin 87 të KPP, që bën fjalë për “provat e marra nga gjykata jokompetente”, janë shprehje e parimit të “konservimit/ruajtjes së akteve”. Neni 88 i KPP, sikurse qartazi (*ictu oculi*) evokon përmbajtja e tij, verifikohet i zbatueshëm, sidomos përse i përket tipologjisë së ndryshme të masave të sigurimit, si të atyre më karakter personal, ashtu edhe të atyre shtrënguese, të parashikuara në nenin 232 të KPP apo të atyre ndaluese, të parashikuara në nenin 240 të KPP, po kështu edhe të atyre të karakterit real pasuror, të parashikuara në nenet 270 dhe 274 të KPP që bëjnë fjalë për masat e sigurimit pasuror të sekuestros konservative dhe preventive. Në të njëjtën kohë, konsiderohet se dispozita e sipërcituar, neni 88 i KPP, nuk gjen zbatim

përsa i përket “sekuestros provuese”, e ashtuquajtura sekuestro penale, e parashikuar në nenin 208 të KPP, përsa kohë që, kjo e fundit, konkretizon njërin nga “mjetet e sigurimit të provës”, të parashikuara në Kreun e Tretë të Titullit të Katërt të KPP, konkretisht seksionin i tretë, “Sekuestrimet”. Pra, përsa i përket çështjes së parë të shtruar për njësim, qartazi dispozita, neni 88 i KPP, nuk parashikon asnjë lloj diferencimi midis masave të sigurimit të të gjitha llojeve, sikurse u sipërcitua, përfshirë edhe masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive. Kolegji vlerëson se edhe masat e sigurimit pasuror, do t’i nënshtrohen pasojave, të identifikuar në “humbjen e efekteve të fuqisë” së tyre, në kushtet e deklarimit kontekstual, me momentin e caktimit të masës apo edhe në një moment të mëvonshëm, të moskompetencës së gjykatës (gjyqtarit për hetimet paraprake) që ka caktuar këtë masë dhe të mosripërtëritjes (mosrinovimit) të saj nga gjykata kompetente, brenda një afati dhjetë ditor nga marrja e akteve. Me verifikimin e kushteve të parashikuara në nenin 88 të KPP, të deklarimit (kontekstual apo të mëvonshëm) të moskompetencës të gjykatës (gjyqtarit për hetimet paraprake) që ka caktuar masën e sigurimit të karakterit pasuror të sekuestros preventive, të parashikuar nga neni 274 i KPP, si dhe të mosripërtëritjes të saj prej gjykatës kompetente, brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, kjo e fundit, pra masa e sigurimit (pasuror) humbet efikasitetin – provizor/të përkohshëm – të “fituar”, me rastin e deklarimit të kësaj moskompetence, (prej këtij momenti), si një masë e caktuar prej gjyqtarit (gjykatës) jokompetent. Masa e sigurimit (pasuror) e caktuar nga gjyqtari jokompetent ka karakter të jashtëzakonshëm dhe emergjencial/si një masë e caktuar në kushte emergjence.

Kolegji, në funksion të interpretimit të dispozitës, objekt i referimit të këtij gjykimi njësuës, neni 88 të KPP, lidhur me kushtet e aplikimit të saj, konsideron se “shkronja” – përmbajtja e kësaj dispozite – e bazuar në identitetin midis (në kuptimin e të njëjtës gjykatë/gjyqtar) gjyqtarit që cakton masën e sigurimit me atë (gjyqtarin) që deklaron, në të njëjtën kohë apo më pas, moskompetencën e tij, nuk përjashton mundësinë që kjo disiplinë e “humbjes së fuqisë së masës së sigurimit” të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe të zbatohet edhe në eventualitetin e verifikimit të diversitetit (në kuptimin e gjykatës/gjyqtarit të ndryshëm) midis gjyqtarit që disponon masën e sigurimit dhe gjyqtarit që deklaron moskompetencën. Ky konkluzion, sikurse u sipërcitua, mbështetet në faktin se masa e sigurimit e caktuar nga gjyqtari jokompetent ka vlefshmëri/efikasitet provizor, duke qenë shprehje e një pushteti të jashtëzakonshëm dhe emergjencial, të “akorduar”, këtij të fundit, prej ligjvënësit, dhe si rrjedhojë nuk mund të kufizohet vetëm në rastet e “identitetit” midis dy gjyqtarëve/gjykatave.

Rast emblemantik i aplikimit të këtij interpretimi zgjerues të disiplinës së parashikuar nga dispozita, neni 88 i KPP, do të konsiderohej “deklarimi i moskompetencës, jo vetëm nga gjyqtari (për hetimet paraprake) që ka caktuar masën e sigurimit, por edhe nga gjyqtari (i gjykatës së apelit), që gjykon ankimin ndaj vendimit të këtij gjyqtari që ka caktuar këtë masë me karakter të përkohshëm. Mbi këtë bazë arsyetimi, konkludohet prej këtij Kolegji, në funksion të problematikës së identifikuar, objekt i njësimi nëpërmjet gjykimit të kësaj çështjeje, (pika 2 e çështjeve objekt njësimi), se: provizoriteti (*ad interim*)/përkohshmëria e masës së sigurimit merr jetë ekskluzivisht vetëm në kushtet

e deklarimit të moskompetencës, për çdo lloj shkaku pa përjashtim, të moskompetencës lëndore apo tokësore, prej gjykatës/gjyqtarit për hetimet paraprake, gjatë kësaj faze të procedimit, të hetimeve paraprake, në të njëjtën kohë (me caktimin e kësaj mase) ose më vonë, e cila (i cili) presupozohet në kushtet e identitetit, me gjykatën (gjyqtarin) që ka caktuar këtë masë, pra e njëjta gjykatë. “Jetëgjatësia” e këtij provizoriteti (të kësaj mase të caktuar, të deklaruar në këto kushte) merr fund (në kuptimin e humbjes së efekteve, të fuqisë së kësaj mase) në kushtet e mosrinovimit (ripërtërimit) të saj prej gjykatës kompetente brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, pra, në thelb, kur nuk konfirmohet nëpërmjet deklarimit stabiliteti/qëndrueshmëria e saj. Ky është rregulli bazë i sanksionuar nga dispozita – neni 88 i KPP, që nuk përjashton, sikurse u argumentua më sipër, diversitetin e gjykatës që ka caktuar masën e sigurimit, me gjykatën që më pas, ka deklaruar moskompetencën, lidhur me caktimin e kësaj mase sigurimi. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionin njësuës si më poshtë vijon: **“Jo domosdoshmërisht, në kushtet e aplikimit të përcaktimeve të dispozitës, nenit 88 të KPP, Gjykata që ka caktuar masën e sigurimit do të (duhet) jetë e njëjtë me Gjykatën, e cila, më vonë, ka deklaruar moskompetencën e saj, për çdo lloj shkaku, për gjykimin e çështjes me këtë objekt.”**

Duke ju referuar konkluzioneve njësuëse lidhur me dy problematikat e para të trajtuara, konkluzioni mbi problematikën e tretë, të identifikuar në mundësinë e aplikimit të përcaktimeve të nenit 88 të KPP, në thelb, “të humbjes së efikasitetit/shuarjes së masave të sigurimit”, të caktuara nga gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake, edhe në rastin e deklarimit të moskompetencës nga prokurori gjatë fazës së hetimeve paraprake, (pas caktimit të tyre prej gjykatës kompetente dhe në kushtet e mungesës së një prononcimi gjyqësor lidhur me (mos)kompetencën) dhe dërgimit të akteve (të çështjes) tek prokurori kompetent, sipas përcaktimit të nenit 84/1 të KPP, është automatik dhe i pashmangshëm. Përsa kohë që masa e sigurimit e caktuar nga gjykata (gjyqtari për hetimet paraprake) kompetente, verifikohet në kushtet e stabilitetit (të efikasitetit të plotë), pra nuk rezulton që gjykata që ka caktuar këtë masë të ketë deklaruar, kontekstualisht apo më vonë, moskompetencën e saj, për çdo lloj shkaku, transferimi i hetimit të çështjes, sipas nenit 84/1 të KPP, nga një prokurori tek tjetra, për vazhdimin e hetimeve, i motivuar ky transferim me verifikimin e moskompetencës së prokurorisë që kishte regjistruar fillimisht/*ab initio* procedimin penal, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi lidhur me efikasitetin e masës së sigurimit të caktuar nga ajo gjykatë, në drejtim të humbjes së efikasitetit të masës së caktuar. Kolegji vlerëson se neni 88 i KPP kushtëzon provizoritetin (përkohshmërinë) e masës së sigurimit të caktuar dhe inefikasitetin e saj (në kushtet e mospërtërimit të saj brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve prej gjykatës kompetente), vetëm në rastin e deklarimit (kontekstual apo të mëvonshëm) të moskompetencës (për çfarëdo lloj shkaku) prej gjykatës (gjyqtarit), në cilësinë e deklarimit të organit juridiksional. Kolegji çmon se nuk sjell asnjë pasojë për masën e sigurimit të caktuar, në rastin kur disponohet për kalimin e akteve, gjatë hetimeve paraprake, nga një prokurori tek tjetra, e motivuar me konstatimin e moskompetencës për të hetuar, duke qenë se bëhet fjalë për akte të nxjerra nga një

organ/prokurori, i konsideruar palë (megjithëse palë publike) në proces (procedim), pa pushtet dhe kompetenca të karakterit juridiksional.

Me të drejtë ligjvënësi, sikurse rezulton nga përmbajtja e dispozitës, nuk ka toleruar (duke mos parashikuar) në funksion të qëllimit të ruajtjes së efikasitetit të masës së sigurimit, domosdoshmërinë e nxjerrjes së një vendimi (disponimi) të ri, prej gjyqtarit kompetent, në rastin kur, menjëherë mbas adoptimit, prej gjyqtarit për hetimet paraprake, të një mase sigurimi dhe në mungesë të një vendimi (disponimi) gjyqësor mbi (mos)kompetencën, prokurori, pranë këtij gjyqtari (kësaj gjykate), transmeton aktet e hetimit të (kësaj) çështjes, sipas përcaktimit të paragrafit të parë të nenit 84 të KPP, tek organi i akuzës (prokurori) pranë gjykatës që ai vlerëson kompetente. Ligjvënësi, duke mbajtur parasysh cilësinë e palës të organit të akuzës/prokurorit, megjithëse palë publike në procesin penal, si dhe rrethanën që, gjatë fazës së hetimeve paraprake të zhvilluara në drejtimin e këtij të fundit (prokurorit), për shkak të dinamikës (fluiditetit) së zhvillimit të tyre, hipotezat mbi karakterizimin (rindërtimin) e fakteve janë subjekt i modifikimit me pasojë ndikimi të drejtpërdrejtë mbi kualifikimin (juridik) të tyre, ka privilegjuar nevojën e efikasitetit dhe të menjëhershmerisë së zhvillimit të funksionit investigativ, nëpërmjet adoptimit të kriterit të elasticitetit në përcaktimin e raporteve (marrëdhënieve) midis prokurorive të ndryshme, duke evituar një ndarje të thellë dhe rigoroze të “pushteteve” respektive, kriter i ndryshëm në raport me ato që përcaktojnë kompetencën midis gjykatave. Sakaq, mbi bazën e kësaj logjike, gjithnjë prej ligjvënësit, nga njëra anë, është ometuar parashikimi i “mekanizmave” detyruese të prokurorit të “palegjitimuar”, për të transmetuar aktet tek titullari i hetimeve paraprake, sipas kriteve të përcaktuara në nenin 25 të KPP dhe toleruar prokurorit titullar të hetimeve paraprake të zhvilluara lidhur me çështjen penale të regjistruar ndaj personit që aplikohet masa e sigurimit, të vazhdojë hetimet edhe në kushtet e deklarimit të moskompetencës prej gjyqtarit të hetimeve paraprake që ka caktuar masën. Por, nga ana tjetër, adresohet rregullimi i konflikteve negative të kompetencës midis prokurorive të ndryshme, gjatë kësaj faze të hetimeve paraprake, në brendësi të strukturës organike të kësaj pale/prokurorisë, duke i atribuar zgjidhjen e tyre “prokurorit më të lartë”, sipas përcaktimit të paragrafit të dytë të nenit 89 të KPP (për mosmarrëveshjet mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm), si dhe “duke i dhënë përparësi” kompetencës së Prokurorisë së Posaçme, në rastet e krijimit të konfliktit të kësaj të fundit, me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Ligjvënësi me këtë zgjidhje ligjore ka evituar, në këtë mënyrë, investimin dhe prononcimin e gjykatës në lidhje me këtë moment.

Në këtë kontekst, të implementimit të kësaj disipline normative, vetëm rrethana që prokurori procedues, në një moment të caktuar të zhvillimit të fazës së hetimeve paraprake, gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre, sipas përcaktimit të paragrafit të parë të nenit 84 të KPP, transmeton aktet tek prokurori pranë gjykatës që ai mendon dhe vlerëson si gjykata kompetente, nuk është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të legjitimuar kompetencën e këtij të fundit/gjyqtarit për tu shprehur mbi masën e sigurimit. Gjyqtari në këtë rast, “paqësisht”, mund ta refuzojë atë (kërkesën) në rastin kur i kërkohet prej palëve, të prononcohet nëpërmjet një disponimi

të tij mbi masën, apo për të përjashtuar/shmangur, kompetencën e gjyqtarit pranë të cilit ushtron funksionet, prokurori që ka transmetuar aktet.

Për pasojë, konkludohet se transmetimi i akteve, i verifikuar në këto kushte, të deklarimit të moskompetencës së prokurorit procedues, në favor të kompetencës së prokurorit pranë gjykatës të vlerësuar (prej tij – prokurorit procedues) si gjykata kompetente, gjatë fazës së hetimeve paraprake të procedimit të regjistruar dhe mbas caktimit të masës së sigurimit prej gjykatës kompetente, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të efikasitetit të masës së sigurimit (të caktuar si më sipër). Në të njëjtën kohë, disponimi i prokurorit për deklarimin e moskompetencës është “i paafte” për t’i “atribuuar” kësaj mase, efikasitet të përkohshëm/të limituar, të tillë që të imponojë deklarimin e humbjes së fuqisë së saj në kushtet e mosrinnovimit brenda afatit dhjetë ditor nga marrja e akteve, sikurse parashikohet në dispozitë, nenin 88 të KPP, përsa kohë që mungon deklarimi i moskompetencës prej organit juridiksional – gjykatës.

Ndërkohë ligjvënësi, me ndryshimet e adoptuara me ligjin nr. 35/2017, neni 52 i këtij ligji, ka shtuar një paragraf të ri në nenin 84, paragrafin e dytë, [..] Përpos përmbajtjes së paqartë të kësaj dispozite, përsa kohë që i atribuon prokurorit “akte të hetimit paraprak të kryera para gjykatës” (të cilat gjykata jokompetente duhet t’ja dërgojë gjykatës kompetente), kur cilësinë e një akti të tillë e “gëzon” vetëm prova e marrë prej gjyqtarit për hetimet paraprake me procedurën e jashtëzakonshme të “sigurimit” të saj, të parashikuar nga nenet 317-322 të KPP, mbi kërkesën e palëve, e justifikuar kjo urgjencë me rrezikun e zhdukjes së saj”, dhe përsa kohë që “aktet e hetimit paraprak konsiderohen në diskrecionin ekskluziv të prokurorit dhe të policisë gjyqësore” të realizuara prej tyre, nën drejtimin e prokurorit titullar i kësaj faze, në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale”, Kolegji çmon se duhet theksuar që në këtë fazë ndërhyrja e gjykatës/gjyqtarit për hetimet paraprake është e karakterit incidental, garantues, e “provokuar”/stimuluar prej palëve, në kushtet e mungesës së disponibilitetit mbi to (hetimet paraprake). Në këto rrethana, dispozita e sipërcituar, paragrafi i dytë i nenit 84 të KPP, megjithë “përkujdesjet” për të vënë në gjendje “gatishmëri” gjykatat respektive, të “interesuara” dhe të “shqetësuara” prej kalimit të akteve nga një prokurori tek tjetra gjatë kësaj faze të hetimeve paraprake, për shkak të kompetencës dhe paragjyqimit, për pasojë, të karakterit definitiv të masave të sigurimit të caktuara, qartazi, për asnjë moment, nuk kontraston dhe nuk mohon arsyen e përcaktimit të nenit 88 të KPP, moskompetencën e deklaruar nga gjykata, si e vetmja mundësi për të “provokuar” provizoritetin/përkohshmërinë e masës së sigurimit personal të caktuar gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në konkluzion të këtij parashtrimi, Kolegji thekson se as përcjellja e akteve nga njëra gjykatë tek gjykata pranë të cilës funksionin prokuroria, të cilës i kanë kaluar aktet për kompetencë, nuk nënkupton zbatimin e nenit 88 të KPP, përsa kohë ky kalim i akteve nuk vjen si pasojë e një vendimi gjyqësor për shpalljen e moskompetencës.

Përfundimisht, mbi këtë bazë, Kolegji, lidhur me problematikën e tretë të shtruar për njësim, konkludon se **“Parashikimet (përcaktimet) e nenit 88 të KPP nuk janë të aplikueshme me rastin e shpalljes (deklarimit) së moskompetencës prej prokurorit, gjatë hetimeve paraprake apo në përfundim të tyre, dhe të**

dërgimit të akteve prokurorisë (prokurorit) kompetente, sipas përcaktimit të nenit 84/1 të KPP.”.

[..] 1. Në lidhje me pyetjen e parë të ngritur për njësimin e praktikës gjyqësore: “A zbatohet neni 88 i KPP për masat e sigurimit pasuror, apo është një dispozitë që i referohet vetëm masave të sigurimit personal?”, të mbahet ky qëndrim njësesues:

Neni 88 i KPP zbatohet si për masat e sigurimit personal, ashtu dhe për masat e sigurimit pasuror.

Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim: “Sipas nenit 88 të KPP, gjykata që cakton masën e sigurimit a është e njëjtë me gjykatën që, në të njëjtën kohë ose më vonë, shpall moskompetencën?”, të mbahet ky qëndrim njësesues:

Gjykata që cakton masën e sigurimit, jo domosdoshmërisht është e njëjtë me gjykatën që shpall moskompetencën.

Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim: “A zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetentë sipas nenit 84/1 të KPP?”, të mbahet ky qëndrim njësesues:

Parashikimet e nenit 88 të KPP në lidhje me masën e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente, nuk zbatohen në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente, sipas nenit 84/1 të KPP.

Duke u kthyer tek zgjidhja e çështjes konkrete, që nxiti këtë gjykim të karakterit njësesues, konkludohet prej këtij Kolegji, duke ju referuar konkluzionit të tretë të këtij vendimi, pamundësia e aplikimit/zbatimit të përcaktimeve të nenit 88 të KPP, me rastin e kalimit të akteve nga njëra prokurori tek tjetra, gjatë fazës së hetimeve paraprake, për shkak moskompetence. [...] Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë, [...], është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të nenit 432 të KPP, e lidhur kjo më zbatimin e gabuar të përcaktimeve të nenit 88 të këtij Kodi. Si rrjedhojë, Kolegji çmon se ky vendimi [...] është i cenusëshëm duke sjellë si pasojë prishjen e këtij vendimi, sipas përcaktimit të shkronjës “b” të paragrafit të parë të nenit 441 të KPP. Në të njëjtën kohë, prej këtij Kolegji, konkludohet mbi ligjshmërinë (në thelb) të vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së të hetuarës D.H. me objekt “Deklarimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit me karakter pasuror të sekuestros preventive”, me rastin e kalimit të akteve nga prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda tek Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të deklarimit të moskompetencës prej prokurorit, me pasojë lënien në fuqi të këtij vendimi.

KPGJL Vendimi Njësues Nr.00-2022-1036(114), datë 07.04.2022 (Rehabilitimi i të dënuarit)

I. Procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481-485 të KPP nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal.

II. Kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore i përket juridiksionit gjyqësor administrativ.

III. Kur një person pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfitur nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të K.Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, gjykata kompetente që vendos për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje do të jetë gjykata penale e rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin penal ndaj kërkuesit që pretendon rehabilitimin. Nëse ndaj kërkuesit është dhënë më shumë se një vendim gjyqësor, gjykata kompetente do të jetë gjykata që ka dhënë vendimin e fundit gjyqësor.

IV. Kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i parashikuar në nenin 69 të K.Penal për t'u konsideruar i rehabilituar përbën kusht ndalues që i dënuari, në përfundim të këtij afati, të përfitojë nga kjo e drejtë. Për efektet e zbatimit të nenit 69 të K.Penal, një vepër tjetër penale do të konsiderohet e kryer kur vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

V. Kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i parashikuar në nenin 69 të K.Penal për tu konsideruar i rehabilituar nuk përbën shkak që subjektit t'i mohohet përfundimisht e drejta për të përfitur nga instituti i rehabilitimit. Kryerja e një vepre tjetër penale sjell si pasojë që afati i parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal të rifillojë të llogaritet nga përfundimi i vuajtjes së dënimit të fundit. Në rast se i dënuari, gjatë periudhës për plotësimin e afatit për tu rehabilituar, dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër tjetër penale, me përfundimin e vuajtjes së dënimit për veprën tjetër, do të fillojnë të ecin njëkohësisht afatet që parashikohen në nenin 69 të K.Penal për tu rehabilituar edhe për vepra të tjera penale, duke u konsideruar si afat rehabilitimi afati më i gjatë.

Fjalë kyçe: ekzekutim i vendimit gjyqësor, instituti i rehabilitimit, regjistër gjendje civile, gjykatë kompetente

Rrethanat e çështjes:

[..] ka rezultuar e provuar se Gjukata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin penal nr. 55-04, datë 20.01.2014, ka deklaruar fajtor kërkuesin K.D. për veprën penale “Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit”, parashikuar nga neni 316 i K.Penal duke e dënuar me 9 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP i pandehuri K.D. është dënuar përfundimisht me 6 muaj burgim. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimit nr. 402, datë 16.03.2015, ka vendosur mospranimin e ankimit. Gjukata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin penal nr. 158, datë 30.03.2015, ka deklaruar fajtor të pandehurin K.D. për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/1 i K.Penal duke e dënuar me 8 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP i pandehuri është dënuar përfundimisht me 5 muaj e 10 ditë burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u apeluar në gjykatat e shkallëve më të larta.

Kërkuesi K.D. ka konstatuar se figuron i dënuar në regjistrin e gjendjes gjyqësore edhe pse kanë kaluar katër vjet nga vuajtja e dënimit. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë [...] pasi pretendon që të njihet “i rehabilituar” duke u urdhëruar Zyra e Gjendjes Gjyqësore të pasqyrojë këtë fakt në regjistra duke bërë fshirjen e dënimeve të dhëna ndaj tij. Kërkuesi pretendon se ai plotëson kushtin e përcaktuar nga neni 69 shkronja “a” i K.Penal, prandaj kërkon fshirjen e dënimeve nga regjistri gjyqësor. [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë [...] ka vendosur rrezimin e kërkesës [...] Gjykata e Apelit Shkodër [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...]

Kolegji [...] në seancë gjyqësore, konstatoi se ndërmjet Kolegjit Penal⁸ dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë⁹, si dhe midis gjykatave të rrethit gjyqësor dhe gjykatave administrative ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesat me objekt rehabilitimin e të dënuarit sipas nenit 69 të K.Penal. Për këtë arsye, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, [...] Kolegji vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim [...] për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me këto çështje:

1. ***A përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481-485 të KPP?***
2. ***Cilit juridiksion i përket kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore?***
3. ***Kur një person pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfutuar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të K.Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë, për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, cila është gjykata kompetente që vendos për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje?***
4. ***Si ndikon kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të K.Penal?***
5. ***A përbën kryerja e një vepre tjetër penale shkak që subjektit t'i mohohet e drejta për të përfutuar nga instituti i rehabilitimit apo kjo përbën shkak vetëm për ndërprerjen e afatit që parashikon neni 69 i K.Penal?***

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Fillimisht, Kolegji çmon me vend të argumentojë se përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet objekt gjykimi dhe përse janë shtruar

⁸ Shih vendimet nr. 94, datë 11.11.2021; nr. 2014-1090, datë 17.04.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁹ Shih vendimet nr. 2394-2018, datë 04.12.2018; nr. 2018-723, datë 05.06.2018; nr. 2017-556, datë 06.03.2017; nr. 2020-672, datë 09.11.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si dhe vendimin nr. 2020-39, datë 14.09.2020, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

pikërisht këto çështje për njësim nga Kolegji.

Kolegji vë në dukje se çështjet e shtruara për njësim, pavarësisht numrit të pyetjeve që janë pesë, mund të grupohen në dy nëndarje kryesore;

Së pari, Kolegji çmon të nevojshme të njësojë praktikën në lidhje me faktin se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesat e palëve me objekt rehabilitimin e të dënuarit, në rast se kërkuessit nuk i njihet kjo e drejtë nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në lidhje me këtë çështje, lindi nevoja për njësim pasi është evidentuar praktikë jo e njëjtë gjyqësore si ndërmjet Kolegjit Penal dhe Kolegjit Administrativ [...] ashtu edhe midis gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe gjykatave administrative të shkallës së parë.

Konkretisht, ndër të tjera, me vendimet nr. 94, datë 11.11.2021, dhe nr. 2014-1090, datë 17.04.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se kompetenca për të shqyrtuar kërkesat në lidhje me rehabilitimin sipas nenit 69 të K.Penal i përket gjykatës së rrethit gjyqësor, konkretisht dhomës penale. [...] Nga ana tjetër, në një sërë vendimesh, Kolegji Administrativ ka mbajtur qëndrimin se kompetenca për të gjykuar në lidhje me sa më sipër i përket gjykatës administrative të shkallës së parë (vendimi nr. 2018-723, datë 05.06.2018; nr. 2017-556, datë 06.03.2017; nr. 2020-672, datë 09.11.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë), ndërsa në ndonjë rast tjetër, si vendimi nr. 2394-2018, datë 04.12.2018, i Kolegjit Administrativ është mbajtur qëndrimi se kjo çështje i përket gjykatës së rrethit gjyqësor, dhomës penale. [...] Gjithashtu, Kolegji Civil në vendimin nr. 00-2017-556, datë 16.03.2017, ka mbajtur këtë qëndrim: [...] Gjithashtu, Kolegji Civil, në vendimin nr. 00-2010-1035, datë 25.06.2010, ka mbajtur qëndrimin se kompetenca për të vendosur në lidhje me kërkesëpadinë për rehabilitimin e të dënuarit i përket gjykatës civile, prandaj e ka gjykuar në themel mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

Në këtë drejtim, Kolegji Penal çmon se lind domosdoshmëria që të njësohet praktika gjyqësore në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesat e palëve me objekt rehabilitimin e të dënuarit, në rast se kërkuessit nuk i njihet kjo e drejtë nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, çështje që është zbërthyer në tre pyetjet e para të shtruara për njësim. Një detyrë e tillë lind për Kolegjin, në kuadër të ushtrimit prej Gjykatës së Lartë të rolit të saj thelbësor kushtetues, sikurse është roli nomofilatik mbi zhvillimin, njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, për shkak të funksionit të saj si gjykatë ligji.

Së dyti, Kolegji konstaton se e paqartë dhe jo uniforme është praktika gjyqësore edhe në lidhje me zbatimin në thelb të nenit 69 të K.Penal që trajton institutin e rehabilitimit të të dënuarit. Për këtë arsye, Kolegji vendosi që të njësojë praktikën gjyqësore edhe në lidhje me dy pyetjet e tjera të shtruara për njësim, konkretisht në lidhje me çështjen se a ndikon kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të K.Penal, dhe nëse po, si ndikon ajo? A përbën kryerja e një vepre tjetër penale shkak që subjektit t'i mohohet përfundimisht e drejta për të përfutur nga instituti i rehabilitimit apo kjo përbën shkak vetëm për ndërprerjen e afatit që parashikon neni 69 i K.Penal?

[...] Fillimisht Kolegji ndalet në trajtimin e pyetjes së parë të shtruar për njësim: **A përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal procesi i hedhjes së të**

dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481-485 të Kodit të Procedurës Penale?

Në vendimet e sipërcituara Kolegji Penal ka arsyetuar, ndër të tjera, se ligji material penal, pikërisht neni 69 i K.Penal, ka përcaktuar se kur një person do të konsiderohet i padënuar/rehabilituar, në raport me kohëzgjatjen e dënimit, me kushtin që gjatë një periudhe kohore të caktuar në vazhdim të mos kryejë veprë tjetër penale. Nga ana tjetër, krahas parashikimit të nenit 69 të K.Penal, është miratuar dhe një ligj i posaçëm që është ligji nr. 9614, datë 02.09.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore” dhe aktet nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji. Sipas këtij ligji Zyra e Gjendjes Gjyqësore është institucioni i posaçëm që bën shënimet, hedhjen e të dhënave, ruajtjen e tyre, kryerjen e veprimeve në regjistrin e gjendjes gjyqësore sipas përcaktimeve të K.Penal dhe KPP. Kolegji vë në dukje se rehabilitimi i të dënuarit rregullohet nga dispozita penale materiale (K.Penal) dhe njëkohësisht procedurale (KPP) si dhe nga ligje të posaçme. Neni 69 i K.Penal [...] Nga ana tjetër, gjendja gjyqësore rregullohet nga nenet 481-485 të KPP [...] Neni 482 parashikon se cilat vendime regjistrohen në regjistrin gjyqësor, ndërsa neni 483 i KPP rregullon heqjen e shënimeve në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Nga ana tjetër, neni 484 parashikon subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë dhe marrin vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Këto janë dispozitat procedurale të KPP që rregullojnë gjendjen gjyqësore dhe veprimtarinë e zyrës së gjendjes gjyqësore, për të cilën Kodi parashikon që krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Gjithashtu, Zyra e Gjendjes Gjyqësore rregullohet dhe funksionon sipas një ligji të posaçëm që është ligji nr. 9614, datë 21.9.2006, [...] Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për administrimin e regjistrit të gjendjes gjyqësore nëpërmjet rrugës elektronike. Neni 3 i këtij ligji përcakton: [...] Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, rezulton se Zyra e Gjendjes Gjyqësore është organi publik, i ngarkuar me ligj, për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore. [...]

[...] për t’iu përgjigjur pyetjes nëse këto veprime, që ligji i’a ngarkon Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, bëjnë pjesë në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, është e nevojshme të trajtohet koncepti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore rregullohet nga neni 462 e vijues i KPP. Gjithashtu, ekzekutimi rregullohet nga ligji nr.79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Me ekzekutim të vendimit penal kuptohet vënia në ekzekutim e një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë dhe vendimeve penale që ekzekutohen menjëherë, sipas nenit 462/2 të KPP. KPP dhe ligji i posaçëm nr. 79/2020 ngarkon prokurorin si subjektin përgjegjës për ekzekutimin e vendimit. Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit.

Sipas nenit 11 të ligjit nr. 79/2020, prokurori merr masa dhe vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhe, në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të KPP, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit,

sipas këtij ligji. Prokurori mban dosje të veçantë për ekzekutimin e vendimit dhe për të gjitha aktet e administruara gjatë ekzekutimit. Urdhri i ekzekutimit është akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal. Neni 12 i ligjit parashikon elementet që përmban urdhri i ekzekutimit të vendimit penal. Ligji përcakton se urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e dënimit. Në rastin e të miturve, urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë në të cilën është ngritur seksioni për të mitur. Ligji i posaçëm nr. 79/2020, [...] përmban rregulla specifike për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale. Ligji parashikon se, si rregull, vendimet penale ekzekutohen kur marrin formë të prerë, ndërsa përjashtimisht ligji parashikon rregulla specifike për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve penale. Ligji përcakton rregulla për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe dënimeve alternative. [...]

Vlen për t'u theksuar që vendimi penal përfundon ekzekutimin kur i dënuari përmbush të gjitha detyrimet që përmbahen në vendim, cilado qoftë mënyra e disponimit të gjykatës apo mënyra e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në rast se i dënuari është dënuar me dënim me burgim, me përfundimin e vuajtjes së dënimit me burgim përfundon dhe faza e ekzekutimit të vendimit penal. Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur përfundon kryerjen e dënimit, i falet dënimi i mbetur, amnistohet vepra penale apo dënimi i mbetur ose lirohet me vendim gjyqësor. Me një nga këto forma përfundon edhe faza e ekzekutimit të vendimit penal për dënimin me burgim. Ligji parashikon rregulla edhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që përmbajnë dënim alternativ, duke përcaktuar rregullim specifik për secilin prej dënimeve alternative. Pikërisht nga momenti që i burgosuri lirohet dhe i dënuari shlyen përfundimisht çdo dënim të dhënë ndaj tij, përfundon faza e ekzekutimit të vendimit penal dhe fillon llogaritja e afateve të përfitimit nga instituti i rehabilitimit ligjor, sipas nenit 69 të Kodit Penal. Ligji nr. 79/2020 parashikon dhe një sërë organesh të tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor si Policinë e Shtetit, Shërbimin Përmbartimor, Shërbimin e Provës, Agjencinë e Administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, organet shtetërore dhe persona të tjerë juridikë. Vlen për t'u theksuar që Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk bën pjesë në organet që ligji i ngarkon me detyra specifike gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor apo që kanë detyrë për të bashkëpunuar me prokurorin gjatë kësaj faze.

Nga leximi i dispozitave të ligjit nr. 79/2020 arrihet në përfundimin se asnjëri prej veprimeve ligjore që është ngarkuar të kryejë prokurori i ekzekutimit nuk lidhet apo ndërhyt në veprimtarinë e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore që është një organizëm që ushtron funksionet pranë Ministrisë së Drejtësisë sipas ligjit të posaçëm në bazë të së cilit vepron, i cili nuk ka lidhje, varësi dhe as jep llogari për veprimtarinë e tij tek prokurori. Në këtë linjë arsyetimi, procesi i përpunimit të të dhënave nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore në lidhje me pasqyrimin e fakteve që provojnë faktin e qenies i dënuar apo i rehabilituar të subjektit që e pretendon, nuk i përket fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Vendimi penal që ka disponuar me dënim me burgim, përfundon ekzekutimin kur i dënuari përfundon vuajtjen e dënimit me burgim. Gjithashtu,

dënimet e tjera alternative përfundojnë ekzekutimin kur i dënuari përmbush të githa detyrimet që përmban vendimi gjyqësor. E drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar në lidhje me dënimin e dhënë nuk është një fazë që i përket ekzekutimit të vendimit penal. Kjo e drejtë subjektiviteti i lind më pas në kohë, jo vetëm pasi ka përfunduar faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor ndaj të cilit ai pretendon se është rehabilituar, por veçanërisht pasi plotësohen kushtet që kërkon neni 69 i K.Penal. Me këtë logjikë arsyetimi, Kolegji arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuarit në lidhje me të drejtën e rehabilitimit si dhe vendimmarrja e organit kompetent në lidhje me këtë pretendim nuk përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Megjithatë, pavarësisht këtij konstatimi, fakti që ushtrimi i kompetencave të dhëna me ligj nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal, në vlerësim të Kolegjit, nuk kushtëzon dhe as përbën një faktor përcaktues për kompetencën lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë kërkesat e palëve në lidhje me të drejtën për rehabilitim, në paraprirje të pyetjes së tretë të shtruar për njësim prej Kolegjit. Kolegji do të elaborojë këtë qëndrim në vijim, në përgjigje të çështjeve të tjera të shtruara për njësim. Në përfundim të linjës së mësipërme të arsyetimit, Kolegji vendos që në përgjigje të çështjes së parë të shtruar për njësim, të mbajë këtë qëndrim:

I. Procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481-485 të KPP nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal.

Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji çmon të nevojshme të evidentojë fillimisht kompetencat e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore referuar dispozitave të KPP dhe ligjit të posaçëm. Ashtu siç u trajtua më sipër, nenet 481-485 të KPP trajtojnë gjendjen gjyqësore. Neni 481 i K.P.P. parashikon se pranë Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e regjistrit gjyqësor, depozitohen shkurtime të vendimeve për personat e gjykuar penalisht. Gjykata e shkallës së parë dërgon në zyrën e regjistrit gjyqësor shkurtime të vendimit të dënimit brenda 10 ditëve nga data që vendimi merr formë të prerë, kur ndaj tij nuk ushtrohet ankimi dhe brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së akteve, kur ndaj vendimit është ushtruar ankimi.

Neni 482 i KPP parashikon se cilat vendime regjistrohen në regjistrin gjyqësor, ndërsa neni 483 i Kodit rregullon heqjen e shënimeve në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Nga ana tjetër, neni 484 parashikon subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë dhe marrin vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Këto janë dispozitat procedurale të KPP që rregullojnë gjendjen gjyqësore dhe veprimtarinë e zyrës së gjendjes gjyqësore, për të cilën Kodi parashikon që krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Gjithashtu, Zyra e Gjendjes Gjyqësore rregullohet dhe funksionon sipas një ligji të posaçëm që është ligji nr. 9614, datë 21.9.2006, "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore". [...] Kompetencat e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore janë të përcaktuara me ligjin e mësipërm. [...] Një prej kompetencave që ligji i ka përcaktuar Zyrës së Gjendjes Gjyqësore është përpunimi automatik i të dhënave. Në kuptim të ligjit ky përpunim

përfshin operacionet e hedhjes së të dhënave në regjistrin themeltar elektronik vetëm nga punonjësi i autorizuar, duke garantuar ruajtjen e të dhënave, kryerjen e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi këto të dhëna, marrjen e tyre nga institucionet përkatëse, gjykata e prokuroria dhe kalimin e këtyre të dhënave në regjistrin elektronik. Gjithashtu, ligji i ngarkon Zyrës kompetencën e administrimit të regjistrit të gjendjes gjyqësore, i cili përbëhet nga regjistri shkresor i gjendjes gjyqësore, regjistri themeltar elektronik i gjendjes gjyqësore dhe regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore.

Nga leximi dhe interpretimi i dispozitave të K.P.P. dhe ligjit të posaçëm, arrihet në përfundimin se Zyra e Gjendjes Gjyqësore është organ i administratës publike, i krijuar dhe që funksionon në bazë të një ligji të posaçëm dhe që ka kompetencë mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore. Tërësia e këtyre kompetencave që organi administrativ ushtron në bazë të ligjit mund të përbëjë shkak për lindje të mosmarrëveshjeve, në eventualitetin e ngritjes së pretendimeve në lidhje me këtë veprimtari. Në rast se individi ka pretendime në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave nga organi administrativ, Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ai ka të drejtë t'i drejtohet me padi gjykatës administrative, duke kundërshtuar veprimtarinë e organit administrativ, në lidhje me mbajtjen apo përpunimin e të dhënave apo kompetencave të tjera që ligji i ngarkon Zyrës.

Gjykata kompetente për shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në drejtim të veprimtarisë së organit publik, Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, në lidhje me hedhjen e të dhënave në regjister, mbajtjen e tyre, heqjen e të dhënave, regjistrimin e vendimeve gjyqësore si dhe përpunimin e këtyre të dhënave do të jetë gjykata administrative e shkallës së parë ku ka qendrën organi administrativ, veprimi administrativ i të cilit kundërshtohet. Një përfundim i tillë arrihet po të marrim në konsideratë që objekti i mosmarrëveshjes është pikërisht veprimtaria e organit administrativ, në kuadër të ushtrimit të kompetencave që i cakton ligji. [...] Gjykata administrative e shkallës së parë do të shqyrtojë ligjshmërinë e veprimtarisë administrative të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, duke disponuar në lidhje me pretendimet eventuale të palës paditëse.

Kolegji vlerëson të theksojë se kur flasim për ushtrim të veprimtarisë administrative, në kuadër të kompetencave që i jep ligji, duhet mbajtur në konsideratë që këtu nuk përfshihet njohja e të drejtës për t'u konsideruar i rehabilituar, si e drejtë penale materiale. Nga tërësia e kompetencave që ligji i ngarkon Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, kompetencat që u detajuan më sipër, konstatohet se njohja e të drejtës për t'u quajtur i rehabilituar nuk përfshihet në sferën e kompetencave ligjore që ligji i posaçëm dhe KPP i ngarkon Zyrës së Gjendjes Gjyqësore. Kompetencat e Zyrës si hedhje të dhënash, përpunimi dhe ruajtja e tyre, kryerja e veprimeve logjike mbi këto të dhëna, mbrojtja nga ndryshimet, marrja, shpërndarja e tyre nëpërmjet niveleve të sigurisë, kryerjen dhe heqja e shënimeve nuk përfshijnë njohjen e të drejtës për t'u quajtur i rehabilituar. Ndërsa kundërshtimi i veprimtarisë administrative të organit administrativ dhe pretendimet eventuale mbi këtë veprimtari dhe mbi saktësinë e këtij informacioni i përkasin juridiksionit gjyqësor administrativ, konkretisht

gjykatës administrative të shkallës së parë, të territorit të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, veprimtaria e së cilës kundërshtohet.

Në këtë linjë arsyetimi, në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji vendos të mbahet ky qëndrim njësuës:

II. Kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore i përket juridiksionit gjyqësor administrativ.

Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim, se, referuar pretendimeve të personit që pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të K.Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë, për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar këto pretendime, Kolegji vlerëson se ajo që ndan juridiksionin është natyra dhe lënda e pretendimeve që ngre subjekti që lidhje me veprimtarinë e gjendjes gjyqësore. Kolegji çmon të theksojë se thelbi i pyetjes së tretë, të shtruar për njësim lidhet me faktin se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesën e palës që pretendon të drejtën e rehabilitimit, sipas nenit 69 të K.Penal, por kjo e drejtë i është refuzuar nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore?

Kolegji vlerëson të nevojshëm rikonfirmimin e qëndrimit se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegji thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. [...] (*shih vendimin nr. 917, datë 11.05.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili determinon konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. “Gjykata e krijuar me ligj” është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1 i KEDNJ. [...] Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kriteret themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. [...] (*shih vendimin njësuës nr. 00-2018-148, datë 04.04.2018 dhe nr.23, datë 27.07.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

Qëndrimi i konsoliduar jo vetëm i Kolegjit Penal, por i Gjykatës së Lartë në tërësi, është që kompetenca lëndore e gjykatës përcaktohet nga natyra e mosmarrëveshjes, nga lënda e të drejtës që pretendohet dhe jo nga subjektet pjesëmarrës në gjykim. Fakti që një nga palët në mosmarrëveshje është organ i administratës publike nuk do të thotë që mosmarrëveshja që lind me këtë organ i përket automatikisht gjykatës administrative, kur në thelb e drejta që pretendon pala i përket një lënde të caktuar, civile ose penale.

Kolegji Civil ka mbajtur qëndrimin se kompetenca lëndore e një mosmarrëveshje i referohet objektit të gjykimit, natyrës së konfliktit që përmban ajo, pra lëndës së gjykimit dhe jo palëve ndërgjyqëse. Fakti që palë e paditur në këtë mosmarrëveshje është organ i administratës publike nuk kondicionon natyrën e mosmarrëveshjes dhe as përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Karakteristikat e subjektit që kryen

cenimin, subjekt privat apo organ i administratës publike, nuk ndryshojnë natyrën e mosmarrëveshjes. Nëse do të përcaktohej kompetenca lëndore e gjykatës referuar palës së paditur, atëherë do të kishim një përcaktim artificial të kompetencës lëndore, duke bërë që ajo të vlerësohej si administrative sa herë që palë e paditur do të ishte një organ i administratës publike, pavarësisht natyrës civile të mosmarrëveshjes. [..]. (shih vendimin e Kolegjit Civil nr. 00-2020- 627, datë 11.11.2020) Ashtu siç ka mbajtur qëndrim Kolegji Administrativ, për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin *prima facie* të saj. Ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. [..] (shih vendimin nr. 112, datë 08.06.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë). Përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen “objekti i padisë” dhe “baza ligjore” e saj. [..]Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit *tura novit curia* (gjykata e njeh ligjin) analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve (shih Vendimin Unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, § 28).

Qëndrimi i mësipërm është mbajtur në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente nga të tre Kolegjet e Gjykatës së Lartë, ku natyra dhe lënda e mosmarrëveshjes përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Interpretimi strikt i natyrës së mosmarrëveshjes duke i'u referuar vetëm objektit të padisë apo kërimit dhe jo shkakut ligjor të saj, do të çonte në një përfundim jo të drejtë në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës që duhet të shqyrtojë mosmarrëveshjen. Në të njëjtën linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se kur kërkuesi pretendon se ka të drejtë të përfitojë nga instituti i rehabilitimit, por Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk i'a njeh këtë të drejtë, atëherë ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës duke pretenduar njohjen e të drejtës së rehabilitimit sipas nenit 69 të K.Penal. Kjo gjykatë është gjykata e rrethit gjyqësor, konkretisht dhoma penale, pikërisht sepse natyra e të drejtës që pretendon dhe kërkon t'i njihet subjektit është e drejtë penale materiale, e drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar kur përmbush kushtet që kërkon neni 69 i K.Penal. Kolegji vlerëson se, në çështjen konkrete, natyra e mosmarrëveshjes nuk duhet parë në mënyrë të ngushtë, duke e konsideruar objektin e mosmarrëveshjes si padi me objekt detyrimin e organit administrativ të kryejë një veprim administrativ që refuzon ta kryejë për subjektin. Në thelb kërkuesi pretendon njohjen e një drejte materiale penale, të drejtën për rehabilitim dhe mosveprimi i organit administrativ lidhet pikërisht me faktin se subjekti nuk e ka të njohur të drejtën materiale, e cila nëse do të ishte e qartë dhe e njohur do ta detyronte organin, në këtë rast Zyrën e Gjendjes Gjyqësore, të vepronte dhe të lëshonte certifikatën e gjendjes gjyqësore me shënimin “i rehabilituar”, ashtu siç pretendon kërkuesi.

Për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tre kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. [..] (shih vendimin nr. 2, datë 10.03.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, § 23).

Në çështjen objekt gjykimi, njëkohësisht të shtruar për njësim prej Kolegjit, Kolegji vlerëson se nuk përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mësipërme, në mënyrë që mosmarrëveshja të përfshihet në lëndën e gjykimit administrativ. Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për t'u u njohur e drejta e rehabilitimit nuk është një çështje që i përket interesit publik, por dukshëm kanalizohet si interes privat i një shtetasi të dënuar për të përfituar nga e drejta e rehabilitimit, njohur nga neni 69 i K.Penal.

Pavarësisht se në pamje të parë duket sikur objekti i mosmarrëveshjes lidhet me mosveprimin e organit publik, Zyrën e Gjendjes Gjyqësore për të kryer një veprim administrativ, nga interpretimi dhe vlerësimi i drejtë i shkakut të kërkimit, kërkuesi në thelb kërkon t'i njihet e drejta për t'u konsideruar i rehabilituar, e drejtë penale materiale që rregullohet nga neni 69 i K.Penal. [...] Kërkuesi nuk padit organin publik dhe as kërkon kryerjen e ndonjë veprimi administrativ prej tij, apo ndryshimin e një akti administrativ. Zyra e Gjendjes Gjyqësore në këtë gjykim paraqitet në cilësinë e personit të interesuar dhe jo palës së paditur, pikërisht se natyra e mosmarrëveshjes nuk lidhet drejtpërdrejtë me mosveprimin e saj, por me njohjen në thelb të së drejtës materiale penale të parashikuar nga neni 69 i K.Penal, të drejtës për t'u rehabilituar.

Megjithatë, as cilësia procedurale e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore si person i interesuar nuk është faktor determinant që përcakton natyrën e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë kompetencën e gjykatës që do të shqyrtojë mosmarrëveshjen. Është natyra e të drejtës që pretendohet të njihet me anë të gjykimit ajo që përcakton thelbin, lëndën e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë edhe kompetencën lëndore të gjykatës. Pavarësisht se kjo e drejtë njihet dhe shënohet në regjistrin përkatës nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore që është organ i administratës publike, në rast se subjekti ka pretendime në lidhje me të drejtën e rehabilitimit atëherë ai duhet t'i drejtohet gjykatës penale, që është gjykata e krijuar me ligj për interpretimin e të drejtës penale materiale dhe për njohjen e një të drejte penale materiale, siç është e drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar, sipas nenit 69 të K.Penal.

Instituti i rehabilitimit është në thelb një institut juridiko – penal dhe konflikti nuk ka lindur sepse kërkuesi kërkon që të detyrohet organi publik që të kryejë një veprim administrativ i cili është refuzuar, duke pasqyruar në vërtetimin e gjendjes gjyqësore faktin e pretenduar prej tij, rehabilitimin apo pasqyrimin e shënimeve si i padënuar. Kërkuesi K.D. në rastin konkret kërkon njohjen e të drejtës së rehabilitimit, e drejtë penale materiale dhe konflikti ka lindur pikërisht për shkak të mosnjohjes së kësaj të drejte dhe jo për shkak të mosveprimit të organit publik.

Kolegji çmon të nevojshme të bëjë dallimin midis kundërshtimit të veprimtarisë administrative të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore në lidhje me mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave apo kompetencave të tjera që i ngarkon ligji dhe pretendimit të kërkuesit për njohjen e të drejtës për t'u konsideruar i rehabilituar, në kuptim të nenit 69 të K.Penal. Ndërsa e para përbën kundërshtim të veprimtarisë së organit administrativ dhe i përket juridiksionit gjyqësor administrativ, e dyta konsiston në pretendimin për njohjen e një të drejte penale materiale dhe i përket juridiksionit gjyqësor penal.

Kolegji shton se refuzimi i organit administrativ, konkretisht i Zyrës së Gjendjes

Gjyqësore për të njohur të drejtën e kërkuarit për t'u rehabilituar, lidhet pikërisht me faktin se thelbi i të drejtës nuk është i qartë. Mosnjohja e kësaj të drejte nga zyra lidhet me përmbushjen e kushteve që kërkon dispozita, neni 69 i K.Penal, në thelb të tij, kushte që i referohen ekzistencës së të drejtës së rehabilitimit të pretenduar nga kërkuari, nëse atij i takon apo jo kjo e drejtë.

Në këtë linjë arsytimi, Kolegji thekson se fakti që Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk vepron nuk do të thotë që gjithmonë mosmarrëveshja duhet të kanalizohet si mosveprim i organit publik, në ato raste kur mosveprimi lidhet pikërisht me moskzistencën apo pamundësinë për të vërtetuar të drejtën materiale në thelb. Në rast se organi administrativ nuk vepron, pra nuk lëshon certifikatën e gjendjes gjyqësore me shënimin “i rehabilituar”, nuk do të thotë që ai nuk ka vepruar, organi e ka lëshuar aktin administrativ, por nuk e ka lëshuar me shënimin që vërteton të drejtën që pretendon kërkuari. Kjo ndodh pikërisht sepse e drejta materiale që pretendon kërkuari, “e drejta për t'u rehabilituar”, nuk është e njohur dhe kompetencën për të njohur një të drejtë të tillë, që lidhet drejtpërdrejtë me interpretimin e një instituti penal material si rehabilitimi, e ka gjykata penale e rrethit gjyqësor.

- *Ligji dhe praktika gjyqësore e vendeve fqinje në lidhje me çështjen e shtruar për njësim*: Kolegji, në vijim, i referohet legjislacionit të vendeve fqinje dhe praktikës gjyqësore të tyre, për të parë mënyrën se si ligji i tyre e rregullon çështjen e mësipërme të shtruar për njësim prej Kolegjit në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rehabilitim: [..]

Duke i'u rikthyer çështjes konkrete dhe rregullimit të ligjit shqiptar, Kolegji Penal vlerëson se pavarësisht se ligji procedural shqiptar nuk shprehet në lidhje me gjykatën kompetente për të marrë në shqyrtim kërkesën në lidhje me rehabilitimin e të dënuarit, sipas neni 69 të K.Penal, kompetenca i përket gjykatës së rrethit gjyqësor, dhomës penale dhe konkretisht gjykatës që ka dhënë vendimin penal. Nëse është më shumë se një vendim penal i kryer nga i dënuari, për të cilin pretendohet rehabilitimi, gjykata kompetente do të jetë gjykata penale që ka dhënë vendimin e fundit gjyqësor. Një përfundim i tillë arrihet po të marrim në konsideratë funksionin që ka kjo gjykatë në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për rehabilitim. Gjykata do të verifikojë kur ka përfunduar vuajtja e dënimit të dhënë, kalimin e afatit kohor që përcakton dispozita si dhe moskryerjen e një veprë tjetër penale nga i dënuari, kushte që, ashtu siç do të trajtohet në vijim, janë kumulative. Gjithashtu, Kolegji e përjashton mundësinë që gjykata kompetente të jetë gjykata e ekzekutimit, sipas neni 470 e vijues të KPP që e parashikon shprehimisht kompetencën e gjykatës së ekzekutimit [..] pasi siç u argumentua më sipër pretendimi për rehabilitim nuk i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Në përfundim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se thelbi dhe lënda e mosmarrëveshjes përcaktojnë natyrën e mosmarrëveshjes dhe rrjedhimisht përcaktojnë edhe kompetencën lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë pretendimet e kërkuarit me objekt të drejtën e tij për t'u konsideruar i rehabilituar edhe në ato raste kur Zyra e Gjendjes Gjyqësore i'a refuzon këtë të drejtë. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se përgjigja e pyetjes së tretë është:

III. Kur një person pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të K.Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, gjykata kompetente që vendos për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje do të jetë gjykata penale e rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin penal ndaj kërkuesit që pretendon rehabilitimin. Nëse ndaj kërkuesit është dhënë më shumë se një vendim gjyqësor, gjykata kompetente do të jetë gjykata që ka dhënë vendimin e fundit gjyqësor.

Si trajtoi çështjen e kompetencën lëndore të gjykatës që shqyrton kërkesat e palëve dhe pretendimet në lidhje me të drejtën e rehabilitimit, Kolegji ndalet në çështjet katër dhe pesë që lidhen me trajtimin në thelb të këtij instituti penal material, të parashikuar nga neni 69 i K.Penal.

Një nga qëllimet e dënimit penal është rehabilitimi i të dënuarit, pra edukimi i tij në shoqëri që ai të mos përfshihet më në veprimtari të kundërligjshme, të jetë një qytetar i denjë dhe të përfshihet në të gjitha funksionet në shoqëri. Neni 5/3 i KPP [...] Krahas rehabilitimit moral subjektivit i lind e drejta të përfitojë edhe nga rehabilitimi ligjor, domethënë e drejta të figurojë i padënuar në certifikatën e gjendjes gjyqësore.

Instituti i rehabilitimit është një nga mekanizmat ligjorë, njëkohësisht një e drejtë themelore që garanton dinjitetin e njeriut; si një nga bazat mbi të cilat është themeluar Kushtetuta. Qëllimi i rehabilitimit është mbrojtja e personalitetit dhe dinjitetit të të dënuarve, të kufizuara për shkak të vendimeve gjyqësore të dënimit për kryerjen e veprave penale, duke i ri-socializuar ata në përditshmërinë normale të jetës.

Kjo e drejtë natyrore e njeriut, mund të kufizohet vetëm për interesa publike, tepër të rëndësishme, siç do të ishte siguria e shoqërisë, por kurrësi nuk mund të mohohet vetë thelbi i saj [...] Instituti i rehabilitimit, në të drejtën penale shqiptare, mbështetet në parimin se çdo qenie njerëzore vazhdimisht evoluon, vetëkorrigjohet dhe ndryshon, si në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, por edhe në lidhje me shoqërinë dhe institucionet e saj. Personi i rehabilituar quhet i padënuar, sikur dënimi të mos ketë ekzistuar asnjëherë dhe ai gëzon të gjitha të drejtat e kufizuara më parë, përveç kur ligji shprehet ndryshe.

Dënimi i autorëve ndikon në statusin juridik të tyre, duke sjellë pasoja për të dënuarit. Pasojat janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme si morale, juridike, ekonomike, sociale, etj. Këtu mund të përmendet edhe konsiderimi si përsëritës, në rast se personi kryen veprë tjetër penale pas rehabilitimit. Filozofia e rehabilitimit të personave të dënuar bazohet në të drejtën që këta persona kanë që shoqëria të falë dhe të harrojë veprat penale të kryera prej tyre në të shkuarën, duke i konsideruar “të padënuar”. [...]

Rehabilitimi presupozon që dënimi kryesor është vuajtur ose shlyer, duke eliminuar pasojat e ardhura prej tij dhe duke i kthyer të dënuarit kapacitetin juridik që ka humbur për shkak të dënimit të dhënë ndaj tij. Duhet mbajtur në konsideratë, gjithashtu, që rehabilitimi nuk ka fuqi prapavepruese, pasi ai vepron vetëm për të ardhmen, për shembull duke mos patur efekt për cilësimin e të dënuarit si përsëritës nëse ai kryen një veprë tjetër penale. Rehabilitimi pushon çdo efekt penal të dënimit kryesor. Termi “efekte të tjera penale” është interpretuar nga jurisprudenca në kuptimin e gjerë, si

gjithëpërfshirës i të gjitha efekteve, qoftë edhe të natyrës civile apo administrative, që rrjedhin nga dënimi dhe që kanë qenë të afta për të zvogëluar aftësinë juridike të shkelësit.

Pasoja kryesore e rehabilitimit është aftësia e të dënuarit që të ri-integrohet në shoqëri, duke u kthyer në të njëjtat kushte dhe pozicion që ishte para se ndaj tij të caktohej dënimi penal. Ky institut karakterizohet nga një funksion shpërblyes dhe promovues, pasi lidhet me shlyerjen me sukses të dënimit kryesor dhe me sjelljen e mirë të demonstruar për një periudhë të caktuar kohore nga i dënuari.

- *E drejta për rehabilitimin e të dënuarit në këndvështrimin e praktikës së GJEDNJ.*

GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se të drejtat e të dënuarve me burgim shihen në dritën e parimit të rehabilitimit, që nënkupton ri-integrimin në shoqëri të një personi të dënuar, (*shih Murray kundër Holandës [GC], 2016, § 101. (Mastromatteo k. Italisë [GC], 2002, § 72)*). Në të njëjtën kohë, GJEDNJ ka njohur qëllimin e ligjshëm të politikave të ri-integrimit social të personave të dënuar me burgim.

[..] E drejta për rehabilitim, pra fshirja e dënimit të personit nga të dhënat personale të tij është trajtuar në jurisprudencën e GJEDNJ edhe në kuptim të së drejtës për t'u harruar. Në çështjen M.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata Evropiane e ka konsideruar shkelje të nenit 8 të Konventës, pra të drejtës për jetë private dhe familjare, pamundësinë e një individi për të përfutur fshirje të dënimeve të tij të mëparshme nga rekordet e tij policore, me kalimin e një periudhe të caktuar kohe. (*shih M.M. k. Mbretërisë së Bashkuar*)

[..] Sipas GJEDNJ, dënimi mbetet një nga qëllimet e burgimit, por theksi në politikën penale evropiane tani është zhvendosur drejt qëllimit të saj rehabilitues. [...] (*shih Vinter dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (parag. 114–115)*).

GJEDNJ e ka trajtuar rehabilitimin të lidhur me respektimin e dinjitetit njerëzor, i cili përfaqëson, siç ka thënë shpesh GJEDNJ, vetë thelbin e sistemit të Konventës. (*Shih Vinter dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar*). [...] (*Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2019, § 119; Gaughran kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2020, § 94*) [...] Ligji shqiptar parashikon se dënimet penale të personave pasqyrohen në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Në bazë të këtij regjistri del certifikata e gjendjes gjyqësore, që pasqyron nëse personi figuron apo jo i dënuar. Neni 481/1 i KPP . [...] Megjithatë, pasqyrimi i të dhënave në lidhje me dënimet penale të dhëna ndaj subjekteve nuk qëndron në një kohë të pakufizuar, pikërisht sepse ligji penal material parashikon institutin e rehabilitimit të të dënuarit.

E drejta për t'u rehabilituar rregullohet nga ligji penal material, neni 69 i K.Penal që parashikon: [...] Në kuptim të ligjit me përmbushjen e kushteve që parashikon neni 69 i K.Penal, i dënuari ka të drejtë të konsiderohet i rehabilituar, pra të konsiderohet i padënuar. Në përgjigje të pyetjes së katërt të shtruar për njësim; “Si ndikon kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal?”, Kolegji çmon të marrë në analizë cilat janë kushtet që kërkon dispozita penale materiale në mënyrë që subjektit t'i lindë e drejta për t'u rehabilituar.

Së pari, ligji përcakton se në mënyrë që subjekti të quhet i padënuar duhet të jetë

dënuar me një dënim me burgim, i cili mund të jetë një dënim sipas masës që përcakton ligji penal, konkretisht neni 32 i K.Penal, që parashikon: [...] Ndaj të dënuarit mund të jetë caktuar një dënim me burgim, por ligji parashikon mundësinë që edhe dënimi me burgim të pezullohet dhe ndaj të dënuarit të caktohet një dënim alternativ. Mënyra e ekzekutimit të dënimit penal ka rëndësi për efekt të llogaritjes së momentit procedural të shlyerjes së dënimit dhe afatit të rehabilitimit që përcakton neni 69 i K.Penal.

Së dyti, ligji kërkon kalimin e një afati të caktuar kohor. Ky afat përcaktohet dhe kushtëzohet nga masa e dënimit me burgim të dhënë ndaj subjektit, në bazë të parimit se sa më i rëndë dënimi aq më i gjatë është afati që kërkohet të kalojë për efekt të rehabilitimit të të dënuarit. Një parashikim i tillë është logjik konform politikës penale dhe kuptimit që ka instituti i rehabilitimit. Në kushtet kur dënimi caktohet në kuadër të parimit të individualizimit të dënimit, parashikuar nga neni 47 i K.Penal, në caktimin e tij merret në konsideratë rrezikshmëria shoqërore e të pandehurit, e veprës penale, shkalla e fajit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Në këtë kuptim, dënimi i caktuar ndaj të pandehurit reflekton drejtpërdrejtë rrezikshmërinë e tij shoqërore dhe të veprës penale të kryer.

Është e kuptueshme që sa më i rëndë të jetë dënimi i caktuar ndaj të dënuarit, aq më e gjatë duhet të jetë koha që ai të rehabilitohet. Rehabilitimi i tij në kuptim të ri-edukimit psikologjik e social, ri-integrimi në shoqëri, bërjes së tij një person i denjë, i cili të mos shkelë më ligjin pasqyrohet edhe në rehabilitimin ligjor të tij, pra në fshirjen e dënimit penal nga regjistri i gjendjes gjyqësore. Një parashikim i tillë ligjor, i njohur nga çdo legjislacion ligjor, lidhet me të drejtën e çdo personi për t'u rehabilituar, e cila përbën dhe thelbin dhe qëllimin kryesor të dënimit penal në një shtet demokratik. Rehabilitimi moral, psikik, social i të dënuarit do të humbiste qëllimin e tij nëse nuk do të gjente pasqyrim edhe në aktet zyrtare që regjistrojnë këto të dhëna për subjektin, të dhëna që sipas jurisprudencës së GJEDNJ përbëjnë të dhëna personale që gëzojnë mbrojtje nga Konventa.

Në vijim të këtij arsyetimi, ligji kërkon kalimin e një afati kohor të caktuar në mënyrë që subjekti të konsiderohet i padënuar, afat kohor që përcaktohet dhe kushtëzohet nga masa e dënimit me burgim të caktuar me vendim gjykate. Çështje që vlen për t'u nënvijëzuar është fakti që dënimi që do të merret në konsideratë për llogaritjen e afatit të rehabilitimit është masa e dënimit përfundimtar me burgim, pavarësisht llojit të dënimit që mund të ketë caktuar gjykata. Fakti që gjykata mund të disponojë me një dënim alternativ sipas llojeve të alternativave të dënimit me burgim të parashikuar nga neni 58 e vijues i K.Penal nuk kushtëzon afatin e rehabilitimit, i cili përcaktohet referuar dënimit kryesor me burgim, por kushtëzon, ashtu siç do të sqarohet në vijim, momentin procedural kur do të fillojë të llogaritet ky afat.

Dënimi me burgim i caktuar ndaj kërkuesit do të merret në konsideratë për llogaritjen e afatit për efekt rehabilitimi, pavarësisht nëse gjykata ka pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim dhe ka caktuar si mënyrë ekzekutimi dënimi një nga dënimet alternative të parashikuara nga ligji penal. Ky përfundim arrihet po të merret në konsideratë se alternativat e dënimit me burgim janë mënyra ekzekutimi të dënimit me burgim, të cilat caktohen nga gjykata ajo kur vlerëson se plotësohen kushtet specifike që kërkon dispozita konkrete për atë lloj dënimi alternativ.

Njëti përfundim arrihet edhe nëse i dënuari përfiton nga lirimi me kusht sipas nenit 64 të K.Penal. Dënimi me burgim i caktuar ndaj tij do të merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit që kërkon ligji për rehabilitimin e të dënuarit.

Nga ana tjetër, mënyra e vuajtjes së dënimit me burgim, fakti nëse ndaj të dënuarit është caktuar një dënim alternativ do të merret në konsideratë në lidhje me faktin se kur do të fillojë të llogaritet afati i rehabilitimit i parashikuar nga neni 69 i K.Penal. Ky afat do të fillojë, në parim, në momentin që i dënuari përmbush të gjitha detyrimet ndaj shtetit në lidhje me dënimin penal të caktuar ndaj tij. Ky afat fillon nga momenti i shlyerjes përfundimisht të dënimit nga i dënuari. Nëse ndaj të dënuarit është caktuar dënimi alternativ, pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë, parashikuar nga neni 59 i K.Penal, afati i rehabilitimit i kërkuar nga dispozita do të fillojë kur i dënuari ka përmbushur të gjitha detyrimet e caktuara nga gjykata në lidhje me vendosjen në provë, në përfundim të afatit të provës. Përjashtim bën dënimi alternativ i parashikuar nga neni 63 i K.Penal. Në rastin e nenit 63 të K.Penal, gjykata cakton dënim me burgim deri në një vit dhe pezullon ekzekutimin e tij duke e zëvendësuar me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik. Në këtë rast është vet dispozita ligjore që parashikon që dënimi të konsiderohet i paqenë. Në këtë rast, ligjvënësi parashikon qenien i padënuar/i rehabilituar nga i dënuari që në momentin e përfundimit të dënimit prej tij.

Rast tjetër është parashikimi i neneve 406/a dhe 406/b të KPP që parashikojnë miratimin e urdhrin penal nga gjykata. Sipas këtyre dispozitave, në rast se vepra penale e kryer është kundërvajtje penale për të cilën prokurori çmon dhe gjykata miraton që nuk duhet caktuar dënim me burgim por me gjobë, gjykata merr vendim për miratimin e urdhrin penal. Ligji parashikon se në këtë rast, dënimi i dhënë nuk shënohet në vërtetimin e gjendjes gjyqësore, përveç rastit kur i dënuari është përsëritës.

Kolegji vlerëson se rastet e mësipërme janë parashikime të posaçme të ligjit penal, i cili në dënime të konsideruara të dhëna për subjekte me rrezikshmëri të vogël shoqërore, e parashikon shprehimisht rehabilitimin e të dënuarit që në përfundimin e ekzekutimit të dënimit (neni 63 i K.Penal) ose që me dhënien e vendimit penal nga gjykata (neni 406/a dhe 406/b të KPP). Në të gjitha rastet e tjera, për rehabilitimin do t'i referohemi dispozitës së përgjithshme materiale penale, që është neni 69 i K.Penal.

Kolegji vlerëson se, në parim, për të konsideruar të përfunduar ekzekutimin e vendimit penal, gjykata do t'i referohet dispozitave të ligjit nr. 79/2020, [...] që përcakton mënyrën e ekzekutimit të secilit vendim penal dhe momentin kur dënimi konsiderohet i kryer për efekt të ligjit. Ky do të jetë edhe momenti procedural nga i cili do të fillojë të llogaritet afati që parashikon neni 69 i Kodit Penal, për efekt të rehabilitimit.

Në konkluzion, kushti i dytë që kërkon dispozita është caktimi me vendim gjyqësor të formës së prerë i një dënimi me burgim, pavarësisht mënyrës së ekzekutimit të këtij vendimi. Momenti kur do të fillojë të llogaritet afati që kërkon ligji për rehabilitimin është momenti kur i dënuari përfundon të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit, të caktuar me vendimin penal, pavarësisht se cila është mënyra e ekzekutimit të këtij vendimi penal.

Së treti, ligji kërkon që gjatë afatit që kërkon dispozita, në përmbushje të së cilit të dënuarit i lind e drejta të përfitojë nga rehabilitimi, pra të quhet i padënuar, i dënuari

të mos kryejë veprë tjetër penale. Një parashikim i tillë është logjik dhe përputhet me kuptimin që ka rehabilitimi, i cili ka të bëjë me ri-integrimin e të dënuarit në shoqëri; për shkak të vuajtjes së dënimit penal i dënuari është rehabilituar në kuptimin social, moral, psikik, rehabilitim që do të pasqyrohet dhe në të drejtën e tij për rehabilitim ligjor, pra të drejtën për të rezultuar i padënuar në certifikatën e gjendjes gjyqësore.

I dënuari do të konsiderohet se ka kryer veprë tjetër penale në rast se fajësia e tij për kryerjen e veprës penale vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Vetëm në rast se në ngarkim të të dënuarit ka një vendim gjyqësor të formës së prerë që provon qënien e tij fajtor për kryerjen e një veprë penale, atëherë për efekt të nenit 69 të K.Penal, konsiderohet i përmbushur kushti ndalues që i dënuari të përfitojë nga e drejta për t'u konsideruar i rehabilituar. Në rast se vendimi gjyqësor me të cilin i dënuari është dënuar për veprën tjetër penale nuk është i formës së prerë, atëherë nuk konsiderohet i vërtetuar kushti ndalues për efekt të përfitimit nga e drejta e rehabilitimit.

Për të përcaktuar vendimin e formës së prerë, i referohemi nenit 462/3 të KPP që parashikon: [...] Kryerja e një veprë penale brenda afatit në të cilin është duke ecur afati i rehabilitimit, afat që ka filluar të ecë por nuk është ezauruar, pra nuk ka përfunduar, përbën kusht ndalues që subjekti të përfitojë nga rehabilitimi, pra për të qenë i padënuar. Ky është një parashikim që e bën vet dispozita, e cila parashikon se i dënuari gjatë afatit të rehabilitimit nuk duhet të kryejë veprë tjetër penale. Kolegji vë në dukje se kushtet e mësipërme janë kumulative, pra ato duhet të vërtetohen të gjitha së bashku në mënyrë që subjektit t'i lindë e drejta për të përfituar nga instituti i rehabilitimit.

Në këto kushte, pyetjes së ngritur se: “*Si ndikon kryerja e një veprë tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal?*”, Kolegji vendos t'i përgjigjet në këtë mënyrë:

IV. Kryerja e një veprë tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i parashikuar në nenin 69 të K.Penal për t'u konsideruar i rehabilituar përbën kusht ndalues që i dënuari, në përfundim të këtij afati, të përfitojë nga kjo e drejtë. Për efektet e zbatimit të nenit 69 të K.Penal, një veprë tjetër penale do të konsiderohet e kryer kur vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

127. Përgjigja e pyetjes së katërt ka vlerë për të drejtën e rehabilitimit gjatë afatit që parashikon neni 69 i Kodit Penal. I dënuari që kryen një veprë tjetër penale gjatë kohës që është duke u ezauruar afati i rehabilitimit për efekt të veprës së parë penale nuk ka të drejtë të përfitojë nga rehabilitimi në fund të këtij afati. Ky përfundim është logjik pasi moskryerja e një veprë tjetër penale përbën kusht ndalues ligjor për efekt të përfitimit nga ky institut. Megjithatë, Kolegji vë në dukje se kryerja e një veprë tjetër penale nuk përbën shkak që të dënuarit t'i humbasë përfundimisht e drejta për t'u konsideruar i padënuar/ rehabilituar.

Kolegji konstaton se ligji penal shqiptar bën një rregullim të përgjithshëm të rehabilitimit, duke përcaktuar afatet e rehabilitimit sipas masës së dënimit me burgim të caktuar, por pa rregulluar si do të zbatohet instituti i rehabilitimit në rast të kryerjes së një veprë tjetër penale. Ky parashikim ligjor ka lenë vend për interpretime të

ndryshme nga gjykatat, vendimmarrja e të cilave nuk ka qenë uniforme, duke u bërë edhe shkak për këtë vendimmarrje njësuere të Kolegjit Penal.

Kolegji vlerëson se kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që ecën afati i rehabilitimit ndërpret afatin e rehabilitimit që parashikon neni 69 i K.Penal. Me kryerjen e një vepre tjetër penale vërtetohet një kusht ndalues për rehabilitimin, çka do të thotë që afati i rehabilitimit nuk vazhdon më të llogaritet, sepse është vërtetuar kushti që pengon plotësimin e kushteve kumulative për qenien para këtij instituti. Megjithatë, vërtetimi i kushtit ndalues që kërkon dispozita për rehabilitimin, pra kryerja e një vepre penale, nuk mund të interpretohet si shkak për humbjen përfundimisht të së drejtës së të dënuarit për rehabilitim. Një interpretim i tillë do të binte ndesh me qëllimin dhe kuptimin që ka dispozita penale, kuptimin e institutit të rehabilitimit dhe për më tepër me jurisprudencën e GJEDNJ.

Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se, referuar ligjit penal shqiptar, kryerja e një vepre tjetër penale nga kërkuesi përbën shkak që i dënuari të mos konsiderohet i rehabilituar në përfundim të afatit të përcaktuar. Nëse subjekti, gjatë kohës që po ecën ky afat, kryen një vepër tjetër penale, atëherë afati i rehabilitimit për veprën e parë do të ndërpritet, pra nuk do të vazhdojë të ecë, pasi është vërtetuar kushti ndalues që pengon fitimin e të drejtës së rehabilitimit nga i dënuari. Megjithatë, Kolegji vlerëson se qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë që këtij subjekti të dënuar t'i humbasë përfundimisht e drejta e të qenit/konsideruarit si i padënuar në lidhje me dënimin e parë. Në rast se i dënuari dënohet me vendim gjykate të formës së prerë në lidhje me veprën e dytë penale, atëherë në përfundim të vuajtjes së dënimit të dytë, për të do të fillojë të eci afati i rehabilitimit për veprën e parë, afat që u ndërpre nga kryerja e veprës së dytë, si dhe afati i rehabilitimit për veprën e dytë, për të cilën ai gjithashtu ka të drejtën e rehabilitimit.

Në një konkluzion logjik, afati i rehabilitimit për të dyja dënimet do të fillojë të ecë në momentin e përfundimit të dënimit të dytë, duke u konsideruar si afat rehabilitimi afati më i gjatë. Kjo do të thotë që afati më i gjatë i rehabilitimit i përfshin afatet e rehabilitimit për të dyja dënimet e vuajtura, pavarësisht se këto afate ecin dhe llogariten më vete që nga momenti kur i dënuari përfundon së vuajturi dënimin për veprën e dytë penale.

Një përfundim i tillë përforcohet po të bëhet interpretimi logjik i institutit të rehabilitimit të të dënuarit por edhe vet përmbajtjes së dispozitës penale. Kryerja e një vepre tjetër penale ndërpret afatin e parashkrimit për të dënuarin për veprën e parë, pikërisht sepse përbën kusht ndalues të përcaktuar nga dispozita. Megjithatë, me përfundimin e ekzekutimit të vendimit të dytë penal, të dënuarit i lind e drejta të rehabilitohet si për dënimin e parë, afati për të cilin u ndërpre nga kryerja e veprës së dytë, ashtu edhe për veprën e dytë penale, për të cilën sapo ka përfunduar ekzekutimin e dënimit.

Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji e vlerëson të pabazuar qëndrimin e mbajtur nga disa gjykata që kryerja e një vepre tjetër penale i'a mohon përfundimisht të drejtën për t'u rehabilituar të dënuarit. Ky qëndrim jo vetëm që nuk mbështetet në qëllimin e ligjvënësit, por bie ndesh edhe me praktikën e sipërcituar të GJEDNJ. Kryerja e një vepre tjetër penale kushtëzon rehabilitimin e të dënuarit, pasi provon se dënimi nuk e ka realizuar funksionin e tij rehabilitues, e për rrjedhojë të dënuarit nuk i takon e

drejta për t'u konsideruar i padënuar në fund të afatit ligjor. Megjithatë, ai nuk e humbet përfundimisht këtë të drejtë, por mund të thuhet se kjo e drejtë i pezullohet në kohë, për aq kohë sa ai të plotësojë edhe një herë afatin e rehabilitimit, që do të fillojë të llogaritet nga e para. Në përfundim të vuajtjes së dënimit për veprën e dytë të kryer, të dënuarit i lind e drejta që t'i fillojë të ecë afati i rehabilitimit për të dyja veprat e kryera.

Në këto kushte, Kolegji konkludon se kryerja e një vepre tjetër penale e penalizon të dënuarin, pasi i heq të drejtën për t'u rehabilituar në fund të afatit që parashikon ligji. Megjithatë, këtë të drejtë ai nuk e humbet përfundimisht, pasi afati i rehabilitimit do të nisë edhe një herë nga e para kur i dënuari të ketë përfunduar vuajtjen e dënimit të caktuar ndaj tij për veprën e dytë.

Nga mënyra e interpretimit gramatikor të nenit 69 të K.Penal, që kryejnë disa gjykata në vendimmarrjen e tyre, mund të deduktohet se nëse personat e dënuar kryejnë vepër tjetër penale gjatë afatit të rehabilitimit, ata nuk do mund të rehabilitohen asnjëherë, duke mos i'u fshirë asnjëherë dënimet nga certifikata e gjendjes gjyqësore. Por kjo mënyrë e interpretimit ligjor të dispozitës do të mohonte të drejtën e dinjitetit të personave të dënuar, si edhe nuk do garantonte parimin e humanizmit, të cilat janë parime themelore kushtetuese të çdo shoqërie demokratike. Kështu, me qëllim që të garantohet e drejta e dinjitetit të personave të dënuar është e nevojshme që dispozitat ligjore të interpretohen me mënyrat e tjera shkencore, të cilat gjejnë zbatim sa herë që ligji mungon, është i paplotë ose i paqartë. Në këtë rast, nëpërmjet interpretimit logjik dhe sistematik të dispozitave ligjore në tërësi, arrihet në konkluzionin që edhe personat që dënohen sërish gjatë afatit të rehabilitimit, kanë të drejtë të rehabilitohen, duke u konsideruar të padënuar. Por për këta persona, për sa kohë që ligji nuk shprehet në mënyrë eksplicite, afati për rehabilitimin do të ndërpritet në momentin kur dënohen sërish për kryerjen e veprave penale dhe do të rifillojë nga e para nga momenti i vuajtjes së dënimit të fundit. Ky qëndrim pasqyron parimet themelore kushtetuese të dinjitetit njerëzor dhe humanizmit në caktimin dhe vuajtjen e dënimeve penale. Për sa i përket momentit të fillimit të afatit të rehabilitimit, Kolegji konkludon se afati duhet të fillojë nga dita e vuajtjes së dënimit, përcaktim që e bën vet dispozita dhe jo nga dita kur vendimi i dënimit merr formë të prerë, siç llogaritet në disa raste në praktikë.

Një interpretim i tillë është konform qëllimit, funksionit që ka instituti i rehabilitimit nga njëra anë, por nga ana tjetër mbështet edhe mundësinë e të dënuarit për t'u rehabilituar, për t'u ri-integruar në shoqëri dhe që të përfitojë të gjitha të drejtat që kishte para kryerjes së veprave penale, përfshirë të drejtën për të qenë i padënuar.

[..] Referuar interpretimit të mësipërm, duke marrë në konsideratë parimet e përgjithshme, natyrën e institutit të rehabilitimit, praktikën e GJEDNJ në lidhje me këtë të drejtë, si dhe rregullimin që bëjnë legjislacionet e vendeve fqinje, Kolegji vlerëson se përgjigjia e pyetjes së pestë të shtruar për njësim është:

V. Kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i parashikuar në nenin 69 të K.Penal për tu konsideruar i rehabilituar nuk përbën shkak që subjektit t'i mohohet përfundimisht e drejta për të

përfitur nga instituti i rehabilitimit. Kryerja e një vepre tjetër penale sjell si pasojë që afati i parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal të rifillojë të llogaritet nga përfundimi i vuajtjes së dënimit të fundit.

Në rast se i dënuari, gjatë periudhës për plotësimin e afatit për tu rehabilituar, dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër tjetër penale, me përfundimin e vuajtjes së dënimit për veprën tjetër, do të fillojnë të ecin njëkohësisht afatet që parashikohen në nenin 69 të K.Penal për tu rehabilituar edhe për vepra të tjera penale, duke u konsideruar si afat rehabilitimi afati më i gjatë.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, e cila u bë shkak për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji vlerëson se kërkuesi K.D. përmbush kriteret për rehabilitim, sipas nenit 69, shkronja "a" të K.Penal. [...] Kolegji vlerëson se, me përfundimin e vuajtjes së dënimit të dytë, kërkuesit i lind e drejta e rehabilitimit për të dyja vendimet penale. Në rastin konkret, për secilin dënim kërkuesi ka të drejtë rehabilitimi pas një afati 2 vjeçar, afat që fillon të llogaritet nga vuajtja e dënimit të dytë. [...] Në këto kushte, Kolegji vlerëson se, duke qenë se çështja lidhet vetëm me interpretimin e ligjit material penal dhe nuk konsiston në rivlerësim faktesh dhe provash, janë kushtet për ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pranimin e kërkesës së kërkuesit.

Sa më sipër, në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji vendos ndryshimin e vendimit nr. [...], të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vendimit [...], të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe pranimin e kërkesës së kërkuesit K.D. për t'u konsideruar i rehabilituar ndaj vendimeve penale nr. [...], të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe [...], të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vendim Njësues Nr.00-2023-470(4), datë 12.01.2023 (Gjykimi i çështjeve në fazën e ekzekutimit të vendimit)

Në rast mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor kompetenca tokësore i përket gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën.

Fjalë kyçe: fazë e ekzekutimit të vendimit penal, kompetencë tokësore

Rrethanat e çështjes:

Kërkuesi R.Ç. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesën me objekt "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ". Në mbështetje të bazës ligjore përkatëse, kërkuesi ka parashtruar edhe shkaqet relevante në mbështetje të kërkimeve të tij. Në seancën gjyqësore datë 10.11.2021, bazuar në informacionin e sjellë nga IIEVP Fushë Krujë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë është vënë në dijeni se kërkuesi nuk ndodhej më në ambientet e IIEVP Fushë Krujë. Referuar urdhrit të transferimit nr. 10144/2, datë 29.09.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rezultonte që i dënuari është transferuar për të vuajtur dënimin në IIEVP Rrogozhinë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë [...] ka vendosur të deklarojë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për gjykimin e kërkesës [...] dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si gjykata kompetente, nga pikëpamja lëndore dhe tokësore.” [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, [...] ka vendosur të **parashtrojë përpara Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës tokësore midis Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për gjykimin e kërkesës penale** [...] Të kërkojë nga Gjykata e Lartë prishjen e vendimit nr. 111, datë 10.11.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit. [...]

Gjykata vëren se parimi i “gjyqtarit natyral të çështjes” është trajtuar gjerësisht edhe në jurisprudencën njësuere të Gjykatës së Lartë. Kështu, në vendimin njësuere Nr. 00 2022-1036 (114), datë 07.04.2022 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke referuar edhe në vendimet e tjera njësuere të njëjtit Kolegj, është shprehur se: [...] Kolegji vlerësoi se ndërmjet trupave gjyqësor të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet, në kohën e shqyrtimit të çështjes.

Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë [...] ka vendosur [...] *njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen: Cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet, në kohën e shqyrtimit të çështjes?*” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji vlerëson se parashtrimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë lidhur me mosmarrëveshjen për kompetencën e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur për gjykim është i drejtë. Për këtë arsye, aktet duhet t'i dërgohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me qëllim vazhdimin e gjykimit të çështjes, referuar argumentimit që do të trajtohet në vijim.¹⁰

[...] Fillimisht, Kolegji çmon të nevojshme të sqarojë përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe në vijim Kolegji do të trajtojë dhe argumentojë çështjen e shtruar për njësim.

Së pari, Kolegji vlerëson që kjo vendimmarrje duhet të shërbejë si vendimmarrje njësuere, pasi konstatohet se ndërmjet trupave gjyqësor të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit

¹⁰ Ky paragraf është saktësuar/korigjuar me vendimin nr.470/1(4), datë 29.03.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

të çështjes. Konkretisht, me vendimin nr. 80002-00690-2022 Regj. Themeltar, datë 08.11.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: [...] Në këtë vendim është mbajtur qëndrimi se gjykata ku paraqitet për herë të parë kërkesa është gjykata e vendit të ekzekutimit, në kuptim të kompetencës tokësore për shqyrtimin e saj.

Gjithashtu, me vendimin nr. 00-2022-1286, datë 20.10.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur [...] I njëjti qëndrim është mbajtur në vendimin nr. 70007-961-2021 Regj. Themeltar datë 03.02.2022 të Kolegjit Penal. Në këto vendime, Kolegji Penal ka mbajtur qëndrimin se gjykata e vendit ku ndodhet kërkuesi në momentin e shqyrtimit të kërkesës përbën gjykatën e vendit të ekzekutimit që ka kompetencë tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Nga ana tjetër, konstatohet se në Gjykatën e Lartë janë paraqitur një sërë çështjesh mosmarrëveshje kompetence ndërmjet gjykatave të rretheve gjyqësore në lidhje me objektin e mësipërm. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes.

Për këto arsye, Kolegji vlerëson se jemi në kushtet që Kolegji të shprehet me një vendimmarrje njëseuese, konform nenit 438/1 të KPP [...]

Së dyti, Kolegji ndalet në trajtimin e çështjes së shtruar për njësim të praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë:

- ***Cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes?***

Fillimisht, Kolegji rikonfirmon qëndrimin se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegji thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. [...] (*shih vendimin njëseues të Kolegjit Penal nr. 23 datë 27.07.2021*).

Kompetenca lëndore është një parakusht procedural i cili përcakton konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. “Gjykata e krijuar me ligj” është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1 i KEDNJ. GJEDNJ, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka trajtuar kuptimin e “gjykatës së krijuar me ligj” duke trajtuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. [...]

Duke iu rikthyer çështjes konkrete, për zgjidhjen e drejtë të çështjes Kolegji vlerëson se është e nevojshme të përcaktohet natyra procedurale e kërkesës objekt gjykimi, me të cilin është investuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë si dhe faza procedurale në të cilën ajo është paraqitur. Objekti i kësaj kërkesë është “Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ”. Kërkesa e kërkuarit R.Ç., fillimisht, është paraqitur në kohën që ai ishte duke vuajtur dënimin me burgim pranë IEPV Fushë Krujë. Në vijim, sipas urdhrin

të transferimit përkatës, kërkuesi është transferuar për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit pranë IEVP Rrogozhinë.

Në kushtet kur kemi të bëjmë me një kërkesë të paraqitur nga personi që vuan dënimin me burgim në një institucion ekzekutimi vendimi penal, atëherë jemi në një çështje që i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Kolegji konstaton se fakti që çështja i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor është një çështje e pranuar nga të dyja gjykatat dhe nuk lë vend për diskutim. Diskutimi që lind në këtë çështje midis dy gjykatave në mosmarrëveshje kompetence, por edhe për të cilën trupat e Kolegjit Penal nuk ndajnë të njëjtin qëndrim, është fakti se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor (përfshirë çështjen objekt gjykimi), kur gjykata në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykata në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes nuk janë e njëjta. Për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, referimi bëhet tek dispozita procedurale penale specifike që rregullon kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit.

Neni 470 i KPP parashikon [...] Ndër kërkesat që shqyrton gjykata e vendit të ekzekutimit është edhe kërkesa objekt gjykimi, ajo për aplikim dënimi alternativ në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në rastin konkret, të dyja gjykatat e përfshira në mosmarrëveshje kompetence bien dakord që gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për gjykimin e çështjes (çështje që në fakt rregullohet shprehimisht nga ligji), por ato ndahen në faktin se cila gjykatë ka konkretisht kompetencën tokësore.

Kolegji vlerëson se për përcaktimin e gjykatës kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e dënimit, referimi duhet të bëhet tek momenti i paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Momenti i paraqitjes së kërkesës në gjykatë përcakton edhe kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit në shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit, kompetencë që nuk mund të ndryshojë sa herë ndryshon vendi i vuajtjes së dënimit me burgim të kërkuesit, sipas IEVP-së përkatëse.

Në arritjen e përfundimit të mësipërm Kolegji çmon t'i referohet parimit bazë të së drejtës procedurale të *"perpetuatio jurisdictionis"*, sipas të cilit kompetenca e gjykatës përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe ndryshime të situatës faktike, që mund të ndodhin pas këtij momenti, nuk pasjellin ndryshimin e gjykatës kompetente¹¹. Ky parim garanton dhe minimumin e nevojshëm të sigurisë dhe stabilitetit për personin e dënuar, në mënyrë që kërkesa e tij të shqyrtohet nga Gjykata e ekzekutimit, (gjyqtari natyral), e konstituuar si e tillë në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe të mos ndryshojë (kushtëzohet) në varësi të kërkesave dhe/ose emergjencave të organit administrativ të ekzekutimit të vendimeve penale.

Në terma të tjerë, kompetenca, për gjykimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi R.Ç. para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë [...], me objekt "aplikim i dënimit alternativ", në cilësinë e gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit, në kushtet e vuajtjes së dënimit, prej kërkuesit pranë IEVP Fushë-Krujë në konformitet me përcaktimet e paragrafit të

¹¹ Gjykata e Kasacionit Itali, Seksioni I, vendimi nr. 1137, datë 13 janar 2010; Gjykata e Kasacionit Itali, Seksioni I, vendimi nr. 53177, datë 22 dhjetor 2014.

parë të nenit 470 të KPP, e rrënjëzuar pranë kësaj gjykate, për këtë shkak, konsiderohet e imunizuar prej ecurisë së mëtejshme dinamike të *iter*-it administrativ të sistemimit *post factum* alternativ të kërkuesit, në cilësinë e subjektit që “pëson” ekzekutimin e vendimit, dinamikë, e cila, presupozon të drejtën dhe kompetencën e organit administrativ, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të vlerësuar, pavarësisht dhe përtej qasjes së organit juridiksional, gjykatës së vendit të ekzekutimit, kërkesat dhe emergjencat e rezultuara në këtë kuadër, në funksion të zgjidhjes dhe eliminimit të pasojave të shkaktuara. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se kompetenca tokësore e gjykatës së vendit të ekzekutimit bëhet mbi bazën e një raporti (marrëdhënie) të karakterizuar prej stabilitetit, midis të dënuarit dhe institucionit në të cilin ndodhet, duke përjashtuar që të marrë përparësi thjesht prania fizike e kërkuesit në çfarëdolloj institucioni, e përcaktuar për arsye të rastësishme dhe momentale (si p.sh.: ato të lidhura me situata tranziti gjatë transferimit nga një institut në tjetrin, etj, dhe që nuk sigurojnë minimumin e stabilitetit të nevojshëm për krijimin e një raporti midis autoriteteve dhe të dënuarit, të përshtatshëm për shqyrtimin e personalitetit të tij në këtë fazë.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se kompetenca tokësore e gjykatës së vendit të ekzekutimit do të përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës së kërkuesit që pretendon një të drejtë të caktuar në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Fakti që vendndodhja e kërkuesit mund të ndryshojë pas momentit të paraqitjes së kërkesës, duke u vendosur ai në një institucion tjetër të ekzekutimit të vendimit penal, nuk përcakton dhe as kushtëzon kompetencën tokësore të gjykatës së parë e cila kishte në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi. Gjykata e vendit të ekzekutimit ku ishte paraqitur për herë të parë kërkesa ka të drejtën dhe detyrimin të vazhdojë me shqyrtimin e saj në themel dhe nuk është në përputhje me dispozitat procedurale penale shpallja e moskompetencës tokësore prej saj.

Kolegji thekson se duke qenë se në momentin e regjistrimit të kërkesës objekt gjykimi, kërkuesi ka qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Fushë Krujë, kalimi i tij në vijim për vuajtjen e dënimit pranë IEVP Rrogozhinë nuk ndikon edhe në përcaktimin e gjykatës që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjes. Duhet vënë në dukje se kërkesa e të dënuarit është një kërkesë e fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Në lidhje me shqyrtimin e kërkesave/çështjeve të fazës së ekzekutimit, gjejnë zbatim përveç KPP edhe ligji nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” ose/dhe ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Këto ligje, ashtu si dhe KPP (neni 470 i këtij Kodi), përcaktojnë gjykatën kompetente, që është gjykata e vendit ku kryhet ekzekutimi i vendimit penal, përfshi këtu edhe rastet kur vendi i ekzekutimit ndryshon për shkaqe të përcaktuara shprehimisht në ligj, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret (transferimi i të dënuarit urdhërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në rastet dhe në kushtet e parashikuara në nenin 78 të ligjit nr. 81/2020). Në nenin 80 të ligjit nr. 81/2020 parashikohet shprehimisht se[...] Nga ana tjetër, edhe ligji nr. 79/2020 thekson se kontrolli procedural për ekzekutimin e vendimeve, bëhet nga gjykata që ka dhënë vendimin ose nga gjykata e vendit të ekzekutimit, kur ekzekutimi i vendimit bëhet në një rreth të ndryshëm nga ai i gjykatës

që ka dhënë vendimin.

Në rastin konkret, vendndodhja e IEVP-së ku vuan dënimin kërkuesi në kohën e paraqitjes së kërkesës përcakton edhe kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit. Kjo gjykatë që ka kompetencën tokësore nuk do të ndryshojë, pavarësisht ndryshimit që mund të pësojë IEVP ku kërkuesi vuan dënimin dhe pavarësisht shkaqeve që kanë sjellë ndryshimin e institucionit të ekzekutimit. Prandaj, kompetenca tokësore për shqyrtimin e kërkesës objekt gjykimi i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, si gjykata që ka nën juridiksion IEVP Fushë-Krujë.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në lidhje me pyetjen e shtruar për njësim të mbahet ky qëndrim njëses:

Në rast mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor kompetenca tokësore i përket gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën.

Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vendos zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për gjykimin e kërkesës së kërkuesit me objekt “Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ”, duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

KPGJL Vendim Nr.00-2023-1020, datë 20.6.2023 (Shuarje masë sigurimi)

Në rast paraqitje të kërkesës për shuarje të masës së sigurimit personal nga çdo subjekt i legjitimuar, gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës është gjykata në të cilën ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit.

Fjalë kyçe: shuarje masë sigurimi, gjykata kompetente, gjykata ku ndodhen aktet

Rrethanat e çështjes:

Në datën 26.11.2022, rreth orës 16:50, në aksin rrugor Krahës - Tepelenë, [...], shtetasia A.H., i cili drejtonte automjetin e markës [...], ka goditur shtetasen E.K.. Ndërkohë, ka rezultuar se drejtuesi i automjetit ishte i pa pajisur me leje drejtimi. Shtetasja E.K. është dërguar në spitalin e Gjirokastrës për të marrë ndihmën mjekësore të nevojshme. Në këto kushte është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit A.H. Prokuroria i është drejtuar gjykatës me kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, ndaj A.H., si i dyshuar për veprat penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga nenet 290/2 dhe 291 të K.Penal.

Me anë të vendimit [...] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër (gjyqtari i hetimeve paraprake) ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë [...]; Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë ndaj dyshuarit A.H.; Caktimin e masës së sigurimit personal

“Arrest në shtëpi” ndaj të dyshuarit [..]

Pasi ka kryer veprimet hetimore që i ka konsideruar të nevojshme, organi i akuzës, në përfundim të hetimeve, i është drejtuar gjykatës me kërkesën me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe pushimin e çështjes për sa i përket veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”. Me anë të vendimit [..] gjykata (gjyqtari seancës paraprake) ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.H.. Për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. 2. Mospranimin e kërkesës për pushimin e pjesshëm të çështjes penale dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve. [..]

Referuar kërkesës së prokurores dhe vërtetimit nr. 30/5, datë 30.05.2023, të gjykatës, rezulton se ndaj vendimit të mësipërm është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe se çështja, aktualisht, ndodhet pranë kësaj gjykate. Ndërkohë, për sa i përket akuzës për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të rregullt”, me anë të vendimit nr. [..], Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit [..]për kryerjen e veprës penale [..]parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe dënimin e tij me 9 (nëntë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim, për kohën e pa vuajtur duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjatë, kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij [..]

Pasi ka marrë në konsideratë sa më sipër, prokurorja e çështjes i është drejtuar në datën 30.05.2023, gjyqtarës që ka shqyrtuar çështjen në themel [..] me kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, të caktuar ndaj të pandehurit.

Me anë të vendimit. [..] Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, që ka shqyrtuar çështjen në themel, lidhur me akuzën për veprën penale [..]ka vendosur deklarimin e moskompetencës funksionale, për shqyrtimin e çështjes me objekt shuarje e masës së sigurimit personal, [..]2. Kalimin e akteve gjyqtarit të hetimit të çështjes në themel. [..] Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me vendimin nr. [..] ka vendosur parashtrimin në Gjykatën e Lartë, të mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore, lidhur me çështjen penale [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji [..] konstaton se, në rastin konkret, pretendohet ekzistenca e konfliktit për kompetencë lëndore/ funksionale, pasi dy gjykata të ndryshme, të të njëjtës shkallë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, gjyqtari i themelit dhe gjyqtari i seancës së hetimeve paraprake, nuk pranojnë të gjykojnë kërkesën penale të Prokurorisë [..] me objekt “Shuarja e masës së sigurimit personal arrest në shtëpi, dhënë me vendimin nr. 396/21-2022-1443 për të dënuarin A.H., parashikuar nga nenet 228, 229, 244 dhe 261, pika “b” të KPP.

KPP, në Kreun II, seksionin V, i titulluar “Mosmarrëveshjet për kompetencat”,

nenet 89, 90 dhe 91 të tij, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve (midis gjykatave), mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen. [..]

Kolegji konstaton se, në rastin konkret, objekt shqyrtimi është shuarja e masës së sigurimit e caktuar për shtetasin A.H., në lidhje me dy vepra penale, konkretisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 291 dhe 290 të K.Penal, ku për veprën penale të parashikuar nga neni 291 të KPenal, i pandehuri është dënues, dënim i cili është pezulluar, ndërsa në lidhje me veprën tjetër të parashikuar nga neni 290/1 i KPenal, prokuroria ka kërkuar pushimin e pjeshëm të procedimit penal, kërkesë e cila nuk është pranuar nga gjyqtari i seancës paraprake dhe vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Me kërkesën e paraqitur objekt gjykimi, prokuroria ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit para gjyqtarit të themelit, duke qënë se dënimi për të pandehurin është pezulluar. Ndërkohë, konstatohet se masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, për të pandehurin është dhënë dhe për veprën tjetër për të cilën, megjithëse është kërkuar pushimi nga prokuroria, ajo nuk është pranuar nga Gjyqtari i Seancës Paraprake. Në arsyetimin e tij, Gjyqtari i Seancës Paraprake ka arsyetuar se, duke qënë se i pandehuri nuk ka patur patentë, ai nuk mund të jetë subjekt i posaçëm i veprës penale të parashikuar nga neni 290 i KPenal, njëkohësisht dëmtimet e viktimës janë kualifikuar për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i KPenal, veprë kjo e cila, referuar nenit 284 të KPP, fillon vetëm me ankimin e viktimës.

Kolegji vlerëson se, pavarësisht problematikave procedurale të konstatuara në rastin konkret për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës nga gjyqtari i hetimit, i cili nuk e ka gjetur veten kompetent për të marrë në shqyrtim kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit, i obliguar nga vendimarrja e gjyqtarit të themelit, ku ky i fundit kërkesën për shuarje mase sigurimi duhet ta dërgonte pranë gjyqtarit të cilit ndodheshin aktet, konkretisht Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pasi çështja ishte ankimuar, vlerësohet se referimi i gjykatës kompetente është i bazuar në ligj. Në rastin konkret nuk jemi përpara konfliktit klasik të mosmarrëveshjes së kompetencës pasi me të drejtë gjyqtari i hetimit ka arsyetuar se kompetent për gjykimin e çështjes objekt gjykimi është gjyqtari pranë të cilit ndodhen aktet e ankimuar nga Prokuroria në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Kolegji i referohet parashikimeve ligjore referuar kërkesës për shuarjen e masave të sigurimit, konkretisht nenit 261/3 të KPP, [..] Në nenin 278 të KPP, parashikohet se [..] Në nenin 329/a të KPP, parashikohet [..] Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se gjykimi i kësaj çështje duhet të merret për shqyrtim nga gjyqtari i cili ka për shqyrtim çështjen e ankimuar për mospranimin e kërkesës për pushimin e pjeshëm të procedimit penal, dhënë me vendimin [..] të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (gjyqtari i seancës paraprake). Kjo, për arsyet si vijojnë: *së pari*, ligjvënësi është shumë i qartë kur në nenin 261, të KPP, ka përcaktuar si gjykatën që shqyrton kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit, gjykatën ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së saj; *së dyti*, ky përcaktim është në sintoni të plotë me natyrën e këtyre kërkesave, të cilat duhet të shqyrtohen me shpejtësi, për shkak të objektit të rëndësishëm që mbrohet në

këtë rast, lirisë së shtetasve, e cila është një nga të liritë themelore të individit, që gjen mbrojtje në ligj, në Kushtetutë dhe në konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Për rrjedhojë, në rast paraqitje të kërkesës për shuarje të masës së sigurimit personal nga çdo subjekt i legjitimuar, gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës është gjykata në të cilën ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit. Bazuar në këtë arsytim, Kolegji vlerëson se në rastin konkret objekt shqyrtimi, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në të cilën ndodhen aktet [...] duhet të shqyrtojë kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit personal të të pandehurit[...]

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2023-266, datë 16.02.2023

II. Gjyqtari i seancës paraprake

KPGJL Vendim Njësues Nr. 00-2021-1134(62), datë 01.01.2021 (Afatet e paraburgimit)

1. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të hetimit paraprak kur, gjyqtari i seancës paraprake disponon “Për plotësimin e hetimeve”, sipas nenit 332/c dhe/ose “Për kthimin e akteve prokurorit për korrigjimin ose saktësimin e akuzës”, sipas nenit 332/d, pika 3 e KPP.

2. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjyqimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për:

a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq;

b) vijimin e gjyqimit nga e njëjta gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe caktimit të dënimit;

c) vijimin e gjyqimit nga e njëjta gjykatë, kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar;

ë) për pushimin e akuzës ose të çështjes, apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligji, sipas nenit 332/dh shkronjat «ç» e «d» të KPP.

Fjalë kyçe: dërgim çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake, afat paraburgimi, pezullim afat paraburgim

Rrethanat e çështjes:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (467) 25, datë 18.05.2020, ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP, midis të tjerëve edhe për shtetasin D.V., me cilësinë e personit të dyshuar (hetuar) për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i K.Penal.

[..]. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj gjykate, me vendimin nr. (471) 242, datë 21.05.2020, ndër të tjera, ka verifikuar pozitivisht, në përputhje me përcaktimet e nenit 248/2 të KPP, kushtet dhe kriteret e caktimit dhe të zbatimit të masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, ndaj të hetuarit, (si dhe nevojat e sigurimit, sipas përcaktimit të neneve 228, 229, 230 të KPP).

Më datë 30.07.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur kërkesë për dërgimin për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 420, të vitit 2018, ku, ndër të tjerë, është marrë i pandehur edhe kërkuesi D.V. [...] Me vendimin nr. (1107) 355, datë 06.11.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtari i seancës paraprake pranë asaj gjykate, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 420, viti 2018, me të pandehur, ndër të tjerë, edhe kërkuesin.

Më datë 10.06.2021, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për shuarje të masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, caktuar ndaj tij me vendimin nr. (467) 25, datë 18.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga kolegji gjykues në disponim të të cilit rezultoi, ndërkohë, gjykimi në themel i akuzës së kontestuar nga prokurori, të pandehurit, si gjykata kompetente, që disponon aktet në zbatim të nenit 261/3 të KPP. Kërkuesi pretendon se është në kushtet e verifikimit të tejkallimit të afateve të paraburgimit të vuajtura prej tij, për efekt të aplikimit të asaj mase, të përcaktuara në nëntë muaj - pa u dhënë vendimi i dënimit - sipas përmbajtjes së nenit 263/2/- të KPP, pasi sanksioni i parashikuar në dispozitën që i atribuohet këtij të fundit, sipas akuzës neni 283/2 të KP, parashikon një dënim, në maksimum deri në 10 vjet.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit D.V. [...]

Gjykata Apelit Shkodër, [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit** [...][...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji Penal [...] vlerësoi se rekursi objekt shqyrtimi plotëson kërkesat e ligjit për tu pranuar, konkretisht të kushtit të karakterit substancial, të përcaktuar në germen “a”, të paragrafit të parë të nenit 432 të KPP, të identifikuar në “mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural”, prej gjykatave të të dy shkallëve (të Rrethit Gjyqësor Kukës dhe të Apelit Shkodër), lidhur me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi/i pandehuri, gjatë gjykimit në themel të çështjes penale në ngarkim të tij, me objekt deklarinimin e humbjes së fuqisë (shuarjes) së masës së sigurimit personal të “arrestit në burg” caktuar ndaj tij. Gjykatat e faktit, në shqyrtimin e kësaj kërkesë, kanë disponuar për rrëzimin e saj, duke vlerësuar qëndrimin e mbrojtësit se afatet e paraburgimit janë konsumuar, pasi kanë kaluar nëntë muaj pa u shprehur gjykata me vendim përfundimtar, si të pabazuar në ligj. Në interpretimin e ligjit procedural penal, gjykatat e faktit kanë arritur në konkluzionin se afati i paraburgimit i “konsumuar”/që ka kaluar gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake deri në momentin që ky i fundit ka disponuar “për dërgimin e çështjes në gjyq”, duhet përfshirë si afat i fazës së hetimit paraprak. Sipas gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, afati i parashikuar në nenin 263/2 të KPP

për fazën e gjykimit, fillon nga momenti i depozitimit dhe i regjistrimit të fashikullit të gjykimit tek gjyqtari i gjykimit të çështjes në themel, duke vlerësuar këtë moment si “dorëzimi i akteve në gjykatë”.

Në verifikim të praktikës gjyqësore në drejtimin e sipërcituar, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin e rëndësishëm të ndryshimeve që ka pësuar KPP [...] ku është parashikuar seanca paraprake si një fazë e procedimit penal, por, nga ana tjetër, edhe faktin që ky ndryshim nuk është shoqëruar edhe me ndryshimin e nenit 263 të KPP, Kolegji çmoi se ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 438 të KPP për iniciimin e procedurës së gjykimit për njësimin e praktikës gjyqësore. Seanca paraprake është parashikuar si një fazë e rëndësishme dhe e pashmangshme e procedimit penal, që synon të garantojë të drejtat e mbrojtjes, duke verifikuar dhe kontrolluar plotësinë e hetimeve të kryera, veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit gjatë fazës së hetimit paraprak.

Kolegji konstaton se, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar seancën paraprake në procesin penal, nuk e ka shoqëruar këtë ndryshim të rëndësishëm edhe me ndryshimin e nenit 263 që parashikon afatet e paraburgimit për çdo fazë të procedimit. Ndërkohë, në funksion të ushtrimit të kontrollit të hetimeve paraprake, gjyqtari i seancës paraprake mund të disponojë edhe për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP dhe/ose për korrigjimin ose saktësimin e akuzës, sipas nenit 332/d të KPP, fakt ky që ndikon edhe në afatin e paraburgimit, për të pandehurin ndaj të cilit është caktuar masa e arrestit.

Përballur me problematikën e sipërcituar, Kolegji konstaton se nga gjykatat e faktit ka pasur qëndrime të ndryshme, në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit dhe ndikimin e kësaj faze të re të procedimit (seanca paraprake) në afatet e posaçme (të secilës fazë përkatëse) dhe/ose në ato të përgjithshme (tërësore) të paraburgimit, të parashikuara në nenin 263 të KPP. Në rastin konkret, gjykatat e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe e Apelit Shkodër, kanë përcaktuar se seanca paraprake, parashikuar në nenet 332 - 332/gj të KPP, është pjesë e fazës së hetimeve paraprake, për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit (të kohëzgjatjes së tyre). Ndërkohë, në raste të tjera të ngjashme, gjykatat kanë mbajtur qëndrimin se seanca paraprake dhe afati i zgjatjes së saj është pjesë e fazës së gjykimit, për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit (për më tepër, shih vendimet nr. 77, datë 30.07.2018 dhe nr. 219, datë 27.11.2019 të (ish) Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda). Në ndryshim nga ligji procedural penal shqiptar, KPP italiane që është marrë si model referimi nga ligjvënësi shqiptar, parashikon afate të qarta paraburgimi për secilën fazë, përfshi këtu edhe seancën paraprake. Kolegji vlerëson me rëndësi të theksojë faktin se edhe pas ndryshimeve të fundit të KPP, me ligjin nr. 41/2021, ku faza e seancës paraprake ka pësuar ndryshime thelbësore, ligjvënësi nuk ka reflektuar në përmbajtjen e nenit 263 të KPP.

Në terma të tjera, kjo problematikë se “Cilës fazë procedurale i përket (i atashohet) afati i (kohëzgjatjes) paraburgimit të konsumuar, prej të pandehurit, gjatë fazës së procedimit të gjykimit (trajtitimit) të çështjes prej gjyqtarit të seancës paraprake”, objekt i këtij gjykimi njësues, do të gjejë zgjidhje në varësi të interpretimit nëse kjo fazë e re e procedimit penal do të cilësohet si një fazë ndërmjetëse midis fazës së hetimeve paraprake dhe fazës së gjykimit të çështjes (në shkallë të parë dhe të dytë) apo do të renditet/përfshihet - *tout*

court/thjesht - në përbërje të njëres apo tjetres fazë (hetim apo gjykim). Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson me rëndësi të evidentojë qëllimin e përfshirjes së kësaj faze procedurale në procesin penal, rolin dhe kompetencat që ka gjyqtari i seancës paraprake.

Kolegji sjell edhe një herë në vëmendje se, me ligjin nr. 35/2017, [...] është parashikuar faza e seancës paraprake, si një fazë “filtri dhe kontrolli” mbi veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të verifikojë provat e mbledhura në ngarkim të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit. Me fjalë të tjera, detyra kryesore e gjyqtarit të seancës paraprake është të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë dhe vlefshmërisë së akteve, por nuk ka si qëllim të arrijë në konkluzione mbi fajësinë e të pandehurit. Kontrolli i ushtruar nga gjyqtari i seancës paraprake mbi hetimet e kryera, përfshi këtu edhe saktësimin apo korrigjimin e akuzës, nuk do të thotë se ai merr funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale.

Përfshirja e seancës paraprake si një nga fazat e procedimit penal, paraqet rëndësi në funksion të forcimit të institutit të mbrojtjes, nëpërmjet kontrollit (filtrimit) të akuzave të nxituara dhe të pambështetura, të paraqitura prej prokurorit, fryt i një veprimtarie hetimore të pakompletuar/të paplotë, përfshirë sidomos rastet kur prokurori anashkalon apo nuk tregon vëmendjen e duhur në lidhje me integrimin e kontributit të mbrojtjes në funksion të kësaj kompletueshmërie. Ligjvënësi, gjithsesi ndryshe nga fazat e tjera klasike të procedimit penal, të hetimeve paraprake dhe të gjyqimit të çështjes në themel (në shkallë të parë dhe të dytë), nuk parashikoi (*ometo*) afate të veçanta kohëzgjatje të paraburgimit për këtë fazë dhe as një pasqyrim të ndikimit të kësaj faze të re, të shtuar, të procedimit, në afatin tërësor të kohëzgjatjes së paraburgimit, të parashikuar në nenin 263/6 të KPP. Kjo fazë e procedimit penal ka ndikim në ecurinë e gjithë procesit, përfshi këtu edhe në kohëzgjatjen e e paraburgimit për të pandehurin.

Verifikimi i kësaj situatë ligjore nga njëra anë, dhe “modelimi” i seancës paraprake, nga ana tjetër, përsa i përket aspektit procedural të zhvillimit të saj, sipas tipologjisë së zhvillimit të seancës gjyqësore të gjyqimit të çështjes në themel, me elemente tipike karakterizues të këtij gjykimi, (*in primis* “kompetenca” e gjyqtarit të seancës paraprake, për të pezulluar afatet e paraburgimit të të pandehurit, në përputhje me përcaktimet e nenit 265 të KPP), sipas konsideratës së këtij Kolegji imponon pashmangshmërisht, një linjë interpretimi të problematikës së identifikuar në këtë gjykim njësoj, në favor të konsiderimit të periudhës së kohëzgjatjes së paraburgimit, të vuajtur prej të pandehurit gjatë seancës paraprake, si periudhë që i përket (integrohet) në fazën e gjyqimit të çështjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 263 të KPP. Ky afat fillon prej momentit (ditës) të “dorëzimit të akteve në gjykatë”, nga prokurori dhe zgjat deri në momentin e “dhënies së vendimit të dënimit në gjykatën e shkallës së parë”, gjithnjë duke respektuar kjo kohëzgjatje afatet e parashikuara, me pasojë humbjen e fuqisë së masës (shuarjen e saj), në shkronjat “a”, “b”, “c”, të paragrafit të dytë të kësaj dispozite, sipas llojit të akuzës për të cilën procedohet.

Por, nga ana tjetër, Kolegji konstaton se gjyqtari i seancës paraprake në ushtrim të

funksioneve që i ka njohur ligji, mund të disponojë edhe për plotësimin e hetimeve, kur ato nuk janë të plota, si dhe mund të urdhërojë prokurorin të korrigjojë apo të saktësojë akuzën e atribuar të pandehurit. Vendimmarrja e gjyqtarit të seancës paraprake në këto raste, nuk i jep fund seancës paraprake, pra nuk përmbyll këtë fazë të procedimit penal. Diskutimi që lind në këtë rast është nëse kemi një regres në fazën e hetimit paraprak apo kjo vendimmarrje është pjesë e seancës paraprake dhe rolit të saj si një fazë që synon kontrollin e plotësisë së hetimeve dhe garantimin e të drejtave procedurale të të pandehurit.

Për arritjen në një përfundim në lidhje me sa më lart parashiroi, Kolegji vlerëson se duhet bërë një interpretim i normave procedurale që rregullojnë institutin e ri të seancës paraprake, por duke e lidhur me mungesën e reflektimit të kësaj fazë të re të procedimit përsa i përket afateve të paraburgimit. Kolegji çmon se parashikimi i figurës së gjyqtarit të seancës paraprake synon jo thjesht ushtrimin e një “kontrolli” mbi veprimtarinë procedurale të prokurorit gjatë hetimit paraprak, por, mbi të gjitha, garantimin e të drejtave të mbrojtjes, duke synuar edhe efektivitetin e gjykimit të çështjes penale në themel.

Në mungesë të parashikimit ligjor në lidhje me afatin e paraburgimit të konsumuar gjatë seancës paraprake, Kolegji vlerëson se duhet analizuar edhe përmbajtja e nenit 263 të KPP. Neni 263/2 i KPP në gjendjen aktuale edhe pas ndryshimeve të vitit 2017, parashikon [...] Ndërsa, neni 263/6 i KPP përcakton [...] Kjo dispozitë, në pikën “1” të saj, e lidh humbjen e fuqisë së paraburgimit të hetimit, me kalimin e afateve të parashikuara “*pa u dorëzuar aktet në gjykatë*”. Interpretimi ligjor që duhet bërë nga Gjykata e Lartë në këtë rast është nëse “dorëzimi i akteve në gjykatë” lidhet me momentin e parashikuar në nenin 327 pika 6, kur prokurori në përfundim të hetimeve kërkon dërgimin e çështjes në gjyq apo në momentin kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për pranimin e kësaj kërkesë, sipas nenit 332/dh të KPP. Në këto dy dispozita ligjvënësi ka parashikuar: (i) detyrimin për prokurorin që, së bashku me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, të depozitojë edhe aktet e provat që përmban fashikulli i hetimeve, sipas nenit 331, pika “4” të KPP; (ii) detyrimin e gjyqtarit të seancës paraprake, që kur vendos dërgimin e çështjes në gjyq, të përcaktojë aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit (neni 332/ë) dhe më pas ta depozitojë këtë fashikull së bashku me aktet e masave të sigurimit, në sekretarinë e gjykatës kompetente (neni 332/f).

Në interpretim të neneve që kanë rregulluar institutin e seancës paraprake, Kolegji Penal nisat nga kriteri teleologjik i normës dhe nga kriteri funksional i organit procedues, në rastin konkret të gjykatës. Pra, vlerësimi se në cilin moment gjykata ushtron funksionet kontrolluese vlerësuese të hetimeve paraprake dhe në cilin moment gjykata ushtron funksionet kushtetuese të bërjes së drejtësisë. Nga vendi që zë në renditjen e normave procedurale, i vendosur në Kreun IX të KPP, “seanca paraprake”, si dhe nga qëllimi i krijimit të kësaj figure të gjyqtarit të seancës paraprake, Kolegji vlerëson se ajo është një fazë e ndërmjetme procedurale, të cilën ligjvënësi nuk e ka përcaktuar as si pjesë e hetimit, por as si pjesë e fazës së gjykimit. Në rrethanat e parashtruara, në lidhje me llogaritjen e afateve të paraburgimit për këtë fazë, në mungesë të një parashikimi të saktë ligjor, Kolegji vlerësoi se duhet t’i referohemi natyrës së vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake, nëse ky vendim i jep fund kësaj faze apo nëse aktet i kthehen prokurorit.

Kolegji vë në dukjese, në zbatim të nenit 327, pika “6” të KPP, prokurori me depozitimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, depoziton njëkohësisht edhe të gjitha aktet në gjykatë/gjyqtari i seancës paraprake. Ky moment procedural, sipas ligjit (shprehimisht në këtë nen parashikohet: “*në përfundim të hetimeve ...*”), shënon përfundimin e hetimeve paraprake. Në favor të këtij interpretimi të karakterit teleologjik, në përshtatje me qëllimin e ligjvënësit në parashikimin e këtij instituti procedural, është edhe përcaktimi i nenit 331 të KPP (kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq) që nënkupton përfundimin e fazës së hetimeve paraprake me kontestimin/atribuimin e akuzës të pandehurit dhe dërgimin e çështjes për gjykim. Është pikërisht kjo kërkesë (për dërgimin e çështjes në gjyq) e paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake, (përmbytja e të cilës pasqyron në thelb akuzën e kontestuar prej këtij të fundit të hetuarit, i cili prej këtij momenti “fiton” statusin e të pandehurit, duke u akuzuar për një akuzë të caktuar), që “provokon” konstituimin e seancës paraprake si një moment kyç në funksion, sikurse u sipërcitua, të verifikimit të akuzës të atribuuar të pandehurit, si përsa i përket aspektit të kompletueshmërisë së hetimeve të zhvilluara, ashtu edhe në drejtim të kualifikimit të saktë juridik të faktit penal të atribuuar nëpërmjet akuzës, të pandehurit.

Neni 327 i KPP parashikon[...] Me kryerjen e këtyre veprimeve procedurale, nga ana e prokurorit merret vendimi për dërgimin e çështjes në gjykim, duke kërkuar diçka të tillë para gjyqtarit të seancës paraprake. Në këtë mënyrë prokurori ka mbyllur fazën e tij të hetimeve duke vlerësuar se i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Zakonisht në praktikë ky moment procedural korrespondon me përmbytjen e afatit të përcaktuar nga neni 263/1 përfshi dhe atë të nenit 327 të KPP. Kontrolli i hetimeve nga gjyqtari i seancës paraprake është konfirmim e kryerjes së hetimeve paraprake në funksion të një gjykimi efektiv e që garanton më mirë të drejtat e garancitë procedurale. Por duke qenë tipar i një kontrolli gjyqësor që realizohet në debat e kontradiktoritet në mes të palëve të thirrur në seancë gjyqësore nënkuptohet që kur gjyqtari i seancës paraprake vendos sipas nenit 332/dh të KPP ai sillet si gjyqtari i gjyqimit, në një gjykim të kufizuar por pa marrë atributet e gjyqtarit të themelit për çështje të vlerësimit të fakteve, provave e fajësisë.

Sipas interpretimit sistematik të normës, seanca paraprake është shtuar si kre më vete (kreu IX, Seanca paraprake), me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017. Më përpara ne nuk kemi pasur një figurë të gjyqtarit të seancës paraprake, kemi pasur vetëm gjyqtarin e hetimit. Që në fillim të parashikimit të rregullave të dhëna nga neni 332 i KPP (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 41/2021, datë 23.03.2021) parashikohet se [...] Nga interpretimi i këtij rregullimi ligjor del se tashmë kemi një figurë të veçantë gjyqtari i cili ka kompetenca për të shqyrtuar në këtë fazë kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjykim, shqyrtim i cili duhet të kryhet brenda 30 ditëve. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë për shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga palët e procesit penal, gjatë kohës që ky gjyqtar disponon me vendim për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP shqiptare.

Disa nga llojet e kërkesave që mund të paraqiten nga palët e procedimit penal, gjatë kësaj kohe janë: zgjatja e afateve të paraburgimit, kërkesa që lidhen me masat e sigurimit

(revokimi dhe zëvendësimi); kërkesa që lidhen me marrjen e provave të reja; kërkesa që lidhen me pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe papërdorshmërinë e provave, të kryera këto gjatë kohës që gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar me vendim sipas nenit 332/ç të KPP shqiptare; kërkesa që paraqet i pandehuri për gjykimin e shkurtuar, pasi gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar me vendim sipas nenit 332/ç të KPP shqiptare apo kërkesa për përgjimin e komunikimeve etj

Kontrolli i hetimeve nga gjyqtari i seancës paraprake është në funksion të një gjykimi efektiv e që garanton më mirë të drejtat e garancitë procedurale të të pandehurit. Por, duke qenë tipar i një kontrolli gjyqësor që realizohet nëpërmjet debatit dhe në zbatim të kontradiktoritetit mes të palëve të thirrura në seancë gjyqësore, nënkuptohet që kur gjyqtari i seancës paraprake vendos sipas nenit 332/dh të KPP, ai ushtron funksione juridiksionale (si gjyqtar i gjykimit), në një gjykim të kufizuar, por pa marrë atributet e gjyqtarit që shqyrton themelin e çështjes, në lidhje me vlerësimin e fakteve, provave dhe fajësisë së pandehurit.

Gjyqtari i seancës paraprake kontrollon hetimet paraprake dhe, nëse konstaton se akuza nuk është e plotë, urdhëron plotësimin e tyre sipas nenit 332/ç të KPP, duke përcaktuar drejtimet e hetimeve, afatin brenda të cilit ato duhet të kryhen, provat që duhet të ribëhen, si dhe cakton datën e seancës së re. Nenet 332/ç të KPP dhe 332/dh, parashikojnë dy situata të ndryshme rrethanash e kushtesh procedurale.

Kolegji vlerëson se, kur gjyqtari i seancës paraprake vepron sipas nenit 332/ç të KPP, duke urdhëruar plotësimin e hetimeve nuk disponon me vendim që i jep fund seancës paraprake. Në këtë rast, gjyqtari urdhëron kryerjen e veprimeve të mirëfillta procedurale hetimore e për rrjedhojë, afatet e paraburgimit në këtë rast duhen llogaritur si afate të paraburgimit të fazës së hetimit. Kur gjyqtari i seancës paraprake urdhëron *plotësimin e hetimeve* sipas nenit 332/ç të KPP, palët e procesit penal mund të paraqesin kërkesë për zgjatjen e afateve të paraburgimit. Afati i caktuar nga gjykata për plotësimin e hetimeve është në funksion të hetimeve, ndërsa afati i paraburgimit është autonom nga ai i hetimeve. Afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake gjithnjë duhet të jetë brenda afatit tërësor të hetimeve. Në momentin e kthimit të akteve prokurorit, lidhur me afatin e paraburgimit, nëse afati i paraburgimit përfundon gjatë periudhës kur aktet janë kthyer sipas kësaj dispozite, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, nëse më parë nuk i ka zgjatur ato, sipas nenit 264/2 të KPP.

Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të vendosë mbi kërkesat e paraqitura nga palët e procesit penal gjatë kohës që ai ka disponuar me vendim për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP. Kërkesat e paraqitura nga palët për zgjatjen e afatit të paraburgimit, revokimin/zëvendësimin e masave të sigurimit, marrjen e provave të reja, konstatimin e pavlefshmërisë së akteve procedurale dhe papërdorshmërisë së provave, pranimin e gjykimit të shkurtuar, apo për përgjimin e komunikimeve, etj. shqyrtohen nga gjyqtari i seancës paraprake, gjatë kohës që ai ka urdhëruar plotësimin e hetimeve sipas nenit 332/ç të KPP. Një konkluzion i tillë bazohet në faktin se ligjvënësi ka parashikuar që bashkë me urdhërimin për plotësimin e hetimeve, gjyqtari i seancës paraprake cakton edhe datën kur duhet të përfundojnë hetimet si dhe seancën e re.

Ndërkohë, me ndryshimet në KPP me ligjin nr. 41/2021, datë 23.03.2021, gjyqtari i seancës paraprake është kompetent për vijimin e gjykimit dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, si dhe kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar. Në shkronjat b) dhe c) të nenit 332/dh të KPP, parashikohet tashmë [...] Edhe në këtë rast, për këtë disponim të gjyqtarit të seancës paraprake sipas pikave “b” e “c” të nenit 332/dh të KPP, i cili zgjidh çështjen përfundimisht, nuk është parashikuar nëse afatet e paraburgimit i përkasin gjykimit apo nëse janë afate autonome. Kompetenca e gjyqtarit të seancës paraprake për të vlerësuar nëse ka prova të mjaftueshme për ta dërguar çështjen në gjykim ose ajo për pushimin e akuzës ose të çështjes të përcaktuara nga shkronjat “a” dhe “ç” të nenit 332/dh të KPP, janë kompetenca të natyrës gjykimore, pasi në këtë rast gjyqtari i seancës paraprake bën një vlerësim tjetër nga ai i hetimeve paraprake. Një element tjetër që tregon se kjo fazë e procedimit ka një karakter juridiksional është edhe parashikimi i pezullimit të afateve të paraburgimit bazuar në nenin 265 të KPP nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake. Pezullimi është ndërprerje e afateve të paraburgimit për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj, afate që rifillojnë pasi të ketë rënë shkaku i pezullimit, dhe vazhdojnë për pjesën e pa konsumuar të tyre. Parashikimi i referimit nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake i mundësisë së pezullimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 332/b, paragrafi 7, nënkupton një mundësi procedurale për të frenuar ecjen e pajustificuar të këtyre afateve. Pezullimi i afateve të paraburgimit nga ana tjetër si një mundësi procedurale me nenin 265 të KPP, nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake nënkupton që legjislatori është mjaftuar në këtë mundësi procedurale për të frenuar kalimin e afateve të paraburgimit, kur shqyrtimi në seancë paraprake nuk ecën për shkak të mungesës nga ana e të pandehurve. Pezullimi është ndërprerje e afateve për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj dhe këto afate rifillojnë pasi të ketë mbaruar, ose të jete hequr shkaku i pezullimit, dhe vazhdojnë për pjesën e pa konsumuar të tyre. Kur gjykata disponon për një nga shkaqet që ligji parashikon për pezullim të afateve të paraburgimit, këto afate nuk ecin, por rifillojnë pas heqjes së pezullimit. Kjo do të thotë, se vete afati maksimal i paraburgimit nuk tejkalohej proceduralisht, por koha fizike e paraburgimit mund të jete me e gjate se afati tërësor. Po t’i referohemi shkaqeve të pezullimit të afateve të paraburgimit, ato lidhen me veprime dhe kërkesa të padrejta të mbrojtësit apo të pandehurit, apo me mosparaqitjen apo largimin e mbrojtësit nga gjykimi. Pra, pezullimi i afateve të paraburgimit vendoset për shkaqe që kanë të bëjnë me sjelljen e të pandehurve e mbrojtësve të tyre dhe jo me ato të organit të akuzës apo të gjykatës. Parashikimi i referimit nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake i mundësisë së pezullimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 332/b paragrafi 7, nënkupton një mundësi procedurale për të frenuar ecjen e pajustificuar të këtyre afateve.

Kolegji konstaton se në fakt, nga analiza e dispozitave që rregullojnë seancën paraprake, evidentohen elemente që të shtyjnë drejt konsiderimit të kësaj faze në përbërje të fazës së hetimeve paraprake, referuar përcaktimit të nenit 332/ç të KPP (vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për plotësimin e hetimeve, duke përcaktuar drejtimin e tyre), si dhe nenit 332/d, pika “3” e KPP (vendimi i gjyqtarit të seancës

paraprake për kthimin e akteve prokurorit, kur ky i fundit nuk vepron për të bërë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme të akuzës). Gjithsesi, konstatimi i këtyre diferencave në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të seancës paraprake, sipas Kolegjit, konsiderohet i pamjaftueshëm për të “eklipsuar” karakterin tendencialisht juridiksional të kësaj faze të procedimit penal (seancës paraprake), dhe përfshirjen e saj (për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit të të pandehurit, sipas përcaktimit të nenit 263 të KPP) në një fazë tjetër, të ndryshme nga faza e gjykimit të çështjes (në shkallë të parë), të asaj të hetimeve paraprake. Kolegji çmon se qëllimi i dy dispozitave të cituara më lart është në funksion të kompetencës funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake, në lidhje me kontrollin dhe verifikimin e akuzës së paraqitur prej prokurorit, në aspektet e përmendura më lart, përta i përket nivelit (standardit) provues të “provave” (burimeve të provave në fakt) të mjaftueshme, për të “toleruar” (standardi minimal) gjykimin e çështjes (akuzës). Kjo kompetencë e gjyqtarit të seancës paraprake, që në thelb lidhet me verifikimin e kushteve të gjykueshmërisë së çështjes, ka diferenca edhe me funksionin e gjyqtarit të gjykimit të çështjes (akuzës) në themel, i cili duhet të verifikojë bazueshmërinë e akuzës në funksion të fajësisë së të pandehurit.

Diferencat e evidentuara më lart, në vlerësimin e Kolegjit, mbështesin konkluzionin se seanca paraprake sipas ligjit procedural penal shqiptar, është një fazë e ndërmjetme, por që ka tipare juridiksionale. Në interpretimin teleologjik të normave, për aq sa ka parashikuar legjislacioni ynë i ri procedural, kompetencën funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake dhe duke iu përmbajtur karakterit funksional të organit procedues në këtë rast, arrihet në përfundimin se afati 30 ditor i paraburgimit që konsumohet gjatë gjykimit të çështjes para gjyqtarit të seancës paraprake, i takon fazës së gjykimit të çështjes në themel (në shkallë të parë) kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për:

- pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq.
- vijimin e gjykimit nga e njëjta Gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe caktimit të dënimit.
- vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar.
- pushimin e akuzës ose të çështjes apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, në rastet e parashikuara në ligj, sipas nenit 332/dh, shkronjat “c” dhe “d” të KPP.

Ndërsa, për sa i përket situatës procedurale të parashikuar në nenet 332/ç dhe 332/d paragrafi i tretë i KPP, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon “*kthimin e akteve prokurorit*” për “*plotësimin e hetimeve*” dhe për “*korrigjimin dhe saktësimin e akuzës*”, pra me verifikimin e pamundësisë së konkludimit të seancës paraprake, në dy rastet e sipërcituara, Kolegji, konsideron periudhën e konsumimit të afateve të paraburgimit për llogari të fazës së procedimi penal, të hetimeve paraprake.

Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që në lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këtë përfundim njësuës:

1. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të hetimit paraprak kur, gjyqtari i seancës paraprake

disponon “Për plotësimin e hetimeve”, sipas nenit 332/c dhe/ose “Për kthimin e akteve prokurorit për korrigjimin ose saktësimin e akuzës”, sipas nenit 332/d, pika 3 e KPP.

- 2. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjykimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për:**
- a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq;**
 - b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe caktimit të dënimit;**
 - c) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar;**
 - ç) për pushimin e akuzës ose të çështjes, apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj, sipas nenit 332/dh shkronjat «ç» e «d» të KPP.**

Duke u kthyer tek rasti konkret, çështja objekt gjykimi, që i përket rekursit të paraqitur prej kërkuesi, ndaj vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe asaj të Apelit Shkodër, të cilat lidhur me kërkesën për deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal “arrest në burg” të caktuar ndaj tij, [...] gjyqtari për hetimet paraprake, Kolegji Penal, duke ju referuar konkluzionit njësuës sipas të cilit (shkronja “a” e pikës 1 të tij) “periudha e afatit të paraburgimit të konsumuar gjatë fazës të trajtimit të çështjes para gjyqtarit të seancës paraprake, kur prej këtij të fundit, është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq, sipas përcaktimit të germës “a”, të paragrafit të parë, të nenit 332/dh të KPP, konsiderohet/përfshihet, në cilësinë e afatit të paraburgimit të fazës së gjykimit (në themel, në shkallë të parë) të çështjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 263 të KPP”, konkludon mbi aplikimin e gabuar të ligjit procedural - përcaktimi i germës “a”, të paragrafit të parë të nenit 332 të KPP - prej gjykatave të faktit (të shkallës së parë dhe të dytë). Si pasojë, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave të faktit, përse i përket përlllogaritjes të afatit të paraburgimit të konsumuar prej të pandehurit Vata, për periudhën prej datës 30.07.2020 deri më datë 06.11.2020, si afat të konsumuar gjatë fazës së hetimit paraprak, është i gabuar, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në vlefshmërinë e masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, të caktuar ndaj tij.

Kolegji së pari vlerëson se, në lidhje me masat e sigurimit, e drejta për të ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, është parashikuar shprehimisht në pikën 8 të nenit 249, të KPP, ku theksohet[...] Në këtë vështrim, rekursi në lëndë të masave të sigurimit duhet të evidentojë shprehimisht shkeljen e ligjit, e lidhur kjo edhe me sa parashikon neni 432 i KPP, ku janë parashikuar shkaqet për të cilat lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë. Kolegji thekson se juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë, nënkupton shqyrtimin e rekurseve për shkelje të ligjit material dhe procedural, duke siguruar zbatimin uniform të ligjit apo zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ligji nuk i jep Gjykatës së Lartë asnjë kompetencë për të shqyrtuar elementet materiale dhe faktike të ngjarjeve të hetuara, përfshirë nivelin e provave që mbështesin dyshimin e arsyeshëm apo elementet që lidhen me vlerësimin e nevojave të sigurimit në rastin konkret.

Kolegji vlerëson se, edhe në rastin e rekurseve në lëndë të masave të sigurimit, shqyrtimi i tyre lidhet ngushtësisht me pretendimet për shkelje të ligjit. Në këtë vështrim, shqyrtimi i fakteve dhe i provave/akteve edhe në këtë rast, del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Kolegji arriti në këtë konkluzion pasi shtroi për diskutim nëse kushtet e kërkuara nga neni 266 i KPP mund të verifikohen në Gjykatën e Lartë, si gjykatë ligji apo duhen verifikuar në gjykatat e faktit. Ky diskutim lind pasi shqyrtimi i kushteve për caktimin e masave të sigurimit, siç mund të jetë ekzistenca në vijim e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova ose/dhe shqyrtimi i kriterëve si përshtatshmëria e masës së sigurimit apo analiza e proporcionalitetit, kërkon domosdoshmërisht edhe çmuarjen e provave/akteve të përfshira në fashikull, vlerësim të rrethanave të faktit dhe të nevojave të sigurimit, vlerësim të personalitetit të të hetuarit/dyshuarit, vlerësim të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të dyshuar të saj. Kolegji vlerëson se, kufizimi në këtë rast është i lidhur me pamundësinë e Gjykatës së Lartë për të caktuar masën më të përshtatshme të sigurimit, qoftë në favor apo kundër të dyshuarit.

Kolegji Penal, duke vlerësuar ligjshmërinë (e munguar) të vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Shkodër por në të njëjtën kohë edhe pamundësinë faktike të tij për të disponuar korrigjimin e kësaj paligjshmërie, në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke zëvendësuar dhe “uzurpuar” diskrecionin e gjykatave të faktit, çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër [...] që ka vendosur “lënien në fuqi” të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duhet të priset duke u kthyer çështja për rigjykim, pranë asaj gjykate si gjykata kompetente.

KPGJL Vendim Nr.00-2022-115(53), datë 18.02.2022 (Dallimi kompetencë gjyqtar seancë paraprake-gjyqtar themeli)

Pavarësisht se në kohën e gjykimit në shkallë të parë nuk ishin miratuar dhe as kishin hyrë në fuqi ndryshimet e KPP, edhe në dispozitat e mëparshme të KPP nuk përmbanin asnjë dispozitë që të parashikonte që gjykata e themelit kontrollonte veprimtarinë hetimore të prokurorit dhe kishte të drejtë të kthente çështjen për hetime kur vlerësonte se ato nuk ishin të plota. Gjykata e themelit gjykon çështjen mbi provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe nga mbrojtja dhe në fund të shqyrtimit gjyqësor, si krijon bindjen, shpall vendimin, që mund të jetë vendim dënimi, pafajësie ose vendim pushimi.

Fjalë kyçe: kontroll veprimtari hetimore prokuror, gjyqtar i seancës paraprake, gjykatë themeli

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. 697, të vitit 2004, për veprën penale “Vrasja me dashje”, e ngelur në tentativë, parashikuar nga neni 76 dhe 22 i K.Penal. Ky procedim penal është pezulluar me vendimin e datës 19.04.2005, për shkak se nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit. Në datën 10.11.2014 është vendosur rifillimi i hetimeve nga ana e Prokurorisë së [...] në lidhje me këtë procedim

penal. Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se për ngjarjen e datës 16.01.2004, [...] shtetasi A.F. ka deklaruar se rreth orës 19:30, në lokalitë e tij ka hyrë një shtetas të cilin e njohte si fytyrë, i cili është vëllai i G.B. Personi i kërkoj të dilnin jashtë për t'u sqaruar dhe të dy kanë dalë jashtë lokalitë. Personi i ka thënë se kishte një sqarim me të vëllain Arjanin dhe në këtë kohë ka nxjerrë një armë tip pistoletë të cilën i ka drejtuar Arbenit. Ndërkohë që e ka fyer me fjalë fyese, Arbeni i ka kërkuar që të qetësohej dhe të vinte ditën tjetër për t'u sqaruar me vëllain e tij Arjanin. Duke i folur i ka ulur pistoletën dhe personi është larguar dhe është futur në një automjet tip Honda me targa Tiranë.

Personi u largua me mjetin tip Honda, duke u kthyer pas disa minutash, dhe pasi ka ndaluar mjetin pranë lokalitë, ka qëlluar tre herë me pistoletë tip TT në drejtim të lokalitë, ku shtetasi A.F. ka qenë jashtë tij, [...] duke biseduar me dajën e tij Festim. Shtetasi A.F. ka sqaruar se vëllai i G.B. e kishte bërë këtë veprim pasi kishte dëgjuar nga të tjerë që vëllai i tij Arjani kishte pirë kafe me motrën e Gentjanit, shkak për të cilin është ndjerë i fyer. Shtetasi A.F. ka sqaruar se nuk e ka parë vëllain e G.B. gjatë këtyre viteve, por Genti ka vetëm një vëlla i cili është personi që qëlloi me armë në lokalitë e tij.

Në lidhje me këtë procedim penal janë kryer veprimet hetimore, këqyrje e vendit të ngjarjes, akt ekspertimi vlerësim prove, janë marrë deklaratimet e personave të pranishëm në vendin e ngjarjes, A.F., E.K., T.S., F.M., A.F. Shtetasi G.B., i pyetur në lidhje me ngjarjen, ka deklaruar se në muajin nëntor 2004 ai ka qenë jashtë shtetit. Me vëllain nuk ka pasur komunikim, pasi nuk kanë marrëdhënie të mira, [...]

Gjatë hetimeve paraprake, nga prokuroria është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit personal "Arrest në burg" ndaj personit nën hetim B.B., kërkesë që është refuzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vendim ky që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë. Të dyja gjykatat kanë arsyetuar se nga të dhënat rezultojnë se personi nën hetim B.B. mund të jetë autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 84, 278/2 dhe 274 të K.Penal që ka qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së ngjarjes, por që për këto vepra penale ndjekja penale në bazë të nenit 66 të K.Penal është parashkuar.

Pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, nga prokuroria është dërguar në gjykatë kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr.697 të vitit 2004 për veprën penale "Vrasja me dashje", e ngelur në tentativë, parashkuar nga neni 76 dhe 22 i K.Penal në ngarkim të të pandehurit B.B..

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, [...] ndër të tjera, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin B.B. për veprën penale të vrasjes me dashje të mbetur në tentativë [...] ta dënojë atë me 10 (dhjetë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të KPP duke i zbritur 1/3 e masës së dënimit, i pandehuri dënohet me 6 vjet e 8 muaj burgim. [...]

Gjykata e Apelit Vlorë, [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se pretendimet e ngritura në rekursin e prokurorisë janë të bazuara dhe përbëjnë shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi prej

kësaj gjykate është zbatuar gabim ligji procedural penal, konkretisht neni 428/1/ç të KPP që i jep të drejtë Gjykatës së Apelit të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të kthejë çështjen për rigjykim. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton dhe mungesë arsytimi nga Gjykata e Apelit në lidhje me shkakun e prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, Gjykata e Apelit nuk ka interpretuar si duhet dispozitat në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me themelin e çështjes dhe të drejtën e disponimit të saj në fund të shqyrtimit gjyqësor.

Kolegji vlerëson se nuk është i saktë interpretimi i Gjykatës së Apelit kur është shprehur se nuk rezulton që nga gjykata e shkallës së parë të jenë kryer verifikimet e duhura nëse nga organi i prokurorisë është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm në lidhje me faktin penal objekt procedimi dhe nëse janë kryer veprimet hetimore të propozuara nga oficeri i policisë gjyqësore. Gjykata e shkallës së parë që gjykon themelin e çështjes, referuar nenit 333 e vijues të KPP, ka të drejtë të shqyrtojë çështjen penale, duke zhvilluar shqyrtimin gjyqësor e duke marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga secila palë (akuza dhe mbrojtja) në respektim të parimit të kontraditoritetit dhe barazisë së armëve. Në fund të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e themelit merr vendim referuar bindjes së brendshme të krijuar nga debati gjyqësor dhe provat e administruara në seancë gjyqësore. Ky vendim mund të jetë vendim pafajësie ose pushimi (sipas nenit 387 të KPP) ose vendim dënimi kur gjykata bindet për fajësinë e të pandehurit (sipas nenit 390 të KPP).

Kolegji vlerëson se ligji procedural penal nuk parashikon në asnjë dispozitë ligjore të drejtën e gjykatës së themelit për të kontrolluar kryerjen e veprimeve hetimore nga prokuroria dhe aq më pak kthimi i çështjes për hetime të mëtejshme. Një kompetencë e tillë me ndryshimet e KPP i përket gjyqtarit të seancës paraprake që ka të drejtë të urdhërojë prokurorin për plotësimin e hetimeve duke përcaktuar dhe drejtimin e tyre, referuar nenit 332/ç të Kodit. Gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet e miratura me ligjin nr. 35/2017 të KPP, ndërsa këto ndryshime kishin hyrë në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes në Apel.

Në çështjen objekt gjykimi, gjykimi ka qenë në fazën e themelit, në të cilën gjykata e shkallës së parë po gjykante kërkesën e prokurorisë për gjykimin e të pandehurit. Kolegji vlerëson se, pavarësisht se në kohën e gjykimit në shkallë të parë nuk ishin miratuar dhe as kishin hyrë në fuqi ndryshimet e KPP, edhe në dispozitat e mëparshme të KPP nuk kishte asnjë dispozitë që të parashikonte që gjykata e themelit kontrollonte veprimtarinë hetimore të prokurorit dhe kishte të drejtë të kthente çështjen për hetime kur vlerësonte se ato nuk ishin të plota. Gjykata e themelit gjykon çështjen mbi provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe nga mbrojtja dhe në fund të shqyrtimit gjyqësor, si krijon bindjen, shpall vendimin, që mund të jetë vendim dënimi, pafajësie ose vendim pushimi. Në rast se nuk ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, siç argumenton Gjykata e Apelit në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë vendos ta deklarojë të pafajshëm të pandehurin.

Kolegji thekson se gjykata e shkallës së parë ka detyrimin të vendosë mbi provat që i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, ndërsa nuk ka kompetencë të kontrollojë veprimtarinë hetimore të prokurorit në këtë fazë të gjykimit. Për më tepër, Gjykata e

Apelit ka prishur vendimin e shkallës së parë, për shkak se ka konstatuar moskryerje të veprimeve procedurale të propozuara nga oficeri i policisë gjyqësore, arsyetim që gjendet i pabazuar nga Kolegji. Oficeri i policisë gjyqësore nuk është organi që ushtron ndekjen penale dhe as që përfaqëson akuzën, prandaj arsyetimi i Gjykatës së Apelit për prishje të vendimit sepse nuk janë kryer veprimet hetimore të kryera prej tij nuk është i bazuar në asnjë dispozitë procedurale. Nëse veprimtaria e prokurorit nuk ka qenë e plotë në kuadër të hetimit paraparak dhe provat janë të pamjaftueshme për të mbështetur akuzën e ngritur, gjykata e themelit do të marrë vendim pafajësie.

Arsyetimi i Gjykatës së Apelit se nga gjykata e shkallës së parë nuk është kontrolluar nëse janë kryer veprimet hetimore të propozuara nga oficeri i policisë gjyqësore nuk është i bazuar në ligjin procedural penal. Gjykata e themelit nuk verifikon veprime të tilla, por nëse ajo vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës merr vendim pafajësie. Gjykata e Apelit, nëse do të krijonte bindje të ndryshme në lidhje me çështjen objekt gjykimi, mund të dispononte duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të deklaronte të pafajshëm të pandehurin. Në rastin konkret nuk mund të vendosej prishja e vendimit të shkallës së parë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim pasi nuk ka pasur shkaqe për një vendimmarrje të tillë referuar nenit 428/1/ç të KPP ose të paktën një shkak i tillë nuk është i arsyetuar.

Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit nuk e ka arsyetuar vendimmarrjen e saj kur ka disponuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në shkelje të normave procedurale penale dhe për pasojë çështja duhet të prishet dhe të kthehet për rigjykim me tjetër trup gjykues. Gjykata e Apelit nuk ka përcaktuar se cilat norma procedurale ka shkelur konkretisht gjykata e shkallës së parë dhe në cilën pikë të nenit 428/1/ç të KPP e bazon vendimmarrjen e saj. Në këtë drejtim, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është i paarsyetuar, pasi nuk përcakton shkakun e prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u bërë shkak që Kolegji të vendosë prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim. Në rishqyrtim, Gjykata e Apelit duhet të marrë në konsideratë konkluzionet e mësipërme të Kolegjit në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së themelit dhe disponimin në fund prej saj. Gjithashtu, Gjykata e Apelit duhet të arsyetojë se cilat dispozita procedurale nuk ka zbatuar gjykata e shkallës së parë, që janë bërë shkak për prishjen e vendimit të saj, sipas nenit 428 të KKP. Gjykata e Apelit duhet të shqyrtojë çështjen në themel, në drejtim të shkaqeve të ankimit me të cilat është investuar dhe duke gjykuar në ushtrim të rolit të saj, si gjykatë fakti dhe ligji.

Sa më sipër, Kolegji vendos prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2022-1151(183), datë 24.06.2022

KPGJL Vendim Nr.00-2023-40, datë 17.01.2023 (Plotësim hetimi/zgjatje afateve të paraburgimit)

Kur gjyqtari i seancës paraprake disponon dërgimin e akteve prokurorit për

“plotësimin e hetimeve”, sipas nenit 332/c të KPP, ai disponon edhe lidhur me kërkesat e palëve për zgjatjen e afateve të paraburgimit, të konsumuara për llogari të fazës së hetimeve paraprake, sipas nenit 263/1/b të KPP.

Fjalë kyçe: kompetencë funksionale, gjyqtari i hetimeve paraprake, gjyqtari i seancës paraprake, zgjatje afate paraburgim

Rrethanat e çështjes:

Nga përmbajtja e vendimeve të “gjykatave” në konflikt ka rezultuar se, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në përfundim të hetimeve paraprake të zhvilluara lidhur me çështjen penale [...], i është drejtuar GJKKO, me kërkesën me objekt “Dërgimin në gjyq të çështjes penale, [...] në ngarkim të të pandehurve; L.P., S.B.”, të akuzuar për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 259/2 - 25 të K.Penal dhe (të pandehurve) H.T., J.K., të akuzuar për veprën penale të “Ushttrimin të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1 - paragrafi 4 - i K.Penal. Gjithashtu, së bashku me kërkesën e sipërcituar, është paraqitur dhe kërkesa për pushimin e çështjes penale, ndaj personit nën hetim, K.K. [...] gjyqtarja e seancës paraprake, e cila pasi ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit - me vendimin nr. 128, datë 14.12.2022, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar të formulojë akuzë e të paraqesë kërkesën për gjykimin e çështjes edhe për personin nën hetim, K.K., e konkretisht akuzën për veprën penale të “Korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, [...]

Më datë 15.12.2022, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar regjistron në këtë gjykatë, kërkesën me objekt: “Zgjatjen e afateve të paraburgimit për të pandehurit L.P., H.T. [...] për 3 (tre) muaj, [...] [...]”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtari i seancës paraprake) [...] ka vendosur shpalljen e moskompetencës funksionale për gjykimin e çështjes penale [...] me objekt zgjatjen e afateve të paraburgimit, për të pandehurit L.P. dhe H.T. dërgimin e akteve pranë gjyqtarit të hetimeve paraprake. [...]

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtari i hetimeve paraprake) me vendimin [...] ka vendosur ngritjen e çështjes së mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore/ funksionale midis gjyqtarit të hetimit paraprak dhe gjyqtarit të seancës paraprake pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, për shqyrtimin e kërkesës penale nr. [...] me objekt zgjatjen e afateve të paraburgimit, për të pandehurit [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se në çështjen në shqyrtim ekziston një mosmarrëveshje/ konflikt negativ për kompetencën funksionale, ndërmjet dy gjyqtarëve që ushtrojnë funksionet pranë GJKKO, pasi si gjyqtari i hetimit paraprak ashtu dhe, gjyqtari i seancës paraprake, nuk pranojnë të marrin në shqyrtim të njëjtën kërkesë penale të Prokurorisë

së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me objekt: *Zgjatjen e afateve të paraburgimit për të pandehurit* [...] duke mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me kompetencën funksionale për shqyrtimin e saj.

KPP në Kreun II, seksionin V, titulluar “Mosmarrëveshjet për kompetencat”, nenet 89, 90 dhe 91 [...] Kolegji konsideron të gabuar – në kundërshtim me obiter dictum-in - urdhërimin e vendimit njehsues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (nr.62, datë 01.11.2021) – qëndrimin e gjyqtarit të seancës paraprake të GJKKO – që i atribuon gjyqtarit të hetimeve paraprake (pranë të njëjtës GJKKO) kompetencën për të gjykuar – trajtuar kërkesën e Prokurorit (të Posaçëm) për zgjatjen e afateve të paraburgimit për të pandehurit [...] (të akuzuar - i pari – [...], për veprën penale të parashikuar nga nenet 259/2 – 25 të K.Penal dhe i dyti – [...]) për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i katërt i K.Penal) për më tepër në kushtet kur (përtej përcaktimeve të këtij urdhërimi) procedimi penal – kërkesa për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurve [...] - varet para gjyqtarit të seancës paraprake - pavarësisht vendimmarrjes së këtij të fundit për të aplikuar kërkesat e nenit 329/3/c të KPP dhe dërguar (kthyer) çështjen, për të hetuarin K.K. (për të cilin organi i akuzës kishte paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes), tek Prokurori - duke e urdhëruar – që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykim - edhe për këtë shtetas, për veprën penale të parashikuar nga nenet 259/2 -25 të K.Penal, pavarësisht përcaktimit të paragrafit të dytë, të nenit 329/a, të KPP, që obligon gjyqtarin e seancës paraprake, për të trajtuar (shqyrtuar), në momentin e gjykimit të kërkesës së Prokurorit për “dërgimin e çështjes në gjyq”- edhe kërkesën (tjetër) të këtij të fundit, për pushimin e çështjes - kërkesë e cila pavarësisht simultaneitetit të gjykimit – marrjes në shqyrtim të saj – në të njëjtën kohë me kërkesën (tjetër të Prokurorit) për “dërgimin e çështjes në gjyq”- dhe para të njëjtës Gjykatë (gjyqtar) – nuk ka asgjë të përbashkët me të.

Prokurori në përfundim të fazës së hetimeve paraprake konkludon – në varësi të rezultatit të verifikimit mbi bazën e rezultateve të këtyre hetimeve, të vërtetësisë së njoftimit – notitia criminis – për veprën penale të regjistruar dhe të subjektivizuar ndaj një personi të caktuar (të hetuarit) - në konformitet me përcaktimet e nenit 287/1 të KPP për alternativat;

- e pushimit të çështjes - sipas përcaktimit të paragrafit të parë, të nenit 328 të KPP (apo të paraqitjes së kërkesës para gjykatës për pushimin e çështjes, sipas përcaktimit të nenit 329/a të KPP) – me verifikimin në mënyrë të qartë – haptazi -ictu oculi - të njërit prej kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë – nenit 328/1 të KPP.
- e dërgimit të çështjes në gjyq – nëpërmjet paraqitjes së kërkesës para Gjykatës – gjyqtarit të seancës paraprake – në prezencë të provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës – sikurse imponohet, prej përcaktimit (kushtit) të paragrafit të parë të nenit 332/dh të KPP, në cilësinë e standardit provues të aplikueshëm - prej kësaj Gjykate – në funksion të “filtrimit” të akuzave të prezantuara prej Prokurorit.

Qartazi - në rastin e paraqitjes së kërkesës për pushimin e çështjes - prokurori ka konsideruar inekzistencën e kushteve për ushtrimin e ndjekjes penale (nëpërmjet

pandehjes së të hetuarit për një vepër penale të caktuar, e cila formalizohet nëpërmjet komunikimit – këtij të fundit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, përsa kohë që kanë rezultuar të verifikuara përcaktimet e nenit 328/1 (njërit prej tyre) të KPP determinuese të konkludimit të procedimit penal (të regjistruar) në formën e pushimit.

Sakaq, në të kundërt, në rastin e konkludimit të procedimit penal (të regjistruar) prej Prokurorit, me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq – qartazi – ky i fundit ka konkluduar për verifikimin e vërtetësisë së njoftimit – notitia criminis – për veprën penale të regjistruar dhe të subjektivizuar ndaj një personi (të hetuar) të caktuar – në thelb për prezencën e “provave të mjaftueshme” mbështetëse të kontestimit të akuzës – këtij të fundit, nëpërmjet kësaj kërkesë (për dërgimin e çështjes në gjyq) që në instancë të fundit, integron ushtrimin e ndjekjes penale ndaj të hetuarit në kuadrin e këtij procedimi – tashmë – për këtë shkak – të kontestimit të akuzës dhe paraqitjes së kësaj akuze para gjyqtarit të seancës paraprake – nën statusin e të pandehurit.

Mbi këtë baze arsyetimi, Kolegji konsideron së vendimarrja e gjyqtarit të seancës paraprake, që është prononcuar lidhur me pabazueshmërinë e kërkesës së Prokurorit, për pushimin e çështjes dhe kthimin e akteve Prokurorit, duke e urdhëruar atë të formulojë akuzë edhe për të hetuarin K.K. dhe të dërgojë çështjen për gjykim, nuk mund të prodhojë asnjë lloj ndikimi – efekti – mbi kërkesën tjetër të Prokurorit - për dërgimin në gjyq të çështjes për të pandehurit [...] – e cila vazhdon të varet në kompetencën (dhe juridiksionit) të gjykimit të gjyqtarit të seancës paraprake (përsa kohë që nuk ekziston asnjë lloj arsye për regredimin, kthimin mbrapa - të procedimit – për këta të pandehur – në fazën e hetimeve paraprake), i cili është kompetent për t`u prononcuar lidhur me problematikën e kontestuar nga palët, përfshirë edhe atë të evokuar nga Prokurori, lidhur me afatet e paraburgimit (të fazës së “hetimeve paraprake në prag të skadencës” – zgjatjen e tyre) të të pandehurve [...].

Në këto kushte - të rrënjëzimit të kompetencës për gjykimin e kërkesës për dërgimin në gjykim të çështjes penale, në ngarkim të të pandehurve [...] - tek gjyqtari i seancës paraprake - afatet e paraburgimit, për të pandehurit e sipërcituar ([...]) - të konsideruara gabimisht në prag të skadencës prej Prokurorit –për shkak të identifikimit të tyre, me cilësinë e afateve të konsumuara gjatë fazës së hetimeve paraprake (sipas përcaktimit të nenit 263/1/b të KPP) – do të konsiderohen në cilësinë e afateve të paraburgimit, të konsumuara gjatë fazës së gjykimit – të filluara rishtazi për efekt të varjes së çështjes para gjyqtarit të seancës paraprak, sipas përcaktimit të paragrafit të dytë, të pikës 42, të vendimit njehsues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 62, datë 01.11.2021.

Sakaq, me vendimin nr. 62, datë 01.11.2021, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka njësuar praktikën gjyqësore, duke mbajtur qëndrimin – lidhur me trajtimin e problematikës referuese - te kërkesat e paraqitura nga palët - gjatë kohës që gjyqtari i seancës paraprake që gjykon kërkesën e paraqitur nga Prokurori “për dërgimin e çështjes në gjyq” - ka disponuar për “plotësimin e hetimeve” - sipas kërkesave të nenit 332/c të KPP [...] Në terma të tjerë edhe në rastet kur gjyqtari i seancës paraprake disponon dërgimin e akteve prokurorit (sipas vendimit të sipërcituar të Kolegjit penal) për “plotësimin e hetimeve”, në konformitet me përcaktimet e nenit 332/c të KPP, është

përsëri ky i fundit që – edhe në këto kushte, do të disponojë lidhur me kërkesat e palëve - përfshirë edhe kërkesën e Prokurorit - për zgjatjen e afateve të paraburgimit (në prag të skadimit për këtë shkak - të kthimit të çështjes për plotësim hetimesh), të konsumuara për llogari të fazës së hetimeve paraprake (sipas përcaktimit të nenit 263/1/b të KPP).

Përfundimisht, Kolegji qartazi prononcohet në favor të kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake (pranë GJKKO) për të gjykuar kërkesën e Prokurorit (të paraqitur para kësaj Gjykatë) me objekt - zgjatjen e afateve të paraburgimit të të pandehurve [...].

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2023-589, datë 13.04.2023

KPGJL Vendim Nr.00-2023-94(23), datë 19.01.2023 (Pushim akuze: ndalim vlerësim provave)

Gjyqtari i seancës paraprake mund të pushojë akuzën kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga neni 328 i KPP, vendim ky që merret nga e tij në zbatim të nenit 332/dh, pika 1, shkronja “ç” e këtij Kodi, por, gjyqtari i seancës paraprake nuk mund t'i hyjë vlerësimit të provave, të çmojë vlerën e tyre provuese në raport me faktin apo fajësinë e të pandehurit apo në raport me prova të tjera, sikundër rezulton se ka ndodhur në rastin konkret.

Fjalë kyçe: kompetencë funksionale gjyqtar seancë paraprake, pushim akuze, vlerësim prove

Rrethanat e çështjes:

Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e faktit, ka rezultuar se, shtetasit A.A., Gj.Gj., U.P, A.L, dhe H.A. kanë shkuar më datë 15.12.2018, [...] në lokalit e quajtur “Maria Bonita”, [...] në pronësi të shtetasit A.F.. Fillimisht, para se të hynin në ambientet e këtij lokali, ata janë kontrolluar nga shtetasit Y.L. dhe F.M, që janë të punësuar si punonjës të shoqërisë [...]. Ka rezultuar se ata nuk kanë pasur asgjë të kundërligjshme apo të rrezikshme me vete. Pasi personat janë futur në lokal, kanë filluar të konsumojnë pije alkoolike si dhe të komunikojnë me zë të lartë. Pronari i lokalit A.F. dhe dy persona të besuar prej tij, shtetasit F.G. dhe G.T, që ai i përdor si truproja të tij, kanë vënë re situatën dhe kanë njoftuar dy punonjësit e SHRSF të sipërcituar.

Ata janë afruar në ambientet e brendshme të lokalit, ndërkohë që truprojat e pronarit të lokalit, shtetasit F.G dhe G.T, kanë dalë në ambientet e jashtme të lokalit. Duke parë që situata po bëhej problematike në lokal, ka ndërhyrë punonjësi i SHFRSF Y.L, i cili ka vajtur tek tavolina ku ndodheshin 5 persona dhe i ka kërkuar njërit prej personave që dukej me i qetë, që të dilnin dhe të diskutonin pak në lidhje me problematikën, pasi aty nuk mund të diskutohej se muzika ishte e lartë. [...] Në momentin që Y.L., po i kërkonte që të mos shqetësonin klientët e tjerë, aty janë afruar dhe katër personat e tjerë. Gjatë kohës që këta po diskutonin katër personat e tjerë, kanë filluar të fyejnë dhe të shajnë shtetasin F.M.. Fillimisht, konflikti ka qenë verbal, me pas kanë tentuar disa herë ta godisinin

shtetasin Y.L. dhe më pas ky i fundit, ka goditur shtetasin A.A.. Në këtë moment, ka nisur konflikti fizik midis tyre, që ka përfunduar me sulmin me send të forte dhe konkretisht, me një elektrike dore të gjatë, nga ana e të pandehurit G.T.. Pas goditjes me këtë send të fortë, personat e goditur ndër të cilët janë dhe shtetasit A.L, H.A. dhe Gj.Gj, kanë ndaluar së vrapuari, duke u rrëzuar në tokë.

Fakti i ndodhur si më sipër, sipas provave të ndodhura në dosjen e hetimit paraprak të paraqitura për shqyrtim nga prokurori, provohet me deklaratimet e personave të pranishëm në vendngjarje, pamjet filmike të marra nga regjistrimet e kamerave, të cilat kanë si fushëpamje vendin ku ka ndodhur konflikti fizik, si dhe aktet e tjera të administruara në këtë procedim penal.

Me të marrë dijeni në lidhje me shpjegimet e shtetasve të sipërcituar, grupi hetimor ka shkuar përsëri në ambientet e brendshme të lokalit [...] me qëllim për të marrë pamjet filmike nga kamerat e sigurisë që monitorojnë lokalit, për të shikuar dinamikën e ngjarjes dhe mënyrën se si ka ndodhur konflikti ndërmjet palëve, si dhe për të përcaktuar shkallën e fajësisë në kuadrin e të dyshimit për secilën palë të përfshirë në konflikt. [...] Në prezencë të avokatit mbrojtës, këtij shtetasi iu bë e qartë arsyeja se pse kishin vajtur dhe oficeri i policisë gjyqësore me pëlqimin e pronarit të lokalit, është futur në ambientet e brendshme të lokalit dhe kanë shkuar tek DVR. Aty shtetasi A.F., u ka thënë që kamerat nuk punojnë. Ky shtetas pretendonte që në fillim që DVR nuk punonte. Në këto kushte, është kryer sekuestrimi DVR, e markës HCVR 5216 A- S/2, me ngjyrë të zezë dhe në momentin e sekuestrimit kapaku i sipërm, i saj ishte i lëvizshëm pa vidat që e fiksojnë me trupin e saj. Ky fakt është shënuar edhe në procesverbalin e sekuestrimit të provës materiale, të mbajtur më datë 15.12.2018 në orën 11:12 min.

Nga akti i ekspertimit kompjuterik nr. 12933 ka rezultuar se, pajisja DVR objekt ekspertimi e markës HCVR, [...], në momentin e ardhjes për ekspertim nuk kishte *hard disk* të instaluar në të. DVR-të i ruajnë pamjet filmike në *hard disk* që montohen në brendësi dhe duke qenë se DVR objekt ekspertimi, në momentin e ardhjes për ekspertim nuk kishte *hard disk* të montuar në të, ekzaminimi i saj për pamje filmike nuk mund të kryhet. [...]

Në vijim të hetimeve, personat e dëmtuar i janë nënshtruar ekzaminimit mjekësor. Sipas akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, ka rezultuar se dëmtimet në trupin e shtetasit [...] hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të rënda dhe kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të tyre nëse nuk do i jepej ndihma e kualifikuar mjekësore; dëmtimet në trupin e shtetasve [...] nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të tyre, hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat kanë shkaktuar humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë. [...]

Në datën 20.03.2019, shtetasi U.P. referuar aktit “procesverbal mbi heqjen dorë nga ankimi”, ka deklaruar se nuk do ta ndjekë në rrugë ligjore këtë problem dhe heq dorë nga ankimi. Në datën 20.3.2019, shtetasi A.A. referuar aktit “procesverbal mbi heqjen dorë nga ankimi”, ka deklaruar se nuk do ta ndjekë në rrugë ligjore këtë problem dhe heq dorë nga ankimi. Po ashtu, rezulton se është ripyetur shtetasi H.A., i cili ka deklaruar se nuk dëshiron ta ndjekë në rrugë ligjore këtë ngjarje, pavarësisht dëmtimeve që ka pësuar ditën e ngjarjes. Gjithashtu, është ripyetur edhe shtetasi A.L.,

i cili ka deklaruar se nuk dëshiron ta ndjekë në rrugë ligjore këtë ngjarje, pavarësisht dëmtimeve që ka pësuar ditën e ngjarjes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit. Dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale për të pandehurin G.T[...] Pushimin çështjes penale ndaj personit nën hetim A.F., për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuar nga neni 301 i K.Penal. Pushimin e çështjes penale ndaj personit nën hetim F.G., për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”, të parashikuar nga neni 88 e 25, të K.Penal. [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...], sa i përket personit nën hetim A.F... [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] sjell në vëmendje se, me ligjin nr. 35/2017 [...] është parashikuar faza e seancës paraprake, si një fazë e rëndësishme dhe e pashmangshme e procedimit penal, që synon të garantojë të drejtat e mbrojtjes, duke verifikuar dhe kontrolluar plotësinë e hetimeve të kryera, veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit gjatë fazës së hetimit paraprak. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të verifikojë provat e mbledhura në ngarkim të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit. Me fjalë të tjera, detyra kryesore e gjyqtarit të seancës paraprake është të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë dhe vlefshmërisë së akteve, por nuk ka si qëllim të arrijë në konkluzione mbi fajësinë e të pandehurit. Kontrolli i ushtruar nga gjyqtari i seancës paraprake mbi hetimet e kryera, përfshi këtu edhe saktësimin apo korrigjimin e akuzës, nuk do të thotë se ai merr funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale. Detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që në prani të burimit të provave që i paraqiten, të verifikojë nëse në situatën në të cilën ndodhen aktet, mund të kalohet çështja në gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjyqimit. Vlerësimi i gjyqtarit të seancës paraprake në këtë rast, bazohet në faktin penal dhe në provat e depozituara nga organi i akuzës, por kjo nuk do të thotë që ai të bëjë një analizë të thelluar duke argumentuar nëse niveli i të provuarit shkon përtej dyshimit të arsyeshëm. [...] Kolegji, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, vendimet e gjykatave dhe shkaqet e rekursit, vlerëson se vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, janë marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit penal procedural. Ky konkluzion i Kolegjit lidhet me atë pjesë të vendimmarrjes, me të cilën është disponuar pushimi i çështjes penale ndaj personit nën hetim A.F., për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuar nga neni 301 i KP, objekt rekursi në Gjykatën e Lartë.

Kolegji vlerëson se përfundimi i arritur që në rastin konkret nuk ka vepër penale, është një përfundim i cili nuk mund të arrihet *prima facie* dhe kërkon një analizë më të thelluar nga ana e gjykatës. Këtë vlerësim të thelluar apo çmuarje të provave, si dhe elementeve

të veprës penale, nuk mund ta bëjë gjyqtari i seancës paraprake, pasi provat duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor dhe kontradiktoritetit, si dhe analizës së elementeve të veprës penale, që janë karakteristikë e gjykimit në themel të çështjes. Gjyqtari i seancës paraprake mund të pushojë akuzën kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga neni 328 i KPP, vendim ky që merret nga e tij në zbatim të nenit 332/dh, pika 1, shkronja "ç" e këtij Kodi, por, gjyqtari i seancës paraprake nuk mund t'i hyjë vlerësimit të provave, të çmojë vlerën e tyre provuese në raport me faktin apo fajësinë e të pandehurit apo në raport me prova të tjera, sikundër rezulton se ka ndodhur në rastin konkret.

Përsa më lart, lidhur me pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur, Kolegji vlerëson se ka shkaqe për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të shkallëve më të ulëta (gjyqtari i seancës paraprake). Në bazë të parashikimeve të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 441, të KPP [...] Kolegji çmon se vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në këtë gjykatë (me atributet e Gjyqtarit të Seancës Paraprake), me tjetër trup gjykues. Në rishqyrtim, gjykata e apelit duhet të rimarrë në shqyrtim ankimin e organit të akuzës ndaj asaj pjese të vendimmarrjes, me të cilën është disponuar pushimi i çështjes penale ndaj personit nën hetim A.F., për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës", të parashikuar nga neni 301 i K.Penal, duke iu përmbajtur këtij arsytimi të Kolegjit (referuar rolit dhe kompetencës funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake).

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2020-144, datë 29.05.2020

III. Gjykimi i shkurtuar

KPGJL Vendim Nr.00-2022-657(175), datë 21.06.2022 (Shqyrtimi në apel i vendimit të pafajësisë së shkallës së parë)

Në rast se nuk është bërë ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës të të pandehurit për gjykim të shkurtuar, gjykata e Apelit kur vlerëson së vendimi i pafajësisë nuk është i drejtë mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë prova, duke i debatuar ato e dhënë mundësi të pandehurit të diskutojë mbi to, duke marrë prova të reja e në veçanti ato me dëshmitarë. Nëse nga ana e të pandehurit nuk paraqiten prova të reja dhe shqyrtimi gjyqësor i ripërsëritur mbyllet po me ato prova për të cilat ai ka kërkuar e është proceduar me gjykim të shkurtuar, të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së 1/3 së dënimit në rast të vendimit të fajësisë nga Gjykata e Apelit.

Fjalë kyçe: reformation in pejus, gjykimi i shkurtuar, vendim pafajësie

Rrethanat e çështjes:

Mbi bazën e kallëzimit penal datë 05.09.2011 të shtetasve, Dh. e K.N., S. e H.D.,

A.R., Th.B., banorë të fshatit Dhërmi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal [...] të vitit 2011 për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Shpërdorim detyrë” parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të K.Penal. Kallëzuesit ishin vënë në dijeni se prej ZRKKP Qarkut Vlorë, mbi bazën e dokumentave arkivore të falsifikuar, i janë njohur dhe kthyer shtetasit P.B., pasuri të paluajtshme, prej 21 ha, tokë e llojit “Kullotë”, ndodhur në vendet e quajtura Dhraleo dhe Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë: [...]

[...] Shtetasi P.B., është trashëgimtar ligjor i shtetasit K.B., bazuar kjo në vendimin Nr. 1223 datë 14.05.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë i cili, pasi është vënë dijeni të faktit se gjyshi i tij, , rezulton si ish-pronar mbi një pasuri të paluajtshme të ndodhur në fshatin Dhërmi të Bashkisë Himarë, Vlorë, ka paraqitur pranë A.Q.SH. Tiranë, kërkesën për pajisje me dokumente arkivore pronësie. Me shkresën Nr.936/1 Prot., datë 1.06.2006 të A.Q.SH.Tiranë i është kthyer përgjigje kërkesës, shtetasit P.B., se në emër të shtetasit K.B., disponoheshin dokumente arkivore, gjithsej 8 fletë të nxjerra nga [...] ku midis të tjerave ishte edhe dokumenti i nxjerrë nga Fondi 409, viti 1942, dosja 94, fletët 20,21, i titulluar “Çertifikatë” sipas së cilës Kryepaqësia e Katundit Dhërmi vërteton dhe dëshmon se K.B. ka zotuar tokat e poshtë shënuar :... [...]

Me vendimin Nr.2068 datë 28.07.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur: *“Vërtetimi i faktit juridik se K.B., në vendin e quajtur Dhraleo, ka patur në pronësi një sipërfaqe toke kullotë me sipërfaqe 80 dynym, me [...] si dhe në vendin e quajtur Ajo Nikolla, një kullotë me sipërfaqe prej 130 dynym. [...] shtetasi P.B. ka paraqitur pranë ZRKKP Qarkut Vlorë, kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronës së trashëgimtarit. Kjo kërkesë është pranuar, me Nr.249 Prot., datë 26.06.2008, [...]*

Në funksion të dosjes Nr.142 datë 26.08.2008 të ZRKKP Qarkut Vlorë, me Urdhrin e Brendshëm të Drejtorit të saj, shtetasit P.P., është përcaktuar grupi i punës i përbërë prej punonjësve të kësaj zyre, juriste M.I. specialist vlerësues B.D. dhe përgjegjës grupi K.J.. Gjatë procedurës së trajtimit administrativ të kërkesës, në përgjigje të shkresave drejtuar institucioneve janë marrë përgjigjet përkatëse. [...] Grupi i punës, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur si dhe të administruar gjatë procesit administrativ, mbi bazën e akteve, të sipërcituara të ndodhura në dosjen me Nr.142, datë 26.08.2008, ka përgatitur dy vlerësime ligjore për dy pasuri lidhur me kërkesën, e konkretisht vlerësimin Nr. 413/1, Prot., datë 29.12.2008 i cili sugjeronte pranimin e kërkesës, pra njohjen e të drejtës së pronësisë të shtetasit P.B. dhe kthimin e pronës prej 130.000 m² në vendin e quajtur Ajo Nikolla, Dhërmi, si dhe vlerësimin ligjor NE414/1 Prot., datë 29.12.2008. i cili sugjeronte pranimin e kërkesës, pra njohjen e të drejtës së pronësisë të shtetasit P.B. dhe kthimin e pronës prej 80.000 m² në vendin e quajtur Dhraleo, Dhërmi.

Raportet e vlerësimit rezultojnë të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar prej juristes M.I. dhe inxhinier B.D. dhe janë këqyruar dhe pranuar prej shtetasit K.J në cilësinë e përgjegjësit të sektorit juridik si dhe janë miratuar si përfundim prej shtetasit P.P., në cilësinë e drejtorit të Zyrës Rajonale të Kthimit të Pronave.

Me vendimin Nr.413 datë 30.12.2008. Z.R.K.K.P. e Qarkut Vlorë ka vendosur të njohë dhe të kthejë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar K.B., pronësinë mbi pyll

dhe kullotë prej 130.000 m² të ndodhur në vendin e quajtur Ajo Nikolla, Dhërmi Vlorë, [...] si dhe ka vendosur të njohë dhe të kthejë trashëgimtarëve [...] pronësinë mbi 80000 m² sipërfaqe pyjore, në vendin e quajtur Dhraleo, Dhërmi Vlorë [...]

[...] Më shkresën me Nr. 8064/1 Prot., datë 27.12.2011 të ZVRPP Vlorë ka rezultuar se, në emër të shtetasit P.B. është regjistruar në [...] një sipërfaqe pyjore prej 80.000 m² si dhe në [...] një sipërfaqe pyjore dhe kullotë prej 130.000 m². [...]

Nga akti i ekspertimit teknik i dokumenteve, Nr. 6838, datë 19.07. 2012 të DPSH Tiranë është konkluduar se: *”Shenjat e vulave rrethore me tekste “Republika e Shqipërisë Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë” të vendosura në dokumentet objekt ekspertimi (dokumentet bashkëlidhur shkresës Nr. 936/1 datë 19.06.2006 të AQSH) dhe shenjat e vulave rrethore modele me të njëjtat tekste nuk janë formuar nga e njëjta klishe vule.*

Me vendimin e datës 12.12.2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur ndarjen e procedimit penal në, procedimin penal [...] që bën fjalë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurve P.B. e S.B. dhe në procedimin penal 1976/2012 që bën fjalë për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal në ngarkim të të pandehurve P.P., K.J. dhe M.I., dërguar për gjykim më datë 09.05.2013, i cili është dhe objekti i gjykimit. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin e saj [...] ka vendosur të *deklarojë fajtorë të pandehurën M.I.* për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe ta dënojë atë me 2 vjet burgim. [...] Të deklarojë të pafajshëm të pandehurin K.J., i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, [...] pasi nuk provohet që e ka kryer veprën për të cilën akuzohet. Të deklarojë të pafajshëm të pandehurin P.P., i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, [...], pasi nuk provohet që e ka kryer veprën për të cilën akuzohet. Të sekuestrohet dhe të kalojë në favor të shtetit sipërfaqe prej 85 mijë m² të ndodhur në vendin Mursia të fshatit Palasë për të cilin me vendimin nr. 261, dt.28.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është marrë vendimi i sekuestros preventive. [...]

Gjykata e Apelit Vlorë [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e akteve për rigjykim po në atë gjykatë me tjetër trup gjykues me arsyetimin se vendimi i gjykatës bie ndesh me dispozitat ligjore që përcaktojnë rregullat për arsyetimin e vendimit, nenit 383 dhe 380 të KPP dhe për këtë shkak vendimi është i pavlefshëm.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë [...] ka vendosur të **deklarojë të pafajshëm të pandehurin K.J, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, [...]. Të deklarojë fajtorë të pandehurën M.I. për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, dhe [...]** e dënon me 2 (dy) vjet burgim. [...]

Gjykata e Apelit Vlorë [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë sa i përket disponimit në lidhje me të pandehurën M.I.. Ndryshimin e këtij vendimi sa i përket disponimit në lidhje me të pandehurin K.J. si më poshtë: Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim

i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe dënimin e tij me dy vjet e gjashtë muaj burgim. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

[..] Kolegji [..] vlerëson se rekursi, nga kërkuesit M.I. dhe K.J. [..] rezulton që të ketë shkaqe për çënimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

[..] Në shqyrtimin e shkaqeve të ngritura në rekurs nga e gjykuara M.K., Kolegji Penal nuk i hyn çështjes së interpretimit të faktit e provës të bëra nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit, por si gjykatë ligji kontrollon zbatimin korrekt të ligjit dhe nën këndvështrimin kushtetues të zbatimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në mënyrën sesi gjykatat më poshtë i kanë dhënë përgjigje apo kanë shqyrtuar pretendimet e paraqitura në ankim. [..] Nisur nga pretendimi për shkelje kushtetuese të procesit të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Apelit, Kolegji Penal këtë pretendim do ta shqyrtojë së bashku me pretendimet e paraqitura si shkak rekursi pasi është në funksionin e Gjykatës së Lartë që si gjykatë ligji në të njëjtën kohë të bëjë dhe kontrollin e respektimit kushtetues të standardeve të procesit të rregullt ligjor, të së drejtës së mbrojtjes e aksesit në gjykim. **Përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehet mbi to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit, duke moslejuar një proces të parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, e duke ushtruar funksionin e saj kontrollues për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta.**Për sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ për procesin e rregullt ligjor me pasojë shkelje të rënda procedurale pasi mungesa e ekzaminimit dhe e vlerësimit të provave që sjell çënimin e rëndë të të gjithë procesit penal të zhvilluar ndaj të pandehurit, sepse vendimet e kundërshtuara nuk përmbushin standardet e kërkuara, Kolegji Penal shqyrton vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit në raport me përmbushjen e detyrimit për shqyrtimin e ankimit dhe arsyetimin e vendimit. Duke konstatuar se, gjykimi është zhvilluar në kushtet e gjykimit të shkurtuar dhe përsëritja e gjykimit në Apel është bërë vetëm për akuzën në ngarkim të të pandehurit K.J., Kolegji Penal e analizon pretendimin e të gjykuarës M.I. së bashku me shkakun e ngritur në rekurs nga i gjykuari K.J. për zbatim të gabuar të ligjit procedural penal e konkretisht të nenit 427/4 të KPP. Në lidhje me pretendimet e tjera të të gjykuarës M.I., Kolegji vlerëson se, ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, dhe duke qenë se kjo e pandehur ka kërkuar zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, i ka pranuar ato në gjëndjen që janë aktet megjithëse nuk ka pranuar fajësinë.

Në lidhje me prezumimin e njohjes së ligjit, Kolegji vlerëson se, nuk ka vënd për njehsimin e praktikës gjyqësore për shkak se ligji material dhe procedural penale është i qartë. Pretendimi i mosnjohjes së ligjit, është një pretendim i cili rezulton i papabuar. E gjykuara në funksionin që ka kryer është emëruar sipas ligjit, dhe është ajo vetë që ka marrë përsipër ushtrimin e asaj detyre.

Në lidhje me pyetjen që pretendon mbrojtja e të pandehurës M.I. për tu zgjidhur në vendimin për njehsimin e praktikës gjyqësore se :

-A duhet të gjykohet dhe dënohet personi që shpërdoron detyrën për çdo episod të kundraliqshëm të kryer gjatë ushtrimit të detyrës për më tepër kur janë kryer veprime të së njëjtës natyrë apo do gjykohet vetëm një herë.

Përsa i përket, pretendimit për bashkimin e çështjeve për këtë të pandehur Kolegji konstaton se, kjo është në vlerësimin e gjykatave të faktit nëse janë kushtet për bashkimin e procedimeve duke vlerësuar nëse veprimet e të pandehurës karakterizohen nga një unitet veprimesh të tilla në kuadër të moskryerjes së detyrave të saj ligjore, në lidhje me raste të ndryshme për verifikimin e dokumentacioneve për regjistrimin e pronave.

[..] Kolegji vlerëson se, procedimet ndaj të pandehurës kanë filluar në kohë të ndryshme dhe për çështje të ndryshme, megjithëse në thelb kanë patur të njëjtën akuzë atë të shpërdorimit të detyrës në institucionin që kjo shtetase ka ushtruar detyrën e saj. Është në të drejtën e të pandehurës që pretendime të tilla t'i parashtrojë para prokurorit ose gjykatës për bashkimin e çështjeve, por duke plotësuar kushtin që çështja të jetë në të njëjtën gjendje dhe shkallë gjykimi. Edhe ky fakt është i lidhur me mundësinë që ka organi procedues që këto gjykimi të ecin paralelisht, dhe të mos pengohet shpejtësia e zgjidhjes së tyre. Gjykata e Lartë, pa i hyrë analizës së provave, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore dhe pretendimeve të parashtruara në rekurs evidenton nëse nga gjykatat e faktit janë lejuar ose jo shkelje të normave procedurale dhe nëse ligji material është respektuar ose jo. Në varësi të zgjidhjes së këtyre çështjeve nga gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë, në realizim të funksionit të saj, shprehet për bazueshmërinë ose jo në ligj të vendimeve të gjykatave të faktit.

Për sa i përket rekursit të parqitur nga i gjykuari K.J., në themel të pretendimeve, qëndron fakti që Gjykata e Apelit Vlorë, ka deklaruar fajtor kërkuesin, mbi të njëjtat fakte dhe prova, në bazë të së cilave ai është deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë duke keqinterpretuar nenet 427/4 dhe 403- 404 të KPP. Kërkuesi pretendon se, Gjykata e Apelit ka shkelur ligjin procedural penal, pasi ka bërë një vlerësim të kundërt të fakteve dhe provave nga gjykata e shkallës së parë, në kushtet e gjykimit të shkurtuar, pa bërë shqyrtim gjyqsor duke e deklaruar atë fajtor.

Gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, pra është zhvilluar gjykim mbi bazë aktesh. Në lidhje me ritin e gjykimit, kërkesa është paraqitur nga të pandehurit në gjykim dhe është pranuar nga gjykata, pasi ajo ka çmuar se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, referuar vendimit nr. 2 datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [..]

Në lidhje me këtë shkak të rekursit, Kolegji Penal konstaton se përpara Gjykatës së Apelit Vlorë, Prokurori ka paraqitur kërkesën për përsëritje të shqyrtimit gjyqsor në zbatim të nenit 427 pika 4 të KPP. Gjykata e Apelit Vlorë duke vlerësuar se, veprimet e listuara nga organi i akuzës, përmbajnë elementë të figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 të K.Penal, për të cilën ai ishte akuzuar, me vendim të ndërmjetëm datë 30.10.2020, ka vendosur të zbatojë nenin 427/4 të KPP, që rregullon përsëritjen e shqyrtimit gjyqsor dhe të administrojë me cilësinë e provës të gjitha aktetet e fashikullit hetimor në ngarkim të të pandehurve. Gjykata e Apelit kreu përsëritjen e shqyrtimit gjyqsor duke administruar vetëm aktet

që gjenden në fashikull e duke vijuar po me gjykimin në kushtet e gjykimit të shkurtuar pa ndryshuar ritin e gjykimit të shkurtuar, me qëllimin e moscënimit të së drejtës së të pandehurve për këtë lloj gjykimi. Gjykata e Apelit në shqyrtimin e çështjes, është investuar edhe nga ankimi i prokurorit, dhe si e ka zhvilluar gjykimin, ka marrë vendim duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke deklaruar fajtor edhe të pandehurin K.J.

Zbatimi në këtë mënyrë i nenit 427/4 i KPP është në interpretim të gabuar të ligjit procedural përse i përket ripësëritjes së shqyrtimit gjyqsor sipas këtij neni, në lidhje me nenet 403 e vijues të KPP, jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ në lidhje me zbatimin e parimit reformation in pejus. Për të arritur në një konkluzion të tillë Kolegji Penal vlerëson të analizojë ndryshimet e nenit 427/4 të KPP, dhe të interpretojë mënyrën e duhur të zbatimit të tij në lidhje me gjykimin e shkurtuar nën frymën e jurisprudencës së GJEDNJ, mbi zbatimin e parimit reformation in pejus, lidhur me të drejtën e përfitimit nga gjykimi shkurtuar. Në interpretimin e kësaj dispozite që ka të bëjë me dy institute të rëndësishme procedurale penale, do të nisët nga kritere logjike-juridike mbi interpretimin e normave procedurale penale, siç janë : interpretimi tekstual, apo literal i dispozitës ligjore, më tej nëse ky kriter nuk do të mjaftojë për kuptimin e domethënies së normës penale, Gjykata do të vijojë me interpretimin logjik, që nënkupton analizën e dispozitës mbi bazën e qëllimit praktik të saj (ratio legis); pra, në analizën që bazohet në kuptimin e normës, duke gjetur qëllimin që ajo ka ose duhet të ketë, në bazë të një krahasimi të dispozitës në raport me dispozitat e tjera në mënyrë sistematike, duke identifikuar nga sistemi juridik qëllimin e vërtetë të normës dhe rolin që ajo në rendin juridik (interpretim teleologjik) gjithnjë në interpretim pajtues me normën ndërkombëtare e frymën e jurisprudencës së GJEDNJ.

Sipas nenit 404 të KPP, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr.35/2017 datë 30.03.2017, por edhe pas këtyre ndryshimeve, sipas nenit 405 pika 6, gjykimi i shkurtuar mund të zhvillohet vetëm mbi kërkesën e të pandehurit dhe vetëm atëherë kur gjykata çmon se, çështja mund të zgjidhet në gjëndjen që janë aktet. Tashmë jurisprudenca e konsoliduar gjyqësore është e qartë se ky rit i posaçëm gjykimi është parashikuar në ligj dhe aplikohet në ato raste kur marrja, dëgjimi dhe administrimi i provave sipas ritit normal të gjykimit, është formal, pasi palët nuk kanë kontestime mbi mënyrën e marrjes së tyre, mbi vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e akteve procedurale dhe provave dhe për efekt të ekonomisë gjyqësore, shmanget procedura normale e hetimit gjyqësor. Këtij gjykimi, në dallim nga gjykimi i zakonshëm, i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Si benefit të kësaj ekonomie gjyqësore, ligji ka parashikuar uljen e dënimit për të pandehurin me 1/3 në rast se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ai deklarohet fajtor. Në nenin 403 të KPP nën titullin “Kërkesa për gjykimin e shkurtuar” parashikohet shprehimisht [...] ndërsa në nenin 405 pika 5, 6, 7 dhe 8 të KPP nën titullin “Seanca e gjykimit të shkurtuar” parashikohet shprehimisht [...] Disa nga veçoritë/elementet e “gjykimit të shkurtuar” që janë vënë në dukje në vendimin unifikues Nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: [...]Gjykata çmon, gjithashtu, se në pranimin e kërkesës për gjykim

të shkurtuar gjykata është e detyruar të mbajë në konsideratë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka marrë në analizë institutin e gjykimit të shkurtuar.

Kështu, në vendimin Nr. 4, datë 10.02.2012 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet se [...] Sipas nenit 427 të KPP, [...] pika 4, [...] Sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr.35/2017, datë 30.03.2017, pika 3 dhe 7, [...] Bazuar në analizën e këtyre dispozitave, por edhe në parimin tashmë të konsoliduar të jurisprudencës gjyqësore, normat e reja procedurale gjejnë zbatim në çastin e hyrjes në fuqi të tyre, duke u zbatuar në atë gjëndje të procedimit penal, pavarësisht nisjes së këtij të fundit përpara ndryshimeve.

Sipas dispozitave procedurale, roli i gjykatës së apelit është ai kontrollues në raport me vendimarrjen e gjykatave të shkallës së parë dhe ky kontroll lidhet si me zbatimin e drejtë të normave procedurale në lidhje me respektimin e garancive procedurale, me hetimin gjyqësor, me mënyrën e administrimit dhe vlerësimit të provave, ashtu edhe me zbatimin e drejtë të ligjit material, në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të procedimit penal, fajësinë e të pandehurit si dhe cilësimin juridik të veprës penale, apo pafajësinë e tij, gjithnjë bazuar në analizën e provave të marra dhe administruara në gjykim. Ky shqyrtim duhet të bazohet brënda kufijve të përcaktuar në nenin 425 të KPP. Ndodhur përpara një vendimi gjyqësor të marrë prej gjykatës së shkallës së parë, në përfundim të gjykimit sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, në kuptim të nenit 406 të KPP dhe natyrës së këtij gjykimi, gjykata më e lartë duhet ta bazojë kontrollin e vendimit të ankimuar, së pari në kontrollin e cilësisë së akteve të procedimit penal, pra në ligjshmërinë e vendimit që ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe më tej, nëse ky vendim ka qenë i drejtë, në analizën që gjykata më e ulët i ka bërë provave dhe fakteve të provuara prej tyre në funksion të akuzës së ngritur ndaj të pandehurit, provueshmërisë së elementëve për përgjegjësi penale dhe cilësimit juridik të veprës.

Në kushtet kur nga kontrolli i cilësisë së akteve të procedimit penal, gjykata më e lartë arrin në përfundimin se me të drejtë është proceduar nga gjykata e shkallës së parë me ritin procedural të gjykimit të shkurtuar, analiza e metëjshme duhet të lidhet me analizën që gjykata më e ulët i ka bërë provave dhe fakteve të provuara prej tyre në funksion të akuzës së ngritur ndaj të pandehurit, provueshmërisë së elementëve për përgjegjësi penale dhe cilësimit juridik të veprës.

Një nga elementet e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. [...]

Duke kuptuar iniciimin e këtij ndryshimi, frymëzuar me së shumti nga jurisprudenca e GJEDNJ, gjykata e apelit çmon se një situatë e tillë, "*reformatio in pejus*" (*reformimi për keq i vendimit të pafajësisë*) duhej t'u referohej rasteve kur kërkesa e prokurorit kundër një vendimi pafajësie bazohet në motive që lidhen me vlerësimin e provave deklarative, siç parashikohet p.sh. në nenin 603 të K.Pr.Italiane ndryshuar me ligjin nr.23/2017, me këtë përmbajtje: "*Në rast apeli të paraqitur nga prokurori, kundër një vendimi pafajësie për motive lidhur me vlerësimin e provës deklarative, gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor*".

Pra, një situatë e tillë, "*reformatio in pejus*" nga gjykata më e lartë, lidhet detyrimisht me egzistencën e dy rrethanave : së pari, me kërkesën e prokurorit për vlerësim të gabuar të

provave dhe së dyti, ky vlerësim i gabuar t'i referohej jo çdo lloj prove (siç mund të jenë edhe provat materiale apo dokumentat), por provave deklarative (dëshmisë, deklarimeve të të pandehurit, ballafaqimeve) dhe jo të të gjitha këtyre provave me këtë natyrë, por të atyre që konsiderohen vendimtare ose thelbësore. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ, vlerësimi ose çmuarja mbi besueshmërinë e një dëshmitari, është një detyrë komplekse që përgjithësisht nuk mund të kryhet nëpërmjet një leximi të thjeshtë të fjalëve të shkruara.

Në çështjen "*Dan kundër Republikës së Maqedonisë*", GJEDNJ ka konstatuar [...]

Gjykimi i shkurtuar është parashikuar në ligj dhe aplikohet në ato raste kur marrja, dëgjimi dhe administrimi i provave sipas ritit normal të gjykimit, është formal, pasi palët nuk kanë kontestime mbi mënyrën e marrjes së tyre, mbi vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e akteve procedurale dhe provave dhe për efekt të ekonomisë gjyqësore, shmanget faza normale e hetimit gjyqësor. Si përfitim të kësaj ekonomie gjyqësore, ligji ka parashikuar uljen e dënimit për të pandehurin me 1/3 në rast se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i pandehuri deklarohet fajtor. Rimarrja e provave materiale apo dokumentave, tashmë sipas një procedure normale mund tu japë atyre një vlerë tjetër në kushtet e kontradiktoritetit dhe debatit gjyqësor e kjo në vëçanti nëse ka prova me dëshmitarë e në rast se diskutohet vlera e deklarimeve e dëshmitarëve të pyetur në fazën e hetimeve paraprake, të fiksuara në procesverbalet e pyetjes së tyre, nëse rimarrja e dëshmisë do të jetë e pamundur për shkak të vdekjes së dëshmitarit apo mosgjetyes së tij.

Në këtë mënyrë gjykimi në apel nënkupton një përsëritje të shqyrtimit gjyqësor pa u kushtëzuar nga riti i gjykimit të shkurtuar. Sipas Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 2 datë 29.01.2003, këtij gjykimi në dallim nga gjykimi i zakonshëm i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. [...]

Detyrimi i përcaktuar në nenin 427 pika 4 ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.03.2017, për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor, edhe kur procedimi është me gjykim të shkurtuar ka qënë i drejtë, nuk nënkupton cënimin e qëllimit të këtij riti të posaçëm gjyqësor, por përmbushjen e detyrimit për gjykim të drejtë që në rast të rëndimit të pozitës së personit shkon drejt ritit normal që konsiston në marrjen dhe dëgjimin e drejtpërdrejtë të provave nga gjykata e apelit. Bazuar në unifikimin e mësipërm, krijohet idea se gjykata e apelit do të ndodhet përpara dy alternativave, ose të konsiderojë të ligjshëm gjykimin e shkurtuar dhe për rrjedhojë të ketë pamundësi të procedojë me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, ose të prishë vendimin e asaj gjykate për gjykimin e shkurtuar, për t'i hapur rrugë mundësisë për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Për rrjedhojë, në cënimin e garancisë së fituar nga i pandehuri për të përfituar uljen e dënimit, megjithëse kërkesa e tij ka qënë e bazuar dhe me të drejtë është çmuar zhvillimi i gjykimit të shkurtuar.

Për shkak të vendimmarrjes së gabuar të gjykatës së shkallës së parë në analizën tërësore të provave dhe fuqisë provuese të tyre, të fakteve dhe dispozitave materiale penale duke e deklaruar të pandehurin të pafajshëm, ky i fundit privohet nga një e drejtë e tillë e fituar, duke u vënë në pozitë të pabarabartë me subjekte të tjerë që, në përfundim të procedimit penal do të deklarohen fajtorë mbi bazën e një vendimmarrje të drejtë të të dy gjykatave, të shkallës së parë dhe të apelit. Detyrimi i përcaktuar në nenin 427 pika 4 ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.03.2017, për të përsëritur shqyrtimin

gjyqësor në rastet kur çështja në shkallë të parë është shqyrtuar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, do të zbatohet drejt nëse do të përsëritej ky shqyrtim për marrjen e provave të reja, qoftë mbi kërkesën e prokurorit si subjekti ankues, qoftë edhe kryesisht nga gjykata e apelit, por gjithnjë pa cënuar rregullshmërinë e procesit të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë dhe për rrjedhojë, të beneficitet të përfutur prej të pandehurit.

Në këtë rast rregullimi i ri në nenin 427 të KPP, lë pa efekt pjesën e vendimit unifikues në rast se, Gjykata e Apelit kryesisht apo mbi bazë të kërkesës së palëve përsërit shqyrtimin e gjyqsor të çështjes. Interpretimi në këtë mënyrë dhe zbatimi në këtë mënyrë interpretimi i nenit 427 pika 4 ndryshuar me ligjin nr.35/2017, datë 30.03.2017, do ishte në përputhje me parimin kushtetues të barazisë së shtetasve përpara ligjit edhe për faktin se, pikërisht për shkak të vendimmarrjes së gabuar të Gjykatës së shkallës së parë në vlerësimin e provave dhe zbatimin e ligjit për pafajësinë e të pandehurit, ky i fundit ekspozohet nga rreziku i zhvillimit të gjykimit në shkallë të dytë sipas rritit normal të gjykimit, duke shkelur pritshmëritë e tij për një kohëzgjatje të arsyeshme të procesit dhe kosto financiare shtesë për të, në raport me po atë kategori subjektesh që janë proceduar me gjykim të shkurtuar dhe dënuar si rrjedhojë e një vendimmarrje të drejtë të gjykatës së shkallës së parë të cilët përfitojnë këto garanci – kohëzgjatje të arsyeshme dhe kosto të ulët financiare.

Ligji procedural i ka njohur të drejtën të pandehurit dhe ekskluzivisht vetëm atij, të drejtën për të vendosur të gjykohej sipas këtij rriti të posaçëm, pikërisht bazuar në këto pritshmëri, ai i gjykimit brënda një kohëzgjatje sa më të shkurtër të procesit dhe me kosto financiare sa më të ulët. Të transformosh në “normale” atë që të pandehurit i është njohur si e drejtë, duke vendosur të përcaktohet në të “shkurtuar”, aq më tepër në fazën e apelit, është në kundërshtim me vetë qëllimin e këtij gjykimi të posaçëm dhe të drejtën e mbrojtjes se të pandehurit. Kjo situatë riskon të ndodhë edhe në rastet e gjykimit me marrëveshje, ku gjykata e shkallës së parë mund të deklarojë të pafajshëm të pandehurin, për shkak të interpretimit të ndryshëm të ligjit penal dhe gjykata e apelit do të jetë e detyruar të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, pavarësisht vullnetit të qartë të të pandehurit për të pranuar fajësinë dhe dënimin e caktuar me marrëveshje.

Formulimi i nenit 427 pika 4 ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.03.2017, duhet interpretuar nën frymën e jurisprudencës së GEDNJ në lidhje me kriteret që duhet të zbatohen në rastin e “*riformatio in pejus*” të vendimit të pafajësisë nga gjykata më e lartë, si një garanci në favor të të pandehurit dhe respektimin e parimit për një proces të drejtë dhe të rregullt.

[..] Më herët Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.6, datë 15.01.2021, ka theksuar [..] çështja *Loreface v. Italia* (aplikimi nr. 63446/13 datë 29 qershor 2017) shprehet se[..
Dan kundër Republikës së Moldavisë [..]

[..] Në çështjen *di Martino dhe Molinari kundër Italisë* GJEDNJ ka bërë vlerësimin e zbatimit të nenit 603 të KPP italiane mbi gjykimin e shkurtuar, nën frymën e zbatimit në përputhje me nenin 6/1 të KEDNJ, [..] Në gjithë jurisprudencën e GJEDNJ theksohet parimi i marrjes e dëgjimit të provave në rast se Gjykata e Apelit konfirmon akuzën pas një vendimi pafajësie. Marrja e provave në mënyrë të drejtëpërdrejtë nënkupton

shqyrtimin e tyre në procedurë gjyqore në debat, kontradiktoritet e mundësinë e kundërshtive e jo vetëm duke i administruar ato, një mënyrë procedurale kjo që nuk parashikohet në KPP.

[..] Prandaj, në rastin e interpretimit të nenit 427 të KPP, Kolegji Penal çmon t'i referohet drejtpërsëdrejti standardeve të vendosura në çështjet *Lorefice v. Italia*, *çështjen Dan kundër Republikës së Moldavisë*, çështjen di Martino dhe Molinari kundër Italisë që ka të bëjë me të drejtën e dëgjimit e marrjes së drejtpërdrejtë të provës në rastet e rëndimit të pozitës së të pandehurit "*riformatio in pejus*".

Në vijim të këtij interpretimi, Kolegji Penal vlerëson se, standarti i vendosur nga GJEDNJ-ja, në lidhje me zbatimin e parimit të "*restitutio in integrum*" është i detyrueshëm të mbahet parasysh nga gjykatat e sistemit të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë. Në analizë të argumenteve në raport me jurisprudencën e GJEDNJ, Gjykata e Apelit në rast të ndryshimit të vendimit të pafajësisë duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqor duke marrë provat në mënyrë të drejtëpërdrejtë një nga një, duke marrë prova të reja e duke dëgjuar dhe dëshmitarë, e se nuk mund të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke realizuar një vlerësim formal të ndryshëm të provave të vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe vetëm me shkakun e vendosjes së përsëritjes së shqyrtimit gjyqor, pa rivlerësuar një provë duke e rimarë atë apo me mungesën e pranimit të një prove të re. Në rastin konkret në shqyrtim, Kolegji konstaton se, Gjykata e Apelit, ka interpretuar vendimmarrjen e saj për këtë fakt, ku ndërkohë ka arsyetuar se me riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, ajo nuk ka cënur të drejtat e të pandehurve për ritin e gjykimit të shkurtuar. Por nga ana tjetër, vendimmarrja e Gjykatës së Apelit, në rastin konkret ka të bëjë me vlerësim të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, pasi nëse ajo nuk ishte e bindur në vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, duhet të kishte riçelur shqyrtimin gjyqësor dhe të kishte marrë prova që do t'i vlerësonte të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, duke ju dhënë mundësinë palëve që të debatonin në lidhje me to, pasi pozita e të pandehurit është rënduar.

Në zbatim të këtyre parimeve në çështjen konkrete Kolegji vlerëson se, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit vlerësohet prej saj rast pas rasti, në ushtrim të pushtetit të saj si gjykatë ligji dhe fakti. Gjykata e Apelit ka të drejtë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, kur çmon se kjo është e nevojshme për të krijuar bindjen mbi faktet dhe provat, por ndërkohë kjo gjykatë ka administruar pikërisht provat që janë marrë për shqyrtim në shkallë të parë. Gjykata i ka zbritur 1/3 të pandehurit, ndërkohë që i ka rënduar pozitën, duke mohuar të drejtën e dëgjimit, debatit e kundërshtimit të provave, element ky i procesit të rregullt ligjor.

Në vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë theksohet se "[..] Kjo procedurë gjithsesi është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Këiatkoxska kundër Italisë, nr. 52868/99*). Këto garanci përbëjnë aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Gjithsesi as teksti dhe as fryma

e kësaj dispozite nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë nën këndvështrimin e Konventës, kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish”.

[..] Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që Shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme kanë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet Shtetit dhe të pandehurit mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij. Procesi i çmuarjes së vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave marra gjatë gjykimi penal duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, që përbën një nga parimet bazë të sistemit akuzator. Për shkak të rëndësisë që paraqet si një parim themelor i këtij sistemi, garantimi i respektimit të këtij parimi është ngritur në nivelin kushtetues duke u parashikuar si i tillë, neni 30 i Kushtetutës së [..] Elementët përbërës të këtij parimi kushtetues përcaktohen në mënyrë më të hollësishme në nenin 4 të KPP. Në aspektin e provueshmërisë së fajësisë në lidhje me një akuzë penale, kjo dispozitë vendos standartin e të provuarit, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, që në rast se ekziston duhet të vlerësohet në favor të pandehurit, me pasojë deklarimin e tij si të pafajshëm.

Mënyra e vlerësimit të provave sipas këtij standarti dhe rëndësia që paraqet respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë gjatë gjykimit penal, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, është theksuar në vijimësi edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së), konkretisht në vendimin nr.47, datë 07.11.2011 Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar se: [..]

Parimi i prezumimit të pafajësisë, në shkallën e dytë të gjykimit, nuk mund të zbatohet i veçuar nga parimi i mosrëndimit të pozitës të të pandehurit gjatë shqyrtimit të çështjes mbi ankimin e palëve të gjykimit penal. Nevoja për harmonizimin e këtyre dy parimeve në shkallën e dytë të gjykimit duhet të jetë mbajtur parasysht nga ligjvënësi në ndryshimet e fundit të KPP në vitin 2017, kur ka parashikuar si risi në procedurën e gjykimit në shkallë të dytë, nëpërmjet një dispozite ndaluese, pamundësinë e gjykatës së apelit për të bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë, për rastin kur objekt ankimi është një vendim pafajësie.

Më konkretisht në këtë drejtim rezulton që në paragrafin 4 të nenit 427 të KPP [..] Mbi bazën e interpretimit gramatikor dhe logjik të kësaj dispozite rezulton se, gjykata penale e juridiksonit rishikues nuk mund të deklarojë fajtor të pandehurin e deklaruar si të pafajshëm nga gjykata penale e juridiksonit filestar, mbi bazën e të njëjtave fakte dhe prova, duke garantuar nëpërmjet një parashikimi të tillë respektimin e parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit.

Përkeqësimi i pozitës të të pandehurit, si rrjedhojë e një vlerësimi të ndryshëm të të njëjtave fakte dhe prova nga gjykata e rigjykimit, është trajtuar edhe në vendimin unifikues nr.2, datë 06.02.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të

cilin ndër të tjera, është theksuar se : [..]

Në përputhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes penale në shkallën e dytë të gjykimit, në nenin 427/1 të KPP [..]

Si rregull Prokurori duhet të ankimojë vendimin e ndërmjetëm për gjykimin e shkurtuar së bashku me vendimin përfundimtar, pasi në shqyrtimin e ankimit Gjykatat e Apelit duhet tu përmbahen atyre të paraqitura në ankimin e prokurorit, duke iu përmbajtur në mënyrë rigorozë kufizimeve ligjore të parashikuara për procedurën e shqyrtimit gjyqësor në shkallën e dytë të gjykimit. Mbi bazën e interpretimit sistematik të paragrafit të parë dhe të katërt të nenit 427 të KPP, si dhe nenit 426/a paragrafi i gjashtë i KPP, rezulton se në rastin e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj një vendim pafajësie, nuk mund të kërkohet fajësia e të pandehurit, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë, dhe se për të provuar fajësinë duhet të kërkohet nga pala ankimuese, jo në seancë gjyqësore, por në kërkesën ankimore apo plotësimin e saj, sipas nenit 415/2 të KPP, marrja e provave të reja apo rimarrja e provave të shqyrtuara në shkallën e parë të gjykimit.

Në mënyrë përjashtimore ligjvënësi në paragrafin e tretë të nenit 427 të KPP, ka lejuar mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, edhe kryesisht nga Gjykata e Apelit, pa kërkesë të palëve. Paragrafi 3 i nenit 427 të KPP, që parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, me kërkesë të palëve, nuk mund të interpretohet i veçuar nga paragrafi i parë i kësaj dispozite që parashikon rregullin e përgjithshëm, si dhe në kundërshtim me rregullat proceduarle të zbatueshme për gjykimin e shkurtuar.

Sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 427/1 të KPP, rezulton se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, qoftë në formën e rrimarrjes së provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë, qoftë në formën e marrjes së provave të reja, lejohet në qoftë se vlerësohet se nuk mund të merret vendim përfundimtar në gjendjen që janë aktet. Gjykimi i shkurtuar, sipas përcaktimeve të nenit 405/6 të KPP është konceptuar si një gjykim në gjendjen që janë aktet, që për më tepër sipas vendimit unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në thelb të tij si gjykim i posaçëm, ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, duke evituar marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatën lidhur me to.

Por ky këndvështrim i natyrës së gjykimit të shkurtuar lidhet me të pandehurin dhe sjelljen e tij ndaj procesit të pranimit të akteve e heqjes dorë nga të drejta për debat mbi provat duke i pranuar ato në gjendjen që janë. Interesi i drejtësisë në rast të rëndimit të prozitetës së të pandehurit në gjykimin në shkallë të dytë, nënkupton një balancim në mes të së drejtës për dëgjim të provave, debatit e kontradiktoritetit mbi to, të drejtës për të debatuar provat e reja të pakërkuara dhe së drejtës së përfitimit të gjykimit të shkurtuar me atë të dhënies së një vendimi objektiv fajësie të mbështetur në prova.

Rimarrja e provave të njëjta apo marrja e provave të reja, me kërkesë të prokurorit ose edhe kryesisht, mbi bazën e interpretimit të mësipërm, mund të bëhet në rastin e shfuqizimit të vendimit të ndërmjetëm që ka pranuar kërkesën për gjykimin e shkurtuar,

kur ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Në vendimin nr.14, datë 26.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ku është theksuar [...] Gjykata e Lartë në Vendimin Unifikues nr. 2/2003 është shprehur se; “[...] Në rast se nuk është bërë ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës të të pandehurit për gjykim të shkurtuar, gjykata e Apelit kur vlerëson së vendimi i pafajësisë nuk është i drejtë mund të përsërisë shqyrtimin gjyqsor duke marrë prova, duke i debatuar ato e dhënë mundësi të pandehurit të diskutojë mbi to, duke marrë prova të reja e në veçanti ato me dëshmitarë. Nëse nga ana e të pandehurit nuk paraqiten prova të reja dhe shqyrtimi gjyqsor i ripërsëritur mbyllet po me ato prova për të cilat ai ka kërkuar e është proceduar me gjykim të shkurtuar, të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së 1/3 së dënimit në rast të vendimit të fajësisë nga Gjykata e Apelit. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ, në çështjen *Scoppola kundër Italisë* ; [...] Në interpretim analogjik e drejta e përfitimit nga gjykimi i shkurtuar në rastet e shqyrtimit në apel e të rëndimit të pozitës së të pandehurit është në kushtet e ripërsëritjes së shqyrtimit gjyqsor duhet t’i njihet, por ripërsëritja e shqyrtimit gjyqsor duhet të bëhet e plotë, me marrje prove në mënyrë të drejtëpërdrejtë, me debat dhe jo në mënyrë formale duke mos i garantuar të pandehurit të drejtën e dëgjimit e të kundërshtimit të akuzës që në këtë rast nënkupton një cilësim tjetër ligjor që rëndon pozitën e tij.

Në të tilla kushte, në të kundërt të pretendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se nuk mund të deklarohet në shkallën e dytë të gjykimit, fajësia e të pandehurit K.J., i deklaruar si i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të të njëjtave prova të marra sipas gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e të një përsëritje të shqyrtimit formal, nëpërmjet një procedure të ashtuquajtur “*të administrimit të provave shkresore*”, që është një rudiment procedural që nuk njihet në frymën e legjislationit tonë të ri procedural.

Kolegji Penal si përfundim konkludon se, rekursi gjendet i mbështetur në bazë të nenit 432 paragrafi 1 shkronja a) dhe në bazë të nenit 441 paragrafi 1 shkronja c), Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë duhet prishur, duke u rikthyer çështja për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues me qëllimin që në rigjykim, Gjykata e Apelit të shqyrtojë e tu japë përgjigje kërkesave procedurale të të pandehurve si dhe të zbatojë në këtë mënyrë interpretimin e nenit 427/4 i KPP.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2021-945, datë 18.11.2021

KPGJL Vendim Nr.00-2023-1078(191), datë 30.06.2023 (Mosrëndimi pozitës së të pandehurit nga gjykata rishikuese)

Gjykata penale e juridiksonit rishikues nuk mund të deklarojë fajtor për të pandehurin për të cilin gjykata gjykata penale e juridiksonit fillestar (me gjykim të shkurtuar të kërkuar nga i pandehuri) kishte pushuar çështjen, mbi bazën e të njëjtave fakte dhe prova, duke garantuar në këtë rast respektimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit

Fjalë kyçe: reformation in pejus, gjykimi i shkurtuar, pushim çështje penale

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të procedimit penal nr. 3683, viti 2016, ka paraqitur për gjykim, [...] të pandehurin S.V., nën akuzën “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i K.Penal.

Gjykatat e faktit, në gjykimin e çështjes me procedurën e gjykimit të shkurtuar, kanë pranuar këto rrethana të çështjes: Në datën 30.04.2016 rreth orës 04:45, Shërbimet e Policisë Rrugore Tiranë kanë ndaluar në rrugën [...], mjetin tip [...], me drejtues mjeti të pandehurin S.V.

[...] Sipas procesverbalit të datës 30.04.2016 “Mbi verifikimin me drager alkooli”, shtetasi S.V., si drejtues i automjetit tip [...], i është nënshtruar testit të matjes së alkoolit me aparatit drager dhe ka rezultuar se, nga testi i parë se kishte përdorur alkool në masën 0.58 mg/l dhe në testin e dytë 0.57 mg/l.

Referuar procesverbalit të datës 30.04.2016, punonjësit e policisë kanë dokumentuar kapjen në flagrancë të shtetasit S.V., i cili drejtonte automjetin, nën efektin e pijeve alkoolike. [...] I pyetur në fazën e hetimeve paraprake, personi nën hetim S.V. ka dhënë shpjegime lidhur me rrethanat e ngjarjes, duke sqaruar se ditën e ngjarjes nuk kishte konsumuar pije alkoolike dhe se ishte duke shkuar për në shtëpinë e tij; I pandehuri ka deklaruar se e ka kundërshtuar edhe rezultatin e testit të alkoolit që i ishte kryer.

Mbi kërkesën e mbrojtësit të personit nën hetim, në datë 30.4.2016, ora 04.51, pasi ka dalë nga dhomat e paraburgimit, është kryer analiza mjekësore që tregon përmbajtjen e alkoolit në gjak, në laboratorin Intermedika;

[...] Prokuroria [...], në datë 28.7.2016 ka bërë njoftimin e akuzës duke e marrë të pandehur shtetasin S.V., për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal; procedimi është zhvilluar me masën e sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, bazuar nënenin 234 të KPP.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit, i akuzuar për kryerjen e veprës penale [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur ndryshimin e vendimit gjyqësor [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të KPP i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 1 (një) muaj burgim. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji [...] vlerëson se pretendimet e ngritura në rekurs i referohen shkaqeve të rekursit të parashikuara nga 432 i KPP. Pavarësisht se Kolegji Penal nuk i hyn vlerësimit të provave në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi i çështjes referuar shkaqeve të rekursit të paraqitur nga kërkuesit S.V., rezulton që të ketë shkaqe për cënimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. [...]

Për sa i përket rekursit të paraqitur nga i gjykuari S.V., i cili në themel të pretendimeve të tij, parashtron se Gjykata e Apelit Tiranë ka deklaruar fajtor kërkuesin, mbi të njëjtat fakte dhe prova, në bazë të së cilave ai është deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë, duke keqinterpretuar nenin 427/4 dhe 403- 404 të KPP. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit ka shkëlur ligjin procedural penal, pasi ka bërë një vlerësim të kundërt të fakteve dhe provave nga gjykata e shkallës së parë, në kushtet e gjykimit të shkurtuar, pa bërë shqyrtim gjyqësor duke e deklaruar atë fajtor.

Kolegji konstaton se, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, pra është zhvilluar gjykim mbi bazën e akteve të ndodhura në fashikullin e prokurorit. Në lidhje me ritin e gjykimit, kërkesa është paraqitur nga i pandehuri në gjykim dhe është pranuar nga gjykata, pasi ajo ka çmuar që çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet; referuar vendimit nr. 2 datë 29. 01. 2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: “[..]

Në lidhje me këtë shkak të rekursit, Kolegji konstaton se përpara Gjykatës së Apelit, Prokurori, i cili ka ushtruar ankim në apel nuk ka paraqitur kërkesë për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor, sipas nenit 427 pika “4” e KPP; gjykata me vendim të ndërmjetëm ka vendosur të zbatojë nenin 427/4 të KPP, që parashikon përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të administarojë me cilësinë e provës aktet e fashikullit hetimor nr. 3683, në ngarkim të të pandehurit. Gjykata e Apelit kreu përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor duke administruar vetëm aktet që gjenden në fashikull e duke vijuar po me gjykimin në kushtet e gjykimit të shkurtuar pa ndryshuar ritin e gjykimit të shkurtuar, me qëllimin e moscënimit të së drejtës së të pandehurit për këtë lloj gjykimi. Gjykata e Apelit në shqyrtim të çështjes, investuar edhe nga ankimi i prokurorit, pasi ka zhvilluar gjykimin, ka marrë vendim duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke deklaruar fajtor të pandehurin S.V..

Zbatimi në këtë mënyrë i nenit 427/4 i KPP është në interpretim të gabuar të ligjit procedural përsa i përket ripërsëritjes së shqyrtimit gjyqësor sipas këtij neni, në lidhje me nenet 403 e vijues të KPP, jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese dhe atë GJEDNJ në lidhje me zbatimin e parimit *reformation in pejus*. Për të arritur në një konkluzion të tillë Kolegji vlerëson të analizojë ndryshimet e nenit 427/4 të KPP dhe të interpretojë mënyrën e duhur të zbatimit të tij në lidhje me gjykimin e shkurtuar nën frymën e jurisprudencës së GJEDNJ mbi zbatimin e parimit *reformation in pejus*, lidhur me të drejtën e përfitimit nga gjykimi shkurtuar. Në interpretimin e kësaj dispozite që ka të bëjë me dy insitute të rëndësishme procedurale penale, do të niset nga kriteret logjike-juridike mbi interpretimin e normave procedurale penale, siç janë: interpretimi tekstual, apo literal i dispozitës ligjore, më tej nëse ky kriter nuk do të mjaftojë për kuptimin e domethënies së normës penale, Gjykata do të vijojë me interpretimin logjik, që nënkupton analizën e dispozitës mbi bazën e qëllimit praktik të saj (*ratio legis*); pra, në analizën që bazohet në kuptimin e normës, duke gjetur qëllimin që ajo ka ose duhet të ketë, në bazë të një krahasimi të dispozitës në raport me dispozitat e tjera në mënyrë sistematike, duke identifikuar nga sistemi juridik qëllimin e vërtetë të normës dhe rolin që ajo në rendin juridik (*interpretim teleologjik*) gjithnjë në interpretim pajtues me

normën ndërkombëtare e frymen e jurisprudencës së GJEDNJ.

Sipas nenit 404 te KPP, perpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr.35/2017, datë 30.3.2017, por edhe pas këtyre ndryshimeve, sipas nenit 405 pika "6", gjykimi i shkurtuar mund të zhvillohet vetëm mbi kërkesën e të pandehurit dhe vetëm atëhere kur gjykata çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Tashmë jurisprudenca e konsoliduar gjyqësore është e qartë se ky rit i posaçëm gjykimi është parashikuar në ligj dhe aplikohet në ato raste kur marrja, dëgjimi dhe administrimi i provave sipas rritit normal të gjykimit, është formal, pasi palët nuk kanë kontestime mbi mënyren e marrjes së tyre, mbi vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e akteve procedurale dhe provave dhe për efekt të ekonomisë gjyqësore, shmanget procedura normale e hetimit gjyqësor. Këtij gjykimi, në dallim nga gjykimi i zakonshem, i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Si benefic të kësaj ekonomie gjyqësore, ligji ka parashikuar uljen e dënimit për të pandehurin me 1/3 në rast se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ai deklarohet fajtor.

Në nenin 403 të KPP nën titullin "Kërkesa për gjykimin e shkurtuar" parashikohet shprehimisht [...] ndërsa në nenin 405 pika 5, 6, 7 dhe 8 të KPP nën titullin "Seanca e gjykimit të shkurtuar" parashikohet shprehimisht se: [...]

[...] Kështu, në vendimin Nr. 4, datë 10.02.2012 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet se: [...] Sipas nenit 427 te KPP, të ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.3.2017, pika "4" [...] Sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr.35/2017, datë 30.3.2017, pika 3 dhe 7, [...] Bazuar në analizën e këtyre dispozitave, por edhe në parimin tashmë të konsoliduar të jurisprudences gjyqësore, normat e reja procedurale gjejnë zbatim në çastin e hyrjes në fuqi të tyre, duke u zbatuar në atë gjendje të procedimit penal, pavarësisht nisjes së këtij të fundit përpara ndryshimeve.

Sipas dispozitave procedurale, roli i gjykates se apelit është ai kontrollues në raport me vendimmarrjen e gjykatave të shkallës së parë dhe ky kontroll lidhet si me zbatimin e drejtë të normave procedurale në lidhje me respektimin e garancive procedurale, me hetimin gjyqësor, me mënyren e administrimit dhe vlerësimin të provave, ashtu edhe me zbatimin e drejtë të ligjit material, në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të procedimit penal, fajësinë e të pandehurit si dhe cilësimin juridik të veprës penale, apo pafajësinë e tij, gjithnjë bazuar në analizen e provave të marra dhe administruara në gjykim. Ky shqyrtim duhet të bazohet brenda kufijve të përcaktuar në nenin 425 të KPP. Ndoshtu përpara një vendimi gjyqësor të marrë prej gjykatës së shkallës së parë, në përfundim të gjykimit sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, në kuptim të nenit 406 të KPP dhe natyrës së këtij gjykimi, gjykata më e lartë duhet ta bazojë kontrollin e vendimit të ankimuar, së pari në kontrollin e cilësisë së akteve të procedimit penal, pra në ligjshmerinë e vendimit që ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe me tej, nëse ky vendim ka qenë i drejtë, në analizën që gjykata më e ulët i ka bërë provave dhe fakteve të provuara prej tyre në funksion të akuzës së ngritur ndaj të pandehurit, provueshmerisë së elementeve për përgjegjësi penale dhe cilësimit juridik të veprës.

Në kushtet kur nga kontrolli i cilësisë së akteve të procedimit penal, gjykata më e lartë arrin në përfundimin se me të drejtë është proceduar nga gjykata e shkallës së

parë me ritin procedural të gjykimit të shkurtuar, analiza e mëtejshme duhet të lidhet me analizën që gjykata më e ulët i ka bërë provave dhe fakteve të provuara prej tyre në funksion të akuzës së ngritur ndaj të pandehurit, provueshmërisë së elementeve për përgjegjesi penale dhe cilësimit juridik të veprës.

Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutes dhe neni 6 i KEDNJ është gjykimi i çeshtjes nga një gjykate e paanshme. [...] Duke kuptuar inicimin e këtij ndryshimi, frymëzuar më së shumti nga jurisprudenca e GJEDNJ, gjykata e apelit çmon se një situatë e tillë, “*reformatio in pejus*” (*reformimi për keq i vendimit të pafajësisë*) duhet t’u referohej rasteve kur kërkesa e prokurorit kundër një vendimi pafajësie bazohet në motive që lidhen me vlerësimin e provave deklarative, [...] Pra, një situatë e tillë, “*reformatio in pejus*” nga gjykata më e lartë, lidhet detyrimisht me egzistencën e dy rrethanave: së pari, me kërkesën e prokurorit për vlerësim të gabuar të provave dhe se dyti, ky vlerësim i gabuar t’i referohej jo çdo lloj prove (siç mund të jenë edhe provat materiale apo dokumentat), por provave deklarative (dëshmitë, deklarimeve të të pandehurit, ballafaqimeve) dhe jo të gjitha këtyre provave me këtë natyrë por të atyre që konsiderohen vendimtare ose thelbësore. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ, vlerësimi ose çmuarja mbi besueshmërinë e një dëshmitari, është një detyrë komplekse që përgjithësisht nuk mund të kryhet nëpërmjet një leximi të thjeshtë të fjalëve të shkruara.

Në çështjen “*Dan kundër Republikës së Maqedonisë*”, GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ, pasi dënimi i ardhur si pasojë e gjykimit në apel, ishte vendosur pa rimarrë ato prova deklarative, të deklaruara thelbësore. Vlerësimi thjesht kartolar i këtyre provave, u quajt nga kjo gjykate, si absolutisht e pavlefshme për të garantuar një proces të rregullt ligjor, duke konsideruar kompleksitetin dhe delikatesën e gjykimit mbi bazueshmërinë e këtyre provave, që bëhet i mundur nga garancia e oralitetit që karakterizon procesin penal akuzator. [...]

[...] Rimarrja e provave materiale apo dokumentave, tashmë sipas një procedure normale mund t’u japë atyre një vlerë tjetër në kushtet e kontradiktoritetit dhe debatit gjyqësor e kjo në veçanti nëse ka prova me dëshmitarë e në rast se diskutohet vlera e deklarimeve e dëshmitareve të pyetur në fazën e hetimeve paraprake, të fiksuara në procesverbalet e pyetjes se tyre, nëse rimarrja e dëshmisë do të jetë e pamundur për shkak të vdekjes së dëshmitarit apo mosgjatjes së tij.

Në këtë mënyrë gjykimi në apel nënkupton një përsëritje të shqyrtimit gjyqësor pa u kushtëzuar nga riti i gjykimit të shkurtuar. Sipas vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 2 datë 29.1.2003, këtij gjykimi në dallim nga gjykimi i zakonshëm i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmerinë e tyre. Sipas Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, të sipërcituar: [...]

Detyrimi i përcaktuar në nenin 427 pika 4 ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.3.2017, për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor, edhe kur procedimi me gjykim të shkurtuar ka qenë i drejtë, nuk nënkupton cenimin e qëllimit të këtij riti të posaçëm gjyqësor, por përmbushjen e detyrimit për gjykim të drejtë që në rast të rëndimit të pozitës së personit shkon drejt drejt rrit normal që konsiston në marrjen dhe dëgjimin e drejtëpërdrejtë të provave nga gjykata e apelit. Bazuar në unifikimin e mësipërm, krijohet

idea se gjykata e apelit do të ndodhet përpara dy alternativave, ose të konsiderojë të ligjshëm gjykimin e shkurtuar dhe për rrjedhojë të ketë pamundësi të procedojë me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, ose të prishë vendimin e asaj gjykate për gjykimin e shkurtuar, për t'i hapur rrugë mundësisë për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Për rrjedhojë, në cenimin e garancisë së fituar nga i pandehuri për të përfituar uljen e denimit, megjithëse kërkesa e tij ka qenë e bazuar dhe me të drejtë është çmuar zhvillimi i gjykimit të shkurtuar. Detyrimi i percaktuar në nenin 427 pika “4” ndryshuar me ligjin nr.35/2017 date 30.3.2017, për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor në rastet kur çështja në shkallë të parë është shqyrtuar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, do të zbatohet drejt nëse do të përsëritej ky shqyrtim për marrjen e provave të reja, qoftë mbi kërkesen e prokurorit si subjekti ankues, qoftë edhe kryesisht nga gjykata e apelit, por gjithnjë pa cenuar rregullshmërinë e procesit të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë dhe për rrjedhojë, të beneficitet të përfituar prej të pandehurit.

Në këtë rast rregullimi i ri në nenin 427 të KPP, lë pa efekt pjesën e vendimit unifikues në rast se Gjykata e Apelit, kryesisht apo mbi bazë të kërkesës së palëve, përsërit shqyrtimin e gjyqësor të çështjes. Interpretimi në këtë mënyrë dhe zbatimi në këtë mënyrë interpretimi i nenit 427 pika “4” ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.3.2017, do ishte në përputhje me parimin kushtetues të barazisë së shtetasve përpara ligjit edhe për faktin se, pikërisht për shkak të vendimmarrjes së gabuar të gjykatës së shkallës së parë në vlerësimin e provave dhe zbatimin e ligjit për pafajësinë e të pandehurit, ky i fundit ekspozohet nga rreziku i zhvillimit të gjykimit në shkallë të dytë sipas rritit normal të gjykimit, duke shkelur pritshmëritë e tij për një kohezgjatje të arsyeshme të procesit dhe kosto financiare shtesë për të, në raport me po atë kategori subjektësh që janë proceduar me gjykim të shkurtuar dhe dënuar si rrjedhojë e një vendimmarrje të drejtë të gjykatës së shkallës së parë të cilët përfitojnë këto garanci – kohëzgjatje të arsyeshme dhe kosto të ulët financiare.

Ligji procedural i ka njohur të drejtën të pandehurit dhe ekskluzivisht vetëm atij, të drejtën për të vendosur të gjykohet sipas këtij riti të posaçëm, pikërisht bazuar në keto pritshmëri, ai i gjykimit brenda një kohezgjatje sa më të shkurter të procesit dhe me kosto financiare sa më të ulët. Të transformosh në “normale” atë që të pandehurit i është njohur si e drejtë, duke vendosur të përcaktohet në të “shkurtuar”, aq më tepër në fazën e apelit, është në kundërshtim me vetë qëllimin e këtij gjykimi të posaçëm dhe të drejten e mbrojtjes së të pandehurit. Kjo situatë riskon të ndodhe edhe në rastet e gjykimit me marrevëshje, ku gjykata e shkallës së parë mund të deklarojë të pafajshëm të pandehurin, për shkak të interpretimit të ndryshëm të ligjit penal dhe gjykata e apelit do të jetë e detyruar të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, pavarësisht vullnetit të qartë të të pandehurit për të pranuar fajësinë dhe dënimin e caktuar me marrevëshje. Formulimi i nenit 427 pika “4” ndryshuar me ligjin nr.35/2017, datë 30.3.2017, duhet interpretuar nën frymen e jurisprudencës së GJEDNJ në lidhje me kriteret që duhet të zbatohen në rastin e “*riformatio in pejus*” të vendimit të pafajësisë nga gjykata më e lartë, si një garanci në favor të të pandehurit dhe respektimin e parimit për një proces të drejtë dhe të rregullt.

[..] Jurisprudenca e GJEDNJ ka vënë theksin tek zbatimi i parimit të gjykimit të drejtë

në rastet e rëndimit të pozitës së të pandehurit. Në çështjen *Lorefice v. Italia* GJEDNJ shprehet se: [...] Në çështjen *Dan kundër Republikës së Moldavisë* GJEDNJ thekson se [...]

[...] Në gjithë jurisprudencën e GJEDNJ theksohet parimi i marrjes e dëgjimit të provave në rast se Gjykata e Apelit konfirmon akuzën pas një vendimi pafajësie. Marrja e provave në mënyrë të drejtëpërdrejtë nënkupton shqyrtimin e tyre në procedurë gjyqësore në debat, kontradiktoritet e mundësinë të kundërshtive e jo vetëm duke i administruar ato, një mënyrë procedurale kjo që nuk parashikohet në KPP.

[...] Prandaj, në rastin e interpretimit të nenit 427 të KPP, kolegji çmon t'i referohet drejtëpërdrejtë standardeve të vendosura në **çështjet** *Lorefice v. Italia* çështjen *Dan kundër Republikës së Moldavisë*, çështjen di Martino dhe Molinari kunër Italisë që ka të bëjë me të drejtën e dëgjimit e marrjes së drejtpoëdrejtë të provës në rastet e rëndimit të pozitës së të pandehurit "*riformatio in pejus*".

Në vijim të këtij interpretimi, Kolegji Penal vlerëson se standarti i vendosur nga GJEDNJ-ja, në lidhje me zbatimin e parimit të *restitutio in integrum* është i detyrueshëm të mbahet parasysh nga gjykatat e sistemit të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë. Në analizë të argumenteve në raport më jurisprudencën e GJEDNJ, gjykata e Apelit në rast të ndryshimit të vendimit të pafajësisë duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë provat në mënyrë të drejtëpërdrejtë një nga një, duke marrë prova të reja e duke dëgjuar dhe dëshmitarë e se nuk mund të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke realizuar një vlerësim formal e të ndryshëm të provave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë dhe vetëm me shkakun e vendosjes së përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor pa rivlerësuar një provë duke e rimarë atë apo me mungesën e pranimit të një prove të re.

Duke iu kthyer rastit konkret në shqyrtim, Kolegji konstaton se, Gjykata e Apelit Tiranë, ka interpretuar vendimmarrjen e saj për këtë fakt, ku ndërkohë ka arsyetuar se me riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, ajo nuk ka cënur të drejtën e të pandehurit për ritin e gjykimit të shkurtuar. Por nga ana tjetër, vendimarrja e Gjykatës së Apelit, në rastin konkret ka të bëjë më vlerësimin të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, pasi nëse ajo nuk ishte e bindur në vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, duhet të kishte riçelur shqyrtimin gjyqësor dhe të kishte marrë prova që do t'i vlerësonte të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, duke ju dhënë mundësinë palëve që të debatonin në lidhje me to pasi pozita e të pandehurit është rënduar.

Në zbatim të këtyre parimeve në çështjen nëngarkim të të pandehurit S.V., Kolegji vlerëson se, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit Tiranë vlerësohet prej saj rast pas rasti, në ushtrim të pushtetit të saj si gjykatë ligji dhe fakti. Gjykata e Apelit ka të drejtë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, kur çmon se kjo është e nevojshme për të krijuar bindjen mbi faktet dhe provat, por ndërkohë kjo gjykatë ka administruar pikërisht provat që janë marrë për shqyrtim në shqyrtim në shkallë të parë. Gjykata i ka zbritur 1/3 të pandehurit ndërkohë që i ka rënduar pozitën duke mohuar të drejtën e dëgjimit, debatit e kundërshtimit të provave, element ky i procesit të rregullt ligjor.

Në vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë theksohet se [...]Kjo procedurë gjithsesi është e shoqëruar me një lehtësim të garancive

procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Këiatkoxska kundër Italisë*). Këto garanci përbëjnë aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Gjithsesi as teksti dhe as fryma e kësaj dispozite nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë nën këndvështrimin e Konventës, kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish”.

Në vijim GJEDNJ-ja ka çmuar se, duke kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar, aplikanti ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga të drejtat e tij për një seancë publike, të thërrasë dëshmitarët e tij në gjykim, të paraqesë prova, në këmbim të një sërë avantazheve që atij i garantohen nga legjislati i brendshëm (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03*). [..]

Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që Shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme kanë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet Shtetit dhe të pandehurit mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij.

Procesi i çmuarjes së vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave marra gjatë gjykimi penal duhet respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, që përbën një nga parimet bazë të sistemit akuzator. Për shkak të rëndësisë që paraqet si një parim themelor i këtij sistemi, garantimi respektimit të këtij parimi është ngritur në nivelin kushtetues duke u parashikuar si i tillë neni 30 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, [..]. Elementët përbërës këtij parimi kushtetues përcaktohen në mënyrë më të hollësishme në 4 të KPP. Në aspektin e provueshmërisë fajësisë në lidhje me një akuzë penale, kjo dispozitë vendos standartin e provuarit, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, që në rast se ekziston duhet të vlerësohet në favor të pandehurit, me pasojë deklarimin e tij si të pafajshëm.

Mënyra e vlerësimit provave sipas këtij standarti dhe rëndësia që paraqet respektimi i parimit të prezumimit pafajësisë gjatë gjykimit penal, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, është theksuar në vijimësi edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së), konkretisht në vendimin nr.47, datë 07.11.2011 Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar se[..]

Parimi i prezumimit të pafajësisë, në shkallën e dytë të gjykimit, nuk mund të zbatohet i veçuar nga parimi i mosrëndimit të pozitës të të pandehurit gjatë shqyrtimit të çështjes mbi ankimin e palëve të gjykimit penal. Nevoja për harmonizimin e këtyre dy parimeve në shkallën e dytë të gjykimit duhet të jetë mbajtur parasysht nga ligjvënësi në ndryshimet e fundit të KPP në vitin 2017, kur ka parashikuar si risi në procedurën e gjykimit në shkallë të dytë, nëpërmjet një dispozite ndaluese, pamundësinë e gjykatës së apelit për të bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë, për rastin kur objekt ankimi është një vendim pafajësie.

Më konkretisht në këtë drejtim rezulton që në paragrafin 4 të nenit 427 të KPP, shtuar me ligjin nr.35/2017, të jetë përcaktuar shprehimisht [...] Përkeqësimi i pozitës të të pandehurit, si rrjedhojë e një vlerësimi të ndryshëm të njëjtave fakte dhe prova nga gjykata e rigjyqimit, është trajtuar edhe në vendimin unifikues nr.2, datë 06.02.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin ndër të tjera, është theksuar se: [...] Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 425/1 të KPP, duhet të shqyrtojë çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim dhe për rrjedhojë, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në këtë shkallë gjykimi, në parim është i lejueshëm vetëm kur kërkohet në përmbajtje të ankimit të paraqitur.

Në përputhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes penale në shkallën e dytë të gjyqimit, në nenin 427/1 të KPP, është përcaktuar më konkretisht se [...] Si rregull Prokurori duhet të ankimojë vendimin e ndërmjetëm për gjykimin e shkurtuar së bashku me vendimin përfundimtar pasi në shqyrtimin e ankimit Gjykatat e Apelit duhet tu përmbahen atyre të paraqitura në ankimin e prokurorit, duke iu përmbajtur në mënyrë rigoroze kufizimeve ligjore të parashikuara për procedurën e shqyrtimit gjyqësor në shkallën e dytë të gjyqimit. Mbi bazën e interpretimit sistematik të paragrafit të parë dhe të katërt të nenit 427 të KPP, si dhe nenit 426/a paragrafi i gjashtë i KPP, rezulton se në rastin e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj një vendim pafajësie, nuk mund të kërkohet fajësia e të pandehurit, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të provave të marra gjatë gjyqimit në shkallë të parë, dhe se për të provuar fajësinë duhet të kërkohet nga pala ankimuese, jo në seancë gjyqësore, por në kërkesën ankimore apo plotësimin e saj, sipas nenit 415/2 të KPP, marrja e provave të reja apo rimarrja e provave të shqyrtuara në shkallën e parë të gjyqimit. Në mënyrë përjashtimore ligjvënësi në paragrafin e tretë të nenit 427 të KPP, ka lejuar mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, edhe kryesisht nga Gjykata e Apelit, pa kërkesë të palëve. Paragrafi 3 i nenit 427 të KPP, që parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, me kërkesë të palëve, nuk mund të interpretohet i veçuar nga paragrafi i parë i kësaj dispozite që parashikon rregullin e përgjithshëm, si dhe në kundërshtim me rregullat proceduale të zbatueshme për gjykimin e shkurtuar.

Sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 427/1 të KPP, rezulton se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, qoftë në formën e rimarrjes së provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë, qoftë në formën e marrjes së provave të reja, lejohet në qoftë se vlerësohet se nuk mund të merret vendim përfundimtar në gjendjen që janë aktet. Gjykimi i shkurtuar, sipas përcaktimeve të nenit 405/6 të KPP është konceptuar si një gjykim në gjendjen që janë aktet, që për më tepër sipas vendimit unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në thelb të tij si gjykim i posaçëm, ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, duke evituar marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to.

Por ky këndëvshtrim i natyrës së gjyqimit të shkurtuar lidhet me të pandehurin dhe sjelljen e tij ndaj procesit pranimit të akteve e heqjes dorë nga të drejta për debat mbi provat duke i pranuar ato në gjendjen që janë. Interesi i drejtësisë në rast të rëndimit të

prozitës së të pandehurit në gjykimin në shkallë të dytë, nënkupton një balancim në mes të së drejtës për dëgjim të provave, debatit e kontradiktoritetit mbi to, të drejtës për të debatuar provat e reja të pakërkua dhe së drejtës së përfitimit të gjykimit të shkurtuar me atë dhënies së një vendimi objektiv fajësie të mbështetur në prova.

Rimarrja e provave të njëjta apo marrja e provave të reja, me kërkesë të prokurorit ose edhe kryesisht, mbi bazën e interpretimit të mësipërm, mund të bëhet në rastin e shfuqizimit të vendimit të ndërmjetëm që ka pranuar kërkesën për gjykimin e shkurtuar, kur ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Në vendimin nr.14, datë 26.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese [...] Gjykata e Lartë në vendimin Unifikues nr. 2/2003 është shprehur se [...]

Në rast se nuk është bërë ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës të të pandehurit për gjykim të shkurtuar, gjykata e Apelit kur vlerëson së vendimi i pafajësisë nuk është i drejtë mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë prova, duke i debatuar ato e dhënë mundësi të pandehurit të diskutojë mbi ro, duke marrë prova të reja e në vecanti ato me dëshmitarë. Nëse nga ana e të pandehurit nuk paraqiten prova të reja dhe shqyrtimi gjyqësor i rëpërsëritur mbyllet po me ato prova për të cilat ai ka kërkuar e është procedura me gjykim të shkurtuar, të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së 1/3 së dënimit në rat të vendimit të fajësisë nga Gjykata e Apelit. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ, në çështjen *Scoppola kundër Italisë* [...]

Në të tilla kushte, në të kundërt të pretendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se nuk mund të deklarohet në shkallën e dytë të gjykimit, fajësia e të pandehurit S.V., për të cilin është pushuar akuza nga gjykata e shkallës së parë, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të të njëjtave prova të marra, sipas gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të një përsëritje shqyrtimi formal nëpërmjet një procedure të ashtuquajtur "të administrimit të provave shkresore" që është një rudiment procedural që nuk njihet në frymën e legjislacionit tonë të ri procedural.

Sa më sipër, Kolegji Penal arrin në përfundimin se rekursi gjendet i mbështetur në bazë të nenit 432 paragrafi 1 shkronja a) dhe në bazë të nenit 441 paragrafi 1 shkronja c), vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet prishur, për zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë si një vendim i dhënë në interpretim të drejtë të tij.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2021-514, datë 12.07.2021

IV. Gjykimi në mungesë

Vendim Kolegjet e Bashkuara Nr.1, datë 01.08.2022 (Rivendosje në afat)

I gjykuari në mungesë, kur provohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dënimit, ka të drejtën të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, pavarësisht se çështja është gjykuar në gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit të një bashkëpandehuri.

Gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat vlerëson formalisht nëse shkaqet e ankimit të të gjykuarit në mungesë janë të njëjta me shkaqet jo personale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtepandehurit tjetër. Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat është shprehur më parë gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtepandehurit për shkaqe jo personale të këtij të fundit.”

Fjalë kyçe: rivendosje në afat, gjykim në mungesë, bashkëtepandehur

Rrethanat e çështjes:

Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore ka rezultuar se, kërkuesi A.M., i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me të cilin është dënuar me 25 vjet burgim. Konkretisht, me vendimin nr. 51, datë 11.12.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka vendosur *deklarimin fajtor të të pandehurit [...] për veprën penale “Vjedhja me pasojë vdekjen”, parashikuar nga nenet 141-22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit [...] për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal përfundimisht e dënon të pandehurin [...] me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dh.T për veprën penale “Vjedhje me armë” të mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 144-22 të K.Penal dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dh.T. për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. [...] përfundimisht e dënon të pandehurin Dh.T. me 8 vjet burgim”.*

Rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është marrë në mungesë të të pandehurit A.M.. Ka rezultuar se kundër vendimit ka ushtruar ankim bashkëtepandehuri Dh.T. dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, pasi ka shqyrtuar çështjen në shkallë të dytë, me vendimin nr. 15, datë 22.02.2000, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor [...]përsa i përket të pandehurit A.M.. Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor [...]përsa i përket fajësisë e kualifikimit të veprës penale të kryer nga i pandehuri Dh.T.. Ndryshimin e vendimit të mësipërm përsa i përket masës së dënimit të dhënë ndaj të pandehurit [...], duke e dënuar atë me 4 (katër) vjet burgim.” [...]*

Mbështetur në vendimin gjyqësor të formës së prerë është bërë shpallja në kërkim ndërkombëtar e të dënuarit A.M.. [...] në datën 05.07.2016 është realizuar ekstradimi nga Greqia në Shqipëri i të dënuarit A.M.

Brenda 5 ditëve nga dita e ekstradimit të tij në Shqipëri, i dënuari, [...],ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës për të ushtruar ankim kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të kësaj Gjykate [...], për

shkak të gjykimit në mungesë, duke pretenduar mospasjen dijeni për procedimin dhe vendimin gjyqësor në ngarkim të tij. Vendimi është marrë në vitin 1999, kohë kur kërkuesi pretendon se ka qenë jashtë shtetit, në Greqi, nuk ka patur asnjë lloj komunikimi me të afërmit e tij dhe nuk është vënë në dijeni për zhvillimin e këtij gjykimi dhe të vendimit të marrë ndaj tij. Në këto rrethana, ai nuk ka mundur të bëjë ankim, në Gjykatën e Apelit, kundër vendimit të Gjykatës [..].

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, [..] ka vendosur rrëzimin e kërkesës. [..] Gjykata e Apelit Gjirokastrë, [..]ka vendosur në fuqi të vendimit [..]
[..]

Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Kolegjet e Bashkuara [..] pasi morën në shqyrtim në seancë gjyqësore, në praninë e palëve, argumentet e parashtruara nga relatorët mbi nevojën e ndryshimit të vendimit njësuës penal nr.1, datë 20.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara, si dhe pasi dëgjuan opinionin e prokurorit dhe mbrojtjes që mbajtën të njëjtin qëndrim për ndryshimin e vendimit të sipërcituar, vlerësojnë se praktika njësuëse e deritanishme që, në një procedim me disa të pandehur, mohon të drejtën e të pandehurit të gjykuar në mungesë për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit, ndërkohë që çështja për pjesën që i përket këtij të pandehuri është gjykuar mbi bazën e shkaqeve të ankimit, jo personale, të parashtruara prej bashkëpandehurit tjetër, duhet të ndryshohet. [..]

Vendimet gjyqësore dhe, për më tepër, vendimet njësuëse duhet të ndryshohen vetëm për rrethana të jashtëzakonshme. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ruajtja e qëndrimeve të mbajtura në vendimet e mëparshme është në interes të stabilitetit, por edhe të legjitimitetit institucional. Nëse praktika gjyqësore e ka zbatuar për një periudhë të gjatë një normë ligjore, referuar një qëndrimi njësuës, padyshim që kjo situatë nuk mund të mos vlerësohet si një rrethanë e rëndësishme për stabilitet jurisprudencial, por, nga ana tjetër, referimi vetëm në këtë argument për të mbajtur të pandryshuar vendimin njësuës nuk do të thotë se i jepet një vlefshmëri më e lartë e aq më pak garanci të nivelit kushtetues.

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka theksuar se vendimet njësuëse kanë fuqi detyruese për zbatimin në mënyrë të njëjtë të ligjit në çështje të njëjta ose të ngjashme, ndërsa ndryshimi i kësaj praktike nga Kolegjet e Bashkuara ndodh në raste më të kufizuara që diktohen nga nevoja për zgjidhjen e drejtë të çështjes konkrete, e cila nuk është e mundur të zgjidhet në kushtet e përplasjeve të jurisprudencës me interpretimet ligjore të mëparshme të vendimeve njësuëse. Pra, janë pikërisht varësia e çështjes nga ndryshimi i praktikës njësuëse dhe nevoja për ndryshim si dy kushte paraprake që vlerëson kolegji inicues dhe më pas Kolegjet e Bashkuara për të shqyrtuar në themel kërkesën për ndryshim. Mbi ekzistencën e këtyre dy kushteve, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 15.07.2022, ka vendosur fillimin e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore në lidhje me vendimin njësuës nr. 1, datë 20.01.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Duke iu rikthyer çështjes, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se formulimi që është

kryer për çështjen e tretë të sentencës së vendimit njësues nr. 1, datë 20.01.2011, ku konkludohet se “*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtpandehuri*”, është i domosdoshëm të ndryshohet, pasi nuk përshatet me parimet ligjore, por edhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ.

Në referim të shkaqeve të parashtruara në rekurs nga kërkuesi A.M dhe të pretendimeve të parashtruara nga palët në gjykim, të cilët mbajnë qëndrimin se për zgjidhjen e çështjes duhet të ndryshohet praktika gjyqësore e njësuar vite më parë, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë të nevojshme që të mbahet parasysh kuptimi dhe zbatimi i dispozitave të KPP lidhur me institutin procedural të rivendosjes në afat. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se ligjvënësi, në funksion të realizimit të qëllimit të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të subjekteve të procedimit penal, në veçanti të të pandehurit dhe balancimit të tyre me interesin e përgjithshëm publik për një proces gjyqësor penal të karakterizuar nga objektiviteti, transparenca, ligjshmëria, ka përcaktuar në mënyrë të qartë në ligjin procedural penal afate për hartimin e akteve procedurale, të detyrueshme për t’u zbatuar si për gjykatat, ashtu edhe nga palët ndërgjyqëse në proces. Rivendosja në afat, që nënkupton kthim në momentin kur ka lindur e drejta për të përmbyshur aktin procedural, është një institut përjashtimor, i mirëpërcaktuar dhe jo i mundshëm për t’u zbatuar për çdo lloj rasti. Instituti i rivendosjes në afat ka si qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, konkretisht, garantimin e ushtrimit të së drejtës nga palët në proces për të kundërshtuar një vendim në një gjykatë më të lartë, në ato raste, të përcaktuara në ligj, kur nuk ka qenë e mundur të ushtrohet kjo e drejtë brenda afatit ligjor. Rivendosja në afat lejon palën ndërgjyqëse të ushtrojë të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykimit të çështjes në themel, pavarësisht tejkalimit të afateve, të cilat për shkak të natyrës prekluzive, me plotësimin apo kalimin e tyre, kanë çuar në dekadencë të së drejtës së saj për të ushtruar këtë ankim.

Përpara ndryshimeve ligjore të KPP të vitit 2017, instituti i rivendosjes në afat parashikohej në Titullin III, Kreu III, neni 147, sipas të cilit [...] Rastet e parashikuara nga neni 147 i KPP për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit janë të lidhura ngushtësisht me arsyet objektive që kanë penguar palën në ushtrimin efektiv të së drejtës së saj. Kështu, pika 1 e nenit 147 të KPP parashikonte “*forcën madhore*” apo “*rastin faktor*”, me cilësinë e shkaqeve, verifikimi i prezencës të secilit prej tyre, (barra e provës për të provuar këtë prezencë rëndon mbi të pandehurin), përcaktonte të drejtën për t’u rivendosur në afat të ankimit kundër një vendimi penal. Ndërsa pika 2 e nenit 147 përcaktonte si kusht për rivendosjen në afat të të drejtës së ankimit për të pandehurin, rastin e “*dhënies së vendimit në mungesë të tij*”, detyrimin e të pandehurit të gjykuar në mungesë, për të provuar padijeninë e tij lidhur me këtë vendim.

Shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ekzistencës së kushteve dhe provave mbështetëse për verifikimin e tyre bëhet nga gjykata gjatë zhvillimit të një procesi, i cili nuk është i njëjtë me gjykimin e themelit të çështjes, ku kërkuesi ka barrën për të provuar

situatën në të cilën është ndodhur, që pa fajin e tij, e ka vendosur në pamundësi absolute për të respektuar afatet procedurale. Pra, gjatë shqyrtimit të kërkesës, ligjvënësi, ka normuar të drejtën e kërkuarit për t'u rivendosur në afat, vetëm nëse ai provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2017 ([..] është shtuar një dispozitë e re, konkretisht neni 420/1, ku parashikohet se [...] Parashikimi i neni 420/1 të KPP, si një dispozitë e posaçme, në kreun e “ankimeve”, i diktuar nga standardi kushtetues dhe ai i GJEDNJ, në kuadër të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor, përcakton palët, të cilat i drejtohen gjykatës për rivendosje në afat të ankimit, afatin kohor brenda të cilës kjo kërkesë paraqitet, si dhe mjetet e ankimit në rastet e pranimit/refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat. Kjo dispozitë ka saktësuar edhe rastin se kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të neni 351 të këtij Kodi (mosparaqitja ose mungesa e vullnetshme e të pandehurit), i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

Në kuptim të kësaj dispozite, kërkesa për rivendosje në afat duhet të argumentojë se, pavarësisht se subjekti ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm, depozitimi i ankimit brenda afatit ligjor, nuk ka qenë i mundur për shkaqe që nuk vareshin prej tij. Në rast se këto shkaqe konsiderohen të ligjshme prej gjykatës që shqyrton kërkesën, ajo i mundëson palës të ushtrojë ankim, i cili duhet paraqitur bashkë me kërkesën për rivendosje në afat, duke kundërshtuar kështu vendimin dhe parashtruar shkaqet për të cilat ajo mendon se vendimi nuk është marrë në zbatim të ligjit. Ndërkohë që në pikën 2 të kësaj dispozite, parashikohet se kur gjykimi është zhvilluar në mungesë (*sipas parashikimeve të neni 351, të këtij Kodi*), i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim, kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimarrjen që ka përmbyllur këtë proces.

Përmbajtja e parashikimeve të neni 420/1 të KPP, në raport me nenin 147 të këtij Kodi, (para ndryshimeve ligjore të vitit 2017), lidhur me të drejtën për rivendosjen në afat të ankimit, përsa i përket verifikimit të kushteve të pranueshmërisë së kërkesës së palëve, të pranishme në gjykim, që kanë humbur afatin e paraqitjes së ankimit ndaj vendimit, për shkak të shfaqjes së “rastit fator” apo të prezencës së “forcës madhore”, paraqitet e njëjtë, ndërkohë që në rastin e verifikimit të kushteve të pranueshmërisë së kërkesës së paraqitur prej të pandehurit të gjykuar në mungesë, paraqitet e ndryshme. Në dispozitën para ndryshimeve ligjore (neni 147 i KPP) në paragrafin e dytë parashikohet “gjykimi në mungesë” si shkak për paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat, ndërsa sipas dispozitës së re, konkretisht, neni 420/1 të KPP, paragrafi i dytë, parashikohet “*kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të neni 351 të këtij Kodi*”. Në terma të tjera, kur gjykimi është zhvilluar në kushtet e “mungesës së vullnetshme” të të pandehurit”, e barazuar kjo “mungesë” me “praninë” sipas përcaktimit të paragrafit të tretë të neni 351 të KPP, këtij të fundit, i garantohet e drejta për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit të dhënë, në konkluzion të gjykimit, të zhvilluar në “prani” të tij (pa prezencën fizike), në kushtet kur, gjithsesi, nuk ka disponuar materialisht vendimin objekt i ankimit.

Sakaq, rastet e tjera, të mungesës së mirëfilltë të të pandehurit, për shkak të padijenisë,

(përfshirë edhe rastet e arratisjes, shmangies së qëllimshme të të pandehurit, nëpërmjet fshehjes prej pasojave të procedimit penal të regjistruar ndaj tij), të përcaktuara në nenin 352 të KPP, janë përfshirë në strukturën e nenit 450/1, shkronja “e”, në cilësinë e shkaqeve mbështetëse të kërkesës për rishikimin e vendimit të “formës së prerë”, nën statusin e “gjësë së gjykuar”. Risi e nenit 420/1 të KPP është edhe parashikimi në paragrafin e parë, i shoqërimit të kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, së bashku me ankimin, me pasojë mospranimi.

Duke ballafaquar të dy situatat procedurale të sipërcituara, në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm lidhur me kualifikimin e kërkesës objekt gjykimi, konsiderohet se gjen zbatim neni 147/2 i KPP (para ndryshimeve ligjore të vitit 2017), përsa kohë që kërkesa për rivendosje në afat të ankimit është gjykuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, në kushtet dhe mbi bazën e përcaktimeve të kësaj dispozite. Rezulton se rekursi i paraqitur prej kërkuesit pranë Gjykatës së Lartë është depozituar më datë 09.02.2017, pra përpara ndryshimeve ligjore në KPP, me ligjin nr. 35/2017. [..]

Lidhur me institutin e rivendosjes në afat, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësesues penal nr. 1, datë 20.01.2011, kanë parashtruar për shqyrtim këto pyetje [..] Lidhur me çështjen e parë të vendimit njësesues nr. 1, datë 20.01.2011, Kolegjet e Bashkuara, kanë arritur në konkluzionin se, pasi çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit apo Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit, ose mbrojtësi i tij nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të të drejtës për të ushtruar ankim apo rekurs, ndaj të njëjtit vendim të Gjykatës së Apelit apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit. Në këtë rast, Gjykata e Apelit apo Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka shqyrtuar ankimin/rekursin në themel (kontrollin e ekzistencës ose jo të shkaqeve të ankimit/rekursit). Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se, edhe pse ankimi apo rekursi i të pandehurit është shqyrtuar në themel, ankimi apo rekursi mund të jetë ushtruar nga mbrojtësi i palegjitimuar, sikurse mund të jetë mbrojtësi i caktuar nga familjarët, duke u gjendur në situatën ku i pandehuri i gjykuar në mungesë nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të të drejtës për të ushtruar ankim apo rekurs.

Kolegjet e Bashkuara sjellin në vëmendje se kjo problematikë ka gjetur trajtim më të zgjeruar dhe të qartësuar në vendimin njësesues nr. 1, datë 10.03.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku janë shtruar për zgjidhje çështjet: - [..]

Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, vendimi njësesues nr. 1, datë 20.01.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku në interpretim të çështjes së parë ka konkluduar se [..] ka humbur aktualitetin dhe efikasitetin, në kushtet kur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësesues nr. 1, datë 10.03.2014, kanë konkluduar se “[..]

Në lidhje me çështjen e dytë të vendimit njësesues nr. 1, datë 20.01.2011, ku është arritur në përfundimin se [..] Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky qëndrim është i drejtë dhe nuk bie ndesh me dispozitat procedurale penale.

Sakaq, Kolegjet e Bashkuara duke evidentuar qëndrimin e mbajtur në vendimin njësesues nr. 1, datë 10.03.2014, që përligj të drejtën e pamohueshme të të gjykuarit në

mungesë për tu rivendosur në afatin e ankimit (me përjashtim të rasteve të parashtruara në vendim), konstatonjë se në këtë vendim njësuës, Kolegjet e Bashkuara nuk janë shprehur lidhur me të drejtën e të pandehurit, që nuk ka ushtruar ankim për shkak të padijenisë (të mospjesëmarrjes në gjykim), për të rivendosur në afat të drejtën e ankimit, ndaj vendimit të gjykimit të tij në mungesë, të prekluduar për shkak të gjykimit të çështjes në apel, mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit në të njëjtin procedim.

Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se interpretimi i kryer për çështjen e tretë në vendimin njësuës nr. 1, datë 20.01.2011, nëpërmjet të cilit është konkluduar se “[..]

nuk është në harmoni me nenin 43 të Kushtetutës dhe me standardet e GJEDNJ. Referuar jurisprudencës së kësaj gjykate konsiderohet cenim i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pamundësia e personit të gjykuar në mungesë, për të ankimuar vendimin e dënimit të tij, por edhe për të garantuar të drejtën e personave të sipërcituar, për t’u dëgjuar, në të njëjtat kushte, sikurse i gjykuari i pranishëm në proces, edhe në kushtet e “investimit” të gjykatës që trajton situatën procesuale të të pandehurit, të gjykuar në mungesë, (apo që nuk ka ushtruar ankim) mbi bazën e “shtrirjes/zgjerimit të ankimit të papersonalizuar të paraqitur prej të gjykuarit të pranishëm, pra, në thelb, për të trajtuar këtë situatë edhe për pjesën që u takon bashkëtëpandehurve të tjerë që nuk kanë ushtruar ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet (jo personale) të ngritura në ankim” (përcaktimi i nenit 425/1 të KPP).

Kushtetuta, në nenin 43 të saj, [..]

Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ, Kolegjet e Bashkuara, vlerësojnë se mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive. E drejta e ankimit nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe në respektim të standardeve që ky nen përcakton. Në funksion të garantimit të së drejtës për tu ankuar ndaj një vendimi gjyqësor penal neni 43 i Kushtetutës vihet në zbatim nga nenet 407-421 të KPP, që dispiplinojnë të drejtën e ushtrimit të ankimit. Mbi bazën e këtyre dispozitave, është ligji ai që cakton rastet në të cilat vendimet e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e përshtatshëm ankimes, që mund të jetë apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë ose kërkesa për rishikim, duke parashikuar aspektet formale dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve ankimese. Në nenin 407 të KPP të titulluar “Rastet dhe mjetet e ankimit” parashikohet shprehimisht [..]

Referuar jurisprudencës kushtetuese, e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Çdo instancë ankimese që njeh sistemi i normave procedurale penale është pjesë e të drejtës së të pandehurit për të pasur akses në gjykatë. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë,

procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.

Rregullat e përgjithshme të ankimit të përcaktuara në nenet 407 e vijues të KPP, parashikojnë, midis të tjerash, subjektet të cilat mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata që e shqyrton atë, duke e trajtuar mjetin “ankim” në kuadrin e një të drejte me karakter individual (pjesë esenciale e të drejtës së mbrojtjes) që sjell pasoja të caktuara vetëm për personin që e ushtron atë. Në rastet kur ka më shumë se një të pandehur, karakteri individual i ankimit vazhdon të ruhet, por për shkak të specifikës së këtij lloji gjykimi - *simultaneus processus* - ligji parashikon një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, kur, në nenin 416 të KPP parashikon se [..]

Në funksion të interpretimit të paragrafit të parë të nenit 416 të KPP, që bën fjalë për zgjerimin e efekteve të ankimit, të paraqitur prej një të pandehuri, edhe për bashkëtëpandehurit e tjerë, që nuk kanë ushtruar ankim, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se këto “efekte” presupozojnë të drejtën e bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim për të përfituar nga vendimmarrja e gjykatës me karakter favorizues ndaj të pandehurit që ka ushtruar ankim. Dispozita e mësipërme, që bën fjalë për zgjerimin e efekteve të ankimit të ushtruar nga një i pandehur edhe për të pandehurit e tjerë (në rastet kur nuk ka ankim nga prokurori për këta bashkëtëpandehur), të cilët nuk kanë ushtruar ankim, do të ketë efekt dhe do të aplikohet, vetëm në kushtet kur favorizojnë *in - bonam parte* - pozitën e bashkëtëpandehurit që nuk ka ushtruar ankim dhe që, eventualisht, nuk është i pranishëm në atë gjykim, por jo kur e dëmtojnë atë.

Gjykata, që investohet për tu prononcuar, mbi bazën e ankimit të të pandehurit, edhe për pjesën e vendimit që i përket bashkëtëpandehurve të cilët nuk kanë ushtruar ankim (mbi bazën e përcaktimit të nenit 416/1 të KPP, gjithnjë, kur ky ankim, nuk bazohet vetëm në motive personale, që ka rezultuar i njëjtë edhe pas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017), nuk mund të përdorë prej paraqitjes së këtij ankimi diskrecionin *in malam parte*, pra, në dëm të interesave të personit të gjykuar që nuk ka ushtruar ankim, për më tepër, si në rastin konkret, jo të pranishëm në gjykim. Mbi këtë bazë arsyetimi, vendimmarrja e gjykatës dhe prononcimi i saj edhe për bashkëtëpandehurin e gjykuar në mungesë që nuk ka ushtruar ankim, duke i hequr mundësinë për të ushtruar një të drejtë themelore kushtetuese, siç është ajo e ankimit të vendimit, konsiderohet në shkelje të hapur të kësaj të drejte.

Në një interpretim të kombinuar të dispozitave që legjitimojnë gjykatën (e apelit), në një procedim penal me disa të pandehur, për të disponuar mbi ankimin e ushtruar nga i pandehuri edhe mbi bashkëtëpandehurit e tjerë që nuk kanë ushtruar ankim (për më tepër kur, këta të fundit rezultojnë të gjykuar në mungesë) dhe konkretisht të nenit 425/1 të KPP, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, si dhe të nenit 416/1 të KPP, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se qëllimi i ligjvënësit për të ndërhyrë në këtë “hapësirë të padepërtueshme”, justifikohet vetëm në kushtet e interpretimit të normave të sipërcituara në favor të situatës procesuale të këtyre bashkëtëpandehurve, të ndikimit të këtyre shkaqeve sikurse për të pandehurin që ka ushtruar ankim, në drejtim të lehtësimit të kësaj pozite.

Në terma të tjerë, ndërhyrja e gjykatës për të disponuar edhe lidhur me pjesën e vendimit (në një procedim me disa të pandehur) që i përket bashkëtepandehurve që nuk kanë ushtruar ankim (në kushtet e zhvillimit të gjykimit pa praninë e tyre, në mungesë), mbi bazën e “shkaqeve, jo personale, të ngritura në ankim” prej të pandehurit që ka ushtruar ankim të pranishëm në gjykim, sipas vlerësimit të Kolegjeve të Bashkuara nuk paragjykon apriori, për asnjë moment, të drejtën e bashkëtepandehurit (jo ankimues, për shkak të padijenisë) për të paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 147/2 (para ndryshimeve të realizuara me ligjin nr. 35/2017) dhe të nenit 420/1, paragrafi i dytë të KPP.

Duke ju referuar parashikimeve të nenit 425/1 të KPP (përpara ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017) sipas të cilit: [...] Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se përmbajtja e kësaj dispozite lidhet ngushtësisht me parashikimin e nenit 416/1 të KPP që parashikon shtrirjen apo zgjerimin e “hapësirës” së diskrecionit gjykues të gjykatës së apelit, për të disponuar mbi ankimin e ushtruar nga bashkëtepandehuri, edhe për pjesën takuese të bashkëtepandehurve që nuk kanë ushtruar ankim, *brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në ankim*, në rastin kur ankimi i bërë nga bashkëtepandehuri nuk bazohet vetëm në motive personale. [...] Në nenin 425/1 të KPP përpara ndryshimeve ligjore, parashikohej se gjykata e apelit e shqyrtonte çështjen në tërësi dhe nuk kufizohej vetëm në shkaqet e paraqitura në ankim (me përjashtim të rastit kur ajo shqyrtonte edhe pjesën që u takon bashkëtepandehurve që nuk kanë ushtruar ankim “brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim”), ndërsa dispozita aktuale (neni 425/1 i KPP) parashikon se kufijtë e shqyrtimit të gjykatës së apelit janë vetëm mbi bazën e shkaqeve të ngritura në ankim, me përjashtim të rasteve kur konstaton çështje ligji, të cilat shqyrtohen kryesisht. Sipas nenit 425/1 (të ndryshuar), shqyrtimi në gjykatën e apelit kufizohet brenda shkaqeve të paraqitura në ankim, të cilat do të shqyrtohen edhe për bashkëtepandehurit që nuk kanë ushtruar ankim, kur shkaqet e ngritura në ankim nuk bazohen në motive personale.

Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, edhe pas ndryshimeve ligjore të vitit 2017, me përjashtim të kufijve të shqyrtimit të çështjes në apel, situata mbetet e njëjtë lidhur me bashkëtepandehurit që nuk kanë ushtruar ankim. Sipas dispozitës së pandryshuar, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtepandehurve që nuk kanë ushtruar ankim, brenda shkaqeve të ngritura në ankim nga bashkëtepandehurit e tjerë. Po kështu, edhe në dispozitën aktuale (neni 425/1), gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtepandehurve që nuk kanë ushtruar ankim brenda shkaqeve të paraqitura në ankim. Për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes në apel për pjesën që u takon bashkëtepandehurve që nuk kanë ushtruar ankim bëhet brenda shkaqeve të ankimit të bashkëtepandehurit që ka ushtruar ankim, ndaj sentenca e tretë e vendimit njëses nr. 1, datë 20.01.2011 mohon të drejtën e bashkëtepandehurve (të gjykuar në mungesë) që nuk kanë ushtruar ankim, për të kërkuar rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në rastet kur parashtrohen shkaqe të ndryshme nga ato të marra në shqyrtim nga gjykata e apelit, e inicuar nga ankimi i bashkëtepandehurve të tjerë.

Mbi këtë bazë arsyetimi, sentenca e tretë e vendimit njëses nr. 1, datë 20.01.2011,

që ndalon paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat të drejtës së ankimit nga i pandehuri, që nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar vetëm mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit (të pranishëm në gjykim) dhe kur shkaqet e ankimit nuk rezultojnë të karakterit personal, konsiderohet e paarsyeshme, qartësisht e paimponuar prej përmbajtjes së dispozitave (neneve 416/1 dhe 425/1 të KPP).

Sakaq, Kolegjet e Bashkuara gjejnë me vend të evidentojnë në mbështetje të konkluzionit të formësuar me këtë rast, edhe evolucionin e tyre gradual (në raport me vendimin njësoj nr. 1, datë 20.01.2011), në qëndrimin e mbajtur në vendimin njësoj, nr. 1, datë 10.03.2014, kur, në paragrafin nr. 65, të këtij vendimi, [..]

Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se paragrafi i parë i nenit 416 të KPP, ku parashikohet se [..] nuk mund të shërbejë “*in peius*”, për të mohuar të drejtën e bashkëtëpandehurit (të gjykuar në mungesë) që nuk ka ushtruar ankim, për t’u rivendosur në afat të drejtës së ankimit, kur pretendon shkaqe të ndryshme nga ato të marra në shqyrtim nga gjykata nëpërmjet ankimit të bashkëtëpandehurve të tjerë (për shkaqe jo personale të këtyre të fundit), duke iu njohur në këtë mënyrë e drejta për të qenë prezent në gjykim dhe për tu dëgjuar, në të njëjtat kushte, sikurse i gjykuari i pranishëm në proces. E drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t’u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. E [..] (shih vendimin nr. 109, datë 28.05.2002 i Gjykatës Kushtetuese).

Gjithashtu, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar [..] (shih vendimin nr. 12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese). [..]

Duke u bazuar në këto parime, edhe GJEDNJ ka përcaktuar kritere të qarta dhe të plota për drejtësinë kushtetuese lidhur me gjykimin në mungesë. (*Ektabani kundër Suedisë, 1988; Vaundelle kundër Francës, 2003*). (*Poitrimol kundër Francës, 1993; Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë, 2001*). (*Geyseghem kundër Belgjikës, 1999*) (*Mariani kundër Francës, 2005*) (*Sejdovic kundër Italisë, 2000*); *Stoichkov kundër Bullgarisë Krombach kundër Francës, Shkalla kundër Shqipërisë, Izet Haxhia kundër Shqipërisë* GJEDNJ, [..]

Pra, referuar praktikës së GJEDNJ edhe pse gjykimet e zhvilluara pa praninë e të pandehurit nuk janë në vetvete në mospërputhje me nenin 6 të KEDNJ, padyshim do të konsiderohej një mohim i drejtësisë nëse një person i gjykuar në mungesë nuk do ishte në gjendje të kërkonte nga gjykata një rivlerësim të themelit të akuzave, në rastet kur nuk provohet se ai ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u mbrojtur.

Kolegjet e Bashkuara, në garantimin e të drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor vlerësojnë të theksojnë dhe Rezolutën (75) 11 “Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit” të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, në të cilën rekomandohen standardet minimale për shtetet anëtarë mbi njoftimin e të gjykuarit dhe zhvillimin e procesin në mungesë të tij, [..] Referuar praktikës kushtetuese, por edhe asaj të GJEDNJ, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se vendimi njësoj nr. 1, datë 20.01.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në interpretimin që i ka bërë çështjes së

tretë, ku ka konkluduar se “Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri”, nuk përputhet me standardet kushtetuese dhe konventore dhe as me parashikimet e vetë KPP.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, i gjykuari në mungesë, kur provohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dënimit, ka të drejtën të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, pavarësisht se çështja është gjykuar në gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri (të pranishëm). Gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat pasi ka verifikuar më parë kushtet formale të parashikuara në nenin 420/1 të KPP, duhet të vlerësojë formalisht “*prima facie*” nëse shkaqet e ankimit të të gjykuarit në mungesë janë të njëjta me shkaqet jo personale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër. Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat është shprehur më parë gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit për shkaqe jo personale të këtij të fundit.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ndërmjet dy parimeve të rëndësishme, ai i sigurisë juridike dhe procesi i rregullt ligjor, në rastin konkret, ky i fundit do të prevalojë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësuës nr. 1, datë 10.03.2014, ku në paragrafin nr. 62, ndër të tjera, kanë arsyetuar se “[..] Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se shmangia nga parimi i sigurisë juridike nëpërmjet mundësisë së rihapjes së çështjes penale, ka si qëllim ndreqjen e gabimit gjyqësor në dhënien e drejtësisë. Në çështjen *Xherraj kundër Shqipërisë*, GJEDNJ shprehet se [..]

Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se interpretimi i kryer për çështjen e tretë në vendimin njësuës nr. 1, datë 20.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është në kundërshtim me parimet ligjore, me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara duke konkluduar se nevoja për ndryshimin e jurisprudencës është “*e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar*”, arrijnë në qëndrimin njësuës si më poshtë:

“I gjykuari në mungesë, kur provohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dënimit, ka të drejtën të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, pavarësisht se çështja është gjykuar në gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri.

Gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat vlerëson formalisht nëse shkaqet e ankimit të të gjykuarit në mungesë janë të njëjta me shkaqet jo personale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër.

Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat

është shprehur më parë gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtpandehurit për shkaqe jo personale të këtij të fundit.”

Përsa i përket zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara [...] konstatojnë se, gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë rrëzuar kërkesën e kërkuarit A.M, me objekt rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, bazuar në interpretimin e kryer nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në çështjen e tretë të vendimit njësuës nr. 1, datë 20.01.2011, [...]

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, vendimet njësuëse dhe ndryshuese të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë hyjnë në fuqi në momentin e shpalljes së tyre dhe kanë fuqi nga ai moment e në vijim. [...]

Vendimi njësuës, por dhe vendimi që ndryshon praktikën gjyqësore të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë vendime me fuqi “*erga omnes*” dhe kanë pothuajse të njëjtat karakteristika me vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo aktet normative. Nëse Kolegjet e Bashkuara ndryshojnë praktikën gjyqësore, ky ndryshim nuk duhet të cenojë parimin e sigurisë juridike, në kuptim edhe të zbatimit të drejtpërdrejtë të nenit 7 të KEDNJ apo nenit 29 të Kushtetutës, ku sigurohet ndalesa kategorike e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit. Edhe në rastin e veprimit në kohë të fuqisë së vendimit njësuës ose ndryshues të praktikës gjyqësore zbatohet parimi i veprimit në kohë të ligjit penal. Nuk ka një normë ligjore, qoftë në ligjet procedurale apo penale që të rregullojë veprimin në kohë të vendimeve njësuëse, zhvilluese dhe ndryshuese të praktikës gjyqësore. Në sferën penale edhe procedurale penale një vendim që përkeqëson pozitën e të pandehurit apo personit nën hetim nuk mund të ketë fuqi prapavepruese.

Përpos rregullit të përgjithshëm të sipërcituar, në rastin objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se duhet të mbahet në konsideratë pika 3 e nenit 29 të Kushtetutës, që parashikon se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. [...]

Gjykata Kushtetuese është shprehur se e [...] (*shih vendimin nr. 12, datë 15.02.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

Në vendimin nr. 35, datë 20.12.2005, Gjykata Kushtetuese shprehet se [...] Nisur sa më sipër, bazuar në parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ndryshimi i praktikës njësuëse të sipërcituar, e cila ka shërbyer si argument nga gjykatat e faktit në mbështetje të rrëzimit të kërkesës së kërkuarit A.M për rivendosjen në afat të ankimit, do të ketë fuqi prapavepruese për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se praktika njësuëse, e cila ka shërbyer në funksion të zgjidhjes së kërkesës së kërkuarit për rivendosjen në afat të të drejtës së ankimit, ndaj vendimit të gjykimit në themel të akuzës, pas ndryshimit me këtë vendim, i jep mundësinë gjykatës për të shqyrtuar kërkesën e tij, me objekt rivendosjen në afat të të drejtës së ankimit, [...] Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara, vlerësojnë se, vendimi [...] i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër (që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka rrëzuar kërkesën e kërkuarit A.M për rivendosjen në afat të të drejtës së ankimit) duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në rishqyrtim, Gjykata e Apelit Gjyrokastër, duke mbajtur

në konsideratë qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara në këtë vendim ndryshues të praktikës gjyqësore, duhet të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuarit, [...] duke verifikuar nëse shkaqet e ankimit të kërkuarit/të gjykuarit në mungesë, janë të njëjta me shkaqet jo personale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër Dh.T.

V. Masat e sigurimit

KPGJL Vendim Njësues Nr.00-2021-1135(147), datë 23.12.2021 (Sekuestrimi i të dhënave kompiuterike)

E drejta e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar sekuestrimin e sendeve lind në momentin që të interesuarit i dorëzohet kopja e vendimi të arsyetuar (nga prokurori ose gjykata). Ky moment mund të jetë i njëkohshëm me zbatimin e sekuestrimit ose me momentin që i interesuari merr dijëni për sekuestrimin e një sendi.

Gjykata kompetente për shqyrtimin e këtij ankimi, në rastet kur sekuestrimi është urdhëruar nga Prokurori, është Gjykata e Shkallës së Parë (Gjyqtari për Hetime Paraprake), në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 212 të KPP. Afati për paraqitjen e ankimit është 10 ditë (duke pasur në vëmendje natyrën e disponimit, që lidhet me sekuestron provuese, referimi për afatin e ankimit bëhet në nenin 301 pika 2, të KPP).

Në rastet kur sekuestrimi është disponuar nga Gjykata, në vijim të kërkesës së prokurorit, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit është Gjykata e Apelit, në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 212 të KPP.

Së pari, duhet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme sipas nenit 208 KPP:

- i. *Kjo do të thotë se sekuestrimi edhe në rastin e të dhënave kompjuterike, vendoset për provat materiale, kuptimi i të cilave jepet në nenin 187 të KPP dhe për sendet që lidhen me veprën penale.*
- ii. *Për sendet që lidhen me veprën penale, duhet të arsyetohet se edhe këto sende janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.*

Së dyti, Gjykata duhet të argumentojë se cila është vepra penale që në mënyrë të arsyeshme dyshohet se është kryer.

Së treti, Gjykata duhet të arsyetojë përse sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes.

Së katërti, Gjykata duhet të përcaktojë ose të argumentojë se cilat janë të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe gfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestron mbi të dhënat ose sistemet kompjuterike. Në këtë përcaktim Gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, duke lejuar sekuestrimin e të dhënave ose të sistemeve kompjuterike për nevoja të hetimit, vetëm nëse është e nevojshme, për sa është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme;

Së pesti, Gjykata duhet të përcaktojë dhe të arsyetojë në vendim modalitetet për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Edhe në këtë rast, Gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë. Sekuestrimi

duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet specifikisht të përcaktuara në vendimin e gjykatës. Për nxjerrjen e të dhënave mund të sekuestrohen pajisjet, vetëm në rast se është e domosdosme dhe për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave apo krijimin e kopjeve;

Së gjashti, përveçse sa më sipër, specifikisht lidhur me sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike ndaj gazetarëve profesionistë, Gjykata duhet të lejojë sekuestrimin, pasi të jetë shteruar kërkimi në të gjitha burimet e tjera të mundshme të të dhënave, duke patur parasysh paragrafin 3 të nenit 159 të KPP. Kjo do të thotë se ndërhyrje të tilla, duhet të jenë të mirëargumentuara dhe vetëm në rastet kur e dhëna nuk mund të merret në burimin e saj. Në raste të tilla përjashtimore Gjykata duhet të saktësojë të dhënat konkrete që kërkohet të sekuestrohen, përse ato janë të domosdoshme/thelbësore për zgjidhjen e çështjes sipas nenit 211/2 të KPP, si dhe arsyet përse sekuestrimi i tyre është i pamundur të realizohet në një mënyrë tjetër. Në çdo rast Gjykata duhet të tregojë kujdes për moscenim të marrëdhënies së gazetarit me burimin e informacionit, duke shmangur zbulimin e këtij burimi kur vërtetësia e të dhënave mund të verifikohet në një mënyrë tjetër.

Fjalë kyçe: sekuestro provuese, mjet marrje prove, afat ankimi, burim informacioni, porporcionalitet

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kryesisht, ka regjistruar, në datë 13.4.2021, [...], në konformitet me përcaktimet e nenit 287/1 të KPP, njoftimin për veprën penale “Përhapja e sekreteve private”, të parashikuar nga neni 122 i K.Penal. Regjistrimi i këtij procedimi është iniciuar nga informacioni i marrë në portalet Lapsi.al dhe Syri.net, nga permbajtja e të cilëve krijohej dyshimi se subjekti elektoral, Partia Socialiste e Shqipërisë, kishte krijuar një sistem të dhënash konfidenciale, në funksion të zgjedhjeve të përgjithshme të datës 25.4.2021, duke ndërhyrë dhe shfrytëzuar për këtë qëllim të dhënat e databazës shtetërore “E-Albania”.

Në artikujt e këtyre portaleve pasqyrohej se bëhej fjalë për të dhënat konfidenciale të 910 000 votuesve nga moshë 19 deri 99 vjeç. Dokumenti përmban të dhënat personale për çdo person, si numrin e telefonit, numrin e kartës së identitetit, numrin e qendrës së votimit, vendin e punës për shumicën e të regjistruarve dhe një përshkrim të përkatësisë politike. Po ashtu, [...],Prokuroria e Posaçme, ka përditësuar regjistrin e njoftimeve të veprave penale, me njoftimin për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, të parashikuar nga neni 328 i K.Penal, krahas regjistrimit të datës 13.4.2021, të njoftimit për veprën penale “Përhapja e sekreteve private”, të parashikuar nga neni 122 i K.Penal, mbi bazën, këtë radhë, të kallëzimit penal [...] të paraqitur prej subjektit elektoral Partia Demokratike e Shqipërisë. Faktet e kallëzuara lidheshin me bazën e të dhënave, pjesë të të cilave ka publikuar portali Lapsi.al, objekt hetimi, i Prokurorisë së Posaçme, në kuadër të procedimit penal të regjistruar me [...]

[...]prokurori i Prokurorisë së Posaçme, ka bashkuar të dy procedimet në një të

vetëm, me nr. 95, datë 13.4.2021. Në vijim të zbatimit urdhërimit të Prokurorit (të datës 13.4.2021), të sekuestrimit dhe/ose këqyrjes së bazës së të dhënave në zotërim të medias Lapsi.al, më datë 14.4.2021, oficerët e policisë gjyqësore dhe ekspertët përkatës, janë paraqitur pranë zyrave të kësaj medieje për të proceduar me kryerjen e veprimit, por nga ana shtetasve A.B. dhe A.Sh., titullarët e saj dhe gazetarë të medias me të njëjtin emër, është refuzuar dhënia e kësaj baze të dhënash, me justifikimin e “ruajtjes së burimit të informacionit” të imponuar prej kodit profesional të gazetarit.

Pasi ka çmuar, në funksion të ecurisë dhe të kompletimit/plotësimit të hetimeve të filluara, rëndësinë e databazës së të dhënave kompjuterike, në zotërim të medias Lapsi.al, si dhe, në kushtet e verifikimit të prezencës së të dhënave të mjaftueshme konfirmuese të dyshimit për konsumimin e veprave penale të regjistruara, objekt i këtij hetimi (procedimi penal), prokurori i Prokurorisë së Posaçme, i ka kërkuar GJKKO, në konformitet me përcaktimet e neneve 208 dhe 208/a, të KPP, vendosjen e sekuestros provuese penale, në thelb, sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, databazës së sistemit të të dhënave, duke u marrë sendi në të cilin gjenden të depozituara të dhënat. [..]

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, [..] ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit të Prokurorisë së Posaçme [..] duke urdhëruar menjëherë: Hyrjen, kërkimin, marrjen dhe sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik ku mund të gjenden këto të dhëna dhe konkretisht: Baza e të dhënave me gjeneralitetet e shtetasve shqiptarë dhe të dhëna të tjera personale të tyre, e identifikuar në artikujt e botuar nga [..] Sekuestrimi të kryhet duke u marrë sendi në të cilin gjenden të dhënat dhe duke u krijuar edhe një kopje unike e këtyre të dhënave kompjuterike, me qëllim ruajtjen e tyre. [..]

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, [..]ka vendosur shfuqizimin e vendimit [..]të Gjykatës së Posaçme [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] gjatë gjykimit në dhomën e këshillimit, Kolegji, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, vendimet e gjykatave dhe shkaqet e rekursit, vlerësoi se në rekurs janë ngritur një sërë çështjesh, trajtimi dhe zgjidhja e të cilave do t'i shërbejë zhvillimit të praktikës gjyqësore, në përputhje me parashikimet e nenit 438 të KPP, si dhe zgjidhjes së drejtë të çështjes konkrete, objekt shqyrtimi.

Kështu, evidentohet se, në rekursin e paraqitur nga prokurori, ngrihet nevoja e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike të publikuara nga një portal i medias elektronike, marrja e të cilave pretendohet si e domosdoshme për kryerjen e hetimit.

Nga ana tjetër, pavarësisht se organi i akuzës pretendon se synimi i tij nuk është që të arrihet tek burimi i informacionit të gazetarit, Kolegji vlerëson se, sekuestrimi i pajisjeve përbën një rrezik për zbulimin e burimit. Gjithashtu, në këto pajisje mund të përmbahen të dhëna të tjera, të cilat nuk kanë lidhje me procedimin konkret të organit akuzës. Për këtë arsye, për të vendosur një balancë të drejtë midis nevojave të organit të akuzës për sekuestrim të të dhënave kompjuterike dhe nga ana tjetër për të siguruar

një mbrojtje efektive të personave të cilëve u sekuestrohen këto të dhëna, në mënyrë të veçantë gazetarëve profesionistë, Kolegji, në zbatim të parashikimeve të nenit 438 të KPP, ka konkluduar, [...] për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson të njësojë praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e nenit 212 të KPP, pas ndryshimeve ligjore që ka pësuar kjo dispozitë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, [...], si dhe të neneve 208 dhe 208/a, të KPP, duke shtruar për njësim çështjet si vijon:

1. Cili është momenti i ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës për Hetime Paraprake për vendosjen, në vijim të kërkesës së prokurorit, të sekuestros provuese, sipas parashikimeve të nenit 212 të KPP dhe cila është Gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit?

2. Cilat janë kriteret nga të cilat duhet të niset Gjykata për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike? [...]

A. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim:

1. Cili është momenti i ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës për Hetimet Paraprake për vendosjen, në vijim të kërkesës së prokurorit, të sekuestros provuese, sipas parashikimeve të nenit 212 të KPP dhe cila është Gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit?

Në arsyetimin e tij, lidhur me këtë çështje Kolegji analizoi dispozitat si vijon: Neni 187 (Kuptimi i provës materiale) [...] Neni 208 (Objekti i sekuestrimit) [...] Neni 212 (Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit) [...] Neni 278 (Kompetencat e Gjykatës – gjyqtarit për hetimet paraprake) [...] Neni 301 (Vleftësimi i sekuestros) [...]

Fillimisht, Kolegji çmon të analizojë dhe të sqarojë kuptimin e termit “sekuestro provuese” e ashtuquajtura sekuestro penale. Sekuestroja provuese është mjet tipik i kërkimit të provës në procesin penal. Si e tillë, do të kuptohet ndalimi përkohësisht i disponimit dhe/ose tjetërsimit të sendit, provë materiale apo dokument, i marrë në ruajtje e në dispozicion të organit të akuzës/procedimit. Sekuestroja provuese shfaqet si instrument ligjor që justifikon marrjen në posedim të sendit që shërben për vërtetimin e fakteve penalisht të ndëshkueshëm dhe për këtë i klasifikuar si mjet i kërkimit të provës. Është objekt i sekuestros provuese, sendi provë materiale drejtpërdrejt apo tërthorazi i lidhur me veprën penale, që është i domosdoshëm për vërtetimin e faktit (neni 208 i KPP). Pra, është ai send pa të cilin nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit dhe sekuestrimi është mjeti i marrjes së tij. Duke qenë se lidhet me nevoja të të provuarit dhe aspak me raportin e pronësisë, sekuestro provuese bie mbi çdo send, pavarësisht nga personi titullar i pronësisë apo i përdorimit të sendit, por kurdoherë vetëm kur është domosdoshmërisht vërtetues i faktit.

Si mjet tipik i marrjes së provës që realizohet, si rregull, me ndalimin përkohësisht të disponimit dhe/ose tjetërsimit të sendit objekt sekuestrimi, sekuestroja provuese passjell kufizim të disponimit të sendit dhe për rrjedhojë kufizim të së drejtës së pronësisë, e cila është një e drejtë themelore që gëzon mbrojtje të shumëfishtë, si në planin kushtetues

(neni 41 i Kushtetutës), ashtu dhe në atë Konventor, sipas konventave ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar, ose synon të aderojë (neni 1, i protokollit 1, të KEDNJ), [...] **Për këtë është i domosdoshëm garantimi i zhvillimit të një procesi të drejtë, i cili i imponon gjykatës të japë arsyet për të cilat është i nevojshëm ky kufizim i të drejtës së pronësisë.**

Nevoja për të evituar kufizime të pronës private, të cilat nuk janë ngushtësisht të lidhura me qëllimin për të cilin merret masa, duhet të mbizotërojë ndaj arsyes së vendosjes së sekuestros. Nga këtu buron dhe nevoja e veçantë e arsyetimit (motivimit) të vendimit, i cili duhet të argumentojë se provueshmëria e faktit nuk mund të arrihet në mënyrë tjetër, pa u kufizuar e drejta e disponimit të sendit dhe për rrjedhojë të legjitimitetit të vendosjes së sekuestros. Për rrjedhojë, vetëm përmes arsyetimit të vendimit të sekuestrimit, mund të vendoset një raport i drejtë midis ndërhyrjes së autoriteteve dhe lirive dhe të drejtave themelore, si ajo e pronësisë dhe e iniciativës së lirë, të cilat gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe konventore. (*Vendimi i Gjykatës së Kasacionit të Italisë nr. 18316, datë 2 maj 2019*).

Edhe në jurisprudencën e GJEDNJ është theksuar se nuk mund të konsiderohet i drejtë raporti midis interesave, nëse personi i interesuar i nënshtrohet një sakrifice më të madhe sesa është e nevojshme në të drejtën e tij të pronësisë (*GJEDNJ, S.C. Fiercolect Impex S.R.L. v. Rumania, App. no. 26429/07, 13.12.2016*). [...] (*GJEDNJ, Agosi v. The United Kingdom, App. no. 9118/80, 24.10.1986*).

Për shkak të nevojave hetimore sekuestroja provuese (penale) vendoset në mënyrë të njëanshme, nga prokurori apo dhe nga Gjykata, gjyqtari për hetimet paraprake mbi kërkesën e këtij të fundit. Në pikën 1, të nenit 208, të KPP parashikohen si subjekte të legjitimuar për vendosjen e sekuestros gjyqtari ose prokurori. Për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që preken nga vendosja e sekuestros provuese, ligjvënësi shqiptar imponon detyrimin që gjyqtari ose prokurori të arsyetojnë vendimin për vendosjen e sekuestros, duke dhënë edhe arsyet se përse sendi, objekt sekuestrimi, është i domosdoshëm dhe jo thjesht i nevojshëm për vërtetimin e fakteve. Në pikën 3 të kësaj dispozite, parashikohet që të interesuarit duhet t'i dorëzohet një kopje e vendimit të sekuestrimit.

Në nenin 212 të KPP, të titulluar “Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit”, ligjvënësi, në vijim të garantimit të interesave të personit ndaj të cilit (pasurisë së tij) është vendosur sekuestro e këtij lloji, i cili preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimi i sekuestrimit, ka parashikuar të drejtën e tij për të kundërshtuar, në gjykatë, këtë vendim.

Sipas këtyre parashikimeve, personi i interesuar, i cili nuk lidhet domosdoshmërisht vetëm me personin ndaj të cilit zhvillohen hetimet (mbi bazën e regjistrimit të njoftimit për veprën penale që i atribuohet këtij të fundit), por mund të jetë çdo person tek i cili ndodhet sendi ose dhe ata persona që kanë të drejtën e kërkimit të tij, mund të paraqesë ankim, në Gjykatë, ndaj vendosjes së kësaj mase të sekuestros. Nga interpretimi literal i kësaj dispozite, pra i nenit 212 të KPP, Kolegji çmon të evidentojë se, referuar terminologjisë së përdorur nga ligjvënësi, duhet që vendimi i gjykatës ose i prokurorit, për sekuestrimin e sendeve, të jetë ekzekutuar. Ky fakt rezulton shumë qartë nga teksti i paragrafit të parë, të kësaj dispozite, ku ligjvënësi ka përdorur togfjalëshin “tek i cili

janë sekuestruar sendet”, që mbart në vetvete një veprim tashmë të kryer dhe që është pikërisht ai i sekuestrimit të sendeve. Gjithashtu, po në këtë paragraf, është përdorur togfjalëshi “*ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre*”, që gjithashtu, i referohet një personi i cili kërkon, pra pikërisht një send që i takon, por që nuk e ka, për shkak të vendosjes së sekuestros provuese, në rastin konkret. Pra, kundërshtimi në gjykatë i vendimit të sekuestrimit, nuk mund të bëhet nëse nuk është ekzekutuar sekuestroja provuese mbi sendet. Ky përfundim, që vjen si rrjedhojë e interpretimit literal të pikës 1 të nenit 212, të KPP, është dhe një përfundim logjik për të mos u investuar gjykata për kundërshtimin e vendimeve, të cilat nuk kanë prodhuar efekt.

Përsa i përket të drejtës së ankimit lidhur me “kundërshtimin e vendimit të sekuestrimit” prej të pandehurit (të hetuarit), personit “tek i cili janë sekuestruar sendet” dhe atij që “ka të drejtën e kërkimit të tyre”, sikurse përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 212 të KPP, momentit të realizimit të kësaj të drejte, qartazi, me këtë cilësi do të identifikohet momenti kur pala e interesuar merr dijeni për zbatimin e sekuestros, të caktuar nga gjykata (mbi kërkesën e prokurorit), nga prokurori ose nga policia gjyqësore (në rastet kur kjo e fundit operon sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 207 të KPP, duke sekuestruar me iniciativë sende që lidhen me veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi penal ose sende që lidhen me një veprë tjetër penale për të cilën procedohet kryesisht). Nëse, nga njëra anë, mund të ndodhë që subjektet e interesuar, e të parashikuar, në paragrafin e parë të nenit 212 të KPP, të vihen menjëherë në dijeni për zbatimin e sekuestros në kohë reale në momentin e zbatimit të saj dhe, për rrjedhojë, nga ai moment u lind e drejta për të kundërshtuar vendimin e zbatimit të sekuestros, nga ana tjetër, mund të ndodhë që personat e interesuar, të cilët janë të legjitimuar për paraqitjen e ankimit, të marrin dijeni në një moment të mëvonshëm. Kolegji çmon se momenti i lindjes së të drejtës, në këtë eventualitet të dytë, nuk mund të përkojë me momentin e zbatimit të sekuestros, por duhet të përkojë me momentin e marrjes dijeni nga titullari i së drejtës për të paraqitur ankim ndaj vendimit të sekuestrimit, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 212 të KPP. Kolegji çmon se në këtë mënyrë garantohet ushtrimi efektiv i të drejtës së ankimit nga ana e subjekteve të legjitimuar për ta paraqitur atë.

Mbi bazën e këtij arsytimi konkludohet (konkluzion njësuës) se e drejta e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar sekuestrimin e sendeve lind në momentin që të interesuarit i dorëzohet kopja e vendimit të arsyetuar (nga prokurori ose gjykata). Ky moment mund të jetë i njëkohshëm me zbatimin e sekuestrimit ose me momentin që i interesuari merr dijeni për sekuestrimin e një sendi.

Pasi u evidentuan subjektet e legjitimuara për kundërshtimin e vendimit të aplikimit të sekuestros dhe pasi u konkludua mbi momentin në të cilin u lind e drejta këtyre subjekteve për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar vendosjen e sekuestros, për të kompletuar të gjithë gamën e parashikimeve të së drejtës së ankimit të parashikuar nga neni 212 i KPP, të ndyshuar me ligjin nr. 35/2017, lind nevoja që të përcaktohet afati për paraqitjen e këtij ankimi në gjykatë dhe cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e tij.

Për të konkluduar lidhur me këto aspekte që lidhen me të drejtën e ankimit, është e nevojshme të bëhet një interpretim literal dhe sistematik i dispozitave të KPP. Sikundër u arsyetua më lart, në nenin 208 të KPP parashikohet se disponimi për vendosjen e sekuestros mund të merret nga prokurori ose, në raste të veçanta, nga gjykata me kërkesë të prokurorit. Praktika gjyqësore ka evidentuar se paraqitja në gjykatë e kërkesës së prokurorit për aplikimin e sekuestros provuese, në një kohë që ligjvënësi i ka garantuar mundësinë e aplikimit në mënyrë të drejtpërdrejtë të saj këtij të fundit, aq më tepër kur bëhet fjalë për një nga mjetet më të zakonshëm të kërkimit të provës në dispozicion të organit të procedimit, prokurorit, por edhe të policisë gjyqësore në rastin e “verifikimeve të ngutshme”, gjatë fazës së hetimeve paraprake, presupozon incerinë e prokurorit për të proceduar me realizimin e një veprimi të tillë, të gjeneruar prej vlerësimit negativ të tij lidhur me domosdoshmerine e aplikimit të këtij “instrumenti” procedural dhe, në të njëjtën kohë, insistimin e palës së dëmtuar nga vepra penale pavarësisht kësaj inercie, mosveprimi, në funksion të stimulimit, për të proceduar me aplikimin e sekuestros së këtij lloji. Pra, si rregull, për këtë lloj sekuestroje, të sekuestrimit të “sendeve, provave materiale, të sendeve që lidhen me veprën penale” sipas përcaktimit të paragrafit të parë, të nenit 208, të KPP prokurori i kërkon gjykatës aplikimin e saj (duke mos e aplikuar vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë) vetëm në rastet e insistimit të palës së dëmtuar, megjithë disaprovimin e tij për të kryer vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë një veprim të tillë. Në varësi të organit që disponon lidhur me aplikimin e mjetit të kërkimit të provës, sekuestro provuese të parashikuar në nenin 208 të KPP, do të përcaktohet edhe *iteri procedural (shtegu procedural)* i paraqitjes së ankimit ndaj këtij disponimi dhe, për pasojë, gjykata kompetente për të trajtuar këtë ankim. Në rastin e aktivizimit të drejtpërdrejtë të prokurorit për të aplikuar masën e sekuestros së sipërcituar, paragrafi i parë i nenit 212 të KPP, që parashikon “kundërshtimin e vendimit të sekuestrimit”, “adreson” ankimin e palëve – të personit nën hetim (pasi për të pandehur, në këtë fazë fillestare të procedimit – të hetimeve paraprake – nuk mund të bëhet fjalë), të personit tek i cili janë sekuestruar sendet apo të kujtdo që ka të drejtën e kërkimit të tyre – natyrshëm, në Gjykatë, duke nënkuptuar - identifikuar – në këtë cilësi “gjyqtarin e hetimeve paraprake” – e cila (i cili) do të rezultojë në kushtet e kompetencës për të gjykuar edhe ankimin e paraqitur nga palët, në rastin e vendosjes së sekuestros (të të njëjtit lloj – provuese), me iniciative, nga oficeri i policisë gjyqësore, gjatë “verifikimeve të ngutshme në vend”, sipas përcaktimit të neneve 300, 301, të KPP, mbas vleftësimit të saj, brenda 48 orëve, nga Prokurori, mbi bazën e parimit, që çdo vendimmarrje e njëanshme e Prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake, në lëndë të masave të sigurimit personal (masave parasiguruese të “arrestimit në flagrance dhe të ndalimit”) dhe pasuror, por edhe në lëndë të aplikimit të drejtpërdrejtë të mjeteve të kërkimit të provës, sikurse në rastin e sekuestros provuese penale, i nënshtrohet, në mënyrë të pashmangshme, kontrollit juridiksional.

Sakaq, duke iu referuar rastit të aplikimit të sekuestros provuese, indirekt mbi kërkesën e Prokurorit, prej të njëjtës gjykatë, gjyqtarit për hetimet paraprake, *inaudita altera parte* – pa prezencën e palës së interesuar – menjëherë pas marrjes dijani,

prej kësaj pale, lidhur me këtë disponim, që mund të përkojë, sikurse u sipërcitua, me momentin e zbatimit të sekuestros, por edhe me një moment të mëpasshëm, paragrafi i dytë i nenit 212 të KPP parashikon të drejtën e ankimit të palëve, brenda 5 ditëve (prej momentit të marrjes dijeni për vendosjen e sekuestros) në Gjykatën e Apelit.

Për të zgjidhur këtë problematikë, të përcaktimit të gjykatës kompetente për trajtimin e ankimit, ndaj vendimit të gjykatës – gjyqtarit për hetimet paraprake – për vendosjen e sekuestros, në kushtet e inercisë së legjislatorit për të identifikuar qartësisht këtë Gjykatë, Kolegji çmon se në këtë rast do të zbatohen rregullat e përgjithshme, lidhur me gjykatën kompetente për shqyrtimin e ankimit, sipas të cilave ankimi shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë. Mbi këtë bazë, Kolegji dedukton konkluzionin se gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit, kur sekuestrimi është disponuar nga gjykata, në vijim të kërkesës së prokurorit, është Gjykata e Apelit. Afati për paraqitjen e ankimit është përcaktuar në pikën 2, të nenit 212 të KPP dhe është 5 ditë nga marrja dijeni.

Përsa i përket rastit kur sekuestrimi është vendosur nga Prokurori (në mënyrë të drejtpërdrejtë), sikundër u evidentua më lart në këtë vendim, dispozita – neni 212 i KPP – në paragrafin e parë të saj, megjithëse parashikon të drejtën e ankimit në Gjykatë (nga i pandehuri, personi tek ë cili jane sekuestruar sendet, ai që ka të drejten e kërimit të tyre), si dhe detyrimin e gjykatës për të gjykuar çështjen dhe për të disponuar me një vendim të arsyetuar, brenda 10 ditëve, hesht lidhur me modalitetet përkatëse përcaktuese të nisjes së afatit të ankimit si dhe me gjykatën kompetente për shqyrtimin e këtij ankimi, kur objekti i kundërshtimit është vendimi i prokurorit për vendosjen e sekuestros.

Për këtë Kolegji çmon se është e nevojshme të bëhet një një interpretim sistematik i dispozitave të KPP, në mënyrë që të konkludohet mbi zgjidhjen e çështjes së parashtruar për njësim duke identifikuar, natyrshëm, me cilësinë e gjykatës kompetente, për të trajtuar ankimet (si rregull), në fazën e hetimeve paraprake, kundër disponimeve të drejtpërdrejta dhe të “njëanshme” të Prokurorit, Gjykatën – gjyqtarin për hetimet paraprake. Në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 278, të KPP, gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata – gjyqtari për hetimet paraprake. Ky parashikim ligjor është plotësisht i aplikueshëm në rastin e vendosjes së sekuestros provuese nga Prokurori dhe posaçërisht për kundërshtimin, nga ana e subjekteve të parashikuara në paragrafin e parë të nenit 212 të KPP, të vendimit të Prokurorit për vendosjen e sekuestros provuese. Këto subjekte mund të paraqesin ankim në gjykatën e shkallës së parë (gjyqtari për hetimet paraprake).

Çështja e fundit të cilës duhet t'i jepet përgjigje për të konkluduar plotësisht mbi pyetjen e shtruar për njësim nga Kolegji Penal, ka të bëjë me afatin për paraqitjen e ankimit ndaj vendimit të Prokurorit për vendosjen e sekuestros penale. Edhe në këtë rast, dispozita – neni 212 i KPP – ka ometuar parashikimin e një afati konkret për ankimin e vendimit, çka imponon detyrimin e një interpretimi – nëpërmjet referimit tek dispozitat e ngjashme, në mënyrë të veçantë tek përcaktimi i nenit 301 të këtij Kodi, që parashikon vlerësimin e sekuestros provuese nga Prokurori, kur është vendosur, në rastet e “verifikimeve të ngutshme”, nga Policia gjyqësore,

Në këtë dispozitë, në paragrafin e dytë të saj, parashikohet e drejta e të pandehurit (të hetuarit), mbrojtësit, e personit të cilit i janë sekuestruar sendet dhe e atij që ka të drejtën e kthimit të tyre, për të ankumuar vendimin e prokurorit, që ka miratuar sekuestron (provuese) të aplikuar me iniciativë nga policia gjyqësore – në kushte emergjence – brenda një afati prej dhjetë ditësh nga dita e njoftimit të vendimit (miratues të prokurorit), në gjykatë.

Kolegji çmon t'i referohet parashikimeve të kësaj dispozite, paragrafit të dytë të nenit 301, të KPP, duke e konsideruar sekuestrimin e aplikuar nga policia gjyqësore, me rastin e “verifikimeve të ngutshme në vend”, të realizuara në konformitet me përcaktimet e nenit 300/2 të këtij Kodi, si situatë analoge me atë të parashikuar nga neni 208 i KPP, kur vendimi i sekuestrimit është disponuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga prokurori, pa “ndërmjetësimin” e gjykatës. Në rastin e vendosjes së sekuestrimit mbi provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, legjislatori ka parashikuar se kundër sekuestrimit të realizuar në kushtet e sipërcituara nga policia gjyqësore, të miratuar nga prokurori, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga (marrja dijani për vendimin e prokurorit) i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Kolegji, duke pasur në vëmendje natyrën e disponimit, që lidhet me sekuestron provuese, çmon se i njëjti afat 10 ditor do të zbatohet dhe për paraqitjen e ankimit nga subjektet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 212 të KPP ndaj vendimit të prokurorit që ka vendosur sekuestron provuese. Në përputhje me përfundimet e arritura më lart në këtë arsyetim të Kolegjit, ky afat do të fillojë nga momenti i marrjes dijani.

Në vijim të arsytimit të mësipërm, në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:

E drejta e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar sekuestrimin e sendeve lind në momentin që të interesuarit i dorëzohet kopja e vendimi të arsyetuar (nga prokurori ose gjykata). Ky moment mund të jetë i njëkohshëm me zbatimin e sekuestrimit ose me momentin që i interesuari merr dijani për sekuestrimin e një sendi.

Gjykata kompetente për shqyrtimin e këtij ankimi, në rastet kur sekuestrimi është urdhëruar nga Prokurori, është Gjykata e Shkallës së Parë (Gjyqtari për Hetime Paraprake), në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 212 të KPP. Afati për paraqitjen e ankimit është 10 ditë (duke pasur në vëmendje natyrën e disponimit, që lidhet me sekuestron provuese, referimi për afatin e ankimit bëhet në nenin 301 pika 2, të KPP).

Në rastet kur sekuestrimi është disponuar nga Gjykata, në vijim të kërkesës së prokurorit, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit është Gjykata e Apelit, në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 212 të KPP.

B. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njësim:

2. Cilat janë kriteret nga të cilat duhet të nisët Gjykata për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike?

Së pari, Kolegji çmon të evidentojë se dispozita ligjore në KPP, që rregullon

sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, është neni 208/a, i cili parashikon: [..]

Konventa e Budapestit për krimin në fushën e kibernetikës, e ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002, “Për Ratifikimin e Konventës për Krimin në Fushën e Kibernetikës”, ka dhënë këto përkufizime për “të dhënat kompjuterike” dhe “sistemin kompjuterik”:[..]

Zhvillimi i vrullshëm që ka marrë në dekadat e fundit teknologjia e informacionit, nuk mund të mos ndikonte fushën e së drejtës në përgjithësi dhe konkretisht procesin penal. Të dhënat dokumentare (përfshirë ato fotografike e filmike) tashmë nuk janë të materializuara vetëm në format “*hard copy*”, por gjenden edhe në “*format kompjuterik*”. Tanimë provat e domosdoshme për vërtetimin e fakteve penalisht të ndëshkueshme gjenden jo rrallë në formën e të dhënave kompjuterike. Për rrjedhojë, ka lindur domosdoshmëria e ndërhyrjes nga ana e ligjvënësit për të normuar këtë situatë faktike të krijuar. Specifikisht, në lidhje me sekuestron provuese, me ligjin nr. 10054, datë 29.12.2008, është shtuar në KPP neni 208/a, i titulluar “*Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike*”.

Sikundër konstatohet, kjo dispozitë është vendosur pas nenit 208 të KPP, që normon rregullat e përgjithshme mbi sekuestron provuese. Kolegji vlerëson se rregullat e përgjithshme të parashikuara në nenin 208 të KPP, përveçse kur në nenin 208/a ka parashikim të posaçëm, do të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Kolegji çmon të theksojë se garancitë e analizuara në pjesën e parë arsyetuese të këtij vendimi njëses, lidhur me nevojën e arsyetimit të vendimit në drejtim të domosdoshmërisë së sekuestrimit të të dhënave, duhet të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Po kështu janë të zbatueshme dhe përfundimet në të cilat arriti ky Kolegj lidhur me të drejtën e ankimit, të parashikuara në nenin 212 të KPP. Në tekstin e dispozitës, nenit 208/a të KPP, konstatohen edhe disa parashikime ndryshe nga ato të nenit 208 të KPP. Konkretisht, vërehet se ligjvënësi në dispozitën e re të shtuar në vitin 2008, në rastin kur procedohet për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike do të bëhet me vendim të gjykatës, në vijim të paraqitjes së kërkesës nga ana e prokurorit. Kolegji e lexon parashikimin e përmbajtur në nenin 208/a të KPP, si vullnet të ligjvënësit që sekuestrimi në këto raste të bëhet vetëm me vendim të gjykatës, si një garanci shtesë, por të domosdoshme për të garantuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike nëse përbëjnë të dhëna të domosdoshme për vërtetimin e faktit penal dhe më e rëndësishme është që të sekuestrohen vetëm ato të dhëna që janë të nevojshme për vërtetimin e këtij fakti penalisht të ndëshkueshëm. Ky preokupim i ligjvënësit konsiderohet i arsyeshëm për faktin se të dhënat kompjuterike, objekt i sekuestron, ndryshe nga të dhënat e përftuara nëpërmjet vendosjes së sekuestron mbi sendet e tjera, për shkak të natyrës së tyre të veçantë, është më e vështirë të individualizohet, si dhe, duke qenë se si rregull “depozitohen” në sisteme kompjuterike, në të cilat “parkohen” edhe të dhëna të tjera që mund të mos kenë lidhje me vërtetimin e faktit penal, ekziston rreziku i ekspozimit të të dhënave të tjera, (që nuk kanë lidhje me faktin penal për të cilin hetohet) marrja e të cilave mund të cenojë liri dhe të drejta të rëndësishme të qytetarëve, të cilat gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe konventore, si liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit, nëpërmjet

nenit 36 të Kushtetutës, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, nenit 8 të KEDNJ, apo lirinë e shprehjes, neni 22 i Kushtetutës, të drejtën e informimit, neni 23 i Kushtetutës, të mbrojtura gjithashtu dhe nga neni 10 i KEDNJ. [..]

[..] Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të GjEDNJ në këtë drejtim, kur Gjykata e Strasburgut, në një sërë vendimesh, është shprehur në mbrojtje të lirisë së shprehjes të parashikuar në nenin 10 të KEDNJ, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e sekretit të burimit të gazetarit (*GJEDNJ, Sanoma Uitgevers v. The Netherlands, App. no. 38224/03, 14.9.2010*), si dhe referuar nenit 8 të Konventës, e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare (*GJEDNJ, Iliya Stefanov v. Bulgaria, App. no. 65755/01 22.8.2008, GJEDNJ, Cronin v. The United Kingdom, App. no. 15848/03, 6.1.2004*). [..]

Për sa më sipës, Kolegji çmon të ritheksojë nevojën e vendosjes së një balance të drejtë midis të drejtave të qytetarëve apo profesionistëve, në veçanti gazetarëve profesionistë dhe nevojës për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit. Sikundër ka parashikuar kushtetutbërësi ndërhyrja bëhet vetëm me ligj dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka ndikuar këtë ndërhyrje. Në rastin konkret të sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, neni 208/a, që i bashkëngjitet nenit 208 të KPP, përbëjnë parashikimet ligjore për sekuestrimin provues të këtyre të dhënave. Sikundër u evidentua më lart, ligjvënësi ka parashikuar që sekuestrimi i të dhënave kompjuterike të bëhet me vendim gjykate, në vijim të kërkesës së prokurorit. Por cilat janë kriteret, të cilave gjykata duhet t'u përmbahet në vendimarrjen e saj për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike?

Parashikimin e parë në këtë drejtim e ka bërë kushtetutbërësi, në nenin 17 të Kushtetutës, ku është parashikuar se kufizimet e të drejtave, që bëhen përmes ligjit, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duhet të jenë në përpjesëtim me të drejtën që e ka diktuar atë. [..]. (*Vendimi nr. 20, datë 11.7.2006, i Gjykatës Kushtetuese §3, fq. 6*).

Gjykata Kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. [..] (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017, § 33, fq. 18; nr. 1 datë 6.2.2013, § 42, fq. 17; nr. 52, datë 5.12.2012, § 29, fq. 10, të Gjykatës Kushtetuese*).

[..] Kolegji vlerëson se parimet e domosdoshmërisë, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit duhet të udhëheqin vendimarrjen e gjykatës, qoftë në marrjen e vendimit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, ashtu edhe në lidhje me parashikimin e modaliteteve konkrete për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike.

Lidhur me kriterin e domosdoshmërisë, së pari, sikundër është argumentuar më lart në këtë arsyetim njësoj të Kolegjit, rregullat e përgjithshme të parashikuara në nenin 208 të KPP, përveçse kur në nenin 208/a ka parashikim të posaçëm, do të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Kështu, duke qenë se sekuestroja provuese është mjet tipik i kërkimit të provës në procesin penal, kjo do të thotë se sekuestrimi edhe në rastin e të dhënave kompjuterike vendoset për provat

materiale (kuptimi i të cilave jepet në nenin 187 të KPP) dhe për sendet që lidhen me veprën penale. Për rrjedhojë është e nevojshme të arsyetohet se përse këto të dhëna janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve penalisht të ndëshkueshëm.

Kjo implikon ekzistencën e një fakti penalisht të ndëshkueshëm, pra ekzistencën e një vepre penale, e cila në fazën fillestare të hetimit, dyshohet në mënyrë të arsyeshme se është kryer. [..]

Këtu lind nevoja e arsyetimit nga ana e Gjykatës se përse për vërtetimin e kësaj vepre penale është e domosdoshme vendosja e sekuestrros mbi të dhënat kompjuterike. Vlen të theksohet, sikundër është parashikuar në nenin 208 të KPP se ligjvënësi ka përdorur termin “domosdoshmëri” dhe jo “nevojë”. Kjo do të thotë se arsyetimi i Gjykatës duhet të shtrihet qoftë në drejtim të vërtetimit të lidhjes së të dhënave kompjuterike për të cilat kërkohet sekuestrimi me vërtetimin e faktit penalisht të ndëshkueshëm, por edhe me arsyetimin se ky vërtetim mund të bëhet vetëm nëpërmjet sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, pa të cilat nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit.

Pasi të përmbushet edhe ky kriter, Gjykatës i imponohet detyrimi të përcaktojë cilat janë konkretisht të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestrros mbi këto të dhëna apo sistemet kompjuterike të përcaktuara për t'u sekuestruar. Në këtë përcaktim/veçim të të dhënave dhe të sistemeve kompjuterike, Gjykata duhet të mbajë në konsideratë parimet e domosdoshmërisë në kuptimin se do të përzgjidhen vetëm ato të dhëna të cilat i shërbejnë vërtetimit të faktit dhe pa të cilat nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit. Sekuestrimi i të dhënave të tjera, jo të domosdoshme do të konsiderohet si shkelje nga ana e Gjykatës. I njëjti arsyetim duhet përdorur edhe për sistemet kompjuterike nëse do të jetë e nevojshme të sekuestrohen. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, jo vetëm që duhet të përzgjidhen ato sisteme kompjuterike në të cilat përmbahen të dhënat e veçuara si të domosdoshme dhe jo sisteme të tjera, por ndër këto sisteme kompjuterike, nëse ekziston mundësia e zgjedhjes, do të përzgjidhen ato sisteme kompjuterike, sekuestrimi i të cilave do të cenojë më pak të drejtat e personit të cilit i përkasin sistemet kompjuterike të përcaktuara për t'u sekuestruar. [..] (*GJEDNJ Smirnov v. Russia, App. no. 71362/01, 7.6.2007, GJEDNJ, Draghici v. Portugal, App. no.. 43620/10, datë 19.6.2014*).

[..] Së fundmi, por jo më pak e rëndësishmja, në vendimin e Gjykatës nuk duhet të mungojë parashikimi mbi modalitetet për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Edhe në përcaktimin e modaliteteve të sekuestrimit të të dhënave ose pajisjeve kompjuterike, Gjykata duhet të udhëhiqet nga parimi i proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë. Mënyra e sekuestrimit të të dhënave ose pajisjeve duhet të jetë e tillë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet specifikisht të përcaktuara në vendimin e Gjykatës. Duhet të mbahet në konsideratë që sekuestrimi i pajisjeve të bëhet në mënyrë të tillë që, personit të cilit do t'i sekuestrohen të dhënat apo pajisjet, të cenohet sa më pak e mundur. Për nxjerrjen e të dhënave mund të sekuestrohen pajisjet, vetëm në rast se është e domosdoshme. Nëse ka disa sisteme apo pajisje alternative që mund të sekuestrohen, duhet të përzgjidhen ato pajisje të cilat cenojnë më pak personin

tek i cili sekuestrohen këto të dhëna apo pajisje, duke mbajtur në konsideratë bërjen e kopjeve nga autoritetet, në mënyrë që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur procesi i sekuestrimit. Nëse sekuestrimi i pajisjeve është i domosdoshëm, ky të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave apo bërjen e kopjeve.

[..] Por, në mënyrë të veçantë, për shkak të ndjeshmërisë që paraqet, referuar dhe rastit objekt shqyrtimi, nga i cili Kolegji vlerësoi të kalojë në këtë vendimarrje njësuere, Kolegji çmon të nevojshme të ndalet pak më tepër në rastin kur sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike bëhet ndaj gazetarëve profesionistë. Kjo për faktin se liritë dhe të drejtat themelore, të cilat u evidentuan më lart, duhet të mbrohen në rastin kur është e nevojshme të procedohet me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike dhe janë liria e shprehjes, liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, të cilat mbrohen në të gjitha sistemet demokratike, bëhen më evidente dhe më të ndjeshme në rastin e gazetarëve profesionistë. Jurisprudenca kushtetuese dhe e GJEDNJ është shumë e pasur në këtë drejtim, duke sanksionuar me vendosmëri respektimin e këtyre të drejtave nga autoritetet shtetërore, nënshkruese të KEDNJ.

Sikundër u evidentua në pjesën hyrëse të këtij vendimi, në rastin specifik të gazetarëve profesionistë, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kërkon një vëmendje të veçantë, pasi përbën një rrezik të dukshëm për zbulimin e burimit të informacionit. Lidhur me rëndësinë e ruajtjes së burimit të informacionit, në çështjen *Goodëin v. The United Kindom, App. no. 17488/90, 27.3.1996*, GJEDNJ ka konkluduar se kërkesa e autoriteteve drejtuar gazetarëve për të zbuluar burimin e informacionit përbën shkelje të lirisë së shprehjes. Po ashtu, sipas GJEDNJ, në çështjen *Roemen e Schmit v. Luxembourg, App. no. 51772/99, 25.5.2003*, [..]

Në përputhje me këtë qëndrim të GJEDNJ, Kolegji vlerëson se, sikundër u aryetua më lart, përveç garancive të parashikuara lidhur me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, specifikisht lidhur me sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike ndaj gazetarëve profesionistë, Gjykata duhet të lejojë sekuestrimin, pasi të jetë shteruar kërkimi në të gjitha burimet e tjera të mundshme të të dhënave, duke pasur parasysh paragrafin 3 të nenit 159 të KPP, i cili parashikon lidhur me emrat e personave nga të cilët gazetarët profesionistë kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe vetëm kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, Gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij. Kjo do të thotë se ndërhyrje të tilla, duhet të jenë të mirëargumentuara dhe vetëm në rastet kur e dhëna nuk mund të merret në mënyrë tjetër.

Sa më sipër, lidhur me çështjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:

Së pari, duhet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme sipas nenit 208 KPP:

- iii. **Kjo do të thotë se sekuestrimi edhe në rastin e të dhënave kompjuterike, vendoset për provat materiale, kuptimi i të cilave jepet në nenin 187 të KPP dhe për sendet që lidhen me veprën penale.**

iv. Për sendet që lidhen me veprën penale, duhet të arsyetohet se edhe këto sende janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.

Së dyti, Gjykata duhet të argumentojë se cila është vepra penale që në mënyrë të arsyeshme dyshohet se është kryer.

Së treti, Gjykata duhet të arsyetojë përse sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes.

Së katërti, Gjykata duhet të përcaktojë ose të argumentojë se cilat janë të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestrës mbi të dhënat ose sistemet kompjuterike. Në këtë përcaktim Gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, duke lejuar sekuestrimin e të dhënave ose të sistemeve kompjuterike për nevoja të hetimit, vetëm nëse është e nevojshme, për sa është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme;

Së pesti, Gjykata duhet të përcaktojë dhe të arsyetojë në vendim modalitetet për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Edhe në këtë rast, Gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë. Sekuestrimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet specifikisht të përcaktuara në vendimin e gjykatës. Për nxjerrjen e të dhënave mund të sekuestrohen pajisjet, vetëm në rast se është e domosdosme dhe për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave apo krijimin e kopjeve;

Së gjashti, përveçse sa më sipër, specifikisht lidhur me sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike ndaj gazetarëve profesionistë, Gjykata duhet të lejojë sekuestrimin, pasi të jetë shteruar kërkimi në të gjitha burimet e tjera të mundshme të të dhënave, duke patur parasysh paragrafin 3 të nenit 159 të KPP. Kjo do të thotë se ndërhyrje të tilla, duhet të jenë të mirëargumentuara dhe vetëm në rastet kur e dhëna nuk mund të merret në burimin e saj. Në raste të tilla përjashtimore Gjykata duhet të saktësojë të dhënat konkrete që kërkohet të sekuestrohen, përse ato janë të domosdoshme/thelbësore për zgjidhjen e çështjes sipas nenit 211/2 të KPP, si dhe arsyet përse sekuestrimi i tyre është i pamundur të realizohet në një mënyrë tjetër. Në çdo rast Gjykata duhet të tregojë kujdes për moscenim të marrëdhënies së gazetarit me burimin e informacionit, duke shmangur zbulimin e këtij burimi kur vërtetësia e të dhënave mund të verifikohet në një mënyrë tjetër.

C. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

Kolegji evidenton se subjektet e interesuar, të cilët dispononin të dhënat kompjuterike objekt sekuestrimi të vendimeve të Prokurorisë së Posaçme dhe më pas të GJKKO, kanë kundërshtuar vendimin e kësaj gjykate me të cilin është vendosur sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në Gjykatën e Apelit [...].

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret objekt shqyrtimi, në përputhje me parashikimet e shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 420, sipas të [...] duke qenë se vendimet e sekuestrimit nuk janë ekzekutuar, në përputhje dhe me parashikimet e shkronjës “a”,

të pikës 1, të nenit 441 të KPP, duhet të vendoset mospranimi i rekursit.

KPGJL Vendim Njësues Nr.00-2022-1823(332), datë 15.12.2022 (Detyrueshmëria e mendimit të prokurorit/ndryshimit të qëndrimit kur s'është bërë ankim)

Në kushtet kur prokurori i çështjes nuk ka bërë ankim, atëherë ai e ka humbur mjetin procedural në bazë të së cilit mund të ndryshonte vendimmarrja e Gjykatës së Apelit, bazuar në shkaqet e pretenduara prej tij. Vendimmarrja e Gjykatës së Apelit mund të ndryshojë vetëm mbi ankimin e palës tjetër (personit nën hetim) dhe vetëm mbi shkaqet e pretenduara prej tij, çka do të thotë se edhe për këtë fakt mendimi i prokurorit nuk është i detyrueshëm për Gjykatën e Apelit që shqyrton çështjen. Nëse personi nën hetim do të hiqte dorë prej ankimit, Gjykata e Apelit do të vendoste mospranim ankimi sipas nenit 420 të KPP, vendimmarrje kjo që do t'i jepte fund shqyrtimit të çështjes pa një vendim në lidhje me themelin.

Fjalë kyçe: person nën hetim, masë sigurie, ankim, vendim i formës së prerë, mendim i prokurorit

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, të parashikuar nga neni 285/a i K.Penal në ngarkim të të dyshuarit, shtetasit E.C.. Sipas akteve të paraqitura rezultoi se nga ana e forcave të policisë në datën 5.10.2015 është ushtruar kontroll në ambientet e lokalit të natës [...] pasi dyshohej se në ambientet e brendshme të këtij lokali shpërndahej dhe konsumohej lëndë narkotike. [...] është konstatuar se në një nga dhomat e lokalit që shërbente për personelin është gjetur dhe sekuestruar një sasi lënde e cila ka rezultuar me peshë 1.8 gram dhe dyshohet se ishte lëndë narkotike e llojit kokainë. Po kështu dhe në tualetin e lokalit janë gjetur dy pjata në sipërfaqen e të cilave dyshohej se kishte mbetje të lëndëve narkotike e dyshuar e llojit kokainë dhe se këto pjata përdorshin për konsumim lënde narkotike.

Ndodhur në këto kushte, OPGJ Tiranë kanë bërë arrestimin në flagrancë të personit nën hetim E.C., në cilësinë e njërit nga bashkëpronarët e lokalit ku dyshohet se ishte konsumuar vepra penale e parashikuar nga neni 285/a i K.Penal si dhe kanë kryer veprime të tjera procedurale. Nisur nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e personit organi i prokurorisë ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi personal atë të “arrestit në burg me afat 40 ditë” të parashikuar nga neni 238 i KPP. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim E.C.. Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg me afat 20 ditë”, të parashikuar nga neni 238 i KPP për personin nën hetim [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur miratimin e vendimit nr. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[..] Në lidhje me themelin, Kolegji vlerëson të shprehet në lidhje me çështjen konkrete, e cila nuk ka më aktualitet, pasi referuar shkresës nr. 1384/1 prot., datë 05.03.2020, provohet se shtetasi E.C. është dënuar me vendimin e formës së prerë nr. 1705, datë 26.06.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dënimin alternativ “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit penal dhe vënia në provë” për një periudhë 18 muajsh. Në datën 28.02.2020 ky shtetas ka përfunduar vuajtjen e dënimit alternativ.

Nga ana tjetër, duke qenë se nga Kolegji Penal, me vendimin datë 09.03.2016, është vendosur vetëm kalimi i çështjes në seancë gjyqësore, pa u shtruar pyetje për njësim, Kolegji vlerëson të shprehet dhe të arsyetojë në lidhje me çështjen e ligjit që ka vlerë për rastin konkret, pa qenë e nevojshme që kjo të konsiderohet si vendimmarrje njësuere, marrë në konsideratë këtu që vendimet e Kolegjit Penal, njësuere ose jo janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta për qëndrimin e mbajtur për çështje konkrete.

Rezulton se, që nga marrja e vendimit datë 09.03.2016 për unifikim të praktikës gjyqësore, ka pasur ndryshime thelbësore kushtetuese dhe ligjore që prekin drejtëpërdrejtë çështjen penale objekt gjykimi. Sipas këtyre ndryshimeve rezulton se ka qenë vet ligjvënësi që e ka rregulluar situatën në lidhje me ndryshimin e qëndrimit të prokurorit në apel, kur ai nuk ka ushtruar të drejtë ankimi. Gjithashtu, Kolegji konstaton se në lidhje me këtë çështje nuk vërehen praktika të ndryshme midis gjykatave të faktit apo vet Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, shkak që sipas nenit 438 të KPP do të kërkonte vendimmarrje njësuere prej Kolegjit Penal. Për këto arsye dhe për arsyetimin që do të parashtrohet në vijim, Kolegji vlerëson se çështja nuk ka nevojë të rregullohet me vendimmarrje njësuere, për sa kohë është rregulluar vet nga ligjvënësi.

Gjatë fazës së studimit dhe shqyrtimit të kësaj çështje, Kolegji ka vënë re se ligji procedural penal është ndryshuar në mënyrë thelbësore me reformën e miratuar nga ligji nr. 35/2017, datë 30.03.2017, i cili ka ndryshuar një pjesë të konsiderueshme të dispozitave aktuale të KPP. Neni 24/5,6 i KPP, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017. parashikonte se: [..]

Me ndryshimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 35/2017, parashikimi i mësipërm është suprimuar, në reflektim edhe të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 6/2016, datë 22.7.2016. që parashikojnë se prokuroria është organ i pavarur dhe jo më një organ i centralizuar. [..] Në këtë kuptim, prokurori ka pavarësi profesionale dhe institucionale në ushtrimin e detyrës së tij. Ai ka qëndrimin e tij në lidhje me çështjen dhe vendimmarrja e tij nuk mund të ndryshohet apo shfuqizohet me vendim të një prokurori më të lartë. Me ndryshimet procedurale që ka pësuar neni 24 i KPP nuk ekziston më koncepti i prokurorit më të lartë dhe është suprimuar edhe e drejta e tij për të ndryshuar apo shfuqizuar vendimet e prokurorit që ushtron funksionin pranë një prokurorie të një shkallë më të ulët.

Në këto kushte, Kolegji çmon se nuk është më relevante nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore për shkak të ndryshimit të situatës kushtetuese dhe asaj ligjore që është rikonceptuar. Për këtë arsye, Kolegji Penal i investuar me shqyrtimin e kësaj çështjeje vendos të procedojë vetëm me shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga ana e prokurorisë duke

trajtuar edhe çështjen ligjore që ka rëndësi në situatën konkrete, ndërkohë që ai vlerëson se nuk është e nevojshme që kjo vendimmarrje të konsiderohet si njësuere. Kolegji vë në dukje se një praktikë të tillë është mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr. 1, datë 26.06.2017 dhe 30.06.2017, në të cilin janë shprehur [..]

Duke i'u rikthyer çështjes konkrete, Kolegji çmon se çështja që shtrohet për diskutim (pa pasur nevojë për njësim praktike) është: ***Kur ankimi ndaj vendimit për caktimin e një mase sigurimi është bërë vetëm nga ana e personit në hetim, a mund të konsiderohet se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i formë së prerë për prokurorin? Nëse po, çfarë roli ka mendimi që paraqet prokurori për gjykatën që shqyrton ankimin?***

Në lidhje me çështjen e parë se, [...] Kolegji vlerëson se është e rëndësishme të merret në vlerësim, së pari, faza procedurale ku ndodhet çështja objekt gjykimi. Në çështjen konkrete jemi në një çështje që i përket fazës së hetimeve paraprake, pasi ankimohet nga personi nën hetim vendimi i gjykatës së shkallës së parë që ka vleftësuar arrestin në flagrancë dhe ka caktuar masë sigurimi “arrest në burg”. Ndaj këtij vendimi prokurori i hetimeve paraprake nuk ka ushtruar ankim, pasi gjykata e shkallës së parë ka miratuar kërkesën e tij. Ankim ka ushtruar vetëm personi nën hetim. Gjykata e Apelit është vënë në lëvizje vetëm me ankimin e personit nën hetim. Ndërsa në apel, prokurori edhe pse nuk ka ushtruar ankim, ka kërkuar nga gjykata ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe caktimin e një mase më të butë sigurimi, konkretisht masën e sigurimit “detyrim për paraqitje”. Prokurori i apelit ka ndryshuar qëndrimin në raport me atë të prokurorit të shkallës së parë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të shkallës së parë. Duke i'u referuar kuadrit ligjor dhe atij kushtetues, Kolegji vlerëson se në kushtet kur nga organi i akuzës nuk është ushtruar ankim, atëherë kjo do të thotë që prokuroria si organ që përfaqëson akuzën ka qenë dakord me vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, kjo rezulton logjike edhe për shkak se gjykata e hetimeve paraprake ka miratuar kërkesën e prokurorisë si për vleftësimin e arrestit në flagrancë ashtu edhe për caktimin e masës së sigurimit.

Kolegji vë në dukje se mjeti procedural i parashikuar nga ligjvënësi për të kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë është ankimi, i cili rregullohet nga neni 407 e vijues i KPP. [...] Kolegji vlerëson se në kushtet kur prokurori nuk ushtron ankim, atëherë ai nuk ka mjet tjetër procedural për të kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar për masën e sigurimit duhet konsideruar si i formës së prerë për prokurorin që nuk ka ushtruar ankim. Ky vendim i shkallës së parë do të ndryshojë vetëm në rast se Gjykata e Apelit, e investuar me ankim të palës tjetër, do ta ndryshojë atë.

Gjykata e Apelit do e shqyrtojë çështjen vetëm bazuar në ankimin e personit nën hetim, për sa kohë mjeti procedural për të investuar Gjykatën e Apelit është ankimi. Gjithashtu për sa kohë gjykata më e lartë e shqyrton çështjen bazuar në shkaqet e ngritura në ankim, sipas nenit 425/1 të KPP [...] atëherë gjykimi në apel do të përqëndrohet në shkaqet e ankimit të ngritura në ankimin e personit nën hetim.

Në lidhje me çështjen e dytë, “[...] Kolegji vlerëson se në gjykimin në apel prokurori i

apelit ka të drejtë të japë mendimin e tij në lidhje me çështjen, pasi është palë ndërgjyqëse dhe ka të gjitha të drejtat procedurale. Megjithatë, ajo që vlen për diskutim është fakti se çfarë roli ka mendimi i prokurorit në gjykimin në apel. A është ai i tillë që të kushtëzojë vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, në kuptim të parashikimit të nenit 244/3 të KPP [...] Kolegji vlerëson se mendimi i prokurorit apo ndryshimi i qëndrimit të tij nuk është i detyrueshëm për Gjykatën e Apelit, në drejtim të disponimit në lidhje me çështjen. Kjo logjikë mendimi përforcohet edhe nga faza procedurale ku ndodhet çështja, në fazën e hetimeve paraprake dhe nga fakti se prokurori i hetimit ka ndjekur hetimin dhe i njeh nevojat e sigurimit, ndryshe nga prokurori i apelit që përfaqëson çështjen në apel për shkak të ligjit. Në kushtet kur prokurori i çështjes nuk ka bërë ankim, atëherë ai e ka humbur mjetin procedural në bazë të së cilit mund të ndryshonte vendimmarrja e Gjykatës së Apelit, bazuar në shkaqet e pretenduara prej tij. Vendimmarrja e Gjykatës së Apelit mund të ndryshojë vetëm mbi ankimin e palës tjetër (personit nën hetim) dhe vetëm mbi shkaqet e pretenduara prej tij, çka do të thotë se edhe për këtë fakt mendimi i prokurorit nuk është i detyrueshëm për Gjykatën e Apelit që shqyrton çështjen.

[...] Në kushtet kur Gjykata e Apelit është investuar me ankimin e personit nën hetim, atëherë objekt shqyrtimi në apel është ankimi i personit nën hetim. Ndryshimi i linjës së qëndrimit nga prokurori i apelit nuk është i detyrueshëm për këtë gjykatë dhe as duhet të kushtëzojë vendimmarrjen në lidhje me çështjen.

Kolegji vlerëson se argument tjetër në favor të këtij përfundimi është fakti se çfarë do të ndodhte nëse personi nën hetim heq dorë nga ankimi? Nëse ky do të hiqte dorë prej ankimit, Gjykata e Apelit do të vendoste mospranim ankimi sipas nenit 420 të KPP, vendimmarrje kjo që do t'i jepte fund shqyrtimit të çështjes pa një vendim në lidhje me themelin. Çështja në apel nuk mund të vazhdonte me mendimin me shkrim të prokurorit për sa kohë nuk përbën mjet procedural që investon gjykatën dhe që vazhdon gjykimin. Bazuar në këto argumente, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit është e drejtë, prandaj duhet lënë në fuqi.

Prokurori i apelit nuk mund të ndryshojë linjën e qëndrimit të prokurorit të shkallës së parë, prokurorit që është prokuror i hetimit paraprak dhe është ai që ka ndjekur hetimin e çështjes dhe njeh nevojat e sigurimit të çështjes. Nëse ai e bën një gjë të tillë, mendimi i tij nuk është detyrues dhe as kushtëzon vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit.

Duke i'u rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit është e drejtë prandaj nuk ka shkaqe për cenimin e saj. Gjithashtu, Kolegji çmon se i drejtë është arsyetimi i Gjykatës së Apelit dhe qëndrimi i mbajtur prej saj. [...]

Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit ka arsyetuar drejtë se përse qëndrimi i prokurorit për ndryshimin e masës së sigurimit nuk është i detyrueshëm për Gjykatën e Apelit, për sa kohë ai nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Mendimi me shkrim i Prokurorit të Apelit i paraqitur gjatë gjykimit, në përmbajtjen e tij nuk mund të njësohet me “mjetin juridik” të ankimit të Prokurorit të Apelit që parashikohet në KPP.

Nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë se rekursi është ushtruar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit që ka disponuar mbi masën e sigurimit personal të vendosur ndaj shtetasit E.C., masë sigurimi që është shuar për shkak se ai është dënuar me vendim

gjyqësor të formës së prerë, dënim i vuajtur përfundimisht prej tij, Kolegji vlerëson se çështja konkrete nuk ka më objekt.

Neni 420, pika 1, shkronja “d” i KPP [..]Në këto kushte, Kolegji vlerëson se në lidhje me rekursin duhet të vendoset mospranimi i tij.

KPGJL Vendim Nr.00-2022-1235 (261), datë 13.10.2022 (Llogaritje afat paraburgimi)

Periodha e afatit të paraburgimit të konsumuar gjatë fazës të trajtimit të çështjes para gjyqtarit të seancës paraprake, kur prej këtij të fundit është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq, konsiderohet pjesë e afatit të paraburgimit të fazës së gjykimit (në themel, në shkallë të parë) të çështjes.

Fjalë kyçe: arsyetim paqartë vendimi, afat paraburgimi, dërgim çështje në gjyq, seancë paraprake

Rrethanat e çështjes:

Më datë 11.02.2022, përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që gjykon çështjen me të pandehur të pandehurit/kërkuesit D.E., I.M., A.G., G.D, është paraqitur kërkesa me objekt : “Shuarjen e masës së sigurimit “arret me burg”, të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 289, datë 08.11.2019”.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, [..], ka vendosur rrëzimin e kërkesës së bërë nga kërkuesit [..]

Gjykata e Apelit Vlorë, [..] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] konstaton se kërkesa e kërkuesve [..] është depozituar gjatë momentit procedural në të cilin ata kanë qenë në gjykim në Gjykatën e shkallës së parë Vlorë, pra të pandehurit kanë qenë duke u gjykuar në themel për akuzat e ngritura nga prokuroria. Në pretendimet e tyre përfaqësuesit e të pandehurve pretendojnë se afatet e paraburgimit kanë kaluar përsa i përket fazës së regjistrimit të çështjes pranë Gjyqtarit të seancës paraprake dhe kalimit të çështjes në themel, të cilat nuk duhet të jenë mbi 12 muaj referuar veprave penale për të cilën akuzohen të pandehurit. Masa e sigurimit është një element procedural dinamik e cila mund të ndryshojë nga momenti i kërkimit deri në momentin e gjykimit duke e bërë që kërkimi i kërkuesve të ndryshoj ose të bjerë për shkak të ndryshimit të rrethanave.

Në pretendimet e tyre përfaqësuesit e të pandehurve pretendojnë se, për efekt të këtyre afateve prekluzive duhet të llogariteshin dhe afatet e gjykimit në seancën paraprake, pretendim të cilën Gjykata e Apelit Vlorë nuk e ka gjetur të drejtë. Kolegji vlerëson se ky pretendim i të kërkuesve/pandehurve, në interpretim të ligjit procedural dhe Vendimit Njësues nr. 00-2021-1134 (62), datë 01.11.2021, është i drejtë, por arsyetimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk është bërë në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë, pasi botimi i Vendimit Njësues në Fletoren Zyrtare Nr. 85, është bërë në datë 07.06.2022,

pra pas vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, bazuar në nenin 441/2 të KPP.

Por, referuar nenit 438 të KKP [...] Gjykata e Apelit Vlorë duhet të ketë qenë në dijeni për argumentet që Kolegji penal i Gjykatës së Lartë ka ngritur për diskutim në vendimin njëses, fakt të cilin e përmëdin dhe palët në pretendimet e tyre.

Në vendimin njëses nr. 00-2021-1134 (62), datë 01.11.2021, Gjykata e Lartë ka arritur në konkluzionin se: ... [...]

Bazuar sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave të faktit, përsa i përket përlogaritjes të afatit të paraburgimit të konsumuar prej të pandehurve [...] nga faktet e pranuar nga gjykatat, është i gabuar. Një tjetër pretendim i rekursuesve e bën vendimin e Gjykatës së Apelit, Vlorë të cënueshëm, përsa i përket datës në të cilën çështja është regjistruar në gjykimin e themelit. Detyrimi i gjyqtarit të seancës paraprahe është që çështja duhet të përfundojë brënda afatit 30 ditor. Nga aktet nuk rezulton se kur është marrë ky vendim, por përmendet data 26.01.2021, ku gjyqtari i seancës paraprahe ka pranuar kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim. Ndërkohë, Gjykata e Apelit pranon, referuar akteve, se çështja në themel është regjistruar më datë 07.07.2021, pas një periudhe prej 6 (muajsh), ndërkohë që përfaqësuesit e të pandehurve pretendojnë se gjykimi ka filluar më datë 23.02.2021, por për shkaqe të dorheqjeve të gjyqtarëve (sipas proces verbaleve të ndodhura në dosje) pjesmarrës në gjykim, përveç trupës aktuale, kanë qenë dhe gjyqtarë të tjerë të cilët nga aktet nuk del pse nuk janë më pjesë e trupës gjyquese.

Kolegji vlerëson se këto momente të arsyetimit dhe të pretendimit të palëve janë të paqarta për dhënien e zgjidhjes së duhur të çështjes dhe nga ana e gjykatave të faktit që vënë në diskutim pretendimet e kërkuësve nuk arrihet të shpjegohet kjo periudhë e gjatë kohore mes vendimit të dërgimit të çështjes për gjykim dhe regjistrimit në themel të çështjes, kur dihet që seanca paraprahe karakterizohet nga një gjykim i shpejtë dhe dorëzim i vendimit të arsyetuar brënda 10 ditëve. Regjistrimi i çështjes dhe fillimi i shqyrtimit të çështjes janë dy momente të ndryshme. Gjykata e themelit, në momentin që çështja regjistrohet pranë saj, bëhet kompetente për disponimin e kërkesave në lidhje me atë procedim, pasi dhe vetë vendimmarrja e gjykatës së seancës paraprahe referohet në dërgimin e akteve gjykatës së themelit dhe çdo veprim procedural për caktimin e seancës së parë gjyqësore dhe njoftimin e palëve fillon nga dita e depozitimit të kërkesës nga prokuroria që do të thotë nga data e regjistrimit të çështjes për gjykim. Kjo për faktin se, gjyqtari i seancës paraprahe me dhënien e vendimit përfundimtar humb kompetencën lëndore mbi çështjen konkrete.

Juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë, nënkupton shqyrtimin e rekurseve për shkelje të ligjit material dhe procedural, duke siguruar zbatimin uniform të ligjit apo zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ligji nuk i jep Gjykatës së Lartë asnjë kompetencë për të shqyrtuar elementet materiale dhe faktike të ngjarjeve të hetuara, përfshirë nivelin e provave që mbështesin dyshimin e arsyeshëm apo elementet që lidhen me vlerësimin e nevojave të sigurimit si dhe plotësimin e kriterëve për shuarjen e masës së sigurimit në rastin konkret.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, shqyrtimi i fakteve dhe i provave/akteve edhe në këtë rast, del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë dhe për këtë

arsye, në lidhje me kushtet e kërkuara nga nenet 261, 263 dhe 266 të KPP, nuk mund të verifikohen në Gjykatën e Lartë, si gjykatë ligji, por duhen verifikuar në gjykatat e faktit. Ky diskutim lind pasi shqyrtimi i kushteve për shuarjen apo caktimin e masave të sigurimit, siç mund të jetë ekzistenca në vijim e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova ose/dhe shqyrtimi i kriterëve si përshtatshmëria e masës së sigurimit apo analiza e proporcionalitetit, kërkon domosdoshmërisht edhe çmuarjen e provave/akteve të përfshira në fashikull, vlerësimin e rrethanave të faktit dhe të nevojave të sigurimit, vlerësim të personalitetit të të hetuarit/dyshuarit, vlerësim të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të dyshuar të saj.

Kolegji vlerëson të drejtë pretendimin e të pandehurve se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk është i mirëargumentuar dhe është i paqartë. Kolegji sjell në vëmendje se, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 7, datë 09.03.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). [...] (*shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 20, datë 13.04.2012; nr 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

Njëkohësisht, referuar dhe faktit se në dosje ka shumë mangësi në paraqitjen e dokumentacionit për të bërë një vlerësim më të qartë të gjëndjes së ecurisë së gjykimit dhe pamundësinë faktike të korigjimit të këtij vlerësimi të gabuar të ligjit, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 134, datë 27.04.2022, që ka vendosur “*Lënien në fuqi të vendimit [...] duhet të priset duke u kthyer çështja për rishqyrtim pranë asaj gjykate si gjykata kompetente me tjetër trup gjykues*. Kolegji vlerëson se kufizimi në këtë rast është i lidhur me pamundësinë e Gjykatës së Lartë për të konstatuar shuarjen e masës së sigurimit apo caktimin e një mase më të përshtatshme të sigurimit, qoftë në favor apo kundër të pandehurve. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga kërkuesit [...] kundër vendimit [...], të Gjykatës së Apelit Vlorë duhet të pranohet, përse i përket interpretimit të gabuar të bërë nga Gjykata e Apelit Vlorë në lidhje me interpretimin se kujt faze procedurale i përkasin afatet e paraburgimit dhe arsytimit të paqartë të vendimit e pretendimeve të palëve, duke plotësuar kushtet që parashikohen në nenin 432 të KPP.

KPGJL Vendim Nr.00-2023-1313(224), datë 25.07.2023 (Arrest burg:

përkatësi minoriteti)

Pushteti që ligjërisht mban funksioni i të zgjedhurit vendor është i tillë që krijon mundësi praktike të paligjshme për të ndikuar tek dëshmitarët potencialë të faktit penal dhe gjithashtu edhe tek subjekte të tjerë privatë apo publikë për të penguar apo për të kryer veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës. Të qenurit përfaqësues i një minoriteti, sikundër pretendohet, nuk mund të përligjë dhe të institucionalizojë shkeljen e ligjit dhe kryerjen e veprimeve kriminale.

Fjalë kyçe: kompetencë lëndore dhe tokësore, prokuroria jocompetente, arrest burg, minoritet, veprime simuluese, pavlefshmëri përgjimi, funksionar publik

Rrethanat e çështjes:

Pranë GJKKO, në datë 29.5.2023, është paraqitur për gjykim kërkesa e Prokurorisë së Posaçme, me objekt verifikimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jocompetente.

Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të gjykimit rezulton se Gjkata e Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë me vendimin nr. 205, datë 13.5.2023, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë datë 12.5.2023, të personit nën hetim Dh.B;Kaktimin ndaj personit nën hetim [...]masën e sigurimit personal shtrëngues “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i KPP.; Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë datë 12.05.2023, të personit nën hetim P.K. Caktimin ndaj personit nën hetim masën e sigurimit personal shtrëngues atë të “arrestit në burg”, parashikuar nga [...]. Deklarimin e moskompetencës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për gjykimin e çështjes penale [...]Dërgimin e akteve të çështjes penale [...]të GJKKO, si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore.

[...]Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë më datë 8.5.2023 ka regjistruar Procedimin Penal me nr. 489, viti 2023 lidhur me veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të K.Penal. Më datë 8.5.2023 OPGJ kanë referuar tek prokurori në Prokurorinë [...] ndër të tjera mbi aktivitetin kriminal të disa shtetasve në fushën e shitblerjes së votës për zgjedhjet vendore në Shqipëri të 14 Majit 2023. Sipas informacioneve të marra dhe vërtetuara në rrugë operative nga policia gjyqësore, ka rezultuar se disa shtetas në territorin e Bashkisë Himarë merren me aktivitet kriminal në fushën e krimeve zgjedhore dhe më konkretisht me shitblerjen e votës, duke u premtuar qytetarëve të ndryshëm ofrimin e shumave të caktuara në të holla kundrejt dhënies së votës.

Nga shërbimet e policisë gjyqësore është referuar se në këtë aktivitet të shitblerjes së votave janë të përfshirë shtetasit Dh.B. kandidati i subjektit zgjedhor “Bashkë Fitojmë” për kryetar të Bashkisë Himarë, [...]Në informacion referohet se, nga të dhënat që disponohen, rezulton se këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin kundrejt përfitimeve materiale të marra nga kandidati për kryetar bashkie marrin shuma me vlera monetare nga ky i fundit dhe i shpërndajnë ato kundrejt premtimit nga shtetas të

ndryshëm në Njësinë Administrative Hore – Vranisht dhe fshatrave që përmbledh kjo njësi administrative. Ndër të tjera në këtë informacion referohet se kandidati në datën 5.5.2023, rreth mesditës, në qytetin e Himarës, tek ambientet e parkimit [...], i ka dhënë shumën prej 50 Euro kundrejt votës pro tij shtetasit E.K. [...]

Nga aktet rezulton se një nga burimet e informacionit të policisë gjyqësore është A.R. Rezulton se në kërkesën për kryerjen e veprimeve simuluese të policisë gjyqësore drejtuar prokurorit identifikohet se burimi i informacionit është shtetasi në fjalë. [...] Për këtë qëllim rezulton se më datë 8.5.2023 midis prokurorëve të [...] dhe A.R. është nënshkruar akti i titulluar “Marrëveshje”.

[...] Rezulton se në datën 12.05.2023, në orën 00:14 është mbajtur “Procesverbal për kapjen ne fragrance” të shtetasit Dh.B. nga tre oficerë të policisë gjyqësore. Rezulton se në këtë datë, 24 minuta më vonë, në orën 00:38 është mbajtur “Procesverbali për kapjen ne fragrance” i P.K. nga tre oficerë të policisë gjyqësore. Më datë 12.05.2023, ora 09:45 është arrestuar në flagrancë shtetasi Dh.B. si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” në bashkëpunim parashikuar nga nenet 328 dhe 25 i K.Penal (procesverbal për arrestimin në flagrancë). Ndërsa po më datë 12.05.2023, ora 08:30 është arrestuar në flagrancë shtetasi P.K. si i dyshuar lidhur me veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje në bashkëpunim parashikuar nga neni 328 dhe 25 i K.Penal (procesverbal për arrestimin në flagrancë).

Arrestimi i të dyshuarve me vendimin nr. 205, datë 13.5.2023, është vleftësuar i ligjshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë, e cila ka caktuar ndaj secilit prej tyre masën e sigurimit personal “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i KPP. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar ndër të tjera se arrestimi në flagrancë është i ligjshëm, pasi secili prej personave nën hetim është arrestuar menjëherë pas kryerjes së veprës penale. Ndërkohë, lidhur me caktimin e masës së sigurimit, gjykata ka arsyetuar se duhet të mbahet parasysh fakti se Dh.B. ka qenë i dënues më parë, se vepra penale për të cilën ka dyshime të arsyeshme se ekziston, parashikon vetëm dënim me burgim nga 1 deri në 5 vjet, duke konkluduar mbi proporcionalitetin e masës së sigurimit arrest në burg, sipas nenit 230 të KPP.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, [...]ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i KPP caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 205, datë 13.5.2023, ndaj personave nën hetim [...]të dyshuar lidhur me veprën penale [...]

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, [...] ka vendosur miratimin e Vendimit nr. 46, datë 22.05.2023, të GJKKP me ndryshimin si vijon: Caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndaj personit nën hetim P.K. sipas nenit 234 të KPP. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] pasi shqyrtoi në themel pretendimet e paraqitura në rekurs, shqyrtoi Vendimet e gjykatave të faktit dhe aktet procedurale të fashikujve të masave të sigurimit,

vlerëson se vendimi i gjykatës së posaçme të apelit, objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë nuk duhet të cenohet, por duhet lënë në fuqi. Kolegji, referuar rekurseve të paraqitur, konstaton se nga ana e rekursuesve/personave nën hetim janë paraqitur një sërë argumentesh me natyrë ligjore, nëpërmjet të cilave kundërshtohen vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, të cilat meritojnë vëmendjen e Kolegjit, për analizimin dhe zgjidhjen e problematikave ligjore të referuara në rekurse.

Së pari, nga ana e mbrojtjes në rekurs është pretenduar se veprimet e kryera nga organi i akuzës janë absolutisht të pavlefshme, duke qenë se janë autorizuar nga prokuroria jokompetente e për rrjedhojë të vesuara nga nuliteti i tyre. Lidhur me këtë pretendim, rezulton se gjykata e posaçme e apelit ka arsyetuar ligjshmërinë e veprimeve hetimore. Nga shqyrtimi i rekurseve të paraqitur, Kolegji konstaton se pretendimet e parashtruara në rekurs lidhen me vendimin e gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar për vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj personit nën hetim [...] Personat nën hetim pretendojnë se nuk janë kushtet për caktimin ndaj tyre të një mase sigurimi. [...]

Si një nga shkaqet kryesore të rekursit nga ana e mbrojtjes së personave nën hetim është paraqitur se hetimi paraprak si rrjedhojë e të cilit është kryer arrestimi në flagrancë dhe më tej është caktuar masa e sigurimit, është kryer nga një prokurori jokompetente, për pasojë aktet janë të pavlefshme. Sipas rekursuesve ky pretendim i mbrojtjes nuk gjen përgjigje në vendimin e gjykatës së apelit.

Në verifikim të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se Gjykata e Apelit të Posaçëm e ka shqyrtuar këtë pretendim si shkak ankimi dhe i ka dhënë përgjigje të argumentuar sipas së cilës, parashtrimet dhe kërkimet për nulitetin absolut të veprimeve hetimore, sipas nenit 128/a të KPP, të kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë [...], pasi sipas nenit 75/a të këtij Kodi vepra penale e parashikuar në nenin 328 të K.Penal është jashtë kompetencës lëndore, janë haptazi të pabazuara në ligj dhe duhet të rrëzohen. Nenet 28 dhe neni 29 i KPP kanë parashikuar eventualitetin e kryerjes së veprimeve hetimore nga një prokurori që i mungon kompetenca lëndore dhe tokësore eventualisht, derisa prokuroria konkrete vlerëson se duhet të shpallet mungesa e kompetencës dhe për rrjedhojë aktet t'i kalojnë prokurorisë kompetente.

Secila nga dispozitat e sjella në vëmendje më lart në pikën 4 të tyre parashikojnë se aktet e hetimit paraprak të kryera nga prokuroria jokompetente janë për përdorshme dhe për rrjedhojë edhe të vlefshme. Kolegji vlerëson se ky arsyetim i Gjykatës së Apelit është në interpretim të drejtë të ligjit procedural penal. Vlerësimi i gjendjes së ngutshme të kryerjes së veprimit procedural penal bëhet nga Prokuroria që regjistron procedimin. Vlerësimi i kompetencës në kryerjen e veprimit hetimor është një proces që evoluon nga faza e parë e veprimeve të para hetimore e në vijim kur ai nuk është një vlerësim qartazi i dukshëm në momentet e para hetimore.

Kolegji konstaton se Gjykata e Posaçme e Apelit ka evidentuar normimin e neneve 28 dhe 29 të KPP, të cilët parashikojnë eventualitetin e kryerjes së veprimeve hetimore nga një prokurori që i mungon kompetenca lëndore dhe tokësore eventualisht, derisa prokuroria konkrete vlerëson se duhet të shpallet mungesa e kompetencës dhe për

rrjedhojë aktet t'i kalojnë prokurorisë kompetente. Secila nga dispozitat e sjella në vëmendje më lart në pikën 4 parashikon se aktet e hetimit paraprak të kryera nga prokuroria jokompetente janë të përdorshme dhe për rrjedhojë edhe të vlefshme. Konkretisht në pikën 4, të nenit 28, të KPP, parashikohet se, [..]

Në këto dispozita ligjvënësi ka parashikuar qartë se veprimet hetimore të kryera para kalimit ose caktimit të bërë sipas paragrafit 1 dhe 2, janë të vlefshme dhe mund të përdoren në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji. Në rastin konkret nuk konstatohet shkelje e ligjit nga ana e organit procedues lidhur me këtë aspekt. Në pikën 1, të nenit 28, të KPP, parashikohet se: [..]

Ndryshe nga sa pretendohet në rekurse, rezulton se ka ekzistuar rrethana e ngutshmërisë në këtë rast, e cila lidhet me faktin se afati për hetimin e krimit zgjedhor të dyshuar nga prokuroria është i shkurtër, referuar datës së afërt të zgjedhjeve; faktit se hetimi proaktiv nga natyra e tij është dinamik dhe nuk lejon pritjen e kryerjes nga prokurora tjetër (ku duhet së pari që drejtuesi i prokurorisë së posaçme të njihet me aktet dhe të vlerësojë nëse i pranon aktet, apo ia ridërgon prokurorisë tjetër) dhe për më tepër kalimi i akteve vetëm me kallëzim të një shtetasi nuk është mjaftueshëm për të invokuar prokurorinë tjetër kompetente.

Me krijimin e dyshimit për ekzistencën e një fakti penalisht të ndëshkueshëm, dyshim ky i krijuar pas kryerjes së hetimit proaktiv me veprimet simuluese, përgjimet ambientale dhe veprimet hetimore të paraqitura në rrethanat e çështjes, prokuroria që ka nisur hetimet ka qenë në gjendje të konkludojë se ka dyshime për ekzistencën e një veprë penale, për të cilën nuk është kompetente dhe, bazuar në ligj, ka proceduar me kalimin e akteve prokurorisë pranë gjykatës kompetente. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet që lidhen me nulitetin e akteve të kryera nga prokuroria jokompetente, referuar argumenteve të parashtruar në rekurs, nuk janë të bazuar.

Edhe arsyetimi i Gjykatës së Apelit të Posaçëm në lidhje me pretendimin për pavlefshmëri të veprimeve të përgjimit, se ndaj vendimit që pranon përgjimin mundet të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga i interesuari që ka ardhur në dijeni të përgjimit, për shkeljen e nenit 221 të këtij Kodi, është në interpretim të drejtë të nenit 222/a, të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Apelit ka argumentuar se nuk ka patur një ankim të tillë nga personat nën hetim dhe se në këto kushte Gjykata e hetimit paraprak nuk mundet të bëjë jashtë kësaj procedure objekt shqyrtimi gjyqësor vlefshmërinë e aktit procedural të prokurorit për autorizimin për përgjim dhe më tej nuk mundet që për shkeljet eventuale të nenit 221 të KPP, të konkludojë mbi papërdorshmërinë e provave të përfuara përmes këtij mjeti për kërkimin e provës.

Në vijim të këtij vlerësimi, pretendimi se bazuar në nenin 432/1 germa "b" i KPP vendimi i ankimuar mbështetet në prova të papërdorshme, të marra nga veprime absolutisht të pavlefshme të prokurorisë, pasi çdo veprim i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Vlorë i kryer pas regjistrimit të procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 328i KP, është i pavlefshëm, pasi kompetenca për hetimin e kësaj veprë penale i është përcaktuar në mënyrë ekskluzive prokurorisë së posaçme, nuk gjendet i bazuar nga ana e këtij Kolegji. Lidhur në vijim me kushtet për caktimin

e masave të sigurimit personal, këto kushte janë përcaktuar në nenin 228 të KPP. Sipas parashikimeve të këtij neni, që të mund të caktohet nga ana e Gjykatës një masë sigurimi, duhet që të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, që personi nën hetim e ka kryer veprën penale (pika 1 e nenit 228 të KPP); duhet që të mos jemi në rastet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale, ose dënimit (pika 2 e nenit 228 të KPP), si dhe mjafton ekzistenca e vetëm njërit prej kritereve alternative të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 228 të KPP.

Dyshimi i arsyeshëm parashikohet në pikën 1 të nenit 228 të KPP, [...] Koncepti “*dyshimi i arsyeshëm*” nënkupton ekzistencën e provave, të elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit, të cilat i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë, që personi nën hetim të ketë kryer veprën penale për të cilën ai akuzohet. Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e personit nën hetim, lidhur me akuzën për të cilën procedohet. Kolegjet e Bashkuara në Vendimin Unifikues nr. 7/2011, kanë konkluduar se: [...] Pra, vlerësimi mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në fazën e caktimit të masave të sigurimit apo të marrjes në pyetje për verifikimin e kushteve dhe të kritereve të caktimit të masës dhe nevojave të sigurimit, është një vlerësim, i cili zbatohet një standard me shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie më të ulët se ai i nevojshëm për përcaktimin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të përgjegjësisë penale ndaj të pandehurit, vlerësim ky që i përket gjykimit të çështjes në themel. Në rastin konkret, rezulton se mbrojtja ka parashtruar në rekurs në mënyrë të detajuar arsyet se përse provat të cilat kanë shërbyer për krijimin nga organi i akuzës së dyshimit të arsyeshëm për kryerjen nga ana e personave nën hetim të veprës penale, janë të pavlefshme. Mbrojtja ka paraqitur pretendime lidhur me mospërputhje të deklarimeve të bashkëpunëtorit të policisë, faktin se në procesverbale nuk disponohet orari i mbajtjes së tyre, faktin se bashkëpunëtori i policisë ka qenë provokator etj.

Lidhur me këto pretendime, rezulton se Gjykata e Posaçme e Apelit ka arsyetuar gjithashtu në mënyrë të detajuar mbi pabazueshmërinë e tyre, duke konkluduar se[...] Kolegji çmon se referuar rrethanave të çështjes, megjithë pretendimet e mbrojtjes, nuk arrin të zhbëhet dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova (në përgjimet ambientale) që kanë të bëjnë me premtimin për pagesë të zgjedhësve nga personi nën hetim Beleri dhe ekzekutimi i këtij premtimi nga personi tjetër nën hetim Kokaveshi. Në stadin aktual nuk rezulton që pretendimet e rekursuesve të zhbëjnë dyshimin e arsyeshëm ndaj tyre për kryerjen e veprës penale për të cilën dyshohen. Theksohet se kjo fazë e procesit bazohet në një standard provueshmërie më të ulët se ai përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, karakteristikë e shqyrtimit të çështjes në themel. Në gjykimin në themel, të gjitha provat do t'i nënshtrohen vlerësimit gjyqësor dhe do të konkludohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për vlefshmërinë e tyre dhe për rrjedhojë në përdorimin e të dhënave të përfuara prej tyre. Regjistrimet kanë ndodhur në një kohë, e cila është e përcaktueshme (janë kryer me aparatura elektronike) dhe në bazë të së cilës do të vlerësohet vlefshmëria e tyre, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Gjithashtu, pretendimet për kontradiktoritetin e të dhënave të përfuara nga

deklarimet, apo kallëzimi i personit të autorizuar, apo e kaluara e tij, nuk arrijnë ta zhbëjnë dyshimin e bazuar mbi kryerjen e veprës penale nga të hetuarit. Po ashtu, Gjykata e Posaçme e Apelit ka argumentuar drejt se, sipas të dhënave të deritanishme, veprimet e personit të autorizuar nuk vesohen nga provokimi, i parashikuar në pikën 3, të nenit 294/a, të KPP. Në paragrafin e tretë të nenit 294/a, parashikohet se nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret. Në rastin konkret objekt shqyrtimi, Gjykata e Posaçme e Apelit ka argumentuar se organet hetimore kanë marrë dijeni për kryerjen e aktit kriminal nga kallëzimi i personit të autorizuar. Pra, ka të dhëna se akti kriminal dyshohet se kryhej prej të hetuarve edhe pa ndërhyrjen e policisë. Nga ana tjetër, të dhënat e bazuara të cilat të krijojnë dyshimin e arsyeshëm (ende jo përtej çdo dyshimi) për kryerjen nga të hetuarit të aktit të dyshuar si kriminal nuk bazohen në faktin se personi i autorizuar ka telefonuar më shpesh të dyshuarit, por mbi veprimin e të dyshuarve të cilët, sipas të dhënave që rezultojnë deri në atë moment të hetimeve (ende të pavërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm) i dhanë para (nuk ka rëndësi nëse u thanë në “euro”, por më pas janë dhënë në “lek”) personit të autorizuar nga prokuroria (pavarësisht nëse ky ndërmjetës ishte votues i të njësisë administrative me zgjedhësit për të cilët dyshohet se mori para), në këmbim të votës së zgjedhësve të tjerë (nuk ka rëndësi përcaktimi i numrit të saktë të tyre për konstatimin e ekzistencës (në kuadër të dyshimit) së anës objektive të veprës penale të parashikuar në nenin 328, të KPP, pasi mjafton dhe një i vetëm për verifikimin e anës objektive të kësaj vepre penale, ndërkohë që numri i tyre mund t'i shërbejë përcaktimit të rëndësisë së faktit dhe rrezikshmërisë së autorit) për kandidatin në zgjedhje, Z. Beleri.

Ky është thelbi i faktit penal të dyshuar se është kryer nga të hetuarit dhe argumentet e sjellë nga mbrojtja, sipas të dhënave deri në atë moment të hetimit nuk arrijnë të zhbëjnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, lidhur me këtë fakt. Sa i përket kushtit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 228, të KPP, sipas të cilit[.]rezulton se Gjykata e Apelit, duke arsyetuar mbi mungesën e shkaqeve që përjashtojnë zbatimin e masës së sigurimit personal për shkak të shuarjes së veprës penale ose dënimit, ka konstatuar plotësimin e këtij kushti, për të cilin, për më tepër konstatohet të mos ketë pretendime në rekurset e paraqitur nga personat nën hetim. Lidhur me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të nenit 228 të KPP, kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni janë alternative. Pra, për të konkluduar në nevojën e vendosjen e masës së sigurimit, mjafton ekzistenca e vetëm njërit prej kriterëve alternative të parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 228 të KPP, përveç ekzistencës së kriterëve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 228 të KPP.

Në rastin konkret, Gjykata e Posaçme e Apelit ka arsyetuar në mënyrë të detajuar ekzistencën e kushteve të parashikuar në nenin 228, pika 3, të KPP, duke konkluduar në ekzistencën në rastin konkret të të tre kushteve të parashikuar në këtë dispozitë. Rezulton se mbrojtja nuk pajtohet me arsyetimin e gjykatës së apelit, duke pretenduar se gjykata ka shkelur parashikimet e nenit 425 të KPP, duke bërë një rëndim të pozitës

së ankuesve (në mungesë të një ankimi nga organi i akuzës) dhe duke shtuar argumente, të cilat nuk i ka evidentuar gjykata e shkallës së parë. Përkundrejt këtyre argumenteve, Kolegji çmon se nuk janë të bazuar dhe se duhet evidentuar parashikimi i pikës 6, të nenit 249, të KPP, të titulluar “Ankimi kundër masave të sigurimit”, sipas të cilës: [..]

Pra, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është pengues për gjykatën e apelit. Sigurisht që në rastin kur ankimi bëhet vetëm nga personi nën hetim, gjykata e apelit nuk mund të rëndojë masën e sigurimit, por nuk ka një limit lidhur me pjesën arsyetuese të vendimmarrjes së saj. Për më tepër që në rastin konkret edhe gjykata e shkallës së parë kishte konkluduar në ekzistencën e të tre kushteve të parashikuara në pikën 3, të nenit 228, të KPP. Pra, nuk konstatohet në rastin konkret shkelje nga gjykata e apelit të parashikimeve të nenit 425, të KPP, duke u çmuar nga Kolegji i pabazuar edhe ky pretendim i mbrojtjes së personave nën hetim. Sa i takon në vijim argumentimit konkret të vendosur në bazë të vendimmarrjes nga gjykata e apelit për ekzistencën e rrezikut të largimit, e lidhur dhe me cenimim sipas mbrojtjes të së drejtës së shqyrtimit të çështjes në kontradiktoritet mes palëve, rezulton se mbrojtja parashtron argumentet e saj lidhur me rrezikun e largimit të personit nën hetim Beleri, qoftë në komponentin e pamundësisë së mbrojtjes që të avancojë pretendimet e saj lidhur me disponueshmërinë ndaj hetimit të këtij të hetuari, e lidhur kjo me qëndrimin e tij ndaj një procedimi të mëpasshëm të regjistruar nga prokuroria e posaçme në vitin 2019, të pushuar me kërkesë të prokurorisë nga gjykata e posaçme në vitin 2021, ku dënimi i rrezikuar ka qenë shumë herë më i madh se tre vjetët e vendimit të vitit 2009, apo dhe sa i përket inklinimit të tij për të kryer vepra të tjera penale, të lidhura me faktin se ai ka qenë i dënuar më parë. Ndryshe nga sa pretendon mbrojtja në rekurs, Gjykata e Posaçme e Apelit ka evidentuar se në dosje ekziston dëshmia e penaltetit të këtij të hetuari, ku ai rezulton “i dënuar” (dokumenti i administruar në dosje).

Kolegji vlerëson se fakti i evidentuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta në rrethanat e çështjes për shmangien e të hetuarit nga kryerja e dënimit penal të dhënë ndaj tij me vendimin nr. 302, datë 18.7.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit nr. 509, datë 26.12.2006, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale “Thirrja për urrejtje nacionale” dhe “Poshtërim i Republikës dhe i simboleve të saj, vepra penale të parashikuara përkatësisht nga nenet 266 dhe 25 dhe nenet 268 dhe 25 të K.Penal, duke e dënuar në bashkimin e dënimeve me masën 3 vjet burgim, ndryshe nga paraqitja në një proces (ai i vitit 2019, i konkluduar me vendim pushimi), ku nuk rezulton të ketë pasur asnjë pasojë, apo penalizim lidhur me personin nën hetim, nuk mund të qëndrojnë në një balancë dhe të argumentojnë se i hetuari nuk paraqet rrezik për t’iu shmangur hetimit apo se nuk ka rrezik të kryejë veprat të tjera më të rënda apo të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. Gjithashtu, fakti se i hetuari po kandidon për Bashkinë e Himarës, nuk e zhbën këtë rrezik, për më tepër kur kandidati nuk ka arritur të konstituohet si kryetar i kësaj njësie vendore.

Edhe sa i përket pretendimeve për rehabilitimin e të hetuarit Beleri lidhur me dënimin e sipërpërmendur, të caktuar ndaj tij nga gjykata dhe të paekzekutuar, Kolegji çmon se nuk është i bazuar. Në shkronjën “b”, të nenin 69 të Kodit Penal parashikohet se: [..]Nga interpretimi literal i dispozitës rezulton se ligjvënësi, duke përdorur fjalën “vuajtjes” dhe

duke parashikuar si moment të fillimit të afatit të kërkuar për rehabilitimin e personit të dënuar “ditën e vuajtjes së dënimit”, qartazi kërkon që dënimi të jetë vuajtur dhe brenda një afati të caktuar (në rastin konkret pesë vjeçar) nga dita e vuajtjes së dënimit, i dënuari të mos ketë kryer veprë tjetër penale. Pra, ndryshe nga sa pretendon mbrojtja e Dh.B., arsyetimi i bërë nga Gjykata e Apelit lidhur me këtë pretendim të mbrojtjes, është marrë në interpretim të drejtë të ligjit. Nga ana tjetër, edhe sikur të marrim të mirëqenë pretendimin e mbrojtjes së, e cila e lidh momentin e fillimit të afatit 5 vjeçar të nevojshëm për rehabilitimin e të dënuarit me kalimin e afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, sërish Kolegji çmon se edhe në një eventualitet të tillë, sërish pretendimi i mbrojtjes për mos t’u marrë në konsideratë nga gjykata e hetimit paraprak në caktimin e masës së sigurimit personal, fakti i shmangies nga dënimi i mëparshëm penal i caktuar ndaj tij, është i pabazuar. Vërtet në një eventualitet të tillë, Dh.B. do të quhej i padënuar, por sjellja e tij e mëparshme nuk mund të mos merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit të sjelljes së tij dhe vlerësimit të rrezikut të largimit. Është fakt i pamohueshëm që Dh.B. i është shmangur dënimit me burgim sipas evidentimit në rrethanat e çështjes dhe, ky fakt është tregues i rëndësishëm në funksion të ekzistencës së rrezikut që ai të largohet.

Në praktikën Njësuere të Gjykatës së Lartë në Vendimin nr. Nr. 00-2022- 1036 Vendimi (114) është theksuar se: [..]

Kolegji çmon se edhe në çështjen në shqyrtim me objekt caktimin e masës së sigurimit, sjellja e mëparshme e Dh.B. nuk mund të mos merret në konsideratë nga gjykata në kuadër të çmuarjes së rrezikut të largimit, apo dhe të kryerjes së veprave penale. Me të drejtë Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ka arsye të bazuara të cilat të çojnë në përfundimin e arsyeshëm se Dh.B. paraqet rrezik për t’u larguar, ashtu edhe për të kryer krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet, pasi rezulton sipas rrethanave të çështjes se ai i është shmangur dënimit penal të caktuar ndaj tij më parë nga gjykatat për veprat penale për të cilat është dënuar “Thirrja për urrejtje nacionale” dhe “Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj”, çka tregon se personi nën hetim Beleri ka një prirje dhe paraqet rrezik jo vetëm për t’u larguar, por edhe për të kryer krime të rënda, ose të të njëjtit lloj, me atë për të cilin procedohet.

Përpos sa më sipër, sikundër me të drejtë ka vlerësuar dhe Gjykata e Posaçme e Apelit, në rastin konkret rezulton i bazuar edhe vlerësimi i ekzistencës së rrezikut të marrjes apo të vërtetësisë së provës. Deklarimet e shtetasve të pyetur nga organi i akuzës, apo i vetë bashkëpunëtorit të policisë janë marrë nga prokuroria, por ato përbëjnë provë kur merren para gjykatës (nuk ka të dhëna se do të procedohet me ritin e gjykimin të shkurtuar). Pozita e personit nën hetim Beleri, është e tillë që mund t’i intimidojë dëshmitarët e ardhshëm, apo të kontribuojë në prishjen e provave. Gjithashtu, sipas të dhënave veprimtaria kriminale e dyshuar e të hetuarit mund të ketë përmasa më të gjera dhe përfshin Njësinë Administrative Hore – Vranisht dhe fshatrat që përmbledh kjo njësi administrative. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se në rastin konkret (referuar të dhënave deri në atë moment të vendimarrjes gjyqësore) ka të dhëna të mjaftueshme dhe të rëndësishme për të konkluduar në ekzistencën e rrezikut të marrjes ose vërtetësisë së provës. Sa më sipër, Kolegji çmon se plotësohen të tre kushtet e parashikuar në pikën 3, të nenit 228

të KPP, duke u konkluduar në këtë mënyrë në ekzistencën e nevojave të sigurimit dhe caktimin e një mase sigurimi. Lidhur me kriteret e përgjithshme që udhëheqin gjykatën në caktimin dhe përzgjedhjen e masës së sigurimit personal, neni 328 i KP parashikon si sanksion vetëm dënimin me burgim, sanksion i cili nis nga masa 1 vit burgim dhe shkon në maksimum deri në 5 vjet burgim. Nga ana tjetër Kolegji mban parasysh se vepra penale paraqet një ndër problemet sistemike të çdo zgjedhje të përgjithshme apo vendore në Shqipëri, që do të thotë se kërkohet prej organeve ligjzbatuese një vëmendje e shtuar në marrjen e masave parandaluese dhe ndëshkuese ndaj këtij fenomeni.

Më tej, në përcaktimin e masës konkrete më të përshtatshme për t'u zbatuar, gjykatat bazohen në kriteret e përcaktuar në nenet 229 dhe 230 të KPP, duke argumentuar rrezikshmërinë e veprave dhe të autorit, rëndësinë e faktit penal, sanksionin e veprës, mungesën e rrethanave lehtësuese. Lidhur me këto rrethana, Kolegji çmon se mbrojtja me të drejtë ka parashtruar se nuk aplikohet në rastin konkret rrethana rënduese e parashikuar në shkronjën “dh”, të nenit 50, të KP, kryerja e veprës penale duke shpërdoruar funksionin publik, pasi Dh.B. nuk është bërë ende funksionar publik megjithëse ka qenë kandidat për kryetar bashkie. Por, megjithatë, ky fakt megjithëse nuk është rrethanë rënduese, është tregues i rëndësisë së faktit penal, pasi dyshohet për një veprë penale për më tepër që prek zgjedhjet e lira nga një kandidat në zgjedhje dhe kjo tregon shpërdorim të besimit publik, duke i dhënë faktit penal një rëndësi të shtuar (në kuadër të dyshimeve) dhe autorit një rrezikshmëri të veçantë, e bërë në këtë mënyrë të aplikueshëm parashikimin e pikës 1, të nenit 230, të KPP. Ky përfundim përforcohet dhe nga dyshimi i bazuar për ekzistencën e rrethanës së kryerjes së veprës penale në bashkëpunim (rrethanë rënduese e parashikuar nga shkronja “gj”, e K.Penal. Nevojat e sigurimit në rastin e Dh.B. mund të sigurohen vetëm nëpërmjet masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, sikundër më lart është arsyetuar. [...]

Sa i përket pretendimeve për mopërmbushjen e anës objektive të parashikimeve të nenit 328, të KPP, Kolegji çmon se është i pabazuar pretendimi i mbrojtjes, e cila argumenton se për të pasur këtë figurë të veprës penale, duhet që zgjedhësit të jenë të identifikuar. Gjykata e Apelit ka argumentuar se ky dyshim nuk zhbëhet dhe se vërtetimi i tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm do të jetë objekt i veprimtarisë hetimore. Deri në këtë moment, pra në momentin e caktimit të masës së sigurimit nga gjykata e shkallës së parë (gjyqtari i hetimit paraprak) dyshimi rezultoi i bazuar në prova, sipas të cilave (në kuadër të dyshimit), ekziston një listë me emra, për të cilët i hetuari Kokaveshi, me porosi të të hetuarit Beleri, dha para për 8 shtetas, me qëllim votimin në zgjedhjet lokale të kandidatit Beleri. Sa i përket pretendimeve që avancohen në rekurs, sipas të cilave i hetuari Dh.B. është përfaqësues i një minoriteti dhe për rrjedhojë, në caktimin e masës së sigurimit gjykata duhet të mbajë parasysh edhe cenimin që mund t'i vijë lirisë së shprehjes, Kolegji çmon se nuk është i bazuar. Të qenurit përfaqësues i një minoriteti, sikundër pretendohet në rastin konkret, por edhe në çdo rast, nuk mund të përligjë dhe të institucionalizojë shkeljen e ligjit dhe kryerjen e veprimeve kriminale. Gjithashtu, lidhur me aludimet e mbrojtjes mbi trajtimin jo të barabartë të rasteve të ngjashme nga gjykatat,

Kolegji vlerëson se nuk është argument i bazuar për ndryshimin e masës së sigurimit. Kolegjit penal i është vënë në shqyrtim ky rast konkret dhe masa e sigurimit caktohet bazuar në përcaktimin e kushteve dhe kritereve, të përcaktuar në ligj, referuar nevojave të sigurimit rast pas rasti. P.sh.: edhe në rastin konkret, megjithëse kemi dy të dyshuar, referuar rrethanave që imponojnë nevojat e sigurimit, Gjykata e Posaçme e Apelit ka konkluduar në caktimin e dy masave të ndryshme sigurimi, konkludim ky i çmuar nga Kolegji i drejtë e i bazuar në ligj. Së fundmi, Kolegji konstaton dhe çmon se Gjykata e Posaçme e Apelit ka argumentuar drejt lidhur me pretendimet e tjera të ngritura në rekurs nga personat nën hetim, duke e bërë të pacenueshme vendimmarrjen në rastin konkret.

Sa më sipër, referuar të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs nga personat nën hetim, Kolegji vlerëson se nuk janë të tilla që të mund të ndryshojnë vendimmarrjen e Gjykatës së Posaçme të Apelit objekt rekursi, e cila në përputhje me parashikimet e shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 441, sipas të cilës: [...] duhet të lihet në fuqi.

VI. Ekzekutimi i dënimit

Vendim Kolegjet e Bashkuara Nr.1, datë 28.10.2022 (Parashkrimi i ekzekutimit të vendimit)

Fjalë kyçe: parashkrimi i ekzekutimit të vendimit, bashkim dënimi, gjë e gjykuar

Rrethanat e çështjes:

Nga dosja gjyqësore rezulton se, kërkuesi Sh.K., me vendimin nr. 67, datë 22.11.1991, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është dënuar me 18 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje për motive të dobëta”. [...] Ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 4, datë 18.01.1992 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Kërkuesi pas vuajtjes së një pjese të dënimit, është arratisur nga vendi i vuajtjes së dënimit në Mars të vitit 1997, gjatë trazirave të vitit 1997. Në datën 06.04.2009 i dënuari është arrestuar sërish dhe është vendosur në burgun e Burrelit për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur. Në datën 19.02.2013, i dënuari Sh.K. nuk është kthyer në vendin e vuajtjes së dënimit në IEVP Burrel, pas lejes shpërblyese të miratuar nga ky institucion. Me vendimin nr.63, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat kërkuesi është dënuar me 4 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”. Ndërsa me vendimin nr.96, datë 11.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur bashkimin e dënimit të mbetur pa vuajtur (5 vjet e 8 muaj) me dënimin e dhënë si pasojë e largimit të kërkuesit (4 vjet), duke e dënuar përfundimisht me 9 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 22.11.2013.

Kërkuesi Sh.K. [...] i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me kërkesë me objekt: “Mosekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë, duke u përjashtuar nga vuajtja e dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të vendimit nr. 67, datë

22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 67, datë 22.11.1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është parashkruar meqenëse kanë kaluar 20 vjet nga momenti i marrjes formë të prerë të këtij vendimi. Sipas kërkuetit, data e fillimit të afatit të parashkrimit për të dënuarin Sh.K. është data 18.01.1992, kur vendimi ka marrë formë të prerë dhe data e parashkrimit të ekzekutimit të këtij vendimi është data 19.01.2012. Në lidhje me vendimin nr. 96, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me të cilin është bërë bashkimi i dënimeve, kjo gjykatë ka gabuar pasi ka bashkuar një dënim të parashkruar që në datën 19.02.2013.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesës. [...]

Gjykata e Apelit Shkodër, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...]

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 447, datë 05.03.2015, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Sh.K. [...]

Kërkuesi Sh.K. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në të trija shkallët e gjykitimit. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 84, datë 30.12.2016 ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.447, datë 05.03.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë. [...]

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 10.06.2022, ka vendosur nisjen e procedurës për ndryshim të vendimit njësuës nr. 7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit “*Nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjë lloj shkaku. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu dhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për çfarëdolloj shkaku, sikurse mund të jetë dhe largimi i të dënuarit nga vuajtja e dënimit*”, lidhur me momentin e llogaritjes së afateve të parashkrimit në kushtet kur ekzekutimi i dënimit ka filluar dhe për shkaqe të ndryshme ndërpritet. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, ka vlerësuar se çështja duhet të dërgohet në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke ngritur çështjen e nevojës së ndryshimit të praktikës gjyqësore të njësuar mbi momentin e llogaritjes së afatit të parashkrimit të ekzekutimit të vendimit penal, në rastet kur vuajtja e dënimit ndërpritet për shkak të largimit të të dënuarit nga vendi i vuajtjes së dënimit apo moskthimit të tij në vendin e vuajtjes së dënimit pas lejes.

Për Kolegjin Penal, vendimi njësuës nr. 7/2002, ka tejkaluar kuptimin që vetë ligji i kishte dhënë institutit të parashkrimit, duke u interpretuar si i tillë jo në mënyrë korrekte lidhur me momentin e llogaritjes së afateve të parashkrimit, në kushtet kur ekzekutimi i dënimit ka filluar e për shkaqe të ndryshme ndërpritet. Interpretimi i bërë ligjit penal nga Kolegjet e Bashkuara dhe njësimi i praktikës gjyqësore sipas këtij vendimi barazon si rastin kur ekzekutimi i dënimit nuk ka filluar ashtu dhe atë kur ai ka filluar dhe është ndërprerë për çfarëdolloj shkaku. Sipas këtij vendimi njësuës nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjë lloj shkaku. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim,

ashtu dhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për shkak të largimit të të dënuarit nga vendi i vuajtjes së dënimit apo moskthimit të tij në vendin e vuajtjes së dënimit pas lejes, duke konsumuar në këtë mënyrë elementet e një vepre tjetër penale.

Kolegji Penal ka vlerësuar se, nisur nga koha e gjatë e kaluar nga marrja e këtij vendimi, konteksti kohor në të cilin është marrë dhe ndryshimet e vullshme legislative të viteve të fundit, kjo praktikë gjyqësore e deritanishme duhet ndryshuar. Në këtë kontekst, Kolegji mban qëndrimin se zbatimi i mëtejshëm nga gjykatat i vendimit njësores të sipërcituar në këtë formë, nuk është në përputhje me përmbajtjen e nenit 68 të K.Penal, dhe do të sillte rrezik për sigurinë në sistemin penitenciar. Në interpretimin krahasues të normave penale, Kolegji ka konstatuar tashmë se janë tejkaluar disa nga konceptet e vjetra të interpretimit të ngushtë të tyre, duke i dhënë legjislacionit material penal një kuptim më të gjerë e të kohës. Pikërisht për këtë çështje Kolegji Penal ka konstatuar se jurisprudenca e vendeve të tjera të cilat kanë legjislacion penal material të ngjashëm me vendin tonë shkojnë në këtë frymë. Po kështu, Kolegji Penal arsyeton se, praktika njësores e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, tashmë ka pranuar konceptin e “ndërprerjes së parashkrimit” edhe në interpretimin e normave materiale penale e procedurale.¹²

Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë:

Kolegjet e Bashkuara [...] në seancë gjyqësore, në praninë e palëve, pasi morën në shqyrtim argumentet e parashtruara nga relatorët mbi nevojën e ndryshimit të vendimit njësores penal nr. 7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara si dhe pasi dëgjuan qëndrimin e prokurorit dhe mbrojtjes, vlerësojnë që praktika njësores e deritanishme nuk duhet të ndryshohet.

[...] Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton, midis të tjerave, edhe rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës gjyqësore. Edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka konsoliduar qëndrimin e saj duke pranuar se, në aspektin kushtetues është e pamundur dhe e pajtueshme që doktrina kushtetuese zyrtare të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra-tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara dhe që ndryshon modelin e ndarjes së pushteteve të rregulluara në Kushtetutë. Çdo ndryshim i “precedentëve të Gjykatës Kushtetuese apo korrigjim i doktrinës kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, siç mund të jetë edhe ndryshimi i përbërjes së saj” (shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 29.04.2010).” Sigurimi i vazhdimësisë së jurisprudencës kushtetuese theksohet në vendimin e sipërcituar “përbën një detyrim për Gjykatën, por, nga ana tjetër, në mënyrë të natyrshme

¹² Vendimi njësores i datës 07.04.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me rehabilitimin.

jurisprudenca nuk mund të mos i nënshtrohet edhe evoluimit të saj. Nga kjo pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzionesh të reja interpretuese edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivist e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar. Duke vendosur në kundërshtim me një praktikë të konsoliduar dhe pa dhënë argumente në lidhje me këtë fakt, Gjykata shmanget nga korniza e rregullave të një procesi të drejtë e të ndershëm, duke i mohuar mbrojtjen gjyqësore kërkuesit në kuptim të asaj se çfarë ky i fundit priste, bazuar në jurisprudencën e vetë Gjykatës”. Një qëndrim i tillë është ritheksuar dhe konsoliduar më tej edhe në vendimet nr. 30, datë 17.06.2010, nr. 21, datë 29.04.2010, nr. 20, datë 01.06.2011 dhe nr. 3 datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Vendimet gjyqësore dhe, për më tepër, vendimet njësuere duhet të ndryshohen vetëm për rrethana të jashtëzakonshme. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ruajtja e qëndrimeve të mbajtura në vendimet e mëparshme është në interes të stabilitetit, por edhe të legjitimitetit institucional. Nëse praktika gjyqësore e ka zbatuar për një periudhë të gjatë një normë ligjore, referuar një qëndrimi njësuere, padyshim që kjo situatë nuk mund të mos vlerësohet si një rrethanë e rëndësishme për stabilitet jurisprudencial.

Çdo kolegji i Gjykatës së Lartë në fushën që vepron, si dhe Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate bëjnë njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore lidhur me mënyrën e kuptimit e zbatimit të ligjit nëpërmjet rolit të tyre natyror kushtetues, që është ai i shqyrtimit dhe i zgjidhjes së çështjes konkrete. Nëse kolegjet me trupën gjyqësore prej pesë anëtarësh bëjnë njësimin e praktikës gjyqësore për të orientuar zbatimin unik të ligjit, Kolegjet e Bashkuara ndryshojnë praktikën gjyqësore të njësuere më parë; pra ndryshojnë mënyrën se si është orientuar kuptimi i ligjit nga kolegjet njësuere. Vendimet njësuere ose unifikuese siç njiheshin më parë, kanë fuqi detyruese për të rregulluar mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat në çështje të ngjashme, ndërsa vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bëjnë të mundur ndryshimin e kësaj praktike gjyqësore, duke krijuar njëkohësisht një praktikë të re. Duke qënë se vendimet njësuere kanë fuqi detyruese për zbatimin unik të ligjit në çështje të njëjta ose të ngjashme, ndryshimi i kësaj praktike nga Kolegjet e Bashkuara duhet të ndodhë në raste sa më të kufizuara e të diktuar nga nevoja për zgjidhjen e drejtë të çështjes konkrete, e cila nuk është e mundur të zgjidhet në kushtet e përplasjeve të jurisprudencës me interpretimet ligjore të mëparshme të vendimeve njësuere. Pra, qëllimi që justifikon përfshirjen e Kolegjeve të Bashkuara në ndryshim të praktikës gjyqësore njësuere është zgjidhja e çështjes konkrete për shkak të specifikave që ajo paraqet. Janë pikërisht veçoritë e rrethanave të çështjes, që e vendosin kolegjin që inicion ndryshimin e vendimit njësuere në pamundësi për një zgjidhje të drejtë të çështjes, për shkak të kufizimit dhe imponimit interpretues që krijon një vendim njësuere në fuqi. Pra, para së gjithash, kolegji iniciues ka detyrimin të arsyetojë pamundësinë e zgjidhjes së çështjes për shkak të kufizimeve të vendimit njësuere ekzistues dhe të argumentojnë nevojën për ndryshimin e këtij vendimi, për shkak të arsyeve të rëndësishme që paraqiten në aspektin kushtetues, ligjor, të

jurisprudencës ndërkombëtare, apo për çdo rrethanë tjetër thelbësore. Verifikimi i dy kushteve paraprake të sipërcituara, siç është *a)* varësia e çështjes nga ndryshimi i praktikës njësuere dhe *b)* nevoja për ndryshim, janë të karakterit procedural, plotësimi i të cilave i paraprin vlerësimin të mëtejshëm në themel të kërkesës për ndryshim. Vetëm kur Kolegjet e Bashkuara binden për ekzistencën e njëkohshme të këtyre dy kushteve të domosdoshme mund të operojnë me ndryshimin e praktikës njësuere (unifikuese) dhe në varësi të qëndrimit që do të mbajnë do të bëjnë interpretimin e ri të institutit të të drejtës, objekt “ndryshimi-njësimi”. Përndryshe, kur këto kushte “*sine qua non*” nuk plotësohen, atëherë kërkesa për ndryshim të vendimit njësuere është e papranueshme. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se në praktikën gjyqësore nuk është evidentuar ndonjë problematikë, lidhur me (keq)zbatimin e vendimit njësuere nr.7, datë 11.10.2002, që të ndikojë domosdoshmërisht në ndryshimin e këtij qëndrimi njësuere. Për më tepër, në çështjen objekt gjykimi, gjykatat e kanë pranuar faktin se afati i parashkrimit të këtij vendimi ka përfunduar por, duke qenë përpara vendimit nr.96, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që ka vendosur bashkimin e dënimeve, kanë qenë të detyruara të vendosin rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Sh.K.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë gjithashtu se, nuk ekziston asnjë mosmarrëveshje mes palëve, në këtë gjykim. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegjin Penal [...], të dy palët si mbrojtja, ashtu dhe prokurori kanë kërkuar shuarjen e dënimit të dhënë për arsye të parashkrimit. Kolegjet e Bashkuara sjellin në vëmendje se pushteti i gjykatave është i kufizuar në shqyrtimin e atyre rasteve që përbëjnë çështje e mosmarrëveshje mes palëve. Një çështje gjyqësore duhet të ketë një mosmarrëveshje aktuale midis palëve, mbi të drejtat e tyre ligjore që konfliktohen në kohën kur paraqitet çështja dhe mënyrat e ndryshme ose të gabuara të interpretimit të ligjit, rrethanë që nuk ekziston në rastin konkret, pasi qëndrimi i tyre është në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Në rastin në shqyrtim, Kolegji Penal [...] nuk rezulton të ketë qenë në pamundësi për të zgjidhur çështjen konkrete, që të detyronte nisjen e një procedure për ndryshimin e praktikës njësuere. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se çështja objekt gjykimi është zgjidhur nga Gjykata Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 84, datë 30.12.2016 ka shfuqizuar si antikushtetues vendimin nr. 447, datë 05.03.2015 të Kolegjit Penal, duke konkluduar për kërkuarin Sh.K. se, “*arsyetimi i gjykatave të faktit e ka vendosur kërkuarin në situatën ku atij i duhet të vuajë një dënim, i cili është parashkruar*”. Pikërisht, në çështjen ndaj kërkuarit, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar parashkrimin e ekzekutimit të vendimit, si dhe shkeljen e të drejtës themelore të individit, duke konkluduar ndër të tjera se [...] Në jurisprudencën kushtetuese (*shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011 të GJK*) është konkluduar se “Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. [...] (*Shih vendimin nr. 5 datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese*)”. [...]

Sikurse u theksua, Kolegjet e Bashkuara zhvillojnë praktikën gjyqësore nëpërmjet funksionit të tyre natyror kushtetues, që është zgjidhja e çështjeve gjyqësore. Vetëm përmes zgjidhjes së çështjeve konkrete ato bëjnë të mundur interpretimin e mënyrës së

kuptimit të ligjit. Përderisa çështja objekt gjykimi mund të zgjidhet në interpretim të kuadrit ligjor aktual në fuqi, jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, si dhe zbatimit të vendimit njësoes nr.7, datë 11.10.2002, atëherë për Kolegjet e Bashkuara mungon lënda, nëpërmjet të cilës të zhvillojnë ose ndryshojnë praktikën gjyqësore. Për atë kohë sa përpara Kolegjeve të Bashkuara nuk rezulton të jetë paraqitur një çështje që imponon nevojën për një ndryshim të vendimit njësoes të mëparshëm, atëherë mungon kushti, pa të cilin ndryshimi i praktikës njësoese nuk mund të bëhet.

Përpos sa u arsyetua më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë gjithashtu se ndryshimi i praktikës njësoese është një situatë që nuk ndodh dhe as nuk duhet të ndodhë në mënyrë të shpeshtë. Përpara marrjes së një vendimi që zgjidh çështjen konkrete, çdo Kolegj i Gjykatës së Lartë mund të ndodhet në pamundësinë e zgjidhjes së çështjes për shkak të mënyrës së formulimit të dispozitës ligjore, ose të ekzistencës së një vendimi njësoes të Kolegjeve të Bashkuara që ka krijuar problematikë në mënyrën e zgjidhjes që jep. Fillimisht, Kolegji do të kërkojë t'i japi zgjidhje çështjes konkrete nëpërmjet një interpretimi pajtues të normës ligjore dhe në pamundësi të zgjidhjes mund të vlerësohet nisja e procedurës për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, nëpërmjet gjykimit incidental. Vetëm në rastin e ekzistencës së një vendimi njësoes që mund të ketë krijuar problematika në zbatim mund të nisë procedura për ndryshimin e vendimit njësoes.

Për të ndryshuar vendimet njësoese të Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se nuk mjafton vetëm pasja e një opinioni ndryshe për të, por duhet të ekzistojnë disa rrethana dhe arsye të forta, që siç thotë jurisprudenca kushtetuese, e justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe se nevoja për ndryshimin e jurisprudencës është *“e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar”*. Element esencial në punën e gjykatës është besueshmëria e publikut, e cila çënohet në ato raste kur gjykata ndryshon qëndrimin e saj njësoes, pa një bazë të arsyeshme kushtetueshmërie e ligjshmërie për ndërmarrjen e kësaj iniciative. Është detyrë e Gjykatës së Lartë që nëpërmjet veprimtarisë së saj në njësimin e praktikës gjyqësore dhe kufizimit të mundësisë së ndryshimit të shpeshtë të praktikës së njësoes në të ardhmen të garantojë stabilitet e vazhdimësi, vendimarrje unike për çështje të njëjta ose të ngjashme, respektim të parimit të sigurisë juridike dhe të parimit të barazisë së palëve para ligjit.

Në rastin në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, nuk janë të pranishme rrethana të tilla që ndikojnë për të ndryshuar praktikën gjyqësore të njësoes prej shumë vitesh. Problematika që mund të paraqesin normat ligjore në zgjidhjen e rasti konkret, nuk është e asaj natyre që të përfshijë domosdoshmërisht si mjetin e vetëm, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në ndërmarrjen e një procedure të ndryshimit të praktikës gjyqësore, se sa e vetë ligjvënësit për gjetjen e zgjidhjeve nëpërmjet ndryshimeve ligjore.

Pikërisht, krijimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore, nëpërmjet zgjidhjes së çështjeve gjyqësore e dallon Gjykatën e Lartë nga pushteti normativ i ligjvënësit, i cili sa herë vlerëson mospërshtatjen e tij me situatën apo rrethanat e krijuara, ia nënshtron ligjin procedurës parlamentare për ndryshim. Detyrë e Kolegjeve të Bashkuara [...] është të respektojë kufijtë kushtetues të interpretimit gjyqësor të normës juridike,

duke mos marrë kompetencat e ligjvënësit, por duke kryer një zhvillim gjyqësor të së drejtës. Nëse ligjvënësi do të vlerësonte problematika për mënyrën e hartimit të nenit 68 të K.Penal, krahasuar me dispozitat e tjera, nenet 66 e 69 të kreut VIII, të titulluar “Shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimi i tyre”, kjo mbetet një çështje e pushtetit që ai ka, me synim shmangien e çdo përplasje apo kontradiksioni mes tyre, gjë e cila del natyrshëm nga kompetenca kushtetuese e Gjykatës së Lartë për njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, këto argumente janë të mjaftueshme për të konkluduar se, për rastin në shqyrtim, çështja ndaj kërkuesit Sh.K. mund të zgjidhet pa qenë nevoja e investimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të ndryshuar praktikën njësuere nr. 7, datë 11.10.2002. Përsa i përket zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara [...] vlerësojnë se, pretendimi i kërkuesit për mosekzekutimin e vendimit nr. 67 datë 22.11.1991, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për shkak se është parashkruar, është i drejtë dhe i bazuar në ligjin material penal, konkretisht nenin 68 të K.Penal dhe vendimin njësuere nr.7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara. [...]

Pikërisht, në çështjen ndaj kërkuesit Sh.K., Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar parashkrimin e ekzekutimit të vendimit, si dhe shkeljen e të drejtës themelore të individit. Me vendimin nr. 84, datë 30.12.2016, ajo ka shfuqizuar si antikushtetues vendimin nr. 447, datë 05.03.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke konkluduar se [...]

Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se, edhe pse parimisht gjykatat e faktit e kanë konstatuar të parashkruar ekzekutimin e vendimit nr.67 datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, kanë mbajtur qëndrimin se, duke qenë përpara faktit që ka një vendim gjykate (vendimi nr. 96 datë 11.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat), me të cilin është vendosur bashkimi i dënimeve, duke llogaritur në këtë bashkim edhe pjesën e dënimit të pavuajtur për dënimin e parë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat në vendimin e saj e ka pranuar faktin se ky vendim penal nuk është parashkruar përderisa ajo ka disponuar duke i bashkuar këto dënime. Po kështu, gjykatat e faktit kanë vlerësuar se jemi përpara rastit kur një gjykatë e të njëjtës shkallë si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat është shprehur në lidhje me këtë çështje edhe pse në mënyrë të nënkuptuar, duke mos e konstatuar të parashkruar këtë vendim penal, përderisa ka bërë bashkimin e dënimeve dhe, në këto kushte, gjykata nuk mund të disponojë për një çështje e cila është zgjidhur me një vendim të një gjykate tjetër të së njëjtës shkallë, vendim i cili ka marrë formë të prerë sepse nuk është ankimuar nga palët, pasi në të kundërt do të cenonte parimin e gjësë së gjykuar.

Në lidhje me faktin nëse i dënuari mund të përfitojë nga parashkrimi i ekzekutimit të dënimit në rastet kur ky dënim është bashkuar me një dënim tjetër, Kolegjet e Bashkuara, vlerësojnë se disponimi i gjykatës për bashkimin e dënimeve nuk mundet të konsiderohet një vendim dënimi. Ky disponim përfaqëson rezultatin e aplikimit të një teknike zbatimi të dënimit në rastet kur ka më shumë se një të tillë. Për këtë arsye ky disponim është i aplikueshëm dhe në rastin kur individi është gjykuar e dënuar në një kohë për dy ose më shumë vepra penale ashtu dhe në rastin kur këto dënime janë dhënë në kohë të ndryshme. Në këtë kuptim, neni 68 i K.Penal, në rastet kur flet për

parashkrim të ekzekutimit të dënimit nënkupton dënimin e caktuar si rezultat i gjykimit të një çështje penale të mirëfilltë, ku në përfundim të tij për veprën penale të gjykuar, është akorduar një dënim i caktuar. Si rrjedhim diskutimi mbi parashkrimin merr për bazë datën kur vendimi për dënimin e personit për një vepër penale të caktuar, ka marrë formë të prerë në mënyrë individuale dhe jo mbi bazën e vendimit të formës së prerë që ka bashkuar dy a më shumë vendime. Kjo, pasi ligjvënësi, duke përcaktuar afate të ndryshme për masa të ndryshme dënimesh, e lidh afatin e parashkrimit me dënimin për veprën penale të kryer. Në lidhje me faktin nëse ndodhemi para “gjësë së gjykuar” në rastin kur në shqyrtimin e kërkesës për bashkim dënimesh nuk është shqyrtuar dhe disponuar për parashkrimin e ekzekutimit të një prej vendimeve, ku qëndrimi i mbajtur nga gjykatat më të ulta, është se fakti që parashkrimi nuk është konstatuar kryesisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, në rastin e vendimmarrjes për bashkimin e dënimeve, përbën, në mënyrë të tërthortë, një disponim prej saj edhe për mosparashkrimin e ekzekutimit, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky arsyetim bie ndesh me kuptimin e drejtë të konceptit “*res judicata*”. Teoria dhe praktika gjyqësore kanë pranuar se do të ndodhemi përpara parimit të “gjësë së gjykuar” nëse janë të pranishme tre elemente: - personi i njëjtë; - fakti i shqyrtuar i njëjtë; - disponimi i njëjtë. Në rastin konkret konstatohet se edhe pse kërkuesi është i njëjtë, faktet e shqyrtuara dhe disponimet janë të ndryshme. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se kërkitimi i kërkuetit Sh.K., për mosekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë nr. 67 datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për shkak se është parashkuar, është i drejtë dhe si i tillë duhet të pranohet. [..]

Ndërkohë, lidhur me pretendimin e [..] kërkuetit, për parashkrimin e ekzekutimit të vendimit nr. 63, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, nëpërmjet të cilit shtetasi është dënuar me 4 vite burgim për veprën penale të “Largimit të të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, parashkuar nga neni 323/1 i K.Penal, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky pretendim është i pabazuar. Kolegjet e Bashkuara konstatojnë faktin se, kërkuesi, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke kërkuar mosekzekutimin e vendimit nr. 67 datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për shkak të parashkrimit. Për rrjedhojë kërkitimi i mbrojtjes për mosekzekutimin e vendimit [..] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, nuk mund të merret në shqyrtim nga Kolegjet e Bashkuara, për sa kohë që ky kërkitim nuk është objekt gjykimi.

VII. Ekstradimi

KPGJL Vendim Nr.00-2023-980(139), datë 25.04.2023 (Moslejm ekstradimi: mosdhënie garancie shteti kërkuës)

Fjalë kyçe: trajtimit jonjerëzor dhe degradues në vendin kërkuës, kusht pengues lejim ekstradimi, rrezik real

Rrethanat e çështjes:

Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e faktit, ka rezultuar se, Komisariati i Policisë Rinas, Tiranë, më datë 11.07.2022, [...] nga ana e kontrollorëve të Policisë Kufitare, është proceduar me ndalimin - ne momentin e paraqitjes në sportelet e hyrjes – e shtetasit L.Ch. - i identifikuar [...] Ndalimi i këtij shtetasi është bërë për arsye se nga kontrolli në sistemin TIMS dhe më pas, nga korrespondenca me Z.Q.K. Interpol Tirana, është konfirmuar në rrugë e-mail se: [...] *rezulton se është shpallur në kërkim nga Interpol Pekini (Kine) (update më datë 11.07.2022) për veprën penale “Mashtrimi”.* [...]

Në këto kushte Komisariati i Policisë Rinas, [...] ka kryer arrestimin e tij në flagrancë (ndalimin) për qëllim ekstradimi - për arsye të masës së sigurimit “Arrest në burg”, në ngarkim të tij, lëshuar nga autoritetet Kineze të Drejtësisë. [...] Sa më sipër, mbështetur në nenet 495 e vijues të KPP, si dhe ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009, të ndryshuar, kërkohet kryerja e veprimeve procedurale përkatëse, lidhur me ekstradimin ne Kinë të shtetasit kinez Liangbin Chen. Me vendimin penal nr. 1563, regj. them, datë 14.07.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, mbi kërkesën e prokurorit, ka vendosur vleftësimin të ligjshëm të arrestimit të shtetasit L.Ch. Caktimin si mase sigurimi personal, [...] “Arrest në burg” parashikuar nga nenet 238 dhe 495 të KPP, lidhur me procedurat e ekstradimit sipas kërkesës së autoriteteve kineze.” [...]

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi konstaton se dokumentacioni i përcjellë për shtetasin kinez L.Ch. [...] nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Prokurorisë së Përgjithshme është i plotë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për ekstradimet dhe parimin e reciprocitetit të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Kinës, mbështetur në nenet 495 e vijues të KPP, si dhe Ligjit nr. 10 193, datë 03.12.2009, të ndryshuar me ligjet 100/2013 datë 18.03.2013, dhe nr. 97/2021, datë 07.07.2021. “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, iu drejtua gjykatës për miratimin e kërkesës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, [...] ndër të tjera, ka vendosur pranimin e kërkesës. Lejimin e ekstradimit të shtetasit L.Ch. [...] **në Republikën Popullore të Kinës për efekt të zbatimit të vendimit penal nr. DG (X) BZ (2022) 00055, datë 20.05.2022, të Gjykatës Deging, të Provincës Zhejiang/Kinë. Rrëzimin e kërkesës për revokimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” të dhënë ndaj shtetasit Liangbin Chen. Gjykata e Apelit, Tiranë, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...]**

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] Përsa i përket pretendimeve, kryesisht, të karakterit formal – të identifikuar në ometimin e gjykatave të faktit për të disponuar në funksion të vendimmarrjes së tyre miratuese të kërkesës së Prokurorit për lejimin e ekstradimit të subjektit me kombësi kineze, drejt shtetit kërkues – Republikës Popullore të Kinës – dokumentacionin e përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 489, të KPP . përfshirës të “aktit të procedimit” dhe të origjinalit (të këtij dokumentacioni) të përkthyer në gjuhën shqipe, Kolegji, mbasi qartazi konstatoi prezencën formale të tyre në parametrat e kërkuar nga dispozita, sikurse arsyetohet shterueshëm, lidhur me këtë argument nga

Gjykatat e faktit – sipas te cilave – dokumentacioni është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe se, nga këqyrja e kërkesës së paraqitur prej autoriteteve kineze për ekstradimin e qytetarit të sipërcituar, nuk ka arsye të dyshohet lidhur me autencitetin e saj (në drejtim të përmbajtjes – pasqyrimit të rrethanave të pavesuara prej falsitetit) dhe të materialit bashkëngjitur – aq më tepër kur pretendime të kësaj natyre nuk janë reklamuar nga pala rekursuese – i konsideron ato në kushtet e papranueshmërisë.

Kolegji, lidhur me këtë moment konsideron se, verifikimi i ometimit të përkthimit të dokumentacionit – përfshirë edhe kërkesën bashkë me aktin e procedimit bashkëngjitur (në gjuhën shqipe) – prej autoritetit të shtetit kërkuar – nuk përbën shkak për deklarimin e nulitetit të tyre përse kohë që; në nenin 33 të ligjit (nr. 10193/2009) për “Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, parashikohet njëkohësisht edhe detyrimi i Ministrisë së Drejtësisë për të transmetuar pranë organit procedues kërkesën bashkë me materialin shoqërues të përkthyer, gjë që nuk pengon organin procedues – gjykatën - të gjykimin të kërkesës për ekstradim – për të proceduar kryesisht me disponimin e përkthimit nëpërmjet caktimit të përkthyesit – në konformitet me përcaktimet e nenit 123/2, të KPP, edhe në rastet ekstreme të anashkalimit të këtij detyrimi prej subjekteve të sipërcituara.

Kolegji konsideron në kushtet e papranueshmërisë pretendimin e karakterit formal, të parashtruar prej rekursuesit të ometimit të organit juridiksional – gjykatave që kanë disponuar lidhur me kërkesën e Prokurorit për lejimin e ekstradimit të subjektit me kombësi kineze – në Republikën Popullore të Kinës – për të administruar – patur në dispozicion – në funksion të vendimmarrjes së tyre – “aktin e procedimit penal” – vendimin – urdhrin – për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, të nxjerrë prej autoritetit që ushtron ndjekjen penale në Republikën Popullore të Kinës – kundër tij” – përse kohë që, në konformitet e me kërkesat e paragrafit të dytë, të nenit 489 të KPP (i cili përcakton së kërkesës për ekstradim i bashkëngjitet dokumentacioni i identifikuar në: [..]në të kundërt, këto Gjykata kanë administruar, në funksion të disponimit për lejimin e ekstradimit, vendimin e miratimit të arrestimit, të Prokurorisë Popullore të Distriktit Deking. Sakaq, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, në kërkesën e autoriteteve kineze për lejimin e ekstradimit bashkëngjitet edhe një relacion (raport) mbi veprën penale që i ngarkohet (atribuohet) të kërkuarit, ku janë paraqitur rrethanat mbi verifikimin e faktit penal që i atribuohet këtij të fundit, bazueshmëria – mbështetja provuese – e verifikimit të tyre (përveç të tjerash në deklarimet e të bashkëhetuarve, të pasqyruara në relacion – në funksion të verifikimit të kushtit të karakterit provues, të përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 498 të KPP, për lejimin e ekstradimit – të prezencës së të dhënave të rëndësishme të fajësisë në ngarkim të personit për të cilin kërkohet ekstradimi) teksti i dispozitave ligjore që do të zbatohen – në thelb mveshja ligjore e faktit penal të atribuar – nën formën e veprave penale integruese të tij bashkë me dispozitat referuese në Kodin Penal (kinez), duke treguar se për veprën (veprat) penale për të cilën kërkohet ekstradimi – “Mashtrimi” – të parashikuar nga neni 266 i Kodit Penal (kinez) – të parashikuar edhe nga Kodi Penal (shqiptar) në nenin 143 të tij – ligji i shtetit kërkuar (Republikës Popullore të Kinës) nuk parashikon dënimin kapital.

Kolegji konsideron në kushtet e papranueshmërisë – së konstatuar haptazi – pretendimin e palës rekursuese, të pasqyruar në një nga motivet e rekursit – invokues të “paraqitjes së kërkesës, së personit ndaj të cilit është aktivuar procedimi i ekstradimit, për strehim politik në Republikën e Shqipërisë” me cilësinë e shkakut (sipas përcaktimit të nenit 32/dh, të ligjit nr. 10193/2009, “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Lëndë Penale”) ndalues të lejimit të ekstradimit përsa kohë që – sipas përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar – vetëm pranimi i kësaj kërkesë prej autoritetit kompetent shtetëror shqiptar – përbën shkak ndalues (ndërprerës nëse është filluar) të implementimit të procedimit të ekstradimit. Gjykatat e faktit kanë evidentuar, gjithsesi, rrethanën e paraqitjes së kërkesës për strehim politik të subjektit me kombësi kineze para autoritetit shtetëror kompetent shqiptar (kërkesë e pagjykuar prej këtij organi përgjatë periudhës së trajtimit – prej gjykatave të faktit – të kërkesës së Prokurorit – për lejimin e ekstradimit), e cila është konsideruar e pamjaftueshme – edhe prej tyre – për të disponuar këtë cilësi – të shkakut ndalues – paralizues – të implementimit të procedimit të ekstradimit, përsa kohë që nuk disponon rekuizitat e pranueshmërisë (definitivitetit të deklarimit të saj).

Kolegji gjen me vend të afirmojë (me këtë rast) – në kushtet e paraqitjes prej palës rekursuese – të pretendimit (motiv rekursi) – të pamundësisë së lejimit të ekstradimit të qytetarit në kushtet e mungesës së një marrëveshje të nënshkruar midis shtetit kërkues (të ekstradimit) dhe shtetit të kërkuar – konkluzion i derivuar prej përcaktimit kushtetues – të sanksionuar në paragrafin e dytë të nenit 39 të Kushtetutës – sipas përmbajtjes së të cilit, [...] se mungesa e një marrëveshjeje dypalëshe e kësaj natyre (midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës) apo edhe fakti që kjo e fundit nuk rezulton firmëtare e Konventës (shumëpalëshe) Evropiane për Ekstradimin [...] – në të cilën ka aderuar Republika e Shqipërisë – nuk paragjykon, për asnjë moment, mundësinë e ekstradimit [...] të huajit, të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë, përsa kohë që ndalimi kushtetues i sipërcituar – qartazi – presupozon kushtin e domosdoshëm për të aktivuar këtë procedurë ndaj qytetarit shqiptar dhe se – kjo “pengesë” – nuk përjashton – apriori – mundësinë e bashkëpunimit dypalësh – në këtë lëndë – të ekstradimit (reciprok) të personave të huaj – të “farkëtuar” jo mbi baza ngushtësisht konvencionale (dypalëshe apo shumëpalëshe), por mbi bazën e parimeve të të drejtës ndërkomëtare – përgjithësisht të pranuar – dhe kryesisht – të reciprocitetit.

Kompletimi – garantimi – eventual i këtij reciprociteti në fushën e kooperimit në lëndë penale, përfshirë dhe ekstradimin midis shteteve – edhe të atyre jofirmëtare të Konventës së sipërcituar – nëpërmjet nënshkrimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve (konventave) dypalëshe, nuk është, thjesht, kusht i legjitimitetit të këtij reciprociteti, por i implementimit sa më efektiv të tij.

Përtej konkluzioneve të evidentuara sa më sipër – të pranuar edhe prej gjykatave të shkallëve më të ulëta – në cilësinë e kushteve (procedurale) – toleruese të ekstradimit të personit me statusin e të huajit, prej Republikës së Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës (si shtet kërkues i ekstradimit të tij) – Kolegji, ndryshe nga konkluzionet e atyre gjykatave, të cilat, në funksion të miratimit të kërkesës së Prokurorit për ekstradimin e

këtij të fundit në Republikën Popullore të Kinës, janë prononcuar edhe për inekzistencën e kushteve ndaluese, të ekstradimit në fjalë, në mënyrë të veçantë, të atij të parashikuar nga shkronja “b”, e nenit 491 të K.Pr.Penale, të identifikuar në prezencën e “rrezikut të dënimit apo të trajtimit jonjerëzor dhe degradues apo të veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut”, të invokuar me forcë prej rekursuesit përgjatë gjithë celebrimit të këtij procedimi dhe të pasqyruar në mënyrë të detajuar në motivet e rekursit, vlerëson vendimmarrjen e tyre të vesuar prej paligjshmërisë – të evidentuar qartazi - në kushtet e ometimit prej të dy gjykatave të shkallëve më të ulëta për t’u prononcuar në kuadrin e “argumentimit” të konkluzionit miratues të kërkesës së Prokurorit për lejimin e ekstradimit mbi përmbajtjen e “kontributit” provues të prezantuar prej të proceduarit të ndikimit të tij, pikërisht në mbështetje të verifikimit të këtij kushti ndalues (të ekstradimit).

Rekursuesi, në mbështetje të pretendimit lidhur me verifikimin e kushtit ndalues të lejimit të ekstradimit, të parashikuar në shkronjën “b”, të nenit 491 të K.Pr.Penale, ka evokuar se “ekstradimi i tij në Republikën Popullore të Kinës – realizimi efektiv i tij – do të cenonte nenin 3 të Konventës për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, që proklamonte se askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës dhe as dënimeve apo trajtimeve çnjëzore ose degraduese”, pasi do ta ekspozonte atë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj rrezikut për t’iu nënshtrohet torturës dhe një dënimi ose trajtimi çnjëzëror degradues, përsa kohë që – sipas tij – përbën fakt të njohur botërisht – shkelja e rëndë e të drejtave të njeriut në Republikën e Kinës - pa harruar persekutimin e personave që denoncojnë shkeljet dhe abuzimet e kësaj natyre.

Kolegji konsideron se gjykimi i garancisë juridiksionale, i parashikuar – sikurse në rastin konkret – në tematikë të ekstradimit pasiv – i aktivuar mbi bazën e kërkesës së Prokurorit, ka për objekt, jo vetëm verifikimin e zbatimit të dispozitave të të drejtës objektive që rregullojnë këtë raport, por edhe garantimin e të drejtës themelore të lirisë dhe të sigurisë së personit që i nënshtrohet këtij gjykimi (procedimi). Përsa kohë që ekstradimi përbën një nga rastet kur – ligjërisht – mund të ushtrohet ndikim mbi këtë të drejtë – nevojitet që procedimi kryesor – “I instaluar” (regjistruar) jashtë shtetit – në vendin kërkues të ekstradimit – që motivon – përbën kushtin e ekstradimit – të respektojë këtë parashikim. Në të kundërt – ekstradimi – do të (keq)përdorej si një “sistem juridik për të shkelur – nëpërkëmbur – lirinë dhe sigurinë e individit”.

Në funksion të verifikimit të kushtit pengues (të lejimit të ekstradimit) të përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 491 të KPP, gjykatat - në kuadrin e “gjykimit të garancisë juridiksionale” – të sipërcituar – duhet të vlerësojnë ekzistencën e rrezikut (të gjeneralizuar) të trajtimit jonjerëzor dhe degradues në vendin kërkues, duke përdorur, për realizimin e këtij qëllimi, elemente objektive, të besueshëm, të sakte dhe të përditësuar në vazhdimësi, lidhur me kushtet e burgimit në Shtetin kërkues dhe, në mënyrë të veçantë – mbas verifikimit të këtij rreziku – duhet të insistojnë – qoftë edhe nëpërmjet kërkimit të informacioneve plotësuese – në drejtim të verifikimit eventual të rrezikut të “personalizuar”, sipas të cilit, i interesuari, në kushtet e dorëzimit do t’i nënshtrohej apo jo një trajtimi jonjerëzor dhe degradues, të papajtueshëm me të drejtat

themelore të personit. Barra e paraqitjes së të dhënave – elementeve – të karakterit objektiv, të besueshëm, të saktë dhe të përditësuara lidhur me gjendjen dhe kushtet e burgimit (institucionet e burgimit dhe të paraburgimit) në Shtetin kërkues [...] takon personit për të cilin kërkohet ekstradimi.

[...] Kolegji [...] konsideron se pretendimet e evokuara prej të interesuarit – personit me statusin e të huajit – ndaj të cilit kërkohet lejimi i ekstradimit në Republikën Popullore të Kinës sipas të cilave – ekstradimi i tij në atë shtet, do ta ekspozonte [...] ndaj rrezikut të nënshtrimit ndaj torturës dhe dënimeve ose trajtimeve jonjerezore dhe degraduese – në shkelje të nenit 3 të KEDNJ – gjejnë mbështetje të plotë në “elemente - të dhëna - të karakterit objektiv, të besueshme, të sakta dhe të përditësuara lidhur me gjendjen e burgimit në shtetin kërkues” – të receptuara/nxjerra prej raporteve (të vena në dispozicion të gjykatave, prej të interesuarit) të organizmave të Kombeve të Bashkuara dhe/ose të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe jo qeveritare – që kanë referuar mbi situatën (gjendjen) e strukturave të vuajtjes së dënimit dhe të paraburgimit të shtetit kinez, të cilat, edhe pa kontributin e të interesuarit – ishin lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultueshme prej Gjykatës (gjykatave të shkallëve më të ulëta).

Duke iu referuar përmbajtjes së këtyre raporteve (të evidentuara në mënyrë ezauruese në vendimin e datës 06.10.2022, të GJEDNJ, *Liu kundër Polonisë*, [...]), do të konstatohej se: [...] Konkluzionet e sipërcituara të organizmave ndërkombëtare, evokuese të përshkrimit të përdorimit të përhapur të torturës dhe të keqtrajtimeve të tjera - të ndaluara prej nenit 3 të Konventës – në shtetin kërkues të ekstradimit – në Republikën Popullore të Kinës, impononin minimalisht detyrimin e gjykatave të shkallëve më të ulëta për të realizuar një analizë penetruese të burimeve të disponuara dhe, në mënyrë të veçantë, në prani të akuzave të rënda për keqtrajtime të përhapura në vendin e destinacionit, detyrimin për të verifikuar impaktin e kësaj situate mbi rastin konkret, nëse i interesuari ishte i ekspozuar ndaj një rreziku real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës (konkluzione të deklamuara mutatis mutandis në vendimin e GJEDNJ, *Amerkhanov kundër Turqisë* – nr. 16026/12, datë 05 Qershor 2018).

Kolegji, duke mbajtur parasysh qëndrimet e GJEDNJ, lidhur me vlerësimin në funksion të përcaktimit se – nëse personi i interesuar do të ekstradohej – do të rrezikonte t'i nënshtrohej trajtimeve në kundërshtim me nenin 3 të Konventës – do të duhej të zhvillonte ekzaminimin e situatës së përgjithshme në vendin e destinimit të të interesuarit – nëse në atë vend ekziston një situatë e përgjithshme dhune me impakt të drejtpërdrejtë, sikurse u sipërcitua në ekspozimin e këtij individi (rrezikimin e tij) ndaj kësaj dhune. Në të njëjtën kohë, në kushtet kur ekstradimi presupozon automatikisht vendosjen – sistemimin – e të interesuarit në strukturat e paraburgimit të shtetit kinez, ky vlerësim imponon prononcimin nëse kjo vendosje e tij, në këto struktura, do ta ekspozonte atë ndaj këtij rreziku në thelb, nëse përdorimi i torturës dhe i formave të tjera të keqtrajtimit në brendësi të sistemit penitenciar kinez është i përhapur në atë shkallë sa të barazohet me ekzistencën e një situate të përgjithshme dhune.

Konstatimet e denoncuar në raportet e publikuara të organizmave qeveritare dhe jo qeveritare ndërkombëtare, sikurse në mënyrë të detajuar u evidentuan në përmbajtjen e

këtij vendimi, për shkak të originës – burimit të tyre – të besueshmërisë, objektivitetit, autoritetit dhe reputacionit të autoreve të tyre, seriozitetit të investigimit, koherencës së konkluzioneve, si dhe mbështetjes së tyre edhe nga burime të tjera, konsiderohen, prej këtij Kolegji, të afta për të konkluduar (në të njëjtat kushte dhe në mënyrë të pashmangshme, sikurse është konkluduar në vendimin e GJEDNJ, [..] *Liu kundër Polonisë*, por edhe në vendimin *Sufi dhe Elmi kundër Mbretërisë së Bashkuar* – [..])

Përfundimisht, referuar këtij aspekti – rrezikut real të keqtrajtimit, me të cilin sipas GJEDNJ, në referim të raporteve ndërkombëtare, do të përballet rekursuesi në eventualitetin e miratimit të kërkesës për ekstradim, Kolegji çmon se ekstradimi nuk mund të lejohet. Ky rast ndalimi parashikohet dhe në shkronjën “b”, të nenit 491, të KPP, të titulluar “Mospranimi i kërkesës për ekstradim”, në të cilin parashikohet [..] Në rastin konkret, në rast ekstradimi, rekursuesi do të përballet me rrezikun real të keqtrajtimit dhe shkeljes së ndalimit të torturës. Ky shkak, edhe pa qenë nevoja të hetohet më tej lidhur me pretendimet e rekursuesit për përballjen me rrezikun e keqtrajtimit për shkak të fesë që ai pretendon se praktikon, është i mjaftueshëm për mospranimin e kërkesës për ekstradim. Në mbështetje të këtij konkluzioni edhe fakti se nga ana e autoriteteve kineze nuk është dhënë garanci se personi i kërkuar nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t’i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi, kusht ky i kërkuar për lejimin e ekstradimit, i parashikuar në nenin 490, të KPP. Konkretisht në pikën 1, të këtij neni [..] duke vijuar përjashtimet përkatëse. Respektimi i këtij parimi, i njohur si parimi i specialitetit i sanksionuar në këtë dispozitë, por edhe në Konventën Evropiane për Ekstradimin, në nenin 14, të së cilës (të ndryshuar më nenin 3, të Protokollit të katërt shtesë), parashikohet se[..]e pra, respektimi i këtij parimi dhe për rrjedhojë mungesa e kësaj garancie përbën kusht (tjetër), mungesa e plotësisht të të cilit gjithashtu, referuar parashikimeve të nenit 490, të Kodit tonë të Procedurës Penale, i cili, në mungesë të një marrëveshjeje ekstradimi të nënshkruar nga të dy shtetet, apo të një konvente përkatëse, përbën ligjin e aplikueshëm, nuk lejon ekstradimin në shtetin kërkuar. Sa më sipër, Kolegji çmon se rekursi duhet të pranohet dhe, në bazë të parashikimeve të shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 441, të KPP, sipas të cilës[..]vlerëson se vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta të ndryshohen, duke u disponuar rrëzimi i kërkesës për ekstradimin e shtetasit [..]në Republikën Popullore të Kinës për efekt të zbatimit të vendimit penal nr. DG (X) BZ (2022) 00055, datë 20.05.2022, të Gjykatës Deking, të Provincës Zhejiang/Kinë, dhe për rrjedhojë, revokimi i masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” të dhënë ndaj palës së interesuar, nga gjykatat shqiptare, për efekt të këtij procedimi lidhur me këtë kërkesë për ekstradim.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2021-53, datë 07.10.2021

KPGJL Vendim Nr.00-2023-1099(195), datë 30.06.2023 (Mosidentifikimi i personit të kërkuar në gjykim)

Në rastin kur personi për të cilin kërkohet ekstradimi është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të ndryshme, dhe kur ekzistojnë paqartësi rreth identifikimit të tij si person i dënuar në një nga vendimet, gjykata lejon ekstradimin duke e reduktuar lejimin e ekstradimit vetëm për ekzekutimin e atij vendimi për të cilin identifikohet qartësisht identiteti i personit.

Fjalë kyçe: identifikim subjekt ekstradimi, kusht pengues lejim ekstradimi

Rrethanat e çështjes:

Ka rezultuar se, më datë 16.04.2022, në orën 19:30, është arrestuar shtetasi E.Gj. pasi nga Zyra Qendrore e Interpolit Tiranë është konfirmuar se ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma - Itali mbështetur në vendimin e Gjykatës së Breshias nr. [...], sepse është dënuar për veprën penale “Shfrytëzim prostitucioni, rrëmbim personi, heqje e paligjshme e lirisë”, vepra këto të parashikuara nga Kodi Penal Italian dhe ai Shqiptar. Mbështetur në marrëveshjen dypalëshe të ekstradimit, [...] ratifikuar nga Parlamenti me Ligjin nr.9871, datë 11.02.2008, si dhe Konventës Europiane të Ekstradimit [...], Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në çështjet penale, nga ana e policisë është bërë identifikimi i të kërkuarit E.GJ. dhe është kryer arrestimi i tij me qëllim ekstradimin. [...]

[...] Në përputhje me kërkesën e Prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës [...], ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin dhe ka caktuar masën e sigurimit “arrest me burg”. [...] Ministria e Drejtësisë Italiane me shkresën me referencë [...], i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë dokumentacionin që lidhet me ekstradimin e shtetasit së bashku me urdhrin e datës 25.09.2007, të Zyrës së Prokurorisë së Breshias Itali, për ekzekutimin e dënimit të dhënë ndaj këtij shtetasi e në përfundim të shkresës kërkohet ekstradimi i shtetasit E.GJ.. Sa më sipër organi i akuzës kërkon nga gjykata dhënien e vendimit në favor të ekstradimit të shtetasit E.Gj., sepse kërkesa është e mbështetur në Konventën Europiane për ekstradimin, datë 13.12.1957, në nenet 492, 497 të KPP si dhe nenin 31 e vijues të Ligjit nr.10193, datë 03.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Durrës, [...] ka vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradimin në shtetin italian të shtetasit shqiptar [...] Gjykata e Apelit, Durrës, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr[...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] konsideron se vendimi [...] i Gjykatës së Apelit, Durrës, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal, për rrjedhojë vendimi duhet të priset dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Asnjë nga shkaqet e përcaktuara nga neni 491 i KPP – integruese të refuzimit të ekstradimit – nuk rezultoi i verifikuar në mbështetje të vendimmarrjeve (refuzuese) të Gjykatave të shkallëve më të ulëta – lidhur me kërkesën e Prokurorit për ekstradimin në shtetin italian të qytetarit shqiptar E.Gj.– për ekzekutimin e dënimit penal të dhënë

– ndaj këtij të fundit – prej autoritetit gjyqësor (Gjykatës) të atij shteti.

Motivimi i vendimmarrjes refuzuese (të ekstradimit të qytetarit shqiptar) prej Gjykatave të shkallëve më të ulëta – dhe prej Gjykatës së Apelit – në mënyrë të veçantë – përtej shkaqeve të përcaktuara në dispozitën e sipërcituar - me - “mosidentifikimin e personit të kërkuar ndaj të cilit zhvillohet ky gjykim – E.Gj. - me qytetarin A.Gj.– ndaj të cilit janë dhënë vendimet e dënimit (prej Gjykatave të shtetit italian) – për të cilat kërkohet ekstradimi” – konsiderohet – prej këtij Kolegji – në kushtet e pabazueshmërisë – së konstatuar haptazi – përsa kohë që kjo “problematikë” i ka rezultuar Gjykatës (gjykatave) të gjykimit të procedimit të ekstradimit – vetëm përsa i përket (njërit prej dënimeve – objekt i kërkesës së ekstradimit) dënimit të dhënë – nga Gjykata e (qytetit) Breshia (seksioni i dytë i kësaj Gjykate) – Itali - ndaj këtij personi - me vendimin nr.515/2004 R.G - datë 09.07.2004 (marrë formë të prerë me datë 01.11.2004) që e ka deklaruar fajtor për veprat penale të “kundërshtimit dhe dëmtimit të punonjësit të policisë së rendit publik” dhe dënuar me gjashtë muaj e dhjetë ditë burgim (për ngjarjen e datës 08.05.1998 - kur edhe rezultonte arrestimi në flagrancë i tij) – dënim i pezulluar dhe - më pas – i revokuar (pezullimi).

Sakaq - lidhur me dy vendimet e tjera të gjykatave të shtetit italian – për të cilat kërkohet ekstradimi i qytetarit shqiptar – të identifikuar në – vendimin e Gjykatës së Apelit – Venecia - nr. 94/2003 N Reg. Gen. App – datë 27.03.2003 – që ka dënuar përfundimisht të pandehurin A.Gj për veprat penale të “trafikimit të femrave për prostitucion dhe shfrytëzimit të prostituimit të tyre - nëpërmjet dhunës të ushtruar ndaj tyre, në bashkëpunim, me gjashtë vjet burgim (dhe 103.688 euro gjobë) (vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 22.06.2003) dhe – në vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (seksioni i parë)- Venecia – nr.1/2003 R.G. (Assise Apello) – datë 07.05.2003 (që ka gjykuar apelin ndaj vendimit të Gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda – Verona – të datës 28.01.2002) – me të cilin është dënuar përfundimisht – i pandehuri – A.Gj (alias Beni) – me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim – për veprat penale të “favorizimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit”, në bashkëpunim dhe të “Reduktimit në kushte të ngjashme me skllavërinë” - në dëm të shtetases shqiptare Gj.GJ. (në bashkëpunim) – të parashikuara nga nenet 110/3, 600, të Kodit Penal Italian (vendim i cili ka marrë formë të prerë, me datë 27.06.2003) – edhe për të cilët është refuzuar ekstradimi i të dënuarit Gjokja – në shtetin italian - Kolegji – në të njëjtat kushte sikurse invokohet në shkaqet – motivet - e rekursit - prej Prokurorit - nuk dallon asnjë lloj “problematike” të këtij karakteri por as ndonjë “pengesë” tjetër si ato të parashikuara në nenin 491 të KPP determinuese të refuzimit të ekstradimit për në shtetin italian të të dënuarit, aq më tepër kur edhe vetë Gjykata e Apelit (duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë) – argumenton korrektësisht – në mënyrë shteruese – inekzistencën e “pengesave” të parashikuara në këtë dispozitë – nenin 491 të KPP – duke “përgënjeshtuar” respektivisht të gjitha argumentet e përdorura nga gjykata e shkallës së parë (me përjashtim të problematikës së identifikimit të personit subjekt i kërkesës për ekstradim) në mbështetje të refuzimit të kësaj kërkesë – të parashikuar në këtë dispozitë.

Sikurse qartazi verifikohet nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të shtetit

italian – të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda – Venecia – që kanë dënuar në mënyrë përfundimtare të pandehurin – në të dy rastet - asnjë lloj problematike nuk evidentohet në drejtim të individualizimit të veprimtarisë kriminale të zhvilluar prej tij në kuadrin e bashkëpunimit me pjesëtarë të tjerë të këtij organizmi për kryerjen e veprave penale të ngarkuara sipas akuzës dhe të verifikuara në gjykim – përsa kohë që – në mënyrë të detajuar – evidentohet pozicionimi dhe veprimtaria konkrete e secilit individ – në këtë “ndërmarrje” të jashtëligjshme – përgjatë gjithë periudhës së shtrirjes së aktivitetit kriminal të saj – periudha midis viteve 1998 - deri në vitin 2001 – të marrë në analizë prej organit të procedimit penal.

Qartazi dhe pa asnjë ekuivok identifikohen dhe ndërliiden - në të dy gjykimet e sipërcituara – në mënyrë individualizuese – pjesëtarët e “organizmës” kriminale të dedikuar në trafikimin e femrave (të rekrutuara në vendet e Europës Lindore – Moldavi, Rumani, por edhe në vendin e origjines së tyre - në Shqipëri) dhe shfrytëzimin e prostituimit të tyre në territorin e shtetit italian – veprimtaria konkrete e secilit prej tyre – në kohë dhe territor – me ndarje detyrash- “patronazhim”, “administrim” dhe “shfrytëzim” të “mallit” – “mish i bardhë” - objekt dhe subjekt i trafikimit - në maksimumin e “efiçencës”- gjë që përjashton edhe mundësinë më të vogël për të paragjykuar dhe vënë në diskutim këtë individualizim.

Kolegji konsideron se - në këto kushte - të inekzistencës - së problematikës identifikuese të personit të dënuar - subjekt i aktivimit të procedurës së ekstradimit – të paktën për dy vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të Apelit për Krime të Rënda të Venecia-as – qytetarit shqiptar – A. (E.) Gj. – përsa kohë që një problematikë e kësaj natyre nuk është evidentuar në asnjë rast as nga gjykatat gjyquese të akuzës (ndaj tij) në shtetin italian dhe as nga gjykatat në disponim të të cilave rezultoi gjykimi i procedimit të ekstradimit – në shtetin shqiptar - por edhe të shkaqeve penguese të ekstradimit - të përcaktuara në nenin 491 të KPP (sikurse qartësisht shprehet Gjykata e Apelit) – asgjë nuk e ndalon atë Gjykatë – të Apelit – që ka gjykuar – në rastin konkret – procedimin e ekstradimit mbi kërkesën e Prokurorit - për të “specializuar” – reduktuar – lejimin e ekstradimit edhe vetëm për ekzekutimin e vendimit – dënimit - të sanksionuar në të dy vendimet e sipërcituara - në total prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim.

Në terma të tjerë - Gjykata e Apelit (sikurse edhe gjykata e shkallës së parë) - megjithëse në kushtet e sipërcituara – të verifikimit të prezencës së dy dënimeve të sanksionuara pa asnjë ekuivok dhe paqartësi ndaj qytetarit shqiptar– prej autoritetit gjyqësor të shtetit italian – objekt i kërkesës së ekstradimit (bashkë me vendimin e Gjykatës së Breshia -as) – ka ometuar - pa asnjë lloj shkaku - të prononcohet në favor të pranimit të kësaj kërkesë – nën justifikimin e paqartësisë së identifikimit të këtij të fundit – [...]– në cilësinë e personit që kryer veprën penale të gjykuar nga Gjykata e qytetit Breshia.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se rekursi i prokurorisë përmban shkaqe të bazuara në nenin 432 të KPP. Fakti nëse gjurmët e gishtave të marra në vendngjarjen e procedimit penal të rregjistruar në vitin 1998 në Prokurorinë pranë Gjykatës së qytetit të Breshia-as nuk përputhen me gjurmët e gishtave të qytetarit E.Gj. nuk pengon ekstradimin e

këtij të fundit - drejt shtetit italian - përsa kohë që dënimet e dhëna - në dy vendimet e tjera - nga Gjykatat e shtetit italian- Gjykata e Apelit dhe e Apelit për Krime të Rënda e qytetit Venecia (të formës së prerë) - respektivisht prej gjashtë dhe dhjetë vjet burgim – kanë identifikuar pa asnjë ekuivok - shtetasin E. Gj.- si autor i veprave penale për të cilat kërkohet ekstradimi. Sa më sipër, Kolegji vlerëson prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2022-96, datë 13.01.2022

VIII. Analizë e elementëve të veprave të ndryshme penale

KPGJL Vendim Nr.00-2021-483, datë 06.07.2021 (Dhuna në familje: klasifikimi i veprës penale)

Klasifikimi i veprave penale si kundërvajtje nuk mund të lidhet automatikisht me masën e dënimit me burgim që parashikon K.Penal. Vepra “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.P. përbën krim dhe jo kundërvajtje penale.

Me ndryshimet e KPP me ligjin nr. 35/2017, në rastin e procedimit për një kundërvajtje penale, vendimi i pushimit të çështjes ose akuzës merret nga prokurori dhe ankimi ndaj këtij vendimi shqyrtohet në dhomë këshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake. Ndërsa, në rastin e procedimit për krime, pushimi i çështjes ose akuzës kërkohet nga prokurori dhe vendimi merret nga gjyqtari i seancës paraprake.

Fjalë kyçe: kundravajtje penale, krim, dhuna në familje, pushim çështje/ akuzë, gjyqtar seancë paraprake

Rrethanat e çështjes:

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se më datë 27.08.2016 shtetasja T.S. ka paraqitur kallëzim penal për dhunë e ushtruar nga shtetasit O.O., nipi i saj (djali i motrës).

Organi procedues ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor. Kallëzuesja ka shkuar për të kontaktuar mjekun e përcaktuar si ekspert, por është vënë në dijeni se ai është larguar dhe në këto kushte është paraqitur pranë një mjeku-ligjor tjetër i cili ka kryer dhe aktin e ekspertimit. Akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. 155, datë 30.08.2016, ka konstatuar se tek shtetasja T.S. janë vërejtur 3 ekimoza [...], dëmtime këto të shkaktuara me mjet mprehtës, të cilat hyjnë në kategorinë e rrahjes, pasi kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme për punë në masën deri në 9 ditë.

Në kushtet kur akti i ekspertimit nuk është realizuar nga mjeku-ligjor i përcaktuar si ekspert, prokuroria e ka shpallur aktin relativisht të pavlefshëm dhe ka urdhëruar kryerjen e riexpertimit. Eksperti mjeko-ligjor i caktuar për riexpertimin nuk ka arritur të realizojë aktin e ekspertimit shtetasja T.S. nuk është paraqitur dhe aktualisht ndodhet jashtë shtetit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e

datës 17.11.2016, ka vendosur pushimin e procedimit penal në bazë të nenit 328 pika 1, shkronja “dh” të KPP.

Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim viktima T.S..

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin [...], ka vendosur pranimin e ankimit. Prishjen e vendimit të datës [...] të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për pushimin e procedimit penal nr. 1600 të vitit 2016. Urdhërohet Prokuroria të vazhdojë hetimet për këtë procedim”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në përfundim të hetimeve me datë 10.03.2017 ka vendosur pushimin e procedimit penal [...], për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal., bazuar në nenin 328/1, shkronja “f” dhe 329/a të KPP, me arsyetimin se nuk provohet që shtetasi O.O. (nipi i saj) të ketë konsumuar elementet e veprës penale “Dhuna në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, nuk provohet se vepra penale është kryer nga ky shtetas.

Viktima T.S. ka paraqitur ankim ndaj vendimmarrjes së prokurorisë për pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, [...] ka vendosur shfuqizimin e vendimit [...] të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan që lidhet me procedimin penal [...] si një vendim që vjen në kundërshtim me ligjin...” [...]

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka paraqitur kërkesën për pushimin e procedimit penal [...], për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, bazuar në nenin 328/1, shkronja “f” dhe 329/a të KPP. Prokuroria, duke marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në kushtet kur fakti i kallëzuar nga shtetasja T.S. nuk përmban elementët e veprës penale të “Dhunës në familje”, si dhe nuk ka elemente të ndonjë vepre tjetër plotësohen kushtet për pushimin e procedimit penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, [...]ka vendosur kthimin e akteve prokurorit duke e urdhëruar të formulojë akuzën në ngarkim shtetasit O.O. për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal....”.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 293, datë 03.10.2018, ka vendosur: prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe pushimin e çështjes për shkak të mungesës së juridiksionit. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] çmon se rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në **nenin 432 të KPP të, cilat do të bënin të cenueshëm vendimin** [...] të Gjykatës së Apelit Durrës pasi vendimi i gjykatës është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural. [...]

Gjykata Apelit ka gabuar kur ka mbajtur qëndrimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet prishur dhe aktet duhen dërguar prokurorit, pasi është në kompetencën e tij të vendosë në lidhje me pushimin e procedimit për një kundërvajtje penale. Gjykata e Apelit gabon në interpretimin e ligjit material, pasi arsyeton se vepra penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.P. përbën kundërvajtje penale, për sa kohë parashikon dënim me burgim deri në dy vjet.

Kolegji vlerëson se K.Penal është i ndërtuar duke u bazuar në frymën e parimit të ligjshmërisë, i cili ka natyrë kushtetuese. Parimi i ligjshmërisë kërkon që legjislatori të përcaktojë në mënyrë precize dënimin, sanksionin për çdo figurë të veprës penale. Sipas këtij parimi është vetëm ligji, ai që përcakton veprat penale, sipas tipareve të specifikës, të plotësisë (përcaktimit të rasteve), dhe fuqisë joprapavepruese, duke identifikuar të mirat juridike që duhet të mbrohen nga sanksioni penal, nëpërmjet përcaktimit të veprimeve ose mosveprimeve që i cenojnë ato. Në këto kushte klasifikimi i veprave penale si kundërvajtje nuk mund të lidhet automatikisht me masën e dënimit me burgim që parashikon vepra penale. Në interpretim sistematik të K.Penal rezulton se në mënyrë taksative Kodi ka parashikuar se cila nga figurat e veprave penale është kundërvajtje, pa e lidhur këtë klasifikim domosdoshmërisht me masën e dënimit me burgim të parashikuar për veprën penale. Në këto kushte, ndryshe nga sa arsyetohet Gjykata e Apelit Durrës, vepra “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.P. përbën krim dhe jo kundërvajtje penale.

Kolegji vlerëson të theksojë se KPP, me ligjin nr. 35/2017 pësoi ndryshime thelbësore lidhur me institutin e pushimit të çështjes ose akuzës. Konkretisht, neni 327/6/a (shtuar me ndryshimet me ligjin nr. 35/2017), parashikon se: [...] Normat procedurale penale në fuqi, në mënyrën sesi janë rregulluar nuk pajtohen me normat e mëparshme të KPP. Me ndryshimet e KPP me ligjin nr. 35/2017, në rastin e procedimit për një kundërvajtje penale, vendimi i pushimit të çështjes ose akuzës merret nga prokurori dhe ankimin ndaj këtij vendimi shqyrtohet në përputhje me nenin 329 në dhomë këshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake. Ndërsa, në rastin e procedimit për krime, siç është dhe rasti objekt gjykimi, pushimi i çështjes ose akuzës kërkohet nga prokurori dhe vendimi merret nga gjyqtari i seancës paraprake. Aktualisht, është gjykata, e cila merr në shqyrtim në seancë paraprake, me dyer të mbyllura dhe në prani të palëve, në përputhje me nenin 329/b, kërkesën e prokurorisë për pushimin e akuzës ose të çështjes.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është i pabazuar dhe çështja duhet të priset dhe të kthehet për të vijuar gjykimi i ankimi të prokurorisë. Gjykata e Apelit duhet të shqyrtojë themelsinë dhe bazueshmërinë e pretendimeve të ngritura në ankim nga organi i akuzës.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2022-548(148), datë 31.05.2022

KPGJL Vendim Nr.00-2022-68(47), datë 17.02.2022 (Shërdorimi i detyrës: ndarja përgjegjësi penale/administrative)

Përfitim i padrejtë në rastin e veprës penale të shpërdorimit të detyrës mund të ekzistojë edhe kur veprimtaria e paligjshme e funksionarit publik është në favor të një shoqate që nuk kryen veprimtari fitimprurëse.

Fjalë kyçe: tejkalim kompetencë, përgjegjësi administrative, përgjegjësia penale, organizatë jofitimprurëse, përfitim i padrejtë

Rrethanat e çështjes:

Nga gjykimi i çështjes me procedurën e gjykimit të zakonshëm ka rezultuar se, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet ka regjistruar procedimin penal nr. 105, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit G.J.

[...] rezulton e provuar se, më datë 13.10.2015, shtetasi E.V. ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë [...], në bazë të së cilit ka kërkuar marrjen në përgjegjësi penale të shtetasit G.J., me cilësinë e ish-Kryetarit Bashkisë Përmet, për shkak se ai ka lejuar shtetasin A.B. të kryejë punime për ndërtimin e një objekti mbi një sipërfaqe trualli në pronësi të vëllazërisë “Vaso”, si dhe të shtetasit G.K., me detyrën e Regjistruarit të ZVRPP Përmet, i cili është pretenduar se ka shpërdoruar detyrën duke mos regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie për këtë sipërfaqe trualli Vëllazërinë “Vaso”.

Rezulton e provuar se, me vendimin nr. 549, datë 29.10.1996, të ish-KKPP pranë Këshillit të Rrethit Përmet, është vendosur të njohë si ish-pronar A.S., P.M., P.V. *për parcelat me sipërfaqe 369 m2, 552 m2, 813 m2 dhe 32 255 m2...*. Vendimi i mësipërm është shfuqizuar me vendimin nr. 164, datë 29.04.2010, të Drejtorit të AKKP Tiranë në ushtrim të së drejtës së iniciativës për shqyrtimin e ligjshmërisë sipas përcaktimeve [...] të ligjit nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, dispozita ligjore këto që janë shfuqizuar me vendimin nr. 27, datë 26.05.2010, të Gjykatës Kushtetuese. Në zbatim të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese rezulton se mbi bazën e padisë së paraqitur nga vëllazëria “Vaso”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anën e vendimit nr.5472, datë 17.05.2013, ka konstatuar si absolutisht të pavlefshëm vendimin [...] të Drejtorit të AKKP dhe kjo mënyrë disponimi rezulton të jetë lënë në fuqi me vendimin [...], të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për sa më sipër, E.V. dhe trashëgimtarë të tjerë disponojnë një titull pronësie për sipërfaqen 25 000 m2, sipas [...] në vendimin nr. 549, datë 29.10.1996, të ish-KKK Pronave Përmet. Më datat 25 dhe 26 korrik 2015, sipas deklarimeve të kallëzuesit E.V. rezulton të jetë konstatuar prej tij [...] se pikërisht në këtë sipërfaqe trualli të pretenduar si e fituar nga vëllazëria “Vaso”, me vendimin [...] të ish-KKK Pronave Përmet, ishte duke u kryer një ndërtim, fakt për të cilin nga ana e kallëzuesit janë njoftuar një sërë organesh shtetërore, si Komisariati i Policisë Përmet, INUK-u dhe Kryetari i porsazgjedhur i Bashkisë Përmet, me qëllim ndalimin e punimeve për realizimin e këtij ndërtimi.

Me urdhrin nr. 7, datë 31.07.2015, “Për pezullim punimesh”, Kryetari i Bashkisë Përmet, ka urdhëruar pezullimin e menjëhershëm të punimeve të subjektit “Rafting Outdoors Sports” deri në verifikimin e plotë të dokumentacionit që disponon subjekti dhe procedurës së dhënies së lejes së ndërtimit; [...]

[...]Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, [...] ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së këtij akti administrativ, për shkak të tejkallimit të kompetencave nga ana e Kryetarit të Bashkisë Përmet. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, nuk rezulton të ketë marrë formë të prerë, pasi ankimi i paraqitur ndaj këtij vendimi nga ana e Bashkisë Përmet, nuk rezulton të jetë shqyrtuar ende nga Gjykata Administrative e Apelit.

[...] Për sa më sipër, në datë 13.10.2015, shtetasi E.V. ka depozituar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet kallëzimin penal nr. 146. [...]

Në dosjen gjyqësore është administruar me cilësinë e provës, kontratë qiraje me nr.137 prot, datë 18.02.2015 e lidhur midis Bashkisë Përmet, e përfaqësuar nga Kryetari G.J., me cilësinë e qiradhënësit dhe “Rafting Vjosa Outdoors Sports”, [...] rezulton se objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e një sipërfaqe trualli prej 70 m2, në administrim të Bashkisë Përmet në funksion të veprimtarisë së “Rafting Vjosa Outdoors Sports”. Çmimi i qirasë për këtë sipërfaqe trualli është përcaktuar 7,000 lekë në muaj, ndërsa afati i kohëzgjatjes së kontratës është përcaktuar 1 vit, nga momenti i lidhjes së kontratës dhe me të drejtë ripërtëritje për çdo vit. Gjithashtu në dosje është administruar “Deklarata Paraprake për Kryerje Punimesh” nr. 471 prot, datë 24.07.2015, dhe rezulton që ky dokument është miratuar dhe nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Përmet, shtetasi G.J. në favor të subjektit, Shoqata “Rafting Vjosa Outdoors Sports” Përmet [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, [...] ka vendosur deklarimin fajtor të pandehurit G.J., për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i K.Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.

Gjykata e Apelit Gjirokastër, [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe pushimin e çështjes.” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se pretendimet e ngitura nga prokuroria i referohen shkaqeve të rekurisit të parashikuara nga 432 i KPP. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit ka vlerësuar ndryshe faktet dhe provat, duke arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa kjo vendimmarrje nuk është në përputhje me faktin penal që rezulton nga të dyja vendimet gjyqësore. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit nuk ka interpretuar si duhet detyrat që ka pasur i gjykuari në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet, kompetencat për dhënien e lejes për të kryer ndërtimin përkatës nga personi juridik “Rafting Vjosa Outdoor Sports” dhe procedurën që duhej ndjekur në një rast të tillë. Kolegji vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Apelit se nga i gjykuari Gilberto Jaçe ka pasur neglizhencë por jo elemente të përgjegjësisë penale, nuk është në përputhje me faktet dhe rrethanat, e vlerësuara si të provuara nga të dyja gjykatat e faktit.

Kolegji çmon se, fillimisht, duhet vënë në dukje se Kolegji Penal nuk e shqyrton rekurstin në drejtim të përcaktimit të fajësisë ose jo të të gjykuarit Gilberto Jaçe, pasi kjo është një çështje që i përket gjykatave të faktit. Gjykata e Lartë nuk është gjykatë fakti, por është gjykatë ligji që kontrollon vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm në drejtim të zbatimit të ligjit material apo procedural. Mënyra e vlerësimit të fakteve dhe provave, sipas qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit Penal është një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. [...]

[...] Kolegji konstaton se ndërsa fakti penal është pasqyruar si i njëjtë nga të dyja gjykatat e faktit, përfundimi i arritur prej tyre në lidhje me përgjegjësinë penale të të gjykuarit është i ndryshëm, për shkak të interpretimit që ato kanë bërë dispozitave ligjore dhe nënligjore në lidhje me procedurën ligjore dhe administrative që duhet të ndiqej

për rastin në fjalë. Gjykata e Apelit ka arritur në përfundimin se i gjykuari vërtetë ka marrë kompetencat e Këshillit Bashkiak për lidhjen e kontratës së qirasë, duke shkelur dispozitat e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, por një situatë e tillë nuk pasjell përgjegjësi penale për të, pasi ai gabimisht ka besuar se ka qenë i autorizuar nga Këshilli për lidhjen e çdo kontrate. Kolegji e gjen këtë përfundim jo në mbështetje me rrethanat e çështjes. Të dyja gjykatat kanë pranuar se i gjykuari në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Përmet ka lidhur një kontratë qiraje për një pronë të ndodhur buzë lumit Vjosë, e cila nga aktet nuk rezultonte në pronësi të Bashkisë, por për të cilën ka pretendime pronësie kallëzuesi dhe familja e tij.

Në lidhje me statusin juridik të pronës, gjykatat kanë arritur në përfundime të ndryshme. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se prona ku është kryer ndërtimi është breg lumi, për rrjedhojë pronë shtetërore, e patjetërsueshme dhe e parashkrueshme. Sipas gjykatës së shkallës së parë, i gjykuari ka dhënë me qira një pronë shtet, e cila është e patjetërsueshme. Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit ka arritur në përfundimin se i gjykuari ka dhënë me qira një pronë, e cila ishte kaluar me VKM Bashkisë Përmet.

Kolegji vlerëson se nga këqyrja e fotografive të kryera në vendin e ngjarjes, konstatohen lehtësisht dy fakte: së pari, objekti është ndërtuar në buzë të lumit “Vjosë”, fakt që mbështet arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me natyrën juridike të kësaj prone. Së dyti, konstatohet se prona e ndërtuar është me konstruksion betoni dhe hekuri, për të cilat, sipas ligjit, është e nevojshme pajisja me leje ndërtimi. Nga ana tjetër, akti i ekspertimit i kryer pas riçeljes së hetimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit ka konkluduar se ndërtimi i kryer mund të kryhej edhe me paraqitjen e një deklaratë paraprake punimesh. Konkluzionet e aktit të ekspertimit mbi të cilat është bazuar Gjykata e Apelit, duhet të vlerësoheshin në raport me të gjitha provat e tjera në gjykim, pa i dhënë atyre vlerë përcaktuese në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Kolegji e vlerëson të drejtë përfundimin e Gjykatës së Apelit se gjykata, kur nuk ka njohuri të posaçme në fushën inxhinierike, duhet të marrë ekspert të fushës, por gjithashtu duhet pasur në vëmendje që akti i ekspertimit është një provë si gjithë të tjerat, i cili duhet vlerësuar në raport me to dhe t’i jepet vlera e duhur ligjore. Nuk është eksperti ai është vendos për përgjegjësinë penale, por është gjykata e caktuar me ligj.

Kolegji konstaton se Gjykata e Apelit pranon tejkalimin e kompetencës nga i gjykuari, duke marrë kompetencat e Këshillit Bashkiak, por konkludon se mungon dashja e tij, si element i anës subjektive të veprës penale. Edhe për këtë shkak përjashtohet përgjegjësia penale sipas nenit 248 të K.Penal. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se përfundimi i Gjykatës së Apelit se objekti i ndërtuar në kohën e gjykimit në apel është hequr dhe vendi është kthyer në gjendjen e mëparshme, nuk është fakt relevant në lidhje me përgjegjësinë penale të të gjykuarit Gilberto Jaçe.

Vepra penale për të cilën është ngritur akuza është “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal: [...] Në çështjen objekt gjykimi, sipas faktit penal të pranuar si i njëjtë nga të dyja gjykatat, rezulton se i gjykuari G.J. ka kryer veprime në kundërshtim me detyrën e tij, në tejkalim të kompetencave të tij, pasi ka lidhur një kontratë qiraje, kompetencë që në bazë të ligjit i përket Këshillit Bashkiak. Subjekti në

rastin konkret është subjekt i posaçëm, pasi i gjykuari në kohën e kryerjes së veprës penale të pretenduar nga akuzu ka qenë në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë dhe ka përdorur funksionin e tij publik për lidhjen e kontratës së qirasë. Dëmtimi i interesave të ligjshëm të shtetit apo shtetasve është një pasojë që dukshëm identifikohet kur ndërtohet një ndërtim, konstruksion betoni dhe hekuri, në buzë të lumit Vjosë, që është zonë me rëndësi të veçantë mjedisore.

Gjykata e Apelit përjashtimin e mungesës së përfitimit të subjektit “Rafting Vjosa Outdoors Sports” e lidh me formën e organizimit të tij, si një organizatë jofitimprurëse në formën e shoqatës. Sipas gjykatës së Apelit fakti që kemi të bëjmë me një shoqatë, që nuk mund të kryejë veprimtari fitimprurëse e përjashton mundësinë që ajo të ketë marrë përfitime nga veprimet e të gjykuarit, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë. Këtë përfundim Kolegji e vlerëson si të sforcuar dhe jo në përputhje me ligjin. Është e vërtetë që një shoqatë nuk mund të kryejë veprimtari fitimprurëse, por nuk përjashtohet mundësia që ajo të kryejë veprimtari ekonomike. Por edhe më tej, fakti që një shoqatë do të kryente veprimtari fitimprurëse në kundërshtim me ligjin e posaçëm që e rregullon, nuk është një fakt relevant për përcaktimin ose jo të përgjegjësisë penale të të gjykuarit në këtë çështje.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, në mënyrë që të gjykuarit G.J. t’i garantohej e drejta e mbrojtjes, vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastër duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, në mënyrë që të sqarohen momentet e mësipërme procedurale. Në rishqyrtim do të duhet të sqarohet natyra juridike e pronës ku ka ndërtuar subjekti subjektit “Rafting Vjosa Outdoors Sports”, cilat kanë qenë kompetencat e Kryetarit të Bashkisë në lidhje me këtë pronë dhe a janë tejkaluar këto kompetenca dhe nëse ky tejkalim përbën përgjegjësi penale apo mbetet vetëm në kuadrin e përgjegjësisë administrative. Gjithashtu duhet të sqarohet nëse veprimet e të gjykuarit në rastin konkret janë kryer me dashje dhe me qëllim të posaçëm përfitimi për vete ose për subjektin “Rafting Vjosa Outdoors Sports”, duke u vlerësuar ana subjektive në raport me veprimet dhe mosveprimet e anës objektive të të gjykuarit. Gjithashtu, duhet të hetohet nëse referuar kuadrin ligjor është e mundur ndërtimi në bregun e lumit Vjosë, në vendin ku ishte kryer ndërtimi nga subjekti “Rafting Vjosa Outdoors Sports”.

Sa më sipër, Kolegji vendos prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

KPGJL Vendim Nr.00-2023-35(10), datë 17.01.2023 (Shpërdorimi i detyrës: Dashja/vetëdija)

Në rastet e shpërdorimit të detyrës nga subjekte që ushtrojnë funksione për regjistrimin e pronës sipas ligjit, vetëdija e personit që ushtron funksione publike, që ka dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit/shtetasve, është element i rëndësishëm i verifikimit të kriterit të “dashjes”, që shënon dhe vijën ndarëse midis përgjegjësisë penale dhe asaj administrative.

Fjalë kyçe: subjekt i posaçëm, përfitim i padrejtë, regjistrim pasurie,

përgjegjësi administrative, përgjegjësia penale

Rrethanat e çështjes:

Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e faktit (*zhvilluar me ritin e gjykimit të shkurtuar*), ka rezultuar e provuar se, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, ka dërguar për gjykim para kësaj gjykatë procedimin penal nr. 1212, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurve A.M. dhe A.Zh., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të K.Penal. Ky procedim është regjistruar në lidhje me kallëzimin penal [...] prej shtetasit A.D.. Kallëzuesi ka parashtruar se ka shkuar me motrën e tij V., pranë ZRPP Berat për të regjistruar një pronë që, sipas tyre, e kanë përfutur me trashëgimi dhe kanë ardhur në dijeni se banesa e shtetasit R.D. – gjyshit të tyre, ishte regjistruar dhe tjetërsuar nga një shtetase tjetër. Ata kishin marrë dijeni se shtetasja R.L., duke pretenduar se ishte trashëgimtare e vetme e gjyshit të tyre kishte regjistruar pronën në emrin e vet dhe më pas ia kishte shitur shtetas D.K..

[...] Prokuroria i ka kërkuar informacion ZVRPP Berat, në lidhje me pasuritë e shtetasit R.D. dhe me shkresën nr. 3458/l prot., datë 31.12.2014, është dërguar gjithë praktika e regjistrimit. [...] për të bërë regjistrimin e pasurisë në emër të shtetasit R.D., duke paraqitur si origjinë të vjetër të pronës vendimin nr. 52, datë 05.02.1965, të Gjykatës Berat dhe dëshminë e trashëgimisë së shtetas B.D., sipas vendimit nr. 1335, datë 23.03.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në të cilin është vendosur: *“Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësen B.D., duke cilësuar si trashëgimtare të vetme ligjore të radhës së parë, në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të saj, kërkuesen R.L.”*. Gjithashtu, është paraqitur një Plan rilevimi për pasurinë truall+ndërtesë, me sipërfaqe 40,5 m², [...], në emër të shtetas R.L.. Duke qenë se sipërfaqja e kësaj pasurie të paluajtshme nuk ka qenë e përcaktuar, bazuar në nenin 25/b të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i është paraqitur regjistruesit një kërkesë për regjistrim pasurie datë 01.10.2013, si dhe ka paraqitur deklaratën noteriale të pronarëve kufitare datë 01.10.2013. Nga regjistruesi i ZVRPP, A.M., është marrë vendim më datë 09.10.2013, për miratimin e kërkesës dhe regjistrimin e pasurisë. Pasi është bërë regjistrimi i kësaj pasurie, shtetasja R.L. është pajisur me vërtetimin e pronësisë [...], me sipërfaqe 40,5 m² – truall + ndërtesë. Pasi është bërë vlerësimi i kësaj pasurie, me kontratën e shitjes nr. [...], është bërë shitja e kësaj pasurie të paluajtshme shtetas D.K.

[...] Sipas prokurorisë nga hetimi rezulton se nga veprimet e kryera nga punonjësit e ZVRPP Berat janë konstatuar veprime të kundërligjshme për regjistrimin e pasurisë së sipërpërmendur [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat, [...] ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit A.M., për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës - “kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 i K.Penal. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.Zh., për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248i K.Penal dhe dënimin e tij me 9 (nëntë) muaj burgim. [...]

Gjykata e Apelit, Vlorë, [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.Zh. dhe lënien në fuqi të për pjesën tjetër. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, vendimet e gjykatave dhe shkaqet e rekursit, konstaton se prokuroria nuk pajtohet me vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, të cilat përfundimisht kanë deklaruar të pafajshëm të gjykuarit A.M. dhe A.Zh.

[...] Në rastin konkret objekt shqyrtimi janë evidentuar në veprimet a mosveprimet e të gjykuarve një sërë shkeljesh të parashikimeve ligjore, specifikisht nenit 25, shkronja “b”, të ligjit nr. 33/2012 shkeljet – ometimet – e lejuara nga të gjykuarit, në mosmarrjen e deklaratave nga kufitarët, apo dhe të akteve të tjera nënligjore, lidhur me krijimin e grupit të punës, si dhe regjistrimin e trullit.

Megjithatë, që të kemi veprën penale të parashikuar në nenin 248 të K.Penal, nuk mjafton vetëm kryerja ose moskryerja e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, por është e nevojshme të përmbushen dhe kriteret e tjera të kërkuara nga kjo dispozitë.

Kushti i dytë i parashikuar nga neni 248 i KPP parashikon si subjekt të posaçëm personin që ushtron funksione publike. Përsa i përket këtij kushti, duke qenë se të gjykuarit janë punonjës të ZVRPP, janë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Sa i përket kushtit të tretë të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, i cili kërkon ardhjen e pasojës, pra, që këto veprime a mosveprime të paligjshme, t'i kenë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a të kenë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, Kolegji e çmon të gabuar arsyetimin e Gjykatës së Apelit, sipas të cilit në rastin konkret mungon pasoja. Arsyetimi i kësaj gjykate për mosardhjen e një pasoje, pasi *nuk rezulton që të jetë vërtetuar që shtetasja R.L. të ketë përfituar në mënyrë të paligjshme nga ky regjistrim fillestar, pasi nuk është vërtetuar që trashëgimlënësja e saj B.D. nuk e ka patur këtë pronë, me një vendim gjyqësor të formës së prerë*, është një përfundim i gabuar. Ndryshe nga Gjykata e Apelit – Kolegji konsideron se fakti që regjistrimi i pasurisë është bërë për njërin prej trashëgimtarëve, nuk përjashton apriori mundësinë që të jenë dëmtuar interesat e ligjshëm të trashëgimtarëve të tjerë të paregjistruar. Kalimi nga R.D. tek R.L., pa akt trashëgimie dhe në shkelje të dispozitave përkatëse që rregullojnë trashëgiminë, cenon si rregull të drejtat e bashkëtrashëgimtarëve të tjerë, të cilët kanë të drejtë të gëzojnë pronën dhe të kenë të drejta vendimmarrjeje mbi disponimin e saj.

Sakaq “veprimtaria” e kundërligjshme e subjekteve ndaj të cilëve – prej Prokurorit – është ushtruar ndjekja penale, në kushtet e verifikimit të saj presupozon, në të njëjtën kohë, edhe paragjykim (dëmtim) të interesave të ligjshme të shtetit përsa kohë që haptazi kompromenton – nëpërmjet veprimeve në kundërshtim me parashikimet ligjore – garancinë e mirëfunksionimit dhe të paanësisë së administratës publike – si shërbim

ekskluziv në favor të Kombit (popullit – sipas përcaktimit të nenit 107 të Kushtetutës).

Mbi këtë bazë, në funksion të verifikimit (konfigurimit) të elementit subjektiv të figurës së veprës penale – të shpërdorimit të detyrës – të parashikuar nga neni 248 i K.Penal – të kontestuar të pandehurve – dhe konkretisht të dashjes në veprimet e mosveprimet e paligjshme të personit të ushtron funksione publike që ka dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të shtetasve, Kolegji vlerëson se që të përmbushet ky kriter, duhet që funksionari publik të jetë i vetëdijshëm në kryerjen e një veprimi a mosveprimi të paligjshëm, i cili i sjell atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta, apo që kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë. Ky element shënon dhe vijën ndarëse midis përgjegjësive penale dhe asaj administrative. Kolegji konsideron në kushtet e inoportunitetit argumentet justifikuese të parashtruara prej Gjykatës së Apelit – vendimit të saj – të pamundësisë së verifikimit të anës subjektive (dashjes në rastin konkret) – në veprimet (ometuese) të të pandehurve – në cilësinë e elementit (njërit prej të cilëve) thelbësor në funksion të konfigurimit të veprës (faktit) penal të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Argumentimi i kësaj gjykatë se, të pandehurit nuk kanë qenë në dijeni të ekzistencës së pretendimeve të shtetasve të tjerë mbi këtë pronë, pasi ata nuk kanë paraqitur kërkesë për regjistrim fillestar apo ndonjë pretendim tjetër më parë në zyrën ku ata ushtronin funksionin, pra nuk kanë patur qëllim dëmtimin e interesave të tyre, nuk është i mjaftueshëm për t'i çliruar të gjykuarit nga përgjegjësia penale, duke arritur në përfundimin se ka munguar dashja në rastin konkret.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit, objekt shqyrtimi, është i cenueshëm dhe se duhet të priset nga Kolegji Penal. Referuar parashikimeve të nenit 437, “Shqyrtimi gjyqësor”, [...] Kolegji vlerëson se çështja nuk bën pjesë në rastet e parashikuar nga ky nen dhe për rrjedhojë, mund të zgjidhet në dhomë këshillimi nga Kolegji Penal. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se nuk ndodhemi në rastin e parashikuar nga pika 3 e nenit 434, të KPP, [...], pasi nuk janë vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, pasi janë shqyrtuar problematikat e ngritura në rekursin e paraqitur nga organi i akuzës. Në përputhje me parashikimet e shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 441, (*pas ndryshimeve të sjella me Ligjin nr. 41/2021*), [...] Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të priset. Në rishqyrtim, kjo gjykatë, duhet t'i përmbahet këtij arsyetimi të Kolegjit.

KPGJL Vendim Nr.00-2023-1169(202), datë 06.07.2023 (Mashtrimi: elementët të kualifikimit)

Vepra penale e mashtrimit, si një moment volutiv i mendimit kriminal, mund të lindë pa filluar, ose kur ka filluar apo pasi subjekti ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me viktimën. Momenti nuk është i rëndësishëm por dallimin e bën sjellja dhe qëllimi që ka pasur autori karshi viktimës, duke analizuar veprimet e tij, i cili mund të ketë pasur mundësi të përmbushë detyrimin, por me veprime me dashje e eviton këtë mundësi.

Fjalë kyçe: marrëdhënie kontraktuale, shitje me falsifikim, pamundësi shlyerje

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim çështjen penale me nr. 1417, viti 2014, [...], në ngarkim të të pandehurit E.S. për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143/1 i K.Penal.

[...] rezultoi se, në datë 18.06.2014, nga ana e shtetasit A.A., është kryer kallëzimi penal, në Drejtorinë e Policisë Durrës, në lidhje me automjetin në pronësi të tij, tip “Jaguar” [...] ku ka shpjeguar se një miku i tij, E.Gj. [...], i ka dalë garant në shitjen e automjetit pronë e tij, të pandehurit E.S.. Sipas tij, ata kanë rënë dakord rreth muajit shkurt 2013, që mjeti të shitej në shumën 12.000 euro, për këtë ja ka dhënë mjetin në përdorim për rreth një javë.

I pandehuri E.S., pasi e ka marrë mjetin, ka rënë dakord për blerjen e tij dhe për këtë i ka dërguar në mënyrë periodike rreth 6.300 euro, deri nga muaji korrik 2013 dhe më pas nuk ka dërguar pjesën tjetër.

Në muajin gusht 2013, A.A. ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më datën 17 qershor 2014, shtetasi A.A. ka mësuar se mjetin e tij e kishte një shtetas në Durrës dhe kishte një targë të re [...] dhe se ishte në pronësi të M.G., i cili, sipas hetimit, ka rezultuar se e ka blerë nga i pandehuri E.S., por në dorë pa dokumentacion.

Më pas ka rezultuar se M.G. ja ka shitur mjetin tip “Jaguar” shtetasit M.T. me kontratën e shitblerjes nr. [...], tek notere [...]. Më pas, ky shtetas e ka regjistruar me targën [...]. Nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se M.G. ka kryer blerjen e këtij mjeti nga A.A., me kontratën e shitblerjes nr. [...], tek notere Sh.Gj., e cila më pas ka dalë e falsifikuar dhe për këtë vepër penale është akuzuar dhe dënuar M.G.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, [...] ka vendosurdeklarimin fajtor të pandehurit E.S., për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimin” në bazë të nenit 143/1 të K.Penal. Të dënojë të pandehurin Elvis Spahiu me një vit burgim. [...]

Gjykata e Apelit Durrës, [...] ka vendosur prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e çështjes.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] Një ndër shkaqet kryesore për të cilat lejohet rekursi është zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural (*errores in iudicando/errores in procedimendo*), që ka një rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Qëllimi (*ratio*) i kësaj pjese të dispozitës është që të kushtëzojë proceduralisht ushtrimin e rekursit, vetëm për arsye të shkeljeve të ligjit material apo procedural penal që të mund të krijojë premisë për zhvillim të jurisprudencës dhe të drejtës gjyqësore në përgjithësi. [...] Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se nga Gjykata e Apelit Durrës është zbatuar jo në mënyrë të drejtë ligji procedural penal në lidhje me nenin 383 të KPP, për të gjykuar in E.S. Neni 383, pika 1, shkronja “ç”, parashikon [...]

Kolegji, në referim të rekursit të paraqitur nga prokurori, konstaton se Gjykata e Apelit Durrës nuk ka respektuar këtë dispozitë, e marrë kjo në analizë me përcaktimet e nenit 152 të KPP, duke mos vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra tjetrën, si dhe duke arritur në përcaktime të pabazuara në lidhje me anën

subjektive të të pandehurit për akuzën e ngritur ndaj tij. Për Kolegjin, rezulton se prej Gjykatës së Apelit ka një mungese arsytimi të provave të paraqitura nga prokuroria ose mos përmendjen e tyre duke mos u ndërthurur në analizë të pretendimeve të prokurorisë dhe duke mëshuar vetëm në pretendimet e të gjykuarit, pretendime këto të pa konfrontuara me provat e lejuara në gjykim në shkallë të parë. Në këtë këndvështrim, rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është i plotë në referim të nenit 383 të KPP, ku janë analizuar provat në mënyrë gjithëpërfshirëse, mënyra e rrjedhjes së ngjarjes duke arsyetuar drejtë në lidhje me ekzistencën e faktit penal në ngarkim të të gjykuarit. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit bën një deduksion të gabuar të provave për të arritur në pushimin e çështjes. Prej Kolegjit vlerësohet se vepra penale e mashtrimit, si një moment volutiv i mendimit kriminal, mund të lind pa filluar marrëdhënia kontraktuale me viktimën, siç mund të lind kur subjekti hynë në një marrëdhënie kontraktuale me viktimën apo ky mendim kriminal mund të lind edhe pasi ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me viktimën, e cila deri në këtë moment ishte një partner në veprimtarinë civile. Ajo që bën dallimin është sjellja e autorit karshi viktimës dhe qëllimit që ai ka pasur, ku këto konkluzione arrihen me anë të një analize të veprimeve që ka bërë autori, i cili ka pasur mundësi të përmbush detyrimin e tij, por me veprime me dashje eviton/mohon mundësinë e përmbushjes së detyrimit.

Sipas gjykatës së apelit autori nuk ka pasur qëllim mashtrimin pasi ai ka qenë në pamundësi për të shlyer shumën dhe sapo i është krijuar kjo mundësi e ka shlyer, siç edhe ka ndodhur. Si dhe fakti tjetër që ai e ka marrë në përdorim mjetin duke dhënë shuma monetare edhe pa bërë një kontratë formale duke treguar besueshmëri të tij për finalizimin e kontratës. Vlerësohet se e gjithë kjo logjikë e përdorur nga gjykata e apelit nuk qëndron për arsye se mendimi për mos të shlyer shumën mund të këtë lindur edhe gjatë kohës së cilës ai kishte marrë në posedim mjetin, kishte paguar një pjesë dhe nuk ka paguar diferencën. Nga aktet rezulton se i gjykuari E.S. i'a ka shitur me një kontratë noteriale të falsifikuar në datë 14.06.2013 mjetin shtetasit M.G., i cili ka paguar shumën 6000 euro për blerjen e mjetit. Pra rezulton se në datë 14.06.2013 i gjykuari Spahiu, ka pasur në posedim shumën prej 6000 euro dhe nuk ka paguar diferencën prej 3000 euro edhe pse ka pasur mundësi. Për Kolegjin, ky është momenti që bën diferencimin midis ekzistencës së veprës penale të mashtrimit apo të marrëdhënies juridiko civile, e cila për pamundësi objekti nuk mund të përmbushet me pasojë pushimin e çështjes.

Pikërisht ky është momenti që arrin të materializohet mendimi kriminal i mashtrimit për të mos dhënë shumën dhe as për të kthyer mjetin për të cilin ka paguar një pjesë të shumës, dhe i pandehuri nuk ka pasur për qëllim dhënien e parave. Shitja me anë të falsifikimit të mjetit tregon qartë që i pandehuri e ka evituar takimin me kallëzuesin edhe pse nga shitja e mjetit u përfituan shuma të mjaftueshme për të shlyer diferencën e mbetur pa likuiduar prej tij. Prandaj, në tërësi rezulton se vepra penale është e konsumuar me pasojë gjendjen të drejtë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës e cila e ka deklaruar fajtor të gjykuarin E.S.

Prandaj, për sa më lart arsytetoi, Kolegji konkludon se rekursi i paraqitur nga prokuroria, kundër vendimit me [...], të Gjykatës së Apelit Durrës duhet të pranohet

me pasojë prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr.00-2022-634(149), datë 31.05.2022

KPGJL Vendim Nr.00-2023-406(76), datë 21.03.2023 (Falsifikim dokumentesh: aplikim gjyqtar KPA)

Kur në veprimet/mosveprimet e paligjshme të të gjykuarit përmbushet elementi i anës objektive dhe subjektive (fajit në formën e dashjes), për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të pavërteta për masën disiplinore të largimit nga puna në kuadër të një aplikimi, e duke sjellë si pasojë një përfitim të padrejtë (plotësimi i kriterëve në aplikimin për gjyqtar në KPA), atëherë përmbushen kushtet për mbajtjen e përgjegjësisë penale të autorit

Fjalë kyçe: falsifikim intelektual, falsifikim material, aplikim për gjyqtar, falsitet i padobishëm/padëmshëm

Rrethanat e çështjes:

Gjatë gjykimit të çështjes ka rezultuar se, Prokuroria e Posaçme, më datë 07.02.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. 56, të vitit 2020, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i K.Penal, në ngarkim të personit nën hetim L.D. Ka rezultuar se, me vendimin [...] të Kuvendit shtetasi L.D. është zgjedhur gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, një nga institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar [...] Zgjedhja e tij në përbërje të këtij institucioni kushtetues ka ardhur si pasojë e një procesi të administruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Kuvendit.

Më datën 03.02.2017 shtetasi L.D. ka paraqitur kërkesë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me objekt “Për aplikimin, emërimin e kërkuesit në vendet vakante të shpallura në bazë të ligjit nr. 84/2016” dhe ka aplikuar për t’u emëruar në vendin vakant [...]Kjo kërkesë për aplikim, është paraqitur në dy kopje; një kopje në gjuhën shqipe dhe një kopje në gjuhën angleze, të nënshkuara prej tij. [...] ndër të tjera, ka deklaruar se:....kam ushtruar profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë, i regjistruar në këtë dhomë në datën 27.03.2000, jam vlerësuar për aftësitë e mia profesionale dhe me rekomandime të profesorëve të këtij fakulteti për jetën akademike, ndaj meje nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit.

Në dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës për aplikim, aplikuesi ka paraqitur edhe një CV (jetëshkrim) në të cilin, [...] nuk ka përkrahur faktin se ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në seancën dëgjimore të datës 02.06.2017, të zhvilluar nga Komisioni *ad hoc* i Kuvendit [...] pyetjes nëse ka punuar para vitit 2000 i është përgjigjur se ka punuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Tiranë. Pyetjes së Komisionit se sa vjet ka punuar si gjyqtar dhe pse është larguar nga funksioni, shtetasi L.D. i është përgjigjur në këtë mënyrë: *.....Kam filluar në shtator të vitit 1993, fillimisht si ndihmës gjyqtar, kur kemi dhënë diplomën para komisionit shtetëror, dy ditë pas dhënies së diplomës, jam emëruar gjyqtar në Gjykatën e Tiranës, madje jam emëruar edhe nënkryetar në Gjykatën e Tiranës, deri në 24 dhjetor të vitit 1997 unë kam qenë gjyqtar në Gjykatën e Tiranës. Pyetjes tjetër nga anëtari i komisionit nëse në vitin 1997 është larguar, ka ikur apo e kanë hequr shtetasi L.D. i është përgjigjur se: *...Unë kam ikur me dorëheqje, sepse nuk na lejuan të regjistroheshim.....**

Ndërkohë, nga një kallëzim i paraqitur në Prokurorinë e Posaçme dhe materialet bashkëngjitur atij, ka rezultuar [...] KLD me vendimin nr. 06, datë 24.12.1997, pas propozimit të Ministrit të Drejtësisë, në nenin 1, ka vendosur: *.....Z. L.D., largohet nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjës dhe paaftësi në detyrë.....*Sipas përmbajtjes së procesverbalit të mbledhjes të datës 24.12.1997 ka rezultuar se shtetasi L.D. ka qenë i pranishëm personalisht në këtë mbledhje dhe ka parashtruar qëndrimin dhe shpjegimet e tij ndaj kërkesës së Ministrit [...]. Gjithashtu, shtetasi L.D. ka paraqitur në vitin 2016 kërkesë në KLD për emërimin në detyrën e gjyqtarit, kërkesë që është marrë në shqyrtim në mbledhjen e datës 15.11.2016, por ai është skualifikuar me arsyetimin se është larguar nga detyra me vendimin nr. 07, datë 24.12.1997, të KLD-së. [...]

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, [...]ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit L.D., për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 paragrafi 1, i K.Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. [...]

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit** [...] të GJKKO.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, [...] ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi L.D. [...].

Kolegji [...], ndërmjet të tjera ka arsyetuar se:.....Asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk i referohet shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i KPP. [...] Kolegji konstaton se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuar në të dyja shkallët e gjykimit për të njëjtat shkaqe që ai i ka ngritur në rekurs pranë Gjykatës së Lartë. [...]

Kërkuesi L.D. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë me ankim kushtetues individual, që me vendimin nr. 21, datë 26.09.2022, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit [...]të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë. Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar ndër të tjera se: *[...]gjyqtari I.P. ka qenë pjesë e trupit gjykues në dy kolegje penale të Gjykatës së Lartë. Në njërin kolegji, në datën 18.9.2020 ka vlerësuar shkaqet e rekursit të ushtruar nga Prokuroria e Posaçme dhe aktet e masës ndaluese duke vendosur kalimin për shqyrtim të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në kolegjin tjetër, në datën 26.10.2021, ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi dhe ka vlerësuar shkaqet e rekursit të ushtruar nga kërkuesi, duke analizuar të njëjtat rrethana dhe të njëjtin fakt, të cilësuar si penal, duke vendosur mbi fajësinë e kërkuesit. Gjykata*

vlerëson se në çështjen konkrete, për shkak të natyrës së veçantë të saj, kompleksitetit, pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në dy vendime të dhëna nga kolegjet penale të Gjykatës së Lartë, duke vlerësuar aktet për të njëjtat rrethana dhe duke e dokumentuar këtë vlerësim, krijon dyshime në respektimin e kriterit objektiv të parimit të paanshmërisë. [...]Gjykata çmon se pretendimi për cënimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë është i bazuar[...]

Gjithashtu, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, duke mos dhënë arsyet për mosshqyrtimin e saj në seancë gjyqësore dhe nuk ka argumentuar për pretendimin thelbësor të kërkesit, që lidhet me funksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit, ajo shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore”.....

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]Në rastin objekt shqyrtimi rezulton se, çështja rikthehet për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, me vendimin nr. 21, datë 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese [...] Në plotësim të këtij detyrimi të caktuar, pra, lidhur me procedurën e shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, Kolegji çmon se ky rishqyrtim i çështjes në Gjykatën e Lartë mund të vijojë në Dhomë Këshillimi dhe kjo pa paragjykuar zgjidhjen e çështjes. KPP, me ligjin nr. 41/2021 [...] ka pësuar disa ndryshime lidhur me mënyrën e shqyrtimit nga Kolegji Penal të rekurseve të paraqitur para kësaj gjykate. Në nenin 38 të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se[...] Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij. Sa i përket çështjes objekt shqyrtimi rezulon se shqyrtimi i mëparshëm i çështjes është zhvilluar gjithësesi në dhomë këshillimi dhe në fund të këtij shqyrtimi është vendosur mospranimi i rekursit. Kjo mënyrë e shqyrtimit të çështjes ka qenë në përputhje me pikën 2, të nenit 432 të KPP, [...] Për më tepër, aktualisht, referuar parashikimeve të nenit 437 të KPP, “Shqyrtimi gjyqësor”, i cili, në vijim të ndryshimeve të sjella me Ligjin nr. 41/2021, në pikën 1 të tij, parashikon se[...]Kolegji vlerëson se çështja nuk bën pjesë në rastet e parashikuar nga ky nen dhe për rrjedhojë, mund të zgjidhet në dhomë këshillimi nga Kolegji Penal.

Gjithashtu, Kolegji vlerëson se nuk jemi në rastin e parashikuar nga pika 3 e nenit 434, të KPP, sipas të cilit[...]Për rrjedhojë, Kolegji çmon se çështja mund të zgjidhet në dhomë këshillimi nga Kolegji Penal i ngarkuar me rigjykimin e çështjes.

Në lidhje me formimin e trupit gjykues:

Lidhur me trupin gjykues të çështjes në Gjykatën e Lartë, [...] Në vijim të këtij arsyetimi të Gjykatës Kushtetuese, i cili, sikundër është arsyetuar më lart, në bazë të parashikimeve të pikës 1, të nenit 132, të Kushtetutës, sipas të cilave vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim, në Gjykatën e Lartë u formua Kolegji që do të rishqyrtojë këtë çështje, duke u përjashtuar nga ky gjykim edhe

gjyqtarë, të cilët kishin disponuar kalimin në seancë gjyqësore dhe më pas kanë gjykuar në Gjykatën e Lartë vleftësimin e masës ndaluese.

Lidhur me themelin e pretendimeve të paraqitura në rekurs:

Përsa i përket themelit të pretendimeve të paraqitura në rekurs, Kolegji konstaton se në gjykimet e mëparshme, si nga gjykatat e faktit, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë janë marrë në shqyrtim pretendimet e rekursuesit, duke iu dhënë dhe një përgjigje e argumentuar. Konkretisht, për pretendimet e ngritura në rekurs, lidhur me masën ndaluese, të dhënë ndaj kërkuesit, Kolegji çmon se me të drejtë është vlerësuar në gjykimin e mëparshëm në Gjykatën e Lartë se ajo nuk përbën çështje objekt të këtij gjykimi, por të një gjykimi tjetër me objekt caktimin e masës ndaluese ndaj shtetasit L.D.. Aktualisht rezulton se vendimmarrja lidhur me vlerësimin e masës ndaluese është konkluduar në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 00-2022-116 (55), datë 18.02.2022.

Sa i përket pretendimeve të tjera të paraqitura, në rekurs, këto kanë të bëjnë në thelb me pretendimin se në rastin konkret nga rekursuesi L.D., nuk janë konsumuar elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga paragrafi 1, i nenit 186 të K.Penl.

[...]Në përmbushje të këtij vlerësimi, pra nëse në veprimet/mosveprimet e rekursuesit L.D., të cilat përbëjnë objekt të këtij shqyrtimi gjyqësor, përmbahen elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga nenin 186 paragrafi 1 i K.Penal, për të cilën është akuzuar, fillimisht Kolegji vlerëson të evidentojë përmbajtjen e nenit 186 paragrafi 1 i K.Penal. [...]Pra, nga teksti i dispozitës, që të kemi këtë vepër penale duhet të kemi një dokument. Duhet që ky dokument të jetë i falsifikuar dhe që ky falsifikim të jetë bërë me dashje, si forma e fajit e kërkuar për këtë vepër penale, nga një subjekt i ligjit penal. Le t'i analizojmë këto elemente të kërkuar nga dispozita ligjore e ligjit material penal. Pjesë e rëndësishme e kësaj vendimmarrjeje ka qenë vlerësimi nëse fakti i shkarkimit nga detyra të rekursuesit kur ai ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mund të konsiderohet si kriter përcaktues në zgjedhjen e anëtarit të institucioneve të rivlerësimit. Referuar legjislationit shqiptar, rezulton se kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit parashikohen në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016, [...] Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se, masa disiplinore “shkarkim nga detyra” dhënë ndaj subjektit L.D., ndryshe nga sa pretendon i gjykuari, nuk është shuar. Gjykatat e shkallëve më të ulëta, sikundër Kolegji që e ka gjykuar më parë çështjen në Gjykatën e Lartë, kanë argumentuar në mënyrë shteruese këtë aspekt. Me të drejtë në vendimet e mëparshme është arsyetuar se, periudha kohore brenda të cilës masa disiplinore duhet të jetë në fuqi, në asnjë rast nuk lidhet me masën disiplinore të largimit apo shkarkimit nga detyra, por lidhet me masat e tjera disiplinore të parashikuara nga ligji. Ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, kanë theksuar pikërisht këtë përfundim, ku më konkretisht në ligjin nr. 96/2016, [...] në nenin 150, pika 3 të tij, parashikohet shprehimisht që:.... “masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri”.

Nga ana tjetër, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, në nenin 33, të ligjit nr. 9877,

datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” parashikohet shuarja brenda 3 viteve e masave disiplinore të rënda, ndërsa për masat disiplinore shumë të rënda siç është ajo e shkarkimit nga detyra nuk parashikohet shuarja. Gjithashtu, nuk rezulton që të ketë një vendim gjykate të formës së prerë, në vijim të të cilit masa disiplinore të jetë shfuqizuar, apo të jetë deklaruar e pavlefshme.

Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për shuarjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra si gjyqtar”, i dhënë nga ish KLD më datë 24.12.1997 është i pambështetur në ligj. Pra, sikundër rezulton nga përmbajtja e nenit 6, të ligjit nr. 84/2016, ekzistenca e një mase të mëparshme disiplinore, të largimit nga detyra, pavarësisht kohës se kur është vendosur kjo masë disiplinore, është një kriter ndalues për t’u emëruar në pozicionet për të cilët ka aplikuar i gjykuari L.D., sepse ai nuk e plotësonte këtë kriter të ligjit.

[...] Sikundër rezulton, i gjykuari L.D. ka deklaruar se ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit. Është evidente se i gjykuari nuk ka deklaruar faktin e marrjes së masës disiplinore të largimit nga detyra si gjyqtar, me vendimin [...] të ish KLD, fakt, ekzistenca e të cilit, sikundër u arrit në përfundimin e mësipërm, e përjashtonte të gjykuarin për t’u emëruar në pozicionet për të cilët ka aplikuar. Por, a mund të konsiderohet ky mosveprim si falsifikim? Për këtë duhet më parë të arsyetojmë nëse kërkesa e lartpërmendur mund të cilësohet si dokument, duke qenë se legjislatori, në nenin 186 paragrafi 3 të K.Penal, kërkon ekzistencën e një dokumenti. Sikundër ka evidentuar gjykata e shkallës së parë, kërkesa apo vetëdeklarimi për masën disiplinore nuk ka pasur ndonjë formë të veçantë, por mund të hartohet nga vetë aplikuesi, duke përbërë një akt deklarativ të vetë personit kandidat për funksionin publik. Akti “Kërkesë” i datës 03.02.2017 i depozituar nga shtetasi L.D., duke qenë një akt formal që kërkohet domosdoshmërisht nga ligji, konkretisht neni 7, i ligjit nr. 84/2016, për fillimin e procedurës, i cili është në gjendje që të sjellë efektet juridike dhe që ka shërbyer për fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së shtetasit L.D. si gjyqtar, i plotëson të gjithë elementët e domosdoshëm të “dokumentit”, si objekt material i veprës penale të parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i K.Penal. Kërkesa e datës 03.02.2017 konsiderohet “dokument”, pasi në thelb ajo është një shkresë, e cila ka shërbyer për të dëshmuar dhe vërtetuar diçka, ajo përbën një akt të shkruar ku janë pasqyruar kriteret që plotëson kandidati, referuar parashikimeve ligjore të bëra në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016.

Kjo kërkesë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, pavarësisht se është një shkresë e plotësuar nga vetë shtetasi L.D. [...] ka qenë një akt i domosdoshëm dhe i kërkuar nga ligji për fillimin e procedurës së kandidimit dhe përzgjedhjes në institucionet e rivlerësimit, i parashikuar në nenin 7, paragrafët (1), (2), (3) dhe (4), të ligjit nr. 84/2016. Në paragrafin 3, të kësaj dispozite legjislatori ka sanksionuar rëndësinë e këtij akti (kërkesë), të përpiluar nga vetë aplikanti, paraqitja e të cilit regjistrohet, me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurës, duke marrë në këtë mënyrë kërkesa vlerë ligjore, në gjendje të prodhojë efekte dhe jo thjesht një akt privat, i cili nuk depozitohet askund. [...] Si akt i tillë ai (kërkesa për aplikim) ka sjellë pasojën e dëshiruar atë të dhënies udhë të

procesit të përzgjedhjes në pozicionet e synuara.

Kolegji sjell në vëmendje se kjo procedurë është e natyrës kushtetuese, duke hyrë në sferën e të drejtës publike, pasi në përfundim të saj, sipas Kushtetutës dhe ligjit 84/2016 emërohen persona që ushtrojnë funksione të rëndësishme kushtetuese në procesin e kalimtar të rivlerësimit të magistratëve dhe këshilltarëve ligjorë. Shtetasi L.D. ka paraqitur kërkesë për të qenë anëtar i KPA që është e ndërtuar në strukturën e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 si dhomë e posaçme në Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, në mënyrë të logjikshme, kuptohet se paraqesin kërkesa, zgjidhen dhe emërohen persona, që prezumohen se kanë aftësi objektive të një niveli të caktuar profesional, për të kuptuar rëndësinë e procesit kushtetues mbi kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët përkatës dhe mbi kriteret penguese për të qenë anëtar i KPA, të cilat janë të parashikuara në mënyrë të shprehur në ligj. Kolegji vëren se, është parashikuar se procedura për të qenë anëtar i KPA nis mbi bazën e një kërkesë të personit të interesuar, që në rastin në gjykim, ka qenë shtetasi L.D. [...]Më tej në dispozitën ligjore të nenit 62 dhe nenit 64 të këtij Kodi përcaktohet mundësia ligjore që pasaktësitë në kërkesën e palës së interesuar për fillimin e procedurës administrative të korrigjohen si dhe e *“e drejta e plotësimi, ndryshimi dhe e tërheqjes së kërkesës”*, që në rastin konkret asnjë prej këtyre mejteve ligjore nuk rezulton të jetë ushtruar prej shtetasit L.D.

Në këtë mënyrë, akti *“Kërkesë”* i datës 03.02.2017, i depozituar nga shtetasi L.D., duke qenë një akt formal që kërkohet domosdoshmërisht nga ligji për fillimin e procedurës, i cili është në gjendje që të sjellë efektet juridike dhe që ka shërbyer për fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së shtetasit si gjyqtar, i plotëson të gjithë elementët e domosdoshëm të *“dokumentit”*, si objekt material i veprës penale, të parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i K.Penal. Shtetasi L.D. nuk kishte një detyrim që të paraqiste kërkesë për aplikim për t’u përzgjedhur si anëtar i komisioneve të rivlerësimit, por në momentin që ka ndërmarrë këtë nismë, duke shprehur vullnetin për të aplikuar për këto pozicione, ka pasur detyrimin të përpilonte dhe të depozitonte një kërkesë, e cila merr vlerë ligjore, pra e aftë të krijojë, ndryshojë apo shuaj një marrëdhënie juridike, në momentin që depozitohet vullnetarisht prej tij në protokollin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Rezulton se i gjykuari L.D. në këtë kërkesë ka pasqyruar të dhëna mbi plotësimin prej tij të kriterëve ligjore për vendet për të cilat aplikonte. Ndër këto të dhëna, përmbahet e dhëna se ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit. Sikundër u konkludua më sipër në këtë arsyetim, i gjykuari e ka marrë këtë masë ekstreme, të largimit nga detyra dhe ai (i gjykuari) ka qenë në dijeni të kësaj mase, e cila është bërë shkak për skualifikimin e tij lidhur me aplikimin e bërë në vitin 2016 pranë ish KLD, për t’u emëruar gjyqtar. I gjykuari ka pretenduar se interpretimi i përmbajtjes së shkronjës *“dh”*, të pikës 1, të nenit 6, të ligjit, është një interpretim jo i lehtë për të arritur në përfundimin se masa e largimit nga puna është një masë që nuk parashkruhet, duke qenë se edhe vetë përmbajtja e kësaj dispozite, sipas të gjykuarit, të çon drejt përfundimit se parashkrimi i nënshtrohen dhe masat disiplinore të largimit nga puna. Edhe sikur të

marrim të mirëqenë këtë pretendim (të hedhur poshtë në arsyetimin e mësipërm), i cili përkthehet në një gabim në të drejtë nga ana e të gjykuarit, kjo nuk e zhbën faktin se në kërkesën e tij përmbahen të dhëna të pavërteta, duke qenë se i gjykuari nuk ka evidentuar faktin se ai ka marrë një masë disiplinore “largim nga puna” për të cilën më pas, sipas interpretimit të tij të ligjit, kjo masë të rezultojë se është parashkruar. Evidentimi në kërkesën për aplikim se i gjykuari nuk ka marrë masë disiplinore të largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit, përbën paraqitjen e një rrethane të pavërtetë.

A e ngarkon kjo rrethanë me përgjegjësi penale të gjykuarin Daci? Përpara se t'i japë përgjigje në mënyrë të drejtpërdrejtë kësaj pyetjeje, Kolegji çmon t'i japë përgjigje më parë pyetjes nëse përbën falsifikim përmbajtja në një dokument të të dhënave të rreme, apo të pavërteta, apo jemi në rastin kur një formë e tillë e falsifikimit nuk parashikohet në ligj dhe për të cilin më tej dënimi nga gjykatat i të gjykuarit L.D., është bërë pa ligj? Në lidhje me nocionin e “falsifikimit” në K.Penal nuk jepet përkufizim. Këtë përkufizim e gjejmë në fjalorin e gjuhës shqipe. Në këtë fjalor rezulton se “falsifikoj” do të thotë: ***“Paraqit si të vërtetë diçka të gënjeshtërt; shtrembëroj të vërtetën, ndërroj a ndryshoj diçka për të mashtruar të tjerët. Falsifiko i moshën. Falsifiko i dëshminë”***. Në fjalorin e gjuhës shqipe rezulton qartë se falsifikim nuk është vetëm falsifikimi i nënshkrimit. Pra, falsifikimi nuk ekziston vetëm në falsifikimin e nënshkrimit të një dokumenti, por dhe paraqitjen e fakteve të pavërteta, shtrembërimi i fakteve me qëllim mashtrimin e të tjerëve. Në jurisprudencë, ky lloj falsifikimi, pra i përmbajtjes së dokumentit njihet edhe si falsifikimi intelektual. Pavarësisht termit që i është vendosur dhe që e ka çuar rekursuesin të mendojë se është krijuar një figurë e re veprë penale dhe se ai është dënuar për rrjedhojë pa ligj, apo si rezultat i një interpretimi të zgjeruar të normës penale, interpretim ky i cili sigurisht që nuk duhet të gjejë zbatim në të drejtën penale, rezulton se i ashtuquajtur i falsifikim intelektual, nuk është gjë tjetër veçse ajo formë e falsifikimit, e cila konsiston në paraqitjen në dokument të të dhënave të pavërteta ose të rreme, formë kjo e parashikuar në fjalorin e gjuhës shqipe, për të përshkruar rrethanat në të cilat verifikohet veprimi i falsifikimit.

Për të ilustruar shembuj të praktikës gjyqësore, nga Kolegji i Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar më herët çështjen është evidentuar qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2017-581 (111), datë 12.07.2017, në të cilin është arsyetuar se[...] Rrjedhimisht, pretendimi i të gjykuarit se nuk ekziston kjo formë falsifikimi dhe se ai është dënuar pa ligj, nuk qëndron.

Vepra penale e falsifikimit të dokumenteve është parashikuar në ligjin penal shqiptar dhe format e kryerjes së saj shpjegohen nga fjalori i gjuhës shqipe, si dhe janë elaboruar në jurisprudencën e gjykatave shqiptare. Megjithatë, Kolegji çmon këtu të bëjë një elaborim të këtyre koncepteve, të cilat, theksohet se nuk janë koncepte të reja dhe aq më pak të përbëjnë një interpretim të zgjeruar të dispozitës. Falsifikimi manifestohet në dy forma, në falsifikimin “material” dhe në falsifikimin “intelektual” (ideologjik). Falsifikimi material konkretizohet me veprime të cilat ndryshojnë një realitet dokumentar. Ai manifestohet si në formën e bërjes së një dokumenti nga një person

i ndryshëm nga ai i cili rezulton si i tillë në dukje, apo që ka kompetencën për ta bërë këtë dokument, ashtu edhe në formën e bërjes së ndryshimeve (nëpërmjet shtesave, fshirjeve, etj) të një dokumenti ekzistues. Kuptohet që ky dallim nuk ka asnjë lloj efekti lidhur me përgjegjësinë penale, pasi këto veprime janë të ndëshkueshëm në çdo formë.

Falsifikimi intelektual (apo ideologjik) lidhet me përmbajtjen dhe jo me formën e dokumentit dhe konsiston në përpilimin e dokumentit nga ai që është autor i tij, por përmbajtja e të cilit nuk i korrespondon së vërtetës, duke përmbajtur të dhëna të rreme. E thënë ndryshe, falsifikimi material ka të bëjë me formën e dokumentit, ndërsa falsifikimi intelektual ka të bëjë me përmbajtjen e tij. Falsifikimi intelektual manifestohet vetëm në rastin kur nuk ka mospërputhje midis autorit të vërtetë të dokumentit dhe atij që rezulton në dukje. Po ashtu kur dokumenti nuk ka pësuar ndryshime të paautorizuar nga persona të tjerë. Në të kundërt jemi në rastin e falsifikimit material.

Këto dy forma nuk konkurojnë me njëra-tjetrën, pasi aty ku ka falsitet material të një dokumenti të ndryshuar, nuk ka më rëndësi nëse fakti përbën dhe falsifikim intelektual. Pra, paraqitja e rrethanave të rreme në një dokument nga autori i këtij dokumenti përbën një rreth prej formave të anës objektive me të cilat manifestohet krimi “Falsifikimi i dokumentit”, i parashikuar në nenin 186 të K.Penal. Megjithatë, është e rëndësishme që të bëhet një dallim midis falsifikimit të dokumentit të përpiluar nga një privat (për lehtësi këtu e në vijim: dokument privat) dhe atij të përpiluar nga personi që ka për detyrë që të lëshojë dokumentin. Sigurisht që i gjykuari në momentin që ka përpiluar kërkesën nuk ka qenë një funksionar publik, apo privat, por një shtetas, i cili ka përpiluar një dokument privat, paraqitja e të cilit pranë instancave të parashikuara në ligj, i jep udhë fillimit të një procedure seleksionuese. Pra, së pari këtu bie hipoteza se, në rastin konkret (nëse do të vërtetohet dhe ekzistenca e anës subjektive) jemi në rastin e parashikuar nga paragrafi 3, i nenit 186, të K.Penal, i cili parashikon rastin e falsifikimit nga personi që ka për detyrë të përpilojë dokumentin. Një shtetas nuk ka detyrim, por vullnet për të përpiluar një dokument/akt privat. Thënë kjo, një karakteristikë tjetër e falsifikimit të një akti/dokumenti privat ka të bëjë me shkaktimin e pasojës. Megjithëse dispozita e përmbajtur në nenin 186 të Kodit Penal është shumë e gjerë dhe nuk bën asnjë lloj diferencimi, Kolegji çmon të bëjë një interpretim më restriktiv lidhur me zbatimin e saj lidhur me dokumentin/aktin privat. Kështu, në rastin e dokumentit privat falsifikimi do të quhet i perfeksionuar kur nga ky falsifikim hartuesi i dokumentit ka pasur përfitim (jo detyrimisht ekonomik) të padrejtë, apo u ka shkaktuar dëme personave të tretë, pra, jo thjesht nga evidentimi i përmbajtjes së rreme pa pasoja, por duke u kërkuar në këtë mënyrë ardhja e një pasoje, e cila në këtë rast, pra të një dokumenti privat identifikohet në pasjen e një përfitimi të paligjshëm nga ana e falsifikuesit të dokumentit, apo me dëm shkaktuar të tretëve.

Ardhja e pasojës është e rëndësishme dhe shënon një vijë ndarëse, mungesa e së cilës, nuk të çon në sferën e aplikimit të nenit 183, paragrafi 1, të K.Penal dhe për rrjedhojë të përgjegjësisë penale, në rastin e falsifikimit të një dokumenti privat. Falsiteti i padobishëm, pra kur nuk ka shkaktuar asnjë pasojë, apo kur pasoja është e papërfillshme, nuk justifikon ngarkimin me përgjegjësi penale dhe për rrjedhojë ndëshkueshmërinë e

subjektit që ka shtrembëruar të vërtetën në dokumentin/aktin privat. E njëjta mungesë përgjegjësie do të verifikohet edhe në rastin e falsitetit të padëmshëm, në rastet kur ky falsitet nuk është në gjendje të shkaktojë asnjë pasojë juridike, apo është aq i dukshëm sa haptazi nuk mund të mashtrojë (termi i përdorur në fjalorin e gjuhës shqipe) askënd, apo kur është bërë në një akt, apo pjesë të tij që nuk ka vlerë provuese, apo për të dhëna të cilat nuk ndikojnë në vlerësimin përfundimtar në raport me qëllimin e paraqitjes së dokumentit të falsifikuar. Gjithashtu, falsiteti (qoftë intelektual, qoftë material) është i padobishëm edhe kur sjell një ndryshim të papërfillshëm në interpretimin e aktit, pa i ndryshuar kuptimin, pra që nuk arrin ta çënojë objektin e mbrojtur, pasi nuk është në gjendje të sjellë pasoja juridike. Falsiteti i padobishëm ravijëzohet edhe në rastin kur mungon objekti tipik që i nënshtrohet falsifikimit, pra, kur bëhet mbi një akt i cili nuk ka asnjë vlerë provuese.

Po t'i kthehemi rastit konkret objekt shqyrtimi, të dhënat e pavërteta të përmblajtura në kërkesën e paraqitur nga i gjykuari, i kanë krijuar këtij të fundit një përfitim, të cilin, ai nuk do ta kishte pasur në rast se do të kishte paraqitur faktin se ai ka qenë larguar nga puna me masën disiplinore “largim nga puna”. Sikundër është arsytuar në gjykimet e mëparshme, si dhe në arsyetimin e mësipërm, ekzistenca e kësaj mase disiplinore është kusht, i cili nuk lejon kandidimin e mëtejshëm të kandidatit. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se nuk do të kishim falsifikim nëse i gjykuari do të evidentonte faktin që ka qenë i larguar më parë nga puna me masë disiplinore, por kjo masë sipas interpretimit të tij është parashkruar. Në këtë rast do të kishim të bënim me interpretim të gabuar të ligjit, por jo me falsifikim, pasi fakti nuk do të rezultonte i shtrembëruar. Njëkohësisht, në CV-në e paraqitur shtetasi L.D., nuk ka përshkruar faktin se ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjithashtu, nuk jemi në rastin e falsifikimit “të padobishëm”, apo “të padëmshëm”, pasi nuk mund të konkludohet se këto të dhëna nuk kanë qenë në gjendje të mashtrojnë institucionet lidhur me faktin e synuar prej aplikuesit dhe procedurën përkatëse për të cilën këto të dhëna janë paraqitur, pasi, duke qenë se sipas rrethanave të çështjes në CV-në e paraqitur shtetasi Luan Daci, nuk ka përshkruar faktin se ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ka pasur asnjë mundësi që institucionet verifikuese që përpilonin listat e kandidatëve që plotësonin kriteret, referuar mënyrës se si zhvillohet procesi i verifikimit, të verifikonin mënyrën se si aplikanti është larguar nga puna, kur nuk kanë pasur informacion për ekzistencën e këtij vendi pune. Evidentimi i të dhënave të rreme në kërkesë mbi mospasjen e një mase disiplinore “largim nga puna”, edhe pse e shoqëruar me përcaktimin “në fuqi”, si dhe mungesa e përshkrimit në CV (dokument ky i detyrueshëm për t'u paraqitur) të pozicionit të punës nga ku aplikuesi ishte larguar me këtë masë disiplinore, kanë qenë në gjendje të mashtrojnë institucionet publike lidhur pikërisht me qëllimin e procedurës që zhvillohej, e cila konsistonte në verifikimin e plotësisht nga aplikuesi të kriterëve ligjore, duke perfeksionuar në këtë mënyrë të gjithë elementet e kërkuar nga dispozita për konsumimin e anës objektive të veprës penale në shqyrtim, përfshirë ardhjen e pasojës, të kërkuar në rastin e falsifikimit të dokumentit privat.

Për rrjedhojë, Kolegji arrin në përfundimin se plotësohet elementi objektiv i kërkuar nga vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga paragrafi 1, i nenit 183 të K.Penal, falsifikim ky, i cili nuk mund të konsiderohet si “i padobishëm”, apo “i padëmshëm”. Gjithashtu, këto veprime e mosveprime të aplikuesit kanë qenë të mjaftueshme dhe përcaktuese në pasjen e një përfitimi të padrejtë, atë për t’u kualifikuar në fazën vijuese të kandidimit, ndërkohë që nuk plotësonte një kriter që e përjashtonte atë nga ky kualifikim dhe më tej nga përfitimi i pozicionit të punës si anëtar i institucioneve të rivlerësimit. Megjithatë, që të kemi një vepër penale e për rrjedhojë përgjegjesi penale, në bazë të parimit të hershëm të së drejtës nullum poena sine culpa, duhet të ekzistojë dhe faji i subjektit agresor, pra që dhunon ligjin penal e që duhet të ndalet në veprimin e tij të kundërligjshëm. Në krimin specifik objekt shqyrtimi, të parashikuar në nenin 183, paragrafi 1, të K.Penal, faji duhet të ekzistojë në formën e dashjes në falsifikimin e dokumentit apo përdorimin e një dokumenti të falsifikuar, duke përjashtuar në këtë mënyrë që ky krim të kryhet nga pakujdesia, e cila mund të sjellë përgjegjësi administrative, por jo përgjegjësi penale. Pra, çështja e radhës, ku përqëndrohet arsyetimi në këtë rast është ajo nëse në veprimet/mosveprimet e kundërligjshme të kryera nga i gjykuari ka ekzistuar dhe ana subjektive në formën e dashjes. Rezulton se ky aspekt është trajtuar nga gjykata në gjykimet e mëparshme, të cilat kanë konkluduar në ekzistencën e këtij elementi.

[...] Sikundër u evidentua më lart, ky veprim nuk mund të konsiderohet si një interpretim i gabuar i ligjit, pasi do të ishte i tillë nëse do të evidentohej saktë rrethana e largimit nga puna me masë disiplinore dhe do të sqaronte se më pas kjo masë është shuar për shkak të parashkrimit (sipas pretendimit të tij, gjithsesi jo të bazuar në ligj). Jo vetëm kaq, por edhe fakti që punësimi përkatës nuk është evidentuar në jetëshkrim (dokument i detyrueshëm për t’u paraqitur), apo dhe më tej dhënia e një arsyeje tjetër në komisionet parlamentare për largimin nga ajo detyrë, tregojnë për një vullnet dhe vetëdije të aplikuesit për paraqitjen si të vërtetë të diçkaje të gënjeshtërt, shtrembërimin e së vërtetës. Në nenin 80 të ligjit nr.44/2015, KPA është përcaktuar kuptimi dhe mjetet e kërimit të provës gjatë procedurës administrative, ku në mënyrë të shprehur është përcaktuar se, “[...]ndaj dhe përpilimi i kërkesës me shkrim të tij, prej shtetasit L.D. për të qenë anëtar i KPA, duke mos e deklaruar rrethanën e largimit nga puna si gjyqtar me masë disiplinore, ka sjellë përfundimin, që prej organeve publike kompetente, të mos ishte e nevojshme kërkitimi i provave të mëtejshme, mbi kriteret penguese për t’u emëruar anëtar i KPA.. Kolegji vëren se, organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ (Neni 81 i ligjit 44/2015). Në këtë mënyrë, të gjitha këto rrethana që hedhin dritë mbi veprimet e mosveprimet e të gjykuarit të çojnë në mënyrë të pashmangshme në përfundimin logjik se këto veprime e mosveprime janë kryer me dashje nga ana e aplikuesit. Sa më sipër, konkludohet se në veprimet/mosveprimet e paligjshme të të gjykuarit përmbushet në rastin konkret dhe elementi i anës subjektive “faj” në formën e dashjes.

Përmbushja edhe e këtij elementi, duke pasur parasysh se i gjykuari është subjekt i

veprës penale, pasi nuk rezulton të ketë asnjë shkak që e përjashton atë nga përgjegjësia penale, çon në përfundimin se në rastin konkret plotësohen të gjithë elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga paragrafi 1, i nenit 183 të K.Penal.

Lidhur me të gjitha pretendimet e tjera të ngritura në rekurs, Kolegji vlerëson se ato nuk janë të tilla që të mund të ndryshojnë vendimmarrjen e Gjykatës së Posaçme të Apelit, e cila, në përputhje me parashikimet e shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 441 të KPP [...], duhet të lihet në fuqi, me arsyetimin e mësipërm.

Referenca në vendime me temë të ngjashme të Gjykatës: VKPGJL Nr. 00-2021-670, datë 26.10.2021

KPGJL Vendim Nr.00-2023-1569(215), datë 24.07.2023 (Deklarim i rremë: formular vetëdeklarimi dekriminalizim)

Deklarimi i pasaktë në formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të çdo dënimi të formës së prerë përbën paraqitje të rrethanave të rreme në kuptim të ligjit penal.

Fjalë kyçe: vepër penale formale, vetëdeklarim dekriminalizimi, dëshmi e rreme para gjykatës

Rrethanat e çështjes:

Në 02.05.2017, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, është regjistruar për gjykim çështja penale me nr[...]në ngarkim të të pandehurit A.Q., i akuzuar për veprat penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve” dhe “Dëshmia e rreme”, parashikuar përkatësisht nga nenet 190/1 dhe 306/1 të K.Penal.

[...] për shkak të gjyqimit të posaçëm (gjykim i shkurtuar) ka rezultuar e provuar fakti se: Në datën 20.01.2017, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Korçë, ishte zhvilluar seanca gjyqësore në ngarkim të pandehurit E.S., i akuzuar për veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi i dytë dhe 25 të K.Penal. Gjatë kësaj seance gjyqësore ishte pyetur në cilësinë e dëshmitarit edhe A.Q., i cili, në ndryshim nga shpjegimet e dhëna në fazën e hetimit paraprak të kësaj çështjeje, ka mohuar interesimin e të pandehurit S.V., për rastin e F.A.. Më konkretisht A.Q., i pyetur në lidhje me faktin nëse ishte interesuar i pandehuri S.V., në lidhje me subjektin “Aliçkollli”, kishte deklaruar se: *“Ai thjesht më ka pyetur se si vazhdon procedura pas gjobës”*. Gjithashtu, i pyetur për lidhjen midis të pandehurit S.V. dhe F.A., ai ishte përgjigjur *“Nuk e di fare, ne na pyesin shpesh edhe njerëz të tjerë për procedurat në vijim”*. A.Q., ishte pyetur përsëri, edhe pas pyetjeve të palës mbrojtëse në lidhje me faktin nëse i kishte kërkuar i pandehuri S.V. ta ndihmonte për F.A., por ai, në cilësinë e dëshmitarit, kishte deklaruar në mënyrë të prerë *“Jo”*.

Në lidhje me këto fakte të deklaruara nga A.Q. në dëshminë e tij, ishte kërkuar kundërshtimi i pjesshëm i dëshmisë së tij dhe, pas vendimit të gjykatës, ishte lejuar

leximi i deklarimeve të dhëna prej tij në fazën e hetimit paraprak.

Më konkretisht, në fazën e hetimit paraprak, A.Q., në lidhje me faktet e mësipërme, kishte sqaruar se: [...]Pra, Artin Qirici kishte bërë dëshmi të rreme para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. [...] mbi bazën e informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. 2116/378 ext., datë 09.02.2017, ka rezultuar se Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 4862 prot., datë 04.08.2016, i ka dërguar Prokurorisë së Përgjithshme listën emërore të 145 subjekteve vetëdeklarues, të cilët nuk kishin deklaruar dënime penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke u përgjigjur me “Jo”, në pyetjen me numër 1, të formularit të vetëdeklarimit. Në listën emërore në fjalë ndodhej edhe emri i të pandehurit A.Q..

[...]Ndërkohë nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 27.02.2017, rezultonte se ndaj këtij shtetasi, ekzistonte një vendim dënimi, pasi në këtë dokument ishte bërë shënimi “1 (një) rehabilitim”. Referuar vendimit nr. 186, datë 22.06.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka rezultuar se A.Q., ishte deklaruar fajtor për veprën penale të “Goditjes për shkak të detyrës” dhe në bazë të nenit 237 të K.Penal, ishte dënuar me 2 (dy) muaj burg. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal, ishte vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burg dhe zëvendësimi i tij me punë në interes publik, duke e detyruar të pandehurin të kryente 64 orë punë në interes publik.

I pyetur si person nën hetim, në lidhje me faktin e mësipërm, A.Q. ka deklaruar se shpjegimet e tij në lidhje me këtë fakt i kishte dhënë në prokurorinë e Tiranës, ku ishte regjistruar një procedim penal në lidhje me këtë fakt.

[...]Referuar sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 01.02.2017 ka regjistruar procedimin penal [...] ndaj A.Q., si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dëshmia e rreme”, parashikuar nga neni 306/1 i K.Penal dhe ndërkohë kishte regjistruar procedimin penal [...], ndaj A.Q., si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi vulave, stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190/1 i K.Penal. Më pas, në datën 20.04.2017, prokuroria ka bërë bashkimin e këtyre dy procedimeve në një procedim të vetëm me nr. 88, viti 2017. [...]

Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, [...]ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit A.A. për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të vulave, stampave ose i formularëve” [...] dënimin e tij me 1 (një) vit burgim; deklarimin fajtor të të pandehurit, për kryerjen e veprës penale të “Dëshmisë së rreme” [...]dënimin e tij me 2 (dy) muaj burgim. [...] në bashkim të dënimeve, i pandehuri A.A. të dënohet me një dënim të vetëm, prej 1 (një) viti burgim [...]i zbritet si përfitim ligjor, për shkak të gjykimit të shkurtuar, 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 8 (tetë) muaj burgim [...]

Gjykata e Apelit Korçë, [...] ka vendosur prishjen e vendimit nr[...] të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.Q. të akuzuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve” dhe “Dëshmi e rreme”, [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit dhe tërësisë së akteve të marra e të verifikuara në këtë proces penal, në verifikim të shkaqeve të rekursit, vlerëson se shkaqet e ngritura në rekursin e prokurorisë integrohen në shkaqet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 432 të KPP, dhe, për rrjedhojë, e cenojnë vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Korçë. Konkretisht pretendimet në rekursin e paraqitur fokusohen në zbatimin e gabuar të ligjit material penal nga gjykata e apelit, lidhur me identifikimin e veprave penale të parashikuara nga nenet 190/1 dhe 306/1 të K.Penal.

Kolegji konstaton se para gjykatave më të ulëta, janë paraqitur për gjykim akuzat ndaj të pandehurit Artin Qirici, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve” dhe “Dëshmia e rreme”, parashikuar nga nenet 190/1 dhe 306/1 të K.Penal. Gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme, lidhur me faktin penal në ngarkim të tij. Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka disponuar për fajësinë e të pandehurit A.Q., duke vlerësuar se në rastin konkret plotësohen të gjithë elementet e veprave penale, të parashikuara nga nenet 190/1 dhe 306/1 të K.Penal, ndërsa, në vlerësim të kundërt me të, Gjykata e Apelit Korçë, mbi të njëjtat prova të marra dhe të pranuar në gjykim, ka vlerësuar se i pandehuri nuk ka konsumuar asnjë prej veprave penale që i janë atribuuar. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Korçë, sa i përket analizës së faktit dhe provave, në përputhje kjo me përcaktimet e nenit 152 të KPP dhe me dispozitat materiale, është marrë në zbatim jo të drejtë të ligjit material dhe procedural penal. Nga ana e Kolegjit evidentohet mosrespektimi/zbatimi i gabuar i ligjit, sikurse parashikohet në shkronjën “b”, të nenit 432/1, të KPP, nga ana e Gjykatës së Apelit, përsa kohë që kjo gjykatë nuk ka vlerësuar drejt veprimet konkrete, të atribuara të pandehurit nga akuza, në cilësinë e veprimeve, që përbëjnë elementet e figurës së veprës penale (anës objektive dhe subjektive të saj), “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve” dhe “Dëshmia e rreme”, të parashikuara nga nenet 190/1 dhe 306/1 të K.Penal.

Vepra penale e falsifikimit është parashikuar në ligjin penal shqiptar dhe format e kryerjes së saj shpjegohen dhe nga fjalori i gjuhës shqipe. Falsifikimi manifestohet në dy forma, në falsifikimin “material” dhe në falsifikimin “intelektual” (ideologjik). Falsifikimi material konkretizohet me veprime të cilat ndryshojnë një realitet dokumentar, ndërsa falsifikimi intelektual (apo ideologjik) lidhet me përmbajtjen dhe jo me formën e dokumentit dhe konsiston në përpilimin e dokumentit nga ai që është autor i tij, por përmbajtja e të cilit nuk i korrespondon së vërtetës, duke përmbajtur të dhëna të rreme. Kjo dispozitë (neni 190/1 i K.Penal) është parashikuar në ligjin penal shqiptar, nën titullin: “*Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve*” dhe parashikon se: “[...] Nga ana objektive, kjo vepër penale, do të quhet e realizuar, nëse realizohet përmes dy formave: i. falsifikimit të vulave, stampave, formularëve (në mënyrë alternative ose kumulative) ose ii. përdorimit të tyre. Vepra penale e falsifikimit të vulave, stampave, formularëve, futet në kategorinë e veprave penale formale, që do të thotë se ajo quhet e konsumuar dhe për pasojë autori i saj do të përgjigjet penalisht, atëherë kur realizohet në njërin nga format e përmendura më sipër, pa pasur nevojë

për ardhjen apo mundësinë e ardhjes së ndonjë pasoje. Midis veprimeve të autorit të veprës penale dhe falsifikimit të dokumenteve apo përdorimit të tyre, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore në kuptimin që objekti i falsifikuar (vula, stampa, formulari) apo përdorimi i tij vjen ekskluzivisht dhe vetëm si rezultat i veprimeve të autorit. Nga ana subjektive, vepra penale e falsifikimit të vulave, stampave, formularëve, kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron falsifikimin apo përdorimin e dokumentit të falsifikuar, pra ka dijeni rreth falsitetit/pavërtetësisë së dokumentit që vë në përdorim.

Lidhur me pretendimet e karakterit ligjor të ngritura nga Prokurori, Kolegji konsideron se gjatë gjykimit të kësaj çështje pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së gjykatave të faktit ka qenë vlerësimi nëse subjektet deklarues janë të detyruar të deklarojnë në formularin e vetëdeklarimit (dalë në zbatim të ligjit 138/2015) një dënim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar/i huaj apo një masë sigurimi me karakter shtrëngues, për një vepër penale që nuk (verifikoje pak nëse fjala “nuk” është e saktë) parashikohet në nenin 2, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

Ligji 138/2015, [...] në nenin 1 të tij, përcakton se: [...] Ndërsa në nenin 5/3 të të këtij ligji përcaktohet se: [...] Referuar përmbajtjes së formularit të vetëdeklarimit, i dalë në zbatim të ligjit nr. 138/2015, i miratuar me vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, Kolegji vlerëson se subjektet deklarues që përcaktohen në këtë ligj kanë detyrim të pasqyrojnë në formular çdo dënim penal të formës së prerë të dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, pavarësisht llojit të veprës penale dhe llojit e masës së dënimit të dhënë. Madje në rubrikën “Marrje dijeni mbi efektet e formularit të vetëdeklarimit” (në pikën “b” të saj), parashikohet se: *“Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë formular përbën vepër penale dhe dënohet sipas nenit 190 të K.Penal.”*

Kolegji vlerëson se, qëllimi i ligjvënësit, në miratimin e ligjit nr. 138/2015, [...] lidhet me detyrimin ligjor të subjekteve të këtij ligji, për të deklaruar të dhënat e kërkuara, duke përcaktuar edhe se ku konsiston ky deklarim dhe duke e strukturuar atë në disa kërkesa specifike dhe për një kategori të përcaktuar veprash penale. Në këtë kuptim, të gjitha rregullimet, normimet e bëra në funksion të zbatimit të këtij ligji, të cilat mundësojnë zbatimin e tij, duhen konsideruar dhe interpretuar brenda qëllimit të vetë ligjit, pasi çdo interpretim ndryshe do të sillte denatyrimin të këtij qëllimi/vullneti të legjislatorit.

Kolegji vlerëson se detyrimi i caktuar ndaj subjekteve të ligjit, në formularin e vetëdeklarimit, është brenda frymës të vetë ligjit. Qënia i dënuar i subjektit të këtij ligji me vendim përfundimtar ose ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi apo është dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve të parashikuara nga vetë ligji nr. 138/2015, përbën shkak ndalues për zgjedhjen ose emërimin e tij në organet të zgjedhura shtetërore, institucionet e pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike etj, apo shkak për largimin e tij nga këto funksione publike. Ndërsa, mosdeklarimi fshehja, deklarimi i pasaktë ose i rremë nga subjekti deklarues, në formularin e vetëdeklarimit, të çdo dënimi të formës së prerë (të dhënë nga autoritetet

gjyqësore shqiptare apo të huaj), përbën paraqitje të rrethanave të rreme para organeve shtetërore, në kuptim të ligjit penal (nenit 190 i K.Penal).

Duke u kthyer te çështja në shqyrtim, Kolegji vlerëson se gjatë shqyrtimit gjyqësor, në të dy shkallët e gjykimit, është ezauruar plotësisht procesi i të provuarit, nëpërmjet marrjes dhe shqyrtimit të provave. Nga tërësia e tyre kanë rezultuar të provuara rrethanat e faktit, të cilat provojnë se, i pandehuri A.Q., nuk ka deklaruar të dhënat e gjendjes gjyqësore, referuar një dënimi penal të mëparshëm, pra duke vendosur shenjën “X” në përgjigjen negative, në rubrikën e formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Kuvendi i, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, [...] kur në fakt rezulton se ka qenë i dënuar më parë, me vendimin gjyqësor nr. 186, datë 22.06.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. I gjykuari, si subjekt i ligjit nr. 138/2015, ka përpiluar një dokument/formular vetëdeklarimi, paraqitja e të cilit pranë institucioneve të parashikuara në ligj, i jep udhë fillimit të një procedure të mëtejshme verifikimi dhe vlerësimi. Ai ka pasur detyrimin për të deklaruar me vërtetësi çdo të dhënë të kërkuar në formularin e vetëdeklarimit, por në fakt ka paraqitur të dhëna të pavërteta, duke konsumuar kështu elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 190/1 i K.Penal.

Kolegji e vlerëson të drejtë arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, se: “... Ai (i pandehuri), megjithëse e ka ditur detyrimin ligjor dhe qëllim e ligjit e shprehur që në nenin 1 të tij, ka plotësuar formularin me të dhëna që nuk janë të vërteta. Pavarësisht “justifikimit të të pandehurit” se “e ka kuptuar pyetjen gabim”, se “është shtënë në lajthim” për shkak të vërtetimit të gjendjes gjyqësore e cila është lëshuar me shënimin “i padënuar”, apo se ka “besuar se dënimi me gjobë nuk ishte detyrim për t’u deklaruar” rezulton se pyetja 1, është e qartë dhe e kuptueshme, e shprehur në termin “A jeni dënuar ndonjëherë”. Pra, pavarësisht kohës, llojit të veprës, llojit dhe masës së dënimit i pandehuri si subjekt që përmban detyrimin për deklarim ka patur detyrimin për plotësimin e çdo rubrike me saktësi dhe duke pasqyruar informacion real. Gjithashtu i pandehuri nëpërmjet deklaratës së nënshkruar në faqen 2 të formularit është paralajmëruar se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta përbën veprë penale dhe dënohet sipas nenit 190/1 i K.Penal ...”.

Gjithashtu, e drejtë vlerësohet edhe vendimmarrja e asaj gjykate - të shkallës së parë Korçë, që ka gjetur fajtor të pandehurin Qirici, sa i përket veprës tjetër penale të autibuuar ndaj tij, “Dëshmia e rreme”, parashikuar nga neni 306/1 i K.Penal. Dëshmia e rreme para gjykatës konkretizohet me veprime të shfaqura nëpërmjet dhënies/paraqitjes me dashje para gjykatës të të dhënave/fakteve tërësisht apo pjesërisht të pavërteta që i referohen një veprë penale të kryer, fajësisë apo motiveve të saj, të cilat mund të ndikojnë në dhënien e vendimit gjyqësor.

Nga rrethanat dhe faktet e shqyrtuara nga gjykatat më të ulëta, rezulton i provuar fakti se mes deklarimeve të dhëna nga i pandehuri gjatë pyetjes në një proces tjetër penal (në ngarkim të pandehurit E.S dhe S.V), me cilësinë procedurale të deklaruesit - si person që kishte dijeni për rrethanat e hetimit dhe dëshmisë së dhënë nga po ky shtetas (në cilësinë procedurale të dëshmitarit) në gjykimin e po të njëjtës çështje penale, i pyetur për fakte të njëjta ka dhënë shpjegime krejt të ndryshme, duke ndryshuar me deklaratimet

e mëparshme, me qëllim shmangien e përgjegjesisë penale të shtetasit S.V., të proceduar në atë gjykim. Për sa më sipër, duke mbajtur në vëmendje elementet e veprave penale të parashikuara nga nenet 190/1 dhe 306/1 të K.Penal, në raport me faktet dhe rrethanat e provuara në gjykimin nga gjykatat e faktit për çështjen në shqyrtim, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është e bazuar, dhe, si e tillë, duhet lënë në fuqi. Në konkluzion, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke çmuar të bazuara shkaqet e rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, Korçë, vlerëson se, vendimi i Gjykatës së Apelit, Korçë, duhet të priset, për zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material, dhe të lihet në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, duke referuar në shkronjën “b” të paragrafit 1 të nenit 441 të KPP, për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit, dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

KPGJL Vendim Njësues Nr.00-2022-1679(217), datë 27.07.2022 (Trafikimi qënieve njerëzore)

Në lidhje me veprën penale të trafikimit, kur personi i dëmtuar është person i rritur me aftësi të kufizuara fizike/mendore, kjo veprë konsiderohet e kryer me ekzistencën e tre elementeve thelbësorë që janë veprimet/format e trafikimit, mjetet e trafikimit/mënyra sesi trafikantët realizojnë qëllimin e tyre dhe qëllimi. Në rastin e trafikimit të personave të rritur, pëlqimi apo vullneti i viktimës për të ushtruar prostitucion apo forma të tjera të shfrytëzimit nuk ndikon në cilësimin e veprës penale përsa kohë rezulton i provuar fakti se është përdorur një nga mjetet e referuara në dispozitën penale konkrete për arritjen e qëllimit.

Fjalë kyçe: trafikim, persona të rritur, persona të mitur, aftësi të kufizuara mendore/fizike, shfrytëzim prostitucioni

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (në vijim prokuroria), më datë 24.11.2015, ka paraqitur kërkesë për gjykimin e të pandehurve I.Xh. dhe Xh.Xh., duke ju atribuar kryerjen e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a/4 i K.Penal. [...]

Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ka referuar në prokurori rastin e trafikimit të një personi të rritur, shtetas E.Xh., e cila shfrytëzohej për lypje, duke përfutur nga gjendja e saj fizike dhe mendore, rast ky i publikuar nga emisionit [...] Nga ana e prokurorisë janë kryer veprimet hetimore që ajo ka çmuar të nevojshme, duke arritur në përfundimin se shtetasja E.Xh. është trafikuar me qëllim shfrytëzimin e saj për lypje, nga vëllezërit, të pandehurit I.Xh. dhe Xh.Xh. Në këto rrethana, prokurori ju ka komunikuar, në përfundim të hetimeve, akuzën për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i personave të rritur”, parashikuar nga neni 110 / a i KP.

Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se shtetasja E.Xh., [...], është motra e dy të pandehurve dhe është me të aftësi të kufizuara fizike dhe mendore. Sipas aktit të ekspertimit psikiatrik-ligjor nr. 235, datë 14.7.2015, të Institutit të Mjekësisë Ligjore,

Tiranë, *kjo shtetase prezanton probleme të zhvillimit intelektual dhe prezanton moshë mendore të një 13-14 vjeçareje të paarsimuar.*

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, [...] ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit I.Xh., për kryerjen e veprës penale të: “Keqtrajtimi i të miturit”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b paragrafi i dytë, e 25 të K.Penal, [...] dhe dënimin e tij, në bazë të këtyre neneve me 5 (pesë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xh.Xh., për kryerjen e veprës penale të: “Keqtrajtimi i të miturit”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë, e 25 të K.Penal, [...] dhe dënimin e tij, në bazë të këtyre neneve, me 4 (katër) vjet e 6 (gjashhtë) muaj burgim.

[...] Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, vlerësoi se në rekursat e depozituara si nga prokuroria, ashtu edhe nga të gjykuarit, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432 pika ”1”, shkronja ”a” të KPP. Kolegji, nga verifikimi i qëndrimit të mbajtur nga (ish) gjykatat për krime të rënda (shkallë e parë dhe apel) në rastin konkret, në raport me raste të tjera të ngjashme ku janë trajtuar çështje të trafikimit të qenieve njerëzore (referuar këtu edhe qëndrimeve të Kolegjit Penal, veçanërisht qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 03/2011), vlerëson se ka qëndrime të ndryshme në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal të trafikimit të personave, të rritur apo të mitur. Këto qëndrime janë ndikuar edhe nga vendimi unifikues i lartpërmendur, në të cilin është dhënë kuptimi i termit “trafikimi”, duke theksuar [...] Në këto rrethana, Kolegji, mbështetur në nenin 438 të KPP, disponoi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë), me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet:

- 1- Cilat janë format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore?
- 2- Veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të K.Penal, janë vepra penale formale apo materiale?
- 3- Cili është kuptimi i termit “trafikim” në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe çfarë duhet kuptuar me “trafikim të brendshëm”?
- 4- Në rast se në kuptimin e termit “trafikim”, përfshihet edhe trafikimi i brendshëm i personave të rritur apo të mitur, cilat janë dallimet mes veprave penale “Trafikim i personave të rritur” (neni 110/a i K.Penal) dhe “Trafikim i të miturve” (neni 128/b i K.Penal), me veprat penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” (neni 114 i K.Penal) dhe “Keqtrajtimi i të miturit” (neni 124/b i K.Penal)?
- 5- Si duhet cilësuar fakti i shtytjes së detyrueshme ose jo, për punë apo për lypje e një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, kur ky person nuk është në moshë të mitur? A mund të trajtohet në këtë rast personi me aftësi të kufizuara mendore si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me një të mitur? [...]

i. E drejta/Ligji i zbatuar

[...]Kolegji konstaton se vendimi unifikues nr. 3/2011 ka konkluduar se, *kriter bazë për kuptimin e zbatimit të drejtë të veprave penale të “trafikimit” sipas Kodit të Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar*. Kolegji shtroi për diskutim nëse në këtë rast konkret ishte e nevojshme iniciimi i procedurës së ndryshimit të këtij vendimi unifikues në Kolegje të Bashkuara apo njësimi i praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal. Për të arritur në një konkluzion të drejtë në këtë aspekt, Kolegji vlerëson se duhet analizuar fakti i trafikimit të qenieve njerëzore, si në aspektin kushtetues, ashtu edhe në aspektin penal.

Kushtetuta nuk ndalon shprehimisht trafikimin e qenieve njerëzore dhe çdo formë të saj. Kolegji thekson se, nuk ka asnjë dyshim se trafikimi cenon dinjitetin njerëzor dhe liritë themelore të personave që janë viktimë e tij, ndaj nuk ka sesi të shihet si i pajtueshëm me një shoqëri demokratike, as me vlerat e sanksionuara në KEDNJ (*shih GJEDNJ, çështja Rantsev kundër Qipro dhe Ruisë*). [...] Kolegji vë në dukje se me rëndësi për rastet kur trajtohet trafikimi i të miturve është edhe neni 54/3 i Kushtetutës, i cili sanksionon të drejtën e fëmijës për të qenë i mbrojtur nga shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht nën moshën minimale lidhur me punën që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën a zhvillimin normal të fëmijës.

Kolegji, nisur nga fakti që Shqipëria është palë në KEDNJ, vlerëson se jo vetëm dispozitat e KEDNJ, por edhe jurisprudenca e GJEDNJ, është e detyrueshme për të. [...]GJEDNJ ka argumentuar në disa raste se trafikimi i qenieve njerëzore mbështetet në ushtrimin e disa atributëve të së drejtës së pronësisë, ku qeniet njerëzore trajtohen si mallra që mund të shiten e të blihen, mund t'i nënshtrohen një pune të detyruar, shpeshherë pak apo aspak të paguar. Trafikimi nënkupton një mbikëqyrje të rreptë të veprimtarive të viktimave dhe shpesh, këtyre të fundit ju kufizohet liria e qarkullimit, i nënshtrohen akteve të dhunës apo kërcënimeve, si dhe vendosen në kushte të papërshtatshme jetese dhe pune (*shih GJEDNJ, çështja Rantsev kundër Qipros e Ruisë, paragrafi 272, çështja M. e të tjerë kundër Italisë dhe Bullgarisë, aplikimi nr. 40020/03, datë 31.07.2012*). Shqipëria ka ratifikuar disa marrëveshje ndërkombëtare që synojnë mbrojtjen e viktimave të trafikimit me qëllim shfrytëzimin e tyre, por në rastin konkret Kolegji vlerëson me rëndësi të evidentojë:[...]

Në zbatim dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare, Republika e Shqipërisë ka bërë disa ndryshime në Kodin Penal. Kolegji vlerëson me rëndësi të theksojë se, me ligjin nr. 144, datë 02.05.2013, dispozitat e ligjit material penal mbi trafikimin e qenieve njerëzore, janë ndryshuar thelbësisht (ligj që ka hyrë në fuqi në datë 04.06.2013). [...] Me formulimin e ri të nenit 110/a të K.Penal, trafikimi i femrave është parashikuar si rrethanë cilësuese; është parashikuar shprehimisht “*trafikimi i brendshëm*” (neni 110/a i K.Penal parashikon shprehimisht se, trafikimi i personave të rritur mund të kryhet si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), përveç atij jashtë kufijve të Shqipërisë; janë ashpërsuar dënimet për disa rrethana cilësuese. Duhet

theksuar se, në nenin 128/b të këtij Kodi, nuk është parashikuar shprehimisht trafikimi i të miturve “si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” – pra nuk është referuar edhe në këtë dispozitë trafikimi i brendshëm. Nga ana tjetër, në paragrafin e dytë të nenit 114 (dispozitë kjo që është ndryshuar me ligjin nr. 144/2013) parashikohet se shfrytëzimi për prostitucion i një të mituri dënohet sipas kësaj dispozite, duke mos u kualifikuar si trafikimi i të miturve (problematika që do të trajtohen në vijim).

Kolegji evidenton edhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal material e procedural, në lidhje me drejtësinë penale për të miturit. Konkretisht, është miratuar me ligjin nr. 37/2017 KDPM. [...]Ky parashtrim u vlerësua me rëndësi nga ana e Kolegjit për të vënë theksin në faktin se, pavarësisht se në KPP apo në KP mungon një dispozitë që të përkufizojë të miturin apo viktimën e mitur në kohën e kryerjes së veprës penale, marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për tu zbatuar edhe nga shteti shqiptar, garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetin e të miturve, viktimat të trafikimit apo të shfrytëzimit. (*shih vendimin nr. 00-2021-727 (46), datë 21.09.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

Kolegji, në vijim të argumenteve të parashtruara më lart dhe në referim të ligjit/legjislacionit të zbatueshëm, vlerëson se vendimi unifikues nr. 3/2011 nuk gjen zbatim në rastin e veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore. Së pari, ky vendim unifikues (nr. 3/2011) trajton një çështje penale që lidhet me trafikimin e lëndëve narkotike dhe/ose trafikimin e armëve, të cilat janë vepra penale që përfshihen në kreun VIII, “Krime kundër autoritetit të shtetit”, seksioni III të Kodit Penal, “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”. Ndërkohë, veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore përfshihen në kreun II të Kodit Penal, “Krime kundër personit”, konkretisht në seksionin VII “Veprat penale kundër lirisë së personit” (neni 110/a i K.Penal) dhe seksioni IX “Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes” (neni 128/b i K.Penal). Në rrethanat e sipërcituara, Kolegji vlerëson se nuk mund të vendoset shenja e barazimit dhe të trajtohen në mënyrë të njëjtë veprat penale të sipërcituara, vetëm për shkak të termit “trafikim” në titullin e dispozitës. Së dyti, siç u theksua, ligji penal ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 144/2013, duke kriminalizuar trafikimin e qenieve njerëzore si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, nuk është e nevojshme iniciimi i procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore, pasi vendimi unifikues i referuar nga gjykata e apelit nuk ka lidhje dhe për pasojë, nuk gjen zbatim në rastin konkret, por edhe më gjerë në trajtimin e veprave penale të trafikimit të personave të rritur apo të mitur, duke vijuar me procedurën për njësimin e praktikës gjyqësore.

ii. Standardet ndërkombëtare dhe jurisprudenca e GJEDNJ, në raport me trafikimin e qenieve njerëzore

Kolegji vlerësoi me rëndësi njësimin e praktikës gjyqësore, nisur edhe nga fakti që ligjvënësi ndonëse ka ndryshuar e përafëruar me standardet ndërkombëtare nenin 110/a të K.Penal, “Trafikimi i personave të rritur”, nuk ka parashikuar shprehimisht trafikimin

e brendshëm edhe në nenin 128/b të K.Penal, “Trafikimi i të miturve”. [...]

GJEDNJ në vendimmarrjet e saj ka theksuar se, në kontekstin e veçantë të trafikimit të qenieve njerëzore, Protokoll i Palermos dhe Konventa kundër Trafikimit (Konventa e Varshavës) përmendin, si njëri ashtu edhe tjetra, domosdoshmërinë e miratimit të një qasjeje globale për të luftuar kundër trafikimit duke vendosur, përveç masave që synojnë të sanksionojnë trafikantët, edhe disa masa për parandalim të trafikimit dhe për mbrojtje të viktimave. [...] (Shih GJEDNJ, çështja *Rantsev kundër Qipro dhe Ruisë/aplikimi nr. 25965/04, datë 07.01.2010*). (Shih çështjen *Rantsev kundër Qipro dhe Ruisë/aplikimi nr. 25965/04, datë 07.01.2010, çështjen C.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 4239/08, datë 13.11.2012*).

Kolegji vlerëson se konkluzionet e cituara më lart, gjejnë zbatim edhe në rastin konkret, në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, duke marrë përsipër edhe interpretimin e ligjit penal në përputhje me to. Ky konstatim lidhet me detyrimin për zbatimin e nenit 128/b të K.Penal në raport me nenin 114 pika ‘2’ të këtij Kodi, në rastet kur viktima e trafikimit apo e shfrytëzimit është një i/e mitur. Standardet ndërkombëtare dhe konventat e ratifikuara nga Shqipëria, sanksionojnë shprehimisht që pëlqimi i një të mituri për të ushtruar prostitucion nuk merret në konsideratë, duke theksuar se pëlqimi apo pranimi i një të viktimit të mitur për të ushtruar prostitucion apo çdo lloj shërbimi a pune tjetër që nuk është në përputhje me zhvillimin e tij, duhet trajtuar si trafikim, pavarësisht faktit nëse ky shfrytëzim i të miturit është realizuar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (*Ky interpretim i gabuar i ligjit nga gjykatat shqiptare është vënë në dukje edhe në rekomandimet e GRETA për Shqipërinë, që monitoron zbatimin e Konventës së Varshavës në vendet anëtare. Këto konkluzione kanë rëndësi për përgjigjet e pyetjeve të shtruara për njësim në këtë vendim*).

iii. Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për njësim: “Cilat janë format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore?”

Në lidhje me këtë çështje, Kolegji gjen me vend të ritheksojë se aktualisht në K.Penal ka dy dispozita që në mënyrë të shprehur kriminalizojnë trafikimin e qenieve njerëzore: trafikimi i personave të rritur/neni 110/a dhe trafikimi i të miturve/neni 128/b. Trajtimi i kësaj çështje u vlerësua me rëndësi nga Kolegji, përse kohë gjykatat e faktit në vendimmarrjet objekt rekursi kanë argumentuar se, “*rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që të pandehurit, kanë shtytur dhe përdorur të dëmtuarën, që ajo të lypë, por ky fakt nuk duhet të ngatërrohet me veprën penale të trafikimit të personave të rritur, e cila kërkon si element të parë të domosdoshëm, rekrutimin e personit dhe më pas, heqjen ose kufizimin e lirisë së vullnetit të tij dhe detyrimin e tij që të kryejë, jashtë vullnetit të tij, veprime të caktuara, ku përfshihet edhe lypja.*”

Kolegji vlerëson të gabuar këtë qëndrim të gjykatave të faktit. [...] Kolegji, pikërisht duke ju referuar këtij argumentimi si dhe mënyrës së zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson me rëndësi trajtimin e formave të kryerjes së veprave penale të trafikimit të personave, të rritur apo të mitur. Kolegji thekson se trafikimi i personave të rritur apo të mitur është një problem kompleks, pasi format dhe mjetet e realizimit ndryshojnë

në funksion të zhvillimit të shoqërisë, të gjendjes ekonomike, sociale apo politike të shteteve të ndryshme. Sot, trafikimi trajtohet si një formë moderne e skllavërisë, nuk është thjesht një dhunim i të drejtave të njeriut, por është edhe një problem i rendit publik, prandaj me rëndësi është edhe evidentimi i formave të ndryshme të shfrytëzimit të individit, të cilat duhen trajtuar si forma të ngjashme me skllavërimin [...]

Kolegji vlerëson me rëndësi në funksion të zbatimit sa më të drejtë të ligjit penal material, në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, të ndalet edhe në një trajtim më të detajuar të elementeve të trafikimit. Konkretisht, përsa i takon “rekrutimit” si një nga format/veprimet e kryera nga subjekti aktiv i veprës penale, Kolegji thekson se ky element nënkupton veprimet aktive/konkrete që kryen i pandehuri për gjetjen në radhë të parë të një personi që mund të nënshtrohet lehtësisht, e lidhur kjo me shkaqe të ndryshme sociale, familjare, ekonomike apo personale. “Rekrutimi synon krijimin e një gjendje varësie mes rekrutuesit dhe të rekrutuarit, ku këto të fundit pasi më parë janë nënshtruar, vendosen në një gjendje varësie, e në vijim ato shfrytëzohen. Nënshtrimi, në të vërtetë, është një pozicion subjektiv pasiv, ku personi i nënshtruar përballet me një aktivitet fuqie që përktëhet në imponimin e detyrave ose të kushteve jo të favorshme për të. Kjo gjendje nënshtrimi dhe varësie varet nga vullneti i rekrutuesit dhe zakonisht vazhdon sipas atij vullneti.” (*shih vendimi nr. 70, datë 11.05.2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Në këtë pikë, Kolegji thekson se gjykatat dhe prokuroria duhet të kenë në vëmendje që personat që jetojnë në një ambient social apo familjar me probleme ekonomike, financiare, personale apo psikologjike, duhen trajtuar me shumë kujdes, si viktimë të mundshme të trafikimit.

Kolegji thekson se forma të trafikimit janë edhe transportimi dhe transferimi i personit, (të ngjashëm mes tyre), që nënkupton lëvizjen apo zhvendosjen e një personi nga një vend në një vend tjetër. Për të ekzistuar kjo formë e trafikimit, nuk kërkohet domosdoshmërisht që lëvizja apo zhvendosja të ketë si synim kalimin e kufijve të Republikës së Shqipërisë, por mund të realizohet edhe brenda territorit të shtetit shqiptar. Transportimi apo transferimi i personit mund të realizohet me vullnetin e lirë të viktimës, e lidhur kjo me mjetet/mënyrën që përdor i pandehuri, zakonisht duke përfutuar nga besimi i viktimës apo për shkak të mashtrimit (veçanërisht mashtrimi për krijimin e një lidhjeje/marrëdhënie intime, që shoqërohet me zhvendosjen në një vend tjetër për një jetë më të mire). Qëllimi i zhvendosjes së viktimës së trafikimit është izolimi i saj, shkëputja e lidhjeve me vendin e saj të origjinës (për shembull me qytetin e lindjes), me personat e saj të afërt apo të familjes, duke e shkëputur nga njerëzit që mund ta ndihmojnë për të shmangur shfrytëzimin.

Për ta evidentuar dallimin mes këtyre dy formave të trafikimit (transportim dhe transferim), Kolegji vlerëson se transportimi i personit përfshihet brenda konceptit të transferimit, që do të thotë se sa herë që kemi transferim të personit kjo shoqërohet edhe me transportim të tij, si brenda dhe jashtë vendit. Një dallim tjetër mes transportimit dhe transferimit të personit, është fakti që tek transferimi i viktimës, subjekti i veprës penale kryen një veprimtari kriminale më të gjatë në kohë, deri sa të arrijë plotësisht zhvendosjen e viktimës nga një shtet/vend në një shtet/vend tjetër. Transportimi i

personit zakonisht zgjat disa orë dhe ka si synim thjesht lëvizjen e viktimës, por jo edhe izolimin e saj apo largimin në një vend të panjohur e të huaj për të. Nisur nga natyra e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, që zakonisht është një veprimtari kriminale e organizuar, Kolegji thekson se në kryerjen e veprës penale mund të bashkëveprojnë disa persona, ku njëri vepron përmes rekrutimit, një tjetër vepron duke e transportuar apo transferuar nga një vend në një vend tjetër, ku e pret me shumë mundësi personi që më pas do e shfrytëzojë. Pavarësisht se mund të veprojnë në forma të ndryshme, qëllimi i tyre i përbashkët është shfrytëzimi, ndaj Kolegji thekson se në këtë rast të gjithë bashkëpjesëmarrësit duhet të hetohen apo gjykohen për veprën penale të trafikimit të personit, qoftë ky i rritur apo i mitur.

Dispozita penale konkrete, neni 110/a i K.Penal, parashikon si formë të trafikimit edhe “fsheshjen e personit”, që nënkupton mbajtjen e viktimës të izoluar nga ambienti i jashtëm, duke ndërprerë çdo lloj komunikimi të saj me persona të tjerë, kryesisht me familjen ose miqtë dhe të afërmit të saj. Kolegji vlerëson se, në mënyrë që të jemi para kësaj forme të kryerjes së veprës penale të trafikimit të personit, kërkohet që viktimës t’i hiqet liria dhe të mbahet e izoluar jashtë vullnetit të saj, duke i hequr çdo mundësi që ajo të komunikojë me persona të tjerë dhe me botën e jashtme. Nga ana tjetër, “pritja e personit” si një nga format e trafikimit, nënkupton veprimet që kryhen nga ana e subjektit të veprës penale që kanë të bëjnë me strehimin e personit dhe me shoqërimin e tij për në një vend të caktuar, zakonisht banesë, hotel ose në ndonjë vend tjetër. Që të jemi para formës “pritja e personit”, kërkohet detyrimisht që subjekti i veprës penale të kryejë veprime aktive që kanë të bëjnë me pritjen e personit/viktimës, me shoqërimin për në vendin e strehimit dhe të qëndrimit dhe me sigurimin prej tij të kushteve të banimit për viktimën. Ligji material penal parashikon në nenin 110/a, paragrafi parë, edhe mjetet nëpërmjet të cilave mund të realizohet secila nga format e kryerjes së trafikimit të personit të rritur. Kolegji vë në dukje se mjetet apo mënyra sesi realizohet trafikimi i personave të rritur, kanë si qëllim të krijojnë një lloj kontrolli të subjektit të veprës penale/të pandehurit mbi viktimën e tij. Në rast se i referohemi paragrafit të parë të nenit 110/a, mjetet për realizimin e trafikimit të personave të rritur janë: me anë të kërcënimit; me anë të përdorimit të forcës; me anë të formave të tjera të shtrëngimit; me anë të rrëmbimit; me anë të mashtrimit; me anë të shpërdorimit të detyrës; me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e të dëmtuarit (pozita vulnerabël); me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër. Kolegji, në interpretim të dispozitës penale materiale, vlerëson se mjetet për realizimin e trafikimit të personave mund të grupohen në: *a)* mjete që kërkojnë ushtrim të dhunës fizike, psikike, rrëmbim apo mënyra të tjera të përdorimit të forcës. Në këto raste, viktimja jo vetëm që izolohet, por ajo vendoset në pamundësi për të lëvizur apo për të vepruar, duke u shoqëruar edhe me heqjen e paligjshme të lirisë së saj (rrëmbimi, dhuna fizike apo psikike, përdhunimi, kërcënimi me jetë, për veten apo familjarët e saj). *b)* Mjete që realizojnë apo lehtësojnë trafikimin e personit, nëpërmjet mashtrimit të viktimës apo shpërdorimit të besimit që ajo mund të ketë tek një person. Forma më klasike e mashtrimit, në jurisprudencën shqiptare, është ajo e krijimit të një marrëdhënie intime, duke premtuar martesë apo bashkëjetesë, si

dhe një jetë më të mirë. Në disa raste të tjera, mashtrimi realizohet edhe duke i premtuar viktimës shkollim, për punë të ndryshme apo dhe thjesht për një udhëtim jashtë vendit.

c) **Përfitim nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e viktimës, është ajo që instrumentet ndërkombëtare e përkufizojnë si “gjendje vulnerabël” apo “pozita vulnerabël e viktimës”. Instrumentet ndërkombëtare e përkufizojnë gjendjen/pozitën e vulnerabilitetit si një situatë ku personi nuk ka asnjë alternativë tjetër konkrete ose të pranueshme, përveçse t’i nënshtrohet abuzimit ku është përfshirë [...]**d) Një mjet tjetër është edhe vënia nën kontroll e një personi, duke përdorur mënyra të ndryshme detyrimi si: me anë të një borxhi; me anë të izolimit nga kontakti me persona të njohur apo të afërm; me anë të marrjes së dokumenteve të identifikimit, duke kufizuar lëvizjen e lirë të personit, por mund të ketë edhe mënyra apo mjete të tjera që do ti identifikojë praktika gjyqësore dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Qëllimi, si element i trafikimit të qenieve njerëzore, është shfrytëzimi i viktimës, që është dhe qëllimi final i trafikimit, qëllim ky që shfaqet në disa forma. Ligji penal shqiptar, bazuar në Protokollin e Palermos dhe në Konventën e Varshavës, përcakton disa forma të shfrytëzimit të personit të trafikuar, qoftë ky i mitur apo personi i rritur. Aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, ndonëse nuk japin një përkufizim të termit “shfrytëzim”, theksojnë se shfrytëzimi përfshin *së paku*, shfrytëzimin e prostitucionit ose shërbimet seksuale. Nenet 110/a dhe 128/b të KP parashikojnë si forma apo mënyra të shfrytëzimit të viktimës së trafikimit: **i.** Shfrytëzim seksual, prostitucion apo edhe puna në shtëpi publike; **ii.** Shfrytëzimi i punës ose shërbime të detyruara: kryerja e detyruar e punës nga viktima, e cila nuk do ta bënte atë me vullnet të lirë; krijimi i situatës ku viktima është e detyruar të bëjë një punë që nuk i përket ta bëjë; mbajtja e një personi në robëri për shkak të borxhit; puna apo shërbimet e kryera me mashtrim, shtrëngim, kërcënim dhe dhunë; **iii.** Shfrytëzimi i skllavërisë apo formave të ngjashme me të.

Kolegji vë në dukje se, GJEDNJ në çështjen *Siliadin kundër Francës*, mes të tjerave, ka theksuar [...] Kolegji vlerëson se këto konkluzione duhen mbajtur në konsideratë nga gjykatat në analizën e faktit penal, ku trafikimi duhet konsideruar si një formë e skllavërisë moderne. Viktima e trafikuar konsiderohet si “pronë” nga trafikanti, duke ju nënshtruar çdo lloj urdhri të tij, nuk gëzon asnjë të drejtë njerëzore përfshi dhe lirinë e lëvizjes. Në ligjin penal shqiptar parashikohet si formë shfrytëzimi edhe forma të tjera të ngjashme me skllavërinë. Kolegji në zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe në jurisprudencën e GJEDNJ, vlerëson se forma të tilla mund të jenë: mbajtja e viktimës në kushte të tilla, ku persona të tjerë e përdorin për qëllime të ndryshme, përfshi këtu edhe për aktivitete kriminale. Një nga format e shfrytëzimit është edhe rekrutimi i një personi me qëllim transplantimin e organeve apo edhe për eksperimente mjekësore, si një nga format më të rënda të shkeljes së dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik të personi. Forma të tjera shfrytëzimi të pranuar në instrumentet të ndryshme ndërkombëtare janë edhe sjellje të tilla kriminale si: birësimi i paligjshëm, martesat me detyrim, lypja e detyruar [...]

Kolegji thekson se duhet vlerësuar me kujdes pëlqimi dhe vullneti i viktimës për të lëvizur apo për tu zhvendosur me të pandehurin, e më pas edhe pëlqimi i saj për

të ushtruar prostitucion apo për të lejuar një formë tjetër shfrytëzimi. Gjykatat dhe prokuroria duhet të ketë në konsideratë se, ky pëlqim apo vullneti i viktimës, nuk sjell asnjë pasojë, kur provohet ekzistenca e një prej mjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore (mjetet janë: mashtrimi, rrëmbimi, dhuna, përfitimi nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, e të tjera forma të trajtuar gjerësisht më lart). Ky konkluzion gjen mbështetje edhe në nenin 4 të Konventës së Varshavës, ku parashikohet se: [...]Konventa e Varshavës në nenin 4, shkronja 'a' parashikon se: “[...] Shfrytëzimi do të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.. Në raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës/Konventa e Varshavës, “detyrimi” është përcaktuar në kuptimin e gjerë, si ndikim psikik mbi sjelljen e vullnetit të lirë të viktimës e që shkon përtej nxitjes (bindjes) së zakonshme të tjetrit dhe nënkupton shtyrje të papërbalueshëm psikologjik, forcë fizike ose kërcënim, rrëmbim, mashtrim, shpërdorim të pushtetit ose pozitës vulnerabël apo dhënie të pagesave ose dhënie të përfitimeve, me qëllim të sigurimit të pëlqimit nga personi i cili është nën kontrollin e trafikantit.

Ndërkohë, siç është theksuar edhe më lart, qëndrimi është i ndryshëm në rastin e trafikimit të të miturve, ku mjafton të provohet ekzistenca e njëres prej formave të trafikimit dhe qëllimi i shfrytëzimit (mjetet nuk kërkohet të provohen në këtë rast, për shkak se fëmijët konsiderohen si persona vulnerabël/formë + qëllim). Kolegji çmon se ka rëndësi të evidentohet që në lidhje me të miturit, Konventa e Varshavës po në nenin 4, shkronja 'c' parashikon se[...]Kjo do të thotë se, fakti nëse jemi para trafikimit apo jo, varet nga rezultati/qëllimi final, pavarësisht nëse është arritur shfrytëzimi i të miturit apo jo, por nga ana tjetër, duhet që qëllimi i trafikimit duhet të provohet përtej çdo dyshimi. [...] Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për njësim: “*Cilat janë format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore?*”, **Kolegji mban këtë qëndrim njësuës:**

- Trafikimi i qenieve njerëzore në ligjin penal të Republikës së Shqipërisë (parashikuar në dy dispozita: “Trafikim i personave të rritur” – neni 110/a dhe “Trafikimi i të miturve” – neni 128/b i K.Penal), përfshin tre elemente thelbësorë:

1- **Veprimet**/format e trafikimit (rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave);

2- **Mjetet e trafikimit**/mënyra sesi trafikantët realizojnë qëllimin e tyre (kërcënim, përdorimi i forcës e formave të tjera të shtyrjes, mashtrim, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël (lehtësisht të cenueshëm) ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve);

3- **Qëllimi** (shfrytëzimi seksual, për punë ose shërbime të detyruara, skllavëria ose praktikat e ngjashme me skllavërinë);

- **Vepra penale e parashikuar** nga neni 110/a i K.Penal konsiderohet e kryer plotësisht, kur vërtetohet njëra nga format/veprimet, njëra nga mjetet dhe qëllimi i shfrytëzimit të viktimës. Në rastin e trafikimit të personave të rritur, pëlqimi apo vullneti i viktimës për të ushtruar prostitucion apo forma të tjera të shfrytëzimit nuk ndikon

në cilësimin e veprës penale përsa kohë rezulton i provuar fakti se është përdorur një nga mjetet e referuara në dispozitën penale konkrete për arritjen e qëllimit (*Mjetet në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, janë: mashtrimi, përdorimi i forcës, rrëmbimi, kërcënimin apo përdorimi i formave të tjera të shtrëngimit, shpërdorim detyre ose përfitim nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, etj – elemente këto që duhen provuar në rastin e trafikimit të një personi të rritur*).

- Në veprën penale “Trafikimi i të miturve”, duhen nxjerrë në pah dy elemente:

(i) mjetet e përdorura për të arritur qëllimin kriminal nuk kanë rëndësi. Mjetet nuk ndikojnë në cilësimin juridik të kësaj vepre penale, që do të thotë se për shkak të cilësimit juridik të veprës, mjafton të provohet ekzistenca e njërës prej formave të trafikimit si: rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturit, me qëllim shfrytëzimin e tij.

(ii) vullneti apo pëlqimi i të miturit viktimë e trafikimit, në lidhje me shfrytëzimin e synuar, nuk ka vlerë, pavarësisht rrethanave apo mënyrës në të cilën është shfaqur.

iv. Pyetja e dytë e shtruar për njësim është: “Veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të K.Penal, janë vepra penale formale apo materiale?”

Në lidhje me këtë pyetje, Kolegji nuk ka si qëllim që të bëjë një trajtim teorik të mënyrave sesi doktrina kategorizon veprat penale. Kolegji, në lidhje me këtë çështje, vlerëson të ndalet tek cilësimi i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore si vepra penale formale apo materiale, duke e lidhur këtë analizë me qëllimin si element të kërkuar nga dispozitat konkrete (neni 110/a dhe neni 128/n i K.Penal). Kolegji vlerëson se veprat penale që ndëshkojnë trafikimin e qenieve njerëzore (persona të rritur apo të mitur), duhen trajtuar si vepra penale formale, domethënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje kriminale, në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kolegji thekson se mjafton të provohet ekzistenca e njërës prej formave të trafikimit (p.sh. rekrutimi ose transportimi ose pritja e të tjera), të paktën ekzistenca e një prej mjeteve (p.sh. mashtrimi ose rrëmbimi ose përfitimi nga gjendja shoqërore/vulnerabël etj.), si dhe qëllimi i shfrytëzimit, së paku për prostitucion – që kryerja e kësaj vepre penale të konsiderohet plotësisht e kryer. Pra, në thelb, ekzistenca e veprës penale është një çështje fakti që duhet provuar e argumentuar rast pas rasti, duke pasur në konsideratë elementet e kësaj figure vepre penale. Me fjalë të tjera, kryerja e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, kërkon që të provohet ekzistenca e tre elementeve të sipërcituar, pra krahas formës (njëra është e mjaftueshme), duhet të provohet edhe ekzistenca e mjeteve si dhe qëllimi i shfrytëzimit (në rastin e trafikimit të personave të rritur). Kolegji tërheq edhe një herë vëmendjen në faktin që, pëlqimi dhe vullneti i viktimës nuk sjell asnjë pasojë, kur provohet ekzistenca e një prej mjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Theksi në këtë rast vendoset tek mjetet/mënyrat e përdorura për të realizuar këtë qëllim – shfrytëzimin e personit. Vetëm trafikimi me qëllim

shfrytëzimi, në kushtet e shtrëngimit me forcë apo përmes mashtrimit apo përmes formave të tjerave të ngjashme me skllavërinë etj., është penalisht i dënueshëm (në rastin e trafikimit të personave të rritur). Kolegji rithekson edhe një herë se, GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka theksuar se, shtetet janë të detyruara të marrin masa efektive për ndalimin e skllavërisë dhe robërisë moderne, e cila haset ende edhe në shtetet me traditë demokratike. (...) (*shih çështja Siliadin kundër Francës, kërkesa nr. 73316/01, datë 26/07/2005.*)

Kolegji, në zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe në referim të jurisprudencës së GJEDNJ, vlerëson se vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore (trafikim i personave të rritur apo trafikimi i të miturve), do të konsiderohet si plotësisht e kryer kur provohet se subjekti aktiv i veprës penale ka realizuar të paktën rekrutimin e personit të trafikuar/viktimës së trafikimit, ose vetëm transportimin e viktimës, ose vetëm transferimin e saj, ose vetëm fshehjen, ose vetëm pritjen e personit viktimë e trafikimit. Në rastin e personave të rritur duhet provuar që secila nga format e sipërcituara është realizuar përmes përdorimit të njërit nga mjetet (mjafton pra qoftë edhe prania e njërit prej tyre), e konkretisht me anë të mashtrimit apo kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, si dhe duke vërtetuar edhe qëllimin për trafikimin e viktimës, pavarësisht faktit nëse personi i trafikuar është shfrytëzuar apo jo. Në çdo rast kur viktimë është e mitur – pëlqimi që jep i mituri për të ushtruar prostitucion apo për të kryer çdo lloj shërbimi tjetër të detyruar (përfshi këtu lypjen apo punën), nuk merret në konsideratë/nuk ka vlerë për efekt të cilësimit të faktit penal si trafikim i të miturit, pavarësisht faktit, nëse është cenuar ose jo vullneti i tij. Ky konkluzion është logjik dhe lidhet me gjendjen vulnerabël të të miturve, për shkak të moshës dhe zhvillimit të tyre. Në akte të ndryshme ndërkombëtare, të miturit/fëmijët konsiderohen si persona veçanërisht vulnerabël [...]

Kolegji vlerëson se, vetëm në rastet kur ligji penal material parashikon rrethana cilësuese, që lidhen me ardhjen e një pasoje konkrete, atëherë vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore do të trajtohet si një vepër penale materiale. Kjo do të thotë se, organi i akuzës në rastin kur i atribuon të pandehurit ekzistencën e një rrethane të tillë cilësuese, duhet të provojë edhe pasojën e ardhur si: dhunën e ushtruar apo keqtrajtimin apo vdekjen e viktimës së trafikimit. Ky element ka rëndësi për cilësimin e saktë të faktit penal, pasi dispozitat penale konkrete parashikojnë disa rrethana cilësuese, ekzistenca e të cilave duhet provuar rast pas rasti. Në përfundim të kësaj analize, duke pasur në konsideratë sa është trajtuar deri tani, në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim: *“Veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të K.Penal, janë vepra penale formale apo materiale?”*, Kolegji mban këtë qëndrim njësuës:

Veprat penale që ndëshkojnë trafikimin e qenieve njerëzore (persona të rritur apo të mitur), janë vepra penale formale, që nuk kërkojnë domosdoshmërisht ardhjen e pasojës kriminale në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kur ligji penal material parashikon rrethana cilësuese që lidhen me ardhjen e një pasoje konkrete, atëherë vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore do të trajtohet si një vepër penale materiale (e lidhur kjo me verifikimin e pasojës).

v. Pyetja e tretë e shtruar për njësim, e lidhur ngushtësisht me sa është trajtuar më lart, është: “Cili është kuptimi i termit “trafikim” në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe çfarë duhet kuptuar me “trafikim të brendshëm”?

Kolegji vë në dukje se trafikimi i qenieve njerëzore është një veprë penale që ka si qëllim kryesor jo kalimin e paligjshëm të kufirit apo zhvendosjen e personave nga një vend në një vend tjetër (qoftë edhe brenda territorit të një shteti), por shfrytëzimin e njerëzve së paku për prostitucion ose në çdo lloj forme tjetër shfrytëzimi. Në këtë kontekst, veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elemente: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, e realizuar kjo nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës, etj. Pikërisht në një rast të tillë, jemi para asaj që njihet si “trafikimi i brendshëm i qenieve njerëzore”.

Në lidhje me shprehjen “trafikim i brendshëm”, Kolegji evidenton se në rastin e qenieve njerëzore qëllimi i shfrytëzimit të tyre së paku për prostitucion apo në kushte të ngjashme me skllavërinë, është element me rëndësi, që duhet provuar rast pas rasti. Parimi i territorit nuk ka asnjë rëndësi për kualifikimin ligjor të faktit penal, pasi në këtë rast, pra trafikimi i personave qofshin këto të rritur apo të mitur, nuk lidhet domosdoshmërisht me kalimin e kufijve shtetërorë. Trafikimi i qenieve njerëzore nuk ka vetëm natyrë transnacionale. Në rastin kur trajtohet hyrja apo dalja e paligjshme e personave nga ose nëpërmjet territorit shqiptar, jemi para veprës penale të kontrabandimit/trafikimit të migrantëve – siç cilësohet nga protokollin shtesë i Konventës së OKB kundër krimit të organizuar ndërkombëtar [...]. Në raste të tilla, Kolegji vlerëson se zbatohet parimi i territorit, siç është përcaktuar në konkluzionin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara në vendimin nr. 3/2011. Kodi Penal shqiptar, në fakt, nuk përdor termin kontrabandimi i personave apo trafikim i migrantëve, por kriminalizon kalimin e paligjshëm të kufirit apo ndihmën për kalimin e paligjshëm të kufijve (*nenet 297 dhe 298 të K.Penal*).

Zhvendosja apo transferimi i viktimës nga një zonë në një tjetër, nga një qytet në një qytet tjetër brenda territorit të Shqipërisë, ka si qëllim izolimin e viktimës për të lehtësuar shfrytëzimin e saj. Kolegji vlerëson se nuk ka asnjë dallim në trajtimin e trafikimit të brendshëm në rastet kur viktimë është e rritur apo e mitur. Kolegji vë në dukje se e vetmja gjë që dallon në rastet e trafikimit të brendshëm është territori apo vendi ku do të shfrytëzohet viktimë. Përsa i takon elementëve të tjerë, ato janë të pranishëm si në rastin kur viktimë trafikohet brenda apo jashtë vendit, qoftë i rritur apo i mitur.

Në rrethanat e parashtruara, Kolegji vlerëson të gabuar referimin e bërë nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në çështjen konkrete, në konkluzionet e vendimit unifikues nr. 3/2011. Ky konkluzion bazohet në faktin se pas këtij vendimi unifikues, ligjvënësi ka ndryshuar dispozitat e KP, në lidhje me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, konkretisht me ligjin nr. 144/2013, duke parashikuar se trafikimi i personave mund të kryhet si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (ky ligj ka qenë

në fuqi në momentin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda).

Në përfundim, në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim: “*Cili është kuptimi i termit “trafikim” në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe çfarë duhet kuptuar me trafikim të brendshëm?*”, **Kolegji mban këtë qëndrim njësuës:**

Trafikimi i qenieve njerëzore nuk kërkon domosdoshmërisht kalimin e kufijve shtetërorë dhe nuk ka vetëm natyrë transnacionale. Trafikimi i qenieve njerëzore ka si qëllim kryesor shfrytëzimin e viktimës. Veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit të shtetit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elemente: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, e realizuar kjo nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës, etj. Kolegji thekson se në këtë rast nuk gjen zbatim parimi i territorit.

vi. Pyetja e katërt e shtruar për njësim: “Në rast se në kuptimin e termit trafikim, përfshihet edhe trafikimi i brendshëm i personave të rritur apo të mitur, cilat janë dallimet mes veprave penale “Trafikim i personave të rritur” (neni 110/a i K.Penal) dhe “Trafikim i të miturve” (neni 128/b i K.Penal), me veprat penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” (neni 114 i K.Penal) dhe “Keqtrajtimi i të miturit” (neni 124/b i K.Penal)?”

Kolegji, në referim të analizës së elementeve të figurës së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore vlerëson se dallimi mes trafikimit të personit të rritur dhe shfrytëzimit për prostitucion qëndron në vullnetin e viktimës dhe aftësinë e saj për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të kryera. Kolegji vë në dukje se, në këtë rast, duhet trajtuar me kujdes pikërisht elementi i ushtrimit të prostitucionit me vullnet të lirë apo nën kërcënim/me shtrëngim. [...]Dispozitat e këtij Protokoll vendosin një standard minimal, në lidhje me parandalimin, ndëshkimin dhe mbrojtjen e viktimës së trafikimit, fakt ky që nënkupton se asgjë nuk i ndalon shtetet palë që të marrin masa edhe më të rrepta. Ky dallim apo përfshirja e mjeteve për realizimin e trafikimit, si element i domosdoshëm për cilësimin e faktit si trafikim i qenieve njerëzore, është i qëllimshëm për të mos ndikuar në politikat e brendshme të shteteve palë që kanë legalizuar ushtrimin e prostitucionit.

Kolegji thekson se pranimi apo pëlqimi i një personi për të kryer një punë apo shërbim, qoftë edhe ushtrimi i prostitucionit, duhet vlerësuar rast pas rasti, ku me rëndësi është analiza e fakteve të atribuuar të pandehurit. Analiza në këtë rast duhet të fokusohet në mjetet e përdorura për të kryer këtë veprim nga viktimja, duke verifikuar në çdo rast nëse ushtrimi i prostitucionit ka ardhur si rrjedhojë e një mashtrimi, si rrjedhojë e dhunës fizike apo psikike apo si rrjedhojë e veprimeve të tjera shtrënguese të parashikuara shprehimisht në nenin 110/a paragrafi i parë i K.Penal. Mungesa apo në rastin kur nuk provohet ekzistenca e një prej formave shtrënguese/mjetet për realizimin e trafikimit, atëherë Kolegji vlerëson se duhet analizuar vullneti dhe vetëdija e viktimës

për realizimin e veprimit konkret që lidhet me shfrytëzimin për prostitucion.

Me ligjin nr. 144 të vitit 2013, është shfuqizuar neni 114/a i KP që kriminalizonte shfrytëzimin e prostitucionit në rrethana rënduese. Kjo dispozitë kishte sjellë konfuzion në praktikën gjyqësore shqiptare, pasi neni 114/a në thelb parashikonte disa forma të shfrytëzimit që janë pjesë e trafikimit të qenieve njerëzore. Kolegji vlerëson se, dallimi kryesor mes shfrytëzimit të prostitucionit/neni 114 dhe trafikimi i personave të rritur/ neni 110/a, kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/dijenja dhe vullneti i saj i lirë për të ushtruar prostitucion. Problematika shfaqet më komplekse në rastin e trafikimit të të miturve dhe dallimit të kësaj figure vepre penale nga fakti i shfrytëzimit të një të mituri për prostitucion, parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 114 të K.Penal. Kolegji paraprakisht evidenton se, me ligjin nr. 9859, datë 21/01/2008, neni 128/b është ndryshuar, duke u shtuar fjala “shitja”, pas fjalës “rekrutimi”, si një nga format e kryerjes së trafikimit të qenieve njerëzore. Ky ndryshim në përmbajtjen e kësaj dispozite, duke shtuar si një nga format e trafikimit të të miturve edhe shitjen e tyre, erdhi si rezultat i aderimit të Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijës”, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë [...]

Trafikimi i të miturve parashikohet në një dispozitë të veçantë, nga trafikimi i të rriturve, duke parashikuar edhe sanksione më të ashpra. Ligji shqiptar nuk parashikon në mënyrë të shprehur se, “pranimi i një viktime trafikimi të mitur për t’u shfrytëzuar, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm”, por kjo rezulton nga mënyra e formulimit, nga përmbajtja e neni 128/b të K.Penal. Në ndryshim nga trafikimi i personave të rritur, në lidhje e veprën penale “Trafikimi i të miturve” Kolegji çmon se duhen nxjerrë në pah dy konkluzione shumë të rëndësishme, që duhen mbajtur në konsideratë nga prokuroria dhe gjykatat. *Së pari*, në rastin e trafikimit të një të mituri mjetet e përdorura (që janë kërcënimi, përdorimi i forcës apo formave të tjera të shtrengimit, mashtrimi, marrja me forcë, dredhi apo abuzimi me pushtetin ose pozitën vulnerabël, dhënia apo marrja e pagesave ose përfitimeve) për të arritur qëllimin kriminal nuk kanë rëndësi, pra nuk ndikojnë në cilësimin juridik të kësaj vepre penale. E thënë ndryshe, për cilësimin juridik të faktit penal, mjafton të provohet ekzistenca e njëres prej formave të trafikimit (që janë rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturit), si dhe qëllimi për shfrytëzimin e tij. *Së dyti*, vullneti apo pëlqimi i të miturit viktimë e trafikimit, në lidhje me shfrytëzimin e synuar, nuk ka asnjë vlerë, pavarësisht rrethanave apo mënyrës në të cilin ai është shfaqur.

Në rastin e trafikimit të të miturve Kolegji konstaton se ka disa problematika, të cilat kanë ndikuar edhe në përcaktimin e një të mituri si viktimë trafikimi: *së pari*, në ndryshim nga dispozita që parashikon trafikimin e personave të rritur, neni që ndëshkon trafikimin e një të mituri nuk përmend fjalët ‘si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë’ (Neni 128/b i K.Penal, “Trafikimi i të miturve”). *Së dyti*, në ligj ka një dispozitë që ndëshkon në mënyrë të posaçme rastin kur një i mitur shtyhet/ nxitet për të ushtruar prostitucion, ndërnmjetësimi apo marrja e shpërblimit si rrjedhojë e shfrytëzimit të një të mituri për prostitucion, fakte këto që nuk cilësohen si trafikim, por “shfrytëzim prostitucioni” (neni 114, paragrafi i dytë i K.Penal, ‘Shfrytëzimi i

prostitucionit’). *Së treti*, “detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i një të mituri për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik apo arsimimin e tij”, nuk cilësohet si trafikim por keqtrajtim i të miturit (neni 124 paragrafi i dytë i K.Penal, ‘Keqtrajtimi i të miturit’). *Së katërti*, në K.Penal ka një dispozitë që dënon “kërkesën e qëllimshme ndaj një të rrituri apo fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin për të lidhur martesë” (neni 130 paragrafi i dytë i K.Penal, ‘Shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë’), fakt ky që nuk cilësohet si trafikim, edhe pse ky detyrim ushtrohet ndaj një të mituri. Madje në këtë rast, ky veprim/fakt cilësohet nga ligjvënësi si kundërvajtje penale.

Duke u rikthyer tek ushtrimi i prostitucionit nga një i/e mitur, Kolegji vë në dukje se neni 114 në paragrafin e dytë parashikon se, “... kur kjo vepër (shfrytëzimi i prostitucionit) kryhet ndaj një të mituri, dënohet ...”. Neni 114 i K.Penal ka parashikuar si vepër penale shfrytëzimin e prostitucionit në mbrojtje të paprekshmërisë së moralit dhe dinjitetit të njeriut. Në paragrafin e parë të kësaj dispozite janë parashikuar format e kryerjes së kësaj veprë penale: shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij janë parashikuar rrethanat që e bëjnë këtë vepër të cilësuar. Një nga këto rrethana cilësuese është kur kjo vepër penale kryhet ndaj një të mituri. Pavarësisht, parashikimit në ligj si rrethanë cilësuese kryerjen e kësaj veprë penale ndaj një të mituri, Kolegji ka konstatuar se shpeshherë gjykatat e faktit argumentojnë se viktima ndonëse e mitur, me dëshirën dhe vullnetin e saj të lirë ka pranuar të ushtrojë prostitucion për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike e familjare, pa u shtyrë nga askush (*rast ky i trajtuar në vendimin nr. 00-2021-727 (46), datë 21.09.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Kolegji çmon se ky argumentim është jo ligjor. Personat që kanë shfrytëzuar një person/viktimë të mitur për prostitucion apo në çdo formë tjetër shfrytëzimi, kanë përfituar nga gjendja e saj vulnerabël, që vjen për shkak të moshës dhe/apo të gjendjes së vështirë familjare, ekonomike e sociale të saj. Gjendja vulnerabël e të miturit/miturës krijon një situatë të favorshme për rekrutimin me qëllim shfrytëzimin e tij/saj për prostitucion apo forma të tjera shfrytëzimi, përfshi këtu edhe punë e detyruar apo lypjen, nga personat e përfshirë sipas rastit konkret. Dallimi ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 dhe nenit 128/b të K.Penal qëndron në përmbajtjen e tyre: *së pari*, mënyrat/format e realizimit të këtyre dy veprave penale janë të ndryshme; *së dyti*, në rastin e trafikimit të të miturve qëllimi i shfrytëzimit është më i gjerë sesa shfrytëzimi për prostitucion. Por, Kolegji vlerëson se edhe nëse kemi shtytje apo ndërmjetësim apo marrje shpërblimi për shfrytëzimin e një të mituri për prostitucion, fakti duhet trajtuar si trafikimi i të miturit sipas nenit 128/b të K.Penal. Ky konkluzion bazohet në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga vendi ynë, pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe të detyrueshme për të zbatuar nga jurisprudenca shqiptare.

Instrumentet ndërkombëtare përcaktojnë edhe se, “lypja e detyruar” duhet kuptuar si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara, siç përcaktohet në Konventën nr. 29, e vitit 1930, të ONP. Kuptimi i punës së detyruar apo me dhunë jepet në nenin 2 të Konventës nr. 29/1930 të ONP (ILO) [...] Në analizë të përmbajtjes së nenit 128/b të

K.Penal, “Trafikimi i të miturve”, Kolegji vlerëson se subjekti aktiv mund të jetë jo vetëm i përgjithshëm, por edhe një subjekt i posaçëm – personi që ka për detyrë të kujdeset për të miturin. Ky konkluzion gjen mbështetje në parashikimin e “shitjes të të miturit” si një formë e trafikimit të tyre, që është një veprim i cili mund të realizohet edhe nga prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor. Në këtë pikë, Kolegji Penal thekson se, pasojat për të miturin mund të jenë të rënda në të dy rastet, duke dëmtuar zhvillimin fizik e psikologjik të tij. Kolegji vlerëson se edhe neni 124/b paragrafi i dytë në fakt është një formë e trafikimit të të miturve, referuar instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Në këtë vështrim, gjykatat duhet të tregojnë kujdesin e duhur për të arritur në konkluzione të sakta në lidhje me këtë fakt, ku në rastin e trafikimit të të miturit duhen analizuar format e trafikimit dhe qëllimi i shfrytëzimit, elemente që dallojnë nga ato të parashikuar në rastin e keqtrajtimit të të miturit.

Edhe jurisprudenca e GJEDNJ ka cilësuar si trafikim të qenieve njerëzore, e për rrjedhojë brenda veprimit të nenit 4 të Konventës, edhe rastin kur një person shfrytëzohet për punë të detyruar apo dhe lypje, duke i trajtuar si shërbime të detyruara të ngjashme me skllavërinë. GJEDNJ në interpretimin e termit “*punë e detyruar ose me dhunë*”, është bazuar pikërisht tek kuptimi që i është dhënë këtij termi nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP/ILO) në Konventën nr. 29 të vitit 1930. [...] Kolegji vlerëson se, në çdo rast kur identifikohet një fëmijë/i mitur që shfrytëzohet për punë apo për lypje, gjykatat duhet të analizojnë më kujdes rrethanat e faktit, si dhe nëse subjekti aktiv është një i afërm, një person që duhet të kujdeset për të miturin apo një person i tretë. Kur subjekti aktiv është një person që duhet të kujdeset për të miturin, (prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të), gjykatat duhet të mos përjashtojnë se ky fakt mund të përbëjë edhe trafikim, por kjo duhet vlerësuar me shumë kujdes rast pas rasti, duke analizuar të gjitha elementet e veprës penale në fjalë (të analizuar më lart në pyetjen e parë e shtruar për njësim).

Në kuptimin e parashikimeve të Protokollit të Palermos, termi “shfrytëzim” përfshin përdorimin e një fëmije për qëllime përftimi. Në të drejtën ndërkombëtare dhe interpretimet e konventave të OKB dhe të ONP/ILO hasen ende debate dhe paqartësi në lidhje me kategorizimin e punës së palejueshme të fëmijës për lypje, si formë e rëndë e punës së fëmijës apo trafikim. ONP/ILO vë theksin tek elementi i “transferimit” dhe shfrytëzimi nga palë të treta (jo prindërit) për të identifikuar veprën e trafikimit të fëmijës. ONP/ILO sqaron se “trafikimi i fëmijës” kryhet nëpërmjet zhvendosjes dhe pikërisht ky element bën dallimin nëse ndodhemi para “shfrytëzimit të fëmijës për punë” apo “trafikimit të fëmijës”. Sipas ONP/ILO shfrytëzimi i fëmijës nga palë të treta është elementi i dytë thelbësor për klasifikimin e trafikimit. Duke kujtuar përkufizimin e punës së detyruar sipas Konventës nr. 29 të ONP/ILO si “*punë apo shërbim e kryer nga personi si formë dënimi apo për të cilën personi nuk ka ofruar veten vullnetarisht*”, Kolegji rithekson se të provuarit e vullnetit të fëmijës është pothuajse e pamundur, veçanërisht në situatat ku fëmija detyrohet nga vetë prindërit.

Kolegji, në lidhje me rastet e trafikimit të të miturve, vlerëson me rëndësi edhe trajtimin e çështjes V.C.L. dhe A.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar (*shih V.C.L. e*

A.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 77587/12 dhe nr. 74603/12, datë 16.02.2021). [...] (Po aty, çështja V.C.L. e A.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 77587/12 dhe nr. 74603/12, datë 16.02.2021). [...]

Në lidhje me pyetjen e katërt të shtruar për njësim: “Në rast se në kuptimin e termit trafikim, përfshihet edhe trafikimi i brendshëm i personave të rritur apo të mitur, cilat janë dallimet mes veprave penale ”Trafikim i personave të rritur” (neni 110/a i K.Penal) dhe ”Trafikim i të miturve” (neni 128/b i K.Penal), me veprat penale ”Shfrytëzimi i prostitucionit” (neni 114 i K.Penal) dhe ”Keqtrajtimi i të miturit” (neni 124/b i K.Penal)?”, **Kolegji mban këtë qëndrim njëses:**

Dallimi kryesor ndërmjet shfrytëzimit të prostitucionit/neni 114 dhe trafikimit të personave të rritur/neni 110/a, kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/dijenja dhe vullneti i saj i lirë për të ushtruar prostitucion. Dallimi ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 dhe nenit 128/b të K.Penal qëndron në përmbajtjen e tyre: së pari, mënyrat/format e realizimit të këtyre dy veprave penale janë të ndryshme; së dyti, në rastin e trafikimit të të miturve qëllimi i shfrytëzimit është më i gjerë sesa shfrytëzimi për prostitucion. Por, Kolegji vë në dukje se edhe shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për shfrytëzimin e një të mituri për prostitucion duhet cilësuar si trafikim i të miturit, sipas nenit 128/b të K.Penal. Ky konkluzion bazohet në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga Republika e Shqipërisë, pjesë e legjislacionit të brendshëm.

Neni 124/b, paragrafi i dytë, “Keqtrajtimi i të miturit” kriminalizon çdo veprim, me anë të të cilit një i mitur detyrohet për të punuar ose për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij. Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij – janë forma të veprës penale “Trafikimi i të miturve” (në çdo rast kur kryhet nga persona të tretë), por edhe kur kryhen nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të (në këtë rast të fundit, vetëm kur ekzistojnë dhe janë analizuar të gjithë elementet e trafikimit).

vii. Pyetja e pestë e shtruar për njësim është: “Si duhet cilësuar fakti i shtytjes së detyrueshme ose jo për punë apo për lypje të një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, kur ky person nuk është në moshë të mitur? A mund të trajtohet në këtë rast personi me aftësi të kufizuara mendore si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me një të mitur?”

Në radhë të parë, Kolegji thekson se ligji penal material nuk sqaron kuptimin e shprehjeve “punë e detyruar” apo “lypja e detyruar” apo “shërbime të tjera të detyruara”. Kolegji edhe në këtë rast, referon në jurisprudencën e GJEDNJ, duke theksuar se në raste të tilla (puna apo lypja e detyruar), duhet vlerësuar me kujdes kompromisi apo pëlqimi i mundshëm i viktimës për të kryer një punë të tillë. Në këto raste, Kolegji

rithekson se vullneti/pëlqimi i një personi që të vlerësohet i vlefshëm (element ky që përjashton përgjegjësinë e subjektit përsa i takon verifikimit të elementeve të trafikimit të qenieve njerëzore), duhet të jetë i plotë dhe i pandryshueshëm. Kjo do të thotë që ky pëlqim të mos ndryshohet me kalimin e kohës, pra të jetë i qëndrueshëm në të gjitha fazat e kryerjes së punës, e mbi të gjitha se personi që ka pranuar të kryejë një punë të caktuar në kushtet e përcaktuara nga “punëdhënësi”, duhet të jetë në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimeve dhe të pasojave që atij mund t’i vijnë. Element me rëndësi që duhet verifikuar rast pas rasti, është edhe mundësia e punëmarrësit për tu larguar dhe për të mos punuar më në këtë punë, e lidhur kjo me mundësinë e tij për të lëvizur, pa kushte apo kërcënime të çdo natyre.

Në këtë analizë merr rëndësi kuptimi i termit “person vulnerabël”. Kolegji vë në dukje se në legjislacionin shqiptar, kuptimi i shprehjes “person vulnerabël” është parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt”. Ndërkohë, K.Penal referon si një nga mjetet e përdorura për trafikimin e një personi të rritur, përfitimin nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e një personi. Në interpretim të Kolegjit, për të identifikuar gjendjen vulnerabël të një personi, ligjzbatuesit duhet të kenë në konsideratë përkufizimin që neni 3, pika 31 e ligjit për të huajt, jep për termin “persona vulnerabël” - [...] Kjo do të thotë se në çdo rast, gjykatat duhet të analizojnë me kujdes situatën në të cilin ndodhet personi që po shfrytëzohet, arsyet që e kanë nxitur për të ushtruar një punë të caktuar apo për të ushtruar prostitucion (si rasti më i shpeshtë i ndeshur në praktikën gjyqësore), duhet analizuar gjendja dhe mënyra sesi personi që po e shfrytëzon apo që e ka shtyrë viktimën për të ushtruar një aktivitet të caktuar apo të kundraligjshëm, ka rënë në kontakt me viktimën, për të saktësuar pikërisht vullnetin e kësaj viktime, nëse ajo ka qenë e vetëdijshme për të kuptuar pasojat dhe nëse ka qenë e lirë për të vendosur nisur nga rrethanat në të cilat është gjendur. Kolegji vlerëson se kjo analizë është e nevojshme në rastin kur viktimja e trafikimit është person i rritur, por në rastin e viktimës së mitur, kjo analizë nuk kërkohet. Fakti që viktimja është e mitur mjafton për të konkluduar se ai apo ajo nuk ka aftësinë apo zhvillimin e duhur intelektual për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që po kryen dhe aq më pak, për të kuptuar pasojat që mund të vijnë. Është kjo arsyeja që në rastin e trafikimit të një mituri, mjafton të provohet ekzistenca e njëres prej formave apo veprimeve të parashikuara në dispozitë dhe qëllimi i shfrytëzimit të viktimës së mitur.

GJEDNJ në vendimet e saj ka marrë në analizë shprehjen “punë e detyruar ose e detyrueshme” duke referuar tek Konventa e ILO/ONP nr. 29: [...] Me qëllim për të sqaruar nocionin “punë” në kuptimin e nenit 4 § 2 të Konventës, GJEDNJ ka saktësuar se jo çdo punë që i kërkohet një individit nën kërcënimin e një “dënimi” përbën medoemos një “punë të detyruar ose të detyrueshme” të ndaluar nga kjo dispozitë. Duhet të merren parasysh në fakt, veçanërisht, natyra dhe vëllimi i veprimtarisë në fjalë. Këto rrethana japin mundësi që të bëhet dallimi i një “punë të detyruar” nga çfarë u përket punëve që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme në emër të ndihmës së ndërsjellë familjare ose të bashkëjetesës (*Shih çështjen Van der Musselle kundër Belgjikës, datë 23.11.1983; Si dhe çështja C.N. dhe V.K. kundër Francës, aplikimi nr. 67724/09, datë 11.10.2012*).

[...] Ky konkluzion është i rëndësishëm dhe mbështet atë që është theksuar edhe më lart nga Kolegji, asnjë pëlqim nuk ka rëndësi kur ekzistojnë mjetet që kanë ndikuar në vullnetin apo në perceptimin e viktimës së trafikimit (pra mashtrimi, kërcënimi, dhuna fizike apo psikologjike, përfitimi nga pozita shoqërore apo gjendja vulnerabël, e të tjera forma që janë analizuar në pyetjen e parë të shtruar për njësim).

Kolegji duke ritheksuar edhe një herë, rëndësinë që ka në një çështje gjyqësore vlerësimi i dakordësisë apo pëlqimi i mundshëm i viktimës për të kryer një punë të caktuar (përfshirje bën rasti i të miturit), çmon se duhen evidentuar disa elemente të punës apo shërbimit të detyruar. Këto elemente duhen vlerësuar rast pas rasti për të arritur në konkluzionin nëse fakti duhet cilësuar si trafikim i qenieve njerëzore [...] (a) natyra dhe shkalla e mashtrimit apo e shtrëngimit të përdorur për të nxitur një person që të punojë në një punë të caktuar; (b) natyra dhe shkalla e shfrytëzimit të mëvonshëm, pas mbërritjes në vendin e punës; (c) kushtet e vendit të punës, së bashku me metodat dhe mënyrat e kontrollit gjatë punës, me synimin që individët të qëndrojnë të bllokuar brenda vendit të punës apo organizatës/shoqërisë ku punon; (d) niveli dhe shtrirja e të drejtave të individit gjatë punës, gjendja apo pozitat e tyre vulnerabël; (e) shkalla e lëndimeve fizike, psikike ose financiare që pëson një individ gjatë punës së tij; (f) Natyra dhe shtrirja e përfitimeve financiare apo përfitimeve të tjera të punëdhënësit, si dhe numri i personave të shfrytëzuar prej tij.

Kolegji vlerëson se kuptimi që instrumentet ndërkombëtare i japin skllavërisë apo punës së detyruar, mund të shërbejnë si pikënisje për interpretimin e formave të ndryshme të shfrytëzimit edhe të personave me aftësi të kufizuara. Në rastin e një viktime veçanërisht vulnerabël, ligji shqiptar parashikon një dënim më të lartë kur viktima është e gjinisë femërore apo e mitur. Por, ligji penal material shqiptar nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë kur viktima është një person i paaftë/i papërgjegjshëm apo për shkak të gjendjes shëndetësore. Në legjislacionin shqiptar përkufizimin e termit “person vulnerabël”, siç është theksuar më lart, është parashikuar në ligjin për të huajt, ku në kategorinë e personave vulnerabël përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara.

Me ligjin nr. 108/2012, Shqipëria ka ratifikuar edhe Konventën e OKB “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”. [...]Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson se shtytja, përdorimi apo shfrytëzimi për të lypur apo çdo lloj shfrytëzimi tjetër (sipas dispozitave mbi trafikimin e qenieve njerëzore) i një personi me probleme të shëndetit mendor ose/dhe me aftësi të kufizuara, duhet trajtuar si një nga format e trafikimit të qenieve njerëzore, nëse vërtetohen elementet e veprës penale (sipas rastit, trafikim i personave të rritur apo trafikimi i të miturit, në varësi të kriterit moshë). Në rastin e personave me aftësi të kufizuara apo me probleme të shëndetit mendor, shfrytëzuesi përfiton nga gjendja fizike dhe psikike e viktimës në këtë rast, që është një nga mjetet e parashikuara në nenin 110/a të K.Penal (kur personi është i rritur/madhor). Kolegji më lart ka theksuar se, mjafton të provohet njëra nga format/veprimet e kryerjes së veprës penale, mjeti dhe qëllimi i shfrytëzimit, që vepra penale të konsiderohet e kryer. Kolegji vlerëson se gjendja fizike a mendore e një personi, duhet të jetë e tillë që ai nuk është një gjendje apo nuk është i aftë që të kujdeset për veten e tij, e si rrjedhojë e kësaj gjendje

kërkohet prania dhe kujdesi i një personi tjetër. Kjo gjendje bën që personi me aftësi të kufizuar apo me probleme të shëndetit mendor, të jetë në një pozitë të pambrojtur dhe të cenueshëm (vulnerabël). Në interpretim të Kolegjit, shfaqja e vullnetit apo pranimi nga një person me aftësi të kufizuara apo me problem të shëndetit mendor, për të lypur apo për të bërë një punë a shërbim tjetër të detyruar, përsa kohë shfrytëzohet gjendja fizike apo psikike e tij/saj për të arritur këtë pëlqim apo pranim, nuk ndikon në cilësimin e faktit penal si trafikim i qenieve njerëzore. Në lidhje me veprimet apo format e kryerjes së kësaj vepre penale, Kolegji rithekson se mjafton të provohet njëra prej tyre: rekrutimi ose transportimi, ose transferimi ose fshehja ose pritja e personit viktimë të trafikimit, ndaj në këtë drejtim Kolegji vlerëson të gabuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, që ekzistencën e trafikimit të personave të rritur apo të mitur, e lidh me ekzistencën e të gjitha formave të sipërcituara (arsyetimi i gjykatës së apelit në këtë rast lidhet me faktin se, viktimja është motra e të pandehurve, e si rrjedhojë mungon veprimi i rekrutimit, si dhe nuk provohet që viktimës ti jetë hequr apo kufizuar vullneti, duke u detyruar të lypë jashtë vullnetit të saj).

Në lidhje me pyetjen e pestë të shtruar për njësim: *“Si duhet cilësuar fakti i shtytjes së detyrueshme ose jo për punë apo për lypje të një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, kur ky person nuk është në moshë të mitur? A mund të trajtohet në këtë rast personi me aftësi të kufizuara mendore si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me një të mitur?”*, Kolegji mban këtë qëndrim njësuës:

Shtytja, përdorimi apo shfrytëzimi për të lypur i një personi me probleme të shëndetit mendor ose/dhe me aftësi të kufizuara, duhet trajtuar si një nga format e trafikimit të qenieve njerëzore (sipas rastit, trafikim i personave të rritur apo trafikimi i të miturit, në varësi të kriterit moshë). Shfaqja e vullnetit apo pranimi nga një person me aftësi të kufizuara apo me probleme të shëndetit mendor, për të lypur ose për të bërë një punë tjetër të detyruar, përsa kohë shfrytëzohet gjendja fizike apo psikike e tij/saj për të arritur këtë pëlqim apo pranim, nuk ndikon në cilësimin e faktit penal si trafikim i qenieve njerëzore.

Përfundimisht, në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji çmon se rekursi i paraqitur nga prokuroria dhe të gjykuarit përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP dhe si të tillë duhet të pranohen. Kolegji vlerëson se gjykatat kanë bërë një analizë të përciptë të rrethanave të faktit, duke arritur në konkluzione dhe zbatim të gabuar të ligjit penal material. Kjo çështje duhet kthyer për rishqyrtim në gjykatën e apelit, si gjykatë fakti dhe ligji. Kolegji vlerëson se ky kthim diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve dhe provave/akteve të marra në këtë proces penal, të cilat duhen verifikuar në raport me të drejtën/ligjin e zbatueshëm në rastin konkret. Në rigjykimin e çështjes, gjykata e apelit duhet të ketë në konsideratë konkluzionet dhe analizën e Kolegjit në këtë vendim njësuës. Referuar akuzës së atribuuar të gjykuarve, “Trafikimi i personave të rritur”, parashikuar nga neni 110/a i K.Penal, si dhe në referim të neneve 74 dhe 75/a të KPP, kjo çështje aktualisht i përket juridiksionit të përgjithshëm (gjykatave të rrethit gjyqësor), ndaj çështja duhet dërguar për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

